



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E
FINANCAVE DHE EKONOMISË

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

NË

MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

“AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË”

Tetor, 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4-13
	I.a Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
	I.b. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-10
	I.c. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	10-13
II.	HYRJA	14-16
	1. Objekti i auditimit	14
	2. Qëllimi i auditimit	14
	3. Identifikimi i çështjes	14
	4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	14
	5. Përgjegjësitë e audituesve	14-15
	6. Kriteret e vlerësimit	15
	7. Standardet e auditimit	15-16
	8. Metoda e auditimit	16
	9. Dokumentimi i auditimit	16
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	17-
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	17-18
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	18-
2.A	Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm	18-33
2.B	Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Buxhetit	33-167
2.B.1	Mbi procesin e planifikimit në drejtim të përgatitjes së dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe Projekt Buxhetit vjetor 2022, kryerja e analizave dhe dhënia e rekomandimeve për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ndjekja e regjistrimit të kërkesave buxhetore të PBA 2022-2024 të njërive e qeverisjes qendrore, përmes sistemit.	33-49
2.B.2	Vlerësimi i veprimtarisë në drejtim të detajimit të planit buxhetor dhe çeljeve fillestare bazuar në ligjin e buxhetit për vitin 2022. Rishpërndarja e fondeve buxhetore me ndryshimet sipas Akteve Normative.	49-61
2.B.3	Mbi menaxhimin e buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, planifikimi dhe transferimi i transfertës së pakushtëzuar, monitorimi dhe analiza e treguesve të buxhetit vendor.	61-71
2.B.4	Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit. Monitorimi dhe analiza e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, dhënia e rekomandimeve, për të gjithë strukturën programore të çdo ministrie linje/institucion qendror. Raportimi i treguesve fiskalë të realizuar dhe monitorimi i tyre. Vlerësimi i projekteve të investimeve, monitorimi dhe raportimi i tyre me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.	71-133
2.B.5	Mbi auditimin e përputhshmërisë së përdorimit të Fondit Rezervë të Këshillit të Ministrave dhe Fondit të Kontigjencës për vitin 2022.	133-142
2.B.6	Risqet fiskale dhe detyrimet kontigjente. Monitorimi i pagesave për kontratat e koncesioneve/PPP me mbështetje buxhetore. Monitorimi i detyrimeve të prapambetura.	142-167
2.C	Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit.	167-233
2.C.1	Kryerja e Pagesave dhe ndjekja e detajimit të planit buxhetor dhe çeljeve fillestare në SIFQ nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë (SIFQ). Regjistrimi, kontrolli, kontabilizimi dhe përpunimi i informacionit të transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme.	167-192
2.C.2	Saktësia e veprimeve mbyllëse për raportimin në treguesit fiskalë dhe paraqitje në pasqyrat financiare të konsoliduara të shtetit.	192-198
2.C.3	Menaxhimi i likuiditetit të qeverisjes së përgjithshme për sigurimin e nevojave për mjete monetare për kryerjen e pagesave brenda kufijve të limitit të cash-it.	199-205
2.C.4	Mbi rregullshmërinë dhe saktësinë e regjistrimeve në llogarinë “Depozitë e Qeverisë” dhe rakordimi i saj me Bankën e Shqipërisë. Konsolidimi i njësive që operojnë në llogari speciale në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet transfertës nga Llogaria e Unifikuar e Thesarit.	205-229
2.C.5	Menaxhimi i procesit të shpërndarjes së dëmshpërblimit financiar të ish të dënuarve dhe përndjekurit politikë mbi bazë të buxhetit vjetor në dispozicion; Rakordime me MSHMS dhe bankat e nivelit të dytë mbi shpërndarjen dhe përfitimin e dëmshpërblimit financiar.	229-233
2.D	Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik.	233-256
2.D.1	Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e treguesve të borxhit publik. Analiza e qëndrueshmërisë së treguesve dhe vlerësimi i përmbushjes së objektivave të strategjive afatshkurtra dhe afatmesme. Treguesit e Borxhit të Brendshëm. Treguesit e Borxhit të Jashtëm. Shërbimi i borxhit. Garancitë dhe nënhatë	233-250

2.D.2	Auditim mbi saktësinë e paraqitjes së treguesve të borxhit në tabelën fiskale dhe Raportin e Zbatimit të Buxhetit për vitin 2022.	250-256
2.E	Mbi veprimtarinë e Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë	256-298
2.E.1	Mbi hartimin e zbatimin e buxhetit të Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.	256-265
2.E.2	Mbi administrimin e burimeve njerëzore në përputhje me kuadrin rregullator.	265-271
2.E.3	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për punë, mallra dhe shërbime.	271-280
2.E.4	Auditim i llogarive vjetore të institucionit.	280-291
2.E.5	Funksionimi dhe monitorimi i shoqërive aksionare dhe të përbashkëta ku shteti zotëron kapital dhe ndikimi i tyre në buxhetin e shtetit	291-298
2.F	Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik	298-338
2.F.1	Veprimtaria e Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.	298-318
2.F.2	Veprimtaria e Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.	318-338
2.G	Auditimi i çështjeve të tjera të cilat mund të rezultojnë gjatë auditimit	338-358
2.G.1	Mbi vlerësimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë	338-350
2.G.2	Mbi vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë	350-357
2.G.3	Mbi bonot e privatizimit	357-358
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	359-400
V.	ANEKSE	401-428

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

KLSH auditoi përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në funksion të hartimit dhe zbatimit të Buxhetit të Shtetit: detajimin e fondeve buxhetore dhe ndryshimet e planit gjatë vitit buxhetor, ekzekutimin, monitorimin dhe raportimin e transaksioneve me fondet buxhetore. Gjithashtu, u auditua dhe saktësia e raportimit të treguesve fiskalë të buxhetit për vitin 2022, të ardhurat, shpenzimet dhe deficitin buxhetor, treguesit e borxhit publik dhe përputhshmërinë e aktivitetit të Aparatit të MFE.

Nga auditimi rezultuan parregullsi në drejtim të mos respektimit të disiplinës fiskale, konstatuar kjo në të gjitha fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit të buxhetit, që konsistojnë në: rialokime për projektet e investimeve me financim të brendshëm pa respektuar radhën prioritare në buxhetim, keqklasifikimin e investimeve, marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore, problematika në lidhje me procesin e detajimit të fondeve për rindërtimin, detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA, shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve me detyrime të prapambetura, mos regjistrimin e kontratave në SIFQ me pasojë krijimin e detyrimeve të prapambetura, stoku i të cilave vazhdon të mos raportohet në vlerën e saktë dhe mbetet jashtë treguesve të konsoliduar fiskalë.

Për gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit është mbajtur 1 Akt Verifikim dhe 21 Akt Konstatime, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit, brenda afatit të periudhës së auditimit në terren.

Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar observacionet e bëra nga subjekti i audituar, mbi aktet e konstatimit dhe Projektraportin e Auditimit dhe janë marrë në konsideratë observacionet, të cilat janë të gjetur të mbështetura nga ana ligjore, apo është paraqitur dokumentacion argumentues shtesë. Probematikat e evidentuara sipas çështjeve të auditimit gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes. Mbështetur në punën audituese në terren, evidencat e marra të cilat sipas mendimit tonë kanë qenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese, mbështetur në Projektraportin e auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituese përshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar.

I.b. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	<p>Janë konstatuar vonesa në hartimin e dokumenteve të Programit Buxhetor nga institucionet buxhetore. Konkretisht, kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike është miratuar me VKM nr. 15, datë 20.01.2021, në tejkallim të afatit të përcaktuar në nenin 22 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Po kështu, udhëzimi për përgatitjen e PBA është miratuar në tejkallim të afatit të përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe në tejkallim të afatit të përcaktuar në pikën 3.1.8 të Udhëzimit nr. 7 datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm".</p> <p>-Hartimi i politikave fiskale të vitit 2022 dhe miratimi i tyre është bërë në datën 25 nëntor 2021 së bashku me projektbuxhetin e vitit 2022, në kundërshtim me pikën 3, neni 4/1 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar.</p> <p>- Për planifikimin e të ardhurave dhe ndryshimet gjatë vitit, mungon evidenca mbi analizat e plota të realizuara nga MFE, megjithëse nga MFE pretendohet se programimi i të ardhurave për vitin pasardhës</p>	Pika 2.B.1	E lartë	<p>Drejtoria e Analizave dhe Programimit Buxhetor në bashkëpunim me Institucionet Buxhetore të marrin masa për respektimin e afateve të përcaktuara në mënyrë që procesi i përgatitjes së PBA-së të rezultojë koherent dhe efektiv.</p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masat e nevojshme që analizat e të gjitha institucioneve për hartimin e kërkesave buxhetore të kryhen në afat, të lidhen me objektivat dhe qëllimet e politikave të programeve si dhe prioritet të pasqyrohen në kohë, me dokumentet përkatëse sipas fazave që ka parashikuar legjislacioni për planifikimin e buxhetit si dhe të krahasojë kërkesat buxhetore në vitin</p>

	<p>bëhet bazuar në metodologjitë standarde bashkëkohore që bazohet në treguesit kryesorë makroekonomikë që projekton Departamenti i Makroekonomisë dhe Banka e Shqipërisë, etj.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se, MFE me shkresën nr. 15943, datë 21.09.2021 “Mbi rishikimin e prioriteteve buxhetore për periudhën 2022-2024 përputhje me Programin e Qeverisë 2021-2025”, ka njoftuar institucionet për rishikimin e prioriteteve buxhetore. Në kuadër të kësaj shkrese kanë dërguar kërkesa të rishikuara Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, institucione të varësisë së MFE, si AIDA, DPPP dhe DPD. Ndryshimi i prioriteteve buxhetore pas përfundimit të fazës së dytë të PBA-së nuk gjen mbështetje ligjore dhe është në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 7, datë 13.01.2021 “Për miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal”, i cili nuk ka rishikim të mëvonshëm.</p> <p>Nga auditimi mbi kryerjen e analizave të PBA 2022-2024 dhe dhënien e rekomandimeve, për njësitë e qeverisjes së përgjithshme u konstatua se referuar analizës dhe komenteve të bëra nga MFE për fazën e parë dhe të dytë të PBA 2022-2024 kanë rezultuar mangësi që përfshijnë:</p> <p>a) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka paraqitur kërkesa buxhetore shtesë në tejkallim edhe të vetë planifikimit të fazës së parë. Gjithashtu kërkesat buxhetore të fazës së dytë rezultojnë në tejkallim të tavanit të miratuar me VKM nr. 440, datë 22.07.2021, si dhe nuk ka prioritarizuar këto kërkesa nga ajo më e domosdoshme dhe më emergjente. Për programet “Mbështetje për Energjinë” dhe “Menaxhimi i mbetjeve urbane” kërkesat buxhetore në fazën strategjike janë dorëzuar në tejkallim të afatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, si dhe afatit të vendosur në kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike.</p> <p>Me shkresën nr. 6894/1 prot., datë 01.10.2021, MIE ka dërguar në MFE jashtë afatit kërkesat buxhetore për fazën teknike, pas rishikimit të prioriteteve buxhetore për programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, referuar dhe shkresës së rishikimit të prioriteteve.</p> <p>b) Për fazën e parë të PBA-së 2022-2024 MFE ka paraqitur kërkesa buxhetore në tejkallim të tavanit të miratuar me VKM nr. 119, datë 03.03.2021, problematikë e cila nuk është reflektuar në analizën e kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjithashtu, evidentohen programe për të cilat kërkesat buxhetore janë dërguar jashtë afatit të përcaktuar në udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021.</p> <p>Për fazën e parë të PBA, MFE ka paraqitur kërkesa buxhetore në tejkallim të tavanit të miratuar me VKM nr. 119, datë 03.03.2021, ndërsa për programet 01120, 01130, 04130 nuk është dorëzuar dokumentacion shoqërues që përfshin formatin nr. 3 për politikën e reja, pasqyrat shtesë si dhe relacionin shpjegues sipas rastit, sipas udhëzimit plotësues nr. 19, datë 09.07.2021.</p> <p>c) Nga auditimi konstatohet se në kërkesat buxhetore të paraqitura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në fazën e parë evidentohet se për disa programe, projektet e planifikuara nuk janë të lidhura me qëllimin e politikës.</p> <p>Nga auditimi evidentohen mospërputhje ndërmjet kërkesave shtesë të disa programeve të MFE dhe MIE, sipas relacioneve të dokumentuara dhe të vëna në dispozicion në format fizik, me të dhënat sipas Aneksit 4 “Kërkesat shtesë 2022-2024”, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të MFE. Mungon një evidencë e dokumentuar mbi analizën e kërkesave buxhetore shtesë bërë nga strukturat përkatëse të MFE dhe listimin e tyre sipas prioriteteve më emergjente dhe rekomandimet e përcjella prej tyre në strukturën përkatëse në Kryeministri për koordinimin e strategjive, si dhe korrespondenca me këtë strukturë.</p> <p>Nga analizat e MFE rezultojnë se për disa programe ka ndryshim të theksuar të kostos për njësi gjatë viteve, mungon sasia e produktit; fragmentim të theksuar të produkteve të investimeve, si dhe nuk janë plotësuar vlerat e kostos së plotë të projektit.</p> <p>Kërkesat nga institucionet nuk janë të mirë argumentuara, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktet konkrete të projekteve dhe programeve, mungon një analizë e detajuar prioritarizimi, duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara.</p> <p>Konstatohet se, për 29 projekte ka diferenca të fondeve të parashikuara nga PBA 2021-2023 në PBA 2022-2024, që tregon për një parashikim të dobët, duke zbehur vlerën e parashikimeve afatmesme për shpenzimet e buxhetit të shtetit, me qëllim ruajtjen e taveve të miratuara dhe alokimit të fondeve për projekte të reja, ndërsa për 16 raste, projektet e investimit miratohen fillimisht në PBA 2021-2023 si projekte të reja me vlerë të ulët, duke ruajtur tavanet e miratuara dhe më pas rriten në PBA 2022-2024 me vlera të konsiderueshme.</p>			<p>aktual edhe me kërkesat buxhetore të PBA-ve të viteve të kaluara duke rakorduar ecurinë e investimeve kapitale.</p>
2	Nga auditimi u konstatuan diferenca në të dhënat e raportuara në	Pika 2.B.2	E lartë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë

	<p>treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar sipas Tabelës nr. 4 të Ligjit të Buxhetit me të dhënat e planit fillestar të vitit 2022 të sistemit SIFQ, konkretisht në zërat e shpenzimeve dhe deficitit. Raportet e ndërtuara dhe ofruara nga SIFQ për qëllime të planifikimit buxhetor nuk përdoren nga DPB si një mënyrë për të kontrolluar saktësinë e detajimit të buxhetit fillestar dhe më pas atij operativ.</p> <p>Konstatohet se propozimet e bëra dhe miratimet e ndryshimit të ligjit të buxhetit vjetor me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 dhe Aktin Normativ nr. 19, datë 29.12.2022 janë në tejkalim të afatit të rishpërndarjeve buxhetore, data 15 nëntor, përcaktuar në nenin 48 “Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore”. Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues të këtyre akteve normative konstatohet se mungon një analizë e detajuar për ndryshimet mes zërave të shpenzimeve buxhetore, korrente e kapitale, me synimin e optimizimit të realizimit të tyre për pjesën e mbetur të vitit 2022, pasi relacionet përmbajnë vetëm një përmbledhje të destinacionit të fondeve.</p> <p>Pas aktit të fundit normativ nr. 19, datë 29.12.2022 janë bërë reflektime/ndryshime në zërat e shpenzimeve korrente në tabelën 4 shoqëruese të tij, duke pasqyruar një kolonë të emërtuar “Plani me ndryshime 2022 (shpërndarje rezervash)”. Nga analiza konstatohet se ndryshimet e vlerave rrjedhin prej faktorëve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Efekti i VKM-ve për përdorimin e Fondit Rezervë përgjatë vitit, të cilat nuk pasqyrohen në aktet e fundit të përditësuara ligjore për buxhetin e vitit, në total rreth 20 miliard lekë. -Efekti i shkurtimeve dhe rritjes së fondeve në zëra të tjerë ku përmendim, uljen e fondeve të shpenzimeve të personelit me 1,062 milion lekë, 1,080 milion lekë ulje të fondeve për politika të reja pagash, 600 milion lekë për shpenzimet e interesit të borxhit të huaj, 6,800 milion lekë për politika të reja pensionesh dhe bonusin e pensionistëve, 1,800 milion lekë për shpenzime për kompensim pronarësh. <p>Këto ulje i kanë dhënë efektet në rritjen e kufirit të shpenzimeve në plan përtej atyre të pasqyruara në tabelën shoqëruese të aktit normativ nr. 19, datë 29.12.2022, kryesisht në 6,509 milion lekë në shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 11,946 në shpenzime për fonde speciale (sigurime shoqërore), 2,059 milion lekë për ndihmën ekonomike dhe 900 milion lekë për bonusin e lindjeve. Nga auditimi konstatohet se ulja e shpenzimeve të ndryshme nga Fondi Rezervë dhe ai i Kontigjencës nuk ndjek parimet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe shumat e shpërndara sipas tabelë nr 4 të Aktit normativ nr. 19, datë 29.12.2022, i cili, megjithëse në tejkalim të afateve për kryerjen e rishpërndarjeve të buxhetit dhe vetëm 2 ditë nga e drejta për të kryer shpenzimeve me mbylljen e vitit buxhetor është objekt i ndryshimeve të brendshme nga Ministria e Financave. Një veprim i tillë i MFE, para së gjithash është ndryshim i planit të shpenzimeve buxhetore pas miratimit të buxhetit të rishikuar në kuvend, dhe në të njëjtën kohë e bën komplekse shqyrtimin dhe analizën e ecurisë së treguesve, duke e shndërruar atë në një veprim për të rregulluar përqindjet e realizimit të disa prej treguesve të shpenzimeve. Kjo, pasi gjatë auditimit është konstatuar rritje e kufirit të shpenzimeve si pasojë e këtyre ndryshimeve edhe të zërave që normalisht duhet të kishin kaluar nëpërmjet procedurës së shqyrtimit parlamentar për marrjen e konfirmimit për rritje, si bonusi i lindjes rritur me 900 milion lekë, kjo pasi ndryshimet buxhetore duhet të ndjekin të njëjtën procedurë, procedura normale për miratimin e buxhetit ose votohet me procedurë të përshpejtuar.</p>			<p>të marrë masa për pasqyrimin e saktë të tabelës 4 shoqëruese të ligjit të buxhetit vjetor në sistemin informatik financiar të qeverisë, me qëllim eliminimin e diferencave ligj-sistem. Titullari i institucionit dhe nëpunësi i parë autorizues të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë e veprimeve të kryera pas aktit normativ nr. 19, datë 29.12.2022 si dhe të evidentojnë efektet në treguesit fiskal.</p>
3	<p>Fondi i rindërtimit me ligjin fillestar të buxhetit është planifikuar në shumën 20,000 milion lekë, ndërsa me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022, ky fond është planifikuar në shumën 32,400 milion lekë, duke u rritur për vlerën 12,400 milion lekë. Sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi, rezulton se fondi i rindërtimit është realizuar në shumën 28,874 milion lekë, nga të cilat, shpenzimet për qeverisjen qendrore janë realizuar në shumën 7,969 milion lekë për shpenzime kapitale, ndërsa shpenzimet e qeverisjes vendore janë realizuar në shumën 20,905 milion lekë.</p> <p>Referuar VKM-vë të dala për rindërtimin, gjatë periudhës 2020-2022 janë miratuar rreth 119,833 milion lekë projekte rindërtimi për qeverisjen qendrore dhe vendore, nga të cilat financimi me VKM për vitin 2020 ka qenë rreth 25,795 milion lekë, për vitin 2021 rreth 28,770 milion lekë dhe për vitin 2022 rreth 22,027 milion lekë, ndërsa realizimi për vitin 2020 ka qenë rreth 16,702 milion lekë, për vitin 2021 rreth 29,521 milion lekë dhe për vitin 2022 rreth 28,874 milion lekë. Bazuar në të dhënat e mësipërme, në qoftë se vlera totale e kostos së projekteve nuk ndryshon me VKM gjatë periudhave në vijim, me</p>	Pika 2.B.4	E lartë	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për reflektimin në vitet pasardhëse buxhetore në tabelën nr. 4 shoqëruese e ligjit vjetor të buxhetit, të efekteve të krijuara nga shpërndarja e fondeve të rindërtimit me VKM dhe në komponentët e treguesve fiskal, me qëllim programimin brenda limiteve buxhetore të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit, shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe financimin në kohën e duhur për të ulur kostot e pagesave për zërin shpenzime qiraje.</p>

	<p>qëllim përfundimin e procesit të rindërtimit, financimi i pritshëm për periudhat e ardhshme (viti 2023 e në vijim) është rreth 44,736 milion lekë. Konstatohet se, në ligjin nr. 85/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, fondet për rindërtimin janë planifikuar në shumën 5,000 milion lekë, ndërsa në tabelën 4 “Treguesit Fiskal të konsoliduar”, bashkëlidhur po këtij ligji, vlera e planifikuar për fondin e rindërtimit për vitet 2024 dhe 2025 është 0 lekë. Rezulton se, kosto totale e projekteve nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së planifikuar me ligjin e buxhetit për fondet e rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani vijon të paraqitet në shumën 0 lekë për vitet 2024 dhe 2025.</p> <p>Në lidhje me shpenzimet e strehimit për familjet, shtëpitë e të cilave janë dëmtuar nga tërmeti rezulton se në fillim të vitit për produktin me kod 91010AE “Subvencionim i qirasë për familjet e prekura”, janë çelur fonde në vlerën 1,000 milion lekë. Më pas, me Aktin Normativ nr. 12, datë 29.07.2022, këtij produkti i janë shtuar fonde në vlerën 1,698.06 milion lekë, duke e çuar në total vlerën e planifikuar për këtë produkt 2,698.06 milion lekë. Sipas bazës së të dhënave, rezulton se gjatë vitit 2022, janë subvencionuar 2,208 milion lekë nga fondet e buxhetit të shtetit, pra shpenzimet e kryera për subvencionet e qirave kanë luhajtur të konsiderueshme në vlera sipas muajve, ku në muajin Dhjetor janë kryer 335.1 milion lekë subvencione, në muajin Korrik janë kryer 29.2 milion lekë subvencione, ndërsa në muajin Janar, vetëm 2 bashki kanë kryer pagesa për subvencionime, bashkia Tiranë dhe bashkia Kurbin.</p> <p>Në krahasim me vitin 2021, shpenzimet për subvencionimin e qirave janë ulur për vlerën 776 milion lekë, megjithatë, për shkak të ecurisë së ngadaltë në zbatimin e punimeve dhe tejkalimit të afatit të përmbylljes së procesit të rindërtimit, kostot totale të rindërtimit rëndohen edhe më tepër nga pagesat për subvencionimin e qirave të familjeve banesat e të cilëve i kanë në proces rikonstruksioni.</p>			
4	<p>Nga auditimi mbi planifikimin, realizimin dhe raportimin e investimeve kapitale me financim të brendshëm konstatohet se:</p> <p>-raportohet si investim, projekti me kod M062991 i Autoritetit Rrugor Shqiptar me përshkrim “Vendime gjyqësore në proces” me vlerë për 180,000 mijë lekë. Për planifikimin dhe realizimin e këtyre shpenzimeve duhet të ishin përdorur llogaritë e shpenzimeve operative. Nga auditimi konstatohet se, vlera për 32,085 mijë lekë, përfaqëson detyrime të prapambetura të periudhave të mëparshme duke filluar nga viti 2016.</p> <p>-Në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në programin buxhetor 6210 “Programe zhvillimi” raportohet si investim i realizuar kosto lokale e menaxhimit të projekteve të investimit në shumën 883,196 mijë lekë, me kod projekti M56032 “Projekti i rrugëve dytësore dhe lokale”, , ndërkohë që këto fonde përdoren në llogari bankare të nivelit të dytë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për aktivitetin e shpenzimeve korente të institucionit.</p> <p>- në programin 4250 “Zhvillimi rural” në AZHBR konstatohet se janë raportuar investime kapitale me kod projekt 18AL301 “Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 1” në shumën 591,615 mijë lekë, kapitulli 3 “kosto lokale”. Këto pagesa kryhen në kuadër të bashkëfinancimit të fondeve të BE për mbështetjen e fermerëve/agroturizimit në kryerjen e investimeve nga ana e investitorëve. Pjesa e buxhetit të shtetit në kuadër të bashkëfinancimit është në masën 25%, ndërkohë që konstatohet se për nga natyra, nuk kemi të bëjmë me investim kapital, por me grant të dhënë të tretëve. Në këtë mënyrë, treguesit e investimeve publike janë të mbivlerësuar.</p>	Pika 2.B.4	E lartë	<p>Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së diskutimit të kërkesave buxhetore dhe në vijim të detajimit të fondeve sipas kërkesave të institucioneve buxhetore të zhvillohet një analizë mbi natyrën ekonomike të fondeve të kërkuara me qëllim klasifikimin dhe raportimin e drejtë të shpenzimeve sipas natyrës dhe destinacionit për rastet e mësipërme dhe të tjera.</p>
5	<p>Nga auditimi i investimeve me financim të brendshëm u konstatua se për 67 projekte në vazhdim nga vitet e mëparshme, fondet nuk janë çelur në fillim të vitit, por janë çelur kryesisht gjatë muajit Mars dhe Korrik, në kundërshtim me pikën 63 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.</p> <p>Gjithashtu, nga auditimi i investimeve kapitale me financim të brendshëm janë evidentuar problematika në drejtimit të detajimit të investimeve pa kaluar ciklin e menaxhimit të investimeve publike, marrjes së angazhimeve nëpërmjet kontraktimit të fondeve publike të pa miratuara në momentin e nënshkrimit të kontratave nga nëpunësit autorizues, detajimit të fondeve të investimeve vetëm për 20% të vlerës dhe pa pasur fonde të miratuara për periudhën e mbetur sipas vlerës dhe kohëzgjatjes totale të projektit, etj, konkretisht:</p> <p>Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për programin buxhetor 04520 “Transportin rrugor” janë audituar 14 projekte investimi, ku është konstatuar se: 3 projekte nuk kanë qenë pjesë e PBA-së; 11 projekte nuk kanë qenë pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet; 6 kontrata janë regjistruar jashtë afatit</p>	Pika 2.B.4	E lartë	<p>Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa me qëllim shmangien e shtyrjes së planit buxhetor përtej periudhës së parashikuar për kohëzgjatjen e kontratave; të merren masa për regjistrimin në kohë të fondeve të obliguara në SIFQ, të shmangjet detajimi i projekteve të reja të investimit publik me akte normative gjatë si dhe në përfundim të vitit buxhetor, të cilat nuk krijojnë mundësinë e përdorimit të buxhetit prej 20% të kërkuar në vitin e parë të zbatimit të tij shoqëruar me kryerjen e inspektimeve dhe marrjen e masave administrative përkatëse.</p>

	<p>kohor; për 9 projekte kontratat e lidhura janë 6,153,761 mijë lekë më shumë se vlera e tyre e planifikuar në PBA; për 4 projekte shumëvjeçare rezultojn se alokimi prej 20% i fondeve është bërë për qëllim të lidhjes së kontratës duke qenë se pak ditë më vonë këtyre projekteve u janë hequr fonde; për 7 projekte janë marrë angazhime pa pasur fonde në dispozicion në shumën 2,461,488 mijë lekë.</p> <p>Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për programin buxhetor 06730 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, janë audituar 2 projekte investimi, ku është konstatuar se: 1 projekt nuk ka qenë pjesë e PBA-së dhe pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet; për 1 projekt regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit; për 1 projekt është marr angazhim pa fond buxhetor në vlerën 17,386 mijë lekë; për 1 projekt është paguar me vlerë 102,600 mijë lekë, ose 19.3% e vlerës së kontratës, 16 ditë pas lidhjes së saj.</p> <p>Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është audituar 1 projekt, ku është konstatuar se: projekti nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet; kontratat e lidhur është 81,430 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti të planifikuar në PBA; regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit; është marr angazhim pa fonde buxhetore në vlerën 119,048 mijë lekë.</p> <p>Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është audituar 1 projekt, ku është konstatuar: për 1 kod projekti janë zhvilluar 2 procedura prokurimi; të dy kontratat janë regjistruar jashtë afatit; është marr angazhim pa fond buxhetor në vlerën 63,320 mijë lekë.</p> <p>Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë janë audituar 4 projekte, ku është konstatuar se: për 1 projekt vlera e kontratës është 26,530 mijë lekë më shumë se vlera e planifikuar në PBA; për 2 projekte edhe pse kontrata është nënshkruar me afat zbatimi 26 javë fondet janë parashikuara të shtrira për 3 vite buxhetore; për 2 projekte regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit, për 4 projekte janë marrë angazhime pa fonde buxhetore në vlerën 249,496 mijë lekë;</p> <p>Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit janë audituar 6 projekte ku është konstatuar se: për 6 projekte kontratat janë regjistruar jashtë afatit; për 6 projekte janë marrë angazhime pa fonde buxhetore në vlerën 644,231 mijë lekë.</p> <p>Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit janë audituar 8 projekte, ku është konstatuar se: për 3 kode projekti janë zhvilluar 7 procedura të ndryshme prokurimi; 8 kontrata janë regjistruar jashtë afatit; për 8 projekte janë marrë angazhime pa fonde buxhetore në vlerën 2,060,892 mijë lekë.</p>			
6	<p>Nga auditimi konstatohet se, me ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” është planifikuar vlera 500 milion lekë për projektin për fëmijët dhe rininë me burim Fondin Rezervë, në kundërshtim me nenin 5 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi Fondi Rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit, dhe projekti për fëmijët dhe rininë është plotësisht i parashikueshëm dhe i mundshëm për t’u programuar më parë, duke sjellë për pasojë denatyrimit të fondit rezervë në planifikim.</p> <p>-Nga auditimi u konstatua se, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 5, kreu II i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Fondi Rezervë i miratuar me Aktet Normative nr. 12, datë 29.07.2022 dhe nr. 19, datë 29.12.2022 ka tejkaluar kufirin e miratuar, përkatësisht përllogaritet në 3.065% dhe 3.84% të totalit të shpenzimeve të miratuara.</p> <p>-Për vitin 2022, Fondi Rezerve të Buxhetit të Shtetit, në 5 raste, në shumën 1,491 milion lekë është përdorur në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit dhe udhëzimin standard për zbatimin e tij, ndërsa në dokumentacionin shoqëruar janë konstatuar mangësi.</p>	Pika 2.B.5	E lartë	MFE të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësiave për përdorimin e fondit rezervë për rastet që duhet të përfshihen në ciklin normal të shpenzimeve referuar kriterit të parashikueshmërisë dhe dhënien e mendimit të MFE në kushtet e mungesës së dokumentacionit shoqëruar të projekt akteve. Në të njëjtën kohë, plotësimi i praktikave të përdorimit të fondit rezervë të jetë objekt i verifikueshmërisë së dokumentacionit të plotë për të vlerësuar kriteret e përdorimit dhe arkivimin e tij.
7	<p>Nga testimet e KLSH-së në lidhje me detyrimet e prapambetura për vitin 2022, konstatohet se ky raportim rezultojn jo i plotë dhe i saktë pasi konstatohet se: 502 Institucione nga 1031, rezultojnë me diferenca në raportim, konkretisht: 104 institucione kanë raportuar pagesa më të mëdha sesa pagesat faktike; 110 institucione kanë raportuar pagesa më të vogla sesa pagesat faktike; 251 institucione nuk rezultojnë në databazën e raportimeve për detyrime të prapambetura për vitin 2022, ndërkohë që nga Thesari për këto institucione/njësi rezultojnë pagesa; 37 institucione rezultojnë në databazën e raportimeve për detyrime të prapambetura për vitin 2022, ndërkohë që nga Thesari për këto institucione/njësi nuk rezultojnë pagesa.</p> <p>Si rrjedhojë, pagesat për faturat dhe detyrime të tjera rezultojnë 9,828,089 mijë lekë më shumë se pagesat e raportuara, vlerë e cila nënkupton fatura të prapambetura të padeklaruara më parë nëpërmjet skemës së parashikuar në Udhëzimin nr. 5, datë 27.02.2014 “Për</p>	Pika 2.B.6	E lartë	MFE të parashikojë procedura shtesë kontrolli për të monitoruar raportimin aktual të detyrimeve të prapambetura, me qëllim shmangien e diferencave midis vlerës së raportuar të detyrimeve me vlerën e detyrimit të njohur në pasqyrat financiare si dhe diferencat midis detyrimit të njohur në pasqyrat financiare dhe detyrimit real të prapambetur, kryesisht fokusuar në detyrimet e prapambetura të investimeve dhe vendimeve gjyqësore si zërat me risk më të lartë. <p>-NPA dhe strukturat përgjegjëse pranë MFE të marrin masat për kryerjen e</p>

	<p><i>shlyerjen e detyrimeve të prapambetura</i>”, procedurë që do të rriste balancën e vitit 2022 , me rreth 9,8 miliard lekë. Nisur nga problematikat e konstatuara, rezultojnë se procesi i raportimit të detyrimeve të prapambetura nuk ka pasur monitorim të plotë dhe mosekzekutimi në kohë i detyrimeve të prapambetura paraqet një risk të shtuar për të ardhmen, duke qenë se krijon kushte potenciale për pretendime mbi interesa dhe penalitete mbi vonesën në ekzekutim, sipas të drejtave dhe detyrimeve të palëve, të përcaktuara në kontratë.</p>			<p>sondazheve periodike tek ministrinë e linjës duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi, nëse ekzistojnë detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme, që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra përtej fondeve në dispozicion.</p>
8	<p>Nga auditimi rezultojnë se detyrimet faktike dhe kontigjente për vendimet e GJEDNJ paraqiten në vlerën gjithsej 21,717,665 milion Euro, për 7 vendime. Konstatohet se 3 vendime, konkretisht: <i>D.. kundër Shqipërisë, R. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, Sh. kundër Shqipërisë</i> që i përkasin viteve 2015, 2016 dhe 2018, rezultojnë ende të palikuiduara, në kundërshtim me nenin 19/4 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.</p> <p>Rezultojnë se MFE për çështjen “<i>Sh. kundër Shqipërisë</i>” me shkresën nr. 2554/I prot., citon se detyrimi nuk mund të përballohet nga buxheti i shtetit dhe sugjeron pagesë me këste, duke mbajtur një qëndrim bllokues. Ndërsa sipas për çështjen “<i>R. dhe të tjerë kundër Shqipërisë</i>” MFE nuk ka kaluar fonde në një llogari të ngurtësuar, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 19/5 të Ligjit nr. 10, datë 13.11.2008 “Për avokaturën e shtetit”, i ndryshuar.</p> <p>Sipas llogaritjeve të bëra nga KLSH, deri më datë 31.12.2022, kamatëvonesat që rëndojnë buxhetin e shtetit për mosekzekutimin e 3 vendimeve të GJEDNJ-së rezultojnë në vlerën 2,840,740 Euro.</p> <p>-Nga auditimi mbi Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit rezultojnë se në raportin “<i>Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022</i>” vlera totale e kostove të vendimeve të arbitrazhit të paguara nga buxheti i shtetit raportohet në shumë 940.25 milion lekë. Ndërkohë nga mbledhja e pagesave analitike të raportuara po në këtë raport rezultojnë se kjo vlerë është 1,004 milionë lekë, duke reflektuar mospërputhje raportimesh brenda këtij raporti.</p> <p>Gjithashtu konstatohet se vlera e raportuar e kostove të arbitrazhit të paguara nga aparati i MFE në raportin e mësipërm është rreth 193 milion lekë. Ndërsa sipas të dhënave të sistemit ORACLE këto pagesa rezultojnë në vlerën 291 milion lekë, ose 98 milion lekë më tepër.</p> <p>Detyrimet e GJEDNJ-së dhe Arbitrazhit, si dhe mosekzekutimi i tyre në kohë, paraqesin një risk fiskal, jo vetëm për treguesit buxhetor të institucioneve përgjegjëse por edhe në nivel makroekonomik për financat publike, pasi pavarësisht se këto detyrime nuk llogariten dhe nuk regjistrohen në treguesit e borxhit publik, e implikojnë dhe e nënvlerësojnë këtë të fundit, pasi janë detyrime që do të shlyhen në të ardhmen.</p>	Pika 2.B.6	E lartë	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për:</p> <p>-Analizimin e të gjitha vendimeve të formës së prerë në pritje për ekzekutim dhe nxjerrjen e përgjegjësi për strukturat përkatëse që me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë shkaktuar rritjen e penaliteteve dhe risqeve fiskale.</p> <p>-Ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së brenda afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore me qëllim uljen e riskut të akumulimit të kamatëvonesave si dhe minimizimin e kostove si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimit gjyqësor.</p>
9	<p>Për vitin 2022 gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është në shumën 19,654 milion lekë nga 17,414 milion lekë në vitin 2021, me një rritje vjetore prej 2,239 milion lekë. Garancitë shtetërore përgjatë vitit 2022 paraqesin një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre dhe situatës së rënduar financiare të cilën kalon kryesisht sektori energjetik. Detyrimet si pasojë e pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022 janë akumuluar në masën më të madhe nga kompanitë private me kapital shtetëror përfituese në sektorin energjetik në shumën 1,941 milion lekë. Gjatë vitit 2022 konstatohet se Buxheti i Shtetit ka kryer pagesa si pasojë e paaftësisë paguese edhe të Radio Televizionit Shqiptar, duke rritur stokun e detyrimeve me 255 milion lekë. Gjithashtu edhe në sektorin e ujësjellësve për projektet në Ujësjellës Kanalizime Tirana situata paraqitet problematike duke vendosur Buxhetin e Shtetit në risk për kryerjen e pagesave që kanë dështuar të kryhen nga ky përfitues i garancisë dhe rritjen e detyrimeve në shumën 27 milion lekë.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për aq kohë sa stoku i detyrimeve jo vetëm që nuk është ulur përgjatë vitit 2022, por është rritur me 2,239 milion lekë.</p>	Pika 2.D	E lartë	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ushtrojë të gjitha mjetet ligjore për arkëtimin e të drejtave për pagesa të kryera për garancitë e arkëtuara dhe në të njëjtën kohë të ushtrojë kontroll mbi planet ekonomike dhe financiare për shlyerjen e këtyre shumave.</p>
10	<p>Konstatohen 9,349 transaksione pagesash për vitin 2022 në shumën totale 16,809 milionë lekë të cilat i përkasin faturave me datë të viteve buxhetore të mëparshme;</p> <p>- konstatohen parregullsi të lejuara për procesim nga sistemi i thesari, konkretisht: 102 raste të urdhër prokurimeve të regjistruara në sistem në vitin buxhetor 2022 të cilat lidhen me një kontratë të nënshkruar në vitet e mëparshme buxhetore, 52 raste në të cilat urdhër prokurimet rezultojnë të jenë regjistruar 0-10 ditë diferencë nga data e kontratës,</p>	Pika 2.C	E lartë	<p>Nga ana e Ministrisë së Financave të merren masa për raportimin e efekteve të investimeve/shpenzimeve të cilat nuk i përkasin vitit buxhetor në raportimin e të dhënave të realizimit të buxhetit për vitin 2022 dhe në të njëjtën kohë të shmangët praktika e krijimit dhe shlyerjes së detyrimeve</p>

	<p>etj.</p> <p>- Në 10,602 raste në vlerën 116,288 milionë lekë ose 61% e kontratave që lidhen me vitin 2022, nuk është respektuar afati 3-ditor për regjistrimin e kontratave në modulën e kontratave në SIFQ, nga data e nënshkrimit të tyre, si dhe konstatohet mos regjistrim në SIFQ i planit të pagesave të kontratës e kushtëzuar nga mosdetajimi i planit buxhetor për projekte të investimeve;</p> <p>- Problematika mbi detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore përgjatë vitit për mbulimin e detyrimeve të prapambetura mbartur nga vitet e kaluara në vlerën 3.8 miliardë lekë, ku vlera e fondeve të detajuara përputhet plotësisht me vlerën e pagesave të kryera;</p> <p>- Konstatohen 27,311 fatura në total me vlerë 52,579 milion lekë të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor;</p> <p>- Përgjatë vitit 2022 gjendja e likuiditeteve ka rezultuar e lartë, ndërmjet intervalit 60-100 miliardë lekë. Pjesa më e madhe e tepriceve është akumuluar gjatë vitit në TSA në Euro, duke mos administruar si duhet mjetet monetare së bashku me konvertimin e panevojshëm të valutave të cilat kanë sjellë shpenzime të pa nevojshme.</p>			<p>financiare të viteve të kaluara duke shpërndarë vlerën e duhur buxhetore sipas detyrimit financiar të ligjshëm të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të investigohen pagesat e kryera për detyrime financiare të viteve të kaluara për ligjshmëri dhe angazhimeve buxhetore sipas fondeve të miratuara në momentin e ndërmarrjes së këtyre angazhimeve nga nëpunësit autorizues dhe miratimin e dhënë nga strukturat përgjegjëse për planin buxhetor në MFE.</p>
11	<p>Referuar analizës së sistemit sipas pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit bazuar në vetëvlerësimin e njësive publike, evidentohet një ulje e efektivitetit për 2 parime krahasimisht me vitin 2021, dhe për më tepër asnjë prej elementëve nuk paraqitet në përmirësim nga viti i kaluar. Për vitin 2022, referuar analizës së DH/MFKK, 30 Njësi të Qeverisjes së Përgjithshme (nga 152 gjithsej) kanë pësuar rënie në vlerësim krahasuar me vitin 2021.</p>	Pika 2.F	E lartë	<p>Titullari i Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit të marrë masa për përfshirjen në Raportin Vjetor të vlerësimeve/monitorimeve që reflektojnë gjendjen e sistemit për vitin përkatës për të cilën hartohet Raporti Vjetor.</p>
12	<p>Nga auditimi konstatohet se SH.A “Korporata e Investimeve Shqiptare” Tiranë, me kapital të regjistruar 100% shtetëror në vlerën 2,178,529,064 lekë, referuar pasqyrave financiare të dorëzuara, për vitin 2021 ka rezultuar me humbje në vlerën 19,465,000 lekë. Për vitin 2022 kjo shoqëri deri në momentin e auditimit nuk ka paraqitur pasqyrat financiare, por konstatohet se është financuar nga buxheti i shtetit për vitet 2021 – 2022. Nga auditimi konstatohet se, për të gjithë këtë vendimmarrje të Aksionarit, nuk ka kërkesa dhe shkresa të AIC SH.A, apo vendimmarrje të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, megjithëse në përbërjen e tij një pjesë e madhe e anëtarëve janë përfaqësues të MFE.</p> <p>Gjithashtu, në këtë datë nga NPA në cilësinë e NA të ministrisë është urdhëruar Drejtoria e Buxhetit dhe Shërbimeve të kalojë fondet e miratuara në llogarinë e kësaj shoqërie, fonde të cilat janë bërë efektive në SIFQ më datë 17.01.2023. Pra në të njëjtën ditë Ortaku i vetëm ka marrë 4 vendime për zmadhim dhe zvogëlim kapitali me efekt neto në rritje kapitali në vlerën 2,120,000,000 lekë, pa ndonjë argument, rezultat apo kërkesë ligjore. Aktualisht kjo shoqëri referuar gjendjes në regjistrin tregtar zotëron një kapital prej 4,318,000,000 lekë, edhe pse paraqitet me humbje dhe për tre vite nuk ka paraqitur e realizuar asnjë projekt.</p>	Pika 2.E.5	E lartë	<p>Asambleja e Ortakëve, Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike të marrë masa për analizimin e veprimtarisë ekonomike dhe të situatës financiare të AIC SH.A dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mosparaqitjen e programit ekonomik dhe të pasqyrave financiare të vitit 2022 të shoqërisë.</p> <p>- Asambleja e Ortakëve të marrë masa për kthimin e kapitalit të AIC SH.A në shumën 4 miliard lekë në buxhetin e shtetit, përfituar pa asnjë kërkesë apo argument dhe në mënyrë të pajustificuar me aktivitetin e kësaj shoqërie.</p> <p>- Ministria e Financave të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për veprimet e kryera për lëvizjen e kapitalit, si dhe të urdhëroje ushtrimin e një misioni auditimi në AIC SH.A mbi aktivitetin e zhvilluar, qëllimet dhe arritjen e objektivave të krijimit të kësaj shoqërie.</p>

I.c. KONKLuzion I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) në drejtim të planifikimit të PBA-së, detajimit të planit buxhetor dhe çeljeve fillestare, monitorimit dhe raportimit të zbatimit të buxhetit, përputhshmërisë së përdorimit të fondit rezervë, monitorimit të risqeve fiskale dhe detyrimeve kontingjente, regjistrimit dhe kontrollit të transaksioneve nëpërmjet SIFQ, planifikimit dhe realizimit të treguesve të borxhit publik, vlerësimit të auditit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; ligjin nr. 9896, datë 04.02.2008, “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; ligjin nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar; si dhe ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore dhe rregullatore mbi të cilët ushtron veprimtarinë MFE.

Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna, informacione dhe dokumentacione të mjaftueshme relevante me çështjet e mësipërme, të cilat mundësojnë dhënien e opinionit me siguri të arsyeshme.

Opinion i modifikuar/kualifikuar mbi auditimin e përputhshmërisë¹:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se, në veprimtarinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinion”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe cilësore, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

Baza për opinionin e auditimit:

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e MFE, rezultoi se problematikat e konstatuara nga KLSH janë të pranishme në vitin 2022 në fazën e planifikimit, miratimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit të buxhetit, të cilat kryesisht konsistojnë në:

- Rishikimin e prioritetëve buxhetore pas përfundimit të fazës së dytë të PBA-së, si dhe detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA dhe vetëm vlerën e 20% të kostos së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore;
- Detajimin e planit buxhetor në 3 vite për kontrata që parashikojnë periudhë faturimi më të vogël se një vit, shkurtrimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin drejt projekteve të tjera të investimeve, mos regjistrimin e obligimit të plotë në SIFQ, duke rrezikuar krijimin e detyrimeve të prapambetura;
- Janë paguar detyrime të prapambetura për investime në vlerën 6,169 milion lekë, ose rreth 6.8% të investimeve kapitale me financim të brendshëm, duke deformuar vëllimin e investimeve të realizuar për vitin fiskal 2022;
- Sipas modulit të kontratave në SIFQ konstatohet se për investimet publike janë nënshkruar 1,319 kontrata pas datës 15 Tetor me vlerë të kontraktuar 10,045 milion lekë, në një kohë që vlera totale e kontraktuar rezulton 34,468 milion lekë;
- Janë raportuar investime kapitale me financim të brendshëm të realizuara nga të ardhurat dytësore në vlerën për 1,352 milion lekë, investime që nuk kanë plan buxheti të miratuar, në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar;
- Nga FSHZH në 17 raste për 9 projekte investimi në vlerën 398,792 mijë lekë është bërë parapagim i kontratave, të cilat janë përfshirë në investime të realizuara;
- Detyrimet e prapambetura të raportuara nga MFE për rreth 12,753 milion lekë nuk janë të përfshira në treguesit fiskalë të konsoliduar, si dhe vlera e paraqitur rezulton me diferenca nga testimet e kryera nga KLSH;
- Vlera e interesave/kamatëve/vonesave që i rëndon buxhetit të shtetit për mosekzekutim në afat të 3 vendimeve të GJEDNJ-së deri më datë 31.12.2022 rezulton e vlerësuar në 2,840,740 Euro.
- Konstatohet kryerje e rikonstruksionit dhe shpenzime nga buxheti i shtetit për objekte që nuk janë në pronësi të shtetit në vlerën 31,961 mijë lekë;
- Detyrimet në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit janë rritur me 2,239 milionë lekë, ndërkohë që janë konstatuar detyrime të reja në shumën 3,404 milionë lekë të subjekteve nënhumarrëse si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve përkatëse;

¹ **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura.

- Me ligjin vjetor të buxhetit është planifikuar vlera 500 milion lekë për projektin për fëmijët dhe rininë me burim fondin rezervë, në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit, pasi këto janë shpenzime plotësisht të parashikueshme duke sjellë për pasojë denatyrim të fondit rezervë që në planifikim. Gjithashtu, fondi rezervë rezulton të jetë përdorur në 5 raste, në shumën 1,491 milion lekë edhe për shpenzime të tjera jo të paparashikuara. Fondi Rezervë i miratuar ka tejkaluar kufirin e miratuar, përkatësisht përlllogaritet në 3.065 % dhe 3.84% të totalit të shpenzimeve të miratuara;

- Janë 26 projekte investimi, me kredi dhe grant, në vlerën 2,200 milion lekë të realizuara pa pasur plan buxhetor dhe 53 projekte në vlerën 1,506 milion lekë janë realizuar në tejkallim të planit të buxhetit të miratuar; ndërsa 95 projekte në vlerën 3,273 milion lekë, janë keq klasifikuar në llogarinë 231 “Investime për rritjen e aktiveve afatgjata materiale” pasi përfaqësojnë natyrë tjetër shpenzimi;

- Vlera e fondeve të rindërtimit e shpërndarë me VKM përgjatë viteve, është mbi vlerën e përcaktuar në ligjet e buxhetit të vitit 2020, 2021 dhe 2022 për shumën 44,736 milion lekë, pasi shpërndarja e fondeve me VKM nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së fondit të rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore sipas tabelës 4 të ligjit të buxhetit vjetor. Gjithashtu, për financimin e një pjese të projekteve të rindërtimit, në VKM është përcaktuar burim financimi ngurtësimi i fondeve, në vlerën rreth 2,763 milion lekë, gjë e cila nuk është në përputhje me ligjin organik të buxhetit dhe ligjin vjetor të buxhetit;

- Nga buxheti i shtetit është financuar Korporata Shqiptare e Investimeve SHA, në shumën 2 miliard lekë, pa kërkesë të shoqërisë dhe pa asnjë projekt të saj, në një kohë që shoqëria rezulton pa aktivitet dhe me humbje. Ortaku i vetëm në të njëjtën ditë ka marrë 4 vendime për zmadhim dhe zvogëlim kapitali me efekt neto në rritje kapitali në vlerën 2.1 miliard lekë, pa ndonjë argument dhe pa vendimmarrje të organeve drejtuese.

- Është konstatuar se gjatë vitit 2022 ka një numër të lartë rialokimesh të fondeve buxhetore, prej 2,956 rishikime të cilat kanë sjellë ndryshime për 25,508 transaksione, të cilat në 763 raste janë kryer në tejkallim të afatit 15 nëntor. Për 313 raste konstatohet regjistrim i rialokimeve të fondeve buxhetore me data kontabile efektive më të hershme (retrospektive);

- Konstatohen 9,349 transaksione pagesash për vitin 2022 në shumën totale 16,809 milionë lekë të cilat i përkasin faturave me datë të viteve buxhetore të mëparshme;

- konstatohen parregullsi të lejuara për procesim nga sistemi i thesari, konkretisht: 102 raste të urdhër prokurimeve të regjistruara në sistem në vitin buxhetor 2022 të cilat lidhen me një kontratë të nënshkruar në vitet e mëparshme buxhetore, 52 raste në të cilat urdhër prokurimet rezultojnë të jenë regjistruar 0-10 ditë diferencë nga data e kontratës, etj.

- Në 10,602 raste në vlerën 116,288 milionë lekë ose 61% e kontratave që lidhen me vitin 2022, nuk është respektuar afati 3-ditor për regjistrimin e kontratave në modulën e kontratave në SIFQ, nga data e nënshkrimit të tyre, si dhe konstatohet mos regjistrim në SIFQ i planit të pagesave të kontratës e kushtëzuar nga mosdetajimi i planit buxhetor për projekte të investimeve;

- Problematika mbi detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore përgjatë vitit për mbulimin e detyrimeve të prapambetura mbartur nga vitet e kaluara në vlerën 3.8 miliardë lekë, ku vlera e fondeve të detajuara përputhet plotësisht me vlerën e pagesave të kryera;

- Konstatohen 27,311 fatura në total me vlerë 52,579 milion lekë të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor;

- Përgjatë vitit 2022 gjendja e likuiditeteve ka rezultuar e lartë, ndërmjet intervalit 60-100 miliardë lekë. Pjesa më e madhe e tepरिकave është akumuluar gjatë vitit në TSA në Euro, duke mos administruar si duhet mjetet monetare së bashku me konvertimin e panevojshëm të valutave të cilat kanë sjellë shpenzime të pa nevojshme;

- Referuar analizës së sistemit sipas pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit bazuar në vetëvlerësimin e njësive publike, evidentohet një ulje e efektivitetit për 2

parime krahasimisht me vitin 2021, dhe për më tepër asnjë prej elementëve nuk paraqitet në përmirësim nga viti i kaluar. Për vitin 2022, referuar analizës së DH/MFKK, 30 Njësi të Qeverisjes së Përgjithshme (nga 152 gjithsej) kanë pësuar rënie në vlerësim krahasuar me vitin 2021.

Përgjegjësitë e Drejtimit

Drejtimi i MFE-së është përgjegjës për menaxhimin e procesit të hartimit, ekzekutimit dhe raportimit buxhetor, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, nxjerrjen dhe garantimin e zbatimit të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre, ndërkohë që theksojmë se të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, janë përgjegjës për programimin dhe ekzekutimin e shpenzimeve për realizimin e aktivitetit të tyre dhe disiplinën financiare që garanton ligjshmërinë dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor buxhetor të nxjerra, por Drejtimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit të treguesve fiskal.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 281/1, datë 03.04.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar, në subjektin: **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**, nga data 03.04.2023 deri më 24.07.2023, u krye auditimi “Mbi Përputhshmërinë”, për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. S. B., Përgjegjës Grupi
2. R. G.,
3. H. S.,
4. E. H.,
5. Xh. N.,
6. M. V.,
7. R. Xh.

Auditimi u krye me bazë risku, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e institucionit, duke përfshirë saktësinë e paraqitjes së të ardhurat dhe shpenzimet, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**.

Projekt-Raporti i auditimit është i strukturuar në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë të hyrjes janë trajtuar çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj. Në vijim është përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit. Në kreun e tretë jepet konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin e auditimit, bazuar në rezultatet e auditimit. Gjetjet dhe rekomandimet të strukturuar sipas llojit të tyre janë vendosur në kreun e katërt. Kreu i pestë është Lista e dokumenteve të auditimit.

1. Objekti i Auditimit: Auditim përputhshmërie në **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë**.

2. Qëllimi. Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor në fuqi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, lidhur me zbatimin e kuadrit rregullator në realizimin e ciklit buxhetor 2022.

Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, gjatë veprimtarisë së tij.

3. Identifikimi i çështjes. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është institucioni që udhëheq veprimtarinë e hartimit, detajimit, miratimit, ekzekutimit, raportimit, monitorimit të buxhetit, realizimit të huamarrjes në tregun e brendshëm dhe të jashtëm si dhe realizon raportimin e të gjitha transaksioneve në treguesit e konsoliduar fiskalë.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të MFE është e lidhur me aktivitetet e projekt buxhetit afatmesëm, hartimit të projekt buxhetit, detajimin e fondeve sipas nivelit të miratuar, regjistrimin e transaksioneve në SIFQ për ekzekutimin, kryerjen e ndryshimeve gjatë vitit buxhetor në fondet e miratuara dhe raportimin e monitorimin e treguesve fiskalë të konsoliduar.

5. Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar;

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4000), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare të aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300).

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300).

-Të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit:

Për dhënien e opinionit të përputhshmërisë jemi bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të procedurave tatimore.

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

- Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9896, datë 04.02.2008, “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”;

- Ligji nr.115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar;

- VKM nr. 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”;

- VKM nr. 587 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të menaxhimit financiar”;

- Udhëzimi nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”;

- Të tjera akte ligjore, nënligjore dhe rregullative.

7. Standardet e auditimit.

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC;

- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për

implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë" etj.;

- Manualët e Auditimit të Përputhshmërisë të miratuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së etj.;

8. Metoda e auditimit.

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke pasur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se thelbi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të prokurimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji si dhe funksionimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm nga njësia e audituar, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të Riskut të Auditimit (RA).

Për sa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer teste kontrolli, të cilat në mënyrë analitike janë të përshkuara në Letrat e punës.

Për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë (përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar në lidhje me zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, u gjykua që të kryhen teste thelbësore (të detajeve) për procedurat e prokurimit të kryera nga subjekti në periudhën objekt auditimi. Është gjykuar të përdoret metoda e përzgjedhjes së disa artikujve të veçantë, mbështetur kjo në pikën 5.7 "Marrja e kampioneve dhe mjete të tjera që përdoren për të përzgjedhur elementet/artikujt që do të testohen" të Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë. Testet e Kontrollit, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, janë të mbështetura tek niveli i materialitetit dhe vlerësimit të riskut, shkalla e sigurisë që përfitohet nga kryerja e testeve të kontrollit, teknikat e kampionimit dhe zgjedhjes rastësore.

9. Dokumentimi i auditimit.

Auditimi është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 400-499 "Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë". Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e planifikimit dhe auditim në terren, si dhe janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit dhe është lënë gjurmë auditimi për të gjitha procedurat e kryera.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Veprimtaria e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në funksion të zbatimit të Buxhetit të Shtetit lidhet me aktivitetet e hartimit të PBA, projekt buxhetit vjetor, detajimin e fondeve buxhetore pas miratimit të ligjit të buxhetit të vitit, ndryshimet e planit gjatë vitit buxhetor, ekzekutimin e fondeve buxhetore dhe monitorimin e raportimin e transaksioneve. Të dhënat mbi planin përfundimtar dhe faktin mbi zbatimin e Buxhetit të Shtetit gjatë vitit buxhetor publikohen në tabelën e treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

-Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit është përgjegjëse për përgatitjen e buxhetit të shtetit; menaxhimin dhe monitorimin e buxhetit; klasifikimin buxhetor; kryerjen e analizave për shpenzimet publike dhe zhvillimi i politikave buxhetore; përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë proceset e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, si dhe sistemin buxhetor në tërësi; të llogarisë dhe transferojë me drejtësi e transparencë transfertat e buxhetit të shtetit për pushtetin vendor, të mbështesë dhe plotësojë me aktet e nevojshme ligjore, decentralizimin fiskal, duke synuar rritjen e të ardhurave, rritjen e efikasitetit të përdorimit të fondeve publike për pushtetin vendor; monitorimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura dhe forcimi i disiplinës financiare për parandalimin e akumulimit të tyre në të ardhmen, për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

-Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit kryen regjistrimin e transaksioneve të pagesave nga Buxheti i Shtetit së bashku me procedurat e kontrollit parandalues në kryerjen e shpenzimeve publike sipas kërkesave të ligjit të buxhetit. Funksionet kryesore të kësaj drejtorie janë: Menaxhimi i likuiditetit të qeverisjes së përgjithshme; bashkëpunimi me drejtoritë e tjera për sigurimin e nevojave të Qeverisë për mjete monetare për kryerjen e pagesave brenda kufijve të Limitit të cash-it; realizimi i kryerjes së pagesave në mënyrë të centralizuar nëpërmjet sistemit informatikë financiar të qeverisë; regjistrimi, kontrolli, kontabilizimi dhe përpunimi i informacionit të transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme dhe mbi këtë bazë, gjenerimi i raporteve të ndryshme; përmirësimi i sistemit të shërbimeve financiare në përshtatje me ndryshimet e vazhdueshme; administrimi funksional i Sistemit Informatikë Financiar të Qeverisë, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi për procesin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe raportimit financiar; pagesat e dëmshpërblimeve të ish të përndjekurve politikë; monitorimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura dhe forcimi i disiplinës financiare për parandalimin e akumulimit të tyre në të ardhmen, për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

-Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj është përgjegjëse për veprimtarinë e huamarrjes gjatë vitit buxhetor. Kjo drejtori e ushtron veprimtarinë në drejtim të regjistrimit të transaksioneve të borxhit publik, realizimin e huamarrjes në tregun e brendshëm dhe të jashtëm, kryerjen e pagesave të principalit dhe shpenzimeve të maturuara të interesit, si dhe raportimin e tyre në treguesit e konsoliduar fiskalë. Gjithashtu drejtoria mban kontakte me kreditorët, kryen analiza dhe harton strategjinë afatmesme të menaxhimit të borxhit publik, komunikon me subjektet përfituese të marrëveshje të nënhuasë apo garancive shtetërore dhe angazhohet në arkëtimin e të drejtave që burojnë nga detyrimet e akumuluar nga këto subjekte.

-Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPHKBFP) përbëhet nga 2 drejtori:

1. Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (këtu e në vijim DH/AB); dhe

2. Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (këtu e në vijim DH/MFKK).

DPHKBFP funksionon në zbatim të Ligjit Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar dhe Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe Rregullores së brendshme miratuar me Urdhrin nr. 52,

datë 10.03.2021 të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, neni 17. Bazuar në nenin 17 të Rregullores së Brendshme, DPHKBFP ka si mision harmonizimin e standardeve, rregullave dhe procedurave për kryerjen, monitorimin dhe raportimin e veprimtarisë së menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit, si dhe auditimit të brendshëm në sektorin publik.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

2.A. Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

2.A.1 Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për verifikimin e zbatimit të detyrave në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, dërguar me shkresën nr. 364/18 prot, datë 30.09.2022, është kërkuar zbatimi i rekomandimeve për 38 masa organizative, 5 masa për eliminimin e efekteve negative, 1 masë administrative dhe 1 masë disiplinore.

MFE me shkresën nr. 6262/55 prot, datë 25.04.2023, ka paraqitur planin e masave mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, **jashtë afatit 20 ditë**, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. MFE me shkresën nr. 6262/56 prot, datë 09.05.2023, ka dërguar informacion mbi zbatimin e rekomandimeve, **jashtë afatit 6 mujor**, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 30 pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, rezultojnë se megjithëse janë pranuar në masën 95% (nga 45 rekomandime, 2 nuk janë pranuar) janë zbatuar plotësisht 2 masa ose 4.7%, pjesërisht 1 masë ose në masë 2.4%, janë në proces 6 masa ose 13.9% e tyre dhe pa u zbatuar 34 masa ose 79% e tyre. Statusi i zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

- a. 38 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar 36 masa organizative, 2 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht, 5 masa organizative rezultojnë në proces zbatimi dhe 29 masa organizative rezultojnë të pazbatuara.
- b. 5 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike**, të cilat janë pranuar nga subjekti. Rezulton se 2 masa janë në proces zbatimi dhe 3 masa nuk janë zbatuar.
- c. 1 masë administrative** e cila është pranuar, por rezultojnë e pazbatuar.
- d. 1 masë disiplinore** lënë në kompetencë të titullarit, e cila është pranuar, por rezultojnë e pazbatuar.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të përmbledhur ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve.

Tabela 1: Përmbledhje e pranimin dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH.

Rekomandimi	Nr.	Pa pranuar	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa Organizative	38	2	36	2	-	5	29
3E	5	-	5	-	-	2	3
Masa administrative	1	-	1	-	-	-	1
Masa disiplinore	1	-	1	-	-	-	1
Totali	45	2	43	2	-	7	34

Burimi: Grupi i auditimit, KLSH.

Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH rezultoi si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Nëpunësi i Parë Autorizues të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve, si dhe të marrë masat e nevojshme për realizimin e plotë të të gjitha rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe forcimin e disiplinës buxhetore dhe fiskale.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

2.1.Rekomandimi: Nga ana e MFE të kryhen veprimet rregulluese, duke e raportuar stokun e borxhit publik me përfshirjen e bonos përkatëse 6-mujore në regjistrin e borxhit dhe treguesit e borxhit publik në vlerën 6,928,660,536.43 lekë. Të rishikohet marrëveshja me Bankën e Shqipërisë, në mënyrë që të parashikohet detyrimi për paraqitjen e kërkesës për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit përpara hartimit të ligjit vjetor të buxhetit të shtetit.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

3.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, të krijojë për çdo VKM të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, dosjen e plotë të dokumentacionit të domosdoshëm për të vlerësuar kriteret e përdorimit të Fondit Rezervë, i cili edhe gjatë vitit 2021 është përdorur për shpenzime të cilat duhej të ishin planifikuar në ligjin e buxhetit dhe nuk e plotësojnë në vlerë dhe koherencë pagese kriterin e pa parashikueshmërisë dhe emergjencës. Gjithashtu për të gjitha kërkesat për përdorimin e fondit rezervë sipas procedurës, të shmanget praktika e mos marrjes së mendimit jo vetëm të Ministrisë së Drejtësisë, por dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ky rekomandim rezulton i papranuar.

4.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me autoritetet kontraktuese, të monitorojë me rigorozitet detyrimet që lindin nga kontratat koncesionare, pagesat e të cilave bazohen në nivelin e shërbimit dhe që krijojnë detyrime të prapambetura për t'u mbartur në vitet e ardhshme buxhetore. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë, duke qenë se janë konstatuar pagesa për detyrime të prapambetura.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të hartojë dhe propozojë për miratim një udhëzim të veçantë mbi procedurën e kërkesës dhe miratimit të fondeve buxhetore shtesë, formatet e dokumentacionit që duhen plotësuar në argumentimin e kërkesës dhe lidhjen e objektivave me produktet, dokumentimin e kësaj procedure nga aplikimi në miratim, analizën e prioritarizimit etj.

Ky rekomandim rezulton i papranuar.

5.2. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të adresojë pranë KM problemin e krijuar në mos përdorimin e sistemit AFMIS nga grupet buxhetore 87 dhe 63, si pasojë e formës së organizimit të tyre, për të vlerësuar mundësinë e rishikimit të organizimit strukturor të këtyre grupeve me qëllim përfshirjen e tyre në këtë sistem.

Nga auditimi rezulton se është përgatitur shkresa nr. 6262/54 datë 16.11.2022 në të cilën i është bërë e ditur Këshillit të Ministrave rekomandimi i KLSH-së dhe i është kërkuar bashkëpunim për të zgjidhur këtë çështje. Deri tani nuk ka një përgjigje zyrtare.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces zbatimi.

6.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrë masa për rivlerësimin e kriterëve të përdorura në hartimin dhe miratimin e akteve normative, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë sipas strukturave për parregullsitë e konstatuara për një parashikim sa më real të treguesve fiskalë, në funksion të qëndrueshmërisë dhe konsolidimit financiar të vendit.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

6.2.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të evidentojë mos rakordimet e planit buxhetor në SIFQ sipas treguesve fiskal të konsoliduar, në rakordimet ditore që realizon me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, me qëllim eliminimin e diferencave sipas zërave ligj-sistem.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të monitorojë zbatimin e buxhetit sipas produkteve përkatëse në Ministrinë e Linjës, zbatimin e objektivave dhe produkteve gjinore, si dhe të përdor numrin e rishpërndarjeve buxhetore si tregues në vlerësimin e performancës.

Nga auditimi rezulton se kanë filluar procedurat për hartimin e udhëzimit mbi procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për NJQQ.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces zbatimi.

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të bëjë një analizë të thelluar për institucionet e evidentuara me numrin më të lartë të rishpërndarjeve buxhetore, të evidentojë arsyet, përgjegjësit dhe të japë rekomandimet e domosdoshme në parandalimin e keq planifikimit të fondeve nga këto institucione dhe për buxhetin në tërësi. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

10.1.Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa, me qëllim shmangien e shtyrjes së planit buxhetor përtej periudhës së parashikuar për kohëzgjatjen e kontratave; të merren masa për regjistrimin në kohë të fondeve të obliguara në SIFQ, duke koordinuar edhe me Agjencinë e Prokurimit Publik, si dhe integrimin e sistemit elektronik të prokurimit publik me sistemin informatik financiar të qeverisë; të merren masa për problematikën e nxjerra nga auditimi me qëllim reflektimin dhe përmirësimin e punës në të ardhmen.

Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të shmanget detajimi i projekteve të reja të investimit publik me akte normative gjatë vitit, si dhe në përfundim të vitit buxhetor, të cilat nuk krijojnë mundësinë e përdorimit të buxhetit prej 20% të kërkuar në vitin e parë të zbatimit të tij.

Nga auditimi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve rezulton se gjatë vitit buxhetor janë detajuar projekte të reja me akte normativ gjatë vitit 2022 për të cilat nuk është përdorur 20% në vitin e parë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

11.1.Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së diskutimit të kërkesave buxhetore dhe në vijim të detajimit të fondeve sipas kërkesave të institucioneve buxhetore të zhvillohet një analizë mbi natyrën ekonomike të fondeve të kërkuara me qëllim klasifikimin dhe raportimin e drejtë të shpenzimeve sipas natyrës dhe destinacionit. Nga auditimi konstatohet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

12.1. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të reflektohet në treguesit fiskalë të konsoliduar, sipas tabelës 4 të ligjit të buxhetit të vitit, plani buxhetor për të gjitha investimet kapitale të brendshme me burim financimi të ardhurat e veta, sikurse parashikohen për investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë. Në të njëjtën kohë, të detajohen në nivel analitik investimet e realizuara nga të ardhurat e veta të arsimit të lartë dhe të shmanget çelja e projekteve të investimit në një kod të përgjithshëm ndërkohë që projektet zbatohen nga njësi shpenzuese të ndryshme. Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka shprehur qëndrim në lidhje me këtë rekomandim. Megjithatë nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

13.1. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të shmanget praktika e detajimit të fondeve të investimeve në projekte me përshkrim “Fond i ngrirë” dhe të alokohen fondet e investimit në projekte specifike, për të krijuar mundësinë e përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve buxhetore të miratuara.

Nga auditimi rezulton se subjekti nuk ka shprehur qëndrim në lidhje me këtë rekomandim. Megjithatë nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

14.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për fuqizimin e kontrollit të brendshëm në drejtim të raportimit të saktë dhe të plotë të investimeve publike me financim të huaj, nëpërmjet përfshirjes së tyre në ciklin e menaxhimit të shpenzimeve buxhetore për t'u siguruar për përputhshmërinë me planet vjetore dhe tavanet përkatës buxhetore. Nga auditimi konstatohet se rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

14.2. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të marrë masa për fuqizimin e rolit të Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike në MFE, në drejtim të monitorimit të procesit të investimeve publike me financim të huaj me qëllim rritjen e cilësisë së menaxhimit të fondeve publike dhe llogaridhënies së strukturave që kryejnë shpenzime buxhetore. Nga auditimi konstatohet se rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

15.1.Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në paraqitjen e listës së investimeve publike të projekt buxhetit të vitit, të paraqitet vlera e plotë e secilës kontratë në vazhdim, duke specifikuar buxhetin për secilin vit sipas periudhës së ekzekutimit të projektit dhe të shmangët praktika e paraqitjes sintetike në një projekt të vetëm me emërtimin “FZHR në proces”. Nga auditimi konstatohet se rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

15.2 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjatë miratimit të detajimit të investimeve publike, të mbahet parasysh prioriteti në financimin e projekteve në vazhdim me burimi financimi Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, si dhe financimi i projekteve të cilat kanë krijuar detyrime të prapambetura, me qëllim shlyerjen dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Nga auditimi konstatohet se rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

16.2.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrë për iniciimin e propozimeve ligjore në lidhje me mënyrën e llogaritjes së statusit financiar të njërive të vetëqeverisjes, duke zëvendësuar “shpenzimet e miratuara” me “shpenzimet e realizuara”, me qëllim paraqitjen reale të statusit financiar të këtyre njërive.

Ministria e Financave ka propozuar ndryshim në Ligjin 68/2017 për të vlerësuar situatën financiare të njërive vendore mbi shpenzimet faktike dhe jo ato të planifikuara. Ndryshimi ligjor është miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe pritet miratim nga Kuvendi.

Ky rekomandim rezulton në proces zbatimi.

17.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të marrë të gjithë masat e nevojshme për shpërndarjen dhe çeljen e plotë të transfertës së përgjithshme dhe sektoriale. Gjithashtu, Drejtoria e Financave Vendore, në rolin e mbikëqyrësit financiar të veprimtarisë të njërive të qeverisjes vendore, të marrë masa për monitorimin e shpërndarjes së planit buxhetor të njërive të qeverisjes vendore sipas prioriteteve si dhe tu rekomandojë njërive të vetëvrasjes vendore përdorimin e të ardhurave të trashëguara të pa obliguara me qëllim shlyerjen dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Nga auditimi rezulton se Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka propozuar ndryshim ligjor në ligjin nr. 68/2017, ku përcaktohet se fondet e trashëguara dhe të pa obliguara, jo më pak se 30% e tyre të përdoren automatikisht për detyrimet e prapambetura.

Ky rekomandim rezulton në proces zbatimi.

18.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për reflektimin në vitet pasardhëse buxhetore, të efekteve të krijuara nga shpërndarja e fondeve të rindërtimit me

VKM dhe në komponentët e treguesve fiskalë, me qëllim programimin e saktë të shpenzimeve. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

19.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa në të ardhmen për shmangien e praktikës së ngurtësimit të fondeve, si një mënyre financimi për projektet e reja të rindërtimit dhe ato në proces. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

20.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, të marrin masat për implementimin e kontroleve të stokut të detyrimeve të prapambetura, duke mundësuar verifikimin e detyrimeve të prapambetura sipas kohës së krijimit të tyre apo shtesave përgjatë vitit, me qëllim kryerjen e një raportimi sa më të saktë dhe të plotë të tyre në materialin përfundimtar të përgatitur dhe publikuar nga njësi përgjegjëse për monitorimin e risqeve të përgjithshme në MFE. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, të marrin masa për harmonizimin e kërkesave të kuadrit nënligjor në fuqi mbi detyrimet e prapambetura, me qëllim parashikimin e procedurave shtesë kontrolli për monitorimin e raportimit aktual të tyre. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

21.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë përgjegjëse: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin të bëjë një analizë të thelluar për institucionet e evidentuara me numrin më të lartë të rishpërndarjeve buxhetore, të evidentojë arsyet, përgjegjësit dhe të japë rekomandimet e domosdoshme në parandalimin e keq planifikimit të fondeve nga këto institucione dhe për buxhetin në tërësi. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

22.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë e saj përgjegjëse, në rolin e ekzekutuesit dhe/apo miratuesit, të analizojë dhe investigojë të gjitha rastet e regjistrimeve me data retrospektive të rishpërndarjeve buxhetore të vitit 2021, duke vlerësuar nëse këto raste janë kryer para apo pas ndërmarrjes së veprimeve për këto investime. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

23.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për analizimin dhe verifikimin e të gjitha rasteve të konstatuara me plan pagesash vetëm në vitin 3 dhe pa plan pagese për vitin aktual, vitin 1 dhe vitin 2. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

24.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik në vijimësi të rakordojnë të dhënat mbi regjistrimin e prokurimeve nga institucionet buxhetore, duke evidentuar dhe raportuar ndryshimet midis këtyre databazave dhe të nxjerrë përgjegjësitë institucionale tek NPA. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, në vijimësi të evidentojë rastet e regjistrimit të kontratave me vonesë, duke evidentuar rastet më problematike dhe t'i raportojë ato tek NPA. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

25.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të evidentojë vazhdimisht rastet e regjistrimit të faturave me vonesë dhe ti raportojë ato tek NPA, duke marrë masat administrative të parashikuara në ligj për këto raste për NA dhe NZ.

Nga auditimi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve nuk rezultojnë të jenë marrë masa administrative.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

26.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të evidentojë vazhdimisht rastet e regjistrimit të faturave pjesore, dhe ti raportojë ato tek NPA, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësi individuale dhe marrjen e masave për këto raste. Gjithashtu, nga DPTH të merren masat e nevojshme për mos lejimin e regjistrimit të faturave pjesore.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të evidentojë vazhdimisht rastet e ekzekutimit të faturave me vonesë, dhe ti raportojë ato tek NPA, duke marrë masat administrative të parashikuara në ligj për punonjësit që kanë shkaktuar vonesat, me qëllim përmirësimin e këtij treguesi në të ardhmen.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të vlerësojë mundësinë e implementimit të mekanizmit të kontrollit të inputit, me qëllim shmangien e gabimeve të evidentuara mbi plotësimin e të dhënave.

Nga auditimi rezultojnë sërish pagesa pjesore të faturave.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

27.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të marrë masat e nevojshme për kontrollin e vazhdueshëm të kryerjes së pagesave me qëllim trajtimin e barabartë të furnitorëve, në zbatim të parimit FIFO.

Nga auditimi kanë rezultuar raste në të cilat nuk është respektuar parimi hyrje e parë dalë e parë në procesim.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

28.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të merren masa për pasqyrimin e saktë të dokumentacionit justifikues mbi të cilin bazohet urdhër-shpenzimi mbi çlirimin e garancisë së punimeve. Gjithashtu në vijimësi të njoftojë NPA në lidhje me rastet e konstatuara për shkeljen e afatit të çlirimit të garancisë.

Nga auditimi rezulton se në përkrahjet e pagesave janë pasqyruar ekstremitetet e çlirimit të garancisë, por nuk rezulton të jetë njoftuar NPA.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

29.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit dhe Menaxhimit të Financave Publike, të marrin masa për hartimin e një metodologjie për përgatitjen e saktë të pasqyrave të konsoliduara financiare të qeverisë në përputhje me rregullat bazë të kontabilitetit. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

31.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe departamentet e Bankës së Shqipërisë si agjentë fiskal të saj, të cilët regjistrojnë dhe konfirmojnë llogarinë e unifikuar të thesarit “Depozitë qeverie”, të përcaktojnë qartë se kush departament duhet të konfirmojë të ndarë në grupe të ardhurat dhe shpenzimet e kësaj llogarie në mbështetje të përcaktimeve ligjore. Nga auditimi rezulton se ende nuk është miratuar një metodologji dhe nuk është përcaktuar konfirmimi i të ardhurave në grupe.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

32.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e Autoritetit Publik dhe të Kompetencës nëpërmjet strukturave të borxhit, të marrë masa për hartimin dhe implementimin e procedurave të qarta ligjore, me qëllim përcaktimin e një procedurë që parashikon monitorimin proaktiv dhe dinamik, si dhe konfirmimin e gjendjes financiare dhe aftësisë paguese të subjekteve kredimarrëse, përmes aksesit të autorizuar në informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjekteve përfituese të garancisë, përpara realizimit të pagesës në mbështetje të vështirësisë financiare të deklaruar nga subjektet përfituese. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

33.1.Rekomandimi: Nga ana e MFE, të merren masa për kryerjen e operacioneve të njëanshme të konvertimit të monedhës së huaj në blerje dhe në shitje me kursin e ditës spot, nëpërmjet ri përcaktimit të termave të marrëveshjes aktuale me Bankën e Shqipërisë, në rolin e agjentit fiskal të qeverisë dhe/ose me Bankat e Nivelit të Dytë. Në varësi të flukseve hyrëse dhe dalëse monetare të evidentohet për çdo rast, arsyetimi i përdorimit të instrumentit SËWAP dhe Outright përkundrejt konvertimit të thjeshtë në tregun e këmbimit valutor nëpërmjet ofertave të gjithë pjesëmarrësve të tregut. DPTH, në vijimësi të kryejë analizën efektive financiare nga përdorimi i instrumentit SËWAP, si instrument i vetëm për kryerjen e operacioneve të konvertimit të monedhës.

Nga auditimi rezulton se janë zbatuar masivisht kontratat sËwap dhe një herë konvertimi i njëanshëm.

Ky rekomandim rezulton i zbatuar pjesërisht.

35.1. Rekomandimi: Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve të marrë masa për kryerjen e rakordimeve mujore, ndërmjet të dhënave që jep raporti i sistemit e-dëmshpërblime me të dhënat që japin nxjerrjet e llogarive (statement) që sjellin çdo fillim muaji Bankat e Nivelit të Dytë, si dhe të dhënave në SIFQ, në mënyrë që të sigurohet një paraqitje sa më e plotë dhe transparente mbi pagesat e këtij fondi. Nga auditimi konstatohet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa të menjëhershme për rikuperimin e të drejtave për të arkëtuar, nëpërmjet ushtrimit të instrumenteve ligjore që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuasë.

Nga auditimi konstatohet se bazuar në iniciativën e ndërmarrë për ndryshime ligjore nga Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, me paraqitjen e draft ligjit të hartuar.

Ky rekomandim rezulton në proces zbatimi.

2.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ushtrojë të gjitha mjetet ligjore për arkëtimin e të drejtave për pagesa të kryera për garancitë e arkëtuara dhe në të njëjtën kohë të ushtrojë kontroll mbi planet ekonomike dhe financiare për shlyerjen e këtyre shumave. Nga auditimi konstatohet se bazuar në iniciativën e ndërmarrë për ndryshime ligjore nga Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, me paraqitjen e draft ligjit të hartuar.

Ky rekomandim rezulton në proces zbatimi.

3.1.Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të ndërmerren inspektime financiare dhe masa administrative në lidhje me detyrimet e prapambetura, për rastet e thyerjes së disiplinës buxhetore sipas përgjegjësive përkatëse të funksionarëve publik të ngarkuar dhe autorizuar për kryerjen e shpenzimeve publike.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

4.1.Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa të menjëhershme për regjistrimi në SIFQ brenda afatit kohor, të të gjithë kontratave të lidhura, si dhe të përputhet planit buxhetor me periudhën e faturimit për secilën kontratë të nënshkruar për investimet e financuara nga programi buxhetor infrastruktura vendore dhe rajonale. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton në proces zbatimi.

5.1. Rekomandimi: NPA dhe strukturat përgjegjëse pranë MFE, të marrin masat për kryerjen e sondazheve periodike tek ministritë e linjës, nëse ekzistojnë detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë, për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme, që rrjedhin

nga faturat ose pretendimet e marra përtej fondeve në dispozicion, si dhe të përcaktojë përgjegjësitë sipas kuadrit ligjor në fuqi. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, të marrin masa, që raporti final i detyrimeve të prapambetura të reflektojë stokun real e gjithëpërfshirës të sistemit të qeverisjes së përgjithshme, duke përfshirë këtu edhe institucione si FSHZH, AKSHI, Ujësjellës Kanalizimeve në vlerat e tyre të plota, nisur dhe nga akt-rakordimet për njohjen e detyrimeve. Nga auditimi rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton në proces zbatimi.

C. MASA ADMINISTRATIVE

KLSH i rekomandon Nëpunësit të Parë Autorizues marrjen e masave në përputhje me kërkesat e nenit 51 “Menaxhimi i Angazhimeve” dhe nenit 71 “Kundërvajtjet administrative” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke analizuar rast pas rasti gjetjet e mësipërme, të reflektuara më hollësisht në raportin përfundimtar të auditimit.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil”, pasi të jenë identifikuar personat përgjegjës në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Komisionit Disiplinor përkatës për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” sipas përgjegjësisë individuale të drejtuesve konkret.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

2.A.2 Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e ushtruar në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për verifikimin e zbatimit të detyrave në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dërguar me shkresën nr. 363/11 prot, datë 30.09.2022, është kërkuar zbatimi i rekomandimeve për 30 masa organizative dhe 2 masa për eliminimin e efekteve negative.

Nga ana e MFE nuk është dërguar plani i masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe informacioni mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, ndaj të gjitha rekomandimet rezultojnë pa përgjigje nga subjekti në kundërshtim me nenin 15, shkronja (j) dhe nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, rezulton se janë zbatuar plotësisht 4 masa ose 12.5%, pjesërisht 1 masë ose në masë 3% dhe pa u zbatuar 34 masa ose 84.5% e tyre. Statusi i zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

- a. **30 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar 30 masa organizative, 4 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht, 1 masë organizative rezulton e zbatuar pjesërisht dhe 25 masa organizative rezultojnë të pazbatuara.
- b. **2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike**, të cilat nuk janë zbatuar.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të përmbledhur ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve.

Tabela 2: Përmbledhje e pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH.

Rekomandimi	Nr.	Pa pranuar	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
-------------	-----	------------	---------	--------------------	--------------------	-------------------	------------

Masa Organizative	30	-	30	4	1	-	25
3E	2	-	2	-	-	-	2
Totali	32	-	32	4	1	-	27

Burimi: Grupi i auditimit, KLSH.

Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH rezultoi si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë konkrete për mos zbatimin e tyre, të marrë masa duke ndjekur procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore, me qëllim realizimin e plotë të rekomandimeve nga KLSH. Nga auditimi rezulton se nuk janë marrë masa lidhur me këtë rekomandim.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

2.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të buxhetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrin masat për hartimin e dokumentit të PBA-së të MFE në mënyrë të plotë dhe të saktë, duke përfshirë të gjitha njësitë e varësisë sipas programeve, përfshirë edhe aparatit, sipas formateve standard të përcaktuar, ku lista shoqëruese e investimeve të plotësohet me të dhënat në përputhje me kontratat e lidhura, me qëllim shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Nga auditimi konstatohet se për aparatit nuk është hartuar PBA më vete.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

3.1.Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të merren masa për zgjidhjen e problematikës së konstatuar nëpërmjet plotësimit të vendeve vakante apo emërimit si Nëpunës Autorizues për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të një punonjësi tjetër të nivelit të lartë të administratës publike, në mënyrë që të mos kryhet nga i njëjti nëpunës detyra që përfshijnë si përcjelljen e kërkesës, ashtu edhe miratimin e saj. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

4.1.Rekomandimi: Titullari i MFE, si kreu i organit qendror të njësisë së qeverisjes qendrore, të marrë masat për hartimin e një udhëzuesi në vijim dhe në zbatim të udhëzimit të MFE-së për monitorimin e buxhetit në NJQQ, përcaktimin e procedurave që duhet të ndjekin njësitë shpenzuese nën juridiksionin e MFE mbi procesin e monitorimit të buxhetit, si dhe përcaktimin e afateve për dërgimin e tyre pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MFE, në mënyrë që të hartohet më pas raporti i konsoliduar dhe publikimin e tij në ueb. Aparati i MFE të marrë masat, për hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit për aparatit si njësi shpenzuese për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

5.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me njësitë shpenzuese nën juridiksionin e saj dhe ekipet e ngritur për menaxhimin e programeve buxhetore të MFE, të marrin masat për rritjen e bashkëpunimit me tyre dhe kryerjen e një planifikimi sa më efektiv të fondeve në përputhje me objektivat institucional, me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta në buxhet të fondeve, situatë kjo me impakt negativ në treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit. Gjithashtu, në kuadër të një monitorimi sa më efektiv të fondeve buxhetore, të identifikohen projektet që janë me realizim më të ulët në mënyrë që të rishpërndahen këto fonde në projekte apo institucione të tjera sipas nevojës, në funksion të përmbushjes së misionit të institucionit dhe shmangien e praktikës së pakësimit të fondeve të dedikuara për një investim, të cilat mund të cenojnë zbatimin e kontratave të tjera dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura për buxhetin e shtetit.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

6.1.Rekomandimi: Nga ana e MFE të shmanget detajimi i projekteve të reja të investimit publik me akte normative apo rishikimeve të tjera gjatë, si dhe në përfundim të vitit buxhetor pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, për t'u dhënë prioritet projekteve të planifikuara në PBA, në respektim të disiplinës buxhetore me qëllim menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

6.2. Rekomandimi: Strukturat drejtuese pranë MFE-së dhe AKSHI-t të rrisin bashkëpunimin ndër institucional, në mënyrë që të kryhet në mënyrë të plotë dhe të saktë planifikimi i fondeve që në fazën e hartimit të PBA-së për ato asete, procedurat e prokurimit të cilave do të kryhen nga AKSHI, në mënyrë që të shmanget fenomeni i ndërmarrjes së angazhimeve pa fonde në dispozicion nga ky i fundit, shoqëruar me efekte financiare apo rishikime të shpeshta të buxhetit të MFE. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit pranë MFE, të trajtojë problematikën lidhur me detajimin në kode produkti/projekti për shpenzimet operative të aparatit të MFE apo edhe institucioneve të tjera, në mënyrë që të mundësohet një ndarje në projekte buxhetore të cilat përfaqësojnë aktivitetin e institucionit dhe që të jetë lehtësisht e zbatueshme nga ana e njësive shpenzuese. Veçanërisht për aparatit të MFE të shqyrtohet detajimi i fondeve vetëm në programe që lidhen me shpenzimet bazuar në aktivitetin e institucionit. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

7.2.Rekomandimi: Aparati i MFE në vijim të objektivave dhe produkteve nën programet të cilat ajo administron, dhe mënyrës së matjes së tyre sikundër trajtohet në raportet e monitorimit të MFE të marrë masa për kryerjen e shpenzimeve sipas produktit përkatës sipas shpenzimeve në qëllim të produkteve për të cilat janë alokuar fondet, në mënyrë që edhe analiza e performancës së produktit të reflektojë nivelin real të realizimit sipas planit. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

8.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpunësi autorizues nëpërmjet bashkërendimit të punës midis sektorit të burimeve njerëzore, sektorit të financës dhe sektorit të ankesave administrative dhe gjyqësore, të marrë masa për hartimin e një databaze të unifikuar të vendimeve gjyqësore dhe ta publikojë atë sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi në mënyrë që të rrisë transparencën dhe besueshmërinë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, si edhe të marrë masa për zbatimin e radhës së shlyerjes së detyrimeve për gjyq fituesit duke ndjekur radhën e paraqitjes së tyre në MFE nëpërmjet publikimit të databazës dhe grafikut të shlyerjes në faqen zyrtare të Institucionit. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

8.2.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet strukturave përkatëse në varësi të saj të marrë masa për rregullimin e situatës, duke nxjerrë udhëzim për rakordimin dhe shuarjen e këtyre detyrimeve të gjeneruara nga sistemi tatimor në mënyrë të padrejtë. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

9.1.Rekomandimi: Titullari i Njesisë apo Zyrtari i Autorizuar, Drejtori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, të marrin masa të duhura që; të krijojnë grupet e procesit të inventarizimit të aktiveve me qëllim verifikimin fizik të të gjitha aktiveve të Njesisë sipas dokumentacionit kontabël;

Drejtori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në cilësinë e Njësimit Zbatues, të hartojë dhe përditësojë regjistrin e të gjitha aktiveve, me qëllim evidentimin e saktë dhe të plotë të tyre në

pasqyrat financiare të Njësisë. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë lidhur me ngritjen e komisionit të inventarizimit, ndërsa regjistri i aktiveve rezulton të jetë hartuar në vitin 2022.

Ky rekomandim rezulton i zbatuar pjesërisht.

11.1.Rekomandimi: Në sistemin kontabël të MFE, në çdo rast që sillen praktikatat për shitje të aktiveve afatgjata të vlerësuara për t'u shitur dhe që kalojnë në procedurat e shitjes, të kryhet regjistrimi i aseteve sipas vlerës kontabël apo vlerës së tregut të përcaktuara nga komisioni përkatës. Në fund të çdo transaksioni shitje të evidentohet qartë arkëtimi, dhe humbja apo fitimi nga krahasimi i vlerës së shitjes me vlerën e aseteve në pasqyrat financiare. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

12.1. Rekomandimi: NA dhe NZ e MFE të marrin masa që të gjitha transferimet drejt të tretëve në formën e huadhënies afatshkurtër të kontabilizohen në llogaritë e debitorëve dhe arkëtimi i tyre të kontabilizohet si shlyerje nga këto debitorë dhe jo si e ardhur e realizuar e vitit ushtrimor. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

14.1.Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë të analizohen përgjegjësitë lidhur me anomalitë e konstatuara në raportimin e investimeve të huaja. Procesi i planifikimit të fondeve që angazhohen në projekte specifike të reflektojnë në çdo kohë kërkesat për përfshirjen në mënyrë të saktë të rasteve që angazhojnë shpenzime operative, në mënyrë që gabimet e bëra që në planifikimin fillestar të fondeve të mos mbarten deri në raportimin e ekzekutimit të tyre. Në rastet e ekzekutimit të fondeve, që transferohen nga të tjera njësi shpenzuese të kryhet konsolidimi, duke patur parasysh efektet rregulluese në raportim, ndërsa efektet e anomalive të konstatuara të pasqyrohen duke kryer veprimet sistemuese. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

15.1 Rekomandimi: Ministria e Financës dhe Ekonomisë në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrin masat e nevojshme për përfundimin e procesit të kalimit të aktiveve të sistemeve të informacionit nga MFE tek AKSHI, si dhe të përcaktojnë përgjegjësitë për vonesat e shkaktuara në zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me këtë çështje. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

16.1. Rekomandimi: Në pasqyrat financiare të MFE të pasqyrohen të gjitha shtesat e financimit të huaj, si pasojë e granteve të huaja dhe në të njëjtën kohë edhe përdorimi i tyre në krijimin e aseteve me vlerën e plotë të investimit përgjatë vitit apo në financimin e shpenzimeve operative. Raportimi i njësive që zbatojnë projektet mos të shikohet si një raportim më vete duke qenë se këto njësi janë brenda strukturës organike të MFE dhe nuk kanë pavarësi në raportim. Gjithashtu të regjistrohet vlera e plotë e investimit të kryer në çdo vit dhe jo vetëm pjesën e TVSH së asetit, pasi informacioni financiar nuk jep një pamje të drejtë vlerës reale të investuar përgjatë vitit. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

17.1. Rekomandimi: Nga AK të merren masat që projektet për punë në çdo rast të nënshtrohen, nga një strukturë kompetente shtetërore apo grup pune ekspertësh për këtë qëllim, vlerësimin e nevojave të domosdoshme sipas zërave dhe volumeve të punimeve dhe duke vlerësuar në vend ekonomikitetin e domosdoshmërinë e duke mundësuar realizimin e opionencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit konform legjisllacionit në fuqi. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

17.2. Rekomandimi: Të merren masat nga Njësia e Prokurimit e MFE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor që kërkesat specifike për kualifikim si pjesë e Dokumenteve Standarde të Tenderit, ti argumentojë një për një duke patur për bazë objektin e prokurimit si dhe zërat e volumet e punës të parashikuara në preventiv. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

18.1. Rekomandimi: Nga AK të merren masat, që në çdo rast në procedura të prokurimeve që zhvillon të studiojë dhe argumentojë afatin e realizimit të kontratës, në mënyrë që kontrata të jetë jo vetëm e nevojshme por dhe e mundshme për tu realizuar. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

19.1.Rekomandimi: Sektori i Prokurimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrë masat që kryerja e procedurave të prokurimit të kryhet duke dokumentuar çdo proces të procedurës, gjithashtu të kryejë procesin e verifikimit të dokumentacionit mbështetës përpara likuidimit të faturave të shpenzimeve. Sektori i Prokurimeve të marrë masat e duhura që në hartimin e regjistrave të prokurimit të analizojë dhe grupojë emërtimin e procedurave, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve. Nga auditimi konstatohet se paraqitet e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

20.1.Rekomandimi: Nga struktura drejtuese e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë të merren masat që auditimi i Pasqyrave Financiare, propozimi dhe miratimi i audituesve të autorizuar kontabël nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, të mund të përfundojë brenda muajit nëntor të vitit ushtrimor. Nga auditimi konstatohet se nga MFE po merren masa për përmbushjen e rekomandimit por për vitin 2022 rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

20.2.Rekomandimi: Nga struktura drejtuese e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë të merren masa për kërkimin e përgjegjësive për vonesat e parregullsitë në dokumentacion, në lidhje me rastet e miratimit të programeve të zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror nga Ministrinë e Linjës. Nga auditimi konstatohet se nga MFE po merren masa për përmbushjen e rekomandimit por për vitin 2022 rezulton e njëjta problematikë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

22.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të MFE-së, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

Nga auditimi është konstatuar se për vitin 2022 paraqiten sërish probleme të njëjta lidhur me sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

23.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa, në plotësimin e pozicioneve vakante të DAB. Nga auditimi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, rezulton se për vitin 2022 Drejtoria e Auditimit në MFE ka rezultuar sërish me të njëjtat vende vakante, duke mos u plotësuar përgjatë vitit.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

24.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa, në emërimin e anëtarëve të rinj të Komitetit të Auditit të Brendshëm. Nga auditimi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, rezulton se Titullari i Institucionit nuk ka emëruar anëtarët e Komitetit të Auditit të Brendshëm.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Nëpunësi Autorizues të marrë masa të menjëhershme për analizimin e të gjitha vendimeve gjyqësore dhe të nxjerrë përgjegjësitë ligjore e administrative ndaj personave shkaktar të krijimit të efektit financiar negativ në buxhetin e shtetit për largime të padrejta nga puna në zbatim të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018. Nga auditimi rezulton se paraqitet e njëjta situatë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

1.2.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrë masa për rregullimin e situatës së likuidimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre duke kryer likuidimet brenda afateve të përcaktuara në zbatim të kuadrit ligjor. Nga auditimi rezulton e njëjta situatë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar.

2.A.3 Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Publik.

MFE me shkresën nr. 169/13 prot., 29.09.2022 drejtuar KLSH “Dërgohet plani i masave sipas rekomandimeve të KLSH në raportin përfundimtar”, bashkëlidhur planin e masave, ka informuar KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, **brenda afatit** kohor prej 20 ditë, referuar nenit 15, shkronja “j” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Përmes shkresës nr. 169/14 Prot., datë 06.03.2023, me subjekt “Qëndrimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Publik (DHKBFP) mbi Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet”, MFE ka dërguar pranë KLSH raportimin në lidhje me qëndrimin e saj përse i përket konstatimeve dhe rekomandimeve të KLSH-së, **brenda afatit** prej 6 muajsh, si dhe planin e masave që janë kërkuar të merren prej këtij institucioni adresuar këto me shkresën nr. 19/9, datë 09.09.2022 të KLSH-së sipas programit të auditimit nr. 19/1, datë 14.01.2022, i ndryshuar, “Mbi përputhshmërinë në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Publik, në Ministrinë e Financave”.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, rezulton se megjithëse janë pranuar në masën 95%, janë zbatuar plotësisht 13 masa ose 68.4%, pjesërisht 1 masë ose në masë 5.2%, është në proces 1 masë ose 5.2% e tyre dhe pa u zbatuar 4 masa ose 21.2% e tyre. Statusi i zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

a. 20 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 19 masa organizative, 13 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht, 2 masa rezulton në proces zbatimi dhe 5 masa rezultojnë të pazbatuara.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të përmbledhur ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve.

Tabela 3: Përmbledhje e pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH.

Rekomandimi	Nr.	Pa pranuar	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa Organizative	20	1	19	13	-	2	4
Totali	20	1	19	13	-	2	4

Burimi: Grupi i auditimit, KLSH.

Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH rezultoi si më poshtë:

5.2. Rekomandimi: DHAB të marrë masa për të propozuar pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, ndryshime në Ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin

publik”, për vendosjen e penalteteve për titullarët që nuk kanë plotësuar strukturën e NJAB-së në përputhje me parashikimet ligjore. Grupi i auditimit konstaton se siç parashtrahet edhe në qëndrimin e DH/AB, edhe pse rekomandimi është pranuar nga kjo strukturë, në Ligjin nr. 12, datë 02.02.2023 nuk është parashikuar vendosja e masës së penaltetit për titullarët që nuk plotësojnë strukturën e NJAB.

Ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

7.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit të AB-së, të merren masa për një analizë sa më objektive të gjendjes së NJAB-së, ku pyetësorët e vetëvlerësimit të mos jenë të vetmit instrument i vlerësimit të indikatorëve 15-18, me qëllim që analiza me rezultatet e pambledhura të pyetësorëve të vetëvlerësimit si pjesë e raportit të shërbejë për rritjen e efektivitetit të këtyre strukturave.

Grupi i auditimit konstaton se për vitin 2022 vlerësimi i NJAB ka konsistuar në vlerësimin e indikatorëve të sipërpërmendur.

Ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar

12.1. Rekomandimi: Të merren masa nga Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e NPA, për shqyrtimin dhe vlerësimin e subjekteve të cilat nuk kanë depozituar deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të KB të njësisë së tyre me qëllim vendosjen e sanksioneve/gjositjen e parashikuar nga neni 29, pika 1 e ligjit të MFK, i ndryshuar.

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të dokumentacionit konstaton se nga ana e DH/MFKK janë dërguar shkresa përkatëse drejt subjekteve të cilat nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm, por nuk rezulton që nga ana e MFE të jenë vendosur sanksione përgjatë vitit 2022.

Ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

13.1. Rekomandimi: DHKBFP të marrë masa për miratimin e formatit tip/strukturës së raportit vjetor të kontrollit të brendshëm financiar publik ku të përfshijë dhe rubrikën “opinion” e cila të jetë shprehje e qartë e vlerësimit përfundimtar mbi efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Grupi i auditimit konstaton se Ligji për MFK është përmirësuar përmes Ligjit nr. 14, datë 16.02.2023, dhe gjithashtu Manuali i MFK është në proces rishikimi.

Ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

17.1. Rekomandimi: DH/MFKK të marrë masa që monitorimet/vlerësimet e cilësisë të kryera gjatë vitit të realizohen në mënyrë dhe afat kohor të tillë që të reflektojnë në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm për të qenë pjesë e Raportit Vjetor të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik të vitit përkatës.

Grupi i auditimit konstaton se në Raportin Vjetor 2022 bëjnë pjesë dhe institucionet për të cilat vlerësimi i cilësisë është kryer për vitin 2021, duke ndikuar në paraqitjen e gjendjes reale për vitin 2022.

Ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

19.1. Rekomandimi: DPH/KBFP si strukturë përgjegjëse për raportimin dhe monitorimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, të marrë masa që në pyetësorët e vetëvlerësimit dërguar njësive publike, të jetë një seksion ku të identifikohet viti në të cilën njësia duhet të paraqesë planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe numri i njësive të varësisë të cilët kanë raportuar dhe me të cilët është konsoliduar pyetësori.

Grupi i auditimit konstaton se për vitin 2022 nga DH/MFKK është kërkuar edhe evidenca e mësipërme.

Ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

Për sa trajtuar në këtë pjesë, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur observacione përmes shkresës nr. 5854/50 Prot., datë

07.09.2023, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 281/25 Prot., datë 11.09.2023, ku subjekti pretendon si në vijim:

Qëndrimi i subjektit:

- Në vijim të rekomandimit A.3.1, mbetemi në qëndrimin e mëparshëm duke mos e pranuar këtë rekomandim.
- Lidhur me rekomandimin A.6.1, nuk janë marrë parasysh shpjegimet e dhëna nga ana e MFE mbi argumentimin se AN të vitit 2021 janë mbështetur në kushtet e nevojës dhe emergjencës.
- Mbi rekomandimin A.6.2, DPB nuk bën rakordime ditore me DPTH për treguesit fiskalë. Nga ana jonë është evidentuar dhe paraqitur pranë DPTH mosrakordimi i planit të buxhetit operativ.
- Sa i takon rekomandimit A.8.1, ky rekomandim rezultoi i zbatuar me miratimin e Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023.
- Mbi rekomandimin A.20.1, monitorimi i detyrimeve të prapambetura realizohet me anë të sistemit SIFQ. DPB ka kërkuar bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në MFE për krijimin e detyrimeve të prapambetura me qëllim përfshirjen e tyre në dy tabela të publikuara të detyrimeve të prapambetura.
- Lidhur me rekomandimin B.5.1, rekomandimi është pranuar dhe zbatuar plotësisht.

Qëndrimi i grupi të auditimit:

Bashkëlidhur observacionit, lidhur me rekomandimet për të cilat subjekti ka paraqitur kundërshtime, nuk është paraqitur asnjë dokumentacion që të kundërshtojë gjetjet e grupit të auditimit, përpos faktit që gjatë auditimit janë paraqitur të njëjtat problematika. Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Titulli i gjetjes:	Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm
Situata:	<p>Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, rezultoi se Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) me shkresën nr. 6262/55, datë 25.04.2023, ka paraqitur planin e masave, jashtë afatit 20 ditë, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Ndërsa me shkresën nr. 6262/56, datë 09.05.2023, ka dërguar informacion mbi zbatimin e rekomandimeve, jashtë afatit 6 mujor, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 30 pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.</p> <p>Rezultoi se KLSH me shkresën nr. 364/18, datë 30.09.2022 ka lënë gjithsej 45 rekomandime: 38 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 36 masa organizative, nga të cilat 2 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht, 5 masa organizative rezultojnë në proces zbatimi dhe 29 masa organizative rezultojnë të pazbatuara; 5 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 3 masa nuk janë zbatuar; 1 masë administrative e cila është pranuar, por rezultoi e pazbatuar; 1 masë disiplinore lënë në kompetencë të titullarit, e cila është pranuar, por rezultoi e pazbatuar.</p> <p>b. Nga auditimi i ushtruar në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e rekomandimeve, konstatohet se MFE nuk ka dërguar planin e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe informacionin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.</p> <p>Rezultoi se nga KLSH me shkresën nr. 363/11, datë 30.09.2022 janë lënë gjithsej 32 rekomandime: 30 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 30 masa organizative, 4 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht, 1 masë organizative rezultoi e zbatuar pjesërisht dhe 25 masa organizative rezultojnë të pazbatuara; 2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat nuk janë zbatuar.</p>

	c. Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Publik për zbatimin e rekomandimeve, konstatohet se MFE me shkresën nr. 169/13, datë 29.09.2022 ka hartuar planin e masave, brenda afatit kohor. Ndërsa me shkresën nr. 169/14, datë 06.03.2023, ka dërguar raportimin në lidhje ecurinë e rekomandimeve, brenda afatit 6 mujor. Rezulton se nga KLSH me shkresën nr. 19/9, datë 09.09.2022, janë lënë 20 rekomandime të llojit masa organizative, nga të cilat janë pranuar 19 masa organizative, nga të cilat 13 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht, 2 masa rezultojnë në proces zbatimi dhe 5 masa rezultojnë të pazbatuara.
Kriteri:	Ligji nr. 154.2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j” dhe “k” dhe pika 2 e nenit 30.
Shkaku:	Neglizhenca e nëpunësit autorizues në marrjen e masave të duhura për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.
Impakti:	Nga mos zbatimimi i rekomandimeve të lëna situata nuk ka përmirësim, problematikat vazhdojnë të jenë evidente.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi	Nëpunësi i Parë Autorizues të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme, si dhe rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve që janë të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe përshtetimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe forcimin e disiplinës buxhetore dhe fiskale.

2.B. Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.

2.B.1. Mbi procesin e planifikimit në drejtim të përgatitjes së dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe Projekt Buxhetit vjetor 2022, kryerja e analizave dhe dhënia e rekomandimeve për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ndjekja e regjistrimit të kërkesave buxhetore të PBA 2022-2024 të njërive të qeverisjes qendrore, përmes sistemit.

Procedura nga Kuadri Makro, PBA, Projekt Buxhet dhe Buxhet

Nga auditimi u konstatua se kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike është përgatitur dhe propozuar për miratim Këshillit të Ministrave me shkresën nr. 352 prot., datë 11.01.2021. Sa më sipër u konstatua se kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike është miratuar me VKM nr. 15, datë 20.01.2021. Ky veprim nuk është në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet: “*Ministri i Financave përgatit dhe i propozon Këshillit të Ministrave kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, duke përcaktuar me hollësi afatet e procesit të menaxhimit të shpenzimeve publike. Kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike miratohet, si pjesë përbërëse e kalendarit të planifikimit strategjik, nga Këshilli i Ministrave dhe bëhet efektiv në ditën e parë të çdo viti*”, si dhe nuk është në përputhje me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, pika 3.1 dhe 3.2, ku citohet: “1. *Ministri i Financave në fund të çdo viti buxhetor përgatit projektvendimin për kalendarin e Menaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin e ardhshëm buxhetor, për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm për njësitë e qeverisjes qendrore. 2. Këshilli i Ministrave miraton kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike për njësitë e qeverisjes qendrore si pjesë përbërëse të kalendarit të planifikimit strategjik*”. Sipas pikës 2 të këtij vendimi “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2021”, ndërkohë VKM mban datën 20.01.2021. Sipas kalendarit, janë miratuar 3 veprime me data përpara marrjes së këtij vendimi, ndër të cilat edhe datat e përgatitjes e paraqitjes së kalendarit në KM, si dhe miratimi i tij. *Data e përcaktuar në kalendar për miratimin e kalendarit të MSHP është 06.01.2021, ndërkohë VKM-ja ka datën 20.01.2021.*

Kuadri Makroekonomik e Fiskal.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur Kuadrin Makroekonomik e Fiskal në Këshillin e Ministrave me shkresën nr. 149, datë 06.01.2021, në përputhje me nenin 23 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe me kalendarin e MSHP ku përcaktohet data 13 Janar.

Kuadri Makroekonomik e Fiskal është miratuar me VKM nr. 7, datë 13.01.2021, në përputhje me nenin 23 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar dhe me kalendarin e MSHP.

Tavanet përgatitore të PBA-së 2022-2024.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2022-2024 për fazën strategjike, në Këshillin e Ministrave me shkresën nr. 3091, datë 15.02.2021, në përputhje me afatin e caktuar në kalendarin e MSHP, ku si afat përcaktohet data 15 Shkurt. Tavanet përgatitore të PBA 2022-2024, për fazën strategjike, janë miratuar me VKM nr. 119, datë 03.03.2021, në tejkalim të afatit të caktuar në kalendarin e MSHP, ku përcaktohet data 24 Shkurt. Gjithashtu, ky veprim nuk është në përputhje me pikën 3.1.7 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” ku citohet: “*Ministri i Financave, përgatit tavanet përgatitore të shpenzimeve për njësitë e qeverisjes qendrore për tre vitet e ardhshme të cilat dërgohen për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave brenda muajit shkurt.*”

Udhëzimi i Përgatitjes së Buxhetit.

Në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 i ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka miratuar Udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”. Sipas këtij Udhëzimi, saktësisht në pikën 2, citohet: “Tavanet përgatitore të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e PBA 2022-2024, janë miratuar me VKM nr. 119, datë 03.03.2021 “Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2022-2024”, në nivel programi dhe gjendet bashkëlidhur këtij udhëzimi”.

Pra, udhëzimi për përgatitjen e PBA-së, është miratuar në shkelje të afatit të përcaktuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008. Saktësisht: Neni 24 “Udhëzimi për përgatitjen e buxhetit”, citon: “*Ministri i Financave, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të vlerësimeve dhe parashikimeve makroekonomike dhe buxhetore, brenda muajit shkurt miraton dhe dërgon për zbatim në njësitë e qeverisjes së përgjithshme udhëzimin për përgatitjen e buxhetit*”.

Edhe pse udhëzimi në letër mban datë brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar, faktikisht ky akt ka dalë më vonë, vërtetuar kjo me datën e Vendimit të Këshillit të Ministrave. Kjo tregon se nga ana e MFE-së është vepruar për formalizëm të veprimtarisë, duke mos shqyrtuar, analizuar dhe vepruar në përputhje me procedurat dhe afatet e përgatitjes së buxhetit.

Nga sa më sipër, konstatohet se udhëzimi mban datën 26.02.2021 dhe i referohet një Vendimi të Këshillit të Ministrave me datë më të mëvonshme konkretisht 03.03.2021. Në këto kushte rezulton se data e vendosur në udhëzim nuk është reale.

Projekt dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024.

Me shkresën nr. 11089 datë 22.06.2021, Ministri i Financave ka paraqitur për miratim Këshillit të Ministrave projektin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm. Ky veprim është në përputhje me nenin 25 të ligjit 9936 datë 26.06.2008. Këshilli i Ministrave ka miratuar projekt dokumentin e PBA-së 2022-2024 me VKM nr. 442 datë 22.07.2021.

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2022-2024.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2022-2024, në Këshillin e Ministrave me shkresën nr. 11090 prot., datë 22.06.2021, në përputhje me afatin e caktuar në kalendarin e MSHP, ku si afat përcaktohet data 22 qershor. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2022-2024, janë miratuar me VKM nr. 440, datë 22.07.2021 “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit

buxhetor afatmesëm 2022-2024”, veprim i cili nuk është në përputhje me afatin e caktuar në kalendarin e MSHP, ku përcaktohet data 30 qershor.

Udhëzimi plotësues i përgatitjes së Buxhetit

Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka miratuar Udhëzimin plotësues nr. 19, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Dokumenti i rishikuar i PBA 2022-2024

Ministri i Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 17300 prot., datë 12.10.2021 ka paraqitur për shqyrtim në Këshillin e Ministrave Projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022” si dhe me shkresën nr. 17301 datë 12.10.2021 dokumentin e rishikuar të PBA 2022-2022, në përputhje me afatin e caktuar në kalendarin e MSHP, ku si afat përcaktohet data 5-12 tetor. Dokumenti i rishikuar i PBA 2020-2022, është miratuar me VKM nr. 735, datë 03.12.2021 “Për miratimin e Projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, të rishikuar”, veprim i cili nuk është në përputhje me nenin 29 “Projektbuxheti vjetor”, ku citohet: “Brenda datës 25 tetor, Këshilli i Ministrave miraton me vendim, projektbuxhetin vjetor dhe programin buxhetor afatmesëm, të rishikuar”, si dhe pikën 3.2.5 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, ku citohet: “Projekt dokumenti i programit buxhetor afatmesëm, i rishikuar, së bashku me projektligjin e buxhetit vjetor paraqiten nga Ministri i Financave për miratim brenda datës 10 tetor në Këshillin e Ministrave”.

Paketa fiskale 2022 dhe efekti në ligjin e buxhetit.

Në 25 nëntor 2021 së bashku me projektbuxhetin e vitit 2022 është miratuar dhe paketa fiskale 2022. Paketa fiskale pati ndërhyrje në:

-Ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili ndryshoi me ligjin nr. 113/2021, datë 25.11.2021 ku u ndryshua skema e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi. Konkretisht u rrit paga dysheme e pa tatueshme nga 30 mijë në 40 mijë lekë, u përgjysmua tatimi për kategorinë nga 40 mijë lekë deri në 50 mijë lekë dhe u vendos aplikimi i normës tatimore 23% për paga mbi 200 mijë lekë nga 150 mijë lekë që ishte në fuqi. Heqja e normës së reduktuar 5% për personat juridik që ushtrojnë aktivitetet për prodhim zhvillim software-ve.

-Ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i cili ndryshoi me ligjin nr. 111/2021, datë 25.11.2021 ku u ndryshua neni 49, pika 10 “Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e inpueteve bujqësore, ku përfshihen plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, me përjashtim të hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave, është 10%. Lista e kategorive të inpueteve bujqësore, sipas këtij neni, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

U ndryshua neni 56 “Përjashtime të veçanta në import”, pika 38 “Importimi i makinerive dhe pajisjeve: a) në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më tëmadhe se 500 milionë lekë (nga 50 milion që ishte);

U ndryshua neni 148 ku: Norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë u bë 0% nga 6%.

-Ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i cili ndryshoi me ligjin nr. 114/2021, datë 25.11.2021 ku u ndryshua “akciza e llogaritur sipas pikës 2 të këtij neni, indekskohet çdo dy vjet në masën e normës zyrtare të inflacionit për dy vitet paraardhëse shpallur nga INSTAT-i, me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve të tij, për të cilat akciza aplikohet sipas kalendarit specifik të përcaktuar në shtojcën nr.1 që i bashkëlidhet ligjit.”

Unifikimin e akcizës për “Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike”. Duke filluar nga 1 korriku 2022, të gjithë konsumatorët kanë të njëjtin nivel taksimi si për përdorim vetjak

ashtu dhe për qëllime biznesi. Pra aplikohet shkalla e taksimit me akcizë 6 lekë/litri, me qëllim shmangien e mundësisë për abuzim dhe mospagim të detyrimeve të akcizës.

Heqja e rimbursimit të Akcizës së lëndëve djegëse për fermerët dhe industrinë agroindustriale (përveç peshkimit) me efekt nga 1 janari 2024.

-Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i cili ndryshoi me ligjin nr. 112/2021, datë 25.11.2021 ku u ndryshua: Taksa për importimin dhe prodhimin e qumështit pluhur është në vlerën 100 lekë/kg; Taksa për importimin dhe prodhimin e pijeve të homogjenizuara është në vlerën 16 lekë/litër; Taksa për importimin dhe prodhimin e hirrës së qumështit është në vlerën 150 lekë/litër; Taksa për importimin dhe prodhimin e krem qumështit është në vlerën 150 lekë/litër; Taksa për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare, është në vlerën 40 lekë/litri.

Efektet e politikave fiskale.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të vendosur në dispozicion, nga analizat e realizuara është parashikuar që politikat fiskale të vitit 2022 të kenë efektet si në vijim:

-Nga heqja e skemës së kompensimit të prodhuesit bujqësor për qëllime të TVSH (nga 6% në 0%), parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 750 milionë lekë në vit.

-Vendosje e normës së reduktuar 10% të TVSH-së për furnizimin e inpleteve bujqësore, parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 900 milionë lekë në vit.

-Përrjashtimi i TVSH-së në importimin e makinerive dhe pajisjeve në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë (nga 50 milion që është aktualisht), parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 400 milionë lekë në vit.

-Ndryshimi i tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat nga ky tatim me rreth 340 miliardë lekë në vit.

-Indeksimi çdo dy vjet i taksës specifike të akcizës me normën e shpallur të inflacionit, parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 500 milion lekë në vit.

-Ndryshimi i shkallës së taksimit për kategorinë T200, “Cigare që përmbajnë duhan”, duke aplikuar kalendarin për 4 vitet në vijim, dhe nga ndryshimi i akcizës së nënprodukteve të tjera të duhanit, parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 750 milionë lekë në vit.

-Unifikimi i akcizës së aplikueshëm gazit të lëngshëm si për konsumatorin privat ashtu edhe tregtar në masën 6 lekë/litër, parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat me rreth 375 milionë lekë në vit.

-Vendosjen e taksës prej për importimin ose prodhimin e qumështit pluhur, parashikohet të kemi një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me 50 milion lekë në vit.

-Vendosja e taksës kombëtare për karburantin e furnizuar në zonat e lira (për ri eksport) 65 lekë/litri, parashikohet të ketë një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me +1,35 miliardë lekë në vit.

-Abrogim i shfuqizimit të lojërave të fatit baste sportive dhe (rikthimi i tyre), parashikohet të ketë një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me +3,5 miliardë lekë në vit.

-Taksa suplementare mbi lojërat e fatit, parashikohet të ketë një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me +1,5 miliardë lekë në vit.

Sa më sipër, lidhur me efektet e parashikuara të paketës fiskale 2022, konstatohen mospërputhje ndërmjet të dhënave të vendosura në dispozicion me email dhe raportit të zbatimit të buxhetit për vitin 2022. Konkretisht:

- Përrjashtimi i TVSH-së në importimin e makinerive dhe pajisjeve në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë (nga 50 milion që është aktualisht), nuk pasqyrohet në tabelën 8.2 Shtojca 2-Efektet e paketës fiskale 2022 të raportit të zbatimit të buxhetit;

-Ndryshimi i tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi parashikohet të rezultojë me një efekt financiar në të ardhurat nga ky tatim me rreth 340 miliardë lekë në vit, sipas relacionit ndërsa sipas tabelës të pasqyruar në raport “Rritja e bazës së pa tatueshme për efektin e tatimit mbi të ardhurat personale 30 000 lekë në 40 000 lekë parashikohet të ketë efekt -1 miliardë lekë;

- Efekti për vendosjen e taksës për importimin ose prodhimin e qumështit pluhur, nuk pasqyrohet në tabelën 8.2 Shtojca 2-Efektet e paketës fiskale 2022 të raportit të zbatimit të buxhetit;

-Vendosja e taksës kombëtare për karburantin e furnizuar në zonat e lira (për ri eksport) 40 lek/litri, parashikohet të ketë një efekt financiar pozitiv në të ardhurat e shtetit me +1,35 miliardë lekë në vit, sipas relacionit ndërsa sipas tabelës të pasqyruar në raport parashikohet të ketë efekt +0.8 miliardë lekë;

-Abrogim i shfuqizimit të lojërave të fatit baste sportive dhe (rikthimi i tyre), nuk pasqyrohet në tabelën 8.2 Shtojca 2-Efektet e paketës fiskale 2022 të raportit të zbatimit të buxhetit;

-Taksa suplementare mbi lojërat e fatit, nuk pasqyrohet në tabelën 8.2 Shtojca 2-Efektet e paketës fiskale 2022 të raportit të zbatimit të buxhetit;

Nga verifikimi i relacionit të projektbuxhetit 2022 të parashikimi i të ardhurave për vitin 2022 evidentohet se për zërin “Të ardhurat nga TVSh-ja” dhe “Të ardhurat nga Tatim Fitimi” një element i rritjes së parashikuar është efekti i paketës fiskale 2022. Këto ndryshime të ligjeve tatimore janë reflektuar në parashikimin e buxhetit të vitit 2022.

Hartimi i paketës fiskale jo në përputhje me pikën 3, neni 4/1 të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, i ndryshuar ku citohet: “Ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal. Ligjet tatimore konsultohen paraprakisht me përfaqësuesit e biznesit dhe grupe të tjera interesi, në strukturat e ngritura për këtë qëllim.”

Konkluzion: Lidhur me politikën fiskale 2022 miratimi i saj është bërë në datën 25 nëntor 2021 së bashku me projektbuxhetin e vitit 2022 në kundërshtim me pikën 3, neni 4/1 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar ku citohet: “Ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal. Ligjet tatimore konsultohen paraprakisht me përfaqësuesit e biznesit dhe grupe të tjera interesi, në strukturat e ngritura për këtë qëllim.”

Zbatimi i afateve dhe përputhja me kërkesat për hartimin e PBA nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Kryerja e analizave të PBA 2022-2024 dhe dhënia e rekomandimeve për njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Sipas Udhëzimit nr. 8, datë 26.02.2021 për “Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm”, pika 4 “Të gjitha njësitë e Qeverisjes Qendrore, do të përgatisin kërkesa buxhetore për PBA 2022-2024, përmes sistemit AFMIS dhe moduleve respektive të përgatitjes së PBA dhe PIM. Raportet e kërkesave buxhetore të gjeneruara përmes sistemit AFMIS do të dorëzohen zyrtarisht në Ministrinë përgjegjëse për financat.”

Nga auditimi u konstatua se njësitë e qeverisjes qendrore kanë përgatitur kërkesat buxhetore përmes sistemit AFMIS, përveç institucioneve buxhetore të grupit 63 “Institucione të sistemit të drejtësisë” dhe grupit 87 “Institucione të tjera qeveritare” përgatitja e kërkesave buxhetore të cilave për fazën strategjike dhe teknike bashkë është përgatitur jashtë sistemit AFMIS.

Nga vlerësimi dhe auditimi mbi bazë risku, duke marrë parasysh planifikimin më të lartë buxhetor u kërkuan praktikatat e kërkesave buxhetore në fazën strategjike dhe fazën teknike të

Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u verifikuan afatet e dorëzimit dhe zbatimi i kërkesave të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Faza I

Me shkresën nr. 7654/1 prot., datë 04.05.2021, Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 për fazën strategjike.

Për këto kërkesa buxhetore ka analizë nga MFE të përcjella me shkresën nr. 11001/61, datë 21.06.2021, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, pika 2.2/4, ku cilësohet: “Nën drejtimin e nëpunësit të parë autorizues, njësia përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë përgjegjëse për financat, analizon dhe vlerëson kërkesat buxhetore dhe përgatit një raport me konkluzione dhe rekomandime për secilën njësi të qeverisjes qendrore. Ky raport paraqitet në seancat dëgjimore, që organizohen në Ministrinë përgjegjëse për financat, me secilën njësi të qeverisjes qendrore sipas një kalendari të paracaktuar.” Si dhe në përputhje me udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Nga grupi i auditimit u konstatua se, për fazën e parë të PBA-së 2022-2024 MFE ka paraqitur kërkesa buxhetore në tejkallim të tavanit të miratuar me VKM nr. 119, datë 03.03.2021. Kërkesat buxhetore janë paraqitur në vlerën 69,199,914 mijë lekë ndërkohë që tavani i miratuar rezulton në vlerën 68,463,484 mijë lekë me një diferencë prej 736,430 mijë lekë. Kjo problematikë nuk është reflektuar në analizën e realizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Mungojnë relacionet shpjeguese apo pasqyrat plotësuese për një pjesë të programeve.

Gjithashtu konstatohet se ka mospërputhje ndërmjet kërkesave shtesë të disa programeve të MFE-së sipas relacioneve të dokumentuara dhe të vëna në dispozicion në hard copy me të dhënat sipas Aneksit 4 “Kërkesat shtesë 2022-2024”, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë. Në kërkesat buxhetore të paraqitura për MFE evidentohet se për disa programe, projektet e planifikuara nuk janë të lidhura me qëllimin e politikës. Konkretisht:

- Për programin 01140 “Menaxhimi i të ardhurave tatimore” me projektin 91004AC-Vendime gjyqësore të ekzekutuara;
- Për programin 01150 “Menaxhimi i të ardhurave doganore” me projektin 91005AB-Vendime gjyqësore të ekzekutuara.

Faza II

Me shkresën nr. 14999/12 prot, datë 01.09.2021, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit PBA-në 2022-2024 për fazën teknike. Për këto kërkesa buxhetore ka analizë nga MFE të përcjella me shkresën nr. 16924/19 datë 05.10.2021, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, pika 2.2/4.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Faza I

Me shkresën nr. 3860 prot., datë 04.05.2021, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë *relacionin për dokumentin e PBA 2022-2024*, ndërsa dërgimi i kërkesave për programet “Mbështetje për energjinë” dhe “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane” në fazën strategjike është në tejkallim të

afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, si dhe me kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, ku afati për dorëzimin e kërkesave buxhetore në këtë fazë është data 4 maj.

Me shkresën nr. 11001/60 prot., datë 21.06.2021 i është dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë analiza e realizuar nga MFE për PBA 2022-2024 faza I. Nga grupi i auditimit konstatohet se ka mospërputhje ndërmjet kërkesave shtesë të disa programeve të MIE-së sipas relacioneve të dokumentuara dhe të vëna në dispozicion në hard copy me të dhënat sipas Aneksit 4 “Kërkesat shtesë 2022-2024”, i cili gjendet i publikuar në faqen e Ministrisë.

Në kërkesat buxhetore të paraqitura nga MIE evidentohet se për disa programe, projektet e planifikuara nuk janë të lidhura me qëllimin e politikës. Konkretisht:

- Për programin 045500 “Transporti Hekurudhor” (me qëllim politike integrimin e sistemit hekurudhor shqiptar me atë rajonal dhe evropian në nivel administrativ dhe nivel tekniko-funksional) projekti 18BJ104- Pajisje zyre për DP Hekurudhave, projekti 18BJ105-Pajisje informatike DP Hekurudhave, 18BJ106-Pajisje zyre për Drejtorinë e Inspektimit Hekurudhor, 18BJ107-Pajisje informatike për Drejtorinë e Inspektimit Hekurudhor;

- Për programin 06180 “Planifikimi Urban” projekti 18BM912– Projekti i GIZ, Lëvizja urbane miqësore ndaj mjedisit në Bashkinë Tiranë.

Faza II

Me shkresën nr. 6894/1 prot., datë 01.10.2021, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë rishikimin e prioriteteve buxhetore për programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 për fazën teknike. Afati i dorëzimit është në kundërshtim me afatet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”. *Si fazë e dytë e PBA-së janë dorëzuar kërkesat buxhetore të rishikuara pas shkresës së rishikimit të prioriteteve.* Institucioni ka paraqitur në relacion kërkesa që mund të kalojnë tavanet e miratuara. Me shkresën nr. 16924/18 prot., datë 05.10.2021 i është dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë analiza e realizuar nga MFE për PBA 2022-2024 faza II.

Për fazën e dytë të PBA-së 2022-2024 MIE ka paraqitur kërkesa buxhetore në tejkallim të tavanit të miratuar me VKM nr. 440, datë 22.07.2021. Kërkesat buxhetore janë paraqitur në vlerën 38,551,776 mijë lekë ndërkohë që taverani i miratuar rezulton në vlerën 38,524,176 mijë lekë me një diferencë prej 27,600 mijë lekë.

Në kërkesat buxhetore të paraqitura nga MIE evidentohet se për disa programe, projektet e planifikuara nuk janë të lidhura me qëllimin e politikës. Konkretisht:

- Për programin 04520 “Transporti Rrugor” projekti 18CD5-Përmirësim i dhomës së serverave të ARRSH-së;

- Për programin 04430 “Mbështetje për burimet natyrore” projekti 18BI208-Azhornim Gjeohapësinor i hapësirave që krijohen nga shfrytëzimi minerar nëntokësor;

- Për programin 06180 “Planifikimi Urban” projekti 18BM906-Hartimi i Standardeve të Projektimit të spitaleve dhe klinikave mjekësore.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Faza I

Me shkresën nr. 1375/1, datë 30.04.2021 të MSHMS janë dërguar kërkesat për PBA 2022-2024 në MFE. Konkretisht, MSHMS ka paraqitur kërkesa buxhetore shtesë 16.4 miliardë lekë për shpenzime korrente. Me shkresën nr. 11001/58 prot., datë 21.06.2021 i është dërguar Ministrisë analiza e realizuar nga MFE për PBA 2022-2024 faza I. Në kërkesat buxhetore të paraqitura nga MSHMS evidentohet se për disa programe, projektet e planifikuara nuk janë të lidhura me qëllimin e politikës. Konkretisht:

- Për programin 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” (me qëllim politike sigurimin e një kujdesi shëndetësor dhe mbrojtjes sociale sipas standardeve të BE-së) projekti M133696-Kosto lokale për PIUn (Njësia e zbatimit të projekteve të huaja);

- Për programin 07220 “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor” (me qëllim politike mbulimin universal të nevojave të popullatës për kujdes mjekësor parësor) projekti M130334-TVSH për projektin “Rikonstrukcion dhe pajisje 5 poliklinikave”-kredi e qeverisë italiane -Kredi;

- Për programin 10430 “Përkujdesja Sociale” (me qëllim politike ndërtimin e një sistemi mbrojtje sociale nëpërmjet politikave dhe mekanizmave për të mbrojtur individët në nevojë) projekti 91307AD- “Bonusi i bebeve”.

Faza II

Ndërsa kërkesat për PBA 2022-2024 për fazën teknike janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021.

Kërkesat buxhetore shtesë

Bazuar në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, institucionet buxhetore kanë dërguar në MFE kërkesat buxhetore shtesë mbi tavanet e miratuar për financimin e politikave aktuale ose të reja, të cilat për vitin 2022 kanë një vlerë prej rreth 103,045 milion lekë, të detajuara sipas institucioneve si më poshtë:

Tabela : Ndryshimet e kërkesave buxhetore 2022 të ministrive sipas fazave të PBA-së në mijë lekë

Institucioni	Tavanet VKM 119 datë 03.03.2021	PBA Faza I		Tavanet VKM 440 datë 22.07.2021	PBA Faza II		Projekt Buxhet 2022	Ligji 115/2021	PBA Faza III	
		Shpenzime Total	Kërkesa shtesë		Shpenzime Total	Projekt Buxhet 2022			Shpenzime Total	
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	11,059,064	11,059,064	5,933,103	10,772,064	10,772,064	12,736,369	12,736,369	12,736,369	12,736,369	
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	39,464,176	39,409,342	44,322,580	38,524,176	38,551,776	47,448,724.7	47,471,724.7	47,471,724.7	32,868,122.3	
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	68,463,484	69,199,914	3,194,981	68,228,483.7	67,948,859	65,273,059	65,473,059	65,473,059	65,473,059	
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	47,225,400	47,225,400	4,584,000	45,224,917	45,224,917	45,658,347	45,458,347	45,458,347	45,458,347	
Ministria e Kulturës	2,366,760	2,366,760	2,789,183	2,246,760	2,246,760	4,112,259.5	4,312,259.5	4,312,259.5	4,312,260	
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	66,039,599	66,039,599	16,629,913	69,971,737.9	69,971,738	77,075,882	77,075,882	77,075,882	77,075,882	
Ministria e Drejtësisë	11,584,832	11,584,832	2,359,447	11,584,832	11,584,832	11,778,132	11,280,132	11,280,132	11,280,132	
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme	2,897,747	2,897,747	617,975	2,897,747	2,897,747	3,142,143	3,120,143	3,120,143	3,120,143	
Ministria e Brendshme	21,728,268	21,718,268	10,154,219	21,628,268	21,628,268	21,191,400	21,191,400	21,191,400	21,191,400	
Ministria e Mbrojtjes	31,606,605	31,606,605	1,905,466	31,606,604.5	31,564,205	32,632,805	32,632,805	32,632,805	32,632,805	
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2,418,720	2,205,790	-	2,378,720,	2,378,720	2,919,460	2,439,460	2,439,460	2,439,460	
Totali	304,854,655	305,313,321	92,490,867	305,064,310.1	304,769,886	323,393,881.2	323,191,581.2	323,191,581.2	303,387,979.3	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës më sipër, evidentohet se Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së parë të planifikimit të PBA-së nuk ka respektuar tavanin e miratuar sipas VKM nr. 119, datë 03.03.2021. Institucionet kanë paraqitur kërkesa shtesë, ku sipas Aneksit 4 të publikuar vlera e kërkesave për Ministrinë rezulton 92,490,867 mijë lekë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka përcjellë kërkesa buxhetore shtesë në tejkallim edhe të vetë planifikimit të fazës së parë duke humbur kështu edhe nocionin e procedurës “kërkesë shtesë”. Evidentohet se tavanet përfundimtare sipas VKM-së nr. 440, datë 22.07.2021 janë miratuar më pak edhe se faza e parë e PBA-së. Gjatë fazës së dytë evidentohet se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka respektuar tavanin e miratuar sipas VKM-së nr. 440, datë 22.07.2021. Në projekt Buxhet vlera e planifikuar për ministrinë rezulton 323,393,881.2 mijë lekë dhe sipas ligjit të buxhetit është çelur në vlerën 323,191,581.2 mijë lekë. Sipas axhustimeve të bëra pas daljes së ligjit të buxhetit me fazën e III të PBA-së vlera e rishikuar rezulton 303,387,979.3 mijë lekë, pra 19,803,601 mijë lekë më pak se ligji i buxhetit.

Nga auditimi lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore shtesë të institucioneve gjatë fazës së planifikimit të buxhetit konstatohet se, këto kërkesa nga institucionet *nuk janë të mirë argumentuara*, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktet konkrete të projekteve dhe programeve, mungon një analizë e detajuar prioritizimi, duke qenë se

mundësitë buxhetore janë të kufizuara. Sipas nenit 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008: Kërkesa për fonde shtesë shoqërohet me justifikimin e paraqitjes së kërkesës, duke argumentuar: a) arsyet e mos planifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b) produktet, që përfitohen nga veprimtari që do të financohen nga kërkesat shtesë; c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç) zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë. Gjithashtu, mungon një evidencë e dokumentuar mbi analizën e kërkesave buxhetore shtesë bërë nga strukturat përkatëse të MFE, listimin e tyre sipas prioriteteve më emergjente dhe rekomandimet e përcjella prej tyre në strukturën përkatëse në Kryeministri për koordinimin e strategjive, si dhe korrespondenca me këtë strukturë. Në udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA” nuk ka të përcaktuar një procedurë për vlerësimin e kërkesave buxhetore shtesë dhe dokumentimin e saj. Sipas llogarive në total kërkesat shtesë buxhetore për të gjithë institucionet jepen si më poshtë:

Tabela : Kërkesat buxhetore shtesë 2022 sipas grupeve të llogarive në mijë lekë

Llogaritë	600-601	602-606	230-231	Total
Kërkesa buxhetore shtesë	4,454,379	29,870,238	68,721,337	103,045,954

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Analizave dhe Programimit Buxhetor z. G.O., Përgjegjës i Sektorit të Programimit Buxhetor znj. I.Dh., Përgjegjës i Sektorit të Analizës Buxhetore znj. V.Gj., ish Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar znj. R.N. dhe NZ e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ndryshimi i prioriteteve

Me shkresën nr. 15943 datë 21.09.2021 “Mbi rishikimin e prioriteteve buxhetore për periudhën 2022-2024 në përputhje me Programin e Qeverisë 2021-2025” janë njoftuar institucionet për rishikimin e prioriteteve buxhetore. Pas shkresës së cilësuar më sipër institucione si Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve kanë dërguar kërkesat e rishikuara. Në bazë të krahasimit të shkresave të vendosura në dispozicion dhe fazës së dytë të PBA-së për institucionet e sipër përmendura evidentohen ndryshimet:

Tabela. Rishikimi i prioriteteve për MFE në mijë lekë

Programet	Planifikimi faza II	Rishikimi pas shkresës	Diferenca
01150	4,594,187	4,550,218	(43,969)
04160	338,520	146,776	(191,744)
04130	739,900	69,000	(670,900)
01160	120,400	120,400	-
Totali	5,793,007	4,886,394	(906,613)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për Ministrinë e Turizmit:

Bazuar në shkresën e ndryshimit të prioriteteve, rezulton të jenë vendosur prioritete të reja më datë 18.10.2021 si më poshtë:

-18BE611 - Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore- Eko-Park Ulza në vlerën 68,500,000 lekë

- 18BE907 - Hartim projekti “Sistemimi i terrenit në një distancë prej 2 km nga pikat kufitare doganore, sistemim i sheshit, krijimi i hapësirave të gjelbërta, vendosja e ndriçimit, vendosja e infopoint-eve) në vlerën 24,240,000 lekë

18BE610 - Ndërtimi i një qendre multifunktionale për zonën e re të mbrojtur të lumit Vjosa në vlerën 50,000,000 lekë

Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Si fazë e dytë e PBA-së janë dorëzuar kërkesat buxhetore të rishikuara pas shkresës së rishikimit të prioriteteve.

Me emailin e datës 20.07.2023 është kërkuar informacion mbi prioritetet e ndryshuara për çdo ministri si rezultat i shkresës së cituar, *informacion i cili nuk u vendos në dispozicion.*

Vendimi dhe veprimi i ndryshimit të prioriteteve buxhetore ka ndodhur pas përfundimit të afatit të dërgimit të kërkesave buxhetore për fazën e dytë të PBA-së. Ky vendim nuk gjen mbështetje në bazë ligjore. Përderisa është miratuar Kuadri Makroekonomik e Fiskal me VKM nr. 7, datë 13.01.2021 dhe nuk ka rishikim të mëvonshëm.

Për veprimin e mësipërm mbajnë përgjegjësi: Përgjegjës i Sektorit të Analizës Buxhetore znj. V.Gj., Drejtori i Drejtorisë së Analizave dhe Programimit Buxhetor z. G.O., Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit znj. M.Dh., dhe ish Sekretar i Përgjithshëm/NPA z. O.M.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga MFE, Drejtoria e Analizave dhe Programimit Buxhetor është paraqitur observacioni me shkresën nr. 5854/50, prot., datë 07.09.2023, protokolluar në KLSH nr. 281/26, datë 12.09.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Së pari lidhur me vonesat e konstatuara në miratimin e projektvendimeve të përgatitura nga ana jonë përkatësisht: VKM nr. 15 datë 20.01.2021 “Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2022”, VKM nr. 119 datë 03.03.2021 “Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA 2022-2024”, VKM nr. 440 datë 22.07.2021 “Për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2022-2024”, VKM nr. 735 datë 03.12.2021 “Për miratimin e PBA të rishikuar 2022-2024” ritheksojmë edhe njëherë qëndrimin tonë se nga ana jonë janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme për përgatitjen e VKM-ve të sipërcituara në përputhje me dispozitat dhe afatet ligjore sa i takon përgjegjësisë të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë. Dëshirojmë të sjellim në vëmendje që procesi i përgatitjes së PBA është një proces ndërinstytucional dhe miratimi/mos miratimi në kohë i akteve përkatëse është përgjegjësi e disa strukturave. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e strukturës që inicion dhe koordinon procesin për të gjitha aktet ka ndjekur brenda fushës së saj të përgjegjësisë afatet ligjore për propozimin e akteve. Ndërsa, sa i përket afatit të miratimit të tyre, theksojmë se ky proces tejkalon kompetencat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përse kohë këto akte nënligjore miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Së dyti, lidhur me cilësinë e analizave buxhetore dhe evidentimin e kërkesave shitesë në analizat për Ministrinë e Linjës të përzgjedhura nga ana juaj për shqyrtim, ju informojmë se nga ana jonë janë përgatitur analiza të detajuara për të gjitha Ministrinë e Linjës dhe institucionet e tjera buxhetore, gjatë fazës së parë dhe të dytë të PBA-së, mbi cilësinë e kërkesave buxhetore të dërguara nga këto institucione mbështetur në udhëzimin standard nr.7/2018 “Për procedurat Standarde të Përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesëm”. Ky proces zhvillohet bashkarisht me Drejtorinë e Menaxhimit të Investimeve Publike, të cilët ndjekin dhe analizojnë procesin e planifikimit buxhetor afatmesëm për projektet e investimeve publike. Në këto analiza janë evidentuar respektimi ose jo i aspekteve procedurale të përgatitjes së kërkesave buxhetore, janë analizuar dhe lënë rekomandime lidhur me cilësinë e kërkesave buxhetore në respektim të metodologjisë së buxhetimit mbi bazë programi dhe performance nga ana e tyre.

Lidhur me mospërputhjen e shifrave të kërkesave shitesë për disa ministri si MFE apo MIE, ju bëjmë me dije se në zbatim të udhëzimit vjetor të përgatitjes së PBA 2022-2024, nr. 8 datë 26.02.2021, pika 4, ‘Të gjitha ML apo IQ të përgatisin kërkesat buxhetore për PBA 2022-2024 në mënyrë elektronike në sistemin AFMIS përmes moduleve respektive të PBA dhe PIM’, formatet zyrtare të kërkesave buxhetore që mbahen në konsideratë nga ana jonë në përgatitjen e Dokumentit të PBA janë ato të sjella nga sistemi AFMIS. Në sistemin AFMIS, ML dhe IQ krahas formatit 2 që përpunon kërkesat buxhetore sipas taveve indikative, plotësojnë për fazën strategjike dhe formatin 3 që është për kërkesat shitesë ose kërkesat për politika të reja. Nga ana jonë evidentohen në aneksin 4 të dokumentit të PBA kërkesat për politikat të reja të sjella përmes formatit 3 dhe jo ato të sjella në relacionin

shoqërues të kërkesave të paraqitura. Çdo pasaktësi e bërë nga ML në rast mospërputhje të kërkesave shtesë me formatet e plotësuar në sistem bëhet e ditur si pjesë e dëgjesave buxhetore.

Lidhur me prioritarizimin e kërkesave shtesë, mbështetur në metodologjinë e përgatitjes së PBA të përcaktuar në udhëzimin standard nr. 7/2018, kërkesat për financimin e politikave ekzistuese dhe politikave të reja ndjekin të njëjtat rregulla dhe mbetet së pari përgjegjësi e ML dhe IQ mirëargumentimi dhe prioritarizimi i tyre në dokumentin e dorëzuar zyrtarisht në MFE.

Krahas kësaj prioritarizimi i ture realizohet edhe gjatë fazës së dëgjesave buxhetore të organizuar sipas kalendarit të dëgjesave të dërguara me udhëzimet vjetore. Pavarësisht kësaj, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit i parashtron Ministrin të Financave dhe Ekonomisë përpara hartimit të VKM-së së tavanëve përfundimtare të shpenzimeve, përmbledhësen e kërkesave shtesë (aneksin 4 të dokumentit të PBA) për njohje dhe diskutim. Këshilli i Ministrave vendos miratimin/rishikim e prioritetëve në mbledhjen e Komitetit të Planifikimit Strategjik dhe për pasojë dhe miratimin e tyre përmes VKM së tavanëve përfundimtare.

Në përfundim, vlerësojmë që përmirësimi i cilësisë së dokumentit të PBA-së është mbi të gjitha detyrë e institucioneve përkatëse, mbështetur në komentet dhe rekomandimet e bëra nga ana jonë. Në zbatim të nenit 25 dhe 26 të ligjit nr. 57/2016 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2018 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë' i ndryshuar, Ministria përgjegjëse për financat, në cilësinë e kordinatorës së procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, analizon dhe vlerëson kërkesat buxhetore të përgatitura nga njësia e qeverisjes qendrore. Është në tagrin institucional reflektimi me përgjegjshmëri i komenteve dhe rekomandimeve të MFE për përmirësimin e cilësisë së kërkesave të tyre buxhetore.

Së treti, lidhur me ligjshmërinë e ndryshimit të prioritetëve të përcjella nga ana jonë më shkresën nr. 15943, datë 21.09.2021, së pari ju sqarojmë se ndryshimi i prioritetëve nuk është bërë jashtë Kuadrit Makroekonomik e Fiskal të miratuar me VKM nr. 7 datë 13.01.2021. Pra ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore u është kërkuar që brenda tavanit të akorduar të përcjellin të përditësuar dokumentin e PBA me Programin e Rishikuar të Qeverisë i cili u miratua gjatë muajit Shtator 2021. Dokumenti i PBA është dokument politikash po aq sa dokument buxhetor. Në këtë kontekst, përditësimi i tij me dokumentat politikë apo strategjikë është bërë në funksion të një planifikimi sa më të saktë buxhetor i cili nuk bie ndesh me aktet ligjore/nënligjore në fuqi për menaxhimin buxhetor.

Së fundi, lidhur me gjetjen për ndryshimin e vlerave të investimeve kapitale ndërmjet PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024 për të cilën ngarkoni me përgjegjësi drejtorin e analizave dhe programimit buxhetor, ju bëjmë më dije sikurse kemi sqaruar më lart që procesi i planifikimit të investimeve publike është nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Menaxhimit të investimeve publike.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Sa i përket problematikave të konstatuara gjatë auditimit për vonesat në lidhje me hartimin dhe miratimin e dokumenteve përkatës të PBA, observacionet e paraqitura nuk ndryshojnë faktet e konstatuara mbi vonesat. Observimi mbi përgjegjësinë për rastet e VKM-ve merret parasysht.

Sa i takon analizës së argumentimit të kërkesave shtesë nga MFE, mungon një evidencë e dokumentuar mbi analizën dhe listimin e tyre sipas prioritetëve më emergjente. Evidentimi ynë mbi kërkesat buxhetore shtesë konsiston më shumë në mungesë dokumentimi të procedurave e mbështetur kjo edhe nga mungesa e një akti nënligjor të detajuar rregullues për këtë analizim. Sa i takon mospërputhjeve të evidentuara ndërmjet kërkesave shtesë të institucioneve, observacioni është sqarues, por nuk e kundërshton faktin që në relacionet e institucioneve këto kërkesa kanë pasur vlerë të ndryshme nga Ankesi 4 i dokumentit të PBA. Observacioni lidhur me ndryshimet e prioritetëve buxhetore nuk merret parasysht pasi nuk ka evidencë dhe dokumentacion të legjitimitetit të veprimeve të ndërmarra sipas shkresës të cituar.

Lidhur me fushën e përgjegjësisë për ndryshimin e vlerave të investimeve kapitale ndërmjet PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024, observacioni merret parasysht.

Ndryshimet midis PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024

Grupi i auditimit verifikoi buxhetin e alokuar për vitin 2022 sipas institucioneve dhe programeve, duke marrë për bazë krahasimore PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024. Në shqyrtim u morën ministritë me buxhetin më të lartë të alokuar, përkatësisht: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Arsimit. Më poshtë listojmë të gjitha ministritë e linjës me planifikimet buxhetore për PBA 2022-2024 dhe 2021-2023:

Tabela Ndryshimet në planifikim PBA sipas Ministrive të Linjës Në milion lekë

Institucioni	Buxheti PBA 2022-2024	Buxheti PBA 2021-2023	Diferenca
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	12,736,369	10,159,790	2,576,579
Ministria e Kulturës	4,312,260	2,306,500	2,005,760
Ministria e Arsimit	45,458,347	44,081,000	1,377,347
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	3,120,143	2,791,056	329,087
Ministria e Brendshme	21,191,400	20,870,868	320,532
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2,439,460	2,387,000	52,460
Ministria e Drejtësisë	11,280,132	11,272,100	8,032
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	77,075,882	80,302,728	(3,226,846)
Ministria e Mbrojtjes	27,432,805	32,238,639	(4,805,834)
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	32,868,122.3	38,850,620	(5,982,497.7)
TOTALI	237,914,920.3	245,260,301	(7,345,380.7)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Evidentohen ndryshime në buxhetin e planifikuar të ministrive për vitin 2022 sipas PBA-së 2022-2024 dhe PBA-së 2021-2023. Konkretisht rritja më e lartë në planifikim rezulton për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me vlerën 2,576,579 mijë lekë. Ndërsa institucioni me rënien më të madhe rezulton Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Më poshtë listojmë programet e ministrive respektive që kanë pasur rritjen më të lartë në planifikim për vitin 2022 sipas PBA 2021-2023 dhe 2022-2024.

Tabela: Programet me rritjen më të lartë të planifikuar për vitin 2022 Në mijë lekë

Institucioni	Kodi i programit	Programi	Rritje e buxhetit të vitit 2022
MSHMS	07330	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	6,098,250
MIE	04520	Transporti Rrugor	3,557,236
MSHMS	07450	Shërbime të Shëndetit Publik	3,132,038
MM	10910	Emergjencat Civile	2,602,000
MA	09120	Arsimi Bazë (përfshirë parashkollorin)	2,049,517
MSHMS	10430	Përkujdesja Sociale	1,529,130
MSHMS	0110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,100,983
MM	09430	Arsimi Ushtarak	618,380
MIE	04550	Transporti Hekurudhor	597,349

Burimi: Të dhënat e publikuara nga MFE, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër programi 07330 “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor” i MSHMS-së është planifikuar në PBA 2022-2024 për buxhetin e vitit 2022 në vlerën 6,098,250 mijë lekë më tepër sesa planifikimi i bërë në PBA 2021-2023 për vitin 2022. E njëjta analizë edhe për programet e tjera të paraqitura në tabelë.

Tabela në vijim paraqet programet që kanë pasur uljen më të madhe në fonde për vitin 2022:

Tabela Programet me uljen më të madhe të planifikuar për vitin 2022

Në mijë lekë

Institucioni	Kodi i programit	Programi	Rënie e buxhetit të vitit 2022
MIE	06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	(9,422,659)
MM	02120	Forcat e Luftimit	(2,523,465)
MM	02150	Mbështetja e Luftimit	(724,028)
MAS	09450	Arsimi i lartë	(645,000)
MIE	06180	Planifikimi Urban	(355,600)
MIE	06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	(224,000)
MAS	08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë	(212,330)

Burimi: Të dhënat e publikuara nga MFE, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës, programi 06370 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime” i MIE nuk është planifikuar në PBA 2022-2024 për buxhetin e vitit 2022, faza e III, ndërkohë që paraqitet në vlerën 9,422,659 mijë lekë në planifikimin e bërë në PBA 2021-2023 për vitin 2022. Në vlerësimin e grupit të auditimit, diferencat e mëdha të fondeve të alokuara për vitin 2022, nga një PBA në tjetrën, flasin për një *parashikim të dobët* duke zbehur vlerën e parashikimeve afatmesme për shpenzimet e buxhetit të shtetit.

Nga auditimi me zgjedhje i ndryshimeve midis PBA 2021-2023 me PBA 2022-2024 në nivel projekti, u konstatuan 29 raste ku projektet e investimit të miratuara për PBA 2021-2023, nuk reflektohen në PBA 2022-2024, ose reflektohen me vlera konsiderueshëm më të ulëta me qëllim ruajtjen e tavanëve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja. Në vijim paraqiten 3 projektet me diferencat më të larta:

1. Projekti KM06129 - Projekti për mbështetje në sektorin energjetik - Tregues tekniko ekonomik të përmirësuar në sektorin elektroenergjitik

Institucioni: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Sipas PBA 2021-2023

	2020 Buxheti	2021 Parashikimi	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi
Sasia	1	1	1	1
Kosto totale (në mijë lekë)	1,330,000,000	1,869,424,000	1,680,000,000	1,000,000,000

Sipas PBA 2022-2024

	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi
Sasia	1	1	1	1
Kosto totale (në lekë)	1,807,107,621	648,038,000	46,400,000	0

Sipas PBA 2021-2023 vlera e projektit reflektohet 5,879,424 mijë lekë, ndërsa sipas PBA 2022-2024 vlera e projektit është 2,501,545 mijë lekë.

2. Projekti M112686 - (Ndërtime të reja/shtesa shkollash 2017 - 2018 - 2019 - 2020)

Institucioni: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Sipas PBA 2021-2023

	2020 Buxheti	2021 Parashikimi	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi
Sasia	82	73	73	73
Kosto totale (në mijë lekë)	254	350,000,000	350,000,000	350,000,000

Nga verifikimi i PBA 2022-2024, rezulton se ky projekt nuk është reflektuar.

3. Projekti M170489 - Sistemi i integruar i vëzhgimit të hapësirës ajrore RSH (SIVHA)

Institucioni: Ministria e Mbrojtjes

Sipas PBA 2021-2023

	2020 Buxheti	2021 Parashikimi	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi
Sasia	1	0	0	0
Kosto totale (në mijë lekë)	0	0	269,187,000	1,244,187,000

Sipas PBA 2022-2024

Ky projekt është planifikuar në vlerën 269,187,000 lekë për vitin 2022 sipas PBA 2021-2023, ndërkohë sipas PBA 2022-2024 nuk është reflektuar për vitin 2022.

Nga auditimi konstatohen 16 raste ku projektet e investimit miratohen fillimisht në PBA 2021-2023 si projekte të reja me vlerë të ulët, duke ruajtur tavanet e miratuar dhe më pas rriten në PBA 2022-2024 me vlerë të konsiderueshme. Më poshtë paraqiten 3 raste të evidentuara me diferencat më të larta:

1. Projekti M112692 - Projekte për zhvillimin institucional

Institucioni: Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Sipas PBA 2021-2023

	2020 Buxheti	2021 Parashikimi	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi
Sasia	10	10	10	10
Kosto totale (në mijë lekë)	0	0	906,000,000	1,130,000,000

Sipas PBA 2022-2024

	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi
Sasia	10	10	10	10
Kosto totale (në lekë)	0	800,000,000	1,110,000,000	1,310,000,000

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 2,036,000 mijë lekë dhe më pas shkon 3,220,000 mijë lekë.

2. Projekti 18AZ208 - Kapacitete të ofruara në modernizim

Institucioni: Ministria e Mbrojtjes

Sipas PBA 2021-2023

	2020 Buxheti	2021 Parashikimi	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi
Sasia		0	5	5
Kosto totale (në mijë lekë)	0	0	3,500,000,000	4,000,000,000

Sipas PBA 2022-2024

	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi
Sasia	0	5	5	5
Kosto totale (në lekë)	0	1,200,000,000	4,300,000,000	6,100,000,000

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 7,500,000 mijë lekë dhe më pas shkon 11,600,000 mijë lekë.

3. Projekti 18AY909 - Ndërtim parku për mjete e blinduara (prona 157 objektet 39, 40, 41), punime për rikonstruksione të godinave të KFT dhe ndërtim godine multi funksionale, truproje Zall-Herr, Rrethim i jashtëm.

Institucioni: Ministria e Mbrojtjes

Sipas PBA 2021-2023

	2020 Buxheti	2021 Parashikimi	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi
Sasia	0	1,366	0	0
Kosto totale (në mijë lekë)	0	250,000,000	40,000,000	40,000,000

Sipas PBA 2022-2024

	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi
Sasia	1,366	3,000	1,500	2,700
Kosto totale (në lekë)	250,000,000	581,572,000	209,729,000	387,710,000

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 330,000 mijë lekë dhe më pas shkon 1,429,019 mijë lekë.

Nga auditimi u konstatuan diferenca të fondeve të alokuara për projekte të caktuara, nga PBA 2021-2023 në PBA 2022-2024, e cila evidenton potencialisht një parashikim të dobët, duke zbehur vlerën e parashikimeve afatmesme për shpenzimet e buxhetit të shtetit. Nga auditimi i ndryshimeve midis PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024, u konstatuan: 29 raste ku projektet e investimit të miratuara për PBA 2021-2023, nuk reflektohen në PBA 2022-2024, ose reflektohen me vlera konsiderueshëm më të ulëta me qëllim ruajtjen e taveve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja, si dhe 16 raste ku projektet e investimit miratohen fillimisht në PBA 2021-2023 si projekte të reja me vlerë të ulët, duke ruajtur tavanet e miratuara dhe më pas rriten në PBA 2022-2024 me vlerë të konsiderueshme.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi ish Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve znj. S.S. Sa trajtuar më sipër nuk është paraqitur observacion nga subjekti.

Titulli i gjetjes:	Problematika në lidhje me hartimin e dokumentit të Programit Buxhetor nga institucionet buxhetore, mosrespektimi i afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore mbi përgatitjen e PBA-së, dërgimi i kërkesave shtesë dhe ndryshimi i prioriteteve buxhetore pa bazë ligjore
Situata:	Janë konstatuar vonesa në hartimin e dokumenteve të Programit Buxhetor nga institucionet buxhetore. Konkretisht, kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike është miratuar me VKM nr. 15, datë 20.01.2021, në

	<p>tejkalim të afatit të përcaktuar në nenin 22 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Po kështu, udhëzimi për përgatitjen e PBA është miratuar në tejkalim të afatit të përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në tejkalim të afatit të përcaktuar në pikën 3.1.8 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”.</p> <p>-Hartimi i politikave fiskale të vitit 2022 dhe miratimi i tyre është bërë në datën 25 nëntor 2021 së bashku me projektbuxhetin e vitit 2022, në kundërshtim me pikën 3, neni 4/1 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar.</p> <p>- Për planifikimin e të ardhurave dhe ndryshimet gjatë vitit, mungon evidenca mbi analizat e plota të realizuara nga MFE, megjithëse nga MFE pretendohet se programimi i të ardhurave për vitin pasardhës bëhet bazuar në metodologjitë standarde bashkëkohore që bazohet në treguesit kryesorë makroekonomikë që projekton Departamenti i Makroekonomisë dhe Banka e Shqipërisë, etj.</p>
Kriteri	<p>Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 22, neni 24, neni 29, neni 38 Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”; pika 3.1.7; 3.1.8 Udhëzimi nr. 8 datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”; VKM nr. 440 datë 22.07.2021 “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2022-2024” Kudri Makroekonomik e Fiskal me VKM nr. 7, datë 13.01.2021</p>
Ndikimi/Efkti:	<p>Tejkalimi i afateve ligjore në kuadër të përgatitjes të PBA-së mund të ketë efekt në vonesa të realizimit të procesit konform dispozitave ligjore. Dërgimi i kërkesave buxhetore në tejkalim të taveve jashtë afatit e bën procesin të mos jetë në përputhje me kriteret e vendosura. Mungesë transparence dhe efektiviteti lidhur me kërkesat shtesë.</p>
Shkaku:	<p>Mos respektimi nga ana e ministrive të linjës i kërkesave dhe përcaktimeve të udhëzimeve të PBA si dhe mos respektimi i afateve dhe përcaktimeve të udhëzimeve të përgatitjes së PBA. Nuk ka procedura të detajuara në një akt nënligjor për kërkesat shtesë buxhetore. Mosrespektimi i udhëzimeve për përgatitjen e PBA.</p>
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	<p>Drejtoria e Analizave dhe Programimit Buxhetor në bashkëpunim me Institucionet Buxhetore të marrin masa për respektimin e afateve të përcaktuara në mënyrë që procesi i përgatitjes së PBA-së të rezultojë koherent dhe efektiv.</p>
Titulli i gjetjes:	<p>Problematika në lidhje me hartimin e dokumentit të Programit Buxhetor nga institucionet buxhetore, mosrespektimi i afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore mbi përgatitjen e PBA-së, dërgimi i kërkesave shtesë dhe ndryshimi i prioriteteve buxhetore pa bazë ligjore</p>
Situata:	<p>Nga auditimi konstatohet se, MFE me shkresën nr. 15943, datë 21.09.2021 “Mbi rishikimin e prioriteteve buxhetore për periudhën 2022-2024 përputhje me Programin e Qeverisë 2021-2025”, ka njoftuar institucionet për rishikimin e prioriteteve buxhetore. Në kuadër të kësaj shkrese kanë dërguar kërkesa të rishikuara Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, institucione të varësisë së MFE, si AIDA,</p>

	<p>DPPPP dhe DPD. Ndryshimi i prioriteteve buxhetore pas përfundimit të fazës së dytë të PBA-së nuk gjen mbështetje ligjore dhe është në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 7, datë 13.01.2021 “Për miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal”, i cili nuk ka rishikim të mëvonshëm.</p> <p>Nga auditimi mbi kryerjen e analizave të PBA 2022-2024 dhe dhënien e rekomandimeve, për njësitë e qeverisjes së përgjithshme u konstatua se referuar analizës dhe komenteve të bëra nga MFE për fazën e parë dhe të dytë të PBA 2022-2024 kanë rezultuar mangësi që përfshijnë:</p> <p>a) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka paraqitur kërkesa buxhetore shtesë në tejkallim edhe të vetë planifikimit të fazës së parë. Gjithashtu kërkesat buxhetore të fazës së dytë rezultojnë në tejkallim të tavanit të miratuar me VKM nr. 440, datë 22.07.2021, si dhe nuk ka prioritarizuar këto kërkesa nga ajo më e domosdoshme dhe më emergjente. Për programet “Mbështetje për Energjinë” dhe “Menaxhimi i mbetjeve urbane” kërkesat buxhetore në fazën strategjike janë dorëzuar në tejkallim të afatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, si dhe afatit të vendosur në kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike.</p> <p>Me shkresën nr. 6894/1 prot., datë 01.10.2021, MIE ka dërguar në MFE jashtë afatit kërkesat buxhetore për fazën teknike, pas rishikimit të prioriteteve buxhetore për programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, referuar dhe shkresës së rishikimit të prioriteteve.</p> <p>b) Për fazën e parë të PBA-së 2022-2024 MFE ka paraqitur kërkesa buxhetore në tejkallim të tavanit të miratuar me VKM nr. 119, datë 03.03.2021, problematikë e cila nuk është reflektuar në analizën e kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjithashtu, evidentohen programe për të cilat kërkesat buxhetore janë dërguar jashtë afatit të përcaktuar në udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021.</p> <p>Për fazën e parë të PBA, MFE ka paraqitur kërkesa buxhetore në tejkallim të tavanit të miratuar me VKM nr. 119, datë 03.03.2021, ndërsa për programet 01120, 01130, 04130 nuk është dorëzuar dokumentacion shoqërues që përfshin formatin nr.3 për politikën e reja, pasqyrat shtesë si dhe relacionin shpjegues sipas rastit, sipas udhëzimit plotësues nr. 19, datë 09.07.2021.</p> <p>c) Nga auditimi konstatohet se në kërkesat buxhetore të paraqitura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në fazën e parë evidentohet se për disa programe, projektet e planifikuara nuk janë të lidhura me qëllimin e politikës.</p> <p>Nga auditimi evidentohen mospërputhje ndërmjet kërkesave shtesë të disa programeve të MFE dhe MIE, sipas relacioneve të dokumentuara dhe të vëna në dispozicion në format fizik, me të dhënat sipas Aneksit 4 “Kërkesat shtesë 2022-2024”, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të MFE. Mungon një evidencë e dokumentuar mbi analizën e kërkesave buxhetore shtesë bërë nga strukturat përkatëse të MFE dhe listimin e tyre sipas prioriteteve më emergjente dhe rekomandimet e përcjella prej tyre në strukturën përkatëse në Kryeministri për koordinimin e strategjive, si dhe korrespondenca me këtë strukturë.</p> <p>Nga analizat e MFE rezultojnë se për disa programe ka ndryshim të theksuar të kostos për njësi gjatë viteve, mungon sasia e produktit; fragmentim të theksuar të produkteve të investimeve, si dhe nuk janë plotësuar vlerat e kostos së plotë të projektit.</p> <p>Kërkesat nga institucionet nuk janë të mirë argumentuara, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktet konkrete të projekteve dhe programeve, mungon një analizë e detajuar prioritarizimi, duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara.</p> <p>Konstatohet se, për 29 projekte ka diferenca të fondeve të parashikuara nga</p>
--	--

	PBA 2021-2023 në PBA 2022-2024,që tregon për një parashikim të dobët, duke zbehur vlerën e parashikimeve afatmesme për shpenzimet e buxhetit të shtetit, me qëllim ruajtjen e taveve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja, ndërsa për 16 raste, projektet e investimit miratohen fillimisht në PBA 2021-2023 si projekte të reja me vlerë të ulët, duke ruajtur tavanet e miratuara dhe më pas rriten në PBA 2022-2024 me vlera të konsiderueshme.
Kriteri	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 22, neni 24, neni 29, neni 38 Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”; pika 3.1.7; 3.1.8 Udhëzimi nr. 8 datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”; VKM nr. 440 datë 22.07.2021 “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2022-2024” Kudri Makroekonomik e Fiskal me VKM nr. 7, datë 13.01.2021
Ndikimi/Efekti:	Ndryshimi i prioriteteve buxhetore ka sjellë ndryshimin e projekteve të investimeve dhe shtimin e projekteve të reja të paplanifikuara gjatë PBA. Tejkalmi i afateve ligjore në kuadër të përgatitjes të PBA-së mund të ketë efekt në vonesa të realizimit të procesit konform dispozitave ligjore. Dërgimi i kërkesave buxhetore në tejkalm të taveve jashtë afatit e bën procesin të mos jetë në përputhje me kriteret e vendosura. Mungesë transparence dhe efektiviteti lidhur me kërkesat shtesë.
Shkaku:	Mos respektimi nga ana e ministrive të linjës i kërkesave dhe përcaktimeve të udhëzimeve të PBA si dhe mos respektimi i afateve dhe përcaktimeve të udhëzimeve të përgatitjes së PBA. Nuk ka procedura të detajuara në një akt nënligjor për kërkesat shtesë buxhetore. Mosrespektimi i udhëzimeve për përgatitjen e PBA.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Drejtoria e Analizave dhe Programimit Buxhetor në bashkëpunim me Institucionet Buxhetore të marrin masa për respektimin e afateve të përcaktuara në mënyrë që procesi i përgatitjes së PBA-së të rezultojë koherent dhe efektiv. Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masat e nevojshme që analizat e të gjitha institucioneve për hartimin e kërkesave buxhetore të kryhen në afat, të lidhen me objektivat dhe qëllimet e politikave të programeve si dhe prioritet të pasqyrohen në kohë, me dokumentet përkatëse sipas fazave që ka parashikuar legjislacioni për planifikimin e buxhetit si dhe të krahasojë kërkesat buxhetore në vitin aktual edhe me kërkesat buxhetore të PBA-ve të viteve të kaluara duke rakorduar ecurinë e investimeve kapitale.

2.B.2. Vlerësimi i veprimtarisë në drejtim të detajimit të planit buxhetor dhe çeljeve fillestare bazuar në ligjin e buxhetit për vitin 2022. Rishpërndarja e fondeve buxhetore me ndryshimet sipas Akteve Normative.

Në datë 25.11.2020 është miratuar ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” në të cilin të ardhurat totale janë planifikuar në vlerën 536,811 milion lekë, shpenzimet totale në vlerën 637,694 milion lekë dhe deficitin buxhetor në vlerën 100,883 milion lekë.

Bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 38, është miratuar Udhëzimi Plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”.

Treguesit fiskal të konsoliduar sipas Kuadrit Makro 2022, miratuar me VKM nr. 7, datë 13.01.2021, PBA 2022-2024, projekt buxhetit 2022 dhe ligjit të miratuar të buxhetit 2022 nr. 115/2021, bazuar edhe në buxhetin faktik 2021 janë si në tabelën më poshtë.

Tabela . Treguesit fiskal të konsoliduar 2022

në milion lekë

ZËRAT		Buxheti Faktik 2021	Kuadri Makro/PBA Faza I+II	Projekt Buxhet	Ligji i Buxhetit
A	TOTALI I TË ARDHURAVE	510,572	517,366	536,811	536,811
I	Të ardhura nga ndihmat	12,671	13,994	13,994	13,994
II	Të ardhura tatimore	475,612	480,722	500,167	500,167
1	Nga Tatimet dhe Doganat	338,074	346,380	360,535	360,535
2	Nga Pushteti Vendor	26,666	26,632	27,632	27,632
3	Nga Fondet Speciale	110,872	107,710	112,000	112,000
III	Të ardhura Jo tatimore	22,289	22,650	22,650	22,650
B	TOTALI I SHPENZIMEVE	595,968	568,951	637,694	637,694
I	Shpenzimet korrente	461,075	481,298	507,201	507,349
1	Personeli	83,268	92,173	90,593	91,590
2	Interesat	35,822	49,534	50,757	50,757
3	Shpenzime operative/mirëmb	59,365	51,448	64,168	63,241
4	Subvencione	1,422	1,500	1,550	1,550
5	Shpenzime për fondet Special	199,457	202,771	212,771	212,271
6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	52,593	58,072	59,712	60,290
7	Shpenzime të tjera	29,149	25,800	27,650	27,650
II	Transferime Kapitale	3,709			
III	Fondi Rezerve/Kontigjenca	461	1,500	3,400	2,900
IV	Shpenzime Kapitale	98,203	86,153	119,093	119,445
V	Të tjera			8,000	8,000
VI	Fondi i Shpronësimeve	3,000	-		
VII	Fondi i Rindërtimit	29,521			
	DEFICITI	(85,397)	(51,585)	(100,883)	(100,883)
	Financim i Brendshëm	(18,701)	(235)	100,251	100,251
	Financim i Huaj	104,098	51,820	632	632
	PPB		1,802,981	1,867,351	1,867,351

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas tabelës më sipër evidentohet se sa i takon të ardhurave të buxhetit parashikohet rritje 5% dhe shpenzimet rritje në masës prej 7% krahasuar me ato të një viti më parë.

Mbi diferencat e planit fillestar sipas ligjit të buxhetit dhe në SIFQ.

Nga auditimi u konstatua se pavarësisht kontrolleve ekzistuese si funksionet dhe raportet e ndërtuara në SIFQ për qëllime të planifikimit buxhetor për të garantuar saktësinë e tavaneve të miratuara, ashtu sikundër është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm u konstatuan diferenca në të dhënat e raportuara në treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar sipas Tabelës nr. 4 të Ligjit të Buxhetit me atë të hedhur në sistemin SIFQ në planin fillestar të vitit 2022, konkretisht në zërat e shpenzimeve dhe financimit të deficitit, si: shpenzime korrente, shpenzime operative, shpenzime për fondet speciale etj. *Diferencat e detajuara paraqiten në tabelën në aneks.*

Krahasimi ndërmjet plan buxhetit me AN nr. 19 dhe hedhja në SIFQ

Gjatë auditimit është krahasuar plani i buxhetit miratuar me Aktin Normativ nr.19, si dhe plani operativ me planin e hedhur në SIFQ për zërat sipas treguesve fiskal, evidentuar në tabelën e paraqitur në aneks.

Evidentohet se plani i buxhetit i miratuar konstatohet të këtë diferenca të shumta me planin e ngarkuar në SIFQ nga strukturat përkatëse sipas rastit. Në konkluzion, raportet e ndërtuara dhe ofruara nga SIFQ për qëllime të planifikimit buxhetor nuk përdoren nga DPB si një mënyrë për të kontrolluar saktësinë e detajimit të buxhetit fillestar dhe më pas atij operativ, mundësi këto që sistemi SIFQ ofron për të bërë të gjithë kontrollet e mundshme të regjistrimeve e deri te analizat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të buxhetit.

Nga auditimi i planit të buxhetit të miratuar me Aktin Normativ nr. 19, datë 29.12.2022 dhe planit operativ sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit me planin e hedhur në SIFQ për zërat sipas treguesve fiskal janë konstatuar diferenca në pothuajse të gjithë zërat e shpenzimeve. Diferencat e evidentuara në tabelën fiskale të gjeneruar nga SIFQ me atë të miratuar në ligj janë një tregues që raportet dhe formatet e standardizuara për ngarkimin e çeljeve apo detajimin buxhetor nuk kanë garantuar saktësinë e të dhënave.

Për diferencat e evidentuara mban përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit znj. M.Dh., Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit znj. Xh.A.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga përfaqësuesit e subjektit është paraqitur observacioni me shkresën nr. 5854/50, prot. datë 07.09.2023, e MFE prot., në KLSH nr. 281/26 datë 12.09.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendime të subjektit:

Bëjmë me dije se DMB nuk është përgjegjëse për hedhjen në sistem të tavanëve të miratuara me ligj për treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar të Tabelës fiskale , të cilat janë paraqitur në tabelën 7 të projektraportit.

-DMB është përgjegjëse për detajimin dhe hedhjen në sistem të zërave të shpenzimeve të miratuara në ligjin e buxhetit në nivel njësie shpenzuese dhe produkti, konsolidimi i të cilave duhet të jetë në përputhje me tavanet e miratuara në ligj.

Ritheksojmë që për zërat e shpenzimeve që janë përgjegjësi e Drejtorisë së menaxhimit, për të cilat detajimi i planit të buxhetit miratohet dhe ndiqet në SIFQ në nivel njësie shpenzuese dhe produkti, kontrolli lidhur me detajimin e planit në SIFQ nëse është në përputhje me tavanet e miratuara dhe të hedhura në SIFQ nga DAPB, nga ana e DMB bëhet me raportet përkatëse të gjeneruara nga SIFQ në formatin e tabelës 1 të Ligjit të Buxhetit 2022, të tabelës 5, si dhe të raportit të detajuar në nivel produkti.

Fondet buxhetore të detajuara dhe të hedhura në SIFQ, janë në përputhje të plotë me tavanet e miratuara në Ligjin e Buxhetit të vitit 2022, sipas strukturave buxhetore përkatëse dhe argumentohen me raportet e gjeneruara nga SIFQ sipas formatit të Tabelës 1 dhe 5 të Ligjit të Buxhetit, raportit sipas formatit 5 me produkte, si dhe në përputhje të plotë me shkresat e miratimit të detajimit të fondeve. Këto shkresa nuk janë kërkuar nga grupi i auditimit por vetëm raportet nga SIFQ. Nëse kërkohet nga auditimi një kopje e shkresave të miratimit të fondeve të detajuara të planit fillestar dhe të hedhura në SIFQ, mund t'ia vemë në dispozicion.

-Në tabelën 12 të projektraportit, diferencat e paraqitura midis Planit Operativ dhe Planit sipas AN nr. 19 datë 29.12.2022 për të cilat grupi i auditimit rekomandon që DPB duhet të evidentojë mosrakordimet e planit të buxhetit sipas treguesve fiskalë të konsoliduar me qëllim eliminimin e diferencave sipas zërave ligj-sistem, sqarojmë se:

-Buxheti Operativ i cili është dhe në SIFQ në modulën përkatës, përfaqëson planin përfundimtar të Buxhetit, i cili përmban: Planin fillestar të detajuar i cili argumentohet me shkresat e miratimit të këtij detajimi i cili verifikohet me SIFQ nëpërmjet raporteve përkatëse në formatin sipas Tabelës 1 të ligjit dhe tabelës 5 të ligjit si dhe raporti me të gjithë planin e buxhetit në SIFQ sipas produkteve.

Ndryshimet e planit e bëra gjatë vitit sipas Akteve Normative, të cilat përcillen me shkresat përkatëse dhe strukturat buxhetore në SIFQ, si dhe ndryshimet e planit përgjatë vitit me VKM për shpërndarje të fondeve të miratuara në ligj (Fondi Rezervë, Paketa e Rezistencës Sociale, paketa për përballimin e inflacionit, fondet për politikën e reja të pensioneve, bonusi i pensionistëve, fondet për politikën e rritjes së pagave., Fondi për mbështetjen e energjisë si dhe rishpërndarjet e fondeve sipas rregullave e përgjegjësi të përcaktuara në LOB. Plani Buxhetor Operativ për vitin 2022 sipas zërave të shpenzimeve i shpjeguar si më sipër është paraqitur në tabelën “Treguesit Fiskalë të Konsoliduar për vitin 2022” të dorëzuar grupit të KLSH dhe që është firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive të DPB dhe që përputhet plotësisht me fondet e Planit Operativ sipas strukturave buxhetore përkatëse në SIFQ. Për sa shpjeguar më sipër diferencat e konstatuara në tabelën 12 nuk kanë të njëjtën bazë krahasimi.

-Lidhur me konkluzionin se “raportet e ndërtruara dhe ofruara nga SIFQ për qëllime të planifikimit buxhetor nuk përdoren nga DPB si një mënyrë për të kontrolluar saktësinë e detajimit të buxhetit

fillestar dhe më pas operativ”, nuk jemi dakord, pasi nga DMB të gjitha raportet që sigurojnë të dhënat lidhur me detajimin e buxhetit fillestar, buxhetin operativ dhe atë me produkte, në formatin e tabelës 1 dhe tabelës 5 të ligjit, përdoren nga ana jonë për të provuar saktësinë e detajimit të planit fillestar dhe më pas atij operativ. Gjithashtu nga të dhënat e siguruara nga tabela 5 ne nxjerrim edhe të dhënat e zërave të shpenzimeve sipas treguesve të konsoliduar fiskalë për buxhetin operativ. Raportet e gjeneruara nga sistemi për planin fillestar të detajuar, buxhetin operativ dhe buxhetin me produkte janë dorëzuar nga ana jonë grupit të auditimit .

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me observimin mbi diferencat e evidentuara ndërmjet ligjit të buxhetit, planit fillestar dhe operativ të regjistruar në SIFQ, theksojmë se tabela mbi bazën e të cilave është evidentuar diferenca është vënë në dispozicion nga Drejtoria e Thesarit me emailin e datës 20.04.2023. Tabelat 1 dhe 5 që ju përmendni nuk paraqesin të dhëna në bazë të treguesve fiskalë.

Qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon pasi si bazë krahasimi është marrë Plani operativ sipas SIFQ i vendosur në dispozicion nga ana juaj. Për rrjedhojë observacioni nuk merret në konsideratë.

Ndryshimet buxhetore që kanë sjellë aktet normative

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 101, përcaktohet se “Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme”. Gjatë vitit 2022 Këshilli i Ministrave ka nxjerrë 4 Akte Normative për ndryshime në ligjin nr. 115/2022 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”.

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i janë vendosur në dispozicion dosjet me praktikën e miratimit të akteve normative në ndryshim të ligjit të buxhetit vjetor trajtuar më hollësisht në vijim:

1. Ministri i Financave ka përcjellë me email në Këshillin e Ministrave projekt aktin normativ për shqyrtim dhe miratim, shoqëruar me relacionin shpjegues, miratuar me AN nr. 3, datë 12.03.2022.

Është konstatuar se qëllimi i këtij projekt ligji ka qenë akordimi i mbështetjes buxhetore për sektorin e energjisë, në vlerën prej 20 miliardë lekë e cila sipas raportit vjetor të Ministrisë raportohet se u përdor nga KESH sha me VKM mbi bazë transhesh periodike.

Rritja e Fondit të Kontigjencës për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës me 6 miliardë lekë. Këto shpenzime të rritura janë parashikuar të mbulohen nëpërmjet rritjes së të ardhurave në vlerën prej 10 miliardë lekë; të ardhurave tatimore të planifikuara nga TVSH-ja në masën 7 miliardë, tatimi mbi fitimin 2 miliardë, akciza 2 miliardë, tatimi mbi të ardhurat personale 2 miliardë dhe taksa nacionale -2 miliardë. Ndikimi tek shpenzimet korrente:

- Mbështetje financiare për sektorin energjitik 20 miliardë, e cila do të përdoret me VKM.
- Akordimin e paketës së Rezistencës Sociale për zbutjen e pasojave të krizës për (shtresat në nevojë, sektorin e transportit publik, sektorin e bujqësisë) në vlerën 6 miliardë lekë.
- Shkurtime në zërat e shpenzimeve korrente prej 5.8 miliardë lekë (reduktim 2.5% për shpenzimet e personelit, reduktim 10% për shpenzimet operative dhe 10% për shpenzimet administrative)

Ndikimi tek shpenzimet kapitale:

- Reduktim i projekteve me financim të brendshëm në masën 5.2 miliardë (projekte të reja, projekte me sfond administrativ, projekte infrastrukturore).
- Reduktim i projekteve me financim të huaj në masën 4.6 miliardë (projekte të reja infrastrukturore).

Ky AN nuk ka prekur parametrat kyç makro fiskal të deficitit buxhetor dhe borxhit publik.

Grupi i auditimit ka kërkuar me e-mailin e datës 14.07.2023 sqarime dhe evidenca mbi analizat e bërë nga MFE në muajin mars 2022, mbi të cilën është konkluduar se të ardhurat tatimore të planifikuara do të rriten për vlerën 10 miliardë lekë. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale është vendosur në dispozicion

informacion mbi AN nr. 3, që konsiston në paraqitjen tabelare të ndryshimeve sipas çdo tatimi dhe një shpjegim i shkurtër i faktorëve ndikues pa një analizë e mirëfilltë dhe e detajuar për ndryshimet e propozuara sipas këtij akti normativ.

2. Me shkresën nr. 14405, datë 27.07.2022 Ministri i Financave ka përcjellë në Këshillin e Ministrave projekt aktin normativ për shqyrtim dhe miratim, shoqëruar me relacionin shpjegues, miratuar me AN nr. 12, datë 29.07.2022.

Është konstatuar se qëllimi i këtij projekt ligji ka qenë alokimi sërish i një fondi kontigjencë për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj pasojave të krizës si pasojë e luftës në Ukrainë, me kosto 6.1 miliardë lekë. Reflektimi në kahun e të ardhurave të një rritje në masën 30 miliardë lekë bazuar në performancën pozitive të realizimit të planit të të ardhurave tatimore dhe doganore. Ky akt normativ ka prekur parametrat kyç makro fiskal, në reduktimin e huamarrjes së brendshme dhe deficitit buxhetor në masën 17 miliardë lekë.

Ndikimi tek shpenzimet korrente:

- Rritje të shpenzimeve të përgjithshme rreth 13 miliardë lekë
- 6.1 miliardë lekë për Paketën e Rezistencës Sociale
- 1.67 miliardë lekë kompensim financiar i çmimit të disa materialeve të ndërtimit
- 4 miliardë lekë rritje e shpenzimeve kapitale me Financim të Huaj
- 1.72 miliardë lekë për subvencionim e qirasë për familjet e prekura nga tërmeti
- 1.2 miliardë lekë për blerjen e teksteve shkollore falas dhe për mbulimin e shpenzimeve të transportit për mësuesit dhe nxënësit

Ndikimi tek shpenzimet korrente dhe kapitale:

- Shkurtime të shpenzimeve korrente e kapitale rreth 5.1 miliardë lekë
- Shkurtime në planin e shpenzimeve korrente (paga, sigurime) rreth 2.9 miliardë lekë;
- Shkurtime të shpenzimeve kapitale me Financim të Brendshëm rreth 2 miliardë lekë;

Ndikimi tek shpenzimet vendore:

- Pakësimi në masën 58 milionë lekë të financimit të huaj vendor për shkak të mos realizimit të plotë deri në këtë periudhë;
- Shtesën në masën 48 milionë lekë për transfertës e pakushtëzuar (Për arsimin parashkollor 38 milionë lekë dhe për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi 10 milionë lekë);
- Shtesën në masën 10 milionë lekë për transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme të njësive të vetëqeverisjes vendore që nuk kanë realizuar mjaftueshëm nivelin e të ardhurave;

Grupi i auditimit ka kërkuar me emailin e datës 14.07.2023 sqarime dhe evidenca mbi analizat e bërë nga MFE në muajin korrik 2022, mbi të cilën është konkluduar se të ardhurat tatimore të planifikuara do të rriten në vlerën 30 miliardë lekë. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale është vendosur në dispozicion analiza e detajuar për ndryshimet e propozuara sipas këtij akti normativ. Sipas analizës rritja e parashikuar përbëhet nga 24.5 miliardë lekë rritje në të ardhurat nga tatimet dhe dogana dhe 5.5 miliardë lekë rritje në të ardhurat nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Parashikimi për periudhën gusht-dhjetor bazohet në realizimin e të ardhurave tatimore dhe doganore përfshirë edhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore me tejkalim plani 15.9 miliardë lekë për 7 mujorin e 2022. Faktorë të tjerë të mbajtur në konsideratë janë rritja e inflacionit, ndryshimet e kursit të këmbimit, konsumi i brendshëm etj, si dhe janë analizuar rritjet/uljet e zërave të taksave dhe tatimeve.

3. Me shkresën nr. 22105, datë 30.11.2022 Ministri i Financave ka përcjellë në Këshillin e Ministrave projekt aktin normativ për shqyrtim dhe miratim, shoqëruar me relacionin shpjegues, miratuar me AN nr. 17, datë 01.12.2022.

Është konstatuar se qëllimi i këtij projekt ligji ka qenë reflektimi në kahun e të ardhurave të një rritje në masën 5 miliardë lekë, si rezultat i performancës së kënaqshme të realizimit të

zërave të tyre për 10 mujorin 2022. Axhustimet mes zërave të shpenzimeve buxhetore, korente e kapitale, me synimin e optimizimit të realizimit të tyre për pjesën e mbetur të vitit 2022, me një rritje neto po në masën 5 miliardë lekë. Reflektimin në kahun e të ardhurave të një rritje në masën 5 miliardë lekë, si rezultat i performancës së kënaqshme të realizimit të zërave të tyre për 10 mujorin 2022, nga të cilat rritja e të ardhurave tatimore është propozuar në masën 5 miliardë lekë, Reduktimi me 2 miliardë lekë të të ardhurave nga Grantet e Huaja; Rritja e të ardhurave jotatimore në masën 2 miliardë lekë në zërin ‘Kthim kapitali nga AIC’, që ka të bëjë me një sistemim veprimi nga pikëpamja kontabël në Llogarinë e Thesarit; Ky akt normativ nuk prek parametrat kyç makro-fiskal, siç janë: deficitin buxhetor dhe borxhi publik, të cilët mbeten të pandryshuar.

Ndikimi tek shpenzimet:

- Rritje të shpenzimeve të përgjithshme rreth 30.2 miliardë lekë.
 - 12.4 miliardë lekë për Fondin e Rindërtimit;
 - 5 miliardë lekë për projektet në vazhdim në Infrastrukturë në programin “Transporti rrugor”;
 - 2 miliardë lekë për projektet në vazhdim për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi;
 - 2 miliardë lekë për Korporatën Shqiptare të Investimeve (AIC), në formën e transfertës kapitale për mbështetjen e projekteve të zhvillimit;
 - 2 miliardë lekë për Aviacionin Civil dhe +1.2 miliardë lekë për Albgaz, bazuar në kërkesat zyrtare të MIE;
 - 1 miliardë lekë për nevoja operative të Policisë së Shtetit, uniforma, karburant;
 - 800 milion lekë për MIE në zërin ‘Mirëmbajtje rrugore’;
 - 674 milion lekë për lekë për projektet me financim të huaj “Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë dhe emergjenca Covid me BB”;
 - 500 milion lekë për projektet në vazhdim për projektet e dixhitalizimit dhe qeverisjes elektronike për Policinë e Shtetit dhe DPT;
 - 200 milion lekë për si financim shtesë për Skemën Kombëtare të Fermerëve;
 - 250 milion lekë për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar;
 - 70 milion lekë për FSHF, për mbështetjen e Ekipit Kombëtar të Futbollit;
 - 150 milion lekë për Fondin rezervë të buxhetit të shtetit 2022.
- Shkurtime të shpenzimeve korrente e kapitale rreth 25.2 miliardë lekë
 - rreth 9.8 miliardë lekë shpenzimeve kapitale me Financim të Huaj;
 - rreth 5.9 miliardë lekë shkurtime në planin e shpenzimeve për interesa;
 - rreth 5.3 miliardë lekë shkurtime të shpenzimeve kapitale me Financim të Brendshëm;
 - rreth 1.88 miliardë lekë kursime nga Paketa e Rezistencës Sociale;
 - rreth 1 miliardë lekë shkurtime të shpenzimeve të Fondit të Kompensimit të Pronarëve.

Ndikimi tek shpenzimet vendore:

- Shtesë në masën 1 miliardë lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura;
- Shtesë në masën 165 milion lekë për transfertën specifike për sportin;
- Shtesë në masën 70 milion lekë për pjesën e taksave të ndara që i transferohen buxhetit vendor;
- Shpërndarjen nga fondi rezervë i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme në masën 70 milionë lekë për transfertën e pakushtëzuar;
- Pakësimi në masën 65 milionë lekë të financimit të huaj vendor.

Grupi i auditimit ka kërkuar me emailin e datës 14.07.2023 sqarime dhe evidenca mbi analizat e bërë nga MFE në muajin dhjetor 2022, mbi të cilën është konkluduar se të ardhurat tatimore të planifikuara do të rriten me vlerën 5 miliardë lekë. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale nuk është vendosur në dispozicion një analizë e mirëfilltë për ndryshimet e propozuara sipas këtij akti normativ. Informacioni i

vendosur në dispozicion konsiston i njëjtë me përmbledhjen e relacionit të Aktit Normativ nr. 17.

Me shkresën nr. 22351/129 prot., datë 30.12.2022 është përcjellë zbatimi i Aktit Normativ nr. 17 datë 01.12.2022, ku aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i është çelur kodi i produktit 21AA201 “Transferta kapitale për AIC” në vlerën 2,120,000,000 lekë.

Referuar sa më sipër, për Korporatën Shqiptare të Investimeve (AIC) efekti neto i veprimeve të autorizuara me këtë akt normativ është 0 (zero) lekë lëvrim fondesh, pasi specifikohet - Rritja e të ardhurave jotatimore në masën 2 miliardë lekë në zërin ‘Kthim kapitali nga AIC’ dhe shtesë 2 miliardë lekë në formën e transfertës kapitale për mbështetjen e projekteve të zhvillimit.

Pavarësisht efektit neto 0 të AN nr. 17 , nga ana e MFE-së zgjidhet të zbatohet vetëm efekti i daljes së mjeteve monetare, me pakësim fondesh për buxhetin e shtetit, pa marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e të njëjtës shumë të specifikuar si kthim kapitali 2,000,000,000 lekë, pasi nga verifikimi në SIFQ kjo vlerë nuk është arkëtuar nga AIC.

Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve nr. 95, datë 15.09.2022 është miratuar zmadhimi i kapitalit të shoqërisë për vlerën 200,000,000 lekë, ndërkohë sipas aktit normativ nr. 3 dhe relacionit përkatës, si dhe shkresave të detajimit të këtij akti të vendosura në dispozicion nuk gjendet informacion për këtë shtesë, edhe *pse nga grupi i auditimit është kërkuar kërkesa e institucionit për transfertën e realizuar, por ky informacion nuk u vendos në dispozicion.*

4. Me shkresën nr. 24043/2, datë 29.12.2022 Ministri i Financave ka përcjellë në Këshillin e Ministrave projekt aktin normativ për shqyrtim dhe miratim, shoqëruar me relacionin shpjegues, miratuar me AN nr. 19, datë 29.12.2022.

Është konstatuar se qëllimi i këtij projekt ligji ka qenë reflektimi në kahun e të ardhurave të një rritje në masën 1.5 miliardë lekë, si rezultat i performancës së kënaqshme të derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore. Alokimin e një shtese fondi prej rreth 7.8 miliardë lekë në zërin ‘Fondi Rezervë’, me qëllim akordimin e mbështetjes financiare të menjëhershme për përballimin e inflacionit të luftës, për disa kategori në kuadër të mbylljes së vitit 2022.

Ndryshimet e këtij akti normativ kanë ruajtur të pandryshuar deficitin buxhetor dhe borxhin publik.

Ndikimi tek shpenzimet:

Rritje të shpenzimeve të përgjithshme rreth 1.48 miliardë lekë (si rezultat i axhustimeve/kursimeve mes zërave, të cilat shkojnë në drejtim të akomodimit të një fondi prej rreth 7.8 miliardë lekë, me qëllim mbështetjen financiare të menjëhershme për përballimin e inflacionit të luftës konkretisht 8,000 lekë për çdo pensionist, 8000 lekë për çdo përfitues të skemave të Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar, si edhe në masë të diferencuar për të gjithë punonjësit buxhetorë, përfshirë mjekë/ infermierë/ arsimtarë/ policë/ zjarrfikës)

Grupi i auditimit ka kërkuar me emailin e datës 14.07.2023 sqarime dhe evidenca mbi analizat e bërë nga MFE në muajin dhjetor 2022, mbi të cilën është konkluduar se të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore të planifikuara do të rriten me 1.48 miliardë lekë. Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga DPPMÇF propozimi për këtë rritje bazohet në:

1. Ecurinë pozitive të të ardhurave në 11 muajin e vitit 2022

2. Vlerësimet e bëra në lidhje me të ardhurat e pritshme për mbylljen e vitit 2022.

Në të ardhurat e buxhetit rezultojnë tejkallim i të ardhurave tatimore dhe doganore për 11-mujorin e vitit 2022 veçanërisht për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në masën 111.5 miliardë lekë ose 4.5% më shumë se plani 11-mujor për vitin 2022, si dhe 11.2

miliardë lekë ose 11.2% më shumë, krahasuar me 11 mujorin e vitit 2021. Informacioni i vendosur në dispozicion nuk përfshin një analizë të mirëfilltë për ndryshimet e propozuara sipas këtij akti normativ.

Sa më sipër me emailin e datës 21.07.2023 kemi kërkuar informacion lidhur me procedurën e planifikimit të të ardhurave tatimore dhe doganore dhe përfshirjen e institucioneve respektive në këtë planifikim. Të dhënat e vendosura në dispozicion nuk rezultojnë në koherencë me planifikim për vitin 2022 (përveç planit të takave kombëtare dhe rimbursimit të TVSH-së). Lidhur me planifikimin dhe ndryshimet gjatë vitit të të ardhurave nuk na është vendosur në dispozicion manual/udhërrëfyes sesi realizohet procedura, pra mungon gjurma e auditimit.

- Lidhur me planifikimin e të ardhurave në kuadër të ndryshimeve gjatë vitit mungon evidenca mbi analizat e plota të realizuara. Nga komunikimi shprehet se programimi i të ardhurave për vitin pasardhës bëhet bazuar në metodologjitë standarde bashkëkohore, metodologji me të cilën projekton edhe vetë Misioni monitorues i FMN për Shqipërinë. Parimi kryesor i forecasting bazohet në treguesit kryesorë makroekonomikë që projekton Departamenti i Makroekonomisë dhe Banka e Shqipërisë në lidhje me deficitin buxhetor, deficitin primar, nivelin e borxhit publik, normën bazë të interesit, kurset e projektuara të këmbimit, shpenzimet e parashikuara, investimet kapitale etj. Ndërkohë një analizë e tillë gjithëpërfshirëse e faktorëve dhe aktorëve pjesëmarrës nuk është vendosur në dispozicion për parashikimin e të ardhurave të vitit 2022.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi ish Sekretar i përgjithshëm z. A.Gj., Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit znj. M.Dh., Drejtor i Drejtorisë së Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale z. N.L., Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit znj Xh.A.

Në mënyrë të përmbledhur të gjitha ndryshimet e buxhetit 2022 me katër aktet normative janë pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela: Ndryshimi i buxhetit me AN sipas treguesve fiskal

në milion lekë

ZËRAT		Ligji i Buxhetit	AN nr.3 12.03.2022	AN nr.12 29.07.2022	AN nr.17 01.12.2022	AN nr.19 29.12.2022	Plani përfundimtar i buxhetit operativ viti 2022
A	TOTALI TE ARDHURAVE	536,811	546,811	576,831	581,831	583,315	583,315
I	Të ardhura nga ndihmat	13,994	13,994	13,994	11,994	11,994	11,994
II	Të ardhura tatimore	500,167	510,167	540,187	545,187	546,671	546,671
1	Nga Tatimet dhe Doganat	360,535	370,535	395,000	398,000	398,000	398,000
2	Nga Pushteti Vendor	27,632	27,632	27,632	27,632	27,632	27,632
3	Nga Fondet Speciale	112,000	112,000	117,555	119,555	121,039	121,039
III	Të ardhura Jo tatimore	22,650	22,650	22,650	24,650	24,650	24,650
B	TOTALI I SHPENZIMEVE	637,694	647,694	660,693	665,694	667,178	667,178
I	Shpenzimet korrente	507,349	501,549	504,802	501,295	498,291	518,923
1	Personeli	91,590	89,388	88,972	87,036	86,684	85,621
2	Interesat	50,757	50,757	50,757	44,800	44,680	44,680
3	Shpenzime operative/mirëmb	63,241	59,643	63,173	67,479	66,556	73,065
4	Subvencione	1,550	1,550	1,689	1,689	1,605	1,655
5	Shpenzime për Fondet Special	212,271	212,271	212,271	211,271	209,771	221,717
6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	60,290	60,290	60,290	61,460	61,460	61,680
7	Shpenzime të tjera	27,650	27,650	27,650	27,560	27,535	30,504
II	Fondi Rezervë/Kontigjenca	2,900	8,650	15,450	13,720	20,840	208
III	Shpenzime Kapitale	119,445	109,496	112,441	122,678	120,047	120,047
IV	Të tjera	8,000	28,000	28,000	28,000	28,000	28,000
C	DEFICITI	(100,883)	(100,883)	(83,863)	(83,863)	(83,863)	(83,863)
	Financim i Brendshëm	100,251	100,251	83,383	88,088	90,088	90,088
	Financim i Huaj	632	632	480	(4,225)	(6,225)	(6,225)
	PPB	1,867,351	1,867,351	1,867,351	1,867,351	1,867,351	1,867,351

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga sa më sipër konstatohet se, pas aktit të fundit normativ nr. 19, datë 29.12.2022 janë bërë reflektime/ndryshime në zërat e shpenzimeve korrente. Grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion me dokument fizik dhe me email tabela e treguesve fiskalë të konsoliduar 2022. MFE, në pasqyrën e treguesve të buxhetit të konsoliduar ka vijuar dhe këtë vit të paraqesë një kolonë me të dhëna, të emërtuar “Plani me ndryshime 2022 (shpërndarje rezervash)”, në të cilin rritet plani i shpenzimeve korrente për 20,632 milion lekë (duke ulur planin e shpenzimeve për nën-zërin për personelin, si dhe duke rritur nën-zërat për shpenzime operative, për fondet speciale, si dhe subvencionet), si dhe zvogëlohet po me këtë vlerë “Fondi rezervë dhe kontigjenca”, si më poshtë.

Tabela e efekteve ne treguesit fiskalë të ndryshimeve

Emertimi sipas llogarise ne treguesit fiskale te konsoliduar, tabela 4 e ligjit nr, 115/2021 date 25,11,2021	Fakti 2022	Plani sipas ligjit te ndryshuar me A.N 19 date 29,12,2022	Plani pas ndryshimeve nga DPB MFE	Diferenca plan sipas ligjit me planpas ndryshimeve MFE.
TOTALI I SHPENZIMEVE	651.015	667.178	667.178	0
Shpenzime Korrente	499.991	498.291	518.923	20.632
Personeli	84.696	86.684	85.622	-1.062
Paga	72.103	72.568	72.756	188
Kontributi per Sigurime Shoqerore	11.784	11.817	11.874	57
Fondi i vecante i pagave	0	300	72	-228
Politika te reja pagash		1.200	120	-1.080
Arsimi I larte nga te ardhurat e veta	808	800	800	0
Interesat	39.624	44.680	44.680	0
Te Brendshme	24.210	24.243	24.243	0
Te Huaja	15.414	15.636	15.036	-600
Kontigjence per risqet e borxhit		4.800	4.800	0
Shpenzime Operative Mirembajtje	68.504	66.556	73.065	6.509
Subveconet	1.650	1.605	1.655	50
Shpenzime per fonde speciale	216.515	209.771	221.717	11.946
Sigurime Shoqerore	163.037	148.135	166.881	18.746
politika te reja pensionesh	0	3.300		-3.300
Bonusi i pensionistev		3.500		-3.500
Sigurime Shendetstore	52.244	52.836	52.836	0
shpenzim per kompensim pronarësh	1.234	2.000	200	-1.800
Shpenzime per Buxhetin Vendor	58.696	61.460	61.680	220
Shpenzime te tjera sociale	30.306	27.535	30.504	2.969
Pagesa e Papunesise	746	735	745	10
Ndihma Ekonomike	25.464	23.600	25.659	2.059
Kompesim per ish-te perndjekurit politik	996	1.000	1.000	0
Bonusi I lindjeve	3.100	2.200	3.100	900
Transferime kapitale	0			0
Fondi Rezerve,Kontigjenca	0	20.840	208	-20.632
Fondi Rezerve i buxhetit		10.620	75	-10.545
nga i cili: Mbeshtetje financiare e menjehershme per perballimin e inflacionit te luftes		7.800	64	-7.736
Kontigjenca per Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës		10.220	133	-10.087

Nga analiza e ndryshimeve të paraqitura më sipër, konstatohet se ndryshimet e vlerave të pasqyruara në tabelën 4 “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar”, në Aktin Normativ nr. 19 datë 29.12.2022 rrjedhin prej dy faktorëve të mëposhtëm:

-Efekti i VKM-ve për përdorimin e fondit rezervë përgjatë vitit të cilat nuk pasqyrohen në aktet e fundit të përditësuara ligjore për buxhetin e vitit, trajtuar edhe në pjesë të tjera të shpenzimeve të audituara pjesë e këtij raporti në total rreth 20 miliard lekë.

-Efekti i shkurtimeve dhe rritjes së fondeve në zëra të tjerë të ndryshëm nga ato të fondit rezervë dhe kontigjencës ku përmendim, uljen e fondeve të shpenzimeve të personelit me 1,062 milion lekë, 1,080 milion lekë ulje të fondeve për politika të reja pagash, 600 milion lekë për shpenzimet e interesit të borxhit të huaj, 6,800 milion lekë për politika të reja pensionesh dhe bonusin e pensionistëve, 1,800 milion lekë për shpenzime për kompensim pronarësh.

Këto ulje i kanë dhënë efektet në rritjen e kufirit të shpenzimeve në plan përtej atyre të pasqyruara në tabelën shoqëruese të aktit normativ nr .19 datë 29.12.2022 kryesisht në 6,509 milion lekë në shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 11,946 në shpenzime për fonde speciale (sigurime shoqërore), 2,059 milion lekë për ndihmën ekonomike dhe 900 milion lekë për bonusin e lindjeve.

Nga auditimi konstatohet se ulja e shpenzimeve të ndryshme nga fondi rezervë dhe ai i kontigjencës nuk ndjek parimet e përcaktuara në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe shumat e shpërndara sipas tabelë nr 4 të Aktit normativ nr .19 datë 29.12.2022, i cili, megjithëse në tejkalim të afateve për kryerjen e rishpërndarjeve të buxhetit dhe vetëm 2 ditë nga e drejta për të kryer shpenzimeve me mbylljen e vitit buxhetor është objekt i ndryshimeve të brendshme nga Ministria e Financave.

Një veprimi tillë i MFE, para së gjithash është ndryshim i planit të shpenzimeve buxhetore pas miratimit të buxhetit të rishikuar në kuvend, dhe në të njëjtën kohë e bën komplekse shqyrtimin dhe analizën e ecurisë së treguesve, duke e shndërruar atë në një veprim për të rregulluar përqindjet e realizimit të disa prej treguesve të shpenzimeve. Kjo pasi gjatë auditimit është konstatuar rritje e kufirit të shpenzimeve si pasojë e këtyre ndryshimeve edhe të zërave që normalisht duhet të kishin kaluar nëpërmjet procedurës së shqyrtimit parlamentar për marrjen e konfirmimit për rritje si bonusi i lindjes që është rritur, me 900 milion lekë. Kjo pasi, ndryshimet buxhetore duhet ose të ndjekin të njëjtën procedurë si për miratimin e buxhetit ose votohet me procedurë të përshpejtuar.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit znj. M.Dh. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit znj. Xh.A., Drejtor i Drejtorisë së Financave Vendore z. F.B., Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike z. E. Ll.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga përfaqësuesit e subjektit është paraqitur observacioni me shkresën nr. 5854/50, prot. datë 07.09.2023, e MFE prot., në KLSH nr. 281/26 datë 12.09.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendime të subjektit:

Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me paqartësi dhe mungesë transparence, pasi të gjitha ndryshimet sipas rialokimeve me VKM dhe të gjitha rishpërndarjet që sjellin ndryshime në zërat e shpenzimeve të miratuara në Ligjin e Buxhetit, të ndryshuar, janë evidentuar dhe publikuar duke paraqitur në evidencat e realizimit të Buxhetit si edhe në Buxhetin Faktik të vitit 2022, përveç planit sipas Ligjit të Buxhetit edhe Buxhetin Operativ që reflekton ndryshimet e zërave të Buxhetit sipas zërave të shpenzimeve. Edhe pranë Grupit të KLSH-së është paraqitur Tabela e Treguesve Fiskale të Konsoliduar për vitin 2022 që përmban të dhënat lidhur me Planin e Buxhetit sipas AN nr. 19/2002, rishpërndarjet e bëra sipas zërave të parashikuar në Ligjin e Buxhetit, si edhe Buxhetin Operativ i cili përfshin të gjitha ndryshimet. Nga ana jonë një paraqitje e tillë bëhet me argumentin: Në Ligjin Organik të Buxhetit dhe në Ligjin Vjetor nuk parashikohet një rregull i tillë. Të gjitha fondet e miratuara në Ligjin e Buxhetit Vjetor të cilat shpërndahen gjatë vitit buxhetor, si edhe të gjitha rishpërndarjet e fondeve gjatë vitit, i nënshtrohen rregullave si edhe procedurave përkatëse të cilat janë të përcaktuara në Ligjin Organik të Buxhetit, në Ligjin Vjetor si edhe në Udhëzimin për procedurat standarde të buxhetit dhe në Udhëzimin plotësues “Për zbatimin e buxhetit vjetor.” Nëse ka një ndryshim të ligjit të buxhetit vjetor nuk është e mundur përfshirja e të gjitha shpërndarjeve dhe rishpërndarjeve, pasi nuk mund të kemi përputhje në kohë të ndryshimit të ligjit të buxhetit vjetor me kohën e kryerjes së shpërndarjeve dhe rishpërndarjeve të fondeve të cilat sipas llojit të tyre mund të kryhen edhe deri në fund të vitit buxhetor. Të tilla janë shpërndarjet nga përdorimi i Fondit Rezervë, Fondit të Veçantë, shpërndarja e fondeve të emergjencës, shpërndarja e fondeve për pagesat kalimtare të funksionarëve, etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me reflektimet pas aktit të fundit normativ nr. 19, datë 29.12.2022, sqarohet se reflektimi i VKM-ve përkatëse (për përballimin e inflacionit dhe për politikën e rritjes së pagave) duhet të ishte realizuar para daljes së aktit të fundit normativ nr. 19 datë 29.12.2022, pra në momentin kur është miratuar AN dhe VKM-ja përkatëse. Plani sipas AN nr. 19 duhet të reflektojë planin përfundimtar. Si rrjedhim observacioni nuk merret parasysh.

Titulli i gjetjes	Diferenca ndërmjet Planit fillestar sipas ligjit të buxhetit dhe SIFQ ndryshime ndërmjet buxhetit sipas AN 19, planit operativ dhe planit në SIFQ, problematika lidhur me Aktet Normative dhe reflektimet pas AN 19.
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatuan diferenca në të dhënat e raportuara në treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar sipas Tabelës nr. 4 të Ligjit të Buxhetit me të dhënat e planit fillestar të vitit 2022 të sistemit SIFQ, konkretisht në zërat e shpenzimeve dhe deficitit. Raportet e ndërhuara dhe ofruara nga SIFQ për qëllime të planifikimit buxhetor nuk përdoren nga DPB si një mënyrë për të kontrolluar saktësinë e detajimit të buxhetit fillestar dhe më pas atij operativ.</p> <p>Konstatohet se propozimet e bëra dhe miratimet e ndryshimit të ligjit të buxhetit vjetor me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 dhe Aktin Normativ nr. 19, datë 29.12.2022 janë në tejkallim të afatit të rishpërndarjeve buxhetore, data 15 nëntor, përcaktuar në nenin 48 “Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore”. Nga auditimi i dokumentacionit shoqëruar të këtyre akteve normative konstatohet se mungon një analizë e detajuar për ndryshimet mes zërave të shpenzimeve buxhetore, korrente e kapitale, me synimin e optimizimit të realizimit të tyre për pjesën e mbetur të vitit 2022, pasi relacionet përmbajnë vetëm një përmbledhje të destinacionit të fondeve.</p> <p>Pas aktit të fundit normativ nr. 19, datë 29.12.2022 janë bërë reflektime/ndryshime në zërat e shpenzimeve korrente në tabelën 4 shoqëruese të tij, duke pasqyruar një kolonë të emërtuar “Plani me ndryshime 2022 (shpërndarje rezervash)”. Nga analiza konstatohet se ndryshimet e vlerave rrjedhin prej faktorëve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Efekti i VKM-ve për përdorimin e Fondit Rezervë përgjatë vitit, të cilat nuk pasqyrohen në aktet e fundit të përditësuar ligjore për buxhetin e vitit, në total rreth 20 miliard lekë. -Efekti i shkurtimeve dhe rritjes së fondeve në zëra të tjerë ku përmendim, uljen e fondeve të shpenzimeve të personelit me 1,062 milion lekë, 1,080 milion lekë ulje të fondeve për politika të reja pagash, 600 milion lekë për shpenzimet e interesit të borxhit të huaj, 6,800 milion lekë për politika të reja pensionesh dhe bonusin e pensionistëve, 1,800 milion lekë për shpenzime për kompensim pronarësh. <p>Këto ulje i kanë dhënë efektet në rritjen e kufirit të shpenzimeve në plan përtej atyre të pasqyruara në tabelën shoqëruese të aktit normativ nr. 19, datë 29.12.2022, kryesisht në 6,509 milion lekë në shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 11,946 në shpenzime për fonde speciale (sigurime shoqërore), 2,059 milion lekë për ndihmën ekonomike dhe 900 milion lekë për bonusin e lindjeve. Nga auditimi konstatohet se ulja e shpenzimeve të ndryshme nga Fondi Rezervë dhe ai i Kontigjencës nuk ndjek parimet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe shumat e shpërndara sipas tabelë nr 4 të Aktit normativ nr. 19, datë 29.12.2022, i cili, megjithëse në tejkallim të afateve për kryerjen e rishpërndarjeve të buxhetit dhe vetëm 2 ditë nga e drejta për të kryer shpenzimeve me mbylljen e vitit buxhetor është objekt i ndryshimeve të brendshme nga Ministria e Financave. Një veprim i tillë i MFE, para së gjithash është ndryshim i planit të shpenzimeve buxhetore pas miratimit të buxhetit të rishikuar në kuvend, dhe në të njëjtën kohë e bën komplekse shqyrtimin dhe analizën e ecurisë së treguesve, duke e shndërruar atë në një veprim për të rregulluar përqindjet e realizimit të disa prej treguesve të shpenzimeve. Kjo, pasi</p>

	<p>gjatë auditimit është konstatuar rritje e kufirit të shpenzimeve si pasojë e këtyre ndryshimeve edhe të zërave që normalisht duhet të kishin kaluar nëpërmjet procedurës së shqyrtimit parlamentar për marrjen e konfirmimit për rritje, si bonusi i lindjes rritur me 900 milion lekë, kjo pasi ndryshimet buxhetore duhet të ndjekin të njëjtën procedurë, procedura normale për miratimin e buxhetit ose votohet me procedurë të përshpejtuar.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 45, 46, 48. Ligji nr.115/2021 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar; Akti Normativ nr. 19 datë 29.12.2022“Për disa ndryshime në ligjin nr. 115/2021, për buxhetin e vitit 2022”; Udhëzimi nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Udhëzimi nr.9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit” për njësitë e qeverisjes së Përgjithshme që përdorin SIFQ.</p>
Impakti:	<p>Miratim aktesh normative në tejkallim afati dhe pa analiza të detajuara. Raportim jo i saktë dhe mungesë transparence.</p>
Shkaku:	<p>Mosrespektim i kriterëve dhe afateve ligjore për propozimin/miratimin e AN/Mungesë e gjurmës së auditimit. Mospërdorim i plotë i raporteve të sistemit për të shmangur diferencat në çelje</p>
Rëndësia	<p>E Lartë</p>
Rekomandimi	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për pasqyrimin e saktë të tabelës 4 shoqëruese të ligjit të buxhetit vjetor në sistemin informatik financiar të qeverisë, me qëllim eliminimin e diferencave ligj-sistem. Titullari i institucionit dhe nëpunësi i parë autorizues të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë e veprimeve të kryera pas aktit normativ nr. 19, datë 29.12 .2022 si dhe të evidentojnë efektet në treguesit fiskal.</p>

Titulli i gjetjes:	<p>Zbatim i njëanshëm i AN 17 datë 01.12.2022 dhe lëvrim fondesh pa kërkesë nga institucioni</p>
Situata:	<p>Në Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 është parashikuar rritja e të ardhurave jotatimore në masën 2 miliardë lekë në zërin “Kthim kapitali nga AIC”, si dhe 2 miliardë lekë për Korporatën Shqiptare të Investimeve (AIC), në formën e transfertës kapitale për mbështetjen e projekteve të zhvillimit, për të cilat nuk ka kërkesë nga institucioni përfitues. Me shkresën nr. 22351/129 prot., datë 30.12.2022 është përcjellë zbatimi i Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022, ku aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i është çelur kodi i produktit 21AA201 “Transferta kapitale për AIC”, në vlerën 2,120 milion lekë. Referuar sa më sipër, për AIC efekti neto i veprimeve të autorizuara me këtë akt normativ është 0 (zero) lekë lëvrim fondesh. Pavarësisht efektit neto 0, nga ana e MFE-së është zbatuar vetëm efekti i daljes së mjeteve monetare, me pakësim fondesh për buxhetin e shtetit, pa marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e të njëjtës shumë të specifikuar si kthim kapitali 2 miliardë lekë, pasi nga verifikimi në SIFQ kjo vlerë nuk është arkëtuar.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Akti normativ nr. 17 datë 01.12.2022 për “Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 Për buxhetin e vitit 2022, të ndryshuar.</p>
Impakti:	<p>Dalja e mjeteve monetare, pa arkëtuar shumën e përcaktuar</p>
Shkaku:	<p>Zbatim i njëanshëm i AN 17, si dhe pa kërkesë nga AIC</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p>
Rekomandimi:	<p>Titullari i institucionit dhe Nëpunësi i Parë Autorizues të marrin masa për nxjerrjen e përgjegjësive për zbatimin e njëanshëm të aktit normativ dhe arkëtimin e shumës së specifikuar prej 2 miliardë lekë, duke njoftuar Kontrollin</p>

2.B.3. Mbi menaxhimin e buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, planifikimi dhe transferimi i transfertës së pakushtëzuar, monitorimi dhe analiza e treguesve të buxhetit vendor.

Mbi të ardhurat e pushtetit vendor

Të ardhurat e Pushtetit Vendor, ndahen në: Grandi nga Buxheti i Shtetit (Transferta të pakushtëzuara dhe specifike); Të ardhura nga burimet e veta vendore ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore, tarifata, huamarrje vendore, tatimi mbi pasurinë, tatimi mbi fitimin e bizneseve të vogla dhe të tjera; Taksa të ndara sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Transferta të kushtëzuara nga ministritë e linjës për funksione të deleguara.

Tre kategoritë e para janë klasifikuar si burimeve financiare të disponueshme, burime mbi të cilat bashkitë kanë të drejta vendimmarrje relative në lidhje me mënyrën e përdorimit. Ndërsa, mbi kategorinë e transfertave të kushtëzuara bashkitë nuk kanë autoritet vendimmarrje në lidhje me sasinë apo mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve; pra, ato shpenzohen sipas përcaktimeve të ministrive të linjës.

Sipas projekt ligjit të buxhetit, ligjit për buxhetin e vitit 2022, Akteve Normative të dala në ndryshim të tij dhe tabelës fiskale të buxhetit të konsoliduar, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga pushteti vendor (të ardhurat nga tarifata dhe taksat vendore) paraqitet si në tabelën në vijim.

Tabela: Planifikimi i të ardhurave nga pushteti vendor dhe realizimi i tyre *Në milion lekë*

Emërtimi	Fakt 2021	Projekt Buxhet	Buxhet 2022	AN 3, dt 12.03	AN 12, dt 29.07	AN 17, dt 01.12	AN 19, dt 29.12	Fakt 2022
Të ardhura nga Pushteti Vendor	26,666	27,632	27,632	27,632	27,632	27,632	27,632	27,638
Taksa Lokale	20,166	21,445	21,445	21,445	21,445	21,445	21,445	21,428
Tatimi mbi Pasurinë	6,116	6,187	6,187	6,187	6,187	6,187	6,187	6,138
Tatimi mbi fitimin e biznesit të vogël	385	0	0	0	0	0	0	72

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Këto të ardhura përbëhen nga të ardhurat e taksave lokale, të ardhurat nga tatimi mbi pasurinë dhe të ardhurat nga tatimi mbi fitimin e biznesin të vogël. Me ligjin fillestar të buxhetit të ardhurat nga pushteti vendor janë planifikuar në vlerën 27,632 milion lekë, nga të cilat të ardhurat nga taksat lokale janë planifikuar në vlerën 21,445 milion lekë dhe të ardhurat nga tatimi mbi pasurinë janë planifikuar në vlerën 6,187 milion lekë. Rezulton se të ardhurat e planifikuara nuk kanë pësuar ndryshime me Aktet Normative të dala gjatë vitit.

Referuar tabelës së treguesve fiskal të konsoliduar, për vitin 2022, të ardhurat nga pushteti vendor janë realizuar në vlerën 27,638 milion lekë, ose në masën 100.02%, me mbi realizimin për vlerën 6 milion lekë. Rezulton se vlera e raportuar në tabelën e treguesve fiskalë rakordon me bazën e të dhënave analitike që disponon Drejtoria e Financave Vendore, për të ardhurat e realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për taksat dhe tarifata vendore.

Për vitin 2022, të ardhurat nga taksat lokale janë realizuar në vlerën 21,428 milion lekë, kundrejt 21,445 milion lekë të planifikuara, realizuar në masën 99.9%, me mos realizim për vlerën 17 milion lekë. Të ardhurat nga tatimi mbi pasurinë (ndërtesat), janë realizuar në vlerën 6,138 milion lekë, kundrejt 6,187 milion lekë të planifikuara, realizuar në masën 99.2%, me mos realizim në vlerën 49 milion lekë. Të ardhurat nga tatimi mbi biznesin e vogël, për vitin 2022, janë realizuar për vlerën 72 milion lekë, pavarësisht se nuk janë planifikuar të ardhura, pasi me ligjin nr. 122/2020, shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm është zeruar. Të ardhurat për këtë zë janë realizuar nga mbledhja e detyrimeve të prapambetura.

Në krahasim me vitin e mëparshëm, të ardhurat e pushtetit vendor, janë rritur për vlerën 972 milion lekë, ose 3.7% më shumë se në vitin 2021.

Referuar bazës së të dhënave të Drejtorisë së Financave Vendore rezulton se në total të ardhurat e veta të realizuara nga njësitë e qeverisjes vendore janë 30,969 milion lekë, nga të cilat të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë 27,638 milion lekë dhe të ardhurat jo tatimore janë 3,331 milion lekë. Të ardhurat jo tatimore, janë të ardhura të cilat përfitohen dhe realizohen nga pushteti vendor por për efekt të raportimit të Treguesve Fiskalë të Konsoliduar raportohen në zërin “Të ardhura jo Tatimore”.

Shpenzimet e buxhetit vendor

Sipas projekt ligjit të buxhetit, ligjit për buxhetin e vitit 2022, Aktet Normative të dala gjatë vitit dhe tabelës fiskale të buxhetit të konsoliduar, planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për buxhetin vendor paraqitet si në tabelën në vijim.

Tabela: Planifikimi i shpenzimeve për buxhetin vendor dhe realizimi i tyre *Në milion lekë*

Emërtimi	Projekt Buxhet	Buxhet 2022	AN 3	AN 12	AN 17	AN 19	Plani përfundimtar i buxhetit	Fakt 2022
Shpenzime për Buxhetin Vendor	59,712	60,290	60,290	60,290	61,460	61,460	61,680	58,696
Transfertat nga buxheti i shtetit	27,450	28,028	28,028	28,086	29,251	29,251		
<i>- Fond i pakushtëzuar</i>	18,700	18,723	18,723	18,733	18,733	18,733		
<i>- Grant Specifik</i>	8,750	9,305	9,305	9,353	9,353	9,353		
<i>- Transfertë specifike për shlyerjen e detyrimeve dhe investimeve në sport</i>	0	0	0	0	1,165	1,165		
Shpenzime me financim të huaj	750	750	750	692	627	627		
Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	27,632	27,632	27,632	27,632	27,632	27,632		
Buxheti vendor (nga të ardhurat jo-tatimore)	2,840	2,840	2,840	2,840	2,840	2,840		
Taksa të ndara	1,040	1,040	1,040	1,040	1,110	1,110		

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Me ligjin fillestar të buxhetit shpenzimet për buxhetin vendor janë planifikuar në vlerën 60,290 milion lekë, nga të cilat shpenzimet nga transfertat e buxhetit të shtetit janë planifikuar në vlerën 28,028 milion lekë, shpenzimet nga të ardhurat e veta tatimore janë planifikuar në vlerën 27,632 milion lekë, shpenzimet nga të ardhurat e veta jo tatimore janë planifikuar në vlerën 2,840 milion lekë, shpenzimet nga taksat janë planifikuar në vlerën 1,040 milion lekë si dhe shpenzimet me financim të huaj janë planifikuar në vlerën 750 milion lekë. Me Aktin Normativ 17, datë 01.12.2022, shpenzimet për buxhetin vendor janë planifikuar në vlerën 61,460 milion lekë, duke u rritur për vlerën 1,170 milion lekë, ku te transfertat nga buxheti i shtetit është shtuar zëri transferta specifike për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe investime në sport për vlerën 1,165 milion lekë.

Për vitin 2022, sipas treguesve fiskalë të gjeneruar nga sistemi SIFQ, shpenzimet e buxhetit vendor janë realizuar në shumën 79,600 milion lekë, duke përfshirë edhe shpenzimet e realizuara nga njësitë e qeverisjes vendore për fondin e rindërtimit.

Ndërsa, referuar tabelës së treguesve fiskalë të konsoliduar dhe të publikuar, shpenzimet e buxhetit vendor, për vitin 2022, janë realizuar në shumën 58,696 milion lekë, kundrejt vlerës 61,460 milion lekë të planifikuara me Aktin Normativ nr. 19, datë 29.12.2022, ose realizuar në masën 95%, me mos realizim për shumën 2,764 milion lekë kundrejt planit të buxhetit të ndryshuar.

Konstatohet se AN nr. 19, datë 29.12.2022 nuk reflekton ndryshimet që ka pësuar me VKM apo shkresa të tjera plani i shpenzimeve për buxhetin vendor, pasi plani përfundimtar për këtë zë rezulton të jetë në vlerën 61,680 milion lekë ose 220 milion lekë me shumë se plani i parashikuar me AN nr. 19, datë 29.12.2022 (nga të cilat 120 milion lekë për paketën për përbalimin e inflacionit dhe 100 milion lekë për politikën e rritjes së pagave).

Për sa më sipër kundrejt planit përfundimtar, shpenzimet për pushtetin vendor janë realizuar në masën 95.16%, ose realizuar më pak për vlerën 2,984 milion lekë. Në krahasim me planin fillestar, shpenzimet e buxhetit vendor janë realizuar në masën 97.4%, me mos realizimin në shumën 1,594 milion lekë.

Konstatohet se në tabelën e treguesve fiskal, shpenzimet e realizuara nga pushteti vendor janë raportuar për vlerën total, pa u specifikuar se sa janë realizimet e kryera për transfertat nga buxheti i shtetit, të ardhurat e veta tatimore, të ardhurat e veta jo tatimore, etj.

Trendi i realizimit të shpenzimeve të pushtetit vendor: Në milion lekë

Emërtimi	2021	2022
Shpenzime të pushtetit vendor	52,593	58,696
Dif. nga viti i mëparshëm	967	6,103

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Krahasuar me vitin e mëparshëm, në të cilin shpenzimet e pushtetit vendor janë realizuar në vlerën 52,593 milion lekë, për vitin 2022, këto shpenzime janë rritur për vlerën 3,103 milion lekë ose 10.4% më shumë, krahasuar me vitin 2021.

Tabela në vijim paraqet shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik. Në milion lekë

Shpenzimet e buxhetit vendor	Realizim 2021	Realizim 2022
Shpenzime Korrente	41,311	46,783
Personeli	24,118	25,211
Shpenzime operative dhe te mirëmbajtjes	15,701	18,749
Subvencione	145	347
Te tjera	1,347	2,476
Shpenzime Kapitale	11,282	11,913
Totali	52,593	58,696

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Për vitin 2022, shpenzimet korrent të buxhetit vendor janë realizuar për vlerën 46,783 milion lekë ose në masën 79.7% të totalit të shpenzimeve, ndërsa shpenzimet kapitale janë realizuar për vlerën 11,913 milion lekë ose në masën 20.3% të totalit të shpenzimeve të realizuara nga buxheti vendor. Peshën më të madhe të shpenzimeve vendore, e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime në vlerën 25,211 milion lekë ose 43% e totalit të shpenzimeve.

Nga testimet e kryera nga grupi i KLSH mbi pagesat e regjistruara në SIFQ, konstatohet se për vitin 2022, njësitë e qeverisjes vendore kanë paguar 3,410 milion lekë detyrime të prapambetura, nga të cilat 2,396 milion lekë detyrime të prapambetura për shpenzime kapitale. Pagesat për detyrime të prapambetura përbëjnë 5.8% të shpenzimeve totale të realizuara nga njësitë e qeverisjes vendore dhe 28.6% të shpenzimeve kapitale të realizuara nga këto njësi.

Mbi transfertat e pakushtëzuara

Transferta e pakushtëzuar janë fonde që u jepen njësitëve të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit për financimin e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj.

Sipas aneksit nr. 1, tabelës nr. 3 bashkëlidhur ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, vlera e transfertës së përgjithshme të pakushtëzuar është planifikuar në vlerën 18,723 milion lekë, nga të cilat 18,163 milion lekë për bashkitë dhe 560 milion lekë për qarqet. Vlera e planifikuar për vitin 2022, është sa 1% i vlerës së Produktit të Brendshëm Bruto të parashikuar për vitin 2021 dhe është 273 milion lekë më e lartë së vlera e transfertës së përgjithshme të pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2021, në përputhje me pikën 2 dhe 3, neni 23 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Ndërsa vlera totale e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike është parashikuar 27,928 milion lekë nga të cilat 27,368 milion lekë për bashkitë dhe 560 milion lekë për qarqet.

Me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022, vlera e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë është planifikuar në shumën 28,642 milion lekë, duke u rritur për shumën 1,274 milion lekë në krahasim me planifikimin fillestar.

Në nenin 7, të ligjit nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, përcaktohet se Fondi i Rindërtimit, i cili do përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelën 3. Në nenin 24 të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, përcaktohet se transferta e pakushtëzuar e njësive të vetëqeverisjes vendore, ndahet sipas formulës me kritere të përcaktuara, që i bashkëlidhet si aneks ligjit vjetor të buxhetit. Nga ana tjetër, Fondet e Rindërtimit shpërndahen me Vendim të Këshillit të Ministrave, të cilat në rastin e njësive të vetëqeverisjes vendore rrisin transfertën e pakushtëzuar në shumën e caktuar në VKM. Shtimi me VKM i transfertës së pakushtëzuar për Fondet e Rindërtimit, është jo në përputhje më ligjin e financave të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Rezulton se gjatë vitit 2022, bashkive u janë shtuar fonde në shumën 26,684 milion lekë në formën e transfertave të pakushtëzuara për Fondin e Rindërtimit. Konkretisht, Bashkisë Tiranë i janë shtuar fonde për Rindërtimin në formën e transfertës së pakushtëzuar në shumën 11,229 milion lekë, bashkisë Durrës në shumën 4,323 milion lekë, bashkisë Kamzë në shumën 1,848 milion lekë, bashkisë Kavajë 928 milion lekë, bashkisë Krujë në shumën 1,766 milion lekë, bashkisë Kurbin në shumën 2,017 milion lekë, bashkisë Mirditë në shumën 1,222 milion lekë, bashkisë Rrogozhinë në shumën 662 milion lekë, bashkisë Shijak në shumën 628 milion lekë, bashkisë Vorë në shumën 902 milion lekë, dhe bashkisë Lezhë në shumën 1,159 milion lekë.

Në pikën 95 të udhëzimit plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” citohet se: “*Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për njësitë e qeverisjes vendore (bashki dhe qarqet) çelet në strukturën: Ministria e Linjës 00, Programi 04960, Kapitulli 01, e ndarë në katër 3 mujorë: për bashkitë dhe qarqet në tremujorin e parë 30%, të dytin 25%, të tretin 23% dhe të katërtin 22%. Kur njësia e vetëqeverisjes vendore kërkon avancim të limitit tremujor të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme, duhet ti drejtohet Nëpunësit të Parë Autorizues, një kërkesë të argumentuar për avancimin e fondit Nëpunësi i Parë pas marrjes së kërkesës, vlerëson kërkesën dhe vendos për avancimin ose jo të fondit*”, ndërsa në pikën 96 citohet se: “*Transferta e pakushtëzuar sektoriale për bashkitë, çelet në strukturën: Ministria e Linjës 00, Programi xxxxx, Kapitulli 01, e ndarë në katër 3-mujore: Për bashkitë në tremujorin e parë 30%, të dytin 25%, të tretin 23% dhe të katërtin 22%*”.

Vendosja e kufijve mbi çeljen dhe përdorimin e transfertës së përgjithshme dhe sektoriale është jo në përputhje më pikën 4, neni 4 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku citohet se: “*Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë autonomi të plotë në përdorimin e të ardhurave të veta, të transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave nga taksat e ndara*”.

Titulli i gjetjes:	Vendosja e limiteve mbi çeljen dhe përdorimin e transfertës së përgjithshme dhe sektoriale si dhe marrja e miratimit nga Nëpunësi i Parë Autorizues për avancimin e limitit tremujor çënon autonomin e njësive të vetëqeverisjes vendore për përdorimin e të ardhurave nga transfertat e buxhetit të shtetit.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se, MFE për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, ka nxjerrë udhëzimin plotësues nr. 1, datë 10.01.2022, ku përcaktimet e pikës 95 çënojnë autonominë e njësive të vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet vendosjes së limitit mbi çeljen dhe përdorimin e transfertës së përgjithshme dhe sektoriale, duke e ndarë në katër 3 mujorë (në tremujorin e parë 30%, në tremujorin e dytë 25%, të tretin 23% dhe të katërtin 22%), në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 67/2017 “Për financat

	e vetëqeverisjes vendore”.
Kriteri:	Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 4, pika.
Ndikimi/Efekti	Cënim i autonomisë së njësive të vetëqeverisjes vendore në përdorimin e të ardhurave nga transfertat e buxhetit të shtetit.
Shkaku:	Vendosja e limiteve mbi ndarjen e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertës së pakushtëzuar sektoriale në katër 3 mujorë (30% tremujorin e parë, 25% të dytin 25%, 23% të tretin dhe 22% të katërtin), sipas udhëzimit plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Drejtoria e Financave Vendore të marrë masa e nevojshme, për iniciimin e rishikimit të udhëzimit plotësues për zbatimin e buxhetit në lidhje me limitet e vendosura mbi çeljen dhe përdorimin e transfertës së pakushtëzuar, me qëllim garantimin e autonomisë të njësive të vetëqeverisjes vendore në përdorimin e të ardhurave nga transfertat e buxhetit të shtetit.

Mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor

Në fund të vitit 2022, stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është 5,428.9 milion lekë, nga të cilat detyrimet e prapambetura për bashkitë janë 5,325.9 milion lekë dhe detyrimet e prapambetura për qarqet janë në shumën 103 milion lekë. Në krahasim me vitin e mëparshëm, stoku i detyrimeve të prapambetura është ulur për shumën 1,154 milion lekë.

Me stokun më të lartë të detyrimeve rezulton bashkia Tiranë, në shumën 1,179.7 milion lekë ose 21.7% e totalit të detyrimeve të prapambetura. Bashkia Kavajë rezulton me detyrime të prapambetura në shumën 837.5 milion lekë; bashkia Vorë në shumën rreth 412.9 milion lekë; bashkia Pogradec në shumën 278.4 milion lekë, etj. Bashkia Këlcyrë dhe bashkia Patos, në fund të viti, rezultojnë pa stok të detyrimeve të prapambetura.

Sa i përket qarqeve, stokun më të lartë të detyrimit e ka qarku Durrës, në shumën 51.5 milion lekë ose 50% e totalit të detyrimeve të prapambetura për qarqet, qarku Berat në shumën 39.6 milion, qarku Gjirokastrë, në shumën 10.4 milion lekë, etj.

Në SIFQ detyrimet e prapambetura për njësitë e qeverisjes vendore, përfshirë detyrimet e prapambetura të buxhetit vendor dhe detyrimet me burim financimi nga buxheti qendror (ministri linje apo nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit), rezultojnë në vlerën totale 7,164 milion lekë.

Mbi statusin e gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Referuar ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, evidentohen katër nivele të ndryshme të rasteve të vështirësive financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet **me probleme financiare** kur në një muaj të caktuar të vitit buxhetor konstatohen vonesa prej më shumë se 30 ditësh në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta dhe kur detyrimet e konstatuara dhe të papaguara përbëjnë **15 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara**.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në **vështirësi financiare** kur vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin pasues të muajit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 55, të këtij ligji, dhe vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta rritet progresivisht **mbi nivelin prej 25 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara**.

3. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në **vështirësi serioze financiare** kur borxhet afatgjata dhe detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta përbëjnë **mbi 80 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara**, konstatimin e situatës së vështirësisë serioze financiare,

kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore njofton menjëherë këshillin e njësisë dhe Ministrinë e Financave.

4. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në situatën e paaftësisë paguesve nëse nuk arrin të zbatojë planin e rehabilitimit financiar dhe/ose nëse raporti i borxheve afatgjata dhe detyrimeve të papaguara ndaj shpenzimeve vjetore të miratuara është më i lartë sesa 1.3.

Drejtoria e Financave Vendore në lidhje me statusin e gjendjes financiare të njësive të qeverisjes vendore ka hartuar raportin mbi statusin e vështirësive financiare, ku është analizuar gjendja financiare e 61 bashkive, duke u bazuar në detyrimet. Sipas raportit, mbi vështirësitë financiare, për vitin 2022, 49 bashki janë klasifikuar pa probleme financiare, 8 bashki janë klasifikuar me probleme financiare dhe 4 bashki janë klasifikuar në vështirësi financiare.

Tabela: Statusi i vështirësisë financiare për bashkitë, 2022

Statusi i Vështirësisë	Nr. i bashkive	Bashkia	Detyrime të prapambetura	% e detyrimeve ndaj totali të shpenzimeve të planifikuara, 2022
Pa probleme financiare	49	Të gjitha bashkitë e tjera		
Me probleme financiare	8	Poliçan	40,578,821	15.07%
		Dibër	168,885,134	16.15%
		Tropojë	71,000,782	16.54%
		Pogradec	278,398,150	18.57%
		Devoll	115,580,200	18.65%
		Libohovë	28,894,056	20.01%
		Delvinë	49,021,631	22.73%
		Peqin	103,377,558	23.96%
Në vështirësi financiare	4	Dimal	146,824,791	26.78%
		Cërrik	157,793,548	31.93%
		Vorë	412,867,557	39.02%
		Kavajë	837,517,800	65.07%

Burimi: Raporti “Mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore, 2022”

Bashkia Poliçan ka një stok të detyrimeve të prapambetura në nivelin 15.07% të shpenzimeve vjetore të miratuara, bashkia Dibër në nivelin 16.15%, bashkia Tropojë në nivelin 16.54%, bashkia Pogradec në nivelin 18.57%, bashkia Devoll në nivelin 18.67% të shpenzimeve vjetore të miratuar, bashkia Libohovë Devoll në nivelin 20.01% të shpenzimeve vjetore të miratuar, bashkia Delvinë në nivelin 22.73% të shpenzimeve vjetore të miratuar dhe bashkia Peqin në nivelin 23.96% të shpenzimeve vjetore të miratuar, bashkia Dimal në nivelin 26.78% të shpenzimeve vjetore të miratuar, bashkia Cërrik në nivelin 31.93% të shpenzimeve vjetore të miratuar dhe bashkia Vorë në nivelin 39.02% të shpenzimeve vjetore të miratuar. Situata më serioze paraqitet për bashkinë e Kavajës, ku niveli i detyrimeve të prapambetura paraqitet në nivelin 65.07% të shpenzimeve vjetore të miratuara.

Drejtoria e Financave Vendore, për herë të parë në raportin e statusit të gjendjes financiare të vitit 2022, ka analizuar edhe situatën financiare për qarqet. Sipas raportit, për vitin 2022, 9 qarqe janë klasifikuar pa probleme financiare, qarku i Gjirokastrës është klasifikuar me probleme financiare, ndërsa qarku i Durrësit dhe Berat janë klasifikuar në vështirësi financiare.

Qarku Gjirokastrë ka një nivel të detyrimeve të prapambetura në nivelin e 15.88% të shpenzimeve vjetore të miratuar dhe klasifikohet me probleme financiare. Situata më serioze paraqitet për qarkun Durrës, ku niveli i detyrimeve të prapambetura paraqitet në nivelin 31.86% të shpenzimeve vjetore të miratuara dhe për qarkun Berat niveli i detyrimeve të prapambetura paraqitet në nivelin 53.53% të shpenzimeve vjetore të miratuara.

Statusi financiar i njësive të qeverisjes vendore

Sipas neneve 55, 56, 57, 58, 59 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, statusi financiar i njësive të vetëqeverisjes vendore llogaritet, si përqindjen e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve, mbi shpenzimet vjetore të miratuara. Konstatohet se, në fund të vitit 2022, 56 bashki ose 92% e tyre, kanë realizuar buxhetin e miratuar në masën 33%-90% dhe vetëm 5 bashki ose 8% e tyre, kanë realizuar buxhetin e miratuar në masën mbi 90%, të shpenzimeve të miratuara. Sipas testimeve të kryera nga grupi i auditimit, në qoftë së, statusi financiar i njësive të vetëqeverisjes vendore do të llogaritet si përqindje e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve, mbi shpenzimet e realizuara, statusi financiar i bashkive do të përkeqësohet. Aneksi “Statusi financiar i bashkive sipas shpenzimeve të miratuara dhe të realizuara” trajton në mënyrë të detajuar, statusin financiar të çdo bashki sipas shpenzimeve vjetore të miratuara dhe sipas shpenzimeve vjetore të realizuara si dhe përqindjen e buxhetit të realizuar.

N.q.s, statusi i njësive të vetëqeverisjes vendore do të llogaritet mbi shpenzimet e realizuara, 45 bashki do të klasifikoheshin pa probleme financiare, 9 bashki do të klasifikoheshin me probleme financiare dhe 7 bashki do të klasifikoheshin në vështirës financiare.

Bashkitë Përmet, Belsh, Selenicë dhe Rrogozhinë nga statusi pa probleme financiare do të klasifikoheshin me probleme financiare. Ndërsa bashkitë Libohovë, Delvinë dhe Peqin, të klasifikuar me probleme financiare do të klasifikoheshin në vështirësi financiare.

Më problematike paraqitet gjendja dhe situata financiare për bashkinë Vorë dhe Kavajë, të cilave edhe pse nuk u ndryshon klasifikohet i statusit financiar, u përkeqësohet përqindja e detyrimeve ndaj shpenzimeve faktike të realizuara.

Bashkia Vorë, gjatë vitit 2022, ka planifikuar të shpenzojë 1,058,0771 mijë lekë, ndërkohë që realizimi faktik është shumën 601,185 mijë lekë **ose me realizmin në masën 56.5%**. Detyrimet ndaj të tretëve, rezultojnë në shumën 412,868 mijë lekë dhe raporti i detyrimeve ndaj të tretëve mbi shpenzimet e miratuara është 39.02%. N.q.s. gjendja financiare e bashkisë Vorë do të vlerësohet mbi bazën e shpenzimeve faktike të realizuara, raporti i detyrimeve të ndaj të tretëve me shpenzimet faktike do të ishte 68.68%.

Gjithashtu, Bashkia Kavajë, gjatë vitit 2022, ka planifikuar të shpenzojë 1,287,025 mijë lekë, ndërkohë që realizimi faktik është shumën 1,114,401 mijë lekë **ose me realizmin në masën 86.5%**. Detyrimet ndaj të tretëve, rezultojnë në shumën 837,518 mijë lekë dhe raporti i detyrimeve ndaj të tretëve mbi shpenzimet e miratuara është 65.07%. N.q.s. gjendja financiare e bashkisë Kavajë do të vlerësohet mbi bazën e shpenzimeve faktike të realizuara, raporti i detyrimeve të ndaj të tretëve me shpenzimet faktike do të ishte 75.15%.

N.q.s, statusi i qarqeve do të llogaritet mbi shpenzimet e realizuara, 9 qarqe do të klasifikoheshin pa probleme financiare, qarku Gjirokastrë do të klasifikohet me probleme financiare, qarku Durrës do të klasifikohet në vështirësi financiare dhe qarku Berat do të klasifikohet në vështirësi serioze financiare. Më problematike paraqitet gjendja dhe situata financiare për qarkun Berat, i cili, sipas shpenzimeve të miratuara, klasifikohet në vështirësi serioze financiare. Qarku Berat, gjatë vitit 2022, ka planifikuar të shpenzojë 74,009 mijë lekë, ndërkohë që realizimi faktik është në shumën 34,332 mijë lekë **ose me realizmin në masën 46.39%**. Detyrimet ndaj të tretëve, rezultojnë në shumën 39,615 mijë lekë. N.q.s. gjendja financiare e qarkut Berat do të vlerësohet mbi bazën e shpenzimeve faktike të realizuara, raporti i detyrimeve të ndaj të tretëve me shpenzimet faktike do të ishte 115.39% dhe ky qark do të klasifikohet si qark në vështirësi serioze financiare.

Mbi të ardhurat e pa përdorura nga njësitë e qeverisjes vendore të cilat trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës.

Në vitin 2022, për njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë trashëguar fonde të përdorura nga vitin 2021, në shumën totale 29,875 milion lekë, nga të cilat 29,507 milion lekë i përkasin bashkive dhe 368 milion lekë qarqeve.

Të ndara sipas kapitujve të ardhurat e trashëguara rezultojnë:

- Për kapitullin 1, “Çelje nga buxheti”, janë trashëguar fonde në vlerën 15,999 milion lekë;
- Për kapitullin 5 dhe 6 “Të ardhurat e veta”, janë trashëguar fonde në vlerën 13,847 milion lekë;
- Për kapitullin 2 janë trashëguar fonde në vlerën për 29 milion lekë.

Në totalin e fondeve trashëguara nga viti 2021 është e përfshirë edhe shuma 9,502 milion lekë, e cila i përket fondeve të përdorura për rindërtimin.

Njësitë e qeverisjes vendore, kanë trashëguar fonde në vitin 2023, në shumën totale 28,827 milion lekë, nga të cilat 28,330 milion i përkasin bashkive dhe 497 milion lekë qarqeve. Të ndara sipas kapitujve të ardhurat e trashëguara rezultojnë:

- Për kapitullin 1, “Çelje nga buxheti”, janë trashëguar fonde në vlerën 10,685 milion lekë;
- Për kapitullin 5 dhe 6 “Të ardhurat e veta”, janë trashëguar fonde në vlerën 18,127 milion lekë;
- Për kapitullin 2 janë trashëguar fonde në vlerën për 15 milion lekë.

Në totalin e fondeve trashëguara për vitin 2023 është e përfshirë edhe shuma 6,258 milion lekë, e cila i përket fondeve të përdorura për rindërtimin.

Mbi analizën e stokut të detyrimeve dhe të ardhurave të trashëguara të bashkive dhe qarqeve

Nëse do të vlerësohej stoku i detyrimeve të prapambetura të bashkive në fund të vitit 2022, përkundrejt të ardhurave të pa përdorura të cilat trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës, situata financiare e bashkive mund të përmirësohej.

Tabela: Detyrimet e prapambetura dhe të ardhurat e trashëguara për bashkitë

Në lekë

Nr.	Bashkia	Detyrime të prapambetura	Të ardhurat e trashëguara	Diferenca e të ardhurave të trashëguar me detyrimet e prapambetura	% e të ardhurave të trashëguara/ detyrimeve e prapambetura
1	Poliçan	40,578,821	16,249,350	(24,329,471)	40.04%
2	Dibër	168,885,134	101,429,431	(67,455,703)	60.06%
3	Tropojë	71,000,782	51,143,180	(19,857,602)	72.03%
4	Pogradec	278,398,150	133,627,640	(144,770,510)	48%
5	Devoll	115,580,200	79,935,203	(35,644,977)	69.16%
6	Libohovë	28,894,056	44,732,956	15,838,900	154.8%
7	Delvinë	49,021,631	33,686,791	(15,334,840)	68.7%
8	Peqin	103,377,558	12,050,563	(91,326,995)	11.66%
9	Dimal	146,824,791	28,896,011	(117,928,780)	19.68%
10	Cërrik	157,793,548	40,753,065	(117,040,483)	25.83%
11	Vorë	412,867,557	123,485,600	(289,381,957)	29.9%
12	Kavajë	837,517,800	250,174,350	(587,343,450)	29.87

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Për bashkinë Vorë dhe bashkinë Kavajë për vlerat e paraqitura janë zbritur të ardhurat e trashëguara për rindërtimin. Për bashkinë Libohovë të ardhurat e trashëguara janë më të larta se stoku i detyrimeve të prapambetura, në fund të vitit 2022. N.q.s. bashkitë të cilat në Raportin e Drejtorisë së Financave Vendore janë klasifikuar si bashki me probleme financiare dhe në vështirës financiare, do të përdorin të ardhurat e trashëguara për vitin 2022, stoku i detyrimeve të prapambetura do të ulej, gjendja dhe statusi financiar i njëjësive të qeverisjes vendore, mund të përmirësohej.

-Stoku i detyrimeve të prapambetura për qarqet që kanë rezultuar me probleme financiare, përkundrejt të ardhurave të pa përdorura të cilat trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës, rezulton si në tabelën në vijim:

Detyrimet e prapambetura dhe të ardhurat e trashëguara për qarqet

Qarku	Detyrime të prapambetura	Të ardhura të trashëguara	Diferenca e të ardhurave të trashëguar me detyrimet e prapambetura	% e të ardhurave të trashëguara/ detyrimeve e prapambetura
Gjirokastrë	10,370,648	11,213,867	843,219	108.13%
Durrës	51,499,860	20,086,290	(31,413,570)	39%
Berat	39,614,901	57,734,620	18,119,719	145%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Rezultoni se të ardhurat e trashëguara për qarkun e Gjirokastrës dhe Beratit janë më të larta se stoku i detyrimeve të prapambetura, në fund të vitit 2022.

Gjatë vitit 2022, rezultoni se nuk është përdorur fondi rezervë i krijuar nga transfertat e pakushtëzuar për njësitë e njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Sa trajtuar më sipër, Drejtoria e Financave Vendore ka paraqitur observacionin me nr. 5854/50, datë 07.09.2023, protokolluar në KLSH me nr. 281/25, datë 11.09.2023 ku pretendohet se:

Qëndrimi i subjektit:

Plani përfundimtar rezultoni në vlerën 61,680 milion lekë ose 220 milion lekë më shumë se plani në AN nr. 19, datë 29.12.2022 (nga të cilat 120 milion lekë për paketën e përballimit të inflacionit dhe 100 milion lekë për politikën e rritjes së pagave”. Plani prej 220 milion lekë është pjesë e AN nr. 19, në zërin e planit të fondit të Kontigjencës dhe pas akordimit për njësitë vendore është reflektuar edhe në planin përfundimtar për shpenzimet e buxhetit vendor.

Referuar konstatimit se në tabelën e treguesve fiskal shpenzimet e realizuara nga pushteti vendor janë raportuar për vlerën totale, sqarojmë se hartimi i tabelës së treguesve fiskal nuk është përgjegjësi dhe kompetencë e Drejtorisë së Financave Vendore. Në tabelën e publikuar nga thesari për treguesin fiskal të konsoliduar, shpenzimet vendore raportohen në total ndryshe nga tabela e treguesve fiskalë e cila përdoret gjatë hartimit të buxhetit dhe pasqyron se nga cilat burime financohen shpenzimet e pushtetit vendor. Megjithatë, Drejtoria e Financave Vendore harton çdo vit një Raport për Financat Publike Vendore, ku raportohet edhe realizimi i buxhetit të pushtetit vendor, jo vetëm sipas llogarive ekonomike, por edhe në bazë të burimit të financimit, nga kapitulli 01 të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar, 05 të ardhurat e veta tatimore dhe jotatimore, 02 financim i huaj, etj.

Referuar konstatimit për vendosjen e kufijve mbi çeljen dhe përdorimin e transfertës së pakushtëzuar dhe sektoriale, sqarojmë se çelja e transfertës në katër 3 mujorë është në përputhje të plotë me përcaktimet e Udhëzimit plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 dhe nuk bie në kundërshtim me nenin 4 të ligjit të financave vendore, pasi nuk çënon mënyrën e përdorimit. Bashkitë kanë autonomi të plotë në përdorimin e këtyre fondeve. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar në katër 3 mujorë nuk është kufizim i autonomisë vendore, përderisa këto fonde përdoren nga bashkitë. Pra bashkive u akordohet transfertat e plotë gjatë vitit dhe pjesa që nuk përdoret trashëgohet. Kjo ndarje është vendosur për arsye të menaxhimit të cash-it dhe mirë administrimit të financave publike, si dhe për përdorimin me efektivitet të fondeve nga ana e bashkive që deri në fund të vitit të kenë mundësi për ofrimin e shërbimeve publike në rast të mos realizimit të të ardhurave nga burimet e veta dhe mospërdorimit të gjithë transfertës të vitit buxhetor.

Referuar konstatimit se n.q.s. bashkitë të cilat janë klasifikuar me probleme financiare dhe në vështirësi financiare do të kishin mundësi të përdornin të ardhurat e trashëguara, stoku i detyrimeve do të ulej, sqarojmë se bashkitë kanë autonomi të plotë për ti përdorur të ardhurat e trashëguara dhe të pa obliguara. Për të shmangur këtë fenomen MFE ka propozuar ndryshim ligjor ku fondet jo më pak se 30% e tyre përdoren për: a) shlyerjen e detyrimeve të prapambetura; b) pagimin e nënhuasë të papaguar në kohë, referuar huamarrjeve të pushtetit vendor të dhëna nëpërmjet marrëveshjeve të nënhuasë, përcaktuar në nenin 30 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Pas shqyrtimit të observacionit grupi i auditimit i qëndron konstatimit se AN nr. 19, datë 29.12.2022 nuk reflekton ndryshimet që ka pësuar gjatë vitit me VKM plani i shpenzimeve për buxhetin vendor, pasi plani përfundimtar për këtë zë rezultoni të jetë në vlerën 61,680 milion lekë ose 220 milion lekë me shumë se plani i parashikuar me AN nr. 19, datë 29.12.2022.

Në lidhje me raportimin në total të shpenzime të realizuara nga pushteti vendor në tabelën e treguesve fiskal, sqarohet se nuk është ngarkuar me përgjegjësi Drejtoria e Financave Vendore. Në lidhje me vendosjen e limiteve për çeljen e transfertës së pakushtëzuar në udhëzimin plotësues për zbatimin e buxhetit grupi i auditimit i qëndron konstatimit se cënon autonomimin.

Titulli i gjetjes	Referuar ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, statusi financiar i njësive të vetëqeverisjes vendore llogaritet, si përqindjen e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve, mbi shpenzimet vjetore të miratuara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat rezultojnë me probleme financiare trashëgojnë të ardhura të pa përdorura në vitin buxhetor pasardhës.
Situata:	<p>Statusi financiar i njësive të vetëqeverisjes vendore llogaritet sipas neneve 55, 56, 57, 58, 59 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si përqindjen e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve, mbi shpenzimet vjetore të miratuara.</p> <p>Në raportin e hartuar nga Drejtoria e Financave Vendore për statusin e vështirësive financiare, për vitin 2022, 49 bashki janë klasifikuar pa probleme financiare, 8 bashki janë klasifikuar me probleme financiare dhe 4 bashki janë klasifikuar në vështirësi financiare. Konstatohet se, 56 bashki ose 92% e tyre, kanë realizuar buxhetin e miratuar në masën 33%-90% dhe vetëm 5 bashki ose 8% e tyre, kanë realizuar buxhetin e miratuar në masën mbi 90% të shpenzimeve të miratuara. Nëse, statusi i njësive të vetëqeverisjes vendore do të llogaritet mbi shpenzimet e realizuara, 45 bashki do të klasifikoheshin pa probleme financiare, 9 bashki do të klasifikoheshin me probleme financiare dhe 7 bashki do të klasifikoheshin në vështirësi financiare. Bashkitë Përmet, Belsh, Selenicë dhe Rrogozhinë nga statusi pa probleme financiare do të klasifikoheshin me probleme financiare, ndërsa bashkitë Libohovë, Delvinë dhe Peqin, të klasifikuar me probleme financiare do të klasifikoheshin në vështirësi financiare. Në lidhje me gjendjen financiare të qarqeve, 9 qarqe janë klasifikuar pa probleme financiare, qarku i Gjirokastrës është klasifikuar me probleme financiare dhe 2 qarqe (Durrës dhe Berat) janë klasifikuar në vështirësi financiare. Nëse, statusi i qarqeve do të llogaritet mbi shpenzimet e realizuara, 9 qarqe do të klasifikoheshin pa probleme financiare, qarku i Gjirokastrës do të klasifikoheshin me probleme financiare, qarku i Durrësit do të klasifikoheshin në vështirësi financiare dhe qarku i Beratit do të klasifikoheshin në vështirësi serioze financiare.</p> <p>Rezulton se të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat janë klasifikuar me probleme financiare kanë trashëguar të ardhura të pa përdorura në vitin buxhetor pasardhës. Në qoftë se këto njësi do të përdornin një pjesë të ardhurave që trashëgohen për shlyerjen e detyrimeve, stoku i detyrimeve të prapambetura do të ullej dhe gjendja financiare do të përmirësohej.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 55-59; Udhëzimi nr. 26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.
Ndikimi/Efekt	Ndryshimi i statusit të gjendjes financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
Shkaku:	Planifikimi i dobët, krijimi i detyrimeve të reja si dhe nivel i lartë i stokut të detyrimeve të prapambetura.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë si institucioni i cili ka propozuar ndryshime në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në lidhje me vlerësimin e gjendjes financiare të njësive të qeverisjes vendore mbi shpenzimet e realizuara, si dhe përdorimin e një pjesë të të ardhurave që trashëgohen në vitin pasardhës buxhetor për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, të insistojnë për miratimin sa më të shpejtë të këtyre ndryshimeve, me qëllim që në vitin 2023, të paraqitet një situatë sa më reale e statusit financiar të njësive.

2.B.4. Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit. Monitorimi dhe analiza e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, dhënia e rekomandimeve, për të gjithë strukturën programore të çdo ministrie linje/institucion qendror.

Për vitin 2022, 8 nga 11 ministri, rezultojnë me diferenca midis të dhënave të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisjes dhe të dhënave të paraqitura në raportet e monitorimit, konkretisht: Ministria e Kulturës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

4 ministri kanë dërguar raportin e monitorimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë jashtë afatit kohor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Mbrojtjes. Ndërsa 3 ministri nuk kanë publikuar raportin e monitorimit në faqet zyrtare të internetit: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Turizmit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi konstatohet se në raportet e monitorimit mungon analiza dhe vlerësimi i performancës për zbatimin e buxhetit bazuar në rishpërndarjet e tij, me qëllim evidentimin e impaktit të mundshëm në performancën e objektivave lidhur me to, në kundërshtim me:

- pikën 4.2 të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, ku citohet se: *“Monitorimi ka për qëllim të evidentojë nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin dhe nëse jo të propozojë/rekomandojë ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve. Në rast rialokimi të burimeve, të evidentojë impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to”*.

- pikën 75 të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” ku citohet se: *“Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”*.

Më hollësisht rezultatet e këtyre analizave paraqiten si në vijim:

1. Në sistemin AFMIS, Ministria e Kulturës nuk ka pasqyruar të dhëna mbi vlerën faktike të produkteve nga ana sasiore, pra nuk janë regjistruar në sistem. Vlera e planit të rishikuar të produkteve nga ana sasiore në anekset e paraqitura në hard copy me raportin e monitorimit nuk është e njëjtë me të dhënat në sistemin AFMIS për këtë tregues. Nga auditimi i raporteve të monitorimit rezulton se midis sistemit AFMIS dhe të dhënave faktike të paraqitura, në zërat e shpenzimeve korente, rezultojnë diferenca si në vijim:

Tabela: Diferencat e realizimit sipas SIFQ

(Mijë lekë)

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Min.	Thes.	Dif. M-TH	Min.	Thes.	Dif. M-TH	Min.	Thesari	Dif.
Planifikimi menaxhimi administrimi	154,857	154,852	-5	0	0	0	154,857	154,852	-5
Trashëgimia kulturore	586,933	589,475	2,542	21,205	21,205	0	608	610,682	2,542
Arti dhe kultura	1,914,802	1,922,429	7,627	1,358,388	1,358,388	0	3,273,190	3,280,818	7,627
Totali	2,656,592	2,666,756	10,164	1,379,593	1,379,593	0	4,036,185	4,046,351	10,164

Burimi: Raporti i monitorimit Ministria e Kulturës

2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën nr. 1057, datë 28.02.2023, protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me nr. 2016/932, datë 13.03.2023, ka dërguar raportin e monitorimit, jashtë afatit kohor, jo në përputhje me pikën 3.2.33 të kapitullit 3 të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, ku citohet se: *“...Raportet e katër mujorit dhe tetë mujorit duhet të dorëzohen tek njësia përgjegjëse për monitorimin në Ministrinë e Financave deri në fund të javës së katërt dhe konkretisht deri më 30 Maj; 30 Shtator ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm”*. Nga auditimi i raporteve të monitorimit rezulton se midis sistemit AFMIS dhe të dhënave faktike të paraqitura, në zërin e

shpenzimeve kapitale nga financimi i huaj dhe shpenzimeve korente për artikullin 604, rezultojnë diferenca si në vijim:

Tabela: Diferencat e realizimit sipas SIFQ

(Mijë lekë)

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Min.	Thes.	Dif. M-TH	Min.	Thes.	Dif. M-TH	Min.	Thesari	Dif.
Planif. Menaxh. Adminis.	443,138	443,138	0	3,000	3,000	0	446,138	446,138	0
Shërbime të Kujdesit Parësor	7,453,386	7,453,386	0	239,177	242,980	-3,803	7,692,563	7,696,367	-3,804
Shërbime të Kujdesit Dytësor	30,702,212	30,702,389	-177	2,576,702	2,762,905	-186,203	33,278,914	33,465,294	-186,380
Shërbime të Shëndetit Publik	4,856,279	4,856,280	-1	13,675	13,675	0	4,869,954	4,869,955	-1
Shërb. Komb. Urgjencës Mjek.	232,995	232,995	0	0	0	0	232,995	232,995	0
Përkujdesi Social	29,462,311	29,462,311	0	24,193	24,194	-1	29,486,504	29,486,505	-1
Rehab. Përndjek. Politikë	1,027,241	1,027,241	0	0	0	0	1,027,241	1,027,241	0
Totali	74,177,562	74,177,741	-180	2,856,747	3,046,754	-190,007	77,034,308	77,224,495	-190,187

Burimi: Raporti i monitorimit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Gjithashtu rezulton se relacioni shoqërues nuk ka një analizë të detajuar të treguesve të monitorimit dhe zërave të shpenzimeve për arsyet e niveli i ulët realizimit, por vetëm një relacion konstataues.

3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 2709, datë 10.03.2023, ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportin e monitorimit, jashtë afatit kohor, jo në përputhje me pikën 3.2.33 të kapitullit 3 të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”. Nga auditimi i raporteve të monitorimit rezulton se midis sistemit AFMIS dhe të dhënave faktike të paraqitura, në zërin e shpenzimeve kapitale nga financimi i huaj dhe në shpenzimet korrente, rezultojnë diferenca si në vijim:

Tabela: Diferencat e realizimit sipas SIFQ

(Mijë lekë)

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Ministria	Thesari	Dif.M-Th	Ministria	Thesari	Dif.M-Th	Ministria	Thesari	Dif.M-Th
Planifikim menaxhim administrim	465,664	465,664	0	69,953	69,953	0	535,617	535,617	0
Transporti Rrugor	3,375,849	3,375,850	-1	24,031,663	24,280,410	-248,747	27,407,512	27,656,260	-248,748
Transporti Hekurudhor	515,214	515,214	0	2,010,613	999,409	1,011,204	2,525,827	1,514,623	1,011,204
Transporti Detar	97,737	97,737	0	37,253	37,253	0	134,990	134,990	0
Transporti Ajror	2,009,031	2,009,031	0	76,232	76,232	0	2,085,262	2,085,262	0
Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Furnizimi me Ujë dhe kanalizim	425,898	425,898	0	9,621,412	9,755,504	-134,092	10,047,310	10,181,401	-134,092
Menaxhimi i Mbetjeve urbane	179,722	179,722	-179,722	1,208,728	1,208,728	-1,208,728	0	1,388,450	-1,388,450
Planifikimi Urban	54,580	54,580	0	42,055	42,055	0	96,635	96,635	0
Mbështetje për Energjinë	126,494	126,494	0	21,636,408	892,037	20,744,371	21,762,902	1,018,531	20,744,371
Mbështetje për Burimet Natyrore	261,415	261,416	-1	136,894	136,894	0	398,309	398,310	-1
Mbështetje për Industrinë	267,596	267,596	0	50,807	50,807	0	318,403	318,403	0
Totali i Ministrisë	7,599,477	7,779,201	-179,724	57,713,291	37,549,283	20,164,008	65,312,767	45,328,484	19,984,284

Burimi: Raporti i monitorimit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Gjithashtu rezulton se relacioni shoqërues nuk ka një analizë të detajuar të treguesve të monitorimit dhe zërave të shpenzimeve për arsyet e niveli i ulët realizimit, por vetëm një relacion konstataues.

4. Nga auditimi i raporteve të monitorimit të Ministrisë së Drejtësisë rezulton se midis sistemit AFMIS dhe të dhënave faktike të paraqitura, konstatohen diferenca të programi ‘Shërbimi i provës’, për shpenzimet kapitale me financim të huaj, si në vijim:

Tabela: Diferencat e realizimit sipas SIFQ

(Mijë lekë)

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Ministria	Thesari	Dif.M-Th	Ministria	Thesari	Dif.M-Th	Ministria	Thesari	Dif.M-Th
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	384,537	384,536	-1	78,323	78,323	0	462,860	462,861	-1
Publikimet Zyrtare	40,395	40,395	0	1,746	1,746	0	42,141	42,141	0
Mjekësia Ligjore	76,372	76,372	0	4,831	4,831	0	81,203	81,203	0
Shërbimi për Çështjet e Birësimit	10,813	10,813	0	174	174	0	10,987	10,987	0
Agjencia e trajtimit të pronave	1,169,976	1,169,976	0	5,506	5,506	0	1,175,482	1,175,482	0
Ndihma juridike	35,656	35,656	0	1,182	1,182	0	36,838	36,838	0
Shërbimi i Përmbartimit gjyqësor	126,015	126,015	0	1,567	1,567	0	127,582	127,582	0
Sistemi i Burgjeve	5,841,067	5,841,067	0	418,473	418,473	0	6,259,541	6,259,541	0
Shërbimi i Provës	128,732	128,733	1	5,563	3,000	-2,563	134,295	131,733	-2,562
Totali i Ministrisë	7,813,563	7,813,563	0	517,365	517,365	2,563	8,330,928	8,328,365	2,563

Burimi: Raporti i monitorimit Ministria e Drejtësisë

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 1389/3, datë 01.03.2023, protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me nr. 7039, datë 14.04.2023 ka dërguar raportin e monitorimit, jashtë afatit kohor, jo në përputhje me pikën 3.2.33 të kapitullit 3 të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e

Qeverisjes Qendrore”. Nga auditimi i raporteve të monitorimit rezulton se midis sistemit AFMIS dhe të dhënave faktike të paraqitura, për shpenzimet korente dhe kapitale me financim të brendshëm dhe financim të huaj, rezultojnë diferenca si në vijim:

Tabela: Diferencat e realizimit sipas SIFQ

(Mijë lekë)

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Min.	Thes.	Dif.	Min.	Thes.	Dif.	Min.	Thes.	Dif.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	665,226	665,226	0	63,550	63,550	0	728,776	728,776	0
Arsimi Baze	24,524,190	24,524,191	-1	683,302	702,547	-19,245	25,207,492	25,226,737	-19,245
Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	6,683,925	6,683,926	-1	755,310	755,310	0	7,439,235	7,439,236	-1
Arsimi Universitar	9,084,748	9,083,578	1,170	271,267	271,267	0	9,356,015	9,354,845	1,170
Fonde për Shkencën	260,760	260,760	0	362,948	363,108	-160	623,708	623,868	-160
Zhvillimi i Sportit dhe Rinise	667,277	667,277	0	87,723	87,723	0	755,000	755,000	0
TOTAL	41,886,126	41,884,959	1,167	2,224,100	2,243,504	-19,404	44,110,226	44,128,463	-18,237

Burimi: Raporti i monitorimit Ministria e Arsimit dhe Sportit

Rezultoni se relacioni shoqërues nuk ka një analizë të detajuar të treguesve të monitorimit dhe zërave të shpenzimeve për arsyt e niveli i ulët realizimit, por vetëm një relacion konstatues. Konstatohet se nuk është plotësuar aneksi nr. 4 “Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit”, jo në përputhje me udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”. Gjithashtu ka rezultuar se anekset dhe relacioni shpjegues i Raportit të Monitorimit për vitin 2022, nuk janë të firmosura nga Drejtuesit e EMP apo Sekretari i Përgjithshëm, jo në përputhje me kapitullin “Përgjegjësia e Nëpunësit Autorizues në procesin e monitorimit” dhe kapitullin “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Programit” të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016.

6. Ministria e Mbrojtjes, me shkresën nr. 1314, datë 28.02.2023, protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me nr. 2016/102, datë 28.03.2023 ka dërguar raportin e monitorimit, jashtë afatit kohor, jo në përputhje me pikën 3.2.33 të kapitullit 3 të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

7. Nga auditimi i raportit të monitorimit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme rezulton se midis sistemit AFMIS dhe të dhënave faktike të paraqitura, konstatohen diferenca të programi ‘Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi’, për shpenzimet korente, si në vijim:

Tabela: Diferencat e realizimit sipas SIFQ

(Mijë lekë)

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Min.	Thes.	Dif.	Min.	Thes.	Dif.	Min.	Thes.	Dif.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	157,024	197,620	-40,596	137,812	137,813	-1	294	335,433	-40,597
Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	1,891,190	1,891,190	0	15,000	15,000	0	1,906,190	1,906,190	0
Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ	184,605	184,605	0	0	0	0	184,605	184,605	0
Mbështetje institucionale për procesin e Integritimit	68,945	68,945	0	83,005	83,005	0	151,950	151,950	0
TOTAL	2,301,764	2,342,360	-40,596	235,817	235,818	-1	2,537,581	2,578,178	-40,597

Burimi: Raporti i monitorimit Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Konstatohet se Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportin e monitorimit, jo në përputhje me pikën 49, kapitulli 4 të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

8. Nga auditimi i raportit të monitorimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rezulton se midis sistemit AFMIS dhe të dhënave faktike të paraqitura, konstatohen diferenca në programin “Zhvillimi Rural duke Mbështetur Prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketingun” tek shpenzimet korente dhe në shpenzimet kapitale. Ndërsa në programin “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor” mospërputhjet janë vetëm në shpenzimet kapitale.

Tabela: Diferencat e realizimit sipas SIFQ

(Mijë lekë)

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Min.	Thes.	Dif.	Min.	Thes.	Dif.	Min.	Thes.	Dif.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	334,964	334,964	0	4,457	4,457	0	339,420	339,420	0
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,434,500	1,434,500	0	288,980	288,980	0	1,723,480	1,723,480	0
Mbështetje për Peshkimin	135,005	135,005	0	133,404	133,404	0	268,410	268,410	0
Menaxhimi i Infrastruktursë së kullimit dhe ujitjes	678,891	678,891	0	1,142,493	1,142,493	0	1,821,384	1,821,384	0
Zhvillimi Rural duke mbështetur prodh.bujq	5,489,098	5,489,053	45	3,298,309	3,297,921	388	8,787,407	8,788,974	433
Këshillim dhe informacion Bujqësor	446,661	446,661	0	169,762	170,076	-314	616,423	616,738	-250

Menaxhim i qëndrueshëm bujqësor	17,681	17,681	0	0	0	0	17,681	17,681	0
TOTAL	8,536,800	8,536,755	45	5,037,386	5,037,312	74	13,574,185	13,574,067	119

Burimi: Raporti i monitorimit Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

9. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportin e monitorimit, jo në përputhje me pikën 49, kapitulli 4 të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

10. Nga auditimi i raportit të monitorimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rezulton se midis sistemit AFMIS dhe të dhënave faktike të paraqitura, konstatohen diferenca të programi ‘Arsimi profesional’, për shpenzimet korente dhe kapitale, si në vijim:

Tabela: Diferencat e realizimit sipas SIFQ

(Mijë lekë)

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale		
	Min.	Thes.	Dif.	Min.	Thes.	Dif.
Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	802,202	802,202	0	294,552	294,552	0
Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	346,509	346,509	0	0	0	0
Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	638,240	638,240	0	0	0	0
Menaxhimi i të ardhurave tatimore	3,279,496	3,279,496	0	531,528	531,528	0
Menaxhimi i të ardhurave doganore	3,749,138	3,749,138	0	70,359	70,359	0
Lufta kundër transaksioneve financiare jo ligjore	68,488	98,488	0	1,780	1,780	0
Mbështetje për zhvillimin ekonomik	546,274	545,274	0	59,578	59,578	0
Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastruktura e cilësisë dhe pronësia intelektuale	277,161	277,161	0	4,715	4,715	0
Inspektimi në punë	162,187	162,187	0	3,503	3,503	0
Strehimi	2,482,149	2,482,194	-45	376,732	376,732	0
Arsimi i mesëm profesional	2,068,117	2,068,143	-26	476,454	465,071	11,382.4
Sigurimi shoqëror	57,509,560	57,509,560	0	0	0	0
Tregu i punës	1,938,148	1,938,255	-107.1	65,195	65,195	65,195
TOTAL	73,867,667	73,867,845	-178.1	1,884,395	1,873,013	11,382.4

Burimi: Raporti i monitorimit Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportin e monitorimit, jo në përputhje me pikën 49, kapitulli 4 të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

Nga auditimi, janë konstatuar problematika gjatë zbatimit të buxhetit për kryerjen e shpenzimeve korrente sipas kodeve të produkteve buxhetore, duke rezultuar me mospërputhje midis objektivave të produkteve të buxhetit dhe alokimin/ekzekutimin e tyre sipas pagesave të kryera. Për kryerjen e pagesave për paga të punonjësve, sigurimeve apo edhe shërbimeve pagesat kryhen në mënyrë të përgjithshme në kufirin e planit të çelur sipas produktit, pavarësisht se objektivat e atij produkti përcaktojnë një qëllim tjetër. Si rezultat, kur kryhet raportimi i buxhetit në analizën e indikatorëve mbi realizimin e treguesve të produktit, analiza bazohet në realizimin e buxhetit (në të cilin jo domosdoshmërisht janë raportuar shpenzime që lidhen me këtë produkt), duke rezultuar kështu në të dhëna që nuk përfaqësojnë situatën reale.

Gjithashtu, një çështje tjetër e konstatuar lidhet me detajimin e investimeve në kode ku investimi përfshin një procedurë rikonstruksioni, dhe një procedurë mbikëqyrjeje, për të cilat procedurat e prokurimit kryhen veçmas dhe shpenzimet realizohen në kode të ndryshme projektsh, praktikë kjo e pa unifikuar në institucionet buxhetore.

Nga auditimi me zgjedhje, në vijimi paraqiten disa raste ku trajtohen këto problematika:

Nga auditimi i programit **01110** “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku qëllimi i programit është “*Realizimi i politikave në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në përputhje me standardet evropiane*” konstatohet se në vitin 2022: - në produktin 90501AB “Institucion në mirëfunksionim” me njësi matëse sipas PBA-së në numër dhe ku sipas raportit të monitorimit të MBZHR realizimi i objektivave të këtij produkti është realizimi dhe miratimi i 137 akte ligjore dhe nënligjore. Nga auditimi konstatohet se janë përfshirë shpenzime të kryera për riparim dhe mirëmbajtje automjetesh; paga; dieta; honorare; posta.

Nga auditimi i programit **04220** “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit” në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku qëllimi i programit është “*Fuqizimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë*” konstatohet se në vitin 2022:

- në produktin 90502AA “Kafshë të vaksinuara dhe të gjurmua” me njësi matëse sipas PBA-

së në numër vaksinash konstatohet se janë përfshirë shpenzime të kryera për karburant, vaj, pjesë këmbimi, goma, bateri, siguracion automjeti, shërbim korrier, etj.

-në produktin 90502AB “Kafshë të shëndetshme dhe të kontrolluara”, konstatohet se janë përfshirë shpenzime të kryera për karburant, vaj, pjesë këmbimi, goma, bateri, siguracion automjeti, posta, shërbim korrier, shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës, shpenzime për aktivitete sociale të personelit, etj.

-në produktin 90502AC “Matrikuj për kafshë të blerë”, me njësi matëse sipas PBA-së matrikuj të blera konstatohet se janë përfshirë shpenzime të kryera për detyrime të prapambetura për ekspert të kontraktuar në çështje gjyqësore jashtë vendit; shpenzime për transportin e mjeteve të rënda dhe pompave.

-në produktin 90502AE “Emergjencia veterinarë dhe emergjencia për sigurinë ushqimore”, me përshkrim produkti “Për emergjencat veterinarë dhe emergjencat për sigurinë ushqimore. Ky zë përdoret në rastet e shpërthimit të sëmundjeve të cilat janë të pa parashikueshme”, me njësi matëse “kafshë të dëmshpërblyera” konstatohet se janë përfshirë shpenzime të kryera për energji elektrike dhe detyrime të prapambetura për ekspert të kontraktuar.

Nga auditimi i programit **04250** “Zhvillimi Rural” në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku qëllimi i programit është “Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe atij rural në Shqipëri, për të përmirësuar performancën e tyre ekonomike dhe kushtet e jetesës në zonat rurale, për t'i përgatitur këta sektorë për anëtarësimin e ardhshëm në BE”, konstatohet se në vitin 2022, në produktin 90505AA “Përfitues nga masat mbështetëse në bujqësi” me njësi matëse sipas PBA-së në numër përfituesish, janë përfshirë shpenzime të kryera për karburant, vaj, elektricitet, materiale pastrimi, kancelari, shpenzime gjyqësore etj.

Nga auditimi i programit **04520** “Transporti Rrugor” në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, konstatohet se në produktin 90605AB “Rrugë Nacionale të Mirëmbajtura” me njësi matëse sipas PBA-së kilometra rrugë, janë përfshirë shpenzime të kryera për pagesa dietash, pagesa për ekzekutime të vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, shpenzime për konsulencë gjyqësore, shpenzime për postën, shpenzime për dezinfektim, etj.

Nga auditimi i programit **04760** “Zhvillimi i Turizmit” në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, në produktin 92603AC “Turizëm i promovuar”, me përshkrim “Pjesëmarrja në panaire ndërkombëtare për promovimin e turizmit” janë kryer shpenzime për pagesën e energjisë elektrike, shpenzime për kancelari, pagesa për pjesë këmbimi automjetesh, shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve, pagesë siguracion, etj.

Nga auditimi i programit **01110** “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë konstatohet se në vitin 2022, në produktin 91001AC “Kontrata të Monitoruara nga CFCU”, konstatohet se janë përfshirë shpenzime të kryera për paga, dieta brenda dhe jashtë vendit, kancelari, elektricitet, shërbime të pastrimit, etj.

Në Programin **01120** “Menaxhimi i shpenzimeve publike”, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në produktin 91002AB “Dokumenti i projektligjit vjetor të buxhetit”, konstatohet se janë përfshirë shpenzime të kryera për paga, dieta, mirëmbajtje sistemi, mirëmbajtjen e networkut të ministrisë dhe TDO, mirëmbajtjen e sistemit për strehimin dhe banesat sociale, etj.

Në produktin 91002AC “Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm” konstatohet se janë përfshirë shpenzime të kryera për paga, dieta, energji elektrike, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, përmirësimin e sigurisë së informacionit në infrastrukturën e MFE, etj.

Nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit (pa emra përfaqësuesish), me shkresën nr. 5854/50 datë 07.09.2023, protokolluar në KLSH me nr. 281/25, datë 11.09.2023 janë paraqitur observacionet si në vijim:

Pretendimi i subjektit: Vlerësojmë që për shpenzimet korrente, rishpërndarja e fondeve gjatë vitit 2022 nuk përbën një problematikë e cila mund të ndikojnë dhe të jetë një tregues për vlerësimin e

performancës gjatë zbatimit të buxhetit. Këtu duhet të bëjmë saktësimin që: Përsa i përket shpenzimeve korrente, të gjitha veprimet që prekin Fondet Rezervë dhe Fondin e Veçantë nuk konsiderohen rialokimit buxhetore, pasi në çdo rast të përdorimit të tyre kemi të bëjmë me shpërndarje të fondeve dhe jo rialokim. Kjo është e përcaktuar qartë në Udhëzimin “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Gjithashtu nuk konsiderohen rishpërndarje edhe disa fonde që sipas procedurave specifike të përcaktuara për përdorimin e tyre, shpërndahen gjatë vitit, si psh detajimi i subvencioneve për ujin e pijshëm, shpërndarjen e fondeve për projekte artistike, për emergjenca, etj. Pra numri i rishpërndarjeve për shpenzimet korrente nuk konsiderohen problematike nga ana jonë. Jemi dakord me rekomandimin e KLSH-së në faqen 96 që DB të marrë masa për monitorimin e zbatimit të buxhetit sipas produkteve përkatëse në Ministrinë e Linjës në lidhje me zbatimin e objektivave, si edhe të përdori rishpërndarjen si tregues i vlerësimit të performancës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi shqyrtimit të observacionit, i qëndron konstatimit për monitorimin e zbatimit të buxhetit sipas produkteve përkatëse në Ministrinë e Linjës në lidhje me zbatimin e objektivave, si edhe të përdori rishpërndarjen si tregues i vlerësimit të performancës. Ndërsa metodologjia që mund të përdoret mbetet brenda kompetencave dhe gjykimit profesional të Drejtorisë së Buxhetit.

Titulli i gjetjes:	Në raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit mungon monitorimi i shpenzimeve të realizuara sipas produkteve, duke sjellë edhe mos evidentim të problematikës së mospërputhshmërisë së natyrës së shpenzimeve të realizuara me produktin përkatës. Mungon një analizë dhe vlerësim performance në zbatimin e buxhetit bazuar në rishpërndarjet buxhetore, me qëllim evidentimin e impaktit të mundshëm në performancën e objektivave lidhur me to.
Situata:	Për vitin 2022, 8 nga 11 ministri, rezultojnë me diferenca midis të dhënave të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisjes (SIFQ) dhe të dhënave të paraqitura në raportet e monitorimit. Konstatohet se 4 ministri kanë dërguar raportin e monitorimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë jashtë afatit kohor, ndërsa 3 ministri nuk kanë publikuar raportin e monitorimit në faqet zyrtare të internetit. Nga auditimi konstatohet se, në raportet e monitorimit mungon analiza dhe vlerësimi i performancës për zbatimin e buxhetit bazuar në rishpërndarjet e tij, me qëllim evidentimin e impaktit të mundshëm në performancën e objektivave lidhur me to, në kundërshtim me pikën 4.2 të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore” dhe pikën 75 të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Nga auditimi është konstatuar mungesë monitorimi të zbatimit të buxhetit nga MFE për ministrinë e linjës, pasi nuk evidentohet dhe merren masa për përdorimin e shpenzimeve në përputhje me qëllimin e programeve buxhetore për të cilën janë miratuar, konkretisht: - Programi 04220 “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit”, programi 04250 “Zhvillimi Rural” në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, programi 04520 “Transporti Rrugor” në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, programi 04760 “Zhvillimi i Turizmit” në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, etj, ku janë përdorur fondet për pagesën e shpenzimeve të kryera për karburant, vaj, pjesë këmbimi, goma, bateri, siguracion automjeti, elektricitet, materiale pastrimi, kancelari, shpenzime gjyqësore, shërbim korrier, shpenzime për aktivitete sociale të personelit, shpenzime të kryera për detyrime të prapambetura për ekspert të kontraktuar në çështje gjyqësore jashtë vendit; shpenzime për transportin e mjeteve të rënda dhe pompave, pagesa për ekzekutime të vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, etj.
Kriteri:	- Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, pika 4.2; - Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të

	buxhetit” pika 75.
Impakti:	Mungesë efektiviteti, eficiencë dhe transparencë në zbatimin e buxhetit dhe monitorimin e tij.
Shkaku:	Mospërputhje e natyrës së shpenzimeve të realizuara me produktin përkatës dhe mungesë monitorimi. Mos përdorim i rishpërndarjeve si një tregues performancë në zbatimin e buxhetit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të marrë masa për monitorimin e zbatimit të buxhetit sipas produkteve përkatëse në Ministrinë e Linjës në lidhje me zbatimin e objektivave, si dhe të përdor rishpërndarjet si tregues në vlerësimin e performancës.

- Vlerësimi i projekteve të investimeve, monitorimi dhe raportimi i tyre me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Investimet Kapitale me Financim të Brendshëm

Sipas projekt ligjit të Buxhetit, ligjit për Buxhetin e vitit 2022, akteve normative për ndryshimin e tij dhe tabelës fiskale, planifikimi dhe realizimi i investimeve me financim të brendshëm paraqitet si në vijim:

Tabela: Planifikimi dhe realizimi i investimeve me financim të brendshëm Në milion lekë

Emërtimi	Fakt 2021	Projekt Buxhet	Ligj Buxheti	AN 3	AN 12	AN 17	AN 19	Fakt 2022
Financim i brendshëm	72,116	61,791	62,766	57,594	58,539	65,196	64,565	63,675

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Në ligjin e buxhetit, investimet me financim të brendshëm janë planifikuar në vlerën 62,766 milion lekë. Me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, shpenzimet për investimet e brendshme janë planifikuar në vlerën 57,594 milion lekë, duke u ulur për vlerën 5,172 milion lekë krahasuar me planin fillestar. Me Aktin Normativ nr. 12, datë 29.07.2022, këto shpenzime janë planifikuar në vlerën 58,539 milion lekë, duke u rritur për vlerën 945 milion lekë. Me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022, janë planifikuar në vlerën 65,196 milion lekë duke u rritur për vlerën 6,657 milion lekë, ndërsa me Aktin Normativ nr. 19, datë 29.12.2022, shpenzimet kapitale me investim të brendshëm janë planifikuar në vlerën 64,566 milion lekë, duke u ulur për vlerën 631 milion lekë.

Sipas tabelës së treguesve fiskal, rezulton se shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në vlerën 63,675 milion lekë ose në masën 98.6% krahasuar me planin përfundimtar (Aktin Normativ nr. 19, datë 29.12.2022), me mos realizim në vlerën 890 milion lekë. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, në krahasim me planin fillestar janë realizuar në masën 101.5%, ose me mbi realizim për vlerën 909 milion lekë.

Kundrejt vitit 2021, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar më pak për vlerën 8,441 milion lekë.

Trendi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, referuar Treguesve Fiskal të Konsoliduar krahasuar me vitin e kaluar rezulton si në vijim:

Tabela: Trendi i realizimit të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm

Në milion lekë

Emërtimi	2021	2022
Kapitale Financim i brendshëm	72,116	63,675
Dif. nga viti i mëparshëm	12,569	-8,441

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Sipas raportimit të Drejtorisë së Investimeve, për vitin 2022, investimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në vlerën 91,181 milion lekë, ndërkohë sipas SIFQ rezulton në vlerën 63,675 milion me një diferencë prej 27,506 milion lekë.

Tabela: Realizimi i investimeve sipas SIFQ dhe Drejtorisë së Investimeve

	Në milion lekë
	Fakt datë 31.12.2022
Financimi i Brendshëm - Drejtoria e Investimeve	91,181
Financimi i Brendshëm – SIFQ	63,675
Diferenca në raportim	27,506

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Kjo diferencë është kryesisht për arsye se:


- Drejtoria e Investimeve ka përfshirë në raportim 2 projekte të llogarisë ekonomike 232 në vlerën 20,000 milion lekë, konkretisht projektin “Akordim i transhit të parë për mbulimin me likuiditet të veprimtarisë operationale të shoqërisë KESH” në vlerën 8,000 milion lekë dhe projektin “Akordim i transhit të dytë për mbulimin me likuiditet të veprimtarisë operationale të shoqërisë KESH” në vlerën 12,000 milion lekë, të cilët në tabelën e treguesve fiskal janë raportuar si zë më vete “Mbështetje buxhetore për sektorin energjitik”.

- Në vlerën e paraqitur për investimet te tabela e treguesve fiskal përfshihen edhe investimet të cilat realizohen nga të ardhurat e kapitullit 6 (të ardhurat dytësore). Për vitin 2022, këto investime të cilat nuk kanë plan buxheti të miratuar, por në tabelën e treguesve fiskal, raportohen si investime të realizuara ndaj planit të buxhetit, duke mbivlerësuar realizimin e tyre, rezultojnë në vlerën totale 1,352 milion lekë.

- Drejtoria e Investimeve ka përfshirë në raportim edhe vlerën e investimeve të realizuara nga njësitë e qeverisjes qendrore për rindërtimin, ndërkohë që në tabelën e treguesve fiskale, fondi i rindërtimit është raportuar si zë më vete.

Sipas Drejtorisë së Investimeve, realizimet mujore të investimeve kapitale me financim të brendshëm, rezultojnë si në grafikun në vijim:

Grafiku: Realizimi mujor i investimeve me kapital të brendshëm



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Konstatohet se në fund të vitit janë realizuar investime në vlerën 37,258 milion lekë ose 40.86% e vlerës totale të investimeve të realizuara, nga të cilat në muajin Dhjetor janë realizuar 19,980 milion lekë investime ose 21.91% e totalit të realizimeve, ndërsa gjatë muajit Janar të vitit 2023, janë paguar investime, për llogari të buxhetit të vitit 2022, në vlerën totale 17,278 milion lekë ose 18.95% të vlerës totale të investimeve të realizuara.

Nga auditimi i projekteve të investimeve me financim të brendshëm janë konstatuar problematikat si në vijim:

- Janë konstatuar 14 projekte me burim financimi të ardhurat e arsimit të lartë, në vlerën 180,661 mijë lekë me përshkrim “Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve” në disa njësi shpenzuese, të cilët janë keq klasifikuar në llogarinë 231 “Investime Kapitale të Trupëzuara”. Për këto investime është përdorur i njëjti kod produkti, për disa institucione të arsimit të lartë, duke mos identifikuar specifikisht investimet e kryera në nivel produkti investimi me impakt në cilësinë e informacionit të raportuar dhe vështirësi në ndjekjen e ecurisë së tyre.

- Për vitin 2022, në lidhje me kontratat e nënshkruara referuar modulit të kontratave në regjistruara në SIFQ, konstatohet se janë nënshkruar 3,518 kontrata, vlera e kontraktuar e të

cilave për vitin 2022 është 14,513,009 mijë lekë, ndërsa vlera e kontraktuar totale është 43,712,668 mijë lekë, nga të cilat 1,319 kontrata janë për investimet, me vlerë të kontraktuar për 2022 prej 10,045,767 mijë lekë dhe vlerë totale kontratash 34,468,412 mijë lekë.

Nga këto 1,319 kontrata rezultojnë se:

-688 kontrata janë nënshkruar nga institucionet e qeverisjes qendrore, me vlerë të kontraktuar për vitin 2022 prej 7,997,295 mijë lekë dhe vlerë totale të kontraktuar për kontratat 27,986,570 mijë lekë.

-631 kontrata janë nënshkruar nga institucionet e vetëqeverisjes vendore, me vlerë të kontraktuar për vitin 2022 prej 2,048,472 mijë lekë dhe vlerë totale të kontraktuar për kontratat 6,481,841 mijë lekë.

Këto 1,321 kontrata u përkasin 172 institucioneve, ku Institucionet më përfaqësuese linje sipas klasifikimit në modulën e kontratave në SIFQ paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela: Kontrata të lidhura pas datës 15 Tetor

lekë

Institucioni	Vlera e kontraktuar viti 2022	Vlera e kontraktuar në total
Reparti Ushtarak Nr.1001 Tirane	2,254,684,160	7,488,755,623
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	1,104,854,115	2,729,196,113
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	758,807,043	1,371,942,583
Aparati Drejt.Pergj.Tatimeve	431,341,926	524,547,888
Autoriteti Rrugor Shqiptar	370,715,506	5,625,274,306
Bashkia Tirana	304,597,560	4,071,046,295
Bashkia Durrës	247,042,425	591,188,999
Bashkia Kavaja	193,615,197	649,908,711
Bashkia Kamez	190,347,496	691,786,734
Universiteti i Tiranës	173,845,690	279,052,989
Reparti Ushtarak nr. 6010 Tirane	161,303,179	243,000,659
Aparati Ministrisë së Financave	151,603,930	163,623,477
Sh.A. Ujësullës-Kanalizime Mat	139,800,000	695,555,899
Aparati Ministrisë Arsimit e Shkencës	122,610,591	195,441,146
Bashkia Roskovec	111,175,257	213,656,523
Aparati Këshilli i Larte Gjyqësor	109,063,258	147,823,258
Sh.A. Ujësullës-Kanalizime Kurbin	108,883,118	533,909,015
Bashkia Pogradec	108,093,140	310,856,479
Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile/Rezervat e Shtetit	105,575,204	105,583,419
Reparti Ushtarak Nr.4300 Tirane	98,457,634	201,852,286
20 Institucione	7,246,416,429	26,834,002,402
Institucione Total 172	10,045,767,138	34,468,411,704
Pesha e 20 Institucioneve mbi Totalin	72%	77.8%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Për sa më sipër, 20 nga 172 institucione (11.6% e totalit) zënë një peshë të konsiderueshme prej 72% të totalit të vlerës së kontraktuar për vitin 2022 dhe 77.8% të vlerës së kontraktuar në total për kontratat.

Nënshkrimi i kontratave pas datës 15 Tetor është në kundërshtim me:

- nenin 51, pika "g" të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ku citohet se: "Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor".

-nenin11 të Kreut III të ligjit nr. 115 datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022" përcakton: Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mund të fillojnë procedurën e prokurimit që në muajin nëntor të vitit korrent, nëse fondet janë akorduar/regjistruar në sistemin e thesarit për vitet 2022 dhe 2023, me kushtin që lidhja e kontratës të bëhet efektive vetëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

-pikën 83 të Udhëzimit nr. 9 datë 20.07.2022 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, ku citohet se: Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor", dhe aneksi "Gjurma Standarde e Auditimit për Ekzekutimin e Shpenzimeve 2/5" përcakton se "Angazhim, do të thotë ngurtësim i fondeve për shumën e kontratës".

-pikën 1 të VKM-së nr. 807 datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore publike”, e dalë në zbatim të ligjit, e lidh ndërmarrjen e angazhimeve me publikimin e procedurave të reja të prokurimit, ku citohet se: “Pas datës 15 tetor të çdo viti buxhetor, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk mund të publikojnë njoftimin për prokurimin e mallrave/punëve/shërbimeve, të cilat nuk janë përfshirë në regjistrin e prokurimeve publike, deri në këtë datë” dhe pikën 2 ku citohet se: “Pas datës 15 tetor, procedurat e prokurimeve publike, të parashikuara në regjistrin e prokurimeve publike, mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar, të miratuar për njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Lidhja e kontratës në këtë rast bëhet vetëm pasi fondi të jetë vënë në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor, në buxhetin e tij, të miratuar për vitin buxhetor pasardhës”.

- 85 institucione të qeverisjes qendrore rezultojnë se kanë paguar detyrime të prapambetura në vlerën 6,169,244 mijë lekë, të cilat përfaqësojnë rreth 6.8% të investimeve kapitale me financim të brendshëm të realizuara për vitin 2022.

Tabela: Detyrimet e prapambetura të paguara me buxhetin e vitit 2022 për investime.

lekë

Instytucioni	Detyrimet e prapambetura të paguara me buxhetin e vitit 2022
Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë	3,142,628,057
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	479,618,374
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizimeve	239,231,643
Autoriteti Rrugor Shqiptar	207,807,386
Bashkia Kolonjë	180,238,069
Bashkia Pogradec	141,714,606
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	131,973,009
Bashkia Belsh	123,170,606
Bashkia Kamëz	97,000,000
Bashkia Dibër	91,200,000
Bashkia Krujë	83,932,448
Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave Durrës	74,668,810
Sh.A. Ujësjetllës-Kanalizime Durrës	68,152,297
Sh.A. Ujësjetllës-Kanalizime Lushnje Qytet	65,550,000
Bashkia Malësi e Madhe	57,000,000
Bashkia Poliçan	57,000,000
Bashkia Fier	51,474,200
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	50,563,200
Bashkia Maliq	48,245,738
Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	47,284,704
Të tjera	730,791,105
Totali për 85 institucione	6,169,244,252
20 institucionet me pagesat më të larta	5,438,453,147
% që zënë 20 institucionet	88%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Pagesa e këtyre detyrimeve të cilat janë raportuar si investime të vitit 2022, është në kundërshtim me pikën a, të nenit 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ku citohet se: “Metoda e shpenzimeve dhe të ardhurave për qëllim të këtij ligji ka të bëjë me: a) njohjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës”. Për këtë arsye, treguesit e realizimit të investimeve publike janë të mbivlerësuar për këtë nivel, duke paraqitur si investime të vitit, investime, faturat e të cilave konstatohet se datojnë që prej vitit 2014.

- Nga auditimi mbi detajimin e fondeve për investimeve publike me financim të brendshëm të miratuara me ligjin nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, konstatohen 6 projekte investimi, me përshkrimin “Fond i ngrirë”, në vlerën fillestare 4,325,430 mijë lekë, në 12 programe të ndryshme buxhetore, si në vijim:

Tabela: Fondi i ngrirë

lekë

Emërtimi	Program	Kodi produktit	Emërtimi i produktit	Buxheti Fillestar	Buxheti Operativ
				Viti 2022	Viti 2022
Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës	4540	M060625	Fond i ngrirë	50,000,000	89

Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës	6220	M060625	Fond i ngrirë	1,029,275,000	70,385
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellsave	6370	M060625	Fond i ngrirë	632,000,000	0
Autoriteti Rrugor Shqiptar	4520	M060625	Fond i ngrirë	1,709,600,000	0
Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhës	4550	M060625	Fond i ngrirë	17,000,000	0
Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhës	4550	M060625	Fond i ngrirë	99,560,000	0
Qendra Kombëtare e Biznesit	4130	M100024	Fond i ngrirë	1,200,000	0
Aparati i Ministrisë së Mbrojtjes	1110	M170203	Fond i ngrirë	120,000,000	0
Reparti Ushtarak Nr.6010 Tiranë	2150	M170203	Fond i ngrirë	75,000,000	0
Reparti Ushtarak Nr.5001 Tiranë	9430	M170203	Fond i ngrirë	37,704,000	0
Reparti Ushtarak Nr.6016 Tiranë	2150	M170203	Fond i ngrirë	70,500,000	0
Reparti Ushtarak Nr.6640 Tiranë	2150	M170203	Fond i ngrirë	262,780,000	0
Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	10910	M170203	Fond i ngrirë	14,456,000	0
Aparati Prokurorisë së Përgjithshme	1110	M280027	Fond i ngrirë	77,830,000	0
Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve	1330	M870013	Fond i ngrirë	67,000,000	366,536
Agjencia Kombëtare e Rinisë	8610	M870013	Fond i ngrirë	50,000,000	0
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave	1110	M890005	Fond i ngrirë	5,500,000	0
Bashkia Mallakastër	6370	M060625	Fond i ngrirë	6,025,536	0
TOTAL				4,325,430,536	437,010

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Detajimi i fondeve të ngrira për investime kapitale nuk është në përputhje me përcaktimet e bëra për përkufizimin e projektit të investimit publik ku citohet se: “projekt investimi” është një seri punimesh, aktiviteteve apo shërbimesh, që synojnë të përmbushin një objektiv të pandashëm të një natyre specifike ekonomike apo teknike, me qëllime qartësisht të identifikuar. Rezervimi i fondeve të këtyre investimeve sipas këtij detajimit fillestar nuk krijon mundësinë e zhvillimit të procedurave për prokurimin përgjatë vitit apo kryerjen e pagesave në rast të detyrimeve të mbartura dhe në vijim kryhen rishpërndarje ndërmjet projekteve për çdo njësi shpenzuese. Në fund të vitit, sipas planit përfundimtar, vlera e këtyre projekteve paraqitet në shumën 437 mijë lekë. Detajimi i këtyre fondeve pa projekt specifik në çeljen fillestare është në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022”, pika 25, ku janë të parashikuara kriteret dhe përparësitë në financimin e projekteve dhe nuk parashikohet çelja e fondeve të ngrira për investimet kapitale të miratuara.

- Referuar të dhënave në SIFQ, konstatohet se, raportohet si investim i realizuar në vitin 2022, projekti i investimit me kod M062991 i Autoritetit Rrugor Shqiptar me përshkrim “Vendime gjyqësore në proces” me vlerë 180,000 mijë lekë. Për planifikimin dhe realizimin e këtyre shpenzimeve duhet të ishin përdorur llogaritë e shpenzimeve operative. Nga auditimi konstatohet se, vlera për 32,085 mijë lekë, përfaqëson detyrime të prapambetura të periudhave të mëparshme duke filluar nga viti 2016.

Tabela: Projekti me Kod M062991 “Vendime gjyqësore në proces”

Mijë lekë

Projekti M062991 "Vendime Gjyqësore në proces"	Vlera
Likuiduar fatura të vitit 2016	7,457
Likuiduar fatura të vitit 2017	5,553
Likuiduar fatura të vitit 2018	18,648
Likuiduar fatura të vitit 2019	1,351
Likuiduar fatura të vitit 2020	427
Totali	32,085

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Konstatohet se gjatë vitit 2022, janë regjistruar dhe likuiduar fatura të vitit 2016, konkretisht në vlerën 7,457 mijë lekë. Referuar auditimit të mëparshëm të KLSH, për këtë projekt rezultoi se nuk ka pasur fatura të likuiduara për vitin 2016.

- Në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në programin buxhetor 06210 “Programe zhvillimi” raportohet si investim i realizuar kosto lokale e menaxhimit të projekteve të investimit në shumën 883,196 mijë lekë, me kod projekti M56032 “Projekti i rrugëve dytësore dhe lokale”, me përfitues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, ndërkohë që këto fonde përdoren në llogari bankare të nivelit të dytë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për aktivitetin e shpenzimeve korente të institucionit.

- Nga auditimi janë konstatuar se në 17 raste për 9 projekte investimi në vlerën 398,792 mijë lekë, është bërë parapagim i kontratave, si në vijim:

Tabela: Kontrata të parapaguara për investime

Ministria e Linjës	Kodi i Projektit	Përshkrimi i Projektit	Furnitori	Vlera (në lekë)
FSHZH	22AC101	Rigjenerimi Urban në zona periferike dhe informale dhe në fshatra me popullsi të dendur, etj	F....	38,848,859
FSHZH	22AD701	Nxjtja e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet aplikimit të modeleve inovative për përmirësimin e shërbimeve utilitare publike	H....	4,082,812
FSHZH	M630008	Rikonstruksione	"K....." SH.P.K.	11,657,461
FSHZH	22AA801	Ndërhyrje në zona sportive dhe lodra për fëmijë "Dua të luaj"	B....SH.P.K	44,659,871
FSHZH	22AD701	Nxjtja e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet aplikimit të modeleve inovative për përmirësimin e shërbimeve utilitare publike	H....	790,044
FSHZH	18BN014	Ndërhyrja Rigjenerimi Urban në Fshatra me potencial Turistik	N.....	22,309,716
FSHZH	18BN014	Ndërhyrja Rigjenerimi Urban në Fshatra me potencial Turistik	E.....	17,636,977
FSHZH	22AD701	Nxjtja e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet aplikimit të modeleve inovative për përmirësimin e shërbimeve utilitare publike	B.....	1,633,541
FSHZH	22AD701	Nxjtja e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet aplikimit të modeleve inovative për përmirësimin e shërbimeve utilitare publike	B.....	969,520
FSHZH	22AB901	Ndërhyrje për ndërtimin e Infrastrukturës së Transportit, Parkimeve, Stacioneve multimodela, moleve, etj	P.....	57,277,000
FSHZH	18BP035	Qendra Multifunkionale e Zhvillimit Rajonal, Rajoni 4, Faza 1	A.....	55,728,000
FSHZH	22AC101	Rigjenerimi Urban në zona periferike dhe informale dhe në fshatra me popullsi të dendur,	V.... H.....	26,364,618
FSHZH	22AA001	Ndërhyrje në zona historike për forcimin e potencialit turistik, kala, ura, qendra historike, pazare, fasada	A....	12,033,768
FSHZH	22AD701	Nxjtja e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet aplikimit të modeleve inovative për përmirësimin e shërbimeve utilitare publike	B.....	5,010,311
FSHZH	18BN138	Faza e Katërt e Sheshit Publik Para Hyrjes së Portit Durrës	I.....	22,611,583
FSHZH	18BN014	Ndërhyrja Rigjenerimi Urban në Fshatra me potencial Turistik	U.....	22,155,101
FSHZH	22AA001	Ndërhyrje në zona historike për forcimin e potencialit turistik, kala, ura, qendra historike, pazare, fasada,	S.....	55,022,536

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimi rezulton se Fondi Shqiptar i Zhvillimit me shkresën nr. 1402/4 prot., datë 14.11.2022, i ka dërguar MFE-së kërkesë për miratimin e dhënies së pagesës paraprake në kontratat e mësipërme të zbatimit të punimeve. Ministri i Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 20993/1 prot., datë 23.11.2022 ka miratuar dhënien e fondeve në formën e paradhënies duke përdorur si referencë ligjore pikën 160 dhe 161 të Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.

Nga auditimi konstatohet se kontratat e mësipërme nuk rezultojnë të jenë të një rëndësie të veçantë. Për sa më sipër parapagimi i kontratave është në kundërshtim me pikën 160, 161 të Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar ku citohet si në vijim:

Pika 160: *Ndalohet përdorimi i formës së ngurtësimit në llogari të klientit për të gjitha kontratat (investime, shërbime). Përyjashtime nga ky rregull mund të bëhen vetëm për kontrata të rëndësisë së veçantë dhe vetëm me miratim paraprak të Ministrit përgjegjës të Financave. Kushti i kontratës i lidhur në kundërshtim me këtë parashikim është i pavlefshëm dhe nuk ekzekutohet.*

Pika 161: *Në lidhjen e kontratave për investime nuk lejohet të parashikohet dhënia e fondeve buxhetore në formën e paradhënies, përveç rasteve kur parashikohet në kontratë me referencë të specifikuar të aktit ligjor/nënligjor...*

Mbi marrjen e angazhimeve buxhetore, rishpërndarjet e fondeve të investimit dhe realizimin për programet buxhetore të audituara:

Nga auditimi mbi detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve të investimeve në projekte investimi përgjatë vitit janë konstatuar problematika që detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA 2022-2024, detajimin e fondeve të investimeve për vetëm vlerën e 20% të kostos së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore, detajimin e planit buxhetor në 3 vite për investime që përfshijnë periudhë faturimi për kontrata që parashikojnë periudhë faturimi më të vogël se një vit, shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve të tjera të investimit publik detyrime të prapambetura apo në proces nga vitet e

kaluara, mosregjistrimin e kontratave dhe rrjedhimisht mos regjistrimin e obligimit në SIFQ duke lejuar ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura. Këto veprime janë legjitimuar nga miratimi i dhënë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në detajimin fillestar të fondeve të investimit apo rialokimet e kryera përgjatë vitit.

Nga auditimi i projekteve të reja të investimeve të analizuara sipas programeve buxhetore dhe institucioneve përkatëse, konstatohen problematikat si në vijim:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, programi buxhetor 04520 “Transporti rrugor”

Planifikimi fillestar dhe ndryshimet në planifikim për programin buxhetor 04520 “Transporti rrugor” paraqiten si në vijim:

Tabela: Planifikimi i programit 04520 “Transporti rrugor”

						Mijë lekë
Programi	Ligji i buxhetit	A.N nr. 3, datë 12.03.2022	A.N nr. 12, datë 29.07.2022	A.N nr. 17, datë 01.12.2022	A.N nr.19, datë 29.12.2022	Realizimi
04520	16,171,887	15,571,887	15,571,887	20,571,887	20,571,887	20,552,957
Ndryshime		-600,000		+5,000,000	0	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Programi “Transporti rrugor” është planifikuar me ligjin e buxhetit në shumën 16,171,887 mijë lekë për investimet me financim të brendshëm. Me aktin normativ nr. 3, datë 12.03.2022, vlera e financimit të brendshëm është ulur për shumën 600,000 mijë lekë, ndërsa me aktin normativ nr. 17, datë 01.12.2022 është rritur për shumën 5,000,000 mijë lekë, duke reflektuar një plan përfundimtar në shumën 20,571,887 mijë lekë. Në fund të viti 2022, investimet për këtë program janë realizuar në shumën 20,552,957 mijë lekë, ose janë realizuar në masën 127% në krahasim me planin fillestar dhe 99.9% në krahasim me planin përfundimtar.

Projekti M060625 “Qendra e monitorimit të trafikut (200 km) Faza e Parë” me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022 është ulur për vlerën 600,000 mijë lekë.

Projektet kryesore të prekura me aktin normativ nr.19 datë 29.12.2022 paraqiten si në vijim:

			Lekë
Instituc.	Kodi Output	Emërtimi i produkteve	Buxheti 2022
MIE	20AC101	Ndertim Tuneli i Llogarase	860,368,000
ARRSH	18BS550	Përfundimi i punimeve në segmentet rrugore ura e Kranesë Qafë Botë, Ura e Kranesë Ura e Gajdarit dhe përmirësimi i segmentit rrugor Shijan Ura e Gajdarit.	567,186,691
ARRSH	18BS552	Ndertim rruga Korce - Erseke Loti 2 (pjesa e dyte)	460,848,960
ARRSH	18BS543	Plotesimi i punimeve dhe rrugët lidhese ne Unazen lindore, Loti 2	364,365,443
ARRSH	18BS540	Ndertim I Unazes se jashtme Tirane, Loti 5	318,516,000
ARRSH	18BS612	Ndertim rruga Palas – Dhermi	288,712,380
ARRSH	M064192	Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 3	231,864,523
ARRSH	M064191	Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 2	223,020,109
ARRSH	18BS547	Ndertim rruga Porto Romano Durres, Loti 3, vazhdimi	210,902,968
ARRSH	18BS609	Ndertim rruga mbikalimi Teg dhe rrugët lidhese te tij	200,000,000
ARRSH	M064194	Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 3.	183,146,518
ARRSH	18BS551	Ndërtim rruga Kardhiq - Delvinë Loti 8 (Sistemi dhe Rivalizimi i Skarpatave).	164,322,094
ARRSH	18BS712	Ndërtim rruga Kardhiq - Delvinë Loti 8 (Sinjalistike dhe Siguri rrugore nga Loti 1 deri Lotin 6).	150,266,009
ARRSH	M062991	Vendime gjyqesore ne process	150,000,000
ARRSH	18BS713	Permiresim i sinjalistikes horizontale, vertikale dhe pajisjeve te siguris rrugore ne akset e Rajonit Verior, LOTI 1 (2022)	139,596,230
ARRSH	18BS542	Ndertim I Unazes se jashtme Tirane, Loti 7	122,936,736
ARRSH	18BS530	Ndertim rruga Kardhiq - Delvine Loti 4 Shtese punimesh	115,027,077
ARRSH	M062974	Ndertim i rruges se Unazes se Jashtme Tirane,pjesa verilin (seg Kth SauK- Bregu i lumit Loti 2	109,486,020
ARRSH	18BS616	Rikonstrukcion i aksit rrugor Maliq-Lozhan i Ri Strelce	106,561,120
ARRSH	20AF401	Ndertim rruga lidhese e Aeroportit Nderkombetar te Vlores (VIA) - Autostrada Fier Vlore.	98,725,200
ARRSH	18BS715	Permiresim i sinjalistikes horizontale, vertikale dhe pajisjeve te siguris rrugore ne akset e Rajonit Jugor, LOTI 3 (2022)	97,604,952
ARRSH	18BS714	Permiresim i sinjalistikes horizontale, vertikale dhe pajisjeve te siguris rrugore ne akset e Rajonit Qendror, LOTI 2 (2022)	86,586,063

ARRSH	18BS548	Ndërtim i rruges se Fush - Bardhes, lidhja me rrugen Kardhiq – Delvine	84,839,618
ARRSH	18BS617	Rehabilitim i segmentit rrugor Fier - Vlore (rruga e vjeter).	83,649,868
ARRSH	18BS539	Ndërtim i Unazes se Jashtme Tirane, Loti 4	74,094,466
ARRSH	M064179	Ndërtim rruga Kardhiq - Delvine Loti 7	64,639,447
ARRSH	18BT013	Emergjence mbrojtje lumore per uren e Drojes	57,752,673
ARRSH	18BS529	Ndërtim rruga Korçe - Ersekë Loti 2 (pjesa e pare)	53,426,160
ARRSH	22AC301	Perfundim i Punimeve te mbetura dhe plotesimi me rruge dytesore nyja e Milotit, shtese punimesh	49,910,981
ARRSH	18BS717	Ndërtim rruga Kardhiq - Delvine Loti 8 (Sinjalistike dhe Siguri rrugore nga Loti 1 deri ne Lotin 6), shtese punimesh	40,292,399
ARRSH	M064190	Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1	30,834,134
ARRSH	18BS538	Ndërtim i lidhjes se rruges se Oroshit me rrugen e Kombit	24,136,783
MIE	18BA217	Supervizioni i kontrates koncesionare per ndertimin, operimin, mirembajtjen e rruges se Arbit (shtese kontrate)	20,438,000
ARRSH	M062778	Ndërtim rruga By Pass Perendimor Shkoder, Loti 1	18,598,571
ARRSH	18BS710	Permiresim i sinjalistikes horizontale ne akset dhe segmentet rrugore te Rajonit Qendror	14,978,824
MIE	18BA216	Supervizioni I kontrates koncesionare per ndertimin, operimin, mirembajtjen e rruges Milot - Morine (shtese kontrate)	11,615,600

Me aktin Normativ të dhjetorit janë kryer rishikime në pothuajse të gjitha projektet e investimeve me financim të brendshëm në lidhje me këtë program që konsistojnë në uljen e buxhetit nga projektet në prokurim/kontrata të lidhura rishtazi, në projekte investimi në vazhdim. Kryerja e rishikimeve pas 15 Nëntorit është në kundërshtim me afatin e parashikuar në ligjin e buxhetit për rishpërndarjen e fondeve buxhetore si dhe akomodon efektet e detyrimeve të pa financuara si pasojë e alokimit të buxhetit në projekte infrastrukturore në masën 20 % të çelura me akt normativ në aktet e mëparshme.

Disa prej projekteve të evidentuara me problematika nga auditimi në këtë program buxhetor përfshijnë:

-Projekti 18BS553 “Zgjerimi i segmentit rrugor, Elbasan - Qafë Thanë (Faza I)”

Ky projekt investimi është detajuar për herë të parë në muajin Prill me vlerën 600,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me ulje për vlerën 350,000 mijë lekë, në datën 15 Dhjetor 2021, duke reflektuar vlerë përfundimtare 250,000 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18BS553	Zgjerimi i segmentit rrugor, Elbasan - Qafë Thanë (Faza I)				TOTAL
	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	0	600,000,000	150,000,000	160,000,000	910,000,000

Ky projekt nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit në datë 02.09.2022 me fond limit 2,499,999 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 05.12.2022 me afat përfundimi 18 muaj, me operator ekonomik fitues “A...-B...”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 06.12.2022, brenda afatit ligjor prej 3 ditësh. Kontrata e lidhur në vlerën 2,620,515 mijë lekë me TVSH është 1,710,515 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti të planifikuar në PBA.

Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe në kohën e nënshkrimit të kontratës ky projekt ka pasur në dispozicion 20% të fondeve të nevojshme për lidhjen e kontratës duke qenë angazhim shumë vjeçar. Nga auditimi rezulton se ky alokim fondesh është bërë për qëllim të lidhjes së kontratës duke qenë se 10 ditë më vonë këtij projekti i janë hequr fonde në vlerën 350,000 mijë lekë. Sipas të dhënave nga Drejtoria e Investimeve, në fund të vitit ky projekt rezulton i realizuar për vlerën 250,000 mijë. Nga testimet e pagesave të kryera në SIFQ rezulton se është paguar 1 faturë në vlerën 237,000 mijë lekë, duke mbivlerësuar në këtë mënyrë raportimin e investimeve të realizuara. **Nga përshkrimi i pagesës konstatohet se likuidimi i situacionit të parë, ose 9% e vlerës së kontratës është realizuar 22 ditë pas lidhjes së kontratës.**

-Projekti 18BS552 “Ndërtim rruga Korçë - Ersekë Loti 2 (pjesa e Dytë)”

Ky projekt investimi është çelur në muajin janar me vlerën 576,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me rritje, në datën 15 Dhjetor 2022 në vlerën 460,849 mijë lekë, duke reflektuar vlerë përfundimtare 1,036,849 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18BS552	"Ndërtim rruga Korçë - Ersekë Loti 2 (pjesa e Dytë)"				
	2021	2022	2023	2024	TOTAL
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	0	576,000,000	150,000,000	160,000,000	886,000,000

Projekti nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit në datë 15.03.2022 me fond limit 2,165,326 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 10.06.2022 me afat përfundimi 24 muaj, me operator ekonomik fitues "A...N...K...". Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 15.06.2022, brenda afatit ligjor prej 3 ditësh. Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe në kohën e nënshkrimit të kontratës ky projekt ka pasur në dispozicion 20% të fondeve të nevojshme për lidhjen e kontratës duke qenë angazhim shumë vjeçar. Vlera e angazhuar në total në PBA 2022-2024 rezulton 886,000 mijë lekë. Kontrata e lidhur në vlerën 2,597,631 mijë lekë me TVSH është 1,737,631 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti të planifikuar në PBA. Nga auditimi konstatohet se me fondet e shtuara me rishikim në datën 15.12.2022, janë paguar faturat me datë para datës së rishikimit, konkretisht fatura e datës 09.12.2022 në vlerën 399,175 mijë lekë, fatura e datës 11.10.2022 në vlerën 14,730 mijë lekë dhe fatura e datës 15.07.2022 në vlerën 23,902 mijë lekë, në total paguar 437,807 mijë lekë.

-Projekti 18BS551 "Ndërtim rruga Kardhiq - Delvinë Loti 8 (Sistemimi dhe Rivitalizim i Skarpateve)

Ky projekt investimi është çelur në muajin janar me vlerën 400,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me ulje, në muajin shtator 2022 në vlerën 240,000 mijë lekë dhe rishikuar sërish në datën 15 Dhjetor me rritje në vlerën 164,322 mijë lekë, duke reflektuar vlerë përfundimtare 324,323 mijë lekë. Pojekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18BS551	"Ndërtim rruga Kardhiq - Delvinë Loti 8 (Sistemimi dhe Rivitalizim i Skarpateve)				
	2021	2022	2023	2024	TOTAL
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	0	400,000,000	200,000,000	200,000,000	800,000,000

Ky projekt nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit në datë 16.03.2022 me fond limit 1,440,907 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 31.05.2022 me afat përfundimi 8 muaj, me operator ekonomik fitues "G....2". Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 02.06.2022, brenda afatit prej 3 ditësh. Kontrata e lidhur në vlerën 1,723,615 mijë lekë me TVSH është 923,631 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti të planifikuar në PBA. Gjithashtu konstatohet se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 400,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 1,323,615 mijë lekë. Nga auditimi rezulton se me fondet e shtuara me rishikim në datën 15.12.2022, në datë 20.12.2022 janë paguar 2 fatura në vlerë 156,063 mijë lekë. Rezulton se faturat janë paguar me vonesë, jashtë afatit 30 ditor për ekzekutim.

-Projekti 18BS616 "Rikonstruksion i aksit rrugor Maliq-Lozhan i Ri-Strelcë"

Ky projekt investimi është detajuar për herë të parë në muajin Prill me vlerën 290,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me ulje, në muajin Shtator 2022 në vlerën 140,000 mijë lekë dhe rishikuar sërish në datën 15 Dhjetor me rritje në vlerën 116,561 mijë lekë, duke reflektuar vlerë përfundimtare 256,561 mijë lekë. Pojekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18BS616	"Rikonstruksion i aksit rrugor Maliq-Lozhan i Ri-Strelcë"				
	2021	2022	2023	2024	TOTAL
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	0	290,000,000	150,000,000	160,000,000	600,000,000

Ky projekt nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit në datë 12.04.2022 me fond limit 1,183,261 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën

05.07.2022 me afat përfundimi 24 muaj, me vlerë 1,397,258 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “Gj...”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 06.07.2022, brenda afatit prej 3 ditësh. Kontrata e lidhur në vlerën 1,397,258 mijë lekë me TVSH është 797,258 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti të planifikuar në PBA.

Nga auditimi konstatohet se me fondet e shtuara me rishikim në datën 15.12.2022, në datë 22.12.2022 dhe 27.12.2022 janë paguar 4 fatura në vlerë 201,292 mijë lekë.

- Projekti 18BS617 “Rehabilitimi i segmentit rrugor Fier-Vlorë (rruga e vjetër)”

Ky projekt investimi është detajuar për herë të parë në muajin Prill me vlerën 200,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me ulje në muajin Shtator 2022 në vlerën 130,000 mijë lekë, në muajin Nëntor me ulje për vlerën 3,750 mijë lekë dhe rishikuar sërish në datën 15 Dhjetor me rritje për vlerën 82,650 mijë lekë, duke reflektuar vlerë përfundimtare 149,000 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18BS617	“Rehabilitimi i segmentit rrugor Fier-Vlorë (rruga e vjetër)”				TOTAL
	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	0	200,000,000	150,000,000	160,000,000	510,000,000

Ky projekt nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 12.05.2022, me fond limit 833,288 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 29.07.2022, me afat përfundimi 14 muaj, me vlerë 950,467 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “C...”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 03.08.2022, jashtë afatit ligjor në kundërshtim me pikën 157 të Udhëzimit nr. 8, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. Konstatohet se vlera totale e kontratës së lidhur është 440,467 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti i planifikuar në PBA. Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe në kohën e nënshkrimit të kontratës ky projekt ka patur në dispozicion 20% të fondeve të nevojshme për lidhjen e kontratës duke qenë angazhim shumë vjeçar.

- Projekti 18BS713 “Përmirësimi i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Verior Loti 1”

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 46,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me rritje në muajin Shtator 2022, në vlerën 30,000 mijë lekë dhe rishikuar sërish në datën 15 Dhjetor me rritje për vlerën 139,596 mijë lekë, duke reflektuar vlerë përfundimtare 215,956 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18BS713	“Përmirësimi i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Verior Loti 1				TOTAL
	Buxheti 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024	
Kosto totale (në lekë)	0	46,000,000	50,000,000	80,000,000	176,000,000

Ky projekt nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 20.04.2022, me fond limit 191,633 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 31.05.2022, me afat përfundimi 26 javë, me vlerë 217,200 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “J...” SHPK. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 02.06.2022, brenda afatit 3 ditor. Konstatohet se vlera totale e kontratës së lidhur është 41,200 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti i planifikuar në PBA.

Gjithashtu konstatohet se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 46,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 171,200 mijë lekë.

- Projekti 18BS715 “Përmirësimi i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Jugor Loti 3”

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 40,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me rritje në muajin Shtator 2022, në vlerën 1,290 mijë lekë dhe rishikuar

sërisht në datën 15 Dhjetor me rritje për vlerën 97,606 mijë lekë, duke reflektuar vlerë përfundimtare 138,895 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18BS715	<i>“Përmirësimi i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Jugor Loti 3</i>				
	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	TOTAL
Kosto totale (në lekë)	0	40,000,000	50,000,000	80,000,000	170,000,000

Ky projekt nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 01.04.2022, me fond limit 165,940 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë 01.07.2022, me afat përfundimi 8 muaj, me vlerë 196,582 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “I...D...K..K...”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 05.07.2022, jashtë afatit ligjor. Konstatohet se vlera totale e kontratës së lidhur është 26,000 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti i planifikuar në PBA. Gjithashtu konstatohet se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 40,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 156,582 mijë lekë.

- Projekti 18BS714 “Përmirësimi i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Qendror Loti 2”

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 40,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me rritje në muajin Shtator 2022 për vlerën 10,000 mijë lekë dhe rishikuar sërisht në datën 15 Dhjetor me rritje për vlerën 86,586 mijë lekë, duke reflektuar vlerë përfundimtare 136,586 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18BS714	<i>Përmirësimi i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Qendror Loti 2</i>				
	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	TOTAL
Kosto totale (në lekë)	0	40,000,000	50,000,000	80,000,000	170,000,000

Ky projekt nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 01.04.2022, me fond limit 165,805 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë 17.05.2022, me afat përfundimi 8 muaj, me vlerë 193,720 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “R...S... & M...”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 19.02.2022, jashtë afatit ligjor. Konstatohet se vlera totale e kontratës së lidhur është 23,720 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti i planifikuar në PBA.

Gjithashtu konstatohet se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 40,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 153,720 mijë lekë.

-Projekti 18BT017 “Sistemimi dhe rivitalizimi i skarpateve në Plani i Bardhë”

Ky projekt investimi është detajuar për herë të parë në muajin Shtator me vlerën 281,000 mijë lekë dhe në datën 15 Dhjetor i janë hequr fondet, duke kaluar me vlerë përfundimtare 0 mijë lekë. Projekti nuk ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 si dhe nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit në datë 22.09.2022 me fond limit 1,170,234 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 25.11.2022, me afat përfundimi 18 muaj, me vlerë 1,375,800 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “S...”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 01.12.2022, jashtë afatit ligjor. Vlera totale e kontratës së lidhur prej 1,375,800 mijë lekë rezulton e gjithë e paplanifikuar në PBA.

Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe në kohën e nënshkrimit të kontratës ky projekt ka pasur në dispozicion 20% të fondeve të nevojshme për lidhjen e kontratës duke qenë angazhim shumë vjeçar. Nga auditimi rezulton se ky alokim fondesh është bërë për

qëllim të lidhjes së kontratës duke qenë se 20 ditë më vonë këtij projekti i janë hequr të gjitha fondet e çelura.

-Projekti 18BT016 “Sistemimi dhe rivitalizimi i skarpatave në Shkallën e Tujanit”

Ky projekt investimi është detajuar për herë të parë në muajin Shtator me vlerën 270,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me ulje, në datën 15 Dhjetor me vlerën 270,000 mijë, duke reflektuar vlerë përfundimtare 0 mijë lekë.

Projekti nuk ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 dhe as pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit në datë 22.09.2022 me fond limit 1,124,816 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 25.11.2022 me afat përfundimi 18 muaj, me vlerë 1,335,373 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “A. G.”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 01.12.2022, jashtë afatit ligjor. Vlera totale e kontratës së lidhur prej 1,335,373 mijë lekë rezulton e gjithë e paplanifikuar në PBA.

Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe në kohën e nënshkrimit të kontratës ky projekt ka patur në dispozicion 20% të fondeve të nevojshme për lidhjen e kontratës duke qenë angazhim shumë vjeçar. Nga auditimi rezulton se ky alokim fondesh është bërë për qëllim të lidhjes së kontratës duke qenë se 20 ditë më vonë këtij projekti i janë hequr të gjitha fondet e çelura.

-Projekti 21AC803 “Ndërtim i Godinës së Qendrës së monitorimit të trafikut”

Ky projekt investimi është detajuar për herë të parë në muajin Shtator me vlerën 50,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me ulje, në datën 15 Dhjetor me vlerën 49,000 mijë lekë, duke reflektuar vlerë përfundimtare 100 mijë lekë.

Projekti nuk ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 dhe as pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit në datë 26.10.2022 me fond limit 205,544 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 13.12.2022 me afat përfundimi 12 muaj, me vlerë 206,640 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “LI.”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 19.12.2022, jashtë afatit ligjor. Vlera totale e kontratës së lidhur prej 206,640 mijë lekë rezulton e gjithë e paplanifikuar në PBA. Gjithashtu konstatohet se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 50,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 156,640 mijë lekë. Rezulton se 2 ditë pas lidhjes së kontratës këtij projekti i janë ulur fondet e planifikuara për vlerën 49,900 mijë lekë.

-Projekti 19AH102 “Rindërtim Ura e Tapizës, (shesë punimesh)”

Ky projekt investimi është detajuar për herë të parë në muajin Qershor 2022 me vlerën 6,100 mijë lekë, vlerë e cila nuk ka pasur ndryshime për periudhën në vijim deri në fund të vitit.

Projekti nuk ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 dhe as pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit në datë 06.10.2022 me fond limit 25,392 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datën 10.11.2022 me afat përfundimi 12 muaj, me vlerë 30,471 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “G.P.G.C.”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 14.11.2022, jashtë afatit ligjor. Vlera totale e kontratës së lidhur prej 30,471 mijë lekë rezulton e gjithë e paplanifikuar në PBA. Konstatohet se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 6,100 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 24,371 mijë lekë.

- Nga auditimi i bazës së të dhënave të APP-së dhe pagesave të realizuara rezulton se ARRSH ka klasifikuar si shpenzim operativ në llogarinë 602 dhe jo si projekt investimi, 2 procedura prokurimi si në vijim:

- Prokurimi me objekt “Rehabilitimi i rrëshqitjes së segmentit rrugor Qafë Mali- Fierzë”. Kjo procedurë prokurimi ka filluar më datë 24.05.2022, me fond 99,168 mijë lekë, me afat 7 muaj, me operator ekonomik fitues “P. G.– S. SHPK”, me vlerë fituese 171,212 mijë lekë me TVSH.
- Prokurimi me objekt “Rehabilitimi i rrugës së ish repartit ushtarak në aeroportin e Rinasit”. Kjo procedurë prokurimi ka filluar më datë 30.05.2022, me fond 33,324 mijë lekë, me afat 3 muaj, me operator ekonomik fitues “B.” SHPK, me vlerë fituese 39,448 mijë lekë me TVSH.

Ministria e Kulturës, programi 08230 buxhetor “Arti dhe Kultura”

- Projekti 18AE715 “Ndërtimi i qendrës kombëtare kulturore për fëmijë dhe Teatri i Kukullave”.

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 250,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me rritje në muajin Prill për vlerën 49,730 mijë lekë, rishikuar me rritje në muajin Gusht për vlerën 50,000 mijë lekë dhe rishikuar me ulje në muajin Nëntor për vlerën 221,705 mijë lekë vlerën 86,586 mijë lekë, ndërsa me rishikimin e muajit Dhjetor është rishikuar përsëri me ulje për vlerën 28,567 mijë lekë duke reflektuar vlerë përfundimtare 0 lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18AE715	Ndërtimi i qendrës kombëtare kulturore për fëmijë dhe Teatri i Kukullave				TOTAL
	Buxheti 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024	
Kosto totale (në lekë)	0	250,000,000	250,000,000	250,000,000	752,000,000

Ky projekt ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022, në vlerën totale në shumën e planifikuar prej 1,000,000 mijë lekë, nga të cilat 250,000 mijë lekë janë parashikuar për vitin 2022, 2023, 2024 dhe 250,000 mijë lekë janë parashikuar pas viti 2024. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 15.08.2022, me fond limit 1,035,362 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë 11.10.2022, me afat përfundimi 24 muaj, me vlerë 1,205,339 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “2. T.”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 11.11.2022, jashtë afatit ligjor. Rezulton se vlera totale e kontratës së lidhur është 453,339 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti i planifikuar në PBA. Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe në kohën e nënshkrimit të kontratës ky projekt ka patur në dispozicion 20% të fondeve të nevojshme për lidhjen e kontratës duke qenë angazhim shumë vjeçar. Rezulton se alokimi i fondeve është bërë vetëm për efekt të lidhjes së kontratës, duke qenë se rreth 1 muaj më vonë këto fonde janë shkurtuar.

Ministria e Mbrojtjes, programi buxhetor 09430 “Arsimi Ushtarak”

- Në Projektin me Kod 19AC403, sipas Drejtorisë së Investimit me përshkrim “Ndërtimi i godinës së re të AFA (prona 21) është regjistruar kontratë e re për projekt investimi me përshkrim “Ndërtimi i godinave shumëfunktionale për Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë (fakulteti dhe menca)”.

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 419,242 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me ulje në muajin Maj për vlerën 126,455 mijë lekë, rishikuar me ulje në muajin Dhjetor për gjithë vlerën duke reflektuar vlerë përfundimtare 0 lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

19AC403	Ndërtimi i godinës së re të AFA, (Prona.21)				TOTAL
	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	1,000,000	419,242,000	150,000,000	400,000,000	969,242,000

Ky projekt ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 02.09.2022, me fond limit 617,946 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë 30.12.2022, me afat përfundimi 8 muaj, me vlerë 600,568 mijë lekë me TVSH, me operator

ekonomik fitues “P. G.”. Rezulton se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 31.03.2023, jashtë afatit ligjor, por në bazën e të dhënave për regjistrimin e kontratave rezulton se kontrata e mësipërme është regjistruar si kontratë e datës 31.03.2023.

Konstatohet se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt nuk ka pasur fonde të planifikuara për shkak të rishikimeve, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 600,568 mijë lekë.

Programi buxhetor 06730 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”

-Projekti 19AG307 “Ndërtimi i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të qytetit të Laçit, baza 4”.

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Shtator në vlerën 108,086 mijë lekë, vlerë e cila nuk është rishikuar më gjatë vitit. Projekti nuk ka qenë pjesë e PBA-së dhe as pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 21.10.2022, me fond limit 450,359 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë 07.12.2022, me afat përfundimi 24 muaj, me vlerë 531,995 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “G. P.G.C. SHPK & Ll. SHPK”. Regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë më datën 07.12.2022, brenda afatit ligjor. Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe në kohën e nënshkrimit të kontratës ky projekt ka patur në dispozicion 20% të fondeve të nevojshme për lidhjen e kontratës duke qenë angazhim shumë vjeçar. Nga auditimi konstatohet se më datën 28.12.2022 është paguar fatura me vlerë 102,600 mijë lekë, me datë furnitori 23.12.2022, pra 16 ditë pas lidhjes së kontratës, kjo kontratë rezulton e realizuar në vlerën 19.3%.

- Projekti 19AF224 “Sistemi i kanaleve të ujërave të zeza KUZ dhe Ujërave të bardha KUB, në rrugët “Riza Beqçela” dhe “Murat Basha”, Bashkia Klos”.

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Korrik në vlerën 5,047 mijë lekë, vlerë e cila nuk është rishikuar më gjatë vitit.

Projekti nuk ka qenë pjesë e PBA-së dhe as pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 15.09.2022, me fond limit 21,027 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë 22.11.2022, me afat përfundimi 6 muaj, me vlerë 22,433 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “U. SHPK & K. SHPK”. Regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë më datën 09.12.2022, jashtë afatit ligjor. Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe në kohën e nënshkrimit të kontratës ky projekt ka pasur në dispozicion 5,047 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 17,386 mijë lekë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, programi buxhetor 04230 “Mbështetje për Peshkimin”.

-Projekti 18AJ603 “Shtim kapaciteti ankorues porti peshkimit Durrës (bankinë) loti 1”.

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 48,362 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me rritje në muajin Nëntor për vlerën 8,864 mijë lekë, rishikuar me rritje në muajin Dhjetor për vlerën 11,270 mijë lekë duke reflektuar vlerë përfundimtare 68,496 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18AJ603	Shtim kapaciteti ankorues porti peshkimit Durrës (bankinë) loti 1				TOTAL
	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	0	48,362,545	37,638,455	0	86,000,000

Ky projekt nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 14.07.2022, me fond limit 165,851 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë 13.09.2022, me afat përfundimi 6 muaj, me vlerë 167,410 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “E.”. Rezulton se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën

22.09.2022, jashtë afatit ligjor. Konstatohet se vlera totale e kontratës së lidhur është 81,430 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti i planifikuar në PBA. Konstatohet se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 48,362 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 119,048 mijë lekë.

-Në AZHBR, nga auditimi mbi investimet e realizuara në programin 4250 “Zhvillimi rural” konstatohet se janë raportuar investime kapitale me kod projekt 18AL301 “Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 1” në shumën 591,615 mijë lekë. Ky projekt investimi është raportuar nga kapitulli 3 “kosto lokale”. Në bazën e të dhënave të pagesave të realizuara në SIFQ konstatohet se njësi shpenzuese është AZHBR me përfitues Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me përshkrimin Fondi Kombëtar IPARD II, kosto lokale dhe sipas pagesës së listave përkatëse. Këto pagesa kryhen në kuadër të bashkëfinancimit të fondeve të BE për mbështetjen e fermerëve/agroturizimit në kryerjen e investimeve nga ana e investitorëve. Pjesa e buxhetit të shtetit në kuadër të bashkëfinancimit është në masën 25%, ndërkohë që konstatohet se për nga natyra, nuk kemi të bëjmë me investim kapital, por me grant të dhënë të tretëve. Në këtë mënyrë, treguesit e investimeve publike janë të mbivlerësuar si pasojë e raportimit të realizimit të këtij projekti, pasi nuk kemi të bëjmë me kryerjen e investimeve publike ku pronar është shteti, por dhënien e grantit drejt përfituesve të ndryshëm për kryerjen e investimeve nga ana e tyre.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, programi buxhetor 07330 “Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”.

-Projekti 18BB008 “Rikonstruksion i godinës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut”.

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 54,046 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me ulje në muajin Nëntor për vlerën 15,987 mijë lekë, rishikuar me rritje në muajin Nëntor për vlerën 50,000 mijë lekë duke reflektuar vlerë përfundimtare 88,059 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18BB08	Rikonstruksion i godinës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut				TOTAL
	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	0	54,046,000	136,721,000	0	190,767,000

Ky projekt ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se kanë filluar procedurat e prokurimit më datë 01.03.2022, me fond limit 158,972 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë 13.05.2022, me afat përfundimi 17 muaj, me vlerë 137,475 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “A.C.”. Rezulton se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 17.05.2022, jashtë afatit ligjor. Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe në kohën e nënshkrimit të kontratës ky projekt ka pasur në dispozicion 20% të fondeve të nevojshme për lidhjen e kontratës duke qenë angazhim shumë vjeçar.

Projekti 20AB705 – “Rikonstruksione të godinave të njëjësive të kujdesit shëndetësor në rrethe”.

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 42,000 mijë lekë, vlerë e cila nuk ka pasur ndryshime përgjatë vitit. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024, detajuar si më poshtë:

20AB705	Rikonstruksione të godinave të njëjësive të kujdesit shëndetësor në rrethe				TOTAL
	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	0	42,000,000	42,073,000	35,123,000	119,073,000

Ky projekt ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se procedura e parë e prokurimit ka nisur më datë 04.04.2022, me fond limit 65,695 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë

28.06.2022, me afat përfundimi 8.5 muaj, me vlerë 67,002 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “C. R. 2008”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 30.09.2022, jashtë afatit ligjor.

Procedura e dytë e prokurimit ka nisur në 04.04.2022 me fond limit 38,224 mijë lekë pa TVSH. Kontrata rezulton të jetë lidhur në datën 14.07.2022 me vlerë 38,318 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues bashkim operatorësh 2.Z. K. SHPK & I.C.C.G. SHPK & V. C. G. Shpk, afat kohëzgjatje 4.6 muaj. Nga auditimi konstatohet se kontrata është regjistruar në SIFQ në datën 22.09.2022, jashtë afatit ligjor.

Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe lidhjeve të kontratave rezulton se për të 2 procedurat ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 42,000 mijë lekë, duke sjell marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 63,320 mijë lekë.

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë, programi buxhetor 09240 “Arsimi profesional”
Projekti 18AY635 “Rikonstruksioni i shkollës së mesme profesionale “Nazmi Rushiti”,
Peshkopi”.**

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 50,987 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me ulje në muajin Prill për vlerën 25,000 mijë lekë, në qershor me rritje për vlerën 2,710 mijë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 28,697 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18AY635	Rikonstruksioni i shkollës së mesme profesionale Nazmi Rushiti, Peshkopi				TOTAL
	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	0	50,987,000	65,017,000	2,500,000	118,504,000

Projekti ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se procedura e prokurimit ka nisur më datë 29.06.2022, me fond limit 121,863 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë 20.09.2022, me afat përfundimi 26 javë, me vlerë 145,034 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “S.”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 20.10.2022, jashtë afatit ligjor. Rezulton se vlera totale e kontratës së lidhur është 26,530 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti i planifikuar në PBA. Edhe pse kontrata është nënshkruar me afat zbatimi 26 javë, fondet janë parashikuara të shtrira për 3 vite buxhetore. Gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 28,697 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 116,337 mijë lekë.

**Projekti 18AY637 “Rikonstruksioni/shtim ambientesh në shkollën “Herman Gmainer”,
Tiranë”.**

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 35,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me ulje në muajin Prill për vlerën 20,000 mijë lekë dhe në Qershor me rritje për vlerën 404 mijë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 15,404 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024 e detajuar si më poshtë:

18AY637	Rikonstruksioni/shtim ambientesh në shkollën “Herman Gmainer”, Tiranë				TOTAL
	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	0	35,000,000	0	0	35,000,000

Projekti ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se procedura e prokurimit ka nisur më datë 20.06.2022, me fond limit 28,004 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë 22.08.2022, me afat përfundimi 6 muaj, me vlerë 31,961 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “M. K. & R. E.”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 19.10.2022, jashtë afatit ligjor. Rezulton se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 15,000 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 16,961 mijë lekë.

Projekti 18AY636 “Ndërtimi/rikonstruksioni i shkollës “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë”

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 45,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me ulje në muajin Prill për vlerën 20,000 mijë lekë dhe në Tetor me rritje për vlerën 503 mijë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 20,503 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024, detajuar si më poshtë:

18AY636	Ndërtimi/rikonstruksioni i shkollës “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë				TOTAL
	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	0	45,000,000	0	0	45,000,000

Gjithashtu projekt ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se procedura e prokurimit ka nisur më datë 28.09.2022, me fond limit 36,274 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë 23.11.2022, me afat përfundimi 6 muaj, me vlerë 38,735 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “A. C.”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 23.11.2022, brenda afatit ligjor. Rezulton se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 20,503 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 18,232 mijë lekë.

Projekti 18AY638 “Ndërtimi/rikonstruksioni i reparteve të praktikave profesionale shkolla “Beqir Çela”, Durrës”

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Qershor në vlerën 30,205 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me rritje në muajin Tetor për vlerën 1,387 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 31,592 mijë lekë. Projekti ka qenë pjesë e PBA, faza e III 2022-2024, detajuar si më poshtë:

18AY638	Ndërtimi/rikonstruksioni i reparteve të praktikave profesionale shkolla “Beqir Çela”, Durrës				TOTAL
	2021 Buxheti	2022 Parashikimi	2023 Parashikimi	2024 Parashikimi	
Kosto totale (në lekë)	0	50,204,903	78,000,000	25,000,000	153,204,903

Gjithashtu ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2022. Nga auditimi konstatohet se procedura e prokurimit ka nisur më datë 30.06.2022, me fond limit 126,163 mijë lekë pa TVSH. Kontrata është lidhur në datë 21.09.2022, me afat përfundimi 26 javë, me vlerë 128,171 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “E. SHPK”. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 19.11.2022, jashtë afatit ligjor. Rezulton se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 30,205 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 97,966 mijë lekë. Pavarësisht kohëzgjatjes së kontratës për 26 javë, parashikimi buxhetor është shtrirë për 3 vite.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Projekti 20AD425 “Përmirësimi i sistemit të QKB-së”

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Gusht në vlerën 100,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me ulje në muajin Dhjetor për vlerën 81,500 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 18,500 mijë lekë. Nga auditimi konstatohet se procedura e prokurimit ka nisur më datë 01.09.2022, me fond limit 209,188 mijë lekë pa TVSH. Kontrata, me operator ekonomik fitues “H.”, është lidhur në datë 14.11.2022, në vlerën totale kontrate 233,454 mijë lekë me TVSH, nga të cilat 219,410 mijë lekë është vlerë e implementimit të sistemit me afat 9 muaj dhe diferenca prej 14,044 mijë lekë i përket vlerës së mirëmbajtjes me afat 24 muaj. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 13.01.2023, jashtë afatit ligjor. Rezulton se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 100,000 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 119,410 mijë lekë, llogaritur për vlerën e implementimit të sistemit.

Projekti 20AD421 “Përmirësimi i sistemit të RUDA – për MBZHR”

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 50,000 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me rritje në muajin Dhjetor për vlerën 153,000 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 203,000 mijë lekë. Nga auditimi konstatohet se procedura e prokurimit ka nisur më datë 01.08.2022, me fond limit 190,000 mijë lekë pa TVSH. Kontrata, me operator ekonomik fitues “A. T. D.”, është lidhur në datë 20.10.2022, në vlerën totale kontrate 224,328 mijë lekë me TVSH, nga të cilat 202,728 mijë lekë është vlerë e implementimit të sistemit me afat 12 muaj dhe diferenca prej 21,600 mijë lekë i përket vlerës së mirëmbajtjes me afat 24 muaj. Regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 27.10.2022, jashtë afatit ligjor. Rezulton se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 50,000 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 152,728 mijë lekë, llogaritur për vlerën e implementimit të sistemit.

Projekti 18AK609 “Sistemet e aplikimit online për skemat IPARD dhe sistemet e tjera”

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 96,404 mijë lekë, vlerë e cila është rishikuar me rritje në muajin Prill për vlerën 94,000 mijë lekë, ulur në muajin Gusht për vlerën 27,103 mijë lekë, ulur në muajin Nëntor për vlerën 10,000 mijë lekë, duke reflektuar vlerën përfundimtare 123,301 mijë lekë. Nga auditimi konstatohet se procedura e prokurimit ka nisur më datë 08.03.2022, me fond limit 266,700 mijë lekë pa TVSH. Kontrata, me operator ekonomik fitues “A.B. S.”, është lidhur në datë 16.05.2022, në vlerën totale kontrate 296,400 mijë lekë me TVSH, nga të cilat 203,963 mijë lekë është vlerë e implementimit të sistemit me afat 9 muaj dhe diferenca prej 92,437 mijë lekë i përket vlerës së mirëmbajtjes me afat 24 muaj. Regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 05.07.2022, jashtë afatit ligjor. Rezulton se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 190,404 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 13,559 mijë lekë, llogaritur për vlerën e implementimit të sistemit.

Projekti 18AZ313 “Ngritja e sistemit të informacionit për gjeografinë dhe infrastrukturës ushtarake në shërbim të IGJIUT”

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Gusht në vlerën 69,500 mijë lekë dhe nuk ka pësuar ndryshime përgjatë vitit. Nga auditimi konstatohet se procedura e prokurimit ka nisur më datë 10.10.2022, me fond limit 206,122 mijë lekë pa TVSH. Kontrata me operatorin ekonomik fitues “C.C.S.”, është lidhur në datë 13.12.2022, në vlerën totale kontrate 227,917 mijë lekë me TVSH, nga të cilat 219,410 mijë lekë është vlerë e implementimit të sistemit me afat 9 muaj dhe diferenca prej 8,507 mijë lekë i përket vlerës së mirëmbajtjes me afat 24 muaj.

Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 20.12.2022, jashtë afatit ligjor. Rezulton se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 69,500 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 149,910 mijë lekë, llogaritur për vlerën e implementimit të sistemit.

Projekti 18AV812 “Hapësira hardw­are për kapacitetin e serverëve”

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 80,000 mijë lekë, duke u rishikuar në muajin Qershor me rritje për vlerën 10,999 mijë lekë, me rritje në muajin Shtator për vlerën 124,992 mijë lekë, me rritje në muajin Dhjetor për vlerën 209,000 mijë, duke reflektuar në vlerë përfundimtare 424,991 mijë lekë. Nga auditimi konstatohet se procedura e prokurimit ka nisur më datë 28.07.2022, me fond limit 377,891 mijë lekë pa TVSH. Kontrata, me operator ekonomik fitues “H.”, është lidhur në datë 20.10.2022, në vlerën totale kontrate 425,353 mijë lekë me TVSH, nga të cilat 404,048 mijë lekë është vlerë e implementimit të

sistemit me afat 9 muaj dhe diferenca prej 21,305 mijë lekë i përket vlerës së mirëmbajtjes me afat 24 muaj.

Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 09.11.2022, jashtë afatit ligjor. Rezulton se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 215,991 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 188,057 mijë lekë, llogaritur për vlerën e implementimit të sistemit.

Projekti 20AD413 “Ngritja e hartës dixhitale të monitorimit me kamera në ambiente publike”

Ky projekt investimi është detajuar në muajin Janar në vlerën 120,000 mijë lekë, duke u rishikuar në muajin Gusht me ulje për vlerën 70,000 mijë lekë, me rritje në muajin Dhjetor për vlerën 46,232 mijë lekë, duke reflektuar në vlerë përfundimtare 96,232 mijë lekë.

Nga auditimi konstatohet se procedura e prokurimit ka nisur më datë 11.08.2022, me fond limit 99,966 mijë lekë pa TVSH. Kontrata, me operator ekonomik fitues “F.”, është lidhur në datë 02.12.2022, në vlerën totale kontrate 116,799 mijë lekë me TVSH. Konstatohet se regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 28.12.2022, jashtë afatit ligjor. Rezulton se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 96,232 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 20,567 mijë lekë.

- Nga auditimi u konstatua se për 67 projekte në vazhdim nga vitet e mëparshme nuk janë çelur fonde në fillim të vitit, por fondet janë çelur kryesisht gjatë muajit Mars dhe Korrik, në kundërshtim me pikën 63 të Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar ku citohet se: *“Plani i investimeve i detajuar nga njësitë e qeverisjes qendrore në nivel projekti, mban parasysh këtë radhë prioritare: i: Projektet e investimeve në proces nga viti i kaluar...”* dhe në kundërshtim me pikën 25/b të Udhëzimit plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit 2022 ku citohet se: *“Njësitë e qeverisjes qendrore, në detajimin e planeve të miratuara të investimeve, do të mbajnë parasysh këto kritere dhe përparësi në financimin e projekteve: b. Projektet në vazhdim nga vitit 2020 ose më parë, do të financohen më përparësi dhe duhet të jenë pjesë e prioritetëve të propozuara për financim gjatë vitit 2022.* Për më tepër detajuar në ankes.

Nga auditimi konstatohet se programet buxhetore më të prekura nga aktet normative (shtim/pakësim fondesh) krahasuar me ligjin e buxhetit, në ankes. Këto ndryshime fondesh përgjatë vitit, me akte normative, në programe të ndryshme buxhetore janë tregues i një planifikimi jo të kujdesshëm nga ana e institucioneve të sipërpërmendura dhe gjithashtu tregues të një monitorimi jo efektiv nga ana e MFE-së.

Konstatohet se çelja e shumicës së projekteve infrastrukturë rrugore, si më sipër, është bërë vetëm për vlerën e 20% të projektit në vitin aktual, me qëllim lidhjen e kontratave edhe pse nisur nga koha e zhvillimit të procedurës në fund të vitit, angazhime të marra pas 15 Tetorit, ka qenë evidente pamundësia e zhvillimit dhe ecurisë së projektit, për disa projekte fondet janë alokuar edhe në formën e paradhënies.

Projekti 22AD001 “Ngritja e infrastrukturës mbështetëse në funksion të kompleksit për zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të motorizimit auto-moto park në Bashkinë Elbasan”

Projekti me kod 22AD001 është detajuar për herë të parë në muajin Gusht për vlerën 318,222 mijë, ndërkohë që në muajin Nëntor janë shtuar fonde në vlerën 181,778 mijë, duke arritur në total vlerën 500,000 mijë lekë. Konstatohet se për këtë kod projekti janë iniciuar 2 procedura prokurimi me lote.

Procedura e parë e prokurimit ka nisur në 15.08.2022 me fond limit 547,563 mijë lekë pa TVSH. Kontrata rezulton të jetë lidhur në datën 03.10.2022 me vlerë 429,478 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues bashkim operatorësh “S.M.O. U. SHPK/B. SHPK/S.M.O. V. SHPK” dhe afat kohëzgjatje 12 muaj. Konstatohet se kontrata është regjistruar në SIFQ në datën 05.12.2022, pra jashtë afatit ligjor prej 3 ditësh.

Procedura e dytë e prokurimit ka nisur në 15.08.2022 me fond limit 759,108 mijë lekë pa TVSH. Kontrata rezulton të jetë lidhur në datën 12.10.2022 me vlerë 630,889 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “A.-B.” dhe afat kohëzgjatje 12 muaj. konstatohet se kontrata është regjistruar në SIFQ në datën 07.11.2022, pra jashtë afatit ligjor prej 3 ditësh.

Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe lidhjeve të kontratave rezulton se për të 2 procedurat ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 318,222 mijë lekë, duke sjell marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 742,145 mijë lekë.

Projekti 22AB901 “Ndërhyrje për ndërtimin e infrastrukturës së transportit, parkimeve, stacioneve mulitmodale, moleve etj” Kontrata ndërtimi i godinës së parkimit pranë stacionit të trenit Durrës dhe punimeve plotësuese në parkimin publik nëntokësor të qendrës multifunkionale Vlorë.

Projekti me kod 22AB901 është detajuar për herë të parë në muajin Maj për vlerën 138,700 mijë, ndërkohë që në muajin Nëntor janë ulur fondet për vlerën 74,700 mijë, në muajin Dhjetor janë rritur fondet për vlerën 4,850 mijë duke arritur në total vlerën 69,850 mijë lekë.

Nga auditimi konstatohet se procedura e prokurimit ka nisur më datë 12.10.2022, me fond limit 582,083 mijë lekë pa TVSH. Kontrata, me operator ekonomik fitues “P.”, është lidhur në datë 13.12.2022, me vlerë totale kontrate 573,770 mijë lekë me TVSH, me afat 12 muaj. Regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë në datën 19.12.2022, jashtë afatit ligjor.

Rezultoni se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 69,850 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 502,920 mijë lekë. Konstatohet se ky projekt, në fund të vitit rezulton i realizuar për vlerën 57,277 mijë lekë, rezultat i paradhënies së fondeve për realizimin e kontratës (*trajtuar në çështjen “Paradhënie të kontratave”*).

Projekti 22AA101 “Transformimi urban në hapësira publike kryesore”

Projekti me kod 22AA101 është detajuar për herë të parë në muajin Maj për vlerën 200,000 mijë, në muajin Nëntor i janë shtuar fonde për vlerën 150,000 mijë, në Dhjetor i janë shtuar fonde për vlerën 27 mijë lekë, duke arritur në total vlerën 350,027 mijë lekë. Konstatohet se për këtë kod projekti janë iniciuar 3 procedura të ndryshme prokurimi.

Procedura e parë e prokurimit me objekt “Transformimi urban në hapësira publike kryesore (rajoni 3 dhe 4) – Shëtitortja Tushemisht dhe përmirësimi i segmentit rrugor Tushemisht – Dogana – Shën Naum”, ka nisur në 01.07.2022 me fond limit 416,667 mijë lekë pa TVSH. Kontrata rezulton të jetë lidhur në datën 23.09.2022 me vlerë 499,164 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “4.A.M.”, afat kohëzgjatje 12 muaj. Konstatohet se kontrata është regjistruar në SIFQ në datën 05.12.2022, jashtë afatit ligjor.

Procedura e dytë e prokurimit me objekt “Transformimi urban në hapësirën publike (rajoni 1 dhe 2) ndërtimi i shëtitores së plazhit nga ura e Dajlanit deri në godinën e Kavalishencës”, ka nisur në 29.06.2022 me fond limit 416,606 mijë lekë pa TVSH. Kontrata rezulton të jetë lidhur në datën 08.10.2022 me vlerë 341,954 mijë lekë me TVSH, me fitues bashkim operatorësh ekonomik “C. SHPK & Xh.”, dhe afat kohëzgjatje 9 muaj. Kontrata është regjistruar në SIFQ në datën 22.11.2022, jashtë afatit ligjor.

Procedura e tretë e prokurimit me objekt “Transformimi urban në hapësira publike kryesore (rajoni 1 dhe 2) ndërhyrje transformimi urban në hapësira publike Sheshi Demokracia rruga lidhëse Sheshi Ahmet Zogu dhe Blloku Drita”, ka nisur në 11.08.2022 me fond limit 131,644 mijë lekë pa TVSH. Kontrata rezulton të jetë lidhur në datën 07.10.2022 me vlerë 127,932

mijë lekë me TVSH, me fitues operator ekonomik “A.” dhe afat kohëzgjatje 12 muaj. Kontrata është regjistruar në SIFQ në datën 05.12.2022, jashtë afatit ligjor.

Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe lidhjeve të kontratave rezulton se për të 3 procedurat ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 200,000 mijë lekë, duke sjell marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 769,050 mijë lekë.

Projekti 22AA501 “Ndërhyrje për mbrojtje mjedisore, lumore, erozion, rrëshqitje”

Projekti me kod 22AA501 është detajuar për herë të parë në muajin Maj për vlerën 80,000 mijë, në muajin Nëntor rishikuar me rritje për vlerën 120,000 mijë lekë, duke reflektuar planin përfundimtar në vlerën 200,000 mijë. Konstatohet se për këtë kod projekti janë zhvilluar 2 procedura të ndryshme prokurimi.

Procedura e parë e prokurimit me objekt “Ndërhyrje për mbrojtje mjedisore, lumore, erozion, rrëshqitje: “Rehabilitimi i sistemit të mbrojtjes dhe largimit të ujërave të larta dhe të shiut, trotuaret dhe ndriçimi i rrugës “Dukas - Kuqar - Manekaj – Rusinje”, Patos, F.I”, ka nisur në 18.08.2022 me fond limit 105,095 mijë lekë pa TVSH. Kontrata rezulton të jetë lidhur në datën 16.09.2022 me vlerë 72,000 mijë lekë me TVSH, me operator ekonomik fitues “G. K. M SH.P.K – Sh. 07 SH.P.K”, afat kohëzgjatje 6 muaj. Nga auditimi konstatohet se kontrata është regjistruar në SIFQ në datën 17.10.2022, jashtë afatit ligjor.

Procedura e dytë e prokurimit me objekt “Rehabilitimi i Përroit Lushnje dhe rikualifikimi urban i zonave rreth tij”, ka nisur në 08.06.2022, me fond limit 323,814 mijë lekë pa TVSH. Kontrata rezulton të jetë lidhur në datën 02.08.2022 me vlerë 273,885 mijë lekë me TVSH, me fitues operatorin ekonomik “A.T.” dhe afat kohëzgjatje 14 muaj. Kkonstatohet se kontrata është regjistruar në SIFQ në datën 19.11.2022, jashtë afatit ligjor.

Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe lidhjeve të kontratave rezulton se për të 2 procedurat ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 80,000 mijë lekë, duke sjell marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore të paktën në vlerën 46,777 mijë lekë.

Disa probleme të përgjithshme të hasura gjatë vitit 2022 të cilat kanë ndikuar në monitorimin e projekteve në mënyrë të përmbledhur problematikat paraqiten si në vijim:

1. Numri i madh i rialokimeve. Një nga problemet kryesore gjatë vitit 2022 kanë qenë rialokimet e shumta, për të krijuar hapësirë buxhetore për fillimin e projekteve të reja.

2. Të dhëna jo të plota në sistemin SIFQ.

3. Projektet e reja kanë financim prej 20% në vitin e parë të ndjekura nga asnjë ndarje në vitet në vijim, për të cilat financimi është planifikuar shumë i ulët, duke zgjatur kështu datën e përfundimit të projektit mbi afatin 3-vjeçar të PBA.

4. Miratimi i shpenzimeve të reja kapitale shkoi për të siguruar financime brenda vitit për projektet në vazhdim dhe të reja – Kjo praktikë financimi brenda vitit dobëson besueshmërinë e PBA dhe procesi buxhetor, pasi duhet që projektet e reja të investimeve të hyjnë në buxhet pas proceseve të vendosura të përzgjedhjes dhe miratimit në fillim të vitit. Pjesa më e madhe e fondit për projektet janë disbursuar menjëherë pas miratimit të Aktit Normativ nga Kuvendi dhe këto shpenzime kanë shkuar për të mbuluar pagesat e prapambetura. Kjo sinjalizon disa problematika si në vijim:

- U planifikuan shpenzime për projekte nuk ishin pjesë e procesit formal të buxhetit 2022;

- U lejua rritja e borxheve të reja të investimeve në 6-mujorin e parë duke i shlyer fondet e disbursuara me akte normative të dhjetorit.

Në konkluzion, nisja e procedurave të prokurimit pa marrë më parë miratimin nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, marrja e angazhimeve buxhetore pa patur fonde të disponueshme, miratimi i fondeve buxhetore vetëm me qëllimin e lidhjes së kontratës dhe më pas shkurtimi i tyre, çelja e projekteve të investimeve në proces me Akte Normative, mbyllja e investimeve në proces dhe çelja e investimeve publike pa kaluar procedurat e menaxhimit të investimeve publike, çelja e investimeve pa përshkrimin e projektit tregojnë për një planifikim të dobët të

investimeve publike nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore dhe një monitorim formal nga ana e instancave drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim dhënien e një sigurie në menaxhimin eficient dhe transparent të fondeve publike. Këto veprime krijojnë kushtet për krijimin e detyrimeve të prapambetura me efekt në rritjen e presionit për rritjen e borxhit publik si pasojë e mosrespektimit të kufijve të miratuar për shpenzime në vitin buxhetor aktual dhe kufijtë e miratuar për vitet e ardhshme buxhetore. Çelja e projekteve përgjatë vitit buxhetor me akte normative, pa kaluar procedurat e PBA dhe vetëm për vlerën e 20% të projektit në vitin aktual, ka krijuar marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore disponibël, lidhjen e kontratave përtej afatit për marrjen e angazhimeve etj. Këto projekte kanë rritur nevojën për financim për vitet pasardhëse buxhetore ku implementohet edhe pjesa e mbetur e tyre sipas kontratave afatshkurtra që nuk përputhen me buxhetin e parashikuar për shlyerjen e tyre, duke krijuar detyrime për tu paguar edhe pas vitit 2024. Referuar më lart, në lidhje me Investimet Kapitale me Financim të Brendshëm konstatohet se,

a) nuk janë respektuar Parimet e Funkcionimit të Sistemit Buxhetor dhe konkretisht pika dh, neni 4 ku citohet: Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë:...dh) respektimi me rreptësi i tërësisë së procesit.

b) Marrja e angazhimeve të reja dhe mungesa e monitorimit paraqet një risk të shtuar në cenimin e qëndrueshmërisë së borxhit publik pasi përcaktimi i limiteve trevjeçare të angazhimeve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme bëhet në përputhje me parimin e qëndrueshmërisë së borxhit publik, në kuadër të:

-neneve përkatëse 40-51 të Ligjit të Menaxhimit të Sistemit Buxhetor ku ndër të tjera përcaktohet:

“Ministri i Financave përcakton një sistem rregullash dhe procedurash për të kontrolluar që angazhimet shumëvjeçare të jenë brenda tavaneve trevjeçare, të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit. Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre duhet të shpërndahen minimumi 20% e vlerës së plotë të projektit përkatës. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të marrë një konfirmim nga Ministria e Financave që fondet, të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë direkt në sistemin informatik financiar të Qeverisë, për ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe raportimin financiar regjistrojnë në këtë sistem angazhimin, brenda pesë ditëve pune nga data e nënshkrimit të tij, kundrejt urdhrat të prokurimit. Përcaktimi i limiteve trevjeçare të angazhimeve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme bëhet në përputhje me parimin e qëndrueshmërisë së borxhit publik. Limiti i angazhimeve për njësitë e qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë vendore dhe regjistrohet në sistemin informatik financiar të Qeverisë.

.. Nëpunësi i parë autorizues miraton detajimin e fondeve buxhetore, të shpërndara për çdo njësi shpenzuese dhe është përgjegjës që kjo të reflektohet në kohë në sistemin e thesarit. Pas miratimit të detajimit të fondeve buxhetore, të shpërndara për çdo njësi shpenzuese, nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes së përgjithshme marrin angazhime dhe bëjnë pagesa, brenda limiteve dhe afateve të përcaktuara....

... E drejta e njësisë të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor....

... Ministri i Financave miraton udhëzime për nëpunësit autorizues për procedurat e regjistrimit të angazhimeve. Nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes së përgjithshme mbajnë të dhëna për angazhimet financiare dhe nuk lejojnë ndërmarrjen e angazhimeve të reja, përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndara.

... Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor. Angazhimet e ndërmarra nga njësitë shpenzuese jashtë fondeve të parashikuara në ligjin e buxhetit vjetor

dhe në vendimin e këshillit të njësisë së qeverisjes vendore për buxhetin ose në kundërshtim me këtë akt ose akte të tjera ligjore, nuk përfshihen si pjesë e detyrimeve financiare të qeverisjes së përgjithshme. Kur nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme merr përsipër angazhime jashtë fondeve të parashikuara në buxhet ose në kundërshtim me këtë akt apo akte të tjera ligjore është përgjegjës për shlyerjen e detyrimit....”

-Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit” ku përcaktohet:

neni 63 citohet: “Plani i investimeve i detajuar nga njësitë e qeverisjes qendrore në nivel projekti mban parasysh këtë radhë prioritare:

a- investimet në proces nga viti i kaluar,

b- objektet e paraqitura në Kuvend gjatë shqyrtimit të projekt buxhetit”

neni 64 citohet: “Nëse në listën e investimeve të detajuara nga njësitë e qeverisjes qendrore ka objekte të reja nga lista e paraqitur në momentin e miratimit të projekt buxhetit të vitit, NPA e përfshin në listën përfundimtare vetëm kur objekti ka kaluar në procedurat e miratimit të investimeve të publikuara. Dhe ja paraqet për miratim përfundimtar Ministrin përgjegjës për Financat.

Neni 157. Nëpunësi zbatues i njësisë respektive regjistron kontratën ose urdhrin e prokurimit për blerjet e vogla, sipas rastit, në kontabilitetin e menaxhimit, përpilon dokumentin e afateve të pagesave, dhe paraqet dokumentacionin si më sipër në gjuhën shqipe (në rastin e kontratave të lidhura në gjuhë të huaj) me njoftimin përfundimtar zyrtar për shpalljen e fituesit, në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë brenda tre ditëve pune nga nënshkrimi i tyre. Mos zbatimi i afatit të mësipërm mund të shkaktojë vonesa në likuidimin e pagesës nga sistemi i thesarit. Penalitetet kontraktuale të shkaktuara nga kjo vonesë janë në ngarkim të njësisë respektive.

c) Nga ana e MFE, nuk janë respektuar rregullat e përgjithshëm të monitorimit të investimeve publike , referuar VKM nr. 185, datë 29.03.2018.

Monitorimi është procesi përmes të cilit institucionet buxhetore, përgjegjëse për zbatimin e projekteve të investimeve publike, sigurojnë që realizimi financiar i projekteve dhe aktivitetet që ato po zbatojnë në këtë kuadër, janë në përputhje me planet vjetore të miratuara në nivel projekti.

Objektivat e monitorimit të projekteve të investimeve publike

Të përmirësojë eficiencën e sistemit aktual të monitorimit të investimeve publike: Sistemi i monitorimit synon një raportim efikas dhe realist që identifikon në kohë dhe i paraprin akumulimit të problemeve, duke vënë në dijeni strukturat vendimmarrëse me qëllim zgjidhjen në kohë të tyre.

Të përmirësojë procesin e planifikimit vjetor dhe afatmesëm në nivel programi dhe projekti: Gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të monitorimit do të ndihmojnë ministrinë të përmirësojnë mënyrën e planifikimit të projekteve, duke mundësuar një përjasje më të mirë në raport me arritjen e objektivave sektoriale, rishikimin e politikave dhe buxhetimin e programeve.

Të përmirësojë kuadrin institucional të monitorimit e raportimit si dhe përgjegjësitë në procesin e planifikimit.

d) Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike, nuk ka përmbushur misionin e saj i cili është të mbështesë zhvillimin ekonomik dhe social të vendit dhe zbatimin e politikave ekonomike të Qeverisë, duke siguruar një menaxhim eficient të burimeve për investime të financuara nga buxheti i shtetit si dhe detyrat e saj:

-Identifikimi, vlerësimi dhe miratimi i projekteve të investimeve publike të paraqitura nga institucionet buxhetore.

-Siguron procesin e përfshirjes së projekteve të investimeve të përzgjedhura në PBA dhe Buxhetin Vjetor.

Nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike është paraqitur observacionin me nr. 14149/2, datë 03.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 281/21, datë 07.08.2023 si dhe nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit (pa emra përfaqësuesish), me shkresën nr. 5854/50, datë 07.09.2023, protokolluar në KLSH me nr. 281/25, datë 11.09.2023 janë paraqitur observacionet si në vijim:

Qëndrimi i subjektit:

-Në lidhje me gjetjen mbi detajimin e fondit me emërtimin “Fond i ngrirë”, sqarojmë se gjatë detajimit të buxhetit koncepti i projekteve me emërtimit “Fond i ngrirë” ka të bëjë kryesisht me projekte të reja dhe kryesisht “Fondet për projektet e reja të investimeve për blerjen e pajisjeve elektronike/informatike që lidhen me teknologjinë e informacionit bëhen efektive vetëm pas konfirmimit nga AKSHI. Si dhe projekte që nuk kanë qenë pjesë e listës së ciklit të PBA-së ose nuk kanë pasur mjaftueshëm, DMIP i çel si fonde të ngrira të cilat nuk mund të përdoren dhe s’ngurtësohen kur plotësohen kërkesat e mësipërme. Nëse kërkohen për qëllime auditimi apo për informacione nga titullarët, sigurisht që zëri “Fond i ngrirë” është i shoqëruar me përshkrimin përkatës dhe kjo është e identifikueshme. Gjithashtu mund të jenë dhe projekte të cilat nuk kanë arritur të implementohen deri në muajt e fundit të përfundimit të vitit buxhetor dhe si të tilla për një menaxhim sa më efektiv të përdorimit të fondeve për shpenzime kapitale, këto projekte kalojnë nën zërin “Fond i ngrirë”.

-Në lidhje me gjetjen shpenzime kapitale me financim të huaj janë realizuar projekte pa pasur plan buxheti, sqarojmë së nga ana jonë i është kërkuar institucioneve që të bëjnë sistemimet e nevojshme mbi këto projekte. MFE ka ndërmarrë këto hapa: çdo javë përgatiten raporte financiare mbi ecurinë e investimeve të cilat i paraqiten ministres dhe njëkohësisht Këshillit të Ministrave. Drejtoria e Investimeve përgatit raporte mujore ku paraqiten edhe problematikat mbi projektet kryesore. Regjistrimi për shpenzimet faktike të projekteve me financim të huaj bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit bazuar në raportimet që bëjnë njësitë e zbatimit të projekteve. Nga Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike nuk mund të bëhet sistemimi i kodeve në mungesë të informacionit të plotë nga ministritë e linjës dhe institucionet buxhetore. Kjo ka sjellë edhe problematikën e tejkalimit apo realizimit pa pasur një plan të miratuar.

-Në lidhje me gjetjen përdorimi i fondeve buxhetore të miratuara për investime në shpenzime operative referuar natyrës së transaksioneve të kryera sqarojmë se parashikimi si shpenzime kapitale “vendimeve gjyqësore në proces” si investime është bërë pasi vendimet gjyqësore janë të lidhura me projektet e investimeve dhe duhet të përfshihen si investime pasi rëndojnë vlerën e projektit. Në lidhje me gjetjet mbi përfshirjen e kostos lokale që përdoret nga FSHZH për shpenzime të funksionimit të institucionit në shpenzime kapitale ju informojmë se në këtë kod janë të detajuara shpenzimet takuese për FSHZH të cilat lidhen në menaxhimin e projektit të caktuar dhe i detajohen FSHZH bazuar në VKM-në nr. 226, datë 21.03.2017 “Për financimin e kostos së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga FSHZH”.

-Në lidhje me gjetjen “ndërmarrja e angazhimeve të reja jashtë afatit dhe përdorimi i buxhetit të vitit 2022 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, sqarojmë se lidhja e kontratave pas datës 15 Tetor është në përgjegjësi direkte të autoriteteve kontraktore dhe jo e DMIP.

-Në lidhje me gjetjen se detyrimet e prapambetura duhet të njihen si investime në vitin që kanë ndodhur pavarësisht nga momenti i pagesës bëjmë me dije se njohja e shpenzimeve në momentin që ka ndodhur bëhet për efekt kontabiliteti, ndërkohë që nga ana jonë shpenzimet për investime janë raportuar për efekt plani buxhetor dhe fakti referuar tavanëve buxhetore ligjore.

-Në lidhje me rishpërndarjet e akteve normative nr. 17, datë 01.12.2022 dhe nr. 19, datë 29.12.2022 MFE shprehet se rastet e regjistrimit të rialokimeve pas datës 15 Nëntor kanë të bëjnë me zbatimin e aktit normativ të cilët kanë fuqinë e ligjit dhe nuk kanë të bëjnë me rishpërndarjet në kuptim të nenit 48 të LOB. Pjesa më e madhe e transferimeve janë zbatim i 2 AN-ve të sipërcituara.

-Në lidhje me gjetjen se mungon një analizë e detajuar dhe dokumentacion mbështetës për axhustimet mes zërave të shpenzimeve buxhetore, sqarojmë se: ndërmarrja e angazhimit për ndryshimet në buxhetin vjetor është bërë me qëllim rritjen e performancës së shpenzimeve kapitale dhe uljen e detyrimeve të prapambetura.

-Në lidhje me gjetjen mbi numrin e lartë të rialokimeve sqarojmë se është një mekanizëm përmes së cilit Ministritë e linjës dhe institucionet buxhetore adresojnë rialokimin e fondeve nga projektet me

ecuri të ulët në krahasim me planifikimin e tyre drejt projekteve të investimeve publike të cilat rezultojnë me progres të mirë duke ndikuar në një përdorim më efikas të burimeve të alokuara.

-Në lidhje me gjetjen se ekzistojnë ndryshime ndërmjet buxhetit sipas AN. 19, planit operativ dhe planit në SIFQ sqarojmë se plani operativ përfshin edhe detajimet e shpërndara ndërmjet VKM-ve të ndryshme.

-Në lidhje me gjetjet se ka ndryshime në vite mes parashikimeve buxhetore në PBA shprehemi se me akte normative kanë ndryshuar tavanet buxhetore të programeve dhe për rrjedhojë edhe projekteve të investimeve. Në këto kushte tavanet buxhetore në PBA-të vijuese ndryshojnë dhe përdoren për vijimin e projekteve të tjera.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Në lidhje me observacionin sqarojmë se:

- Për sa i përket termit fond i ngrirë është një term që nuk njihet në ligjin organik të buxhetit i cili ka parashikuar një proces normal të detajimit të buxhetit dhe bërjen e tij të vlefshëm në SIFQ.

- Në lidhje me investimet e huaja, pavarësisht masave që janë marrë, edhe për vitin 2022 ekziston problematika e realizimit të projekteve pa pasur plan buxhetor, apo në tejkalim të tij.

-Në lidhje me vendimi gjyqësore të raportuara si investime, observacioni nuk merret në konsideratë pasi nuk ka dokumentacion bashkëlidhur për të vërtetuar pretendimet.

- Në lidhje me lidhjen e kontratave të reja pas datës 15 Tetor, grupi i auditimit sqaron se për këtë problematikë nuk është ngarkuar me përgjegjësi DMIP, por NA dhe NZ e institucioneve përkatëse.

- Në lidhje me detyrimet e prapambetura grupi i auditimit i qëndron konstatimit se detyrimet duhet të njihen në momentin e krijimit të tyre dhe jo në momentin e kryerjes së pagesës. Në lidhje me çështjet e tjera të observuara nuk janë paraqitur fakte dhe dokumente të cilat kundërshtojnë konstatimet e grupit të auditimit. Argumentet e cituara në observacion janë sqaruese dhe jo kundërshtuese të konstatimeve të grupit të auditimit, konstatime këto të përsëritura edhe nga vitet e kaluara.

Titulli i gjetjes:	Investimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar me burim financimi të ardhurat dytësore në shumën 1,148 milion lekë pa u shoqëruar me planin përkatës buxhetor dhe raportimi i investimeve me burim financimi të ardhurat e arsimit të lartë kryhet në projekte investimi të sintetizuara për disa njësi shpenzuese.
Situata:	Nga auditimi mbi investimet kapitale me financim të brendshëm të realizuara nga të ardhurat dytësore, për vitin 2022 të regjistruara në SIFQ, konstatohet se janë realizuar investime kapitale me financim të brendshëm në vlerën për 1,352 milion lekë. Këto investime nuk kanë plan buxheti të miratuar, ndërkohë që në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar janë raportuar të realizuara ndaj planit të buxhetit. Nga auditimi mbi investimet kapitale me financim të brendshëm të realizuara me burim financimi të ardhurat e arsimit të lartë konstatohet se janë kontabilizuar në llogarinë 231 “Investime Kapitale Të Trupëzuara” 14 projekte investimi me vlerë 180,661 mijë lekë me përshkrimin “Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve” në disa njësi shpenzuese të ndryshme. Për këto investime është përdorur i njëjti kod projekti investimi për disa institucione të arsimit të lartë, duke mos identifikuar specifikisht investimet e kryera në nivel produkti investimi me impakt në cilësinë e informacionit të raportuar dhe vështirësi në ndjekjen e ecurisë së tyre.
Impakti:	Mungesë ndjekje të investimeve në nivel produkt investimi dhe lejimi i planifikimit të investimeve të tjera.
Shkaku:	Mos detajimi i planit dhe përdorimi i projekteve të investimit të njëjta
Rëndësia:	E mesme
Kriteri:	Përkufizimi i investimit publik në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 49, neni 1.
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të reflektohet në treguesit fiskalë të konsoliduar, sipas tabelës 4 të ligjit të buxhetit të vitit, plani buxhetor për të gjitha investimet kapitale të brendshme me burim financimi të ardhurat e veta sikurse parashikohen për investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë. Në të

	njëjtën kohë, të detajohen në nivel analitik investimet e realizuara nga të ardhurat e veta të arsimit të lartë dhe të shmanget çelja e projekteve të investimit në një kod të përgjithshëm ndërkohë që projektet zbatohen nga njësi shpenzuese të ndryshme.
--	--

Titulli i gjetjes:	Në detajimin fillestar të investimeve çelen projekte me përshkrimin fond i ngrirë.
Situata:	Nga auditimi mbi detajimin e fondeve për investimeve publike me financim të brendshëm të miratuara me ligjin nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, konstatohet se janë detajuar në institucione të ndryshme 6 Projekte Investimi me përshkrimin “Fond i ngrirë”, me vlerë fillestare 4,325 mijë lekë, në 12 programe të ndryshme buxhetore. Institucionet më përfaqësuese ku janë detajuar këto fonde përgjatë vitit përfshijnë: <i>Aparatin e Ministrisë së Infrastrukturës si dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar</i> . Detajimi i fondeve të ngrira për investime kapitale është në kundërshtim me përcaktimet e bëra për përkufizimin e projektit të investimit publik, pika 49, neni 1 i Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kërkesat e udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022”, pika 25, ku janë të parashikuara kriteret dhe përparësitë në financimin e projekteve dhe nuk parashikohet çelja e fondeve të ngrira për investimet kapitale të miratuara. Rezervimi i fondeve të këtyre investimeve sipas këtij detajimit fillestar nuk krijon mundësinë e zhvillimit të procedurave për prokurimin përgjatë vitit apo kryerjen e pagesave në rast të detyrimeve të mbartura dhe në vijim kryhen rishpërndarje ndërmjet projekteve për çdo njësi shpenzuese.
Impakti:	Mos përdorim në kohë i fondeve buxhetore
Shkaku:	Mos detajimi i investimeve
Rëndësia:	E mesme
Kriteri:	Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 49, neni 1. Udhëzimi plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022”, pika 25
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të shmanget praktika e detajimit fillestar të fondeve të investimeve në projekte me përshkrim “Fond i ngrirë” dhe të alokohen fondet e investimit në projekte specifike për të krijuar mundësinë e përdorimit të fondeve buxhetore të miratuara.

Titulli i gjetjes:	Përdorimi i fondeve buxhetore të miratuara për investime në shpenzime operative referuar natyrës së transaksioneve të kryera.
Situata:	Nga auditimi mbi planifikimin, realizimin dhe raportimin e investimeve kapitale me financim të brendshëm konstatohet se: -raportohet si investim, projekti me kod M062991 i Autoritetit Rrugor Shqiptar me përshkrim “Vendime gjyqësore në proces” me vlerë për 180,000 mijë lekë. Për planifikimin dhe realizimin e këtyre shpenzimeve duhet të ishin përdorur llogaritë e shpenzimeve operative. Nga auditimi konstatohet se, vlera për 32,085 mijë lekë, përfaqëson detyrime të prapambetura të periudhave të mëparshme duke filluar nga viti 2016. -Në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në programin buxhetor 6210 “Programe zhvillimi” raportohet si investim i realizuar kosto lokale e menaxhimit të projekteve të investimit në shumën 883,196 mijë lekë, me kod projekti M56032 “Projekti i rrugëve dytësore dhe lokale”, ndërkohë që këto fonde përdoren në llogari bankare të nivelit të dytë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për aktivitetin e shpenzimeve korente të institucionit. - në programin 4250 “Zhvillimi rural” në AZHBR konstatohet se janë raportuar investime kapitale me kod projekt 18AL301 “Përfitues nga Programi IPARD II

	nga masa 1” në shumën 591,615 mijë lekë, kapitulli 3 “kosto lokale”. Këto pagesa kryhen në kuadër të bashkëfinancimit të fondeve të BE për mbështetjen e fermerëve/agroturizimit në kryerjen e investimeve nga ana e investitorëve. Pjesa e buxhetit të shtetit në kuadër të bashkëfinancimit është në masën 25%, ndërkohë që konstatohet se për nga natyra, nuk kemi të bëjmë me investim kapital, por me grant të dhënë të tretëve. Në këtë mënyrë, treguesit e investimeve publike janë të mbivlerësuar.
Impakti:	Mbivlerësim i treguesve të investimeve.
Shkaku:	Planifikimi dhe raportimi i gabuar i fondeve.
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Ligji nr.115 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar për nivelin e miratuar të fondeve, sipas tabelës 1 dhe 4 të tij.
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së diskutimit të kërkesave buxhetore dhe në vijim të detajimit të fondeve sipas kërkesave të institucioneve buxhetore të zhvillohet një analizë mbi natyrën ekonomike të fondeve të kërkuara me qëllim klasifikimin dhe raportimin e drejtë të shpenzimeve sipas natyrës dhe destinacionit për rastet e mësipërme dhe të tjera.

Titulli i gjetjes:	Ndërmarrja e angazhimeve të reja jashtë afatit dhe përdorimi i buxhetit të vitit 2022 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.
Situata:	<p>Nga auditimi i të dhënave në lidhje me kontratat e nënshkruara për investimet përgjatë vitit 2022, sipas modulit të kontratave në SIFQ konstatohet se janë nënshkruar 1,319 kontrata pas datës 15 Tetor për investimet publike, në kundërshtim me nenin 51, pika “g” të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe pikën 1 dhe 2 të VKM-së nr. 807 datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore publike”.</p> <p>Nga këto rezultojnë se 688 kontrata janë nënshkruar nga institucionet e qeverisjes qendrore, me vlerë të kontraktuar për vitin 2022 prej 7,997,295 mijë lekë dhe vlerë totale të kontraktuar gjithsej 27,986,570 mijë lekë dhe 631 nga institucionet e vetëqeverisjes vendore, me vlerë të kontraktuar për vitin 2022 prej 2,048,472 mijë lekë dhe vlerë totale të kontraktuar gjithsej 6,481,841 mijë lekë. Lidhja e kontratave pas kësaj date krijon kushtet për lindjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë për përdorim pa efikasitet të fondeve buxhetore në nivelin e 20% të kostos së projektit në vitin e parë të zbatimit të tij, pasi koha e mbetur për përdorimin e këtij fondi deri në fund të vitit buxhetor është shumë e shkurtër. Nga auditimi mbi investimet e raportuara gjatë vitit 2022, konstatohet se 85 institucione të qeverisjes qendrore kanë paguar detyrime të prapambetura në vlerë 6,169,244 mijë lekë të cilat përfaqësojnë rreth 6.8% të investimeve kapitale me financim të brendshëm të realizuara, në kundërshtim me pikën a, të nenit 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, duke mbivlerësuar investimet e raportuara faturat e të cilave konstatohet se datojnë që prej vitit 2014.</p>
Impakti:	Krijim detyrimesh të prapambetura, mbivlerësim treguesish të investimeve.
Shkaku:	Lidhja e kontratave dhe mos raportimi në kohë i faturave të investimit.
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 51/pika g, 61/pika a.</p> <p>Ligji nr. 115 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, kreu III, neni 11, aneksin “Gjurma Standarde e Auditimit për Ekzekutimin e Shpenzimeve 2/5”.</p> <p>VKM nr. 807 datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore publike”, pika 1 dhe 2.</p>
Rekomandimi	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të ndërmerren inspektime

	financiare dhe masa administrative në lidhje me detyrimet e prapambetura, për rastet e thyerjes së disiplinës buxhetore sipas përgjegjësive përkatëse të funksionarëve publik të ngarkuar dhe autorizuar për kryerjen e shpenzimeve publike.
--	--

Titulli i gjetjes:	Në 17 raste për 9 projekte investimi në vlerën 398,792 mijë lekë, është bërë parapagim i kontratave.
Situata:	Nga auditimi është konstatuar se nga FSHZH, në 17 raste për 9 projekte investimi në vlerën 398,792 mijë lekë, është bërë parapagim i kontratave. Fondi Shqiptar i Zhvillimit me shkresën nr. 1402/4 prot., datë 14.11.2022, i ka dërguar MFE-së kërkesë për miratimin e dhënies së pagesës paraprake në kontratat e mësipërme të zbatimit të punimeve. Ministri i Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 20993/1 prot., datë 23.11.2022 ka miratuar dhënien e fondeve në formën e paradhënies duke përdorur si referencë ligjore pikën 160 dhe 161 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. Nga auditimi konstatohet se kontratat e mësipërme nuk rezultojnë të jenë të një rëndësie të veçantë. Për sa më sipër parapagimi i kontratave është në kundërshtim me pikën 160, 161 të Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar dhe nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Impakti:	Mbivlerësim i realizimit të investimeve për vitin 2022
Shkaku:	Miratimi i kërkesës për paradhënie nga ana e MFE-së
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 160, 161.
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për nxjerrjen e përgjegjësive dhe parandalimin e kryerjes së parapagimeve për kontrata investimi, pasi ndikojnë në shqyrtimin dhe analizën e vëllimit të investimeve të realizuara në vitin përkatës fiskal.

Titulli i gjetjes:	Problematika mbi investimet publike me financim të brendshëm.
Situata:	<p>Nga auditimi i investimeve me financim të brendshëm u konstatua se për 67 projekte në vazhdim nga vitet e mëparshme, fondet nuk janë çelur në fillim të vitit, por janë çelur kryesisht gjatë muajit Mars dhe Korrik, në kundërshtim me pikën 63 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.</p> <p>Gjithashtu, nga auditimi i investimeve kapitale me financim të brendshëm janë evidentuar problematika në drejtim të detajimit të investimeve pa kaluar ciklin e menaxhimit të investimeve publike, marrjen e angazhimeve nëpërmjet kontraktimit të fondeve publike të pa miratuara në momentin e nënshkrimit të kontratave nga nëpunësit autorizues, detajimin e fondeve të investimeve vetëm për 20% të vlerës dhe pa pasur fonde të miratuara për periudhën e mbetur sipas vlerës dhe kohëzgjatjes totale të projektit, etj të paraqitura sipas projekteve në vijim:</p> <p>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, programi buxhetor 04520 “Transport rrugor”</p> <p>Projekti 18BS553 “Zgjerimi i segmentit rrugor, Elbasan - Qafë Thanë (Faza I) nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet. Kontrata e lidhur me afat 18 muaj, në vlerën 2,620,515 mijë lekë është 1,710,515 mijë lekë më shumë se vlera e planifikuar në PBA. Rezulton se alokimi prej 20% i fondeve është bërë për qëllim të lidhjes së kontratës duke qenë se 10 ditë më vonë këtij projekti i janë hequr fonde dhe pagesa e situacionit të parë, ose 9% e vlerës së kontratës është realizuar 22 ditë pas lidhjes së kontratës.</p> <p>Projekti 18BS552 “Ndërtim rruga Korçë - Ersekë Loti 2 (pjesa e Dytë)” nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet. Kontrata e lidhur me afat 24 muaj, në vlerën 2,623,631 mijë lekë është 1,737,631 mijë lekë më shumë se vlera e planifikuar në PBA. Konstatohet se me fondet e situara me rishikim janë paguar faturat me datë para datës së rishikimit, në total për 437,807 mijë lekë.</p> <p>Projekti 18BS551 “Ndërtim rruga Kardhiq - Delvinë Loti 8 (Sistemimi dhe Rivitalizim i Skarpateve) nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet. Kontrata e lidhur me afat përfundimi 8 muaj, në vlerën 1,726,615 mijë lekë me TVSH është 923,631 mijë lekë më shumë se vlera e planifikuar në PBA. Rezulton se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 400,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 1,323,615 mijë lekë.</p> <p>Projekti 18BS616 “Rikonstruksion i aksit rrugor Maliq-Lozhan i Ri-Strelcë” nuk ka qenë pjesë e listës së</p>

investimeve publike të paraqitura në projekt buxhet. Kontrata e lidhur me afat 24 muaj në vlerën 1,397,258 mijë lekë është 797,258 mijë lekë më shumë se vlera e planifikuar në PBA.

Projekti 18BS617 “Rehabilitimi i segmentit rrugor Fier-Vlorë (rruga e vjetër)” nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura në projekt buxhet. Kontrata e lidhur me afat 14 muaj, në vlerën 950,467 mijë lekë është 440,467 mijë lekë më shumë se vlera totale e planifikuar në PBA dhe regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit ligjor.

Projekti 18BS713 “Përmirësimi i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Verior Loti 1” nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura në projekt buxhet. Kontrata e lidhur me afat 26 javë, në vlerën 217,200 mijë lekë me TVSH është 41,200 mijë lekë më shumë se vlera e planifikuar në PBA. Rezulton se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 46,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 171,200 mijë lekë.

Projekti 18BS715 “Përmirësimi i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Jugor Loti 3” nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura në projekt buxhet. Kontrata e lidhur me afat 8 muaj, në vlerën 196,582 mijë lekë me TVSH është 26,000 mijë lekë më shumë se vlera totale e planifikuar në PBA dhe regjistrimi i kontratës është jashtë afatit ligjor. Rezulton se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 40,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 156,582 mijë lekë.

Projekti 18BS714 “Përmirësimi i sinjalistikës horizontale në akset dhe segmentet rrugore të Rajonit Qendror Loti 2” nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet. Kontrata e lidhur me afat 8 muaj, në vlerën 193,720 mijë lekë me TVSH është 23,720 mijë lekë më shumë se vlera e planifikuar në PBA. Regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit. Rezulton se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 40,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 153,720 mijë lekë.

Projekti 18BT017 “Sistemi dhe rivitalizimi i skarpateve në Plani i Bardhë” nuk ka qenë pjesë e PBA-së dhe listës së investimeve publike në projekt buxhet. Regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit ligjor. Nga auditimi rezulton se alokimi 20% i fondeve është bërë me qëllim të lidhjes së kontratës, pasi 20 ditë më vonë janë hequr të gjitha fondet e çelura.

Projekti 18BT016 “Sistemi dhe rivitalizimi i skarpateve në Shkallën e Tujanit” nuk ka qenë pjesë e PBA-së dhe as pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhetin. Regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit. Nga auditimi rezulton se alokimi 20% i fondeve është bërë me qëllim të lidhjes së kontratës, pasi 20 ditë më vonë janë hequr të gjitha fondet e çelura.

Projekti 21AC803 “Ndërtim i Godinës së Qendrës së monitorimit të trafikut” nuk ka qenë pjesë e PBA-së dhe as pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet. Regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit. Konstatohet se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 50,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 156,640 mijë lekë.

Projekti 19AH102 “Rindërtim Ura e Tapizës, (shtesë punimesh)” nuk ka qenë pjesë e PBA-së dhe as pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet. Për këtë projekt është lidhur kontrata me vlerë 30,471 mijë lekë, me afat përfundimi 12 muaj. Regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit. Konstatohet se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 6,100 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 24,371 mijë lekë.

Projekti 18AE715 “Ndërtimi i qendrës kombëtare kulturore për fëmijë dhe Teatri i Kukullave” për të cilin është lidhur kontrata me vlerë 1,205,339 mijë lekë, me afat 24 muaj, 453,339 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti të planifikuar në PBA. Regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit ligjor. Konstatohet se alokimi i fondeve prej 20% është bërë vetëm për efekt të lidhjes së kontratës, duke qenë se rreth 1 muaj më vonë këto fonde janë shkurtuar.

Në Projektin me Kod 19AC403, sipas Drejtorisë së Investimit me përshkrim “Ndërtimi i godinës së re të AFA (prona 21) është regjistruar kontratë e re për projekt investimi me përshkrim “Ndërtimi i godinave shumë funksionale për Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë (fakulteti dhe mensa)”. Për këtë projekt është lidhur kontrata datë 30.12.2022, me vlerë 600,568 mijë lekë, me afat përfundimi 8 muaj. Regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit. Konstatohet se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt nuk ka pasur fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 600,568 mijë lekë.

Programi buxhetor 06730 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”.

Projekti 19AG307 “Ndërtimi i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të qytetit të Laçit, baza 4” Për këtë projekt është lidhur kontrata me vlerë 531,995 mijë lekë, me afat 24 muaj. Konstatohet se më datën 28.12.2022 është paguar fatura me vlerë 102,600 mijë lekë, me datë furnitori 23.12.2022, pra 16 ditë pas lidhjes së kontratës.

Projekti 19AF224 “Sistemi i kanaleve të ujërave të zeza KUZ dhe Ujërave të bardha KUB, në rrugët Riza Begçela dhe Murat Basha, Bashkia Klos” nuk ka qenë pjesë e PBA-së dhe as pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet. Për këtë projekt është lidhur kontrata me vlerë 22,433 mijë lekë, me afat 6 muaj. Regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit. Rezulton se në kohën e nënshkrimit të kontratës ka pasur në dispozicion 5,047 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 17,386 mijë lekë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Projekti 18AJ603 “Shtimi kapaciteti ankorues porti peshkimit Durrës (bankinë) loti 1” nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet. Për këtë projekt është lidhur kontrata me vlerë 167,410 mijë lekë, me afat 6 muaj, 81,430 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti të planifikuar në PBA.

Regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit. Rezulton se në momentin e lidhjes së kontratës ka pasur 48,362 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 119,048 mijë lekë.

Projekti 20AB705 “Rikonstruksione të godinave të njërive të kujdesit shëndetësor në rrethe”

Konstatohet se për këtë kod projekti janë zhvilluar 2 procedura prokurimi duke nënshkruar kontrata me vlerë 67,002 mijë lekë, me afat 8.5 muaj dhe kontrata me vlerë 38,318 mijë lekë, me afat 4.6 muaj. Të dyja kontratat janë regjistruar jashtë afatit. Rezulton se për të 2 procedurat ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 42,000 mijë lekë, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 63,320 mijë lekë.

Projekti 18AY635 “Rikonstruksioni i shkollës së mesme profesionale Nazmi Rushiti, Peshkopi” për të cilin është lidhur kontrata me vlerë 145,034 mijë lekë, me afat 26 javë, 26,530 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti të planifikuar në PBA. Edhe pse kontrata është nënshkruar me afat zbatimi 26 javë, fondet janë parashikuara të shtrira për 3 vite buxhetore. Regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit. Rezulton se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 28,697 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 116,337 mijë lekë.

Projekti 18AY637 “Rikonstruksioni/shtim ambientesh në shkollën “Herman Gmainer”, Tiranë” për të cilin është lidhur kontrata me vlerë 31,961 mijë lekë, me afat 6 muaj. Regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë jashtë afatit. Konstatohet se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 15,000 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 16,961 mijë lekë.

Projekti 18AY636 “Ndërtimi/rikonstruksioni i shkollës “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë” për të cilin është lidhur kontrata me vlerë 38,735 mijë lekë, me afat përfundimi 6 muaj. Rezulton se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 20,503 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 18,232 mijë lekë.

Projekti 18AY638 “Ndërtimi/ikonstruksioni i reparteve të praktikave profesionale shkolla “Beqir Çela”, Durrës” për të cilin është lidhur kontrata me vlerë 128,171 mijë lekë, me afat 26 javë. Regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit. Rezulton se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 30,205 mijë lekë fonde, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 97,966 mijë lekë. Pavarësisht kohëzgjatjes së kontratës për 26 javë, parashikimi buxhetor është shtrirë për 3 vite.

Projekti 20AD425 “Përmirësimi i sistemit të QKB-së” për të cilin është lidhur kontrata me vlerë 233,454 mijë lekë, nga të cilat 219,410 mijë lekë është vlerë e implementimit të sistemit me afat 9 muaj. Regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë jashtë afatit. Rezulton se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 100,000 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 119,410 mijë lekë, për vlerën e implementimit të sistemit.

Projekti 20AD421 “Përmirësimi i sistemit të RUDA- për MBZHR” për të cilin është lidhur kontrata me vlerë 224,328 mijë lekë, nga të cilat 202,728 mijë lekë është vlerë e implementimit të sistemit me afat 12 muaj. Regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë jashtë afatit. Rezulton se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 50,000 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 152,728 mijë lekë, për vlerën e implementimit të sistemit.

Projekti 18AK609 “Sistemet e aplikimit online për skemat IPARD dhe sistemet e tjera” për të cilin është lidhur kontrata me vlerë 296,400 mijë lekë, nga të cilat 203,963 mijë lekë është vlerë e implementimit të sistemit me afat 9 muaj. Kontrata është regjistruar në SIFQ jashtë afatit. Rezulton se gjatë lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 190,404 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 13,559 mijë lekë, për vlerën e implementimit të sistemit.

Projekti 18AZ313 “Ngritja e sistemit të informacionit për gjeografinë dhe infrastrukturës ushtarake në shërbim të IGJIUT” për të cilin është lidhur kontrata në vlerën 227,917 mijë lekë, nga të cilat 219,410 mijë lekë është vlerë e implementimit të sistemit me afat 9 muaj. Regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë jashtë afatit. Rezulton se në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 69,500 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 149,910 mijë lekë.

Projekti 18AV812 “Hapësira hardware për kapacitetin e serverëve” për të cilin është lidhur kontrata me vlerë 425,353 mijë lekë, nga të cilat 404,048 mijë lekë është vlerë e implementimit të sistemit me afat 9 muaj. Regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit. Rezulton se për këtë projekt ka pasur 215,991 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 188,057 mijë lekë.

Projekti 20AD413 “Ngritja e hartës dixhitale të monitorimit me kamera në ambiente publike” për të cilin është lidhur kontrata me vlerë 116,799 mijë lekë, regjistruar në SIFQ jashtë afatit. Rezulton se për projekt ka pasur 96,232 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 20,567 mijë lekë.

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Projekti 22AD001 “Ngritja e infrastrukturës mbështetëse në funksion të kompleksit për zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të motorizimit auto-moto park në Bashkinë Elbasan” për të cilin janë zhvilluar 2 procedura prokurimi dhe janë lidhur kontratat me vlerë 429,478 mijë lekë, me afat 12 muaj dhe me vlerë 630,889 mijë lekë, me afat 12 muaj, regjistruar në SIFQ jashtë afatit. Konstatohet se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe lidhjeve të kontratave për të 2 procedurat ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 318,222 mijë lekë, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 742,145 mijë lekë.

Projekti 22AB901 “Ndërhyrje për ndërtimin e infrastrukturës së transportit, parkimeve, stacioneve

	<p><i>multimodale, moleve etj.</i>” Kontrata ndërtimi i godinës së parkimit pranë stacionit të trenit Durrës dhe punimeve plotësuese në parkimin publik nëntokësor të qendrës multifunksionale Vlorë. Regjistrimi i kontratës në SIFQ është bërë jashtë afatit ligjor. Rezultoni se gjatë kohës së zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe në momentin e lidhjes së kontratës ky projekt ka pasur 69,850 mijë lekë fonde të planifikuara, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore për këtë projekt në vlerën 502,920 mijë lekë.</p> <p>Projekti 22AA101 “Transformimi urban në hapësira publike kryesore” për të cilin janë zhvilluar 3 procedura prokurimi dhe janë lidhur kontratat me vlerë 499,164 mijë lekë, me afat 12 muaj me vlerë 341,954 mijë lekë, me afat 9 muaj dhe me vlerë 127,932 mijë lekë, me afat 12 muaj, regjistruar në SIFQ jashtë afatit ligjor. Rezultoni se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe lidhjeve të kontratave, për të 3 procedurat ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 200,000 mijë lekë, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në vlerën 769,050 mijë lekë.</p> <p>Projekti 22AA501 “Ndërhyrje për mbrojtje mjedisore, lumore, erozion, rrëshqitje” për të cilin janë zhvilluar 2 procedura prokurimi dhe janë lidhur kontrata me vlerë 72,000 mijë lekë, me afat 6 muaj dhe kontrata me vlerë 273,885 mijë lekë, me afat 14 muaj, regjistruar në SIFQ jashtë afatit. Rezultoni se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe lidhjeve të kontratave, për të 2 procedurat ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 80,000 mijë lekë, duke sjellë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore të paktën në vlerën 46,777 mijë lekë.</p>
Impakti:	Krijimi i detyrimeve të prapambetura, presion rritës për rritjen e borxhit publik, etj
Shkaku:	Lidhja e kontratave pas 15 tetorit, çelja e projekteve të reja gjatë vitit, rialokimet e fondeve në fund të vitit, regjistrimi i kontratave me vonesë etj.
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Neni 40-51 Udhëzimi nr. 8 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 63, 157.
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa me qëllim shmangien e shtyrjes së planit buxhetor përtej periudhës së parashikuar për kohëzgjatjen e kontratave; të merren masa për regjistrimin në kohë të fondeve të obliguara në SIFQ, të shmangjet detajimi i projekteve të reja të investimit publik me akte normative gjatë si dhe në përfundim të vitit buxhetor, të cilat nuk krijojnë mundësinë e përdorimit të buxhetit prej 20% të kërkuar në vitin e parë të zbatimit të tij shoqëruar me kryerjen e inspektimeve dhe marrjen e masave administrative përkatëse.

b. Investimet Kapitale me Financim të Huaj

Financime të huaja, konsiderohen të gjitha fondet nga huat, kreditë dhe grantet që merr Republika e Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave nga shtetet e huaja, organizmat ndërkombëtare, institucionet financiare ndërkombëtare, bankat e huaja, organizatat joqeveritare, etj. Hua/kredi janë të hyrat të marra me kusht kthimi me ose pa interes për financimin e projekteve të përcaktuara brenda fondeve të miratuar ose për financimin e deficitit buxhetor që jepen nga institucionet financiare të huaja mbi bazën e marrëveshjeve të përkatëse. Ndërsa, grant janë të ardhurat e përfituara në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes, për një qëllim të përcaktuar ose jo, të cilat përdoren për financimin e veprimtarisë në përputhje me politikat të caktuara dhe që jepet mbi bazën e një marrëveshje.

Sipas ligjit nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, ligjit nr. 137, datë 16.12.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, ligjit nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, planifikimi total i investimeve të huaja për vitin 2022 paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela: Planifikimi i investimeve të huaja për vitin 2022, sipas ligjit të buxhetit të vitit 2020, 2021 dhe 2022

Në milion lekë

	Vlera e planifikuara për vitin 2022 në ligjin e buxhetit të vitit 2020	Vlera e planifikuara për vitin 2022 në ligjin e buxhetit të vitit 2021	Vlera e planifikuara për vitin 2022 në ligjin e buxhetit të vitit 2022
Planifikimi i Investimeve me Financim të Huaj	35,160	31,112	34,502

Burimi: Ligji i buxhetit, vitit 2020, 2021, 2022, përpunuar nga grupi i auditimit

Vlera totale e investimeve me financim të huaj e planifikuar për vitin 2022 referuar ligjit fillestar të buxhetit të vitit 2020, 2021 dhe 2022 ka pësuar ndryshime. Në ligjin e buxhetit të vitin 2022, investimet me financim të huaj janë planifikuar në vlerën totale 34,502 milion lekë, duke u ulur për vlerën 658 milion lekë krahasuar me vlerën e planifikuar në ligjin e buxhetit të vitit 2020, ndërsa krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2021, këto investime janë rritur në vlerën 3,390 milion lekë. Tabela në vijim paraqet institucionet dhe programet që

kanë pësuar ndryshimet më të mëdha në vlerën e planifikuar për vitin 2022, në ligjin e buxhetit të për vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Tabela: Planifikimi i investimeve të huaja për vitin 2022, sipas ligjit të buxhetit të vitit 2020, 2021 dhe 2022
mijë lekë

Kodi	Emërtimi i Institucionit / Programit	Investime FH, 2020	Investime FH, 2021	Investime FH, 2022	Dif 2022-2020	Dif 2022-2021
3	Kryeministria	330,000	130,000	0	(330,000)	(130,000)
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	330,000	130,000	0	(330,000)	(130,000)
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	4,024,946	3,224,946	3,163,251	(861,695)	(61,695)
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	497,918	249,709	388,014	(109,904)	138,305
04240	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	755,800	0	0	(755,800)	-
04250	Zhvillimi Rural duke mbetsh. Prodh. Bujq. Blek, Agroind dhe Market.	1,898,628	2,213,755	2,413,755	515,127	200,000
04230	Mbështetje për Peshkimin	872,600	761,482	361,482	(511,118)	(400,000)
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	17,054,406	14,526,406	16,943,755	(110,651)	2,417,349
04520	Transporti rrugor	5,808,132	4,860,132	5,030,132	(778,000)	170,000
04550	Transporti Hekurudhor	1,400,000	1,400,000	1,958,349	558,349	558,349
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	5,066,274	4,666,274	6,669,274	1,603,000	2,003,000
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	1,200,000	600,000	476,000	(724,000)	(124,000)
04320	Mbështetje për Energjinë	3,360,000	2,780,000	2,780,000	(580,000)	-
06180	Planifikimi Urban	220,000	220,000	0	(220,000)	(220,000)
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1,238,000	1,038,000	938,000	(300,000)	(100,000)
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	200,000	200,000	350,000	150,000	150,000
09240	Arsimi i Mesëm (profesional)	767,310	567,310	317,310	(450,000)	(250,000)
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	300,000	300,000	320,000	20,000	20,000
09450	Arsimi Universitar	100,000	100,000	200,000	100,000	100,000
08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinise	100,000	100,000	20,000	(80,000)	(80,000)
12	Ministria e Kulturës	0	0	160,000	160,000	160,000
08220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë			65,000	65,000	65,000
08230	Arti dhe Kultura			95,000	95,000	95,000
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	810,000	810,000	1,410,000	600,000	600,000
07330	Shërbimet e Kujdesit Dytësor	552,000	552,000	1,152,000	600,000	600,000
16	Ministria e Brendshme	818,868	618,868	350,290	(468,578)	(268,578)
03140	Policia e Shtetit	818,868	618,868	335,290	(483,578)	(283,578)
17	Ministria e Mbrojtjes	3,300,000	3,900,000	1,900,000	(1,400,000)	(2,000,000)
02120	Forcat e Luftimit	3,000,000	3,500,000	1,200,000	(1,800,000)	(2,300,000)
10910	Emergjencat Civile	300,000	400,000	700,000	400,000	300,000
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	690,000	590,000	490,000	(200,000)	(100,000)
05320	Programe për mbrojtjen e Mjedisit	690,000	390,000	390,000	(300,000)	-
50	Instituti Statistikës	0	0	400,000	400,000	400,000
01320	Veprimtaria Statistikore			400,000	400,000	400,000
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	6,160,000	5,540,000	7,851,924	1,691,924	2,311,924
06210	Programe Zhvillimi	6,160,000	5,540,000	7,851,924	1,691,924	2,311,924
TOTALI		35,160,000	31,112,000	34,502,000	(658,000)	3,390,000

Burimi: Ligji i buxhetit viti 2020, 2021, 2022, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar tabelës më sipër, rezulton se ndryshimet me vlerat më të larta kanë ndodhur në programin 6210 “Programe zhvillimi”, ku në ligjin e buxhetit të vitit 2022 investimet me financim të huaj janë planifikuar në vlerën 7,852 milion lekë, duke u rritur për vlerën 1,692 milion lekë krahasuar me vlerën e planifikuar në vitin 2020, ndërsa në krahasim me vitin 2021 këto investime janë rritur për vlerën 2,312 milion lekë. Për programin 6370 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, investimet me financim të huaj janë planifikuar në vlerën 6,669 milion lekë duke u rritur për vlerën 1,603 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2020 dhe 2,003 milion lekë krahasuar me vlerën e planifikuar për këto investime në ligjin e buxhetit të vitit 2021. Për programin 2120 “Forcat e luftimit”, investimet me financim të huaj janë planifikuar në vlerën 1,200 milion lekë duke u ulur për vlerën 1,800 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2020 dhe 2,300 milion lekë krahasuar me vlerën e planifikuar për këto investime në ligjin e buxhetit të vitit 2021.

Sipas projekt ligjit të buxhetit, ligjit për buxhetin e vitit 2022, Akteve Normative për ndryshimin e tij dhe tabelës fiskale të buxhetit të konsoliduar, planifikimi dhe realizimi i investimeve me financim të huaj për vitin 2022, paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela: Planifikimi dhe realizimi i investimeve me financim të huaj

Në milion lekë

Emërtimi	Fakt 2021	Projekt buxhet	Ligj buxheti	AN 3	AN 12	AN 17	AN 19	Fakt 2022
Financim i Huaj	25,378	34,502	34,502	29,902	33,902	24,082	22,082	18,676

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Në ligjin e buxhetit, investimet me financim të huaj janë planifikuar në vlerën 34,502 milion lekë. Me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, shpenzimet për investimet e huaja janë

planifikuar në vlerën 29,902 milion lekë, duke u ulur për vlerën 4,600 milion lekë krahasuar me planifikimin fillestar. Me Aktin Normativ nr. 12, datë 29.07.2022 shpenzimet për investime të huaja janë planifikuar në vlerën 33,902 milion lekë duke u rritur për vlerën 4,000 milion lekë. Me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 janë planifikuar në vlerën 24,082 milion lekë duke u ulur për vlerën 9,820 milion lekë, ndërsa me Aktin Normativ nr. 19, datë 29.12.2022, shpenzimet kapitale me investim të huaj janë planifikuar në vlerën 22,082 milion lekë, duke u ulur më tej për vlerën 2,000 milion lekë. Rezulton se shpenzimet kapitale me financim të huaj janë realizuar në vlerën 18,676 milion lekë ose në masën 84.6% krahasuar me planin përfundimtar (Aktin Normativ nr. 19, datë 29.12.2022), me mos realizimi në vlerën 3,406 milion lekë. Shpenzimet kapitale me financim të huaj, në krahasim me planin fillestar janë realizuar në masën 54.1%, ose me mos realizimi në vlerën 15,826 milion lekë. Kundrejt vitit 2021, shpenzimet kapitale me financim të huaj janë realizuar më pak për vlerën 6,702 milion lekë ose janë realizuar më pak në masën 26%. Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin e një planifikimi të dobët të shpenzimeve kapitale me burim të huaj financimi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Tabela: Trendi i realizimit të shpenzimeve kapitale me financim të huaj
lekë

Në milion

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Kapitale Financim i Jashtëm	28,776	26,785	24,926	20,334	22,278	26,210	23,462	24,722	25,378	18,676
Dif. nga viti i mëparshëm	-5,481	-1,991	-1,859	-4,592	1,944	3,922	-2,748	1,260	656	-6,702

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit



Tabela në vijim paraqet ecurinë e investimeve me financim të huaj përgjatë vitit buxhetor 2022 sipas Tabelës së Treguesve Fiskal të Konsoliduar.

Tabela: Realizimi i investime të huaja, për njësit e qeverisjes qendrore

Në milion

Viti	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2022	703	1,395	4,043	5,090	6,989	8,180	9,502	10,342	11,622	13,013	14,348	18,676

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në vitin 2022, shpenzimet kapitale me burim të huaj financimi janë realizuar në vlerën 18,676 milion lekë ose 85% e planit të ndryshuar, me një mosrealizim prej 3,406 milion lekë. Krahasuar me vitin 2021 janë shpenzuar më pak për investimet e huaja 6,702 milion lekë, duke theksuar se është realizimi më i ulët i dhjetë viteve të fundit. **Kjo tregon për një mungesë monitorimi sistematik dhe aktiv të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të institucioneve publike përfituese të këtyre financimeve, si dhe mungesën e një analize më të thellë për zbatimin e projekteve, për të përcaktuar se ku dhe nëse mund të bëhen përmirësime, veçanërisht në lidhje me zbatimin e tyre.**

Disbursimet

Referuar bazës së dhënave të investimeve me financim të huaja, në fund të vitit 2022, disbursimet janë regjistruar në vlerën 18,690 milion lekë. Disbursimet për investimet me financim të huaj në formë granti, janë regjistruar në vlerën 7,549 milion lekë, nga të cilat disbursimet për investimet e huaja të njëjësive të qeverisjes vendore janë regjistruar në vlerën 868 milion lekë. Disbursimet për investimet me financim të huaj në formë kredie, janë regjistruar në vlerën 11,141 milion lekë.

Për sa i përket saktësisë së regjistrimit të disbursimeve, nga auditimi janë konstatuar 29 projekte të investimit me financimit të huaj, disbursimet e të cilëve janë regjistruar në vlerë negative.

Tabela: Projekte investimi, disbursimi i të cilëve është regjistruar me vlerë negative (mijë lekë)

Nr.	Kodi	Emërtimi i Projektit	Disbursime
1	18BO601	Projekti CoCo Tour	(28,470.81)
2	18CF313	Creatures DRTK Vlorë	(807.03)
3	GM10112	Programi Fiscalis 2020	(1,895.25)
4	18BS313	FORWORK FOSTERING OPPORTIUNITIES Euro	(774.82)
5	18CD237	Interba UT	(25,873.24)
6	18BD865	REACH Univ. Arteve	(12,451.17)
7	GM11055	DIYPES Universiteti i Sporteve	(543.42)
8	GM11074	ERASMUS+ Drejt ngritjes së ndërgjegj. përgjegjësisë dhe cilësisë së përbashkët Univ. Elbasan ALL Task	(2,522.40)
9	GM11050	PROJEKTI BESTSDI ERASMUS+ UPT politeknik	(2,314.34)
10	GM11060	Erasmus+ DIMTV Univeristet i Durrësit llog lehtë	(2,617.15)
11	18BD829	Erasmus+ Vtech	(4,060.00)
12	18CH401	DUE MARI	(4,061.77)
13	GM06116	Location	(1,576.20)
14	GM10102	Doganat 2020	(2,768.63)
15	GM15015	Asistencë Teknike për zbatimin e Programit Kosovë - Shqipëri 2014	(1,364.20)
16	18BI015	Regional Energy Efficiency (REEHUB)	(655.74)
17	18CI001	WetMainAreas	(1,296.01)
18	18AX306	EEN-Albania	(1,374.47)
19	G107004	PoWER Bashkia Durrës	(682.72)
20	G115004	Green Point Mob Bashkia Gjirokastrë	(700.28)
21	G115005	HERBINO B Gjirokastrë	(1,389.46)
22	G452002	Led B Dropull	(905.77)
23	G120003	GREEN-POINT B.Kolonjë	(2,824.99)
24	G120001	4 Plus B. Kolonjë	(488.50)
25	G125002	New opportunities in Kukës NOK	(5,721.82)
26	G128003	NO DRUGS, FOOD HUB	(2,285.28)
27	18BS308	NEST	(4,071.64)
28	18BS310	OIS AIR	(2,699.60)
29	KM06130	Projekti për Rimëkëmbjen e Energjisë, Komponenti 4	(3,370.84)
Totali			(120,567.56)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Vlera totale negative e raportuar për 29 projekte investimi me financim të huaj është 120,568 mijë lekë, nga të cilat 28 projekte në vlerë 117,197 mijë lekë i përkasin investimeve të huaja në formë granti dhe 1 projekt në vlerën 3,371 mijë lekë i përket investimeve të huaja në formë kredie. Sipas pikës 2.13, të Udhëzimit të MFE nr. 35, datë 21.09.2020, disbursimet janë hyrjet/ të ardhura në para ose në natyrë nga kreditorët apo donatorët në favor të Njësisë së Zbatimit të Projektit sipas marrëveshjes së miratuar, të nënshkruar midis palëve. Regjistrimi i disbursimeve në vlerë negative nuk ka logjike ekonomike, deri sa kemi të bëjmë me të ardhura. Regjistrimi i disbursimeve të mësipërme, nuk është në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 35, datë 21.09.2020, pika 6.3, ku citohet se: “Disbursimet nga huatë dhe kreditë e financimeve të huaja regjistrohen si të hyra të Buxhetit të Shtetit, ndërsa disbursimet nga ndihmat dhe grantet regjistrohen si të ardhura”. Regjistrimi i disbursimeve me vlerë negative, ul vlerën totale të disbursimeve të ardhura gjatë vitit 2022.

Nga auditimi me përzgjedhje i projekteve të investimit më financim të huaj, u konstatuan problematikat si në vijim:

1. Nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj në formë kredie, u konstatua se 8 projekte, në vlerën 1,953,180 mijë lekë janë realizuar pa pasur plan buxhetor të miratuar me ligjin e buxhetit, akte normative apo rishikime buxhetore.

Tabela: Projekte investimesh të huaj me kredi, të realizuara pa plan buxheti

Në lekë

Min	Programi	Llogaria	Kodi	Përshkrimi i projektit	Plan	Fakt
06	04520	230	KM06141	Linja anazore 110 Kv e Shqipërisë së Jugut (donator 09/10 KFE)	-	120,776,124
06	04520	230	KM06148	Linja anazore 110 Kv e Shqipërisë së Jugut 09/12 KFW OST	-	36,075,977
13	07220	231	KM13001	Rikonstrukcion dhe pajisje 5 poliklinikave	-	11,372,590
06	04320	231	KM06145	Fuqia energjitike dhe Siguria e Digës në Kaskaën e Drinit	-	59,803,611
06	04320	231	KM93013	Fuqia Energjitike dhe Siguria e Digës në Kaskaën e Drinit	-	350,288,720
06	06220	231	KM06149	Menaxhimi i mbetjeve të ngurta Vlorë	-	202,864,110
06	06370	231	KM06091	Menaxhimi mbetjeve Urbane të Tiranës (faza II) impianti i pastrimit të ujërave të ndotura	-	119,577,905
56	06210	230	KM56209	Projekti i Rehabilitimit të lumit të Vlorës (Kuvajt)	-	1,052,420,698
TOTALI					-	1,953,179,735

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

2. Nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj (**kredi**), u konstatua se, **8 projekte** në vlerën **985,615 mijë lekë**, janë realizuar në tejkallim të planit të buxhetit të miratuar, fakt i cili tregon për një monitorim formal nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Tabela: Projekte investimesh të huaj me kredi, të realizuara në tejkallim të planit buxhetor

Në lekë

Min	Programi	Kodi	Përshkrimi i projektit	Plan	Fakt	Diferenca
06	04520	20AC001	Studim fizibiliteti dhe përgatitja e projektit të detajuar për sigurinë e urave	42,034,965	49,779,720	(7,744,755)
06	04520	KM06111	Ndërtim segmenti rrugor Qukës - Qafë Pllaçë Loti 1	372,527,223	663,330,490	(290,803,267)
06	04520	KM06112	Ndërtim segmenti rrugor Qukës - Qafë Pllaçë Loti 1	4,000,000	577,853,010	(573,853,010)
10	04130	KM10012	Linja e kredisë për asistencën e integruar për zhvillimin e SME-ve Shqiptare	20,000,000	23,067,180	(3,067,180)
10	09240	18BS303	Mbështetje të arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit	73,200,000	80,492,350	(7,292,350)
13	10430	18BC201	Modernizimi i Asistencës Sociale nga BB	20,000,000	21,012,667	(1,012,667)
13	07330	KM13017	Faza e Dytë e Zbatimit të Master-Planit të QSUT- kredi e CEB-it (përfundimi i dy kateve të sp. të ri të ndërtuar dhe rikonstruksioni i 6-katshit) vazhdim i Master Planit	400,000,000	430,948,713	(30,948,713)
13	07330	KM13021	Përmirësimi i sistemit të shëndetësive	514,000,000	584,892,832	(70,892,832)
TOTALI				1,445,762,188	2,431,376,962	985,614,774

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

3. Nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj (**grant**), u konstatua se, **18 projekte** në vlerën **247,278 mijë lekë** janë realizuar pa pasur plan buxhetor të miratuar me ligjin e buxhetit, akte normative apo rishikime buxhetore.

Tabela: Projekte investimesh të huaj me grant realizuara pa plan buxheti

Në lekë

Min	Programi	Llogaria	Kodi	Përshkrimi i projektit	Plan	Fakt
05	04250	231	18AL304	Projekti Food 4 HEALTH	-	23,966,420
05	04860	231	G037017	Projekti Olive Culture	-	314,880
06	04320	230	19AC201	Projekti REHUB + Efikasiteti Rajonal i Energjisë	-	4,159,540
06	04520	230	19AC805	Projektet EcoPortil	-	680,790
06	04550	230	18BM202	Promovimi i Intermodalitetit dhe Rilidhja Hekurudhore në Rajonin Adriatik-Jon	-	920,680
06	04550	230	18BM301	Studim i Përfishibilitetit për lidhjen hekurudhore Pogradec - Greqi [KR.lopigy]	-	4,574,310
15	01150	231	GM15014	Asistencë Teknike për zbatimin e Programit Shqipëri-Itali-Mal i Zi 2012	-	8,291,780
10	01140	230	GM10112	Programi Fiscalis	-	127,370
11	09450	230	18CA726	Programi i bashkëpunimit interreg-balkan-mediterrean 2014-2020	-	136,180
06	04320	231	18BI014	Projekti GATE	-	3,724,230
06	04320	231	GM06095	Rehabilitimi i Qytetit Studenti No.2	-	21,113,490
11	09450	230	GM11062	Erasmus+ ITG4AU Projekt Universiteti Durrës	-	1,295,500
11	09450	230	GM11081	Drejt ndërgjegjësimit përgjegjësive dhe cilësisë së përbashkët në punën sociale, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	-	156,870
12	08220	231	48CF303	Projekt IPA "Polyphonia MK"	-	359,250
13	07220	230	GM13021	Investime në qendrat shëndetësore të qarqeve Fier dhe Dibër nga Cooperazioni Zviceran	-	157,080,770
13	07330	230	G037018	Projekti Pharem	-	1,276,220
15	01150	230	18BP504	Projekte Grant – IPA	-	118,900
15	01150	230	18BV301	Asistencë Teknike për programet Europiane	-	18,978,360
TOTALI					-	247,25,540

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

4. Nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj (grant), u konstatua se, 45 projekte në vlerën 519,754 mijë lekë, janë realizuar në tejkallim të planit të buxhetit të miratuar, trajtuar në Aneksin "Projekte investimesh të huaj me grant, të realizuara në tejkallim të planit buxhetor".

Sa më sipër realizimi i projekteve pa plan buxhetor apo në tejkallim të planit buxhetor është tregues i një planifikimi të dobët i cili mund të sjellë si pasojë ndryshimin e prioriteteve qeveritare si dhe kalim të tavanit përkatës buxhetor.

Realizimi i projekteve të investimeve me financim të huaj pa plan apo në tejkallim të planit buxhetor të miratuar është në kundërshtim me pikën 29 të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022" ku citohet se: "Plani i miratuar në ligjin e buxhetit për financimet e huaja, është kufiri i cili duhet të respektohet gjatë procesit të kryerjes së shpenzimeve, si për projektet me skemë të plotë thesari ashtu edhe për projektet me skemë të pjesshme thesari (jashtë TSA-së, në bankat e nivelit të dytë). Në rast të tejkallimit të planit të shpenzimeve njësitë e qeverisjes qendrore do të marrin masa për sistemimin e tyre nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit dhe gjatë procesit të rishikimit të buxhetit".

5. Nga auditimi konstatohet se 95 projekte investimesh me financim të huaj në vlerën totale 3,272,501 mijë lekë, referuar përshkrimit të projektit dhe produkteve të pritshme prej projekteve janë keq klasifikuar kryesisht në llogarinë 231 "Investime për rritjen e aktiveve afatgjata materiale". Tabela në vijim paraqet 5 projektet me vlerat më larta.

Tabela: Projekte investimesh të keq klasifikuar në llogarinë 231

Në lekë

Min	Programi	Llog.	Kodi i projektit	Përshkrimi i projektit	Realizim 31.12.2022
5	4250	231	18AL303	Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 3 (7)	1,739,104,990
5	4250	231	18CF201	GIZ Mbështetje për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Zonave Rurale në Shqipëri - SDRA (GRAND)	586,462,190
26	5320	231	GM26071	Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit	182,352,760
13	7330	231	GM13009	Fuqizimi i përgjigjes kombëtare ndaj HIV/AIDS (Global Fund)	115,147,035
50	1320	231	GM50002	Projekti i Regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë e banesave	92,942,789

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit

Sipas udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar aktive të qëndrueshme të trupëzuara janë aktivet materiale që përdoren nga njësia ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për t'ua dhënë me qira palëve të treta; ose përdoren për qëllime administrative, ose mbahen për rritje të çmimit dhe priten të përdoren në më shumë se një periudhë kontabël. Në tabelën e mësipërme identifikohen 2 grupe kryesore keq klasifikimesh:

- projekte shërbimi, studimi, asistencë, konsultimi, monitorimi si dhe shpenzime operative të cilat janë klasifikuar si investime për rritjen e aktiveve afatgjata material, ndërkohë që duhet të ishin klasifikuar në llogarinë 230 "investime afatgjata jo material".
- projekte si "IPARD" të cilët janë klasifikuar si investime për rritjen e aktiveve afatgjata materiale, por për këtë projekte janë angazhuar fonde të planifikuara si investime, për kryerjen e transfertave ndaj të tretëve, pra nuk janë kryer shpenzime për të krijuar një aset të prekshëm ose të paprekshëm dhe rrjedhimisht nuk plotësohen kushtet për njohjen e një aktivi në pasqyrën e pozicionit financiar.

Titulli i gjetjes:	Nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj janë konstatuar projekte të realizuar pa pasur plan buxheti, projekte të realizuar në tejkalim të planit të buxhetit si dhe keq klasifikime projektsh kryesisht në llogarinë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale".
Situata:	Për vitin 2022, nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj është konstatuar se, 8 projekte investimi, me kredi, në vlerën 1,953,180 mijë lekë dhe 18 projekte investimi me grant, në vlerën 247,278 mijë lekë janë realizuar pa pasur plan buxhetor të miratuar me ligjin e buxhetit, akte normative apo rishikime buxhetore. Ndërsa 8 projekte investimi me financim të huaja në formën e kredisë, në vlerën 985,615 mijë lekë dhe 45 projekte investimi me financim të huaj në formën e grantit, në vlerën 519,754 mijë lekë janë realizuar në tejkalim të planit të buxhetit të miratuar. Realizimi i projekteve të investimeve me financim të huaj pa plan apo në tejkalim të planit buxhetor të miratuar është në kundërshtim me pikën 29 të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022". Konstatohet se, 95 projekte investimesh me financim të huaj në vlerën totale 3,272,501 mijë lekë, referuar përshkrimit të projektit janë keq klasifikuar kryesisht në llogarinë 231 "Investime për rritjen e aktiveve afatgjata materiale", duke qenë për nga natyra shpenzimeve operative, aktive afatgjata jo materiale si dhe transfertave ndaj të tretëve. Gjithashtu, nga auditimi, janë konstatuar 29 projekte investimi me financim të huaj, në vlerën totale 120,568 mijë lekë, disbursimet e të cilëve janë regjistruar në vlerë negative, nga të cilat 28 projekte në vlerë 117,197 mijë lekë i përkasin investimeve të huaja në formë granti, ndërsa 1 projekt në vlerën 3,371 mijë lekë i përket investimit të huaj në formë kredie.
Kriteri:	Udhëzimi plotësues i MFE-së nr. 1, datë 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022", pika 29; Udhëzimi i MFE-së nr. 35, datë 21.09.2020 "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", pika 6.3; Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, përkufizimi i aktive të qëndrueshme të trupëzuara.

Impakti:	Cilësi e ulët e menaxhimit të fondeve publike.
Shkaku:	Mosrespektimi i legjislacionit dhe mosfunksionimi i hallkave të kontrollit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për fuqizimin e kontrollit të brendshëm në drejtim të raportimit të saktë dhe të plotë të investimeve publike me financim të huaj, nëpërmjet përfshirjes së tyre në ciklin e menaxhimit të shpenzimeve buxhetore për t'u siguruar për përputhshmërinë me planet vjetore dhe tavanet përkatës buxhetore.

Mbi Fondin e Zhvillimit të Rajoneve

Referuar aneksit nr. 3, bashkëlidhur ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit administron nevojat dhe propozimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, qendrore dhe aktorë të tjerë (përfshirë FSHZH dhe njësitë e zhvillimit rajonal të tij) që konsistojnë në projekte në interes dhe në funksion të zhvillimit lokal e rajonal, përfshirë edhe projekte zhvillimore me natyrë ekonomike, të zbatuara në partneritet midis FSHZH dhe njërive të vetëqeverisjes vendore dhe subjekte të tjera. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimin e projekteve të reja miratohen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Sipas projekt buxhetit, ligjit për buxhetin e vitit 2022 dhe akteve normative për ndryshimin e ligjit të buxhetit, planifikimi dhe realizimi i fondeve buxhetore për programin 06220 “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale” paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela: Fondet buxhetore për programin 06220 “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale”

Mijë lekë

Programi	Projekt-Buxhet	Ligj Buxheti	AN 3	AN 12	AN 17	AN 19	Realizim
06220	2,600,000	3,500,000	2,800,000	2,800,000	3,058,300	3,058,300	3,012,138

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Për programin “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale” planifikim fillestar është 3,500,000 mijë lekë. Me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, këtij programi i janë ulur fonde për shumën 700,000 mijë lekë, ndërsa me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 i janë shtuar fonde në shumën 258,300 mijë lekë, duke reflektuar një plan përfundimtar në shumën 3,058,300 mijë lekë. Për vitin 2022, vlera e realizimit të programit infrastruktura vendore dhe rajonale është në shumën 3,012,138 mijë lekë, nga të cilat 34,297 mijë lekë për detyrime të prapambetura.

Gjatë vitit 2022, në programin e Infrastruktura Vendore dhe Rajonale janë detajuar dhe realizuar 2 projekte investimi me burimi financimi ish Fondin e Zhvillimit të Rajoneve.

- Projekti me kod M560391 “Rehabilitimi i bregut të liqenit të Ohrit dhe gjelbërimit përgjatë rrugës, segmenti Lin - Pogradec”, në muajin Gusht është çelur si projekt, në vlerën 559 mijë lekë. Rezulton se me këtë fond është paguar fatura, me datë furnitori 13.12.2021, në vlerën 531.38 mijë lekë.

- Projekti me kod 22AD901 “Rikonstruksioni i rrugës Nacionale - Qendër Manskur” është çelur në Nëntor, në vlerën 13,709 mijë lekë. Rezulton se me këtë fond është paguar fatura me datë furnitori 31.05.2014, në vlerën 13,709 mijë lekë.

Nga auditimi konstatohet se financimi i detyrimeve të fondit të zhvillimit të rajoneve nuk është kryer sipas pikës 4 të Aneksit nr. 3 të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, ku citohet se: “Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastruktura Vendore dhe Rajonale”.

Fondi i Rindërtimit

Në nenin 7, të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” është cituar se: “Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 20,000 milionë lekësh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pa financuara të viteve të mëparshme dhe pjesa e mbetur për projekte të reja. Ky fond shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar...”

Fondet e rindërtimit përdoren për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, pra për projekte specifike të cilat kanë kusht rindërtimin e objekteve të cilët kanë pësuar dëmtime nga tërmeti. Sa më sipër, shtimi i kufijve të transfertës së pakushtëzuar, për projektet e rindërtimit është jo në përputhje me nenin 3, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku citohet se transferta e pakushtëzuar është një transfertë e dhëna nga buxheti i shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore, pa kusht, pa interes dhe pa të drejtë kthimi.

Mbi planifikimin dhe shpërndarjen e Fondit të Rindërtimit

Planifikimi i Fondit të Rindërtimit sipas projekt ligjit të buxhetit, ligjit të buxhetit dhe ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit me Akte Normative si dhe realizimi i tij sipas tabelës së treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar, paraqitet si në tabelën në vijim.

Tabela: Planifikimi i dhe realizimi i Fondit të Rindërtimit

Në milion lekë

Emërtimi	Fakt 2021	Projekt Buxhet	Ligj buxheti	AN 3	AN 12	AN 17	AN 19	Fakt 2022
Fondi i Rindërtimit	29,521	20,000	20,000	20,000	20,000	32,400	32,400	28,874

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Fondi i rindërtimit me ligjin fillestar të buxhetit është planifikuar në shumën 20,000 milion lekë, ndërsa me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022, ky fond është planifikuar në shumën 32,400 milion lekë, duke u rritur për vlerën 12,400 milion lekë. Sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi, rezulton se fondi i rindërtimit është realizuar në shumën 28,874 milion lekë, nga të cilat, shpenzimet për qeverisjen qendrore janë realizuar në shumën 7,969 milion lekë për shpenzime kapitale, ndërsa shpenzimet e qeverisjes vendore janë realizuar në shumën 20,905 milion lekë (16,137 milion lekë për shpenzime kapitale dhe 4,768 milion lekë për shpenzime operative dhe transfertat te të tretët). Në krahasim me vitin e mëparshëm, realizimi i shpenzimeve për fondin e rindërtimit është ulur për shumën 647 milion lekë.

Konstatohet se në vlerën e raportuar te tabela e treguesve fiskalë janë përfshirë edhe shpenzimet për rindërtimin që janë realizuar nga të ardhurat e veta të institucioneve, në vlerën 415.9 milion lekë, nga të cilat 414.9 milion lekë nga të ardhurat e veta të njërive të qeverisjes vendore dhe 1 milion lekë nga të ardhurat e veta të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Rezulton se për projektet e rindërtimit është përdorur i njëjti kod projekti për disa investime të ndryshme, duke mos identifikuar specifikisht investimet e kryera për çdo projekt. Kjo sjellë vështirësi në ndjekjen, monitorimin dhe auditimin e ecurisë të secilit prej tyre.

Mënyra e përdorimit të fondit të rindërtimit, programet buxhetore ku do alokohen fondet si dhe institucionet dhe agjencitë zbatuese të tij, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Referuar VKM-vë të dala për rindërtimin, gjatë periudhës 2020-2022 janë miratuar rreth 119,833 milion lekë projekte rindërtimi për qeverisjen qendrore dhe vendore, nga të cilat

financimi me VKM për vitin 2020 ka qenë rreth 25,795 milion lekë, për vitin 2021 rreth 28,770 milion lekë dhe për vitin 2022 rreth 22,027 milion lekë, ndërsa realizimi për vitin 2020 ka qenë rreth 16,702 milion lekë, për vitin 2021 rreth 29,521 milion lekë dhe për vitin 2022 rreth 28,874 milion lekë.

Tabela: Vlera e projekteve të rindërtimit dhe realizimi deri në fund të vitit 2022

milion lekë

Rindërtimi	Vlera e kostos së projektit	Fakt 2020	Fakt 2020 (kap. 6)	Fakt 2021	Fakt 2021 (kap. 6)	Fakt 2022	Fakt 2022 (kap. 6)	Për t'u realizuar në vitet në vijim
Qendrori	34,298	7,255	-	11,401	-	7,969	-	7,673
Vendori	85,535	8,385	1,062	17,126	994	20,490	415	37,063
Totali	119,833	15,640	1,062	28,527	994	28,459	415	44,736

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit

Bazuar në të dhënat e mësipërme, në qoftë se vlera totale e kostos projekteve nuk ndryshon me VKM gjatë periudhave në vijim, me qëllim përfundimin e procesit të rindërtimit, financimi i pritshëm për periudhat e ardhshme (viti 2023 e në vijim) është rreth 44,736 milion lekë. Konstatohet se në ligjin nr. 85/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, fondet për rindërtimin janë planifikuar në shumën 5,000 milion lekë, ndërsa në tabelën 4 “Treguesit Fiskal të konsoliduar”, bashkëlidhur po këtij ligji, vlera e planifikuar për fondin e rindërtimit për vitet 2024 dhe 2025 është 0 lekë. Rezulton se kosto totale e projekteve nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së planifikuar më ligjin e buxhetin për fondet e rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani vijon të paraqitet në shumën 0 lekë për vitet 2024 dhe 2025.

Sa më sipër konstatohet mungesë bashkërendimi i kostove totale të projekteve me planifikimin e vlerave përkatëse në ligjin e buxhetin për vitet pasardhëse buxhetore.

Mbi ngurtësimin e fondeve të rindërtimit

Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2022, në 18 prej VKM të dala për përdorimin e fondit të rindërtimit, konkretisht: (VKM nr. 164, datë 18.03.2022; VKM nr. 239, datë 20.04.2022; VKM nr.255, datë 29.04.2022; VKM nr. 291, datë 11.05.2022; VKM nr.391, datë 9.06.2022; VKM nr.392, datë 09.06.2022; VKM nr. 412, datë 15.06.2022; VKM nr. 445, datë 29.06.2022; VKM nr. 446, datë 29.06.2022; VKM nr. 428, datë 22.06.2022; VKM nr. 489, datë 27.07.2022; VKM nr. 493, datë 21.07.2022; VKM nr.491, datë 21.07.2022; VKM nr. 499, datë 27.07.2022; VKM nr.500, datë 27.07.2022; VKM nr. 501, datë 27.07.2022; VKM nr.502, datë 27.07.2022; VKM nr.512, datë 27.07.2022), për financimin e projekteve të përcaktuara në këto VKM, është përcaktuar si burimi financimi, edhe ngurtësimi i fondeve nga projekte të tjera të rindërtimit me ecuri të ngadaltë. Shprehimisht në VKM-të e mësipërme citohet se: “Efekti financiar të përballohet nga hapësira e siguruara pas ngurtësimit të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe i transferohet bashkisë... në formën e transfertës së pakushtëzuara”. Në VKM e mësipërme nuk përcaktohet se cilët janë projektet me ecuri të ngadaltë që do t’u ngurtësohen fondet si dhe vlerën e ngurtësimit për çdo projekt. Për vitin 2022, shuma e ngurtësuar për projektet me ecuri të ngadaltë dhe përdorim si burimi financimi për projektet e tjera, është 2,763 milion lekë. Përdorimi i ngurtësimit të fondeve, si formë financimi për projektet e investimit nuk është e mbështetur në bazë ligjore, pasi në ligjin organik të buxhetit dhe ligjin e buxhetit të vitit nuk parashikohet ngurtësimi, si mënyrë për alokimin e fondeve ndërmjet projekteve të investimit.

Mbi shpenzimet e strehimit

Familjet, shtëpitë e të cilave janë dëmtuar nga tërmeti, janë akomoduar në apartamente me qira të subvencionuar nga shteti. Në fillim të vitit për produktin me kod 91010AE “Subvencionim i qirasë për familjet e prekura”, janë çelur fonde në vlerën 1,000 milion lekë,

më pas me rishikimet buxhetore të ndodhura gjatë vitit, vlera e planifikuar për këtë produkt është 2,282 milion lekë. Në tabelën në vijim paraqiten shpenzimet për subvencionimin e strehimit për familjet e prekura nga tërmeti sipas bashkive, për çdo muaj gjatë vitit 2022.

Tabela: Subvencione qiraje

milion lekë

Bashkia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Durrës		82.77	80.077	87.073	80.162	0.35	8.565	76.002	151.635	62.778	124.68	122.527
Kamëz		8.99	12.693	8.65	8.782	8.277	0.018	13.976	5.634	2.793	2.879	5.367
Kavajë		2.59	3.747	0.441	5.078	2.338	0.457	4.22	2.065		4.156	4.072
Krujë		19.31	38.095		18.335	18.275		21.14	34.67	34.7		38.24
Kurbin	25.57		42.564	17.025	10.655	0.27	16.837	33.479	16.68	16.86	16.509	16.282
Lezhë		6.14	5.191	5.191	5.191	5.19		10.267	5.044	4.98	4.98	9.960
Mirditë			2.852	5.07		3.396	2.281	6.868	0.623	5.185		5.937
Rrogozhinë			6.966		2.622			8.042	9.522	0.174	6.783	5.518
Shijak		9.61	9.882	14.129		16.659	1.033	13.406	0.618	8.574	6.933	23.479
Tiranë	49.36		98.518	48.998	3.078				45.499	43.941		89.555
Vorë		16.41	16.615	16.445	16.07	16.035		32.09	15.455	14.745	14.18	14.2
TOTAL	74.39	145.82	317.2	203.022	149.973	70.79	29.191	219.491	287.445	194.73	181.055	335.137

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Sipas bazës së të dhënave për pagesat të kryera nga sistemi i thesari, rezultojnë se gjatë vitit 2022, janë subvencionuar 2,208 milion lekë. Konstatohet se shpenzimet e kryera për subvencionet e qirave kanë luhatur të konsiderueshme në vlera sipas muajve, ku në muajin Dhjetor janë kryer 335.1 milion lekë subvencione, ndërsa në muajin Korrik janë kryer 29.2 milion lekë subvencione. Në muajin Janar, vetëm 2 bashki kanë kryer pagesa për subvencionime, konkretisht bashkia Tiranë dhe bashkia Kurbin. Gjithashtu konstatohet se bashkitë nuk kanë kryer çdo muaj subvencionime për qiratë, p.sh. Bashkia Tiranë nuk ka kryer pagesa për qiratë, në muajin Shkurt, Qershor, Korrik, Gusht, Nëntor; Bashkia Mirditë nuk ka kryer pagesa për muajin Janar, Shkurt, Maj, Nëntor; Bashkia Rrogozhinë nuk ka kryer pagesa për muajin Janar, Shkurt, Prill, Qershor, Korrik; etj.

Në krahasim me vitin 2021, shpenzimet për subvencionimin e qirave janë ulur për vlerën 776 milion lekë. Pavarësisht se shpenzimet operative janë ulur në krahasim me vitin e mëparshëm, për shkak të ecurisë së ngadaltë në zbatimin e punimeve dhe tejkalimit të afatit të përmblylljes së procesit të rindërtimit, kostot totale e rindërtimit rëndohet më tepër nga pagesat për subvencionimin e qirave të familjeve të cilat banesat i kanë në proces rikonstruksioni.

Sa trajtuar më sipër, Drejtoria e Financave Vendore ka paraqitur observacionin me nr. 5854/50, datë 07.09.2023, protokolluar në KLSH me nr. 281/25, datë 11.09.2023 ku pretendohet se:

Qëndrimi i subjektit: Mbi ngurtësimin e fondeve, në bashki të ndryshme gjatë vitit 2022, ka pasur projekte të rindërtimit me ecuri të ngadaltë në realizimi e punimeve dhe si rrjedhojë fondet e akorduara nga buxheti i fondit të rindërtimit nuk janë përdorur. Ndërkohë, për shkak të emergjencës dhe rëndësisë në përfundimin e projekteve të rindërtimit, ka pasur bashki të tjera me ecuri shumë të mirë të realizimit të projekteve të cilët kanë kërkuar financimi për vitin 2022. Si rrjedhojë, për të mos penguar realizimin e tyre për vetë specifikën që pasur dhe ndikimin në komunitet është realizuar financimi i këtyre projekteve me burim financimin fondet e ngurtësuara, nga fondet me ecuri të ngadaltë, përse kohë këto fonde nuk do të përdoren deri në fund të vitit buxhetor. Ngurtësimi është parë si mundësi financimi duke u nisur nga fakti se forma e financimit është transferata e pakushtëzuar dhe fondi i papërdorur trashëgohet në vitin e ardhshëm buxhetor. Nisur nga specifikat që ka transferata e pakushtëzuar në formën e akordimit dhe përdorimit nuk ka asnjë pengesë ligjore që fondet e papërdorura të rindërtimit nga bashkitë me miratim të KM të ngurtësohen dhe të përdoren për projekte të tjera, brena planit buxhetor të miratuar. Ngurtësimi i projekteve është mbështetur në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, pra nuk është i saktë konstatimi i grupit të auditimit që nuk ka një bazë ligjore ku të mbështetet. MFE me synim menaxhimin e fondit të rindërtimit brenda kuadrit makroekonomi-fiskal, përdori mekanizimin e ngurtësimit. Fondi i rindërtimit është një fond special buxhetor i cili pjesën e pa përdoruar e trashëgon. Kjo sjell si pasojë që buxheti i vit të ardhshëm të jetë: fondi i miratuar me ligjin e buxhetit + fondet e trashëguara, që në fund të vitit mund të rezultojnë me një tejkalim të tavanit të vendosur me ligj dhe si pasojë të deficitit buxhetor. Për këtë qëllim, mekanizimi i ngurtësimit lejon miratimin e fondeve të

reja (në ligjin vjetor të buxhetit) si edhe atyre të trashëguara, por gjithmonë brenda tavanit total të miratuar, në ligjin vjetor të buxhetit. Kjo realizohet duke ngurtësuar fondet me ecuri të ngadaltë, me qëllim që të rritet siguria e respektimit të taveve buxhetore.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Pas shqyrtimit të observacionit grupi i auditimit i qëndron konstatimit se përdorimi i ngurtësimit të fondeve, si formë financimi për projektet e investimit nuk është e mbështetur në bazë ligjore, pasi në ligjin organik të buxhetit dhe ligjin e buxhetit të vitit nuk parashikohet ngurtësimi, si mënyrë për alokimin e fondeve ndërmjet projekteve të investimit. Gjithashtu i qëndrojmë konstatimit se kosto totale e projekteve nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së planifikuar me ligjin e buxhetin për fondet e rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani vijon të paraqitet në shumën 0 lekë, duke sjellë mungesë bashkërendimi të kostove totale të projekteve me planifikimin e vlerave përkatëse në ligjin e buxhetin për vitet pasardhëse buxhetore.

Për problematikat e mësipërme të përshkruara në lidhje me investimet kapitale mbajnë përgjegjësi strukturat NA dhe NZ të njësive të qeverisjes së përgjithshme sipas trajtimit për çdo institucion, ish Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. A. Gj., Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit zj. M.Dh., Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike, z. E.Ll. dhe Përgjegjësi i Sektorit të Vlerësimit të Projekteve z. E.Sh.

Titulli i gjetjes:	Referuar VKM-vë të dala deri në fund të vitit 2022 për rindërtimin, rezulton se fondet e shpërndara janë mbi vlerën e përcaktuara në ligjin e buxhetit për këtë fond.
Situata:	<p>Fondi i rindërtimit me ligjin fillestar të buxhetit është planifikuar në shumën 20,000 milion lekë, ndërsa me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022, ky fond është planifikuar në shumën 32,400 milion lekë, duke u rritur për vlerën 12,400 milion lekë. Sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi, rezulton se fondi i rindërtimit është realizuar në shumën 28,874 milion lekë, nga të cilat, shpenzimet për qeverisjen qendrore janë realizuar në shumën 7,969 milion lekë për shpenzime kapitale, ndërsa shpenzimet e qeverisjes vendore janë realizuar në shumën 20,905 milion lekë.</p> <p>Referuar VKM-vë të dala për rindërtimin, gjatë periudhës 2020-2022 janë miratuar rreth 119,833 milion lekë projekte rindërtimi për qeverisjen qendrore dhe vendore, nga të cilat financimi me VKM për vitin 2020 ka qenë rreth 25,795 milion lekë, për vitin 2021 rreth 28,770 milion lekë dhe për vitin 2022 rreth 22,027 milion lekë, ndërsa realizimi për vitin 2020 ka qenë rreth 16,702 milion lekë, për vitin 2021 rreth 29,521 milion lekë dhe për vitin 2022 rreth 28,874 milion lekë. Bazuar në të dhënat e mësipërme, në qoftë se vlera totale e kostos së projekteve nuk ndryshon me VKM gjatë periudhave në vijim, me qëllim përfundimin e procesit të rindërtimit, financimi i pritshëm për periudhat e ardhshme (viti 2023 e në vijim) është rreth 44,736 milion lekë. Konstatohet se, në ligjin nr. 85/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, fondet për rindërtimin janë planifikuar në shumën 5,000 milion lekë, ndërsa në tabelën 4 “Treguesit Fiskal të konsoliduar”, bashkëlidhur po këtij ligji, vlera e planifikuar për fondin e rindërtimit për vitet 2024 dhe 2025 është 0 lekë. Rezulton se, kosto totale e projekteve nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së planifikuar me ligjin e buxhetit për fondet e rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani vijon të paraqitet në shumën 0 lekë për vitet 2024 dhe 2025.</p> <p>Në lidhje me shpenzimet e strehimit për familjet, shtëpitë e të cilave janë dëmtuar nga tërmeti rezulton se në fillim të vitit për produktin me kod 91010AE “Subvencionim i qirasë për familjet e prekura”, janë çelur fonde në vlerën 1,000 milion lekë. Më pas, me Aktin Normativ nr. 12, datë 29.07.2022, këtij produkti i janë shtuar fonde në vlerën 1,698.06 milion lekë, duke e çuar në total vlerën e planifikuar për këtë produkt 2,698.06 milion lekë. Sipas bazës së të dhënave, rezulton se gjatë vitit 2022, janë subvencionuar 2,208 milion lekë nga fondet e buxhetit të shtetit, pra shpenzimet e kryera për subvencionet e qirave kanë</p>

	<p>luhatje të konsiderueshme në vlera sipas muajve, ku në muajin Dhjetor janë kryer 335.1 milion lekë subvencione, në muajin Korrik janë kryer 29.2 milion lekë subvencione, ndërsa në muajin Janar, vetëm 2 bashki kanë kryer pagesa për subvencionime, bashkia Tiranë dhe bashkia Kurbin.</p> <p>Në krahasim me vitin 2021, shpenzimet për subvencionimin e qirave janë ulur për vlerën 776 milion lekë, megjithatë, për shkak të ecurisë së ngadaltë në zbatimin e punimeve dhe tejkalimit të afatit të përmbylljes së procesit të rindërtimit, kostot totale të rindërtimit rëndohen edhe më tepër nga pagesat për subvencionimin e qirave të familjeve banesat e të cilëve i kanë në proces rikonstruksioni.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar neni 7; Ligji nr. 85/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, tabela nr. 4 “Treguesit Fiskal të konsoliduar”; VKM e miratuara për rindërtimin.</p>
Impakti	<p>Risk për krijimin e detyrimeve të prapambetura, me efekt në rritjen e borxhit publik, si pasojë e mosrespektimit të kufijve të miratuar për shpenzime në vitin buxhetor aktual dhe kufijtë e miratuar për vitet e ardhshme buxhetore. Shpenzimet për pagesën e qirave rëndon më tepër koston totale të rindërtimit.</p>
Shkaku:	<p>Fondet e shpërndara me VKM për rindërtimin janë mbi vlerën e përcaktuar në ligjin e buxhetit për këtë fond. Efekti i VKM-ve nuk është reflektuar në Aktet Normative të dala në vijim si dhe në ligjin e buxhetit të viti pasardhës. Ecuria e ngadaltë e procesit të rindërtimit.</p>
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për reflektimin në vitet pasardhëse buxhetore në tabelën nr. 4 shoqëruese e ligjit vjetor të buxhetit, të efekteve të krijuara nga shpërndarja e fondeve të rindërtimit me VKM dhe në komponentët e treguesve fiskal, me qëllim programimin brenda limiteve buxhetore të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit, shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe financimin në kohën e duhur për të ulur kostot e pagesave për zërin shpenzime qiraje.</p>

Titulli i gjetjes:	<p>Në VKM-të e dala për përdorimin e fondit të rindërtimit, është përcaktuar si burim financimi edhe ngurtësimi i fondeve nga projekte të tjera të rindërtimit, të cilat paraqiten me ecuri të ngadaltë.</p>
Situata:	<p>Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2022, në 18 prej VKM-ve të dala për përdorimin e fondit të rindërtimit, në lidhje me financimin e projekteve të investimit është përcaktuar si burimi financimi, edhe ngurtësimi i fondeve nga projekte të tjera të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, ku shprehimisht citohet se: “Efekti financiar të përballohet nga hapësirat e siguruara pas ngurtësimit të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe i transferohet bashkisë... në formën e transfertës së pakushtëzuar”. Në VKM nuk përcaktohet se cilat janë projektet me ecuri të ngadaltë që do t’u ngurtësohen fondet, si dhe vlera e ngurtësimit për çdo projekt. Për vitin 2022, shumat e ngurtësuar për projektet me ecuri të ngadaltë dhe përdorim si burimi financimi për projektet e tjera është 2,763 milion lekë. Përdorimi i ngurtësimit të fondeve, si formë financimi për projektet e investimit nuk është e mbështetur në bazë ligjore, pasi në ligjin organik të buxhetit dhe ligjin e buxhetit të vitit nuk parashikohet ngurtësimi, si mënyrë për alokimin e fondeve ndërmjet projekteve të investimit.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar neni 7; VKM nr. 164, datë 18.03.2022; VKM nr. 239, datë 20.04.2022; VKM nr. 255, datë 29.04.2022; VKM nr. 291, datë 11.05.2022; VKM nr. 391, datë 09.06.2022; VKM nr. 392, datë 09.06.2022; VKM nr. 412, datë 15.06.2022; VKM nr. 445, datë 29.06.2022; VKM nr. 446, datë 29.06.2022; VKM nr. 428, datë 22.06.2022; VKM nr. 489, datë 27.07.2022; VKM nr. 493, datë 21.07.2022; VKM nr. 491,</p>

	datë 21.07.2022; VKM nr. 499, datë 27.07.2022; VKM nr. 500, datë 27.07.2022; VKM nr. 501, datë 27.07.2022; VKM nr. 502, datë 27.07.2022; VKM nr. 512, datë 27.07.2022.
Impakti	Përdorimi i ngurtësimit të fondeve, si formë financimi për projektet e investimit, rrit risqet për mbajtjen në mënyrë fiktive të realizimit të projekteve brenda planit të miratuar.
Shkaku:	Shpërndarja e fondeve të rindërtimit në formën e transfertës së pakushtëzuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa në të ardhmen për shmangien e praktikës së ngurtësimit të fondeve, si një mënyre financimi për projektet e reja të rindërtimit dhe ato në proces, e cila nuk ka bazë ligjore që të shërbejë si burim financimi.

- Raportimi i treguesve fiskalë të realizuar dhe monitorimi i tyre.

Mbi realizimin e të ardhurave të buxhetit

Sipas tabelës së treguesve fiskal, rezulton se të ardhurat totale për vitin 2022 janë realizuar në vlerën 572,790 milion lekë ose në masën 98.2% krahasuar me planin përfundimtar (Aktin Normativ nr. 19, datë 29.12.2022), me mos realizim në vlerën 10,525 milion lekë. Ndërsa në krahasim me planin fillestar të ardhurat totale janë realizuar në masën 106.7% ose me mbi realizim për vlerën 35,979 milion lekë. Kundrejt vitit 2021, të ardhurat totale janë realizuar më shumë për vlerën 62,218 milion lekë ose realizuar më shumë në masën 12.2%.

Tabela: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave sipas grupeve

Milion lekë

ËRAT		Buxhet Faktik 2021	Projekt Buxhet	Ligji i Buxhetit	AN nr.3 12.03.2022	AN nr.12 29.07.2022	AN nr.17 01.12.2022	AN nr.19 29.12.2022	Plani pas Axhustimeve	Fakt 2022	Ndryshimi fakt 2022-fakt 2021
A	TOTALI TE ARDHURAVE	510,572	536,811	536,811	546,811	576,831	581,831	583,315	583,315	572,790	62,218
I	Te ardhura nga ndihmat	12,671	13,994	13,994	13,994	13,994	11,994	11,994	11,994	9,510	(3,161)
II	Te ardhura tatimore	475,612	500,167	500,167	510,167	540,187	545,187	546,671	546,671	541,342	65,730
1	Nga Tatimet dhe Doganat	338,074	360,535	360,535	370,535	395,000	398,000	398,000	398,000	390,892	52,818
2	Nga Pushteti Vendor	26,666	27,632	27,632	27,632	27,632	27,632	27,632	27,632	27,638	972
3	Nga Fondet Speciale	110,872	112,000	112,000	112,000	117,555	119,555	121,039	121,039	122,811	11,939
III	Të ardhura Jo tatimore	22,289	22,650	22,650	22,650	22,650	24,650	24,650	24,650	21,938	(351)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Zërat kryesor në të ardhurat totale të buxhetit të shtetit janë ndihmat, të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat e pushtetit vendor, të ardhurat nga fondet speciale dhe të ardhurat jo tatimore, me peshë në të ardhurat e përgjithshme si në vijim:

-Të ardhurat nga ndihmat janë realizuar në vlerën 9,510 milion lekë dhe zënë 1.7% të të ardhurave të përgjithshme.

-Të ardhurat nga tatimet dhe doganat janë realizuar në vlerën 390,892 milion lekë dhe zënë 68.2% të të ardhurave të përgjithshme.


-Të ardhurat nga pushteti vendor janë realizuar në vlerën 27,638 milion lekë dhe zënë 4.8% të të ardhurave të përgjithshme.

-Të ardhurat nga fondet speciale janë realizuar në vlerën 122,811 milion lekë dhe zënë 21.5% të të ardhurave të përgjithshme.

-Të ardhurat jo tatimore janë realizuar në vlerën 21,938 milion lekë dhe zënë 3.8% të të ardhurave të përgjithshme.

Grafiku: Planifikimi dhe realizimi të ardhurave sipas grupeve

(Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Pra siç shihet edhe grafikisht, të ardhurat nga Tatimet dhe Doganat janë burimi kryesor i të hyrave në buxhetin e shtetit dhe janë burimi kryesor për kryerjen e investimeve dhe shpenzimeve nga ana e institucioneve publike.

I. Të Ardhurat nga Ndhimat, zënë 2.8% të totalit të të ardhurave të planifikuara me ligj buxheti, ose 2% të të ardhurave të planifikuara me AN nr. 19, datë 29.12.2022, ndërsa realizimi i këtij zëri zë 1.7% të totalit.

Të ardhura nga ndihmat të planifikuar me buxhetin fillestar në vlerën 13,994 milion lekë janë realizuar në masën 68% ose me mosrealizim për shumën 4,484 milion lekë, ndërsa në krahasim me AN nr. 19, datë 29.12.2022 janë realizuar në masën 79.2% me mosrealizim për shumën 2,484 milion lekë. Kundrejt vitit 2021, të ardhurat nga ndihma janë realizuar më pak për vlerën 3,161 milion lekë ose 24.9% më pak.

II. Të Ardhurat Tatimore, zënë 93.2% të totalit të të ardhurave në planifikuara me ligj buxheti, ose 93.7% të të ardhurave të planifikuara me AN nr. 19, datë 29.12.2022, ndërsa realizimi i këtij zëri zë 94.5% të totalit.

Të ardhurat tatimore të planifikuara me buxhetin fillestar në vlerën 500,167 milion lekë janë realizuar në masën 108% ose me mbirealizim për shumën 41,175 milion lekë, ndërsa në krahasim me AN nr. 19, datë 29.12.2022 janë realizuar në masën 99% me mosrealizim për shumën 5,329 milion lekë. Kundrejt vitit 2021, të ardhurat tatimore janë realizuar më shumë për vlerën 65,730 milion lekë ose 24.9% më pak.

Tabela: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave sipas grupeve (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Të ardhurave tatimore	475,612	541,342
Dif. nga viti i mëparshëm		65,730
Në % nga viti mëparshëm		13.8%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në mënyrë grafike, trendi i realizimit të të Ardhurave Tatimore paraqitet si më poshtë

Grafiku: Trendi i realizimit të të Ardhurave Tatimore në 2 vitet e fundit (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Të Ardhurat Tatimore përbëhen nga:

- Të ardhurat nga Tatimet dhe Doganat, në masën 390,892 milion lekë ose 72.2 % të totalit të të ardhurave.
- Të ardhura nga Pushteti Vendor, në masën 26,666 milion lekë ose 5.1 % të totalit të të ardhurave.
- Të ardhura nga Fondet Speciale në masën 110,872 milion lekë ose 22.7% të totalit të të ardhurave.

II.1. Të ardhura nga Tatimet dhe Doganat, janë të përbëra nga:


a. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), është realizuar për 191,412 milion lekë, kundrejt 193,000 milion lekë të planifikuar me AN 19 datë 29.12.2022, realizuar në masën 99.2%, me mos realizimi për vlerën 1,588 milion lekë. Trendi i realizimit të të ardhurave nga TVSH për 2 vitet e fundit rezultojn si në tabelën më poshtë:

Tabela: Trendi i realizimit të ardhurave nga TVSH në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Të ardhurave nga TVSH	161,536	191,412
Dif. nga viti i mëparshëm		29,876
Në % nga viti mëparshëm		18.5%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Grafiku: Trendi i realizimit të të ardhurave nga TVSH në 2 vite (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga auditimi i zhvilluar nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve rezulton se: Në treguesit fiskalë të konsoliduar dhe në kryqëzimin e të dhënave të raportuara me ato të publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, TVSH në terma bruto raportohet në shumën 56,995 milion lekë ndërkohë që në terma neto raportohet në shumën 34,514 milion lekë. Diferenca në terma bruto konstatohet se i përket përfshirjes së raportimit të kamatëvonesave sipas llogarisë 7090102 “Kamatëvonesa nga tatimi mbi vlerën e shtuar” në shumën 73,275,875 lekë për efekt të realizimit të planit nga ana e drejtorisë së përgjithshme të tatimeve. Ndërkohë, depozitimet e përkohshëm në llogarinë 4665504 janë raportuar në të dyja rastet si e ardhur për efekt të realizimit të të ardhurave tatimore përgjatë vitit buxhetor. Për sa i përket diferencës në të ardhura neto të raportuara konstatohet se ajo vjen edhe si pasojë e rimbursimit të kryer nga drejtoritë rajonale tatimore për tatimin mbi vlerën e shtuar. Rimbursimet e kryera për tatimin mbi vlerën e shtuar nga aparati qendror i drejtorisë së përgjithshme të tatimeve raportohen në shumën 22,469,292,374 lekë ndërkohë që nga drejtoritë rajonale tatimore është rimbursuar shuma prej 11,768,568 lekë, në total rimbursuar në shumën 22,481,060,942 lekë. Kjo vlerë e rimbursimit në total të kryer për vitin buxhetor 2022 rakordon me shumën e paraqitur në treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar për buxhetin e shtetit të vitit 2022.

b. Tatimi mbi Fitimin, është realizuar në shumën 47,683 milion lekë, kundrejt 46,000 milion lekë të planifikuar me AN 19 datë 29.12.2022, realizuar në masën 103.7%, ose realizuar më shumë për shumën 1,683 milion lekë.

Tabela: Realizimi i të ardhurave nga tatimi mbi fitimin në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Të ardhurave nga tatim fitimi	35,610	47,683
Dif. nga viti i mëparshëm		12,073
Në % nga viti mëparshëm		33.9%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Grafiku: Trendi i realizimit të të ardhurave nga Tatimi mbi Fitimin në 2 vite (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga auditimi i zhvilluar nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve rezulton se: Sipas raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të ardhurat tatimore nga tatimi mbi fitimin, janë arkëtuar në shumën 47,797 milion lekë. Ndërsa sipas treguesve fiskalë të konsoliduar janë raportuar të ardhura nga tatimi mbi fitimin në shumën 47,683 milion lekë. Pra me mosrakordimit me të dhënat e paraqitura nga DPT në shumën 114 milion lekë. Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në mosrakordim konstatohet se janë përfshirja e kamatëvonesave si e ardhur dhe mos evidentimi i kthimeve të këtij tatimi të kryera nga drejtoritë rajonale tatimore. Nga krahasimi i llogarive analitike të të ardhurave konstatohet se në raportim nga DPT nuk janë përfshirë kthimet e tatim fitimit të kryera nga drejtoritë rajonale tatimore për tatimin mbi fitimin të cilat zvogëlojnë tepricën e llogarisë 7001200 “Tatimi mbi Fitimin nga Subjektet e Sektorit Privat” në shumën 14,383,565 lekë. Faktori i dytë që ndikon në mosrakordimin e të dhënave të raportuara nga DPT me atë të treguesve

fiskalë të konsoliduar konstatohet se është teprica e llogarisë 7090106 “Kamatëvonesa nga tatim fitimi” në shumën 104 milion lekë që për efekt të planit është raportuar si e ardhur tatimore nga DPT ndërkohë që në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar është raportuar në zërin e të ardhurave jo tatimore. Përsa i përket depozitimeve të përkohshme për tatimin e fitimit konstatohet se është raportuar në të dyja rastet si e ardhur tatimore që lidhet me arkëtimet e vitit buxhetor.

c. Të ardhurat nga Akciza janë realizuar për 53,547 milion lekë, kundrejt 55,000 milion lekë të planifikuar me AN 19 datë 29.12.2022, ose me realizim në masën 97.4%, ose më pak për 1,453 milion lekë.

Tabela: Realizimi i të ardhurave nga akciza në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Të ardhurave nga akciza	51,637	53,547
Dif. nga viti i mëparshëm		1,453
Në % nga viti mëparshëm		3.7%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në mënyrë grafike, trendi i realizimit të të ardhurave nga akciza, paraqitet si më poshtë.

Grafiku: Trendi i realizimit të të ardhurave nga akciza në 2 vite (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

d. Tatimi mbi të Ardhurat Personale është realizuar për vlerën 44,983 milion lekë, kundrejt 47,000 milion lekë të planifikuar me AN nr.19, datë 29.12.2022, me realizim në masën 95.7%, ose realizuar më pak për 2,017 milion lekë.

Tabela: Realizimi i të ardhurave nga të ardhurat personale në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Të ardhurave personale	39,312	44,983
Dif. nga viti i mëparshëm		5,671
Në % nga viti mëparshëm		14.4%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Grafiku: Trendi i realizimit të të Ardhurave Personale në 2 vite (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga auditimi i zhvilluar nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve rezultojnë se: Sipas raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të ardhurat tatimore nga tatimi mbi të ardhurat personale janë arkëtuar në shumën 50.7 miliard lekë. Ndërsa në treguesit fiskalë të konsoliduar sipas buxhetit të konsoliduar të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale janë raportuar në shumën 45 miliard lekë, diferencë e cila vjen në pjesën më të madhe si pasojë e të ardhurave nga rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme të cilat në zbatim të udhëzimit nr. 2727 datë 04.02.2020 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit”. Këto të ardhura në shumën 5,612 milion lekë janë përcjellë me evidencat analitike të konfirmuara edhe nga DRT dhe degët e thesarit sipas shkresës nr. 1765 datë 06.02.2023 të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës në llogaritë analitike 7020400 “Tatim nga rivlerësimi i pasurisë së individëve” në shumën 290.4 milion lekë dhe llogarisë 7020800 “Të ardhura nga rivlerësimi” në shumën 5,322 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se shuma e mësipërme prej 45,084.6 milion lekë nuk rakordon me shumën e raportuar në treguesit fiskalë sipas

buxhetit të konsoliduar për shkak të faktorëve të mëposhtëm: ditar manual në llogarinë 7000100 “nga të punësuarit e sektorit buxhetor dhe publik” e evidentuar në rakordimin e kryer nga DPT me degën e thesarit Tiranë në shumën 743 mijë lekë. - kthimit të tatimit që është realizuar nga DRT për llogarinë 7000900 “Të tjera tatime mbi të ardhurat në burim”.

e. Taksa Nacionale dhe të tjera është realizuar për vlerën 44,821 milion lekë, kundrejt 48,500 milion lekë të planifikuar me AN nr. 19, datë 29.12.2022, realizuar në masën 92.4%, ose realizuar më pak për vlerën 3,679 milion lekë.


Tabela: Realizimi i të ardhurave nga taksat nacionale dhe të tjera në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Të ardhura nga taksat nacion. e tj.	42,521	44,821
Dif. nga viti i mëparshëm		2,300
Në % nga viti mëparshëm		5.4%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në mënyrë grafike, trendi i realizimit të të ardhurave nga taksat nacionale paraqitet si më poshtë.

Grafiku: Trendi i realizimit të Taksave Nacionale në 2 vite (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

f. Taksa Doganore është realizuar për vlerën 8,447 milion lekë, kundrejt 8,500 milion lekë të planifikuara me AN nr. 19, datë 29.12.2022, ose me realizim në masën 92.4%, ose më pak për 3,679 milion lekë.

Tabela: Realizimi i të ardhurave nga Taksat Doganore dhe të tjera në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Të ardhura nga taksat doganore	7,457	8,447
Dif. nga viti i mëparshëm		990
Në % nga viti mëparshëm		13.27%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në mënyrë grafike, trendi i realizimit të të Ardhurave nga taksat doganore paraqitet si më poshtë.

Grafiku: Trendi i realizimit të të ardhurave nga taksat doganore në 2 vite (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

II.2. Të ardhura nga Pushteti Vendor janë realizuar për 27,638 milion lekë, kundrejt 27,632 milion lekë të planifikuar sipas AN 19 datë 29.12.2022, ose realizuar në masën 100.02%, ose më shumë për 6 milion lekë. Këto të ardhura përbehen nga: të ardhurat nga taksat lokale; nga tatimi mbi pasurinë; dhe nga tatimi mbi biznesin e vogël.


Tabela: Realizimi i të ardhurave nga Pushteti Vendor në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Të ardhurat e pushtetit vendor	26,666	27,638
Dif. nga viti i mëparshëm		972
Në % nga viti mëparshëm		3.52%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në mënyrë grafike, trendi i realizimit të të Ardhurave nga Pushteti Vendor paraqitet më poshtë.

Grafiku : Trendi i realizimit të të ardhurave nga Pushteti Vendor në 2 vite (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Të ardhurat nga Pushteti Vendor përbëhen nga:


a. Taksa lokale realizuar për 21,428 milion lekë, kundrejt 21,445 milion lekë të planifikuar sipas AN 19, datë 29.12.2022 ose realizuar në masën 99.9%, ose më pak për 17 milion lekë.

b. Tatimi mbi Pasurinë realizuar për 6,138 milion lekë, kundrejt 6,187 milion lekë të planifikuar, ose 99.2%, me 49 milion lekë më pak sipas AN 19, datë 29.12.2022.

c. Tatimi mbi Biznesin e vogël realizuar për 72 milion lekë, të cilat konsiston në pagesa për detyrimet e prapambetura të bizneseve, pavarësisht se nuk janë planifikuar të ardhura pasi me Ligjin nr. 122/2020 shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm është zeruar. Të ardhurat për këtë zë janë realizuar nga mbledhja e detyrimeve të prapambetura.

Grafiku në vijim paraqet realizimin e komponentëve të të Ardhurave nga Pushteti Vendor për vitin buxhetor 2022.

Grafiku: Përbërja e të ardhurave të realizuara nga Pushteti Vendor 2022 (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

II.3 Të ardhura nga Fondet Speciale, të cilat janë realizuar për 122,811 milion lekë, kundrejt 121,039 milion lekë të planifikuar sipas AN 19 datë 29.12.2022, realizuar planin në masën 101.5%, ose 1,772 milion lekë më shumë.

Tabela: Realizimi i të ardhurave nga Fondet Speciale në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Të ardhurat nga Fondet speciale	110,872	122,811
Dif. nga viti i mëparshëm		11,939
Në % nga viti mëparshëm		10.7%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Grafiku: Trendi i realizimit të të ardhurave nga fondet speciale në 2 vite (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Të ardhurat nga Fondet Speciale janë të përbëra nga:

a. Të ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore realizuar për 105,640 milion lekë, kundrejt 104,009 milion lekë të planifikuar sipas AN 19 datë 29.12.2022, ose 101.6% pra 1,631 milion lekë më shumë se plani përfundimtar. Nga auditimi në ISSH rezulton se të ardhurat nga fondet speciale (sigurimet shoqërore) paraqiten në vlerën 105,656 milionë lekë, ose 16 milion lekë më shumë se tabela e treguesve fiskalë. Në realizimin e të ardhurave të deklaruar nga ISSH janë përfshirë të ardhura tatimore në shumën 104,459 milionë lekë dhe të ardhura jo tatimore në shumën 1,197 milionë lekë.

b. Të ardhura nga kontributet e sigurimeve shëndetësore realizuar për 16,266 milion lekë, kundrejt 16,030 milion lekë të planifikuar sipas AN 19 datë 29.12.2022, ose realizuar planin në masën 101.5%, pra 236 milion lekë më shumë se plani përfundimtar.

Nga auditimi i zhvilluar nga KLSH në FSDKSH, mbi planifikimin, realizimin dhe rakordimin e të ardhurave të FSDKSH, nga financimi i buxhetit të shtetit dhe realizimi i të ardhurave nga kontributet, ka rezultuar se në vitin 2022, të ardhurat nga kontributet janë realizuar në masën 101.1%, duke përfshirë edhe të ardhurat jo tatimore, ndërsa përdorimi i financimit të buxhetit ka rezultuar në masën 99.5 %. Të ardhurat e realizuara, janë të rakorduara me strukturat përgjegjëse për mbledhjen e tyre, si DPT dhe ISSH, për të ardhurat nga kontributet dhe thesarin për financimin nga buxheti i shtetit.

Gjithashtu, u verifikua saktësia e raportimit në raport me Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, ku rezultoi se plani i të ardhurave nga kontributet, plani dhe realizimi i shpenzimeve është i njëjtë, ndërsa pjesa e përket realizimit të të ardhurave, nga FSDKSH janë raportuar në shumën 16,158 milionë lekë të mbledhura dhe 15,686 milionë lekë të hyra në llogarinë e FSDKSH, ndërsa nga MFE realizimi i tyre është raportuar në shumën 16,266 milionë lekë, me një diferencë midis raportimeve në shumën 108 milionë lekë.

Shuma e pa derdhur në llogarinë e FSDKSH për të ardhurat nga kontributet e mbledhura nga DPT në shumën 638,614,928 lekë dhe ISSH në shumën 223,493,214 lekë (shuma totale 862,108,142 lekë) është e pasqyruar në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në klasën 3 “Llogari të arkëtueshme”, llogaria 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme”, në shumën 862,108,142 lekë.

Në lekë

Të ardhura nga kontributet	Gjendje 01.01.2022	Të ardhura nga kontributet	Transferta nga TSA	Gjendje 31.12.2022
DPT	168,256,503	16,100,358,425	15,630,000,000	638,614,928
ISSH	221,606,408	57,693,336	55,806,530	223,493,214
Llogari të arkëtueshme	16,158,051,761	15,685,806,530	16,158,051,761	862,108,142
MFE		16,266 milion		

c. Të ardhura Kompensimi të Pronarëve realizuar për 905 milion lekë, kundrejt 1,000 milion lekë të planifikuar sipas AN 19 datë 29.12.2022, ose realizuar në masën 90%, ose më pak se plani përfundimtar për 95 milion lekë.

Grafiku: Përbërja e të ardhurave të realizuara nga Fondet Speciale (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

II Të Ardhurat Jo Tatimore janë realizuar në vlerën 21,938 milion lekë, ose 89% kundrejt planifikimit prej 24,650 milion lekësh me AN datë 29.12.2022, pra 2,712 milion lekë më pak.

Tabela: Realizimi i të Ardhurave Jo Tatimore në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Të ardhura jo tatimore	22,289	21,938
Dif. nga viti i mëparshëm		2,712
Në % nga viti mëparshëm		-15.7%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në mënyrë grafike, trendi i realizimit të të Ardhurave Jo Tatimore paraqitet si në vijim.

Grafiku: Trendi i realizimit të të Ardhurave Jo Tatimore në 2 vite (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Grafiku në vijim paraqet realizimin e komponentëve të të Ardhurave jo Tatimore për vitin buxhetor 2022.

Grafiku: Përbërja e të ardhurave të realizuara nga të Ardhurat Jo Tatimore (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Mbi Realizimin e Shpenzimeve Buxhetore

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit për vitin 2022, janë realizuar në vlerë 651,015 milion lekë, nga 667,178 milion lekë të planifikuara sipas AN 19 datë 29.12.2022, ose janë realizuar në masën 97.58%, pra 16,163 milion lekë më pak, dhe janë realizuar në masën 102.1% kundrejt planit fillestar prej 637,694 milion lekë.

Tabela: Shpenzimet buxhetore të planifikuara dhe realizuara (Milion lekë)

ZËRAT	Buxhet Faktik 2021	Projekt Buxhet	Ligji i Buxhetit	AN nr.3 12.03.2022	AN nr.12 29.07.2022	AN nr.17 01.12.2022	AN nr.19 29.12.2022	Plani pas Axxhustimeve	Fakt 2022
B	595,968	637,694	637,694	647,694	660,693	665,694	667,178	667,178	651,015
I	461,075	507,201	507,349	501,549	504,802	501,295	498,291	518,923	499,991
1	Personeli	83,268	90,593	91,590	89,388	88,972	87,036	86,684	84,696
2	Interesat	35,822	50,757	50,757	50,757	50,757	44,800	44,680	39,624
3	Shpenzime operative/miremb	59,365	64,168	63,241	59,643	63,173	67,479	66,556	68,504
4	Subvencione	1,422	1,550	1,550	1,550	1,689	1,689	1,605	1,650
5	Shpenzime për fondet Special	199,457	212,771	212,271	212,271	212,271	211,271	209,771	216,515
6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	52,593	59,712	60,290	60,290	60,290	61,460	61,680	58,696
7	Shpenzime te tjera	29,149	27,650	27,650	27,650	27,650	27,560	27,535	30,306

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Gjatë vitit 2022 shpenzimet buxhetore janë realizuar për vlerën 55,047 milion lekë më shumë se viti 2021, ose 9.2% më shumë se realizimi i vitit paraardhës.

Tabela: Realizimi i shpenzimeve buxhetore në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Shpenzimet e përgjithshme	595,968	651,015
Dif. nga viti i mëparshëm		55,047
Në % nga viti mëparshëm		9.2%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Grafiku: Trendi i realizimit të Shpenzimeve të Përgjithshme në 2 vite (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Grafiku në vijim paraqet realizimin e shpenzimeve të buxhetit 2022 sipas zërave.

Grafiku: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit 2022 sipas zërave përbërës (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

I. Shpenzimet Korrente janë realizuar në vlerën 499,991 milion lekë, nga 498,291 milion lekë të planifikuara sipas AN 19 datë 29.12.2022, ose realizuar në masën 100.34%, me realizim kundrejt planit më shumë në vlerën 1,700 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se AN nr. 19 datë 29.12.2022 nuk reflekton ndryshimet e planit të ndodhura gjatë vitit me VKM

apo shkresa të tjera për shpenzimet korrente, pasi plani përfundimtar për këtë zë rezultoi të jetë në vlerën 518,923 milion lekë. Për sa më sipër kundrejt planit përfundimtar, shpenzimet korrente janë realizuar në masën 96.4%, ose realizuar më pak për vlerën 18,932 milion lekë. Në shpenzimet korrente përfshihen: shpenzimet për personelin, për interesat, shpenzimet operative të mirëmbajtjes, shpenzimet për subvencionet, shpenzimet për fondet speciale, shpenzime për buxhetin e pushtetit vendor, shpenzime të tjera sociale.

Tabela: Realizimi i shpenzimeve korrente në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Shpenzimet korrente	461,075	499,991
Dif. nga viti i mëparshëm		38,913
Në % nga viti mëparshëm		8.44%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në mënyrë grafike planifikimi dhe realizimi i këtyre shpenzimeve për vitin 2022 paraqitet si më poshtë.


Grafiku: Trendi i realizimit të Shpenzimeve Korrente në 2 vite (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Sipas përbërjes shpenzimet korrente të realizuara 2022 jepen në grafikun më poshtë.

Grafiku: Realizimi i shpenzimeve korrente sipas zërave përbërës (Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga auditimi rezultoi se në totalin e shpenzimeve korrente janë përfshirë edhe shpenzimet kapitale të kryera nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për vlerën 11,913 milion lekë, duke mbivlerësuar këtë zë.

I.1. Shpenzimet e Personelit janë realizuar në vlerën 84,696 milion lekë, nga 86,684 milion lekë të planifikuara sipas AN nr. 19, datë 29.12.2022, ose realizuar në masën 97.7%, me mosrealizim për vlerën 1,989 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se AN nr. 19, datë 29.12.2022 nuk reflekton ndryshimet e planit të ndodhura gjatë vitit me VKM apo shkresa të tjera për shpenzimet e personelit, pasi plani përfundimtar për këtë zë rezultoi të jetë në vlerën 85,621 milion lekë. Për sa më sipër kundrejt planit përfundimtar, shpenzimet e personelit janë realizuar në masën 98.9%, ose realizuar më pak për vlerën 925 milion lekë.

Tabela: Realizimi i shpenzimeve të personelit në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Shpenzime personeli	83,268	84,696
Dif. nga viti i mëparshëm		1,428
Në % nga viti mëparshëm		1.71%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në shpenzimet e personelit përfshihen:

a. Shpenzimet për pagat janë realizuar në vlerën 72,103 milion lekë ose në masën 99.36% kundrejt planit prej 72,568 milion lekë me AN nr.19, datë 29.12.2022, pra 464 milion lekë më pak.

b. Kontributi i sigurimeve shoqërore është realizuar në vlerën 11,784 milion lekë ose në masën 99.72% kundrejt planit prej 11,817 milion lekë me AN nr.19, datë 29.12.2022, pra 33 milion lekë më pak.

c. Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta është realizuar në vlerën 808 milion lekë ose në masën 101% kundrejt planit prej 800 milion lekë me AN nr.19, datë 29.12.2022, pra 8 milion lekë më shumë.

I.2. Shpenzimet për interesat janë realizuar në vlerën 39,624 milion lekë, nga 44,680 milion lekë të planifikuara sipas AN nr.19, datë 29.12.2022, ose realizuar në masën 88.68% me mosrealizim kundrejt planit me 5,056 milion lekë. Krahasuar me vitin 2021, këto shpenzime janë realizuar më shumë për vlerën 3,802 milion lekë, ose rreth 10.6% më shumë. Shpenzimet për interesa përbëhen nga interesa të brendshme në masën 61%, ose 24,210 milion lekë dhe interesa të huaja në masën 39%, ose 15,414 milion lekë.

Tabela: Realizimi i shpenzimeve të personelit në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Shpenzimet për interesat	35,822	39,624
Dif. nga viti i mëparshëm		3,802
Dif. në % nga një vit më parë		10.6%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

a. Shpenzimet për interesat e brendshme janë realizuar për vlerën 24,210 milion lekë, nga 24,243 milion lekë të planifikuara sipas AN nr. 19, datë 29.12.2022, ose realizuar në masën 99.86%, me një mosrealizim kundrejt planit me 33 milion lekë.

b. Shpenzimet për interesat e huaja janë realizuar për 15,414 milion lekë, nga 15,636 milion lekë të planifikuara sipas AN nr. 19, datë 29.12.2022, ose realizuar në masën 98.58% me një mosrealizim kundrejt planit me 223 milion lekë.

I.3. Shpenzimet operative të mirëmbajtjes -Në këtë zë, përfshihen të gjitha shpenzimet e tjera korrente të institucioneve publike, që nuk janë paga për personelin, por të domosdoshme për funksionimin e institucionit dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarin. Këto shpenzime zënë 9.98% të shpenzimeve të planifikuara me AN 19 datë 29.12.2022 dhe 10.5% të shpenzimeve të realizuara. Gjatë vitit 2022, janë realizuar për 68,504 milion lekë nga 66,556 milion lekë të planifikuara sipas AN nr.19, datë 29.12.2022. Krahasuar me vitin 2021 shpenzime operative janë realizuar për më shumë në vlerën 9,139 milion lekë ose 15.4% më shumë. Trendi i realizimit të shpenzimeve operative për 2 vite, rezulton si më poshtë.

Tabela: Realizimi i shpenzimeve operative në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Shpenzime Operative	59,365	68,504
Dif. nga viti i mëparshëm		9,139
Dif. në % nga një vit më parë		15.4

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

I.4. Shpenzimet për Subvencionet janë realizuar për vlerën 1,650 milion lekë nga 1,605 milion lekë të planifikuara me AN nr.19, datë 29.12.2022 dhe realizuar 102.82% me realizim kundrejt planit me shumë në vlerën 45 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se AN nr. 19, datë 29.12.2022 nuk reflekton ndryshimet e planit të ndodhura gjatë vitit me VKM apo shkresa të tjera për shpenzimet për subvencionet, pasi plani përfundimtar për këtë zë rezulton të jetë në vlerën 1,655 milion lekë. Për sa më sipër kundrejt planit përfundimtar, shpenzimet e subvencionit janë realizuar në masën 99.7%, ose realizuar më pak për vlerën 5 milion lekë.

I.5. Shpenzimet për fondet speciale zënë 31.4% të shpenzimeve të planifikuara dhe 33.3% të shpenzimeve të realizuara. Ato janë realizuar për 216,515 milion lekë nga 209,771 milion lekë të planifikuara sipas AN nr. 19, datë 29.12.2022, ose realizuar në masën 103.2% me realizim mbi planin prej 6,744 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se AN nr. 19, datë

29.12.2022 nuk reflekton ndryshimet e planit të ndodhura gjatë vitit me VKM apo shkresa të tjera për shpenzimet për fondet speciale, pasi plani përfundimtar për këtë zë rezulton të jetë në vlerën 221,717 milion lekë. Për sa më sipër kundrejt planit përfundimtar, shpenzimet për fondet speciale janë realizuar në masën 97.7%, ose realizuar më pak për vlerën 5,202 milion lekë.

Tabela: Realizimi i shpenzimeve për fondet speciale në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Shpen. Fondeve Speciale	199,457	216,515
Dif. nga viti i mëparshëm		17,058
Dif. në % nga një vit më parë		8.55%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në vitin 2022 këto shpenzime janë realizuar 17,058 milion lekë më shumë se në vitin 2021, ose 8.55% më shumë.

a. Shpenzimet për sigurimet shoqërore janë realizuar për 163,037 milion lekë nga 148,135 milion lekë të planifikuara sipas AN nr.19, datë 29.12.2022, ose kanë tejkaluar planin me 10.06%, ose me 14,902 milion lekë më shumë. Nga auditimi konstatohet se AN nr. 19, datë 29.12.2022 nuk reflekton ndryshimet e planit të ndodhura gjatë vitit me VKM apo shkresa të tjera për shpenzimet për sigurimet shoqërore pasi plani përfundimtar për këtë zë rezulton të jetë në vlerën 166,881 milion lekë. Për sa më sipër kundrejt planit përfundimtar, shpenzimet për sigurimet shoqërore janë realizuar në masën 97.7%, ose realizuar më pak për vlerën 3,844 milion lekë.

b. Shpenzimet për sigurimet shëndetësore janë realizuar për 52,244 milion lekë nga 52,836 milion lekë të planifikuara sipas AN nr.19, datë 29.12.2022, ose realizuar në masën 98.8% me mos realizim kundrejt planit në vlerën 592 milion lekë.

c. Shpenzimet për kompensimin e pronarëve janë realizuar për 1,234 milion lekë nga 2,000 milion lekë të planifikuara sipas AN nr.19, datë 29.12.2022, ose realizuar në masën 61.6% me një mos realizim kundrejt planit me 766 milion lekë.

I.6 Shpenzimet për Buxhetin Vendor janë realizuar në shumën 58,696 milion lekë nga 61,460 milion lekë të planifikuara me sipas AN nr.19, datë 29.12.2022, ose realizuar në masën 95.5% me mos realizim për vlerën 2,764 milion lekë. Shpenzimet e qeverisjes vendore përfaqësojnë rreth 9.02% të shpenzimeve totale të qeverisjes së përgjithshme në vitin 2022. Nga auditimi konstatohet se AN nr.19, datë 29.12.2022 nuk reflekton ndryshimet e planit të ndodhura gjatë vitit me VKM apo shkresa të tjera për shpenzimet për shpenzimet për buxhetin vendor pasi plani përfundimtar për këtë zë rezulton të jetë në vlerën 61,680 milion lekë. Për sa më sipër kundrejt planit përfundimtar, shpenzimet për buxhetin vendor janë realizuar në masën 95.16%, ose realizuar më pak për vlerën 2,984 milion lekë. Konstatohet se shpenzimet për buxhetin vendor raportohen në total, pa specifikuar realizimin e shpenzimeve të kryera nga transfertat e buxhetit të shtetit, të ardhurat e veta të njëjësive të qeverisjes vendore si dhe financimet e huaja të realizuara nga këto njësi.

Trendi i realizimit të këtyre të shpenzimeve të pushtetit vendor për 2 vite rezulton si vijon:

Tabela: Realizimi i shpenzimeve të Pushtetit Vendor në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Shpenzime të pushtetit vendor	52,593	58,696
Dif. nga viti i mëparshëm		6,103
Dif. në % nga një vit më parë		11.6%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

I.7. Shpenzime të tjera sociale zënë 4.13% të shpenzimeve të planifikuara dhe 4.6% të shpenzimeve të realizuara. Ato janë realizuar për 30,306 milion lekë nga 27,535 milion lekë të planifikuara sipas AN nr.19, datë 29.12.2022 ose realizuar në masën 110.06%. Shpenzimet e tjera sociale përbëhen nga: *pagesa e papunësisë, ndihma ekonomike dhe paaftësia, kompensim për ish të përndjekurit dhe bonusi i lindjeve*. Nga auditimi konstatohet

se AN nr. 19, datë 29.12.2022 nuk reflekton ndryshimet e planit të ndodhura gjatë vitit me VKM apo shkresa të tjera për shpenzimet për shpenzimet për shpenzimet e tjera sociale pasi plani përfundimtar për këtë zë rezulton të jetë në vlerën 30,504 milion lekë. Për sa më sipër kundrejt planit përfundimtar, shpenzimet e tjera sociale janë realizuar në masën 99.35%, ose realizuar më shumë për vlerën 198 milion lekë.

Tabela 21: Realizimi i shpenzimeve të tjera sociale në 2 vite (Milion lekë)

Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
Shpenzime të tjera	29,149	30,306
Dif. nga viti i mëparshëm		1,157
Dif. në % nga një vit më parë		3.97%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në vitin 2022 këto shpenzime janë realizuar më shumë se në vitin 2021 për 1,157 milion lekë, ose 3.97% më shumë.

Transferime kapitale në tabelën e treguesve fiskal të konsoliduar janë raportuar në vlerën 0 lekë. Nga auditimi konstatohet se janë realizuar 3 transferime kapitale në vlerën totale 3,385 milion lekë, konkretisht:

- transferimi kapital për ALBGAS SHA në vlerën 1,200 milion lekë;
- transferimi kapital për AIC (The Association of Investment Companies) Korporata Shqiptare e Investimeve, për vlerën 2,120 milion lekë;
- transferimi kapital për blerjen e godinës “Poli i Drejtësisë” në vlerën 65.1 milion lekë.

Këto transfertat kapitale janë përfshirë te realizimi i treguesve të investimeve kapitale.

Shpenzimet Kapitale janë realizuar në vlerën 112,117 milion lekë kundrejt planit me AN nr.19, datë 29.12.2022, prej 120,047 milion lekësh, pra në masën 93.39%, ose me mosrealizim në vlerën 7,931 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se te shpenzimet kapitale janë përfshirë edhe shpenzimet operative dhe transfertat ndaj të tretëve të kryera nga njësitë e qeverisjes vendore për fondin e rindërtimit në vlerën 4,768 milion lekë.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në vlerën 63,675 milion lekë, kundrejt planit me AN nr.19, datë 29.12.2022, prej 64,565 milion lekë, pra në masën 98.62%, ose me mosrealizim për vlerën 890 milion lekë. Konstatohet se në tabelën e treguesve fiskal për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë raportuar edhe transfertat kapitale duke mbivlerësuar këtë zë për vlerën 3,385 milion lekë.

Shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm i është zbritur vlera e realizuar e shpenzimeve kapitale të fondit të rindërtimit të qeverisjes qendrore dhe vendore prej 28,874 milion lekë dhe vlera e realizimit të investimeve nga IAL prej 892 milion lekë, të cilat kanë dalë si zë më vetë në tabelën e treguesve fiskal.

Shpenzimet kapitale me financim të jashtëm janë realizuar në vlerën 18,676 milion lekë, kundrejt planit me AN nr.19, datë 29.12.2022, prej 22,082 milion lekë, pra në masën 84.58%, ose me mosrealizim për vlerën 3,406 milion lekë.

Fond i Shpronësimeve sipas tabelës së treguesve fiskal është realizuar në vlerën 11,000 milion lekë dhe është klasifikuar si shpenzim.

Në pikën 5 të nenit 4 të AN nr. 17 datë 01.12.2022 citohet: “Gjendja e mjeteve monetare, që do të rezultojë në fund të vitit buxhetor 2022 në llogarinë unike të thesarit, si rezultat i mosrealizimit të shpenzimeve ose tejkalimit të të ardhurave, transferohet në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë në masën jo më shumë se 11 000 milionë lekë dhe përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave”.

Klasifikimi si shpenzim i transfertës midis llogarive është në kundërshtim me pikën 17 të nenit 3 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku citohet se: “Shpenzim” është pakësimi i pasurisë neto, e cila përfundon me kryerjen e pagesave kapitale ose korrente, të pakthyeshme, me ose

pa detyrim kthimi” dhe me nenin 61 ku citohet se: “Metoda e shpenzimeve dhe e të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me:

a) njohjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës;

b) njohjen e të ardhurave tatimore, jotatimore, përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e aktiveve, në çastin e arkëtimit të tyre.”

Fond i Rindërtimit është realizuar në vlerën 28,874 milion lekë, me realizim 89.12% kundrejt vlerës së planifikuar në AN nr.19 ,datë 29.12.2022, prej të cilave 20,864 milion lekë janë shpenzuar për qeverisjen vendore. Konstatohet se në vlerën e raportuar te tabela e treguesve fiskalë janë përfshirë edhe shpenzimet e rindërtimit që janë realizuar nga të ardhurat e veta të institucioneve, në vlerën 415.9 milion lekë, nga të cilat 414.9 milion lekë nga të ardhurat e veta të njëjësive të qeverisjes vendore dhe 1 milion lekë nga të ardhurat e veta të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pra paraqitja në treguesit fiskal e shpenzimeve me burim financimi buxhetin e shtetin janë mbivlerësuar.

MBI DEFICITIN BUXHETOR

Me ligjin e buxhetit nr. 115 datë 25.11.2021, është përcaktuar financimi i deficitit në vlerën 100,883 milion lekë. Me aktin normativ nr.12, datë 29.07.2022 u ul nga 100,883 milion lekë në 83,863 milion lekë, pra ulje për vlerën 17,2020 milion lekë. Me aktin normativ nr. 17 datë 01.12.2022 dhe aktin normativ nr. 19 datë 29.12.2022 nuk janë bërë ndryshime të deficitit por janë bërë rialokime në strukturën e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm brenda kufirit të deficitit.

Deficiti buxhetor për vitin 2022 është realizuar në vlerën 78,225 milion lekë ose në masën 93.3%. Krahasuar me vitin 2021, deficit buxhetor është ulur në vlerën 7,172 milion lekë ose në masën 8.4%.

Raportimi në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar për financimin e deficitit të vitit 2022, së bashku me planifikimet e ndryshuara përgjatë vitit paraqiten:

Në milion lekë

ZËRI BUXHETOR	Ligji nr.115/2021 Buxheti 2022	AN nr.3 12.03.'22	AN nr.12 29.07.'22	AN nr.17 01.12.'22	AN nr.19 29.12.'22	Fakti në tregues fiskale
DEFICITI	-100,883	-100,883	-83,863	-83,863	-83,863	-78,225
Financimi Deficitet	100,883	100,883	83,863	83,863	83,863	78,225
Brendshëm	100,251	100,251	83,383	88,088	90,088	87,765
Të ardhura nga privatizimi	0	0	0	0	0	191
Hua-marrje e brendshme	50,000	50,000	33,000	33,000	33,000	26,156
Të tjera	50,251	50,251	50,383	55,088	57,088	61,417
I Huaj	632	632	480	-4,225	-6,225	-9,539
Hua afatgjatë (e marrë)	25,752	25,752	23,652	15,829	13,829	11,140
Ndryshimi i gjendjes së arkës	0	0	0	0	0	589
Ripagesat	-42,529	-42,529	-42,529	-39,042	-39,042	-38,386
Mbështetje buxhetore	17,409	17,409	19,357	18,987	18,987	17,117

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në lidhje me raportimet për huanë e re të marrë dhe pagesat e principalit të kryera sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe bashkërendimit të ndihmës së huaj konstatohen diferenca në disa prej elementëve sipas tabelës së mëposhtme:

Në milion lekë

Lloji i Huasë	Fakti DPTH	Fakti DPB	Diferenca Thesar-Borxh
Hua-marrje e brendshme	26,156	26,308	(152)
Ripagesat	(38,386)	(38,394)	8
Hua afatgjatë (e marrë) e jashtme	11,140	35,945	(24,805)
nga e cila Eurobond	0	0	0
Mbështetje buxhetore	17,117	17,117	0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Huamarrja e brendshme që ka shërbyer për financimin e deficitit në treguesit fiskalë të konsoliduar paraqitet në shumën 26,156 milion lekë ndërkohë që sipas raportimit nga drejtorja e borxhit huaja e re e brendshme paraqitet në shumën 26,308 milion lekë. Vlëra prej 26,308 milionë lekë rezultojnë të konfirmuar edhe në akt rakordimin ndërmjet strukturave të thesarit dhe strukturave të borxhit. Konstatohet se realizimi faktik i huamarrjes së brendshme i konfirmuar edhe me strukturat e DPTH nuk rakordon me realizimin faktik të paraqitur në

treguesit fiskalë të konsoliduar në huamarrjen e brendshme për financimin e deficitit në shumën (152) milionë lekë.

Të dhënat në lidhje me huanë afatgjatë të jashtme paraqitet në shumën 11,140 milion lekë ndërkohë që sipas raportimi nga drejtorja e borxhit huanë afatgjatë të marrë e jashtme paraqitet në shumën 35,945 milion lekë. Konstatohet se realizimi faktik i huasë afatgjatë të marrë e jashtme nuk rakordon në shumën 24,805 milionë lekë, e konvertuar sipas kursit të këmbimit të datës 31.12.2022 referuar Bankës së Shqipërisë në euro/lekë prej 114.23, diferenca në euro paraqitet në shumën 217 milion Euro.


Rezulton se diferenca vjen për shkak të “Front & Fee”, që janë komisione që parapagohen, të cilat nuk dalin në regjistrimet e thesarit, trajtimi dhe regjistrimi i garancive nga dy drejtoritë si psh 22/01/IBRD – Financimi shtesë përmirësimi i sistemit shëndetësor si dhe 22/02/IBRD – Zhvillimi i integruar urban dhe turzimi financim shtesë të cilën thesari e përfshin tek financimi i huaj.

Në lidhje me pagesat e principalit të regjistruara për vitin 2022 nga auditimi është konstatuar se fakti i raportuar në sistemin e DPB paraqitet në shumën 38,394 milion lekë e cila në krahasim me faktin e paraqitur në treguesit fiskalë, paraqitet me diferencë në shumën 8 milion lekë. Kjo diferencë e cila paraqet një pagesë të kryer nga IDB në TSA në muajin janar 2023.

Përsa i përket diferencave në treguesit e disbursimit të borxhit, si pasojë e rakordimit ndërmjet thesarit dhe borxhit, konstatohet se vjen si pasojë e mbështetjeve buxhetore dhe lidhet me raportimin veçmas në treguesit e konsoliduar fiskal nën vijën e deficitit në seksionin e financimit të jashtëm me mbështetje buxhetore, të cilat kalojnë drejtpërdrejtë në TSA në monedhë të huaj, e detajuar në seksionin e borxhit të jashtëm, e cila nuk ka efekte në rakordimin midis thesarit dhe borxhit.

Grafiku: Defiçiti buxhetor

(Milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Për problematikat e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit zj. M.Dh., ish Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit zj. A.B. për periudhën 01.01.2022-14.10.2022, znj. A.V. ngarkuar për kohësisht për kryerjen e detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit për periudhën 14.10.2022-31.12.2022, Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit zj. Xh.A., Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit zj. M.P., Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Buxhetit Qëndror zj. Sh.K., Përgjegjës i Sektorit të Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit zj. A.B.

Nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit (pa emra përfaqësuesish), me shkresën nr. 5854/50 datë 07.09.2023, protokolluar në KLSH me nr. 281/25, datë 11.09.2023 janë paraqitur observacionet si në vijim:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin në faqen 106-107: Në shpenzimet korrente përfshihen: shpenzimet për personelin, për interesat, shpenzimet operative të mirëmbajtjes,

shpenzimet për subvencionet, shpenzimet për fondet speciale, shpenzimet për buxhetin vendor dhe shpenzimet e tjera sociale.

Vlerësojmë që “Analiza e të Ardhurave të Buxhetit” dhe Analiza “Mbi deficit buxhetor”, nuk është kompetencë dhe përgjegjësi e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit merr në konsideratë observacionin dhe reflekton në këtë raport, për pjesën e shpenzimeve korrente. Në lidhje me përgjegjësin e Drejtorisë së Buxhetit mbi analizën e të ardhurave dhe deficitit buxhetor, merret në konsideratë observacioni, por ngelet përgjegjësia për konstatimet e tjera të trajtuara në këtë drejtim të auditimit.

2.B.5. Mbi auditimin e përputhshmërisë së përdorimit të Fondit Rezervë të Këshillit të Ministrave dhe Fondit të Kontigjencës për vitin 2022.

Në vlerësim të përputhshmërisë së planifikimit dhe përdorimit të Fondit Rezervë, nga auditimi për vitin 2022, konstatohet se:

1. Në zbatim të ligjit vjetor nr.115/2021, datë 16.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2021”, në nenet 11 dhe 14 “Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit dhe Fondet e Kontigjencës janë përcaktuar:

Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit qendror	490,362	milione lekë;
- Fondi rezervë	2,900	milione lekë;
- Kontingjencë për risqet e borxhit	4,800	milione lekë;

Planifikimi i Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës, sa i takon masës së tij, është bërë në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreun e II, nenin 5, sipas të cilit: “*Buxheti i Shtetit përfshin një fond rezervë dhe një fond kontingjence të pashpërndarë, i cili miratohet nga Kuvendi në ligjin e buxhetit vjetor, deri në masën 3% të vlerës totale të fondeve të miratuara*”. Konstatohet se në Ligjin e Buxhetit vjetor ky koeficient është në masën 1.2% duke ruajtur kështu **kufirin ligjor në planifikimin e fondeve rezervë të buxhetit të shtetit dhe të kontigjencave, si më poshtë:**

Tabela nr. 1

Në milion lekë

Nr.	Struktura Buxhetore	Me ligjin nr. 115/2021
1	Shuma e fondit rezervë	2,900
2	Shuma kontigjencave	4,800
I	Shuma 1+2	7,700
II	Fondet e miratuara (shpenzimet)	637,694
	Koeficienti (I/II)	1.2%

Burimi: Tabela hartuar nga grupi i auditimit në bazë të dhënave të MFE.

Në nenin 14 të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, përcaktohet përdorimi i Fondit Rezervë i Buxhetit të Shtetit në shumën **2,900 milion lekë**, si më poshtë:

- 2,400 milionë lekë për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme;*
- 500 milionë lekë për projektin për fëmijët dhe rininë.*

Ndërsa Fondi i Kontigjencës për mbulimin e risqeve të borxhit është miratuar në masën 4,500 milion lekë.

Planifikimi nga qeveria dhe miratimi i vlerës 500 milion lekë për projektin për fëmijët dhe rininë me burim fondin rezervë është në kundërshtim me nenin 5 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit, dhe projekti për fëmijët dhe rininë është plotësisht i parashikueshëm dhe i mundshëm për t’u programuar më parë, duke sjellë për pasojë denatyrim të fondit rezervë në planifikim.

Gjatë vitit Fondi Rezervë i KM është shtuar dhe për produktet: “Fond Kontigjence për Paketën e Rezistencë sociale ndaj Pasojave të Krizës” dhe Fondi “Për mbështetjen financiare të menjëhershme për zbutjen maksimale të impaktit të inflacionit të luftës në një dimër të vështirë ekonomik për mbarë Evropën”.

Në kundërshtim me përcaktimet ligjore: nenin 5, kreu II të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Fondi Rezervë i miratuar me Aktet Normative nr. 12, datë 29.07.2022 dhe nr. 19, datë 29.12.2022 ka tejkaluar kufirin e miratuar, përkatësisht përllogaritet në 3.065% dhe 3.84% të totalit të shpenzimeve të miratuara.

Ndryshimet në FR janë bërë si më poshtë:

- Me AN nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Fondi Rezerve ndryshoi në masën 2,650 milion lekë, duke u pakësuar për 250 milion lekë, ku në nenin 5, përcaktohet përdorimin e tij me vendim të Këshillit të Ministrave, për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme. Me këtë AN është pakësuar i gjithë fondi i parashikuar fillimisht për projektin për fëmijët dhe rininë.

- Me AN nr. 12, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, Fondi Rezervë shtohet për 700 milion lekë dhe arrin në shumën 3,350 milionë lekë.

- Me AN nr. 17, datë 1.12.2022 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, Fondi Rezervë është shtuar me 150 milion lekë dhe ka arritur në shumën 3,500 milionë lekë.

- Me AN nr. 19, datë 29.12.2022 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, Fondi Rezervë është shtuar me 7,150 milion lekë, duke arritur në masën 10,620 milionë lekë, ku në nenin 3 të aktit përcaktohet përdorimi si më poshtë:

a) Në masën 2,820 milionë lekë me vendim të Këshillit të Ministrave, për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme;

b) Në masën 7,800 milionë lekë me vendim të Këshillit të Ministrave, për mbështetjen financiare të menjëhershme për zbutjen maksimale të impaktit të inflacionit të luftës në një dimër të vështirë ekonomik për mbarë Evropën.

I. Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit i planifikuar për raste të paparashikuara, është përdorur nëpërmjet 8 Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) në shumën 2,808.9 milionë lekësh, ose në rreth 99.6% të planit. Nga përdorimi deri më **31.12.2022**, prej 2,808.9 milionë lekë, rezulton se:

- Rreth 53.1milion lekë, ose 2 % e planit, janë akorduar për shpenzime personeli;
- Rreth 2,755.8 milionë lekë, ose 97.7% e planit janë akorduar për shpenzime operative dhe transferta të brendshme e të jashtme.

Përdorimi i Fondit Rezervë sipas ministrive dhe institucioneve qendrore paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Përdorimi i fondit rezervë, sipas institucioneve përfituese

në 000/lekë

Kodi instit.	Emërtimi i institucionit	Numri i VKM-ve të miratuara	Fondi i përdorur	
			Vlera e akorduar	Në % ndaj totalit
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	10	755,262	26.9%
12	Ministria e Kulturës	1	700,000	24.9%
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1	190,000	6.8%
11	Ministria Arsimit dhe Sportit	4	500,710	17.8%
13	Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	399,000	14.2%

15	Ministria e Punëve të Jashtme	1	116,760	4.2%
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	65,000	2.3%
87	Institucione të tjera Qeveritare	2	69,700	2.5%
16	Ministria e Brendshme	1	7,200	0.3%
50	Instituti i Statistikave	1	5,300	0.4%
TOTALI			2,808,932	100%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga shqyrtimi i dosjeve për nxjerrjen e këtyre vendimeve, në 4 (katër) raste rezultojnë me mangësi në dokumentacionin e kërkuar, në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, i ndryshuar dhe me nenin 45, Kreu V “Zbatimi i buxhetit”, “Kërkesat për fonde shtesë”, ku përcaktohet: “Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore paraqesin pranë NPA kërkesë për fonde shtesë, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në kohën e përgatitjes së buxhetit dhe që nuk mund të shtyhen për vitin buxhetor pasardhës. ... Kërkesa për fonde shtesë shoqërohet me justifikimin e paraqitjes së kërkesës, duke argumentuar:

- a. arsyet e mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit;
- b. produktet që përfitohen nga veprimtaritë e që do të financohen nga kërkesat shtesë;
- c. kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave;
- ç. zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë. NPA shqyrton kërkesat për fonde shtesë të njësive të qeverisjes qendrore dhe i rekomandon Ministrit të Financave refuzimin, ose pranimin e kërkesave për fonde shtesë të argumentuara”.

Në mënyrë analitike kanë rezultuar mangësitë si më poshtë:

1. Për VKM nr. 287, datë 10.05.2022 " Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për Bashkinë Tiranë, për financimin e projektit "Tirana Youth European Capital 2022" (TEYC), në shumën 700 milion lekë, në dokumentacionin e vënë në dispozicion janë konstatuar mangësi:

- Korrespondencat shkresore me Bashkinë e Tiranës për këtë projekt, me argumentat se pse nuk është planifikuar dhe përballuar nga fondet e Bashkisë Tiranë;
- Mendimet e Ministrave përkatës, ku është adresuar ky P/Vendim;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 8097, datë 04.05.2022 “Mendime për projektvendimin” drejtuar Ministrisë së Kulturës në përgjigje të shkresës së kësaj të fundit nr. 4835/1, datë 07.04.2022, shprehet dakord lidhur me burimin e financimit të këtij projekti... *“nisur nga natyra specifike dhe rëndësia e konsiderueshme e këtij eventit madhor”*. MFE kërkon që relacioni shpjegues duhet të shoqërohet me përlllogaritjen e efektit financiar prej 700 milionë lekë sipas projekteve dhe aktiviteteve të parashikuara. *Memo e datës 21.04.2022 e paraqitur është e pa protokolluar dhe pa nënshkrimet e personave përkatës.*

-Në përgjigje të shkresës së MFE nga Ministria e Kulturës (shkresa të kanalizuar nëpërmjet sistemit të akteve) shpjegohet dhe buxheti i funksionimit të strukturës së TEYC:

“Buxheti i funksionimit të strukturës TEYC 2022. Gjithashtu, referuar kushteve të aplikimit, implementimi i Programit të kryhej në bashkëpunim me një organizatë jo fitimprurëse e cila ka në fokus rininë dhe është partnere gjatë fazës së aplikimit, Bashkia Tiranë në këtë proces është angazhuar të bashkëpunojë me Kongresin Rinor Kombëtar dhe së bashku kanë themeluar strukturën e posaçme për implementimin e suksesshëm të titullit TEYC 2022, që prej muajit Nëntor 2021. Për funksionimin e strukturës kërkohet gjithashtu një mbështetje financiare nga ana e Qeverisë, të bëjnë të mundur funksionimin e strukturës dhe implementimin e suksesshëm të titullit TEYC 2022. Buxheti i nevojshëm për këtë qëllim

është 100.000.000 lekë dhe do të alokohet për të mbuluar shpenzime administrative (paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, qira, materiale promocionale etj)”.

-Shkresa nr. 8623/1 “Dërgohet miratimi i akordimit të fondeve buxhetore” mban datën 19.03.2022 ku referohet: “...Në zbatim të VKM nr. 287, datë 10.05.2022 dhe shkresës së Ministrisë së Kulturës nr. 2603/1, datë 10.05.2022, ju dërgojmë miratimin e akordimit të fondit...”, pra shkresa është nxjerrë dy muaj para daljes së VKM-së.

2. Për VKM nr. 606, datë 28.10.2022 "Për miratimin e Programit Kombëtar të aktiviteteve jashtë orarit mësimor dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, në shumën 276 milion lekë, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit", në dokumentacionin e vënë në dispozicion në rrugë elektronike konstatohet se:

- Në mendimet të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, përcjellë nëpërmjet sistemit më datë 13.09.2022, kërkohet një preventiv i detajuar: “...përdorimi i fondit rezervë kërkon paraqitjen e preventivit të detajuar dhe zërat e shpenzimeve që parashikohen të realizohen nëpërmjet këtij projekti në zbatim të rregullave e procedurave buxhetore në fuqi”.

- Shkresa përcjellëse për Projekt VKM dhe relacioni i Ministrit të Arsimit vënë në dispozicion të auditimit është pa datë dhe nënshkrime, çka nuk na mundëson nëse janë marrë në konsideratë mendimet e Ministrit të Financave.

Në këtë praktikë mungojnë edhe:

- Memo e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, e cila nëpërmjet NPA i dërgohet Ministrit të Financave,

- Mendime të Ministrit të Drejtësisë, apo të ministrive të tjera nëse i është dërguar.

Nga MAS me shkresën nr. 6976, datë 21.10.2022 “Për zbatimin e VKM nr. 606, datë 14.09.2022” është kërkuar MFE çelja e shtesës së miratuar sipas klasifikimit buxhetor në projektin me kod 91103AB në shumën 200 milion lekë dhe 91104AA në shumën 76 milion lekë. MFE me shkresën nr. 19468/1, datë 28.10.2022 ka miratuar transferimin e fondeve për MAS në këto dy produkte, duke pakësuar llogarinë e Fondit Rezerve, pra veprimet janë kryer me afërsisht 1 muaj e gjysmë nga dalja e vendimit, çka nuk justifikon domosdoshmërinë e përdorimit të Fondit Rezervë.

3. Për VKM nr. 375, datë 01.06.2022 "Për në shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nga Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit për zbatimin e ligjit nr. 25/2022 " Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve" , në dosjen e vënë në dispozicion nëpërmjet strukturës së protokollit mungojnë:

- Projekt Vendimi;

- Relacioni për Projektvendimin;

- Argumentimi i institucionit kërkues për fondet e parashikuara,

- Memo e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit Buxhetor,

- Mendim i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë,

- Mendime të Ministrit të Drejtësisë.

Nga AIDA me shkresën nr. 561, datë 21.07.2022 “Kërkesë për zbatimin e VKM nr. 375, datë 01.06.2022” është kërkuar MFE çelja e shtesës së miratuar sipas klasifikimit buxhetor në projektin me kod 91007AP “Mbështetje për zhvillim të start-up” në llogarinë 604. MFE me shkresën nr. 14043/2, datë 28.07.2022 ka miratuar transferimin e fondeve: duke shtuar llog. 604 me kod 991007AP dhe pakësuar llog 609 me kod 94901AA në shumën 300,000,000 lekë. Bashkëlidhur nuk ka asnjë shkresë apo argument të AIDA apo MFE, fondet janë bërë efektive dy muaj pas daljes së VKM, çka nuk justifikon urgjencën në përdorimin e Fondit Rezervë. Nga të dhënat në sistemin e pagesave SIFQ ky projekt është realizuar në shumën 196,936,089 lekë, ose 65.6% të tij, çka nuk justifikon planifikimin në këtë vlerë dhe domosdoshmërinë e përdorimit të Fondit Rezervë.

4. Me dy VKM i janë akorduar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit fonde për shpërblimin e artistëve dhe për medaljet e marra vitet e kaluara, gjithsej në shumën 215 milionë lekë, si më poshtë:

- Me VKM-së nr. 330, datë 18.05.2022 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për MAS" i janë akorduar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit 170 milionë lekë dhe më

- Me VKM-së nr. 833, datë 19.12.2022 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për MAS" i janë akorduar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit 45 milionë lekë.

Në këtë praktika mungojnë:

- Projekt Vendimi;

- Relacioni për Projektvendimin;

- Argumentimi i institucionit kërkues për fondet e parashikuara,

- Memo e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit Buxhetor,

- Mendim i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë,

- Mendime të Ministrit të Drejtësisë.

Referuar objektit të këtyre VKM -ve për përdorimin e Fondit Rezervë, këto fonde duhej të ishin parashikuar e përfshirë me buxhetin e MAS dhe nuk justifikojnë domosdoshmërinë e përdorimit të Fondit Rezervë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pikat 89 dhe 90.

➤ **Fondi "Për mbështetjen financiare të menjëhershme për zbutjen maksimale të impaktit të inflacionit të luftës në një dimër të vështirë ekonomik për mbarë Evropën"**, i planifikuar për 7.800 milionë lekë me AN nr. 19, datë 29.12.2022, është akorduar sipas 3 VKM-ve dhe deri më datën 31.12.2022, në shumën 7,736.2 milion lekë, ndërsa gjendja e papërdorur është 63.8 milionë lekë. Ky fond është akorduar nga buxheti i shtetit për ndihme financiare për punonjësit e njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik, për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta dhe për mbështetjen financiare të menjëhershme të pensionistëve, për zbutjen e impaktit të krizës.

II. **Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit**

Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit në masën 4.8 miliard lekë, deri me datë 31.12.2022, nuk është përdorur.

III. **Fondi i Kontigjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës gjatë vitit 2022 është akorduar me:**

Me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", në shumën 6,000 milionë lekë, për mbështetjen e shtresave në nevojë, për mbështetjen e sektorit të transportit dhe për mbështetjen e sektorit të bujqësisë dhe që përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave, ndërsa me AN nr. 12, datë 29.07.2022 dhe AN nr. 17, datë 01.12.2022, ky fond miratohet përkatësisht, në shumat 12,100 milion lekë dhe 10,220 milion lekë.

Fondi i kontigjencës për "Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës", planifikuar në shumën 10,220 milionë lekë, është përdorur në shumën 10,086.9 milionë lekë, ose 98.1% e planit, ndërsa më 31.12.2022 ka mbetur i papërdorur në shumën 133.1 milion lekë. Gjatë vitit 2022 ky fond është përdorur përkatësisht, në shumën 9,694 milion lekë, ose 96% e tij, janë akorduar për shpenzime operative (transferta të brendshme) dhe 392.6 milionë lekë, ose 4% e planit, janë akorduar për shpenzime personeli.

Nga auditimi për përdorimin e këtij fondi rezulton se ndër përfituesit kryesorë kanë qenë:

1. *Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural* i janë akorduar fonde në shumën 1,700 milionë lekë, nëpërmjet dy VKM si më poshtë:

- me VKM nr. 245, datë 20.04.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 101, datë 9.02.2022 ‘Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2022’ në shumën 500 milionë lekë dhe

-me VKM nr. 556, datë 29.07.2022, në shumën 1,200 milionë lekë. Këto fonde janë çelur në kuadër të Akteve Normative nr. 3 dhe nr. 12.

2. *Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë* me katër VKM i janë akorduar 6,437.6 milionë lekë, ku veçojmë si më poshtë:

- me VKM nr. 225, datë 13.04.2022 dhe VKM nr. 569, datë 13.12.2022 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetëse dhe ndërqytetëse, pjesë e paketës anti-krizë” faza I dhe II i janë akorduar përkatësisht 430 milionë lekë dhe 120 milionë lekë;

- 507.9 milionë lekë i janë akorduar ministrive dhe institucioneve qendrore për përballimin e efekteve financiare nga rritja e pagave në zbatim të VKM-ve përkatëse.

Nga auditimi i dokumentacionit për nxjerrjen e VKM nr. 621, datë 28.09.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 187, datë 8.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar” vënë në dispozicion në rrugë protokollare konstatojmë mangësitë si më poshtë:

- Memo e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit Buxhetor,

- Mendime të Ministrit të Drejtësisë,

- Korrespondenca me DAP

- Nuk administrohet dhe evidentohet në dokumentacionin kush janë strukturat përkatëse që kanë hartuar P/VKM dhe relacionin.

Në praktikën e VKM bashkëlidhur është relacioni shpjegues (*që sipas dokumentit është përgatitur në Kryeministri*), në Pjesën I “Qëllimi i projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen” citohet si një prej qëllimeve dhe objektiveve “*rritjen e nivelit të pagave për nëpunësit e institucioneve të administratës publike pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, në bazë të politikave të qeverisë shqiptare për vitin 2022, në këtë drejtim*”.

Në Pjesën II “Argumentimi i projektaktit lidhur me përparësitë, problematikat, efektet e pritshme” të këtij Relacioni, citohet se “*Në bazë të politikave të miratuara nga qeveria shqiptare në plan afatmesëm në kuadër edhe të paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, ministria përgjegjëse për financat përcolli pranë DAP-it orientimet përkatëse për rritjen e elementit të pagës mujore “shtesa e pozicionit”, për funksionarët dhe nëpunësit e administratës publike, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi*”.

Pra, në këtë kuadër, në fillim relacioni citon se kjo rritje pagash është bazuar në politikat e qeverisë shqiptare dhe më pas përmendet paketa e rezistencës sociale si arsye për të argumentuar këtë rritje.

Referuar analizës së këtij projektakti, ku përcaktohet se Drejtoria e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit dhe njësitë teknike të përmbajtjes në Departamentin e Administratës Publike kanë kompetenca horizontale që prekin të gjitha institucionet e administratës shtetërore, vlen të theksohet se po njëjloj edhe Drejtoritë me rol koordinues në ministri të tjera, apo në institucione me disa varësi, kanë kompetenca horizontale dhe rol koordinues për këto njësi varësie, duke rezultuar në rol të ngjashëm me strukturat e sipërcituara.

Për më tepër, në momentin që citohet se rritja e pagës do të ndikonte në rritjen e mundësive për zhvillimin në karrierë si dhe do t'ju jepte mundësi MD, MFE dhe DAP për të tërhequr në strukturat e tyre nëpunësit më të kualifikuar nga ministrinë dhe institucionet e tjera, ky arsyetim bie ndesh me vetë konceptin e pagës, pasi paga, në koncept, është shpërblimi për punën që punonjësi kryen dhe nuk mund të jetë arsye primare në rritjen e mundësive të punonjësit për zhvillimin në karrierë. Paga në parim shërben si shpërblim për punën dhe mbi të gjitha, ndikim në pagë ka rezultati i arritur nga puna e kryer.

Për më tepër, përdorimi i arsytimit se rritja e pagave do të tërhiqte punonjës më të kualifikuar, ngre pikëpyetje për profesionalizmin e punonjësve aktualë të këtyre strukturave. Në momentin që, sipas këtij relacioni, këto struktura të sipërpërmendura konsiderohen me një rëndësi të veçantë nga ndikimi i tyre, rrjedhimisht supozohet që të karakterizohen nga një nivel i lartë profesionalizmi. Me argumentimet e Relacionit nga këto struktura “vetëpranohet” se ka nevojë për përmirësime në nivelin e profesionalizmit të stafit, duke pranuar “dështimin” në përthithjen e punonjësve profesionistë.

Në relacion citohet se, në themel të çdo përcaktimi të nivelit të pagës dhe elementëve përbërës të saj, qëndron parimi “shpërblim i njëjtë për punë të njëjtë/ngjashme”. Strukturat e përmendura të MFE, MD dhe DAP nuk janë të vetmet struktura që luajnë rol koordinues; të njëjtin rol koordinues e kryejnë dhe institucione të tjera të cilat kanë njësi të shumta varësie, të cilat janë përjashtuar nga trajtimi i propozuar.

Në përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune, rezulton se shtesa për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm” është më e vogël se shtesa për pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm” dhe “Drejtor Drejtorie” edhe pse pozicionet e Drejtorit të Përgjithshëm/Drejtorit të Drejtorisë janë më të ulta në nivel hierarkik sesa pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm. Në këtë mënyrë, nuk është ruajtur hierarkia për masën e shtesës në fjalë.

Argumentet e përdorura, sa i takon pozicionit “Koordinator” në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit” nuk përbëjnë justifikim për punën konkrete që do të kryhet, pasi së pari kjo drejtori e realizon tashmë këtë funksion koordinues dhe së dyti, të gjitha njësitë shpenzuese i kanë këto struktura.

Pavarësisht se në relacionin për nxjerrjen e këtij vendimi citohet se në themel të çdo përcaktimi të nivelit të pagës dhe elementëve përbërës të saj, qëndron parimi “shpërblim i njëjtë për punë të njëjtë/ngjashme”, mënyra e trajtimit të këtyre strukturave krijon pabarazi në trajtimin e punonjësve.

Pra, strukturat drejtuese e menaxhuese të njërive të qeverisjes qendrore, kërkojnë përdorimin e këtij fondi pa plotësuar kriteret e domosdoshme, MFE i miraton e alokon këto fonde pa pasur dokumentacionin e miratuar ligjor dhe strukturat e Këshillit të Ministrave që i miratojnë këto vendime pa pasur dokumentacionin e plotë ligjor. Për sa konstatuar më lart, për veprimet dhe mosveprimet e tyre, duke ekspozuar cënueshmërinë e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave ngarkohen me përgjegjësi:

z. A.Gj., ish Sekretar i Përgjithshëm, në cilësinë e Nëpunësit të Parë Autorizues;
znj. M.Dh., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;
znj. Xh.A., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit e Monitorimit të Buxhetit;
znj. V.Ç., me detyrë Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor;
znj. Sh.H., me detyrë Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Zbatimit dhe Monitorimit të Buxhetit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është paraqitur observacioni me nr. 5854/50 Prot., datë 07.09.2023 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, protokolluar në KLSH me nr. 281/26Prot., datë 12.09.2023, nga Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit, pa përcaktuar punonjësit përkatës që kanë paraqitur observime, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Lidhur me tejkalimin e kufirit prej 3% të Fondit Rezervë, trajtuar në faqen 171 të Projektraportit, mbahet qëndrimi: *Vlerësojmë që ky konstatim, nuk është i saktë, pasi kufinj të prej 3% të vlerës totale të fondeve të miratuara në përlllogaritjen e Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës në AN-të e sipërcituara, janë respektuar, përkatësisht si më poshtë vijon:*

- Në nenin 7 të AN nr. 12/2022, i cili ndryshon nenin 14 të ligjit nr. 115/2021, janë përvcaktuar fondet rezervë në kuptimin e nenit 5 të LOB-it dhe konkretisht:

- Fondi Rezervë për raste të paparashikuara për 3,350 milion lekë, dhe
- Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit për 4,800 milion lekë.

Këto fonde përbëjnë **1.2% të Totalit të fondeve të miratuara.**

- Në nenin 3, të AN nr. 19/2022, i cili ndryshon nenin 14 të ligjit nr. 115/2021, janë përcaktuar fondet rezervë në kuptim të nenit 5 të LOB-it dhe konkretisht:

- Në masën 2,280 milion lekësh me vendim të Këshillit të Minidstrave, për raste të paparashikuara të njësisve të qeverisjes së përgjithshme;
- Në masën 7,800 milion lekësh me vendime të Këshillit të Ministrave, për mbështetjen financiare të menjëhershme për zbutjen maksimale të impaktit të inflacionit të luftës në një dimër të vështirë ekonomik për mbarë Evropën.

Këto fonde përbëjnë **2.3% të Totalit të fondeve të miratuara.**

-Lidhur me mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e kërkuar nga ana e KLSH-së si dhe në VKM-të e miratuara i mbetemi sqarimeve të dhëna me observacionin e përgatitur nga ana jonë dhe të dërguara pranë KLSH-së me Memon me nr. Prot 5854/43, datë 1.08.2023 “Mbi Akt Konstatimin nr. 5” të KLSH-së.

-Në lidhje me rekomandimin e lënë në faqe 185 të Projektraportit mbahet qëndrimi:

Nga ana jonë i mbetemi qëndrimit tonë duke mos e pranuar këtë rekomandim me shpjegimin: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit për cdo vendim që prek Fondi Rezervë nuk mund të krijojë dosjen me dokumentacionin e plotë për të, për sa kohë që dokumentat përkatës për cdo projektvendim dhe vendim janë të protokolluara dhe pjesë e dosjeve dhe regjistrit zyrtar që mban zyra e protokollit në MFE, për dokumentacionin origjinal respektiv.

Meqenësi i gjithë dokumentacioni origjinal respektiv për çdo VKM gjendet në arshive, mendojmë që rekomandimi në fjalë duhet të adresohet për arshivën, për të krijuar dosjet respektive për çdo VKM.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të observacioneve, sqarojmë se,

- Lidhur me pretendimin se përdorimi i Fondit Rezervë është bërë brenda kufijve të përcaktuar ju kjojmë se nga Fondi Rezervë i KM është përballuar dhe produkti “**Kontigjencë për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizë**”, të cilin ju nuk e përfshini në përlllogaritjet tuaja.

- Sa i takon pretendimeve të sjella për Akt Konstatimin nr. 5, datë 27.07.2023, ato janë trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit dhe ato që kanë patur dokumentacione e mbështetje ligjore janë marrë në konsideratë.

-Sa i takon rekomandimit të lënë në Projekt Raport, për krijimin e dosjeve me dokumentacionin e plotë për çdo VKM, dhe pretendimit tuaj se kjo duhet ti adresohet arshivës, ju risqarojmë se është detyrë e strukturës tuaj paraqitja e dokumentacionit të plotë për vendimmarrjet, por dhe arshivimi i tyre referuar ligjit për arkivat.

Titulli i gjetjes:	Mangësi dokumentare të konstatuara në përputhshmërinë e përdorimit të Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës, tejkalim i kufirit të tij prej 3%.
Situata 1:	Nga auditimi konstatohet se, me ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” është planifikuar vlera 500 milion lekë për projektin për fëmijët dhe rininë me burim Fondin Rezervë, në kundërshtim me nenin 5 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi Fondi Rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit, dhe projekti për fëmijët dhe rininë është plotësisht i parashikueshëm dhe i mundshëm për t’u programuar më parë, duke sjellë për pasojë denatyrin të fondit rezervë në planifikim. -Nga auditimi u konstatua se, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 5, kreu II

	<p>i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Fondi Rezervë i miratuar me Aktet Normative nr. 12, datë 29.07.2022 dhe nr. 19, datë 29.12.2022 ka tejkuluar kufirin e miratuar, përkatësisht përlllogaritet në 3.065% dhe 3.84% të totalit të shpenzimeve të miratuara.</p> <p>-Për vitin 2022, Fondi Rezerve të Buxhetit të Shtetit, në 5 raste, në shumën 1,491 milion lekë është përdorur në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit dhe udhëzimin standard për zbatimin e tij, ndërsa në dokumentacionin shoqërues janë konstatuar mangësi, konkretisht në VKM nr. 287, datë 10.05.2022 " Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për Bashkinë Tiranë, për financimin e projektit "Tirana Youth European Capital 2022", në shumën 700 milion lekë; në VKM nr. 606, datë 28.10.2022 "Për miratimin e Programit Kombëtar të aktiviteteve jashtë orarit mësimor dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit", në shumën 276 milion lekë; në VKM nr. 375, datë 01.06.2022 "Për në shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nga Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit për zbatimin e ligjit nr. 25/2022 " Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve" , në shumën 300 milion lekë; në VKM nr. 330, datë 18.05.2022 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për MAS" akorduar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit 160 milionë lekë dhe VKM nr. 833, datë 19.12.2022 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për MAS" akorduar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit 45 milionë lekë.</p> <p>Referuar objektit të këtyre VKM -ve për përdorimin e Fondit Rezervë, këto fonde duhej të ishin parashikuar e përfshirë me buxhetin e institucioneve dhe nuk justifikojnë përdorimin e Fondit Rezervë, veprime në kundërshtim dhe me UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pikat 89 dhe 90.</p>
Situata 2:	<p>Nga auditimi konstatohet se, Fondi i Kontigjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës gjatë vitit 2022 në një rast është përdorur për përballimin e rritjes së pagave në disa institucione qendrore dhe njësi varësie, ku konstatohen mangësi në dokumentacion, përkatësisht për VKM nr. 621, datë 28.09.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 187, datë 8.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar. Argumentet e përdorura për rritjen e elementit të pagës mujore “shtesa e pozicionit” për disa kategori të veçanta në disa institucione janë të diferencuara dhe përjashtuese për strukturat e ngjashme në institucionet e tjera. Pavarësisht se në relacionin për nxjerrjen e këtij vendimi citohet se në themel të çdo përcaktimi të nivelit të pagës dhe elementëve përbërës të saj, qëndron parimi “shpërblim i njëjtë për punë të njëjtë/ngjashme”, mënyra e trajtimit të këtyre strukturave krijon pabarazi në trajtimin e punonjësve.</p>
	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar , neni 5; - Ligji nr. 10405/2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, neni 4, pika 2; - Ligji nr. 115 /2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar. - UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pikat 89 dhe 90.
Impakti:	Fondeve buxhetore të përdorura jo sipas kriterëve dhe përcaktimeve ligjore.
Shkaku:	Strukturat drejtuese e menaxhuese të njësisve të qeverisjes qendrore, kërkojnë përdorimin e këtij fondi pa kriteret e domosdoshme, MFE i miraton e alokon këto fonde pa pasur dokumentacionin e miratuar ligjor dhe strukturat e

	Këshillit të Ministrave që i miratojnë këto vendime pa pasur dokumentacionin e plotë ligjor.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi 1:	MFE të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për përdorimin e fondit rezervë për rastet që duhet të përfshihen në ciklin normal të shpenzimeve referuar kriterit të parashikueshmërisë dhe dhënien e mendimit të MFE në kushtet e mungesës së dokumentacionit shoqërues të projekt akteve. Në të njëjtën kohë, plotësimi i praktikave të përdorimit të fondit rezervë të jetë objekt i verifikueshmërisë së dokumentacionit të plotë për të vlerësuar kriteret e përdorimit dhe arkivimin e tij.
Rekomandimi 2:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të marrë masa për rishikimin e pagave dhe elementëve përbërës të saj në respektim të parimit “shpërblim i njëjtë për punë të njëjtë/ngjashme”, pasi mënyra e trajtimit me VKM nr. 621, datë 28.09.2021 krijon pabarazi në trajtimin e punonjësve.

2.B.6. Risqet fiskale dhe detyrimet kontigjente. Monitorimi i pagesave për kontratat e koncesioneve/PPP me mbështetje buxhetore. Monitorimi i detyrimeve të prapambetura.

Nga auditimi konstatohet se risqet fiskale lidhen kryesisht me: *risqet nga koncesione/PPP me mbështetje buxhetore, risqet e ndërmarrjet e sektorit energjetik, ndërmarrjet e sektorit ujësjellës kanalizime, detyrimet e prapambetura të qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, detyrimet të tjera kontigjente si: detyrimet nga vendimet e GJEDNJ-së dhe nga vendimet e Arbitrazhit, të cilat janë analizuar si në vijim:*

A. Monitorimi i pagesave për kontratat e koncesioneve/PPP me mbështetje buxhetore

Sipas raportimit në faqen 57-58 në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për vitin 2022 rezultojnë:

-11 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore;

-për të gjitha kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore janë realizuar pagesa faktike.

Nga auditimi evidentohet se në tabelën e paraqitur për koncesionet/PPP me mbështetje buxhetore paraqiten 12 kontrata dhe për kontratën koncesionare/PPP Ndërtimi dhe Operimi i rrugës Milot-Balldren, plani dhe fakti, rezultojnë 0 lekë. Si rrjedhojë nga 12 kontrata koncesionare për 1 prej tyre nuk janë realizuar pagesa.

Në total, plani përfundimtar për këto projekte paraqitet në shumën 12,706,156 mijë lekë, ndërkohë që pagesat rezultuan në shumën 12,640,991 mijë lekë, me një realizim në masën 99,5%. Pagesat vjetore faktike nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare apo PPP, rezultuan në shumën 12,640,991 mijë lekë ose 2.66 % e totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2021, prej rreth 475.61 miliardë lekë, duke qenë brenda kufirit të pagesave prej 5% të të ardhurave tatimore faktike.

Sipas raportit të buxhetit faktik 2022, të detajuara sipas kontratave respektive plani dhe pagesat për kontratat koncesionare/PPP aktualisht në zbatim paraqiten:

Mijë lekë

Autoriteti Kontraktor	Nr	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti fillimi	Viti mbarimi	2021		2022		
					Plan	Fakt	Plan fillestar	Plan i ndryshuar	Fakt
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2022	752,771	690,040	188,200	376,400	376,385
		Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2015	2021	50,000	40,292	-	-	-
	2	Përmirësimi, Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës së	2018	2031	3,393,100	3,392,727	2,940,000	2,940,000	2,940,000

		Arbrit							
	3	Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot – Morinë	2019	2032	792,259	790,027	743,000	740,978	740,978
	4	Përmirësim, Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje e Rrugës Porti i Jahteve – By Pass Orikum – Dukat (Ura e Shën Elizës)	2019	2032	48,029	47,069	312,000	224,699	224,698
	5	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Balldren	2020	2033	3,100	3,100	-	-	-
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë	2013	2030	1,660,686	1,660,686	1,965,913	1,925,922	1,925,903
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë (Check-up)	2015	2025	366,090	219,021	876,090	876,090	876,083
	2	Konçesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2016	2026	1,564,982	1,500,924	1,700,000	1,700,000	1,699,975
	3	Konçesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës)	2016	2026	754,000	747,195	835,000	835,000	802,583
	4	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	2020	2030	1,137,845	1,103,199	1,574,900	1,639,002	1,612,914
Bashkia Tiranë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës "Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1"	2018	2025	0	0		395,074	395,074
MIE / Bashkia Tiranë	1	Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike"	2017	2047	1,300,000	1,249,399	650,000	1,052,990	1,046,397
					700,000	651,626	450,000	872,990	866,675
					600,000	597,773	200,000	180,000	179,722
12	TOTAL				11,822,862	11,443,679	11,785,103	12,706,156	12,640,991

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga auditimi konstatohet se në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2021”, pagesat e realizuara të vitit 2021 rezultojnë në vlerën 11,517,745 mijë lekë ndërkohë që në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, pagesat e vitit 2021 rezultojnë 11,443,679 mijë lekë, pra 74,066 mijë lekë më pak.

Sipas të dhënave të MFE, shpenzimet për kontratat koncesionare/PPP për periudhën 2020-2022 kanë pësuar rritje nga viti në viti, paraqitur si në vijim:

Emërtimi	2020	2021	2022
Shpenzime faktike (mijë lekë)	9,633,635	11,517,745	12,640,991
Nr. kontratash të financuara	10	12	11
Rritja në vlerë (mijë lekë)		1,884,110	1,123,246
Rritja në %		19.6%	9.8%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga KLSH

Kontratat koncesionare/PPP që rezultojnë me rritje pagesash për periudhën 2021-2021 janë:

-kontrata “Përmirësim, Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje e Rrugës Porti i Jahteve – By Pass Orikum-Dukat (Ura e Shën Elizës)”;

-kontrata “Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë”;

-kontrata “Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë (Check-up)”;

-kontrata “Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale”;

-kontrata “Ofrimi i shërbimit të dializës”;

-kontrata “Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore”.

Rritja e shpenzimeve për kontratat koncesionare/PPP nga viti në vit përbën një risk fiskal për buxhetin, për më tepër që në mungesë të treguesve të matshëm të performancës së tyre bën të diskutueshme dhe arritjen në kohë të objektivave të tyre me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet. Gjithashtu duke qenë se këto kontrata koncesionare/PPP janë me mbështetje buxhetore dhe koncesionari nuk ka përgjegjësi apo angazhim financiar, këto shpenzime nga ana e buxhetit të shtetit janë një borxh i fshehur për vitet në vijim.

Në mënyrë të detajuar, auditimi në lidhje me koncesionet/PPP me mbështetje buxhetore duke përfshirë, planin, pagesat faktike dhe regjistrimet në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë paraqiten si në vijim:

1. Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier

Ky projekt koncesionar është planifikuar në PBA 2022-2024 sipas tabelës së mëposhtme:

Produkti	Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier.	Kodi i Projektit sipas listës së investimeve	M064079	
			2023	2024
	2021	2022		
Kosto totale (në mijë lekë)	752,771,000	630,000,000	0	0

Projekti koncesionar/PPP për inceneratorin e Fierit është detajuar në fondet e investimeve me kod projekti "M064079" dhe ka pësuar ndryshime në rritje përgjatë vitit sipas tabelës së mëposhtme:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	-	-	-	-	188,200,000	188,200,000
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
	376,400,000	376,400,000	376,400,000	376,400,000	376,400,000	376,400,000

Ky projekt është çelur në mes të vitit dhe nuk reflekton vlerën e plotë të angazhimit, si rrjedhojë as ndryshime të argumentuara buxhetore. Pagesat e kryera gjatë vitit 2022 për këtë kontratë koncesionare janë në shumën 376,385 mijë lekë, sipas 6 urdhër shpenzimeve të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë të kryera nga ana e aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Secila faturë rezulton në vlerën 62,731 mijë lekë.

2. Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit

Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e rrugës së Arbrit. Kontrata e koncesionit është nënshkruar në 16.03.2018, në vlerën 33.6 miliard lekë pa TVSH ose 40.32 miliard lekë me TVSH. Ky projekt koncesionar është planifikuar në PBA 2022-2024, sipas tabelës së mëposhtme:

Produkti	Kontrata koncesionare "Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e rrugës së Arbrit PPP	Kodi i Projektit sipas listës së investimeve	18BA201	
			2023	2024
	2021	2022		
Kosto totale (në mijë lekë)	3,180,000,000	2,940,000,000	2,844,000,000	3,504,000,000

Ky projekt është detajuar në fondet e investimeve me kod projekti "18BA201" dhe nuk ka pësuar ndryshime përgjatë vitit sipas tabelës së mëposhtme:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	2,940,000,000	2,940,000,000	2,940,000,000	2,940,000,000	2,940,000,000	2,940,000,000
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
	2,940,000,000	2,940,000,000	2,940,000,000	2,940,000,000	2,940,000,000	2,940,000,000

Pagesat e kryera gjatë vitit 2022 për këtë kontratë koncesionare janë në shumën 2,940,000 mijë lekë, sipas 4 urdhër shpenzimeve të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë të kryera nga ana e aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe i përkasin shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, konkretisht faturave të vitit 2019 dhe 2020.

3. Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rrugës Milot-Morinë

Planifikimi në PBA 2022-2024 paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Produkti	Subvencioni i Kontratës koncesionare "Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot - Morinë"	Kodi i Projektit sipas listës së investimeve	18BA203	
			2023	2024
	2021	2022		
Kosto totale (në mijë lekë)	740,259,000	743,000,000	743,000,000	743,000,000

Projekti koncesionar/PPP për subvencionimin e rrugës Milot - Morinë është detajuar në fondet e investimeve me kod projekti “18BA203” i cili përgjatë vitit paraqitet si në vijim:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	743,000,000	743,000,000	743,000,000	743,000,000	743,000,000	743,000,000
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
	743,000,000	743,000,000	741,000,000	741,000,000	740,978,300	740,978,300

Pagesat e kryera gjatë vitit 2022 për këtë projekt janë në shumën 740,978 mijë lekë, sipas 2 urdhër shpenzimeve të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë të kryera nga ana e aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

4. Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Orikum – Dukat

Në PBA 2022-2024, ky projekt koncesionar paraqet planin e pagesave si më poshtë:

Produkti	Ndërtim dhe operimi i rrugës Orikum-Dukat		Kodi i Projektit sipas listës së investimeve		18BA213	
	2021	2022	2023	2024		
Kosto totale (në mijë lekë)	579,000	312,000,000	1,004,000,000	960,000,000		

Plani buxhetor i detajuar për projektin me kod “18BA213” në fillim të vitit 2022 dhe i ndryshuar përgjatë vitit sipas muajve përkatës paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	312,000,000	312,000,000	312,000,000	312,000,000	312,000,000	312,000,000
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
	312,000,000	312,000,000	260,500,000	260,500,000	227,825,000	224,699,000

Gjatë vitit 2022 pagesat e kryera janë në vlerën 224,698 mijë lekë, sipas 3 urdhër shpenzimeve. Nga auditimi konstatohet se 2 fatura në vlerën totale 150,532 mijë lekë i përkasin shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, konkretisht vitit 2021.

5. Shërbimi i Skanimit në Dogana

Planifikimi në PBA 2022-2024 paraqitet:

Produkti	Shërbim skanimi 91005AE			
	2021	2022	2023	2024
Kosto totale (në mijë lekë)	1,660,686,100	1,965,913,355	1,676,962,054	1,727,270,916

Plani buxhetor i detajuar për projektin me kod “91005AE” është çelur në vlerën 1,965,913,355 lekë dhe përgjatë vitit ka pësuar ndryshimet si në vijim:

BUDGET REVISION ID	GL PERIOD NAME	BUDGET BALANCE	REVISION TYPE	REVISION AMOUNT	LAST UPDATE DATE	CREATION DATE
6573327	02-2022	1,965,913,355	D	340,205,000	18-FEB-22	17-FEB-22
6595352	03-2022	1,625,708,355	I	100,000,000	30-MAR-22	30-MAR-22
6596355	03-2022	1,725,708,355	D	100,000,000	31-MAR-22	31-MAR-22
6598383	04-2022	1,625,708,355	I	100,000,000	06-APR-22	06-APR-22
6707408	10-2022	1,725,708,355	I	13,600,000	31-OCT-22	27-OCT-22
6711423	11-2022	1,739,308,355	I	25,570,000	04-NOV-22	01-NOV-22
6738527	12-2022	1,764,878,355	I	166,744,000	19-DEC-22	19-DEC-22

Pagesat e realizuara në vitin 2022 sipas databazës së pagesave në SIFQ rezultojnë në shumën 1,898,906 mijë lekë sipas 69 urdhër shpenzimeve.

Nga vlera e paguar për këtë kontratë, konstatohet se për 8 urdhër shpenzime, në shumën 231,864 mijë lekë i përkasin detyrimeve të prapambetura periudhës 2020-2021, të cilat janë paguar duke përdorur buxhetin e miratuar për vitin 2022, konkretisht:

-4 fatura me datë furnitori viti 2020 në vlerën 138,919 mijë lekë.

-4 fatura me datë furnitori viti 2021 në vlerën 92,945 mijë lekë.

Vlera e paguar sipas databazës së pagesave në SIFQ rezulton me një diferencë krahasuar me vlerën e raportuar në raportin e buxhetit faktik 2022, pasi kjo e fundit rezulton 1,925,903 mijë lekë. Diferenca midis raportimit dhe SIFQ rezulton në vlerën 26,997 mijë lekë.

6. Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës

Për këtë kontratë koncesionare, buxheti është detajuar për herë të parë në qershor të vitit 2022, si në vijim:

BUDGET REVISION ID	GL PERIOD NAME	BUDGET BALANCE	REVISION TYPE	REVISION AMOUNT	LAST UPDATE DATE	CREATION DATE
6643376	06-2022	0	I	197,537,194	22-JUN-22	22-JUN-22

Bashkia e Tiranës si autoritet kontraktues ka paguar 395,047 mijë lekë, të financuara nga të ardhurat e veta dhe buxheti i vendosur në dispozicion nga MASR, në masën 50% me 50%, konkretisht nga 197,537 mijë lekë.

Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës është një kontratë koncesionare e nënshkruar në datën 17.10.2018 ndërmjet MAS dhe Bashkisë Tiranë me BOE

në shumën 2,364,096,027 lekë, në të cilën është ndërmarrë angazhimi për kryerjen e pagesës së kësaj shumë për shtatë vjet nga momenti i marrjes në dorëzim, *angazhim pa fonde buxhetore*. Kjo kontratë është regjistruar në modulën e kontratave në datën 31.05.2022 në vlerën 197,537,194 lekë, me kod projekti 18BC893, kontratë e copëzuar dhe jo në vlerën e saj të plotë.

7. Inceneratori i Tiranës

Në PBA 2022-2024 ky projekt koncesionar, vetëm për pjesën e financuar nga ana e MIE në programin e mbetjeve urbane paraqet planin e pagesave si më poshtë:

Produkti	Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Tiranë 90610AA			
	2021	2022	2023	2024
Kosto totale (në mijë lekë)	600,000,000	200,000,000	200,000,000	200,000,000

Vlera e detajuar në fillim të vitit për këtë projekt koncesionar paraqitet në shumën 200,000,000 dhe e rishikuar në ulje në shumën 180,000,000 lekë, plan përfundimtar. Këto ndryshime buxhetit me ulje, krahasuar me vitet e kaluara, për kontratat në vazhdim rezultojnë të paargumentuara. Pagesat e realizuara përgjatë vitit 2022 sipas raportimit në “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, rezultojnë 1,046,397 mijë lekë. Këto pagesa sipas SIFQ janë financuar në shumën 179,722 mijë lekë nga buxheti i MIE, programi i mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej 866,675 mijë lekë është financuar prej të ardhurave të veta të Bashkisë Tiranë.

Pagesat faktike për muajin Dhjetor rezultojnë rreth 15.94% të totalit të pagesave faktike për vitin 2022, ku vetëm pagesa prej 840 milion lekë për kontratën “Për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit” përbën 80% të totalit të pagesave të realizuara në muajin Dhjetor.

Nga auditimi konstatohet se janë krijuar detyrime të prapambetura si dhe gjatë vitit janë shlyer detyrime të viteve të mëparshme, konkretisht:

- projekti *Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit*;
- Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Oriku* – *Dukat*;
- Shërbimi i Skanimit në Dogana*.

Koncesioni i skanimit në dogana përfshin kryerjen e pagesave në bazë të nivelit shërbim të ofruar kushtëzuar nga kërkesa për këtë shërbim, kërkesë kjo që mund të jetë mbi nivelin e buxhetuar. Realizimi i shërbimit përtej vlerës së buxhetuar ka shkaktuar krijimin e detyrimeve të prapambetura për vitin aktual dhe në të njëjtën kohë mbartjen e tyre në vitin pasardhës.

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2023 nuk është publikuar raporti i Performancës së Kontratave të Koncesionit dhe të Partneritetit Publik Privat për vitin 2022.

Monitorimi i risqeve fiskale dhe buxhetore që burojnë nga kontratat e koncesionit/PPP dhe publikimi është përcaktim i pikës 7 të nenit 10 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar dhe udhëzimit plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”. Ky raport përfshin mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të ecurisë dhe performancës financiare dhe jofinanciare të kontratave të koncesionit/PPP dhe synon të sigurojë që risqet kryesore fiskale nga kontratat e koncesionit/PPP janë identifikuar dhe raportuar në mënyrë sistematike.

Për sa më sipër mos-publikimi i këtij raporti dhe mungesa e raportimit të tij bashkëlidhur Raportit mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022, cilësohet mungesë transparence nga ana e MFE dhe veprim në kundërshtim me: pikën 7 të nenit 10 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar dhe shkronjën c, të pikës 126.3, të kapitullit IV “Raportimi dhe monitorimi i risqeve fiskale nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësi të tjera të sektorit publik” të udhëzimit plotësues nr. 2 datë 19.01.2023.

B. Ndërmarrjet e Sektorit Energjetik

Për periudhën objekt auditimi konstatohet se sektori i energjisë ka përfituar mbështetje buxhetore, konkretisht si në vijim:

➤ Për vitin 2022 KESH sh.a është mbështetur nga marrëveshja e huasë e datës 24.03.2022 me MFE-në, në vlerën 8 miliardë lekë si dhe nga mbështetja buxhetore në vlerën 20 miliardë lekë.

➤ Projektet e investimeve me financim të huaj për këtë sektor gjatë vitit 2022 janë miratuar në vlerën 2.1 miliardë lekë, sipas buxhetit fillestar të miratuar me Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, mbështetje të cilat nuk janë përkthyer në rezultat për këtë sektor duke qenë se ende nuk ka përfunduar procesi i rakordimit të detyrimeve të ndërsjella ndërmjet sektorit publik dhe enteve të tjera publike dhe këto detyrime kanë ardhur duke u rritur. Këto detyrime sipas raportit “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, faqe nr. 50, paraqiten si në vijim:

Deri në Dhjetor 2022 (në mld LEK)	KESH	OST	OSHEE	MFE	DPT	Total
KESH ndaj:		0*		33.69		33.69
OST ndaj:	9.19*		1.66	8.66		19.51
OSHEE ndaj:	51.13**	9.50**		2.69	5.19	68.51
Ndërmarrjet UK ndaj:			25.35	10.39		35.74
ML/IB			5.67			5.67
Total	60.32		32.67	55.42	5.19	163.11

Burimi: MFE, KESH, OST, OSHEE Group, dhe AKUM (2023)

*Vlera e detyrimeve të ndërsjella varion nga 0-0.194 mld lekë për KESH ndaj OST dhe nga 9.193-10.547 mld lekë për OST ndaj KESH, për arsye të mosrakordimit mes tyre.

**Vlera e detyrimeve të ndërsjella varion nga 51.13-56.04 lekë për OSHEE ndaj KESH dhe nga 9.50-18.55 mld lekë për OSHEE ndaj OST, për arsye të mosrakordimit mes tyre.

Detyrimet e ndërsjella në sektorin e energjisë elektrike për vitin 2021 rezultojnë në vlerën 144.21 miliardë lekë, pra në fund të vitit 2022 paraqiten 163.11 miliardë ose me një vlerë prej 18.9 miliardë me tepër.

Kjo vlerë paraqet riskun për të qenë më e lartë për 2 arsye:

1. Detyrimet e ndërmarrjeve UK ndaj OSHEE dhe detyrimet e ML/IB ndaj OSHEE, janë raportuar për periudhën deri më 31.09.2022, në kundërshtim me pikën 143, të kreut 6, të Udhëzimit Plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” ku parashikohet ndër të tjera monitorimi nga MFE dhe raportimi periodik mbi bazë tremujore të detyrimeve të ndërsjellta të sektorit energjetik dhe palëve të treta.

2. Në vlerën e detyrimeve të ndërsjella ende të pa-rakorduara është marr kufiri minimal i detyrimit. Nëse kjo do të llogaritej me kufirin maksimal tek i cili variojnë detyrimet, detyrimi total i ndërsjellë do të shkonte në vlerën 178.62 miliardë lekë.

C. Ndërmarrjet e Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve

Për periudhën objekt auditimi konstatohet se sektori ujësjellës kanalizime vijon të paraqitet me vështirësi në pagimin e detyrimeve dhe mbledhjen e të ardhurave të faturuara korrente dhe të prapambetura edhe pse ka përfituar subvencione në vlerën prej 360 milion lekësh.

Nga auditimi konstatohet se në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022” mungon raportimi mbi të dhënat financiare të ndërmarrjeve të këtij sektori. Sipas këtij raporti, për periudhën deri në Dhjetor 2022, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) raporton se detyrimet e akumuluar të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të jenë në vlerën 14.01 miliardë lekë (pa kamata), ku pjesën më të madhe të detyrimit e zë ndërmarrja e UK Sh.a Durrës me 4.93 miliardë lekë detyrime. Kjo e dhënë nuk rakordon me raportimin me tabelën nr. 14 të faqes 50 të këtij raporti, ku detyrimet e ndërmarrjeve UK ndaj OSHEE rezultojnë të raportuara 25.35 miliard.

Po kështu krahasuar me raportimet e vitit 2021 rezultojnë se referuar raportit të “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2021”, faqe 52 citohet se:

Për periudhën deri në Dhjetor 2021, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) pas rakordimit të të dhënave me OSHEE Group Sh.a, raporton se detyrimet e akumuluarra të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të jenë në vlerën 21.9 miliardë lekë, ku vetëm ndërmarrja e UK sh.a Durrës ka 6.71 miliardë lekë të këtyre detyrimeve. Për sa më sipër të dhënat e raportuara për fundin e vitit 2021, nuk rakordojnë me të dhënat e fillimit të vitit 2022 dhe si rrjedhojë as me raportimin e dhjetor 2022. Sipas sqarimeve të MFE raportimet kanë diferenca për arsyen se në vitin 2021 janë përlllogaritur sëbashku me kamatat. Paraqitja e detyrimeve të këtij sektori për vitin 2022 pa kamata ka nënvlerësuar këtë të fundit.

MFE dhe MIE kanë dështuar në zbatimin e dy urdhrave të përbashkët të viteve 2020 dhe 2021 “Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, pasi detyrimet janë shtuar me 17 % në vitin 2022.

Po ashtu, nuk kanë qenë rezultative as intensifikimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës: ndërmarrjet Ujësjellës –Kanalizimeve me MIE, si dhe me ndërmarrjet e sektorit të energjisë.

D. Detyrimet e prapambetura për qeverisjen e përgjithshme nga MFE

Me qëllim evidentimin, monitorimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, është kërkuar vazhdimisht një angazhim maksimal i MFE dhe institucioneve buxhetore, duke qenë se akumulimi i detyrimeve të prapambetura përbën një problematikë për sistemin buxhetor, kjo në zbatim të ligjit organik të buxhetit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, në nenin 52. **Detyrimet e prapambetura nuk përlllogariten dhe nuk përfshihen si vlerë në raportet dhe statistikat e borxhit publik, duke e nënvlerësuar këtë të fundit.**

Monitorimi aktual i kryer nga MFE nëpërmjet Udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 për “Monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme” konstatohet se nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 31 të Udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar dhe me pikën 33. Format i administrimit të të dhënave mbi detyrimet e prapambetura nga ana e Ministrisë së Financave nuk paraqet informacion mbi kohën e krijimit të detyrimit së bashku me shtesat dhe pakësimin përgjatë vitit, duke krijuar në këtë mënyrë kushte për mosrespektimin e parimit FIFO në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, auditimi dhe konstatimi i të cilave ka qenë në fokus nga KLSH ku dhe janë identifikuar një sërë parregullsish, veçanërisht në likuidimin e detyrimeve si rezultat i vendimeve për largimin nga puna të ish punonjësve. Njësoj si dhe në vitet e kaluara edhe për periudhën objekt auditimi vitin 2022, janë konstatuar një sërë problematikash lidhur me disiplinimin e angazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, situata këto që konstatohen me impakt për shkak të cënimit të kontrolleve për marrjen e angazhimeve buxhetore pa fonde disponibël, apo për marrjen e masave për reduktimin e këtij stoku.

Nga auditimi mbi rakordimin e detyrimeve të prapambetura ndërmjet të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, publikimit të tyre në faqen zyrtare të MFE dhe në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, konstatohet si në vijim:

Në milion lekë

Detyrimet e prapambetura	DPTH	Të dhënat e DPB për KLSH	ËEB MFE	Raporti Buxheti faktik 2022
Të njësisë qendrore	4,738.9	6,769.7	6,769.7	6,769.7
Të vetëqeverisjes vendore	7,714.1	5,428.9	5,428.9	5,428.9
Për rimbursimin e TVSH	-	-	-	-
Extrabuxhetorëve Vendor	300.2	547.6	547.6	pa raportim
Të universiteteve		7.1	7.1	pa raportim
Total	12,753.2	12,753.3	12,753.3	12,198.6

Burimi: Raportimet e DPTH, DPB, WEB, Raporti mbi zbatimin e buxhetit vjetor 2022, përpunuar nga KLSH

Për sa më sipër konstatohet se të dhënat e raportuara paraqiten me diferenca në detajimin e detyrimeve të prapambetura sipas llogarive përkatëse dhe vlerave të raportuara, kryesisht për qeverisjen qendrore dhe vetëqeverisjen vendore, krahasuar midis të dhënave të marra nga SIFQ dhe atyre të publikuara në faqen zyrtare të MFE dhe në raportin vjetor mbi zbatimin e buxhetit.

Deri në fund të muajit Dhjetor 2022 nisur nga raporti “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022” dhe raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit rezulton se u regjistrua një stok kumulativ prej 12.2 miliardë lekë (pa përfshirë detyrime ujësjellës kanalizime dhe detyrimet e universiteteve) nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat:

- ✓ Totali detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 6.77 miliardë lekë
 - ✓ Totali detyrimeve për rimbursimin e TVSH-së rreth 0 miliardë lekë
 - ✓ Totali detyrimeve të qeverisë vendore rreth 5.43 miliardë lekë, detajuar si në vijim:
- Krahasuar me vitin 2021, detyrimet e prapambetura paraqiten si në vijim:

Detyrimet e prapambetura të ndara në kategori	Viti 2021	Viti 2022
Totali detyrimeve të qeverisë qendrore	6.15	6.77
Totali detyrimeve të qeverisë vendore	6.6	5.43
Totali detyrimeve për rimbursimin e TVSH-së	0.48	-
Total	13.23	12.20

Miliardë lekë

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

➤ Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore

Sipas raportimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit situata deri në Dhjetor 2022 e stokut të detyrimeve të prapambetura paraqitet e detajuar në aneks.

Konstatohet se vetëm 13 bashki (në totalin bashki/qarqe) konkretisht: Bashkia Tiranë, Kavajë, Vorë, Pogradec, Kamzë, Dibër, Cërrik, Dimal, Devoll, Fier, Vlorë, Durrës, Peqin, përbëjnë rreth 73% të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore.


Pesha që zënë kategoritë kryesore të detyrimeve të prapambetura, krahasuar dhe me vitin 2021 rezultojnë si në vijim:

Detyrimet e prapambetura të ndara në kategori	Viti 2021	Viti 2022
Investime	54.7%	44%
Detyrime të prapambetura të tjera	14.7%	28%
Shërbime	10.9%	11%
Vendime gjyqësore	10.5%	10%
Mallra	5.2%	4%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Për sa më sipër konstatohet se kategoria detyrime të prapambetura të tjera ka një rritje gati me dyfish krahasuar me vitin 2021, kategori e cila nuk specifikon çfarë detyrimesh të prapambetura përfshihen në këtë zë, ndërkohë që zërat e tjera janë në raporte pak a shumë të njëjta me vitin e kaluar.

Të përmbledhura grafikisht sipas kategorisë, detyrimet e prapambetura për vitin 2022 paraqiten si në vijim:



➤ **Detyrimet e prapambetura të njërive të qeverisjes së përgjithshme qendrore**

Sipas raportimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit situata deri në Dhjetor 2022 e stokut të detyrimeve të prapambetura paraqitet e detajuar në aneks:

Konstatohet se vetëm 4 Ministrinë (përkatësisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë) përbëjnë rreth 91% të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura të njërive të qeverisjes qendrore.


Pesha që zë secila kategori detyrim i prapambetur, krahasuar dhe me vitin 2021 rezulton si në vijim:

Detyrimet e prapambetura të ndara në kategori	Viti 2021	Viti 2022
Vendimet Gjyqësore	10.5%	47.9%
Investimet	54.7%	35.5%
Detyrime të prapambetura të tjera	14.7%	9.5%
Mallra	5.2%	0.8%
Shërbimet	10.9%	0.6%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Për sa më sipër konstatohet se detyrimet e prapambetura për zërin vendime gjyqësore kanë ardhur me rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2021, me një rritje të konsiderueshme 37.4%.

Të përmbledhura grafikisht sipas kategorisë, detyrimet e prapambetura për vitin 2022 paraqiten si në vijim:



Në faqe 54 të raportit “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022” citohet: “...duke konsideruar që procesi i shlyerjes së detyrimeve nga ana e institucioneve kryhet në respektim të parimit FIFO, rezulton se detyrimet që mbeten për t’u shlyer gjatë vitit 2022 karakterizohen nga një “moshë mesatare” e re e krijimit të tyre”. Ky konstatim nga ana e MFE-së nuk qëndron duke qenë se nga auditimi janë konstatuar raste të mosrespektimit të parimit FIFO dhe po kështu likuidime të faturave të viteve të kaluara, duke filluar nga viti 2013. Gjithashtu ky konstatim bie në kundërshtim me raportin “Mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2022” konkretisht në faqen 65 “Gjetjet kryesore në sistemin e detyrimeve të prapambetura” ku ndër të tjera evidentohet mosrespektim i qasjes FIFO në radhën e shlyerjes së detyrimeve.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimin plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, nuk ka kërkuar nga njësitë e qeverisjes qendrore hartimin e një plani për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, me qëllim përfshirjen e tij në propozimet e PBA-së, në kundërshtim me tabelën nr. 5 “Kriteret për kostimin e politikave ekzistuese”, të kapitullit 6.3 të PBA-së nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”. Në këtë drejtim, planifikimi buxhetor për një periudhë afatmesme nuk ka parashikuar të trajtojë me prioritet likuidimin e detyrimeve krahasuar me fondet që do të alokohen për projekte të reja. Kjo është kërkuar vetëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore në pikën 128, të kreut III, të Udhëzimit plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”. Hartimi në këtë formë i PBA-së do të mund të garantonte që fondet e kërkuara nga institucionet të kenë marrë në konsideratë fillimisht likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe detyrimet në kuadër të kontratave në zbatim, përpara financimit të projekteve të reja. Kjo edhe në zbatim të nenit 43 të Ligjit nr.

9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 i cili në pikën 63 të tij përcakton prioritet për t’u mbajtur parasysh në planifikim. Kryerja e rishikimeve përgjatë vitit për alokimin e fondeve të cilat janë përdorur për likuidimin e detyrimeve të kontratave të lidhura në vitet e mëparshme, është një ndër treguesit që gjatë hartimit të projekt buxhetit, nuk janë marrë në konsideratë këto detyrime.

➤ **Stokut i detyrimeve të prapambetura nga rimbursimi i TVSH-së**

Nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT është përcjellë raportimi periodik që Drejtoria e Rimbursimit ka bërë në MFE, në zbatim të Udhëzimit nr. 37 datë 06.10.2020 mbi detyrimet e krijuara rishtazi dhe stokun e detyrimeve të prapambetura për periudhën deri në 31 Dhjetor 2022 ku ato paraqiten në vlerën rreth 0 milion lekë, me një ulje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2021 që rezultonte në vlerën 476,7 milion lekë. Nuk rezulton diferencë midis raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, publikimit të vlerës në faqen zyrtare të MFE-s dhe raportit mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022 hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Raportimi i detyrimeve të prapambetura - Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

U analizuan të dhënat e vëna në dispozicion në lidhje me shumat e paguara, si dhe gjendja e detyrimeve të prapambetura raportuar më 31.12.2022 (grupi 486, llogaria 4864 “shpenzime të periudhave të ardhshme-faturo të prapambetura” analitike sipas natyrës së detyrimit të deklaruar dhe raportuar nga çdo institucion):

Detyrimet e prapambetura deri në fund të vitit 2022 paraqiten në shumën 12,753,240 mijë lekë (v.2021: 13,334,943 mijë lekë, vlerë e raportuar në përfundim të auditimit nga KLSH për vitin 2021) ose 581,703 mijë lekë më pak se një vit më parë.

Mijë lekë

	Detyrimi i mbetur në fund të vitit raportues
Stoku 2022	12,753,240
Stoku 2021	13,334,943
Neto ndryshimi stokut 2022-2021	(581,703)

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit bazuar në evidencat e Drejtorisë së Thesarit në MFE

Testimet e auditimit janë kryer me të dhënat e paraqitura nga DPTH, me objekt auditimi detyrimet e prapambetura të vitit 2022.

Me qëllim vlerësimin e saktësisë dhe plotësisë së këtij raportimi u krahasuan të dhënat e raportuara nga njësitë, konkretisht shumat e deklaruara “të paguara” gjatë vitit 2022 me të dhënat e SIFQ të vëna në dispozicion, nga të cilat konstatohet se pagesat për faturat dhe detyrime të tjera rezultojnë 9,828,089 mijë lekë më shumë se pagesat e raportuara, si në vijim:

Mijë lekë

Shtesa e llogaritur KLSH	Pakësime sipas raportit	Gjendje fund sipas raportit	Sipas Pagesave të Thesarit	Diferenca
23,132,808	23,730,883	12,753,240	33,558,972	(9,828,089)

Vlera prej 9,828,089 mijë lekë nënkupton fatura të prapambetura të padeklaruara më parë nëpërmjet skemës së parashikuar në udhëzimin nr. 5 datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, procedurë që do të rriste balancën fillestare të vitit 2022 me rreth 9.8 miliardë lekë.

Konkretisht nga testimet e KLSH-së ka rezultuar se:

502 Institucione nga 1031, rezultojnë me diferencë në raportim si në vijim:

Mijë lekë

Statusi Rakordimit	Nr. Njësite	Pagesa 2022 të raportuara	Pagesa 2022 në SIFQ	Diferenca raportuar-paguar
Kanë kryer pagesa/ ska raportuar	251	0	4,502,688	(4,502,688)
Ka raportuar/ska kryer pagesa	37	74,275	0	74,275
Kanë raportuar shumën më të vogël se pagesat e kryera	110	4,787,718	14,553,646	(9,765,928)
Kanë raportuar shumën më të mëdha se pagesat e kryera	104	18,737,338	14,371,087	4,366,251

Pagesa = raportim	44	131,551	131,551	0
0 raportim 0 pagesa	485	0	0	0
Total	1031	23,730,882	33,558,972	9,828,089

Nga auditimi konstatohet se 30 institucione nga 1031 të listuara me detyrime të prapambetura më 31.12.2022 (llogaria 4864 sipas SIFQ) përbëjnë 72% të stokut total të detyrimeve ku veçojmë Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës me 11% të totalit, Bashkinë e Tiranës me 9%, Bashkinë e Kavajës me 7%, INUK me 5%, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me 4%, Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me 3%, etj. Për më tepër detajuar në aneks.

Institucionet që sipas raportit rezultojnë me pagesa të raportuara më të mëdha se pagesat e testuara nga SIFQ

Nga auditimi u konstatuan se 104 institucione kanë raportuar pagesa më të mëdha sesa pagesat faktike. Institucionet me diferencat më të larta midis raportimit dhe pagesave në këtë kategori janë ARRSH, Bashkia Tirana, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave etj. Për më tepër detajuar në aneks.

Institucionet që sipas raportit rezultojnë me pagesa të raportuara më të vogla se pagesat e testuara nga SIFQ

Nga auditimi u konstatuan se 110 institucione kanë raportuar pagesa më të vogla sesa pagesat faktike. Institucionet me diferenca më të mëdha midis raportimit dhe pagesave në këtë kategori rezultojnë MIE, AKSHI, Bashkia Kamzë, Bashkia Krujë, Aparati i MFE-së etj. Për më tepër detajuar në aneks.

Institucione nuk rezultojnë në databazën e raportimeve për detyrime të prapambetura

Nga auditimi i të dhënave të llogarisë 4864, 251 institucione nuk rezultojnë në databazën e raportimeve për detyrime të prapambetura për vitin 2022, ndërkohë që nga Thesari për këto institucione/njësi rezultojnë pagesa, të detajuara në aneks. Institucionet me peshën më të madhe që kanë kryer pagesa për detyrime të prapambetura dhe nuk kanë raportuar rezultojnë FZSHH, Qendra Spitalore Nënë Tereza, Agjencia e Eficencës së Energjisë, etj. Për më tepër detajuar në aneks.

Institucionet që sipas raportit rezultojnë me pagesa por sipas SIFQ nuk kanë kryer pagesa

Nga auditimi i të dhënave të llogarisë 4864, 37 institucione rezultojnë në databazën e raportimeve për detyrime të prapambetura për vitin 2022, ndërkohë që nga Thesari për këto institucione/njësi nuk rezultojnë pagesa, të detajuara në aneks.

Institucionet me shtesën më të lartë të detyrimeve

Nga auditimi konstatohet Institucionet me shtesë më të lartë të detyrimeve për vitin 2022, sipas testimeve të kryera nga KLSH, nisur nga raportimet e DPTH-së mbi stokun 2021, pakësimet sipas raportit dhe stokut të vitit 2022, rezultojnë Bashkia Tiranë rezulton me një shtesë detyrimi për vitin 2022 në vlerën 6,060,246 mijë lekë, ARRSH me një shtesë prej 5,996,708 mijë lekë, AKSHI me një shtesë prej 1,037,723 mijë lekë.

Institucionet me pakësimet më të larta të detyrimeve

Nga auditimi konstatohet Institucionet me pakësimet më të larta të detyrimeve për vitin 2022, sipas SIFQ (krahasuar dhe me pakësimet sipas raportit) rezultojnë: Bashkia Tiranë vlerën ndjekur nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, MIE, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Konstatohet se në përputhje me kreun IV, pikën 1 të Udhëzimit nr. 35 datë 06.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë *“Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”*, është bërë publikimi në faqen MFE i stokut të detyrimeve të prapambetura, por procesi i raportimit tremujor nuk ka pasur

monitorim të plotë përgjatë vitit 2022, nisur nga problematikat e konstatuara nga KLSH. Shifrat e pagesave në pjesën më të madhe nuk është e mundur që të investigohen dhe verifikohen me modulën e pagesave për të parë nëse ato kanë kaluar përmes skemës 486. Në konkluzion konstatohet se raportimi aktual i vlerës totale të detyrimeve të prapambetura nuk është i plotë dhe i saktë për shkak të:

- problematikave në drejtim të raportimit të saktë të tyre;
- mungesës së regjistrimit në kontabilitet nga nëpunësit zbatues të detyrimeve të prapambetura etj;
- pamundësi për të evidentuar shtesat e kryera përgjatë vitit për të monitoruar respektimin e parimit FIFO;
- mungesës së klasifikimit të detyrimeve sipas kohës së krijimit;
- pagesave të kryera jashtë skemës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura;
- mos reflektim i të gjithë detyrimeve të prapambetura, etj.

Gjithashtu mos-ekzekutimi në kohë i tyre paraqet një risk të shtuar për të ardhmen duke qenë se krijon kushte potenciale për pretendime mbi interesa dhe penalitete mbi vonesën në ekzekutim, sipas të drejtave dhe detyrimeve të palëve, të përcaktuara në kontratë.

Mbi mënyrën e kontabilizimit dhe mos raportimit në treguesit fiskal të detyrimeve të prapambetura.

Mënyra e kontabilizimit të stokut të faturave të prapambetura si "shpenzime të periudhave të ardhshme" vazhdon të jetë e njëjtë si në vitet e kaluara dhe në kundërshtim me ligjin e zbatimit të buxhetit dhe standardeve të kontabilitetit dhe me parimin e njohjes së shpenzimit në momentin e ndodhjes sipas Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 pika 36 sipas të cilit shpenzimi njihet në momentin e ndodhjes/kryerjes. *Kjo me impakt, deformim të pasqyrave financiare dhe treguesve fiskal: zëri shpenzime dhe rrjedhimisht deficitit buxhetor.* Llogaria e zgjedhur për kontabilizimin e faturave është një llogari aktive dhe duhet të preket për shpenzime të parapaguara dhe që i përkasin periudhave të ardhshme. Kjo mënyrë kontabilizimi duke mos prekur klasën e duhur të shpenzimeve apo investimeve, bën që stoku i detyrimeve të prapambetura apo borxhi ndaj palëve të treta i krijuar nga angazhime të pa buxhetuara apo parashikuara në PBA, nuk raportohet në treguesit e konsoliduar fiskal me arsyetimin që "ligji lejon njohjen, regjistrimin dhe pagesën vetëm të faturave për të cilat ka fonde disponibël". Për sa më sipër, nuk mund të japim siguri se stoku i faturave të prapambetura më 31.12.2022 është i saktë dhe i plotë.

Detyrimet e tjera kontingjente

- Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)

Gjatë vitit 2022, rezultoi se:

- Këshilli i Ministrave ka miratuar **7** (shtatë) VKM me një vlerë totale prej 103.150 EUR (rreth 12.37 milionë lekë) të cilat janë përballuar nga Fondi Rezervë i buxheti i shtetit, i miratuar për vitin 2022.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ekzekutuar edhe **13** (trembëdhjetë) vendime të GJEDNJ, me vlera nën 10.000 EUR, me një vlerë totale 40.200 EUR (rreth 4.92 milionë lekë).

Në raportin "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022, evidentohet se deri në fund të vitit 2022", detyrimet faktike dhe kontingjente për vendimet e GJEDNJ-së paraqiten si më poshtë:

Në Euro

Vendimet e GJEDNJ	Data e vendimit	Detyrimi faktik	Detyrimi kontigjent	Totali
D. kundër Shqipërisë	14.09.2015	15,600		15,600
R. dhe të tjerë kundër Shqipërisë	17.03.2016	4,417,750		4,417,750
Sh. kundër Shqipërisë	11.01.2018	13,447,300		13,447,300

Sh....dhe të tjerë kundër Shqipërisë			3,811,365	3,811,365
Çështjet "M.... kundër Shqipërisë", "K..... kundër Shqipërisë", "J.... kundër Shqipërisë", "L.... kundër Shqipërisë", "S.... kundër Shqipërisë"			16,800	16,800
Çështja "D.... kundër Shqipërisë"			5,000	5,000
Çështjet "P.... dhe T.... kundër Shqipërisë" kërkesa nr. 16351/15			3,850	3,850
Totali			17,880,650	17,880,650

Vendimet e GJEDNJ-së identifikohen me risk financiar duke qenë se nëse pagesat nuk kryhen brenda afatit 3-mujor, paguhet kamatë-vonesë për çdo ditë vonesë.

Për sa më sipër konstatohet se vendimet i perkasin viteve 2015, 2016 dhe 2018, pra në tejkalim të afatit 3 mujor. Nga auditimi i pagesave të kryera përgjatë vitit 2022, marr nga sistemi ORACLE, në lidhje me vendimet e GJEDNJ-së u konstatua se interesi i paguar për vonesë rezulton 596,347 lekë, detajuar në aneks.

Me email-in e datës 21.06.2023 u kërkuan komunikimet zyrtare me Avokaturën e Shtetit në lidhje me:

- listën e vendimeve të GJEDNJ-së, listën e vendimeve të Arbitrazhit*
- detyrimet e GJEDNJ-së dhe Vendimeve të Arbitrazhit.*

Nga ana e MFE-së, me email-in e datës 20.07.2023, u vu në dispozicion shkresa nr. 2282 prot., datë 27.04.2023 e Avokaturës së Shtetit, shkresë-përcjellje e CD-së për informacionin në lidhje me vendimet e formës së prerë dhe çështjeve në pritje pranë GJEDNJ-së. Grupi i auditimit nuk disponon CD-në apo shkresa të tjera në lidhje me kërkesën e bërë për këtë drejtim.

Në lidhje me kërkesën e grupit të auditimit mbi arsyen e mos-ekzekutimit të 3 vendimeve të GJEDNJ-së, konkretisht: D. kundër Shqipërisë, R. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, Sh. kundër Shqipërisë, të cilat vijojnë të gjenerojnë interesa, me email-in e datës 20.07.2023, u dhanë argumentet si në vijim:

-*Lidhur me vendimin e GJEDNJ-së datë 14.09.2015, për çështjen "D. kundër Shqipërisë", informojmë se, në MFE ende nuk ka ardhur PVKM për mendim.*

-*Lidhur me vendimin e GJEDNJ-së datë 17.03.2016 "R. dhe të tjerë kundër Shqipërisë", më datë 17.03.2016, GJEDNJ ka nxjerrë vendimin, pjesë e të cilit është dhe aplikimi nr. 48522/10 "Dh. dhe N. kundër Shqipërisë" që parashikon vlerën e dëmshpërblimit për çdo përfitues dhe burimin përkatës të financimit. Nga ana e MFE-së, VKM-ja në fjalë nuk është zbatuar vetëm për çështjen nr. 48522/10 (Dh. dhe N.). Kjo pasi, çështja në fjalë ka qënë objekt i një kalvari procesesh gjyqësore në gjykatat shqiptare, përkatësisht ndërmjet përfituesve të përcaktuar në VKM-në e mësipërme dhe disa trashëgimtarëve të tjerë (të cilët nuk janë pjesë e vendimit përkatës të GJEDNJ-së dhe e VKM-së respektive), të së Shtetit është paraqitur në GJEDNJ një kërkesë për rishikim të vendimit "R... dhe të tjerë kundër Shqipërisë", vetëm për kërkesën nr. 48522/10 "Dh. dhe N. kundër Shqipërisë". Bazuar në informacionin më të fundit të përcjellë nga Avokatura e Shtetit, kjo kërkesë për rishikim është ende në shqyrtim pranë GJEDNJ-së. MFE, në korrespondencat me Avokaturën e Shtetit dhe Ministrinë e Drejtësisë, ka shprehur gatishmërinë për zbatimin e vendimit të GJEDNJ-së datë 17.03.2016 dhe të VKM nr. 613 datë 31.08.2016, aplikimi nr. 48522/10 "Dh. dhe N. kundër Shqipërisë", duke theksuar nevojën për propozimin e aktit ligjor përkatës (PVKM) që saktëson masën dhe vlerën e efektit financiar, me qëllim procedimin për ekzekutimin e vendimit pa probleme.*

-*Lidhur me vendimin e GJEDNJ-së datë 28.05.2018, për çështjen "Sh. kundër Shqipërisë", duke konsideruar faturën e konsiderueshme financiare që implikon ky vendim, me anë të komunikimeve zyrtare, MFE, në mënyrë të përsëritur ka mbajtur qëndrimin mbi domosdoshmërinë e skedulimit me këste të shlyerjes së detyrimit financiar, në përputhje me mundësitë e kufizuara të buxhetit të shtetit.*

Nga auditimi i zhvilluar në Avokaturën e Shtetit, për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 31.12.2020 me objekt “Auditim përputhshmërie” u konstatua se për çështjen “Sh. kundër Shqipërisë” është mbajtur komunikim me Ministrinë e Drejtësisë dhe veçanërisht me Ministrinë e Financave si në vijim:

-Me shkresën nr. 151/3 prot., datë 14.06.2018 i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë, materialet lidhur me ekzekutimin e masave individuale, përkthimin, publikimin dhe ekzekutimin financiar të vendimit.

-Me shkresën nr. 151/6 prot., datë 31.08.2018 i janë dërguar Ministrisë së Financave dokumentet e përfituesve dërguar nga përfaqësuesi i tyre me shkresën datë 01.08.2018.

-Me shkresën nr. 6852/9 prot., datë 26.10.2018, Ministria e Drejtësisë ka dërguar bashkëlidhur komunikimin e Ministrisë së Financave lidhur me sugjerimin për të negociuar me përfituesit për pagesën me këste sipas mundësive të buxhetit.

-Me shkresën nr. 151/12 prot., datë 13.11.2018, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Avokatura ka shprehur dakordësinë që të negociohet me përfituesin, duke propozuar që të bëhet me grup negocimi, me anëtarë nga MD, MFE dhe ASH.

-Me shkresën nr. 6852/11 prot., datë 07.12.2018, Ministria e Drejtësisë, në përgjigje të shkresës nr. 151/12, është shprehur lidhur me negocimin.

-Me shkresën nr. 564 prot., datë 10.05.2019, Avokatura ka paraqitur pranë Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ, Planin e Veprimit mbi masat individuale dhe të përgjithshme.

-Me shkresën nr. 15671/1 prot., datë 10.07.2019 i është dërguar Kryeministrisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, komunikimi i Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ, lidhur me ankesën e paraqitur nga përfaqësuesi i kërkuësve, ku ndër të tjera nuk bien dakord me shlyerjen e pagesës me këste.

-Me shkresën nr. 15783/1 prot., datë 27.09.2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vlerëson dhe sugjeron negocimin juridik me përfituesit, për shkak të vlerës së madhe të detyrimit.

-Vendim i Këshillit Konsultativ për çështjet e GJEDNJ nr. 9, datë 26.12.2019 - vendosi shtyrjen e diskutimit për marrjen e masave individuale për çështjen Sh., pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme.

-Me shkresën nr. 1795/1 prot., datë 22.06.2020 i është dërguar Kryeministrisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, komunikimi i Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ, lidhur me një ankesë të paraqitur nga përfaqësuesi i kërkuësve pranë Komitetit të Ministrave të KIE.

-Me shkresën nr. 1795/7 prot., datë 05.02.2021 Avokatura e Shtetit i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë shkresën e Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ-së, me të cilën vihet në vëmendje çështja e ekzekutimit të masave individuale për rastin “Sh... dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.

-Me shkresën nr. 2554/1 prot., datë 10.02.2021, Ministria e Financave informon se ka marrë të gjitha masat për ekzekutimin e VKM 1015/2013 të ndryshuar, si dhe thekson nevojën e skedulimit të shumës për ekzekutimin e vendimit “Sh...i”, duke qenë se nuk mund të përballohet nga Buxheti i Shtetit.

-Me shkresën nr. 655 prot., datë 15.02.2022, Avokatura e Shtetit i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shkresën e Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ-së, me të cilën vihet në vëmendje çështja e ekzekutimit të masave individuale për rastin “Sh.... dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.

Konstatim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, sipas akteve shkrësor të sipërcituar, rezulton të ketë mbajtur një qëndrim bllokues për projektvendimin e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, pavarësisht se, vendimi i GJEDNJ ka formë të prerë, është botuar në Fletoren Zyrtare dhe ky propozim është hartuar nga 2 institucione kompetente për çështjet ligjore, siç

janë Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit. Moszbatimi i këtij vendimi përkthehet në kosto financiare shtesë për buxhetin e shtetit. Propozimi i MFE për marrëveshje me këste nuk gjen mbështetje në dispozitat e vendimit dhe në ligjin organik të Avokaturës së Shtetit.

Mos kalimi në llogarinë bankare të ngurtësuar të shuma që lindin nga vendimet gjyqësore të GJEDNJ-ve.

Nga auditimi konstatohet se megjithëse VKM ka dalë për vlerën totale të vendimit “R.... dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (VKM nr. 613 datë 31.08.2016), nga MFE, nuk janë kaluar të gjitha fondet në llogaritë bankare të përfitueses “DH.N”, me pretendimin se për këtë çështje janë në proces gjyqësor. Nga auditimet e KLSH-së në aparatën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe në Avokaturën e Shtetit është konstatuar se:

Ministria e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. 12074/1, datë 21.09.2016 i ka kërkuar orientim Avokaturës së Shtetit në lidhje me mënyrën sesi Ministria duhet të procedojë me kryerjen e pagesës së shumës për vendimin e GJEDNJ-së “R... dhe të tjerë kundër Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nxjerr në zbatim të tij.

Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 180/10, datë 20.10.2016 i ka kthyer përgjigje MFE-së ku citohet se: *Bazuar edhe në praktikën e deritanishme, shteti debitor nuk ngarkohet me detyrim për të paguar interesat e vonesave të ekzekutimit të vendimeve në rast të provueshmërisë të vështirësisë të justifikuar për kryerjen e pagesës të shpërblimit të drejtë (shumës së dëmit monetar dhe jo monetar) si dhe, duke provuar se shuma është derdhur rregullisht në llogarinë bankare të aplikueshme aplikantëve të cilët janë aktualisht të legjitimuar për të përfituar por pa i dhënë mundësi atyre për t'i tërhequr shumat respektive, pra duke e mbajtur këtë shumë të bllokuar deri në zgjidhjen e situatës së konfliktit.*

Për sa më sipër Avokatura e Shtetit e ka orientuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të derdhë në një llogari bankare të bllokuar detyrimin që shteti shqiptar ka për këtë çështje. Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka ardhur Vendimi për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm nr. 300/3 datë 09.03.2021 ku kërkohet që MFE të paguajë menjëherë në favor të palës paditëse pjesën takuese 2/3 e vlerës prej 4,416,900 Euro, të përcaktuara në VKM nr. 613 datë 31.08.2016, pra vlerën 2,944,600 Euro, si dhe të paguajë tarifën përbarimore në vlerën 13,153,174 lekë.

Nga MFE, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 19/5 të Ligjit nr. 10 datë 13.11.2008 “Për avokaturën e shtetit”, i ndryshuar. Mos kalimi i fondeve në një llogari të ngurtësuar rrit riskun e kërkesave për interesa dhe kamatëvonesa si dhe kostot nga mosekzekutimi vullnetar (kontraktimi i përbaruesve privat).

Konkluzion: *Veprimet dhe mosveprimet e MFE për mos-ekzekutimet e vendimeve të mësipërme krijojnë risk të lartë për efekte shtesë në dëm të buxhetit të shtetit, si rrjedhojë e kamatë vonesave të kërkueshme për moszbatim në afat të vendimeve të GJEDNJ-së.*

Sipas llogaritjeve të bëra vlera e interesave/kamatëvonesave që i rëndon buxhetit të shtetit deri më datë 31.12.2022 rezulton 2,840,740 Euro, bazuar në llogaritjen si në vijim:

Në Euro

Çështjet:	D.... kundër Shqipërisë	R..... dhe të tjerë kundër Shqipërisë	Sh..... kundër Shqipërisë
Dëshmshpërblimi nga GJEDNJ	15,600	4,417,750	13,447,300
Data për ekzekutim	14.09.2015	17.03.2016	28.05.2018
Data e fillimit të kamatë vonesës	14.12.2015	17.06.2016	28.08.2018
Interesi bazë	3%	3%	3%
Interesi sipas BQE	0.25%	0.25%	0.25%
Interesi vjetor	3.25%	3.25%	3.25%
Periudha	14.12.2015-31.12.2022	17.06.2016-31.12.2022	28.08.2018-31.12.2022
Ditët	2573	2388	1585
Interesi për 1 ditë	0,00890411%	0,00890411%	0,00890411%
Interesi për tu paguar	3,574	939,347	1,897,819
Principali	15,600	4,417,750	13,447,300
Interes+principal në Euro	19,174	5,357,097	15,345,119

Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, faqe 60, raportohet se *vlera totale e kostove të vendimeve të arbitrazhit të paguara nga buxheti i shtetit (kosto ligjore/mbrojtje/shpenzime gjyqësore apo kosto të tjera) për vitin 2022 është në masën rreth 940.25 milionë lekë dhe totali i detyrimeve të mbetura/kontingjente 173,914,609 euro*. Ndërkohë nga mbledhja e pagesave analitike të raportuara po në faqen 60 të këtij raporti rezulton se kjo vlerë është 1,004 milionë lekë, paraqitur si në vijim:

Milionë lekë

Paguar nga:	Kosto ligjore/mbrojtje/shpenzime gjyqësore apo kosto të tjera të lidhura me vendime të arbitrazhit ndërkombëtar	Vlera
MFE	Për pagesën e kostove paraprake, shërbimeve juridike dhe kosto të tjera ligjore	198
MTM	Për pagesën e shërbimeve juridike lidhur me procesin e anulimit të një vendimi	79.2
MBZHR	Për pagesën e kostove ligjore dhe administrative të Gjykatës	81.4
MIE	Për pagesën e kostove ligjore për përfaqësim dhe mbrojtje/ procesin e anulimit të një vendimi	155
AKUK	Për pagesën e kostove ligjore për shërbime konsulence, juridike, për përfaqësim dhe mbrojtje	126.7
ARRSH	Për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin në procedurat e anulimit të një vendimi	11.4
Albpetrol sh.a	Për pagesën e shpenzimeve gjyqësore, kostove administrative/ligjore për përfaqësim dhe mbrojtje	63.5
Albpetrol sh.a	Për pagesën e shpenzimeve gjyqësore, kostove administrative/ligjore për përfaqësim dhe mbrojtje	140.1
AKBN	Për pagesën e kostove ligjore për përfaqësim dhe mbrojtje	31.75
APD	Për konsulencë ligjore dhe financiare si dhe për kosto administrative	116.7
	Total	1,004

Për sa më sipër evidentohet mospërputhje raportimesh brenda vet raportit “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, në lidhje me kostot e vendimeve të arbitrazhit të paguara nga buxheti i shtetit (kosto ligjore/mbrojtje/shpenzime gjyqësore apo kosto të tjera) për vitin 2022. Grupi i auditimit me qëllim auditimin e saktësisë së të dhënave të raportuara, kryqëzoi pagesat e raportuara për kostot e vendimeve të arbitrazhit paguar nga MFE me të dhënat e marra nga sistemi ORACLE, ku sipas këtij të fundit këto pagesa rezultojnë rreth 291 milionë lekë. Pra janë paguar rreth 98 milionë lekë më tepër sesa janë raportuar në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, sipas tabelës së detajuar në aneks.

Konkluzion: Detyrimet e prapambetura dhe detyrimet nga vendimet e GJEDNJ-së/Arbitrazhit vijnë të jenë të larta dhe përbëjnë një risk të shtuar për treguesit buxhetor. Nga auditimi konstatohet se mungon një analizë mbi shkaqet e nivelit dhe tyre dhe shtimit të tyre në nivel ende të lartë. Kjo analizë do të mundësonte nxjerrjen e konkluzioneve të sakta dhe dhënien e rekomandimeve sa më të përshtatshme dhe në nevojë të situatës së krijuar. Si rrjedhojë detyrimet e prapambetura paraqesin një risk fiskal, jo vetëm për treguesit buxhetor të institucioneve përgjegjëse por edhe në nivel makroekonomik për financat publike, pasi pavarësisht se këto detyrime nuk llogariten dhe nuk regjistrohen në treguesit e borxhit publik, e implikojnë dhe e nënvlerësojnë këtë të fundit, pasi janë detyrime që do të shlyhen në të ardhmen.

Për sa më sipër, për problematikat e konstatuara nga testimet në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në drejtim të problematikave të detyrimeve të prapambetura ngarkohen me përgjegjësi: NA dhe NZ e institucioneve trajtuar për çdo rast të konstatuar me problematika, përfaqësuesit e Degëve të Thesarit për çdo rast të konstatuar me problematika, ish Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. A.GJ., Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit zj. M.DH., ish Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit zj. A.B. periudha 01.01.2022-14.10.2022, znj. A.V. ngarkuar për kohësisht për kryerjen e detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit periudha 14.10.2022-31.12.2022.

Për sa më sipër, për problematikat e konstatuara në drejtim të çështjes së monitorimit të risqeve fiskale ngarkohen me përgjegjësi: NA e institucioneve trajtuar sipas çdo institucioni të konstatuar me problematika, ish Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. A.GJ., Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit zj.

M.DH., Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit zj. Xh.A., përgjegjësi i sektorit të menaxhimit të buxhetit qëndror zj. Sh.K., përgjegjës i sektorit të monitorimit të risqeve buxhetore zj. A.K..

Sa trajtuar në këtë çështje, nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit (pa identifikuar nga cilët përfaqësues është dërguar) me shkresën nr. 5854/50 prot., datë 07.09.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 281/26 datë 12.09.2023) janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin si në vijim:

Pretendimi i subjektit:

1. Lidhur me konstatimin mbi Kontratën koncesionare/PPP “Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot – Balldre”, sipas raportimit zyrtar të Autoritetit Kontraktor (MIE) është zgjidhur (anulluar). Shkresa/njoftimi për anulimin e kontratës shkon pranë Drejtorisë përgjegjëse për Koncesionet pranë MFE, ndërsa përfshirja e saj në tabelë është bërë me qëllim ruajtjen e historikut të kontratave. Kjo kontratë nuk është përfshirë në numrin total të kontratave koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore.

2. Lidhur me konstatimet mbi diferencën e pagesave faktike të koncesioneve në total dhe kontratës koncesionare “shërbimi i skanimit në dogana”:

Me anë të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. Prot. 183/40, datë 13.07.2022 është ridërguar raportimi periodik një vjeçar, duke saktësuar vlerat përfundimtare faktike për vitin 2021 për tre kontrata koncesionare. Saktësimet/verifikimet lidhur me pagesat mbi kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore. Raportimi i tyre pranë DPMB është përgjegjësi e autoriteteve kontraktore përkatëse.

3. Lidhur me konstatimet mbi “Detyrimet e ndërmarrjeve UK ndaj OSHEE dhe detyrimet e ML/IB ndaj OSHEE”: DMB në rolin monitorues të detyrimeve të prapambetura të ndërsjella në sektorin energjitik, ka kërkuar vazhdimisht përditësimin e të dhënave në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzim. Në mungesë të raportimit në kohë nga ana e entiteteve, informacioni i publikuar ka qënë raportimi i fundit disponibël për periudhën në fjalë. Ndërsa lidhur me vlerën e detyrimeve të ndërsjella ende të pa-rakorduara ku është marrë kufiri minimal i detyrimit, vlera minimale është një detyrim që të dyja palët e njohin dhe e konsiderojnë detyrim të akumuluar, ndërsa vlera maksimale është pretendim vetëm i njëjës palë dhe nuk mund të përdoret në llogaritjen e totalit të detyrimeve të ndërsjella.

4. Lidhur me konstatimet mbi mungesën e të dhënave financiare të ndërmarrjeve të sektorit ujësjellës-kanalizimeve: Në zbatim të Ligjit Organik të Buxhetit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, specifikisht nenit 4/2 sipas së cilit: “...*Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujori, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme përfituese të fondeve buxhetore dhe/ose garancive shtetërore, dorëzohen në Ministrinë e Financave...*”, dhe në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 1/2022 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022”, kanë detyrimin e ndarjes së planeve financiare vjetore dhe pasqyrave financiare mbi bazë tremujori me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Këto raporte analitike të cilat përgatiten rregullisht mbi bazë tremujore, bëhen pjesë/publikohen në të gjitha raportet periodike të MFE, si Buxheti Faktik, Raporti i Mesvitit dhe ProjektBuxheti.

5. Lidhur me konstatimet mbi diferencat e sektorit energjitik për vitin 2021 dhe 2022: Në raportimin e vitit 2021, vlera totale e stokut të detyrimeve të prapambetura përfshin principalin dhe kamatëvonesat. Ashtu siç është raportuar nga AKUM, ky ndryshim në raportim për vitin 2022, ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së rakordimit të vlerës së kamatave me OSHEE Group.

6. Lidhur me konstatimet për monitorimin/shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, respektimin e parimit FIFO: Me anë të VKM nr. 50, datë 5.2.2014 u miratua Strategjia për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit, strategji tashmë e finalizuar në vitin 2015, ku u arrit shlyerja e të gjitha detyrimeve të prapambetura të krijuara deri në vitin 2013. Aktualisht MFE monitoron detyrime e prapambetura nëpërmjet zbatimit të Udhëzimit nr. 37 datë 06.10.2020 “Për monitorimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme”. Sipas përcaktimeve në fjalë janë të përcaktuara përgjegjësitë e strukturave përfshirëse për raportim dhe publikim.

7. Lidhur me konstatimet se të dhënat e raportuara paraqiten me diferenca në detajimin e detyrimeve të prapambetura sipas llogarive përkatëse...: Theksojmë se, vlera përfundimtare e stokut të detyrimeve të prapambetura e raportuar nga DPTH është rreth 12,199 milion lekë. E njëjta vlerë është raportuar

dhe publikuar në faqen zyrtare Web të MFE. Të gjitha raportimet zyrtare të MFE raportojnë të njëjtën vlerë. Gjithashtu, të dhënat për raportin e publikuar të detyrimeve të prapambetura janë marrë nga raportimi më i fundit i përditësuar i Drejtorisë së Thesarit e cila nuk përkon me raportimin e marrë nga ana juaj në DPTH. Për pasojë, diferencat e konstatuara nga ana Juaj lidhen me afatin e marrjes së raportit nga DPTH.

8. Lidhur me konstatimet për zërin detyrime të tera: Në zërin detyrime të tjera përfshihen:

-Llogaria 4864201-D.P. Energji Elektrike

-Llogaria 4864900-Det.Prap. Të Tjera

-Llogaria 4864901-Paga

-Llogaria 4864902-Shpronësime

-Llogaria 4864903-Trans.Individi

-Llogaria 4864904-Transt.Subjektet

9. Lidhur me konstatimet mbi kërkesat e komunikimeve me Avokaturën e Shtetit: Nga ana e MFE-së, me emailin e datës 20.07.2023, është vënë në dispozicion shkresa nr. 2282 prot, datë 27.04.2023 e Avokaturës së Shtetit gjithashtu dhe informacioni në lidhje me vendimet e formës së prerë dhe çështjeve në pritje pranë GJEDNJ-së, përcjellë me anë të CD-së nga Avokatura e Shtetit. CD përmban vetëm tabelën në Excel.

10. Lidhur me konstatimin se veprimet dhe mosveprimet e MFE-së për mosekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, krijojnë risk të lartë për efekte shtesë në buxhetin e shtetit: Janë dhënë të gjitha argumentet përkatëse në lidhje me vendimet e paekzekutuara të GJEDNJ-së dhe masat e marra nga MFE.

11. Lidhur me konstatimet mbi vlerën totale të kostove të arbitrazhit të paguara nga buxheti i shtetit dhe mos-rakordimi me sistemin Oracle: Lidhur me këtë konstatim shprehemi se vlera totale e kostove të vendimeve të arbitrazhit të paguara nga buxheti i shtetit (kosto ligjore/mbrojtje/shpenzime gjyqësore apo kosto të tjera) për vitin 2022, është në masën 940.25 milion lekë. Diferenca prej 63.5 milion lekë vjen si pasojë e raportimit të plotë nga Albpetrol sh.a lidhur me pagesat për vendime të arbitrazhit ndërkombëtar. Për sa më sipër saktësojmë se vlera e pagesave nga Albpetrol sh.a [ër vendime/çështje të arbitrazhit ndërkombëtar rezulton në masën rreth 140.1 milion lekë (vlera 63.5 milion lekë i referohet informacionit më të hershëm që dispononte MFE dhe nuk është përfshirë në totalin e pagesave nga buxheti i shtetit për këto vendime). Pas dërgimit të informacionit nga Albpetrol sh.a, vlera e llogaritur në totalin e pagesave nga buxheti i shtetit për vendime të arbitrazhit ndërkombëtar, nga Albpetrol sh.a, është 140.1 milion lekë. Lidhur me konstatimin se detyrimet e paguara nga MFE për vendime/çështje/kosto ligjore të arbitrazhit, bazuar në sistemin oracle rezultojnë më të larta se vlera e raportuar në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, shprehemi se, në këtë rast nga MFE evidentohen vetëm pagesat e realizuara brenda vitit 2022. Në tabelën e paraqitur nga ana juaj, rezultojnë edhe pagesat e realizuara në vitin 2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pikën 1, grupi auditimit nuk disponon shkresën zyrtare nga autoriteti kontraktor për anulimin e koncesionit dhe as në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022” nuk është paraqitur ky fakt.

Në lidhje me pikën 2, grupi i auditimit sqaron se këto saktësime dhe verifikime duhen bërë para miratimit të raportit “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale të vitit”, si dokumenti final dhe zyrtar i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me zbatimin e buxhetit. Ndërhyrjet dhe ndryshimet në lidhje me zërat e raportuar paraqesin risk në lidhje me sigurinë dhe vërtetësinë e tyre.

Në lidhje me pikën 3, nuk është kundërshtuar gjetja e grupit të auditimit në lidhje me raportimin 9-mujor. Në lidhje me vlerën e detyrimeve të ndërsjella ende të pa-rakorduara ku është marrë kufiri minimal i detyrimit, grupi i auditimit ka sqaruar se ky rakordim nuk ka përfunduar ende dhe e ka marrë si risk për të vlerësuar detyrimin edhe në kahun e vlerës maksimale, duke qenë se nga të dyja palët është caktuar një kufi detyrimesh.

Në lidhje me pikën 4, grupi i auditimit sqaron se në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale 2022”, nuk paraqiten të dhëna mbi monitorimin dhe raportimin e treguesve financiar të ndërmarrjeve të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve për vitin 2022.

Në lidhje me pikën 5, grupi i auditimit sqaron se nga ana e MFE duhet ruajtur një metodologji raportimi, përpos faktit që raportimi pa principalin që në vetvete është po detyrim, nënvlerëson këtë të fundit. Për atë kohë sa për vitin 2021 është raportuar me principal dhe kamatëvonesa, ndryshimet në raportimet në vijim paraqesin risk në lidhje me saktësinë e të dhënave.

Në lidhje me pikën 6, grupi i auditimit sqaron se VKM-së nr. 50, datë 5.02.2014 ‘Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit’”, nuk rezultoi të jetë e shfuqizuar, përpos faktit që nisur nga testimet e KLSH-së konstatohen ende likuidime faturash të viteve të kaluara, 2013 e në vijim. Në lidhje me mospërfshirjen e vendimeve të detyrimeve të prapambetura në raportet dhe statistikën e borxhit publik, grupi i auditimit nuk ngarkon me përgjegjësi strukturën tuaj, por e thekson si risk, kostot e të cilit janë për vitet dhe buxhetet në vijim.

Në lidhje me pikën 7, grupi i auditimit sqaron se nuk është shprehur për diferenca në vlerë totale, por në detajimin e tyre sipas kategorisë, konkretisht për ndarjen e detyrimit sipas institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore. Përpos faktit të diferencave midis raportit të pagesave dhe testeve nga SIFQ.

Në lidhje me pikën 8, grupi i auditimit sqaron se kjo ndarje për efekt transparence dhe veçanërisht për rritjen e konsiderueshme që ka si zë është e nevojshme të paraqitet e detajuar edhe në raportin vjetor të buxhetit 2022.

Në lidhje me pikën 9, grupi i auditimit sqaron se nuk e disponon CD-n dhe as shkresat/komunikimet zyrtare me Avokaturën në lidhje me vendimet e GJEDNJ-së dhe arbitrazhit. Një nga kërkesat e grupit të auditimit ka qenë vënia në dispozicion e “listës së vendimeve të GJEDNJ-së dhe listës së vendimeve të Arbitrazhit”, të cilat i kërkuam me shkresat e përcjella zyrtarisht nga ASH, për kryqëzim informacioni.

Në lidhje me pikën 10, në akt konstatim janë pasqyruar sqarimet e Drejtorisë suaj, po kështu dhe qëndrimi i grupit të auditimit, si në akt konstatim ashtu dhe në Projekt Raport.

Në lidhje me pikën 11 sqarojmë se qëndrimi juaj mbi vlerën totale të pagesave nga buxheti i shtetit për pagesën e kostove ligjore/përfaqësimit/shpenzimeve gjyqësore e cila rezultoi 940.25 milion lekë, nuk rakordon me qëndrimin tuaj mbi akt-konstatimin ku observoni se: *“vlera totale e kostove të vendimeve të arbitrazhit të paguara nga buxheti i shtetit (kosto ligjore/mbrojtje/shpenzime gjyqësore apo kosto të tjera) për vitin 2022, është në masën 1,004 milion lekë”*. Gjithashtu sqarojmë se pagesat e kryera në janar të vitit 2023 janë bërë me buxhetin e vitit 2022 për detyrime të njohura të vitit 2022 kështu që janë pjesë e vlerës totale të raportimit të pagesave të vitit 2022. Grupi i auditimit, sqaron se observacioni nuk ka bashkëlidhur asnjë dokument apo evidencë që të kundërshtojë apo ndryshojë gjetjen e grupit të auditimit. Gjithashtu paraqet të njëjtat argumenta të dhëna dhe mbi akt-konstatimet, për të cilat grupi i auditimit ka dhënë sqarime të detajuara edhe në Projekt Raportin e Auditimit. Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, zj. A.V., zj. M.P., zj. A.B., me shkresën nr. 5854/50 datë 07.09.2023 (prot në KLSH me nr. 281/15 datë 11.09.2023, janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin si në vijim:

Pretendimi i subjektit:

Në vijim të rekomandimit -Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të marrin masa për implementimin e kontrolleve të stokut të detyrimeve të prapambetura, duke mundësuar verifikimin e detyrimeve të prapambetura sipas kohës së krijimit të tyre...të parashikojë procedura shtesë kontrolli...të marrë masa për vlerësimin e problematikave....sqarojmë se: SIFQ është përshtatur që në janar 2021 për të vendosur edhe datën e faturës së furnitorit me qëllim përcaktimin e vjetërsisë së detyrimit të prapambetur. Degët e Thesarit në përfundim të afateve të miratuara për paraqitjen e pasqyrave financiare kanë rakorduar në akt rakordimin vjetor të konfirmuar nga NA/NZ e institucioneve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin e mësipërm grupi i auditimit sqaron se: Grupi i auditimit ka reflektuar rekomandimin duke marrë pjesërisht në konsideratë përshtatjen në SIFQ me vendosjen e datës së faturës së furnitorit. Sqaron se informacioni i paraqitur për detyrimet e prapambetura duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e pikës 31 të Udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar, e cila citon se *“Informacioni financiar për pagesat e detyrimeve të prapambetura do të përditësohet çdo muaj dhe do të publikohet*

në faqen e internetit të MF-së me bazë mujore. Ky raport do të përfshijë gjendjen fillestare të verifikuar sipas kategorive, sektorëve dhe kohës së krijimit, pagesat e bëra gjatë periudhës nga çdo institucion buxhetor, llojin e detyrimit financiar, përfituesin dhe balancën e verifikuar mbyllëse të mbetur” dhe pikës 33 ku citohet se: “Krahas monitorimit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura Ministria e Financave zhvillon një sondazh tremujor te ministritë e linjës nëse ka detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të paguara në kohë për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme, që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra pas datës 1 janar 2014 si dhe do të zhvillojë një analizë të periudhës së pretendimeve, duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi. Po kështu pavarësisht rakordimeve vjetore nga ana e strukturave tuaja, nevojitet një vëmendje e shtuar dhe monitorim i vazhdueshëm, kjo nisur edhe nga problematikat e konstatuara nga KLSH, në lidhje me diferencat e konsiderueshme në lidhje me detyrimet e prapambetura.

Gjetja:	Pagesat vjetore faktike për projektet koncesionare rezultojnë brenda kufirit prej 5% të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës, megjithatë konstatohet mos realizim i 1 projekti nga 12 në zbatim gjatë këtij viti për të cilin nuk është kryer asnjë pagesë dhe njëkohësisht mos financim për vlerën e plotë të shpenzimeve duke qenë se janë krijuar detyrime të prapambetura në 3 projekte. Kjo situatë krijon risk për pagesat e kërkuara për vitet në vijim në raport me të ardhurat tatimore.
Situata:	<p>Sipas raportit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, për vitin 2022 rezultojnë 11 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore me pagesa faktike dhe në tabelën e koncesioneve/PPP me mbështetje buxhetore, raportohen 12 kontrata duke përfshirë kontratën koncesionare/PPP “Ndërtimi dhe Operimi i rrugës Milot-Balldren”, me plan dhe fakt 0 lekë. Plani përfundimtar për këto projekte paraqitet në shumën 12,706,156 mijë lekë, ndërkohë që pagesat rezultojnë në shumën 12,640,991 mijë lekë, me një realizim në masën 99.5%. Shuma totale e pagesave vjetore neto përbën 2.66% të totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2021, prej rreth 475.61 miliardë lekë, duke qenë brenda kufirit të pagesave prej 5% të të ardhurave tatimore faktike.</p> <p>- Nga auditimi konstatohet se në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2021”, pagesat e realizuara të vitit 2021 rezultojnë në vlerën 11,517,745 mijë lekë ndërkohë që në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, pagesat e vitit 2021 rezultojnë 11,443,679 mijë lekë, pra 74,066 mijë lekë më pak.</p> <p>- Nga auditimi konstatohet se në 3 projekte koncesionare, janë shlyer detyrime të viteve të mëparshme, konkretisht për: ndërtimin dhe operimin e Rrugës së Arbrit në vlerën 2,940,000 mijë lekë, ndërtimin dhe operimin e Portit të Jahteve Orikum – Dukat në vlerën 150,532 mijë lekë, shërbimin e Skanimit në Dogana në vlerën 23,864 mijë lekë. Realizimi i shërbimit përtej vlerës së buxhetuar ka shkaktuar krijimin e detyrimeve të prapambetura për vitin aktual dhe në të njëjtën kohë mbartjen e tyre në vitin pasardhës.</p> <p>Për koncesionin “Shërbimi i Skanimit në Dogana”, pagesat e realizuara në vitin 2022 sipas databazës së pagesave në SIFQ rezultojnë në shumën 1,898,906 mijë lekë, ndërkohë në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, rezultojnë 1,925,903 mijë lekë, me një diferencë prej 26,997 mijë lekë.</p> <p>-Për projektin “Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës”, edhe pse kontrata është nënshkruar në datën 17.10.2018 në shumën 2,364,096 mijë lekë, rezulton se është regjistruar në modulën e kontratave në datën 31.05.2022 në vlerën 197,537 mijë lekë, si një kontratë e copëzuar, jo në vlerën e saj të plotë.</p> <p>-Pagesat faktike për muajin Dhjetor për kontratat koncesionare rezultojnë rreth 15.94% të totalit të pagesave faktike për vitin 2022, ku vetëm pagesa prej 840 milion lekë për kontratën “Për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe</p>

	<p>mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit” përbën 80% të totalit të pagesave të realizuara në muajin Dhjetor.</p> <p>-6 nga 12 kontrata koncesionare/PPP rezultojnë me rritje pagesash faktike në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021, gjë që përbën një risk fiskal për buxhetin, për më tepër që në mungesë të treguesve të matshëm të performancës së tyre bën të diskutueshme dhe arrijten në kohë të objektivave të tyre me eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet.</p> <p>Gjithashtu, duke qenë se këto kontrata koncesionare/PPP janë me mbështetje buxhetore dhe koncesionari nuk ka përgjegjësi apo angazhim financiar, këto shpenzime nga ana e buxhetit të shtetit konsiderohen një borxh i fshehur për vitet në vijim.</p>
Impakti:	Risk i shtuar, që implikon borxhin publik për vitet në vijim
Shkaku:	Kontratat koncesionare, niveli i kërkesës për shërbime që ofrohen nga këto kontrata, mos regjistrimi i plotë i shpenzimeve/obligimeve në lidhje me këto kontrata.
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Raporti “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”.
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me autoritetet kontraktuese, të monitorojë detyrimet që lindin nga kontratat koncesionare, veçanërisht kontratat që krijojnë detyrime të prapambetura për t’u mbartur në vitet e ardhshme buxhetore, të cilat përbëjnë një risk fiskal për buxhetin dhe implikojnë borxhin publik për vitet në vijim.

Gjetja:	Mungesë transparence nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nuk është publikuar raporti i Performancës së Kontratave të Koncesionit dhe të Partneritetit Publik Privat për vitin 2022.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se për vitin 2023 nuk është publikuar raporti i Performancës së Kontratave të Koncesionit dhe të Partneritetit Publik Privat për vitin 2022, raporti i cili përfshin mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të ecurisë dhe performancës financiare dhe jofinanciare të kontratave të koncesionit/PPP dhe synon të sigurojë që risqet kryesore fiskale nga kontratat e koncesionit/PPP janë identifikuar dhe raportuar në mënyrë sistematike. Mos-publikimi i këtij raporti dhe mungesa e raportimit të tij bashkëlidhur raportit të zbatimit të buxhetit me efekt mungesë transparence nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është në kundërshtim me pikën 7 të nenit 10 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar dhe shkronjën c, të pikës 126.3, të kapitullit IV “Raportimi dhe monitorimi i risqeve fiskale nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësi të tjera të sektorit publik” të udhëzimit plotësues nr. 2 datë 19.01.2023.
Impakti:	Mungesë transparence nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nuk janë identifikuar dhe raportuar në mënyrë sistematike risqet fiskale nga kontratat e koncesionit/PPP.
Shkaku:	Mos-publikimi nga ana e MFE
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, pika 7 e nenit 10. Udhëzimi plotësues nr. 2 datë 19.01.2023, shkronja c, pika 126.3, kapitulli IV.
Rekomandimi:	Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të nxjerr përgjegjësitë e mos-publikimit të raportit të Performancës së Kontratave të Koncesionit dhe të Partneritetit Publik Privat për vitin 2022 dhe mungesës së tij bashkëlidhur raportit “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”. Drejtorja e Koncesioneve, në funksion të kërkesave të përcaktimeve të kuadrit

	ligjor në fuqi, transparencës me publikun, përdoruesit e këtij raporti dhe palët e treta të interesuara, të marr masa të menjëhershme për publikimin e tij me qëllim garantimin e identifikimit dhe raportimit të risqeve fiskale.
--	--

Gjetja:	<p>Mosekzekutim nga ana e MFE-së të 3 vendimeve të GJEDNJ-së, duke sjellë interesa/kamatëvonesa që i rëndojnë buxhetit të shtetit, të llogaritura deri më datë 31.12.2022 në vlerën 2,840,740 Euro.</p> <p>Moskalim në llogari bankare të ngurtësuar të detyrimit që ka lindur nga vendimi i GJEDNJ-së për çështjen “Dh.N.”.</p> <p>Pasaktësi në raportime mbi pagesat e kryera në lidhje me vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit.</p>
Situata:	<p>Nga auditimi rezulton se detyrimet faktike dhe kontigjente për vendimet e GJEDNJ paraqiten në vlerën gjithsej 21,717,665 milion Euro, për 7 vendime. Konstatohet se 3 vendime, konkretisht: <i>D... kundër Shqipërisë, R... dhe të tjerë kundër Shqipërisë, Sh.... kundër Shqipërisë</i> që i përkasin viteve 2015, 2016 dhe 2018, rezultojnë ende të palikuiduara, në kundërshtim me nenin 19/4 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.</p> <p>Rezulton se MFE për çështjen “<i>Sh.... kundër Shqipërisë</i>” me shkresën nr. 2554/1 prot., citon se detyrimi nuk mund të përballohet nga buxheti i shtetit dhe sugjeron pagesë me këste, duke mbajtur një qëndrim bllokues. Ndërsa për çështjen “<i>R... dhe të tjerë kundër Shqipërisë</i>” MFE nuk ka kaluar fonde në një llogari të ngurtësuar, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 19/5 të Ligjit nr. 10, datë 13.11.2008 “Për avokaturën e shtetit”, i ndryshuar.</p> <p>Sipas llogaritjeve të bëra nga KLSH, deri më datë 31.12.2022, kamatëvonesat që rëndojnë buxhetit të shtetit për mosekzekutimin e 3 vendimeve të GJEDNJ-së rezultojnë në vlerën 2,840,740 Euro.</p> <p>-Nga auditimi mbi Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit rezulton se në raportin “<i>Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022</i>” vlera totale e kostove të vendimeve të arbitrazhit të paguara nga buxheti i shtetit raportohet në shumë 940.25 milion lekë. Ndërkohë nga mbledhja e pagesave analitike të raportuara po në këtë raport rezulton se kjo vlerë është 1,004 milionë lekë, duke reflektuar mospërputhje raportimesh brenda këtij raporti.</p> <p>Gjithashtu konstatohet se vlera e raportuar e kostove të arbitrazhit të paguara nga aparati i MFE në raportin e mësipërm është rreth 193 milion lekë. Ndërsa sipas të dhënave të sistemit ORACLE këto pagesa rezultojnë në vlerën 291 milion lekë, ose 98 milion lekë më tepër.</p> <p>Detyrimet e GJEDNJ-së dhe Arbitrazhit, si dhe mosekzekutimi i tyre në kohë, paraqesin një risk fiskal, jo vetëm për treguesit buxhetor të institucioneve përgjegjëse por edhe në nivel makroekonomik për financat publike, pasi pavarësisht se këto detyrime nuk llogariten dhe nuk regjistrohen në treguesit e borxhit publik, e implikojnë dhe e nënvlerësojnë këtë të fundit, pasi janë detyrime që do të shlyhen në të ardhmen.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, neni 19/4, 19/5.
Impakti:	Detyrimet e GJEDNJ-së dhe Arbitrazhit, si dhe mosekzekutimi i tyre në kohë, paraqesin një risk fiskal, jo vetëm për treguesit buxhetor të institucioneve përgjegjëse por edhe në nivel makroekonomik për financat publike, pasi pavarësisht se këto detyrime nuk llogariten dhe nuk regjistrohen në treguesit e borxhit publik, e implikojnë dhe e nënvlerësojnë këtë të fundit, pasi janë detyrime që do të shlyhen në të ardhmen.
Shkaku:	<p>Mosekzekutimi i vendimeve në kohë</p> <p>Mos kalimi i fondeve në një llogari të ngurtësuar</p>
Rëndësia:	E lartë

Rekomandimi:	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Analizimin e të gjitha vendimeve të formës së prerë në pritje për ekzekutim dhe nxjerrjen e përgjegjësiive për strukturat përkatëse që me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë shkaktuar rritjen e penaliteteve dhe risqeve fiskale. -Ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së brenda afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore me qëllim uljen e riskut të akumulimit të kamatëvonesave si dhe minimizimin e kostove si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimit gjyqësor.
---------------------	---

Gjetja:	Problematika të konstatuara në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e raportimit të stokut të detyrimeve të prapambetura në 31.12.2022.
Situata:	<p>Nga auditimi, referuar raportit të MFE për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, evidentohet se stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e qeverisjes qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore në datën 31.12.2022 është në shumën 12,753,240 mijë lekë, ose 581,703 mijë lekë më pak se një vit më parë.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se 4 Ministri, përkatësisht: <i>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>, përbëjnë rreth 91% të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore. Kategoritë që zënë peshën kryesore janë investimet me 35.5% dhe vendimet gjyqësore me 47.9%, të cilat në krahasim me vitin e mëparshëm janë rritur me 37.4%. Në lidhje me institucionet e vetëqeverisjes vendore konstatohet se 13 bashki përbëjnë rreth 73% të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura. Kategoritë që zënë peshën kryesore janë vendimet gjyqësore me 44% dhe detyrimet e tjera me 28%, të cilat janë dyfishuar në krahasim me vitin e mëparshëm.</p> <p>Institucionet me shtesën më të lartë të detyrimeve për vitin 2022, sipas testimeve të kryera nga KLSH, janë: Bashkia Tiranë me një shtesë detyrimi për vitin 2022 në vlerën 6,060,246 mijë lekë, ARRSH me një shtesë prej 5,996,708 mijë lekë, AKSHI me një shtesë prej 1,037,723 mijë lekë etj.</p> <p>Nga testimet e KLSH-së në lidhje me detyrimet e prapambetura për vitin 2022, konstatohet se ky raportim rezulton jo i plotë dhe i saktë pasi konstatohet se: 502 Institucione nga 1031, rezultojnë me diferenca në raportim, konkretisht: 104 institucione kanë raportuar pagesa më të mëdha sesa pagesat faktike; 110 institucione kanë raportuar pagesa më të vogla sesa pagesat faktike; 251 institucione nuk rezultojnë në databazën e raportimeve për detyrime të prapambetura për vitin 2022, ndërkohë që nga Thesari për këto institucione/njësi rezultojnë pagesa; 37 institucione rezultojnë në databazën e raportimeve për detyrime të prapambetura për vitin 2022, ndërkohë që nga Thesari për këto institucione/njësi nuk rezultojnë pagesa.</p> <p>Si rrjedhojë, pagesat për faturat dhe detyrime të tjera rezultojnë 9,828,089 mijë lekë më shumë se pagesat e raportuara, vlerë e cila nënkupton fatura të prapambetura të padeklaruara më parë nëpërmjet skemës së parashikuar në Udhëzimin nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, procedurë që do të rriste balancën e vitit 2022, me rreth 9.8 miliard lekë. Nisur nga problematikat e konstatuara, rezulton se procesi i raportimit të detyrimeve të prapambetura nuk ka pasur monitorim të plotë dhe mosekzekutimi në kohë i detyrimeve të prapambetura paraqet një risk të shtuar për të ardhmen, duke qenë se krijon kushte potenciale për pretendime mbi interesa dhe penalitete mbi vonesën në ekzekutim, sipas të drejtave dhe detyrimeve të palëve, të përcaktuara në kontratë.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 61.</p> <p>Udhëzimi plotësues nr. 1, datë 10.01.2022, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”;</p> <p>Udhëzimi nr. 37, datë 06.10.2020 për “Monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”;</p>

	Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”; Udhëzimit nr. 34 datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”.
Impakti:	Pasaktësi në raportimin e stokut të detyrimeve të prapambetura. Deformim të pasqyrave financiare dhe treguesve fiskal: zërit shpenzime dhe rrjedhimisht defiçitit buxhetor. Mos-ekzekutimi në kohë i tyre paraqet një risk të shtuar për të ardhmen duke qenë se krijon kushte potenciale për pretendime mbi interesa dhe penalitete mbi vonesën në ekzekutim, sipas të drejtave dhe detyrimeve të palëve, të përcaktuara në kontratë. Detyrimet e prapambetura implikojnë rritjen e borxhit publik në vitet në vijim.
Shkaku:	Rikrijimi i detyrimeve të prapambetura, pra shtesa e detyrimeve është më e lartë se niveli i pakësimit; Metodologjia aktuale e raportimit të detyrimeve nuk parashikon raportimin e borxhit sipas krijimit të tij, shtesave përgjatë vitit; Monitorimi aktual nuk përjashton riskun e mos ekzistencës së diferencave midis vlerës së raportuar të detyrimeve dhe detyrimit të njohur në pasqyrat financiare apo riskun e kryerjes së pagesave për likuidimin e detyrimeve jashtë skemës së parashikuar për këtë proces.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	MFE të parashikojë procedura shtesë kontrolli për të monitoruar raportimin aktual të detyrimeve të prapambetura, me qëllim shmangien e diferencave midis vlerës së raportuar të detyrimeve me vlerën e detyrimit të njohur në pasqyrat financiare si dhe diferencat midis detyrimit të njohur në pasqyrat financiare dhe detyrimit real të prapambetur, kryesisht fokusuar në detyrimet e prapambetura të investimeve dhe vendimeve gjyqësore si zërat me risk më të lartë. -NPA dhe strukturat përgjegjëse pranë MFE të marrin masat për kryerjen e sondazheve periodike tek ministritë e linjës duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi, nëse ekzistojnë detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme, që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra përtej fondeve në dispozicion

Gjetje	Mangësi të konstatuara në drejtim të monitorimit të stokut të detyrimeve të prapambetura.
Situata:	Nga auditimi i monitorimit të stokut të detyrimeve të prapambetura u konstatua se: - Monitorimi aktual i kryer nga MFE nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 31 dhe 33 të Udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar dhe krijon kushte për mosrespektimin e parimit FIFO në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. - Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimin plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, nuk ka kërkuar nga njësitë e qeverisjes qendrore hartimin e një plani për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, me qëllim përfshirjen e tij në propozimet e PBA-së, në kundërshtim me tabelën nr. 5 të kapitullit 6.3 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”. Në këtë drejtim, planifikimi buxhetor për një periudhë afatmesme nuk ka parashikuar të trajtojë me prioritet likuidimin e detyrimeve krahasuar me fondet që do të alokohen për projekte të reja, veprim ky në kundërshtim me nenin 43 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe pikën 63 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Kryerja e rishikimeve përgjatë vitit për alokimin e fondeve të cilat janë përdorur për likuidimin e detyrimeve të kontratave të lidhura

	<p>në vitet e mëparshme, është një ndër treguesit që gjatë hartimit të projekt buxhetit, nuk janë marrë në konsideratë këto detyrime.</p> <p>-Nga auditimi janë konstatuar problematika në lidhje me saktësinë e raportimeve si në vijim:</p> <p>Për ndërmarrjet e sektorit energjetik: procesi i rakordimit të detyrimeve të ndërsjella ndërmjet sektorit publik dhe enteve të tjera publike nuk ka përfunduar ende dhe këto detyrime kanë ardhur duke u rritur. Në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, këto detyrime paraqiten në vlerën 163.11 miliardë lekë ose 18.9 miliardë lekë më tepër krahasuar me vitin 2021. Megjithatë edhe kjo vlerë mbart riskun për të qenë më e lartë për 2 arsye:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Detyrimet e ndërmarrjeve UK ndaj OSHEE dhe detyrimet e ML/IB ndaj OSHEE, janë raportuar për periudhën deri më 31.09.2022, në kundërshtim me pikën 143, të kreut 6, të Udhëzimit Plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”. 2. Në vlerën e detyrimeve të ndërsjella ende të pa-rakorduara është marr kufiri minimal i detyrimit. Nëse kjo do të llogaritej me kufirin maksimal tek i cili variojnë detyrimet, detyrimi total i ndërsjellë do të shkonte në vlerën 178.62 miliardë lekë. <p>Për ndërmarrjet e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve: mungon monitorimi dhe raportimi mbi të dhënat financiare të ndërmarrjeve të këtij sektori. Sipas raportit “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, për periudhën deri në Dhjetor 2022, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) raporton se detyrimet e akumuluar të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve kundrejt OSHEE rezultojnë të jenë në vlerën 14.01 miliard lekë (pa kamata), ku pjesën më të madhe të detyrimit e zë ndërmarrja e UK SH.A Durrës me 4.93 miliardë lekë detyrime. Kjo e dhënë nuk rakordon me raportimin me tabelën nr. 14 të faqes 50 të këtij raporti, ku detyrimet e ndërmarrjeve UK ndaj OSHEE rezultojnë të raportuara 25.35 miliard.</p> <p>Po kështu krahasuar me raportimet e vitit 2021 rezulton se referuar raportit të “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2021”, faqe 52 citohet se: <i>Për periudhën deri në Dhjetor 2021, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) pas rakordimit të të dhënave me OSHEE Group SH.A, raporton se detyrimet e akumuluar të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të jenë në vlerën 21.9 miliard lekë, ku vetëm ndërmarrja e UK SH.A Durrës ka 6.71 miliardë lekë të këtyre detyrimeve.</i> Për sa më sipër të dhënat e raportuara për fundin e vitit 2021, nuk rakordojnë me të dhënat e fillimit të vitit 2022 dhe si rrjedhojë as me raportimin e dhjetor 2022.</p> <p>Për detyrimet e prapambetura të qeverisjes së përgjithshme nga MFE në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022” është evidentuar se duke qenë se procesi i shlyerjes së detyrimeve nga ana e institucioneve kryhet në respektim të parimit FIFO, rezulton se detyrimet që mbeten për t’u shlyer gjatë vitit 2022 karakterizohen nga një “moshë mesatare” e re e krijimit të tyre, konstatim i cili nuk qëndron duke qenë se nga auditimi janë konstatuar raste të mosrespektimit të parimit FIFO dhe po kështu likuidime të faturave të viteve të kaluara, duke filluar nga viti 2013. Gjithashtu ky konstatim bie në kundërshtim dhe me raportin “Mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2022” në seksionin “Gjetjet kryesore në sistemin e detyrimeve të prapambetura” ku ndër të tjera evidentohet mosrespektim i qasjes FIFO në radhën e shlyerjes së detyrimeve. Këto situata konstatohen me impakt negativ për krijimin e detyrimeve të prapambetura për shkak të cenimit të kontroleve për marrjen e masave për reduktimin e këtij stoku. Të gjitha këto problematika ndikojnë në rritjen e</p>
--	---

	detyrimeve të prapambetura dhe si rrjedhojë edhe të risqeve fiskale në të ardhmen.
Kriteri:	Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 43. Udhëzimi nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar, pika 31, 33. Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, kapitulli 6.3, tabela nr. 5. Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 63. Udhëzimi plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, kreut 6, pika 43.
Impakti:	Krijimi i detyrimeve të prapambetura rishtazi; Kryerje të rishikimeve të fondeve buxhetore për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, për shkak të mos marrjes në konsideratë të tyre në miratimin e detajimit të projekteve në çelje.
Shkaku:	Shkelje e disiplinimit të angazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme; Mungesa e një plani veprimi dhe shlyerje.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të marrin masat për implementimin e kontrolleve të stokut të detyrimeve të prapambetura, duke mundësuar gjenerimin dhe publikimin e të dhënave financiare mbi detyrimet e prapambetura sipas kohës së krijimit të tyre, shtesave përgjatë vitit, pagesave dhe gjendjes në fund viti, me qëllim kryerjen e një raportimi sa më të saktë dhe forcimin e monitorimit të risqeve nga njësia përgjegjëse në MFE. MFE të marr masa për vlerësimin e problematikave të konstatuara nga KLSH me qëllim rritjen e monitorimit të risqeve fiskale.

2.C. Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit.

2.C.1. Kryerja e Pagesave dhe ndjekja e detajimit të planit buxhetor dhe çeljeve fillestare në SIFQ nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë (SIFQ). Regjistrimi, kontrolli, kontabilizimi dhe përpunimi i informacionit të transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme.

-Mbi bazën e të dhënave për kryerjen e testeve të auditimit për vitin buxhetor 2022 nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion me burim sistemin SIFQ, moduli pagesave, rezultojnë gjithsej rreth 370,568 transaksione të regjistruara në total në shkallë sistemi të Degëve të Thesarit me shtrirje përgjatë 12 muajve duke përfshirë edhe transaksionet me xhirim të brendshëm për periudhën 01.01.2022 – 31.03.2023. Nga këto transaksione për efekt realizimi të buxhetit të vitit 2022, me datë libri të madh vitin 2022 përfshihen 307,448 transaksione për ekzekutimin e buxhetit dhe kryerjen e pagesave sipas modulit të pagesave. Ekzekutimi i buxhetit të vitit 2022 është kryer përgjatë gjithë muajve të vitit 2022 si dhe në muajt e parë të vitit 2023, sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pjesa më e madhe e transaksioneve janë të përqendruara në ekzekutim nga Dega e Thesarit Tiranë për shkak të numrit të institucioneve buxhetore të cilat operojnë me këtë degë thesari (124,955 transaksione si bazës së të dhënave të vendosura në dispozicion me efekt buxhetin e vitit 2022).

Institucionet me numrin më të lartë të veprimeve, sipas SIFQ janë: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit me njësitë e tyre të

varësisë. Përveç modulit të pagesave, SIFQ ofron dhe modulën për qëllime planifikimi dhe monitorim të zbatimit të buxhetit dhe angazhimeve shumëvjeçare të qeverisë shqiptare në tre vite sipas planit buxhetor afatmesëm të miratuar. Nga këto transaksione, u shqyrtuan saktësia dhe përputhshmëria e regjistrimit të çeljeve buxhetore si dhe regjistrimet për rishikimet e çeljeve buxhetore si reflektim i kërkesave të institucioneve, VKM-ve dhe akteve normative, urdhër-prokurimeve, kontratave të angazhimeve për blerje dhe investime, urdhër-shpenzimet e dërguara nga njësitë ekonomike për pagesa të faturave dhe shpenzimeve të tjera operative. Në vijim janë paraqitur konstatimet në bazë të auditimit të evidencave të vëna në dispozicion për secilin komponent/modul.

Mbi regjistrimet për rishikimet buxhetore për vitin 2022

Me qëllim vlerësimin e regjistrimeve të çeljeve dhe rishikimeve buxhetore, u analizuan të dhënat e plan buxhetit të projekteve të qeverisjes qendrore dhe vendore për 12 muajt të vitit 2022 nga ku konstatohen edhe këtë vit rishikime të shumta të fondeve buxhetore të kryera përgjatë gjithë vitit. Konkretisht, me efekt për buxhetin e vitit 2022 konstatohen 2956 rishikime sipas numrit unik të rishikimit buxhetor të cilat kanë sjellë ndryshime për 25,508 transaksione sipas muajit buxhetor në të cilin kanë sjellë ndryshime. Nga auditimi konstatohet se muaji me efekte rishikimesh buxhetore më të mëdha është muaji dhjetor me 6731 raste ose rreth 26.4% të rasteve në total.

01-2022	02-2022	03-2022	04-2022	05-2022	06-2022	07-2022	08-2022	09-2022	10-2022	11-2022	12-2022	Total
751	1075	2054	2299	1094	1590	1313	1710	1968	1991	2932	6731	25508

Numri i rishikimeve buxhetore është i lartë përgjatë gjithë vitit dhe ka filluar që në muajin janar 2022, me detajimin e fondeve buxhetore sapo ka përfunduar procesi i detajimit fillestar buxhetor në nivel njësie ekonomike. Kërkesat për rishikime vijnë nga pothuaj të gjitha njësitë ekonomike. Sipas Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt.06.12.2012, të ndryshuar, pika 79 e tij: “Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”, dhe në bazë të numrit të lartë të rishikimeve mund të konkludojmë për një planifikim tepër të dobët të shpenzimeve për investime ashtu edhe ato për shpenzime operationale, nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore, mungesës së analizave të mirëfillta para planifikimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, mungesë monitorimi i zbatimit të buxhetit dhe veçanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve me rrjedhojë numrin e lartë të faturave të prapambetura nga viti në vit.

-Nga ana tjetër, nga analiza e bazës së të dhënave të vendosura në dispozicion për rishikimet buxhetore me efekt në vitin buxhetor 2022 konstatohen rishikime të cilat janë kryer në tejkalim të afateve të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, paraqitur në aneks. Këto rishikime buxhetore kanë ndodhur në muajin shkurt dhe mars 2023 ndërkohë që sipas përcaktimeve në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor e drejta për të kryer pagesa mbi planin e rishikuar zgjat deri në muajin janar pas vitit buxhetor dhe për më tepër, tabela e treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar ka afat publikimi deri në ditën e fundit të muajit shkurt pas vitit buxhetor që raportohet.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se janë kryer 763 rishikime buxhetore pas datës 15 nëntor të vitit 2022, veprim në kundërshtim me nenin 48 “Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet: “E drejta e njësite të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor” (lista e detajuar paraqitet në aneks). Të grupuara sipas

numrit të identifikimit të rishikimit buxhetor dhe datës së krijimit të rishikimit në sistemin informatik financiar të qeverisë këto rishikime buxhetore të cilat janë kryer në vitin 2023 për llogari të vitit buxhetor 2022, paraqiten:

Periudha e krijimit të rishikimit	Numri i rishikimeve buxhetore
16-31 Nëntor 2022	103
Dhjetor 2022	394
Janar 2023	253
Shkurt 2023	11
Mars 2023	2

Këto rishikime buxhetore janë ndikuar edhe nga ndryshimi i buxhetit me dy akte normative në muajin dhjetor 2022 duke ndryshuar të drejtën për të shpenzuar në pakësim apo shtesë të fondeve buxhetore të njëjseve shpenzuese në muajin e fundit të mbylljes së buxhetit të shtetit për vitin buxhetor objekt auditimi.

- Nga shqyrtimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, një tjetër fenomen që konstatohet është regjistrimi i rialokimeve të fondeve buxhetore me data kontabile efektive më të hershme (retrospektive). Në përputhje me Udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit, detajimi i buxhetit dërgohet zyrtarisht tek çdo njësi qendrore dhe bëhet i vlefshëm për zbatim vetëm pasi regjistrohet në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ) nga struktura përgjegjëse për buxhetin. Çdo regjistrim kalon nëpër disa faza miratimi. Kështu sipas udhëzuesit miratuar me Urdhrin nr.62 datë 31.08.2010 “Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit” sipas procedurës: 1) *Pranimi i dokumentacionit nga institucionet buxhetore*; 2) *Hetimi i të dhënave në sistemin e thesarit*; 3) *Regjistrimi i transaksionit të rishikimit*; 4) *Paraqitja për aprovim*; *Veprimi i aprovimit*; *Postimi i rishikimit të buxhetit në Librin e Madh*; *Kryerja e mbylljeve ditore në sistem*, parashikohen mjaftueshëm kontrole për shmangien e gabimeve në regjistrim. Ky fenomen konstatohet për aktivitetin e Drejtorisë së Buxhetit, si përgjegjëse për monitorimin e këtyre regjistrimeve në SIFQ. Tabela në vijim bën një paraqitje të numrit të rasteve të regjistrimeve me data efektive (GL) retrospektive ku rezultojnë gjithsej 373 regjistrime datat efektive të të cilave janë të një ose disa muajve më të hershëm:

Muaji i librit të madh	2022												2023			Total	
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars		
01-2022	678	66	4							3							751
02-2022		1025	39		11												1075
03-2022			2050	4													2054
04-2022			18	2271	10												2299
05-2022				58	983	45				8							1094
06-2022		11			11	1551	13					4					1590
07-2022						21	1254	32	4	2							1313
08-2022								1664	46								1710
09-2022								33	1908	23	4						1968
10-2022								3	73	1875	38	2					1991
11-2022										206	2711	15					2932
12-2022											81	3345	3273	26	6		6731
Total	678	1102	2111	2333	1015	1617	1267	1732	2042	2110	2834	3362	3273	26	6		25508

Ndryshimi i planit të buxhetit për periudha të hershme buxhetore nuk është në përputhje me parashikimet e bëra në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit sipas gjurmëve të miratuara të auditimit duke qenë se ky kriter përcakton kryerjen e ndryshimeve sipas kërkesave të njëjseve buxhetore për periudha në vijim të kryerjes së ndryshimit dhe jo para saj.

Mbi kryerjen e pagesave nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë, regjistrimi, kontrolli, kontabilizimi dhe përpunimi i informacionit të transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme.

-Mbi regjistrimet për urdhër-prokurimet (urdhër-blerje)

Institucionet buxhetore, të cilat operojnë direkt në SIFQ, krijojnë dhe regjistrojnë në sistem çdo urdhër prokurim shoqëruar me kodin dhe përshkrimin e projektit dhe fondin limit të përcaktuar në planin e miratuar të prokurimeve të institucionit dhe pasi marrin numrin unik të regjistrimit në SIFQ dhe vulën e Thesarit, procedojnë me dërgimin në Agjencinë e Prokurimit Publik për vazhdimin e procedurës së prokurimit. Me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së këtij kriteri, u audituan të dhënat e vendosura në dispozicion mbi numrin e urdhër-prokurimeve të regjistruara në SIFQ gjatë vitit 2022 ku rezultojnë 642 rekorde unike të dokumentit urdhër-prokurim me vlerë totale 76.19 miliard lekë. Ekzistenca e një numri të vogël të regjistrimit në SIFQ të urdhër-prokurimit rezulton pasi elektronikisht ai është i mundur vetëm për institucionet që kanë akses të plotë në SIFQ, aktualisht vetëm 15 institucione (ky numër nuk ka ndryshuar nga viti i kaluar). Institucionet e tjera buxhetore të cilat nuk kanë akses online në sistemin Informatik Financiar të Qeverisë, për ekzekutimin e këtij kontrolli, marrin konfirmimin nga dega e thesarit përkatëse nëpërmjet vulosjes së urdhër prokurimit në rast të vlefshmërisë në sistem të fondeve të cilat synohen të prokurohen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Tabela në vijim paraqet vlerat e urdhëruara për prokurim nga secili institucion buxhetor online:

Institucioni buxhetor	Shuma e urdhër prokurimit
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	7,771,643,004
Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR) (3535)	313,854,350
Aparati i Këshillit të Ministrave (3535)	22,455,819
Aparati i Ministrisë së Brendshme (3535)	42,270,459
Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (3535)	10,140,197,984
Aparati i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (3535)	250,819,919
Aparati i Ministrisë së Arsimit e Shkencës (3535)	2,664,493,663
Aparati i Ministrisë së Mbrojtjes (3535)	109,639,515
Aparati i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (3535)	289,166,801
Aparati i Ministrisë së Drejtësisë (3535)	95,370,163
Aparati i Ministrisë së Financave (3535)	670,492,625
Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	1,620,310,225
Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (3535)	180,273,669
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	37,517,243,284
Bashkia Tirana (3535)	14,499,799,523
Totali	76,188,031,001

Nga kryqëzimi i të dhënave të bazës së të dhënave të urdhër prokurimeve me të bazën e të dhënave të vendosura në dispozicion për kontratat e regjistruara në SIFQ përgjatë vitit 2022 janë konstatuar parregullsi të cilat janë iniciuar nga institucionet buxhetore dhe janë lejuar të procesohen nga sistemi i thesarit si në vijim:

- **Janë konstatuar 102 raste të urdhër prokurimeve** të regjistruara në sistem në vitin buxhetor 2022 të cilat lidhen me një kontratë të nënshkruar në vitet e mëparshme buxhetore (2011-2021), pra procedura e prokurimit ka përfunduar para se urdhër-prokurimi të regjistrohet në SIFQ dhe regjistrimi në SIFQ është formal dhe në shkelje të afateve ligjore. Në tabelën e mëposhtme janë detajuar rastet më përfaqësuese sipas institucioneve buxhetore, të detajuar më hollësisht në aneks.

Institucioni buxhetor	Raste
Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (3535)	1
Aparati i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (3535)	3
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	12
Aparati i Ministrisë së Financave (3535)	4
Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	3

Aparati Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (3535)	8
Aparati Ministrisë së Drejtësisë (3535)	1
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	41
Bashkia Tirana (3535)	29

-Janë konstatuar 52 raste në të cilat urdhër prokurimet rezultojnë të jenë regjistruar 0 deri në 10 ditë diferencë nga data e kontratës, afat ky i pamundur për realizimin e një procedure prokurimi. Në këto raste konstatohet se radha e regjistrimit në SIFQ është formale dhe pa asnjë vlerë për kontrollin dhe bllokimin e fondeve disponibël përpara fillimit të procedurës së prokurimit. Tabela në vijim paraqet numrin e rasteve sipas institucioneve përgjegjëse më përfaqësuese për sa i përket vlerës së kontraktimit sipas numrit unik të urdhër prokurimit.

NR. Urdhër prok.	data e kontratës	data urdhër prok.	institucioni	Vlera
2101001-2200200	12/16/2022	12/12/2022	Bashkia Tirana (3535)	2,208,940,967
1087006-2200070	11/1/2022	11/10/2022	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	748,183,200
2101001-2200203	12/7/2022	12/13/2022	Bashkia Tirana (3535)	414,119,902
1012001-2200019	8/19/2022	8/26/2022	Aparati i Ministrisë së Kulturës (3535)	179,259,167
1006054-2200083	9/30/2022	9/22/2022	Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	113,795,689
2101001-2200187	11/24/2022	12/1/2022	Bashkia Tirana (3535)	106,903,717
1011001-2200014	10/14/2022	10/13/2022	Aparati i Ministrisë Arsimit e Shkencës (3535)	96,192,792
1087006-2200040	5/17/2022	5/12/2022	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	93,720,000
1087006-2200048	6/6/2022	6/6/2022	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	78,621,696
1006054-2200076	6/29/2022	7/7/2022	Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	51,292,399
1087006-2200051	6/8/2022	6/13/2022	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	37,779,251
1087006-2200049	6/6/2022	6/13/2022	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	19,655,424

Përsa i përket urdhër-prokurimeve të institucioneve e tjera, pa akses të plotë në SIFQ, dhe që sipas Udhëzimit duhet të paraqiten fizikisht në Degët e Thesarit për të marrë vulën e konfirmimit të fondeve disponibël, përpara se të fillojë procesin e tenderimit, nuk ekziston ende mundësia (fusha) për regjistrimin e këtij dokumenti në SIFQ. Në konkluzion, dokumenti i urdhër-prokurimit regjistrohet në SIFQ në shkelje të Udhëzimit standard për zbatimin e buxhetit. Në SIFQ nuk ka informacion nëse çdo prokurim ka filluar pasi janë konfirmuar fondet disponibël në Thesar.

Mbi regjistrimin e kontratave sipas bazës së të dhënave të kontratave në sistemin informatik financiar të qeverisë.

Me qëllim arritjen e konkluzioneve audituese mbi afatet dhe përputhshmërinë e regjistrimit të kontratave sipas viteve buxhetore në përputhje me planin e ekzekutimit të tyre si dhe buxhetin e alokuar u testuan të dhënat e marra nga SIFQ për periudhën 01.01.2022-31.03.2023 sipas modulit të kontratave duke u analizuar sipas periudhave. Nga auditimi konstatohen se rezultojnë gjithsej 20,288 kontrata për periudhën 01.01.2022-31.03.2023 me një vlerë të kontraktuar 177,496,958,820 lekë, nga të cilat 16,503 kontrata në shumën 146,373,423,513 lekë të regjistruara për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 (viti 2021; 25291 kontrata unike me vlerë 88.03 miliard lekë). Për llogari të vitit buxhetor 2022 rezultojnë të jenë lidhur 17,283 kontrata (me datë kontratë 01.01.2022-31.12.2022) me vlerë të kontraktuar 159,282,645,396 lekë. Të analizuar sipas ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera si dhe në llogari ekonomike sipas buxhetit të miratuar, kontratat e lidhura në vitet e mëparshme dhe përgjatë vitit 2022, të regjistruara deri në 31.03.2023 paraqiten në aneks. Diferencat në analizën e të dhënave dhe arsyeja pse janë marrë të dhenat e regjistruara seri në 31.03.2023 për kontratat është sepse kontratat e lidhura në vitin 2022 nuk janë regjistruar në kohën e duhur në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe regjistrimi i tyre ka vijuar edhe përgjatë vitit 2023.

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme vlerën më të lartë të kontraktuar e kanë njësitet e vetëqeverisjes vendore me të ardhurat e veta apo fonde të deleguara, ndjekur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale etj.

Nga auditimi konstatohet se nuk është respektuar afati 3 ditor për regjistrimin e kontratave

nga data e nënshkrimit të tyre në 10,602 raste në vlerën 116,287,680,801 lekë sipas përcaktimeve të bëra në pikën 157 të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit ku citohet që “Nëpunësi zbatues i njësisë respektive regjistron kontratën ose urdhrin e prokurimit për blerjet e vogla, sipas rastit, në kontabilitetin e menaxhimit, përpilon dokumentin e afateve të pagesave, dhe paraqet dokumentacionin si më sipër në gjuhën shqipe (në rastin e kontratave të lidhura në gjuhë të huaj) me njoftimin përfundimtar zyrtar për shpalljen e fituesit, në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë brenda tre ditëve pune nga nënshkrimi i tyre”. Fenomeni i regjistrimit me vonesë i kontratave vazhdon të shfaqet edhe këtë vit i përhapur, si në njësitë e qeverisje vendore ashtu dhe në ato qendrore, përfshirë dhe institucionet e pavarura, paraqitur më hollësisht në tabelën në vijim:

Ministria/Institucioni	Vlera	Raste
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	33,880,512,922	711
Njësitë e vetqeverisjes vendore	31,081,065,855	3,830
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	15,494,161,087	505
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	8,498,797,742	3,386
Institucione të tjera Qeveritare	7,791,591,758	326
Ministria e Brendshme	4,726,920,848	226
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	3,500,166,603	337
Ministria e Mbrojtjes	3,017,900,898	245
Ministria e Kulturës	2,748,797,140	67
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1,918,950,331	332
Të tjera	3,628,815,617	637
Total	116,287,680,801	10,602

Njësitë e qeverisjes vendore zënë 27% të totalit të vonesave në regjistrime. Në nivel njësie shpenzuese në njësitë e qeverisjes së përgjithshme me numrin më të lartë të vonesave evidentohen si më poshtë:

Ministria/Institucioni	Vlera	Raste
Bashkia Tirana (3535)	10,709,281,364	347
Bashkia Durrës (0707)	4,980,956,211	95
Bashkia Kavaja (3513)	1,651,939,322	110
Bashkia Kurbin (2019)	1,167,235,284	40
Bashkia Kamëz (3535)	1,081,158,042	91
Ndërmarrja e punëtorëve nr. 2 (3535)	817,258,039	71
Bashkia Himarë (3737)	664,932,256	48
Bashkia Krujë (0716)	535,052,873	45
Bashkia Vorë (3535)	502,550,034	27
Bashkia Shkodër (3333)	485,480,239	161

Nga auditimi i të dhënave të paraqitura në këtë modul konstatohen kontrata të viteve të mëparshme buxhetore që datojnë nga viti 2007-2020 të paraqitura sipas institucioneve dhe vitit të kontratës në tabelën e mëposhtme:

Viti kontratës dhe institucioni	Vlera e kontrates
2007	8,280,000
Dogana Rinas (3535)	8,280,000
2011	62,738,397
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	55,219,677
Bashkia Pukë (3330)	7,518,720
2012	15,554,253
Bashkia Cërrik (0808)	15,554,253
2013	1,800,000
Bashkia Kukës (1818)	1,800,000
2014	13,633,220
Bashkia Cërrik (0808)	5,590,000
Bashkia Vorë (3535)	7,800,000
Spitali Kukës (1818)	243,220
2017	149,614,120
Bashkia Belsh (0808)	34,975,992
Bashkia Dibër (0606)	1,864,504
Bashkia Kavaja (3513)	1,952,050
Bashkia Vorë (3535)	16,551,574

Tirana Parking (3535)	94,270,000
2018	2,843,162,397
Bashkia Poliçan (0232)	4,449,323
Bashkia Tirana (3535)	2,836,915,232
Fondi i Zhvillimit Shqiptar (3535)	1,797,842
2019	10,120,221,248
Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (3535)	9,942,325,078
Aparati i Ministrisë së Financave (3535)	19,454,930
Bashkia Kukës (1818)	832,560
Bashkia Tirana (3535)	1,656,645
Bashkia Vorë (3535)	29,121,605
Spitali Dibër (0606)	14,447,487
Spitali Kukës (1818)	8,800,000
Spitali Vlorë (3737)	103,582,943
2020	285,726,976
Aparati Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (3535)	22,795,285
Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (3535)	9,009,010
Bashkia Belsh (0808)	3,578,205
Bashkia Elbasan (0808)	24,099,780
Bashkia Konispol (3731)	2,644,220
Bashkia Kukës (1818)	564,660
Bashkia Malësi e Madhe (3323)	1,300,000
Bashkia Pogradec (1529)	976,274
Bashkia Tirana (3535)	18,796,227
Fondi i Zhvillimit Shqiptar (3535)	162,319,756
Qendra spitalore universitare "Nënë Tereza" (3535)	7,887,210
Sanatoriumi Tiranë (3535)	442,080
Sh.A. Ujësllës-Kanalizime Tiranë (3535)	4,171,629
Shoqëria Rajonale Ujësllës Kanalizime Durrës SH.A (0707)	24,142,640
Sp. Laç (2019)	3,000,000

I njëjti konstatim vlerësohet edhe për kontratat e vitit 2021 të cilat janë regjistruar në vitin 2022 të cilat përfshihen në kontratat në tejkalim të afatit në 138 raste në shumën 21,314,065,063 lekë ku institucionet më përfaqësuese përfshihen në tabelën e mëposhtme:

Viti kontratës dhe institucioni	Vlera e kontratës
Fondi i Zhvillimit Shqiptar (3535)	5,291,455,862
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	4,689,959,916
Bashkia Tirana (3535)	2,450,091,449
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	2,033,679,056
Shoqëria Rajonale Ujësllës Kanalizime Durrës SH.A (0707)	1,052,847,647
Sh.A. Ujësllës-Kanalizime Tiranë (3535)	1,034,625,403
Drejtoria e Rajonit Jugor (Gjirokastër) (1111)	1,007,702,250
Reparti Ushtarak Nr.1001 Tiranë (3535)	486,301,449
Qendra spitalore universitare "Nënë Tereza" (3535)	346,855,875
Bashkia Kavaja (3513)	207,998,070

-Nga auditimi u konstatua mosregjistrim në SIFQ i planit të pagesave të kontratës e kushtëzuar nga mos detajimi i planit buxhetor për projekte të investimeve sipas parashikimeve të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Analiza është kryer duke përdorur modulën e regjistrimit të investimeve sipas angazhimit të ndërmarrë të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ku janë konstatuar raste të projekteve për të cilat ka angazhim në vitin aktual në vlerë të përcaktuar, angazhim 0 lekë për vitet 1 dhe 2 dhe në vijim angazhim në vitin e tretë dhe të katërt në vlerë sipas tabelës së mëposhtme:

Project	Inst.	Acc	TDO	Current Year	F-Y	F-Y	F-Y	F-Y
				MY Commitment	Commitments 1	Commitments 2	Commitments 3	Commitments 4
18AJ603	1005001	231	3535	2.00			70,689,812.00	11,878,268.00
19AH101	1006054	231	3535	1.00			3,276,780.00	
21AA501	1006184	231	3535	148.00			7,536,345.00	
M062784	1006054	231	3535	2.00			1,629,053.00	
M063284	1006054	231	3535	17,456,908.00			14,077,900.00	
18AV906	1010039	231	3535	25,382,497.00			29,612,914.00	
18AY635	1010001	231	3535	1,912,381.00			117,344,007.00	
18AY637	1010001	231	3535	404,190.00			17,144,110.00	
18AY638	1010001	231	3535	6,311,964.00			97,965,394.00	4,640.00
18AY645	1010001	231	3535	1,652,830.00			0.60	

18AE710	1012001	231	3535	9,966,158.00			109,981.00	
18AE712	1012001	231	3535	36.00			2,941,759.00	
18AU711	1016056	231	3535	13,641.00			30,925,189.00	
18AZ406	1017051	231	3535	1.00			390,861.00	
18AZ818	1017138	231	3535	243,480.00			1,337,065.00	
18AZ901	1017142	231	3535	61,798,867.28			306,002.00	
M280016	1028001	231	3535	3,834.00			112,888.00	
M290068	1029007	231	3535	358,182.14			3,992,443.76	
20AD424	1087006	231	3535	10,273,084.00			122,240,000.00	

Konstatimi është formuar në bazë të raportit më të fundit për vitin buxhetor, atë të muajit dhjetor të vitit 2022, duke qenë se në këtë periudhë janë konsoliduar edhe të dhënat në lidhje me planin dhe faktin. Ndryshimi i shpeshtë i projekteve të investimit me rialokime apo akte normative si dhe ndërmarrja e angazhimeve në projekte të reja investimesh në kuadër të tavaneve të përcaktuara për programet e shpenzimeve të miratuara, ka sjellë shtyrjen e planit të pagesave si pasojë e planit buxhetor me efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Ndër raste të tjera përfaqësuese në fund të vitit buxhetor 2022 paraqiten edhe projekte përmbledhës të cilët e kanë të shtyrë të gjithë shumën e angazhimit të investimit në tejkallim të buxhetit të miratuar tre vjeçar sipas ligjit nr.115/2021 me rreth 50 miliard lekë si në tabelën e mëposhtme:

Project	Inst.	Current Year	F-Y	F-Y	F-Y	F-Y
		MY Commitment	Commitments 1	Commitments 2	Commitments 3	Commitments 4
18BA201	1006001			1,874,000,000.00	1,730,000,000.00	16,562,000,000.00
18BA213	1006001	161,176,173.00		967,000,000.00	956,000,000.00	6,963,626,545.00
18BA203	1006001	1,498,500.00		738,000,000.00	738,000,000.00	4,946,632,200.00
18BS546	1006054	138.00		2,637,411,845.00	2,488,410,947.00	2,550,411,845.00
18BS542	1006054	1.00		2,587,593,464.00	2,415,659,727.00	2,358,657,727.00
18BS539	1006054	1.00		2,262,220,416.00	2,140,128,949.00	2,044,220,415.00
18BS544	1006054	1.00		2,141,677,167.00	3,578,944,024.00	1,766,266,857.00
18BS552	1006054			209,000,000.00	2,962,415,078.00	1,456,783,059.00
18BS540	1006054	38,917.00		2,036,316,398.00	4,012,119,795.00	1,349,801,397.00
18BS551	1006054			250,000,000.00	1,922,908,380.00	1,257,293,143.00
18BT017	1006054			49,000,000.00	281,000,000.00	971,800,000.00
18BT016	1006054			49,000,000.00	270,000,000.00	942,372,840.00
18BD511	1011040					872,000,000.00
18BS616	1006054			209,000,000.00	937,257,703.00	857,696,583.00
18BS609	1006054			2,386,366,784.00	1,308,862,455.00	724,302,954.00
18AE715	1012001			208,104,189.00	12,693,594.00	611,967,359.00
18BS612	1006054			2,571,334,953.00	948,271,017.00	563,127,496.00
18BD511	1011040					387,915,120.00
19AG903	1006190					286,886,741.02
18BB045	1013050					254,848,545.42
18BQ479	1006190					248,293,030.29
Te tjera		75,277,231.00	804,183,232.00	16,364,291,286.20	13,107,740,485.72	2,385,870,055.74
Totali		237,990,962.00	804,183,232.00	37,540,316,502.20	39,810,412,154.72	50,362,773,912.47

Project	Inst.	Acc	TDO	Current Year	F-Y	F-Y	F-Y	F-Y
				MY Commitment	Commitments 1	Commitments 2	Commitments 3	Commitments 4
18AY636	1010001	231	3535	5,040,836.00				19,134,477.00

-Mbi regjistrimet për pagesat e realizuara përgjatë vitit buxhetor 2022.

Referuar Ligjit Nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit. Nga auditimi i të dhënave të transaksioneve të procesuara në sistemin SIFQ u konstatuan tejkallime të këtyre afateve si nga ana e njësisve shpenzuese ashtu edhe nga degët e thesarit. Në analizën e kryer me qëllim testimin e respektimit të afateve të kryerjes së pagesave janë marrë në shqyrtim vetëm llogaritë e shpenzimeve operative (602) dhe shpenzimeve në proces për rritjen e investimeve (230 dhe 231).

Nga auditimi u konstatuan 27,311 fatura në total me vlerë 52,578,940 mijë lekë të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor nga data e furnitorit të përcaktuar në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga këto transaksione të procesuara me vonesë, 4,033 prej tyre i përkasin shpenzimeve për investime me vlerë 34,203,157 mijë lekë, ndërkohë që pjesa tjetër prej 23,279 rastesh i përket shpenzimeve operative me vlerë totale prej 18,375,783.7 mijë lekë. Të analizuara sipas institucioneve kryesore me problematikat më të mëdha në regjistrimet e faturave për investime dhe shpenzime operative apo vendime gjyqësore paraqiten:

Institucionet buxhetore	Shuma
Vendori, nga të cilat	18,353,960,233
Bashkia Durrës (0707)	1,556,451,595
Bashkia Kamez (3535)	962,900,882
Bashkia Lezhë (2020)	812,052,754
Bashkia Tirana (3535)	6,938,449,277
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nga të cilat	16,124,798,557
Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (3535)	4,526,178,301
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	5,550,474,554
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve (3535)	592,972,701
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nga të cilat	5,027,229,397
Qendra spitalore universitare "Nënë Tereza" (3535)	2,883,810,960
Institucione të tjera Qeveritare, nga të cilat	4,460,880,572
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	4,429,067,400
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	3,566,980,682

-Ekzekutimi i transaksioneve të pagesës, pas regjistrimit në SIFQ, referuar kuadrin ligjor për menaxhimin e shpenzimeve publike, duhet të kryhet brenda 30 ditëve. Nga auditimi konstatohet se në disa raste këto parashikime nuk janë respektuar ku janë konstatuar 9 raste në vlerën 65.4 milion lekë të transaksioneve në të cilat diferenca ndërmjet datës së ekzekutimit në SIFQ me datën e regjistrimit në SIFQ është mbi 30 ditë, për llogari të buxhetit të vitit 2022.

INVOICE_ID	NUMRI_FATURES	EMRI_INSTITUCIONIT	SHUMA	DATA_REGJISTRIMIT	DATA_EKZEKUTIMI	Dif ekz-regj
4887363	8121090102022	Teatri "Skampa" (0808)	40,000	5/9/2022	7/4/2022	56
5066025	453321010012022	Bashkia Tirana (3535)	72,922	11/25/2022	1/4/2023	40
4949283	94221660012022	Bashkia Kamëz (3535)	6,950,000	7/15/2022	8/31/2022	47
4848360	8010170892022	Reparti Ushtarak Nr.4401 Tiranë (3535)	3,513,030	3/23/2022	5/4/2022	42
5065255	16811660012022	Bashkia Kamëz (3535)	24,096,636	11/25/2022	12/29/2022	34
5021257	44920171382022	Spitali Universitar i Traumës (3535)	2,610,000	10/11/2022	11/11/2022	31
5043612	151521660012022	Bashkia Kamëz (3535)	20,000,000	11/4/2022	12/13/2022	39
4948406	95021660012022	Bashkia Kamëz (3535)	8,000,000	7/14/2022	9/1/2022	49
4906600	18110870172022	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike	116,160	5/30/2022	7/1/2022	32

Mbi pagesat pjesore të faturave.

Nga auditimi u konstatuan të paktën 20 raste në rreth 2.7 miliard lekë të regjistrimit dhe pagesave pjesore të faturave, të cilat janë më të vogla se sa vlera e detyrimit të lindur sipas faturës së furnitorit, kjo me qëllim përputhjen e fondeve buxhetore disponibël. Me paraqitjen e faturës dhe urdhër-shpenzimit nga njësitë buxhetore, regjistrimi nga degët e thesarit është bërë pjesor duke rezultuar në pagesa pjesore, me vlerë të barabartë me fondet disponibël të detajuara nga buxheti. Pavarësisht numrit të vogël të rasteve të konstatuara, KLSH thekson efektin e detyrimeve të prapambetura në kushtëzimin e procesimit të transaksioneve të pjesshme në sistem, veprime që nuk japin siguri për vlerën reale të shpenzimeve apo investimeve të raportuara. Këto praktika nuk janë në përputhje me ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku njohja e shpenzimit bëhet në çastin e konstatimit dhe pagesa e tij bëhet brenda 30 ditëve.

INVOICE_ID	NUMRI_FATURES	PERSHKRIMI_FATURES	SHUMA
5093657	77710060012022	MIE NDER TIM TUNELI I LLOGARASE PAGESE PJESORE SIT 12.SHK 9464/1 DT 12.12.2022 KONTRAT VZHD 4061/13 DT 8.11.21 VAZHD SHK 8776 DT 14.11.22 FAT 16/2022 DT 30.11.22 SHK 9418 DT 9.12.22 RAPORTI PROG 12 NENTOR 22 SITUACION 12	633,904,750

4843881	10210060012022	MIE PAGESA NR 14 RRUGA E ARBRIT SHKRESA 911/2 DT 23.2.22 KONTRATA 553 REP NR 247 KOL 16.3.2019 SHKRESA NJZP 24/12 DATE 24/12/2019 SITUACIONI NR 14FAT 18(63302518)30.9.2019 SITUACIONI NR. 15FAT 15 FAT 19(63302519)DT 31.10.2019 PAGESE PJESORE	420,000,000
4908552	186921010012022	2101001 Bashkia Tirane lik për infrst arsimi per 5obj shkrs 16153/2 dt12.05.22 cert fin perf10.05.22 VKM nr353 dt.19.04.17 aneksi nr.3 fnjf 6649/1 dt.14.02.18 kontr 9513 dt.17.10.18 pv dt.27.04.22 fat nr 5/22 dt.29.04.22 (pjesore)	197,537,194
5093636	77610060012022	MIE NDERTIM TUNELI I LLOGARASE PAGESE PJESORE MBYLLSE SIT 11 SHK 8776/1 DT 23.11.2022 KONTRAT VZHD 4061/13 DT 8.11.21 VAZHD SHK 8776 DT 14.11.22 FAT 15/2022 DT 31.10.22 SHK 8484 DT 7.11.22 RAPORTI PROG 11 TETOR 22 SITUACION 11	191,815,613
5100097	88921060012022	2106001 Bashkia Diber furnizim me uje nga burimi i Grames,faza1,up nr 25/1.kont nr 25/13 dt 15.09.2020,njf,sit perfu nr 08 dt 31.10.2022,ft nr 128/2022 dt 31.10.2022,pv kolaudimi,certifikate e perkohshme ,pv marrje ne dorezim lik pjesor sit	161,500,000
5101730	157421070012022	LOTI RIKONSTRUKSION OSE RIPARIMIN E MJEDISEVE NE NE BASHKEPRONESI NJESIA12345 SUKTH MANZ KONTR. 588/17 DT 1.4.221 LIK PJESOR FAT 36/202 BASHKIA DURRES / 2107001 /DEGA E THESARIT DURRES/ 0707	123,804,517
5105249	557321010012022	2101001 Bashkia Tirane Hart dhe lik proj god7 seks C Kombinart kont ne vazhd 9350/4 dt 05.03.2021 amendim kont 27184/2 dt 29.07.2022 sit 2 dt 19.12.2022 fat 547/2022 dt 21.12.2022 pjesore	95,450,746
5099657	56221120012022	Bashkia Patos 2112001 rikonstruks. magjist.ujesj. Patos lik.pjesor up.16.08.2019 rrp.26.03.2020 njf.30.03.2020 kontr.2214/21 dt.31.03.2020 fat.158/2022 sit.perf. akt-kolaud 20.07.2022 amdperk.DP	95,000,000
4996313	95921070012022	ENERGJI PJESORE SIPAS KONTRATAVE BASHKENGJITUR/ BASHKIA DURRES / 2107001 /DEGA E THESARIT DURRES/ 0707	87,750,518
5100094	88821060012022	2106001 Bashkia Diber furnizim me uje nga burimi i Grames,up nr 03/1.kont nr 03/13 dt 14.06.2021,njf,si perfundimt nr 06 dt 21.10.2022,ft nr 90/2022 dt 27.10.2022,pv kolaudimi,certifikat e perk.pv marrje ne dore,lik pjesor	85,500,000
5093759	178921270012022	BASHKIA LEZHE LIK FAT.12 DT.24.06.2022,fat.1 dt.16.11.2022,SITUAC NR.2,SIT NR.3(LIK PJESOR),URDH PROK 44 DT.25.10.2021,NJ.F DT.14.01.22 PL I ZBATIM PUNIM NR.18530/24 DT.21.01.2022 KONTR.18530/21 DT.21.01.2022 RIFORCIM I PALLAT TE KULTURES	84,849,747
5099602	539021010012022	2101001 Bashkia Tirane lik dep ndert landfild incenerator Kontr vazhd nr 6597 dt.31.08.17 sitc Nentor 22 fat nr 6224/22 dt.13.12.2022 pjesore	76,114,312
5118445	575721010012022	2101001 Bashkia Tirane Lik ndert montim liqeni Farke kontr vazhd nr 4049/3 dt.18.02.2022 sitc nr 2 dt.16.12.2022 fat nr 121 dt.28.12.2022 (pjesore)	72,790,876
5106038	186121230012022	2123001 - Bashkia Kruje Riforcimi i njesive te banimit ne ndertesa te cilat do te rikonstruktohen ne kuader te procesit te rindertimit kontrate nr 5903 dt 14.09.2022 sit nr 2 fat nr 16/2022 dt 29.12.2022 per vlere pjesore	69,459,088
5065675	460921010012022	2101001 Bashkia Tirane Lik per depoztimin e mbetjeve ndert incenerator dhe rehabilitim kontr vazhd nr 6597 dt.31.08.17 sitc Korrik 2022 fat nr 4354/22 dt.05.08.2022 (pjesore) skan ne ush nr 3801/22	67,143,316
4988296	33010560012022	1056001 F ZH SH 2022, lik fit rindert ban ind, kontr ne vazhd GOA /p-33 dt 24.02.2021, ft nr 81/2022 dt 31.08.2022, sit nr 3 pjesore dt 18.08.2022-30.08.2022	66,644,459
5101754	155621070012022	LOTI RIKONSTRUKSION OSE RIPARIMIN PALL BASHK DURRES KONTR. 4985/144 DT 15.08.2022 LIK PJESOR FAT 13/202 BASHKIA DURRES / 2107001 /DEGA E THESARIT DURRES/ 0707	57,795,670
4997878	131810870062022	AKSHI- Shkrese Deges se Thesarit Tirane Nr.Prot. 5652 Date 13.09.2022 per Kontraten e Klasifikuar Nr. Prot 72 Date 05.03.2021 Likujdim Fature pjesore Implem.Nr.1172/2021 dt 16.12.2021 Rap Mujor 356 dt.16.12 FH Nr 65 Dt 16.12.2021	54,451,648
4888187	8410060472022	1006047 AKUM.2022, lik fit permirsim infrastr, kontr ne vazhd nr 2446 dt 26.08.2019, ft nr 17/2021 dt 12.04.2021sit nr 5 pjesore dt 20.12.2020-30.01.2021	53,998,000
5086542	503521010012022	2101001 Bashkia Tirane lik shites kontr Rijetesimi Piramides UP30470 dt02.09.22 pv 22.09.22 fnjf 30740/3 dt.03.10.22 kontr 30740/5 dt.19.10.22 sitc nr 1 dt.02.12.22 fat nr 594/22 dt.12.12.22 (pjesore)	52,107,668
Totali			2,747,618,122

-Mbi përdorimin e buxhetit të vitit 2022 për kryerjen e pagesave për detyrime të viteve të mëparshme buxhetore

Nga auditimi konstatohet se buxheti i vitit 2022 i miratuar me ligjin nr. 115/2021 të ndryshuar është përdorur për shlyerjen e detyrimeve që i përkasin viteve të mëparshme buxhetore, detyrime të prapambetura për vitet e kaluara, për fatura investimesh, për fatura shpenzimesh operative apo zbatimin e vendimeve gjyqësore. Pagesa e këtyre faturave/detyrimeve të viteve të kaluara buxhetore me fondet e miratuara për vitin 2022 është në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në lidhje me parashikimet e bëra për njohjen e tyre në momentin e ndodhjes pavarësisht momentin të pagesës, duke sjellë mbivlerësim të treguesve përkatës sipas klasifikimit në llogari ekonomike të publikuar në treguesit e konsoliduar fiskalë në të njëjtën masë për këtë vit. Nga procedurat analitike mbi bazën e të dhënave të pagesave konstatohen gjithsej 9,349 transaksione pagesash në vitin 2022 në shumën totale 16,808.9 milion lekë të cilat i përkasin faturave me datë të viteve buxhetore të mëparshme. Të detajuara sipas llogarive të investimeve apo shpenzimeve operative/vendime gjyqësore këto pagesa paraqiten në 7,654 transaksione pagesash në

shumën 5,038.3 milion lekë raportuar në grupin e llogarive 602 dhe pjesa tjetër prej 1,695 në shumën 11,770.6 milion lekë në grupin e llogarive të investimeve 230/231.

- Efekti për vitin buxhetor 2022 për investime konstatohet në 44 projekte investimesh në shumën 11.8 miliard lekë, paraqitur në tabelën e mëposhtme me institucionet më përfaqësuese të cilat kanë paguar fatura investimesh të viteve të kaluara:

Institucioni	Shuma
Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (3535)	3,147,181,981
Fondi i Zhvillimit Shqiptar (3535)	1,082,337,014
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	650,716,025
Bashkia Tirana (3535)	614,865,823
Bashkia Kamëz (3535)	412,490,154
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizimeve (3535)	285,229,614
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	283,388,818
Bashkia Mat (0625)	268,034,614
Bashkia Kolonjë (1514)	263,615,924
Bashkia Vorë (3535)	205,704,498
Të tjera institucione	4,557,003,842
Totali	11,770,568,307

- Efekti për vitin buxhetor 2022 për shpenzime operative dhe vendime gjyqësore konstatohet në llogari të ndryshme në shumën rreth 5 miliard lekë, klasifikuar në llogaritë më përfaqësuese si në vijim:

Kategori shpenzimesh	Shuma
Shpenzime për mirëmbajtjen e paisjeve të zyrave	1,154,897,066
Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit	652,617,666
Elektricitet	433,724,334
Ilaçe dhe materiale mjekësore	420,355,166
Shërbime të tjera	356,300,333
Te tjera materiale dhe shërbime speciale	226,820,275
Shërbimet bankare	205,601,430
Shpenzime për mirëmb.e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj	199,640,504
Karburant dhe vaj	186,889,773
Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative	141,656,679
Te tjera	1,059,787,980
Totali	5,038,291,207

Institucionet më përfaqësuese të cilët kanë ekzekutuar pagesa me buxhetin e vitit 2022 për shpenzime operative të ndodhura në vitet e mëparshme buxhetore paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Emri i institucionit	Shuma
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	1,198,721,531
Qendra spitalore universitare "Nënë Tereza" (3535)	486,027,129
Aparati Drejt.Përgj.Doganave (3535)	320,466,953
Aparati Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (3535)	227,965,780
Bashkia Vlorë (3737)	210,840,315
Bashkia Kavaja (3513)	194,200,485
Bashkia Tirana (3535)	146,871,276
QFM Teknike Tiranë (3535)	138,387,557
Aparati Drejt.Përgj.Tatimeve (3535)	100,991,751
Bashkia Lezhë (2020)	95,005,681
Te tjera	1,918,812,749
Totali	5,038,291,207

-Mbi detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve buxhetore përgjatë vitit 2022 për mbulimin e detyrimeve të prapambetura mbartur nga vitet e kaluara për rreth 3.8 miliard lekë ku vlera e fondeve të detajuara përrputhet plotësisht me vlerën e pagesave të kryera.

Në lidhje me kryerjen e këtyre pagesave, nga kryerja e procedurave audituese, konstatohet se nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në një pjesë të konsiderueshme të faturave

të investimeve të viteve të kaluara, detajimi i fondeve buxhetore përputhet plotësisht me vlerën e paguar nga ana e njësive të qeverisjes së përgjithshme. Fondet disponibël të këtyre projekteve të investimeve janë buxhetuar vetëm për paguar detyrimet e prapambetura të këtyre projekteve/kontratave, pra detajimi/rishpërndarja buxhetore është ekzaktësisht e barabartë me vlerën e faturës (ve) të prapambetura.

Në njësitë e qeverisjes qendrore, efektet e këtyre konstatimeve vlerësohen në shumën 3.64 miliard lekë sipas institucioneve të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Institucioni buxhetor	Shuma
Aparati i Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise (3535)	2,940,000,000
Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit (3535)	458,000,000
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Elbasan Qytet (Elber) (0808)	57,033,662
Agjensia Kombetare e Punësimit dhe Aftësive (3535)	50,563,200
Aparati Drejt.Pergj.Tatimeve (3535)	41,340,000
Agjencia e Eficences se Energjise (AEE) (3535)	18,178,640
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	17,492,815
Qarku Durres (0707)	13,708,846
Universiteti Bujqesor (3535)	11,640,000
Te tjera	35,310,940
Totali	3,643,268,103

Në njësitë e qeverisjes vendore, efektet e këtyre konstatimeve vlerësohen në shumën 193 milion lekë sipas institucioneve të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Institucioni	Shuma
Bashkia Kamëz (3535)	76,444,096
Bashkia Cërrik (0808)	25,612,422
Bashkia Shijak (0707)	20,000,000
Bashkia Lezhë (2020)	11,932,200
Bashkia Kavaja (3513)	10,645,294
Bashkia Mirditë (2026)	10,285,451
Bashkia Delvinë (3704)	9,355,956
Bashkia Konispol (3731)	5,614,680
Bashkia Finiq (3704)	4,442,970
Bashkia Malësi e Madhe (3323)	3,459,903
Të tjera	15,157,042
Totali	192,950,014

-Gjithashtu nga auditimi janë konstatuar raste në të cilat pagesat nga buxheti i shtetit për shlyerjen e faturave kryhen në të njëjtën ditë ose deri në 10 ditë diferencë nga data e regjistrimit të kontratës (data e krijimit të kontratës) në sistemin informatik financiar të qeverisë. Ky konstatim përfshin 202 projekte investimesh të procesuara për pagesë në shumën 2,168 milion lekë, që dëshmon formalitetin e regjistrimit të transaksioneve në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe jo duke ndjekur procedurat e parashikuara në udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit si pasojë e anashkalimit të kontroleve të brendshme. Lista e detajuar e projekteve të investimit paraqitet në aneks, ku janë paraqitur shuma e urdhër shpenzimit të parë të kryer, data e regjistrimit të kontratës në sistem dhe diferenca ndërmjet regjistrimit të urdhër shpenzimit dhe datës së krijimit të kontratës sipas kodeve të projekteve të investimeve publike kryer nga njësitë e qeverisjes qendrore apo njësitë e qeverisjes vendore. Nga analiza e kryer pasi këtij konstatimi arrihet në konkluzionin që përveç shmangies së procedurave të kontrollit në lidhje me ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore, detajimin e fondeve, regjistrimin e tyre dhe kryerjen e pagesave për angazhimet e marra përsipër ekziston risku që si pasojë e diferencës së vogël në kohë ndërmjet datës së kontratës dhe datës së kryerjes së pagesës, rast pas rasti nga ana e njësive të qeverisjes së përgjithshme të kryhen pagesa në formën e parafinancimit për përfituesit e fondeve publike.

-Nga auditimi mbi regjistrimin e kontratave dhe kryerjen e urdhër shpenzimeve në sistemin informatik financiar të qeverisë, konstatohen raste në të cilat data e kontratës (data e kontratës fizike) sipas modulit të kontratave është në të njëjtën ditë apo me diferencë deri në 10 ditë nga regjistrimi i urdhër shpenzimit të parë për projektet e investimit të identifikuar me problematika. Këto konstatime përfshijnë gjithsej 63 projekte investimesh në shumën 471 milion lekë, që dëshmon për kryerjen e pagesave drejt përfituesve të fondeve publike në një kohë shumë të shkurtër nga kryerja lidhja e kontratës, afat i pamjaftueshëm për kryerjen e punimeve apo marrjen në dorëzim të tyre. Gjithashtu në disa raste përfaqësuese këto projekte investimesh përfshijnë lëvrimin e fondeve në formën e paradhënieve për kryerjen e punimeve, në kundërshtim me parashikimet e bëra në udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit duke parafinancuar investimet publike dhe duke mbivlerësuar treguesit e investimeve publike. Lista e detajuar e këtyre projekteve paraqitet në aneks.

-Nga auditimi në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e informacionit të raportuar në treguesit fiskalë të konsoliduar për vlerat e raportuara të shpenzimeve operative dhe investimeve u konstatuan nga baza e të dhënave të pagesave deri në 31.03.2023 transaksione me datë fature të vitit 2022 dhe të mëparshëm për të cilat është përdorur buxheti i vitit 2023. Këto transaksione, nuk rezultojnë të jenë paguar në kohë në shumën 8,377 milion lekë, të cilat megjithë efektet e akteve normative dy ditë përpara fundit buxhetor si dhe të drejtës për të kryer shpenzime edhe gjatë muajit janar 2023 për efekt të vitit buxhetor 2022. Të grupuara në investime dhe shpenzime operative klasifikimi paraqitet në shumën 5,677 milion lekë për investime dhe 2,700 milion lekë për shpenzime operative sipas paraqitjes në tabelën e mëposhtme:

Fatura sipas viteve	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Shpenzime/investime													
Investime	-	-	1,099,210	-	-	-	1,952,050	-	16,976,045	787,121,392	695,436,120	4,174,347,962	5,676,932,779
Shpenzime operative	3,281,215	1,249,225	856,811	426,142	523,161	887,131	2,405,524	5,415,190	8,437,251	5,965,826	18,364,028	2,652,359,904	2,700,171,408
Total	3,281,215	1,249,225	1,956,021	426,142	523,161	887,131	4,357,574	5,415,190	25,413,296	793,087,218	713,800,148	6,826,707,867	8,377,104,188

-Nga auditimi konstatohet se pjesa më e madhe e ekzekutimit të shpenzimeve/investimeve përqendrohet në muajin dhjetor në mbyllje të vitit buxhetor. Nga analiza e bazës së të dhënave të pagesës konstatohet me datë libri të madh në muajin dhjetor 2022 janë procesuar për pagesë edhe fatura të viteve të mëparshme apo të muajve të mëparshëm të vitit 2022 si në tabelën e mëposhtme:

Periudha e fatures	Shuma
2008-2021	1,411,873,247
Viti 2022	64,483,712,427
Janar	110,129,678
Shkurt	352,390,178
Mars	736,755,980
Prill	560,974,232
Maj	536,187,522
Qershor	627,224,254
Korrik	1,226,461,870
Gusht	1,667,842,256
Shtator	2,331,369,103
Tetor	3,299,004,004
Nentor	9,375,845,357
Dhjetor	43,659,527,992
Totali	65,895,585,673

Nga 65.89 miliard lekë fatura të kaluara me datë libri të madh në dhjetor 2022 konstatohen rreth 20.8 miliard lekë të pagesa të faturave që i përkasin muajve janar-nëntor 2022, nga ku konstatohet se ekzekutimi i buxhetit nuk është i njëtrajtshëm përgjatë vitit 2022 duke sjellë problematika si pasojë e planit buxhetor edhe në planin e arkës për procesimin e tyre.

- Auditimi mbi respektimin e procedurave të radhës së prioriteteve të pagesës (FIFO).

Në udhëzimin e MFE nr.9 dt. 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 178, 179 dhe 180 është përcaktuar: “178. Struktura përgjegjëse për thesarin miraton kërkesat për pagesë në SIFQ. 179. Në fillim të çdo dite struktura përgjegjëse për thesarin procedon me vendosjen e limitit ditor të pagesave në funksion të menaxhimit efektiv dhe transparent të likuiditeteve të llogarisë së unifikuar të thesarit në Bankën e Shqipërisë. 180. Më pas, nëpërmjet SIFQ vijohet me procedurën e grupimit të kërkesave për pagesë sipas rregullit të regjistrimit kronologjik të urdhër-shpenzimeve (hyrje e parë - dalje e parë)”. Referuar rregullit kush hyn i pari (regjistrohet) në sistemin e pagesave likuidohet i pari, nga grupi i auditimit u morën me testimin e gjithë popullatës për llogari të buxhetit të vitit 2022, me një total prej 182,580 transaksione që përfshijnë një vlerë transaksionesh prej 193,088 milion lekë. Analiza u krye vetëm për pagesat nga llogarisë e shpenzimeve operative (602) dhe shpenzimeve për investime (230 dhe 231), pra duke përjashtuar pagat, kontributet apo llogari të tjera të transfertave. Sipas udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit plani i arkës propozohet nga struktura e Thesarit dhe miratohet nga Nëpunësi i Parë Autorizues dhe në të njëjtën kohë gjatë vitit është objekt rishikimi, në zmadhim/reduktim në kufijtë maksimalë mujorë të lejuar për shpenzim, pa cenuar funksionimin normal të njësisë. Regjistrimi i transaksioneve të pagesave dhe ekzekutimi i tyre i përmbledhur sipas muajve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Janar 2023	Totali
Janar	1,378,119,496	135,406,295												1,513,525,791
Shkurt		5,708,228,096	1,078,513,728	135,720			11,000							6,786,888,544
Mars			8,735,176,016	638,858,970	3,584,488									9,377,619,474
Prill				12,280,234,975	1,108,059,191									13,388,294,166
Maj					9,501,505,612	1,053,226,154	2,230,108	1,077,600						10,558,039,474
Qershor						11,055,726,889	1,136,496,094	880,786						12,193,103,769
Korrik							12,069,045,512	770,717,203	8,000,000			87,400		12,847,850,115
Gusht								15,116,147,197	1,020,848,819	377,424				16,137,373,440
Shtator									12,521,106,802	626,693,847				13,147,800,649
Tetor											1,056,725,329			18,148,827,180
Nentor											10,913,253,861	2,179,049,436	72,922	13,092,376,219
Dhjetor												36,788,546,273	8,072,846,405	44,861,392,678
Janar 2023													21,034,889,411	21,034,889,411
Totali	1,378,119,496	5,843,634,391	9,813,689,744	12,919,229,666	10,613,149,291	12,108,953,043	13,207,782,714	15,888,822,786	13,549,955,621	17,719,173,123	11,969,979,189	38,967,683,109	29,107,808,738	193,087,980,910

Nga auditimi mbi krahasimin e datës së ekzekutimit të transaksioneve të pagesave në SIFQ me datë e regjistrimit të urdhër shpenzimit konstatohen raste në të cilat edhe sipas muajve janë ekzekutuar pagesa jo sipas parimit hyrje e parë, dalje e parë në sistem. Analiza e mëtejshme është fokusuar në baza ditore të procesimit të transaksioneve. Nga auditimi u konstatuan ekzekutime të pagesave të faturave të regjistruara në data të mëvonshme, përpara urdhër shpenzimeve të regjistruara në data më të hershme. Ky konstatim rezultoi i përhapur përgjatë gjithë muajve të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2022 dhe nga ana e grupit të auditimit janë përzgjedhur për çdo muaj raste të pagesave sipas klasifikimit të realizuar mbi datën e regjistrimit të urdhër pagesës në thesar me datën e ekzekutimit të saj. Në këtë mënyrë, është konstatuar se pagesa e kryera në 21 data të ndryshme të vitit buxhetor nuk kanë ndjekur në disa raste parimin hyrje e parë dalje e parë (FIFO) sipas përcaktimeve në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit sipas për kampionin e paraqitur në tabelën e mëposhtme:

INVOICE_ID	NUMRI FATURES	EMRI INSTITUCIONIT	SHUMA	Data e regjistrimit	Data e ekzekutimit
4798244	1510170092022	Repartit Ushtarak Nr.1001 Tiranë (3535)	40,015,336	1/17/2022	1/21/2022
4812680	5921360212022	Qendra Arsimore Pogradec (1529)	58,780	2/4/2022	2/25/2022
4818125	9510100012022	Aparati Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (3535)	47,623,000	2/11/2022	2/18/2022
4825061	11110870062022	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	21,639,999	2/22/2022	3/1/2022
4840885	64821010012022	Bashkia Tirana (3535)	51,053,179	3/10/2022	3/18/2022
4867601	55110870062022	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	116,592,507	4/12/2022	4/21/2022
4874541	131221010012022	Bashkia Tirana (3535)	34,320,000	4/21/2022	5/9/2022

4889854	13421560012022	Bashkia Konispol (3731)	1,000,000	5/11/2022	6/15/2022
4901342	168321010012022	Bashkia Tirana (3535)	37,963,980	5/23/2022	5/31/2022
4915108	198121010012022	Bashkia Tirana (3535)	111,753,619	6/7/2022	6/16/2022
4947507	255221010012022	Bashkia Tirana (3535)	87,870,527	7/14/2022	7/29/2022
4966769	76310060542022	Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	21,098,733	8/5/2022	9/1/2022
4997878	131810870062022	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (3535)	54,451,648	9/15/2022	9/27/2022
5029899	112410100012022	Aparati Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (3535)	28,582,860	10/20/2022	11/2/2022
5052971	122910100012022	Aparati Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (3535)	56,899,079	11/14/2022	11/21/2022
5043612	151521660012022	Bashkia Kamëz (3535)	20,000,000	11/4/2022	12/13/2022
5077498	79510170092022	Reparti Ushtarak Nr.1001 Tiranë (3535)	333,845,554	12/9/2022	12/15/2022
5096555	71210560012022	Fondi i Zhvillimit Shqiptar (3535)	56,244,385	12/23/2022	1/4/2023
5097963	539621010012022	Bashkia Tirana (3535)	48,177,336	12/24/2022	1/19/2023
5109878	565021010012022	Bashkia Tirana (3535)	66,038,823	1/6/2023	1/17/2023
5119645	27010260882022	Agjencia Kombëtare e Turizmit (3535)	10,740,000	1/12/2023	1/31/2023

Nga auditimi konstatohet se për këto raste të evidentuara në tabelën e mësipërme janë procesuar transaksione në datat e ndërmjetme të datës së regjistrimit të transaksioneve në sistem dhe datës së ekzekutimit në sistem, çka përcakton devijimin në parimin hyrje e parë, dalje e parë sipas përcaktimeve në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit.

Për problematikat e mësipërme mbajnë përgjegjësi nëpunësit autorizues, nëpunësit zbatues të njësisve të qeverisjes së përgjithshme, degët e thesarit në rrethe në rolin e autorizuesit të regjistrimit dhe kryerjes së transaksioneve në sistem, Zj. M.DH. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, Zj. Xh.A. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit, Z. E.T. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike Z. F.B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financave Vendore për çështjet e detajimit të planit buxhetor dhe rishikimeve përgjatë vitit, Zj. A.B. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Zj. A.V. me detyrë drejtor i ngarkuar përkohësisht i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për çështjet e procesimit të transaksioneve dhe regjistrimit të tyre në sistem si dhe Z.A.GJ. në rolin e ish- nëpunësit të parë autorizues.

Për konstatimet e mësipërme janë paraqitur observacione me shkresën nr. 5854/36 datë 31.07.2023 nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ku në mënyrë të përmbledhur është pretenduar:

Pretendimet e subjektit:

-Lidhur me kontratat e depozituara në degët e thesarit në rrethe me mbi 3 ditë pune është raportuar nga degët e thesarit dhe Nëpunësi i Parë Autorizues i ka tërhequr vëmendjen zyrtarisht Nëpunësve Autorizues të njësisve të qeverisjes së përgjithshme.

- Lidhur me faturat e depozituara në degët e thesarit në rrethe me vonesë, është raportuar nga degët e thesarit dhe Nëpunësi i Parë Autorizues i ka tërhequr vëmendjen zyrtarisht Nëpunësve Autorizues të njësisve të qeverisjes së përgjithshme.

-Lidhur me vonesat regjistrimit – ekzekutim, Këto pagesa janë ekzekutuar me vonesë në mungesë të planit limit mujor, janë depozituar dhe regjistruar në SIFQ për të respektuar afatin 30 ditorë të faturës, por për mungesë të limitit mujor janë ekzekutuar me vonesë.

-Lidhur me pagesat pjesore të faturave,..... Bazuar në Udhëzimin e përhershëm të buxhetit përgjegjësia e likuidimit pjesor të faturave është e NA dhe NZ të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në menaxhimin e fondeve buxhetore. Lidhur me faturat e Bashkisë Patos kalimet pjesore janë bërë për arsye se çelja e fondeve nga Ministritë e linjës është më pak se shumica e faturës. Kjo ndodh sidomos me ministritë e linjës për fonde që transferojnë për pushtetin vendor. Në këtë rast është çelur fondi nga ministria 06 për 100.000.000 lekë me periudhë 12-2022 dhe duhet ekzekutuar. Ndërkohë që kontrata e lidhur ka vlerë më të madhe dhe fatura është lëshuar njëherësh për të gjithë vlerën. Kalimi bëhet pjesor pasi fondet e ministrive të linjës nuk mbarthen në vitin pasardhës.....Fatura e Bashkisë Krujë është likuiduar me fonde të rindërtimit dhe për mungesë fondesh është likuiduar pjesërisht. Pagesa pjesore e bërë nga Bashkia Dibër është bërë në bazë të fondeve të disponueshme.

-lidhur me regjistrimin e kontratës në të njëjtën ditë me faturën ... Dokumentacioni i paraqitur në degët e thesarit ne rrethe për ekzekutimin e pagesës ka qenë i rregullt, nuk është kompetencë e thesarit zbatimi i projektit.

- lidhur me ekzekutimin e buxhetit në Dhjetor Në SIFQ bëhet ekzekutimi i pagesave sipas urdhër – shpenzimeve të depozituara nga institucionet buxhetore. Është në përgjegjësinë e NA-së dhe NZ-së së institucionit përcaktimi i fondeve buxhetore që përdorin. Nuk është në kompetencë të DOTH-së ekzekutimi i njëtrajtshëm i buxhetit. Për punonjësit e thesarit në degë bëhet e papërbalueshme kjo ngarkesë në muajt e fundit të vitit nga institucionet.

- mbi respektimin e radhës së pagesës hyrje e parë, dalje e parë, Janë institucione buxhetore që kane akses të drejtpërdrejtë në SIFQ dhe pasi është marrë miratimi dhe janë depozituar dokumentet për kontroll ne degët e thesarit janë ekzekutuar pagesat. Vonesat e depozitimit në thesar sjellin diferenca në datat e regjistrimit me ekzekutimin. Pamje nga sistemi për çdo rast. Këto pagesa janë refuzuar nga përgjegjësja e degës së thesarit Tiranë për mangësi dokumentacioni ose gabim në përshkrim dhe pasi është plotësuar dokumentacioni i saktë është bërë miratimi në SIFQ dhe ekzekutimi pagesave. Kjo ka sjellë vonesë nga data e regjistrimit në datën e ekzekutimit.

-rishikime përtej afatit ligjor për kryerjen e tyre,.... Dy rishikime buxheti të Bashkisë Kamëz të rregjistruara në shkurt të vitit 2023 për llogari të vitit 2022 janë kryer vetë për efekt të sistemimit të planeve ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe ndërmarrjeve në varësi të saj, jo për ti përdorur për ekzekutim.

-për regjistrimet e urdhër prokurimeve,.... Dega e Thesarit Tirane sqaron: Për sa i takon regjistrimit të urdhër prokurimeve (kërkesë blerje) me vonesë në SIFQ nga institucionet me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ për vitet e mëparshme është përgjegjësia e vet institucionit. Kjo i takon periudhave të mëparshme dhe për kontratat e lidhura para vitit 2022.

Me fillimin e arshivës elektronike dhe lidhjes së sistemit AFMIS me sistemin e APP-së nuk mund të fillojë prokurimi pa regjistruar më parë urdhrin e prokurimit (kërkesën e blerjes) në sistem.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në përgjigje të observacioneve të mësipërme sqarojmë:

- lidhur me vonesat e fatura dhe kontratave sqarojmë se tërheqja e vëmendjes nuk është e parashikuar në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor, por për disiplinimin e këtyre anomalive është përcaktuar kontrolli i brendshëm si dhe aplikimi i masave administrative.

-lidhur me vonesat regjistrim – ekzekutim sqarojmë se limiti mujor është kontroll që aplikohet përpara aprovimit të faturës në sistem sipas përcaktimeve të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit.

-lidhur me regjistrimin e kontratës në të njëjtën ditë me faturën, për çdo rast, nga strukturat e thesarit janë procesuar transaksione të cilat mbartin elementë të angazhimeve jashtë fondeve të disponueshme dhe duhet të ishin objekt referimi për vendimmarrje të mëtejshme administrative.

- lidhur me ekzekutimin e buxhetit në Dhjetor janë pranuar efektet e mungesës së menaxhimit të duhur të ekzekutimit të buxhetit.

- mbi respektimin e radhës së pagesës hyrje e parë, dalje e parë, argumentimi për refuzimet dhe vonesat në dorëzim dokumentacioni nuk dokumentohet nga pamjet e sistemit, por vetëm diferenca e datave.

-rishikime përtej afatit ligjor për kryerjen e tyre, pohojnë konstatimin për ndodhjen e tyre.

-për regjistrimet e urdhër prokurimeve, sqarojmë se pranimi nga ana e thesarit për procesim dhe mos përcjellja për vendimmarrjen e duhur administrative nuk përbën argument për heqjen nga përgjegjësia. Për këto arsye observacionet nuk merren në konsideratë.

Për konstatimet e mësipërme janë paraqitur observacione nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit ku në mënyrë të përmbledhur është pretenduar:

Pretendimet e subjektit:

1. **Numri i lartë i rishikimeve buxhetore**, Paraqitet një numër i lartë i rishikimeve të evidentuara në SIFQ nga Grupi i KLSH-së. Lidhur me këtë konstatim, sjellim në vëmendje se nga ana e grupit të KLSH-së nuk janë evidentuar më vete numri i rialokimeve të planit të buxhetit i ndarë ky në shpenzime korrente dhe shpenzime për investime, rialokime të planit të buxhetit vendor, rialokimet e planit të thesarit, si edhe rialokimet e numrit të punonjësve. **Rishikime buxhetore të miratuara pas**

datës 15 Nëntor të vitit 2022. Edhe në këtë rast nuk është evidentuar numri i rialokimeve pas kësaj date për shpenzimet korrente.

Duke qenë se nuk është i evidentuar më vete numri i rialokimeve të planit të buxhetit për shpenzime korrente, për të cilat Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit është përgjegjëse, nga ana jonë sqarojmë se: -Përsa i përket shpenzimeve korrente, të gjitha veprimet që prekin Fondin Rezervë, Fondin e Kontingjencës si edhe dhe Fondin e Veçantë nuk konsiderohen rialokime buxhetore, pasi në çdo rast të përdorimit të tyre kemi të bëjmë me shpërndarje/detajim të fondeve dhe jo rialokim/transferim. Kjo është e përcaktuar qartë në Udhëzimin e përhershëm "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". Gjithashtu nuk konsiderohen rishpërndarje edhe disa fonde që sipas procedurave specifike të përcaktuara për përdorimin e tyre, shpërndahen gjatë vitit, si psh, shpërndarja e fondeve për projektet artistike, për emergjencat, shpërndarja e fondeve për shpërblim të menjëhershëm të funksionarëve që lirohen nga detyra, etj. Pra numri i rishpërndarjeve për shpenzimet korrente nuk konsiderohet problematik nga ana jonë, bazuar në argumentimin e mësipërm.

-Gjithashtu për shpenzime korrentet nuk janë miratuar rialokime shpenzimesh për të cilat janë paraqitur kërkesa pas datës 15 Nëntor. Të gjitha alokimet e fondet për rastet e përmendura në paragrafin e mësipërm nuk mund të konsiderohen si rialokime të kryera pas datë 15 Nëntor. Gjithashtu edhe rishikimet e kryera në zbatim të AN nr .17/2022 dhe nr.19/2022, si edhe VKM-ve në këtë periudhë nuk mund të konsiderohen si rishikime të kryera pas datës 15 nëntor si rishikime jashtë këtij afati.

-Gjithashtu nga ana e DMB nuk janë miratuar rialokime me data retrospektive. Këtu mund të përjashtojmë ndonjë rast të zbatimit të Aktit Normativ 19/2022, i cili u diktua nga fakti i miratimit të tij më datë 29.12.2022.

2.Nga ana e Drejtorisë së Financave Vendore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit është parashtruar se "referuar konstatimeve që kanë të bëjnë me parregullsitë dhe vonesat në regjistrimin e urdhrave të prokurimit, dorëzimit në thesar të faturave jashtë afatit 30-ditor nga data e furnitorit, pagesat pjesore të faturave, pagesa të urdhër shpenzimeve në të njëjtën ditë me lidhjen e kontratës, mos respektimit të radhës së pagesave, sqarojmë se janë jashtë kompetencave të Drejtorisë së Financave Vendore".

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në përgjigje të observacioneve të mësipërme sqarojmë:

- miratimi i ndryshimeve të buxhetit pas datës 15 nëntor, qoftë nëpërmjet VKM-ve (për të cilat MFE nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit jep miratimin), qoftë nëpërmjet akteve normative (për të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit është në rolin e propozuesit të ndryshimeve të projekt aktit për MFE), është në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit, nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në të cilin është kategorikisht e ndaluar kryerja e rishikimeve sipas përkufizimit të rishikimit buxhetor pas datës 15 Nëntor. Kjo pasi deri në 20 Tetor të çdo viti hartohet projekt buxheti i vitit të ardhshëm dhe në këto kushte, nuk mund të ndryshohen shumat e pasqyruara mbi fondet e miratuara pas depozitimit të akteve për marrjen e miratimit të buxhetit për vitin e ardhshëm.

Për pjesën e detajimit për shpenzimet operative dhe konstatimit me efekte retrospektive, sqarojmë se rishikimet e listuara sipas aneksit (ku mund të aksesohen rishikimet sipas drejtorive përkatëse të DPB) me numër identifikimi për rishikimet buxhetore në sistemin informatik financiar të qeverisë përfshijnë edhe rishikime të kryera nga Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit (600-606). Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

- për pretendimin nga ana e Drejtorisë së Financave Vendore për çështje për të cilat lidhen me pagesa pjesore, jashtë afateve, në të njëjtën ditë me kontratës se janë jashtë kompetencave të kësaj drejtorie, sqarojmë se janë pikërisht shpërndarjet e planit dhe rishpërndarjet gjatë vitit, objekt kompetence të Drejtorisë së Financave Vendore për fondet e njësisve të vetëqeverisjes vendore (sikurse janë cituar në akt), të cilat shkaktojnë këto efekte në ciklin e menaxhimit të shpenzimeve publike, vetëm për konstatimet në rastet e njësisve të vetëqeverisjes vendore, referuar përcaktimeve të bëra në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit dhe ligjit organik të buxhetit. Sipas gjurmëve të auditimit dhe përcaktimeve në kuadrin rregullator përkatës, çdo detajim dhe rishikim i planit të shpenzimeve pas propozimit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ai bëhet i vlefshëm dhe efektiv në sistemin informatik financiar të qeverisë vetëm pas miratimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit nëpërmjet Drejtorisë së Financave Vendore. I njëjti arsyetim vlen edhe për miratimin e dhënë nivelin e fondeve për shpenzimet operative nga Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit dhe për fondet e

investimeve nga ana e Drejtorisë së Investimeve Publike. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit me shkresën nr. 281/25 prot. KLSH datë 11.09.2023 janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit ku janë parashtruar pretendimet e mëposhtme:

Pretendimi i subjektit:

Për rekomandimin nr. 28Drejtoria e Procesimit të Biznesit shprehet se rkeomandimi nuk mund të pranohet për arsye se rregullat e regjistrimit të buxhetit dhe kontrollit të fondeve buxhetore në SIFQ janë në përputhje me rregullat e përcaktuara në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, akteve ligjore dhe nënligjore që rrjedhin prej tij. Nëse këto rregulla do të ndryshojnë atëherë do të vijohet edhe me ndryshimet e nevojshme të konfigurimeve në SIFQ lidhur me këto procese.

Për rekomandimin nr. 31....Sqarojmë se radha dhe prioritetet janë respektuar. Faturat e konstatuara janë për mungesë plani të thesarit, pasi urdhër shpenzimet regjistruhen/miratoohen në SIFQ përkundrejt planit vjetor të buxhetit. Theksojmë se plani i thesarit për njësitë vendore krijohet vetëm kur arkëtohen të ardhurat e këtyre njësive dhe si rrjedhim pagesa e faturave të tyre është në varësi pikërisht të likuiditetit që njësitë vendore krijojnë. Nëse këto fatura do të kontrolloheshin për ekzistencën e planit të thesarit që në momentin e regjistrimit në SIFQ, atëherë do të ishte i pamundur regjistrimi i tyre në SIFQ dhe si rrjedhim edhe raportimi i tyre si shpenzime faktike. Pikërisht ky ka qenë motivi i shtyrjes së kontrollit të planit të thesarit në momentin e pagesës së shpenzimit dhe jo në momentin e regjistrimit të tij në kontabilitet.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se:

- Rekomandimi 28- konstatimi përfshin moszbatim të rregullave të parashikuara në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi nga ana e njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe strukturave të thesarit nëpërmjet anashkalimit të kontrolleve aktuale. Duke qenë se është detyrë e strukturave drejtuese përmirësimi i sistemeve të kontrollit të përputhshmërisë së aktivitetit, lind e nevojshme përcaktimi i kontrolleve shtesë me qëllim shmangien e paligjshmërisë, të cilat duhet ti përshtaten kushteve aktuale të kuadrit rregullator në fuqi i cili ka të përcaktuar qartë mënyrën e regjistrimit të kontratave në sistem. Për këto arsye obsevacioni nuk merret në konsideratë.

-Rekomandimi 31- konstatimi përfshin si kriter ligjor përcaktimet e bëra në udhëzimin standart të zbatimit të buxhetit ku përcaktohet qartë në gjurmët e auditimit që miratimi i transaksionit të pagesës kryhet vetëm pas kontrollit që kryhet mbi ekzistencën e planit të arkës. Gjithashtu sqarojmë se sigurimi i likuiditetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme është i qendëruar nëpërmjet sistemit të thesarit sipas përcaktimeve të bëra në ligjin e buxhetit dhe është detyrë e strukturës qendore procesimi i transaksioneve dhe marrja e masave për përshtatjen e planit të arkës të njësive të qeverisjes së përgjithshme pas kërkesës së tyre. Nga ana tjetër, fakti që shpenzimet e vendorit financohen vetëm nga të ardhurat e tyre nuk përbën argument pasi pjesa më e madhe e shpenzimeve financohen nëpërmjet të transfertave nga buxheti i shtetit të kushtëzuara ose jo. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Titulli i gjetjes:	Kryerja e rishikimeve buxhetore përtej afatit të lejuar ligjor dhe kryerja e rishpërndarjeve të fonde me efekt në periudha buxhetore të mbyllura në sistemin informatik financiar të qeverisë.
Situata:	Nga auditimi konstatohen rishikime të shumta të fondeve buxhetore të kryera përgjatë gjithë vitit, me efekt buxhetin e vitit 2022 me 2,956 rishikime të cilat kanë sjellë ndryshime për 25,508 transaksione. Muaji me efekt rishikimesh buxhetore më të mëdha është muaji dhjetor me 6731 raste ose rreth 26.4% të rasteve në total. Numri i rishikimeve buxhetore është i lartë përgjatë gjithë vitit dhe ka filluar që në muajin janar 2022, me detajimin e fondeve buxhetore sapo ka përfunduar procesi i detajimit fillestar buxhetor në nivel njësive ekonomike, nga pothuaj të gjitha njësitë ekonomike. Numri i lartë i rishikimeve është tregues për një planifikim tepër të dobët të shpenzimeve, nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore, mungesës së analizave të mirëfillta para

	<p>planifikimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, mungesë monitorimi i zbatimit të buxhetit dhe veçanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve me rrjedhje numrin e lartë të faturave të prapambetura nga viti në vit.</p> <p>-Nga ana tjetër, nga analiza e bazës së të dhënave të vendosura në dispozicion për rishikimet buxhetore me efekt në vitin buxhetor 2022 konstatohen rishikime të cilat janë kryer në tejkalim të afateve, duke filluar nga data 07.02.2023 deri në datën 13.03.2023, ndërkohë që sipas përcaktimeve në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor e drejta për të kryer pagesa mbi planin e rishikuar zgjat deri në muajin janar pas vitit buxhetor dhe tabela e treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar ka afat publikimi deri në ditën e fundit të muajit shkurt. Këto rishikime janë pjesë të rishikimeve të kryera pas datës 15 nëntor, afati i fundit për kryerjen e rishikimeve buxhetore. Në total, pas datës 15 nëntor 2022, janë kryer 763 rishikime buxhetore, veprim në kundërshtim me nenin 48 “Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>- Nga shqyrtimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, konstatohet regjistrimi i rialokimeve të fondeve buxhetore me data kontabile efektive më të hershme (retrospektive) në 313 raste të regjistrimeve me data efektive (sipas librit të madh) <i>më të hershme se data e kryerjes së veprimit në SIFQ, në kundërshtim me udhëzuesin e miratuar me Urdhrin nr. 62, datë 31.08.2010 “Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit”</i>. Ndryshimi i planit të buxhetit për periudha të hershme buxhetore nuk është në përputhje me parashikimet e bëra në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit sipas gjurmëve të miratuara të auditimit duke qenë se ky kriter përcakton kryerjen e ndryshimeve sipas kërkesave të njëjësive buxhetore për periudha në vijim të kryerjes së ndryshimit dhe jo para saj.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”;</p> <p>Urdhri nr. 62, datë 31.08.2010 “Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit”;</p> <p>Udhëzim nr. 34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Të dhëna jo të sakta në lidhje me planin buxhetor dhe mundësi krijimi të detyrimeve të prapambetura, pasiguri në lidhje me fondet në dispozicion nga ana e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në mbyllje të vitit buxhetor si pasojë e rialokimeve.
Shkaku:	Planifikim i dobët i shpenzimeve si në nivelin e qeverisjes qendrore dhe atë vendore. Mungesë kontrolli dhe monitorimi i ecurisë së fondeve buxhetore.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të analizohen shkaqet e kryerjes së veprimeve në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe të nxirren përgjegjësitë për kryerjen e rishikimeve pas mbylljes së vitit buxhetor. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë e saj përgjegjëse, në rolin e ekzekutuesit dhe/apo miratuesit, të analizojë dhe investigojë të gjitha rastet e regjistrimeve me data retrospektive të rishpërndarjeve buxhetore të vitit 2022 me ndikim në saktësinë e raportimeve periodike për të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë përkatëse.
Titulli i gjetjes:	Pagesa të faturave të viteve të mëparshëm buxhetorë.

Situata:	Nga auditimi konstatohet se buxheti i vitit 2022 i miratuar me ligjin nr. 115/2021 të ndryshuar është përdorur për shlyerjen e detyrimeve që i përkasin viteve të mëparshme buxhetore, detyrime të prapambetura për vitet e kaluara, në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, duke sjellë mbivlerësim të treguesve përkatës sipas klasifikimit në llogari ekonomike të publikuar në treguesit e konsoliduar fiskalë në të njëjtën masë për këtë vit. Nga procedurat analitike mbi bazën e të dhënave të pagesave konstatohen gjithsej 9,349 transaksione pagesash në vitin 2022 në shumën totale 16,808.9 milion lekë të cilat i përkasin faturave me datë të viteve buxhetore të mëparshme. Të detajuara sipas llogarive të investimeve apo shpenzime operative/vendime gjyqësore këto pagesa paraqiten në 7,654 transaksione pagesash në shumën 5,038.3 milion lekë raportuar në grupin e llogarive 602 dhe pjesa tjetër prej 1,695 në shumën 11,770.6 milion lekë në grupin e llogarive të investimeve 230/231. Gjatë detajimit të planit të buxhetit, njësitë e qeverisjes qendrore më parë shpërndajnë fonde për të paguar detyrimet e prapambetura të viteve të kaluara për të gjitha llojet e shpenzimeve. Efekti për vitin buxhetor 2022 për investime konstatohet në 44 projekte investimesh me institucionet më përfaqësuese që përfshijnë MIE, FSHZH, AKSHI, AKUKM, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Tiranë dhe Kamëz. Efekti për vitin buxhetor 2022 për shpenzime operative dhe vendime gjyqësore konstatohet në llogari të ndryshme me institucionet më përfaqësuese AKSHI, QSUT, DPD, MFE si dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vlorë, Kavajë, Tiranë
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 48/ 2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar; VKM nr. 50, dt.05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, të ndryshuar; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”; Urdhri nr. 62, datë 31.08.2010 “Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit”; Udhëzimi nr. 34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”.
Ndikimi/Efekti:	Përdorimi i buxhetit të vitit korrent për detyrimet e prapambetura që vazhdojnë të krijohen nga viti në vit
Shkaku:	Pavarësisht prioriteteve të parashikuara për planifikimin e fondeve buxhetore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, çelja e këtyre fondeve është një praktikë e konstatuar përgjatë gjithë vitit buxhetor miratuar nga MFE jo vetëm në programimin fillestar të buxhetit korrent.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave të merren masa për raportimin e efekteve të investimeve/shpenzimeve të cilat nuk i përkasin vitit buxhetor në raportimin e të dhënave të realizimit të buxhetit për vitin 2022 dhe në të njëjtën kohë të shmanget praktika e krijimit dhe shlyerjes së detyrimeve financiare të viteve të kaluara duke shpërndarë vlerën e duhur buxhetore sipas detyrimit financiar të ligjshëm të njësitë të qeverisjes së përgjithshme. Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të investigohen pagesat e kryera për detyrime financiare të viteve të kaluara për ligjshmërinë e angazhimeve buxhetore sipas fondeve të miratuara në momentin e ndërmarrjes së këtyre

	angazhimeve nga nëpunësit autorizues dhe miratimin e dhënë nga strukturat përgjegjëse për planin buxhetor në MFE.
--	---

Titulli i gjetjes:	Nga auditimi është konstatuar mos regjistrim i urdhërprokurimeve në kohë në sistemin informatik financiar të qeverisë, por regjistrim formal i tyre vetëm pas ndërmarrjes së angazhimit buxhetor me nënshkrimin e kontratës.
Situata:	<p>Institucionet buxhetore, të cilat operojnë direkt në SIFQ, krijojnë dhe regjistrojnë në sistem çdo urdhër prokurim dhe pasi marrin numrin unik të regjistrimit në SIFQ dhe vulën e Thesarit, procedojnë me dërgimin në Agjencinë e Prokurimit Publik për vazhdimin e procedurës së prokurimit. Në SIFQ gjatë vitit 2022 rezultojnë 642 rekorde unike të dokumentit urdhër-prokurim me vlerë totale 76.19 miliard lekë. Ekzistenca e një numri të vogël të regjistrimit në SIFQ të urdhër-prokurimit rezulton pasi elektronikisht ai është i mundur vetëm për institucionet që kanë akses të plotë në SIFQ, aktualisht vetëm 15 institucione. Institucionet e tjera buxhetore të cilat nuk kanë akses online në sistemin Informatik Financiar të Qeverisë, për ekzekutimin e këtij kontrolli, marrin konfirmimin nga dega e thesarit përkatëse nëpërmjet vulosjes së urdhër prokurimit në rast të vlefshmërisë në sistem të fondeve të cilat synohen të prokurohen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Nga kryqëzimi i të dhënave të bazës së të dhënave të urdhër prokurimeve me të bazën e të dhënave të vendosura në dispozicion për kontratat e regjistruara në SIFQ përgjatë vitit 2022 janë konstatuar parregullsi të cilat janë iniciuar nga institucionet buxhetore dhe janë lejuar të procesohen nga sistemi i thesarit si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Janë konstatuar 102 raste të urdhër prokurimeve të regjistruara në sistem në vitin buxhetor 2022 të cilat lidhen me një kontratë të nënshkruar në vitet e mëparshme buxhetore (2011-2021), pra procedura e prokurimit ka përfunduar para se urdhër-prokurimi të regjistrohet në SIFQ dhe regjistrimi është formal dhe në shkelje të afateve ligjore. Institucionet me problematikat më të mëdha në këtë konstatim përfshijnë MSHMS, AKSHI, ARRSH dhe Bashkia Tiranë. -Janë konstatuar 52 raste në të cilat urdhër prokurimet rezultojnë të jenë regjistruar 0 deri në 10 ditë diferencë nga data e kontratës, afat ky i pamundur për realizimin e një procedure prokurimi. Konstatohet se radha e regjistrimit në SIFQ është formale dhe pa asnjë vlerë për kontrollin dhe bllokimin e fondeve disponibël përpara fillimit të procedurës së prokurimit. <p>Konstatohet se, dokumenti i urdhër-prokurimit nuk regjistrohet në sistem në shkelje me Udhëzimin nr. 9/1, datë 19.01.2018, pjesa III Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, pika 15.1 “Faza para angazhimit”.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”; Udhëzimi nr. 9/1, datë 19.01.2018, pjesa III Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, pika 15.1 “Faza para angazhimit”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Shkelje e Ligjit të menaxhimit të buxhetit dhe udhëzimeve përkatëse në funksion të disiplinimit të angazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura.
Shkaku:	Mungesë kontrolli të procedurave të aplikacionit në SIFQ, nga Degët e Thesarit në përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, mosveprim për marrjen e masave efektive nga NPA dhe nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik për pranimin e urdhër-prokurimeve pa marrë vulën në Thesar sipas parashikimeve të Udhëzimit përkatës.
Rëndësia:	E mesme

Rekomandimi:	Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të investigohen regjistrimet e konstatuara për urdhër prokurimet e mësipërme për detyrime financiare të viteve të kaluara si dhe ato në diferencë të shkurtër kohore nga data e kontratës për ligjshmërinë e angazhimeve buxhetore sipas fondeve të miratuara në momentin e ndërmarrjes së këtyre angazhimeve nga nëpunësit autorizues.
---------------------	---

Titulli i gjetjes:	Regjistrim i kontratave nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme në tejkalim të afatit të përcaktuar në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se në SIFQ rezultojnë gjithsej 20,288 kontrata për periudhën 01.01.2022-31.03.2023 me një vlerë të kontraktuar 177,497 milion lekë, nga të cilat 16,503 kontrata në shumën 146,373 milion lekë të regjistruara për periudhën 01.01.2022-31.12.2022. Për llogari të vitit buxhetor 2022 rezultojnë të jenë lidhur 17,283 kontrata (me datë kontratë 01.01.2022-31.12.2022) me vlerë të kontraktuar 159,283 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se nuk është respektuar afati 3 ditor për regjistrimin e kontratave nga data e nënshkrimit të tyre në 10,602 raste në vlerën 116,288 milion lekë në kundërshtim me pikën 157 të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Njësitë e qeverisjes vendore zënë 27% të totalit të vonesave në regjistrime. Nga auditimi i databazës së angazhimeve në SIFQ, konstatohet se gjatë vitit 2022 është lejuar regjistrimi i kontratave të “vjetra” të cilat datojnë nga viti 2007 deri 2021. Nga të cilat për periudhën 2007-2020 në vlerën 13.5 miliard lekë dhe për vitin 2021 në 138 raste në shumën 21,314 milion lekë. Në konkluzion ka ende kontrata të lidhura por të paregjistruara në Thesar, në pritje të fondeve buxhetore, me ose pa punime të kryera dhe grupi i auditimit nuk mund të konfirmojë plotësinë e databazës së angazhimeve në SIFQ.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”.
Ndikimi/Efekti:	Shkelje e Ligjit të menaxhimit të buxhetit dhe udhëzimeve përkatëse në funksion të disiplinimit të angazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura.
Shkaku:	Mungesë kontrolli të procedurave dhe aplikacionit SIFQ, mosveprim dhe marrja e masave administrative nga NPA.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për investigimin e kontratave të viteve të mëparshme buxhetore në lidhje me ligjshmërinë e lidhjes së tyre në momentin e marrjes së angazhimit dhe të merren masa administrative për rastet e konstatuara në shkelje të afatit për regjistrimin e tyre.

Titulli i gjetjes:	Mos regjistrim i saktë i shpërndarjes së buxhetit dhe planit të kontratave sipas viteve përkatëse për projektet e investimeve publike.
Situata:	Nga auditimi u konstatua mos regjistrim në SIFQ i planit të pagesave të kontratës e kushtëzuar nga mos detajimi i planit buxhetor për projekte të investimeve sipas parashikimeve të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Analiza është kryer duke përdorur modulën e regjistrimit të investimeve sipas angazhimit të ndërmarrë të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ku janë konstatuar raste të projekteve për të cilat ka angazhim në vitin aktual në vlerë të përcaktuar, angazhim 0 lekë për vitet 1 dhe 2 dhe në vijim angazhim në vitin e tretë dhe të katërt në vlerë. Konstatimi është formuar në bazë të raportit më të fundit për vitin buxhetor, atë të muajit dhjetor të vitit 2022, duke qenë se në këtë periudhë janë konsoliduar edhe të dhënat në lidhje me planin dhe faktin. Ndryshimi i shpeshtë i projekteve të investimit me

	<p>rialokime apo akte normative si dhe ndërmarrja e angazhimeve në projekte të reja investimesh në kuadër të tavaneve të përcaktuara për programet e shpenzimeve të miratuara, ka sjellë shtyrjen e planit të pagesave si pasojë e planit buxhetor me efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura. Ndër raste të tjera përfaqësuese në fund të vitit buxhetor 2022 paraqiten edhe projekte përmbledhës të cilët e kanë të shtyrë të gjithë shumën e angazhimit të investimit në tejkalim të buxhetit të miratuar tre vjeçar sipas ligjit nr. 115/2021 me rreth 50 miliard lekë. Përgjegjësia e regjistrimit të plan buxhetit sipas PBA është e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, ndërkohë që në Degët e Thesarit ku paraqiten autoritet kontraktuese për regjistrimin e kontratës në SIFQ janë udhëzuar të regjistrojnë në vitin 3 të gjithë shumën e angazhimit në mungesë të fondeve sipas viteve. Nga testimet e këtyre angazhimeve këto raste janë përgjithësisht kontrata apo angazhime të ndërmarrja pa fonde buxhetore për gjithë projektin dhe jo thjesht në neglizhencë e Drejtorisë përgjegjëse.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Marrja e angazhimeve pa fonde buxhetore, mungesë raportimi për qëllime monitorimi të programeve buxhetore dhe menaxhimit të likuiditetit.</p>
Shkaku:	<p>Akomodimi në SIFQ nga ana teknike i regjistrimit të angazhimeve pa fonde buxhetore.</p>
Rëndësia:	<p>E mesme</p>
Rekomandimi:	<p>Drejtoria e Procesimit të Biznesit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të shikojë mundësinë e implementimit të kontrollove të aplikacionit në SIFQ në mënyrë që sistemi të mos lejojë regjistrim buxheti në vitin 1+1 kur viti 1 është zero dhe të shmanget praktika e shtyrjes së planit buxhetor përtej afatit 3 vjeçar për të cilat bëhet miratimi i fondeve buxhetore.</p>

Titulli i gjetjes:	<p>Mbi regjistrimin e kontratës dhe faturës në të njëjtën ose deri në 10 ditë diferencë kohore.</p>
Situata:	<p>Nga auditimi janë konstatuar raste në vlerën 3.8 miliard lekë ku vlera e fondeve të detajuara përputhet plotësisht me vlerën e pagesave të kryera. Fondet disponibël të projekteve të investimeve janë buxhetuar vetëm për paguar detyrimet e prapambetura të këtyre projekteve/kontratave, pra detajimi/rishpërndarja buxhetore është ekzaktësisht e barabartë me vlerën e faturës/ave të prapambetura. Në njësitë e qeverisjes qendrore, efektet e këtyre konstatimeve vlerësohen në shumën 3.64 miliard lekë.</p> <p>-Nga auditimi janë konstatuar raste në të cilat pagesat nga buxheti i shtetit për shlyerjen e faturave kryhen në të njëjtën ditë ose deri në 10 ditë diferencë nga data e regjistrimit të kontratës (data e krijimit të kontratës) në sistemin informatik financiar të qeverisë. Ky konstatim përfshin 202 projekte investimesh të procesuara për pagesë në shumën 2,168 milion lekë, që dëshmon formalitetin e regjistrimit të transaksioneve në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe jo duke ndjekur procedurat e parashikuara në udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit si pasojë e anashkalimit të kontroleve të brendshme.</p> <p>-Nga auditimi mbi regjistrimin e kontratave dhe kryerjen e urdhër shpenzimeve në sistemin informatik financiar të qeverisë, konstatohen raste në të cilat data e kontratës (data e kontratës fizike) sipas modulit të kontratave është në të njëjtën ditë apo me diferencë deri në 10 ditë nga regjistrimi i urdhër shpenzimit të parë për projektet e investimit të identifikuar me problematika. Këto konstatime përfshijnë gjithsej 63 projekte investimesh në shumën 471 milion lekë, që dëshmon për kryerjen e pagesave drejt</p>

	përfituesve të fondeve publike në një kohë shumë të shkurtër nga kryerja lidhja e kontratës, afat i pamjaftueshëm për kryerjen e punimeve apo marrjen në dorëzim të tyre. Gjithashtu në disa raste përfaqësuese këto projekte investimesh përfshijnë lëvrimin e fondeve në formën e paradhënies për kryerjen e punimeve, në kundërshtim me parashikimet e bëra në udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit duke parafinancuar investimet publike dhe duke mbivlerësuar treguesit e investimeve publike.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”; Urdhri nr. 62, datë 31.08.2010 “Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit”; Udhëzim nr. 34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”.
Ndikimi/Efekti:	Raportim i pasaktë i kontratave shumëvjeçare dhe krijim mundësish për detyrime pa fonde buxhetore në dispozicion si pasojë e angazhimeve përtej buxhetit të miratuar.
Shkaku:	Legjitimi i shkeljeve buxhetore nëpërmjet procesimit të transaksioneve për pagesë.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për investigimin e rasteve të konstatuara me detajim fondesh për detyrime të periudhave të kaluara dhe të nxirren përgjegjësitë për regjistrimin, miratimin dhe procesimin e transaksioneve për pagesë edhe në rastet e paradhënies.

Titulli i gjetjes:	Tejkalim i afateve për kryerjen e pagesave për faturat nga detyrimet e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme, pagesa pjesore të faturave dhe përqendrim i ekzekutimit të buxhetit në muajin dhjetor 2022.
Situata:	Nga auditimi i të dhënave të transaksioneve të pagesave të procesuara në sistemin SIFQ u konstatuan tejkalime të afateve të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, si nga ana e njëjësive shpenzuese ashtu edhe nga degët e thesarit. Në analizën e kryer me qëllim testimin e respektimit të afateve të kryerjes së pagesave janë marrë në shqyrtim vetëm llogaritë e shpenzimeve operative (602) dhe shpenzimeve në proces për rritjen e investimeve (230 dhe 231). Nga auditimi u konstatuan 27,311 fatura në total me vlerë 52,578,940 mijë lekë të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor nga data e furnitorit të përcaktuar në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga këto transaksione të procesuara me vonesë, 4,033 prej tyre i përkasin shpenzimeve për investime me vlerë 34,203,157 mijë lekë, ndërkohë që pjesa tjetër prej 23,279 rastesh i përket shpenzimeve operative me vlerë totale prej 18,375,783.7 mijë lekë. -Nga auditimi u konstatuan të paktën 20 raste në rreth 2.7 miliard lekë të regjistrimit dhe pagesave pjesore të faturave, të cilat janë më të vogla se sa vlera e detyrimit të lindur sipas faturës së furnitorit, kjo me qëllim përputhjen e fondeve buxhetore disponibël. Me paraqitjen e faturës dhe urdhër-shpenzimit nga njësitë buxhetore, regjistrimi nga degët e thesarit është bërë pjesor duke rezultuar në pagesa pjesore, me vlerë të barabartë me fondet disponibël të detajuara nga buxheti. -Ekzekutimi i transaksioneve të pagesës, pas regjistrimit në SIFQ, referuar kuadrit ligjor për menaxhimin e shpenzimeve publike, duhet të kryhet brenda 30 ditëve. Nga auditimi konstatohet se në disa raste këto parashikime nuk janë

	<p>respektuar ku janë konstatuar 9 raste në vlerën 65.4 milion lekë të transaksioneve në të cilat diferenca ndërmjet datës së ekzekutimit në SIFQ me datën e regjistrimit në SIFQ është mbi 30 ditë.</p> <p>-Nga auditimi konstatohet se pjesa më e madhe e ekzekutimit të shpenzimeve/investimeve përqendrohet në muajin dhjetor në mbyllje të vitit buxhetor. Nga analiza e bazës së të dhënave të pagesës konstatohet se me datë libri të madh në muajin dhjetor 2022 janë procesuar për pagesë edhe fatura të viteve të mëparshme apo të muajve të mëparshëm të vitit 2022. Nga 65.89 miliard lekë fatura të kaluara me datë libri të madh në dhjetor 2022 konstatohen rreth 20.8 miliard lekë të pagesa të faturave që i përkasin muajve janar-nëntor 2022, nga ku konstatohet se ekzekutimi i buxhetit nuk është i njëtrajtshëm përgjatë vitit 2022 duke sjellë problematika si pasojë e planit buxhetor, në planin e arkës për procesimin e tyre.</p> <p>-Nga auditimi në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e informacionit të raportuar në treguesit fiskalë të konsoliduar për vlerat e raportuara të shpenzimeve operative dhe investimeve u konstatuan nga baza e të dhënave të pagesave deri në 31.03.2023 transaksione me datë fature të vitit 2022 dhe të mëparshëm për të cilat është përdorur buxheti i vitit 2023. Këto transaksione, nuk rezultojnë të jenë paguar në kohë në shumën 8,377 milion lekë, të cilat megjithë efektet e akteve normative dy ditë përpara fundit buxhetor si dhe të drejtës për të kryer shpenzime edhe gjatë muajit janar 2023 për efekt të vitit buxhetor 2022. Të grupuara në investime dhe shpenzime operative klasifikimi paraqitet në shumën 5,677 milion lekë për investime dhe 2,700 milion lekë për shpenzime operative.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr. 48/ 2014 “Për pagesat e vonuar a në detyrimet kontraktore e tregtare”;</p> <p>Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Ekspozojnë buxhetin e shtetit ndaj riskut të detyrimeve shtesë financiare si pasojë e penaliteteve për mos shlyerjen e detyrimeve financiare në kohë.</p>
Shkaku:	<p>ndërmarrja e angazhimeve buxhetore përtej fondeve të miratuara dhe mos detajimi i planit buxhetor në kohën dhe vlerën e duhur.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p>
Rekomandimi:	<p>Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa administrative për rastet e konstatuara në tejkalim të afateve për procesimin për pagesë si dhe të shmanget praktika e detajimit të copëzuar të fondeve buxhetore përtej detyrimeve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në rastet e vlerësimit të ligjshëm të këtyre detyrimeve pas kryerjes së investimeve përkatëse.</p>
Titulli i gjetjes:	<p>Mos respektim i radhës së kryerjes së pagesave sipas parimit hyrje e parë dalje e parë.</p>
Situata:	<p>Nga auditimi mbi krahasimin e datës së ekzekutimit të transaksioneve të pagesave në SIFQ me datën e regjistrimit të urdhër shpenzimit konstatohen raste në të cilat edhe sipas muajve janë ekzekutuar pagesa jo sipas parimit hyrje e parë, dalje e parë në sistem. Nga auditimi u konstatuan ekzekutime të pagesave të faturave të regjistruara në data të mëvonshme, përpara urdhër shpenzimeve të regjistruara në data më të hershme. Ky konstatim rezulton i përhapur përgjatë gjithë muajve të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2022. Në këtë mënyrë, është konstatuar se pagesat e kryera në 21 data të ndryshme të vitit buxhetor nuk kanë ndjekur në disa raste parimin hyrje e parë dalje e parë (FIFO) sipas përcaktimeve në udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 178, 179 dhe 180 është</p>

	përcaktuar procedura e procesimit të transaksioneve sipas parimit hyrje e parë dalje e parë për pagesë pas regjistrimit të tyre.
Kriteri:	Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 178, 179 dhe 180.
Ndikimi/Efekti:	Vonesa në procesimin e pagesave
Shkaku:	Mos respektim i radhës dhe vonesa në miratim
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga ana e DPTH në vijimësi të merren masa për sigurimin e likuiditetit të mjaftueshëm me qëllim financimin e të gjitha shpenzimeve buxhetore dhe ekzekutimit të tyre në procesimin normal të ciklit të menaxhimit të shpenzimeve buxhetore duke respektuar radhën dhe prioritet e pagesave buxhetore.

2.C.2. Saktësia e veprimeve mbyllëse për raportimin në treguesit fiskalë dhe paraqitje në pasqyrat financiare të konsoliduara të shtetit.

Nga auditimi mbi përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara sipas shpjegimeve të dhëna nga sektori i raportimit financiar konstatohet se procedurat dhe detyrat teknike janë si në vijim:

Procedura	Detyrat teknike
Monitorimi i regjistrimeve mujore të inventarëve/aseteve/të drejtave/detyrimeve të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme nga degët e thesarit	Gjeneron raporte në SIFQ (analiza llogarie 180 karaktere) për të kontrolluar transaksionet e kryera nga Dega e Thesarit
	Nëse konstaton gabime në regjistrimin e transaksioneve kontakton me Degën e Thesarit
	Në rast se problematika nuk është operacionale kalon për zgjidhje Drejtorisë së Procesimit të Biznesit
Monitorimi i regjistrimeve përfundimtare për pasqyrat financiare brenda datës 31 Mars	Monitoron procesin e dorëzimit të balanceve fizike nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme në Degën e Thesarit dhe regjistrimin e tyre
	Monitoron procesin e regjistrimeve të të dhënave të borxhit për bilancin
	Monitoron procesin e regjistrimeve të të dhënave të bilancit nga ISSH dhe FSDKSH
Përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara të Qeverisë	Kryerja e mbylljeve vjetore nëpërmjet mass allocations
	Gjenerimi i raporteve të Pasqyrave Financiare në SIFQ dhe dërgimi tek eprorët
Monitorimi i përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara të Qeverisë	Monitoron punën për gjenerimin e pasqyrave financiare në bazë të raportimit të punonjësve të sektorit mbi përfundimin e proceseve dhe problematikat dhe e përcjell tek eprorët
Konfirmimi	Paraqitja e të dhënave përfundimtare të pasqyrave financiare vjetore te drejtori i përgjithshëm
Konfirmimi dhe publikimi	Paraqitja e të dhënave përfundimtare të pasqyrave financiare vjetore në strukturën përgjegjëse për certifikimin e tyre

Në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara konstatohet se:

Sistemi i thesarit është përgjegjës për mbajtjen e llogarive të shtetit dhe përgatitjen e raporteve periodike e vjetore të zbatimit të buxhetit, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme. Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, citon “Ministri i Financave është përgjegjës për krijimin e sistemit të kontabilitetit, i detyrueshëm për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme....

..Nëpunësi i parë autorizues (NPA) dhe nëpunësit autorizues të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme (NA), përgjigjen për funksionimin dhe zbatimin e sistemit të kontabilitetit, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera në zbatim të tij, të nxjerra nga Ministri i Financave...

....Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me:

a. njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës;

b. njohjen e të ardhurave në çastin e arkëtimit të tyre....

Neni 62 “Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit”, citon: ...Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes së përgjithshme finalizojnë dhe konfirmojnë përfundimisht me nëpunësin e parë autorizues pasqyrat financiare vjetore të buxhetit, brenda datës 31 mars.

Neni 71 citon: “Kur nëpunësi autorizues dhe/ose nëpunësi zbatues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme nuk përmbushin detyrimet për mbylljen e vitit buxhetor dhe nxjerrjen e llogarive vjetore të buxhetit, në kundërshtim me nenin 62 të këtij ligji, dënohen nga nëpunësi i parë autorizues me masë administrative, ose me gjobë në masën 1-3 paga mujore”.

Udhëzimi nr. 8, date 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" në pikat e mëposhtme parashikon:

Pika 117-118-119: “Njësitë e qeverisjes qendrore...njësitë e qeverisjes vendore... njësitë e menaxhimit/zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj, janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit mars...

Pika 120: Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore hartojnë përmbledhësen e konsoliduar të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor të mbyllur, për të gjitha institucionet apo njësitë vartëse të tyre, brenda muajit prill të vitit pasardhës...

Pika 121: Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, të cilat nuk kanë varësi institucione apo njësi shpenzuese me kontabilitet më vete, brenda muajit Mars të vitit pasardhës depozitojnë pasqyrat financiare të tyre...

Pika 122: Këshillat e qarkut hartojnë përmbledhëse të konsoliduar të pasqyrave financiare vjetore të njësive vendore të juridiksionit brenda muajit Prill të vitit pasardhës...

Pika 123: Drejtoria e Operacioneve të Thesarit, në MFE harton dhe përmbledh brenda muajit maj të vitit pasardhës, për vitin ushtrimor të mbyllur, raportin mbi lëvizjen dhe gjendjen e stokut të llogarive të tjera speciale të çelura për llogari të shtetit shqiptar në Bankën e Shqipërisë, të aseteve financiare, të rezervës valutore të qeverisë e të tjerë elementë pasurorë që duhet të përfshihen në bilancin e shtetit shqiptar.

Pika 124: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe e Borxhit Publik, në MFE, harton, përmbledh dhe depoziton në Drejtorinë e Operacioneve të Thesarit, brenda muajit Maj të vitit pasardhës, raportet e vitit ushtrimor të mbyllur lidhur me borxhin e jashtëm të qeverisë.

Pika 125: Në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në MFE, hartohen pasqyrat financiare përmbledhëse të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme qendrore e vendore, brenda muajit Qershor të vitit pasardhës, për vitin ushtrimor të mbyllur....

Dy produktet e kërkuara në lidhje me raportimin sipas përcaktimeve nga ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë:”, i ndryshuar, përfshijnë:

1. Pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, të cilat janë të publikuara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në raportin e treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar, objekt miratimi sipas tabelës 4, të ligjit vjetor për miratimin e buxhetit;

2. pasqyrat financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme të konsoliduara, të cilat nuk janë të publikuara dhe nuk miratohen.

Në kuadrin rregullator të mësipërm është paraqitur kuadri i raportimit financiar mbi procedurat që ndiqen nga pasqyrat individuale të njësive të qeverisjes së përgjithshme deri në hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara. Nga procedurat audituese ka rezultuar se jo të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme kanë dorëzuar në kohë pasqyrat financiare individuale të tyre me qëllim që të reflektohen në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe në vijim të vijnë procedurat për konfirmimin me degët e thesarit dhe konsolidimin e tyre, duke shkaktuar problematika në drejtim afateve dhe produktit që rezulton nga ky proces. Këto njësi respektive të cilat nuk kanë depozituar pranë Degës së Thesarit pasqyrat financiare

për vitin ushtrimor 2022 në kohë, në kundërshtim me nenin 62 “Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 8, date 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", paraqiten në tabelën në vijim:

Nr.	Institucioni	Statusi	Kodi dege thesari	Shkresë për informim të mosdepozitimit të pasqyrave financiare 2022 dërguar nga degët e thesarit
1	Bashkia Pustec	Me Vonesë	1515	Shkresë nr. 400, datë 04.04.2023
2	Ujësjetllës Kanalizime sha Patos	Me Vonesë	909	Shkresë nr. 329 datë 24.04.2023
3	Bashkia Kavajë	Me Vonesë	3513	Shkresë nr.150/1 datë 04.04.2023
4	Bashkia Kolonjë	Me Vonesë	1515	Shkresë nr.65 datë 03.04.2023
5	Bashkia Pustec	Me Vonesë	1515	Shkresë nr.400 datë 04.04.2023
6	Këshilli i Qarkut Dibër	Me Vonesë	606	Shkresë nr. 231 datë 04.04.2023
7	Klubi Sportiv Gramozi	Me Vonesë	1514	Shkresë nr. 65 datë 03.04.2023
8	Ndërmarrja Rruga Durrës	Me Vonesë	707	Shkresë nr. 547 datë 19.04.2023
9	Ujësjetllës Kanalizime sha Fushe Arrëz	Me Vonesë	3330	Shkresë nr. 121/2 datë 03.04.2023
10	Qendra e Zhvillimit Shkodër	Me Vonesë	3333	Shkresë nr.764, datë 04.04.2023
11	Qendra Kulturore FS Noli	Me Vonesë	1515	Shkresë nr. 65 datë 03.04.2023
12	Teatri Migjeni Shkodër	Me Vonesë	3333	Shkresë nr. 764, date 04.04.2023
13	Ujësjetllës Kanalizime Durrës	Me Vonesë	707	Shkresë nr. 547, datë 19.04.2023
14	Ujësjetllës Kanalizime Elbasan	Me Vonesë	808	Shkresë nr. 384 datë 20.04.2023
16	Ujësjetllës Kanalizime Pustec	Me Vonesë	1515	Shkresë nr.400, datë 04.04.2023
17	Ujësjetllës Kanalizime Shkodër	Me Vonesë	3333	Shkresë nr.764, datë 04.04.2023
18	Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës	Me Vonesë	3333	Shkresë nr.764, datë 04.04.2023
19	Zyres Vendore Arsimore Gjirokastër-Libohovë	Me Vonesë	1111	Shkresë nr.764, datë 04.04.2023
20	Gjykata Krujë	Me Vonesë	716	
21	IEVP Kruje	Me Vonesë	716	
22	Ujësjetllës Kanalizime Krujë	Me Vonesë	716	
23	Klubi Sportiv Kastrioti	Me Vonesë	716	
24	Klubi Sportiv Iliria	Me Vonesë	716	
26	Ujësjetllës Kanalizime Selenicë	Me Vonesë	3737	
27	Ujësjetllës Kanalizime Himarë	Me Vonesë	3737	
28	Klubi i Futbollit Oriku	Me Vonesë	3737	
29	Sha Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lushnjë	Me Vonesë	922	
30	Ministria e Kulturës	Me Vonesë	3535	
36	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore	Me Vonesë	3535	
37	Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijët	Me Vonesë	3535	

Sipas shpjegimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, në rastin e vonesave janë kryer lajmërimet për kryerjen e procesit të depozitimit të pasqyrave financiare në degët e thesarit përkatëse sipas shkresave të paraqitura në tabelën e mësipërme, pas të cilave nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë depozituar në vijim dhe pas këtij konstatimi nuk rezultojnë njësi të qeverisjes së përgjithshme të cilat nuk kanë depozituar pasqyra financiare për vitin financiar 2022. Nga auditimi konstatohet se pas dorëzimit të pasqyrave financiare individuale, dorëzimi i pasqyrave financiare të konsoliduara nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk është objekt shqyrtimi dhe konfirmimi nga strukturat e thesarit për tu siguruar që janë kryer veprimet e eliminimit të transaksioneve të ndërsjellta me njësitë e varësisë dhe për të shmangur efektin e dublimeve në transaksione. Kjo rezulton si pasojë e mungesës së kuadrit rregullator në formën e standardeve të kontabilitetit në sektorin publik të cilat vazhdojnë të mos jenë të miratuara, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 61 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet që “...Ministria e Financave harton standardet e kontabilitetit publik dhe raportimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar, aktet nënligjore dhe metodologjinë në fushën e kontabilitetit publik, të cilat miratohen nga Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik....”. Në mungesë të këtyre standardeve, por regjistrimit të transaksioneve, konsolidimit dhe raportimit të tyre sipas parashikimeve të Udhëzimin nr. 8, date 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", ku parashikohen

veprime mekanike të regjistrimit në llogari dhe lëvizjet e tyre në fund të vitit për ngjarjet ekonomike dhe balancat e transaksioneve, pasqyrat financiare sipas sistemit informatik financiar të qeverisë paraqiten të pakonfirmuara dhe për këtë arsye nuk janë objekt raportimi, publikimi dhe miratimi.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2022, u konstatua se: Ka diferenca midis pasqyrave fizike, të dorëzuara nga institucionet buxhetore në degët e thesarit dhe pasqyrave financiare të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), si në vijim:

-Në pasqyrat financiare të gjeneruara nga SIFQ, pasqyrohen shpenzimet faktike të vitit, ndërsa në pasqyrat fizike (manuale) të institucioneve buxhetore pasqyrohen detyrimet e konstatuara dhe të papaguara, si pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo detyrimi për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit dhe paguhen me buxhetin e vitit të ardhshëm;

-Në pasqyrat financiare të gjeneruara nga SIFQ pasqyrohen arkëtimet e vitit, ndërsa në pasqyrat fizike të institucioneve buxhetore, pasqyrohen të drejtat e konstatuara dhe të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme, siç janë debitorët.

-shpenzimet nuk njihen në momentin e ndodhjes së tyre sipas përcaktimit të shpenzimeve dhe për detyrimet e prapambetura përdoret një llogari ekstrakontabile për raportimin e tyre, në grupin e llogarive 486;

-mungon kuadri konceptual për raportimin financiar sipas përcaktimeve në kuadrin rregullator financiar ndërkombëtar;

-mungojnë standardet e kontabilitetit për regjistrimin e transaksioneve financiare, balancat e llogarive dhe shënimet shpjeguese mbi shumat e pasqyruara.

-nuk kryhet procesi i konsolidimit të pasqyrave në nivel njësie mëmë konsoliduese dhe pasqyrimi në sistem i tyre si dhe në nivel pasqyre financiare të konsoliduar.

-mungon konsolidimi i pasqyrave financiare të sipërmarrjeve privatë në të cilat shteti ka interesa pjesëmarrje në kapital nëpërmjet konsolidimit në formën e investimeve afatgjata apo konsolidimit total në varësi të raportit të ushtrimit të influencës mbi vendimmarrjen në këto njësi.

Për sa më sipër rezulton se: Pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme, pasqyrat financiare të konsoliduara të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), nuk pasqyrojnë plotësisht gjendjen reale financiare të saj, duke mos përmbushur misionin kryesor të Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit, Sektorit të Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit, i cili është: “raportim financiar i besueshëm dhe cilësor”.

Për problematikat e mësipërme mbajnë përgjegjësi sipas analizës së mësipërme nëpunësit zbatues dhe autorizues të njësisë të qeverisjes së përgjithshme për mos përmbushjen e dorëzimit të pasqyrave financiare individuale, strukturat e njësisë konsoliduese për mos kryerjen e konsolidimit të pasqyrave financiare dhe pasqyrimin e tyre në SIFQ, strukturat e ngarkuara me kryerjen e konsolidimit në sistemin e thesarit si degët e thesarit në rrethe si dhe strukturat e ngarkuara me detyrimin për hartimin dhe miratimin e standardeve dhe metodologjisë me efekt në mos publikimin e pasqyrave financiare të konsoliduara vjetore të vitit 2022.

Sa më sipër, janë paraqitur observacione me shkresën nr. 14149/1 datë 31.07.2023 dërguar me email me përmbajtje si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

.... konsolidimi mes njësisë të varësisë është detyrë e institucionit të nivelit të parë në hierarki (aparati). SIFQ nuk përmban transaksione për të gjitha eventet kontabile (jo vetëm të ardhura dhe shpenzime) për rrjedhojë nuk mund të përcaktojë të gjitha eliminimet mes njësisë të varësisë apo mes

tyre dhe aparatit, pasi SIFQ nuk mban kontabilitet të mirëfilltë transaksional për çdo event financiar që ndodh në institucione. Kjo është kompetencë e vetë institucioneve. Në SIFQ raportohen vetëm balanca vjetore kontabile të llogarive ekonomike për të drejtat e konstatuara, nuk rregjistrohen transaksione. Ndërsa për asetet e qëndrueshme në SIFQ regjistrohen transaksionet vetëm nga institucionet “online” me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, kurse për institucionet “offline” me SIFQ vetëm balanca vjetore kontabile e llogarive ekonomike (nuk regjistrohen transaksionet). Aktualisht, në zbatim të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” konsolidimet kryhen për transfertat, grantet, shpenzimet që njësitë shpenzuese të të njëjtit entitet apo të njëjseve shpenzuese të entiteteve të ndryshme kryejnë midis njëri tjetrit, të cilat nëse përfaqësojnë shpenzim për njërën nga njësitë shpenzuese, për njësinë që merr transfertën, grantin apo pagesën brenda sistemit informatik financiar të qeverisë (SIFQ), do të shërbejë si e ardhur për njësinë pritëse të fondit. Kështu, për dublikimet e transaksioneve midis njëjseve shpenzuese të të njëjtit entitet dhe midis entiteteve të ndryshme lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet eliminimet e dublimeve, respektivisht: eliminimet e kontabilizimeve midis njësive të qeverisjes qendrore (QQ) dhe qeverisjes vendore (QV) dhe qeverisjes qendrore dhe fondeve speciale ekzekutohen në SIFQ. **Si përfundim, realizimi i konsolidimit të pasqyrave financiare bëhet i pjesshëm ndaj nuk mund të raportojmë pasqyra financiare të konsoliduara.**

... argumentojmë se, për sa trajtuar më sipër, certifikimi i balancave të llogarive ekonomike të pasqyrave financiare të NJQP-ve dhe miratimi i metodologjisë për mbajtjen e kontabilitetit dhe konsolidimit të pasqyrave financiare të NJQP nuk është kompetencë e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, strukturave përbërëse të saj referuar funksioneve përkatëse të tyre të miratuara nga ministri përgjegjës për financat në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e DPTH (dorëzuar audituesve)

Drejtoria e Procesimit të Biznesit:

1. Sigurimi i administrimit dhe mirëmbajtjes funksionale të moduleve të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) me qëllim realizimin e një funksionimi normal të procesit të ekzekutimit të buxhetit të shtetit, kontrollit të brendshëm financiar dhe sigurimin e një informacioni financiar të saktë e të besueshëm të Qeverisë.
2. Siguron realizimin e ndryshimeve funksionale të SIFQ në kuadër të ndryshimeve në aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me procesin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe raportimit financiar të Qeverisë si dhe në rast të integritetit të SIFQ me sisteme të tjera të financave publike me qëllim automatizimin e proceseve të shkëmbimit të të dhënave financiare.
3. Realizimi i përgatitjes së manualeve të përdorimit të SIFQ për përdoruesit operacional të tij si dhe kryerja e trajnimit të tyre me qëllim sigurimin e zbatimit të saktë dhe korrekt të proceseve operacionale në SIFQ.
4. Sigurimi i procesit të menaxhimit të përdoruesve, dhënia e aksesit për kryerjen ose delegimin e funksioneve të caktuara të përdoruesve të SIFQ në përputhje të plotë me rregullat e kontrollit të brendshëm financiar publik.
5. Propozimi i procedurave dhe përgatja e udhëzimeve për rregullimin e ekzekutimit të proceseve të punës në SIFQ.

Drejtoria e Operacioneve të Thesarit:

1. Menaxhon paranë e gatshme për kryerjen e transaksioneve të pagesave të qeverisjes së përgjithshme;
2. Parashikon flukset ditore të mjeteve monetare në llogarinë e unifikuar të thesarit për kryerjen e pagesave brenda kufijve mujore të shpenzimeve të miratuara në bashkëpunim me drejtoritë e tjera dhe strukturat përgjegjëse përkatëse;
3. Realizon kryerjen e pagesave të konfirmuara nga degët e Thesarit në mënyrë të centralizuar nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë;
4. Menaxhon llogarinë e unifikuar të Thesarit (TSA) në Bankën e Shqipërisë dhe monitoron çeljen e llogarive jashtë TSA në Bankën e Shqipërisë dhe në bankat e nivelit të dytë bazuar në legjislacionin në fuqi;
5. Regjistron, kontrollon, kontabilizon dhe përpunon informacionin mbi transaksionet e qeverisjes së përgjithshme dhe mbi këtë bazë, gjeneron raportet dhe pasqyrat financiare në monedhën vendase si dhe të dhënat e treguesve fiskalë në përfshirje të ligjit të buxhetit faktik vjetor për miratim nga Parlamenti;
6. Siguron të dhënat mbi transaksionet në monedhë të huaj për përfshirjen në bilancin e pagesave të raportuar nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet raportimeve periodike të njëjësive të zbatimit të projekteve të financimeve të huaja që i akordohen qeverisjes qendrore dhe

vendore nga kreditorë dhe donatorë të huaj si dhe të ministrive të linjës gjatë zbatimit të buxhetit të shtetit;

7. Përfaqëson ministrinë përgjegjëse për financat e qeverisë në procesin e miratimit të legjislacionit mbi rritjen e kapitalit të shtetit shqiptar në organizmat financiare dhe mënyrën/afatet e pagesave të tyre, krahas strukturave të tjera përgjegjëse të ministrisë;
8. Mbikqyr rregullaritetin e dokumentacionit të ekzekutimit të buxhetit dhe relaton për marrjen e masave disiplinore në zbatim të legjislacionit në fuqi;
9. Monitoron respektimin e kushteve të marrëveshjeve midis ministrisë përgjegjëse për financat dhe sistemit bankar për kryerjen e operacioneve me sistemin e Thesarit (derdhjen ditore të swift-it për arkëtimet, kthimet e transaksioneve me instruksione bankare të gabuara, etj.);
10. Përpilon treguesit e performancës së njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në procesin e ekzekutimit të buxhetit nëpërmjet raportimeve statistikore të degëve të Thesarit me anë të SIFQ;
11. Përmirëson sistemin e shërbimeve financiare operacionale në përshtatje me ndryshimet e vazhdueshme.

Në përfundim lutemi të mund të rishikohet paragrafi i mësipërm i këtij Akt Konstatimi për përgjegjësi e strukturave të ngarkuara me kryerjen e konsolidimit në SIFQ (Znj. A.B., Znj. M.P. dhe Znj. A.V.), pasi këto struktura do të angazhohen për publikimin e pasqyrave financiare pas ndryshimit të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe implementimit të projektit të standarteve të IPSAS (Standartet Ndërkombëtare për Kontabilitetin e Sektorit Publik), me përfundimin e të cilit mund të kemi një metodologji të saktë, të duhur, të krahasueshme dhe të besueshme të konsolidimit të elementëve kontabël. Këto struktura kanë zbatuar përcaktimet e legjislacionit në fuqi (Udhëzimit Nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë Nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”).

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit pranohen problematikat që janë konstatuar gjatë fazës së auditimit në terren në lidhje me mungesën e kuadrit rregullator të nevojshëm dhe mundësive teknike në SIFQ për kryerjen e tyre por relatojnë mungesën e përgjegjësisë për moskryerjen e konsolidimit duke qenë një pasojë e shkaqeve të tjera të jashtme si dhe referuar detyrave funksionale sipas rregullores së institucionit, nga të cilat merret në konsideratë dhe reflektohet në rubrikën përkatëse të materialit.

Titulli i gjetjes:	Mungesë procedurash konsoliduese në lidhje me pasqyrat financiare, mos dorëzim në kohë të pasqyrave nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kryerjen e procesit të konsolidimit, mungesë të kuadrit rregullator në formën e standarteve për kryerjen e procesit të konsolidimit.
Situata:	Nga procedurat audituese ka rezultuar se jo të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme kanë dorëzuar në kohë pasqyrat financiare individuale të tyre me

	<p>qëllim që të reflektohen në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe në vijim të vijnë procedurat për konfirmimin me degët e thesarit dhe konsolidimin e tyre, duke shkaktuar problematika në drejtim të afateve dhe produktit që rezultojnë nga ky proces, në kundërshtim me nenin 62 “Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se pas dorëzimit të pasqyrave financiare individuale, dorëzimi i pasqyrave financiare të konsoliduara nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk është objekt shqyrtimi dhe konfirmimi nga strukturat e thesarit për tu siguruar që janë kryer veprimet e eliminimit të transaksioneve të ndërsjellta me njësitë e varësisë dhe për të shmangur efektin e dublimeve në transaksione. Kjo rezultojnë si pasojë e mungesës së kuadrit rregullator në formën e standardeve të kontabilitetit në sektorin publik të cilat vazhdojnë të mos jenë të miratuara, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 61 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në mungesë të këtyre standardeve, pasqyrat financiare sipas sistemit informatik financiar të qeverisë paraqiten të pakonfirmuara dhe për këtë arsye nuk janë objekt raportimi, publikimi dhe miratimi. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2022, u konstatua se ka diferenca midis pasqyrave fizike, të dorëzuara nga institucionet buxhetore në degët e thesarit dhe pasqyrave financiare të gjeneruara nga (SIFQ), si pasojë e shpenzimeve të konstatuara të muajit dhjetor të vitit, momentit të konstatimit të të ardhurave në krahasim me arkëtimin e tyre, shpenzimet nuk njihen në momentin e ndodhjes së tyre sipas përcaktimit të shpenzimeve dhe për detyrimet e prapambetura përdoret një llogari ekstrakontabile për raportimin e tyre, në grupin e llogarive 486; mungon kuadri konceptual për raportimin financiar sipas përcaktimeve në kuadrin rregullator financiar ndërkombëtar; mungojnë standardet e kontabilitetit për regjistrimin e transaksioneve financiare, nuk kryhet procesi i konsolidimit të pasqyrave në nivel njësie mëmë konsolidues; mungon konsolidimi i pasqyrave financiare të sipërmarrjeve privatë në të cilat shteti ka interesa pjesëmarrje në kapital.</p>
Kriteri:	<p>Neni 62 “Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Pasqyrat financiare të konsoliduara të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), nuk pasqyrojnë plotësisht gjendjen reale financiare.</p>
Shkaku:	<p>Mos dorëzim në kohë të pasqyrave nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kryerjen e procesit të konsolidimit, mungesë të kuadrit rregullator në formën e standardeve për kryerjen e procesit të konsolidimit.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p>
Rekomandimi:	<p>Nga ana e Ministrisë së Financave të hartohen dhe publikohen standardet kontabël dhe kuadri i nevojshëm rregullator për metodologjinë e procesit të konsolidimit.</p> <p>Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa administrative për vonesat në dorëzimin e pasqyrave financiare individuale.</p>

2.C.3. Menaxhimi i likuiditetit të qeverisjes së përgjithshme për sigurimin e nevojave për mjete monetare për kryerjen e pagesave brenda kufijve të limitit të cash-it.

Një nga përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit është menaxhimi i likuiditetit dhe i llogarisë së unifikuar të thesarit nga Drejtoria e Operacioneve të Thesarit, sektori i drejtimit të Likuiditetit. Në kuadrin e menaxhimit të likuiditetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë së bashku me Bankën e Shqipërisë, kanë nënshkruar marrëveshjen kuadër “Për ofrimin e shërbimeve financiare nga Banka e Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë” me nr.prot.716/1, datë 20.01.2015, përditësuar me shkresën me nr. Prot. 5633/1, datë 18.12.2017 “Për një ndryshim në marrëveshjen ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, “Mbi instrumentet e ofruar nga Banka e Shqipërisë për menaxhimin e likuiditeteve të Ministrisë së Financave”.

Me qëllim analizën e likuiditetit dhe veprimeve në llogarisë së unifikuar të thesarit në të katër monedhat në të cilat administrohet për përballimin e nevojave për flukse dalëse, auditimi është përqendruar në drejtim të elementëve të parashikuar në marrëveshjen për ofrimin e shërbimeve financiare me Bankën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2022 është konstatuar përdorimi i instrumenteve SWAP si një mjet për menaxhimin e likuiditetit të lirë në monedhën EUR dhe SDR, të cilat paraqiten me tepriçë dhe nga konvertimi i tyre fondet e siguruara në monedhë kombëtare janë përdorur për shlyerjen e kërkesave për pagesë në monedhë kombëtare. Në marrëveshjes nr.716/1 datë 20.01.2015, në nenin 3 të saj “Përkufizime”, jepet përshkrimi i kontratës Swap ku citohet *“Kontratë SWAP - është një instrument i derivuar ku dy palë bien dakord të shkëmbejnë fondet bazuar në nevojat e ndryshme të secilit. Shkëmbimi i fondeve bëhet sipas kushteve të rëna dakord paraprakisht ku përfshihen kohëzgjatja e kontratës, instrumenti që po shkëmbejnë, mënyra e shlyerjes, etj.”*

Përdorimi i këtij instrumenti bazohet në analizën që sektorët përgjegjës për menaxhimin e likuiditetit bëjnë për flukset hyrëse dhe dalëse të mjeteve monetare, parashikimet 3 mujore dhe vjetore të realizimit të të ardhurave buxhetore me 3 skenarë të mundshëm (bazë, realist dhe negativ), në varësi të faktorëve makroekonomik si dhe pagesat e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe kërkesave për mbështetje buxhetore. Më pas këto analiza merren në shqyrtim në mbledhjet periodike të Komitetit të Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit.

Gjatë vitit 2022 janë realizuar 10 mbledhje të Komitetit të Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit ku në vazhdimësi nga pjesëmarrësit janë diskutuar:

- Flukset e parasë historike, gjendja e likuiditetit dhe parashikimet sipas skenarëve për këto dy elementë;

- Aktiviteti i huamarrjes për vitin buxhetor;

- Gjendja e valutës së huaj për vitin 2022 dhe instrumente për menaxhimin e likuiditetit

Vendimi për rinovimin e kontratës SWAP dhe termave të saj në vlera dhe maturim, kushtëzohet nga nevoja për të plotësuar llogarinë në monedhë të huaj në të njëjtën shumë (blerje EUR, SDR apo USD) si dhe nevoja për likuiditet në monedhën lek, nëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit (DPTH) parashikohet që do të ketë nevojë për to në kuadër të kryerjes së pagesave në valutë. Pra Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke u bazuar tek Marrëveshja 716/1 datë 20.01.2015, nuk është e detyruar të ushtrojë SWAP në maturim nëse nuk i nevojitet të plotësojë llogarinë në valutë dhe nëse nuk parashikon kryerje të pagesave në monedhën e huaj. Në praktikë, përdorimi i instrumenteve swap bazohet kryesisht në shkëmbimin e monedhave ndërmjet palëve nëse flukset hyrëse dhe dalëse të secilës palë të përfshirë në transaksion nuk përputhen në terma të arkëtimeve dhe pagesave të pritshme në të ardhmen.


Me kërkesë të grupit të auditimit u vu në dispozicion lista e transaksioneve SWAP, konvertim të njëanshëm si dhe praktikat shkresore të inicimit dhe kushteve të pranimit të kontratave nga ana e Bankës së Shqipërisë. Nga shqyrtimi i këtyre evidencave, rezulton se përgjatë vitit 2022, është vazhduar në drejtim të përdorimit të instrumenteve SWAP me Bankën e Shqipërisë në monedhat e huaja në të cilat administrohet TSA: EUR, SDR dhe LEK,USD, përdorimi i outright si dhe kryerja e një depozitimi për vendosje në depozitë kur ka pasur tepriçë të mjeteve monetare. Kontratat swap të cilat janë të maturuara nga viti i buxhetor 2021 dhe kontratat e reja për vitin buxhetor 2022 në rend kronologjik në monedhë origjinale së bashku me kundravleftën në lekë si pasojë e kurseve në emetim dhe maturim, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Monedha	Shuma	Data e Fillimit	Data e maturimit	Vlera në ALL
EUR	60,000,000	25.11.2021	30.03.2022	7,325,101,566
SDR	30,000,000	01.12.2021	31.03.2022	4,530,993,501
EUR	30,000,000	24.12.2021	24.06.2022	3,658,629,834
EUR	79,000,000	29.12.2021	29.12.2022	9,243,000,000
EUR	40,000,000	31.12.2021	30.11.2022	4,927,084,088
EUR	50,000,000	05.01.2022	30.12.2022	5,850,000,000
EUR	70,000,000	09.08.2022	15.09.2022	8,193,380,762
EUR	79,000,000	29.12.2022	16.03.2023	8,940,454,324
EUR	50,000,000	30.12.2022	17.04.2023	5,696,031,385
EUR	45,000,000	30.12.2022	17.11.2023	5,226,736,505
EUR	40,000,000	30.12.2022	20.10.2023	4,608,334,216

Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2022 ka pasur një konvertim outright me datë valutë 05.01.2022 në shumën 50,000,000 Euro, kurs këmbimi 119.55 dhe kundravleftë në lekë në shumën 5,977,500 mijë lekë sipas shkresës nr. 23062 datë 31.12.2021 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë drejtuar Bankës së Shqipërisë. Pra efektet e konvertimit të njëanshëm janë pasqyruar me datë valutë në vitin 2022, ndërkohë që për pjesën tjetër të vitit 2022 konstatohet se nuk ka pasur asnjë konvertim të njëanshëm por gjatë gjithë kohës janë përdorur instrumentet SWAP për menaxhimin e likuiditetit, me arsyetimin se gjendja e likuiditetit nuk është ende e qartë në fund të vitit 2022, sipas minutave të takimit të Komitetit të Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit.

Nga auditimi është konstatuar se gjatë vitit 2022 është kryer edhe një investim në depozitë sipas shkresës nr. 12114 datë 20.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit ku është kërkuar depozitimi i shumës prej 10 miliard lekë për qëllime investimi me datë valute 22.06.2022 dhe datë maturimi 01.07.2022.

Me qëllim ndjekjen e nevojave për likuiditet, janë analizuar tepriçat ditore të llogarive të TSA në lek dhe në monedha të huaja sipas informacionit faktik të vendosura në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit ku paraqiten sipas grafikut të mëposhtëm:



Sikurse është paraqitur në informacionin e përpunuar si më sipër, përgjatë vitit 2022, gjendja e likuiditeteve ka rezultuar e lartë ku në total, për pjesën më të madhe të vitit ajo paraqitet në ndërmjet intervalit 60 miliard lekë – 100 miliard lekë. Pjesa më e madhe e tepricave është akumuluar përgjatë gjithë vitit në TSA në Euro me një interval të konvertuar në lekë ndërmjet 40 miliard lekë - 70 miliard lekë. Bazuar në analizën e mësipërme konstatohet se nuk janë administruar siç duhet mjetet monetare duke kryer shumë pak investime të mjeteve monetare në vendosje në depozitë në rastin e tepricave të përkohshme të likuiditetit, sidomos për mjetet monetare në valutën euro. Akumulimi i gjendjes konstatohet se është krijuar nga huamarrjet e mbartura nga viti i kaluar në monedhën Euro si pasojë e Eurobondit të emetuar si dhe nga mbështetjet buxhetore. Mos ndjekja e duhur e këtyre tepricave jo normale të krijuara gjatë administrimit është jo në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 8 “Menaxhimi i mjeteve monetare të qeverisjes së përgjithshme” të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet që “Teprica e mjeteve monetare, përkohësisht të lira, të llogarive të qeverisjes së përgjithshme në Bankën e Shqipërisë investohet sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave”.

Nga auditimi konstatohet se mbajtja e tepricave në valutë përtej nevojave normale të funksionimit të sistemit të pagesave i ka ekspozuar mjetet monetare të qeverisjes së përgjithshme ndaj riskut të kursit të këmbimit. Si pasojë, gjatë vitit 2022 sipas raportimit në llogaritë analitike të treguesve fiskalë sipas buxheti të konsoliduar janë krijuar humbje nga kursi i këmbimit në rreth 4.6 miliard lekë të cilat janë reflektuar në zërin të tjera, nën financimin e deficitit në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar, sipas raportit analitik mbi gjendjen e llogarive. Kjo vlerë paraqet pakësim të mjeteve monetare si pasojë e rivlerësimit me kursin e datës së fundit të vitit si dhe efektin e humbjeve nga konvertimi nëpërmjet instrumenteve SWAP.

Gjithashtu është konstatuar se humbja është realizuar edhe nga transaksionet e konvertimit në valutë ku në masë të madhe janë përdorur instrumentet swap përkundrejt konvertimeve outright të cilat nga diferenca e kurse spot-forward kanë rezultuar në humbje të paraqitur analitikisht sipas rastit në tabelën e mëposhtme:

Në Euro

Veprimi	Data	Shuma euro	shuma leke	kursi	dif nga kurset
Fillim forwardi	25.11.2021	60,000,000	7,276,200,000	121.27	48,901,566
Maturim Forward	30.03.2022	60,000,000	7,325,101,566		
Fillim forwardi	24.12.2021	30,000,000	3,619,800,000	120.66	38,829,834
Maturim Forward	24.06.2022	30,000,000	3,658,629,834		
Fillim forwardi	29.12.2021	79,000,000	9,508,440,000	120.36	228,869,826
Maturim Forward	29.12.2022	79,000,000	9,737,309,826		
Fillim forwardi	31.12.2021	40,000,000	4,822,800,000	120.57	104,284,088
Maturim Forward	30.11.2022	40,000,000	4,927,084,088		
Fillim forwardi	05.01.2022	50,000,000	6,038,000,000	120.76	142,508,090
Maturim Forward	30.12.2022	50,000,000	6,180,508,090		
Fillim forwardi	09.08.2022	70,000,000	8,176,700,000	116.81	16,680,762
Maturim Forward	15.09.2022	70,000,000	8,193,380,762		
Fillim forwardi	29.12.2022	79,000,000	8,913,570,000	112.83	
Maturim Forward	16.03.2023	79,000,000	8,940,454,324		
Fillim forwardi	30.12.2022	40,000,000	4,513,200,000	112.83	
Maturim Forward	20.10.2023	40,000,000	4,608,334,216		
Fillim forwardi	30.12.2022	45,000,000	5,103,450,000	113.41	
Maturim Forward	17.11.2023	45,000,000	5,226,736,505		
Fillim forwardi	30.12.2022	50,000,000	5,670,500,000	113.41	
Maturim Forward	17.04.2023	50,000,000	5,696,031,385		
Totali I differences nga kurset spot-forward					580,074,166

SDR

Veprimi	Dt	Shuma SDR	shuma leke	kursi	dif nga kurset
Fillim forwardi	01.12.2021	30,000,000	4,516,200,000	150.54	14,793,501
Maturim Forward	31.03.2022	30,000,000	4,530,993,501		

Në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar është përcaktuar në nenin 8 të tij që *“Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë marrëveshje me Bankën e Shqipërisë dhe me bankat e nivelit të dytë, për kryerjen e operacioneve bankare dhe menaxhimin e mjeteve monetare të qeverisjes së përgjithshme.”*. Për këtë arsye argumentohet edhe në bazë të marrëveshjes me Bankën e Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve financiare mundësia e administrimit më të mirë të nevojave dhe tepricave për likuiditetin të buxhetit të shtetit. Në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Mbi instrumentet e ofruara nga Banka e Shqipërisë për menaxhimin e likuiditetit të Ministrisë së Financave”, të ndryshuar, në nenin 4 të saj është përcaktuar që *“Për të menaxhuar likuiditetin në periudhë afatshkurtër, Ministria kërkon vendosjen e depozitës në Bankë. Depozita mund të jetë e denominuar në lekë dhe/se valutë. Shuma maksimale e vendosur si depozitë në lekë, në çdo kohë do të jetë 10 (dhjetë) miliard lekë”*.

Në këtë mënyrë, referuar edhe kuadrit ligjor dhe instrumenteve operacionale për një mirëadministrim të likuiditetit, konstatohet se veçanërisht për mjetet monetare në valutë nuk është shfrytëzuar mundësia e investimit të tyre në depozitë për të përfituar të ardhura nga interesi, ndërkohë që nga ana tjetër, mbajtja e këtyre parave shoqërohet me kosto të mbajtjes së tyre.

Kryerja e konvertimeve me anë të instrumenteve swap përgjatë vitit 2022, për përballimin e nevojave për flukse dalëse në monedhën kombëtare ka rezultuar me humbje të konsiderueshme si pasojë e diferencës ndërmjet kurseve spot-forward. Nga auditimi konstatohet se nuk janë shfrytëzuar mundësitë për kryerjen e konvertimeve të njëanshme të monedhës së huaj në monedhë vendase. Gjithashtu konstatohet se konvertimet janë kryer në kah të kundërt me parashikimet e bëra në marrëveshjen e BSH me MFE mbi përdorimin e kontratave SWAP. Konkretisht, në nenin 5 të kësaj marrëveshje përcaktohet që *“Me qëllim menaxhimin e likuiditetit në valutë dhe flukseve të shërbimit të borxhit të jashtëm, Ministria mund të kërkojë realizimin e kontratave Swap me Bankën”*. Thelbi i kryerjes faktikisht të konvertimeve me swap ka rezultuar për përballimin e nevojave në monedhë kombëtare, ku fondet e siguruar nga konvertimi janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve në monedhë kombëtare, pasi gjatë gjithë kohës vlera e llogarive në valutë ka qenë e mjaftueshme për kryerjen e pagesave për shërbimin e borxhit apo të tjera pagesa në valutë.

Teprica e kontratave swap në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 214 milion euro me maturitet të ndryshëm përgjatë vitit 2023 dhe paraqitet brenda kufirit maksimal prej 25 miliard lekë të lejuar nga marrëveshja me Bankën e Shqipërisë.

Në konkluzion, menaxhimi i likuiditetit konstatohet se mbart problematika në drejtim të konstatimeve të mësipërme si pasojë edhe të faktorëve të mëposhtëm:

- mungesës së instrumenteve operacionale të kufizuar vetëm në drejtim të njëanshëm nga Banka e Shqipërisë dhe kushteve ekskluzivë të ofruara prej tyre;
- akumulimit të daljeve të mjeteve monetare përgjatë pjesës së fundit të vitit buxhetor;
- kufizimit të shpenzimeve (dhe rrjedhimisht të flukseve monetare dalëse) me anë të mos detajimit në kohë të planit buxhetor për realizimin e tyre;
- ndryshimit të shpeshtë të buxhetit me akte normative si ngjarje të “ngutshme dhe të paparashikuara” të cilat deformojnë planin e arkës dhe krijojnë situata të paparashikuara në drejtim të administrimit të duhur të likuiditetit të njërive të qeverisjes së përgjithshme.

Për problematikën e mësipërme për aq sa i përket kompetencave të strukturave përkatëse sipas detyrave funksionale, mbajnë përgjegjësi strukturat e ngarkuara me menaxhimin e likuiditetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit Zj. A.K. me detyrë përgjegjësi i sektorit të likuiditetit, Zj. M.P. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit, Komiteti i Menaxhimit të

Borxhit dhe Likuiditetit dhe Zj. A.B.e Zj A.V. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit sipas afatit të ushtrimit të detyrës.

Për konstatimet e mësipërme janë paraqitur observacione nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit me shkresën nr. 14149 datë 31.07.2023 duke pretenduar si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- ... sqarojmë se analizat e kryera nga KMBL-ja dhe vendimet e marra në lidhje me likuiditetin bazohen në të dhënat e parashikimeve periodike të flukseve hyrëse dhe dalëse në llogarinë e unifikuar të Thesarit “Depozitë e qeverisë” (TSA) në Bankën e Shqipërisë (BSH) dhe jo në të dhënat faktike të analizuara nga KLSH-ja për konstatimet e përfshira në këtë akt.

- lidhur me humbjet në valutë,.... sqarojmë se gjendja e valutës përtej nevojave normale të funksionimit të sistemit të pagesave u trashëgua prej vitit 2021 me emetimin e Eurobond-it, i cili ishte i domosdoshëm për pagesat e borxhit të jashtëm gjatë vitit 2022, por edhe në gjysmën e parë të vitit 2023. Emetimi i Eurobond-it në tregjet ndërkombëtare kryhet me frekuencë të ulët dhe në shuma të mëdha, sepse është një operacion që kërkon kohë dhe ka kosto. Gjithashtu, rivlerësimi/zhvleftësimi i gjendjes së mjeteve monetare në fund të çdo viti kalendarik është i kushtëzuar nga politika monetare. Për këtë arsye risku i kursit të këmbimit është i pashmangshëm. Në rast se gjendja e valutës përtej nevojave normale të funksionimit të sistemit të pagesave do të konvertohej në lekë, sërish nuk do të mund të investohej plotësisht, sepse kufiri i depozitës është i limituar deri në 10 miliardë lekë në zbatim të marrëveshjes dypalëshe. Nga ana tjetër, sipas marrëveshjes së rishikuar BSH mundëson blerjen e një sasive të limituar të gjendjes në lekë përtej nevojave normale të funksionimit të sistemit të pagesave, deri në 200 milionë euro në një vit, e cila nuk përballonte nevojat në valutë për pagesat e borxhit të jashtëm në periudhat në vijim.

-lidhur me mungesën e investimit të tepricave.... sqarojmë se investimi në depozitë i mjeteve monetare në monedhë të huaj (valutë) për të përfutur të ardhura nga interesi nuk rekomandohet nga BSH-së si agjenti financiar i Qeverisë. Në vitet e mëparshme depozitat me afat në valutë nuk rezultojnë fitimprurëse për shkak të interesave negative në treg. Nga ana tjetër viti 2022 është karakterizuar nga një pasiguri e theksuar për hyrjet dhe daljet e TSA-së në monedhën vendase, konkretisht:

Hyrjet nga huamarrja e brendshme: Në pjesën më të madhe të vitit ankandet e huamarrjes së brendshme nuk u plotësuan nga sistemi bankar.

Ecuria e shpenzimeve të njësisë të qeverisjes së përgjithshme gjatë vitit rezultoi shumë e ngadaltë, jashtë çdo parashikimi, duke rezultuar në muajin janar 2023 (periudhë komplementare e vitit 2022) me pagesa prej rreth 35 miliardë lekë për llogari të fondeve buxhetore të vitit 2022 (e pakrahasueshme me asnjë vit të mëparshëm).

Kërkesa të menjëhershme për shpenzime të paparashikuara: Transfertat për Koorporatën Elektroenergjitike Shqiptare, vaksinat, etj.

Luhatjet e kursit të këmbimit në tregun valutor, si dhe faktorët që ndikojnë në përcaktimin e çmimit forward (yieldet e bonove të thesarit dhe normat e depozitave të aplikuara nga Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare.

Në këto kushte nuk u ndërmorën investime për depozitë në valutë pranë BSH-së. Në lidhje me koston e mbajtjes së gjendjes në valutë sqarojmë se rezulton i kushtueshëm nga një pikëpamje e ngushtë e kostove direkte të MFE-së, por megjithatë kjo është e justifikueshme nga një pikëpamje tjetër më e gjerë nëse konsiderohet se sërish lëvizjet mbeten brenda fondeve publike pasi fitimi më i lartë i BSH-së derdhet sërish në buxhetin e shtetit. Aktualisht, duke qenë se gjendja e likuiditetit në valutë për vitin 2023 është e lartë, KMBL-ja po diskuton me Bankën e Shqipërisë për investimin në depozitë të valutës.

-lidhur me faktorët që kanë ndikuar në drejtim të menaxhimit të likuiditetit, sqarojmë se në zbatim të marrëveshjes dypalëshe e hartuar në mbështetje të ligjit organik të buxhetit dhe të ligjit të BSH, konkretisht cituar me poshtë: ... Banka e Shqipërisë luan rolin e agjentit financiar të Qeverisë pasi ka struktura të specializuara për mirëadministrimin e mjeteve monetare; për këtë arsye nuk ndërmerret asnjë vendim në këtë drejtim pa këshillimin me Bankën e Shqipërisë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se:

-konstatimet mbi rezultatet faktike janë bërë duke marrë në konsideratë nga grupi i auditimit të gjitha propozimet mbi parashikimet të paraqitura nga DPTH sipas mbledhjeve të KMBL dhe janë reflektuar edhe në shpjegimin e shkaqeve të problematikave të konstatuara në konkluzion, dhe për këtë çështje nuk rezultojnë jetë paraqitura observacione shtesë.

-lidhur me mos investimet e tepricave në valutë, konstatimet janë mbështetur në kërkesat e kuadrit rregullator për menaxhimin e likuiditetit që përfshijnë ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe marrëveshjen me Bankën e Shqipërisë dhe mos kryerja e analizave kosto përfitim në mbajtjen e likuiditetit ka shkaktuar efektet e konstatuara dhe për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-lidhur me strukturat e specializuara për menaxhimin e likuiditetit nga Banka e Shqipërisë observacioni merret në konsideratë.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit me shkresën nr. 281/25 prot. KLSH datë 11.09.2023 janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit ku janë parashtruar pretendimet e mëposhtme:

Pretendimi i subjektit:

Për rekomandimin nr. 33 ...sqarojmë se rekomandimi është pjesërisht i zbatueshëm pasi investimi i tepricave të mjeteve monetare është realizuar në zbatim të kufizimeve të vendosura nga Banka e Shqipërisë në marrëveshjen e përbashkët (në shumën maksimale prej 10 miliard lekë dhe jo më pak se një javë si dhe jo më shumë se një muaj). Në vijim MFE do të bashkëpunojë me Bankën e Shqipërisë për rritjen e limitit për investim të likuiditeteve të lira në monedhën vendase dhe të huaj si dhe të afatit të investimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se ato janë përshkruese të gjetjes së auditimit dhe nuk paraqesin kundërshtime mbi rekomandimin për tu zbatuar pjesërisht. Për këto arsye nuk merren në konsideratë.

Titulli i gjetjes:	Akumulimi i humbjeve nga rivlerësimi i valutës si pasojë e mbajtjes së tepricave përtej nevojave reale të detyrimeve financiare si dhe përdorimi ekskluziv i kontratave swap për konvertimet ndërmjet monedhave në llogarinë e unifikuar të thesarit.
Situata:	Gjatë vitit 2022 është konstatuar përdorimi i instrumenteve të shkëmbimit SWAP si një mjet për menaxhimin e likuiditetit të lirë në monedhën EUR dhe SDR, të cilat paraqiten me tepricë dhe nga konvertimi i tyre fondet e siguruara në monedhë kombëtare janë përdorur për shlyerjen e kërkesave për pagesë në monedhë kombëtare. Nga shqyrtimi i listës së transaksioneve të SWAP, rezultojnë se gjatë vitit 2022, është vazhduar në drejtim të përdorimit të instrumenteve SWAP me Bankën e Shqipërisë në monedhat e huaja në të cilat administrohet TSA, përdorimi i konvertimit të njëanshëm si dhe kryerja e një depozitimi për vendosje në depozitë kur ka pasur tepricë të mjeteve monetare. Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2022 ka pasur një konvertim të njëanshëm sipas shkresës nr. 23062 datë 31.12.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë drejtuar Bankës së Shqipërisë. Efektet e konvertimit të njëanshëm janë pasqyruar me datë valutë në vitin 2022, ndërkohë që për pjesën tjetër të vitit 2022 konstatohet se nuk ka pasur asnjë konvertim të njëanshëm por gjatë gjithë kohës janë përdorur instrumentet SWAP për menaxhimin e likuiditetit, me arsyetimin se gjendja e likuiditetit nuk është ende e qartë në fund të vitit 2022, sipas minutave të takimit të Komitetit të Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit. Nga auditimi është konstatuar se gjatë vitit 2022 është kryer edhe një investim në depozitë sipas shkresës nr. 12114 datë 20.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit ku është kërkuar depozitimi i shumës prej 10 miliard lekë për qëllime investimi me datë valute 22.06.2022 dhe datë maturimi 01.07.2022. Përgjatë vitit 2022, gjendja e likuiditeteve ka rezultuar e lartë ku në total, për

	<p>pjesën më të madhe të vitit ajo paraqitet në ndërmjet intervalit 60 miliard lekë – 100 miliard lekë. Pjesa më e madhe e tepricave është akumuluar përgjatë gjithë vitit në TSA në Euro me një interval të konvertuar në lekë ndërmjet 40 miliard lekë - 70 miliard lekë. Bazuar në analizën e mësipërme konstatohet se nuk janë administruar siç duhet mjetet monetare duke kryer shumë pak investime të mjeteve monetare në vendosje në depozitë në rastin e tepricave të përkohshme të likuiditetit, sidomos për mjetet monetare në valutën euro. Akumulimi i gjendjes konstatohet se është krijuar nga huamarrjet e mbartura nga viti i kaluar në monedhën Euro si pasojë e Eurobondit të emetuar si dhe nga mbështetjet buxhetore. Mungesa e ndjekjes së duhur e këtyre tepricave jo normale të krijuara gjatë administrimit nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 8 “Menaxhimi i mjeteve monetare të qeverisjes së përgjithshme” të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga auditimi konstatohet se mbajtja e tepricave në valutë përtej nevojave normale të funksionimit të sistemit të pagesave i ka ekspozuar mjetet monetare të qeverisjes së përgjithshme ndaj riskut të kursit të këmbimit. Si pasojë, gjatë vitit janë krijuar humbje nga kursi i këmbimit në rreth 4.6 miliard lekë të cilat janë reflektuar në zërin të tjera, nën financimin e deficitit në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar. Kjo vlerë paraqet pakësim të mjeteve monetare si pasojë e rivlerësimit me kursin e datës së fundit të vitit si dhe efektin e humbjeve nga konvertimi nëpërmjet instrumenteve SWAP. Kryerja e konvertimeve me anë të instrumenteve SWAP përgjatë vitit 2022, për përballimin e nevojave për flukse dalëse në monedhën kombëtare ka rezultuar me humbje të konsiderueshme si pasojë e diferencës ndërmjet kurseve të ditës dhe kurseve të së ardhmes në vlerën 580 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se nuk janë shfrytëzuar mundësitë për kryerjen e konvertimeve të njëanshme të monedhës së huaj në monedhë vendase.</p>
Kriteri:	<p>ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; marrëveshjen kuadër “Për ofrimin e shërbimeve financiare nga Banka e Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë” me nr.prot.716/1, datë 20.01.2015, të ndryshuar.</p>
Ndikimi/Efekti:	Akumulimi i humbjeve në procesin e menaxhimit të likuiditetit
Shkaku:	Tepricë e lartë e llogarisë në euro dhe konvertimet vetëm nëpërmjet përdorimit të kontratave swap.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për investimin e tepricave të mjeteve monetare në depozita me qëllim reduktimin e humbjeve nga procesi i menaxhimit të likuiditetit, si dhe për shtimin e instrumenteve për konvertimin e monedhave edhe me anë të konvertimit të njëanshëm me të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin financiar.

2.C.4. Mbi rregullshmërinë dhe saktësinë e regjistrimeve në llogarinë “Depozitë e Qeverisë” dhe rakordimi i saj me Bankën e Shqipërisë. Konsolidimi i njësive që operojnë në llogari speciale në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet transfertës nga Llogaria e Unifikuar e Thesarit.

Për auditimin e kësaj pike të Drejtimit të Auditimit është shqyrtuar dokumentacioni si më poshtë:

- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kapitulli V;
- Udhëzimi nr. 34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”;

- Akt Rakordime midis Sektorit të Transaksioneve Qendrore dhe Sektorit të Borxhit të Brendshëm;
- Akt Rakordime midis Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit dhe Bashkërendimit të ndihmës së Huaj dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit;
- Akt Rakordime midis Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Akt Rakordime midis Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- Konfirmimet e bankave të nivelit të dytë të dorëzuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në MFE;
- Konfirmim mbi të ardhurat nga bankat e nivelit të dytë mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë;
- Korrespondenca mes Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë lidhur me të ardhurat totale dhe shpenzimet totale të raportuara nga bankat e nivelit të dytë;
- Dokumentacion mbi lëvizjet dhe gjendjen e Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë Qeverie” çdo muaj dhe në fund të vitit financiar;
- Dokumentacion mbi kontratat Spot – Forward për vitin 2022;
- Dokumentacion mbi arkëtimet dhe pagesat direkte të kryera nëpërmjet llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë e Qeverisë” për vitin 2022;
- Dokumentacion mbi transfertat në valutë me jashtë kaluar përmes Bankës së Shqipërisë;
- Urdhër-shpenzimet për transfertat në valutë;
- Dokumentacion i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit lidhur me lëvizjet ditore të valutave;
- Dokumentacion mbi llogaritë speciale të qeverisë në Bankën e Shqipërisë, jashtë llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë qeverie”.

Nga auditimi ka rezultuar:

Rakordimi i të dhënave të llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë qeverie”, me Sektorin e Borxhit të Jashtëm dhe Sektorin e Borxhit të Brendshëm:

Mbështetur në Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kapitulli V, dhe në Udhëzimin nr. 34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”, nga auditimi i deritanishëm rezulton:

Në fund të çdo muaji dhe në fund të vitit 2022, Sektori i Menaxhimit të Llogarisë së Unifikuar të Thesarit, pranë Drejtorisë së Thesarit ka rakorduar në lidhje me arkëtimet dhe pagesat e bëra me Sektorin e Borxhit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, në zërin “Financim i Brendshëm” dhe me Sektorin e Borxhit të Jashtëm në zërin “Financim i Jashtëm”.

Sipas akt rakordimit midis Sektorit të Menaxhimit të Llogarisë së Unifikuar të Thesarit, dhe Sektorit të Borxhit të Brendshëm, pagesat për borxhin e brendshëm janë në total në vlerën 26,308,279.25 mijë lekë, të detajuara si në tabelën nr. 1:

Tabela nr. 1: Pagesat për borxhin e brendshëm, Dhjetor 2022

Zëri	TSA/cash	Borxhi/accrual
Interesa për kredinë direkte		
Interesa BTH të maturuara në 2022	3,566,256.63	3,566,256.63
Interesa obligacione me afat 2 vjeçar	2,004,488.98	2,004,488.98
Interesa obligacione në Euro me afat 2 vjeçar	208,034.53	208,034.53
Interesa obligacione me afat 3 vjeçar	1,513,914.07	1,513,914.07
Interesa obligacione me afat 5 vjeçar	5,223,076.12	5,223,076.12
Interesa obligacione me afat 7 vjeçar	3,950,480.09	3,950,480.09
Interesa obligacione me afat 10 vjeçar	7,550,604.65	7,550,604.65

Në mijë lekë

Interesa obligacione me afat 15 vjeçar	176,189.09	176,189.09
Interesa Garancia Sovrane	17,273.27	17,273.27
Totali (Interesa borxhi i brendshëm + Garanci Sovrane)	24,210,317.43	24,210,317.43

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Në tabelën e lëvizjeve të llogarisë 211008 “Depozitë e Qeverisë” për vitin 2022, pagesat e borxhit të brendshëm paraqiten në vlerën 20,621,808.1 mijë lekë (shpenzime për interesat e obligacioneve) dhe diferenca në vlerën 3,566,256.6 mijë lekë paraqitet si shpenzime për interesat e bonove të thesarit. Për më tepër, në këtë akt rakordim janë pasqyruar edhe arkëtimet nga borxhi i brendshëm, paraqitur si në tabelën nr. 2:

Tabela nr. 2: Arkëtimet nga borxhi i brendshëm, Dhjetor 2022

Zëri	Në mijë lekë
	TSA - Borxhi
Bono thesari neto	32,357,937.34
-Emetim	245,527,880.71
-Maturim	-213,169,943.37
-Euro Bono	-
Obligacione me afat kthimi 2 vjeçar	- 1,937,307.10
Obligacione me afat kthimi 2 vjeçar Euro	- 3,767,370.79
Obligacione me afat kthimi 3 vjeçar	- 2,890,125.53
Obligacione me afat kthimi 5 vjeçar	- 13,354,166.30
Obligacione me afat kthimi 7 vjeçar	879,400.01
Obligacione me afat kthimi 10 vjeçar	9,894,138.67
Obligacione me afat kthimi 15 vjeçar	5,125,772.96
Kredia A... Bank (Eurobond)	-
Totali (Interesa borxhi i brendshëm + Garanci Sovrane)	26,308,279.26

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Këto vlera rakordojnë me vlerat e paraqitura tek të Hyrat/Arkëtime nga Borxhi i Brendshëm i paraqitur në lëvizjet e llogarisë 211008 “Depozitë e Qeverisë” për vitin 2022.

Sipas akt rakordimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit dhe Bashkërendimit të ndihmës së Huaj dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, pagesat e shërbimit për borxhin e jashtëm janë në total 53,799,418.22 mijë lekë nga të cilat principali është në 38,385,744.51 mijë lekë dhe interesat së bashku me komisionet janë në vlerën 15,413,673.91 mijë lekë. Kjo vlerë është sa vlera totale 53,799,418.22 mijë lekë të paraqitur në zërin “Pagesat e borxhit të jashtëm” të tabelës lëvizjet e llogarisë 211008 “Depozitë e Qeverisë” për vitin 2022, të ndarë në dy zëra:

- Maturimi në vlerën 38,115,506.38 mijë lekë; dhe
- Interesa të borxhit të jashtëm në vlerën 15,683,912.04 mijë lekë.

Sipas tabelës së paraqitjes së gjendjes së llogarisë “Depozitë e Qeverisë” në datën 31.12.2022 paraqiten zërat në vlerën e mëposhtme nën zërin “Financimi i jashtëm”:

- Mbështetje buxhetore asistencë sociale – kredi në vlerën 905,045.00 mijë lekë;
- Mbështetje buxhetore kredia EBRD në vlerën 7,313,100.00 mijë lekë;
- Mbështetje buxhetore kredia AFD në vlerën 8,898,750.00 mijë lekë.

Tri zërat e mësipërm në total paraqiten në vlerën 17,116,895.00 mijë lekë, vlerë e cila paraqitet e njëjtë me 4 projekte të klasifikuara si mbështetje buxhetore dhe janë transferuar në llogarinë e unifikuar të thesarit në monedhë të huaj dhe jo në llogarinë speciale në Bankën e Shqipërisë për projektin përkatës. (Trajtuar më hollësisht në Drejtimin D.2 të këtij Raporti).

Rakordimi i të dhënave të llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë qeverie” me ISSH

Në fund të çdo muaji dhe në fund të vitit 2022, Drejtoria e Operacioneve të Thesarit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit ka rakorduar për të ardhurat tatimore e jo tatimore dhe kamatëvonesat, si dhe për transfertat që i kanë kaluar institucionit nga TSA. Në fund të vitit 2022, rakordimi është bërë me shkresën nr. 738 Prot., datë 27.01.2023 “Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara nga kontributet për Sigurimeve Shoqërore nga DPT për vitin 2022”. Arkëtimet nga llogaria e unifikuar e thesarit “Depozitë Qeverie” (TSA) dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, për 2 vitet e fundit, janë si në tabelën nr. 3:

Tabela nr. 3: Përmbledhja për 2 vitet e fundit të rakordimeve vjetore me ISSH

Nr.	Emërtimi	2021	2022
I	Gjendja në fillim të vitit (1 Janar)	2,786,999,356	990,507,348
1	Të ardhura tatimore (llog 75)	91,152,488,061	101,605,758,948
2	Të ardhura jo tatimore (llog. 711-gjoba)	267,712,164	310,611,031
3	Kamat vonesa të sigurimeve (llog. 709-gjoba)	113,307,767	118,186,207
II	Totali të ardhurave për vitin (1+2+3)	91,533,507,992	102,034,556,186
I+II	Totali të ardhurave në fund të vitit	94,320,507,348	103,025,063,534
III	Transferuar nga TSA në ISSH për vitin	93,420,000,000	100,877,173,000
	Gjendja në fund të vitit (31 Dhjetor)	990,507,348	2,147,890,534

Burimi: Drejtoria e Operacioneve të Thesarit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë Shifrat janë të sigluara dhe vulosura nga të dy institucionet në tabelën përmbledhëse nga ISSH & MFE (përkatësisht për ISSH nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Financës, Përgjegjësi i Sektorit dhe specialisti i Buxhetit dhe për MFE nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit (Zëvendësues i Përkohshëm), Drejtori i Operacioneve të Thesarit, nga Sektori i Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit (përgjegjësi dhe specialisti), për të ardhurat dhe Sektori i Llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë Qeverie” (TSA) - specialist për transfertat në favor të ISSH).

Nga llogaria e unifikuar e thesarit “Depozitë Qeverie” për ISSH, në vlerë **100,877,173,000 lekë**, rezulton se shumatat e kaluara në këtë llogari janë të barabarta me evidencën e shpenzimeve të llogarisë pikërisht për këtë zë specifik.

Rakordimi i të dhënave të llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë qeverie” me FSDKSH

Në fund të çdo muaji dhe në fund të vitit 2022, Drejtoria e Operacioneve me Thesarin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit ka rakorduar me strukturat e FSDKSH për të ardhurat tatimore dhe transfertat e tyre nga TSA. Në fund të vitit 2022, rakordimi është bërë me shkresën nr. 765 Prot., datë 13.01.2023, “Dërgohet rakordimi vjetor për arkëtimet dhe transferimet e kontributeve të sigurimit shëndetësor”. Për arkëtimet nga llogaria e unifikuar e thesarit “Depozitë Qeverie” (TSA) dhe nga kontributet e sigurimeve shëndetësore, ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe rakorduar me MFE, për vitin 2022, por krahasuar për 2 vite paraqiten në tabelën nr. 4:

Tabela nr. 4: Përmbledhja për 2 vitet e fundit të rakordimeve vjetore me FSDKSH

Nr.	Emërtimi	2021	2022
1	Gjendja në fillim të vitit (01 Janar)	282,209,668	168,256,503
2	Të ardhura tatimore gjatë vitit (llogaria 75)	14,436,046,835	16,100,358,425
I	Totali të ardhurave (1+2)	14,718,256,503	16,268,614,928
II	Transferuar nga TSA	14,550,000,000	15,630,000,000
III	Gjendja në fund të vitit (31 Dhjetor)	168,256,503	638,614,928

Burimi: Drejtoria e Operacioneve të Thesarit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tabela nr. 5: Rakordimi vjetor 2022 me FSDKSH

Emërtimi	Gjendje në fillim 01.01.2022	Të ardhura	Transferta nga TSA progresive	Gjendje në fund 31.12.2022
----------	------------------------------	------------	-------------------------------	----------------------------

Të ardhura nga kontributet e sigurimeve shëndetësore	168,256,503.06	16,100,358,425.00	15,630,000,000.00	638,614,928.06
--	----------------	-------------------	-------------------	----------------

Burimi: Drejtoria e Operacioneve të Thesarit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Gjatë raportit të rakordimit nuk kanë rezultuar diferenca dhe janë të miratuara e sigluara nga FSDKSH & MFE; përkatësisht për FSDKSH-në nga Sektori i të Ardhurave dhe Likuiditeteve-përgjegjës dhe specialist dhe nga MFE, nga Sektori Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit-përgjegjës dhe specialist dhe nga Sektori i Llogarisë së Unifikuar të Thesarit TSA “Depozitë qeverie” - specialist. Për vitin 2022, nga auditimi rezultoi se transfertat nga Llogaria e Unifikuar e Thesarit “Depozitë Qeverie” (TSA) për FSDKSH, në vlerë 15,630,000,000 lekë, janë kontabilizuar si shpenzim në llogarinë e TSA dhe se shumatat e kaluara me këto shkresa, ishin të barabarta me nxjerrjen e evidencës së shpenzimeve të “Depozitës së Qeverisë” nga të dy institucionet (Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë), por edhe nga të dhënat e nxjerra nga llogaria vjetore e FSDKSH.

Rakordimi i të dhënave të llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë qeverie me bankat e nivelit të dytë dhe me Degët e Thesarit në rrethe çdo muaj dhe për vitin 2022

Në mbështetje të Udhëzimit nr. 34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”, kapitulli II “Marrëdhëniet e Ministrisë së Financave me bankat e nivelit të dytë”, në pikat e mëposhtme citohet se:

- Në zbatim të marrëveshjes me ministrinë përgjegjëse për financat, bankat e nivelit të dytë kryejnë arkëtime të fondeve publike për llogari të vitit 2022 deri në fund të vitit 2022. Bankat e nivelit të dytë transferojnë në Bankën e Shqipërisë brenda orës 10:00 të datës së parë të punës në muajin Janar 2023 të gjitha mjetet monetare të arkëtuara për buxhetin e shtetit deri në fund të vitit 2022. Llogaritë e degëve të thesarit në bankat e nivelit të dytë do të fillojnë me gjendje zero në vitin 2023.

- Degët e Thesarit përfundojnë rakordimin me bankat e nivelit të dytë dhe raportojnë elektronikisht në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër brenda datës 10.01.2023.

Në pikën 13 të udhëzimit nr. 34, datë 14.12.2022, përcaktohet se: “Drejtoritë qendrore të bankave të nivelit të dytë, rakordojnë me strukturën përgjegjëse për thesarin në Ministrinë e Financave, sipas formatit të dërguar nga kjo e fundit brenda datës 19.01.2023”.

Sa më sipër, grupi i auditimit ka shqyrtuar konfirmimet e bankave të nivelit të dytë të dorëzuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në MFE, ku ka rezultuar si në vijim.

Përmes shkresës nr. 561 Prot., datë 12.01.2023, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE ka dërguar drejt bankave të nivelit të dytë, konfirmimin për gjendjen e llogarive të të ardhurave të buxhetit për periudhën 01.12.2022 – 31.12.2022, të gjeneruara nga sistemi SIFQ. Përmes kësaj shkrese kërkohet që bankat në fjalë të konfirmojnë gjendjen e llogarive brenda datës 19.01.2023. Në tabelën nr. 6 paraqiten afatet e konfirmimit (në mënyrë elektronike dhe me shkresë) si dhe të ardhurat e grupuara për gjendjet e rakorduara të bankave.

Tabela nr. 6: Konfirmimet e të ardhurave sipas bankave të nivelit të dytë

Në mijë lekë

Banka	Datë konfirmimi		Të ardhura				Totali Neto
	Rrugë elektronike	Me shkresë	Tatimore DPT	Doganore DPD	Thesari	Nënhua	
Banka R..	11.01.2023	19.01.2023	55,942,246.2	60,923,822.9	8,922,684.6	-	125,788,753.7
Banka K.	17.01.2023	17.01.2023	49,679,545.8	49,878,512.4	7,880,885.3	-	107,438,943.5
Banka C.	16.01.2023	16.01.2023	44,323,178.4	8,611,862.2	18,440,710.3	-	101,375,751.0
O. Bank	13.01.2023	20.01.2023	18,764,104.5	20,285,119.5	3,590,274.0	-	42,639,498.0
A... Bank*	16.01.2023	08.03.2023	5,712,976.5	9,901,345.3	984,228.1	-	16,598,549.9
Banka A.	13.01.2023	17.01.2023	6,272,770.0	3,970,302.1	1,764,348.1	-	12,007,420.0
Banka I.	11.01.2023	17.01.2023	29,200,620.4	31,351,700.9	1,872,522.0	-	62,424,843.3
Banka U.	18.01.2023	25.01.2023	8,820,499.4	5,795,468.6	3,772,412.3	-	18,388,380.4

P. Bank	11.01.2023	19.01.2023	8,325,946.1	2,479,061.8	542,851.0	-	21,347,859.0
Banka P.	11.01.2023	01.02.2023	3,388,311.8	2,504,200.4	747,462.4	-	6,639,974.7
T. Bank	11.01.2023	17.01.2023	10,740,268.1	11,318,815.7	2,719,102.6	-	24,778,186.4
Banka B.	17.01.2023	23.01.2023	1,095,881.5	808,444.7	291,268.7	-	2,195,594.9
Shuma			242,266,348.7	247,828,656.5	51,528,749.6	-	541,623,754.7
Në % ndaj totalit neto			44.73%	45.76%	9.51%	-	100%

* A... Bank dhe O... Bank bëhen një bankë, duke vepruar si O... Bank Albania nga 01.12.2022.

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Konstatohet se bankat e nivelit të dytë kanë respektuar afatin kohor për rakordim përmes rrugës elektronike, ndërsa përsa i përket dorëzimit të shkresave pranë MFE, afati është tejkaluar nga O. Bank (në shkresën e dorëzuar për bankën O... si dhe në shkresën e dorëzuar për bashkimin O. Bank – A. Bank), nga Banka U. dhe nga Banka B., të cilat i kanë dërguar shkresat fizike përtej datës 19 Janar 2023 të përcaktuar në Udhëzimin e MFE nr. 34, datë 14.12.2022.

Sa i përket shumave të rakorduara nga bankat e nivelit të dytë me MFE rezulton se në total vlera e rakorduar si total neto është 541,623,754.7 mijë lekë e ndarë sipas grupeve:

- Shuma e të ardhurave tatimore nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve prej 242,266,348.7 mijë lekë;
- Shuma e të ardhurave doganore nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave prej 47,828,656.5 mijë lekë;
- Shuma e të ardhurave nga degët e thesarit prej 51,528,749.6 mijë lekë.

Ndërkohë, përmes shkresës nr. 1507 Prot., datë 24.01.2023 MFE i ka kërkuar Bankës së Shqipërisë konfirmim mbi të ardhurat nga bankat e nivelit të dytë. Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë përmes shkresës nr. 429/1 Prot., datë 26.01.2023 ka dërguar të dhënat për konfirmim. ku rezulton se janë konfirmuar të ardhurat e kaluara në bankat e nivelit të dytë për vitin 2022 në shumën totale prej 541,623,754.8 mijë lekë. Konstatohet se nuk rezultojnë diferenca në të ardhurat e bankave të nivelit të dytë të rakorduara mes MFE dhe BSH.

Mbi saktësinë e raportimeve të Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë Qeverie”, me Bankën e Shqipërisë çdo muaj dhe në fund të vitit 2022

Konfirmimi i raportimeve të bankave të nivelit të dytë dhe Ministrisë së Financave për të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit

Nga verifikimi i shkresave të dërguara mes palëve: Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për konfirmimin mbi të ardhurat, konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit (DPTH) në MFE inicion kërkesën për raportim nga Departamenti i Operacioneve Monetare (DOM) në BSH, ku ky i fundit i konfirmon përmbledhësen e të ardhurave të buxhetit të shtetit të raportuara nga bankat tregtare.

Për vitin 2022, DPTH ka kërkuar raportim nga BSH në 7 periudha, ku DOM ka kryer raportime për të ardhurat sipas informacionit në vijim:

- 1 Janar – 31 Janar 2022, përmes shkresës nr. 717/1 prot., datë 14.02.2022;
- 1 Janar – 28 Shkurt 2022, përmes shkresës nr. 1128/1 prot., datë 11.03.2022;
- 1 Janar – 31 Korrik 2022, përmes shkresës nr. 3437/1 prot., datë 11.08.2022;
- 1 Janar – 31 Gusht 2022, përmes shkresës nr. 3750/1 prot., datë 13.09.2022;
- 1 Janar – 30 Shtator 2022, përmes shkresës nr. 4392/1 prot., datë 11.10.2022;
- 1 Janar – 31 Tetor 2022, përmes shkresës nr. 4899/1 prot., datë 11.11.2022;
- 1 Janar – 31 Dhjetor 2022, përmes shkresës nr. 429/1 prot., datë 26.01.2023.

Për vitin 2022 konstatohet se raportimet nuk kanë qenë me bazë mujore. Sipas të dhënave dhe dokumenteve të vëna në dispozicion, rezulton se DPTH ka iniciuar 7 kërkesa ndaj janë kryer vetëm 7 raportime. Pra, nuk është bërë shkëmbim i informacionit çdo muaj për të ardhurat e bankave të nivelit të dytë sipas referimit të Aneksit nr. 2 të “Marrëveshjes Kuadër”, të datës

16.01.2015 mes BSH dhe Qeverisë Shqiptare, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ku është përcaktuar se: *“Banka e Shqipërisë duhet të dërgojë çdo muaj konfirmim mbi të ardhurat dhe shpenzimet totale të qeverisë.”*

Nga të dhënat e vitit 2022, për periudhën 1 Janar – 28 Shkurt, rezulton një diferencë prej 150,000 lekë në të ardhurat e Bankës O. sipas raportimeve në të dy institucionet (tabela në Aneksin e këtij Raporti). Në përgjigje të shkresës ku kërkohet konfirmim nga ana e DPTH në MFE me nr. 4688 Prot., datë 10.03.2022 të MFE, nga ana e DOM është dërguar konfirmimi nëpërmjet shkresës nr. 1128/1 Prot., datë 11.03.2022 për të ardhurat nga bankat tregtare për periudhën 01.01.2022-28.02.2022. Konstatohet se arsyeimi i kësaj difference dhe mënyra se si diferenca është sistemuar, nuk i janë bashkëlidhur korrespondencës mes palëve.

Për raportimet e tjera të vitit 2022 të cilat janë listuar më sipër sipas shkresave përkatëse, grupi i auditimit ka shqyrtuar të dhënat dhe konstaton se nuk rezultojnë diferenca në të ardhurat e bankave tregtare sipas raportimeve në të dy institucionet MFE dhe BSH.

Rakordimi i zërit të të ardhurave totale të raportuara nga bankat dhe shpenzimet totale të iniciuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me zërin e Llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë qeverie”, zëri “Të ardhurat nga Bankat e Nivelit të Dytë” (BN II-të).

Lidhur me të ardhurat totale dhe shpenzimet totale, përmes korrespondencës mes DPTH në MFE dhe DOM në BSH, konstatohet se nga ana e DOM raportohet vetëm për shumat totale të të ardhurave dhe shpenzimet totale të iniciuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Përsa i përket periudhës 01.01.2022-31.12.2022 konstatohet një diferencë konstante prej afërsisht 2,199 mijë lekë që prej muajit Shkurt e deri në fund të vitit 2022, e cila vjen si pasojë e mënyrës së pasqyrimin të kësaj vlere nga ana e MFE në evidencën e saj në zërin “Pagesat e interesit të garancisë sovrane” për COVID 19, duke i zbritur nga shpenzimet totale. (Tabela e detajuar paraqitet në Aneksin e këtij Raporti)

Mbi saktësinë e konfirmimeve të Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë Qeverie”, me Bankën e Shqipërisë për periudhën 1 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022.

Për lëvizjet dhe gjendjen e Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë Qeverie” çdo muaj dhe në fund të vitit financiar, në mbështetje të Marrëveshjes Kuadër, Ministria e Financës dhe Ekonomisë rakordon me Bankën e Shqipërisë sipas korrespondencës. Çdo muaj të vitit 2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit pranë Ministrisë së Financave ka rakorduar me Departamentin e Operacioneve Monetare dhe Departamentin e Sistemit të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës pranë Bankës së Shqipërisë, në lidhje me “Gjendjen dhe lëvizjet e llogarisë së unifikuar të thesarit “Depozitë Qeverie” në lekë (ALL), në euro (EUR), në dollarë (USD) dhe SDR, të shoqëruara me evidencat mujore të tyre. Çdo evidencë mujore e transaksioneve të “Depozitës së Qeverisë në lekë dhe valutë”, ka bashkëngjitur datën e kryerjes së transaksionit, kursin e këmbimit dhe përshkrimin e zërave, në të cilat janë kontabilizuar transaksionet.

Çdo shkresë mujore e DOM në Bankën e Shqipërisë konfirmon të ardhurat totale të raportuara nga Bankat e Nivelit të Dytë dhe shpenzimet totale të iniciuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. DOM nuk kryen raportim të gjendjes së llogarisë “Depozitë Qeverie” në përgjigje të shkresave nga MFE, pasi citon se *“Evidenca e Buxhetit në ALL, EUR, USD, SDR dërgohet çdo ditë në rrugë elektronike pranë institucionit tuaj, bazuar në këtë marrëveshje”*. Konfirmimi nga DOM çdo muaj dhe në fund të vitit bëhet për shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve (pa evidencën me zëra të ndarë në 7 grupe shpenzimesh e të ardhurash), ndërsa DSPKF konfirmon çdo muaj dhe në fund të vitit gjendjen e llogarisë dhe në valuta.

Për vitin 2022, rakordimi është bërë çdo muaj nga ana e DSPKF në BSH, në përgjigje të shkresave të nisura nga ana e MFE. Nga auditimi i korrespondencës për gjendjen e llogarisë

së unifikuar të thesarit “Depozitë e qeverisë” në valutë, si dhe gjendja e llogarisë “Depozitë e Qeverisë” e detajuar për çdo muaj së bashku me lëvizjet debi-kredi (të hyra dhe të dala), ndërmjet dy institucioneve, rezultoi se gjendja e kësaj llogarie është e njëjtë (Tabelat e detajuara paraqiten në Aneksin e këtij Raporti).

Konstatohet se shumat e hyrjeve dhe daljeve për secilën prej valutave paraqitet si në tabelën nr. 7. Totali i të dalave dhe të hyrave për secilën nga valutat rakordon me konfirmimet në fund të vitit të lëvizjeve të llogarisë “Depozitë Qeverie”, së bashku me gjendjet në fund.

Tabela nr. 7: Shumat e të dalave dhe të hyrave për lekë dhe valutë në llogarinë “Depozitë Qeverie”

Valuta	Totali i të dalave	Totali i të hyrave
ALL	723,583,506,735.28	733,087,680,133.82
EUR	969,891,392.55	594,694,722.17
USD	45,820,726.90	47,640,268.33
SDR	56,854,416.00	30,000,000.00

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Afatet e Raportimit

Sipas Marrëveshjes Kuadër mes Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, datë 20.01.2015, në aneksin nr. 1 të saj përcaktohet se Banka e Shqipërisë dërgon konfirmimin e informacionit mbi të ardhurat dhe shpenzimet totale, çdo muaj (përmes një shkresë) në afatin kohor prej 3 ditë pune pas mbërritjes së shkresës nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

Bazuar në korrespondencën mes dy institucioneve, janë evidentuar datat e dërgimit të informacionit lidhur me konfirmimet e gjendjes së llogarisë “Depozitë Qeverie”, paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 8: Pasqyra e afateve të korrespondencave mes MFE dhe BSH për vitin 2022

Për gjendjen më datë:	Shkresa e dërguar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë		Data e mbërritjes në BSH	Shkresa e dërguar nga Banka e Shqipërisë		Diferenca në ditë
	Nr. Prot	Data		Data	Nr. Prot	
31.01.2022	1396/5	17.02.2022	24.02.2022	28.02.2022	1409/1	7
28.02.2022	1396/8	17.03.2022	25.03.2022	28.03.2022	2031/1	8
31.03.2022	1396/11	15.04.2022	20.04.2022	21.04.2022	2773/1	5
30.04.2022	1396/14	17.05.2022	27.05.2022	30.05.2022	3537/1	10
31.05.2022	1396/16	17.06.2022	23.06.2022	24.06.2022	4626/1	6
30.06.2022	1394/19	15.07.2022	01.08.2022	03.08.2022	5649/1	17
31.07.2022	1396/20	17.08.2022	18.08.2022	19.08.2022	6060/1	1
31.08.2022	1396/23	16.09.2022	21.09.2022	22.09.2022	6791/1	5
30.09.2022	1396/27	31.10.2022	03.11.2022	07.11.2022	7802/1	3
31.10.2022	1396/30	21.11.2022	23.11.2022	25.11.2022	8313/1	2
30.11.2022	1396/33	21.12.2022	28.12.2022	29.12.2022	9109/1	7
31.12.2022	1576	25.01.2023	01/02/2023	02.02.2023	818/1	7

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Në korrespondencën mes Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë vihen re diferenca në datat mes shkresës së dërguar nga MFE dhe kthimit të përgjigjes nga BSH. Përgjithësisht, shkresat e MFE mbajnë datën rreth/pas javës së dytë të muajit pasardhës, ndërkohë që vihet re një distancë e largët kohore mes datës së shkresave të MFE dhe datës së mbërritjes së po këtyre shkresave pranë BSH, ku konstatohet diferenca deri në 17 ditë kalendarike, paraqitur në kolonën e fundit të tabelës nr. 8. Pas datës së përcaktuar nga ana e Bankës së Shqipërisë si datë të mbërritjes së shkresave konfirmuese nga ana e MFE, është zbatuar afati prej 3 ditë pune për kthimin e përgjigjes nga ana e BSH drejt MFE.

Në Marrëveshjen Kuadër mes Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, lidhur për periodicitetin e raportimit nga ana e MFE-së përcaktohet vetëm periudha e raportimit mujor, pa caktuar një afat. Ndërkohë për Bankën e Shqipërisë përcaktohet afati prej 3 ditë pune pas mbërritjes së shkresës nga MFE. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara më sipër, konstatohet se ekziston një diferencë e largët kohore mes datës së shkresave të dërguara nga MFE dhe datës së mbërritjes së tyre në BSH, në një pjesë të mirë të muajve.

Titulli i Gjetjes:	Mosrespektim i periodicitetit mujor të konfirmimit nga MFE mbi të ardhurat dhe shpenzimet totale.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se procesi i konfirmimit të të ardhurave dhe shpenzimeve totale mes MFE dhe BSH zgjat deri në muajin e dytë pasardhës, pasi shkresat e MFE mbërrijnë në BSH disa ditë pas datës së shënuar në shkresë (në disa raste edhe deri në 10-17 ditë), megjithëse nga ana e BSH shkresa konfirmuese është brenda 3 ditëve sipas përcaktimit në marrëveshje. Në kuadër të procesit të konfirmimit sikurse është përcaktuar në marrëveshjen midis palëve, konfirmimi në muajin e dytë pasardhës nuk i shërben objektivitetit dhe në të njëjtën kohë është jo në përputhje me periodicitetin e parashikuar.
Kriteri:	Marrëveshja Kuadër mes Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë Shqiptare “Për ofrimin e shërbimeve financiare nga Banka e Shqipërisë për qeverinë e Republikës së Shqipërisë”, e datës 20.01.2015, aneksi 1.
Ndikimi	Vonesa në rakordimet periodike duke riskuar rregullimin në një kohë të arsyeshme të mospërputhjeve të mundshme.
Shkaku	Mospërcaktim i qartë i afateve në Marrëveshjen Kuadër për iniciimin e procesit për konfirmimin e të ardhurave dhe shpenzimeve totale nga ana e MFE duke nisur një shkresë drejt BSH.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për hartimin e një udhëzimi në zbatim të Marrëveshjes Kuadër me Bankën e Shqipërisë, ku në mbështetje të periodicitetit mujor të specifikuar, të përcaktohet afati i dërgimit të shkresës nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë drejt Bankës së Shqipërisë për dërgimin e konfirmimeve mujore me qëllim optimizimin e procesit.

Rakordimi dhe konfirmimi me zëra i të ardhurave, shpenzimeve dhe gjendjes së llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë e Qeverisë” më 31.12.2022

Nga shqyrtimi i të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në MFE, të dhënave të dërguara në rrugë elektronike nga Departamenti i Operacioneve Monetare të BSH, në tabelën nr. 14 paraqiten të ardhurat, shpenzimet si dhe gjendja e llogarisë së unifikuar “Depozitë e Qeverisë” më 31.12.2022, të konfirmuara edhe nga Departamenti i Sistemit të Pagesave Kontabilitetit e Financës në Bankën e Shqipërisë.

Në zërin “Të ardhura të tjera” në evidencën e MFE (trajtuar analitikiisht e detajuar në tabelën në Aneksin e këtij Raporti) për llogarinë “Depozitë e Qeverisë” në seksionin A “Totali i të ardhurave”, grupi II “Të ardhura jo tatimore”, zëri 9 “Të ardhura të tjera” përbëhet nga 8 elemente në shumën totale prej 100,227.23 mijë lekë, siç paraqitet në tabelën nr. 9.

Tabela nr. 9: Elementët e zërit “Të ardhura të tjera” në evidencën e MFE për llogarinë “Depozitë e Qeverisë”.

Në mijë lekë

1	Të ardhura të tjera	3.31
2	Kthim nga Fondi Kombëtar	97,495.74
3	Të ardhura të tjera (rimbursim bileta udhëtimi/dieta)	47.16
4	E ardhur qiraje Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	19.17
5	Derdhur transferim projekti EUR gabim nga BSH	10,724.87

6	Kthim shume derdhur gabim nga RZB	- 67.17
7	Kthim shume derdhur nga BSH në një llogari tjetër projekti gabim	- 10,724.87
8	Të ardhura të tjera mbyllje llogarie projekti	2,729.01
	Totali i zërit “Të ardhura të tjera”	100,227.23

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE.

Nga shqyrtimi i të dhënave të vëna në dispozicion si dhe nga auditimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të kaluara në llogarinë “Depozitë e Qeverisë” nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe nga Banka e Shqipërisë ka rezultuar se Departamenti i Operacioneve Monetare dërgon konfirmime mujore mbi të ardhurat totale dhe shpenzimet totale jo të konfirmuara e të ndara në të paktën 7 grupe të ardhurash dhe shpenzimesh drejt MFE; dhe gjithashtu dërgon konfirmime ditore në rrugë elektronike (përmes email) drejt Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në MFE.

Gjendja në fund, në datën 31.12.2022, e llogarisë “Depozitë e Qeverisë” është e njëjtë si në monedhën vendase (ALL), ashtu edhe në valutë të huaj (EUR, USD, SDR), megjithatë rezultojnë diferenca në zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve sepse MFE dhe BSH përdorin sisteme të ndryshme regjistrimi. Megjithatë, edhe pse në zëra rezultojnë diferenca, nga mbledhja e totalit të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve, totali rezultoi i njëjtë. Diferenca mes totalit të të ardhurave dhe totalit të shpenzimeve paraqitet në vlerë të njëjtë prej 53,870,198.49 mijë lekë për MFE dhe BSH. Kjo vlerë paraqet edhe gjendjen e llogarive në fund të vitit 2022 për të dy institucionet.

Rezultati financiar nga këmbimi valutor për kontratat spot-forward dhe rivlerësimet e valutave në llogarinë e Unifikuar të Thesarit “Depozitë Qeverie” për vitin 2022

Në hyrjet dhe daljet të llogarisë “Depozitë Qeverie” paraqiten edhe zëra të shpenzimeve në valutë, e cila sjell përlllogaritjen e interesave spot-forward gjatë kryerjes së këtyre veprimeve përgjatë vitit. Për më tepër, në fund të vitit kryhet vlerësimi i gjendjes së valutës në monedhat e ndryshme me kursin e ditës së fundit të vitit përkatës, për secilën nga monedhat EUR, USD dhe SDR, duke i konvertuar në monedhën vendase ALL.

Sa i përket vitit 2022, nga të dhënat e vëna në dispozicion dhe shqyrtimi i tyre, konstatohet se llogaritja e rezultatit nga përdorimi i valutës nga interesat spot-forward si dhe rivlerësimi i gjendjes së llogarisë në fund të vitit me kursin e ditës së fundit të vitit paraqitet si në tabelën nr. 10, krahasimisht me një vit më parë.

Tabela nr. 10: Rezultatet nga përdorimi i valutës për kontratat spot-forward dhe rivlerësimi i llogarisë në fund të vitit

Në mijë lekë

Rezultati nga përdorimi i valutës	Interesa spot-forward (A)		Dif. kursi me fundin e vitit (B)		Shuma (A) + (B)	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022
EUR	655,884	580,074	1,067,199	3,968,284	1,723,083	4,548,359
USD	2,414	-	45,466	310	47,880	310
SDR	186,895	14,794	-297,948	- 33,922	- 19,129	- 19,129
Shuma	845,193	594,868	814,717	3,934,672	1,770,963	4,529,540

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Sipas të dhënave të tabelës nr. 10, rezulton se totali i rezultatit nga përdorimi i valutës paraqitet në vlerën 4,529,540 mijë lekë në fund të vitit 2022. Sipas valutës specifikohet:

- Monedha EUR:

Nga përdorimi i kontratave spot-forward, pra për interesa, rezulton në shumën 580,074 mijë lekë dhe nga rivlerësimi në fund të vitit i tepricës së EUR në shumën 3,968,284 mijë lekë.

- Monedha USD:

Përgjatë vitit 2022 nuk rezultojnë interesa të kontratave spot-forward; ndërkohë nga rivlerësimi në fund të vitit i tepricës së USD rezulton shuma 45,466 mijë lekë.

- Monedha SDR:

Nga përdorimi i kontratave spot-forward, pra për interesa, rezulton në shumën 14,794 mijë lekë dhe nga rivlerësimi në fund të vitit i tepricës së SDR në shumën -33,922 mijë lekë.

Mbi zbatimin e ligjshmërisë për arkëtimet dhe pagesat direkte të kryera nëpërmjet llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë e Qeverisë” për vitin 2022

Lidhur me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve përmes llogarisë “Depozitë e Qeverisë” janë shqyrtuar si në vijim:

➤ **TË HYRAT** (të ardhurat), kontabilizuar në llogarinë e Unifikuar të thesarit “Depozitë e Qeverisë”:

1. Të ardhura nga koncesionet

Për vitin 2022, rezulton se të ardhurat nga koncesionet paraqiten në vlerën 8,149.2 mijë lekë. Gjatë këtij vitit, të ardhurat e vetme që paraqiten janë ato nga Koncesioni i Anijeve përmes 13 transfertave përgjatë vitit 2022.

Tabela nr. 11: Të ardhurat nga koncesionet

Nr.	Data	Shuma (EUR)	Kursi	Vlera (000/ALL)
1	11.01.2022	7,202.00	121.68	876.34
2	09.02.2022	4,713.62	121.35	572.00
3	08.03.2022	4,921.26	127.08	625.39
4	06.04.2022	4,697.00	121.38	570.12
5	17.05.2022	4,465.00	120.52	538.12
6	16.06.2022	5,125.10	119.85	614.24
7	07.07.2022	3,964.86	118.25	468.84
8	07.07.2022	143.70	118.25	16.99
9	08.08.2022	3,836.42	116.81	448.13
10	09.09.2022	7,967.70	117.62	937.16
11	14.10.2022	9,606.68	116.82	1,122.25
12	08.11.2022	5,754.46	116.93	672.87
13	07.12.2022	6,285.64	116.4	731.65
Totali		68,683.44		8,194.12

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE.

Krahasimisht me vitin 2021, i cili paraqiste të ardhura në shumë 7,360.02 mijë lekë, rezulton se për vitin 2022 këto të ardhura janë rritur me 12.14%.

2. Fitim/Humbja e Bankës së Shqipërisë

Për vitin 2022, Banka e Shqipërisë ka rezultuar me humbje, ndaj nuk ka derdhur fitim në llogarinë “Depozitë e Qeverisë”.

➤ **DALJET** (shpenzimet), kontabilizuar në llogarinë e unifikuar të thesarit “Depozitë e Qeverisë”:

1. Transferta për kompensimin e pronave

Gjatë vitit 2022 janë kaluar gjithsej 3 (tre) transfertat për shpronësimet, në vlerë totale prej 750,000.00 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2021, ku transfertat për kompensimin e pronave kanë qenë në vlerën 3,218,326.84 mijë lekë, rezulton se për vitin 2022 këto transfertat janë 77% më të ulëta se në vitin 2021.

Tabela nr. 12: Transferta për shpronësimet

Nr.	Data e transfertës	Shuma
1	20.07.2022	50,000.00
2	02.11.2022	500,000.00
3	12.12.2022	200,000.00
	Totali	750,000.00

Në mijë lekë

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE.

Shuma totale e kaluar me këto transferta është e barabartë me nxjerrjen e evidencës së llogarisë “Depozitë e Qeverisë” nga MFE në zërin “Transferuar në mjete në ruajtje për shpronësimet”.

Ndërkohë, transfertat për ATP (për kompensimin e pronave) janë në total 6 të tilla me vlerë 1,858,397.35 mijë lekë paraqitur në tabelën nr. 13:

Tabela nr. 13: Transferta ATP

Në mijë lekë

Nr.	Data e transfertës	Shuma
1	18.01.2022	1,394.07
2	05.04.2022	297,734.73
3	31.05.2022	1,000,000.00
4	10.08.2022	254,726.00
5	26.09.2022	158,419.81
6	25.09.2022	146,122.74
Totali		1,858,397.35

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE.

Në evidencën e nxjerrë nga MFE për llogarinë “Depozitë e Qeverisë” rezulton se zëri “Transferta për kompensimin e pronave” paraqitet në vlerën 1,857,003.28 mijë lekë. Diferenca prej 1,394.07 mijë lekë është paraqitur nën zërin “Shpenzime sipas bankave” pasi është në vlerë më të ulët se 1,500.00 mijë lekë.

2. Transferta në valutë

Shpenzime për transferta direkt nga llogaria e unifikuar e thesarit në valuta dhe të konvertuara rezultojnë në shumën totale 5,824,858.34 mijë lekë përmes Urdhër-Shpenzimeve. Analitikisht këto pagesa janë trajtuar në vijim. Nga auditimi i transfertave në valutë për vitin 2022, grupi i auditimit ka konstatuar se për shkak të përdorimit të llogarisë “Depozitë e Qeverisë në Euro” për transfertat në valutën USD (iniciuar përmes shkresave të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, MFE drejtuar Departamentit të Operacioneve Monetare, BSH) është shkaktuar shpenzim i panevojshëm në vlerë totale prej 43,275,715.77 lekë (si diferencë e vlerave në urdhër-shpenzime nga konvertimi USD-ALL dhe nga transaksionet e konvertimit EUR-USD-ALL për transfertat). Për më tepër, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit rezulton të mos ketë kryer një analizë paraprake për përdorimin e valutave të huaja me qëllim shmangien e shkaktimit të shpenzimeve të panevojshme. Në vijim janë paraqitur vlerat e transfertave referuar Urdhër-Shpenzimeve (Urdhër-Shpenzimet janë detajuar në tabelën në Aneksin e këtij Raporti).

A. Me urdhërues “**Instituti i Shëndetit Publik**” janë kryer 6 transferta në vlerë totale 1,836,333.39 mijë lekë, detajuar si më poshtë:

- 3 (tre) pagesa me objekt *Transfertë për vaksinë Anti-Covid 19*

Përmes shkresës nr. 6940/1 Prot., datë 14.04.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka bërë kërkesën drejt Bankës së Shqipërisë për transfertë për likuidim pagese në vlerën 1,637,230.95 EUR nga llogaria Depozitë e Qeverisë në Euro, bazuar në Aktin Normativ nr. 1, datë 10.01.2021, “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin, ndërmjet P. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Shëndetit Publik dhe Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave Anti Covid 19 në Republikën e Shqipërisë si dhe përdorimin e tyre në popullatë” miratuar përmes Ligjit nr. 2/2021, Aktit Normativ nr. 1, datë 09.02.2022, Aktit Normativ nr. 3, datë 18.01.2021, Aktit Normativ nr. 6, datë 18.03.2022, praktikës së Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 2587/1 Prot., datë 13.04.2022. Urdhër-shpenzim nr. 105, datë

13.04.2022, *Transfertë për vakcina Anti Covid 19*, në shumën 198,072,200.33 lekë (me kurs 120.98 lekë) me urdhërues Instituti i Shëndetit Publik dhe përfitues BSH, bazuar në Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 107, datë 13.04.2022, Akteve normative: nr. 1, datë 10.01.2021; nr. 3, datë 18.01.2021; nr. 1, datë 09.02.2022; nr. 6, datë 18.03.2022 dhe faturës nr. 31648353, datë 08.04.2022.

Përmes shkresës nr. 7347/1 Prot., datë 19.04.2022, Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit ka bërë kërkesën drejt Bankës së Shqipërisë për transfertë për likuidim pagese në vlerën 3,198,830.17 EUR nga llogaria Depozitë e Qeverisë në Euro, bazuar në Aktin Normativ nr. 1, datë 10.01.2021, “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin, ndërmjet P. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Shëndetit Publik dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave Anti Covid 19 në Republikën e Shqipërisë si dhe përdorimin e tyre në popullatë” miratuar përmes Ligjit nr. 2/2021, Aktit Normativ nr. 1, datë 09.02.2022, Aktit Normativ nr. 3, datë 18.01.2021, Aktit Normativ nr. 6, datë 18.03.2022, praktikës së Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 2649/1 Prot., datë 19.04.2022. Urdhër-shpenzim nr. 116, datë 19.04.2022, *Transfertë për vakcina Anti Covid 19*, në shumën 386,770,555.85 lekë (me kurs 120.91 lekë) me urdhërues Instituti i Shëndetit Publik dhe përfitues BSH, bazuar në Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 112, datë 19.04.2022, Akteve normative: nr. 1, datë 10.01.2021; nr. 3, datë 18.01.2021; nr. 1, datë 09.02.2022; nr. 6, datë 18.03.2022 dhe faturës nr. 31648357, datë 08.04.2022.

Përmes shkresës nr. 19987/1 Prot., datë 01.11.2022, Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit në MFE ka bërë kërkesën drejt Bankës së Shqipërisë për transfertë në vlerën 7,434,916.80 EUR nga llogaria Depozitë e Qeverisë në Euro drejt përfituesit P.bazuar në Aktin Normativ nr. 1, datë 10.01.2021 “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet P. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Shëndetit Publik dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave Anti-Covid 19 në Republikën e Shqipërisë si dhe përdorimin e tyre në popullatë” dhe Ligjit nr. 2/2021 që e miraton këtë akt, Aktit normativ nr. 3, datë 18.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin ndërmjet P. të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik” dhe Ligjit nr. 3/2021 që e miraton këtë akt, Aktit normativ nr. 5, datë 07.04.2021 “Për një ndryshim në Aktin Normativ nr. 1, datë 10.01.2021 të KM”, Aktit Normativ nr. 13, datë 05.10.2022, Aktit Normativ nr. 6, datë 18.03.2022 miratuar me Ligjin nr. 40/2022. Urdhër-shpenzimi nr. 391, datë 31.10.2022, *Transfertë për vaksinë antiCovid-19*, në vlerën 877,840,626.58 lekë (me kurs 118.07 ALL) me urdhërues ISHP dhe përfitues Banka e Shqipërisë, bazuar në Urdhrin nr. 300, datë 31.10.2022, dhe faturat:

- Proforma Invoice 31683377, datë 04.10.2022;
- Proforma Invoice 31683375, datë 04.10.2022;
- Proforma Invoice 31686379, datë 19.10.2022.

- 1 pagesë me objekt *Transfertë për vaksinë gripi*

Përmes shkresës nr. 2361/1 Prot., datë 08.02.2022, Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit ka bërë kërkesën drejt Bankës së Shqipërisë për transfertë për likuidim pagese në vlerën 1,072,937.50 USD në mbështetje të Marrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe UNICEF më datë 15.04.2005 dhe shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë nr. 1898, datë 05.04.2016, “Për Prokurimin e Vaksinave të Programit Kombëtar të Imunizimit” dhe në vijim të praktikës së Degës së Thesarit Tiranë, shkresa nr. 808/1 prot., datë 08.02.2022. Për të kryer këtë pagesë

fondi është marrë nga llogaria “Depozitë e Qeverisë në Euro” dhe është konvertuar në USD. Urdhër-shpenzimi nr. 23, datë 08.02.2022, *Transfertë për vaksinë gripi*, në vlerën 114,117,632.50 lekë (me kurs 106.36 ALL) me urdhërues ISHP dhe Përfitues Banka e Shqipërisë, bazuar në Urdhër e ISHP nr. 35, datë 08.02.2022 dhe shkresën nr. 136/3 Prot., datë 08.02.2022.

Kjo transfertë është shoqëruar me diferenca nga konvertimi të cilat janë pasqyruar në zërin “Diferenca kursi i këmbimit konvertim SDR USD transfertë ISHP Shkurt” në vlerën 2,952.94 mijë lekë.

- 2 pagesa me objekt *Transfertë për vaksinë kalendari*

Me shkresën nr. 8659/1 Prot., datë 13.05.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE ka bërë kërkesën drejt Bankës së Shqipërisë për transfertë për likudim pagese në vlerën 1,139,432.94 USD në mbështetje të Marrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe UNICEF më datë 15.04.2005 dhe shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë nr. 1898, datë 05.04.2016, “Për Prokurimin e Vaksinave të Programit Kombëtar të Imunizimit” dhe në vijim të praktikës së Degës së Thesarit Tiranë, shkresa nr. 3068/1 Prot., datë 12.05.2022. Urdhër-shpenzim nr. 151, datë 12.05.2022, *Transfertë për vaksinë kalendari*, në vlerën 131,809,602.50 lekë (me kurs 115.68 ALL) me urdhërues ISHP dhe Përfitues Banka e Shqipërisë, bazuar në Urdhër e ISHP nr. 138, datë 12.05.2022 dhe shkresën nr. 1898, datë 05.04.2016.

Me shkresën nr. 17005/1 Prot., datë 16.09.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE ka bërë kërkesën drejt Bankës së Shqipërisë për transfertë për likuidim pagese në vlerën 1,096,050.56 USD në mbështetje të Marrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe UNICEF më datë 15.04.2005 dhe shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë nr. 1898, datë 05.04.2016, “Për Prokurimin e Vaksinave të Programit Kombëtar të Imunizimit” dhe në vijim të praktikës së Degës së Thesarit Tiranë, shkresa nr. 4912/1 Prot., datë 12.05.2022. Urdhër-shpenzim nr. 317, datë 15.09.2022, *Transfertë për vaksinë kalendari*, në vlerën 127,722,771.76 lekë (me kurs 116.53 ALL) me urdhërues ISHP dhe Përfitues Banka e Shqipërisë, bazuar në Urdhër e ISHP nr. 248, datë 15.09.2022 dhe shkresën nr. 1051/3, datë 15.09.2022.

Tabela nr. 14: Urdhër-shpenzimet për transfertat për ISHP

Nr.	Datë	Kod Programi	Llog Ek.	Nën Llog	Kod Projekti	Shuma (lekë)	Urdhërues	Përfitues	Objekti i Shpenzimit
105	13.04.2022	7450	605	1099	91305AH	198,072,200.33	ISHP	BSH	Transfertë për vaksinë Anti Covid 19
116	19.04.2022	7450	605	1099	91305AH	386,770,555.85	ISHP	BSH	Transfertë për vaksinë Anti Covid 19
23	08.02.2022	7450	605	1099	91305AI	114,117,632.50	ISHP	BSH	Transfertë për vaksinë gripi
151	12.05.2022	7450	605	1099	91305AA	131,809,602.50	ISHP	BSH	Transfertë për vaksinë kalendari
317	15.09.2022	7450	605	1099	91305AA	127,722,771.76	ISHP	BSH	Transfertë për vaksinë kalendari
391	31.10.2022	7450	605	1099	91305AH	877,840,626.58	ISHP	BSH	Transfertë për vaksinë Anti Covid 19
Shuma						1,836,333,389.52			

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Shuma në total e 6 transfertave me urdhërues ISHP është e njëjtë me evidencën e nxjerrë nga MFE në zërin “Transfertë për ISHP” në vlerë 1,836,333.39 mijë lekë. Ndërkohë në zërin “Diferenca kursi i këmbimit konvertim SDR USD transfertë ISHP Shkurt” është paraqitur vlera 2,952.94 mijë lekë.

Nga krahasimi i të dhënave të Urdhër-Shpenzimeve dhe transaksioneve të BSH lidhur me 2 transfertat për ISHP të muajit Shkurt 2022 ku pagesa në USD është kryer nga llogaria “Depozitë e Qeverisë në Euro” ka rezultuar si në vijim:

Tabela nr. 15: Krahasimi i pagesave sipas Urdhër-Shpenzimeve dhe sipas transaksioneve të BSH për transfertat për ISHP

Vlera në USD e transaksionit	Sipas Urdhër-Shpenzimit			Sipas Bankës së Shqipërisë (Transferta)			Diferenca mes Urdhër-shpenzimit dhe Transfertës	Diferenca në ditë
	Data e Urdhrit	Kursi ALL/USD	Vlera në ALL	Datë konvertimi	Kursi ALL/USD përmes EUR	Vlera në ALL		
1,072,937.50	08/02/2022	106.36	114,117,632.50	09/02/2022	107.38	115,212,028.75	- 1,094,396.25	1
1,096,050.56	15/09/2022	116.53	127,722,771.76	16/09/2022	118.23	129,586,057.71	- 1,863,285.95	1
2,168,988.06			241,840,404.26			244,798,086.46	- 2,957,682.20	

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Nga të dhënat e shqyrtuara për këto dy transferta janë konstatuar problematikat e mëposhtme:

1. Dy transfertat e sipërcituara në tabelën nr. 15 për Institutin e Shëndetit Publik, nuk janë kryer duke përdorur llogarinë “Depozitë e Qeverisë në USD”, pasi nga të dhënat e audituara lidhur me gjendjen fillestare, lëvizjet neto dhe gjendjen përfundimtare, rezultojnë se kjo llogari nuk ka patur gjendje të mjaftueshme për të përballuar vlerat e këtyre transfertave si shkak i mangësive në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të kësaj llogarie. Transaksionet e kryera nga Banka e Shqipërisë kanë diferencë njëditore me Urdhër-Shpenzimet.
2. Në shkresat e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit drejtuar Bankës së Shqipërisë për të 2 transfertat e mësipërme citohet se “Për të kryer këtë pagesë të përdoret fondi në llogarinë “Depozitë e Qeverisë në Euro” IBAN: AL..... 001E.” Nga auditimi konstatohet se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit nuk rezultojnë që kjo kërkesë të jetë mbështetur në një analizë të kryer nga MFE për përcaktimin e valutës që do të përdoret në konvertim.
3. Nga konvertimi i njëpasnjëshëm EUR në USD në ALL (iniciuar nga shkresat e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në MFE) sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit rezultojnë se në total ka një diferencë prej 2,957,682.20 lekë lekë mes Urdhër-Shpenzimeve dhe transfertave të realizuara në të cilën kanë ndikuar:
 - (i) mënyra e kryerjes së konvertimit (nga EUR në USD në ALL) dhe
 - (ii) kurset e këmbimit të përdorura në konvertim nga Banka e Shqipërisë në datat e kryerjes së konvertimit.

B. Me urdhërues “Ministria e Arsimit dhe Sporteve” është kryer 1 transfertë në vlerën totale prej 315,368.19 mijë lekë.

Nëpërmjet shkresës nr. 16922/1 Prot., datë 15.09.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit pranë MFE ka bërë kërkesën drejt Bankës së Shqipërisë për transfertë në favor të Komisionit Europian në vlerën 2,687,644.39 EUR nga llogaria Depozitë e Qeverisë në Euro, referuar pjesëmarrjes në programin kuadër “Horizont Europa – Programi Kuadër për Kërkim dhe Inovacion 2021-2027”, Ligjit nr. 47/2022 “Për ratifikimin e marrëveshjes Horizont Europa” miratuar në datë 28.04.2022 me dekretin nr. 3612, datë 10.05.2022 të Presidentit të RSH, sipas të dhënave në debit-notat nr. 3242208167 dhe nr. 3242208192; dhe në vijim të praktikës së Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 4877/1 Prot., datë 14.09.2022. Urdhër-shpenzimi nr. 450, datë 14.09.2022, *Pagesë kuote vjetore 2021-2022 “Horizon Europa”*, në vlerën 315,368,192.72 lekë (me kurs 117.34 ALL) me urdhërues Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Përfitues European Commission, bazuar në Marrëveshjen me Komisionin Europian, Ligjin nr. 47/2022, kërkesën nr. 5032/5 Prot., datë 14.09.2022 dhe notat verbale nr. ref. ares (2022) 5106915 – 13.07.2022 dhe nr. ref. ares. (2022) 5107754 – 13.07.2022.

Vlera e kësaj pagese është e njëjtë me atë të evidencës nga MFE nën zërin “Transferta Ministria e Arsimit” në vlerën prej 315,368.19 mijë lekë.

C. Me urdhërues “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit” është kryer 1 transfertë në vlerën totale prej 178,000.00 mijë lekë.

Përmes shkresës nr. 4133/1 Prot., datë 03.08.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka bërë kërkesën drejt Bankës së Shqipërisë për transfertë për likuidim pagese në vlerën 1,462,492.81 EUR në mbështetje të Ligjit nr. 39/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes “Për ndryshimin dhe rivendosjen e Marrëveshjes nr. 1, në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 Janar 2016 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH-Shqipëri, llogari bashkëpunimi”. Urdhërshpenzim nr. 81, datë 02.03.2022, *Mbështetje financiare projektit BERZH, viti 2022*, në vlerën 178,000,000 lekë (me kurs 121.71 lekë) me urdhërues Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe përfitues Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim me bankë Wells Fargo N.A., bazuar në Urdhër e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 89, datë 02.03.2022, shkresës së MFE nr. 1906/1 Prot., datë 22.02.2022 për miratimin e investimeve për vitin 2022 dhe faturës FFC-2022-02-07, datë 24.02.2022.

Kjo vlerë përkon me evidencën në zërin “Pagesë Ministria e Mbrojtjes e Turizmit dhe Mjedisit” rakorduar nga MFE në vlerën 178,000.00 mijë lekë. Gjithashtu, në zërin “Komision i Transfertës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit” paraqitet vlera prej 2.49 mijë lekë.

D. Me urdhërues “**Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**” janë kryer 2 transfertat në vlerën totale prej 232,177.39 mijë lekë.

▪ Pagesë me objekt *Ndihmë për Qeverinë e Ukrainës*

Përmes shkresës nr. 14905/1 Prot., datë 03.08.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE ka kërkuar nga Banka e Shqipërisë të transferojë shumën prej 1,000,000.00 EUR nga Depozita e Qeverisë në Euro në favor të shtetit ukrainas bazuar në VKM nr. 406, datë 10.06.2022, “Për dhënien e ndihmës financiare humanitare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Mbështetjen e Qeverisë së Ukrainës”, në vijim të praktikës së Degës së Thesarit të Tiranës me shkresë nr. 4303/1 Prot., datë 03.08.2022. Urdhërshpenzim nr. 45, datë 03.08.2022, *Ndihmë për Qeverinë e Ukrainës*, në vlerën 116,760,000 lekë (me kurs 116.76 ALL) me urdhërues Përfaqësitetë Diplomatike (MEPJ) dhe Përfitues State Treasury Service of Ukraine, bazuar në VKM nr. 406, datë 10.06.2022.

▪ Pagesë me objekt *Transferim fondi në llogarinë bankare të Fondit Kombëtar pranë Bankës së Shqipërisë.*

Me shkresën nr. 23735/1 Prot., datë 29.12.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE i ka kërkuar Bankës së Shqipërisë të kryejë transfertën për likuidim pagese në vlerën 1,013,678.15 EUR nga Depozita e Qeverisë në Euro. Paga referohet të kryhet bazuar në Aktin Normativ nr. 17, datë 01.11.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/2021, “Për Buxhetin e vitit 2022”, shkresës së MFE nr. 22351/71, datë 15.12.2022 për detajimin e fondeve për investime, shkresës nr. 2254 Prot., datë 07.02.2022 të Drejtorisë së Fondit Kombëtar dhe në vijim të praktikës së Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 6702/1 Prot., datë 27.12.2022. Urdhërshpenzimi nr. 1049, datë 27.12.2022, *Transferim fondi në llogarinë bankare të Fondit Kombëtar pranë Bankës së Shqipërisë*, në vlerën 115,417,394.159 lekë (me kurs 113.86 ALL) me urdhërues Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe përfitues EU Funds for IPA 2014 Programme/EUR, bazuar në Aktin Normativ nr. 17, datë 15.12.2022, shkresën e MF nr. 2235/71, datë 15.12.2022 dhe shkresën e MF nr. 2254, datë 07.02.2022.

Tabela nr. 16: Urdhërshpenzimet për transfertat për MEPJ

Nr.	Datë	Kod Programi	Llog. Ek.	Nën Llog	Kod Projekti	Shuma (lekë)	Urdhërues	Përfitues	Objekti i Shpenzimit
45	03.08.2022	01120	605	1099	91502AE	116,760,000.00	Përfaqësitetë Diplomatike	State Treasury Service of Ukraine	Ndihmë për Qeverinë e Ukrainës
1049	27.12.2022	01110	231	0500	GM15008	115,417,394.16	MEPJ	EU Funds for IPA 2014 Programme/EUR	Transferim fondi në llogarinë bankare të Fondit Kombëtar pranë Bankës së

									Shqipërisë
Shuma						232,177,394.16			

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Shuma në total e 2 transfertave me urdhërues MEPJ është e njëjtë me evidencën e nxjerrë nga MFE në zërin “Transfertë për Ukrainën (ndihmë) MEPJ” në vlerë 116,760.00 mijë lekë dhe në zërin “Transfertë për Fondin Kombëtar nga MEPJ” në vlerë 115,417.39 mijë lekë. Ndërkohë në zërin “Komision i transfertës për Ukrainën (ndihmë) MEPJ” është pasqyruar vlera prej 5.73 mijë lekë dhe në zërin “Diferenca datë pagese datë regjistrimi në sistem pagesë e MEPJ Dhjetor” është pasqyruar vlera -456.16 mijë lekë.

E. Me urdhërues “Ministria e Mbrojtjes” janë kryer 6 transfertat në vlerën totale prej 3,262,979.37 mijë lekë.

- Pagesë me objekt *Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Shpenzime për likuidim LOA nr. ref AL-B-UBZ*

Përmes shkresës nr. 20360/1 Prot., datë 04.11.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE ka kërkuar nga Banka e Shqipërisë transfertën për likuidim pagese në vlerën 1,070,391.00 USD në vijim të shkresës nr. 4609/3 Prot., datë 03.11.2022, të Komandës së Forcës Tokësore (Reparti 1001) të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Ministrisë së Mbrojtjes.

Pagesa referohet të kryhet bazuar në VKM nr. 1085, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operacionale përfshirë teknologjinë dhe software-t e lidhura me këto mallra, si dhe përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave”, Letter of Offer and Acceptance (LOA) AL-B-UBZ për FMS “Mobile Marksmanship Training Systems”, shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr. 5544/1 Prot., datë 26.10.2022 dhe praktikës së Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 5771/1 Prot., datë 04.11.2022. Urdhër-shpenzimi nr. 722, datë 03.11.2022, Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Shpenzime për likuidim LOA nr. ref AL-B-UBZ, në vlerën 129,388,864.08 lekë (me kurs 120.88 ALL) me urdhërues Reparti Ushtarak nr. 1001 dhe përfitues D. , bazuar në VKM nr. 1085, datë 24.12.2020, shkresa e MM nr. 5544/1 Prot., datë 26.10.2022, dhe shkresa nr. 4609/3 Prot., datë 03.11.2022 e Komandës së Forcës Tokësore drejtuar Degës së Thesarit Tiranë.

Në Urdhër-Shpenzim, kjo vlerë është klasifikuar e gjitha nën llogarinë 231 “Investime të trupëzuara”, nënlllogaria 4320 “Shpenz.Mjete dhe pajisje te tjera teknik.”, ndërkohë që përbërja e nënzërave të kësaj blerje konsiston si në tabelën nr. 17:

Tabela nr. 17: Zërat përbërës të blerjes përmes Urdhër-Shpenzimit nr. 722, datë 03.11.2022

Emërtimi	Vlera (USD)
Simulatorë (STRICOM)	651,338.00
Mbështetje logjistike për pajisjet e trajnimit, simulatorët dhe shënjestrat	201,914.00
Mbështetje teknike për pajisjet e trajnimit, simulatorët dhe shënjestrat	183,949.00
Shuma neto	1,037,201.00
Shpenzime paketimi	0.00
Shpenzime administrative	33,190.00
Shpenzime transporti	0.00
Të tjera	0.00
Totali	1,070,391.00

Burimi: Letter of Offer and Acceptance (LOA) AL-B-UBZ, datë 24.10.2022

Grupi i auditimit konstaton se shpenzimet për mbështetje logjistike dhe mbështetje teknike, së bashku me shpenzimet administrative janë konsideruar pjesë e shpenzimit total dhe janë keqklasifikuar në llogarinë 231, pasi nuk janë pjesë e investimit të trupëzuar, por shpenzim

lidhur me këtë investim. Këto tri nënzëra përbëjnë 39.15% të vlerës totale të këtij investimi. Keqklasifikimi i këtyre tri nënzërave rrit në vijueshmëri shpenzimin e amortizimit, pasi në këtë mënyrë rritet baza e amortizueshme me 419,053.00 USD ose me 50,655,126.64 lekë (me kurs këmbimi 120.88 ALL, kursi ditor i Urdhër Shpenzimit më datë 03.11.2022).

Për pjesën takuese të verifikimit të saktësisë së Urdhër Shpenzimit dhe çdo elementi të Urdhër Shpenzimit përpara miratimit të pagesës, mban përgjegjësi Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues që kanë nënshkruar Urdhër-Shpenzimin nr. 722, datë 03.11.2022, si dhe dega e Thesarit Tiranë.

Titulli i Gjetjes	Parregullsi në klasifikimin e zërave në Urdhër Shpenzimet e pranuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
Situata	Nga auditimi u konstatua se në Urdhër Shpenzimin nr. 722, datë 03.11.2022, me objekt “Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Shpenzime për likuidim LOA nr. ref AL-B-UBZ”, me urdhërues Reparti Ushtarak 1001 (Ministria e Mbrojtjes), vlera totale prej 1,070,391.00 USD është klasifikuar si “Investim i trupëzuar” në llogarinë ekonomike 231, nënlllogaria 4320. Në fakt, përbërja e kësaj vlere sipas “Letter of Offer and Acceptance (LOA) AL-B-UBZ” të nënshkruar në datën 24.10.2022, ndahet në nënzërat: - simulatorë në vlerën 651,338.00 USD; - mbështetje logjistike për pajisjet e trajnimit, simulatorët dhe shënjestrat në vlerën 201,914.00 USD; - mbështetje teknike për pajisjet e trajnimit, simulatorët dhe shënjestrat në vlerën 183,949.00 USD; dhe - shpenzime administrative në vlerën 33,190.00 USD. Tri nënzërat e shpenzimeve përbëjnë rreth 39% të vlerës totale prej 1,070,391.00 USD. Klasifikimi i këtyre shpenzimeve në totalin e vlerës si Investim i Trupëzuar, rrit shpenzimet e amortizimit në vijimësi, duke amortizuar edhe shpenzimet, pasi baza e amortizueshme rritet në masën e këtyre tri nënzërave prej 419,053.00 USD.
Kriteri	Nomenklatura e Llogarive të Planit Kontabël Publik, Klasifikimi Kontabël në Llogaritë Ekonomike.
Ndikimi	Rritje në vijueshmëri e shpenzimit të amortizimit, duke rritur bazën e amortizueshme me 419,053.00 USD ose me 50,655,126.64 lekë (me kurs këmbimi 120.88 ALL, kursi ditor i Urdhër Shpenzimit më datë 03.11.2022).
Shkaku	Keqklasifikimi i zërave të shpenzimeve në llogarinë ekonomike 231 “Investime të trupëzuara”.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit të marrë masa për verifikimin e klasifikimit të saktë ekonomik në llogaritë kontabël të zërave përbërës të objektit të shpenzimit në Urdhër Shpenzime, ku secili prej zërave të jetë saktësisht i evidentuar në llogarinë ekonomike dhe nënlllogarinë përkatëse.

- Pagesë me objekt *Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Blerje e sistemeve të mortajave të çmontuara*

Me shkresën nr. 22800/1 Prot., datë 13.12.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE i ka kërkuar Bankës së Shqipërisë të kryejë transfertën për likuidim pagese në vlerën 1,800,000.000 USD në vijim të shkresës nr. 5367/1 Prot., datë 12.12.2022, të Komandës së Forcës Tokësore (Reparti 1001) të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Ministrisë së Mbrojtjes. Pagesa referohet të kryhet bazuar në VKM nr. 1085, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operationale përfshirë teknologjinë dhe software-t e lidhura

me këto mallra, si dhe përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave”, Letter of Acceptance LOA ODC-ALBANIA (23-006), datë 09.12.2022, shkresës së MM nr. 6454, datë 09.12.2022 dhe praktikës së Degës së Thesarit Tiranë me shkresë nr. 6359/1 Prot., datë 12.12.2022. Urdhër-shpenzimi nr. 796, datë 12.12.2022, Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Blerje e sistemeve të mortajave të çmontuara, në vlerën 197,028,000.00 (me kurs 109.46 ALL) me urdhërues Reparti Ushtarak nr. 1001 dhe përfitues D., bazuar në VKM nr. 1085, datë 24.12.2020, shkresa e MM nr. 6454 Prot., datë 09.12.2022, dhe shkresa nr. 5367/1 Prot., datë 12.12.2022 e Komandës së Forcës Tokësore drejtuar Degës së Thesarit Tiranë.

- Pagesë me objekt *Pajisje, materiale dhe shërbime ushtarake*

Përmes shkresës nr. 22797/1 Prot., datë 13.12.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE i ka kërkuar Bankës së Shqipërisë të kryejë transfertën për likuidim pagese në vlerën 7,620,000.00 USD në vijim të shkresës nr. 7512/2 Prot., datë 12.12.2022, të Komandës së Forcës Tokësore (Reparti 4001) të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Ministrisë së Mbrojtjes. Pagesa referohet të kryhet bazuar në VKM nr. 1085, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operationale përfshirë teknologjinë dhe softëare-t e lidhura me këto mallra, si dhe përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave”, Letter of Acceptance LOA me nr. ref. ODC-ALBANIA (23-006), datë 09.12.2022, shkresës së MM nr. 6454, datë 09.12.2022 dhe praktikës së Degës së Thesarit Tiranë me shkresë nr. 6358/1 Prot., datë 12.12.2022. Urdhër-shpenzimi nr. 934, datë 12.12.2022, Pajisje, materiale dhe shërbime ushtarake, në vlerën 834,085,200.00 lekë (me kurs 109.46 ALL) me urdhërues Reparti Ushtarak nr. 4001 dhe përfitues D., bazuar në VKM nr. 1085, datë 24.12.2020, shkresa e MM nr. 6454 Prot., datë 09.12.2022, shkresa e MM nr. 6346/1 Prot., datë 05.12.2022, dhe shkresa e MM nr. 6348/1 Prot., datë 05.12.2022.

- Pagesë me objekt *Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Blerje automjeti taktik të lehtë të përbashkët dhe Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Blerje pajisje të komunikimit taktik SOLTG.*

Me shkresën nr. 22978/1 Prot., datë 15.12.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE i ka kërkuar Bankës së Shqipërisë të kryejë transfertën për likuidim pagese në vlerën 9,000,000.00 USD në vijim të shkresës nr. 5367/3 Prot., datë 12.12.2022, të Komandës së Forcës Tokësore (Reparti 1001) të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Ministrisë së Mbrojtjes. Pagesa referohet të kryhet bazuar në VKM nr. 1085, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operationale përfshirë teknologjinë dhe software-t e lidhura me këto mallra, si dhe përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave”, Letter of Acceptance LOA me nr. ref. ODC-ALBANIA (23-006), datë 09.12.2022, shkresës së MM nr. 6454, datë 09.12.2022 dhe praktikës së Degës së Thesarit Tiranë me shkresë nr. 4607/1 Prot., datë 14.12.2022. Urdhër-shpenzim nr. 812, datë 14.12.2022, Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Blerje automjeti taktik të lehtë të përbashkët dhe Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Blerje pajisje të komunikimit taktik SOLTG, në vlerën totale 969,120,000.00 lekë (me kurs 107.68 ALL) me urdhërues Reparti Ushtarak nr. 1001 dhe përfitues D., bazuar në VKM nr. 1085, datë 24.12.2020, Letra e Pranimit ZBM-Shqipëri (23-006), datë 09.12.2022, dhe shkresa nr. 5367/3 Prot., datë 14.12.2022 e Komandës së Forcës Tokësore drejtuar Degës së Thesarit Tiranë.

- Pagesë me objekt *Materiale për mirëmbajtjen e objekteve specifike (Radar)*

Përmes shkresës nr. 22980/1 Prot., datë 15.12.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE i ka kërkuar Bankës së Shqipërisë të kryejë transfertën për likuidim pagese në vlerën 1,339,662.00 USD në vijim të shkresës nr. 4377/3 Prot., datë 12.12.2022, të Komandës së Forcës Ajrore të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Ministrisë së Mbrojtjes. Pagesa referohet të kryhet bazuar në shtesën e kontratës nr. 5844, datë 02.10.2017 “Për Sistemin e Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore (Faza I)” me nr. 1933/1 Prot., datë 03.11.2022 dhe praktikës së Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 6408/1 Prot., datë 14.12.2022. Urdhër-shpenzimi nr. 425, datë 14.12.2022, Materiale për mirëmbajtjen e objekteve specifike (Radar), në vlerën 144,254,804.16 lekë (me kurs 107.68 ALL) me urdhërues Forca Ajrore (Rp. 3001) dhe përfitues L. M. G. I., bazuar në shtesën e kontratës nr. 1933/1, datë 03.11.2022, Urdhër nr. 523, datë 18.11.2022, faturë nr. 9000860842, datë 22.11.2022, Raport i progresit të punës Nëntor 2022, Certifikatë për realizimin e Milestone 1, shkresë nr. 6369 Prot., datë 05.12.2022 dhe shkresë nr. 4377/3 Prot., datë 13.12.2022.

- Pagesë me objekt *Shpenzime për rritjen e AAM – Sistem dhe pajisje të teknologjisë dhe informacioni e komunikimit*

Përmes shkresës nr. 23533/1 Prot., datë 29.12.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE i ka kërkuar Bankës së Shqipërisë transfertën për likuidim pagese në vlerën 9,250,000.00 USD në vijim të shkresës nr. 4589/1 Prot., datë 22.12.2022 të Komandës së Forcës Ajrore të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Ministrisë së Mbrojtjes. Pagesa referohet të kryhet bazuar në kontratën nr. 6675, datë 20.12.2022 “Për furnizim me sistem mjetes ajrore pa pilot B. T. 2” lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së RSH dhe B. M. S. shkresës së MFE nr. 23179/1 Prot., datë 19.12.2022 dhe praktikës së Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 6661/1 Prot., datë 22.12.2022. Urdhër-shpenzimi nr. 470, datë 22.12.2022, Shpenzime për rritjen e AAM – Sistem dhe pajisje të teknologjisë dhe informacioni e komunikimit, në vlerën 989,102,500.00 lekë (me kurs 106.93 ALL) me urdhërues Forca Ajrore (Rp. 3001) dhe përfitues Reparti Ushtarak nr. 3001 (B. M. S.), bazuar në shkresën e MFE nr. 23179/1 Prot., datë 19.12.2022, kontratën nr. 6675, datë 20.12.2022 dhe shkresën nr. 6675/2 Prot., datë 21.12.2022.

Tabela nr. 18: Urdhër-shpenzimet për transfertat për MM

Nr.	Datë	Kod Programi	Llog Ek.	Nën Llog	Kod Projekti	Shuma (lekë)	Urdhërues	Përfitues	Objekti i Shpenzimit
722	03.11.2022	02120	231	4320	M170424	129,388,864.08	Reparti Ushtarak nr. 1001	D.	Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/shpenzime për likuidim LOA nr. Ref. AL-B-UBZ
796	12.12.2022	02120	231	4320	M170424	197,028,000.00	Reparti Ushtarak nr. 1001	D.	Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/blerje e sistemeve të mortajave të çmontuara
934	12.12.2022	02150	602	1005	91703AA	834,085,200.00	Reparti Ushtarak nr. 4001	D.	Pajisje, materiale dhe shërbime ushtarake
812	14.12.2022	02120	231	4320	M170424	646,080,000.00	Reparti Ushtarak nr. 1001	D.	Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Blerje automjeti taktik të lehtë të përbashkët
		02120	231	4320	M170424	323,040,000.00	Reparti Ushtarak nr. 1001	D.	Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Blerje pajisje të komunikimit taktik SOLTG
425	14.12.2022	02120	6025	200	91702AE	144,254,804.16	Forca Ajrore (Rp. 3001)	L.	Materiale për mirëmbajtjen e objekteve specifike (Radar)
470	22.12.2022	02120	231	4280	21AC101	989,102,500.00	Forca Ajrore (Rp. 3001)	Reparti Ushtarak nr. 3001	Shpenzime për rritjen e AAM – Sistem dhe pajisje të teknologjisë dhe informacioni e komunikimit
Shuma						3,262,979,368.24			

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Totali i 6 transfertave të mësipërme është i njëjtë me vlerën e paraqitur në zërin “Pagesë Ministria e Mbrojtjes në USD Nëntor 2022” në evidencën e MFE prej 3,262,979.37 mijë lekë. Ndërkohë në zërin “Diferenca kursi i këmbimit konvertim EUR USD transfertë Ministria e Mbrojtjes” MFE ka paraqitur vlerën prej 40,292.92 mijë lekë.

Nga krahasimi i të dhënave nga Urdhër-Shpenzimet dhe nga databaza e transaksioneve të BSH mbi transfertat për Ministrinë e Mbrojtjes, ka rezultuar si në vijim:

Tabela nr. 19: Krahasimi i pagesave sipas Urdhër-Shpenzimeve dhe sipas transaksioneve të BSH për transfertat me MM

Vlera në USD e transaksionit	Sipas Urdhër-Shpenzimit			Sipas Bankës së Shqipërisë (Transferta)			Diferenca mes Urdhër-shpenzimit dhe Transfertës	Diferenca në ditë
	Data e Urdhrit	Kursi ALL/USD	Vlera në ALL	Data konvertimi	Kursi ALL/USD përmes EUR	Vlera në ALL		
1,070,391.00	03/11/2022	120.88	129,388,864.08	04/11/2022	121.63	130,191,657.33	- 802,793.25	1
1,800,000.00	12/12/2022	109.46	197,028,000.00	13/12/2022	109.63	197,334,000.00	- 306,000.00	1
7,620,000.00	12/12/2022	109.46	834,085,200.00	13/12/2022	111.00	845,820,000.00	- 11,734,800.00	1
6,000,000.00	14/12/2022	107.68	646,080,000.00	15/12/2022	109.04	654,240,000.00	- 8,160,000.00	1
3,000,000.00	14/12/2022	107.68	323,040,000.00	15/12/2022	109.04	327,120,000.00	- 4,080,000.00	1
1,339,662.00	14/12/2022	107.68	144,254,804.16	15/12/2022	109.04	146,076,744.48	- 1,821,940.32	1
9,250,000.00	22/12/2022	106.93	989,102,500.00	30/12/2022	108.38	1,002,515,000.00	- 13,412,500.00	8
30,080,053.00			3,262,979,368.24			3,303,297,401.81	- 40,318,033.57	

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Nga të dhënat e shqyrtuara janë konstatuar problematikat e mëposhtme:

1. Transfertat për Ministrinë e Mbrojtjes nuk janë kryer duke përdorur llogarinë “Depozitë e Qeverisë në USD” pasi nga të dhënat e audituara lidhur me gjendjen fillestare, lëvizjet neto dhe gjendjen përfundimtare, rezulton se kjo llogari nuk ka patur gjendje të mjaftueshme për të përballuar vlerat e këtyre transfertave si shkak i mangësive në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të kësaj llogarie.
2. Transaksionet e kryera nga Banka e Shqipërisë kanë diferencë në ditë me Urdhër-Shpenzimet ku për transfertën me Urdhër-Shpenzimin nr. 470, rezulton një diferencë prej 8 ditësh vonesë nga dalja e Urdhër-Shpenzimit më datë 22.12.2022 deri në datën 30.12.2022 kur BSH ka kryer transaksionin.
3. Në shkresat e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit drejtuar Bankës së Shqipërisë për të 6 transfertat e mësipërme citohet se “Për të kryer këtë pagesë të përdoret fondi në llogarinë “Depozitë e Qeverisë në Euro” IBAN: AL89 1011 1008 0000 0000 2111 001E.” Nga auditimi konstatohet se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit nuk rezulton që kjo kërkesë të jetë mbështetur në një analizë të kryer nga MFE për përcaktimin e valutës që do të përdoret në konvertim.

Nga konvertimi i njëpasnjëshëm EUR në USD në ALL (iniciuar nga shkresat e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në MFE) rezulton se në total ka një diferencë prej 40,318,033.57 lekë mes Urdhër-Shpenzimeve dhe transfertave të realizuara në të cilën kanë ndikuar:

- (i) mënyra e kryerjes së konvertimit (nga EUR në USD në ALL) dhe
- (ii) kurset e këmbimit të përdorura në konvertim nga Banka e Shqipërisë në datat e kryerjes së konvertimit.

Titulli i Gjetjes	Krijim i shpenzimeve të panevojshme për shkak të përdorimit të valutës EUR për transfertat në valutën USD
Situata	Nga auditimi i transfertave në valutë për vitin 2022, grupi i auditimit ka konstatuar se për shkak të përdorimit të llogarisë “Depozitë e Qeverisë në Euro” për 8 transfertat në valutën USD (iniciuar përmes shkresave të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, MFE drejtuar Departamentit të Operacioneve Monetare, BSH, ku 2 transfertat kanë si urdhërues Institutin e Shëndetit Publik dhe 6 të tjera kanë si urdhërues Ministrinë e Mbrojtjes) është shkaktuar

	shpenzim i panevojshëm në vlerë totale prej 43,275,715.77 lekë (si diferencë e vlerave në urdhër-shpenzime nga konvertimi USD-ALL dhe nga transaksionet e konvertimit EUR-USD-ALL për transfertat). Rezulton se në momentin e kryerjes së transaksioneve, llogaria “Depozitë e Qeverisë në USD” nuk ka patur gjendje të mjaftueshme, pasi nuk është përfshirë në planifikimin vjetor, edhe pse Ministria e Financave dhe Ekonomisë kryen pagesa vjetore të përvitshme në valutën USD. Për më tepër, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit rezulton të mos ketë kryer një analizë paraprake për përdorimin e valutave të huaja me qëllim përdorimin e mënyrës më të favorshme me më pak kosto si dhe për shmangien e shkakimit të shpenzimeve të panevojshme. Gjithashtu, në një rast të evidentuar, diferenca mes datës së Urdhër Shpenzimit të Thesarit dhe datës së kryerjes së transaksionit nga Banka e Shqipërisë rezulton në 8 ditë, duke ndikuar dhe kursin me të cilin është kryer transaksioni.
Kriteri	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Kreu II “Përgjegjshmëria Menaxheriale”.
Ndikimi	Përdorimi i valutës EUR për pagesat e 8 transfertave në valutën USD ka shkakuar shpenzime të panevojshme në vlerën totale prej 43,275,715.77 lekë (si diferencë e vlerave në urdhër-shpenzime nga konvertimi USD-ALL dhe nga transaksionet e konvertimit EUR-USD-ALL për transfertat).
Shkaku	Problematika në menaxhimin e llogarisë “Depozitë e Qeverisë në USD” nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe në kushtet e pamjaftueshmërisë së gjendjes së kësaj llogarie nuk është kryer një analizë paraprake për përdorimin e valutave të huaja me qëllim përdorimin e mënyrës më të favorshme me më pak kosto si dhe për shmangien e shkakimit të shpenzimeve të panevojshme.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit të marrë masa për (i) përfshirjen e llogarisë “Depozitë e Qeverisë në USD” në planifikimin vjetor dhe (ii) kryerjen e një analize paraprake me qëllim përcaktimin e mënyrës më të favorshme për pagesë, në rastet kur kjo llogari nuk rezulton me gjendje të mjaftueshme për kryerjen e pagesave, me qëllim shmangien e shkakimit të shpenzimeve të panevojshme nga përdorimi i valutave të huaja.

Sa më sipër, për problematikat e evidentuara mban përgjegjësi znj. A.B.; me detyrë ish Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, dhe znj. M.P., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit.

3. Huadhënia në favor të KESH

Bazuar në Marrëveshjen e Huasë të nënshkruar nga palët MFE (nr. 1566/7, datë 24.03.2022) dhe KESH (nr. 471/8, datë 24.03.2022), neni 2 “Disbursimi” citohet se “*KESH sh.a. do t’i disbursohet kredia në monedhën Euro, në dy transhe, ku transhi i parë në vlerën prej 44,100,000 Euro do të tërhiqet brenda muajit Mars 2022 dhe transhi i dytë në vlerën prej 20,900,000 Euro do të tërhiqet në fund të muajit Prill 2022.*”

Përmes shkresës nr. 5800/1 Prot., datë 29.03.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka bërë kërkesën drejt Bankës së Shqipërisë për transfertë në favor të KESH sh.a. në vlerën 44,100,000.00 EUR nga llogaria Depozitë e Qeverisë në Euro, referuar shkresës nr. 471/9 Prot., datë 29.03.2022 të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, Ligjit nr. 155/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” i ndryshuar, VKM nr. 854, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, VKM nr. 757, datë 09.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 620, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave” dhe Marrëveshjes së Huasë të nënshkruar nga palët MFE (nr. 1566/7, datë 24.03.2022) dhe KESH (nr. 471/8, datë 24.03.2022).

KESH përmes shkresës nr. 1960 Prot., datë 20.04.2022, ka kërkuar disbursim Transhi II sipas Marrëveshjes së Huasë nr. 1566/7 Prot., datë 24.03.2022 nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Përmes shkresës nr. 7449/2 Prot., datë 28.04.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka bërë kërkesën drejt Bankës së Shqipërisë për transfertë në favor të KESH sh.a. në vlerën 20,900,000.00 EUR nga llogaria “Depozitë e Qeverisë në Euro”.

Tabela nr. 20: Disbursimet e transeve për kreditë e dhënë ndaj KESH

Data	Përshkrimi	Vlera (ALL)	Kursi ditor	Vlera (EUR)
30.03.2022	Investime kredi dhënie	5,376,231,000	121.91	44,100,000
29.04.2022	Investime kredi dhënie	2,530,990,000	121.10	20,900,000
Totali		7,907,221,000		65,000,000

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE.

Shuma e investimit në kredidhënie është e njëjtë me vlerën e paraqitur në Seksionin “Shpenzime kapitale” në zërin “Huadhënie e KESH” në vlerë totale 7,907,221.00 mijë lekë në evidencën e MFE për llogarinë “Depozitë Qeverie”.

Auditimi i konfirmimit të llogarive speciale të qeverisë në Bankën e Shqipërisë, jashtë llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë qeverie”

Në referencë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të veprojë si **agjente fiskale** për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, sipas kushteve dhe mënyrave të parashikuara në marrëveshje me Ministrinë e Financave. Gjithashtu Banka e Shqipërisë nëpërmjet sistemit bankar, **kryen funksionet e arkës së buxhetit të shtetit**. Ajo mund të pranojë depozita nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe kryen veprime pagesash deri në kufijtë e këtyre depozitave dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshje, mund të autorizojë një bankë sipas gjykimit të saj, ku të kalojnë këto depozita. Në Udhëzimin nr. 34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”, kapitulli III “Marrëdhëniet e Ministrisë së Financave me Bankën e Shqipërisë” në pikën 15 citohet se “Llogaria “Depozitë e qeverisë dhe të gjitha llogaritë speciale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Bankën e Shqipërisë, në datën e parë të punës në muajin Janar të vitit 2023, do të mbartin tepriçën e këtyre llogarive në fund të vitit.”

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me llogaritë speciale të MFE në Bankën e Shqipërisë rezulton se:

Bankën e Shqipërisë janë të çelura për llogari të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, përveç Llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë qeverie” edhe disa llogari të tjera speciale të qeverisë, në monedhë vendase dhe në valutë. Drejtoria e Operacioneve të Thesarit në DPTH, MFE përmes shkresës nr. 83, datë 04.01.2023, ka dërguar për rakordim pranë Bankës së Shqipërisë llogaritë jashtë TSA, specifikisht llogaritë në ALL, EUR, USD, CHF, GBP, JPY, SEK. Nga rakordimi me BSH, në datën 30.12.2022, gjendja e llogarive këtyre llogarive paraqiten si në vijim.

Llogaritë speciale në ALL

Llogaritë speciale të qeverisë në ALL, të çelura në BSH janë gjendje në fund të vitit si:

- totali i llogarive të shpronësimeve në 4 llogari në vlerën 6,701,442,431.66 lekë;
- totali i llogarive të çelura sipas projekteve në 5 llogari në vlerën 1,1157,857,269.83 lekë.

Tabela nr. 21: Gjendja e llogarive speciale në ALL në 30.12.2022.

Emërtimi i llogarisë	Monedha	Gjendja në 30.12.2022
<i>Llogaritë e Shpronësimeve</i>		
Fondi i shpronësimeve	ALL	96,490,457.85
Fondi për mbështetjen dhe rindërtimin e Gërdecit	ALL	64,643,000.00
Fondi shpronësimeve të ngrira për procedurë	ALL	45,114,257.82
Për administ. fondit special kompensimit të pronave	ALL	6,495,194,715.99
Total		6,701,442,431.66

<i>Llogari Speciale të Qeverisë</i>		
Grant Japonez	ALL	113,352,388.00
Grant Japonez për mbështetjen buxhetore	ALL	310,942,586.00
Italian Albani Dept. S'wap Agreement.II Managem. Committ.	ALL	29,517,500.13
Proj. Ins. Resu. Gjen. Kons. Agrobiodiver. Z. Rurale Shqj	ALL	1,122,895.20
Projekti Fond. Kunderpart Shqip-Zvic. Sec. Energj.	ALL	702,921,900.00
Total		1,157,857,269.33

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Llogaritë speciale në EUR

Nga rakordimi me BSH, në fund të vitit 2022, gjendja e llogarisë speciale në monedhën EUR, e specifikuar sipas projekteve përkatëse, paraqitet në vlerën 9,386,868.20 EUR. Konstatohet se llogaritë e tjera të Qeverisë në EUR si: llogari solidariteti për dëmet nga tërmeti; detyrime ndaj qeverisë "Të ardhura nga privatizimi"; fondi i shpronësimeve; fondi për mbështetjen dhe rindërtimin e Gërdecit kanë vlerën 0 në fund të vitit 2022, paraqitur në tabelën në Aneksin e këtij Raporti.

Llogaritë speciale në USD

Nga rakordimi me BSH, në fund të vitit 2022 rezulton se llogaria speciale në USD paraqitet si në tabelën nr. 23. Përsa u përket llogarive të tjera të qeverisë në USD si: llogari solidariteti për dëmet nga tërmeti; detyrime të qeverisë "Të ardhurat nga privatizimi"; detyrime ndaj qeverisë për interesat e projekteve të huaja; fondi për mbështetjen dhe rindërtimin e Gërdecit, paraqiten në vlerën 0 USD në fund të vitit 2022.

Tabela nr. 22: Gjendja e llogarive speciale në USD në 30.12.2022

Emërtimi i llogarisë	Monedha	Gjendja në 30.12.2022
Loan - Zhvillimi Rural i Rretheve Verilind.	USD	17,772.05
Projekt Importeve Kritike (Bank. Botërore)	USD	21,064.96
Kredi - Projekti i Pyjeve, IDA	USD	0.29
Kredi Zhvill. Rural. Zonat Verilind.	USD	778.30
GRAND "Projekti Sekuestrimit të Karbonit" Qev Japoneze	USD	2.00
Grant Projekti për Administrimin e Integruar të Ujrave Ekosistemeve	USD	54.00
Ndërti.Sek.Rrug.Qukës-Qafë Plloçë pjesë e korridorit Tiranë-Korçë	USD	91,015.00
Zhvillimi i Kontabilitetit në Sektorin Publik	USD	153,810.01
Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale	USD	13,171.31
Total		297,667.92

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Totali i gjendjes së llogarive speciale në USD në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 297,667.92 USD, të ndara specifikisht sipas llogarive të projekteve të paraqitura në tabelën nr. 22.

Ndërkohë për llogaritë e tjera të qeverisë në valutat GBP dhe JPY rezultojnë me vlerë 0 në fund të vitit 2022, bazuar dhe në rakordimin e MFE me BSH.

Sa më sipër, konstatohet se llogaritë speciale janë të çelura sipas projekteve përkatëse për vitin 2022 dhe janë rakorduar mes MFE dhe BSH duke mos shfaqur diferenca.

Sa trajtuar më sipër, subjekti ka paraqitur observacione përmes shkresës nr. 5854/50 Prot., datë 07.09.2023, protokolluar në KLSH me shkresën me nr. 281/25 Prot., datë 11.09.2023, ku pretendohet si në vijim:

Pretendimi i subjektit:

- Në vijim të rekomandimit nr. 35.1 (faqe 533 e Projekt Raportit të Auditimit), sqarojmë se zbatimi i këtij rekomandimi është në varësi të buxhetimit në zërat e shpenzimeve si dhe në përgjegjësi të NA/NZ të njësisë shpenzuese. Për këtë arsye, fakti regjistrohët kundrejt zërave të shpenzimeve të buxhetuara dhe të regjistruar në SIFQ nga strukturat përgjegjëse për buxhetin. Gjithashtu, dega e thesarit kryen

kontrollet lidhur me kontabilizimin e shpenzimit bazuar në natyrën e tij vërtetuar sipas dokumentacionit justifikues të shpenzimit në zbatim të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Në vijim të rekomandimit nr. 36.1 (faqe 533 e Projekt Raportit të Auditimit), sqarojmë se kryhet planifikimi i shpenzimeve në monedhë të huaj, por këmbimi valutë është i domosdoshëm, sepse borxhi në valutë është marrë në monedhën EURO dhe pikërisht likuiditeti i siguar për këtë monedhë përdoret kundrejt konvertimeve sipas nevojave për monedhën LEK apo për monedha të tjera (pagesat e borxhit janë në monedha të ndryshme).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin e paraqitur, grupi i auditimit sqaron se:

- Konstatimi i grupit të auditimit qëndron në keqklasifikimin në zëra të një shpenzimi të konsiderueshëm, i cili kryhet përmes transfertave që kalojnë nga MFE dhe BSH. Referuar rëndësisë dhe vlerës së lartë të shpenzimit, Drejtoria e Thesarit, si miratues fundor, duhet të verifikojë saktësinë e Urdhër-Shpenzimit dhe të dhënave të tij.

- Mungesa e gjendjes së monedhës USD për kryerjen e transfertave të analizuar në këtë Raport Auditimi si dhe mungesa e planifikimit të llogarisë TSA në valutën USD është e pajustificuar për faktin se në mënyrë periodike të përvitshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë kryen transferta në valutën USD për blerje vaksinash (vaksina gripi/vaksina kalendari) apo blerje armatimesh.

Sa sqaruar më sipër nga grupi i auditimit, observacioni nuk merret në konsideratë.

2.C.5. Menaxhimi i procesit të shpërndarjes së dëmshpërblimit financiar të ish të dënuarve dhe përndjekurit politikë mbi bazë të buxhetit vjetor në dispozicion; Rakordime me MSHMS dhe bankat e nivelit të dytë mbi shpërndarjen dhe përfitimin e dëmshpërblimit financiar.

Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve pjesë e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është struktura përgjegjëse për shpërndarjen e dëmshpërblimit për ish të dënuarit dhe përndjekurit politikë, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën objekt auditimi drejtoria ka pasur vakanca 1 specialist për arkivën, 1 specialist për pagesat, dhe drejtori i drejtorisë është vakant që nga perioda 14.10.2021. Vakanca e pozicionit të drejtorit të drejtorisë nuk është autorizuar si detyrë por me urdhrin nr. 239 datë 14.10.2022 të Ministrit, *Drejtori i Procesimit të Biznesit është ngarkuar përkohësisht për kryerjen e detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit*, Gjatë auditimit u konstatua se, Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve i ka paraqitur Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, raportin mbi shpërndarjen e dëmshpërblimeve për vitin 2022, me shkresën nr. 1392 prot, datë 24.01.2023, referuar ligjit nr. 9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të MFE nr. 5 datë 15.04.2016, i ndryshuar. Në vijim me shkresën nr. 1392 prot., datë 24.01.2023 nga ana e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është dërguar në Kuvendin e Shqipërisë raportimi vjetor mbi pagesat e realizuara për këtë kategori, viti 2022. Sipas Projekt-ligjit të Buxhetit për vitin 2022, ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” si dhe bazuar në ndryshimet e aktit normativ nr. 3, datë 12.03.2022, aktit normativ nr. 12 datë 29.07.2022, aktit normativ nr. 17 datë 01.12.2022 dhe aktit normativ nr. 19 datë 29.12.2022, planifikimi për programin 01190 “Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik” paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela: Planifikimi i Fondit për ish të Përndjekurve Politikë

mijë lekë

Planifikimi	Projekt ligj	Ligj Buxheti	Akt Normativ nr. 3	Akt Normativ nr. 12	Akt Normativ nr. 17	Akt Normativ nr. 19
Rehabilitimi të Përndjekurve Politik	1,035,991	1,035,991	1,034,325	1,034,325	1,031,325	1,031,325

Për vitin 2022 Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve ka çelur dy këste për kategorinë parësore të ligjit konkretisht me:

-Urdhrin nr. 118, datë 14.04.2022 të Ministres së Financave dhe Ekonomisë, kësti nr. 18;

-Urdhrin nr. 193 datë 19.07.2022 të Ministres së Financave dhe Ekonomisë, kësti nr. 19.

Gjithashtu është çelur kësti i katërt për kategorinë jo parësore që përfshin trashëgimtarët e ish të dënuarve, që nuk bëjnë pjesë në kategorinë parësore, konkretisht me:

-Urdhri nr. 214 datë 12.09.2022 të Ministres së Financave dhe Ekonomisë.

Gjatë auditimit është vënë në dispozicion informacion mbi realizimin e pagesave të këtij fondi nga tre burime të ndryshme, që janë:

- Tabela Fiskale (SIFQ)
- Bankat e nivelit të dytë
- Sistemi elektronik e-dëshmëpërblime

Tabela: Realizimi i Pagesave sipas 3 burimeve

Tabela Fiskale	Bankat e Nivelit të Dytë	Sistemi e-dëshmëpërblime
996 milion lekë	996,424 mijë lekë	997,785 mijë lekë

Realizimi sipas tabelës fiskale dhe pagesat sipas bankave të nivelit të dytë nuk rakordojnë me sistemin E-dëshmëpërblime që përdor Drejtoria e Pagesave dhe Dëshmëpërblimeve, argumentuar si në vijim: Nga vlera që rezulton në sistemin E-dëshmëpërblime janë kthyer 3,141 mijë lekë dhe rezulton se fondi i paguar është 996,424 mijë lekë. Shuma prej 3,141 mijë lekë janë fonde të kthyer nga bankat e nivelit të dytë për vitin 2022, në rastet kur përfituesit e fondit kanë problem me llogaritë e tyre bankare. *Për sa më sipër rezulton një realizim prej rreth 99.64% të fondit për ish të përndjekurit politikë.*

Në bazë të Standardit Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 610, rishikuar në vitin 2013, “Përdorimi i punës së audituesve të brendshëm”, problematikat e konstatuara nga auditimi i brendshëm, në auditimin e kryer me planin e auditimit nr. 2611/1 datë 24.02.2023 në Drejtorinë e Pagesave dhe Dëshmëpërblimeve, evidentohen kryesisht në lidhje me sistemin elektronik E-dëshmëpërblime, të cilat konsistojnë në raste duplikimi të listës dhe vlerës së trashëgimtarëve përfitues, pamundësinë e korrigjimit të vlerë financiare kur ndryshon VKM, pamundësisë së pasqyrimin si zbritje në sistemin e-dëshmëpërblimit të vlerave të kthyer nga bankat e nivelit të dytë, vështirësive në ngarkimin e dokumenteve të përfituesve, mungon gjurma e auditimit për kronologjinë e pagesave, pamundësia e gjenerimit të raporteve të konsoliduar etj. Këto problematika dhe nevoja për përmirësimin e sistemit e-dëshmëpërblime janë përcjellë pranë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit me memo-n e datës 30.05.2023, për të cilat deri në mbylljen e fazës së auditimit në terren nuk rezultoi vendimmarrje mbi rishikimin dhe përmirësimin e sistemit.

Për vitin 2022 është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 686 datë 26.10.2022 “Për miratimin e dëshmëpërblimit financiar për ish të dënuarit politik të regjimit komunist”, i cili vendosi miratimin e dëshmëpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të dënuar me burgim, izolim në hetuesi, izolim në institucion mjekësor apo mjekësor psikiatrik, gjithsej për 37 dosje me vlerë totale 103,538,669 lekë. Miratimin e dëshmëpërblimit financiar për ish të dënuarit politik të dënuar me dënim kapital ose të ekzekutuar pa gjyq, që janë 17 dosje me vlerë totale 73,292,872 lekë. Në vlerë totale dëshmëpërblimi i miratuar rezulton në vlerën 176,831,540 lekë.

Për vitin 2022 pagesat e realizuar sipas sistemit e-Dëshmëpërblime të ndara sipas kategorive dhe kësteve, detajuar në anekse. Nga viti 2008, kur ka filluar procesi i përlllogaritjes së masës së dëshmëpërblimit si dhe shpërndarja e kësteve përkatëse pranë Ministrisë së Financave dhe deri në fund të vitit 2022 janë miratuar në total **30 VKM** për shpërndarjen e dëshmëpërblimeve. Nga auditimi konstatohet se gjithë fondi i vitit 2022 për “Rehabilitimin e të Përndjekurve Politik” është përdorur për detyrimet e lindura nga VKM-të e viteve të kaluara. Në lidhje me detyrimin e mbetur në vlerë, për kompensimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, duke marrë në konsideratë të gjitha VKM-të e miratuara deri në vitin 2022 është:

	Në mijë lekë
Detyrimi i lindur nga viti 2009 – 2022 sipas VKM të miratuara	52,454,799
Shuma e shpërndarë nga viti 2009 – 2022	22,572,624

Nga auditimi konstatohet se vlera e detyrimit të mbetur për ish të përndjekurve politik deri në fund të viti 2022 është 29,882,175 lekë. Nëse buxhetimi dhe çelja e fondit për ish të përndjekurit do të vazhdojë me këtë ritëm apo të ulet më tej, ky detyrim do të mund të shlyhet mesatarisht pas rreth 30 vitesh.

Trajtimi i ankesës të z. B. dhe K.M., protokolluar në KLSH me nr. 153/3 datë 03.04.2023.

Kërkesë: Për përfitimin e dëmshpërblimit financiar për dënimin penal të padrejtë të P. F. Gj. si dhe për përfitimin e dëmshpërblimit financiar për personat e familjes sonë të internuar në ish kampet e internimit Berat dhe Tepelenë.

Data: 29.03.2023

Objekti: 1...përfitimin e dëmshpërblimit financiar për dënimin e padrejtë të xhaxhait tonë P. F. Gj., i dënuar politik me 12 vite burgim në 15.02.1949 dhe vdekur në burgun e Gjirokastrës në muajin shtator 1953.

2...përfitimin e dëmshpërblimit financiar për prindërit dhe të afërmit e të dënuarit politik të xhaxhait P.F.Gj., të internuar konkretisht M.P.Gj., N.F.Gj., B.F.Gj.i, Gj.F.Gj., M.F.Gj., internuar më 15.02.1949-25.12.1951, në ish kampet e internimit Berat dhe Tepelenë.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e **z. B. dhe K.B.M.** është protokolluar edhe një ankesë e mëparshme në KLSH me nr 153 datë 10.02.2023, në vijim të së cilës me shkresën nr. 153/1 datë 13.02.2023, kjo ankesë i është përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për kompetencë në shqyrtimin dhe kthim përgjigje.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshpërblimeve ka verifikuar rastin në fjalë dhe i ka kthyer përgjigje **z. B. dhe K.M. me shkresën nr. 3159/1 datë 16.02.2023**, se për z. P.F.Gj., nuk rezultoi të jetë miratuar në asnjë prej listave të VKM-ve për përfitim, siç e parashikon legjislacioni në fuqi. Ndërsa në lidhje me dënimet me internim, aktualisht nuk ka VKM të miratuar për këto dënime.

Pavarësisht se nga ana e MFE është kthyer përgjigje mbi këtë ankesë, rezulton se nga ana e **z. B. dhe K.M., është protokolluar sërish në KLSH ankesë-kërkesa me nr. 153/3 datë 03.04.2023, e cila u shqyrtua gjatë auditimit nga grupi i KLSH-së.**

Sipas kësaj kërkesë z. B. dhe K.M. pretendojnë se të afërm të tyre kanë tërhequr dëmshpërblimin, duke i përjashtuar ata, gjatë kohës që kanë qene në emigrim, periudha nëntor-dhjetor 2015 dhe kërkon nga KLSH auditimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Financave, si institucione të implikuara në këtë rast.

Çështje të sqaruara në ankesë:

-I janë drejtuar me kërkesë Institutit të ish të përndjekurve politikë dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave për dosjen nr. 21139 të z. P.F.Gj. Nga ana e MD është kthyer përgjigje se dosja është e paplotësuar pasi mungon vendimi që ka dhënë dënimin.

-I janë drejtuar Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor për marrjen e vendimit, i cili përgjigjet me shkresën nr. 121.1 datë 23.02.2022, se fondi arkivor i transferuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, fillon nga viti 1952.

-I janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për marrjen e vendimit, e cila me shkresën nr. 1024 datë 28.04.2022, përgjigjet se në regjistrat e arkivit nuk rezulton pendim penal për z. P.F.Gj.

-I janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër (duke qenë se në dijeninë e tyre z. Gj. ka vdekur në burgun e Gjirokastrës), e cila me shkresën nr. 223/1 datë 26.05.2022 ka kthyer përgjigje se nuk disponon të dhëna.

-I janë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila me shkresën nr. 1572/1 datë 03.08.2022 ka kthyer përgjigje se disponon vetëm regjistra themeltar të të dënuarve politikë në të cilat pasqyrohet vetëm koha e vuajtjes së dënimit. Nga verifikimi në regjistra z. F. nuk figuron i regjistruar.

-I janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë për vërtetimin e faktit juridik të vdekjes në burg si i dënuar politik.

Nga auditimi konstatohet se: Në shkresën ankesë-kërkesë prot., në KLSH me nr. 153/3 datë 03.04.2023, citohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë ka arritur në përfundimin se P.F.Gj. ka vdekur në burgun e Gjirokastrës në shtator 1953. (Grupi i auditimit nuk e disponon këtë vendim).

Gjithashtu në këtë ankesë citohet se i janë drejtuar sërish Ministrinë të Drejtësisë në datën 13.10.2022

dhe 13.01.2023. Kjo e fundit me shkresën nr. 249/2 prot datë 17.01.2023 është përgjigjur se: "...Ministria e Drejtësisë ka kthyer përgjigje shteruese me shkresën nr. 20/1 datë 10.02.2022, duke iu sqaruar mbi problematikën që ka dosja dhe iu ka informuar gjithashtu me shkresën dërguar Institutit të Integrimit të të Përndjekurve Politikë nr. 20/4 datë 25.05.2022". Grupi i auditimit nuk i disponon këto shkresa.

Në vijim të auditimit, duke vlerësuar problematikën e mësipërme dhe korrespondencat e sipas materialit të trajtuar, grupi i auditimit vlerëson se nga ana e Drejtorisë së Pagesave dhe Dëshmshpërblimeve, nuk është paguar dëshmshpërblim, pasi z. P.F.Gj., nuk rezulton në asnjë prej listave të VKM-ve për përfitim të miratuara, siç e parashikon legjislacioni në fuqi. Ndërsa në lidhje me dënimet me internim, aktualisht nuk ka VKM të miratuar për këto dënime, përgjigje e dhënë edhe **me shkresën nr. 3159/1 datë 16.02.2023 nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.**

Për sa më sipër veprimet e Drejtorisë së Pagesave dhe Dëshmshpërblimeve rezultojnë në përputhje me procedurat e ndjekura nga kjo drejtori në shpërndarjen e dëshmshpërblimeve, të cilat janë si në vijim:

-Identifikimi i dosjeve të miratuara me VKM për dëshmshpërblimin financiar të ish të dënuar politikë, sipas kategorisë së përcaktuar;

-Inicjalizimi i dosjeve sipas radhës së pagesës;

-Shqyrtimi i dosjeve të cilat janë inicjalizuar;

-Përcaktimi i shpërndarjes së vlerës së dëshmshpërblimit financiar të miratuar për çdo ish të dënuar politikë të regjimit komunist dhe familjarëve, në mënyrë proporcionale dhe sipas kushteve ligjore të listave të dosjeve që janë gati për pagesë;

-Realizimin e pagesës së dëshmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politikë dhe/ose familjarëve të tyre;

-Miratimi i listave të pagesave.

Nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Pagesave dhe Dëshmshpërblimeve zj. A.V., me shkresën nr. 5854/50, datë 07.09.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 281/25, datë 11.09.2023, janë paraqitur observacione si në vijim:

Prezantimi i subjektit: Në lidhje me rekomandimin 1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me qëllim rivendosjen e drejtësisë dhe dinjitetit shoqëror.

2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marr masa për analizimin e problematikave të sistemit E-dëshmshpërblime.

3. Drejtorja e Pagesave dhe Dëshmshpërblimeve dhe Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit, në bashkëpunim me Nëpunësin e Parë Autorizues, të iniciojë akt nënligjor për transferimin e programit buxhetor.

Sqarojmë se në lidhje me pikën 1 MFE mbetet e hapur të bashkëpunojë me MSHMS me qëllim rritjen e masës së këtij fondi nga viti në vit, gjithmonë duke respektuar balancat e hapësirave të mundshme buxhetore.

Në lidhje me pikën 2, Drejtorja e Pagesave dhe Dëshmshpërblimeve ka kërkuar pranë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit me memo-n datë 25.05.2023 (kopje bashkëlidhur) mbështetjen e kësaj Drejtorie për zgjidhjen e problematikave që janë konstatuar me sistemin.

Në lidhje me pikën 3, Dëshmshpërblimi i të përndjekurve politikë është funksion i ministrisë së linjës, e cila ka në fushën e saj të përgjegjësisë mbrojtjen sociale, pra MSHMS. Përgjegjësia e kontrollit të ekzekutimit të fondeve buxhetore është e strukturës së cilës i alokohen fondet buxhetore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vijim të rishikimit të funksioneve të të gjitha strukturave të saj, po vlerëson mundësinë për të kaluar strukturën e Drejtorisë së Pagesave dhe Dëshmshpërblimeve pranë MSHMS.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër në observacion nuk janë paraqitur kundërshtime në lidhje me gjetjen dhe rekomandimin e grupit të auditimit, por vetëm sqarime në koherencë materialin e auditimit mbi këtë Drejtori dhe nevojën e rishikimit të strukturës/programit buxhetor/vlerës së fondit për të përndjekurit politik etj. Reflektuar në raportin përfundimtar të auditimit përcjellja e problematikave të sistemit në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit.

Titulli i gjetjes:	Vlera e detyrimit të njohur nga shteti Shqiptar dhe i papaguar për ish të përndjekurve politik deri në fund të viti 2022 rezulton 29,882,175 mijë lekë.
---------------------------	---

	Problematika në lidhje me sistemin elektronik E-dëmshpërblime, risk në lidhje me saktësinë e të dhënave dhe pagesave të kryera.
Situata:	<p>Me ligjin fillestar të buxhetit fondi për rehabilitimin e të përndjekurve politik është planifikuar në vlerën 1,035,991 mijë lekë, nga të cilat vlera 35,991 mijë lekë për shpenzime administrative.</p> <p>Me Aktin Normativ nr. 3 datë 12.03.2022 ky fond është ulur në vlerën 1,666 mijë lekë krahasuar me planin fillestar, ndërsa me Aktin Normativ nr. 17 datë 01.12.2022, programimi përfundimtar i këtij fondi është 1,031,325 mijë lekë, duke u ulur në vlerën 4,666 mijë lekë, krahasuar me Ligjin e Buxhetit. Për vitin 2022 fondi i paguar rezultoi 996,424 mijë lekë.</p> <p>- Konstatohet se vlera e detyrimit të njohur nga shteti Shqiptar dhe i papaguar për ish të përndjekurve politik deri në fund të viti 2022 rezultoi 29,882,175 mijë lekë. Nëse buxheti dhe çelja e fondit për ish të përndjekurit do të vazhdojë me këtë ritëm apo të ulet më tej, ky detyrim do të mund të shlyhet mesatarisht pas rreth 30 vitesh.</p> <p>Përveç këtij fakti, nga auditimi i MFE-së janë konstatuar problematika në lidhje me sistemin elektronik e-dëmshpërblime të cilat konsistojnë kryesisht në raste dublikimi të listës dhe vlerës së trashëgimtarëve përfitues, pamundësinë e korigjimit të vlerës financiare kur ndryshon VKM, pamundësisë së pasqyrit si zbritje në sistemin e-dëmshpërblimit të vlerave të kthyer nga bankat e nivelit të dytë, vështirësive në ngarkimin e dokumenteve të përfituesve, mungon gjurma e auditimit për kronologjinë e pagesave, pamundësia e gjenerimit të raporteve të konsoliduar etj. Këto problematika dhe nevoja për përmirësimin e sistemit e-dëmshpërblime janë përcjellë pranë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit me memo-n e datës 30.05.2023, për të cilat deri në mbylljen e fazës së auditimit në terren nuk rezultoi vendimmarrje mbi rishikimin dhe përmirësimin e sistemit.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 9831, datë 11.12.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar;</p> <p>-Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e viti 2022”;</p> <p>-VKM nr. 686 datë 26.10.2022 “Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politik të regjimit komunist”;</p> <p>-Akti Normativ nr. 3 datë 12.03.2022 dhe Akti Normativ nr. 17 datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 115/2021 “Për Buxhetin e Vitit 2022”.</p>
Ndikimi/Efekti	Nëse buxheti dhe çelja e fondit për ish të përndjekurit do të vazhdojë me këtë ritëm apo të ulet më tej, ky detyrim do të mund të shlyhet pas rreth 30 vitesh.
Shkaku:	Buxheti i shtetit gjendet në pamundësi për ta shpërndarë detyrimin e njohur ndaj ish të përndjekurve brenda një viti buxhetor.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me qëllim rivendosjen e drejtësisë dhe dinjitetit shoqëror të kategorisë së të përndjekurve politik të kërkojë shtimin e fondeve për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, duke mundur shlyerjen e detyrimit të njohur nga shteti Shqiptar.</p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marr masa për analizimin e problematikave të sistemit E-dëmshpërblime me qëllim rritjen e sigurisë mbi të dhënat e regjistruara dhe pagesat e kryera për ish të përndjekurit politikë.</p>

2.D. Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik

2.D.1. Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e treguesve të borxhit publik. Analiza e qëndrueshmërisë së treguesve dhe vlerësimi i përmbushjes së objektivave të strategjive afatshkurtra dhe afatmesme. Treguesit e Borxhit të Brendshëm. Treguesit e Borxhit të Jashtëm. Shërbimi i borxhit. Garancitë dhe nënhatë.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 281/1 Prot., datë 03.04.2023, për vitin 2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Strategjia e afatmesme e menaxhimit të borxhit publik 2021-2023;
- Strategjia afatmesme e menaxhimit të borxhit 2022-2026;
- Raporti i Borxhit Faktik për vitin 2022;
- Regjistrat e borxhit në baza 3-mujore për vitin 2022;
- Raportet e treguesve të borxhit të publikuara nga MFE për vitin 2022;
- Rezultatet e ankandëve të emetimit të titujve shtetërore të borxhit të brendshëm për vitin 2022;
- Raporte nga sistemi i informatizuar i menaxhimit të borxhit;
- Rakordimet vjetore ndërmjet strukturave të thesarit dhe borxhit në lidhje me pagesat dhe - disbursimet e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Korrespondencat shkresore të MFE;
- Strategjia afatmesme e menaxhimit të financave publike 2019-2022;
- Të dhëna në lidhje me garancitë, nënkuatë, garancitë sovrane për vitin 2022.

Bazuar në modelin e Bankës Botërore për përgatitjen e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, alternativat e mëposhtme të Strategjisë së Huamarrjes janë shqyrtuar dhe analizuar nga ana e MFE-së. Për secilën nga Strategjitë Alternative është gjeneruar modeli me rezultatet e treguesve kryesorë të përmbledhur si më poshtë:

Indikatorët e riskut të skenarëve alternative të strategjisë

Indikatorët		Në fund të vitit 2026			
		S1	S2	S3	S4
Shpenzimet e Interesit si % / GDP		3.2	3.1	3.2	3.2
Norma mesatare e interesit (përqind)		5.6	5.5	5.6	5.6
Risku i Rifinancimit	Borxhi që maturohet brenda një viti (%/totalit)	28.7	34.9	25.4	25.7
	Borxhi që maturohet brenda një viti (% ndaj GDP)	17.5	21.3	15.5	15.7
	Koha Mesatare në Maturim i B. Jashtëm (vite)	6.9	6.6	7.1	7.2
	Koha Mesatare në Maturim i B. Brendsh (vite)	3.0	2.6	3.3	2.9
	KMM Total Portfolit (vite)	4.7	4.2	5.0	5.3
Risku i normës së interesit	Koha Mesatare në Rifiksion (vite)	3.7	3.4	3.9	3.9
	Borxhi që rifiksohet brenda një viti (%/totalit)	42.0	46.4	39.5	43.3
	Instrumente me normë fikse (përqindje ndaj totalit)	85.8	87.6	85.0	81.5
	Bono thesari (përqindje ndaj totalit)	14.6	20.8	11.2	12.5
Risku i kursit të këmbimit	Pesha e Borxhit të Jashtëm ndaj totalit	44.8	39.8	45.2	55.0

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

Strategjitë alternative të huamarrjes u analizuan dhe krahasuan duke konsideruar dy indikatorë paralelisht: koston e borxhit, si dhe zhvillimet mbi treguesit e riskut për secilën prej strategjive. Sipas SAMB 2022-2026 rezulton se strategjia S3 sipas MFE-së paraqet avantazhe të dukshme sa i takon treguesve të risqeve, ku konkretisht:

Ndryshe nga S1, financimi në tregun e brendshëm në vitet 2022-2026 është planifikuar në këtë skenar të mundësohet kryesisht nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit në një masë gjithnjë e në ulje ndër vite, ku gjatë periudhës së strategjisë parashikohet në një nivel mesatar prej rreth 58% të huamarrjes në tregun e brendshëm, duke vijuar me emetimin e instrumenteve afatmesme, këto çdo vit në rritje (mesatarisht në masën prej 29%), si dhe atyre afatgjata në masën prej 13%.

Përmirëson ndjeshëm profilin e maturimit të borxhit, për rrjedhojë treguesit e riskut të refinancimit dhe ato të normës së interesit. Gjithashtu, Strategjia S3 sjell zhvillime pozitive edhe në drejtim të riskut të kursit të këmbimit duke mundësuar rënie graduale të peshës së borxhit në valutë të huaj nga rreth 50%, niveli që arriti ky tregues në fund të vitit 2021, në nivelin e projektuar prej rreth 45% në fund të periudhës së strategjisë.

Përmirësim sa i takon këtij risku sjellin edhe Alternativat S1 dhe S2 të strategjisë, ndërkohë që strategjia S4 sjell një përkeqësim të këtij treguesi, kjo për shkak të karakteristikave të kësaj strategjie financimi të mbështetur gjerësisht në burimet e huaja.


Sipas MFE-së është analizuar se financimi në periudhën e ardhshme duke përzgjedhur dhe aplikuar strategjinë S3 do të ketë rezultate të kënaqshme në drejtim të optimizimit të risqeve të portofolit të borxhit, dhe me një kosto të pranueshme.

Strategjia S3 paraqet gjithashtu avantazhe sa i takon nivelit të nevojave bruto për financim gjatë periudhës së strategjisë, ku ky nivel është ndjeshëm më i ulët krahasuar me Strategjinë S2, por më i ulët edhe nga strategjitë e tjera. Niveli i shërbimit të borxhit gjithashtu, si dhe ripagesat e principalit, në Strategjinë S3, janë më të ulëta krahasuar me të tre alternativat e tjera të strategjisë. Sa i takon nivelit të shpenzimeve për interesa, Strategjia S2 paraqet një avantazh jodomethënës, përkundrejt tre strategjive të tjera.

Një ndër objektivat kryesore të SAMB është reduktimi i riskut të rifinancimit kryesisht në portofolin e borxhit të brendshëm, pasi borxhi i jashtëm paraqet më pak risk duke qenë se është i përbërë nga instrumente me afat të gjatë maturimi dhe me profile amortizimi të shtrira gjatë në kohë. Gjatë vitit 2022, si rezultat i emetimit të shtuar të titujve afatshkurtër për qëllime të sigurimit të financimit të nevojshëm, treguesit e riskut të rifinancimit nuk kanë shfaqur përmirësim. Konkretisht, jetëgjatësia e borxhit të brendshëm është ulur me 13 ditë, nga 793 ditë në fund të vitit 2021 në 780 ditë në fund të vitit 2022. Gjithashtu, pesha e borxhit që maturohet brenda një viti është rritur nga 46.6% në dhjetor 2021 në 47.9% në dhjetor 2022. Këto janë tregues të cilët, në kushtet e rikthimit të kërkesës së investitorëve në kushte normale referuar SAMB 2022-2026, gjë e cila filloi që në pjesën e dytë të vitit 2022, do të vijojnë trendet e përmirësimit në përputhje me objektivat e përcaktuar në Strategjinë Afatmesme të Borxhit Publik (SAMB).

Të dhënat historike dhe treguesit për vitin 2022 sipas raportimit në Raportin e Borxhit Faktik për vitin 2022 paraqiten:

Ecuria e treguesve të riskut të rifinancimit (2018–2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Konstatohet se tendenca e borxhit që maturohet brenda 1 viti, për vitin 2022 rezulton të jetë rritur me 1,3% duke kaluar nga 46,6% në vitin 2021 në 47,9% në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një tavan prej 40%.

Gjithashtu konstatohet se edhe koha mesatare në maturim ka ardhur në ulje nga 2,20 vite në 2021 në 2,17 vite në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një kufi minimal 2,5 vite.

Për rrjedhojë tendenca faktike e vitit 2022 nuk ka shkuar në drejtimin e përmirësimit të arritjes së objektivit të strategjisë 2022-2026.

Tabela në vijim paraqet të dhënat historike së bashku me treguesit për vitin 2022 sipas raportimit në Raportin e Borxhit Faktik për vitin 2022:

Ecuria e treguesve të riskut të normës së interesit (2018–2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Konstatohet se tendenca e borxhit që rifiksohet brenda 1 viti, për vitin 2022 rezulton të jetë rritur me 1% duke kaluar nga 48% në vitin 2021 në 49% në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një tavan prej 43%.

Gjithashtu konstatohet se edhe koha mesatare në rifiksim ka ardhur në ulje nga 2,19 vite në 2021 në 2,17 vite në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një kufi minimal 2,5 vite.

Për rrjedhojë tendenca faktike e vitit 2022 nuk ka shkuar në drejtimin e përmirësimit të arritjes së objektivit të strategjisë 2022-2026, duke cënuar ekuilibrat me Ligjin e Buxhetit Vjetor, Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal të qeverisë, si edhe me politikat monetare që Banka e Shqipërisë planifikon të zbatojë në periudhën afatmesme.

Risku i normave të interesit gjithashtu nuk ka shfaqur përmirësim gjatë vitit, kjo në rrethanat e përdorimit rregullisht të instrumenteve afatshkurtër (bono thesari 3, 6 dhe 12 mujore). Konkretisht, pesha e titujve që rivlerësojnë normën e interesit brenda vitit është rritur nga 48.0% në 49.0%, ndërkohë që edhe koha mesatare në rifiksim është ulur nga 2.19 vite në 2.17 vite.

Ecuria e treguesit të riskut të kursit të këmbimit (2018–2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ndryshe nga treguesit e tjerë, risku i kursit të këmbimit gjatë 2022 ka hasur një përmirësim të ndjeshëm. Ky tregues ndër vite është mbajtur në nivele të qëndrueshme duke qëndruar nën tavanin e përcaktuar në strategjinë e borxhit (SAMB). Konkretisht, totali i stokut të borxhit në valutë ndaj stokut të borxhit total rezultoi 46.8% në fund të vitit 2022, duke u ulur me 3 p.p, krahasuar me fundin e vitit 2021. Gjatë vitit 2022 ky tregues është ndikuar pjesërisht edhe nga nënçmimi i pjesës më të madhe të valutave të huaja, kryesisht Euros, kundrejt Lekut, por gjithashtu është ndikuar nga një huamarrje e ulët nga burimet e jashtme, e cila në terma neto (diferenca ndërmjet huamarrjes së jashtme vjetore me borxhin e jashtëm të shlyer gjatë vitit) ka qenë në nivel negativ.

Treguesit e borxhit publik.

Raporti i borxhit publik ndaj PBB përgjatë vitit 2022 ka rezultuar në rënie në krahasim me një vit më parë, ku ky raport ka shënuar rënie nga 74.5% në 64.59% të PBB sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në treguesit e borxhit publik. Treguesit kryesorë të borxhit publik dhe ecuria e tij sipas raportimit të MFE, sipas stokut të raportuar për vitin 2022, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në milion lekë

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022 ²
Borxhi publik	1,043,229	1,066,611	1,088,169	1,107,285	1,112,626	1,224,470	1,382,940	1,378,623
Borxhi i qeverisë qendrore	1,042,272	1,065,710	1,087,342	1,106,569	1,112,044	1,224,038	1,382,625	1,378,421
Borxhi i pushtetit lokal	957	901	827	716	582	432	315	202
PBB¹	1,434,307	1,472,479	1,550,645	1,636,731	1,691,903	1,647,431	1,856,172	2,134,464
Stoku i borxhit / PBB (%)	72.73%	72.44%	70.18%	67.65%	65.76%	74.33%	74.50%	64.59%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Analiza e treguesve të borxhit)

IGDP e rivlerësuar sipas citimeve në buletin e borxhit mars 2023

2 Të dhëna të rishikuara në buletin mars 2023

Në raportin e buxhetit faktik për vitin 2022 të hartuar nga MFE është raportuar se stoku i borxhit publik ndaj PBB në nivelin e 64.6% në vitin 2022 nga 74.5% në vitin 2021. Rënia e treguesit të borxhit publik në raport me PBB ka ardhur kryesisht nga dy faktor si pasojë e rritjes së GDP-së si dhe rënies së nivelit të stokut të borxhit në vlera nominale. Niveli i borxhit ndaj PBB-së u ul me 9.9% krahasuar me fundin e 2021. Në terma nominalë, niveli i borxhit gjatë vitit 2022 është ulur me 4.3 miliardë lekë krahasuar me fundin e vitit 2021. Është llogaritur një efekt i kursit të këmbimit në portofolin e borxhit të shprehur në valutë prej rreth 31.7 miliardë lekësh, ose rreth 1.5% të PBB-së.

Në këtë mënyrë arrihet në konkluzion se ka rënie të borxhit publik në vlerë absolute me 4,317 milion lekë ose me rreth 0.3% më pak në krahasim me vitin 2021 duke përfshirë efektin e rivlerësimit të stokut të borxhit nga kursi i këmbimit ndërkohë që kemi edhe rritje të PBB në raport me një vit më parë, e cila vlerësohet në rreth 278,291 milion lekë ose rreth 15% më shumë. (Sqarojmë se GDP e rivlerësuar sipas burimeve të cituara në buletin e borxhit Mars 2023 (INSTAT dhe Drejtoria Makroekonomike).

Konstatohet se referuar Raportit mbi Zbatimin e Buxhetit Vjetor, Situatën Makroekonomike dhe Fiskale gjatë vitit 2022, sipas MFE-së (Maj 2023), në faqen nr. 7 është përcaktuar se: “Paragrafi 2.1.1 Sektori Real” konkretisht “Shifrat faktike të vitit 2022 për rritjen nominale të rritjes ekonomike ka sjellë një rishikim dhe të treguesve kryesorë të borxhit dhe të deficitit, ku për vitin 2022 treguesi i borxhit shënoi nivelin 64.6% të PBB, **nga 78.8% në vitin 2021 që ishte sipas parashikimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe treguesi i deficitit shënoi nivelin 3.7% nga 5.4% që ishte në parashikimet fillestare.**”

Rezultoni një diferencë për stokun e borxhit kundrejt PBB-së për vitin 2021 në vlerën 4.3% konkretisht, nga Analiza e treguesve të borxhit Mars 2023 stoku i borxhit kundrejt PBB-së për vitin 2021 paraqitet në masën 74.5% ndërsa në Raportin mbi Zbatimin e Buxhetit Vjetor, Situatën Makroekonomike dhe Fiskale gjatë vitit 2022, sipas MFE-së (Maj 2023), stoku i borxhit kundrejt PBB-së për vitin 2021 paraqitet në masën 78.8%.

Referuar Buletinit të Borxhit T4 2022 nga MFE, sipas tabelës 1.4. Stoku i borxhit të Qeverisë Qendrore, përfshirë borxhin e garantuar, kundrejt PBB-së, rezultoni se Stoku i borxhit publik ndaj PBB është në masën 67% me një diferencë prej 2.4% në krahasim me Raportin mbi Zbatimin e Buxhetit Vjetor, Situatën Makroekonomike dhe Fiskale gjatë vitit 2022, sipas MFE-së (Maj 2023) në masën 64.59%.

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Stoku i Borxhit Gjithsej	827.981	884.692	977.102	1.042.272	1.065.709	1.087.342	1.106.569	1.112.044	1.224.038	1.382.625	1.378.404
PBB ¹	1.332.811	1.350.053	1.395.305	1.434.307	1.472.479	1.550.645	1.636.731	1.691.903	1.644.077	1.889.839	2.058.155
Stoku i Borxhit Gjithsej/PBB	62,12%	65,53%	70,03%	72,67%	72,38%	70,12%	67,61%	65,73%	74,45%	73,16%	66,97%
Stoku i Borxhit të Brendshëm/PBB	35,29%	38,58%	40,47%	38,44%	38,11%	37,21%	35,46%	35,30%	39,18%	37,16%	35,60%
Stoku i Borxhit të Jashtëm/PBB	26,83%	26,95%	29,56%	34,23%	34,27%	32,91%	32,15%	30,42%	35,28%	36,00%	31,38%

Burimi:

Gjithashtu konstatohet se referuar “Buletinit të Borxhit T4 2022 nga MFE” stoku i borxhit kundrejt PBB-së për vitin 2021 paraqitet në masën 73.16% ndërsa në Raportin mbi Zbatimin e Buxhetit Vjetor, sipas MFE-së (Maj 2023), stoku i borxhit kundrejt PBB-së për vitin 2021 paraqitet në masën 78.8%.

Për sa më sipër nuk ka rakordim midis Buletinit të Borxhit T4 2022 dhe Raportit mbi Zbatimin e Buxhetit Vjetor 2023 në lidhje me treguesit e stokut të borxhit/PBB për vitin 2021, si dhe mungon një analizë mbi arsyet e diferencave.

Diferenca ndërmjet huamarrjes së paraqitur në tabelën e “Analiza e treguesve të borxhit Mars 2023” me diferencën e stokut të borxhit publik në krahasim me një vit më parë konstatohet se vjen si pasojë e efektit favorizues të kursit të këmbimit në vlerësimin e stokut edhe për këtë vit. Stoku i rivlerësuar i borxhit sipas kursit të këmbimit të ndryshuar në krahasim me një vit më parë për secilin komponent të borxhit publik dhe monedhës përkatëse origjinale paraqitet:

Instrumenti	Monedha	2021		2022*		Efekti kursit të këmbimit
		Njësi monedhë origjinale	Milion Lekë	Njësi monedhë origjinale	Milion Lekë	
Bono Thesari*	ALL	202,111,781,962	202,112	240,489,524,584	240,490	-
Garanci të brendshme	ALL	10,038,352,053	10,038	7,365,043,344	7,365	-
	EUR	110,436,450	13,336	109,511,222	12,509	-716.67
Obligacione	ALL	464,693,100,000	464,693	464,393,000,000	464,393	-
	EUR	100,000,000	12,076	69,131,000	7,897	-411.80
Kredi shtetërore	ACU	32,616,150	4,863	27,504,454	3,919	-184.93
	AED	188,541,911	5,471	153,237,911	4,467	130.97
	EUR	3,683,394,066	444,807	3,750,939,676	428,470	-24,516.49
	JPY	7,359,563,734	6,813	6,909,424,893	5,606	-831.10
	KËD	19,655,773	6,925	21,902,940	7,676	-35.80
	SAR	99,093,326	2,811	93,173,176	2,654	23.92
	SDR	725,583,377	108,192	638,636,997	90,987	-3,935.40
	USD	647,336,243	68,967	650,574,441	69,644	348.49
Garanci të huaja	EUR	239,051,559	28,868	264,504,227	30,214	-1,808.96
	JPY	1,043,535,000	966	809,613,000	657	-109.57
	KRË	18,839,470,000	1,688	17,390,280,000	1,475	-84.69
Pushteti lokal	ALL	314,876,805	315	201,617,047	202	-
Totali milion ALL			1,382,940		1,378,623	-32,132

Burimi: Ministria e Financave.

*përfshihet letra me vlere 6 mujore për rivlerësimin valutor

Ky efekt, duke marrë në konsideratë vetëm tepicën e huasë së rivlerësuar në raport me një vit më parë për njësi të monedhës së huaj (pa efektin e disbursimeve apo pagesave të principalit) vlerësohet në rreth 32,132 milion lekë dhe ndikimin më të madh e ka nga borxhi në monedhën EURO dhe SDR, kursi i këmbimit të cilave ka ardhur në ulje në krahasim me lekun. Kompozimi i borxhit shtetëror i klasifikuar në të brendshëm dhe të jashtëm dhe i garantuar ose jo paraqitet në milion lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Në Milion Lekë

Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022 ¹
Stoku i borxhit të brendshëm	577,056	580,311	597,290	644,088	702,256	732,654
Stoku i brendshëm shtetëror*	546,939	565,093	582,136	630,791	678,881	712,779
Stoku i brendshëm i garantuar	30,117	15,218	15,154	13,297	23,375	19,875
Stoku i borxhit të jashtëm	510,286	526,258	514,754	579,950	680,369	645,768
Stoku i jashtëm shtetëror	490,518	496,804	488,056	544,434	648,848	613,421
Stoku i jashtëm i garantuar	19,768	29,454	26,698	35,516	31,521	32,346
Stoku i borxhit të qeverisjes gendrore	1,087,342	1,106,569	1,112,044	1,224,038	1,382,625	1,378,421

Burimi: Ministria e Financave.

¹ Të dhëna të rishikuara në buletin mars 2023

*përfshihet rivlerësimi valutës

Rënia në stokun e borxhit të qeverisjes qendrore i atribuohet kryesisht rënies së stokut të borxhit të jashtëm në rreth 34,602 milion lekë, e ndikuar nga huamarrja e huaj e cila është ulur për shkak se gjatë vitit 2022 nuk u emetua Eurobond, niveli i mbështetjes buxhetore ishte më e ulët se vitin e kaluar dhe gjithashtu vlera e kredive të disbursuara për financimin e projekteve është më e ulët se në vitin 2021.

Për sa i përket kompozimit të portofolit të borxhit publik sipas instrumenteve, më shumë se 60% të peshës vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme (bono thesari, obligacione, eurobond). Pesha e instrumenteve të tregtueshme vlerësohet të jetë në rritje nga viti në vit kryesisht për shkak të emetimeve më të shpeshta në tregjet ndërkombëtare, por edhe për shkak të rritjes së huamarrjes në tregun e brendshëm bazuar në rritjen e nevojave për financim gjatë viteve të fundit duke filluar nga viti 2020.

Borxhi i brendshëm.

Borxhi i brendshëm shtetëror.

Sipas regjistrimit të borxhit në fund të vitit 2021 dhe fund të vitit 2022, kryqëzuar me rezultatet e ankandeve të shpallura në raportimet e MFE konstatohet se titujt e emetuar janë të ndarë me afate maturimi:

- *Bono thesari, sipas afateve të maturimit: 3, 6 dhe 12 mujore;*
- *Obligacione sipas afateve të maturimit: 2, 7, 10 dhe 15 vjeçar;*
- *Obligacione reference (Benchmark) me afat maturimi 3 dhe 5 vjeçar.*

Nga auditimi konstatohet se janë emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 357.86 miliard lekë me çmim blerje/pastër në total, nga të cilat 245.53 miliard lekë bono thesari dhe 112.33 miliard lekë obligacione. Nga analiza konstatohet se instrumentet e emetuar janë të gjitha në monedhë kombëtare dhe nuk kemi instrumente të emetuar në monedhë të huaj. Sipas raportimit në treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar, 26.31 miliard lekë të kësaj huamarrje janë përdorur për financimin e deficitit, ndërkohë që pjesa tjetër është përdorur për rifinancimin e titujve të maturuar sipas instrumenteve të brendshëm.

Borxhi i ri është huazuar plotësisht nëpërmjet titujve afatshkurtër (32,36 miliard lekë nga 26.31 miliard lekë huamarrje neto). Nga analiza vërehet një reduktim i huamarrjes afatgjatë në vlerën 6.05 miliard lekë. Kjo strategji nuk është plotësisht në linjë me objektivat strategjike afatmesëm për reduktimin e riskut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit në lidhje me afatin e maturimit, ku citohet “SAMB 2021-2023, në periudhën afatshkurtër do të ketë në fokus plotësimin e nevojave për huamarrje në kuadër të rimëkëmbjes së ekonomisë pas situatës së krijuar nga tërmeti i muajit nëntor 2019 dhe pandemisë Covid-19, ndërkohë në periudhën afatmesme do të synojë përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit (kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm), në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si edhe mbajtjes nën kontroll të kostos. Në këtë drejtim, prioritet do të mbetet zgjatja e jetëgjatësisë së borxhit nëpërmjet uljes së mëtejshme të përqendrimit të titujve afatshkurtër në portofol”.

Maturimet përgjatë vitit 2022 paraqiten në shumën 331.55 miliard lekë në total me çmim blerje, nga të cilat 213.17 miliard lekë për bonot e thesarit dhe 118.38 miliard lekë për obligacionet. Procedura e planifikimit, zhvillimit dhe raportimit të ankandeve të bonove të thesarit dhe obligacioneve është zhvilluar në Bankën e Shqipërisë, si autoriteti përkatës i mandatuar për emetimin këtyre instrumenteve për llogari të shtetit shqiptar. Emetimet dhe maturimet përgjatë vitit 2022 të instrumenteve të borxhit të brendshëm paraqiten si më poshtë:

Instrumentet e tregut të brendshëm	Viti 2022		Huamarrja neto (në mld lekë)	Huamarrja neto (në%)
	Emetim(në mld lekë)	Maturim(në mld lekë)		
Tituj afatshkurtër	245.53	213.17	32.36	123%
Bono thesari në lekë	245.53	213.17	32.36	123%

<i>Nga e cila Bono thesari 12-mujor</i>	225.68	196.75	28.93	
Tituj afatgjatë	112.33	118.38	-6.05	-23%
Obligacione 2-vjeçar lekë	42.31	44.24	-1.94	-7%
Obligacione 2-vjeçar euro	8.36	12.13	-3.77	-14%
Obligacione 3-vjeçar	19.31	22.20	-2.89	-11%
Obligacione 5-vjeçar	15.07	28.42	-13.35	-51%
Obligacione 7-vjeçar	12.26	11.38	0.88	3%
Obligacione 10-vjeçar	9.89	-	9.89	38%
Obligacione 15-vjeçar	5.13	-	5.13	19%
TOTALI	357.86	331.55	26.31	100%

Burimi: Ministria e Financave.

Stoku i borxhit të brendshëm dominohet kryesisht nga instrumentet afatgjatë të obligacioneve me një vlerë stoku në fund të vitit 2022 në shumën 472,290 milion lekë, përkundrejt 240,490 milionë lekë të stokut të instrumenteve afatshkurtër. Të krahasuara në raport me të njëjtën periudhë të vitit më parë, stoku i instrumenteve të tregut të brendshëm paraqitet si më poshtë:

Në milion lekë

Instrumenti	2021	2022*	Ndryshimi
Bono thesari	202,112	240,490	38,378
3 mujore	2,644	2,978	334
6 mujore*	2,717	11,829	9,112
12 mujore	196,750	225,682	28,932
Obligacione	476,769	472,290	-4,479
2 vjeçare	89,856	88,306	-1,550
<i>2 vjeçare euro</i>	<i>12,076</i>	<i>7,897</i>	<i>-4,179</i>
3 vjeçare	59,858	57,376	-2,483
5 vjeçare	117,754	105,003	-12,751
7 vjeçare	84,728	85,931	1,203
10 vjeçare	111,347	121,392	10,045
15 vjeçare	1,150	6,385	5,235
Total instrumenteve	678,881	712,779	33,898

Burimi: Ministria e Financave.

Stoku i borxhit për vitin 2022 është rritur me 33,898 milion lekë ose rreth 5%, duke kaluar nga 678,881 milion lekë në vitin 2021 në 712,779 milion lekë në vitin 2022. Në lidhje me instrumentet afatshkurtër konstatohet se është rritur pesha specifike e bonove të thesarit 3 mujore, 6 mujore (ku përfshihet emetimi i letrave me vlerë 6 mujore për rivlerësimin e valutës) dhe 12 mujore dhe financimi i nevojave buxhetore me anë të instrumenteve afatshkurtër, me një efekt neto në instrumente afatshkurtër në 38,378 milion lekë ose rreth 19% e totalit të stokut të bonove të thesarit, duke kaluar nga 202,112 milion lekë në vitin 2021 në 240,490 milion lekë në vitin 2022. Konstatohet një rënie e stokut të borxhit afatgjatë prej 4,479 milion lekë ose rreth 1% të totalit të stokut afatgjatë, nga 476,769 milion lekë në fund të vitit 2021 në 472,290 milion lekë në fund të vitit 2022.

Tendenca përgjatë vitit 2022, nuk ka shkuar në drejtim të rikompozimit të portofolit me instrumente më afatgjatë duke mos qenë në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm për rritjen e maturitetit të portofolit të borxhit.

Emetimi i bonove të thesarit për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit të BSH.

Në bazë të Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 6 të marrëveshjes “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë”, në rastet kur pasqyra financiare e Bankës së Shqipërisë rezulton me humbje mbulimi i humbjes nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit kryhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Banka e Shqipërisë me shkresë nr. 2628/1, datë 06.12.2022 ka vendosur në dijeni MFE për kërkesën për rinovimin e titujve shtetërorë për mbulimin e vlerës negative të llogarisë “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave” se në datën 22.12.2022 maturohet titulli 6-mujor i emetuar për këtë qëllim.

Për sa më sipër në zbatim të shkronjës b të nenit 64 të Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 6 të marrëveshjes “Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë” MFE duhet që në datën e maturimit të kryejë rinovimin e emetimit me çmim blerje 6,019,805,285 lekë që i korrespondon vlerës së llogarisë “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave”.

Me shkresën nr. 12142/2, datë 21.12.2022, MFE i drejtohet BSH. ku e njofton se MFE do të rinovojë emetimin letra me vlerën në shumën 6,019,805,285 lekë, me datë emetimi 22.12.2022 dhe me afat maturimi 6 mujor.

Borxhi i brendshëm i garantuar.

Në fund të vitit 2022 borxhi i brendshëm i garantuar ka pasur rënie me 3,500 milion lekë duke kaluar nga niveli i 23,375 milion lekë në fund të vitit 2021 në 19,875 milion lekë në fund të vitit 2022 të detajuar në tabelën e mëposhtme.

Huamarrësi	Huadhënësi	2021		2022		Diferenca
		Milion/Euro	Milion/Lekë	Milion/Euro	Milion/Lekë	
FSHU	R. Bank	14.99	1.810	15.00	1.713	-97
OSSH / OSHEE, FTL	R. Bank	16.49	1.991	16.50	1.885	-106
FSHU / OSHEE	O.	20.00	2.415	19.99	2.284	-132
FSHU / OSHEE	I. Bank	20.00	2.415	20.00	2.284	-130
FSHU / OSHEE	ABI	10.00	1.207	9.99	1.141	-66
KESH	IS. ¹	9.36	1.130	8.42	962	-168
KESH	R. Bank		500		500	0
KESH	R. Bank	19.61	2.368	19.61	2.240	-128
GS1	S B.		1,397		25	-1,372
GS2	S. B...r		8,141		6,473	-1,669
GS3	B.../O.../C.../R....				368	368
Totali milion Lekë			23,375		19,875	-3,500

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Ulja e stokut të garancive të brendshme konstatohet se vjen kryesisht nga efekti rezultat i dy garancive sovrane, konkretisht: **Garancia Sovrane Nr.1** dhe **Garancia Sovrane Nr.2: stoku i të cilës është zvogëluar si rezultat i pagesave të bëra nga bizneset përfituese, si dhe nuk ka pasur disbursime të reja gjate vitit 2022.** Garancitë e brendshme përfshijnë masa emergjence të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, të detajuar si në vijim:

- Marrëveshje Garancie Nr. 30286/1, datë 14.12.2021 për kontratën e kredisë ndërmjet R. Bank dhe FSHU, OSHEE, FTL dhe OSSH 15 mln Euro;
- Marrëveshje Garancie Nr. 30286/2, datë 14.12.2021 për kontratën e kredisë ndërmjet R. Bank dhe OSSH, OSHEE, FTL dhe FSHU 16,5 mln Euro;
- Marrëveshje Garancie Nr. 3642/1, datë 19.11.2021 për kontratën e kredisë ndërmjet O. Bank dhe FSHU/OSHEE 20 mln euro;
- Marrëveshje Garancie Nr. 21/58243, datë 14.12.2021 për kontratën e kredisë ndërmjet I. Bank dhe FSHU/OSHEE 20 mln euro;
- Marrëveshje Garancie Nr. 18877, datë 19.11.2021 për kontratën e kredisë ndërmjet A. Bank dhe FSHU/OSHEE vlera 10 mln euro;
- Marrëveshje Garancie Nr. 2916/2, datë 16.02.2021 në favor të I. Bank për rifinancimin e kredive afatshkurtra, vlera 10,296 euro.
- VKM nr. 349, date 26.05.2022 mbi garantimin e huamarrjes së subjekteve që tregtojnë produkte ushqimore bazë

Borxhi i jashtëm.

Mbi Raportin e Disbursimeve.

Përgjatë vitit 2022 janë regjistruar në sistemin e brendshëm të menaxhimit të borxhit transaksionet e disbursimit për 40 kredi me një total në monedhë kombëtare në shumën 35,944,698,236.74 lekë nga të cilat 3 kredi janë evidentuar si garanci që kanë pasur

disbursime gjatë vitit në shumën 7,671,061,271.03 lekë. Pjesa tjetër prej 37 projektsh përfshin një shumë të disbursuara prej 28,273,636,965.71 lekë. Nga këto 37 projekte 4 prej tyre projektet që janë klasifikuar si mbështetje buxhetore në shumën 17,116,895,000.00 lekë që kanë pasur këtë trajtim duke qenë se janë transferuar drejtpërsëdrejti në llogarinë e unifikuar të thesarit në monedhën të huaj dhe jo në llogarinë speciale në Bankën e Shqipërisë për projektin përkatës. Konkretisht projektet për të cilat është klasifikuar shuma e disbursuar si mbështetje buxhetore në monedhë origjinale dhe monedhë kombëtare paraqiten:

Në lekë

ID Kredia	Shuma në euro	Shuma në lekë
21/11/AFD	50 000 000,00	5 968 500 000,00
21/12/AFD	25 000 000,00	2 930 250 000,00
21/08/CEB	60 000 000,00	7 313 100 000,00
18/04/IBRD	8 000 000,00	905 045 000,00
Totali	143 000 000,00	17 116 895 000,00

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Regjistrimi i transaksioneve të disbursimit vlerësohet të jetë kryer në mënyrë të rregullt duke pasur parasysh vlerën e raportuar në ditë të caktuara në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë. Projektet specifike të cilat janë financuara përgjatë vitit 2022 janë në shumën 35,944,698,236 lekë, duke përfshirë edhe mbështetjen buxhetore sipas disbursimeve të kredive respektive, kryesisht nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë.

Përgjatë vitit 2022 janë nënshkruar 8 marrëveshje huaje në kuadër të huamarrjes së jashtme, për financim të projekteve, kredi të garantuara apo mbështetje buxhetore, shuma dhe kreditorë sipas tabelës në vijim:

Loan ID	Kreditor i	Projekti	Data e nënshkrimit	Monedha	Shuma /000	Njësia Zbatuese
Kredi shtetërore						
22/01/IBRD	IBRD	Përmirësimi i Sistemit Shëndetësor Financim shtesë	29/04/2022	EUR	25 000	Ministria e Shëndetësisë
22/02/IBRD	IBRD	Zhvillimi i integruar urban dhe turizmit. Financim shtesë	29/07/2022	EUR	30 000	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
22/03/SAUDIA RAB	Saudi Arabia	Rruga Tiranë-Elbasan-Qukës-Qafë Ploçë. Financim Shtesë	10/08/2022	SAR	183 750	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
22/04/IDB	IDB	Qukës -Qafë Ploçë. Financim shtesë	04/07/2022	USD	56 800	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
22/05/IBRD	IBRD	Modernizimi i sektorit të ujësjellës kanalizimeve	15/12/2022	EUR	67 300	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AKUM)
22/06/KFË	KfË	Mbështetja e manaxhimit të mbetjeve të ngurta	29/12/2022	EUR	50 000	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AKUM)
22/07/KFË	KfË	Zhvillimi i Integruar rajonal	29/12/2022	EUR	20 000	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
22/08/AFD	AFD	Furnizimi me ujë i Durrësit	15/11/2022	EUR	60 000	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AKUM)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Mbi Pagesat e Principalit.

Në sistemin e brendshëm të regjistrimit të transaksioneve të borxhit janë evidentuar shlyerje principali në shumën 38,394,095,697.09 lekë, duke përfshirë edhe pagesat e kryera për përfituesit e garancive. Të dhënat e detajuara në lidhje me pagesat e principalit të kryera për kreditë shtetërore dhe garancitë, të kryera nga Buxheti i Shtetit dhe përfituesit përkatës paraqiten:

Në lekë

Principalit i Shlyer	Principalit i shlyer/Lek		Totali
	Buxheti i Shtetit	Njësia Përfituese	
Kredi Shtetërore	34,587,222,154	53,115,167	34,640,337,321
Garanci Shtetërore	3,706,981,942	46,776,433	3,753,758,375
Totali	38,294,204,097	99,891,600	38,394,095,697

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Nga testet e zhvilluara në lidhje me pasqyrimin e transaksioneve të shlyerjes të principalit në llogarinë e unifikuar të thesarit të marrë nga strukturat e thesarit nuk rezultuan me diferenca të tjera. Përgjatë vitit 2022 kreditë shtetërore dhe garancitë për të cilat është paguar më

shumë janë nga Projekti “Rruga Rrëshen-Kalimash”, Plani i ristrukturimit të KESH dhe Rruga Tiranë–Elbasan.

Borxhi i Jashtëm i Garantuar.

Përgjatë vitit 2022 borxhi i jashtëm i garantuar paraqitet në rritje me 825 milion lekë sipas raportimeve në regjistrin e borxhit në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë nga 31,521 milion lekë në 32,346 milion lekë në fund të vitit 2022. Ndryshimet në kreditë e jashtme të garantuara sipas viteve paraqiten sipas tabelës së mëposhtme në milion lekë:

Në milion lekë

Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Stoku i jashtëm i garantuar	19,768	29,454	26,698	35,516	31,521	32,346

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Buxheti i Shtetit për vitin 2022, ka paguar principal 3,753.76 milion lek për rastet e garancive të huaja kur përfituesit e garancive kanë dështuar të përmbushin detyrimet e tyre. E njëjta situatë paraqitet edhe për shpenzimet e interesit, ku Buxheti i Shtetit ka paguar 354.98 milion lekë shpenzime interesi. Shuma e paguar nga vetë njësitë përfituese të garancive gjatë vitit 2022 është 1,135.88 milion lekë për principalin dhe 154.22 milion lekë për interesat, duke vazhduar tendencën e akumulimit të detyrimeve ndaj buxhetit si në vitet e kaluara.

Në milion lekë

	Principali i Shlyer	Interes i Shlyer	Totali
Buxheti i Shtetit	3 753,76	354,98	4 108,74
Njësia Përfituese	1 135,88	154,22	1 290,10
Totali	4 889,64	509,20	5 398,84

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi është konstatuar se pagesat e kryera nga Buxheti i Shtetit për garancitë e huaja jo performuese nuk kryhen në përputhje me kërkesat e nenit 42 të Ligjit Nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në të cilën citohet se: “Kur huamarrësi s’ka mundur të bëjë pagesën/pagesat, në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huasë, të përcaktuara për këtë qëllim dhe institucioni huadhënës vërteton se ka marrë të gjitha masat e nevojshme, siç përcaktohet në këtë ligj dhe në marrëveshjen e garancisë, për të marrë në dorëzim pagesën/pagesat e premtuara, institucioni huadhënës i paraqet Ministrin të Financave një kërkesë për pagesë, në përmbushje të së drejtës së tij, sipas garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave, pasi vëren se kërkesa për pagesë është në përputhje me kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për institucionin huadhënës brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës”.

Aktualisht konstatohet se procesi konsiston në komunikim paraprak nga MFE me përfituesin e garancisë i cili konfirmon nëse është apo jo në gjendje që të shlyejë këstin e radhës dhe në rast paaftësie nga ana e tij procedohet me pagesën nga Buxheti i Shtetit.

Mbi Shërbimin e Borxhit.

Shpenzimet për interesa përgjatë vitit 2022, kanë rezultuar në një rritje në krahasim me vitin e kaluar duke shënuar vlerën prej 39,820.37 milion lekë, përkundrajt 36,378.05 milion lekë që rezultuan një vit më parë, pra kemi një rritje prej 3,442.31 milion lekë në total. Raportimet mbi shpenzimet për interesa për borxhin e brendshëm dhe interesa për borxhin e huaja paraqiten në milion lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Në milion lekë

Shpenzimet e interesit	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Interesat e borxhit të brendshëm	21,414.59	23,157.97	22,837.89	22,350.91	23,470.40	24,210.32
Interesat e borxhit të jashtëm	10,489.19	13,355.40	12,304.93	12,042.49	12,907.66	15,610.05
Interesat e borxhit gjithsej	31,903.78	36,513.37	35,142.82	34,393.40	36,378.05	39,820.37

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Rritja më e madhe në interesat e borxhit konstatohet në interesat e borxhit të jashtëm me rreth 2,702.39 milion lekë, përkundrejt 739.92 milion lekë interesa të paguara për borxhin e brendshëm.

Interesat e Borxhit të Brendshëm.

Shpenzimet e interesit të borxhit të brendshëm kanë ardhur në rritje në krahasim me një vit më parë, ku interesat për vitin 2022 vlerësohen në shumën 24,210.32 milion lekë përkundrejt 23,470.40 milion lekë në vitin 2021. Pjesa më e madhe e interesave për shërbimin e borxhit të brendshëm është e akumuluar në drejtim *të interesave për kuponat e obligacioneve*. Në vijim janë paraqitur të dhënat mbi interesat e paguara përgjatë vitit 2022 sipas instrumenteve të borxhit të brendshëm në lekë:

Në milion lekë

Viti	2021	2022
Interesa Borxhi i Brendshëm	23,470.40	24,210.32
Interesa Bono Thesari	3,733.82	3,566.26
Interesa bono thesari 3/mujor te emetuara ne tregun financiar	30.19	34.16
Interesa bono thesari 6/mujor te emetuara ne tregun financiar	39.65	40.20
Interesa bono thesari një vjeçar te emetuara ne tregun financiar	3,663.97	3,491.90
Interesa Obligacione	19,645.00	20,626.79
Interesa obligacione ne tregun financiar me afat maturimi mbi 15 vjet		176.19
Interesa obligacione ne tregun financiar me afat maturimi 6 deri 10 vjet	11,026.83	11,501.08
Interesa obligacione ne tregun financiar me afat maturimi nga 1 deri 5 vjet	8,618.17	8,949.51
Interesa Garancia Sovrane	91.57	17.27
Interesa për Garancinë Sovrane 1	91.57	17.27

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Interesat e bonove të thesarit 3 mujore paraqiten në vlerën 34.16 milion lekë duke qenë se gjatë vitit janë emetuar më shumë bono të tilla kurse vitin e kaluar kanë qenë në vlerën 30.19 milion lekë. Interesat e bonove të thesarit 6 mujore paraqiten në rritje me rreth 0.54 milion lekë në raport me një vit më parë, duke qenë se janë kryer më shumë emetime të këtij instrumenti përgjatë vitit në raport me një vit më parë.

Edhe kuponët e obligacioneve paraqiten jo në të njëjtat nivele me një vit më parë, përkatësisht me një ndryshim ndërmjet maturiteteve përkatëse, ku interesi i paguar për obligacionet me maturitet 1-5 vjet paraqitet në rritje me rreth 331.34 milion lekë si edhe interesi i paguar për obligacionet me maturitet 6-10 vjet paraqiten me rritje me rreth 474.25 milion lekë.

Konstatohet se në ndryshim nga viti 2021 paraqiten pagesa për obligacionet me afat maturimi mbi 15 vjet në shumën 176.19 milion lekë.

Interesat e Borxhit të Jashtëm.

Shpenzimet e interesit të borxhit të jashtëm kanë ardhur në rritje në krahasim me një vit më parë ku shpenzimet e interesit të borxhit të jashtëm për vitin 2022 vlerësohen në shumën 15,610.05 milion lekë përkundrejt 12,907.66 milion lekë të deklaruara në vitin 2021. Në vijim janë paraqitur të dhënat mbi interesat e paguara përgjatë vitit 2021 dhe 2022 sipas llojit të huamarrjes në lekë.

Në milion lekë

Viti	2020	2021*	2022
Interesa Borxhi i Jashtëm Deklaruar	12 396,00	12 907,66	15 610,05
Interesa Borxhi i Jashtëm	11 440,00	11 702,55	14 827,22
Interesa huamarrje afatgjate nga institucionet ndërkombëtare	5 650,52	5 054,66	5 589,28
Interesa huamarrje afatgjate nga qeveri te huaja	1 175,19	1 085,99	1 206,65
Interesa huamarrje afatgjate për huamarrje te tjera te jashtme	4 614,01	5 561,90	8 031,29
Komisione Huamarrje e Jashtme	956,00	1 205,11	782,83
Komisione te huamarrjes se jashtme	956,42	1 205,11	782,83

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

*rishikuar komisionet

Rritja në shërbimin e borxhit i atribuohet rritjes së interesave të huamarrjes së jashtme në krahasim me vitin e kaluar me rreth 3,124.67 milion lekë. Ku më konkretisht kemi rritjen me

2,469.39 milion lekë të “Interesa të huamarrjes afatgjatë për huamarrje të tjera të jashtëme”, me 534,62 milion lekë të “Interesave të huamarrjes afatgjatë nga institucionet ndërkombëtare” dhe me 120.66 milion lekë të “Interesave të huamarrjes afatgjatë nga qeveri të huaja”.

Konstatohet se është rritur ekspozimi ndaj riskut të normave të interesit duke qenë se kemi emetime të instrumenteve (eurobond) në tregjet ndërkombëtare nga vitet e kaluara si dhe efekte nga ndryshimi i normave bazë të interesit në tregjet ndërkombëtare për huatë të cilat janë me norma të ndryshueshme interesi, ku në kushtet e pritshmërive për rritjen e normave nga autoritet monetare ndërkombëtare ekspozojnë buxhetin e shtetit në pagesa të rritura aktuale dhe të pritshme për shpenzime interesi për shërbimin e borxhit të jashtëm.

Mbi regjistrimin dhe arkëtimin e të drejtave të lindura nga marrëdhënia e nënhuasë, garancive dhe huave nga buxheti.

Të drejtat për të arkëtuar nga marrëdhëniet e nënhuasë.

KLSH ka konstatuar krijim të detyrimeve të reja në shumën **3,404 milionë lekë** të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë përgjatë vitit 2022, si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve përkatëse. Nga auditimi në lidhje me marrëveshjet e nënhuasë konstatohet se stoku i kredive në lidhje me këtë komponent të borxhit shtetëror është përkeqësuar përgjatë vitit 2022. Në këtë mënyrë të dhënat në lidhje me të drejtat e shtetit për të arkëtuar përkundrejt marrëveshjeve përkatëse tregojnë rritje të së drejtës për të arkëtuar dhe për vitet e fundit paraqiten:

Në Lekë

Sektori/Institucioni	Detyrimi fund 2018	Detyrimi fund 2019	Detyrimi fund 2020	Detyrimi fund 2021	Detyrimi fund 2022
Energjia	12,688,764,872	16,980,772,829	22,772,169,156.00	27,128,734,793	28,778,860,247
<i>KESH</i>	<i>6,932,415,130</i>	<i>8,649,361,190</i>	<i>12,887,266,141.80</i>	<i>15,286,928,519.72</i>	<i>17,429,281,567</i>
<i>OSHEE</i>	<i>1,510,620,353</i>	<i>2,583,655,499</i>	<i>2,593,797,377</i>	<i>2,640,445,990.15</i>	<i>2,687,239,704</i>
<i>OST</i>	<i>4,245,729,389</i>	<i>5,747,756,140</i>	<i>7,291,105,637</i>	<i>9,201,360,283.46</i>	<i>8,662,338,976</i>
Ujësjiellës	5,981,938,063	6,409,007,664	7,177,075,469	7,991,844,828	8,599,808,111
<i>Ujësjiellesi Durres</i>	<i>1,156,396,669</i>	<i>1,339,229,523</i>	<i>1,467,625,951</i>	<i>1,686,424,196</i>	<i>1,824,320,619</i>
<i>Ujësjiellesi Korce</i>	<i>977,275,071</i>	<i>1,284,074,366</i>	<i>1,634,770,700</i>	<i>1,907,687,217</i>	<i>2,119,219,634</i>
<i>Ujësjiellesi Vlore</i>	<i>1,847,464,146</i>	<i>1,965,131,665</i>	<i>2,052,373,975</i>	<i>2,055,067,587</i>	<i>1,998,204,242</i>
<i>Te tjere ujësjielles</i>	<i>2,000,802,177</i>	<i>1,820,572,110</i>	<i>2,022,304,843</i>	<i>2,342,665,828</i>	<i>2,658,063,616</i>
Bashki	2,571,631,379	3,877,431,361	5,050,189,246	6,372,067,193	7,499,711,329
<i>Bashkia Tirane</i>	<i>2,533,853,418</i>	<i>3,825,880,230</i>	<i>4,994,602,981</i>	<i>6,314,169,682</i>	<i>7,418,298,901</i>
<i>Te tjera bashki</i>	<i>37,777,961</i>	<i>51,551,131</i>	<i>55,586,265,20</i>	<i>57,897,511</i>	<i>81,412,428</i>
Mikrokredi	31,270,041	70,269,933	87,028,161	104,079,093	121,432,799
<i>FAF</i>	<i>310,382</i>	<i>-</i>	<i>-</i>	<i>-</i>	<i>0</i>
<i>U....i Kursim Kredi</i>	<i>30,959,658</i>	<i>70,269,933</i>	<i>87,028,161</i>	<i>104,079,093</i>	<i>121,432,799</i>
Armo	5,363,783	6,456,933	7,742,595	8,713,772	9,335,313
TOTALI	21,278,968,137	27,343,938,720	35,094,204,628	41,605,439,680	45,009,147,798

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Sektorët me përkeqësim të situatës financiare paraqiten sektori i energjetikës kryesisht me nënhuatë e KESH, OSHEE dhe OST me rreth 1,650 milion lekë të rritjes totale të detyrimeve nga 3,404 milion lekë në total, pushteti vendor me rreth 1,128 milion lekë, sektori i ujësjiellësve me rreth 608 milion lekë, Institucionet e Mikrokredisë me nënhuatë, U....i i Kursim Kredisë me 17 milion lekë, dhe ARMO me 0.62 milion lekë. Në nenin 30 “Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror, mbi të cilat zbatohen kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të Ligjit Nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është përcaktuar që “...është përgjegjësi ligjore e huamarrësve, të cilët kanë marrë fonde, sipas paragrafit të parë të këtij neni, që ti kthejnë fondet e marra hua në përputhje me marrëveshjet e nënhuave dhe të paraqesin raporte për gjendjen e huasë dhe përdorimin e saj, sipas kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Financave”.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet të Ligjit Nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar duke paraqitur një situatë ku detyrimet ndaj shtetit si pasojë e mos pagesave janë rritur me 3,404 milion lekë, me një trend rritës nga viti në vit. Krahasuar nga stoku i detyrimeve të vitit 2018 në vlerën 21,279 milion lekë në fund të vitit 2022 stoku i detyrimeve paraqitet në vlerën 45,009 milion lekë ose me një rritje totale për periudhën 5 vjeçare (2018-2022) në masën 112%.

Niveli i kthimeve nga nënhuatë, vlerësohet i ulët përse i përket detyrimit për të përmbushur kushtet e marrëveshjeve përkatëse. Nga 103 projekte për të cilat Buxheti i Shtetit ka të drejta për të arkëtuar, përgjatë vitit 2022 janë arkëtuar vetëm për 27 prej tyre në shuma të vogla, më konkretisht vlera totale e kthimeve nga nënhuatë është në shumën 3,242,121,387 lekë, nga të cilat interesi i paguar për 2022 në shumën 1,190,989,560 lekë, komisioni i paguar për 2022 në shumën 11,656,254 lekë si dhe principali i paguar në shumën 2,039,475,574lekë.

Të drejtat për të arkëtuar nga marrëdhëniet e garancisë.

Garancitë shtetërore përgjatë vitit 2022 paraqesin një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre dhe situatës së rënduar financiare të cilën kalon kryesisht sektori energjistik. *Për vitin 2022 gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është rritur nga 17,415 milion lekë në 19,654 milion lekë, me një rritje vjetore prej 2,239 milion lekë.* Referuar institucioneve dhe projekteve specifike me problematikat më të mëdha konstatohet sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

Institucioni/projekti	Detyrimet 31.12.2018	Detyrimet 31.12.2019	Detyrimet 31.12.2020	Detyrimet 31.12.2021	Detyrimet 31.12.2022
Ministria e Energjisë dhe Industrisë (KESH, OST)	9 025 642	10 870 489	12 968 270	14 040 954	15 982 039
<i>Elektrifikimi i Zonave Rurale</i>	658 915	828 829	1 002 646	1 141 750,31	1 243 409,29
<i>Linja e Transmetimit 400 KV Tiranë-Podgoricë I</i>	27 660	37 586	52 912	63 834	69 860
<i>Linja e Transmetimit 400 KV Tiranë-Podgoricë II</i>	650 661	960 796	976 024	952 827	901 303
<i>TEC-i Vlorë</i>	4 465 018	5 222 945	5 879 703	6 277 091	6 305 168
<i>Transmetim, Shpërndarje e Energjisë</i>	1 815 979	2 321 047	2 818 323	3 119 622	3 123 957
<i>Hidrocentrali mbi Lumin Drin</i>	371 759	477 481	560 467	616 463	614 230
<i>Nënstacioni i Transmetimit të Energjisë</i>	1 034 998	1 021 161	1 037 346	1 012 691	957 931
<i>Plani i rristurimit të KESH</i>	0	0	640 850	625 619	2 766 180
<i>Projekti i efikasitetit në energji</i>	652	644	0	231 056	0
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës/UKT	1 285 030	1 390 135	1 536 390	1 621 144	1 648 195
<i>Furnizimi me Ujë i Tiranës II</i>	783 343	849 735	941 285	995 140	1 013 434
<i>Ujësjellësi i Tiranës I</i>	493 283	532 108	586 682	617 781	626 982
<i>Rehabilitimi i rrjetit hidrik të Tiranës</i>	8 404	8 292	8 424	8 223	7 779
Hekurudha Durrës	238 498	257 687	284 291	299 311	303 529
<i>Rehabilitimi i Hekurudhës së Durrësit</i>	238 498	257 687	284 291	299 311	303 529
Ministria e Financave (ndihme në mallra)	94 409	129 976	185 695	218 484	230 057
<i>Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizime Krujë</i>	59 548	63 739	69 783	73 005	73 644
Radio Televizioni Shqiptar	165 685	486 821	840 635	1 161 744	1 416 644
TOTALI	10 868 812	13 198 847	15 885 064	17 414 642	19 654 107

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Detyrimet si pasojë e pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022 janë akumuluar në masën më të madhe nga kompanitë private me kapital shtetëror përfituese në sektorin energjistik në shumën 1,941 milion lekë. Gjatë vitit 2022 konstatohet se Buxheti i Shtetit ka kryer pagesa si pasojë e paafetësisë paguese edhe të Radio Televizionit Shqiptar, duke rritur stokun e detyrimeve me 255 milion lekë. Gjithashtu edhe në sektorin e ujësjellësve për projektet në Ujësjellës Kanalizime Tirana situata paraqitet problematike duke vendosur Buxhetin e Shtetit në risk për kryerjen e pagesave që kanë dështuar të kryhen nga ky përfitues i garancisë dhe rritjen e detyrimeve në shumën 27 milion lekë. Në nenin 43 “*Kthimi i garancisë shtetërore të huasë*” të Ligjit Nr. 9665, datë 18.12.2006, “*Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, është përcaktuar që “*Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet*

ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, në masën e çdo pagese të bërë në kuadër të garancisë së dhënë. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë Ministrinë të Financave së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ai i ka në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit. Huamarrësi, në zbatim të këtij ligji dhe të marrëveshjes së mirëkuptimit, është i detyruar t'i kthejë Ministrisë së Financave shumën që kjo e fundit i ka paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përftuar nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të”.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e Ligjit Nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për aq kohë sa stoku i detyrimeve jo vetëm që nuk është ulur përgjatë vitit 2022, por është rritur me 2,239 milion lekë.

Niveli i kthimeve nga garancitë, vlerësohet i ulët përse i përket detyrimit për të përmbushur kushtet e marrëveshjeve përkatëse. Nga 27 projekte për të cilat Buxheti i Shtetit ka të drejta për të arkëtuar, përgjatë vitit 2022 janë arkëtuar vetëm për 9 prej tyre në shumën të vogla nga UKT, ATK, A. KESH, OST, A., A. dhe S. Arkëtimet nga detyrimet e garancive sipas përfituesve përkatës në monedhë origjinale dhe monedhë kombëtare paraqiten në tabelën në vijim:

Në Lekë

Institucioni	Kthyer 2022 Euro			Kthyer 2022 ALL		
	Principal	Interes&Komision	Total	Principal	Interes&Komision	Total
ATK	217,374.76	50,625.24	268,000.00	25,774,579.32	994,050.68	31,768,630.00
A.	378,264.44	12,293.62	390,558.06	45,056,968.77	1,466,439.73	46,523,408.50
UKT	-	140,050.60	140,050.60	-	16,773,322.30	16,773,322.30
UKT	-	2,193.13	2,193.13	-	262,633.82	262,633.82
OST	4,135,351.10	179,510.97	4,314,862.07	484,001,492.74	21,009,963.93	505,011,456.67
KESH	44,182.95	7,724.09	51,907.04	5,186,931.05	907,198.87	6,094,129.93
S.	3,392.52	228.90	3,621.42	403,658.99	27,253.26	430,912.25
A.	56,574.12	3,818.76	60,392.88	6,731,471.67	454,668.65	7,186,140.31
AKUM	104,878.62	23,656.08	128,534.70	12,239,335.46	2,760,664.54	15,000,000.00
TOTALI	4,940,019	420,101	5,360,120	579,394,438	49,656,196	629,050,634

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1.4.3 Të drejtat për të arkëtuar nga kreditë shtetërore të tjera

Nga auditimi mbi konfirmimin e gjendjes së detyrimit që subjektet përfituese të marrëveshjeve të nënhuasë apo garancisë kanë ndaj Buxhetit të Shtetit është konstatuar se për kredinë me numër identifikimi 88 sipas regjistrit të borxhit ekzistojnë detyrime në 31.12.2022 nga subjektet përfitues të ndryshëm. Kjo kredi ndërmjet M. C. C. (kreditore) dhe Qeverisë Shqiptare (huamarrësi) është nënshkruar me 06.07.1998 dhe është regjistruar si kredi shtetërore. Detyrimet që ekzistojnë vetëm për këtë kredi dhe sipas subjektit përfitues në euro paraqiten:

Institucioni	Shuma e disbursuar EURO	Principali i papaguar	Interesi i papaguar	Total detyrimi 2022	Komenti
UKT	584,833	389,889	38,857	428,745	Funksionon si garanci
DPUK	435,611	130,311	1,634	131,944	Funksionon si garanci
ARMO	148,439	70,096	11,628	81,724	Nënhuazuar
S.	61,066	25,444	5,343	30,787	Funksionon si garanci
A.	1,018,335	424,306	113,372	537,678	Funksionon si garanci
KESH	5,031,314	2,153,120	218,258	2,371,377	Funksionon si garanci
A.	651,837	0	0	0	Kredi shtetërore
A.	181,977	0	0	0	Kredi shtetërore
Ministria e Bujqësisë	3,078,467	0	0	0	Kredi shtetërore
Ministria e Financave	158,987	0	0	0	Kredi shtetërore
Totali	11,350,865	3,193,165	389,091	3,582,256	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Ecuritë e Garancive Sovrane 1 dhe 2 për vitin 2022.

Ecuria e Garancisë Sovrane Nr. 1 (GS1).

Deri më 31.12.2022, vlera e kredive të miratuara nga 12 bankat nënshkruese, rezulton në një total prej 5,901,304,786 lekë, nga të cilat janë disbursuar 5,333,740,211 lekë dhe ku numri i kontratave të miratuara deri në fund të periudhës është 500. Më poshtë po paraqesim në përmbledhëse miratimet dhe disbursimet sipas bankave nënshkruese:

Në Lekë

Banka	Miratime (Total)		Disbursime (Total)		Fondi i Miratuar	Fondi i Mbetur (Fondi Limit-Miratime)
	Nr Miratimesh	Vlerë (Lek)	Nr Disbursime	Vlerë (Lek)		
T. Bank	31	334,395,335	31	308,422,309	600,000,000	265,604,665
F. Bank	19	90,341,627	19	90,341,627	300,000,000	209,658,373
U. Bank	25	192,040,000	25	188,500,934	600,000,000	407,960,000
B.K.	103	1,089,212,312	103	955,828,657	1,900,000,000	810,787,688
U. Bank	1	1,650,000	1	1,650,000	100,000,000	98,350,000
O. Bank	56	913,014,351	56	850,295,200	1,100,000,000	186,985,649
A. Bank	24	150,256,231	24	125,919,751	700,000,000	549,743,769
C. Bank	47	319,241,098	47	316,558,236	2,000,000,000	1,680,758,902
R. Bank	82	1,410,872,696	82	1,217,643,803	1,900,000,000	489,127,304
A. Bank	22	495,065,072	22	430,170,113	500,000,000	4,934,928
I. Bank	60	604,415,072	60	546,608,589	900,000,000	295,584,928
P... Bank	30	300,800,992	30	300,800,992	400,000,000	99,199,008
Totali	500	5,901,304,790	500	5,332,740,211	11,000,000,000	5,098,695,214

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Garancia sovrane 1 është përdorur në masën prej rreth 54% (vlera e miratimeve kundrejt totalit) ku bankat që e kanë shfrytëzuar më tepër skemën e garancisë (në vlerë absolute) janë Banka K., R. Bank dhe O. Bank. Kreditë e miratuara nga këto tre banka përbëjnë pothuajse 60% të totalit të kredive të miratuara sipas kësaj skeme garancie. Nga kjo skemë kanë përfituar biznese në sektorët e ekonomisë si: tregti, prodhim, turizëm, media, shërbime, edukim, ndërtim, miniera, industri nxjerrëse dhe ajo përpunuese, aktivitete të qiradhënies, transport, shërbime spitalore apo shëndetësore, aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike.

Ecuria e Garancisë Sovrane Nr. 2 (GS2)

Gjatë muajit dhjetor 2022, vlera e kredive të miratuara nga bankat nën skemën e Garancisë Sovrane 2, është rritur me vlerën prej rreth 635 milionë Lekë, ku janë shënuar 11 kontrata të reja. Vlera e disbursimeve është rritur me 846 milionë Lekë. Deri në fund të muajit dhjetor 2022, vlera e kredive të miratuara nga 12 bankat nënshkruese, rezulton në një total prej 18,782,266,484 lekë, nga të cilat janë disbursuar 18,315,872,627 lekë.

Numri i kontratave të miratuara deri në fund të periudhës është rreth 616 (Kontrata kredie, Linja Kredie ose Overdraft). Më poshtë po paraqesim në përmbledhëse miratimet dhe disbursimet sipas bankave nënshkruese:

Në Lekë

Banka	Miratime (Total)		Disbursime (Total)		Fondi i Miratuar 60 % i garantuar		Fondi i Mbetur (Fond Limit i rialokuar - 60 % Miratime)
	Nr Marrëveshje Kredie	Vlerë (Lek)	Nr Kontrata të Disbursuara	Vlerë (Lek)	Fondi Fillestar sipas VKM 387 datë 13.05.2020	Fondi i rialokuar sipas VKM 463 date 30.07.2021	
T. Bank	14	1,369,000,000	14	1,368,661,693	850,000,000	1,250,000,000	428,600,000
F. Bank	30	1,019,700,000	30	999,700,000	400,000,000	800,000,000	188,180,000
U. Bank	10	419,500,000	10	419,500,000	800,000,000	300,000,000	48,300,000
B.K.	18	240,500,000	18	235,500,000	2,550,000,000	500,000,000	355,700,000
U. Bank	5	153,056,000	5	153,056,000	150,000,000	300,000,000	208,166,400
O. Bank	87	2,841,063,500	87	2,772,183,500	1,450,000,000	2,200,000,000	495,361,900
A. Bank	17	884,007,500	17	764,391,885	950,000,000	950,000,000	419,595,500
C. Bank	78	1,373,850,000	78	1,337,499,000	2,800,000,000	1,500,000,000	675,690,000
R. Bank	218	6,416,193,734	218	6,292,484,799	2,600,000,000	4,100,000,000	250,283,760

A. Bank	39	1,864,200,000	39	1,771,700,000	650,000,000	1,300,000,000	181,480,000
I. Bank	53	1,461,695,750	53	1,461,695,750	1,200,000,000	1,200,000,000	322,982,550
P. Bank	47	739,500,000	47	739,500,000	600,000,000	600,000,000	156,300,000
Totali	616	18,782,266,484	616	18,315,872,627	15,000,000,000	15,000,000,000	3,730,640,110

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Garancia Sovrane 2, deri në fund të muajit dhjetor 2022 është përdorur në masën prej rreth 75% (Vlera e miratimeve kundrejt totalit 60% te garantuar) ku bankat që kanë qenë më aktive në përdorimin e Garancisë Sovrane 2, janë A. dhe R. Bank, nisur nga fakti i përdorimit të vlerës limit fillestar dhe asaj të rialokuar. Kjo skemë ka kredituar biznese në sektorët e ekonomisë si: tregti, prodhim, turizëm, media, shërbime, ndërtim, industri përpunuese dhe transport.

Ecuria e Garancisë Sovrane Nr. 3 (GS3)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 8, të aktit normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave vendosi:

1. Miratimin e linjës së garancisë shtetërore në vlerën 3,000,000,000 (tre miliardë) lekë, në favor të bankave tregtare, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat do të jenë pjesë e skemës së garancisë, që do të mundësojë huadhënien për subjektet, që tregtojnë me shumicë, produkte ushqimore bazë, për të siguruar financimin e nevojshëm për të mbajtur rezerva për një periudhë 3-mujore ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së veçantë, të krijuar në treg.

2. Linja e garancisë shtetërore do të lëshohet në favor të bankave tregtare, si më poshtë vijon

- Banka K., sh.a.;
- Banka C., sh.a.;
- Banka R. sh.a., Albania;
- Banka O. Albania, sh.a.

Në lekë

Banka	Emri i klientit	Nipt	Shuma e miratuar	Shuma e disbursuar 31.12.2022	Detyrimi i biznesit ndaj bankes 31.12.2022	Stoku i garantuar nga MFE (60%)
B..	E. SHPK	402C.....	40,000,000.00	40,000,000.00	34,444,444.45	20,666,666.67
	P. SHPK	425C.....	140,000,000.00	36,380,000.00	36,380,000.00	21,828,000.00
	P. SHPK	425C.....		11,560,000.00	11,560,000.00	6,936,000.00
	P. SHPK	425C.....		60,060,000.00	60,060,000.00	36,036,000.00
R....	A. SHPK	L.....I		250,000,000.00	250,000,000.00	215,277,777.80
Bank	B.SHPK	J.....I	150,000,000.00	150,000,000.00	129,166,666.65	77,499,999.99
	B. SHPK	K.....D	90,000,000.00	90,000,000.00	82,500,000.00	49,500,000.00
	I. A. SHPK	J.....U	50,000,000.00	50,000,000.00	43,577,087.69	26,146,252.61
Shuma			720,000,000.00	688,000,000.00	612,965,976.59	367,779,585.95

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Garancia Sovrane 3, deri në fund të muajit dhjetor 2022 është përdorur në masën prej rreth 14% (Vlera e miratimeve kundrejt totalit 60% te garantuar) ku nga 4 bankat e përcaktuara në Vendim vetëm 2 prej tyre (B. dhe R. Bank) kanë kredituar biznese. Kjo skemë ka kredituar biznese në sektorët e ekonomisë në tregti dhe prodhim.

Titulli i gjetjes:	Ecuria e treguesve të riskut të rifinancimit dhe treguesve të riskut të normës së interesit në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuara në SAMB 2022 – 2026.
Situata:	Nga analizimi i Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (2022-2026), rezulton nga ana e MFE-së është përzgjedhur Strategjia S3. Nga MFE është

	<p>analizuar se financimi në periudhën e ardhshme duke përzgjedhur dhe aplikuar strategjinë S3 do të ketë rezultate të kënaqshme në drejtim të optimizimit të risqeve të portofolit të borxhit, dhe me një kosto të pranueshme.</p> <p>Konstatohet se tendenca e borxhit që maturohet brenda 1 viti, për vitin 2022 rezulton të jetë rritur me 1,3% duke kaluar nga 46,6% në vitin 2021 në 47,9% në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një tavan prej 40%.</p> <p>Koha mesatare në maturim ka ardhur në ulje nga 2,20 vite në 2021 në 2,17 vite në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një kufi minimal 2,5 vite.</p> <p>Për rrjedhojë tendenca faktike e vitit 2022 nuk ka shkuar në drejtimin e përmirësimit të arritjes së objektivit të strategjisë 2022-2026.</p> <p>Tendenca e borxhit që rifiksohet brenda 1 viti, për vitin 2022 rezulton të jetë rritur me 1% duke kaluar nga 48% në vitin 2021 në 49% në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një tavan prej 43%.</p> <p>Gjithashtu konstatohet se edhe koha mesatare në rifiksime ka ardhur në ulje nga 2,19 vite në 2021 në 2,17 vite në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një kufi minimal 2,5 vite.</p> <p>Për rrjedhojë tendenca faktike e vitit 2022 nuk ka shkuar në drejtimin e përmirësimit të arritjes së objektivit të strategjisë 2022-2026.</p>
Kriteri :	Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (SAMB) 2022 - 2026
Ndikimi/Efekti	Tendenca faktike e treguesve të riskut të rfinansimit dhe treguesve të riskut të normës së interesit për vitin 2022 nuk ka shkuar në drejtimin e përmirësimit të arritjes së objektivit të strategjisë 2022-2026.
Shkaku:	Mungesa e përmirësimit të treguesve të borxhit publik për vitin 2022 referuar objektivave strategjike.
Rëndësia	E Lartë.
Rekomandimi	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa konkrete në përmirësimin e treguesve të riskut të rfinansimit dhe treguesve të riskut të normës së interesit për arritjen e objektivave strategjike të përcaktuara në SAMB 2022 – 2026.

2.D.2. Auditim mbi saktësinë e paraqitjes së treguesve të borxhit në tabelën fiskale dhe Raportin e Zbatimit të Buxhetit për vitin 2022.

Kufijtë e huamarrjes vjetore dhe huaja e marrë për financimin e deficitit.

Gjatë vitit 2022, kufizimet për borxhin e ri të emetuar dhe shlyerjen e borxhit ekzistues janë përcaktuar në nenet 10, 19 dhe 20 të Ligjit Nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar. Në këtë ligj është përcaktuar financimi i deficitit prej 100,883 milion lekësh nëpërmjet rritjes së huamarrjes totale neto nga burime të brendshme dhe të huaja.

Me aktin normativ Nr. 3, datë 12.03.2022, nuk janë bërë ndryshime të deficitit. Me aktin normativ nr. 12, datë 29.07.2022 për disa ndryshime të Ligjit Nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, u vendos ndryshimi i deficitit duke kaluar nga 100,883 milion lekë në 83,863 milion lekë. Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër sesa deficiti i përcaktuar në nenin 1, të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes totale neto nga burime të brendshme prej 83,383 milionë lekë dhe të huaja prej 480 milionë lekë. Ndërsa me aktin normativ Nr. 17, datë 01.12.2022 dhe aktin normativ nr. 19, datë 29.12.2022, për disa ndryshime të Ligjit Nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, nuk janë bërë ndryshime të deficitit por janë bërë rialokime në strukturën e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm brenda kufirit të deficitit. Raportimi në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar për financimin e deficitit të vitit 2022, së bashku me planifikimet e ndryshuara përgjatë vitit paraqiten:

Në milion lekë

ZËRI BUXHETOR	Ligji nr.115/2021 Buxheti 2022	AN nr.3 12.03.'22	AN nr.12 29.07.'22	AN nr.17 01.12.'22	AN nr.19 29.12.'22	Fakti në tregues fiskale
DEFICITI	-100,883	-100,883	-83,863	-83,863	-83,863	-78,225
Financimi Deficitet	100,883	100,883	83,863	83,863	83,863	78,225
Brendshëm	100,251	100,251	83,383	88,088	90,088	87,765
Të ardhura nga privatizimi	0	0	0	0	0	191
Hua-marrje e brendshme	50,000	50,000	33,000	33,000	33,000	26,156
Të tjera	50,251	50,251	50,383	55,088	57,088	61,417
I Huaj	632	632	480	-4,225	-6,225	-9,539
Hua afatgjatë (e marrë)	25,752	25,752	23,652	15,829	13,829	11,140
Ndryshimi i gjendjes së arkës	0	0	0	0	0	589
Ripagesat	-42,529	-42,529	-42,529	-39,042	-39,042	-38,386
Mbështetje buxhetore	17,409	17,409	19,357	18,987	18,987	17,117

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Huamarrja e brendshme me anë të instrumenteve të bonove të thesarit dhe obligacioneve sipas raportimit në treguesit fiskalë të konsoliduar paraqitet në shumën 26,156 milion lekë, me nën realizim përkundrejt planit në shumën 33,000 milion lekë. Gjithashtu ripagesat për borxhin e huaj paraqiten me nën realizim duke shlyer principal të borxhit të jashtëm në shumën 38,386 milion lekë përkundrejt 39,042 milion lekë të planifikuara.

Analiza e Akteve Normative

1. Me Aktin Normativ nr. 12, datë 29.07.2022,

-U ul huamarrja e brendshme nga 50,000 milion lekë në 33,000 milion lekë. Gjatë gjysmës së parë të 2022, financimi në tregun e brendshëm nuk u realizua në masën e parashikuar, përkundrazi rezultoi në vlerë negative prej -2,825 milion lekë maturime më të larta se emetime.

-U ndryshua zëri i mbështetjes buxhetore, nga 17,407 milion lekë në 19,357 milion lekë, vetëm si rrjedhojë e kursit të këmbimit të përdorur në projeksionet makroekonomike.

-U ul zëri i financimit “Hua afatgjatë” nga 25,752 milionë lekë në 23,652 milionë lekë për arsye të mosrealizimit të disbursimeve të kredive për financimin e projekteve të investimit në masën e parashikuar fillimisht.

2. Me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022,

-U ul zëri i shpenzimeve për interesa të borxhit të brendshëm nga 27,363 milion lekë në 24,363 milion lekë, si dhe shpenzimeve për interesa të borxhit të jashtëm nga 18,593 milion lekë në 15.636 milion lekë.

Gjatë vitit 2022 pati rritje të konsiderueshme të normave, por nga ana tjetër kemi një ngadalësim të huamarrjes së pritshme si nga burimet e brendshme edhe nga burimet e huaja, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shpenzimet e interesave për vitin përkatës.

-U ul zëri i ripagesave të borxhit nga 42,529 milion Lekë në 39,042 milion lekë.

-Ndryshim i zërit të mbështetjes buxhetore, nga 19,357 milion lekë në 18,987 milion lekë, vetëm si rrjedhojë e kursit të këmbimit të përdorur në projeksionet makroekonomike.

-U ul zëri i financimit “Hua afatgjatë” nga 23,652 milionë lekë në 15,829 milionë lekë për arsye të mosrealizimit të disbursimeve të kredive për financimin e projekteve të investimit në masën e parashikuar fillimisht.

3. Me Aktin Normativ nr. 19, datë 29.12.2022,

-U ul zëri i shpenzimeve për interesa të borxhit të brendshëm nga 24,363 milionë lekë në 24,243 milionë lekë për arsye të konstatimit përsëri të një kursimi në këtë zë.

-U ul zëri i financimit “Hua afatgjatë” nga 15,829 milionë lekë në 13,829 milionë lekë për arsye të mosrealizimit të disbursimeve të kredive për financimin e projekteve të investimit në masën e parashikuar fillimisht.

Në lidhje me raportimet për huanë e re të marrë dhe pagesat e principalit të kryera sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe bashkërendimit të ndihmës së huaj konstatohen diferenca në disa prej elementëve sipas tabelës së mëposhtme:

Në milion lekë

Lloji i Huasë	Fakti DPTH	Fakti DPB	Diferenca Thesar-Borxh
Hua-marrje e brendshme	26,156	26,308	(152)
Ripagesat	(38,386)	(38,394)	8
Hua afatgjate (e marre) e jashtme	11,140	35,945	(24,805)
nga e cila Eurobond	0	0	0
Mbeshetje buxhetore	17,117	17,117	0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Huamarrja e brendshme që ka shërbyer për financimin e deficitit në treguesit fiskale të konsoliduar paraqitet në shumën 26,156 milion lekë ndërkohë që sipas raportimit nga drejtorja e borxhit huaja e re e brendshme paraqitet në shumën 26,308 milion lekë. **Vlera prej 26,308 milionë lekë rezulton e konfirmuar edhe në akt rakordimin ndërmjet strukturave të thesarit dhe strukturave të borxhit. Konstatohet se realizimi faktik i huamarrjes së brendshme i konfirmuar edhe me strukturat e DPTH nuk rakordon me realizimin faktik të paraqitur në treguesit fiskalë të konsoliduar në huamarrjen e brendshme për financimin e deficitit në shumën (152) milionë lekë.**

Të dhënat në lidhje me huanë afatgjatë të marrë e jashtme paraqitet në shumën 11,140 milionë lekë, ndërkohë që sipas raportimi nga drejtorja e borxhit huanë afatgjatë të marrë e jashtme paraqitet në shumën 35,945 milionë lekë. Konstatohet se realizimi faktik i huasë afatgjatë të marrë e jashtme nuk rakordon në shumën 24,805 milionë lekë, e konvertuar sipas kursit të këmbimit të datës 31.12.2022 referuar Bankës së Shqipërisë në euro/lekë prej 114,23, diferenca në euro paraqitet në shumën 217 milionë Euro.

Disbursimet e projekteve me financim të huaj janë rakorduar në fund të vitit 2022 ndërmjet strukturës së thesarit dhe strukturës së borxhit në monedhën origjinale të disbursuar nga kreditorët dhe kanë rezultuar diferenca të sqaruara si më poshtë:

Kredia	Përshkrimi	Shuma	Monedha	Koment	
18/04/IBRD	Modernizimi i asistencës sociale fin.shtesë	8,000,000	Euro	Borxhi>Thesari	MB
16/03/IBRD	Zhvillimi i integruar urban dhe Turizmi	50	USD	Borxhi>Thesari	
21/08/CEB	Mbeshetje për zbutjen e riskut të pandemisë Covid	60,000,000	Euro	Borxhi>Thesari	MB
21/11/AFD	Politikat për mbështetjen e sektorit të energjisë	50,000,000	Euro	Borxhi>Thesari	MB
22/01/IBRD	Fin.shtesë përmirësimi i sistemit shëndetësor	62,500	Euro	Borxhi>Thesari	Front&Fee
21/12/AFD	Barazia gjinore e mbështetur në politika	25,000,000	Euro	Borxhi>Thesari	MB
22/02/IBRD	Zhvillimi i integruar urban dhe turizmi fin.shtesë	75,000	Euro	Borxhi>Thesari	Front&Fee

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Pra nga sa më sipër rrjedh se diferencat kanë rezultuar për shkak të “Front & Fee” të cilat janë komisione që parapagohen të cilat nuk dalin në regjistrimet e thesarit, trajtimi dhe regjistrimi i garancive nga dy drejtoritë si p.sh 22/01/IBRD – *Financimi shtesë përmirësimi i sistemit shëndetësor si dhe 22/02/IBRD – Zhvillimi i integruar urban dhe turizmi financim shtesë* të cilën thesari e përfshin tek financimi i huaj.

Në lidhje me pagesat e principalit të regjistruara për vitin 2022 nga auditimi është konstatuar se fakti i raportuar në sistemin e DPB paraqitet në shumën 38,394 milion lekë e cila në krahasim me faktin e paraqitur në treguesit fiskalë, paraqitet me diferencë në shumën 8 milion lekë. Kjo diferencë e cila paraqet një pagesë të kryer nga IDB në TSA në muajin janar 2023.

Përsa i përket diferencave në treguesit e disbursimit të borxhit, si pasojë e rakordimit ndërmjet thesarit dhe borxhit, konstatohet se vjen si pasojë e mbështetjeve buxhetore sipas tabelës më sipër dhe lidhet me raportimin veçmas në treguesit e konsoliduar fiskal nën vijën e deficitit në seksionin e financimit të jashtëm me mbështetje buxhetore, të cilat kalojnë

drejtpërdrejtë në TSA në monedhë të huaj, e detajuar në seksionin e borxhit të jashtëm, e cila nuk ka efekte në rakordimin midis thesarit dhe borxhit.

Titulli i gjetjes:	Pagesat e principalit dhe interesave për garancitë jo performuese kryhen nga Buxheti i Shtetit pa u marrë të gjitha masat e nevojshme nga ana e institucionit huadhënës për rikuperimin e detyrimit, por vetëm bazuar në vetëdeklarimin e përfituesit të garancisë mbi paaftësinë paguese të tij.
Situata:	Nga auditimi i garancive të huaja jo performuese është konstatuar se në rastet kur huamarrësi nuk ka mundur të bëjë pagesën, në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huasë institucioni huadhënës nuk i ka paraqitur Ministrin të Financave një kërkesë për pagesë, në përmbushje të së drejtës së tij, sipas garancisë shtetërore të huasë, me qëllim që Ministri i Financave, pasi të konfirmoj se kërkesa për pagesë është në përputhje me kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, të autorizojë transfertën e pagesës ose pagesave për institucionin huadhënës brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës”. Aktualisht konstatohet se procesi konsiston në komunikim paraprak nga MFE me përfituesin e garancisë i cili konfirmon nëse është apo jo në gjendje që të shlyejë këstin e radhës dhe në rast paaftësie nga ana e tij procedohet me pagesën nga Buxheti i Shtetit, veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Kriteri :	Ligji nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 42.
Ndikimi/Efekti	Risk i shtuar në drejtim të realizimit të drejtave për të arkëtuar.
Shkaku:	Shmangia e kamatëvonesave apo penaltiteteve në rast vonese të pagesës
Rëndësia	E Lartë.
Rekomandimi	Ministria e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e Autoritetit Publik dhe të Kompetencës nëpërmjet nga strukturat e borxhit, të ndjek të gjitha rrugët ligjore që të merren masa për hartimin dhe implementimin e procedurave të qarta ligjore me qëllim përcaktimin e një procedurë që parashikon monitorimin proaktiv dhe dinamik dhe konfirmimit të gjendjes financiare dhe aftësisë paguese të subjekteve kredimarrëse (përmes aksesit të autorizuar në informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjekteve përfituese të garancisë), përpara realizimit të pagesës në mbështetje të vështirësisë financiare të deklaruar nga subjektet përfituese.

Titulli i gjetjes:	KLSH ka konstatuar krijim të detyrimeve të reja në shumën 3,404 milionë lekë të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë përgjatë vitit 2022, si pasojë e mosshlyerjes së detyrimeve përkatëse.
Situata:	KLSH ka konstatuar krijim të detyrimeve të reja në shumën 3,404 milionë lekë të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë përgjatë vitit 2022, si pasojë e mosshlyerjes së detyrimeve përkatëse. Nga auditimi në lidhje me marrëveshjet e nënhuasë konstatohet se stoku i kredive në lidhje me këtë komponent të borxhit shtetëror është përkeqësuar përgjatë vitit 2022. Sektorët me përkeqësim të situatës financiare paraqiten sektori i energjetikës kryesisht me nënhuatë e KESH, OSHEE dhe OST me rreth 1,650 milion lekë të rritjes totale të detyrimeve nga 3,404 milion lekë në total, pushteti vendor me rreth 1,128 milion lekë, sektori i ujësjellësve me rreth 608 milion lekë, Institucionet e Mikrokredisë me nënhuatë të U...i i K....K.... me 17 milion lekë, dhe ARMO me 0.62 milion lekë. Në nenin 30 “Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror, mbi të cilat zbatohen kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është përcaktuar që “...është përgjegjësi ligjore e huamarrësve, të cilët kanë marrë fonde, sipas paragrafit të

	<p>parë të këtij neni, që ti kthejnë fondet e marra hua në përputhje me marrëveshjet e nënhuave dhe të paraqesin raporte për gjendjen e huasë dhe përdorimin e saj, sipas kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Financave”.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e nenit, duke paraqitur një situatë ku detyrimet ndaj shtetit si pasojë e mos pagesave janë rritur me 3,404 milion lekë, me një trend rritës nga viti në vit. Krahasuar nga stoku i detyrimeve të vitit 2018 në vlerën 21,279 milion lekë në fund të vitit 2022 stoku i detyrimeve paraqitet në vlerën 45,009 milion lekë ose me një rritje totale për periudhën 5 vjeçare (2018-2022) në masën 112%.</p>
Kriteri :	Ligji nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 30 “Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror, mbi të cilat zbatohen kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare”.
Ndikimi/Efekti	Rritje e detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit.
Shkaku:	Mungesa e respektimit të marrëveshjeve të nënhuasë të lidhura ndërmjet shtetit dhe nënhuamarrësit, performanca e dobët e nënhuamarrësve e evidentuar kryesisht në sektorin energjetik, pushtetin vendor dhe ujësjellës.
Rëndësia	E Lartë.
Rekomandimi	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa të menjëhershme për rikuperimin e të drejtave për të arkëtuar nëpërmjet ushtrimit të instrumenteve ligjore që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuasë dhe përcaktimeve të ligjit për institucionet e caktuara për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive.

Titulli i gjetjes:	Gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja në shumën 2,239 milion lekë në kuadër të dështimit të pagesave për kreditë e garantuara nga përfituesi i garancisë.
Situata:	<p>Për vitin 2022 gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është në shumën 19,654 milion lekë nga 17,414 milion lekë në vitin 2021, me një rritje vjetore prej 2,239 milion lekë. Garancitë shtetërore përgjatë vitit 2022 paraqesin një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre dhe situatës së rënduar financiare të cilën kalon kryesisht sektori energjetik. Detyrimet si pasojë e pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022 janë akumuluar në masën më të madhe nga kompanitë private me kapital shtetëror përfituese në sektorin energjetik në shumën 1,941 milion lekë. Gjatë vitit 2022 konstatohet se Buxheti i Shtetit ka kryer pagesa si pasojë e paafësisë paguese edhe të Radio Televizionit Shqiptar, duke rritur stokun e detyrimeve me 255 milion lekë. Gjithashtu edhe në sektorin e ujësjellësve për projektet në Ujësjellës Kanalizime Tirana situata paraqitet problematike duke vendosur Buxhetin e Shtetit në risk për kryerjen e pagesave që kanë dështuar të kryhen nga ky përfitues i garancisë dhe rritjen e detyrimeve në shumën 27 milion lekë. Në nenin 43 “Kthimi i garancisë shtetërore të huasë” të Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është përcaktuar që “Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, në masën e çdo pagese të bërë në kuadër të garancisë së dhënë. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë Ministrisë së Financave së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ai i ka në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit. Huamarrësi, në zbatim të këtij ligji dhe të marrëveshjes së mirëkuptimit, është i detyruar t’i kthejë Ministrisë së Financave shumën që kjo e fundit i ka paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përftuar nga</p>

	huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të”. Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për aq kohë sa stoku i detyrimeve jo vetëm që nuk është ulur përgjatë vitit 2022, por është rritur me 2,239 milion lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 43 “Kthimi i garancisë shtetërore të huasë”.
Ndikimi/Efekti	Rritje e detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit me 2,239 milion lekë përgjatë vitit 2022 për garancitë shtetërore të huasë të huaja.
Shkaku:	Performanca e dobët e subjekteve përfituesve të garancisë si pasojë e paaftësisë paguese dhe mungesa e marrjes së masave të mjaftueshme për realizimin e të drejtave që rrjedhin nga transferimi i të drejtës për të arkëtuar. të dorëzanësi.
Rëndësia	E Lartë.
Rekomandimi	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ushtrojë të gjitha mjetet ligjore për arkëtimin e të drejtave për pagesa të kryera për garancitë e arkëtuara dhe në të njëjtën kohë të ushtrojë kontroll mbi planet ekonomike dhe financiare për shlyerjen e këtyre shumave.

Sa trajtuar më sipër, subjekti ka paraqitur observacione përmes shkresës nr. 5854/48 Prot., datë 06.09.2023, protokolluar në KLSH me shkresën me nr.281/24 Prot., datë 07.09.2023, ku pretendohet si në vijim:

Pretendimi i subjektit:

Në vijim të Projekt Raportit të Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë – Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, dërguar me shkresën tuaj 281/22, datë 07.08.2023 dhe protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me nr. 5854/46, datë 08.08.2023, më poshtë do të gjeni komentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Shtetëror:

1-Lidhur me pikën 2.D.1, në faqen 332, paragrafi i fundit ku citohet: “Në lidhje me qëndrimin e subjektit se pagesat e borxhit të jashtëm të garantuar kryhen në përputhje me marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare të garancive të cilat janë ratifikuar me ligj, grupi i auditimit sqaron se nuk është dërguar asnjë dokumentacion që të mbështesë pretendimet e ngritura”, sjellim në vëmendjen tuaj sa vijon:

Qëndrimi ynë lidhur me këtë pikë ju është përcjellë edhe më parë nëpërmjet shkresës tonë nr. 6262/51, datë 20.10.2022 “Masa Organizative” në përgjigje të rekomandimit 32.1 në të cilën është argumentuar qartësisht kryerja e pagesave nga buxheti i shtetit për garancitë e huaja, si më poshtë:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka aktualisht të ngritur një strukturë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, si dhe procedurat përkatëse të monitorimit të gjendjes financiare të institucioneve dhe ndërmarrjeve me kapital shtetëror, ku përfshihen edhe ato ndërmarrje të cilat kanë përfituar nga garancitë shtetërore, në kushte ku ato paraqesin rrisje fiskale dhe buxhetore.

Nga ana tjetër sqarojmë se marrëveshjet e garancisë të lidhura nuk parashikojnë mbulimin me garanci vetëm në rastin kur huamarrësi paraqet mungesë të aftësisë paguese, por në gfarëdolloj situatë kur huamarrësi nuk paguan detyrimet që rrjedhin nga kontrata e huasë. Në këto kushte, pagesa nga ana e garantuesit në rast se huamarrësi nuk përmbush detyrimet për pagesë, duhet të bëhet me patjetër pavarësisht nëse huamarrësi ka apo nuk ka aftësi paguese. Përndryshe, mos pagimi nga ana e garantuesit do të përbënte shkeljet të marrëveshjes së garancisë dhe do të sillte një sërë konsekuencash e pasojash të rënda të cilat i kemi theksuar dhe shpjeguar vazhdimisht në misionin e auditimit.

Në vijim të sa sqaruar më sipër, si dhe duke konsideruar ndryshimet ligjore të realizuara në ligjin, që rregullon huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë, vlerësojmë se

duhet të rishikohet rekomandimi i paraqitur nga ana juaj sipas të cilit “MFE në cilësinë e autoritetit të kompetencës, nëpërmjet strukturave të borxhit, të ndjekë gjithë rrugët ligjore që të merren masa...” Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë tashmë ndryshimet ligjore që do të përforcojnë mekanizmat ligjore për verifikimin e aftësisë paguese dhe mundësimin e arkëtimeve të detyrimeve të këtyre subjekteve, dhe këto mekanizma nuk do të mundësohen nga struktura e borxhit por nga një strukturë e specializuar dhe autorizuar me ligj për këtë qëllim. Konkretisht ndryshimet në ligjin e borxhit, të miratuara nga parlamenti nëpërmjet Ligjit nr. 92/2022, datë 22.12.2022 ndër të tjera parashikojnë se Ministria përgjegjëse për financat, nëpërmjet institucionit të caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive (AKT aktualisht), kryen verifikimin e aftësisë paguese të huamarrësve. Nëse nga ky verifikim rezulton se ka mundësi pagese dhe në rast se pagesa e detyrimit është kryer nga ministria institucioni i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, me anë të një urdhri me shkrim kërkon bllokimin e llogarive dhe sekuestrimin e kundërvlerës që ministria përgjegjëse ka paguar dhe ndjek shlyerjen e plotë të detyrimit.

2-Lidhur me pikën 2.D.1, për sa i përket “ecurisë së treguesve të riskut të rifinancimit dhe treguesve të riskut të normave të interesit në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuara në SAMB 2022-2026” sqarojmë se qëndrimi ynë në lidhje me këtë pikë është dhënë nëpërmjet shkresës me nr. 5354/37, datë 31.07.2023.

3-Lidhur me konstatimin fq. 340, i qëndrojmë të njëjtës përgjigje përsa i përket nivelit të borxhit të rishikuar në buletin e tremujorit të parë të vitit 2023, pra 64.59% si dhe pas verifikimit edhe njëherë të dokumentit “Raporti i zbatimit të buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, maj 2023, ritheksojmë se niveli prej 78.8% i referohet nivelit të pritshëm të stokut të borxhit për fundin e vitit 2022, dhe jo nivelit të stokut të vitit 2021.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin e paraqitur, grupi i auditimit sqaron se:

1-Lidhur me marrëveshjet përkatëse të garancive ndërkombëtare, nga ana e grupit të auditimit është sqaruar se Autoriteti Përgjegjës sipas citimeve tuaja në observacion rezulton të jetë Ministria e Financave dhe Ekonomisë për verifikimin paguese të huamarrësve nëpërmjet një Institucioni të caktuar me ligj. Për rrjedhojë nuk përjashtohet detyrimet ligjor i MFE-së për verifikimin e aftësisë paguese. Për sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

2- Në lidhje me strategjinë e borxhit, grupi i auditimit sqaron se është kryer analiza dhe janë detajuar dhe shpjegimet përkatëse në lidhje me faktorët që kanë ndikuar në mos përmbushjen e objektivave strategjike afatmesëm, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve si dhe mbajtjes në kontroll të kostos së borxhit. Faktet e paraqitura në këtë observacion janë analizuar dhe gjatë përgatitjes së Projekt Raportit të Auditimit. Për rrjedhojë observacioni nuk merret në konsideratë.

3- Sa u takon treguesve të borxhit publik, pika d) grupi i auditimit sqaron se diferencat vjen si rezultat i informacionit të marrë nga Buletini i Borxhit T4 2022, tabela 1.4 dhe Raporti mbi Zbatimin e Buxhetit Vjetor, për rrjedhojë observacioni nuk merret në konsideratë.

2.E. Mbi veprimtarinë e Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2.E.1. Mbi hartimin e zbatimit e buxhetit të Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Nga dokumentacioni dhe të dhënat e vendosura në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua si më poshtë vijon:

Aparati i MFE për vitin 2022 ka realizuar shpenzime që përfshihen në programet: 01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi; 01120 Menaxhimi i Shpenzimeve Publike; 01130 Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme; 04130 Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik; 04160 Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastruktura e Cilësisë dhe Pronësia Industriale; 09240 Arsimi i Mesëm Profesional; 06190 Strehimi.

Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Financave mbi hartimin e buxhetit të shtetit. Programimi i PBA-së 2022-2024 dhe buxheti i shpenzimeve të vitit 2022.

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të qeverisë. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës në programin e qeverisë gjatë një periudhe 3-vjeçare, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe udhëzimit plotësues nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I-rë të PBA 2022-2024

Me shkresën nr. 7654/1, datë 04.05.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore dhe relacioni shoqërues për institucionet e varësisë dhe aparatit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në kuadër të hartimit të PBA 2022-2024, në përputhje me udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021. *Kërkesat buxhetore për PBA 2022-2024 për programin 01110 “Planifikim Menaxhim, Administrim” sipas memos së datës 14.06.2021, si dhe për programin 01120 “Menaxhimi i Shpenzimeve Publike” sipas memos nr. 9384, datë 27.05.2021, janë përcjellë pas datës 1 Maj 2021, në kundërshtim me pikën 9 të udhëzimit nr.8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor 2022-2024”. Gjithashtu evidentohet se për disa nga programet mungon relacioni shoqërues.*

Fondet në programet e planifikuara dhe shpenzuara nga aparati i MFE, nuk janë të përfshira në një program si njësi shpenzuese më vehte, por ato janë pjesë e programeve ku përfshihen edhe fondet e njësive të tjera shpenzuese të varësisë. Si rezultat, shpenzimet që lidhen me aktivitetin normal të institucionit të tilla si shpenzimet për paga, sigurime shoqërore të personelit, apo operative nuk raportohen vetëm në kodin 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” por edhe në kodet e produkteve të çelura nën programet në vijim: Menaxhimi i Shpenzimeve Publike; Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme; Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik; Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastruktura e Cilësisë dhe Pronësia Industriale; Arsimi i Mesëm Profesional; Strehimi.

Nga auditimi konstatohet se, kërkesat shtesë të buxhetit të MFE në kushtet kur limitet buxhetore janë të kufizuara dhe kërkesat shtesë për disa programe janë të shumta, ato nuk janë të prioritizuara nga më e domosdoshmja dhe më emergjentja tek ajo më pak, në mënyrë që të garantohet dhe përzgjedhja e duhur për financimin e tyre.

Konstatohet se brenda programeve ku janë të planifikuara fondet e Aparatit të MFE-së, janë të përfshira gjithashtu edhe fonde për njësitë e tjera shpenzuese si AIDA, QKB etj. Aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si njësi shpenzuese, nuk ka përgatitur dhe dorëzuar më vete kërkesat për programin buxhetor afatmesëm PBA 2022-2024 dhe kërkesat shtesë.

Nga auditimi u evidentua se planifikimi i shpenzimeve në rastet kur programi përfshin vetëm aparatit dhe thesarin në fazën e parë të PBA-së 2022-2024 është si vijon:

-shpenzime korrente në total 1,506,160 mijë lekë, nga të cilat 776,185 mijë lekë për llogarinë 600-601 dhe 729,975 mijë lekë për llogaritë 602-606;

-shpenzime kapitale 313,000 mijë lekë nga të cilat 113,000 mijë lekë për shpenzime kapitale me financim të brendshëm dhe 200,000 mijë lekë për shpenzime me financim të huaj.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II-të të PBA 2022-2024

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e PBA 2022-2024, janë miratuar me VKM-në nr. 440 datë 22.07.2021 "Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022- 2024", në nivel programi.

Me shkresën nr. 14999/12, datë 01.09.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE-së janë përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore dhe relacioni shoqërues. Për programet 01120, 01130 mungojnë relacionet shoqëruese dhe pasqyrat shtesë të buxhetit vjetor të vitit 2022, veprim i cili nuk është në përputhje me pikën 7, të udhëzimit plotësues nr. 19, datë 09.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Planifikimi i zërave buxhetore nga faza e parë e PBA-së 2022-2024, në fazën e II-të ka pësuar ndryshime. Totali i shpenzimeve të planifikuara për Aparatin e MFE-së në fazën e II-të është 1,919,160 mijë lekë, krahasuar me fazën e I-rë të PBA 2022-2024 është rritur në vlerën 100,000 mijë lekë. Totali i shpenzimeve korrente për Aparatin në fazën e II-të të PBA-së është 1,456,160 mijë lekë, krahasuar me fazën e parë është ulur në vlerën 50,000 mijë lekë. Totali i shpenzimeve kapitale të planifikuara për Aparatin është 463,000 mijë lekë dhe krahasuar me fazën e I-rë janë rritur me 150,000 mijë lekë.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet fondi i miratuar me ligjin e buxhetit, krahasuar me planin sipas tavanit të përcaktuar gjatë hartimit të PBA-së dhe kërkesat shtesë për çdo program:

Tabela. Plani sipas taveve përfundimtare dhe ligjit të buxhetit në 000/lekë

Programi	Emërtimi i programit	Plani sipas tavanit	Kërkesa shtesë	Plani i miratuar sipas Ligjit të Buxhetit	Diferenca mes Ligjit dhe PBA-së
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,064,040		1,134,040	70,000
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	393,120		374,120	(19,000)
01130	Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	462,000	805,255	1,000,000	538,000
01140	Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	3,183,000	870,416	2,892,640	(290,360)
01150	Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	3,605,910	741,310	3,806,010	200,100
01160	Lufta kundër Transaksioneve Jo-ligjore	90,400	28,000	80,400	(10,000)
04130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	750,400		1,000,400	250,000
04160	Mbështetja për Mbik. E Tregut, Infrast. E Cilësisë dhe pronës. Industriale	338,520		328,520	(10,000)
10220	Sigurimi shoqëror	52,257,515		47,656,350	(4,601,165)
10550	Tregu i Punës	2,250,600		2,430,600	180,000
04170	Inspektimi në Punë	197,200		179,200	(18,000)
09240	Arsimi i Mesëm (Profesional)	3,063,379		2,868,379	(195,000)
06190	Strehimi	572,400	750,000	1,722,400	1,150,000
Total		68,228,484	3,194,981	65,473,059	(2,755,425)

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MFE-së

Nga auditimi konstatohet se plani i miratuar sipas ligjit të buxhetit paraqitet në vlerën 65,473,059 mijë lekë, pra 2,755,425 mijë lekë më pak se plani sipas tavanit të PBA-së miratuar me VKM-në nr. 440, datë 22.07.2021, ndërkohë që kërkesat shtesë të institucionit sipas programeve paraqiten në vlerën 3,194,981 mijë lekë. Rritja më e madhe e fondeve me ligjin e buxhetit paraqitet për programin “06190 Strehimi”, në vlerën 1,150,000 mijë lekë më shumë se kërkesat e programit në zbatim të tavanit të miratuar.

Përsa më trajtuar më sipër ngarkohet me përgjegjësi ish Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar znj. R.M.

Referuar **planit të investimeve** të miratuar në projekt buxhet për vitin 2022, grupi i auditimit krahasoi këto projekte me ato të cilat janë çelur në vijim të miratimit të ligjit vjetor. Konstatohet se 13 projekte të çelura në fillim të vitit me ligjin e vjetor të buxhetit rezultojnë të pa përfshira në listën e investimeve publike të miratuara në projekt buxhet, si dhe janë miratuar me ligj pa kaluar procedurat e përgatitjes së kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm, duke reflektuar kështu ndryshimet që ka pësuar plani i financimit të projekteve nga momenti i miratimit të PBA-së deri në ligjin e buxhetit.

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, transferimi i fondeve buxhetore si dhe plani përfundimtar.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit 2022

Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet korrente është bërë me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22922/91, datë 18.01.2022 me subjekt “Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2022-2024, për shpenzime korrente”.

Sipas shkresës së çeljes, buxheti për shpenzime korrente për aparatit e MFE-së paraqitet në vlerën 2,693,322 mijë lekë, nga të cilat në nivel artikujsh: Shpenzime për paga në vlerën 441,479 mijë lekë; Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 100,928 mijë lekë; Shpenzime operative në vlerën 492,655 mijë lekë; Shpenzime për transferta korrente të brendshme në vlerën 60,000 mijë lekë; Shpenzime për transferta korrente të huaja në vlerën 361,800 mijë lekë; Shpenzime për transferta të buxheteve familjarë & individë në vlerën 1,236,460 mijë lekë.

Detajimi i planit të buxhetit për shpenzimet kapitale është bërë me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1218, datë 21.01.2022 me subjekt “Dërgohet detajimi i buxhetit 2022-2024 për shpenzimet kapitale”.

Tabela Çeljet e shp. Kapitale për Aparatin e MFE-së në 000/lekë

Programi	Emërtimi i programit	Llogaria 230	Llogaria 231	Totali
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	336,434	246,004	582,438
01130	Ekzekutimi i pagesave të ndryshme	-	400,000	400,000
04130	Mbështetje për Zhvillimin ekonomik		20,000	20,000
09240	Arsimi i Mesëm (Profesional)	51,210	689,569	740,779
06190	Strehimi	-	400,000	400,000
Totali		387,644	1,755,573	2,143,217

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MFE-së

Janë evidentuar problematika si “TVSH për projekte me financim të huaj” në vlerën 5,000,000 lekë, e cila nuk është detajuar në relacionin e PBA-së se për cilat projekte është planifikuar rimbursimi i TVSH-së. Ka raste kur për projektet e investimeve të planifikuara nuk është respektuar metodologjia “Buxheti mbi bazë Programi dhe Performance (BPP)” ku të ekzistojë lidhja midis burimeve publike, produkteve dhe rezultateve të arritura me veprimtarinë buxhetore të ekipeve të programeve buxhetore të MFE-së.

Tabelat në vijim paraqesin diferencat e konstatuara në vlerë, në numër projektsh investimi dhe më pas sipas projekteve specifike duke krahasuar planin në çelje me planifikimin gjatë fazës së hartimit të PBA-së.

Tabela. Projektet sipas PBA-së faza e II dhe ligjit në 000/lekë

Programi	Vlera e miratuar në PBA për aparatit e MFE	Vlera e çelur	Numri i projekteve të miratuara në PBA për aparatit e MFE	Numri i projekteve të çelura
01110	463,000	582,438	10	18
01130	-	400,000	-	1
04130	23,170	20,000	1	1
09240	1,286,989	740,779	16	13
06190	250,000	400,000	2	2
Totali	2,023,159	2,143,217	29	35

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MFE-së

Konkretisht, rezulton se për programin 01110, sipas PBA-së së fazës së dytë janë planifikuar 10 projekte investimi, me një vlerë totale prej 463,000 mijë lekë dhe ndërkohë janë çelur me ligjin e buxhetit 18 projekte, me një vlerë totale investimi prej 582,438 mijë lekë. Për programin 01130, sipas PBA-së nuk është planifikuar asnjë projekt dhe ndërkohë është çelur me ligjin e buxhetit 1 projekt, me vlerë investimi 400,000 mijë lekë.

Për programin 06190, sipas PBA-së janë planifikuar 2 projekte investimi, me një vlerë totale prej 250,000 mijë lekë dhe janë çelur me ligjin e buxhetit 2 projekte, por me një vlerë totale investimi prej 400,000 mijë lekë.

Tabela. Projektet të çelura që nuk shfaqen në PBA

në 000/lekë

Projekte të çelura por që nuk rezultojnë në PBA 2022-2024		
Kodi i projektit	Projekti	Vlera
18BP402	Zgjerimi i SIFQ tek njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	39,951
18BP218	Sigurimi i ndërlidhjes me sistemin e Fiskalizimit, për institucionet e MFE-së	242
M100177	Blerje pajisje zyrash	1,200
I Ri	Rikonstrukcion tualetesh në degën e thesarit Skrapar	561
18BP211	Furnizim, vendosje sistem ngrohje-ftohje 280 Kë +kondicionerë për degët e thesarit	16,975
18BP212	Furnizim, vendosje sistem ngrohje-ftohje 280 Kë +kondicionerë për degët e thesarit	15,195
M100013	Blerje pasjisje kompjuterike	8,030
M100007	Blerje pajisje (perde)	2,400
M100511	Blerje rafte arkivash	3,000
Totali për programin 0110		87,554
I Ri	Rritje e kapitalit për IBRD+IFC	400,000
Totali për programin 01130		400,000
18AY645	Shkoll. Prof "Antoni Athanasi" Sarandë	61,547
18AY505	Sistem sigurie me kamera për AKAFPK	731
Totali		549,832

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MFE-së

Sa më sipër rezultojnë diferenca në numër dhe në vlerë projektesh të planifikuara në PBA dhe të çelura me ligjin e buxhetit.

• Rishikimet e buxhetit

Për vitin 2022 plani i buxhetit për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në shpenzimet korrente dhe kapitale ka pësuar ndryshime (shtesa/pakësime), kryesisht me Akte normative, ku përmendim: AN nr. 3, datë 12.03.2022, AN nr. 12, datë 29.07.2022, AN nr. 17, datë 01.12.2022, AN nr. 19, datë 29.12.2022, gjithashtu edhe me VKM.

Nga auditimi i shkresave për rishpërndarjen e fondeve buxhetore u konstatua se kërkesa për rialokim fondesh për shpenzimet operative të Aparatit të MFE-së bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së dhe miratimi bëhet po nga Sekretari i Përgjithshëm. Nëpunësi i Parë Autorizues ushtron njëkohësisht edhe funksionet e Nëpunësit Autorizues të MFE-së, duke rezultuar në mbivendosje të kompetencave ku i njehti nëpunësi i lartë i administratës publike është përgjegjës për kërkesën, miratimin, raportimin dhe kontrollin duke lënë të kuptohet për një konflikt në dukje interesi në ushtrimin e funksioneve publike. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 19 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet: “Nëpunës autorizues, në njësitë e qeverisjes qendrore, është punonjësi i administratës publike i nivelit më të lartë të shërbimit civil. Për Ministrinë e Financave, nëpunësi i parë autorizues emëron një punonjës të nivelit të lartë të administratës publike si nëpunës autorizues” si dhe me Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”.

Buxheti i aparatit ka ndryshuar herë pas here në zërat e shpenzimeve korrente dhe kapitale sipas akteve normative për ndryshimin e ligjit të buxhetit.

Sipas shkresës nr. 24043/8 datë 30.12.2022 me Aktin Normativ nr. 19 janë çelur fonde buxhetore për Aparatin e MFE-së në vlerën 353,000,000 lekë konkretisht për: Produktin 91003AC-Vendime Gjyqësore të Ekzekutuara 43,000,000 lekë; Produktin 91001AE-Interesa për rimbursimin e vonuar 310,000,000 lekë. Sipas informacionit të marrë kjo çelje rezultoi për detyrimin që DPT ka ndaj Trans Adriatic Pipeline (TAP) në vlerën totale 806,618,673 lekë.

Sa më sipër çeljet për aparatit për produktet 91003AC dhe 91001AE **nuk janë në përputhje me qëllimin e hartimit të aktit normativ nr. 19**, qëllimi i të cilit ishte akordimi i një mbështetje financiare të menjëhershme për përballimin e inflacionit të luftës, për disa kategori në kuadër të mbylljes së vitit 2022.

• **Realizimi i planit të buxhetit**

Plani përfundimtar i buxhetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për vitin 2022, mbas ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit, rezulton në vlerën totale 79,362,952 mijë lekë, duke e krahasuar me çeljen e buxhetit në vlerë 65,473,059 mijë lekë, plani përfundimtar është rritur për shumën 13,889,893 mijë lekë, ose 21.2% më shumë.

Referuar të dhënave nga plani i rishikuar i vitit 2022, në shpenzimet korrente në krahasim me planin fillestar, ka ndryshime në rritje. Ndryshimet në drejtim të rritjes janë kryesisht në artikullin 606 të programit 06190 “Strehimi”, në vlerën 1,159,794 mijë lekë, artikulli 604 të programit “Sigurimi Shoqëror”, në vlerën 9,854,909 mijë lekë, artikulli 602 në programin “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme” në vlerën 437,554.5 mijë lekë etj.

Tabela në vijim paraqet realizimin e shpenzimeve për çdo program sipas planit të buxhetit të rishikuar për vitin 2022:

Tabela. Realizimi i shpenzimeve 2022

në 000/lekë

Programet	Fakti Viti 2021	PBA Plan Viti 2022	Plan Fillestar Viti 2022	Plan i Rishikuar viti 2022	Fakti 2022	Realizimi në %
01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,047,908	1,064,040	1,134,040	1,903,229	1,096,753	58%
01120 Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	342,740	393,120	374,120	358,681	346,509	97%
01130 Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	2,212,099	462,000	1,000,000	2,857,190	2,758,240	97%
01140 Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,919,874	3,183,000	2,892,640	3,897,079	3,811,023	98%
01150 Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	3,574,773	3,605,910	3,806,010	3,938,554	3,819,497	97%
01160 Lufta kundër Transaksioneve Jo-ligjore	62,524	90,400	80,400	74,175	70,267	95%
04130 Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	292,116	750,400	1,000,400	725,070	605,852	84%
04160 Mbështetje për Mbik. E Tregut, Infrast. e Cilësisë dhe pronës. Industriale	275,961	338,520	328,520	288,140	281,876	98%
10220 Sigurimi shoqëror	52,591,899	52,257,515	47,656,350	57,511,025	57,509,560	99.9%
10550 Tregu i Punës	2,466,302	2,250,600	2,430,600	2,043,145	2,003,451	98%
04170 Inspektimi në Punë	163,090	197,200	179,200	169,537	165,690	98%
09240 Arsimi i Mesëm (Profesional)	2,307,305	3,063,379	2,868,379	2,644,929	2,533,214	96%
06190 Strehimi	3,513,715	572,400	1,722,400	2,952,200	2,858,926	97%
Total i Shpenzimeve të Ministrisë	71,770,306	68,228,484	65,473,059	79,362,954	77,860,858	98%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MFE

Shpenzimet faktike totale të MFE-së paraqiten në vlerën 77,860,952 mijë lekë, krahasuar me planin e rishikuar prej rreth 79,362,952 mijë lekë (realizimi në masën 98%). Referuar programeve ku janë realizuar fondet e aparatit, rezulton se për programin 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” nga MFE janë realizuar fondet në vlerën rreth 1,096,753 mijë lekë krahasuar me planin prej 1,903,229 mijë lekë (58%). *Evidentohet një realizim i ulët i shpenzimeve të këtij programi*, ku efektin më të madh në mosrealizim e ka zëri 602 “Mallra dhe shpenzime të tjera”. Sipas raportit të monitorimit ky zë është planifikuar në vlerën 74,095 mijë lekë në planin fillestar dhe është rishikuar në rritje, duke rezultuar në plan vjetor të rishikuar në vlerën 1,062,395 mijë lekë. Ndërkohë realizimi është në vlerën 382,491 mijë lekë ose 36% e planit të rishikuar.

Për programin 01120 “Menaxhimi i Shpenzimeve Publike nga MFE” janë realizuar fondet në vlerën rreth 346,509 mijë lekë krahasuar me planin prej 358,681 mijë lekë (97%).

Për programin 01130 “Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme” janë realizuar fondet në vlerën rreth 2,758,240 mijë lekë krahasuar me planin prej 2,857,190 mijë lekë (97%).

Për programin 04130 “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik” janë realizuar fondet në vlerën rreth 605,852 mijë lekë krahasuar me planin prej 725,070 mijë lekë (84%).

Për programin 10220 “Sigurimi Shoqëror” janë realizuar fondet në vlerën rreth 57,509,560 mijë lekë krahasuar me planin prej 57,511,025 mijë lekë (99.9%).

Për programin 09240 “Arsimi i Mesëm Profesional” janë realizuar fondet në vlerën rreth 2,533,214 mijë lekë krahasuar me planin prej 2,644,929 mijë lekë (96%).

Për programin 06190 “Strehimi” janë realizuar fondet në vlerën rreth 2,858,926 mijë lekë krahasuar me planin prej 2,952,200 mijë lekë (97%).

Për programin 01110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, nga projektet e realizuara për vitin 2022 konstatohet se nga 13 projekte investimi me financim të brendshëm, 8 projekte kanë qenë të pa planifikuara në fazën e I dhe të II të PBA-së 2022-2024. Për programin

01130 “Ekzekutim i pagesave të ndryshme”, konstatohet se projekti i investimit 18AV703 "Transferta kapitale për IBRD dhe IFC" nuk ishte planifikuar deri në fazën e dytë të PBA-së. Me ligjin e vitit 2022 ai është çelur në vlerën 400,000 mijë lekë, është rishikuar duke u pakësuar në 200,000 mijë lekë dhe rezultoi i pa realizuar. Për programin 04130 “Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik”: Projekti i investimit M100332 "TVSH për projekte me financim të huaj" është çelur në vlerën 20,000 mijë lekë dhe nuk ka evidencë në aneksin e monitorimit për realizimin. Për programin 09240 “Arsimi i Mesëm Profesional”: Projekti i investimit 18AY505 “Sistem sigurie me Kamera për AKAFPK" edhe pse është projekt në vijimësi, nuk rezultoi në fazën e I dhe II të PBA-së 2022-2024 dhe më pas është çelur në vlerën 730,500 mijë lekë dhe është realizuar vetëm 60% e buxhetit në dispozicion, në vlerën 449,000 lekë, duke mos u alokuar diferenca në projekte të tjera. Projekti 18AY645 “Rikonstruksion i shkollës Prof Antoni Athanasi Sarandë” edhe pse është projekt në vijimësi, nuk rezultoi në fazën e I dhe II të PBA-së 2022-2024, më pas është çelur në vlerën 61,546 mijë lekë, është rishikuar në vlerën 62,937 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 61,250 mijë lekë.

Sa më sipër nga auditimi u konstatuan projekte për aparatit e MFE-së të cilat edhe pse janë në vijimësi, nuk planifikohen në fazën e parë dhe të dytë të PBA-së 2022-2024.

Monitorimi i buxhetit të vitit 2022 për Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Në zbatim të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka hartuar raportet e monitorimit të buxhetit sipas anekseve me detajimin e treguesve buxhetore dhe performancën e produkteve së bashku me relacionet shpjeguese me shkresat si më poshtë:

-Me shkresën nr. 9631/22, datë 31.05.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm është përcjellë raporti 4 mujor i monitorimit të buxhetit, brenda afateve kohore.

- Me shkresën nr. 16750/50, datë 29.09.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm është përcjellë raporti 8 mujor i monitorimit të buxhetit, brenda afateve kohore.

-Me shkresën nr. 2016/47, datë 28.02.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm është përcjellë raporti 12 mujor i monitorimit të buxhetit, brenda afateve kohore.

Nga auditimi konstatohet se aparati i MFE, si njësi shpenzuese **nuk harton raporte monitorimi për fondet e planifikuara dhe realizuara vetëm nga aparati**. Evidentohet se aparati i MFE-së realizon pagesa dhe në programe të tjera ku përfshihen dhe institucione (të tilla si DPTH, EKB, AIDA, QKB etj). Në këtë rast nuk mundësohet identifikimi i buxhetit që administrohet vetëm nga aparati i MFE. Kjo situatë, ku nuk kryhet krahasimi i treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik për shpenzimet e realizuara vetëm nga aparati, mund të bëhet shkak për të ndjekur arritjen e qëllimit me objektivat e synuar sipas deklaratës së politikës së programit për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, duke kryer në kohë propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve.

-Raporti i monitorimit i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për vitin 2022 nuk është publikuar në faqen e saj zyrtare, në kundërshtim me udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit”, kapitulli VI, pika 271 dhe udhëzimin nr. 22 datë 17.11.2016.

-Për institucionin e varësisë “Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)” evidentohet mospërputhje ndërmjet realizimit të buxhetit sipas të dhënave të pasqyrave financiare/raportit të monitorimit dhe sipas planit të pagesave në SIFQ. Konkretisht: sipas shpjegimeve të pasqyrës së performancës financiare transferimet korente në bazë të VKM-së nr. 480 datë 13.07.2022 “Për miratimin e dhënies së granteve për startup-et dhe lehtësuesit e

startup-eve, i ndryshuar rezultojnë 300,000,000 lekë me një fakt realizimi prej 274,543,706 lekë në përfundim të procesit. Gjithashtu sipas raportit të monitorimit realizimi i zërit 604 “Transferta korente të brendshme” pasqyrohet në vlerën 274,543,706 lekë. Ndërkohë sipas databazës së pagesave, për llogarinë 604 për projektet 91007AP dhe 91007AA, pagesat rezultojnë në vlerën 197,939,989 lekë. *Evidentohet diferenca prej 76,603,717 lekë.*

Në bazë të VKM-së nr. 618 datë 22.09.2022 fitues lehtësues të startup-eve rezultojnë disa bashki (Korçë, Dimal, Bulqizë, Pukë, Shkodër, Malësi e Madhe, Roskovec) të cilave nuk iu janë alokuar fonde referuar databazës së pagesave që AIDA ka realizuar gjatë vitit.

Sa më sipër evidentohet pasqyrim i pasaktë i raportit të monitorimit të institucionit, e cila sjell mungesë besueshmërie të të dhënave të raportuara dhe mungesë transparence. Ky veprim rezulton nuk është në përputhje me pikën 49, kapitulli 4, të udhëzimit nr. 22 datë 17.11.2016 ku citohet: *“Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe institucionet konsiston në paraqitjen e informacionit sipas kërkesave të përcaktuara në udhëzim duke- Plotësuar formatet e përcaktuara në këtë udhëzim ku të dhënat janë të rakorduara me planin e buxhetit dhe realizimin në fakt të thesarit sipas SIFQ.”*

Sa më sipër mban përgjegjësi Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues i institucionit.

Titulli i gjetjes:	Problematika në lidhje me përgatitjen e dokumentit të Programit Buxhetor për MFE dhe rishikimet e shpeshta të fondeve përgjatë vitit
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentit të PBA-së së hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për periudhën objekt auditimi, u konstatua se fondet në programet e planifikuara dhe shpenzuara nga aparati i MFE, nuk janë të përfshira në një program të vetëm, por ato janë pjesë e programeve ku përfshihen edhe fondet e njësisve të tjera shpenzuese. Aparati si njësi shpenzuese, nuk ka përgatitur dhe dorëzuar më vete kërkesat për programin buxhetor afatmesëm PBA 2022-2024.</p> <p>-Nga auditimi konstatohen rishikime të shpeshta të fondeve, situatë që reflekton mangësi në planifikimin efektiv të buxhetit të institucionit, duke u bërë shkak për rishikime të shpeshta të fondeve.</p> <p>- Nga auditimi u konstatua së në listën e investimeve publike për aparatin e MFE nuk janë përfshirë 5 projekte të cilët janë në vijim nga vitet e mëparshme, si dhe 6 projekte të reja të çelura në fillim të vitit, nuk rezultojnë të përfshira në listën e investimeve publike të miratuara në projekt buxhet.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”;</p> <p>Udhëzimi nr. 8 datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”</p> <p>Udhëzimi plotësues nr. 19, datë 09.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”</p> <p>Udhëzimi nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kreu I pika 72, 73, 74,75;</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Mos planifikimi i kërkesave buxhetore dhe kërkesave shtesë më vetë për Aparatin, si njësi shpenzuese e bën të vështirë ndjekjen e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të shpenzimeve përkatëse.</p> <p>Rishikimet e shpeshta të fondeve shkaktojnë impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit pasi numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore përbën një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit;</p>
Shkaku:	<p>Kërkesa buxhetore të hartuara në bazë programi;</p> <p>Rishikimet e shpeshta të fondeve që konsistojnë në shtime/pakësime për financimin e investimeve për shkak të problematikave në planifikim.</p>

Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Sektori i Buxhetit të marrë masa për hartimin e kërkesave buxhetore për aparatit si njësi shpenzuese më vete si dhe të marrin masa për hartimin e dokumentit të PBA-së për MFE konform udhëzimeve përkatëse. -Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të merren masa për planifikim efektiv të fondeve me qëllim shmangien e ndryshimeve/rishikimeve të shpeshta tregues ky negative për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e raportit të monitorimit për Aparatin si njësi shpenzuese dhe mospërputhjet në raportin e monitorimit të AIDA-s
Situata:	Nga auditimi konstatohet se, aparati i MFE, si njësi shpenzuese më vete nuk harton raporte monitorimi për fondet e planifikuara dhe realizuara, pasi kryen pagesa dhe nëpërmjet programeve të tjera, ku përfshihen dhe institucione (të tilla si DPTH, EKB, SHMP, AIDA, QKB etj), duke mos mundur identifikimin e buxhetit që administrohet vetëm nga aparati i MFE. Referuar raportit të monitorimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) evidentohet mospërputhje ndërmjet realizimit të buxhetit sipas të dhënave të pasqyrave financiare/raportit të monitorimit dhe pagesave në SIFQ. Konkretisht, sipas raportit të monitorimit dhe pasqyrave financiare të agjencisë zëri 604 “Transferta korrente të brendshme” për projektet 91007AP dhe 91007AA, parashikuar me VKM nr. 480 datë, 13.07.2022 “Për miratimin e dhënies së granteve për startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve”, për 300,000,000 lekë, është realizuar në shumën 274,543,706 lekë. Ndërsa sipas databazës së pagesave të thesarit, pagesat për këto projekte rezultojnë në shumën 197,939,989 lekë, me një diferencë prej 76,603,717 lekë, mosrakordim i cili nuk është monitoruar nga strukturat përkatëse të MFE.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar . Udhëzimi nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, pika 49
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e raporteve të monitorimit të buxhetit për aparatit e MFE e vështirëson ndjekjen e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, nuk bëhet i mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve të aparatit është në përputhje me planin, në mënyrë që të kryhen propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve. Mos publikimi i raportit të monitorimit për MFE nuk garanton transparencën institucionale.
Shkaku:	Mungesa e raporteve të monitorimit të buxhetit për programet e menaxhuara nga aparati i MFE si njësi shpenzuese, por përfshirja e tyre në raportin përmbledhës; Mos publikimi i raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të MFE.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Sektori i Buxhetit të marrë masa për hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit për aparatit si njësi shpenzuese, për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit. Për mospërputhjet e evidentuara në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) rekomandohet të ushtrohet një mision auditimi nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

2.E.2. Mbi administrimin e burimeve njerëzore në përputhje me kuadrin rregullator.
Gjatë auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Struktura organizative e ministrisë miratuar me urdhër të Kryeministrit,
- Rregullorja e brendshme e MFE,
- Dosjet e personelit.
- Informacione të marra nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori Ligjor dhe Financës mbi databazën e vendimeve gjyqësore për të larguarit nga puna.
- Listë pagesat dhe listë prezencat për MFE.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka funksionuar në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 89, datë 13.06.2018 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*”.

Me këtë urdhër është miratuar Struktura e Ministrisë sipas skemave 1 dhe 2 bashkangjitur urdhrit, me 334 punonjës gjithsej, nga të cilët me status nëpunësi civil janë 281 punonjës dhe 53 punonjës me kontratë pune 1 vjeçare.

Struktura përbëhet nga 8 Drejtori të Përgjithshme dhe 6 Drejtori, konkretisht sipas skemës së miratuar: Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale; Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit; Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit; Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të ndihmës së huaj; Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë; Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik; Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Shtetërore; Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse; Drejtoria e Fondit Kombëtar; Drejtoria Mbështetëse ZKA; Drejtoria e Apelitimit Tatimor; Drejtoria AMFIS; Drejtoria e Auditimit të Brendshëm; Drejtoria e Menaxhimit të Reformës së Financave Publike.

Me urdhrin nr. 140, date 26.08.2022 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*”, është miratuar struktura e ministrisë sipas skemave nr. 1 dhe nr. 2 me 432 punonjës.

Nga auditimi u konstatua se, referuar të dhënave mbi strukturat organike për vitin 2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, rezulton se në fund të vitit janë 381 punonjës, pra një numër i konsiderueshëm vendesh vakante prej 51 vende (dhjetor 2022), i shpërndarë në drejtori të ndryshme, fenomen i cili tregon për planifikime dhe ndërveprime jo të kujdesshme me DAP. Performanca e disa drejtorive me pak punonjës ndikon në evidencën e funksionimit të këtyre drejtorive apo sektorëve. Diferenca e numrit të punonjësve nga plani në fakt lë hapësirë interpretimi me faktin se puna e pozicioneve vakante kryhet nga punonjësit ekzistues të cilët mbingarkohen me funksione shtesë që nuk janë kompetencë e tyre dhe kështu riskon të cenohet performanca dhe cilësia e punës.

Rregullorja e brendshme.

Nga auditimi konstatohet se Ministria Financës dhe Ekonomisë për periudhën objekt auditimi ka funksionuar me Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të miratuar me Urdhrin nr. 52, datë 10.03.2021 të ministrit, e cila është ndryshuar në maj 2023, për t’ju përshtatur dhe strukturës së miratuar në muajin gusht 2022.

Pagat dhe sigurimet shoqërore.

Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave, për periudhën objekt auditimi, rezultoi se pagat e punonjësve janë vendosur sipas funksionit dhe kategorisë konform ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar, VKM nr. 187, datë 08.03.2017, VKM nr.

202, datë 15.3.2017 të ndryshuar. VKM nr. 893, datë 17.12.2014, Ligjin Nr. 10405, datë 24.03.2011, i ndryshuar.

Në funksion të auditimit të respektimit të dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, etj, u përzgjedhën në bazë risku praktikat dokumentare që shoqëronin shpenzimet e kryera për muajt shtator-dhjetor dhe nuk u konstatuan problematika.

Nga ana e strukturave përgjegjëse është hartuar regjistri themeltar i punonjësve dhe libri i personelit, ndërkohë që vendimet e emërimit, transferimit, ndryshimit të kategorisë dhe largimit nga detyra janë të pasqyruara në format Excel. Tabela e vjetërsisë në punë të punonjësve rishikohet për çdo muaj.

Nga analiza e listë pagesave të punonjësve të zgjedhur për muajt shtator-dhjetor 2022, u konstatua se, janë llogaritur sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017, me ndryshime. Gjithashtu janë llogaritur saktë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi.

*Ndërsa nga auditimi i pagave dhe shtesave për natyrë të veçantë pune të punonjësve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u konstatua, se nuk ka pasur një trajtim të barabartë të punonjësve që përfitojnë shtesën mbi pagën mujore për natyrë të veçantë pune, problematikë e trajtuar edhe nga auditimi i mëparshëm në Raportin Përfundimtar dërguar në Ministrinë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 94/19, datë 30.09.2021, ku është lënë rekomandimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet strukturave përkatëse në varësi të saj të marrë masa për rregullimin e situatës duke reflektuar saktë në pagesën e pagës dhe shtesës mbi pagë për natyrë të veçantë pune sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi për një trajtim të barabartë të nëpunësve të Drejtorisë Auditimit Brendshëm dhe Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse*”. Ky rekomandim rezultoi të jetë zbatuar pjesërisht me urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 286, datë 29.12.2022, sipas të cilit nëpunësit civil të Drejtorisë Auditimit Brendshëm dhe Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse kanë përfituar 10,000 lekë në muaj shtesën për natyrë të veçantë pune për periudhën 01.01.2018-01.12.2021.*

Pra, konstatohet se pas datës 01.12.2021, në mënyrë të paargumentuar nuk përfshihen në përfitimin e kësaj shtese nëpunësit civil të këtyre strukturave, në kundërshtim me pikën 4/12 të VKM-së Nr. 187, datë 8.3.2017, e ndryshuar “*Për miratimin strukturës së dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve...*”, me arsyetimin se këto struktura janë cilësuar njësi teknike të përmbajtjes.

Interpretimi dhe kuptimi i njësive teknike të përmbajtjes është përcaktuar me VKM nr. 711, datë 24.11.2021, shtesë e VKM-së nr. 187, datë 8.3.2017 konkretisht;

“Njësitë teknike të përmbajtjes, njësitë/drejtoritë/sectorët e përmbajtjes dhe drejtoritë/sectorët teknikë janë ata/ato, që realizojnë funksionet për të cilat është krijuar dhe funksionon institucioni. Në to nuk përfshihen strukturat organizative përgjegjëse për funksionet horizontale të institucionit, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Konstatohet se, në VKM-së nr. 187, datë 8.3.2017, e ndryshuar, ka disa pozicione në administratën publike që janë sipas legjislacionit të sipërpërmendur, janë pjesë e struktura horizontale dhe përfitojnë shtesë për natyrë të veçantë pune si më poshtë:

-Sipas lidhje 6.7 kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të punonjësve të sistemit doganor përfitojnë shtesë për natyrë të veçantë pune pozicionet e punës auditues, financier, jurist.

-Sipas lidhjes 6.8 nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve përfitojnë shtesë për natyrë të veçantë pune të gjitha pozicionet sipas strukturës së miratuar pozicionet e financës, buxhetit, prokurimeve, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, etj.

Këto pozicione të punës të mësipërme dhe jo vetëm (kemi trajtuar vetëm këto dy institucione, njësi varësie e MFE), edhe pse janë struktura organizative përgjegjëse për funksionet horizontale të institucionit, kanë përfituar dhe përfitojnë në vazhdimësi shtesa për natyrë të veçantë pune.

Ndërsa, sipas legjislacionit në fuqi kuptimit për funksionet horizontale nëse i referohemi akteve të mëposhtme gjejmë:

-Në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” në pikat 1-4 të nenit 16 përcakton strukturat përgjegjëse për funksionet horizontale, si më poshtë:

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore, çështjet juridike, mirëmbajtja dhe shërbimet e tjera mbështetëse kryhen të gjitha së bashku nga një strukturë administrative, në vijim "shërbimet e brendshme mbështetëse", që i raporton drejtpërdrejt sekretarit të përgjithshëm.

2. Funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar, më poshtë "funksionet e financave", kryhen të gjitha së bashku nga një strukturë administrative, që i raporton drejtpërdrejt sekretarit të përgjithshëm.

3. Funksionet e auditimit të brendshëm kryhen nga një strukturë administrative që i raporton drejtpërdrejt titullarit.

4. Njësitë e parashikuara në pikat 1, 2 e 3 të këtij neni organizohen në sektorë, drejtori apo drejtori të përgjithshme, në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të detyrave përkatëse.

Pra, qëllimi i këtij ligji është organizimi dhe funksionimi i administratës shtetërore dhe nuk ka të bëjë me aplikimin apo mosaplikimin e shtesave për natyrë të veçantë pune për nëpunësit civil në administratën publike.

Ndërsa, në VKM-së nr. 305, datë 05.04.2017 “Për disa shtesa në VKM-në nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” pika 12/1 përcaktohen grupet e pozicioneve pjesë të struktura horizontale si më poshtë:

- Specialistë të financës;
- Specialistë të buxhetit;
- Specialistë të prokurimeve;
- Specialistë të burimeve njerëzore;
- Specialistë arkiv/protokoll;
- Specialistë të marrëdhënieve me publikun;
- Specialistë jurist;
- Specialistë të teknologjisë së informacionit;

Sa më sipër, argumentimi se nëpunësit e Drejtorisë Auditimit Brendshëm dhe Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk mund ta përfitojnë pasi janë struktura horizontale është i pasaktë.

E njëjta situatë paraqitet edhe pas daljes së VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin strukturës së pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë...”, ku nëpunësit në njësitë organizative të përmbajtjes në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë referuar pikës lidhjes 3 pika 7/d, përfitojnë masën 10,000 lekë shtesë për natyrë të veçantë pune.

Konstatohet se, për këtë problematikë ka raste në të cilën nëpunës civil të Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë, pjesë e këtyre strukturave, kanë referuar çështjen në gjykatën administrative, ku gjykata ka vendosur trajtimin e nëpunësit me shtesën e pagës 10,000 lekë nga data 01.12.2021 e në vijimësi, referuar Vendimit të Gjykatës Administrative nr. 1387(80-2023-1420) datë 05.06.2023.

Nga auditimi i listë pagesave u konstatua se:

- Listë pagesat janë plotësuar nga punonjësi i caktuar për hartimin e pagave, Specialisti i Financës. Ato janë nënshkruar nga Nëpunësi Zbatues (Drejtori Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar) dhe Nëpunësi Autorizues (Sekretari i Përgjithshëm), konform pikës 69 të

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik”. Listë pagesat nënshkruhen nga punonjësi i caktuar për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

- Listëpagesat janë të plotësuar me të gjitha të dhënat sipas VKM-së pagave (Paga e kategorisë, paga e grupit, vjetërsia për vite pune, si dhe shtesat e tjera të përfituara nga pozicioni i punës)

Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për periudhën objekt auditimi:

Llogaria	Plani fillestar	Plani i rishikuar	Fakt	% e realizmit
600	441,479	434,732	426,434	98.1 %
601	100,928	70,366	68,843	97.8%
	542,407	505,098	495,277	98%

Burimi Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se fondi i pagave është realizuar në masën 98.1% e planifikimit edhe pse rezultojnë vakanca të konsiderueshme që vjen si rezultat e rialokimit të fondeve por dhe të mbulimit të shpenzimeve për paga nga rritja e për disa pozicione në MFE me VKM nr. 621, datë 28.09.2022.

Shpenzimet gjyqësore për largim të padrejtë të punonjësve nga puna

a- Nga auditimi u konstatua se për vitin 2022 në aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë kryer likuidime për Vendime Gjyqësore të formës së prerë për ish-punonjës të larguar nga puna përpara vitit 2022, **për 5 punonjës, gjithsej në vlerën 13,568,651 lekë (paga në shumë 5,901,429 dhe sigurime shoqërore në shumën 7,667,222 lekë) duke sjellë efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.**

Veprime të cilat janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 60 në të cilën përcaktohet se: “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësisë të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa miratimin e titullarit.”.

b- Drejtoria e Buxhetit dhe Financës i ka vënë në dispozicion grupit të auditimit databazën e vendimeve gjyqësore të ekzekutuara dhe përlllogaritjen e detyrimit për çdo gjyq fitues, e cila nuk është publikuar në faqen zyrtare të MFE apo në forma të tjera, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Kryeministrit nr. 1 datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” pika 4 dhe 5 në të cilën thuhet se “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar”. Mos dokumentimi i një evidence zyrtare krijon kushtet për keq planifikim buxhetor apo akumulim interesash kundrejt gjyq fituesve.

c. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, Komisioni i Posaçëm i Shqyrtimit të Kërkesave për Ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore të formës së prerë, ngritur me urdhrin e Ministrit nr. 151, datë 26.04.2019, i ndryshuar me këtë përbërje: z.A.GJ., kryetar dhe anëtarët z.F.H., znj.R.M. dhe znj.Sh.N., gjatë vitit 2022 është mbledhur 3 herë për shqyrtimin e ankesave (në dy raste për gjyqfituesen Laureta Ahmeti dhe në një rast për z. U.M.), por pa dalë me vendim për sistemimin e tyre me arsyetimin se: “...aktualisht institucioni jonë është në ristrukturim. Për këtë arsye, lidhur me sistemimin e gjyqfituesve, do të ndërmerren masa e duhura për ripropozimin e tyre, gjatë procesit të ristrukturimit”.

Rekrutimi i punonjësve

- Nga auditimi rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë rekrutuar gjithsej 73 punonjës, nga këta 31 punonjës me kontratë, përkatësisht: 11 punonjës me emërim, janë pranuar nga jashtë 8 punonjës, janë rikthyer nga pezullimi 4 punonjës, me lëvizje paralele 10 punonjës, 3 punonjës me ngritje në detyrë dhe nga Ekselencia bashke me Gati për Shqipërinë 6 punonjës, etj. Gjatë vitit 2022 janë larguar gjithsej 46 punonjës, nga këta 13 me kontratë, si: liruar me dorëheqje e10 punonjës, 5 punonjës për dalje në pension, 9 punonjës kanë bërë pezullim statusi, lirim 4 punonjës dhe me masë disiplinore janë larguar dy punonjës.

- Nga auditimi u konstatua se, **punonjësit me kontratë të përkohshme** nuk bëhen pjesë e strukturës organike, por pavarësisht kësaj ata kryejnë funksionet e pozicionit duke u paguar gjithashtu me të njëjtën kategori page sipas VKM nr. 187, datë 08.03.2017 dhe VKM Nr. 202, datë 15.03.2017.

Administrimi i dosjeve individuale të punonjësve.

Gjatë procesit të verifikimit me zgjedhje (8 nëpunës) të dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit rezulton se janë plotësuar dokumentet sipas kërkesave të përgjithshme dhe specifike për vendin e punës (fotokopje e dokumenteve të identifikimit si ID apo pasaportës, diploma e shkollës së lartë, bachelor apo master së bashku me listën e notave të noterizuar, akti i emërimit, certifikata trajnimesh, librezë e punës, etj, në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. Dosja përbëhet nga dokumente me të dhënat personale, të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara sipas lidhjes 1 dhe 2, që janë pjesë e aktit nënligjor që rregullon këtë aspekt. Secila dosje është e inventarizuar me fletën e inventarit dhe përmban fletën prezantuese të dosjes teknike të nëpunësit.

Fleta e inventarit është firmosur nga nëpunësi, ndërsa në disa prej dosjeve fleta prezantuese nuk përmbante të gjitha të dhënat e përcaktuara në lidhjen 2 të VKM Nr. 117, datë 05.03.2014 dhe VKM nr. 833, datë 28.10.2020.

Nga auditimi i dosjeve të personelit në lidhje me rekrutimet e reja për periudhën objekt auditimi nuk janë konstatuar problematika në lidhje me plotësimin e kriterëve sipas pozicioneve të punës. Grupi i auditimit testoi nivelin e diplomës sipas dokumentacionit bashkëlidhur dosjes me pagesën e kryer nga Drejtoria e Financës dhe nuk u konstatuan mospërputhje midis nivelit të pagesës dhe diplomës.

Titulli i Gjetjes:	Trajtim jo i barabartë me shtesa mbi pagë.
Situata:	<p>Nga auditimi i pagave dhe shtesave për natyrë të veçantë pune të punonjësve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u konstatua, se nuk ka pasur një trajtim të barabartë të punonjësve që përfitojnë shtesën mbi pagën mujore për natyrë të veçantë pune, problematikë e trajtuar dhe lënë rekomandim edhe nga auditimet e mëparshme, i cili rezultoi të jetë zbatuar pjesërisht me urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 286, datë 29.12.2022, sipas të cilit nëpunësit civil të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse kanë përfituar 10,000 lekë në muaj shtesën për natyrë të veçantë pune për periudhën 01.01.2018-01.12.2021.</p> <p>Pas datës 01.12.2021, në mënyrë të paargumentuar nuk përfshihen në përfitimin e kësaj shtese nëpunësit civil të këtyre strukturave, në kundërshtim me pikën 4/12 të VKM nr. 187, datë 08.03.2017, e ndryshuar “Për miratimin e strukturës së dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve...”, me arsyetimin se këto struktura janë cilësuar njësi teknike të përmbajtjes, referuar legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, në vendim ka disa pozicione në administratën publike, të strukturave horizontale, pjesë e njësive të varësisë së MFE, që përfitojnë</p>

	<p>shtesë për natyrë të veçantë pune, referuar lidhjeve 6.7 dhe 6.8, duke sjellë nja pabarazi në trajtimin e punonjësve të strukturave të sipërcituara të Aparatit të MFE .</p> <p>Trajtim i diferencuar i këtyre punonjësve paraqitet edhe pas daljes së VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin strukturës së pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë...”.</p> <p>Kjo qasje është nxjerrë në fokus edhe nga Gjykata Administrative, konkretisht në Vendimin nr. 1387(80-2023-1420) datë 05.06.2023. ku është vendosur trajtimin e nëpunësit me shtesën e pagës 10,000 lekë nga data 01.12.2021 e në vijimësi.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - VKM nr. 187, datë 8.03.2017, e ndryshuar ‘Për miratimin strukturës së dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve...’, pika 4.12 - VKM-së nr. 305, datë 05.04.2017 “Për disa shtesa në VKM-në nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” pika 12/1. - VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 ‘Për miratimin strukturës së pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë...’, pika 7/d, lidhja 3
Efekti:	Trajtim i pabarabartë i punonjësve të institucionit.
Shkaku:	Mos argumentim i saktë i kërkesave të dispozitave nënligjore për pagat
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet strukturave përkatëse në varësi të saj të marrë masa për rregullimin e situatës, duke reflektuar saktë në pagesën e pagës dhe shtesës mbi pagë për natyrë të veçantë pune sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, për një trajtim të barabartë të nëpunësve të strukturave të saj.

Titulli i Gjetjes	Efekte financiare negative në buxhetin e shtetit në vlerën 13,568,651 lekë për likuidime të Vendimeve Gjyqësore të formës së prerë për ish-punonjës të larguar padrejtësisht nga puna.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se për vitin 2022 në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë kryer likuidime për Vendime Gjyqësore të formës së prerë për ish-punonjës të larguar nga puna për shkaqe të pa përligjura përpara vitit 2022, për 5 punonjës, gjithsej në vlerën 13,568,651 lekë (paga në shumën 5,901,429 dhe sigurime shoqërore në shumën 7,667,222 lekë), duke shkaktuar efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit, për të cilët nuk janë analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë nga titullari, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 60.
Kriteri:	Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 60.
Efekti:	Largime të padrejta nga puna
Shkaku:	Vendimmarrja e gabuar dhe mos zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi nga ana e titullarëve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Nëpunësi Autorizues të marrë masa të menjëhershme për analizimin e të gjitha vendimeve gjyqësore dhe të nxjerrë përgjegjësitë ligjore e administrative ndaj personave shkaktar të krijimit të efektit financiar negativ në buxhetin e shtetit për largime të padrejta nga puna në zbatim të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018.

2.E.3. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave për punë, mallra dhe shërbime.

Nga auditimi konstatohet se Autoriteti Kontraktor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë për blerjen e mallrave e shërbimeve dhe kryerjen e investimeve ka kryer 25 procedura prokurimi si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Fondi limit		Kontratat e lidhura	
		Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	Procedurë e hapur	5	388,866,798	5	356,152,651
2	Procedurë e kufizuar	4	6,070,881	4	3,604,850
3	Blerje me sistem dinamik	1	15,000,000	1	11,893,062
4	Blerje me vlera të vogla	15	13,300,260	15	8,783,597
	TOTALI	25	423,237,939	25	339,434,160

Nga auditimi ka rezultuar:

1. Prokurimi me objekt: “Ndërtim i Bazës Prodhuese në Shkollën “Beqir Çela”, Durrës”, me REF-34550-06-28-2022, “procedurë e hapur”, prokurim elektronik, me fond limit 126,163,061 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë: 22/07/2022, ora 13:00 në www.app.gov.al

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Ndërtim i Bazës Prodhuese në Shkollën “Beqir Çela”, Durrës”		
1. Urdhër Prokurimi nr.12120 prot., datë 20.06.2022 Njësia e prokurimit : A.N. personi përgjegjës për prokurimet, N.Z., ekonomiste, A.H., inxhinier	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, nr.16179/4 prot., datë 02.09.2022 i përbërë : A.G., kryetar B.T., anëtar Ing. R.B., anëtare
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar e		
5. Fondi Limit Lot 1 (pa tvsh) 126,163,061 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) BOE “A.” SHPK NUIS J.....Q & “E.” SHPKNJ me NUIS L.....G me ofertë ekonomike 106,808,581 (Njëqind e gjashtë milion e tetëqind e tete mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë, pa TVSH	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 19,354,480 lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 15.07.2022, ndryshohet 22.07.2022	3	10. Operatorët Ekonomike 1. BOE “B.” SHPK NUIS J.....B & “LL.” SHPK me NUIS K.....K me ofertë 105,006,277 (njëqind e pesë milionë e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH (skualifikuar) 2. BOE “R. C.” SHPK NUIS L.....A & “B.... N.” SHPK me NUIS K.....O me ofertë 113,185,761.63 (njëqind e trembëdhjetë milionë njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH . (skualifikuar) 3. BOE “E.” SHPK NUIS K.....P & “B.” SHPK me NUIS K....A me ofertë 115,440,172 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë e katërqind e dyzet mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH (skualifikuar) 4. BOE “A. C.” SHPK NUIS K....F & “C.R.” SHPK me NUIS K.....V me ofertë 119,315,395.15 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë pikë pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH (skualifikuar) 5. BOE “A.” SHPK NUIS J.....Q & “E.” SHPKNJ me NUIS L.....G me ofertë ekonomike 128,170,297 (Njëqind e njëzet e tete milion e njëqind e shtatëdhjetë mije e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë, pa TVSH
11. Ankimime po	12. Përgjigje Ankesës nga AK Po	13 Përgjigje Ankesës nga KPP Po
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Kontrata me nr.12120/9 prot, datë 21.09.2022 midis MFE-së dhe operatorit eko fitues BOE “A.” SHPK NUIS J.....Q & “E.” SHPKNJ me NUIS L.....G me ofertë ekonomike 128,170,297 (Njëqind e njëzet e tete milion e	15. Zbatimi i kontratës: Me urdhrin nr.12120/13prot., datë 0911.2022 është caktuar personi për ndjekjen e zbatimit të kontratës B.T., ndryshuar. Kontratë në vazhdim	

a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit mbi përlogaritjen e fondit limit, konstatohet:

Si objekt i punës së këtij projekti është ndërtimi i bazës prodhuese, projekti dhe preventivi I objektit është hartuar nga studio projektimi, nëpërmjet procedure prokurimi, por në dosjen e procedurës nuk ndodhet.

b-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit mbi kapacitetet teknike, konstatohet:

Nga auditimi në lidhje me hartimin e miratimin e DST, rezulton se, nga Njësia e Prokurimit (NjP) me procesverbalin e datës 29.06.2022 janë miratuar Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) në të cilën janë përcaktuar dhe kriteret e veçanta për kualifikim.

Konstatohet se AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të argumentonte teknikisht dhe ligjërish çdo kriter të vendosur duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Nga NjP për kriteret e vendosura, citohet vetëm baza ligjore: neni 77, i ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik “i ndryshuar. Nga auditimi në SPE dhe dosjen fizike konstatohet se Njësia e Prokurimit ka bërë dy modifikime, referuar ankesave dhe kërkesës së APP, pasi janë konstatuar vendosje të kriterëve kufizues të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në procedurë.

c-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE “B.” SHPK NIPT J.....B & “LL.” SHPK me NIPT K.....K Vlera: 105 006 277 (njëqind e pesë milionë e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë PA TVSH;
2. BOE “A.” SHPK NIPT J.....Q & “E.” SHPKNJ me NIPT L.....G Vlera: 106 808 581 (njëqind e gjashtë milionë e tetëqind e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë PA TVSH;
3. BOE “R. C.” SHPK NIPT L.....A & “B.N.” SHPK me NIPT K.....O Vlera: 113 185 761.63 (njëqind e trembëdhjetë milionë njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë PA TVSH;
4. BOE “E.” SHPK NIPT K.....P & “B...” SHPK me NIPT K....A me vlerë 115 440 172 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë e katërqind e dyzet mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë PA TVSH .
5. BOE “A. C.” SHPK NIPT K....F & “C.R.” SHPK me NIPT K....V Vlera: 119 315 395.15 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë pikë pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga KVO janë skualifikuar 4 OE për mosplotësim të kërkesave për kualifikim dhe ka kualifikuar e shpallur fituese BOE “A.” SHPK NIPT J.....Q & “E.” SHPK me NIPT L.....G me ofertë në vlerën 106,808,581 (njëqind e gjashtë milionë e tetëqind e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH, si oferta më e suksesshme.

Me datë 22.08.2022 me shkresën nr. 12120/7 është bërë njoftimi i fituesit dhe me datë 21.09.2022 është lidhur kontrata nr. 12120/9 me afat realizimi 26 javë nga nënshkrimi.

Nga verifikimi i dosjes elektronike dhe fizike të BOE fitues në plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, nuk u konstatuan devijime dhe kriteret ishin në përputhje me ato të vendosura nga NjP.

2. Prokurimi me objekt: Rikonstruksion i Shkollës Profesionale “Herman Gmeiner”, Tiranë, REF-32778-06-14-2022, “procedurë e hapur”, prokurim elektronik, me fond limit prej 28,003,885.4 (njëzet e tetë milionë e tremijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë pikë katër) lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë: 05/07/2022, ora 13:00 në www.app.gov.al me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rikonstruksion i Shkollës Profesionale “Herman Gmeiner”, Tiranë		
1. Urdhër Prokurimi nr.9106/2 prot., datë 01.06.2022 Njësia e prokurimit: A.N. personi përgjegjës për prokurimet , N.Z., ekonomiste, A.H. -inspektor	3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, nr. 9106/7 prot., datë 17.06.2022 i përbërë: A.G., kryetar B.T., anëtar R.B., anëtar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 28,003,885.4 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) “M. K. & R.” SHPK me nr.NUIS-i K.....A me ofertë ekonomike 26 634 099.5 (njëzet e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëdhjetë e nëntë pikë pesë) Lekë PA TVSH	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Lekë
8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 05.07.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike 1. Operatori Ekonomik “2.” SHPK, me numër NUIS L.....L me vlerë 24,416,921 lekë pa TVSH (skualifikuar). 2. Operatori Ekonomik “A.2.” SHPK, me numër NUIS-i K.....C Vlera: 25 245 029.25 lekë PA TVSH (skualifikuar) . 3. Operatori Ekonomik “D.C.” SHPK, me numër NUIS K.....J me vlerë 25,818,116.91 lekë pa TVSH (skualifikuar). 4. Operatori Ekonomik “M. K. & R.” SHPK me numër NUIS K.....A me vlerë 26,634,099.5 lekë pa TVSH (skualifikuar). 5. Operatori Ekonomik “B.” SHPK me numër NUIS K.....A me vlerë 26,798,638 lekë pa TVSH (skualifikuar).
11. Ankimime SKA	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga KPP
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Kontrata me nr.9106/13 prot, datë 22.08.2022 midis MFE-së dhe OE fitues “M. K. & R.” SHPK me nr.NUIS-i 81314023A, me vlerë totale 31,960,919,3 lekë me tvsh.	Zbatimi i kontratës: S.	

a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit mbi përlloraritjen e fondit limit, konstatohet:

Si objekt i punës së këtij projekti është ndërtimi i bazës prodhuese, projekti dhe preventivi i objektit me vlerën përkatëse është hartuar nga studio projektimi, nëpërmjet procedure prokurimi, por në dosjen e procedurës nuk ndodhet në hard copy apo CD.

Lidhur me rikonstruksionin e këtij objekti në dosje administrohen dy korrespondenca me “SOS FSHATRAT E FËMIJËVE NË SHQIPËRI”, konkretisht:

-me shkresën nr. 11385, datë 08.06.2022 “Dërgim informacioni” të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kërkohet nga kjo OJF mirëkuptimi lidhur me rikonstruksionin e kësaj shkolle si rezultat i dëmtimeve nga tërmeti i vitit 2019, (referuar procesverbaleve të Institutit të Ndërtimit - nuk ka një vendim përfundimtar, por vetëm akt konstatime) dhe me qëllim përmirësimin e kushteve, bazuar dhe në kontratën e huapërdorjes.

-Me shkresën nr. 11385, datë 29.06.2022 të SP të MFE “Kthim përgjigje”, ku jepen sqarimi lidhur me shkresën e shoqatës nr. 860, datë 16.06.2022, ndër të tjera shprehet:

“Për shkak se MFE bazuar në kontratën e huapërdorjes nr. 4175, datë 31.07.2017, në nenin 3, pika 3.2.1 ku parashikohet se , “Huamarrësi do ta përdorë pronën objekt i kësaj kontrate, brenda kuadrit ligjor të referuar në këtë kontratë. Ai merr përsipër të gjitha shpenzimet për

mirëmbajtjen e objektit të marrë në huapërdorim përgjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate. Çdo ndryshim në strukturën ekzistuese, të sistemit të ventilimit dhe të ngrohjes qendrore pa cenuar atë ekzistues, të objektit godinë, do të bëhet VETËM me miratimin paraprak të huadhënësit, me shpenzimet e huamarrësit dhe në përfundim të afatit 10vjeçar të kontratës të mbetet në posedim dhe pronësi të huadhënësit pa asnjë kundër shpërblim nga ky i fundit...”.

Nga Grupi i Auditimit u kërkua dokumentacioni i sipërpërmendur, ku nga shqyrtimi rezultoi se:

-Referuar kontratës së huapërdorjes nr. 4175, datë 31.07.2014 ky objekt është në pronësi të Shoqatës “SOS FSHATRAT E FËMIJËVE NË SHQIPËRI”, dhe referuar neneve përkatëse të kontratës, nga huapërdoruesi do dhe duhet të kryhen vetëm shpenzimet e mirëmbajtjes dhe jo të rikonstruksionit, duke rënduar buxhetin e shtetit në shumën 31,960,919.3 lekë, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni, pika b), dh), neni 4, pika 37, si dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale”, dhe ngarkon me përgjegjësi ish Sekretarin e Përgjithshëm të MFE z. A.GJ.

b-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit mbi kapacitetet teknike, konstatohet:

Nga auditimi në lidhje me hartimin e miratimin e DST, rezultoi se, nga Njësia e Prokurimit (NjP) me procesverbalin e datës 17.06.2022 janë miratuar Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) në të cilën janë përcaktuar dhe kriteret e veçanta për kualifikim, por në dosje mungojnë CD e DST

Konstatohet se AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të argumentonte teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Nga NjP për kriteret e vendosura apo modifikimin e tyre, citohet vetëm baza ligjore: neni 77, i ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik “i ndryshuar.

-Në DST “Kriteret e veçanta për kualifikim” në pikën 2.3.7 kërkohet: “Për gjithë drejtuesit e makinerive te renda, sipas Urdhër Nr. 44, datë 4.2.2004 "Për miratimin e rregullores "Për Procedurat dhe kriteret për dhënie e lejeve te manovrimit përdoruesve te makinerive te renda te ndërtimit dhe disiplinimi i përdorimit te makinerive te ndërtimit" Dëshmi te Aftësisë Profesionale ose leje manovrimi te vlefshme lëshuar nga institucionet përkatëse/Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës te vlefshme, minimumi 3 manovrator, dhe 2 shoferë te shoqëruar me kontratat e punës dhe të figurojnë ne listëpagesa për periudhën e fundit të deklaruar. (Në rastin kur punonjësit e mësipërm janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë)”.Pra në këtë rast operatori nuk ka detyrimin që këta punonjës të jenë në listëpagesat e tij. Me vendosjen e këtij kriteri NjP ka vepruar me dy standarde, pasi në rikonstruksionin e shkollës ‘Hoteleri Turizëm’ ky kriter do të plotësohet nga OE vetëm në rast se këta punonjës janë në listëpagesat e operatorit.

c-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë OE e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “2 N” SHPK me NIPT-i L.....L, me vlerë të ofertës 24,416,921 (njëzet e katër milionë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekë pa TVSH

2. Operatori Ekonomik “A. 2.” SHPK, me NIPT-i K.....C, me ofertë 25,245,029.25 (njëzet e pesë milionë e dyqind e dyzet e pesë mijë e njëzet e nëntë pikë njëzet e pesë) lekë pa TVSH

3. Operatori Ekonomik “D.C.” SHPK, me numër NIPT-i K.....J me ofertë 25 818 116.91 (njëzet e pesë milionë e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik “M.K. & R.” SHPK, me numër NIPT-i K.....A, me ofertë 26 634 099.5 (njëzet e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëdhjetë e nëntë pikë pesë) lekë pa TVSH .

5. Operatori Ekonomik “B.” SHPK, me numër NIPT-i K....A me ofertë 26.798.638 (njëzet e gjashtë milion e shtatëqind nëntëdhjetë e tetë mijë gjashtëqind e tridhjetë e tetë) Lekë PA TVSH .

KVO ka kualifikuar dhe identifikuar si ofertë të suksesshme ofertën e OE “M. K. & R.” SHPK, me NIPT: K.....A, me ofertë 26,634,099.5 (njëzet e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëdhjetë e nëntë pikë pesë) lekë pa TVSH

Nga auditimi konstatohet se dokumentacioni i paraqitur ne SPE nga “M. K. & R.” për plotësimin e pikës 2.3.7 të “Kriteret e veçanta për kualifikim” për 3 manovratorë, nuk korrespondojnë me kodin përkatës, çka përbën kusht skualifikues, e në këtë rast KVO duhej të kishte anuluar procedurën dhe të përsëritej, në bazë të nenit 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Me datë 25.07.2022 me shkresën nr.9106/11 është bërë njoftimi i fituesit dhe me datë 22.08.2022 është lidhur kontrata nr. 12120/13 me afat realizimi 6 muaj nga nënshkrimi.

Nga verifikimi i dosjes elektronike dhe fizike të OE fitues në plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, u konstatuan se dokumentacioni i OE nuk është marrë në dorëzim me procesverbal nga KVO dhe me inventarin përkatës, për të vlerësuar nëse ka apo jo devijime dhe kriteret ishin në përputhje me ato të vendosura nga NJP.

3. Prokurimi me objekt: Rikonstruksion i Shkollës Profesionale “Hoteleri Turizëm”, REF-43453-09-27-2022, “procedurë e hapur”, prokurim elektronik, me fond limit prej 36,274,073 (tridhjetë e gjashtë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëdhjetë e tre) lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë: 13.10.2022, ora 13:00 në www.app.gov.al

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rikonstruksion i Shkollës Profesionale “Hoteleri Turizëm”.		
<p>1. Urdhër Prokurimi nr.17608 prot., datë 26.09.2022 Njësia e prokurimit : A.N. personi përgjegjës për prokurimet , N.Z., ekonomiste, Ing.R.C.</p>	<p>3. Urdhër i brendshëm për ngritjen e komisionit për LLFL dhe ST</p>	<p>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave, nr.17608/3 prot., datë 29.09.2022 i përbërë : A.G.,kryetar B.T.,anëtar Ing.I.L., anëtare</p>
<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur</p>		
<p>5.Fondi Limit (pa tvsh) 36,274,073 lekë</p>	<p>6. Oferta fituese (pa tvsh) (BOE) “A.C.” me NUIS M.....L dhe shoqëria “6. P. me NUIS L....H me ofertë ekonomike 32,279,547 (tridhjetë e dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Lekë</p>
<p>8. Data e hapjes së procedurës së prokurimit 13.10.2022</p>	<p>9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit</p>	<p>10. Operatorët Ekonomike 1.Operatori Ek. “2.” SHPK , NUIS L.....L, Vlera: 30,824,874 Lekë pa TVSH (skualifikuar). 2.BO E “A.C. ” me NUIS M.L dhe shoqëria “6...” me NUIS L.....H, Vlerë: 32,279,547 Lekë pa TVSH. 3.BO E “A.2.” SHPK me NUIS K.....C, dhe shoqëria “2 Z K.” me NUIS J.....K (skualifikuar), Vlerë: 31,710,378 Lekë pa TVSH. 4.OE “D.P.” SHPK me NUIS K.....S, Vlerë: 33,372,933.30 Lekë pa TVSH. 5.OE “E. shpknj” SHPK me NUIS L.....G, Vlerë: 35,810,067 Lekë pa TVSH (skualifikuar).</p>

		6.OE "I." SHPK, me NUIS J.....Ë, Vlerë: 29,794,365 Lekë pa TVSH (skualifikuar).
11. Ankimime Nr.185 prot., dt.04.11.2022	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr.20666/1 prot., dt.11.11.2022	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Nr.2427/6 prot., dt.10.11.2022
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Kontrata me nr.17608/8 prot, datë 16.11.2022 midis MFE-së dhe (BOE) "A.C." me NUIS M.L dhe shoqëria "6 P..." me NUIS L.....H me ofertë ekonomike 32,279,547 (<i>tridhjetë e dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër</i>) Lekë pa TVSH	Zbatimi i kontratës: SUPERVIZIONI nr.17608/11 prot, 23.11.2022	

a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit mbi përlogaritjen e fondit limit, konstatohet:

Si objekt i punës së këtij projekti është ndërtimi i bazës prodhuese, projekti dhe preventivi i objektit është hartuar nga studio projektimi, nëpërmjet procedure prokurimi, por në dosjen e procedurës nuk ndodhet.

b-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit mbi kapacitetet teknike, konstatohet:

Nga auditimi në lidhje me hartimin e miratimin e DST, rezulton se, nga Njësia e Prokurimit (NjP) me procesverbalin e datës 27.09.2022 janë miratuar Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) në të cilën janë përcaktuar dhe kriteret e veçanta për kualifikim.

Konstatohet se AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të argumentonte teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Nga NjP për kriteret e vendosura, citohet vetëm baza ligjore: neni 77, i ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe neni 39, e VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik "i ndryshuar.

c-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë OE e mëposhtëm:

- 1- Operatori ekonomik "2." SHPK , me NIPT L.....L, me ofertë në vlerën 30,824,874 (*tridhjetë milionë e tetëqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër*) lekë pa TVSH.
- 2- Bashkimi operatorëve ekonomikë (BOE) "A. C." me NIPT M...L dhe shoqëria "6.P. me NIPT L.....H me ofertë me vlerë: 32,279,547 (*tridhjetë e dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër*) lekë pa TVSH.
- 3- Bashkimi operatorëve ekonomik BOE "A. 2." SHPK me NIPT K.....C, dhe shoqëria "2 Z. K." me NIPT J.....K , me ofertë në vlerën 31,710,378 (*tridhjetenjë milionë e shtatëqind e dhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë*) lekë pa TVSH.
- 4- Operatori ekonomik "D.P. 2007" SHPK, me NIPT K.....S, me ofertë me vlerë 33,372,933.30 (*tridhjetetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë*) lekë pa TVSH.
- 5- Operatori ekonomik "E. shpknj" SHPK, me NIPT L.....G, me ofertë me vlerë 35,810,067 (*tridhjetepesë milion e tetëqind e dhjetëmijë e gjashtëdhjeteshtatë*) lekë pa TVSH.
- 6- Operatori ekonomik "I." SHPK, me NIPT J.....Ë, me ofertë me vlerë 29,794,365 (*njëzetnëntë milion e shtatëqind nëntëdhjetekatër mijë e treqind e gjashtëdhjetepesë*) Lekë pa TVSH.

KVO në përfundim të vlerësimit ka skualifikuar 4 OE për mosplotësim të kriterëve të kualifikimit dhe ka kualifikuar dhe identifikuar si ofertë të suksesshme ofertën e BOE "A. C" me NIPT M.....L & "6 P.." me NIPT L.....H, me vlerë totale prej: 32,279,547 (*tridhjetë e*

dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe të hedhur në SPE rezulton se, Operatori Ekonomik “I.” SHPK, me NIPT J.....Ë, ka depozituar “Deklaratën në formë Autorizimi” nga prodhuesi e cila është specifikuar vetëm për një Autoritet Kontraktor, të ndryshëm nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për të cilën është skualifikuar nga KVO.

Grupi i Auditimit arrin në konkluzionin se, gjatë vlerësimit, KVO-ja, pavarësisht këtij fakti, përpara se të kryente skualifikimin e OE “I.” SHPK, në interes të AK mund të konsideronte aplikimin e nenit 53 pika 4, në përputhje me frymën dhe qëllimin e LPP, sipas të cilit: *“autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...”*., pasi veprimet e KVO-së ndikojnë negativisht në mirëpërdorimin e fondeve publike dhe për pasojë kryerjen e punimeve me një vlerë me të lartë ekonomike. Në alternativë, sa më sipër KVO-ja, midis operatorëve pjesëmarrës në procedurë, referuar nenit 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit duke siguruar mirëpërdorim e fondeve publike si dhe uljen e shpenzimeve procedurale, duhej të vlerësonte kriterin kryesor që është “Oferta më e ulët” për të bërë të mundur shmangien e përdorimit me efekt negativ të fondeve publike Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga NJP dhe mos veprimet të KVO-së nuk është bërë e mundur minimalisht shmangja e kryerjes së punimeve me një vlerë ekonomike në disfavor të buxhetit të shtetit, përkatësisht: Nga skualifikimi i OE Operatori Ekonomik “I.” ShPK me ofertë ekonomike 29,794,365 lekë, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një efekt negativ në vlerën **2,485,182 lekë pa TVSH** = (32,279,547 oferta e OE i shpallur fitues – 29,794,365 oferta e “I.” SHPK) si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se, në tre procedurat e prokurimit të mësipërme nga KVO, pas verifikimeve në SPE janë skualifikuar OE kryesisht për mosplotësim të “Kritereve të veçanta për kualifikim” sa i takon stafit, pasi kanë paraqitur punonjës sipas profesioneve, por që nga verifikimi në listëpagesave nuk u korespondojnë kodeve përkatëse. Në të gjitha rastet e deklarimeve të pasakta të OE të konstatuara nga KVO, Autoriteti Kontraktor duhej ti ishte drejtuar APP për veprim të mëtejshëm pasi: *“Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetë deklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, germa (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP)”*, Me datë 16.11.2022 është lidhur kontrata nr. 17608/8 me afat realizimi brenda 6 muajve nga data e njoftimit të fillimit të punimeve, kontratë e cila deri në përfundimin e auditivit në terren është në vazhdim.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi NJP dhe KVO sipas procedurave përkatëse.

Titulli i gjetjes:	Hartim i specifikimeve teknike të pa argumentuara dhe kualifikim të operatorëve ekonomikë me mangësi
Situata:	Nga auditimi i tre procedurave të prokurimit, “Ndërtim i Bazës Prodhuese në Shkollën “Beqir Çela”, Durrës”, “Rikonstruksion i Shkollës Profesionale “Herman Gmeiner” dhe “Rikonstruksion i Shkollës Profesionale “Hoteleri Turizëm”, u konstatuan se në dosjen e procedurës nuk ndodhet në hard copy apo CD projekti dhe preventivi i objekteve me vlerat përkatëse, të cilët kanë shërbyer për hartimin e fondit limit. Konstatohet se, nga Njësia e Prokurimit me procesverbalet përkatëse janë miratuar

	<p>Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) ku janë përcaktuar dhe kriteret e veçanta për kualifikim, por nuk ka argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter të vendosur dhe dokumentuar në procesverbal. Nga Njësia e Prokurimit për kriteret e vendosura apo modifikimin e tyre, citohet vetëm baza ligjore: neni 77, i ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.</p> <p>- Në DST e procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i Shkollës Profesionale “Herman Gmeiner”, në “Kriteret e veçanta për kualifikim” në pikën 2.3.7 Njësia e Prokurimit ka vepruar me dy standarde krahasuar me kriteret e vendosura në rikonstruksionin e shkollës ‘Hoteleri Turizëm’, veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, neni 39.</p> <p>- Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se, në të tre procedurat e prokurimit, nga KVO, pas verifikimeve në SPE janë s’kualifikuar OE kryesisht për mosplotësim të “Kritereve të veçanta për kualifikim” sa i takon stafit, pasi kanë paraqitur punonjës sipas profesioneve, por që nga verifikimi në listëpagesa nuk u korespondojnë kodeve përkatëse. Në të gjitha rastet e deklarimeve të pasakta të OE të konstatuara nga KVO, Autoriteti Kontraktor duhej ti ishte drejtuar APP për veprim të mëtejshëm pasi Operatorët Ekonomikë janë në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, germa (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP)”.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77; neni 4, pika 37; neni 78, pika 1, germa a;</p> <p>-VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 39;</p> <p>- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 9.</p>
Impakti:	Vështirësi të OE në plotësimin e kërkesave për kualifikim dhe kualifikim të operatorëve ekonomikë me mangësi
Shkaku:	Mos argumentim i kritereve kualifikuese.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.</p> <p>KVO në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s’kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.</p>
Titulli i gjetjes:	Efekt negativ në rikonstruksionin e objekteve shkollore si dhe skualifikimi i Operatorit Ekonomik me ofertë ekonomike më të leverdisshme, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një efekt negativ në vlerën 34,446 mijë lekë
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit është konstatuar kryerja e rikonstruksionit dhe shpenzimeve nga buxheti i shtetit për një objekt që nuk është në pronësi të shtetit, si dhe skualifikim i operatorit ekonomik me ofertë ekonomike më të leverdisshme, duke i shkaktuar përdorim të buxhetit pa efektivitet gjithsej në shumën 34,446 mijë lekë konkretisht:</p> <p>-Nga auditimi i procedurës së prokurimi me objekt: Rikonstruksion i Shkollës Profesionale “Herman Gmainer”, konstatohet se ky objekt është në pronësi të Shoqatës “SOS FSHATRAT E FËMIJËVE NË SHQIPËRI”, ndërsa shkolla e</p>

	<p>zhvillon aktivitetin e saj në bazë të kontratës së huapërdorjes nr. 4175, datë 31.07.2014. Nga MFE është parashikuar rikonstruksioni i kësaj shkolle si rezultat i dëmtimeve nga tërmeti i vitit 2019, (referuar procesverbaleve të Institutit të Ndërtimit - nuk ka një vendim përfundimtar, por vetëm akt konstatime) dhe me qëllim përmirësimit dhe kushteve, bazuar dhe në kontratën e huapërdorjes. Referuar neneve përkatëse të kontratës, nga huapërdoruesi do të kryhen vetëm shpenzimet e mirëmbajtjes dhe jo të rikonstruksionit, duke rënduar buxhetin e shtetit në shumën 31,960,919.3 lekë, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 2, pika b), dh), neni 4, pika 37, si dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 9.</p> <p>-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: Rikonstruksion i Shkollës Profesionale “Hoteleri Turizëm”, konstatohet se Operatori Ekonomik “I.” SHPK është s’kualifikuar nga KVO, pasi ka depozituar “Deklaratën në formë Autorizimi” nga prodhuesi e cila është specifikuar vetëm për një Autoritet Kontraktor, të ndryshëm nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Gjatë vlerësimit, KVO-ja, pavarësisht këtij fakti, përpara se të kryente s’kualifikimin e OE “I.” SHPK, në interes të AK mund të konsideronte aplikimin e nenit 53, pika 4, në përputhje me frymën dhe qëllimin e LPP, pra të devijimeve të vogla dhe që nuk ndryshojnë në thelb ofertën, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit duke siguruar mirëpërdorimin e fondeve publike, referuar dhe nenit 2 të ligjit nr. 162/2020 prot., “Për prokurimin publik”.</p> <p>Nga s’kualifikimi i OE Operatori Ekonomik “I.” SHPK me ofertë ekonomike 29,794,365 lekë, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një efekt negativ në vlerën 2,485,182 lekë pa TVSH (32,279,547 – 29,794,365), si diferenca midis ofertave të OE i shpallur fitues BOE “A. C.” & “6 P.” dhe të OE “I.” SHPK.</p>
Kriteri:	-Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, 53, pika 4 dhe neni 78, pika 1, germa a.
Impakti:	Mos rritje e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit
Shkaku:	Mos mbajta në konsideratë ofertën më të leverdishme
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi	<p>Titullari i MFE të marrë në analizë inicimin e rikonstruksionit të shkollës “Herman Gmainer” dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit për një subjekt privat, në shumën 31,960,919 lekë.</p> <p>KVO në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave ,përpara së të kryejë një s’kualifikimin e OE, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.</p>

2.E.4. Auditim i llogarive vjetore të institucionit

Për vitin 2022, pasqyrat financiare të aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 5616, datë 27.03.20231 “Dërgohen pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor”, brenda afatit ligjor, në përputhje me pikën 117 të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar .

Pasqyrat financiare, janë përgatitur nga ana e Drejtorit të Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe janë nënshkruar nga Nëpunësi Autorizues në përputhje me shkronjën d), pika 4, neni 9 dhe shkronjën b), pika 2 e nenit 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Rezulton se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarë, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave

ligjore në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programeve dhe ato të realizuara nga aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

Konstatohet se të shënimet shpjeguese nuk jepet informacion i detajuar në lidhje me detyrimet dhe detyrimet e prapambetura jo në përputhje me tabelën e aneksit nr. 2, paragrafi 20 i Udhëzimit të MFE nr. 5, datë 21.02.2022.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Auditimi i llogarive të performancës financiare

Nga auditimi rezulton se për vitin 2022, totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Performancës” nuk është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit.

Sipas pasqyrave financiare të aparatit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, situata paraqitet si në vijim:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2)	= 1,440,452,919 lekë
ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2)	= 1,440,452,919 lekë
iii. Rezultati i ushtrimit (llog. 85)	= 1,557,157,427 lekë
Totali ii + iii	= 2,997,610,346 lekë

Analiza e posteve kryesore të pasqyrës së “Pozicionit Financiar”.

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të pasqyrës rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Sipas pasqyrës së pozicionit financiar vjetore rezulton se:

- “Aktivet afatgjata” zënë 90% të vlerës totale të aktivit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 10% të totalit.

Aktivet qarkulluese

Aktivet Afatshkurtra përbëhen nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

Lekë

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
2		I. Aktivet Afat shkurtra	1,066,943,101	1,091,848,670
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	322,655,013	338,261,554
6	520	Disponibilitete në Thesar	322,655,013	338,261,554
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	33,858,977	33,080,774
12	31	Materiale	22,258,958	19,957,737
13	32	Inventar i imët	6,483,177	7,611,022
16	35	Mallra	5,116,816	5,512,014
21		3.Llogari te Arkëtueshme	709,601,254	716,078,486
22	411	Klientë e llogari të ngjashme	535,303,000	535,303,000
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	3,823,842	1,889,116
32	468	Debitorë të ndryshëm	127,513,063	132,502,554
33	4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	42,961,349	46,383,816
36		4.Të tjera aktive afatshkurtra	827,856	4,427,856
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	827,856	4,427,856

Burimi: Ministria e Financës dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, për vitin 2022, paraqitet në vlerën 322,655,013 lekë. Sipas pikës 49, të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepicën debitore të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Për vitin 2022, llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” në formatin nr. 2 të Pasqyrës

së Performancës Financiare për vlerën 778,204 lekë, rezulton e barabartë me diferencën midis gjendjes më 31.12.2022 të llogarisë “gjendje e inventarit qarkullues” në Pasqyrën e Pozicionit Financiar dhe gjendjes më datë 31.12.2021, përkatësisht 33,858,977 lekë – 33,080,774 lekë. Llogaria 411 “Klientë e llogari të ngjashme” në vlerën 535,303,000, që përbëhet nga “Regjistrim detyrimi sipas pikës 2 të faqes 135 projekt raportit të KLSH-së, datë 25.05.2018”.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në vlerën 127,513,063 lekë. Në këtë llogari janë përfshirë Debitorët e ndryshëm ku peshën më të madhe e zë Fondi Kombëtar.

Referuar legjislacionit në fuqi Fondi Kombëtar kryen pagesa për projektet IPA me fondet e çelura në programet e Aparatit të Ministrisë së Financave dhe më pas nga donatorët bëhet rimbursimi i këtyre fondeve. Detyrimi që Fondi Kombëtar ka ndaj Ministrisë së Financave më datë 31.12.2022 është 113,311,988 lekë. Gjithashtu këtu bën pjesë detyrimi i ish MZHETS, në vlerën 5,367,529 lekë dhe detyrime të tjera që kanë ardhur nga shitja e pronës shtetërore (rastet e kontratave me rezervë) në vlerën 8,814,353 lekë.

Llogari të arkëtueshme:

- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin debitor” paraqitet në vlerën 42,964,349 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka aparati i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2022, për pagat, sigurime shëndetësore, sigurime shoqërore dhe tatim taksa.

Detyrimet e prapambetura

Nga auditimi i zërave të aktiveve afatshkurtra u konstatua se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 827,856 lekë, dhe i përket detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore për largimet nga puna. Nga analiza e pagesave të realizuara në SIQF u konstatua se aparati i MFE-së në vitin 2022 ka likuiduar 632,624 lekë për fatura të cilat i përkasin vitit 2021, për shërbime të ndryshme. Ndërsa deri në muajin Mars të vitit 2023, rezulton se ka likuiduar fatura të lëshuara gjatë vitit 2022, në vlerën 425,032 lekë për shërbime të ndryshme. Pra, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk është paraqitur drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar, por është nënvlerësuar.

Aktivet afatgjata

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në vlerën neto prej 9,695,602,342 lekë, janë të pasqyruara në zërin “Aktive Afatgjata jo materiale” në vlerën neto 1,154,672,952 lekë, “Aktive Afatgjata materiale” në vlerën neto 3,139,846,753 lekë dhe në zërin “Investime” në vlerën neto 5,401,082,638 lekë.

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
42		II. Aktivet Afat gjata	9,695,602,342	7,309,310,352
43	20	1. Aktivet Afatgjata jo materiale	1,154,672,952	873,905,758
44	201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave	49,269,294	65,640,893
45	202	Studime dhe kërkime	29,382,404	31,341,230
46	203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme	1,076,021,255	766,923,635
47	21	2. Aktivet Afatgjata materiale	3,139,846,753	2,827,833,837
48	210	Toka, Troje, Terrene		
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	2,855,015,893	2,645,263,900
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	218,551,340	68,530,603
53	215	Mjete Transporti	4,263,218	4,263,218
54	216	Rezerva Shtetërore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	60,614,942	108,374,757
57	24	Aktive afatgjata të dëmtuara	1,401,359	1,401,359
58	28	Caktime të Aktiveve Afatgjata		
62		4. Investime	5,401,082,638	3,607,570,757
63	230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	53,275,100	145,516,114
64	231	Për Aktive Afatgjata materiale	5,347,807,538	3,462,054,643

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit

- Llogaria 201 “Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave”, paraqiten në fund të vitit 2022 në vlerën neto 49,269,294 lekë.

- Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në fund të vitit në vlerën neto 29,382,404 lekë.

- Llogaria 203 “*Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme*”, paraqitet në fund të vitit në vlerën neto 1,196,433,902 lekë, ku sipas regjistrimit të aktiveve përfshin vlerën e programeve kompjuterike, software dhe licenca. Në lidhje me kalimin kapital të infrastrukturës dhe sistemeve IT, Ministria e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. 23068, datë 15.12.2022 i ka dërguar AKSHI-t listën e sistemeve si dhe vlerat përkatëse të tyre. AKSHI me shkresën nr. 113, datë 09.01.2023, i ka kërkuar MFE-së dorëzimin e dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese, kodin e burimit si dhe ngritjen e një grupi pune për kalimin e kapitalit. Pavarësisht korrespondencës së vazhdueshme dhe përfundimit të afatit të përcaktuar në nenin 18, të VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar (30 shtator 2018), rezulton se ende nuk ka përfunduar procesi i transferimit të aktiveve të teknologjisë së informacionit nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë te Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

- Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 2,855,015,893 lekë, përbërë nga vlera e godinës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe nga vlerat e godinave të ndërtuara apo rikonstruara të shkollave profesionale. Konstatohet se Ministria e Financës edhe Ekonomisë ka kontabilizuar si asetet e veta, vlera e konstruksioneve dhe rikonstruksioneve, pra investimeve që janë kryera në shkollat profesionale të mësipërme, për të cilat çdo vit llogaritet edhe vlerat e amortizimit. Gjithashtu rezulton se në pasqyrat financiare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pasqyrohet vetëm vlera e investimeve të kryera nga kjo Ministri dhe jo vlera e plotë e aktiveve të shkollave profesionale. Një njësi ekonomike duhet të njohë në pasqyrat financiare një aktiv afatgjatë vetëm nëse ky aktiv kontrollohet nga njësi ekonomike. Sa më sipër, rezulton se Ministria e Financës ka njohur si aktive shkollat profesionale, pa pasur kontroll të këtyre aktiveve.

-Llogaria 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në vlerën neto 218,551,340 lekë.

-Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” paraqitet në vlerën 1,401,359 lekë.

Nga auditimi rezulton se grupi i komisionit të vlerësimit të aktiveve, i ngritur me Urdhrin nr. 67, datë 12.04.2021 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të aktiveve të MFE-së, të identifikuar për nxjerrje nga përdorimi, nga komisionet e inventarizimit të vitit 2017 dhe 2019 dhe nga Komisionet e Degëve të Thesarit në Rrethe, për vitin 2021”, ndryshuar me Urdhrin nr. 67/1, datë 26.07.2021, ka hartuar relacionin mbi vlerësimin e aktiveve që janë konstatuar jashtë përdorimit si dhe ka mbajtur procesverbalin nr. 24191 prot., datë 31.12.2022. Rezulton se relacioni i përgatitur nuk ka datë. Në relacionin e përgatitur nuk llogaritet për asnjë aktiv efekti ekonomik i masave për riaftësimin e tyre, jo në përputhje me pikën 106, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Sipas procesverbalit “Për vlerësimin e aktiveve që janë konstatuar jashtë përdorimit” rezulton se është mbajtur nga komisioni i vlerësimit të aktiveve më datë 26.09.2022, ndërsa protokollimi i këtij proces verbali është bërë me nr. 24191 prot., ndërsa data 30.12.2022, pra 3 muaj më pas. Vlera e aktiveve të verifikuara si jashtë përdorimit nga komisioni i inventarizimit është 156,603,431 lekë. Ndërsa nga komisioni i vlerësimit të aktiveve janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit 434 aktive në vlerën totale 65,479,948 lekë.

Sa më sipër rezulton se llogaria 24 është nënvlerësuar, pasi në të nuk është pasqyruar vlera e aktiveve të cilat rezultojnë të dëmtuara nga komisioni i inventarizimit dhe më pas janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit.

Gjithashtu konstatohet se në pasqyrën financiare 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me kosto historike)”, vlera e propozuar nga komisioni i inventarizimit si jashtë përdorimit, është pasqyruar si pakësim gjatë vitit, te kolona nr. 8 “Nxjerrje jashtë përdorimit”,

për llogaritë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla punë” me kosto historike 2,571,927 lekë dhe për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” me kosto historike 63,521,661 lekë.

- Llogaria 215 “Mjete Transporti”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 4,263,218 lekë dhe përfaqëson vlerën e automjeteve në dispozicion të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, e cila nuk ka ndryshime nga viti paraardhës.

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në fund në vlerën neto prej 60,614,942 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit, si rezultat i blerjeve gjatë vitit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit në vlerën 63,421,661 lekë.

- Nga auditimi rezulton se llogaritë e investimeve me burim financime të huaja të realizuara përgjatë vitit janë të nënvlerësuara, pasi nuk raportohen projekte me financim të huaj të zbatuara nga CFCU dhe Fondi Kombëtar. Në rastin e krijimit të aseteve nëpërmjet projekteve me financim të huaj, në pasqyrat financiare paraqitet vlera e TVSH së investimit të kryer dhe jo kosto e plotë e asetit. Gjatë vitit 2022, shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara dhe trupëzuara me burim financimi të huaj, rezultojnë në shumën 355,657,877 lekë.

Tabela: Projektet me investim të huaja, realizuar nga aparati i MFE, për vitin 2022 Në Lekë

Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i projektit	Përshkrimi i projektit	Realizim 31.12.2022
01110	231	18BP213	Lehtësimi i Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor	27,352,494
01110	230	18BP504	Projekte Grant - IPA	6,785,150
01110	230	18BR904	Fuqizimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, faza 2	15,114,890
01110	230	GM10152	Protax Albania CFCU EUR	34,711,158
01110	230	GM10154	Zhvillimi i kontabilitetit në Sektorin Publik	43,021,315
09240	231	18BS303	Mbështetje të arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit	80,492,350
09240	230	GM10148	Mbështetje për arsimin dhe aftësimin profesional të orientuar drejt punësimit Fondi Kombëtar	128,180,520
Totali				355,657,877

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Në fillim të vitit, nga MFE janë planifikuar fonde për projektet e investimit me burim financimi të huaj, sipas projekteve të listuara në PBA. Konstatohet se megjithëse këto fonde planifikohen dhe administrohen nga njësitë në strukturën e MFE (Drejtoria e CFCU dhe Drejtoria e Fondit Kombëtar), ato nuk janë pjesë e pasqyrave financiare të MFE-së. Pra këto shuma nuk raportohen në pasqyrat financiare të Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë por raportohen më vete nga njësia e cila i zbaton këto projekte, CFCU, drejtori në strukturën e MFE dhe Fondi Kombëtar për projektet IPA, duke sjellë që vlera prej 80% e investimit në proces të jetë jashtë pasqyrës së pozicionit financiar të MFE.

Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka kryer procesin e inventarizimit, në kundërshtim me kreun IV, pika 74 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar si dhe pikën 30, të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Pasivet Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2022, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasivet afatshkurtra në vlerën 3,510,284,869 lekë.

Lekë

67		1. Llogari te Pagueshme	2,852,925,930	670,420,128
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	2,478,600,027	277,675,297
69	42	Detyrime ndaj personelit	26,783,606	26,381,651
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	3,080,613	2,859,049
73	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
75	435	Sigurime Shogërore	8,397,900	8221,278
76	436	Sigurime Shëndetësorë	2,014,669	2,027,197
77	436	Sigurime Suplementare		
81	466	Kreditore për mjete në ruajtje	322,655,013	338,261,554
82	467	Kreditore te ndryshëm	4,125,690	7,725,690

83	4341	Operacione me shtetin (detyrime)	7,268,412	7,268,412
84	49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)		
85		2. Të tjera pasive afatshkurta	657,358,939	662,348,430
86	419	Kreditor, Parapagime	535,272,185	535,272,185
87	475	Të ardhura për tu regjistruar në vitet pasardhëse	122,086,754	127,076,245

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit

- Llogaria 401 - 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në vlerën 2,478,600,027 lekë dhe në krahasim me vitin e mëparshëm është rritur për vlerën 2,200,924,730 lekë. Nga auditimi rezulton se me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022, Korporatës Shqiptare të Investimeve (AIC) i janë shtuar fonde në shumën 2.12 miliard lekë në formën e transfertës kapitale për mbështetjen e projekteve të zhvillimit. Regjistrimi i kësaj vlerën në llogarinë e mësipërme, nuk është në përputhje me kapitullimin 3.3 “Trajtimet kontabël dhe funksioni i llogarive të tretëve (klasa 4), të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, ku citohet se: *“Të drejtat dhe detyrimet, nga pikëpamja e pronësisë, paraqesin burime të të tretëve që përdoren përkohësisht për aktivitetin e funksionimit të institucionit dhe që do t'i kthejë në të ardhmen. Ato kanë si karakteristikë kryesore se janë të përkohshme dhe se duhet të kthehen, të shlyhen patjetër pas një kohe të caktuar. Ato janë sakrificat të mundshme në të ardhmen të përfitimeve ekonomike që rrjedhin (lindin) prej detyrimeve tashmë të një njësie publike për t'u dhënë (transferuar) aktive ose për t'u kryer shërbime njëjësive të tjera në të ardhmen si rezultat i veprimeve të kryera në të tashmen. ... Lloje të detyrimeve afatshkurtra kryesore janë detyrimet ndaj furnitorëve për blerje të mallrave, shërbimeve ose investimeve. Këto janë detyrimet me afat të shkurtër që ka njëjësia për aktivet (mallrat, makineritë, etj...) dhe shërbimet e blera me pagesë të mëvonshme. Pra, shkak i lindjes së këtyre detyrimeve është mospërputhja në kohë midis momentit të marrjes (blerjes) së aktiveve ose përfitimit të shërbimeve dhe momentit të pagimit të parave për to.”* Sa më sipër, nga kjo transfertë aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk do të përfitojë ndonjë aktiv apo shërbim.

- Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to“ në vlerën 26,783,606 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2022, që paguhen në janar të vitit 2023.

- Llogaria 431 “Detyrim ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 3,080,613 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2022, të cilat paguhen në Janar të vitit 2023.

- Llogaria 435 “Sigurimet shoqërore” në vlerën 8,397,900 lekë përfaqëson sigurimet shoqërore për pagat e muajit Dhjetor 2022, që paguhen në Janar të vitit 2023.

- Llogaria 436 “Sigurime Shëndetësore“ përfaqëson kontributin e sigurimit shëndetësor në vlerën 2,014,669 lekë të muajit Dhjetor 2022, të cilat paguhen në muajin Janar 2023.

- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në shumën prej 322,655,013 lekë, përbëhet nga shuma 135,258,726 lekë e cila është trashëguar në llogarinë 466 të viteve të mëparshme; shuma 10,285,898 lekë nga arkëtimet e realizuara për vitin 2022 në artikullin 466 të cilat do të trashëgohen në vitet pasardhëse (9,975,674 lekë janë arkëtimet e kryera për pjesëmarrje në ankand dhe 310,244 lekë nga garancitë bankare); shuma 20,701,172 lekë nga garancitë e punimeve të kryera për rikonstruksionet e shkollave të arsimit profesional; shuma 145,862,628 lekë nga garancitë e objekteve të trashëguara nga ish MZHETS; Shuma prej 10,546,589 janë arkëtime të tjera nga të cilat 3,293,203 lekë janë arkëtim nga Lotaria shtetërore.

- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshme” është paraqitur në vlerën 4,125,690 lekë dhe sipas ditarit të llogarive përfaqëson detyrimin për pagimin e një vendimi gjyqësor. Në këtë llogari nuk janë regjistruar faturat e shërbimeve të muajit Dhjetor të vitit, të cilat likuidohen në muajin Janar të viti pasardhës. Këto shpenzimet janë njohur në momentin e likuidimit të faturave ndaj palëve të treta dhe jo në momentin e konstatimit dhe realizimit të shërbimit, jo në përputhje me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, paragrafi 3.3 ku citohet se: *“Klasa 4 përfaqëson në përgjithësi ngjarjet apo*

fenomenet që kanë ndodhur dhe duhet të trajtohen kontabilisht, sipas parimit të të drejtave e detyrimeve të konstatuara”.

-Llogaria 419 “Kreditorë, Parapagime” paraqitet në vlerën 535,272,185 lekë, kundër parti e llogarisë 411.

-Llogaria 475 “Të ardhurat për t’u regjistruar në vitet pasardhëse” paraqitet në vlerën 122,086,754 lekë.

Aktivitet neto/ fondet:

D	FONDI I KONSOLIDUAR :	7,252,260,573	7,068,390,462
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti i akumuluar	5,695,260,573	7,068,390,462
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	1,557,157,427	1,497,525,230
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	10,7621,545,442	8,401,159,021

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi i fondeve të konsoliduar në “Pasqyrën e pozicionit financiar”, konstatohet se llogaria nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” paraqitet në vlerën 0 lekë. Në fakt kjo llogari duhet çdo vit të pasqyrohet sa “Rezultati i ushtrimit nga funksioni” + “Rezultatet e mbartura” të periudhës ushtrimore paraardhëse. Në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësohej pozicioni i çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe të realizohej transaksioni i transferimit të tepricës së llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”.

Gjithashtu nga auditimi është konstatuar se MFE, nëpërmjet Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike realizon shitjen e aseteve afatgjata të shtetit, të cilat vlerësohen për t’u shitur nga njësi që i ka në administrim. Të ardhurat e krijuara përgjatë vitit 2022, nga shitja e këtyre aktiveve nëpërmjet procedurës së ankandit janë në vlerën 109,169,909 lekë, nga të cilat të ardhurat nga shitja e trojeve, llogaria 1161110, janë në vlerën 27,000,040 lekë dhe të ardhurat nga shitja e objekteve, llogaria 1161130, janë në vlerën 82,169,869 lekë. Në pasqyrat financiare të publikuara dhe në librin e madh nuk konstatohen pakësime të aktiveve afatgjata, si rezultat i shitjeve të realizuara përgjatë vitit, në drejtim të çregjistrimit të aktiveve për të cilat ka ndryshuar pronësia në bazë të kontratës respektive të shitjes. Në këtë mënyrë, pronësia e aseteve që shiten, nuk evidentohet në pasqyrat financiare të MFE.

- Konstatohet se në të ardhurat për vitin 2022, është kontabilizuar edhe llogaria 7780100 “Korrigjime nga vitet e kaluara”, në vlerën totale 84,304,139 lekë, nga të cilat vlera 80,104,138 lekë, referuar ditarëve kontabël dhe librit të madh, i përket kthimit të huas që Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka dhënë Fondit Kombëtar në vitet e mëparshme për IPA 2012, IPA 2013, hua e cila duhet të ishte kthyer brenda vitit kur është bërë disbursimi i shumës. Si rezultat, janë mbivlerësuar të ardhurat e vitit 2022, për vlerën 80,104,138 lekë, pasi transaksioni i arkëtimit nga Fondi Kombëtar është kthim i një shume të dhënë hua që trajtohet si një shlyerje nga debitorët e vitit të kaluar.

Në lidhje me problematikat e konstatuar për pasqyrat financiare ngarkohet me përgjegjësi A. V. në cilësinë e hartuesit të llogarive vjetore.

Mbi shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit.

Nga auditimi mbi rregullshmërinë e pagesave mbi shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, u përzgjedhën urdhër shpenzimet, për periudhën objekt auditimi si në vijim:

Në lekë

Urdhër shpenzimi nr. datë	Shpenzime akomodimi në hotel	Vendi/Shtet	Nr. i punonjësve përfitues	Shpenzimi i akomodimit në hotel në natë/ për person	Pozicioni i punonjësve përfitues	Datat e qëndrimit në hotel	Data e faturës	Operatori ekonomik që ka lëshuar faturën
505, dt 19.05.2022	520,862	Uashington	2	52,086	Ministër; Këshilltar Ministri	20- 25.04.2022	05.05.2022	O. Travel and Tours
506, dt 19.05.2022	625,035	Uashington	3	52,086	Zv. Ministër; Drejtor i Përgjithshëm	20- 24.04.2022	05.05.2022	O. Travel and Tours
507, dt 19.05.2022	98,753	Bruksel	2	24,688	Përgjegjës Sektori; Specialist	04- 06.05.2022	09.05.2022	O. Travel and Tours
191, dt 10.03.2022	95,127	Paris	1	47,563	Ministër	06-	12.02.2022	I. Travel and Tours

						08.02.2022		
192, dt 10.03.2022	155,430	Londër	1	38,857	Ministër	25.02-01.03.2022	02.03.2022	O. Travel and Tours
1492, dt 24.01.2023	73,868	Bruksel	1	36,936	Specialist	24-26.11.2022	28.12.2022	I. Travel and Tours
415, dt 15.04.2022	188,759	Stamboll	2	47,189	Ministër; Këshilltar Ministri	06-08.03.2022	18.03.2022	O. Travel and Tours
937, dt 13.09.2022	103,802	Hagë	1	51,901	Ministër	03-05.07.2022	15.07.2022	O. Travel and Tours
980, dt 19.09.2022	132,360	Athinë	2	22,060	Drejtor; Specialist	05-08.09.2022	14.09.2022	O. Travel and Tours
668, dt 17.06.2022	47,063	Ohër	2	11,767	Ministër; Këshilltar Ministri	07-09.06.2022	13.06.2022	O. Travel and Tours
669, dt 17.06.2022	53,969	Shkup	3	17,990	Ministër; Këshilltar Ministri Shofer	29-30.06.2022	16.06.2022	O. Travel and Tours
841, dt 19.08.2022	393,129	Bruksel	5	39,213	Drejtori i Përgjithshëm; Përgjegjës Sektori	28-30.06.2022	04.07.2022	O. Travel and Tours
1139, dt 26.10.2022	2,120,063	Washington	5	70,669	Zv. Ministër; Drejtor Kabineti; Drejtor i Përgjithshëm	11-17.10.2022	21.10.2022	O. Travel and Tours
1140, dt 26.10.2022	179,020	Bruksel	1	44,755	Drejtori i Përgjithshëm	11-15.10.2022	20.10.2022	O. Travel and Tours
933, dt 13.09.2022	79,689	Stamboll	2	39,845	Ministër; Këshilltar i Ministrin	24-25.08.2022	31.08.2022	O. Travel and Tours

Burimi: Urdhër shpenzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimi rezulton se Ministra e Financave dhe Ekonomisë prenoton hotelin nëpërmjet agjencive turistike. Në të gjitha rastet, faturat e paraqitura nga Agjencia Turistike, rezultojnë me data më të vonshme se data e fundit e qëndrimit në hotel. Në faturat e paraqitura nuk identifikohet emrin hoteli në të cilën kanë qëndruan punonjësit si dhe numri i yjeve të hotelit, në kundërshtim me pikën nr. 9 dhe lidhjen nr. 1 të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, ku citohet se: “Në shpenzimet e fjetjes përfshihen faturat e hoteli të përzgjedhur...”

Gjithashtu, si është trajtuar në tabelën më sipër, rezulton se në të gjitha rastet punonjësit pavarësisht nga pozicioni i punës/kategorisë janë akomoduar në të njëjtin hotel, si Ministri dhe zv. Ministri; Drejtori i Përgjithshëm dhe Përgjegjësi i Sektorit, etj., në kundërshtim me pikën nr. 9 dhe lidhjen nr. 1 të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 ku citohet se: “Në shpenzimet e fjetjes përfshihen faturat e hoteli të përzgjedhur, si rregull, në mënyrë të diferencuar, sipas numrave rendorë të lidhjes nr.1, si më poshtë vijon: a) për kategorinë 1, 2, 3 – hotel deri në 5 yje; b) për kategoritë 4,5,6 – hotel deri në 4 yje; c) për kategoritë 7, 8 – hotel deri me 3 yje”. Sipas lidhjes nr. 1, ministri është pjesë e kategorisë nr. 3, zëvendës ministri është pjesë e kategorisë nr. 4, drejtori i përgjithshëm dhe drejtorët në Ministri bëjnë pjesë në kategorinë nr. 6, përgjegjësi i sektorit dhe specialistët në Ministri bëjnë pjesë në kategorinë nr. 7, ndërsa punonjësit mbështetës (teknikë, sekretarë, shoferë, etj.) bëjnë pjesë më kategorinë nr. 8. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi R. M. në cilësinë e ish Nëpunësit Zbatues dhe A.GJ. në cilësinë e ish Nëpunësit Autorizues.

Baza ligjore për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbimin si dhe shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimi që u bëhet delegacioneve të huaja.

Shpenzimet që kryejnë institucionet për pritjen e delegacioneve të huaja bazohen në VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, ndryshuar me VKM nr. 258, datë 03.06.1999.

Referuar pikës 1 të VKM nr. 243, datë 15.05.1995, delegacionet e huaja për efekt të kuotës ditore të ushqimit, ndahen në tri grupe:

- Në grupin e parë hyjnë delegacionet parlamentare të kryesuar nga anëtarët të Parlamentit, delegacionet qeveritare të kryesuara nga anëtarë qeverie, ambasadorë, zëvendësministra, personalitete të organizatave ndërkombëtare ose personaliteteve të tjera të shquar në fushën politike, shtetërore, shoqërore e shkencore.
- Në grupin e dytë hyjnë delegacionet që përfaqësojnë institucione të rëndësishme ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe miq e të ftuar të tjerë dhe personalitete të veçanta të kulturës.
- Në grupin e tretë hyjnë specialistët e huaj, grupet artistike e sportive etj.

Ndërsa referuar pasqyrave nr. 1, 2 dhe 3 të VKM-së nr. 258, datë 03.06.1999, kuota maksimale ditore e ushqimit për grupin e parë është 6,500 lekë, për grupin e dytë 4,800 lekë, për grupin e tretë është 3,400 lekë; kuota maksimale ditore për dreka e darka zyrtare për grupin e parë është 4,500 lekë, për grupin e dytë 3,500 lekë, për grupin e tretë 2,000 lekë; kuota maksimale e pritjes së zyrtareve është për grupin e parë 800 lekë, për grupin e dytë 450 lekë dhe për grupin e tretë 260 lekë.

Masa e dietës për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen më shërbim jashtë vendit përcaktohet sipas lidhjes nr. 1, të VKM nr. 870, datë 14.12.2011.

Lidhja nr. 1 “Masa e Dietës në valutë të huaj sipas kategorive”

Nr.	Kategoritë	Në Euro/USD
1	Presidenti i Republikës	120
2	Kryeministri dhe Kryetari i Kuvendit	100
3	Zëvendëskryeministri dhe nënkryetari i Kuvendit, ministrat dhe funksionarë të tjerë me pagë më të lartë apo që barazohen me ta në pagë	80
4	Deputetët e Kuvendit dhe funksionarëve të tjerë që barazohen në pagë me to	70
5	Zëvendësministrat, sekretarët e përgjithshëm në ministri dhe institucione të tjera qendrore dhe funksionare të tjerë që barazohen me ta në pagë	60
6	Ambasadorët, Konsullit i Përgjithshëm, të ngarkuarit me punë në shtetet të huaja, Drejtorët e Përgjithshëm dhe drejtorët në Ministri dhe institucionet të tjera qendrore dhe të gjitha funksionet e tjera që barazohen me ta në pagë	50
7	Diplomatë të tjerë në shtete të huaja, përgjegjës sektori dhe specialistë të ministrive, punonjësit e institucioneve të tjera në varësi të ministrive dhe institucioneve të tjera buxhetore.	40
8	Punonjës mbështetës (teknikë, sekretarë, shoferë etj.)	35

Burimi: VKM nr. 870, datë 14.12.2011

Ndërsa trajtimi financiar i punonjësve që dërgohen për shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit përcaktohet në VKM nr. 997, datë 10.12.2010, i ndryshuar me VKM nr. 329, datë 20.04.2016, ku përcaktohet se: “Për shërbime në një largësi mbi 50 km, jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin: a) dietën ditore, e cila, për çdo punonjës të dërguar me shërbim, llogaritet në masën, si më poshtë vijon: 1,000 lekë në ditë, kur punonjësi kthehet brenda ditës; 10 për qind të pagës mujore, por jo më shumë se 2,500 lekë në ditë, kur shërbimi zgjat më shumë se një ditë. b) shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, të paraqitur nga hoteli dhe të shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, por jo më shumë se 3,000 lekë për çdo natë; c) shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni”.

Sa më sipër, në vlerësimin e grupit të auditimit, nisur nga periudha e hershme e miratimit të VKM-së nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje përcjellje që u bëhet delegacioneve të huaja”, ndryshuar me VKM nr. 258, datë 03.06.1998, kjo VKM dhe VKM-t për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit, si dhe akte të tjera nënligjore të cilat janë të miratuara konsiderueshëm vite më parë, paraqesin nevojën e rishikimit të tyre për të qenë koherente me ndryshimet e bëra së fundmi në sistemin/strukturën e pagave me qëllim të qenurit në përputhje me aktualitetin.

Titulli i Gjetjes:	Ministria e Financës dhe Ekonomisë nuk ka transferuar aktivet e teknologjisë së informacionit si dhe nuk ka transferuar tek njësitë përfituese konstruksionet dhe rikonstruksionet e kryera për shkollat profesionale. Për vitin 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk ka kryer procesin e inventarizimit si dhe nuk ka përfunduar procesin e nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve të identifikuar nga komisionet e inventarizimit të vitit 2017 dhe 2019.
Situata:	Llogaria 203 “Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme”, paraqitet në fund të vitit në vlerën neto 1,196,434 mijë lekë ku përfshihen vlerën e programeve kompjuterike, software dhe licencave. Konstatohet se nuk ka përfunduar procesi i transferimit të aktiveve të teknologjisë së informacionit nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë te Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 2,855,016 mijë lekë e cila përbëhet nga vlera e godinës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe nga vlerat e godinave të ndërtuara apo rikonstruktura të 18 shkollave profesionale në vlerën 2,196,134 mijë lekë. Konstatohet se Ministria e Financës edhe Ekonomisë ka

	<p>kontabilizuar si asetet e veta, pa pasur kontroll të këtyre aktiveve, vlerën e konstruksioneve dhe rikonstruksioneve, pra investimeve që janë kryera në shkollat profesionale, për të cila çdo vit llogaritet edhe vlerat e amortizimit. Gjithashtu rezulton se në pasqyrat financiare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pasqyrohet vetëm vlera e investimeve të kryera nga kjo Ministri dhe jo vlera e plotë e aktiveve të shkollave profesionale.</p> <p>Nga auditimi rezulton se llogaritë e investimeve me burim financime të huaja janë të nënvlerësuar, pasi nuk raportohen projektet me financim të huaj të zbatuara nga CFCU dhe Fondi Kombëtar. Në rastin e krijimit të asetëve nëpërmjet projekteve me financim të huaj, në pasqyrat financiare paraqitet vlera e TVSH së investimit të kryer dhe jo kosto e plotë e asetit. Gjatë vitit 2022, shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara dhe trupëzuara me burim financimi të huaj, rezultojnë në shumën 355,657,877 lekë.</p>
Kriteri	<p>- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, pika 18.</p> <p>- Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Aneksi nr. 1, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).</p>
Ndikimi	Pasaktësi dhe mos paraqitje e drejtë e vlerave të aktivet afatgjata materiale.
Shkaku	<p>Mos transferim i aktiveve të teknologjisë së informacionit te AKSHI. Njohja e konstruksioneve dhe rikonstruksioneve të kryera për shkollat profesionale si aktiv i Aparatit të MFE-së edhe pse këto aktive nuk kontrollohen nga kjo njësi ekonomike.</p> <p>Vlera për investimet me financim të huaj nuk raportohen në pasqyrat financiare të Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë por raportohen më vete nga njësia e cila i zbaton këto projekte, CFCU, drejtori në strukturën e MFE dhe Fondi Kombëtar për projektet IPA, duke sjellë që vlera prej 80% e investimit në proces të jetë jashtë pasqyrës së pozicionit financiar të MFE.</p>
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi:	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë hapat e nevojshëm ligjor për transferimin e të gjithë asetëve dhe investimet e kryera gjatë viteve për shkollat e arsimit profesional te njësitë shpenzuese përkatëse, me qëllimin kontabilizimin dhe njohjen e aktiveve te njësive të cilat kanë kontroll mbi to. Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për përfundimin e procesit të kalimit të aktiveve të sistemeve të informacionit nga MFE tek AKSHI, si dhe të përcaktojnë përgjegjësitë për vonesat e shkaktuara në zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me këtë çështje. Në pasqyrat financiare të MFE-së të pasqyrohet vlera e plotë e të gjitha investimeve të kryera me burim financimi të huaj (grant apo kredi) me qëllim paraqitjen e vlerës së drejtë dhe të plotë të investimeve të kryera gjatë vitit.</p>

Titulli i Gjetjes:	Për vitin 2022, të ardhurat e realizuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë mbivlerësuar nga arkëtimi i kryer nga huaja dhënë drejt Fondit Kombëtar.
Situata	Për vitin 2022 në të ardhurat e Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rezulton se është kontabilizuar edhe llogaria 7780100 “Korrigjime nga vitet e kaluara”, në vlerën totale 84,304,139 lekë, nga të cilat vlera 80,104,138 lekë, referuar ditarëve kontabël dhe librit të madh, i përket kthimit të huasë që MFE i ka dhënë Fondit Kombëtar, në vitet e mëparshme, për IPA 2012, IPA 2013, hua e cila duhet të ishte kthyer brenda vitit kur është bërë disbursimi i shumës. Si rezultat, janë mbivlerësuar të ardhurat e vitit 2022, për vlerën 80,104,138 lekë, pasi transaksioni i arkëtimimit nga Fondi Kombëtar është kthim i një shume të dhënë hua që trajtohet si një shlyerje nga debitorët e vitit

	të kaluar.
Kriteri	- Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik” ; - Standardi Kombëtar i Kontabilitetit Nr. 8 “Të Ardhurat”.
Ndikimi	Mbivlerësim i të ardhurave të periudhës.
Shkaku	Përdorimi i gabuar i llogarisë kontabël në dhënien e huasë në vitin e kaluar që ka kaluar si një transfertë drejt të tretëve pa kundërkthim dhe kontabilizimi i kthimit të saj si një e ardhur dhe jo shlyerje nga debitorët e konstatuar. Vlera për investimet me financim të huaj nuk raportohen në pasqyrat financiare të Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë por raportohen më vete nga njësia e cila i zbaton këto projekte, CFCU, drejtori në strukturën e MFE dhe Fondi Kombëtar për projektet IPA, duke sjellë që vlera prej 80% e investimit në proces të jetë jashtë pasqyrës së pozicionit financiar të MFE.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues të marrin masa që të gjitha transferimet drejt të tretëve në formën e huadhënies afatshkurtër të kontabilizohen në llogaritë e debitorëve dhe arkëtimi i tyre të kontabilizohet si shlyerje nga këto debitorë dhe jo si e ardhur e realizuar e vitit ushtrimor.

Titulli i Gjetjes:	Për vitin 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk ka kryer procesin e inventarizimit si dhe nuk ka përfunduar procesin e nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve të identifikuar nga komisionet e inventarizimit të vitit 2017 dhe 2019.
Situata:	Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka kryer procesin e inventarizimit, në kundërshtim me kreun IV, pika 74 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, si dhe pikën 30, të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Gjithashtu nga auditimi rezulton se grupi i komisionit të vlerësimit të aktiveve, i ngritur me Urdhrin nr. 67, datë 12.04.2021 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të aktiveve të MFE-së, të identifikuar për nxjerrje nga përdorimi, nga komisionet e inventarizimit të vitit 2017 dhe 2019 dhe nga Komisionet e Degëve të Thesarit në Rrethe, për vitin 2021”, i ndryshuar, ka hartuar relacionin mbi vlerësimin e aktiveve, i cili nuk ka datë. Në relacion nuk llogaritet për asnjë aktiv efekti ekonomik i masave për riaftësimin e tyre, në kundërshtim me pikën 106, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Sipas procesverbalit “Për vlerësimin e aktiveve që janë konstatuar jashtë përdorimit” rezulton se është mbajtur nga komisioni i vlerësimit të aktiveve më datë 26.09.2022, ndërsa protokollimi i këtij procesverbali është bërë me nr. 24191 prot., ndërsa data 30.12.2022, pra 3 muaj më pas. Vlera e aktiveve të verifikuara si jashtë përdorimit nga komisioni i inventarizimit është 156,603 mijë lekë. Ndërsa nga komisioni i vlerësimit të aktiveve janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit 434 aktive në vlerën totale 65,480 mijë lekë.
Kriteri	- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreun IV, pika 74, pika 106; - Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pikën 30.
Ndikimi	Mos krahasim i gjendjes fizike dhe kontabël të aktiveve të njësisë. Mbi ngarkimin i magazinës së institucionit me aktive të dëmtuara.
Shkaku	Mos nxjerrja e urdhrin nga titullari për ngritjen e grupit të inventarizimit dhe mos përfundimi i procedurave për nxjerrjen nga përdorimi.
Rëndësia	E lartë

Rekomandimi	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve me qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, për të parandaluar shpërdorimin dhe humbjen e tyre. Gjithashtu të merren masa për përshpejtimin e procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve dhe asgjësimit të aktiveve sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
--------------------	--

Titulli i Gjetjes:	Problematika në lidhje me shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit. VKM-të për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit, janë të miratuara vite më parë dhe paraqesin nevojën e rishikimit.
Situata	<p>Nga auditimi në lidhje me shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit rezulton se, nga institucioni për akomodimin e punonjësve hoteli prenotohet nëpërmjet agjencive turistike, ku në të gjitha rastet, faturat e paraqitura nga agjencitë turistike, rezultojnë me data më të vonshme se data e fundit e qëndrimit në hotel. Në faturat e paraqitura nuk identifikohet emri i hotelit në të cilën kanë qëndruan punonjësit si dhe numri i yjeve të hotelit, në kundërshtim me pikën nr. 9 dhe lidhjen nr. 1 të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.</p> <p>Rezulton se në të gjitha rastet punonjësit pavarësisht nga pozicioni i punës/kategorisë janë akomoduar në të njëjtin hotel, si Ministri dhe zv. Ministri; Drejtori i Përgjithshëm dhe Përgjegjësi i Sektorit etj., në kundërshtim me pikën nr. 9 dhe lidhjen nr. 1 të VKM nr. 870, datë 14.12.2011.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se, për kryerjen e shpenzimeve për pritjet dhe përcjelljet dhe trajtimin financiar të delegacioneve të huaja, institucioni i referohet përcaktimeve të VKM-së nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje përcjellje që u bëhet delegacioneve të huaja”, ndryshuar me VKM nr. 258, datë 03.06.1998. Në vlerësimin e grupit të auditimit, nisur nga periudha e hershme e miratimit dhe ndryshimeve të kësaj VKM-je, të VKM-ve për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit, por dhe VKM-ve në fuqi në fusha të tjera të veprimtarisë, paraqesin nevojën e rishikimit të tyre, me qëllim sjelljen në koherencë me ndryshimet e bëra në politikat e pagave dhe për të garantuar të qënurit në përputhje me zhvillimet ekonomike dhe financiare të vendit.</p>
Kriteri	<ul style="list-style-type: none"> - VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit, pika nr. 9 dhe lidhja nr. 1; - VKM-së nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje përcjellje që u bëhet delegacioneve të huaja”.
Ndikimi	Risk për kryerjen e shpenzimeve të zërit udhëtime jashtë vendit jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
Shkaku	Kryerja e shpenzimeve pa gjurmë auditimi në lidhje me dokumentacionin shoqërues për udhëtime jashtë vendit.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	<p>Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë të marrë masa për rishikimin e kuadrit ligjor në fuqi në lidhje me trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit, si dhe për shpenzimet për pritje përcjellje që u bëhet delegacioneve të huaja me qëllim garantim e të qënurit në përputhje me aktualitetin.</p> <p>- Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për hartimin e gjurmës së auditimit në lidhjen me shpenzimet e udhëtimit të punonjësve brenda dhe jashtë vendit.</p>

2.E.5. Funkcionimi dhe monitorimi i shoqërive aksionare dhe të përbashkëta ku shteti zotëron kapital dhe ndikimi i tyre në buxhetin e shtetit.

Në zbatim të pikës E.5 të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Vendimmarrja e Asamblesë së Aksionarit për miratimin e pasqyrave Financiare dhe Raportit të Audituesit Ligjor për vitin 2021 dhe 2022;

- Vendimmarrja e Asamblesë së Aksionarit për miratimin e treguesve ekonomikë të shoqërive tregtare, si dhe dokumentacioni i paraqitur nga shoqëritë;

-Informacion nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore mbi gjendje e shoqërive shtetërore me kapital 100% shtetëror dhe më kapital të përbashkët.

Në lidhje me këtë pikë të auditimit u shqyrtua dokumentacioni i dosjeve të administruara nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Pronës Publike në MFE, nga ku u konstatua si më poshtë:

Drejtorja e Administrimit të Pronës shtetërore, e cila ka në varësi tre sektorë e konkretisht:

Sektorin e qirave dhe monitorimit të kontratave

Sektorin e menaxhimit të shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore

Sektorin e zonave ekonomike, standardizimit dhe monitorimit të shpronësimeve

Në lidhje me këtë drejtim auditimi objekti është: veprimtaria mbi administrimin dhe monitorimin e pronës shtetërore (shoqërive aksionare dhe të përbashkëta) ku shteti është aksionar **për sa i takon implikimit të tyre në buxhetin e shtetit për dividendin dhe mbështetjen buxhetore.**

Nga auditimi rezulton se, bazuar në legjislacionin e sipërcituar Ministria Financave dhe Ekonomisë (MFE), është përfaqësuese e pronarit të pronës shtetërore (të pasqyruara në tabelën e mëposhtme jepet dhe gjendja bilanci për secilën prej shoqërive me kapital mbi 50% shtetëror si dhe për një ndërmarrje shtetërore) si më poshtë:

Janë në përgjegjësi administrimi të MFE 14 shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror:

1. Sh.a “OST”, Tiranë;
2. Sh.a “Posta Shqiptare”, Tiranë;
3. Sh.a “Porti Detar”, Sarandë;
4. Sh.a “Albcontrol”, Tiranë;
5. Sh.a “Regjistri Detar Shqiptar”, Durrës;
6. Sh.a “Agrokredit”, Tiranë;
7. Sh.a “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”, Tiranë.
8. Sh.a “Porti Detar”, Vlorë
9. Sh.a “Porti Detar”, Shëngjin
10. Sh.a “Hekurudha Shqiptare”, Durrës
11. Sh.a “Trajtimi Studentëve”, Vlorë
12. Sh.a “Trajtimi i Studentëve”, Korçë
13. Sh.a “Prodhim Mobilje”, Tiranë
14. Sh.a “Korporata e Investimeve Shqiptare” sha Tiranë.

➤ 1 ndërmarrje shtetërore;

1. Ndërmarrja Industriale Nr. 1, Tiranë

➤ 2 shoqëri aksionare me kapital mbi 50% shtetëror;

1. Sha “Tregu i shitjes me shumicë Fruta-Perime”, Shkodër,
2. Sha “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sha Tiranë

➤ 12 shoqëri aksionare (sha) me kapital nën 50 % shtetëror, që varion nga 7.5% në “B.” SH.A, Tiranë deri në 49% te “Frigoriferi” SH.A Durrës.

- **16 shoqëri të përbashkëta (shpk) me kapital nën 50 % shtetëror, që varion nga 4.5% në “A.” SHPK”, Shkodër deri në 49% te “T. A.” SHPK, Tiranë.**

Shoqëritë me formë organizimi sh.a apo shpk, me kapital zotëruar nga shteti nën 50%, janë krijuar në vendin tonë kryesisht në vitet 1993-1996. Disa prej tyre kanë pësuar dëmtime dhe kanë ndërprerë aktivitetin prej vitit 1997. Në praktikë, ndër vite SHPK-të kanë paraqitur vështirësi në ushtrimin e aktivitetit dhe privatizimin e kuotave shtetërore të tyre. Shoqëritë fillimisht janë regjistruar si person juridik i formës Shpk ose Sha me Vendim Gjykate, e cila ka depozituar bashkëlidhur vendimit të saj edhe Autorizimin zyrtar për krijimin e shoqërisë, Kontratën e themelimit dhe Statutin e secilës prej tyre.

Në aktet e themelimit të shoqërisë, është pasqyruar nënshkrimi i kontributeve, që ortakët apo aksionarët kanë marrë përsipër të derdhin.

Si kontribut i ortakut/aksionarit shtetëror në këto shoqëri, fillimisht janë nënshkruar vlera e asaj periudhe e ndërtesave, makinerive e pajisjeve, të disa ish ndërmarrjeve shtetërore. Shteti shqiptar përfaqësuar në të gjitha këto shoqëri, nga ministri përgjegjës për ekonominë nuk merr dot vendim, pasi nuk ka kuorumin e duhur sipas ligjit. Megjithatë mban qëndrimin e vet në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

Bilancet e këtyre shoqërive janë të depozituara në QKB dhe tek Drejtoria e Tatimeve, dhe kjo e fundit ka kompetencë ligjore për ti kontrolluar të gjitha shoqëritë pavarësisht përqindjeve të pjesëmarrjes.

Për arsye të mos marrjes së vendimeve apo kontrollit në administrim, prej vitesh Shteti Shqiptar ka filluar disa herë procedurën e privatizimit të kuotave apo aksioneve për mos degradim të mëtejshëm të tyre. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar disa herë fillimin e procedurës së vlerësimit të kuotave dhe aksioneve në këto shoqëri.

Spektori i Sha-ve, krahas hartimit të procedurave që kërkojnë vendimmarrjen e Asamblesë së Aksionarit, në fund të çdo viti ushtrimor i propozon Ministrin lidhur me shpalljen e shoqërive në likuidim, privatizim apo bashkimin e disa shoqërive në një të vetme, me qëllim eliminimin e kostove në vazhdimësi.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me cilësinë e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, ushtron të gjitha kompetencat e përcaktuara në nenin 135, të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, si: miratimin e treguesve financiarë të shoqërive; miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ndryshime të statutit; emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillave Mbikëqyrës dhe të administrimit, si dhe të administratorëve; riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, etj.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë miraton me vendim të aksionarit të vetëm çështjet e specifikuar më sipër, vetëm në shoqëritë ku është zotëruese e 100% të paketës së aksioneve.

I. Mbi miratimin e Pasqyrave Financiare

Gjatë vitit 2022 janë miratuar Pasqyrat Financiare të vitit 2021 të 15 shoqërive me kapital 100% shtetërore, ku 5 shoqëri kanë rezultuar me fitim gjithsej në shumën 1,241,781 mijë lekë, ndërsa 10 shoqëritë e tjera kanë rezultuar me humbje gjithsej në shumën 722,977 mijë lekë. Për shoqëritë që kanë rezultuar më fitim vetëm në dy prej tyre është shpërndarë dividend në shumën 2,448 mijë lekë, ndërsa për shoqëritë e tjera fitimi është shpërndarë për mbulimin e humbjeve të periudhave të mëparshme, si dhe në rezerve ligjore, sipas Aneksit bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për llogari të vitit 2022, referuar arkëttimeve në sistemin e Thesarit dhe rakordimit ndërmjet Drejtorisë së Administrimit të Pronës dhe Sektorit të Financës së Aparatit të MFE -së

konstatohet se, janë derdhur dividend nga 4 shoqëri, në shumën 61,005,900 lekë e cila rakordon me treguesit fiskalë të buxhetit faktik të vitit 2022, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Data e veprimit	Vlera e dividendit (në lekë)
1	Shoqëria C. C.	08.11.2022	13,676,554
2	Sh. L. V.	08.11.2022	1,293,751
3	D. B. L.	02.02.2023	58,033
4	T. shpk	02.02.2023	45,977,562
5	Derdhje dividendi e mbartur nga vitet e kaluara	24.08.2022	1,154,706
	TOTALI		62,160,606

Burimi: MFE, Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike

Gjithashtu, është derdhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe gjendja e mbartur e dividendit në shumën 1,154,706 lekë, gjithsej derdhur shuma 62,160,606 lekë.

Deri më 31.12.2022 referuar raportimeve të DA Pronës konstatohet së Dividendi i prapambetur i pa likuiduar është në **shumën 4,054,214 mijë lekë**, i cili i përket shoqërive si më poshtë:

1. Dividendi i pa likuiduar prej 8,910 mijë lekë i përket shoqërisë “Q. T. Zh. K.” SHPK Tiranë, e cila me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 29.03.2017, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Tiranë. Meqenëse shoqëria ka kaluar me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, detyrimet e prapambetura të pa likuiduara ndiqen nga Ortaku i ri, Bashkia Tiranë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 16550/13, datë 23.01.2023, i është drejtuar Bashkisë Tiranë për likuidimin e shumës së dividendit të prapambetur.

2. Dividendi i pa likuiduar prej **3,979,239 mijë lekë** i përket shoqërive “KESH” sh.a dhe “Albpetrol” sh.a, të cilat me VKM nr. 317, datë 27.04.2016 dhe VKM nr. 848, datë 07.12.2016 kanë kaluar në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për të dy këto shoqëri Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vijimësi gjatë viteve, por dhe me shkresën e fundit nr. 16550/12, datë 23.01.2023, i ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë likuidimin e shumës së dividendit të prapambetur.

4. Dividendi i pa likuiduar prej **66,065 mijë lekë** i përket bilancit kontabël të vitit 2012 të shoqërisë “H. U. Sh...”. Me ligjin nr. 94/2013 është ratifikuar kontrata për shitjen e 100% të aksioneve të shoqërisë nga MFE tek shoqëria “K. I.” sha. Në momentin e privatizimit të gjitha të drejtat dhe detyrimet i kanë kaluar blerësit të paketës së aksioneve. Disa herë MFE ka kërkuar ndërhyrjen e Drejtorisë së Tatimeve për likuidimin e dividendit në favor të Buxhetit të Shtetit. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 16550/11, datë 23.01.2023 ka ripërsëritur kërkesën për likuidimin e dividendit, pasi në momentin e privatizimit të paketës shtetërore, pasqyrat financiare nga subjektet dorëzohen në Drejtorinë e Tatimeve.

Deri në momentin e auditimit janë dorëzuar dhe miratuar Pasqyrat Financiare dhe rezultati financiar i vitit 2022, për shoqërive anonime si më poshtë:

Nr	Shoqëria	Përqindja e kapitalit	Kapitali	Fitim/Humbja	Data e trajtimit nga struktura	Data e miratimit
1	Trajtimi Studentëve Korçë	100	469,295,826	-13,102,360	13.06.2023	27.06.2023
2	OST	100	32,745,048,489	907,587,774	15.05.2023	31.05.2023
3	Trajtimi Studentëve Vlorë	100	1,216,670,818	-4,030,166	19.06.2023	
4	Shtypshkronja e Letrave me Vlerë	100	560,549,842	9,317,062	03.07.2023	
4	Regjistri Detar Shqiptar	100	102,782,357	14,369,121	04.07.2023	
5	Porti Detar Sarandë	100	964,731,219	18,311,180	12.07.2023	

Burimi: MFE; Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se deri në momentin e përfundimit të auditimit janë dorëzuar pasqyrat financiare vetëm nga 5 shoqëri anonime, nga të cilat dy kanë rezultuar me humbje, ndërsa 4 shoqëri të tjera kane rezultuar me fitim dhe nëse Asambleja e Ortakëve vendos shpërndarje dividendi, ai do jetë detyrim për tu derdhur gjatë vitit 2023.

II. Mbi Programet e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2022.

Nga Ortaku i Vetëm janë miratuar programet e zhvillimit ekonomik, për të cilat disponohen të gjitha dosjet e programeve të zhvillimit ekonomik të miratuara paraprakisht nga Këshilli Mbikëqyrës, të cilat referuar dhënave të Aneksit bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, janë miratuar me vonesë treguesit ekonomikë, e në rastin e “P. M.” sh.a, Tiranë ka miratuar treguesit ne fund të vitit.

Ndërsa Korporata e Investimeve Shqiptare sh.a, e cila referuar të dhënave të vëna në dispozicion të auditimit, jo vetëm nuk ka dorëzuar në kohë programin ekonomik të zhvillimit të vitit 2022 dhe as të vitit 2023, si dhe nuk ka paraqitur programin e korrigjuar pas shqyrtimit të tij nga struktura përgjegjëse, pra për këtë shoqëri nuk ka tregues ekonomikë të miratuar për këto dy vite.

Kjo shoqëri ka si objekt: “Nxitja e zhvillimit ekonomik nëpërmjet projekteve të investimit me potencial komercial në nivel qendror, vendor dhe rajonal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit. Vënia në përdorim me eficiencë të pronave shtetërore. Kryerja e investimeve duke mobilizuar kapital shtetëror dhe/ose privat. Këshillimi i institucioneve publike dhe/ose private ne hartimin, analizimin, rekomandimin, dhe strukturimin e projekteve. Zhvillimi i Zonave të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, me vendim/autorizim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit për Zonat Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik. Financimi ose bashkëfinancimi i projekteve ose subjekteve për qëllime të veçanta (SPV) të ngritura 2 për realizimin e tyre. Këshilli i Ministrave mund të autorizojë Korporatën të kryejë funksione të tjera, sipas legjislacionit në fuqi”.

- Nga auditimi konstatohet se Sh.a “Korporata e Investimeve Shqiptare” sha Tiranë, me kapital të regjistruar 100% shtetëror, në vlerën 2,178,529,064 lekë, referuar pasqyrave financiare të dorëzuara, për vitin 2021 ka rezultuar me humbje në vlerën 19,465,000 lekë. Për vitin 2022 kjo shoqëri deri në momentin e auditimit nuk ka paraqitur pasqyrat financiare, por konstatohet se është financuar nga buxheti i shtetit për vitet 2021 dhe 2022, si më poshtë:

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 98, datë 22.12.2021, Aksionari i Vetëm (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 2,000,000,000 lekë (dy miliardë lekë), kaluar me Aktin Normativ nr. 34, datë 03.12.2021, duke e çuar kapitalin e kësaj shoqërie në 2,198,000,000 lekë referuar gjendjes në regjistrin tregtar më datë 13.01.2022.

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 95, datë 15.09.2022, Aksionari i Vetëm ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 200,000,000 lekë, kaluar me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022. Bashkëlidhur këtij vendimi janë shkresat nr. 07, datë 20.04.2022 e Drejtorit Ekzekutiv të AIC, E. F. drejtuar MFE ku kërkon: “ Në vijim të komunikimeve të mëhershme për rritjen e Kapitalit të AIC dhe në bazë të ligjit 115/2021 , për buxhetin e vitit 2022, Parashikimi i Investimeve me Financim të Brendshëm, është aprovuar financimi i AIC-s me vlerën 200,000,000 lekë. Kërkojmë nga ana juaj zbatimin e procesit për rritje kapitali duke mundësuar kalimin e fondit të miratuar në AIC”. Nga AIC është rikërkuar rritja e kapitalit dhe me shkresën nr. 07/1, datë 01.08.2022.

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 112, datë 28.12.2022, Aksionari i Vetëm (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) ka vendosur zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 2,000,000,000 (dy miliardë) lekë, kaluar më Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022.

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 112/1, datë 28.12.2022, Aksionari i Vetëm (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 2,000,000,000 (dy miliardë) lekë, kaluar më Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022,

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 113, datë 28.12.2022, Aksionari i Vetëm (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) ka vendosur shfuqizimin e

Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 98, datë 15.09.2022 për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 200,000,000 lekë.

-Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 113/1, datë 28.12.2022, Aksionari i Vetëm (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 120,000,000 lekë, duke ju referuar Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022.

Nga auditimi konstatohet se, për të gjithë këtë vendimmarrje të Aksionarit, nuk na janë vënë në dispozicion kërkesa apo shkresa të AIC sh.a. Gjithashtu, po në këtë datë nga NPA në cilësinë e NA të ministrisë është urdhëruar Drejtoria e Buxhetit dhe Shërbimeve të kalojë fondet e miratuar në llogarinë e kësaj shoqërie, fonde të cilat janë bërë efektive në SIFQ më datë 17.01.2023.

Ndërsa, Ministri me urdhrin nr. 298, datë 30.12.2022 “Për kthim fondi”, në pikën 1 të tij ka urdhëruar AIC kthimin e fondit prej 2 miliard lekë në favor të buxhetit të Shtetit, si dhe ky fond të zbritet nga kapitali themeltar i shoqërisë. Deri në përfundim të auditimit konstatohet se, ky urdhër nuk është zbatuar nga AIC, pra fondet nuk janë kthyer në buxhetin e shtetit.

Pra, në të njëjtën ditë Ortaku i Vetëm ka marrë 4 vendime për zmadhim dhe zvogëlim kapitali me efekt neto në rritje kapitali të AIC në vlerën 2,120,000,000 lekë, pa ndonjë argument, rezultat apo kërkesë ligjore. Aktualisht kjo shoqëri referuar gjendjes në regjistrin tregtar zotëron një kapital prej 4,318,000,000 lekë, edhe pse paraqitet me humbje dhe për tre vite nuk ka paraqitur e realizuar asnjë projekt.

Titulli i Gjetjes	Mangësi në paraqitjen dhe miratimin e treguesve ekonomikë dhe shtim kapitali për shoqërinë AIC duke rënduar buxhetin e shtetit në shumën 2 miliard lekë për vitin 2022.
Situata:	<p>Nga auditimi konstatohet se, Korporata e Investimeve Shqiptare SH.A, nuk ka dorëzuar në kohë programet e zhvillimit ekonomik të vitit 2022 dhe vitit 2023, si dhe nuk ka paraqitur programin e korrigjuar pas shqyrtimit të tij nga strukturat përgjegjëse, pra për këtë shoqëri nuk ka tregues ekonomikë të miratuar për këto dy vite.</p> <p>- Nga auditimi konstatohet se SH.A “Koorporata e Investimeve Shqiptare” Tiranë, me kapital të regjistruar 100% shtetëror në vlerën 2,178,529,064 lekë, referuar pasqyrave financiare të dorëzuara, për vitin 2021 ka rezultuar me humbje në vlerën 19,465,000 lekë. Për vitin 2022 kjo shoqëri deri në momentin e auditimit nuk ka paraqitur pasqyrat financiare, por konstatohet se është financuar nga buxheti i shtetit për vitet 2021 - 2022, si më poshtë:</p> <p>- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 98, datë 22.12.2022, Aksionari i Vetëm (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 2,000,000,000 lekë, kaluar me Aktin Normativ nr. 34, datë 03.12.2021, duke e çuar kapitalin e kësaj shoqërie në 2,198,000,000 lekë referuar gjendjes në regjistrin tregtar më datë 13.01.2022.</p> <p>- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 95, datë 15.09.2022, Aksionari ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 200,000,000 lekë, kaluar me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022.</p> <p>- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 112, datë 28.12.2022, Aksionari i Vetëm ka vendosur zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 2,000,000,000 lekë, kaluar më Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022.</p> <p>- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 112/1, datë 28.12.2022, Aksionari i Vetëm ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 2,000,000,000 lekë, kaluar më Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022.</p> <p>- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 113, datë</p>

	<p>28.12.2022, Aksionari i Vetëm ka vendosur shfuqizimin e Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 98, datë 15,09,2022 për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 200,000,000 lekë.</p> <p>-Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 113/1, datë 28.12.2022, Aksionari i Vetëm ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 120,000,000 lekë.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se, për të gjithë këtë vendimmarrje të Aksionarit, nuk ka kërkesa dhe shkresa të AIC SH.A, apo vendimmarrje të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, megjithëse në përbërjen e tij një pjesë e madhe e anëtarëve janë përfaqësues të MFE.</p> <p>Gjithashtu, në këtë datë nga NPA në cilësinë e NA të ministrisë është urdhëruar Drejtorja e Buxhetit dhe Shërbimeve të kalojë fondet e miratuara në llogarinë e kësaj shoqërie, fonde të cilat janë bërë efektive në SIFQ më datë 17.01.2023. Pra në të njëjtën ditë Ortaku i vetëm ka marrë 4 vendime për zmadhim dhe zvogëlim kapitali me efekt neto në rritje kapitali në vlerën 2,120,000,000 lekë, pa ndonjë argument, rezultat apo kërkesë ligjore. Aktualisht kjo shoqëri referuar gjendjes në regjistrin tregtar zotëron një kapital prej 4,318,000,000 lekë, edhe pse paraqitet me humbje dhe për tre vite nuk ka paraqitur e realizuar asnjë projekt.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, neni 135; - VKM nr. 570, datë 3.1.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”; - Udhëzimi nr. 15, datë 2.5.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”.
Efekti:	Efekte financiare në buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Vendimmarrje e pa argumentuar e strukturave të buxhetit dhe të administrimit të pronës.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi :	<p>Asambleja e Ortakëve, Drejtorja e Administrimit të Pronës Publike të marrë masa për analizimin e veprimtarisë ekonomike dhe të situatës financiare të AIC SH.A dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mosparaqitjen e programit ekonomik dhe të pasqyrave financiare të vitit 2022 të shoqërisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Asambleja e Ortakëve të marrë masa për kthimin e kapitalit të AIC SH.A në shumën 4 miliard lekë në buxhetin e shtetit, përfituar pa asnjë kërkesë apo argument dhe në mënyrë të pajustificuar me aktivitetin e kësaj shoqërie. - Ministria e Financave të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësve për veprimet e kryera për lëvizjen e kapitalit, si dhe të urdhëroje ushtrimin e një misioni auditimi në AIC SH.A mbi aktivitetin e zhvilluar, qëllimet dhe arritjen e objektivave të krijimit të kësaj shoqërie.

Titulli i Gjetjes	Efekte financiare negative në buxhetin e shtetit në vlerën 4,054,214 mijë lekë nga mos derdhja e dividendit.
Situata:	<p>Nga auditimi konstatohet se, deri më 31.12.2022 referuar raportimeve të Drejtorisë së Administrimit të Pronës, dividendi i prapambetur i pa likuiduar është në shumën 4,054,214 mijë lekë, i cili i përket shoqërive si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dividendi i palikuiduar prej 8,910 mijë lekë i përket shoqërisë “Q. T. Zh. K.” SHPK Tiranë, e cila me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 29.03.2017, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Tiranë. Meqenëse shoqëria ka kaluar me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, detyrimet e prapambetura të palikuiduara ndiqen nga Ortaku i ri, Bashkia Tiranë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 16550/13, datë 23.01.2023, i është drejtuar Bashkisë Tiranë për likuidimin e shumës së dividendit të prapambetur. 2. Dividendi i palikuiduar prej 3,979,239 mijë lekë i përket shoqërive “KESH”

	<p>SH.A dhe “Albpetrol” SH.A, të cilat me VKM nr. 317, datë 27.04.2016 dhe VKM nr. 848, datë 07.12.2016 kanë kaluar në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.</p> <p>Për të dy këto shoqëri Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vijimësi gjatë viteve, por dhe me shkresën e fundit nr. 16550/12, datë 23.01.2023, i ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë likuidimin e shumës së dividendit të prapambetur.</p> <p>4. Dividendi i palikuiduar prej 66,065 mijë lekë i përket bilancit kontabël të vitit 2012 të shoqërisë “H. U. Sh.”. Me ligjin nr. 94/2013 është ratifikuar kontrata për shitjen e 100% të aksioneve të shoqërisë nga MFE tek shoqëria “K. I.” SH.A.</p>
Kriteri:	<p>- Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, neni 128,</p> <p>- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 33;</p> <p>-Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.5</p>
Efekti:	Efekte financiare negative në buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Mungesë koordinimi midis shoqërive anonime dhe Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike në MFE, por dhe të kësaj të fundit me ministrinë që këto subjekte i kanë në fushën e përgjegjësisë së tyre.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me ministrinë e linjës të kërkojnë arkëtimin e detyrimeve për dividendin e pa derdhur në shumën 4,054 milion lekë.

2.F. Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

2.F.1. Veprimtaria e Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Për auditimin e kësaj çështje të programit të auditimit është shqyrtuar dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pyetësorët e vetëvlerësimit të njësive publike;
- Plani Vjetor 2022 nga DH/MFKK;
- Raporti Vjetor mbi Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme për vitin 2022;
- Monitorimet dhe trajnimet e DH/MFKK;
- Regjistri i NA dhe NZ; etj.

Nga auditimi ka rezultuar:

Në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit është audituar përputhshmëria e veprimtarisë e këtij subjekti me ligjet dhe aktet normative, mbi strukturën e Auditit të Brendshëm dhe funksionimin e tij në zbatim të Ligjit Nr.114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, aktivitetin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Kontabilitetit si dhe vlerësimi i strukturave kontrolluese, mbi bazën e të cilave e ushtron veprimtarinë subjekti i audituar, për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022.

Plani Vjetor 2022 i DPHKBFP me nr. 23648 Prot., datë 31.12.2021 ka patur 17 objektiva për DH/AB dhe 10 objektiva për DH/MFKK. Bazuar në nenin 26, pika 3 e Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku përcaktohet se “Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ndihmon Nëpunësin e Parë Autorizues dhe Ministrin e Financave për monitorimin e sistemeve të

menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe për përgatitjen e raportit vjetor për gjendjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit publik, ku përmbledhet informacioni i marrë, në përputhje me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji” janë analizuar, ndër të tjera, edhe të dhënat e raportuara në Raportin Vjetor të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, kapitulli II, “Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli”.

Analiza e sistemit sipas pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit bazuar në vetëvlerësimin e njësive publike

Në zbatim të Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, neni 18 “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, pika 1, citon se “Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë vetëvlerësimeve, depoziton te titullari I njësisë publike dhe nëpunësi i pare autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji;”, dhe neni 29 “Kundërvajtjet administrative, pika 1 citon se “Shkelja apo mospërbushja e detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e pikës 1 të nenit 18 të këtij ligji nga nëpunësi autorizues i njësisë publike, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 20 000 deri në 40 000 lekë”.

MFE u ka shpërndarë për plotësim pyetësorët e vetëvlerësimit 152 njësive të sektorit publik, referuar Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”. Nga këto njësi, 146 prej tyre kanë depozituar përgjigjet e pyetësorit të vetëvlerësimit pranë MFE.

Disa prej njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk kanë raportuar në mënyrën e duhur duke pasur mangësi në dokumentacionin e dërguar apo vonesa në depozitim të informacionit të kërkuar, ku përfshihen:

1. Bashkia Konispol;
2. Bashkia Rrogozhinë;
3. Bashkia Finiq;
4. Bashkia Memaliaj;
5. Bashkia Kavajë;
6. Bashkia Vorë;
7. Bashkia Delvinë;
8. Bashkia Himarë;
9. Qarku Lezhë;
10. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
11. Sekretariati i Këshillit Ekonomik Kombëtar; si dhe
12. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Tabela nr. 1: Të dhëna lidhur me raportimin mbi pyetësorin e vetëvlerësimit

Institucionet	Dërguar për raportim	Raportuar faktikisht	Diferenca me faktin
Bashki dhe Këshill Qarku	73	68	-5
Ministri	11	10	-1
Institucione të Pavarura	55	55	0
Institucione Varësie	13	13	0
Total	152	146	-6

Burimi: DH/MFKK në MFE

Pra, nga të dhënat rezultojnë se pjesa më e madhe e njësive publike që nuk kanë plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit të MFK u përkasin bashkive dhe këshillave të qarkut.

Pyetëtori i vetëvlerësimit përbëhet nga 17 parime të cilat ndahen në 5 ndarje kryesore (Mjedisi i kontrollit/Menaxhimi i riskut/Aktivitetet e kontrollit/informimi dhe komunikimi/Monitorimi) dhe konsistojnë në 114 pyetje në total.

Nga përgjigjet e pyetësorit të vetëvlerësimit janë evidentuar vlerësimet në vijim nga DH/MFKK sipas paraqitjes në tabelën nr. 2:

Tabela nr. 2: Vlerësimi i komponentëve të MFK për sistemin

Elementi	Vlerësimi 2021	Vlerësimi 2022
Mjedisi i kontrollit	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 1: Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike</i>	Efektiv	Efektiv
<i>Parimi 2: Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 3: Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 4: Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 5: Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Menaxhimi i riskut	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 7: Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 8: Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 9: Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Aktivitetet e kontrollit	Efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 10: Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit</i>	Efektiv	Efektiv
<i>Parimi 11: Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 12: Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave</i>	Efektiv	Pjesërisht efektiv
Informimi dhe komunikimi	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 13: Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 14: Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm</i>	Efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 15: Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Monitorimi	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 16: Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 17: Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Total	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv

Burimi: Të dhënat nga DH/MFKK në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Nga krahasimi i vitit 2021 me vitin 2022, evidentohet një ulje e efektivitetit për parimet 12 dhe 14 respektivisht pjesë e Aktiviteteve të Kontrollit dhe Informimit dhe Komunikimit. Ndërkohë, asnjë prej elementëve nuk paraqitet në përmirësim nga viti i kaluar.

Vlerësimi i cilësisë

Referuar dispozitave ligjore të fushës së kontrollit të brendshëm (neni 18, pika 3 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar), MFE realizon vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm bazuar në raportet vjetore të konsoliduara të përfituesve të fondeve publike mbi statusin e menaxhimit financiar dhe

kontrollit dhe auditimit të brendshëm. Procedurat për realizimin e procesit të vlerësimit të cilësisë janë përcaktuar në dokumentin e Metodologjisë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 311, datë 23.12.2020. Ky proces synon përmirësimin e standardeve të punës si dhe analizimin dhe vlerësimin me detaje të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Për vitin 2022, përmes Planit Vjetor është planifikuar realizimi i procesit të vlerësimit të cilësisë në 20 njësi të qeverisjes së përgjithshme (NJQP) ku, u finalizua procesi i vlerësimit të cilësisë në 16 NJQP, ndërkohë në 4 prej tyre ky proces nuk u realizua, ku DH/MFKK ka paraqitur si shkak mosangazhimin e këtyre institucioneve për vënien në dispozicion të grupit të vlerësimit të dokumenteve zyrtarë të gjeneruar. Sa i përket vlerësimit të sistemit të brendshëm, nga DH/MFKK rezulton se vlerësimi në institucione është konsideruar “pjesërisht efektiv”, detajuar si në tabelën nr. 3:

Tabela nr. 3: Planifikimi dhe realizimi për NJQP mbi vlerësimin e cilësisë dhe asistencë teknike, 2022

Institucioni	Vlerësim Cilësie		Asistencë Teknike		Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm
	Afati	Planifikuar	Afati	Planifikuar	
Ministria e Mbrojtjes	Shkurt	x	Gjatë gjithë vitit	x	Efektiv
Ministria e Kulturës	Shkurt	x			Pjesërisht efektiv
Avokatura e Shtetit	Mars	x			Pjesërisht efektiv
Gjykata Kushtetuese	Mars	x			NR
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	Mars	x			Pjesërisht efektiv
Bashkia Lezhë	Mars	x	Gjatë gjithë vitit	x	Joefektiv
Agjencia e Prokurimit Publik	Prill	x	Gjatë gjithë vitit	x	Pjesërisht efektiv
Kuvendi	Prill	x			Efektiv
Bashkia Cërrik	Maj	x			NR
Bashkia Belsh	Maj	x	Gjatë gjithë vitit	x	NR
Prokuroria e Përgjithshme	Qershor	x	Gjatë gjithë vitit	x	Pjesërisht efektiv
Bashkia Tropojë	Qershor	x			Joefektiv
ILDKPKI	Korrik	x			Efektiv
Bashkia Klos	Korrik	x			Joefektiv
Kryeministria	Shtator	x			Efektiv
Bashkia Vlorë	Shtator	x			NR
Bashkia Roskovec	Tetor	x			Joefektiv
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Tetor	x			Efektiv
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Tetor	x			Pjesërisht efektiv
Bashkia Durrës	Nëntor	x			Pjesërisht efektiv

Shënim: NR – nuk është realizuar vlerësimi i cilësisë

Burimi: DH/MFKK në MFE.

DH/MFKK përmes shkresave të cituara më poshtë i ka tërhequr vëmendjen subjekteve: Bashkia Cërrik, Bashkia Vlorë, Gjykata Kushtetuese, Bashkia Belsh, për mungesë dorëzimi dokumentacioni dhe rrjedhimisht mungesë të mundësisë së vlerësimit të cilësisë së sistemit të brendshëm.

Përmes shkresës nr. 3500 Prot., datë 20.02.2023, DH/MFKK i ka tërhequr vëmendjen Bashkisë Cërrik për mosdorëzimin e dokumenteve zyrtare të gjeneruara lidhur me procesin e vlerësimit që është realizuar në datat 14-18 Nëntor 2022 (ndërkohë periudha e planifikuar dhe

lajmëruar pranë Bashkisë Cërrik për këtë vlerësim ka qenë 23-27 Maj, bazuar në shkresën nr. 5228 Prot., datë 23.03.2022 të MFE).

Përmes shkresës nr. 3499 Prot., datë 20.02.2023, DH/MFKK i ka tërhequr vëmendjen Bashkisë Vlorë për mosdorëzimin e dokumenteve zyrtare të gjeneruara lidhur me procesin e vlerësimit që është realizuar në datat 19-23 Shtator 2022.

Përmes shkresës nr. 3497 Prot., datë 20.02.2023, DH/MFKK i ka tërhequr vëmendjen Gjykatës Kushtetuese për mosdorëzimin e dokumenteve zyrtare të gjeneruara lidhur me procesin e vlerësimit që është realizuar në datat 07-11 Mars 2022.

Përmes shkresës nr. 3498 Prot., datë 20.02.2023, DH/MFKK i ka tërhequr vëmendjen Bashkisë Belsh për mosdorëzimin e dokumenteve zyrtare të gjeneruara lidhur me procesin e vlerësimit që është realizuar në datat 14-18 Nëntor 2022.

Të katërt subjektet e sipërcituara nuk kanë kthyer përgjigje, duke mos mundur DH/MFKK të japë një opinion mbi vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm.

Për 16 NJQP e vlerësuara, DH/MFKK ka evidentuar gjetjet e mëposhtme:

1. Rregullat bazë për funksionimin e institucioneve janë përshkruar në dokumentin e Rregullores së Brendshme, dhe kryesisht këto rregullore rezultojnë të rishikuara me ndryshimet e fundit strukturore ose rezultojnë në fazë rishikimi në momentin e realizimit të vlerësimit të cilësisë ndërkohë që rregullat për sjelljen dhe etikën janë miratuar nëpërmjet një dokumenti të veçantë ose janë përfshirë në rregulloren e brendshme;
2. Objektivat kryesore për realizimin e veprimtarisë së çdo strukture brenda institucionit janë përcaktuar në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe jo në të gjitha rastet janë hartuar planet vjetore të punës të konsoliduara, me objektiva dhe aktivitete të specifikuara;
3. Menaxhimi i burimeve njerëzore realizohet duke respektuar rregullat e përcaktuara nga vetë institucioni apo nga Departamenti i Administratës Publike duke mbajtur në konsideratë dhe trajtimin dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve në fusha të ndryshme por jo shpesh lidhur me fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Trajnimi i punonjësve realizohet kryesisht nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnimet e realizuara nga ASPA;
4. Institucionet paraqesin vështirësi ose mungesë angazhimi në hartimin apo zbatimin e instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit (regjistër risku, harta dhe manuali i proceseve të punës, gjurmë auditimi);
5. Delegimi i funksioneve kryhet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi dhe realizohet kryesisht për autorizimin e punonjësve në mungesë ndërkohë që delegimi sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor të MFK përdoret në pak raste;
6. GMS-të janë ngritur me urdhër të brendshëm të titullarit, të shoqëruara me plan veprimi, por në këto grupe diskutohen vetëm çështje të aspektit buxhetor dhe nuk ka evidencë që të jenë trajtuar çështje të MFK;
7. Në disa prej institucioneve, evidentohet një mungesë e vlerësimit apo monitorimit në vazhdimësi të sistemit të kontrollit të brendshëm me qëllim komunikimin dhe adresimin e problematikave të konstatuara. Kryesisht, vlerësimi dhe raportimi realizohet për veprimtarinë financiare të institucionit;
8. Njësitë e Auditimit të Brendshëm për ato institucione që kanë një strukturë të tillë (ose auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit), në misionet e tyre audituese, kanë bërë një vlerësim gjithëpërfshirës për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse, por nuk evidentohet përfshirja e rekomandimeve në planet e zbatimit të masave apo niveli i zbatimit të këtyre rekomandimeve nga ana e institucioneve të vlerësuara mbetet në nivele të ulëta.

Pika 1.2.2 “Procedura e përzgjedhjes së njësisë të qeverisjes së përgjithshme për vlerësimin e sistemit të KB” citon se “Procedura e përzgjedhjes së njësisë të qeverisjes së përgjithshme për vlerësimin e sistemit të cilësisë së KB, realizohet si më poshtë vijon:

- Ndahen njësitë e qeverisjes së përgjithshme në grupe duke u bazuar tek ndarja e detyrave brenda DH/MFKKK (ministritë e linjës, institucionet e pavarura, bashkitë);
- Llogaritet numri i njësisë të qeverisjes së përgjithshme që do të vlerësohen nga çdo punonjës i DH/MFKKK, duke ndarë ditët e punës në dispozicion për një vit të caktuar që DH/MFKKK ka planifikuar të shpenzojë për vlerësimin në terren, si dhe duke nisur nga kohëzgjatja e një vlerësimi në terren;
- Përzgjidhen njësitë e qeverisjes së përgjithshme nga të treja grupet e sipërpërmendura në pikën 1.2.1”

Sa më sipër, konstatohet se nga ana e DH/MFKKK nuk është administruar dhe vënë në dispozicion të grupit të auditimit, një dokument i cili vërteton një analizë të tillë të përlllogaritur për planifikimin e vlerësimin të sistemit të cilësisë së kontrollit të brendshëm sipas përcaktimeve të pikës 1.2.2 të Metodologjisë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në njësitë publike.

Në Planin Vjetor me nr. 23648 Prot., datë 31.12.2021, DH/MFKK ka përcaktuar 10 objektiva specifike për vitin 2022, specifikuar me detyra/aktivitetet për secilin prej objektivave. Përgjatë vitit 2022, në kuadër të reformës së menaxhimit të financave publike dhe angazhimit të MFE në zbatimin e Dokumentit të Politikave për Zhvillimin e mëtejshëm të Kontrollit të Brendshëm, DH/MFKK ka planifikuar ofrimin e asistencës teknike në 5 (pesë) institucione si program pilot për vitin 2022:

1. Bashkia Lezhë;
2. Prokuroria e Përgjithshme;
3. Bashkia Belsh;
4. Agjencia e Prokurimit Publik;
5. Ministria e Mbrojtjes.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur për të shqyrtuar dosjet e vlerësimin të cilësisë në 5 subjektet e mësipërme. Nga auditimi i tyre ka rezultuar se DH/MFKK ka lajmëruar secilin prej subjekteve se bazuar në nenin 25 dhe 26 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2021 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, do të kryhet vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në datat përkatëse, referuar edhe listës së kontrolleve miratuar përmes Urdhrit nr. 311, datë 23.12.2020 “Për miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në njësitë publike”. Për më tepër, në kuadër të reformës së menaxhimit të financave publike dhe angazhimit të MFE në zbatimin e Dokumentit të Politikave për Zhvillimin e mëtejshëm të Kontrollit të Brendshëm, DH/MFKK ka njoftuar edhe për ofrimin e asistencës teknike, për të cilën stafi i DH/MFKK deklaroi se do të punojë në bashkëpunim me stafin e secilit prej subjekteve për:

- Hartimin e planeve operationale të punës;
- Zbatimin e udhëzimit të miratuar të delegimit dhe përdorimit të linjave të raportimit;
- Ndërtimin dhe finalizimin e manualeve dhe hartës së proceseve të punës;
- Gjurmën e auditimit për proceset kryesore të punës;
- Regjistrin e riskut;
- Planin e veprimit për ngritjen e sistemeve të MFK;
- Mbështetjen e nëpunësit autorizues në monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në mënyrë të përmbledhur për këto 5 subjekte paraqitet si në vijim:

1. Ministria e Mbrojtjes është njoftuar përmes shkresës nr. 3234 Prot., datë 21.02.2022 për kryerjen e vlerësimin të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në MM, në datat 21-25 Shkurt 2022. Në Raportin e përgatitur nga DH/MFKK, citohet se sistemi i kontrollit të

brendshëm në MM vlerësohet efektiv me 54 pika të plotësuara nga lista e kontrollit. Projekt-Raporti është dërguar përmes shkresës nr. 3234/1 Prot., datë 25.01.2023, drejt Ministrisë së Mbrojtjes, e cila nuk ka paraqitur observacione dhe Projekt-Raporti ka marrë formën përfundimtare të Raportit.

2. Bashkia Lezhë është njoftuar me shkresën nr. 5229 Prot., datë 23.03.2022 për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në datat 28 Mars – 1 Prill 2022. Në Raportin e përgatitur nga DH/MFKK, citohet se vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Lezhë është realizuar përgjatë datave 1-3 Qershor 2022 (ndryshe nga lajmërimi përmes shkresës nr. 5229 Prot., datë 23.03.2022 të MFE) dhe subjekti ka rezultuar me sistem kontrolli të brendshëm joefektiv me 24 pika të plotësuara nga lista e kontrolleve. Projekt-Raporti është dërguar përmes shkresës nr. 5229/1 Prot., datë 26.08.2022 drejt Bashkisë Lezhë, e cila nuk ka paraqitur observacione dhe Projekt-Raporti ka marrë formën përfundimtare të Raportit.
3. Bashkia Belsh është njoftuar me shkresën nr. 5227 Prot., datë 23.03.2022 për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në datat 23-27 Maj 2022. Për ofrimin e asistencës teknike dhe për vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Belsh nuk ka një raportim.
4. Agjencia e Prokurimit Publik është njoftuar me shkresën nr. 5241 Prot., datë 23.03.2022 për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në datat 11-15 Prill 2022. Në Raportin e përgatitur nga DH/MFKK, citohet se nga vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, subjekti ka rezultuar me sistem kontrolli të brendshëm pjesërisht efektiv me 43 pika të plotësuara nga lista e kontrolleve. Raporti është dërguar përmes shkresës nr. 5241/3 Prot., datë 29.08.2022 drejt Agjencisë së Prokurimit Publik. Subjekti përmes shkresës nr. 3262/1 Prot., datë 28.04.2023, ka përcjellë drejt MFE informacion për dokumentacionin e miratuar në kuadër të sistemeve të kontrollit.
5. Prokuroria e Përgjithshme është njoftuar me shkresën nr. 5240 Prot., datë 23.03.2022 për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në datat 6-10 Qershor 2022. Në Raportin e përgatitur nga DH/MFKK, citohet se nga vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, subjekti ka rezultuar me sistem kontrolli të brendshëm pjesërisht efektiv me 30 pika të plotësuara nga lista e kontrolleve. Raporti është dërguar përmes shkresës nr. 2261 Prot., datë 03.02.2023 drejt Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga auditimi i dosjeve të mësipërme konstatohet se përgjithësisht ekziston diferencë kohore mes realizimit të kontrollit dhe daljes së Raportit Përfundimtar mbi cilësinë e sistemeve të KB, duke cënuar koherencën e gjetjeve dhe rekomandimeve lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe asistencës teknike në këtë institucion.

DH/MFKK ka kërkuar një raportim përmbledhës mbi ecurinë e zbatimit të instrumenteve të MFK nga këto subjekte (brenda datës 5 Maj 2023):

- Shkresa nr. 7182 Prot., datë 19.04.2023, drejtuar Bashkisë Lezhë;
- Shkresa nr. 7183 Prot., datë 19.04.2023, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme;
- Shkresa nr. 7184 Prot., datë 19.04.2023, drejtuar Bashkisë Belsh;
- Shkresa nr. 7185 Prot., datë 19.04.2023, drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik;
- Shkresa nr. 7186 Prot., datë 19.04.2023, drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes.

Nga këto subjekte, ka kthyer përgjigje Agjencia e Prokurimit Publik përmes shkresës nr. 3262/1 Prot., datë 28.04.2023, ku ka përcjellë drejt MFE listën e dokumentacionit:

1. Vendim nr. 07, datë 29.12.2022, “Për miratimin e gjurmëve të auditit”;
2. Urdhër nr. 26, datë 24.02.2023, “Për zbatimin e Planit të Veprimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”;
3. Harta e Proceseve të Punës;
4. Strategjia e Menaxhimit të Riskut të APP nr. 4158 Prot., datë 16.06.2022;

5. Plani i Punës me objektiva për vitin 2023 nr. 480 Prot., datë 16.01.2023;
6. Regjistri i Riskut dhe Plani i Veprimit për minimizimin e riskut;
7. Plani i Trajnimeve për vitin 2023.

Titulli i Gjetjes:	Problematika lidhur me afatet e dërgimit të raporteve të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm
Situata	Nga auditimi i dosjeve të subjekteve ku Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit ka realizuar vlerësimet e cilësisë për sistemin e kontrollit të brendshëm, konstatohet se përgjithësisht ekziston diferencë kohore mes realizimit të kontrollit dhe hartimit/dërgimit të Raportit Përfundimtar mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke cënuar koherencën e gjetjeve dhe rekomandimeve lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe asistencës teknike në këtë institucion.
Kriteri	Metodologjia për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në njësitë publike.
Ndikimi	Vonesat e tejzgjatura në kohë mes realizimit të kontrollit dhe daljes së Raportit Përfundimtar mbi cilësinë e sistemeve të KB cenojnë koherencën e gjetjeve dhe rekomandimeve lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe asistencës teknike në subjekt si dhe pamundësojnë përmirësimin e situatës brenda një kohe të arsyeshme nga ana e njësiteve publike në të cilat është kryer verifikimi.
Shkaku	Përgatitje/dërgim me vonesë e raportit mbi vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	Titullari i Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa për rishikimin e dokumentit të Metodologjisë së Vlerësimit me qëllim përshtatjen dhe përmirësimin e procedurave të vlerësimit, ndër të tjera duke përcaktuar afate të qarta dhe të arsyeshme të publikimit dhe dërgimit të raportit përfundimtar, me qëllim marrjen e masave në kohë të përshtatshme nga ana e njësiteve publike për përmirësimin e situatës.

Në Raportin Vjetor të DH/MFKK për vitin 2022, lidhur me ofrimin e asistencës teknike citohet se *“Realizimi i procesit të vlerësimit të cilësisë apo ofrimi i asistencës teknike, ka mundësuar rritjen e ndërgjegjësisë së menaxherëve dhe stafit për njohjen dhe zbatimin e instrumenteve të MFK. Rekomandimet e dhëna në raportet e vlerësimit kanë shërbyer si pikënisje për hartimin e planit të veprimit me qëllim evidentimin e masave për adresimin e mangësive të konstatuara dhe ndjekjen në vazhdimësi të tyre duke kontribuar në përmirësimin e mekanizmave të monitorimit të sistemit të kontrollit të brendshëm”* dhe *“Ofrimi i asistencës teknike dhe aktivitetet e ndërmarra kanë sjellë një përmirësim të sistemit të MFK-së në disa institucione publike duke rezultuar në një performancë më të mirë të tyre të karakterizuar nga operacione të përmirësuara të sistemit të ekzekutimit të planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit, dhe forcimin e mekanizmave për garantimin e përgjegjshmërisë menaxheriale.”*

Megjithatë, siç është evidentuar më sipër, nga ana e NJQP të përfshira në ofrimin e asistencës teknike nuk ka patur një reagim lidhur me ecurinë e zbatimit të instrumenteve të MFK dhe për më tepër nga vetë DH/MFKK nuk ka një dokument vërtetues për vlerësim të detajuar të këtij programi, përveç listëprezencave të trajnimeve të zhvilluara në këto NJQP, në mënyrë që të konkludohej në një përmirësim të sistemit të MFK si rezultat i këtij programi.

Referuar manualit të MFK, Kapitulli II “Rolet dhe Aktorët në Sistemin e MFK-së”, pika 2.2.2 citon objektivat e realizimit të monitorimit/Vlerësimit të cilësisë, ku një ndër objektivat e realizimit të këtij procesi është përgatitja e raportit vjetor për NPA dhe Ministrinë e Financave mbi statusin e përgjithshëm të MFK-së. Nga auditimi është konstatuar se disa prej

vlerësimeve të cilësisë të realizuara në 6 mujorin e parë të vitit 2022 kanë analizuar sistemet e MFK për vitin 2021, ndaj paraqitja e tyre duke u bërë pjesë e Raportit Vjetor 2022 të DH/MFKK i cili i dorëzohet NPA, nuk paraqet në mënyrë të drejtë situatën për vitin 2022, pasi përfshihen në të edhe vlerësimet e cilësisë për periudhën që i takon vitit 2021.

Titulli i Gjetjes:	Problematika lidhur me vlerësimet/monitorimet e reflektuara në Raportin për vitin 2022
Situata	Nga auditimi u konstatua se disa prej vlerësimeve të cilësisë të realizuara në 6 mujorin e parë të vitit 2022 nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit kanë analizuar sistemet e MFK për vitin 2021, ndaj paraqitja e tyre duke u bërë pjesë e Raportit Vjetor 2022 të DH/MFKK i cili i dorëzohet NPA, nuk paraqet në mënyrë të drejtë situatën për vitin 2022. Referuar manualit të MFK, Kapitulli II “Rolet dhe Aktorët në Sistemin e MFK-së”, pika 2.2.2 citon objektivat e realizimit të monitorimit/Vlerësimit të cilësisë, ku një ndër objektivat e realizimit të këtij procesi është përgatitja e raportit vjetor për NPA dhe Ministrinë e Financave mbi statusin e përgjithshëm të MFK-së.
Kriteri	- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, neni 25; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, neni 26, pika 2; - Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Kapitulli II “Rolet dhe Aktorët në Sistemin e MFK-së”, pika 2.2.2
Ndikimi	Paraqitja e vlerësimeve të realizuara që mbulojnë vitin 2021 nuk paraqesin situatën/gjendjen e sistemit për vitin 2022.
Shkaku	Përfshirje në Raportin Vjetor 2022 të vlerësimeve/monitorimeve për vitin 2021
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Titullari i Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit të marrë masa për përfshirjen në Raportin Vjetor të vlerësimeve/monitorimeve që reflektojnë gjendjen e sistemit për vitin përkatës për të cilën hartohet Raporti Vjetor.

Trajnimet

Pika “c” e nenit 26 të Ligjit nr.10926, datë 08.07.2010 i ndryshuar parashikon rolin e Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe më konkretisht një ndër rolet është *“Përcaktimi i nevojave dhe udhëheqjen e trajnimeve në vijueshmëri në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik”*. Në Planin Vjetor të DH/MFKK janë parashikuar të kryhen trajnime gjatë gjithë vitit në 18 bashki në kuadër të projektit “Financat Lokale”, trajnime specifike në varësi të kërkesave të institucioneve për asistencë lidhur me implementimin e sistemit të MFK (gjatë gjithë vitit), si dhe rritja e kapaciteteve të punonjësve të njësive publike mbi zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe kontabilitetin në sektorin publik në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), gjatë gjithë vitit. Përsa i përket realizimit të trajnimeve, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar 19 të tilla me 1083 pjesëmarrës nga tri trajnerë. Listat e punonjësve të trajnuar administrohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ndaj është e pamundur të bëhet dallimi se punonjësit e cilit institucion kanë marrë pjesë në këto trajnime.

Regjistri i NA dhe NZ

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 26, pika 1, germa dh citon se *“Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Ministrinë e Financave është përgjegjëse për krijimin dhe përditësimin e regjistrit të nëpunësve autorizues dhe nëpunësve zbatues të njësive publike”*. Nga shqyrtimi i Regjistrave të NA dhe NZ (në format Excel) u konstatuan dublikime të personave të autorizuar si NA apo NZ, mungesa të

çaktimit të NA apo NZ apo mangësi informacioni. Grupi i auditimit thekson se konstatimi është kryer për periudhën objekt auditimi 01.01.2022 – 31.12.2022, periudhë në të cilën DH/MFKK ka administruar regjistrat përkatës të NA dhe NZ referuar të dhënave nga degët e thesarit. Ndërkohë, me ndryshimet ligjore, përkatësisht me miratimin e Ligjit nr. 14, datë 16.02.2023 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, DH/MFKK nuk do të angazhohet në mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të NA dhe NZ.

Vlerësimi i indikatorëve të sistemit të MFK

Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPH/KBFP) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit ka realizuar analizimin e 18 (tetëmbëdhjetë) treguesve të performancës, referuar Metodologjisë për Monitorimin e Performancës së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike, miratuar me Urdhrin e MFE nr. 117, datë 01.04.2019 “Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njërive publike” i ndryshuar.

Indikatorët e vlerësimit Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit janë 3 nga 18 vlerësuar nga DH/MFKK si në vijim:

Indikatori 12 – *Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara;*

Indikatori 13 – *Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm;*

Indikatori 14 – *Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik.*

Lidhur me indikatorin 12, i cili përcakton respektimin e afatit kohor dhe cilësinë e përmbajtjes së Planit të Veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së në NJQP, DH/MFKK e ka vlerësuar këtë tregues me 2.57 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 64%), duke paraqitur një nivel të përmirësuar krahasimisht me vlerësimin e vitit 2021 i cili paraqitej në nivelin 1.9 pikë. Sipas DH/MFKK përmirësimi ka ardhur si rezultat i procesit të vlerësimit të cilësisë apo ofrimi i asistencës teknike, çka ka mundësuar rritjen e ndërgjegjësimit të menaxherëve dhe stafit për njohjen dhe zbatimin e instrumenteve të MFK. Nga DH/MFKK për vitin 2022 është evidentuar se një pjesë e institucioneve nuk kanë hartuar një plan veprimi për vitin 2023, nuk kanë respektuar formatin e rishikuar dhe miratuar në manualin e MFK si dhe kanë ende në përdorim planin e veprimit për vitin 2022, gjë e cila ka ndikuar edhe vlerësimin me pikë për secilin institucion.

Indikatori 13, i cili përcakton përmbushjen e kritereve ligjore, cilësinë e raportit vjetor dhe deklaratës së cilësisë si dhe gjithëpërfshirjen e informacionit mbi statusin e implementimit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike (nëpërmjet pyetësorëve të vetëvlerësimit) është vlerësuar mesatarisht në nivelin 3.06 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 76%), me një rritje të lehtë nga vlerësimi i vitit 2021 ku paraqitej në nivelin 3.0 pikë. DH/MFKK ka evidentuar një performancë mesatarisht të kënaqshme në këtë fushë kryesisht për ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura, ndërkohë vlerësimi për njësitë e vetëqeverisjes vendore vijon të jetë më i ulët se për grupet e tjera të marra në analizë, specifikisht 3.8 pikë. DH/MFKK ka konkluduar se pjesa më e madhe e institucioneve kanë respektuar afatin kohor të dërgimit të raportit vjetor dhe deklaratës së cilësisë si dhe i kanë paraqitur ato në formatin e duhur. Ndërkohë, ende ka njësi (kryesisht njësi të vetëqeverisjes vendore), të cilat nuk kanë depozituar pyetësorët në formatin e duhur apo përmbajtja dhe cilësia e informacionit të përfshirë nuk ishte në nivelin e dëshiruar për të realizuar një analizë të thelluar të gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, janë evidentuar institucione të cilat nuk kanë

zbatuar kërkesat ligjore në fuqi duke mos depozituar pranë MFE-së, deklaratën dhe raportin për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm apo pyetësozin e duhur të vetëvlerësimit.

Indikatori 14, i cili vlerëson se në çfarë mase dhe sa shpesh njësitë publike përmbushin kriteret themelore të përgjegjshmërisë menaxheriale është vlerësuar nga DH/MFKK në nivelin 2.91 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 73%), duke reflektuar një performancë të mirë në këtë fushë, të ngjashme me atë të dy viteve paraardhëse. Megjithatë, nga krahasimi më të dhënat e vitit të kaluar grupi i auditimit evidenton se për vitin 2021, ky tregues ka qenë në nivelin 2.95 pikë nga 4 të plota, duke paraqitur një rënie të lehtë për vitin 2022.

Referuar përgjigjeve të dhëna dhe situatës së prezantuar në pyetësozët e vetëvlerësimit, nga analizat e kryera nga DH/MFKK, fokusi i raportimeve mbetet në dhënien e informacionit mbi performancën financiare, siç janë raportet për monitorimin e buxhetit apo raportet për detyrimet financiare dhe më pak mbi përgatitjen e raporteve periodike mbi ecurinë dhe statusin e implementimit të objektivave të vendosura apo edhe çështjeve që lidhen me sistemet e kontrollit të brendshëm. Nga DH/MFKK evidentohet se pavarësisht mbështetjes së ofruar nga MFE nëpërmjet kuadrit rregullator apo asistencës teknike si dhe rekomandimeve të dhëna gjatë kryerjes së vlerësimeve të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm të pakta janë ato institucione që kanë kthyer në praktikë pune procesin e delegimit duke rritur efektivitetin e realizimit të veprimtarisë së tyre. Mangësitë e evidentuara për zbatimin e këtij instrumenti lidhen kryesisht me mungesën e ndërgjegjësimit për të kuptuar rëndësinë e tij si dhe përcaktimin e qartë të termave, rregullave dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e delegimit të detyrave brenda njësisë publike.

Tabela nr. 5: Vlerësimi i indikatorëve të performancës nga DH/MFKK

Indikatori	Viti 2021	Viti 2022	Ndryshimi vjetor
Indikatori 13	1.9	2.57	+ 0.67
Indikatori 14	3.0	3.06	+ 0.06
Indikatori 15	2.95	2.91	- 0.04

Burimi: Të dhënat nga DH/MFKK, në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Përgatitja e Raportit Vjetor 2022

Neni 17 i Rregullores së Brendshme miratuar me Urdhrin nr. 52, datë 10.03.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, në pikën 4 citon se “*DH/MFKKK ka për detyrë hartimin e Raportit vjetor mbi zhvillimet e sistemit të kontrollit të brendshëm në institucionet publike*”. Ndërkohë, neni 18 i Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, në pikën 1 citon se “*1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual...”, dhe “2. Nëpunësi i parë autorizues përgatit dhe depoziton te Ministri i Financave raportin vjetor të konsoliduar jo më vonë se fundi i muajit maj, duke u mbështetur në raportet, sipas pikës 1 të këtij neni, për kontrollin e brendshëm të sektorit publik. Ky raport është përmbledhje e raporteve vjetore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e auditimit e brendshëm në sektorin publik”.*

Për më tepër, Urdhri nr. 117, datë 01.04.2019 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike”, i ndryshuar, në pikën 4, germa a, citon se “*DH/MFKKK ... monitoron në nivel vjetor cilësinë e sistemeve të MFK për njësitë publike. Ky monitorim*

kryhet nëpërmjet analizës së përgjigjeve të pyetësorëve vjetorë të vetëvlerësimit të sistemeve ...”.

Me qëllim hartimin e Raportit Vjetor 2022, DH/MFKK ka dërguar drejt njësive publike të qeverisjes së përgjithshme pyetësorët e vetëvlerësimit (dërguar në 152 NJQP dhe vetëm 146 kanë kthyer përgjigje lidhur me këta pyetësorë). Këta pyetësorë duhet të dorëzohen deri në datën 28.02.2023 pasi shërbejnë si burim informacioni për përgatitjen e Raportit Vjetor 2022. Disa prej njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk kanë raportuar në mënyrën e duhur duke pasur mangësi në dokumentacionin e dërguar apo vonesa në depozitimin e informacionit të kërkuar². Nga ana e DH/MFKK janë dërguar shkresa ri kujtesë drejt këtyre subjekteve me qëllim dorëzimin e informacionit të kërkuar. Ndërkohë, nga dokumentacioni i dorëzuar evidentohet se nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues nuk janë ndërmarrë masa sa i takon subjekteve që nuk kanë dorëzuar deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm referuar nenit 29, pika 1 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar. Për më tepër, përmes ndryshimeve ligjore, përkatësisht miratimit të Ligjit nr. 14, datë 16.02.2023, janë forcuar masat lidhur me subjektet që nuk respektojnë përcaktimet për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Titulli i Gjetjes:	Mosmarrje e masave për vendosjen e sanksioneve për subjektet mbi dorëzimin e dokumentacioneve lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollit
Situata	Nga auditimi u konstatua se DH/MFKK ka dërguar drejt njësive publike të qeverisjes së përgjithshme pyetësorët e vetëvlerësimit (dërguar në 152 NJQP dhe vetëm 146 kanë kthyer përgjigje lidhur me këta pyetësorë). Këta pyetësorë duhet të dorëzohen deri në datën 28.02.2023 pasi shërbejnë si burim informacioni për përgatitjen e Raportit Vjetor 2022. Disa prej njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk kanë raportuar në mënyrën e duhur duke pasur mangësi në dokumentacionin e dërguar apo vonesa në depozitimin e informacionit të kërkuar. Nga ana e DH/MFKK janë dërguar shkresa rikujtese drejt këtyre subjekteve me qëllim dorëzimin e informacionit të kërkuar. Ndërkohë, nga dokumentacioni i dorëzuar, evidentohet se nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues nuk janë ndërmarrë masa (sanksione/gjobitje) sa i takon subjekteve që nuk kanë dorëzuar deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, referuar nenit 29, pika 1 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar.
Kriteri	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, neni 29, pika 1.
Ndikimi	Mosaplikimi i masës sanksion/gjobë sipas legjislacionit përkatës.
Shkaku	Mospërmbushje e detyrimit të përcaktuar në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, neni 29, pika 1.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e Nëpunësit të Parë Autorizues, të marrë masa për përmbushjen e detyrimit ligjor mbi vendosjen e sanksioneve të parashikuara në ligj për subjektet të cilat nuk kanë depozituar dokumentacionin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë së tyre.

DH/MFKK ka përpunuar të dhënat e grumbulluara nga pyetësorët e dorëzuar në zbatim të Urdhrit nr. 117, datë 01.04.2019 “Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e

² Bashkia Konispol, Bashkia Rrogzohinë, Bashkia Finiq, Bashkia Memaliaj, Bashkia Kavajë, Bashkia Vorë, Bashkia Delvinë, Bashkia Himarë, Qarku Lezhë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretariati i Këshillit Ekonomik Kombëtar; si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike” i ndryshuar, të Ministrisë të MFE, i cili në pikën 4 citon se “Ngarkohet struktura përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik, për përpunimin e informacionit të konsoliduar dhe paraqitur sipas kërkesave të metodologjisë bashkëlidhur si dhe hartimin e raportit përfundimtar brenda muajit Maj të çdo viti”. Nga të dhënat e dorëzuara tek grupi i auditimit, MFE ka dërguar Raportin Vjetor 2022 të KBFP pranë KLSH përmes shkresës nr. 9861/2 Prot., datë 30.05.2023, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 549 Prot., datë 13.06.2023.

Në pikëpamjen strukturore Raporti Vjetor i vitit 2022 përbëhet nga: Përmbledhja Ekzekutive, 5 kapituj, 1 aneks dhe 1 shtojcë.

Vlerësimi i treguesve të performancës

Në Raportin Vjetor 2022, përkatësisht në Kapitullin I “Vlerësimi i performancës së Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPH/KBFP) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit kanë kryer analiza për gjenerimin e të dhënave për 18 tregues performance mbi planifikimin, zbatimin dhe ekzekutimin e buxhetit si dhe treguesit për implementimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, specifikuar si në tabelën nr. 6.

Tabela nr. 6: Treguesit e Performancës dhe burimet e të dhënave sipas Drejtorive në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	Drejtoria e Harmonizimit të MFKK	Drejtoria e Harmonizimit të AB
1.Realizimi i shpenzimeve buxhetore (në %)	1.Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit	1.Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara	1.Organizimi i NJAB-ve dhe kapacitetet e AB
2.Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik (në %)	2.Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme	2.Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm	2.Cilësia e përgatitjes së planifikimit strategjik dhe vjetor nga NJAB-të
3.Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura	3.Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit	3.Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik	3.Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor të NJAB-ve
4.Realizimi i shpenzimeve kapitale	4.Numri i urdhër prokurimeve të paautorizuara		4.Zbatimi i rekomandimeve të AB-së
5.Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit	5.Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës		
	6.Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi		

Burimi: Raporti Vjetor 2022 i KBFP

Nga shqyrtimi i Raportit Vjetor 2022, konstatohet se janë vlerësuar treguesit e performancës për NJQP dhe për njësitë shpenzuese me buxhet të madh (përkatësisht në Kapitullin I dhe në Aneksin I e Raportit Vjetor 2022) si specifikohet në tabelën nr. 7.

Tabela nr. 7: Vlerësimi i treguesve të performancës për NJQP dhe njësitë shpenzuese me buxhet të madh, 2022

Nr.	Treguesi	Për NJQP		Për njësi me buxhet të madh	
		Pikë	Në %	Pikë	Në %
1	Realizimi i shpenzimeve buxhetore	2.19	55%	3.00	75%
2	Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik	1.70	43%	2.60	65%
3	Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura	3.23	81%	4.00	100%
4	Realizimi i shpenzimeve kapitale	1.39	35%	2.70	68%
5	Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit	3.35	84%	3.15	79%
6	Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit	2.24	56%	2.10	53%
7	Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria ekonomike 486)	1.70	43%	N/A	N/A
8	Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit	1.57	39%	1.45	36%
9	Numri i urdhër-prokurimeve të paautorizuara	3.90	98%	4.00	100%
10	Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës	4.00	100%	4.00	100%
11	Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi	3.81	95%	3.84	96%
12	Hartimi me cilësi i Planit të Veprimt të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara	2.57	64%	3.20	80%
13	Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm	3.06	77%	3.00	75%
14	Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik	2.91	73%	3.30	83%

Shënim: N/A – e pamundur të llogaritet për shkak të mungesës së të dhënave nga NJQP

Burimi: Të dhënat nga DH/MFKK në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Nga analiza e këtyre treguesve, DH/MFKK ka konkluduar në gjetjet kryesore për secilin nga treguesit:

- *Realizimi i shpenzimeve buxhetore*: vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.19 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 55%). Krahasuar me periudhat paraardhëse, evidentohet një paqëndrueshmëri në performancën e këtij treguesi, e cila thekson nevojën për krijimin e kushteve të favorshme për rritjen e eficiencës dhe efektivitetit lidhur me përdorimin e buxhetit dhe realizimin e shpenzimeve të planifikuara për mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit. Ndikimin kryesor në vlerësimin e performancës për këtë tregues e paraqesin njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku edhe për këtë vit vlerësohet më pak se ministritë e linjës apo institucionet e pavarura.

- *Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik*: rezultati është 1.7 pikë ose 42%, me një ulje të lehtë në krahasim me vitin e kaluar. Edhe për këtë tregues, njësitë e vetëqeverisjes vendore paraqiten me vlerësimin më të ulët me 0.67 pikë (16.7 %), ku kryesisht evidentohet se llogaritë me treguesin më të ulët janë ato të investimeve dhe subvencioneve, i cili lidhet me afatet kohore që në shumë raste tejkalohen duke vështirësuar realizimin në kohë të këtyre shpenzimeve.

- *Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura*: vlerësuar mesatarisht 3.23 pikë (81%). Në nivel të përgjithshëm stoku 12 mujor i detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 është ulur me 7.2% krahasuar me stokun e detyrimeve të vitit paraardhës 2021. Duke nisur nga

muaji Dhjetor 2020, ky monitorim dhe raportimi, i cili më parë kryhej mbi bazë tre-mujore nëpërmjet raportimit shkresor të institucioneve, gjenerohet automatikisht nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 “Për Monitorimin dhe Publikimin Periodik të Stokut të Detyrimeve të Prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme”.

- *Realizimi i shpenzimeve kapitale*: vlerësuar mesatarisht me 1.39 pikë (35%). Edhe për këtë vit, nga të gjitha grupet e NJQP-ve të marra në analizë, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë devijimin më të lartë, në krahasim me ministrinë e linjës dhe institucionet e pavarura. Për ato njësi, të cilat paraqesin një performancë shumë të ulët të realizimit të këtij treguesi, evidentohet se shkaqet kryesore janë të lidhura kryesisht me problematikat dhe vonesat që ndodhin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit. Nga analiza e kryer, rezulton se, për disa institucione vijon të mbetet praktikë mosplanifikimi i investimeve edhe përgjatë vitit 2022.

- *Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit*: Për shkak të mungesës së të dhënave për vlerësim nga struktura përkatëse në MFE, njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashki dhe këshill qarku), nuk përfshihen në analizë për këtë tregues. Për periudhën analizuese, për ministrinë e linjës dhe institucionet e pavarura, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 3.35 pikë (ose 84%). Problematikat e këtij treguesi vijnë kryesisht nga rishikimi i buxhetit, i cili kryhet duke i kaluar fondet nga projektet me ecuri më të ulët në ato me ecuri më të lartë, ku ecuria e ulët mund të jetë rezultat edhe i planifikimit të gabuar dhe nuk janë mbajtur parasysh faktorët që mund të pengojnë ecurinë e projektit gjatë vitit.

- *Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit*: vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.24 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 54%). Struktura përgjegjëse për gjenerimin dhe analizimin e të dhënave për këtë tregues, evidenton se arsyet e mosdërgimit në kohë të faturave në thesar vijnë për shkak se furnitorët nuk paraqesin faturat në kohë në institucion, dokumentacioni mbështetës i dërguar nuk është i plotë ose i saktë si dhe ndodh që shpesh të ketë vonesa në lidhje me dërgimin e të dhënave bankare të furnitorit. Gjithashtu, një faktor tjetër prezent për rezultatin e vlerësimit të këtij treguesi është paqëndrueshmëria e strukturave dhe mosfunksionimi i institucioneve dhe stafit përkatës me kapacitet të plotë.

- *Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria ekonomike 486)*: vlerësuar me 1.7 pikë (ose 42%). Referuar vlerësimit për këtë vit, rezulton se 42% e faturave të detyrimeve të prapambetura nuk janë kontabilizuar brenda afatit kohor prej 30 ditësh në SIFQ. Kryesisht, kjo problematikë vjen për shkak të mungesës së fondeve buxhetore nga ana e institucioneve, të cilat ndërmarrin angazhime përtej kapaciteteve të tyre ose për shkak të mosplanifikimit të duhur mujor të arkës. Ajo që duhet të mbahet në konsideratë, është fakti se, gjatë vlerësimit të këtij treguesi, ka pasur mungesë të dhënash për pjesën më të madhe të institucioneve, kryesisht institucionet e nivelit qendror, për të cilat struktura përgjegjëse për thesarin është shprehur se nuk mund të japë një vlerësim për ekzistencën apo jo të faturave të detyrimeve të prapambetura, për aq kohë sa ato nuk janë paraqitur për regjistrim në degët përkatëse të thesarit nga ana e institucioneve.

- *Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit*: vlerësuar mesatarisht në nivelin 1.57 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 39%). Arsyet për mosrealizimin e këtij treguesi vijnë kryesisht si pasojë e mungesës së disponibilitetit të personave, të cilët nënshkruajnë kontratën, duke shkaktuar vonesa në dërgimin e tyre. Gjithashtu, ashtu siç është kontestuar edhe nga institucionet e marra në analizë, afati ditor prej 3 ditësh për dërgimin e kontratave në thesar është praktikisht i pamundur për t’u zbatuar, kryesisht nga ato institucione të cilat nënshkruajnë dhe menaxhojnë një numër të konsiderueshëm kontratash.

- *Numri i urdhër-prokurimeve të paautorizuara*: vlerësuar me 3.9 pikë (ose 97%). Pavarësisht detyrimit ligjor për kryerjen e një procesi të saktë të prokurimit publik, ende paraqitet një numër i vogël institucionesh të cilat devijojnë nga këto rregulla për shkak të mungesës ose mospërputhjes së dokumentacionit mbështetës të urdhër prokurimeve.
- *Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës*: vlerësuar në nivelin maksimal 4 pikë (ose 100%). Evidentohet nevoja e parashikimit mujor të fluksit të mjeteve monetare nga institucionet si dhe raportimin në intervale kohore të shpeshta pranë strukturave përgjegjëse në MFE.
- *Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi*: vlerësuar në nivelin 3.81 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 95%). Në zbatim të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP”, pika 117 dhe 118, të cilat përcaktojnë paraqitjen e pasqyrave financiare dhe afatet kohore ligjore për dorëzimin e pasqyrave financiare, institucionet depozitojnë pasqyrat financiare pranë degëve përkatëse të thesarit.
- *Hartimi me cilësi i planit të veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara*: vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.57 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 64%). Pavarësisht performancës në rritje të këtij treguesi, referuar edhe situatës së prezantuar në pyetësorët e vetëvlerësimit, evidentohen mangësi në zbatimin e tij kryesisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat vihet re një mungesë e ndërmarrjes së masave për sigurimin e realizimit të procesit të monitorimit në institucion dhe zbatimit të masave konkrete për adresimin e problematikave.
- *Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm*: vlerësuar mesatarisht në nivelin 3.06 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 76%). Ndërkohë, vlerësimi për njësitë e vetëqeverisjes vendore vijon të jetë më i ulët se për grupet e tjera të marra në analizë, specifikisht 2.75 pikë. Ende ka njësi (kryesisht njësi të vetëqeverisjes vendore), të cilat nuk kanë depozituar pyetësorët në formatin e duhur apo përmbajtja dhe cilësia e informacionit të përfshirë nuk ishte në nivelin e dëshiruar për të realizuar një analizë të thelluar të gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm, apo institucione të cilat nuk kanë zbatuar kërkesat ligjore në fuqi duke mos depozituar pranë MFE-së, deklaratën dhe raportin për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- *Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik*: i vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.91 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 73%). Ende vazhdon të mbetet problematikë mungesa e raportimeve të rregullta periodike si dhe ndërmarrja e masave konkrete për adresimin e çështjeve në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm, gjë e cila evidenton nevojën për hartimin e një sistemi procedurash lidhur me krijimin, zbatimin dhe raportimin standard periodik pranë menaxherëve apo strukturave të tjera të institucionit.

Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në pikën 3.5 “Monitorimi dhe Raportimi” citon se “*Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të KBFP prodhon një raport të konsoliduar vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm financiar publik. ... Raporti duhet të përmbajë vlerësimin e përgjithshëm të sistemit të MFK-së në sektorin publik, së bashku me informacionin mbi rezultatet dhe veprimet e rëndësishme që duhet të ndërmerren me qëllim të forcimit të sistemit të MFK-së. ... Njëkohësisht, Raporti Vjetor i Konsoliduar përmban një Raport të Performancës të DPH/KBFP për periudhën raportuese. Qëllimi i tij është që të njohë Qeverinë e Republikës së Shqipërisë me aktivitetet e kryera gjatë periudhës raportuese në zhvillimin e sistemit të KBFP-së, gjendjen aktuale dhe drejtimit e ardhshme që do të merren në zhvillimin e sistemit të KBFP.*”

Në Raportin Vjetor 2022, DH/MFKK citon se “Bazuar në vlerësimet e treguesve të mësipërm nga drejtoritë përkatëse, është realizuar rankimi i ministrive të linjës, bashkive, institucioneve të pavarura dhe njërive shpenzuese me buxhet të madh për vitin 2022, ku vlen të theksohet se, niveli i vlerësimit maksimal në pikë për pjesën më të madhe të institucioneve ka pësuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin e kaluar.” Nga shqyrtimi dhe analizimi i këtyre treguesve, grupi i auditimit konstaton se për pjesën më të madhe të NJQP, në rreth 80% të NJQP vlerësimi me pikë ka patur tendencë rritje ose ka qëndruar njësoj si në vitin 2021, ndërsa për pjesën tjetër rreth 20%, vlerësimi në pikë ka pësuar rënie. Krahasimisht me vitin 2021, ku mesatarja e vlerësimit në total për NJQP paraqitej në 39.1 pikë, për vitin 2022 paraqitet në 42.7 pikë.

Sipas analizës së grupit të auditimit, nga 152 NJQP të paraqitura në vlerësim ku 9 prej tyre nuk kanë ndryshim me vlerësimin e vitit 2021, 30 NJQP kanë vlerësim në rënie krahasimisht me vitin 2021, detajuar në tabelën nr. 8.

Tabela nr. 8: Analiza e vlerësimit të NJQP për vitin 2022

	Rritje në vlerësim nga viti 2021	Njësoj në vlerësim si viti 2021	Rënie në vlerësim nga viti 2021	Total
Nr. i NJQP	113	9	30	152
NJQP (në %)	74.34%	5.92%	19.73%	100%
NJQP më përfaqësuese	<ol style="list-style-type: none"> 1. Agjencia e Trajtimit të Pronave 2. Bashkia Vlorë 3. Bashkia Devoll 4. Kryeministria 5. Komisioni i Prokurimit Publik 6. Agjencia për Mbështetje për Shoqërinë Civile 7. Komiteti Shtetëror i Kulteve 8. Agjencia e Zhvillimit të Territorit 9. Avokatura e Shtetit 10. Agjencia për Hapje, Dialog dhe Bashkëqeverisje 11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar 12. Inspektoriati Qendror 13. Komiteti për Pakicat Kombëtare 14. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore 15. Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ministria e Mbrojtjes 2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit 3. Bashkia Elbasan 4. Bashkia Finiq 5. Bashkia Pogradec 6. Bashkia Roskovec 7. Bashkia Kurbin 8. Qarku Vlorë 9. Departamenti i Administratës Publike 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë 2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit 3. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme 4. Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve 5. Bashkia Bulqizë 6. Bashkia Tropojë 7. Bashkia Pukë 8. Qarku Fier 9. Shërbimi Informativ Shtetëror 10. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 11. Autoriteti i Konkurrencës 12. Kolegji i Posaçëm i Apelimit 13. Akademia e Shkencës 14. Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit 15. Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet ish-sigurimit 16. Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike 	

		të Integruara	
--	--	---------------	--

Burimi: Të dhënat nga Raporti Vjetor 2022 i KBFP. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Detajuar në tabelën nr. 8 paraqiten dhe NJQP më përfaqësuese për të tri grupet (rënie/rritje/mosndryshim nga vlerësimi i vitit 2021). Ndërkohë në tabelën nr. 9, paraqitet në mënyrë të detajuar vlerësimi për 16 NJQP më përfaqësuese që kanë treguar rënie.

Tabela nr. 9: Detajimi për 16 NJQP më përfaqësuese që kanë pësuar rënie në vlerësim

Rankimi për vitin 2022	Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2021(+/-)	Institucioni	Vlerësimi 2021	Vlerësimi 2022	Diferenca 2022-2021
22	-18	Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet ish-sigurimit	53	32	-21
7	-5	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	62	48.5	-13.5
21	-10	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunitetit	46	33	-13
14	-11	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara	49	37	-12
19	-12	Akademia e Shkencës	50	39	-11
15	-11	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	53	43	-10
11	-9	Shërbimi Informativ Shtetëror	58	50	-8
10	-1	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	45	37.5	-7.5
27	-20	Bashkia Tropojë	37	31	-6
3	-2	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	64	59	-5
11	-6	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve	48	43	-5
24	-20	Bashkia Bulqizë	40	35	-5
31	-19	Bashkia Pukë	32	27	-5
8	-6	Qarku Fier	32	27	-5
18	-6	Autoriteti i Konkurrencës	45	40	-5
18	-6	Kolegji i Posaçëm i Apelimit	45	40	-5

Burimi: Të dhënat nga Raporti Vjetor 2022 dhe 2021 i KBFP. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Sipas tabelës nr. 9, konstatohet se në 16 NJQP më përfaqësuese që kanë pësuar ulje në vlerësim për vitin 2022, rënia e tyre varion nga 21 deri në 5 pikë, ku kryeson Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet ish-sigurimit. Në këtë listë, paraqiten me rënie të konsiderueshme edhe Ministri Linje, përkatësisht: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. MFE rezultoi me rënie në vlerësim në performancën e saj, ndërkohë që është institucioni përgjegjës dhe mbikëqyrës për procesin e vlerësimit të NJQP.

Zhvillimi i kontabilitetit publik dhe ndjekja e procesit të zbatimit të strategjisë së qeverisë për implementimin e standardeve të kontabilitetit publik

Sa i përket përmirësimeve ligjore, është realizuar përmirësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Auditimin e Brendshëm, duke rezultuar në Ligjin nr. 12, datë 02.02.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.114/2015, Për Auditimin e Brendshëm”.

Ndërkohë, sa i përket tentativave për përmirësime ligjore mbi VKM të cilat lidhen me aspekte financiare, DH/MFKK ka njoftuar përmes email të datës 05.07.2023 se “*Ju bejme me dije se Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DH/MFKK) nuk ka ndërmarre iniciativë për parafrimë legjislativë për VKM të largëta në kohë apo akte të tjera duke qenë se nuk është në funksionet e kësaj drejtorie angazhimi për hartimin dhe përparimin e akteve të këtij lloji*”.

Për vitin 2022, DH/MFKK ka përcaktuar disa objektiva në drejtimet, referuar edhe objektivave të parashikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022 për fushën e menaxhimit financiar dhe fushën e kontabilitetit publik si dhe Dokumentin e Politikave për Zhvillimin e mëtejshëm të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik 2021-2022:

1. Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e kontrollit të brendshëm nëpërmjet rishikimit të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
2. Vijimi i progresit në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme;
3. Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në 20 njësi të qeverisjes së përgjithshme;
4. Zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ndërtimi i instrumentave të menaxhimit financiar dhe kontrollit nëpërmjet ofrimit të asistencës teknike në 5 institucione të përzgjedhura (Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Lezhë, Bashkia Belsh, Agjencia e Prokurimit Publik, Prokuroria e Përgjithshme);
5. Rritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të administratës publike dhe nivelit drejtues të njësive publike mbi rolin dhe rëndësinë e zbatimit të sistemit të MFK-së;
6. Rishikimi i kuadrit rregullator ekzistues i kontabilitetit të sektorit publik (Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”);
7. Hartimi i kuadrit rregullator të fushës së kontabilitetit të sektorit publik, në përputhje me standardet IPSAS, nëpërmjet projektit “Zhvillimi i kontabilitetit të sektorit publik në Shqipëri (IPSAS)”;
8. Ngritja e kapaciteteve të kontabilistëve dhe financierëve të sektorit publik në lidhje me fushën e kontabilitetit të sektorit publik;
9. Përkthimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik;
10. Pilotimi i kuadrit rregullator të fushës së kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me IPSAS në shtatë institucione pilot.

Përgjatë vitit 2022, konstatohet se nga ana e DH/MFKK në kuadër të zhvillimeve për kontabilitetin në sektorin publik janë kryer:

- *Përafrime ligjore në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar*

Gjatë vitit 2021 dhe fillim të vitit 2022, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DH/MFKK), në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, referuar edhe rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka realizuar disa ndryshime të udhëzimit numër. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nëpërmjet miratimit të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Është përmbushur miratimi final i VKM mbi zgjatjen e afatit të projektit “Zhvillimi i kontabilitetit të sektorit publik (IPSAS)” dhe zhvillimi i aktiviteteve të parashikuara në kuadër të projektit. Në kuadër të realizimit më të mirë të produkteve të projektit, nga ana e BB u vlerësua shtyrja me 12 muaj të tjerë, pra deri në dhjetor të vitit 2022.

Nga DH/MFKK janë hartuar draftet e kuadrit të ri rregullator bazuar në kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (IPSAS), të cilat kanë përfunduar brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2022. Konkretisht, është hartuar nga ana e konsulentit ndërkombëtar dhe diskutuar me MFE udhëzimi në lidhje me inventarët, provigjionet, aktivet afatgjata materiale, aktivet afatgjata jomateriale, mbi shpenzimet, mbi përfitimet sociale dhe përfitimet e punonjësve, instrumentat financiarë, konsolidimi i pasqyrave financiare si dhe të ardhurat. Gjithashtu, ka përfunduar dokumenti për rishikimin e proceseve të punës për kontabilitetin dhe raportimin financiar si dhe është realizuar vlerësimi mbi funksionalitetin e sistemit të thesarit AGFIS.

- *Ngritja e kapaciteteve të kontabilistëve publikë*

Një nga aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2022 është rritja e kapaciteteve për kontabilistët dhe financierët në njësitë e qeverisjes së përgjithshme në Republikën e Shqipërisë mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik bazuar në standardet IPSAS, nëpërmjet organizimit të trajnimeve në mënyrë intensive për stafin e angazhuar në fushën e kontabilitetit, proces i cili nisi në vitin 2021 dhe vazhdoi gjatë vitit 2022. Gjatë muajit shkurt – mars 2022 është realizuar faza e dytë e pilotimit të trajnimit mbi kontabilitetin në sektorin publik dhe raportimit financiar bazuar në IPSAS për 25 pjesëmarrës të tjerë, gjatë fundit të muajit prill është realizuar faza e tretë e këtij pilotimi dhe gjatë muajit qershor është realizuar faza e katërt e pilotimit. Ndërkohë, gjatë muajve nëntor – dhjetor 2022, u realizuan trajnimet masive për kontabilistët dhe financierët e sektorit publik, duke u trajnuar rreth 400 kontabilistë të institucioneve që i përkasin qytetit të Tiranës.

- *Përkthimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik*

Gjatë vitit 2022 është realizuar përkthimi Handbook të standardeve IPSAS, të cilët përfshijnë dhe fjalorin e termave kyc si dhe kuadrin konceptual brenda muajit Nëntor 2022.

- *Pilotimi i kuadrit rregullator të fushës së kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me IPSAS në shtatë institucione pilot*

Në vitin 2022 është realizuar procesi i pilotimit të hartimit të pasqyrave financiare bazuar në kuadrin e ri rregullator të fushës së kontabilitetit të sektorit publik pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe në institucionet e tjera të përzgjedhura si: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Autoriteti Rrugor Shqiptar, AKSHI, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës si dhe Bashkia Tiranë.

Sa i përket Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, konstatohet se Bordi është ngritur me Urdhrin nr. Nr.210, datë 07.06.2019 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik” me ndryshime. Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, në nenin 28 citon se “Në Ministrinë e Financave ngrihet Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, me detyrën e mbikëqyrjes së çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm, në sektorin publik...”.

Bordi ka në përbërje të tij 7 anëtarë ku në cilësinë e kryetarit të këtij bordi është Ministri i Financave, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i përgjithshëm i DHMFKK, Drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Buxhetit, Drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Thesarit, një anëtar nga fusha e menaxhimit financiar dhe kontrollit, një anëtar nga fusha e kontabilitetit dhe një anëtar nga fusha e auditit të brendshëm.

Konstatohet se për vitin 2022 Bordi është mbledhur në datat 25.03.2022 dhe 23.05.2022 ku janë mbajtur dhe procesverbalet përkatëse. Në mbledhjen e parë të datës 25.03.2022 janë diskutuar planet vjetore, planet strategjike, vlerësimi i jashtëm i cilësisë, ndryshimet e reja ligjore për AB, etj.

Në mbledhjen e dytë, në datën 23.05.2022 nga procesverbali rezulton të jetë diskutuar Raporti Vjetor 2021 i Funksionimit të Sistemit të KBFP në NJQP.

Sa trajtuar më sipër, subjekti ka paraqitur observacione me shresën nr. 5854/51, datë 08.09.2023, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 281/27 Prot., datë 14.09.2023, ku pretendohet si në vijim:

Pretendimi i subjektit:

- Lidhur me rekomandimin 54.1, sqarojmë se, ky proces zhvillohet në përputhje me specifikimet e dokumentit të Metodologjisë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në njësitë publike (Urdhri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 311, datë 23.12.2020). Ky proces zhvillohet përmes vizitave në terren. Përzgjedhja e institucioneve për vlerësim është kryer mbi bazën e vlerësimit të nivelit të riskut që paraqesin këto njësi në ushtrimin e veprimtarisë së tyre si dhe zbatimin rigoroz të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i nivelit të riskut bazohet në totalin

e buxhetit akorduar njësisive publike (ministri linje, institucionet e pavarura dhe bashki) për vitin që analizohet, si dhe ndikimin që ka patur treguesi i reduktimit të detyrimeve të prapambetura, impaktit që një stok i rritur apo i zvogëluar i detyrimeve të prapambetura ka në buxhetin akorduar njësisë së qeverisjes së përgjithshme. Në këtë kontekst, do të konsiderohen me risk më të lartë ato njësi që kanë një buxhet të madh e një stok të rritur të detyrimeve të prapambetura dhe anasjellta. Ndërkohë, përsa i përket mundësisë së ndodhjes do ti referohemi vlerësimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm për secilën njësi, vlerësim i kryer mbi bazën e 18 treguesve specifikë, ku supozohet se njësitë e qeverisjes së përgjithshme të vlerësuara më mirë paraqesin më pak mundësi për ndodhjen e situatave të pafavorshme që mund të pengojnë realizimin e objektivave të njësisë së qeverisjes së përgjithshme.

Përsa më sipër, duke përcaktuar të dy elementët e nevojshëm për vlerësimin e riskut, bëhet i mundur ndërtimi i matricës së riskut për të tre grupet e njësisive të qeverisjes së përgjithshme (ministri linje, institucionet e pavarura dhe bashki) dhe përcaktohen për vlerësim njësitë e qeverisjes së përgjithshme me risk më të lartë të cilat do të përfshihen në planin vjetor të punës. Siç u theksua më sipër, janë përzgjedhur 20 njësi të qeverisjes së përgjithshme, duke marrë në konsideratë faktin se janë përjashtuar nga kjo listë institucionet e krijuara rishtazi, institucionet që kanë pushuar së ekzistuari si dhe ato në të cilat, procesi i vlerësimit të cilësisë është realizuar gjatë vitit 2021. Ndër të tjera, gjatë përgatitjes së planit vjetor të punës, merret në konsideratë ngarkesa në ditë punë e secilit punonjës të DH/MFKK. Ndërkohë, ditët e punës për vlerësimin e cilësisë për çdo institucion janë përcaktuar në shkresën përcjellëse drejtuar tyre, ku, mesatarisht janë përcaktuar 4 ditë pune të plota për vlerësim

- Lidhur me realizimin e asistencës teknike në 5 institucionet e përzgjedhura dhe konstatimit për mungesën e evidencave për zhvillimin e aktiviteteve apo raporteve përmbledhëse, sjellim në vëmendjen tuaj se, në kushtet e parashtruara më sipër mbi kufizimin e shpenzimeve për shkak të krizës ekonomike, DH/MFKK është angazhuar në realizimin e disa prej këtyre aktiviteteve nëpërmjet platformave online. Për këto aktivitete, institucionet janë njoftuar në rrugë elektronike (emailt e njoftimit janë vënë paraprakisht në dispozicion të grupit të auditimit). Ndërkohë, përsa i përket raporteve përmbledhëse për asistencën teknike, DH/MFKK ka raportuar në mënyrë periodike pranë strukturave eprorë përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (bashkëlidhur dokumenti i Analizës Vjetore të DH/MFKK për vitin 2022). Gjithashtu, në Raportin Vjetor të KBFP për vitin 2022 përveç informacionit të detajuar për procesin e ofrimit të asistencës teknike, paraqitet edhe vlerësimi i performancës dhe rankimi me pikë i institucioneve të përzgjedhura.

- Lidhur me rekomandimin 55.1, theksojmë se ky proces është realizuar në përputhje me procedurat e parashikuara në Metodologjinë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm. Në këtë mënyrë, DH/MFKK ka verifikuar gjendjen e zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm duke ekzaminuar bazën dokumentare sipas secilës rubrike të listës së kontrolleve. Sipas metodologjisë u planifikuar realizimi i këtij procesi në 20 njësi të qeverisjes së përgjithshme. Përzgjedhja për vlerësim e tyre është kryer mbi bazën e vlerësimit të nivelit të riskut që paraqesin këto njësi në ushtrimin e veprimtarisë së tyre si dhe në zbatimin rigoroz të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Gjatë procesit të vlerësimit, grupi u fokusua në analizimin e bazës dokumentare të vënë në dispozicion nga subjekti deri në momentin e realizimit të këtij misioni, duke iu përmbajtur parimeve specifike të listës së kontrollit. Pra, në ndryshim me praktikën e kaluar për kryerjen e vizitave në terren/monitorimeve ku baza e vlerësimit ishte verifikimi i dokumentave në bazë të përgjigjeve të dhëna në pyetësorët e vetëvlerësimit për situatën e një viti më parë, realizimi i procesit të vlerësimit të cilësisë referuar specifikimeve të Metodologjisë përkatëse (Urdhri nr. 311, datë 23.12.2020) bazohet në verifikimin e dokumentacionit sipas listës së kontrollit. Në këtë mënyrë, periudha e realizimit të procesit të vlerësimit jo detyrimisht përbën një faktor vendimtar për stadin e funksionimit dhe zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin që merret në analizë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin e paraqitur, grupi i auditimit sqaron se:

- Sa i përket procesit të vlerësimit të cilësisë në institucionet e përzgjedhura, grupi i auditimit ka evidentuar gjatë trajtimit të çështjes se ka patur rishikime të planit vjetor mbi vizitat në terren. Sa i takon përzgjedhjes së institucioneve, grupi i auditimit shprehet lidhur me këtë proces se në Planin Vjetor nuk janë specifikuar detajet e parashtruara në observacion nga subjekti.

- Lidhur me realizimin e asistencës teknike në 5 institucionet e përzgjedhura për vitin 2022, grupi i auditimit i qëndron konstatimit se nga këto subjekte nuk ka patur përgjigje dhe DH/MFKK nuk ka

administruar dokumentacion vërtetues lidhur me informacionin e përgatitur për Raportin Vjetor 2022 të KBFP, përveç listëprezencave të takimeve me përfaqësues të këtyre institucioneve.

- Sa i takon vlerësimin të sistemeve të kontrollit të brendshëm të realizuar në fillim të vitit 2022, referuar argumenteve të subjektit, është kryer në bazë të dokumentacionit deri në datën e zhvillimit të kontrollit, çka nuk mund të mundësojë paraqitjen e gjendjes së plotë për vitin 2022, referuar kohës kur është kryer kontrolli.

2.F.2. Veprimtaria e Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Për auditimin e kësaj çështje të programit të auditimit është shqyrtuar dokumentacioni i mëposhtëm:

- Plani Vjetor 2022 dhe i konsoliduar hartuar nga DH/AB;
- Plani strategjik 2023-2025 dhe vjetor i konsoliduar, hartuar nga DH/AB;
- Planet individuale vjetore të Njësive të Auditimit të Brendshëm;
- Ndryshimet në Planet Vjetore të Njësive të Auditimit të Brendshëm;
- Pyetësorët e vetëvlerësimit;
- Dokumentacion mbi trajnimet;
- Dokumentacion mbi përbërjen e strukturave të NJAB;
- Dokumentacion mbi Trajnimin e Vijuëshëm Profesional;
- Dokumentacion mbi procesin e certifikimit;
- Vendime të Komitetit të Kualifikimit;
- Raporti mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme për vitin 2022.

Nga auditimi ka rezultuar:

Planifikimi nga Njësitë e Auditit të Brendshëm dhe nga DH/AB

Referuar gurmës ç të nenit 24 të Ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, struktura përgjegjëse e harmonizimit të auditit të brendshëm citohet se “Struktura përgjegjëse e harmonizimit për auditimin e brendshëm përgatit dhe administron planin e konsoliduar strategjik e vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në njësitë publike”. Pra, DH/AB duhet të konsolidojë planet individuale të Njësive të Auditit të Brendshëm.

Për më tepër, në pikën 3.3 “Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor” të Kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik citohet se “*Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën 10 Tetor të çdo viti. Planet pas dhënies së mendimit të KA-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data 20 Tetor e çdo viti, në strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, brenda datës 15 Dhjetor të çdo viti përgatit planin e konsoliduar strategjik dhe vjetor për të gjithë veprimtarinë e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Ky plan, i paraqitet për informim Ministrin të Financave, brenda datës 31 Dhjetor të çdo viti dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit në kuadrin e shkëmbimit të informacionit të ndërsjellët.*” Sa më sipër, konstatohet se për vitin 2022, Plani Vjetor të punës në DH/AB për vitin 2022 është miratuar nga Ministri i MFE me shkresën nr. 23648 Prot., datë 31.12.2021, në tejkallim të afateve të sipërcituara.

Titulli i Gjetjes:	Tejkallim i afatit për miratimin e Planit Vjetor 2022
Situata	Nga auditimi u konstatua se referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka miratuar Planin Vjetor 2022 në tejkallim të afatit të datës 15 Dhjetor të çdo viti, i cili përcaktohet në Manualin e

	Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, Kapitulli III, pika 3.3 “Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor”.
Kriteri	Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, Kapitulli III, pika 3.3
Ndikimi	Miratimi përtej afatit të përcaktuar potencialisht mund të ndikojë në shkëmbimin e informacionit të ndërsjelltë me Kontrollin e Lartë të Shtetit, duke riskuar mbivendosjen e auditimeve dhe ndryshimin e Planit përgjatë vitit.
Shkaku	Tejkalim i afateve të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	Titullari i Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të marrë masa për respektimin e afatit për përgatitjen dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor, ndër të tjera për të mundësuar edhe shmangien e mbivendosjeve të programeve të auditimit me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Për vitin 2022 shërbimi i Auditimit të Brendshëm mbulon 138 njësi publike shpenzuese. Në 136 prej tyre janë ngritur strukturat e auditimit të brendshëm, nga të cilat në vetëm 3 prej tyre këto struktura nuk janë bërë funksionale. DH/AB konstaton se mungesa e funksionalitetit të këtyre 3 strukturave është ndjekja e procedurave për plotësimin e pozicioneve sipas strukturës së miratuar dhe largimit të përkohshëm të audituesve. Këto tri struktura janë:

1. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve;
2. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
3. Spitali Rajonal Lushnje.

Dy Njësi Publike e kanë të mbuluar shërbimin e AB sipas Akt-Marrëveshjeve të lidhura midis palëve, respektivisht:

1. Bashkia Finiq – Akt-Marrëveshje me Bashkinë Dropull, nr. 17390/1 Prot., datë 05.11.2021;
2. Bashkia Libohovë – Akt-Marrëveshje me Bashkinë Dropull, nr. 8447 Prot., datë 12.05.2021.

Nga lista e vitit 2022 në krahasim më vitin 2021 nuk figurojnë 2 NJAB si në vijim:

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (Institucioni me shkresën nr. 7787/1 Prot., datë 25.07.2022 ka njoftuar që NJAB është suprimuar sipas Urdhërit nr. 9, datë 13.01.2022 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”).

Plani i konsoliduar vjetor 2023

Bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, në Kapitulli II, Pika 2.2.1, germa *d*, citon se “*Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm: d) Përgatit dhe administron planin e konsoliduar strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në njësitë publike.*” Sipas formateve standarde të planit strategjik të përcaktuar në kapitullin III të Manualit e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, citon se “*Plotësimi i pasqyrave standarde nevojitet për përgatitjen e pjesës së shkruar të Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB. Të dhënat e paraqitura në pasqyra duhet të gjejnë argumentim të detajuar në pjesën e shkruar të dokumentit dhe kur është e nevojshme mund të bëhen dhe shënime shtesë në fund të materialit të përgatitur. Përgatitja e pasqyrave standarde ka si qëllim që të vendosë në të njëjtën linjë dhe formë planifikimin dhe rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në të gjithë sektorin publik.*

Pasqyrat pjesë përbërëse e planit janë:

1. Pasqyra 1 “Vlerësimi i nivelit të riskut për të gjithë subjektet që duhet të auditohen nga NJAB”
2. Pasqyra 2 “Plani strategjik i subjekteve të synuara për t’u audituar për vitet”
3. Pasqyra 3 “Plani i angazhimeve të NJAB për vitin”
4. Pasqyra 4 “Planifikimi i nevojave për trajnim të NJAB për vitin”
5. Pasqyra 5 “Planifikimi i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin”.

Nga auditimi i Planit Strategjik dhe Vjetor 2023-2025 nuk rezulton që Pasqyra 4 – Planifikimi i nevojave për trajnim të NJAB për vitin, të jetë përgatitur nga DH/AB sipas përcaktimeve të Manualit të AB-së, ndërsa pasqyrat e tjera të mësipërme janë përgatitur e përmbledhur nga ana e DH/AB.

Pasqyra 4 lidhur me trajnimet paraqitet në format Word dhe jo Excel sipas përcaktimeve të Manualit të AB, si dhe nuk rezulton të jetë plotësuar në përputhje me përcaktimet:

“Kolona 1) “Tematika e identifikuarra për trajnim” do të përcaktohen temat për të cilat audituesit e NjAB janë të interesuar të marrin trajnime (p.sh. planifikimi i angazhimit, vlerësimi i riskut etj).

Kolona 2) “Pjesëmarrës në trajnim” do të përcaktohet numri i audituesve që janë të interesuar të marrin pjesë në trajnimin me tematikën përkatëse.

Kolona 3) “Periudha” do të përcaktohet periudha në të cilën kanë mundësi audituesit e brendshëm të ndjekin trajnimin, duke marrë parasysh planin vjetor të angazhimeve.

Kolona 4) “Kohëzgjatja e trajnimit” do të përcaktohet duke pasur parasysh detyrimin ligjor që ka çdo auditues për trajnim”.

DH/AB ka dërguar drejt KLSH me shkresën nr. 23361 Prot., datë 20.12.2022 Planin e Konsoliduar strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së auditit të brendshëm në sektorin publik për vitet 2023-2025, referuar gurmës a të pikës 2 të nenit 25 “Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit” të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” ku citohet se “Mbi bazën e këtyre parimeve, fushat kryesore të bashkëpunimit janë shkëmbimi i planit të konsoliduar të auditimit, me synim shmangien e mbivendosjeve”.

Lidhur me dorëzimin e Planeve Strategjike/Vjetore të NJAB-ve pranë DH/AB konstatohet se: Aktualisht në sektorin publik janë krijuar 136 struktura të Auditimit të Brendshëm, të ngritura në njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, nga të cilat 133 janë funksionale, dhe 3 ende nuk janë bërë funksionale (Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve; Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile; dhe Spitali Rajonal Lushnjë).

Përsa i përket afateve të dorëzimit të Planeve Vjetore të këtyre NjAB-ve pranë DH/AB rezulton se nga të dhënat e Planit Strategjik dhe Vjetor 2023-2025, kanë raportuar gjithsej 128 NjAB nga 133 të tilla, ku 17 prej tyre i kanë dorëzuar Planet Vjetore përtej afatit të datës 20.10.2022. Ndërkohë, 2 NjAB (Ujësjellës Kanalizime Elbasan dhe Ujësjellës Kanalizime Korçë) nuk kanë raportuar dhe 3 NjAB (Autoriteti Portual Durrës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Universiteti Politeknik i Tiranës) kanë raportuar vetëm përmes email dhe jo me shkresë zyrtare. Të dhënat paraqiten në tabelën nr. 1.

Tabela nr. 1: Mbi dorëzimin e Planeve Vjetore nga NjAB drejt DH/AB

<i>Përshkrimi</i>	<i>Nr. i NjAB-ve</i>
Dorëzim i Planit Vjetor brenda afatit (20.10.2022)	111
Dorëzim i Planit Vjetor përtej afatit	17
Nuk kanë dorëzuar Plan Vjetor	2
Kanë raportuar vetëm përmes email (jo me shkresë zyrtare)	3
Totali	133

Burimi: Të dhënat nga DH/AB në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Gjatë miratimit të Planit Strategjik 2023-2025 dhe Planit Vjetor nga ana e DH/AB është referuar se nga ana e NjAB ka patur disa mangësi si në vijim:

- NjAB, nuk kanë hartuar Planin Strategjik dhe Vjetor sipas strukturës dhe përmbajtjes të paraqitur në Formatin Standard nr. 5 “Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NjAB” të Manualit të Auditimit të Brendshëm;
- NjAB, kanë dërguar të plotësuar vetëm pasqyrat e planit strategjik dhe vjetor të pa shoqëruar me pjesën përshkuese të Planit strategjik dhe Vjetor të veprimtarisë së njësisë;
- Titullari i njësisë publike ka nënshkruar vetëm shkresën shoqëruese të këtyre planeve, pa nënshkruar miratimin e Planit Strategjik dhe Vjetor 2023-2025, sikurse përcaktohet në kërkesat e standardeve;
- Universi i auditimit nuk përfaqëson të gjitha fushat/sistemet/operacionet e njësisë publike, si të strukturave/Drejtorive pjesë të organigramës së njësisë publike, dhe të njësisve të varësisë (të gjitha subjektet ku ajo mund të ushtrojë auditimin, pra subjektet që janë në fushën e autoritetit të njësisë publike), pavarësisht se në çfarë periudhe gjykohet të auditohet (Pasqyra nr. 1);
- Nuk janë identifikuar fushat për tu audituar, respektivisht për subjektet e audituara;
- Njësitë e AB nuk kanë respektuar kërkesat lidhur me plotësimin e formateve të planeve, si:
 - Numri i angazhimeve në planin vjetor (Pasqyra nr. 3) nuk është në koherencë me numrin e misionëve në vitin e parë të planit strategjik (Pasqyra nr. 2),
 - Planifikimi i numrit të misionëve të përlllogaritura dhe të programuara, nuk është në raport me burimet njerëzore në dispozicion të njësisë së auditimit të brendshëm, në momentin e hartimit të planeve (Në 6 raste – Zyra e Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese, Ujësjellës Kanalizime Lushnjë, Bashkitë Mallakastër, Kurbin dhe Himarë);
- Përlllogaritja e burimeve njerëzore të nevojshme për realizimin e angazhimeve të planifikuara është mbështetur në organikën e miratuar, ndërkohë që ky proces duhet të bazohet në burimet faktike që njësia ka në dispozicion.

Ndryshimet e planit përgjatë vitit 2022

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga DH/AB rezulton se 48 NJAB kanë kryer ndryshim të planit për vitin 2022 të miratuara nga Titullari i Institucionit përkatës. Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016, kapitulli III, pika 3.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetor të Auditimit të Brendshëm” citon se “*Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm duhet të arsyetohen me shkrim nga drejtuesi i NJAB, ndryshime të cilat miratohen nga titullari i njësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit, (atje ku krijohet)... Të gjithë planet vjetore dhe strategjike të rishikuar të auditimit të brendshëm duhet t’i dërgohen strukturës përgjegjëse të harmonizimit për AB-në, së bashku me shpjegimet e ndryshimeve të bëra*”. Nga auditimi rezulton se nga këto 48 NJAB, vetëm 36 prej tyre e kanë argumentuar ndryshimin e Planit Vjetor 2022 me relacionin përkatës dhe me pasqyrën nr. 3 e cila reflekton planin e angazhimeve për vitin 2022, i ndryshuar.

Tabela nr. 2: Numri i NJAB që kanë arsyetuar ndryshimin e Planit Vjetor 2022

	Ndryshimi i planit është shoqëruar me relacionin përkatës, si dhe me Pasqyrën nr. 3 "Plani i Angazhimeve për vitin 2022", i ndryshuar	Ndryshimi i planit është shoqëruar me relacionin përkatës, por jo me Pasqyrën nr. 3 "Plani i Angazhimeve për vitin 2022", i ndryshuar	Ndryshimi i planit nuk është shoqëruar me relacionin përkatës, por vetëm me Pasqyrën nr. 3 "Plani i Angazhimeve për vitin 2022", i ndryshuar	Ndryshimi i planit nuk është shoqëruar me relacionin përkatës dhe as me Pasqyrën nr. 3 "Plani i Angazhimeve për vitin 2022", i ndryshuar
Nr. i NJAB	36	4	4	4

Burimi: Të dhënat nga DH/AB në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Plani i konsoliduar për vitin 2022 ka përfshirë 127 NJAB me 1181 angazhime auditimi gjithsej. Nga të dhënat rezulton se 3 NJAB me 10 angazhime auditimi që kanë raportuar me vonesë dhe të dhënat nuk janë pasqyruar në Planin e Konsoliduar janë:

1. Kryeministria;
2. Universiteti i Mjekësisë;
3. Bashkia Divjakë.

Bashkë me ndryshimet e planit vjetor me pakësime prej 52 angazhime auditimi, Plani i Konsoliduar për vitin 2022 rezulton gjithsej me 1181 angazhime auditimi. Pas ndryshimit të Planeve Vjetore 2022 rezultojnë gjithsej 1139 angazhime auditimi.

Tabela nr. 3: Tabela me angazhimet e auditimit për vitin 2022 para dhe pas ndryshimeve

		Auditime gjithsej	Shërbimet e Sigurisë					Shërbime konsulence
			Auditime përputhshmërie	Auditime performance	Auditime financiare	Auditime TI	Auditime të kombinuara	
A	Plani i konsoliduar per vitin 2022	1181	420	34	80	14	621	12
B	NJAB që kanë raportuar me vonesë	10	4	0	3	0	3	0
	Totali A+B	1191	424	34	83	14	624	12
C	Ndryshime Plani Vjetor 2022 (pakësim)	-52	-31	-4	-7	-2	-17	+4
	Totali A+B+C	1139	393	30	76	12	607	16

Burimi: DH/AB në MFE

Kapacitetet audituese të NJAB gjatë 2022

Sa i takon kapaciteteve audituese dhe zhvillimit të auditimeve përgjatë vitit, nga analiza e kryer nga grupi i auditimit konstatohet se:

NJAB me asnjë auditim të zhvilluar gjatë vitit 2022 (ose që nuk kanë raportuar) rezultojnë si në vijim:

1. Njësia Vend. Op. Kujd. Shënd. Tiranë (0 auditime);
2. Gjykata Kushtetuese (AB me leje lindje);
3. Spitali Rajonal Elbasan (AB emëruar me Urdhër nr. 205, datë 20.10.2022);
4. Qendra Spitalore Lushnje (AB me leje lindje);
5. Spitali Rajonal Gjirokastrë (Pa raportuar);
6. Qendra Spitalore Korçë (AB emëruar me Urdhër nr. 1800, datë 23.11.2022);
7. Spitali Memorial Fier (AB emëruar me Urdhër nr. 122, datë 31.08.2022 dhe Urdhër nr. 146, datë 01.11.2022);
8. Bashkia Librazhd (AB dalë në pension);
9. Bashkia Has (AB emëruar në datë 01.11.2022);
10. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (struktura jofunksionale);
11. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (struktura jofunksionale).

Ndërkohë në tabelën nr. 4 paraqiten NJAB të cilët kanë patur ngarkesën më të lartë për auditues (auditime/auditues) përgjatë vitit 2022, ku paraqiten vlerat më të larta të këtij treguesi:

Tabela nr. 4: NJAB me raportin më të lartë Auditime/Auditues (10% më të lartat), 2022

	Auditues	Auditime gjithsej	Auditime/ Auditues	Auditime në bashki	Aud. performance	Aud. financiare	Aud. TI	Aud. të kombinuara	Shërbime këshillimi	Me kërkesë titullari	Përfunduar	Në proces
Bashkia Memaliaj	1	8	8.00	8	0	0	0	0	0	0	8	0
Bashkia Tepelenë	1	8	8.00	4	0	4	0	0	0	0	8	0
Shërbimi Informativ Shtetëror	3	20	6.67	11	0	8	0	1	0	0	17	3
Bashkia Patos	2	13	6.50	7	0	0	0	6	0	0	13	0
Spitali Rajonal Kukës	1	6	6.00	3	0	0	0	1	0	2	6	0
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	5	28	5.60	2	1	2	2	18	2	1	22	6
Bashkia Fier	2	11	5.50	6	2	0	0	3	0	0	11	0
Rezidenca Stud Univ nr.1	1	5	5.00	3	0	0	0	2	0	0	5	0
Ujës.Kanalizime Lushnje	1	5	5.00	1	0	1	0	3	0	0	4	1
Bashkia Skrapar	1	5	5.00	5	0	0	0	0	0	0	5	0
Bashkia Dropull	3	15	5.00	12	0	0	0	3	0	0	15	0
Ministria e Bujqësisë & Zhvillimit Rural	3	14	4.67	0	0	0	0	12	0	2	13	1
Ministria e Financave & Ekonomisë	7	32	4.57	0	0	0	0	32	0	0	31	1

Burimi: Të dhënat nga DH/AB në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Ndërsa, në tabelën nr. 5 paraqiten NJAB të cilët kanë patur ngarkesën më të ulët për auditues (auditime/auditues) përgjatë vitit 2022 (duke mos paraqitur NJAB e listës së mësipërme që nuk kanë realizuar asnjë auditim përgjatë vitit):

Tabela nr. 5: NJAB me raportin më të ulët Auditime/Auditues (10% më të ulëtat), 2022

	Auditues	Auditime gjithsej	Auditime/ Auditues	Auditime përputhshme	Aud. performance	Aud. financiare	Aud. TI	Aud. të kombinuara	Shërbime këshillimi	Me kërkesë titullari	Përfunduar	Në proces
Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	3	2	0.67	0	0	1	0	1	0	0	1	1
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	6	4	0.67	0	0	0	0	2	0	2	4	0
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	3	2	0.67	0	0	2	0	0	0	0	2	0
Bashkia Rrogozhinë	3	2	0.67	0	0	1	0	1	0	0	2	0

Burimi: Të dhënat nga DH/AB në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Realizimi i planit të vitit 2022

DH/AB në Raportin Vjetor 2022 citon se “Për vitin 2022, universi i auditimit të 135 NJAB-ve përfshiu për auditim 1109 (me ndryshimet) fusha dhe sisteme. Përgjatë vitit 2022, nga 126 NJAB u përfunduan 1008 angazhime auditimi që rezultuan në një nivel të realizimit të Planit Vjetor në vetëm 91 %, niveli më i ulët gjatë 5 viteve të fundit”. Ndërkohë në grafikun nr. 2 të Raporti Vjetor 2022 të DH/AB rezultojnë 1181 auditime të planifikuara dhe 1008 auditime të

realizuara. Konstatohet se në Raportin Vjetor 2022, DH/AB ka krahasuar realizimin faktik me planin fillestar, pa marrë parasysh ndryshimet përgjatë vitit 2022 të Planeve Vjetore të NJAB dhe NJAB që nuk kanë raportuar në kohë dhe nuk janë bërë pjesë e Planit të Konsoliduar.

Raporti Vjetor 2022 i DH/AB nuk paraqet në mënyrë konsistente të dhënat reale lidhur me realizimet dhe planifikimet, duke ndikuar kështu në përllogaritjet e realizimit faktik kundrejt atij të planifikuar për secilin prej angazhimeve të auditimit. Në tabelën nr. 9 të Raportit Vjetor të DH/AB paraqiten llojet e angazhimeve të realizuara ku shumatorja e tyre arrin në 999 dhe jo në 1008 angazhime siç është shënuar në tabelë. Për më tepër, në përllogaritjet e kryera lidhur me realizimin në përqindje (të treguar në Grafikon nr. 2 të Raportit Vjetor të DH/AB) konstatohet se planifikimi paraqitet në 1181 auditime dhe realizimi në 1008 auditime, ndërkohë që në Grafikon nr. 3 të Raportit Vjetor të DH/AB rezulton se planifikimi në përqindje është përllogaritur në vlerat që paraqiten edhe në tabelë.

Tabela nr. 6: Krahasimi i realizimit të angazhimeve të auditimit me planifikimin

	Auditime të Kombinuar	Auditime përputhshme	Auditime Financiare	Auditime Performance	Auditime të TI	Auditime Tematike	Shërbime të Këshillimit	Total
Plani fillestar	621	420	80	34	14	0	12	1181
<i>NJAB që kanë raportuar me vonesë</i>	3	4	3	0	0	0	0	10
Plani (me vonesa)	624	424	83	34	14	0	12	1191
Plani i ndryshuar	612	393	76	30	12	0	16	1139
<i>NJAB planifikuar pa raportuar</i>	5	0	4	0	0	0	0	9
Planifikimi me ndryshimet e miratuara	607	393	72	30	12	0	16	1130
Realizimi	469	379	89	28	4	29	10	1008
Realizimi sipas DH/AB (në %)	84%	98.4%	123.6%	93.3%	33.3%	-	62.50%	90.9%
Realizimi sipas KLSH (në %)	77.3%	96.4%	123.6%	93.3%	33.3%	-	62.5%	89.2%

Burimi: Të dhënat nga DH/AB në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela nr. 6 paraqet realizimin e Planit Vjetor të DH/AB së bashku me përllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit të KLSH.

DH/AB ka konstatuar se në analizën e mosrealizimit të Planit Vjetor të Auditimit kanë ndikuar faktorët:

- Kapacitete të pamjaftueshme të strukturave auditimit të brendshëm Mungesa dhe qarkullim i stafit auditues të certifikuar; Iarkullimi i shpeshtë i stafit auditues, largimi i audituesve me eksperiencë dhe të kualifikuar dhe zëvendësimi i tyre me staf të ri, çka tregon për humbje të investimit që është bërë më parë në kapacitete. Ky fenomen bëhet më i theksuar në NJAB e pushtetit vendor dhe shoqërive aksionare;
- Ndryshimi i prioriteteve në veprimtaritë e subjekteve të audituara, pra ndryshim i shkallës së vlerësimit të riskut, përgjatë vitit ushtrimor. Sisteme komplekse dhe të reja që kërkojnë më shumë kohë për tu audituar;
- Planifikim të pabazuar në burimet reale të NJAB (planifikojnë numër të madh auditimesh dhe nuk arrijnë ti realizojnë);
- Planifikim “me rezerva” ku vihet re që NJAB-të kanë më shumë kapacitete në dispozicion duke planifikuar një numër të kufizuar auditimesh por në fakt realizojnë shumë më tepër çka tregon mungesë efektiviteti dhe shpërdorim të burimeve;
- Kërkesa specifike të menaxhimit të lartë për auditime të fushave dhe sistemeve që janë paraqitur me risk më të lartë gjatë vitit;

- Procedura të zgjatura të auditimit si rezultat i komunikimeve dhe diskutimeve me palët e treta të përfshira në procesin e auditimit.

Pra, nga DH/AB konstatohet se mangësitë në planifikimin e veprimtarisë audituese mbartin riskun që angazhimet e auditimit nuk sigurojnë që risqet kryesore janë adresuar dhe fushat apo sistemet me risk të lartë e të mesëm që kanë ndikim thelbësor në arritjen e objektivave të jenë mbuluar me auditim. Ato gjithashtu “flasin” për një eficiencë të ulët në planifikimin e burimeve të faktorëve të cilët mund të ndikojnë në të gjithë cilësinë e procesit të auditimit si gjate punës në terren ashtu dhe në arritjen e objektivave të auditimit. Dobësitë në planifikimin e veprimtarisë dhe ndryshimet e shpeshta gjatë vitit, bartin riskun që veprimtarisë audituese të mos realizohet në mënyrë sistematike dhe të disiplinuar, duke vazhduar të jetë e orientuar nga inspektimet financiare.

Nga ana e NJAB, gjatë vitit 2022, janë realizuar auditime që kanë konkluduar në gjetje me rëndësi deri në dëm ekonomik në sistemin e prokurimeve, ku janë identifikuar numri më i madh i shkeljeve të procedurave të prokurimit publik. Po ashtu në fushën e tatim taksave dhe doganave kanë rezultuar më një numër të konsiderueshëm të devijimeve dhe shkeljeve të cilat kanë sjellë dhe efekt financiar negativ. Të tjera sisteme ku paraqitet nivel i lartë i gjetjeve dhe nënsistemet përkatëse përfshihen: sistemi i pagave dhe shpërblimeve, administrimi i aseteve, planifikimi buxhetit dhe sisteme të tjera operationale sipas natyrës së subjekteve të audituara. Nga auditimet janë evidentuar problematika të ndryshme në hallka të ndryshme të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes në nivel qendror dhe vetëqeverisjes vendore, ashtu dhe agjencive shtetërore dhe shoqërive aksionere publike.

Shkeljet e disiplinës financiare të konstatuara nga NJAB-të gjatë auditimeve, kanë shkaktuar efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit prej 406.3 milion Lekë nga të cilat rreth 41.2% e dëmit është konstatuar në tatime-taksa dhe rreth 25.5% në sisteme të tjera specifike të njësive publike. Vlera në rritje e shkeljeve financiare e konstatuar gjatë vitit 2022 është ulur në krahasim me vitin 2021.

Tabela nr. 7: Gjetjet me efekt financiar negativ nga NJAB sipas sistemeve për vitin 2022

Nr.	Gjetjet me efekt financiar negativ sipas sistemit	Gjetje në vlerë (mijë lekë)	Gjetje në numër
1	Prokurim, blerje dhe investime	20,743.64	939
2	Paga, shpërblime, trajtime, komisione	36,986.70	719
3	Fondet e sig. shoq dhe shëndetësore	8,460.40	24
4	Tatime, taksa dhe dogana	167,269.37	480
5	Admin. prone dhe pasurie	20,117.32	1,165
6	Privatizime, shitje dhe qiradhënie	20,880.11	103
7	Koncesione dhe ankande	28,135.86	25
8	Legalizime, Urbanistikë, kth. Pronash	0	14
9	Kreditim, subvencione	5	50
10	Të tjera	103,682.21	3,741
	TOTALI	406,280.60	7,260

Burimi: Raporti Vjetor i DH/AB, 2022

Sa i përket rekomandimeve të lëna nga NJAB-të gjatë auditimeve, rezulton se përgjatë vitit 2022 janë lënë në total 2287 rekomandime, të specifikuara si në tabelën nr. 8:

Tabela nr. 8: Rekomandimet e lëna përgjatë vitit 2022 nga NJAB-të

Nr.	Rekomandimet sipas llojit	Rekomandimet (nr)
1	Rekomandime për përmirësim sistemesh	2238
2	Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor	205
3	Rekomandime të karakterit organizativ	3105
4	Rekomandime për arkëtime	517
5	Rekomandime të tjera	1222

TOTALI	7287
---------------	-------------

Burimi: Raporti Vjetor i DH/AB, 2022

Për vitin 2022, niveli i pranimit të rekomandimeve paraqitet në nivelin 99.2%, ku nga 7808 rekomandime të dhëna janë pranuar 7745 dhe nuk janë pranuar 63 rekomandime. Në funksion të ndjekjes deri në zbatimin e plotë të rekomandimeve, NJAB vazhdojnë të monitorojnë zbatueshmërinë e rekomandimeve deri në dy vite pas lëshimit të raportit përfundimtar të auditimit. Në këtë këndvështrim niveli i zbatimit të rekomandimeve i shtrirë në dy vite (2021-2022) paraqitet në nivelin 56%.

Strukturat e auditimit

Në pikën 1 të nenit 10 të Ligjit nr.114/2015, datë 20.10.2015 i ndryshuar citohet se *“Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në gerrat a-c të kësaj pike”*.

Rezulton se bazuar në Raportin Vjetor 2022 të DH/AB, shërbimi i auditimit të brendshëm në sektorin publik gjatë vitit 2022 është realizuar nga 136 NJAB, të krijuara në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Në tabelën nr. 9 specifikohet struktura e NJAB, e ndarë në nivel drejtorie/ sektori/zyre/dege etj për vitin 2022.

Tabela nr. 9: Të dhëna për strukturën e NJAB, 2022

Nr.	Niveli i NJAB	Në numër
1	Drejtori	40
2	Sektor	73
3	Zyrë	3
4	Degë	1
5	Njësi	1
6	Specialist	16
	Totali	134
7	Sektor (vetëm miratuar)	2
	Totali	136

Burimi: DH/AB në MFE

Struktura organike e miratuar për stafin auditues në NJAB ka parashikuar 499 auditues të brendshëm, por në fund të vitit 2022 janë evidentuar të punësuar vetëm 435, duke paraqitur riskun që veprimtaria audituese të mos mbështetet nga burimet e nevojshme dhe kapacitetet profesionale njerëzore që do të mundësonin realizimin në kohë dhe me cilësi të shërbimit të auditimit. Nga evidentimi i vendeve vakante (64 të tilla), konstatohet se ndarja e tyre rezulton si më poshtë:

- 15 vende vakante në ministritë e linjës;
- 19 vende vakante në njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- 15 vende vakante në institucionet qendrore;
- 5 vende vakante në institucionet e pavarura;
- 3 vende vakante në universitetet publike;
- 2 vende vakante në qendrat spitalore;
- 5 vende vakante në shoqëritë aksionere.

Tabela nr. 10: Të dhëna mbi audituesit e brendshëm, 2022

Nr. NJAB gjithsej	Auditues të Brendshëm Plan	Auditues të Brendshëm Fakt	Vende Vakante	Auditues të Brendshëm të certifik	Auditues të Brendshëm të pa certifik	Auditues të Brendshëm në proces certifik
136	499	435	64	309	51	75

Burimi: DH/AB në MFE.

Struktura profesionale e audituesve të brendshëm konsiston në:

- 348 ekonomistë;
- 67 juristë;
- 20 me profesione të tjera specifike sipas sektorëve të ekonomisë.

Tabela nr. 11: Paraqitja e audituesve të certifikuar për vitin 2022

Auditues të certifikuar	Auditues në proces certifikimi	Auditues të pacertifikuar	Auditues gjithsej
309	75	51	435
71.03%	17.24%	11.72%	

Burimi: Të dhënat nga DH/AB në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Pra, në total paraqitet një nivel prej 11.72% të audituesve të cilët janë të pacertifikuar. Numri më i madh i audituesve të pa certifikuar (30 të tillë) i përket njësive të vetëqeverisjes vendore dhe shoqërive aksionere publike.

Eksperiencia në profesion është një kriter bazë për punësimin dhe zhvillimin në karrierë të audituesve e diferencuar për drejtues të NJAB dhe auditues të brendshëm. Kriteri i eksperiencës përmbushet nga 245 auditues të brendshëm që kanë vjetërsi pune mbi 5 vjet dhe 190 kanë vjetërsi në auditim deri në 5 vjet. Evidentohen:

- 24 njësi me më pak se tre auditues, nga të cilat 17 NJAB me 1 punonjës dhe 7 NJAB me 2 punonjës (tre më pak se vjet);
- 17 njësi me drejtues të NJAB me më pak se 5 vjet në auditim të brendshëm ose të jashtëm, 11 njësi me drejtues të NJAB të pa certifikuar ose në proces certifikimi;
- 25 njësi kanë punësuar më shumë se 1/3 të punonjësve të pa certifikuar.

Shërbimi i auditimit të brendshëm nuk shtrihet në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, konkretisht në 11 institucione të pavarura, 9 njësi publike në varësi të Kryeministrisë (të Grupit Buxhetor 87) dhe në 9 njësi të pushtetit vendor (Bashki) nuk realizohet shërbimi i auditimit të brendshëm. Në këto kushte, krijimi i njësive të auditimit duke mos përmbushur kriteret mbart risk të lartë dhe mund të ketë efekt në funksionimin dhe performancën e auditimit, risk i evidentuar dhe nga DH/AB në Raportin Vjetor 2022 të kësaj Drejtorie.

Në njësitë e vetëqeverisjes vendore që realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kanë krijuar NJAB përfshihen 50 Bashki, ku janë të punësuar 134 auditues të brendshëm kundrejt 153 të miratuar në strukturat organike përkatëse. Kapacitete profesionale të auditimit të brendshëm në njësitë e vetëqeverisjes vendore vlerësohet të jenë jo plotësisht në përputhje me kriteret ligjore të rekrutimit. Nga 134 auditues të brendshëm të punësuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore 74 janë të certifikuar, 30 auditues janë në proces certifikimi dhe 30 janë auditues të rekrutuar rishtazi dhe që nuk janë certifikuar.

Ndërkohë njësitë e vetëqeverisjes vendore relativisht të vogla (Finiq dhe Libohovë) e kanë realizuar shërbimin e auditimit me akt-marrëveshje me njësi auditimi të brendshëm të njësive të tjera publike (konkretisht me Bashkinë Dropull). Njësitë e vetëqeverisjes vendore (Belsh, Pukë, Konispol, Delvinë, Tropojë, Pustec, Këlcyrë, Përmet dhe Poliçan) nuk realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm me asnjë nga format e përcaktuara në kuadrin rregullator.

Hartimi, zhvillimi dhe administrimi i politikave kombëtare për zhvillimin profesional të audituesve të brendshëm nga certifikimi e trajnimi i vazhdueshëm i tyre në përshtatshmëri me praktikat bashkëkohore të fushës

Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të audituesve të brendshëm

Ligji nr.114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin Publik” në nenin 20 të tij citon se “Trajnimi i vijueshëm profesional organizohet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, sipas procedurës së miratuar me urdhër të Ministrit të Financave.”

Urdhri nr. 3, datë 08.01.2016 i Ministrit të Financave “Për miratimin e Rregullores së trajnimit të vijueshëm, profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, ka përcaktuar Rregulloren e Trajnimit të Vijueshëm Profesional (TVP) dhe përmes Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 248, datë 31.12.2021, është miratuar Programi i Trajnimit të Vijueshëm Profesional (TVP) të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik për vitin 2022, i cili përfshin 8 module kryesore. Implementimi i programit të miratuar ndiqet nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, e cila raporton te Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe te Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm.

Një ndër objektivat specifike të Planit Vjetor të DH/AB miratuar me shkresën nr. 23648 Prot., datë 31.12.2021 është “Ngritja profesionale e Audituesve të Brendshëm në sektorin publik” për të cilin janë specifikuar detyrat/aktivitetet nr. 5, 6, 7 dhe 8 si më poshtë:

- Trajnimi i vijueshëm profesional i 300 audituesve të brendshëm në detyrë, planifikuar të zhvillohet në Mars-Dhjetor 2022 (3 faza të plota për trajnim) me indikator realizimi 300 auditues të brendshëm të trajnuar;
- Përgatitja e Programit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional të audituesve të brendshëm në detyrë për vitin 2023, planifikuar të zhvillohet në Nëntor-Dhjetor 2022, me indikator realizimi miratimin e programit TVP;
- Organizimi i procesit të certifikimit të kandidatëve për auditues të brendshëm për sezonin 2022-2023, planifikuar të zhvillohet në Janar 2022-Qershor 2023, me indikator realizimi 40 kandidatë të regjistruar si Auditues të Brendshëm në këtë sezon;
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta (takime, trajnime, konferenca) me projektin SECO, planifikuar të zhvillohet në Shkurt-Nëntor 2022, me indikator realizimi auditues të brendshëm të pushtetit vendor.

Përmes Urdhrit nr. 248, datë 31.12.2021 “Për miratimin e programit të trajnimit të vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik për vitin 2022” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është miratuar programi i TVP si dhe është ngarkuar DH/AB, Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e këtij Urdhri.

Programi i TVP për vitin 2022 ka synuar të arrijë 350 auditues të brendshëm në detyrë dhe ka planifikuar 8 module kryesore:

1. Prokurimi Publik dhe auditimi i PPP;
2. Auditimi i Shoqërive Aksionere (publike);
3. Auditimi i Njësive të Vetqeverisjes Vendore;
4. Auditimi i brendshëm në sistemin e shëndetit publik;
5. Qasja audituese e bazuar në risk;
6. Auditimi me bazë sistemi (ABS/System Based Audit);
7. Auditimi i brendshëm në qeverisje;
8. Auditimi i Asistencës së para-anëtarësimit në BE (IPA).

MFE ka lidhur 7 kontrata shërbimi me trajnerët të cilët do të përgatisin dhe prezantojnë temat e trajnimit, referuar VKM nr. 116, datë 17.02.2017, “Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”.

Gjatë vitit 2022, referuar Raportit Vjetor, rezultoi se DH/AB ka zhvilluar trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik sipas moduleve të Programit të trajnimit të miratuar, me 8 tema trajnime të zhvilluara në 40 orë në platformë online, ku kanë marrë pjesë 310 auditues të brendshëm të certifikuar. Nga shqyrtimi i të

dhënave të Regjistrisë të pjesëmarrësve në TVP të publikuar në faqen zyrtare të MFE, rezultojnë se janë regjistruar për TVP 318 auditues të brendshëm dhe 3 auditues të brendshëm të cilët nuk e ushtrojnë më detyrën (pra kanë marrë pjesë në program me pagesë).

Tabela nr. 12: Të dhëna mbi pjesëmarrjen në TVP të audituesve të brendshëm, 2022

	Nr. Pjesëmarrësish
Orë trajnimi nga DH/AB = 40 orë	272
0 orë < Orë trajnimi nga DH/AB < 40 orë	34
Orë trajnimi nga DH/AB = 0 orë	12
Njohje trajnimi	77
Orë gjithsej trajnimi ≥ 40 orë	304
0 orë < Orë gjithsej trajnimi < 40 orë	10
Orë gjithsej trajnimi = 0 orë	4

Burimi: Të dhënat nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Sipas pikës 2 të nenit 20 të Ligjit Nr.114/2015 me ndryshime parashikohet se: *“Të gjithë audituesit e certifikuar në detyrë, të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji, i nënshtrohen trajnimit të vijueshëm profesional, të paktën 80 orë në dy vjet”*. Kriteri i 80 orëve në dy vite e bën të vështirë kontrollin e plotësimin të këtij kushti dhe të dhënat mbahen për çdo auditues, duke llogaritur periudhën e fillimit të detyrës dhe duke e ndarë në periudha dy vjeçare. Këto të dhëna mbahen nga DH/AB dhe janë dhe të evidentuara nga kjo strukturë.

Nga 318 auditues të brendshëm të regjistruar në TVP, rezultojnë se 4 prej tyre nuk kanë realizuar asnjë orë trajnimi nga DH/AB si dhe asnjë orë shtesë njohje, duke përfunduar me 0 orë trajnim gjithsej për vitin 2022. Ndërkohë, 10 auditues të brendshëm kanë rezultuar në fund të vitit me më pak se 40 orë gjithsej trajnim, dhe 304 auditues të brendshëm rezultojnë të kenë kryer 40 orë dhe më shumë trajnim gjithsej. Nga audituesit e brendshëm, 77 prej tyre kanë realizuar orë shtesë trajnimi të cilat janë njohur referuar Vendimit nr. 8, datë 24.11.2022 dhe Vendimit nr. 13, datë 06.01.2023 të Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm (KKAB), ku është janë njohur orët e trajnimit zhvilluar nga audituesit e brendshëm në detyrë pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP) si dhe Projektit Zviceran SECCO (Financave vendore 2018-2023), e drejtë kjo e audituesve që njihet dhe në legjislacionin për auditimin e brendshëm në pikën 3, neni 20 ku citohet se *“Audituesit të brendshëm në detyrë i njihet si trajnim i vijueshëm profesional pjesëmarrja në trajnime për auditimin e brendshëm, të organizuara nga institucione kombëtare ose ndërkombëtare, si dhe publikime në fusha që lidhen me auditimin e brendshëm, të cilat raportohen dhe njihen sipas procedurës së përcaktuar në urdhrin e nxjerrë sipas pikës 1 të këtij neni.”* Me Vendimin nr. 12, datë 27.12.2022 të Komisionit të Kualifikimit është miratuar Raporti Përmbledhës për vlerësimin e TVP 2022, i cili i paraqitet Ministrit të Financave.

Nga krahasimi i të dhënave për numrin e planifikuar dhe faktik të audituesve pjesëmarrës në trajnim, DH/AB ka evidentuar një diferencë e cila sipas saj përfaqëson auditues të brendshëm të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me Njësinë e Auditimit të Brendshëm për shkaqe të ndryshme (dalë në pension, transferuar në një pozicion të ri pune), si dhe auditues që kanë patur arsye shëndetësore apo nuk kanë patur akses në platformën ku prezantoheshin temat e trajnimit.

Nga vlerësimi i trajnimit nga ana e DH/AB është evidentuar se audituesit e brendshëm e kanë vlerësuar trajnimin të dobishëm për mënyrën e konceptimit në funksion të përditësimit, zhvillimit të njohurive dhe pasurimit të përvojës së tyre për ushtrimin e detyrës (41.2% e audituesve pjesëmarrës që kanë plotësuar formularin e vlerësimit të trajnimit). Analizimi dhe përpunimi i të dhënave nga DH/AB nga formularët e vlerësimit plotësuar nga audituesit e

brendshëm pjesëmarrës në trajnim, kanë përcaktuar treguesin e vlerësimit të përgjithshëm të trajnimit në nivelin e mirë.

Temat të cilat janë vlerësuar se kanë përmbushur në një masë të konsiderueshme pritshmërinë e audituesve pjesëmarrës në TVP janë:

- Qasja audituese bazuar në risk;
- Prokurimi Publik dhe Auditimi i Partneritetit Publik Privat;
- Auditimi i Shoqërive Aksionere Publike.

Grupi i auditimit konstaton se edhe pse tema “Auditimi i Partneritetit Publik Privat” ka qenë objekt trajnimi për audituesit e brendshëm, nuk rezulton që të jetë planifikuar e realizuar asnjë auditim mbi kontrata PPP nga ana e NJAB që mbikëqyren nga DH/AB.

Certifikimi i audituesve të brendshëm

Sa i përket certifikimit të audituesve të brendshëm, në kreun VI “Kriteret e kualifikimit të audituesve të brendshëm” neni 19 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin Publik” citohet se “*Certifikimi i audituesve të brendshëm organizohet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, sipas procedurës së miratuar me urdhër të Ministrit të Financave*”.

Procesi i certifikimit të audituesve të brendshëm ka nisur përmes Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 191, datë 19.07.2022 “Për fillimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik për sezonin 2022-2023”. Përmes këtij Urdhri janë përcaktuar kriteret dhe mënyra e aplikimit për kandidatët për auditues të brendshëm dhe kandidatët për trajnerë. Sipas këtij Urdhri, afati i aplikimit është data 06.09.2022 për audituesit e brendshëm dhe trajnerë. Përmes shkresës nr. 13881/1 Prot., datë 19.07.2022 MFE ka dërguar drejt Njësive të Auditimit të Brendshëm njoftimin për fillimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik për sezonin 2022-2023. Kalendarin e veprimtarisë së Komisionit të Kualifikimit është miratuar përmes Vendimit nr. 2 të Komisionit të Kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, datë 13.07.2022, ku programi konsiston në 6 module, planifikuar si proces i plotë në periudhën 18.07.2022 – 10.07.2023.

Lidhur me certifikimet, në Planin Vjetor të DH/AB është përcaktuar detyra e organizimit të procesit të certifikimit të kandidatëve për auditues të brendshëm për sezonin 2022-2023, planifikuar të zhvillohet në Janar 2022-Qershor 2023, me indikator realizimi 40 kandidatë të regjistruar si Auditues të Brendshëm në këtë sezon. Në Raportin Vjetor 2022 të DH/AB, rezulton se pas vlerësimit nga ana e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, 81 auditues të brendshëm në NJAB e sektorit publik u vlerësuan të plotësonin kriteret për ndjekjen e certifikimit.

Nga raportimi vjetor i DH/AB rezulton se aktualisht procesi i ndjekjes së trajnimeve vijon të kryhet i ndarë në katër grupe pjesëmarrësish me një frekuencë prej tre orë trajnimi në javë përmes platformës online. Deri në fund të vitit 2022 janë realizuar testimet për dy modulet e para dhe vijojnë trajnimet për pjesën e mbetur të moduleve. Në faqen zyrtare të MFE janë publikuar rezultatet për Modulet I-IV të këtij programi certifikimi.

Me Urdhrin nr. 176, datë 20.06.2022 “Për emërimin anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, janë emëruar anëtarët me mandat 2 vjeçar nga data e hyrjes në fuqi të Urdhrit:

1. A. Gj.;
2. R. Q.;
3. L. N.;
4. D. D.;
5. I. M.

Me Vendimin nr. 1, datë 07.07.2022 të Komisionit të Kualifikimit është bërë zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarit të Komisionit. Me Vendimin nr. 3, datë 19.07.2022 është kryer miratimi për njoftimin e NJAB për fillimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm, si dhe miratimi i njoftimit për fillimin e procesit të aplikimit për trajnerë të Trajnimit të Vijueshëm Profesional.

Përmes Vendimit nr. 4 të Komisionit të Kualifikimit, datë 21.09.2022 është miratuar lista paraprake e kandidatëve për auditues të brendshëm për sezonin 2022-2023 me 75 fitues, nga 110 kandidatë në tërësi.

Me Vendimin nr. 5 të Komisionit të Kualifikimit, datë 30.09.2022 është miratuar lista përfundimtare e kandidatëve pas shqyrtimit të ankimit të kandidatëve jofitues. Në tërësi, konstatohet se janë përzgjedhur 84 kandidatë dhe janë skualifikuar 26 të tjerë. Përmes të njëjtit Vendim, është miratuar lista paraprake e trajnerëve me 4 fitues.

KK përmes Vendimit nr. 6 të tij, datë 13.10.2022 ka miratuar listën përfundimtare të trajnerëve për certifikimin si dhe ka miratuar listën e trajnerëve dhe materialeve të procesit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional.

Me Vendimin nr. 7, datë 30.10.2022, Komisioni i Kualifikimit ka çregjistruar dy kandidatë nga lista përfundimtare e audituesve të përzgjedhur.

Ndërkohë, me Vendimin nr. 9, datë 02.12.2022, KK ka miratuar tezën për modulën e parë të certifikimit si dhe ka kryer sekretimin e fletoreve. Më pas, përmes Vendimit nr. 10, datë 16.12.2022 është kryer ç'sekretimi i fletoreve nga Komisioni.

Grupi i auditimit konstaton se nga publikimet e vitit 2022, Regjistri Kombëtar i Audituesve të Certifikuar i publikuar në faqen zyrtare të MFE nuk jep informacione të mjaftueshme në lidhje me statusin e audituesve: aktiv ose pasiv në kryerjen e funksionit të audituesit, duke sjellë si pasojë paraqitjen e të dhënave jo të plota për audituesit e certifikuar në vite.

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë nga DH/AB

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë nga DH/AB në NjAB i referohet nenit 24 të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", në Kapitullin VII të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të MF nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, si dhe në Metodologjinë e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, miratuar me Urdhër të MF nr. 22, datë 06.03.2017. Në metodologjinë e Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik citohet se "*Vlerësimi i brendshëm me vlefshmëri të jashtme do të kryhet nga struktura përgjegjëse e harmonizimit për auditimin e brendshëm, e cila harton regjistrin e vlerësimit të NJAB-ve me qëllim:*

- *Hartimin e programit vjetor të veprimtarisë së SPHAB-së;*
- *Respektimin e frekuencës së vlerësimit të jashtëm të cilësisë (të paktën 1 herë në 5 vjet);*
- *Identifikimin e njësive të auditimit me problematikë të shtuar;*
- *Ndjekjen dhe monitorimin e progresit të njësive të auditimit."*

Pra, në kërkesat standarde të auditimit përcaktohet se çdo NJAB duhet të vlerësohet nga jashtë të paktën një herë në 5 vite. Për më tepër, DH/AB ka si detyrë hartimin e regjistrit të vlerësimit të NJAB-ve me qëllim përmbushjen e aktiviteteve të sipërcituara.

Sipas Planit Vjetor të DH/AB të miratuar përmes shkresës nr. 23648 Prot., datë 31.12.2021, rezulton se për vitin 2022 janë parashikuar të kryhen 25 vlerësime të jashtme të cilësisë (VJC) në periudhën Janar-Dhjetor 2022, me objektiv zbatimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm nga NjAB. Përmes shkresës nr. 20967 Prot., datë 14.11.2022 është ndryshuar plani vjetor i VJC në sektorin publik për vitin 2022, ku është hequr VJC për Spitalin Rajonal Korçë dhe është shtuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, duke e lënë të njëjtë numrin e angazhimeve për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, në 25 të tilla. Nga krahasimi plan-fakt, konstatohet se janë realizuar në total 24 Vlerësime të Jashtme të Cilësisë,

ku paraqitet të mos jetë kryer VJC në Spitalin Rajonal Lushnjë, i parashikuar në datat 12-23 Dhjetor 2022.

Për vitin 2022 janë dhënë opinionet e mëposhtme që kanë rezultuar nga Vlerësimi i Jashtëm i Cilësisë për 24 subjekte (3 Institucione Qendrore, 5 Universitete, 2 Spitale Rajonale, 1 Shoqëri Aksionere dhe 13 Bashki):

- 10 opinione pjesërisht pozitive: veprimtaria e AB në disa fusha është në mospërputhje me kërkesat e SNA;
- 10 opinione thuajse negative: veprimtaria e AB në pjesën më të madhe është në mospërputhje të pjeshme me kërkesat e SNA, përmirësime të rëndësishme janë të nevojshme përputhshmëri e pjeshme;
- 3 opinione negative: veprimtaria e AB përgjithësisht në mospërputhje të plotë me kërkesat e SNA;
- 1 opinion pozitiv: veprimtaria e AB përgjithësisht në përputhje me kërkesat e SNA.

Specifikisht opinionet paraqiten si në tabelën nr. 13:

Tabela nr. 13: Opinionet e Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë, 2022

Vlerësimi	Mospërputhje e plotë	Përputhje në disa fusha	Përputhje e pjeshme	Përputhje e plotë
Subjektet	1. Spitali Rajonal Elbasan 2. Spitali Rajonal Fier 3. Bashkia Tepelenë	1. Ujësjiellës Kanalizime Durrës sha 2. Bashkia Kukës 3. Bashkia Malësi e Madhe 4. Bashkia Mirditë 5. Bashkia Selenicë 6. Bashkia Skrapar 7. Bashkia Memaliaj 8. Bashkia Prenjas 9. Bashkia Rrogozhinë 10. Bashkia Divjakë	1. Enti Kombëtar i Banesave 2. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit 3. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare 4. Universiteti i Tiranës 5. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 6. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 7. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 8. Bashkia Maliq 9. Bashkia Bulqizë 10. Bashkia Peqin	1. Universiteti Bujqësor i Tiranës

Burimi: Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, MFE.

Ndër gjetjet më të rëndësishme nga VJC për vitin 2022 nga DH/AB janë evidentuar si në vijim:

- Roli i auditimit të brendshëm nuk njihet mjaftueshëm nga titullari dhe për pasojë ekziston risku që auditimi i brendshëm nuk ka mbështetjen e mjaftueshme që duhet ti jepet për përmbushjen e misionit të tij;
- Në disa raste Karta e Auditimit duhet të përditësohet, si një dokument kryesor që përcakton statusin dhe përgjegjshmërinë e auditimit të brendshëm dhe siguron pavarësinë de juro të auditimit të brendshëm;
- Përshkrim jo i qartë dhe i mjaftueshëm mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve në Rregulloren e Brendshme, si pjesë integrale e njësisë publike;
- Njësia e auditimit të brendshëm nuk është krijuar sipas kërkesave të Ligjit për auditimin e brendshëm (ka më pak se 3 auditues staf) dhe vetë Drejtuesi apo audituesit nuk plotësojnë kriteret e punësimit referuar eksperiencës në auditim dhe kërkesës për certifikim;
- Burimet në dispozicion të strukturës audituese nuk janë të plota në numër dhe disa raste ka mungesë të përvojës së punës në auditim, duke mbartuar riskun e pamjaftueshmërisë së burimeve për arritjen e objektivave në sasi si dhe cënimin e cilësisë së auditimeve;

- Mos respektimi i plotësisë së informacionit që duhet të përmbajë Programi i Angazhim Auditimit, duke mos përfshirë të gjitha sistemet e nevojshme për t'u vlerësuar nga ana e audituesve të brendshëm;
- Mangësi në hartimin e pyetësorëve të vlerësimit të kontrollit të brendshëm dhe teste të pamjaftueshme për sistemet/fushat e përzgjedhura;
- Raportimi i rezultateve të auditimit nuk respekton parimet e raportimit në formë dhe disa herë në përmbajtje;
- Nuk respektohet lidhja organike gjetje, konkluzion e rekomandim, nuk trajtohen observacionet e subjektit, si dhe opinion për funksionimin e KB duhet të jetë më i qartë;
- Në disa raste mungon Plani i Veprimtë të dakortësuar me njësinë e audituar për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, si dhe tek Programet për sigurimin e brendshme të cilësisë dhe përmirësimin në disa raste mungojnë ose indikatorët e performancës nuk janë të përcaktuar me mangësi;
- Nuk është vendosur një sistem efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit, duke mos arritur deri në impaktin përfundimtar të auditimit.

Rekomandimet kryesore të lëna nga DH/AB përgjatë vitit 2022 janë:

- Përditësimi i Dokumenteve bazë të auditimit, Karta e Auditimit e të tjera të nevojshme sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe të sigurohet aplikimi i tyre në praktikën e punës audituese;
- Qartësimi i rolit, funksionit, detyrave dhe përgjegjësi të auditimit të brendshëm në Rregulloren e Brendshme të njësisë publike si dhe përcaktimi i qartë i linjave të komunikimit duke respektuar Kodin e Etikës për shmangien e konfliktit të interesit;
- Programi i angazhimeve të auditimit të kryhet mbi bazën e një analize reale të vlerësimit të riskut dhe të adresojë të gjitha sistemet dhe fushat sipas prioritarizimit të riskut që këto sisteme paraqesin;
- Çdo NJAB duhet të hartojë, miratojë dhe të mbajë të përditësuar Programin e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë , i cili zbatohet për çdo angazhim auditimi mbi bazën e indikatorëve të matjes së cilësisë së performancës;
- NJAB të dokumentojë procesin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve, si dhe komunikimin me subjektin e audituar, lidhur me marrjen e informacionit mbi progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve, duke e përfshirë këtë monitorim dhe në raportin vjetor të veprimtarisë së tij;.

Nga shqyrtimi i 6 dosjeve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë (përzgjedhur nga grupi i auditimit me kampionim të rastësishëm) në subjektet:

1. Universiteti i Tiranës;
2. Ujësjetës Kanalizime sh.a. Durrës;
3. Spitali Rajonal Elbasan;
4. Universiteti Bujqësor i Tiranës;
5. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit;
6. Bashkia Tepelenë;

rezulton se këto vlerësime i janë referuar germës *dh* të nenit 24, të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2017, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 06.03.2017, “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik” dhe Planit Vjetor të punës në DH/AB për vitin 2022, miratuar nga Ministri i MFE me shkresën nr. 23648 Prot., datë 31.12.2021.

Në dosjet e shqyrtuar janë administruar Autorizimet për fillimin dhe përgatitjen e vlerësimit të jashtëm të cilësisë në NjAB përkatëse, si dhe janë firmosur ndarja e detyrave, Deklaratat e Pavarësisë nga audituesit dhe Deklaratat e Konfliktit të Interesave. Secili prej subjekteve është njoftuar përmes një shkrese zyrtare e cila përmban dhe datën e fillimit të

VJC. Për secilin nga subjektet është miratuar Programi i Auditimit i cili përmban: objektin e vlerësimit, metodën e vlerësimit, periudhën e vlerësimit, kohën e kryerjes së vlerësimit, grupin e punës, si dhe drejtimit e vlerësimit.

Sa i takon opinionit të përgjithshëm të grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e DAB në UT me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm të pranuar, bazuar në vlerësimin e kritereve kryesore ISSPA (ISSPA 1100, ISSPA 1200, ISSPA 2000, ISSPA 2200, ISSPA 2300) dhe dytësore, paraqiten si në vijim:

- Universiteti i Tiranës: *përputhshmëri e pjesshme me standardet ndërkombëtare;*
- Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a: *përputhshmëri në disa fusha me kuadrin rregullator;*
- Spitali Rajonal Elbasan: *mospërputhje e plotë me kuadrin rregullator;*
- Universiteti Bujqësor i Tiranës: *përputhshmëri e plotë me kuadrin rregullator;*
- Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit: *përputhshmëri e pjesshme me kuadrin rregullator;*
- Bashkia Tepelenë: *mospërputhje e plotë me kuadrin rregullator.*

Lidhur me Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga DH/AB konstatohet se subjektet e mësipërme e kanë dërguar atë drejt DH/AB brenda afatit 30 ditor, përveç Universitetit të Tiranës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, të cilët e kanë tejkaluar këtë afat.

Pyetësi i vetëvlerësimit të NJAB

Pyetësi i vetëvlerësimit për vitin 2022 është plotësuar nga 125 NJAB (nga 136 NJAB që kanë raportuar). Nga 136 NJAB që kanë detyrimin për të raportuar veprimtarinë e tyre pranë DH/AB:

- 2 njësi publike megjithëse e kanë të miratuar strukturën e NJAB nuk e kanë të plotësuar me stafin auditues (Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile) dhe për këtë arsye nuk kanë dërguar raport për vitin 2022.
- 1 njësi publike nuk ka dërguar raportin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2022 (Spitali Rajonal Gjirokastrë).

Krahas këtyre rasteve ka institucione të cilat në Raportin Vjetor të Veprimtarisë kanë të përfshirë Pyetësorë të vjetër, ku përfshihen: Spitali Rajonal Kukës.

Në këtë kuadër janë evidentuar 7 njësi auditimi pa veprimtari: Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Spitali Rajonal Elbasan, Spitali Rajonal Korçë, Bashkia Has (auditues të brendshëm të emëruar në muajt e fundit të vitit), Bashkia Librazhd (auditues të brendshëm dalë në pension), Spitali Lushnjë dhe Gjykata Kushtetuese (auditues të brendshëm me leje lindjeje).

Nga analiza në tërësi e “Pyetësorit të vetëvlerësimit”, konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e NJAB nuk kanë qenë të qarta dhe koncize në përgjigjet e tyre. Të dhënat tregojnë që përgjigjet e dhëna nuk janë plotësisht në përputhje me të dhënat reale, të cilat janë konsoliduar nga të dhënat e raporteve vjetore të veprimtarisë së NJAB.

Pyetësi i vetëvlerësimit përmban pyetje për të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe analiza për vitin 2022 paraqitet e ndarë në 4 grupime kryesore.

I. Funksionimi i NJAB sipas akteve ligjore

Nga analiza e të dhënave të pyetësorëve të vetëvlerësimit, sa i përket kuadrin ligjor (paraqitur në tabelën nr. 20) rezulton se vetëm 78% e NJAB janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Për më tepër, në 80% të NJAB ka komunikim të rregullt me me titullarin dhe është e pavarur nga ana funksionale.

Tabela nr. 14: Përputhshmëria e NJAB me kuadrin ligjor, 2022

	NJAB në përputhje të plotë	NJAB në përputhje të pjesshme	NJAB në përputhje në disa	NJAB në mospërputhje të plotë

			fusha	
NjAB krijuar në përputhje me kërkesat ligjore	78%	18%	2%	2%
NjAB është e pavarur nga ana funksionale dhe komunikon periodikisht me titullarin	80%	17%	1%	2%
Audituesit e Brendshëm janë të përfshirë në veprimtari operacionale	91%	7%	0%	2%
Objektivat e NjAB janë në përputhje me objektivat e Njesisë Publike	87%	13%	0%	0%

Burimi: DH/AB në MFE.

Nga të dhënat e konsoliduara të pyetësorëve, rezulton se në 91% të NJAB audituesit e brendshëm nuk përfshihen në veprimtari operacionale. Pjesa tjetër 9% e tyre rezulton në kundërshtim me kriteret ligjore, ku në to vihet re përfshirje e audituesve të brendshëm në veprimtari operacionale.

Objektivat e NJAB gjithnjë duhet të jenë në përputhje me objektivat e njesisë publike. Nga analiza e të dhënave, vihet re se 87% e NJAB i kanë objektivat e tyre në përputhje me objektivat e njësive publike në të cilat ato operojnë.

II. Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhim i risqeve nga NJAB

Nga analiza e përgjigjeve të NJAB në pyetësorët e dorëzuar në MFE, rezulton që 66% e tyre e bazojnë planin e auditimit plotësisht në vlerësimin e riskut të veprimtarisë së njesisë publike. Vetëm 57% e NJAB kanë vlerësuar drejt risqet e lidhura me objektivat e njesisë publike, kurse 37% e NJAB kanë nevojë për përmirësime në këtë vlerësim. Nga të dhënat e analizuar vetëm 53% e NJAB e përmbushin kriterin e kontributit në hartimin e regjistrit të riskut. Për më tepër, 80% e NJAB vlerësojnë funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe 19% e vlerësojnë pjesërisht, duke mos përmbushur detyrimin ligjor.

Tabela nr. 15: Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i risqeve nga NJAB, 2022

	NJAB në përputhje të plotë	NJAB në përputhje të pjesshme	NJAB në përputhje në disa fusha	NJAB në mospërputhje të plotë
AB përdorin metodologji dhe marrin opinionin e titullarit në identifikimin e risqeve	66%	30%	4%	0%
Risqet e lidhura me objektivat e njesisë publike janë vlerësuar drejt nga AB	57%	37%	6%	0%
NJAB kontribuon në hartimin e regjistrit të riskut të njesisë publike	53%	36%	10%	1%
Veprimtaria e AB përfshin vlerësimin e sistemit të KB dhe nivelin e riskut	80%	19%	1%	0%

Burimi: DH/AB në MFE.

III. Vendosja e kontrolleve efektive dhe monitorimi i rekomandimeve

Nga analiza e pyetësorëve, 65% e NJAB e vlerësojnë përshtatshmërinë e kontrolleve të vendosura, kurse 32% e tyre i vlerësojnë ato pjesërisht. Në lidhje me monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna rezulton që vetëm 80% të NJAB i monitorojnë në vazhdimësi këtë komponent dhe 19% e NJAB i monitorojnë ato pjesërisht. 87% të drejtuesve të NJAB paraqesin analizën vjetore të veprimtarisë në KAB dhe tek titullari i njesisë publike. Manuali i auditimit të brendshëm ka një procedurë të qartë në lidhje me raportimin e angazhimit të auditimit dhe vihet re se 13% e NJAB e realizojnë pjesërisht këtë kërkesë të Manualit.

Tabela nr. 16: Vlerësimi për kontrollet e vendosura dhe funksionimi i tyre, 2022

	NJAB në përputhje të plotë	NJAB në përputhje të pjesshme	NJAB në përputhje në disa fusha	NJAB në mospërputhje të plotë
AB identifikojnë kontrollet që minimizojnë risqet dhe vlerësojnë përshtashmërinë e kontrolleve.	65%	32%	3%	0%
NJAB monitoron zbatimin e rekomandimeve	80%	19%	1%	0%
Drejtuesi i NJAB paraqet analizën vjetore të veprimtarisë tek KAB dhe titullari	87%	12%	0%	1%

Burimi: DH/AB në MFE.

IV. Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese

Në lidhje me Programin e Sigurimit të Cilësisë vetëm 58% të NJAB rezultojnë të kenë hartuar, miratuar dhe zbatuar këtë program dhe 30% e NJAB e kanë zbatuar pjesërisht këtë program. Në lidhje rishikimin e brendshëm të cilësisë nga ana e drejtuesve të NJAB rezulton se vetëm 61% e tyre realizojnë këtë proces në përputhje me standardet. Në këtë tregues evidentohet se 8% e NJAB nuk e realizojnë fare këtë proces për shkak të strukturave të cunguara dhe jashtë kriterëve (me 1 ose 2 auditues).

Në 63% të NJAB rekomandimet e rishikimit të brendshëm të cilësisë merren në konsideratë nga audituesit. Në këtë element evidentohet se 4% e tyre nuk bien dakord me rekomandimet e dhëna nga ana e rishikuesve.

Tabela nr. 17: Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese të NJAB, 2022

	NJAB në përputhje të plotë	NJAB në përputhje të pjesshme	NJAB në përputhje në disa fusha	NJAB në mospërputhje të plotë
NJAB ka Program të Sigurimit të Cilësisë	58%	30%	6%	6%
Rishikimi i brendshëm i cilësisë kryhet nga Drejtuesi i NJAB.	61%	28%	3%	8%
Rekomandimet e rishikimit të brendshëm të cilësisë merren në konsideratë për përmirësimin e punës së NJAB	63%	29%	4%	4%

Burimi: DH/AB në MFE

Në lidhje me problematikat e konstatuara në këtë analizë, DH/AB në Raportin Vjetor 2022 ka theksuar se do të ketë një nga prioritetet e saj ndërgjegjësimin dhe koordinimin më të madh të informacionit me NJAB për mirëfunksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në përafrim të plotë me standardet ndërkombëtare.

Vlerësimi i indikatorëve që tregojnë nivelin e zbatimit të objektivave në përmbushje të strategjisë për auditimin e brendshëm në sektorin publik

Sa i takon vlerësimin të indikatorëve në lidhje me zbatimin e objektivave në përmbushje të strategjisë për auditimin e brendshëm në sektorin publik, rezulton se në Raportin Vjetor të KBFP 2022, nuk është paraqitur një vlerësim lidhur me këto katër indikatorë, edhe pse Raporti citon se Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPH/KBFP) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit ka analizuar 18 tregues të performancës ku përfshihen:

- Indikator 15 “Organizimi dhe kapacitetet e AB”;
- Indikator 16 “Cilësia e përgatitjes së planifikimit strategjik dhe vjetor nga NJAB-të”;
- Indikator 17 “Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor”;

- Indikatori 18 “Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm”.

Indikatori 15 përbëhet nga nëntreguesit:

- Njësia publike realizon shërbimin e AB;
- NJAB është krijuar në përputhje me kërkesat ligjore;
- NJAB dhe AB plotësojnë kërkesat ligjore;
- AB trajnohen në përputhje me kërkesat ligjore (TVP).

Indikatori 16 përbëhet nga nëntreguesit:

- Plani strategjik dhe vjetor i përmbahet strukturës së përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe është paraqitur në afatet e përcaktuara në DH/AB
- Plani strategjik dhe vjetor është përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore (përfaqëson një univers gjithëpërfshirës dhe miratohet nga titullari)
- Plani strategjik dhe vjetor është bazuar në vlerësimin e riskut që mbulon të gjitha sistemet e njësisë;
- Plani strategjik dhe vjetor ka parashikuar lloje të ndryshme auditimi (përputhshmërie, të kombinuar, performance, të fondeve të BE (nëse ka), etj.

Indikatori 17 përbëhet nga nëntreguesit:

- Raporti sipas strukturës së përcaktuar në MAB dhe është paraqitur në afat në DH/AB
- Raporti përfshin analizën e gjetjeve dhe rekomandimeve të AB;
- Raporti përfshin vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Raporti evidenton dobësitë dhe përcakton prioritetet të qarta për të ardhmen.

Indikatori 18 përbëhet nga treguesi: shkalla e zbatimit të rekomandimeve të AB.

Për indikatorët e mësipërm, DH/AB ka vënë në dispozicion informacion mbi vlerësimin (0-4) për secilin prej indikatorëve, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në vijim.

Tabela nr. 24: Vlerësimi i indikatorëve nga DH/AB për vitin 2022

<i>Indikatori 15 “Organizimi dhe kapacitetet e AB”</i>	
0 pikë	2
1 pikë	2
2 pikë	9
3 pikë	49
4 pikë	74
<i>Indikatori 16 “Cilësia e përgatitjes së planifikimit strategjik dhe vjetor nga NJAB-të”</i>	
0 pikë	3
2-2.5 pikë	5
3-3.5 pikë	73
4 pikë	52
<i>Indikatori 17 “Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor”</i>	
0 - 0.5 pikë	10
1 - 1.5 pikë	6
2 - 2.5 pikë	6
3 - 3.5 pikë	16
4 pikë	96
<i>Indikatori 18 “Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm”</i>	
0 pikë	34
1 pikë	34
2 pikë	16
3 pikë	19
4 pikë	30

Burimi: DH/AB në MFE.

Nga 191 njësi të paraqitura në databazën e mbajtur nga DH/AB rezulton se në total për të katërt treguesit (pikë maksimale 16 në total): 31 njësi rezultojnë me 0 pikë, prej të cilave 9

Bashki janë pa shërbim dhe 28 njësi rezultojnë me pikë maksimale 16 pikë, detajuar në tabelën nr. 25.

Tabela nr. 25: Të dhëna mbi vlerësimin e njërive bazuar në indikatorët e DH/AB

Vlerësimi	0-4 pikë	4.5-9 pikë	9.5-15 pikë	15.5 pikë	16 pikë
Nr. i njërive	33	13	116	1	28

Burimi: Të dhënat nga DH/AB në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Rezulton se në total, 33 njësi paraqiten me 0-4 pikë (ku përfshihen dhe 9 bashki pa shërbim) duke paraqitur një performancë të ulët për shkak të mosfunksionimit të NJAB-ve. Ndërkohë, 28 njësi paraqiten në performancë optimale me 16 pikë në total nga vlerësimi i të katërt treguesve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, subjekti nuk ka paraqitur observacione.

2.G. Çështje të tjera që dalin gjatë auditimit.

2.G.1. Mbi vlerësimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për auditimin e kësaj çështje të programit të auditimit është shqyrtuar dokumentacioni i mëposhtëm:

- Urdhri nr. 22, datë 06.03.2017 i Ministrit të Financave për “Miratimin e Metodologjisë për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”;
- Urdhri nr. 86, datë 10.12.2015 i Ministrit të Financave “Për miratimin e Kodit të etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik”;
- Karta e Auditimit e miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 11, datë 06.02.2017 “Për miratimin e kartës së Auditimit”;
- Urdhri i Ministrit të Financave nr. 14 datë, 13.02.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm”;
- Urdhri i Ministrit të Financave nr. 98, datë 21.09.2017 “Për sigurimin e brendshëm të cilësisë së njësisë së auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”;
- Plani Strategjik 2022-2024 dhe Plani Vjetor 2022 (së bashku me pasqyrat përkatëse pjesës integrale të Planit) i Drejtorisë së Auditimit miratuar përmes Urdhrit nr. 172, datë 05.10.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë;
- Raporti Vjetor 2022 i Drejtorisë së Auditimit;
- Dosje auditimi të Drejtorisë së Auditimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi ka rezultuar:

Veprimtaria e Drejtorisë së Auditimit në MFE (DA) i është referuar Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar, Udhërrëfyesin e Auditimit të Brendshëm të Sistemit Financiar Publik”, etj., specifikuar si më poshtë:

- VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 160, datë 02.03.2016 “Për Mënyrën e Funkcionimit, Kompetencat dhe Përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në Njësitë Publike”;
- Manualin e auditimit të brendshëm, Miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 për “Miratimin e manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar;
- Standardet Ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, të publikuara me urdhër të Ministrit të Financave nr. 40, datë 08.05.2017 për “Publikimin e

standardeve ndërkombëtare për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm në sektorin publik, të pranuar për zbatim në Republikën e Shqipërisë”;

- Urdhrin nr. 22, datë 06.03.2017 të Ministrit të Financave për “Miratimin e Metodologjisë për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”;
- Urdhrin nr. 86, datë 10.12.2015, të Ministrit të Financave “Për miratimin e Kodit të etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik”;
- Metodologjia për vlerësimin e jashtëm të cilësisë “Për veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik”;
- Kartën e Auditimit e miratuar më urdhrin e Ministrit të Financave nr. 11, datë 06.02.2017 “Për miratimin e kartës së Auditimit”;
- Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 14 datë, 13.02.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm”;
- Urdhrin e ministrit të Financave nr. 98, datë 21.09.2017 “Për sigurimin e brendshëm të cilësisë së njësisë së auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”;
- Udhërrëfyesin e Auditimit të Brendshëm të Sistemit Financiar Publik.

Drejtorja e Auditimit, në funksion të arritjes së objektivave të MFE-së dhe arritjeve në fushën e përgjegjësisë së saj, ka përcaktuar si objektiva strategjike për periudhën 2022-2024:

- Realizimin e auditimeve bazuar në rrezik;
- Përcaktimin nëse kontrollet janë adekuate;
- Sugjerimin e përmirësimeve për të ritur efikasitetin dhe eficientë, si dhe ulur kostot e funksionimit;
- Mbështetjen për përmirësime dhe inovacione;
- Zhvillimin e kompetencës së stafit të auditimit.

Kapacitetet audituese të Drejtorisë së Auditimit

Drejtorja e Auditimit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është autoriteti ligjor i krijuar sipas ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të AB në sektorin publik”, i ndryshuar.

Organizimi i drejtorisë është në nivel drejtorie dhe në varësi direkte nga Ministri. DAB ka në përbërje të strukturës së saj Drejtorin e Drejtorisë dhe 3 sektorë, pra 10 punonjës në total:

- Sektori i Auditimit të Sigurisë (1+2)
- Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit & Raportimit (1+2)
- Sektori Auditimit të Fondeve të BE (1+2)

Për vitin 2022, struktura e DA rezulton me 7 vende të plotësuara dhe 3 vende vakante duke vepruar jo në përputhje me strukturën organike të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 89, datë 13.06.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.

Kapacitetet e punonjësve të DA rezultojnë si në vijim: 6 prej tyre kanë formim ekonomik dhe 1 ka formim ekonomik-juridik. Të gjithë punonjësit janë të pajisur me certifikimin “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” dhe kanë përvojë pune mbi 5 vite në auditimin e brendshëm, specifikisht 5 prej tyre kanë mbi 15 vite eksperiencë në profesion dhe 2 prej tyre mbi 6 vite eksperiencë në profesion. Sa i përket trajnimit të tyre, konstatohet se stafi ka ndjekur trajnim të vijueshëm dhe një pjesë e stafit ka kryer trajnime dhe në fushën e auditimit të fondeve të BE si dhe në fusha të tjera si:

- Trajnimin e vijueshëm të organizuar nga NJQH/AB – 7 punonjës;
- Trajnim nga DSIK me temë “Siguria e informacionit & materialeve të klasifikuara, shkeljet dhe incidentet e sigurisë” – 6 punonjës;

- Trajnim ASPA, me temë “Auditimi i fondeve të BE” – 2 punonjës.

Karta e Auditimit

Nga auditimi konstatohet se nga ana e DA është hartuar Karta e Auditimit, miratuar me Urdhrin nr. 11, datë 06.02.2017 të Ministrit të Financave, referuar Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 14, germa b e të cilit citon se “Drejtuuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për hartimin e Kartës së Auditimit, akteve të tjera specifike në fusha të veçanta të auditimit të brendshëm, në zbatim të këtij ligji dhe akteve të tjera në zbatim të tij, si dhe dërgimin e tyre për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësisë publike.”

Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Titulli i Gjetjes	Mungesë e funksionimit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm
Situata	Nga auditimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm konstatohet se Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka funksionuar në MFE dhe nuk janë emëruar anëtarët e tij, që pas mbarimit të mandatit të anëtarëve në vitin 2021. Në Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 12 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike”, germa b, si dhe VKM-së nr. 160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike” përcaktohet funksionimi i këtij Komiteti. Komiteti i Auditimit ka si kompetencë shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimeve për ndryshimin e planit vjetor, gjatë vitit; në monitorimin, nëpërmjet raporteve të auditimit të brendshëm të efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm të MFE; monitorimin e performancës së njësisë së auditimit të brendshëm; këshillimin e Titullarit të Institucionit për mjaftueshmërinë në numër, të burimeve të njësisë së auditimit të brendshëm për realizimin e planit të auditimit; analizimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit të brendshëm, me qëllim informimin për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në MFE; njësitë e varësisë së MFE, në të cilën mbulon veprimtarinë e auditimit të brendshëm.
Kriteri	- Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; - VKM nr. 160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike”.
Ndikimi	Mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm ka sjellë moskryerjen e kompetencave dhe detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015.
Shkaku	Mosmarrje e veprimeve për emërimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit pas përfundimit të mandatit të anëtarëve në vitin 2021.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për emërimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm, me qëllim funksionimin dhe kryerjen e kompetencave të tij.

Planifikimi Vjetor 2022 i DA

Sa i përket veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit (DA) në Aparatin e MFE, konstatohet se nga ana e DAB është përgatitur Plani Strategjik 2022-2024 dhe Plani Vjetor 2022, miratuar përmes Urdhrit nr. 172, datë 05.10.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Përgjatë vitit 2021, disa shoqëri aksionere janë bashkuar/përthithur me shoqëri të tjera dhe institucione qendrore që kanë ndryshuar varësinë; lëvizje të cilat kanë ndryshuar numrin e subjekteve objekt auditimi nga 178 në 152 subjekte në total për vitin 2022.

Në procesin e planifikimit për vitin 2022 janë vlerësuar me risk të lartë fushat:

- Sistemi i politikave të punësimit, migracionit & arsimit profesional;
- Sistemi i borxhit publik/huamarrja;
- Sistemi i menaxhimit dhe monitorimit të thesarit;
- Veprimtaria në fushën e strehimit publik;
- Veprimtaria e apelimit tatimor;
- Veprimtaria e menaxhimit të reformës së financave publike;
- Pajtueshmëria në menaxhimin e fondeve të BE-së;
- Veprimtaria e Inspektoriateve të Punës, shkollave profesionale & shoqërive aksionere;
- Veprimtaria e Shkollës së Magjistraturës, QTATD-së, Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit, etj.

Për vitin 2022 janë planifikuar të zhvillohen auditime të ndara në 3 grupe:

1. Auditime që bazohen në vlerësimin e riskut;
2. Auditime të mandatuara;
3. Auditime që kërkohen nga menaxhimi i lartë edhe pse nuk janë të përfshira në planin vjetor.

Për grupimin e parë të auditimeve, janë evidentuar risqet më të larta:

- *Risku i sistemit të kontrollit të brendshëm;*
- *Rreziqe të sistemit të menaxhimit të buxhetit, nga faktorët e ndryshimit të mjedisit të sistemit të kontrollit të brendshëm të ndodhura gjatë vitit ushtrimor;*
- *Rreziqe të sistemit të operacioneve të thesarit si dhe pagesave të ish të përndjekurve politik, që vlerësohen nga faktorë të ndryshimeve në mjedisin e sistemit të kontrollit të brendshëm, kryerjes së transaksioneve në numër të lartë, si dhe atyre në shuma të mëdha nga paratë publike.*

Për më tepër, DA ka vlerësuar dhe risqe që lidhen me aktivitetin e auditimit të cilat janë:

- Risqe që shkaktohen nga ristrukturimi i institucionit dhe lëvizjet e stafit;
- Risqe që shkaktohen nga burimet njerëzore të auditimit;
- Risqe që shkaktohen nga krijimi i kushteve të punës;
- Risqe që vijnë nga moszbatimi i Manualit të auditimit, Kodit të Etikës, Kartës së Auditimit, etj;
- Risqe që vijnë nga marrëdhëniet me palët e audituara;
- Risqe që shkaktohen nga situata e pandemisë në vend.

Për vitin 2022 niveli i vlerësimit të riskut për 152 subjektet paraqitet në tabelën nr. 1. Në total, 26 subjekte janë vlerësuar me risk të lartë, 52 subjekte me risk të mesëm dhe 74 subjekte me risk të ulët. Në krahasim me vitin 2021, konstatohet një rënie e subjekteve të vlerësuara me risk të lartë, rënie e subjekteve të vlerësuara me risk të mesëm dhe rritje e subjekteve të vlerësuara me risk të lartë (të gjitha këto në përqindje në raport me numrin përkatës të subjekteve sipas viteve).

Tabela nr. 1: Vlerësimi i riskut për subjektet nga DA gjatë planifikimit

	Vlerësimi i riskut	I lartë	I mesëm	I ulët	Total
2022	Nr. subjektsh	26	52	74	152
	Në %	17.11%	34.21%	48.68%	
2021	Nr. subjektsh	30	116	24	170
	Në %	17.65%	68.24%	14.12%	

Burimi: Të dhënat nga DA në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Planifikimi dhe përlogaritja e treguesve janë kryer me supozimin se DA ka 10 auditues në strukturë. Përgjatë vitit 2021 (3 vende vakante) dhe 2022 (3 vende vakante), struktura e DA ka qenë e paplotësuar.

Në Planin Vjetor për vitin 2022 janë planifikuar 32 angazhime auditimi dhe auditim për verifikim zbatim rekomandimesh. Mesatarisht për vitin 2022 janë planifikuar mesatarisht

burime njerëzore 63 ditë/njerëz. Për 10 subjektet për të cilat nuk paraqiten informacion mbi auditimin e fundit, janë subjekte të cilat i janë bashkuar MFE në vitin 2017. Ndërkohë planifikimi i kostos për vitin 2022 paraqitet në vlerën 2,350 mijë lekë/auditues.

Realizimi i Planit Vjetor 2022

Përgjatë vitit 2022, nga DA nuk ka patur ndryshime në planifikim. Nga auditimet e planifikuara për vitin 2022 nuk janë realizuar auditimet në:

a) Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e brendshëm (*për arsye mbivendosje me KLSH*);

b) Degën e shoqërive publike Kukës (*pasi struktura ishte vakante dhe nuk kishte staf*).

Gjatë vitit 2022 janë kryer dhe dy auditime të reja me marrëveshje bashkëpunimi, përkatësisht për subjektet:

1. KMSHC;
2. Shkolla e Magjistraturës.

Pra në total, për vitin 2022 janë realizuar 32 misione auditimi konkretisht:

- 29 misione janë nga të planifikuarat (1 është në proces evadimi);
- 2 misione janë kryer me marrëveshje bashkëpunimi (auditime për vlerësimin e sistemit, përputshmërie dhe financiar);
- 1 mision ka filluar në vitin 2021 dhe është evaduar dhe raportuar në vitin 2022 (Bashkia Përmet).

Në fund të vitit janë kryer 30 qyryje zbatim rekomandimesh. Realizimi i misioneve të auditimit paraqitet në tabelën nr. 2, ku evidentohen auditimet e përfunduara, ato në proces, auditimet e kryera nga plani i vitit 2022 si dhe auditimet e mbartura nga viti 2021.

Tabela nr. 2: Realizimi i angazhimeve të auditimit, 2022

Nr.	Subjekti i audituar	Total	Shërbime të Sigurisë						Shërbim Këshillimi Me kërkesë Titullari	Përfunduar	Në proces
			A. Përputhsh	A. Perform	A. Financi	A. të TI	A. Sistemesh	A. kombinuara			
Mbartur nga viti 2021											
1	Dega e Thesarit Përmet	1								1	
Viti 2022											
1	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit										
	Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Arsimit Profesional	1							1	1	
2	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit										
	Drejtoria e Strehimit	1							1	1	
3	Drejtoria e Borxhit Publik dhe bashkërendimit të ndihmës së huaj										
	Drejtoria e Huamarrjes	1							1	1	
4	Drejtoria e Përgjithshme rregullatore dhe Përputhshmërisë										
	Drejtoria e Kocensioneve	1							1	1	
5	Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse										
	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar	1							1	1	

6	Drejtoria e Fondit Kombëtar	1						1			1	
7	Zyra Mbështetëse ZKA (drejtoria)	1						1			1	
8	Drejtoria e Apelit Tatimor	1						1			1	
9	Drejtoria e Menaxhimit të Reformës së Financave Publike	1						1			1	
10	Dr. Përgjithsh e financ.&Kontrakt. CFCU	1						1			1	
11	QTATD	1						1			1	
12	Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit	1						1			1	
13	ISHPSHSH, Rajoni IV - Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH, Korçë	1						1			1	
	Spektori i Inspektimit Elbasan											
	Spektori i Inspektimit Korçë											
14	ISHPSHSH, Rajoni V - Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH, Shkodër	1						1			1	
	Spektori i Inspektimit Lezhë											
	Spektori i Inspektimit Shkodër											
	<i>Degë Thesari në rrethe</i>											
15	Dega e Thesarit Berat	1						1			1	
16	Dega e Thesarit Delvinë	1						1			1	
17	Dega e Thesarit Devoll	1						1			1	
18	Dega e Thesarit Dibër	1						1			1	
19	Dega e Thesarit Gjirokastër	1						1			1	
20	Dega e Thesarit Kuçovë	1						1			1	
21	Dega e Thesarit Kolonjë	1						1			1	
22	Dega e Thesarit Peqin	1						1				1
23	Dega e Thesarit Tepelenë	1						1			1	
24	Dega e Thesarit Vlorë	1						1			1	
	<i>Degë Shoqëri Publike</i>											
25	Dega e Shoqërive Publike Berat	1						1			1	
	<i>Shkolla Profesionale</i>											
26	Shkolla "Teknike Ekonomike" Tiranë	1						1			1	
27	Shkolla Teknologjike "H. Bushati" Shkodër	1						1			1	
28	Shkolla Hotel Turizmit "A.Athanas" Sarandë	1						1			1	
	<i>Shoqëri Aksionare varësi e MFE</i>											
29	Sh.A Shtypshkronja e Letrave me Vlerë	1						1			1	
30	Sh.A "Tregu i shitjes me shumicë Fruta-Perim" Shkodër	1						1			1	
	<i>Marrëveshje auditimi</i>											
31	KMSHC	1						1			1	
32	Shkolla e Magjistraturës	1						1			1	
	Total	33	0	0	0	0	0	32	0	0	32	1

Burimi: Drejtoria e Auditimit, MFE.

Gjetje dhe rekomandimet e auditimeve të DA për vitin 2022

Në kuadër të auditimeve të kryera përgjatë vitit 2022, DA ka evidentuar gjetjet detajuar në numër sipas sistemit. Gjetjet e identifikuar gjatë vitit (pa efekte financiare) janë të sistemeve sa vijon:

- Sistemi i kontrollit të brendshëm;
- Sistemi i punësimit, migracionit dhe arsimit profesional;
- Sistemi i strehimit;
- Sistemi i prokurimeve, blerjeve dhe investimeve, etj.

Nga analiza e të dhënave rezulton se subjektet me më shumë gjetje/problematika sipas sistemeve paraqiten:

- Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Arsimit Profesional (21 gjetje);
- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar (13 gjetje);
- Drejtoria e Fondit Kombëtar (10 gjetje); dhe
- Shoqëria Aksionare “Tregu i shitjes me shumicë Fruta-Perime”, Shkodër (10 gjetje).

Pjesa më e madhe e gjetjeve për 4 subjektet e sipërcituara janë gjetje “Të tjera/në sistemin e Kontrollit të Brendshëm”.

Ndërkohë, përsa i takon gjetjeve në vlerë, paraqiten 3 subjekte ku është gjetur dëm në vlerë monetare si në tabelën nr. 3 me vlerat përkatëse:

- Shoqëria Aksionare “Tregu i shitjes me shumicë Fruta-Perime”, Shkodër (në vlerë 7,432 mijë lekë);
- Drejtoria e Fondit Kombëtar (në vlerë 273,579 mijë lekë);
- Shoqëria Aksionare “Shypshkronja e Letrave me Vlerë” (në vlerë 108,987 mijë lekë).

Sipas fushave, gjetjet për vitin 2022 janë në vlerën total 389,998 mijë lekë për këto tri subjekte nga të cilat:

- vlera 125 mijë lekë është konstatuar si shkelje e disiplinës financiare për gjoba dhe penalitete të pa arkëtura;
- vlera prej 108 mijë lekë të konstatuara si të ardhura të pa deklaruara;
- vlera prej 5,054 mijë lekë me efekte financiare rezulton vlerë e lëndë të parë dhe materiale (të mbartur prej vitesh pa historik krijimi) që nuk ekzistojnë fizikisht;
- vlera prej 5,841 mijë lekë janë debitore pa shpresë arkëtimi;
- vlera 679 mijë lekë është konstatuar si përfitim i padrejtë pagese;
- vlera prej 104,612 mijë lekë është konstatuar si rritje e detyrimeve debitore;
- vlera prej 273,579 mijë lekë (ose 252,355 euro) rikuperim financiar nga Komisioni Europian.

Tabela nr. 3: Gjetjet në vlerë nga auditimet e DA për vitin 2022

Në mijë lekë

Nr.	Subjekte të audituara	Prokurim, blerje & inv	Paga, shpërbime, trajtime, komisione, penalitete	Fondet e sig.shoq, sig.shëndetësore, përkuqdesje shoqërore	Tatime, taksa, dogana	Administrim prone, pasurie/asete	Privatizime, shitje, qiradhënie	Koncesione, ankande	Legalizime, Urbanistikë, kthim pronash	Kreditim, subvencione	Të tjera/KB	Shuma
1	Sh.A. Shtypshkronja e Letrave me Vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	108,987	108,987
2	Sh.A “Tregu i shitjes me shumicë Fruta-Perime” Shkodër	-	679	-	-	-	-	-	-	-	6,753	7,432
3	Drejtoria e Fondit Kombëtar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	273,579	273,579
Total		-	679	-	-	-	-	-	-	-	389,319	389,998

Burimi: Drejtoria e Auditimit, MFE.

Rekomandimet e lëna nga DA dhe zbatimi i tyre nga subjektet e audituara

Gjatë vitit 2022 janë lënë gjithsej 164 rekomandime në 33 auditime (përfshirë këtu dhe rekomandimet e auditimit të filluar në vitin 2021 dhe evaduar në vitin 2022). Rezulton se nga subjektet e audituara janë pranuar 162 rekomandime nga 164 që janë dhënë gjithsej, pra 98.78% e tyre, ku statusi i tyre paraqitet:

- 82 rekomandime të realizuara;

- 55 rekomandime në proces realizimi;
- 3 rekomandime nuk janë zbatuar;
- 22 rekomandime janë në afat për tu kryer verifikimi i zbatimit të tyre;
- 2 rekomandime nuk janë pranuar (nga subjektet: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Fondit Kombëtar).

Tabela nr. 4: Zbatimi i rekomandimeve për vitin 2022

Të pranuar	Të realizuara	Në proces realizimi	Në afat për t'u verifikuar zb.	Të pazbatuara	Të papranuara	Të lëna në total
162	82	55	22	3	2	164

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Auditimit në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Nga analiza e reagimeve të subjekteve të audituara gjatë vitit 2022, rezulton se subjektet kanë kthyer përgjigje brenda afatit për pranueshmërinë e rekomandimeve përveç 2 subjekteve të cilat nuk kanë sjellë kthim përgjigje: ISHPSHSH Shkodër dhe Sh.A. “Tregu i shitjes me shumicë Fruta-Perime” Shkodër.

Nga vlerësimi i nivelit të riskut të 164 rekomandimeve të lëna gjatë këtij viti, rezulton se janë lënë 92 rekomandime të vlerësuara me rëndësi/risk të lartë dhe 71 rekomandime të vlerësuara me rëndësi risk/ të mesëm dhe 1 rekomandim i vlerësuar me rëndësi/risk të ulët.

Referuar Urdhrit nr. 14, datë 13.02.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të auditimit” të MF, nga Drejtori i DA janë ngritur grupet e punës për kryerjen e kqyrjes së zbatimit të rekomandimeve. Gjatë vitit 2022, Drejtoria e Auditimit ka ndërmarrë gjithsej 30 angazhime për kqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga të cilat 27 angazhime (me 140 rekomandime të pranuar) në subjektet e audituara gjatë vitit 2022 dhe 3 angazhime (10 rekomandime) në subjektet e audituara gjatë vitit 2021.

Ndërsa nga mbikqyrja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin 2021, të monitoruara në vitin 2022, për 3 subjektet: DPPP, Dega e Thesarit Shkodër dhe Dega e Thesarit Korçë, ka rezultuar se nga 10 rekomandimet e lëna në këto subjekte janë realizuar të gjitha.

Për vitin 2022, DA nuk ka dërguar asnjë çështje për investigim të mëtejshëm.

Shqyrtimi i dosjeve fizike të auditimit

Grupi i auditimit ka përzgjedhur disa prej dosjeve të auditimeve të zhvilluara nga DA përgjatë vitit 2022 me qëllim shqyrtimin e mëtejshëm të tyre, përkatësisht dosjet:

- Dosje auditimi në subjektin “Drejtoria e Koncesioneve”;
- Dosje auditimi në subjektin “Drejtoria e Huamarrjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit”;
- Dosje auditimi në subjektin “Drejtoria e Strehimit”;
- Dosje auditimi në subjektin “Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar”;
- Dosje auditimi në subjektin “Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Arsimit Profesional”.

Në kuadër të inventarizimit, nga grupi i auditimit u konstatua se grupet e punës kanë krijuar dosje të veçantë për secilin prej angazhimeve; dosje të cilat janë të inventarizuara. Në secilën prej dosjeve të shqyrtuara, referuar gurmës c të nenit 14 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” si dhe Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 172, datë 05.10.2021 “Për miratimin e planit strategjik të auditimit për vitet 2022-2024 si dhe planit të auditimit për vitin 2022 të Drejtorisë së Auditimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë” është nënshkruar nga Drejtori i DA, autorizimi për përgatitjen e angazhimit të auditimit të brendshëm në subjektin përkatës. Janë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit të audituesit të brendshëm, ndarja e detyrave si dhe testet individuale të Auditimit të Brendshëm. Konstatohet se janë plotësuar dhe firmosur dokumentat për buxhetin dhe afatin kohor për angazhimet e auditimit (Formati Standard 6). Gjithashtu, në takimet fillestare dhe ato përmbyllëse janë mbajtur procesverbalet përkatëse për secilin takim.

Në secilën prej dosjeve ishin plotësuar Vlerësimi i Riskut për Mjedisin e Përgjithshëm të Kontrollit (Formati standard 4) dhe Vlerësimi i risqeve për sisteme/fusha të veçanta të llogarisë (Formati standard 5). Në dosje gjenden pyetësorët e dhënë nga grupet e auditimeve. Pas përfundimit të punës në terren, grupet kanë përcjellë pranë subjekteve të audituara Raportin e Auditimit si dhe Planin e Veprimit të sugjeruar për realizimin e rekomandimeve të lëna. Pas përfundimit të angazhimit auditues, nga Drejtori i DA janë përcjellë tek Ministri i MFE memot të cilat paraqesin përmbledhje të shkurtër të raportit përfundimtar të auditimit. Përsa i përket dokumentit “Rishikimi i Cilësisë së Punës” konstatohet se për dosjet e përzgjedhura dokumenti është administruar në secilën prej dosjeve, referuar Kapitullit VII “Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm”, Pika 4.1.10, Hapi 9 “Rishikimi i punës së Auditimit” në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i ndryshuar. Referuar kërkesave të parashikuara në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, një kopje e dokumenteve të dosjeve të auditimeve (shkresa dhe/ose dokumente që lidhen me të) duhet të protokollohen e të dorëzohen në arkivën e Institucionit. Nga auditimi u konstatua se dosjet e angazhimeve për vitin 2022, janë protokolluar e arkivuar.

Nga shqyrtimi i materialeve të administruara në dosjet e sipërcituara grupi i auditimit ka konstatuar se DA përgjatë vitit 2022 ka evidentuar problematika me rëndësi për impaktin e tyre në buxhetin e shtetit apo në performancën e drejtorive të audituara. Specifikisht, disa nga gjetjet me rëndësi (në mënyrë të përmbledhur) të evidentuara nga DA gjatë vitit 2022 janë paraqitur në vijim.

1. Drejtoria e Koncesioneve

Në këtë Raport Auditimi nga DA janë evidentuar problematikat kryesore si:

- Nuk ka gjurmë të analizës së hollësishme ekonomike-financiare, nga Drejtoria e Koncesioneve, por është mjaftuar vetëm në studimin e fizibilitetit të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor.
- Në Studimin e fizibilitetit të Projektit koncesionar/PPP “Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës” është parashikuar garantim i të ardhurave deri në nivelin e të ardhurave minimale vjetore për 10 vitet e para të operimit, ndonëse në dokumentin e shpalljes së koncesionit ky projekt nuk është me mbështetje financiare, por ka si burimi të financimit kapitalin privat. Pas korrespondencave të shqyrtuara nga DA është konstatuar se edhe pse nuk është parashikuar mbështetje buxhetore, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit nuk është shprehur për garancinë e të ardhurave edhe pse ky është risk i ekspozuar, Drejtoria e Koncesioneve është shprehur se garantimi i të ardhurave implikon indirekt buxhetin e shtetit në aspektin sasior rreth 138 milion Euro, dhe MFE nuk është shprehur direkt mbi garancinë e të ardhurave, por indirekt ka pranuar riskun e mbështetjes financiare. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në vlerësimin e dhënë mbi draft kontratën, që i ka përcjellë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si Autoritet Kontraktor, nuk ka dhënë opinion për mbështetjen financiare në formën e garancisë deri në kufirin minimal të të ardhurave bruto për 10 vjet, përcaktuar në nenin 11.3 dhe shtojcën 3 të draft-kontratës. Gjithashtu në mendimin e dhënë mbi projekt vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e kontratës MFE nuk ka komentuar mbështetjen financiare, por shprehet “*Parimisht dakord në lidhje me këtë projekt-vendim*”.
- Për veprimtarinë deri më 31.12.2021, nga 228 kontrata efektive koncesioni/PPP, nga 15 kontrata me mbështetje buxhetore Autoritetet Kontraktore kanë raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë vetëm për 7 kontrata ose në masën 46.7% dhe për 8 kontrata

ose 53.3% të kontratave me mbështetje buxhetore nuk ka informacion. Për 8 kontratat që nuk ka informacion në 4 kontrata Autoritet Kontraktor është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe për 4 kontrata Autoritet Kontraktor është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Sipas përcaktimeve në kontratën koncensionare/PPP “Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)”, të nënshkruar rezulton se ka përfunduar afati i plotësimit të kushteve paraprake dhe duhet të jetë nënshkruar Deklarata e Mbylljes, për rrjedhojë kontrata duhet të jetë efektive që nga data 10.02.2022. Drejtorja e Koncensionave deri më 15.03.2022, megjithëse kanë kaluar mbi 270 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës nga 240 ditë të përcaktuara për përmbushjen e kushteve paraprake, nuk ka informacion apo raport monitorimi mbi ecurinë e kësaj kontrate.

Sa më sipër, grupi i auditimit të KLSH konstaton se nga ana e Drejtorisë së Auditit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, janë evidentuar problematika të rëndësishme me impakt të mundshëm në buxhetin e shtetit, sa i takon kontratave koncensionare, veprimtarisë së Drejtorisë së Koncensionave, si dhe veprimtarisë së Drejtorive të tjera lidhur me dhënien e mendimit/opinionit brenda fushëveprimit të tyre mbi kontratat koncensionare. Në këtë kuadër, Kontrolli i Lartë i Shtetit i sugjeron Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (i) ndërmarrjen e veprimeve lidhur me auditimin e Drejtorive të përfshira sa i takon procesit të dhënies së opinionit mbi kontratat koncensionare, (ii) në vijimësi ndjekjen e ecurisë së kontratave, (iii) si dhe evidentimin dhe marrjen e masave në rastet e mungesës së raportimit/raportimit jo të plotë të ecurisë së zbatimit të këtyre kontratave nga ana e Autoriteteve Kontraktore.

2. Drejtorja e Huamarrjes në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit

Në këtë Raport Auditimi nga DA janë evidentuar problematikat kryesore:

- Vakanca të paplotësuara përgjatë viteve 2019-2021 në Drejtori.
- Problematika lidhur me sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit ku evidentohen: mospërditësimi i risqeve, mungesë e planit të veprimit për minimizimin e risqeve të drejtorisë dhe monitorimin e vazhdueshëm të tyre, mungesë e një formati standard për mënyrën e ndërtimit të raportit vjetor, mungesë e rregullave të miratuara për detyrimin e hartimit të raportit vjetor.
- Treguesit e huamarrjes së brendshme vjetore nga viti 2019 deri në 11 mujin e vitit 2021 kanë patur trend rritës.
- Me rritje rezulton si Huamarrja në tregun e brendshëm në bono thesari dhe Huamarrja në tregun e brendshëm në titujve 2,3,5,7, 10 dhe 15 vjeçar.
- Për plotësimin e nevojave në rritje për hua, në vitin 2021 është ndryshuar udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 31, datë 26.12.2013 duke i dhënë të drejtë ministrisë që të emetojë tituj me vlerë deri në 15% mbi vlerën e ofertës së shpallur, pa ndryshuar vlerën e shpallur në kalendarin 3 mujin dhe vjetor të ankandeve. Nga ndryshimi i udhëzimit për vitin 2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka pranuar kërkesa nga tregu më shumë se vlera e shpallur në njoftim dhe në kalendarin 3 mujin e vjetor, në 18 ankande të zhvilluara në shumën 8,310 milion lekë.
- Nga viti 2019 deri në vitin 2021, stoku i huamarrjes së brendshme ka patur trend në rritje nga 582,137 milion lekë në fund të vitit 2019 në nëntor të vitit 2021 ka arritur në 681,552 milion lekë ose 17.1% më i lartë se në vitin 2019 dhe 8% më i lartë se në vitin 2020.

3. Drejtorja e Strehimit

Në këtë Raport Auditimi nga DA janë evidentuar problematikat kryesore:

- Mangësi e të dhënave të sakta për çdo bashki për çdo kategori të pastrehësh, siç përcaktohet në ligjin për strehimin.
- Mungesë e bashkëpunimit nga NJQV-të me MFE-në, për hartimin e politikave dhe strategjive kombëtare në fushën e strehimit sipas kërkesave dhe detyrimeve ligjore.
- Sistemi i implementuar nga MFE “Për strehimin dhe banesat sociale” (për aplikimin online të qytetarëve për strehim), nuk është funksional edhe pse sipas kontratës duhej të vihej në funksion që nga Janari i vitit 2021.
- Nuk është kaluar në fond banese për të pa strehët 3%-shi i sipërfaqeve të ndërtimit për lejet e ndërtimit mbi 2000 m². Ligji nuk ka të parashikuara sanksione për këtë qëllim.
- Nuk është zbatuar kalendarit për buxhetin e çdo viti për shqyrtimin e kërkesave të NJQV, në përcaktimin e fondeve për strehim sipas udhëzimit.
- Planifikimi për buxhet vazhdon të bazohet në treguesit dhe kërkesat për strehim të vitit 2016, të cilat nuk u përgjigjet nevojave reale për çdo vit buxhetor, në një kohë kur treguesit e fushës së strehimit janë dinamik dhe ndryshojnë çdo vit.
- Nuk bëhet monitorimi i zbatimit të investimeve, por vetëm azhurnohen evidencat nga raportimet e bëra nga NJQV-të, të cilat janë me mangësi të theksuara dhe nuk ka gjurmë për këtë proces, etj.
- Struktura e drejtorisë ka patur mungesa në staf për periudhën e audituar.
- Mangësi në kuadër të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si: mungesë e manualit të proceseve të punës dhe gjurmës së auditimit, mosrespektimi i hierarkisë së nënshkrimit për dërgimin e raportit të monitorimit të buxhetit, mungesë e një raporti/analize vjetore mbi veprimtarinë e drejtorisë, mosrishikim i strategjisë në përputhje me strategjinë afat mesme të hartimit të buxhetit, mungesë e dokumentimit të proceseve dhe shqyrtimit të kërkesave për buxhetim.

4. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Në këtë Raport Auditimi nga DA janë evidentuar problematikat kryesore me konkluzion të përgjithshëm *“Ka nevojë për rritjen e efektivitetit të planifikimit buxhetor dhe argumentimin e kërkesave buxhetore sipas misioneve të programeve”*:

- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka kontabilizuar në llogarinë 212 vlerën e rikonstruksioneve të shkollave profesionale (investimeve), pa i patur këto asete në vlerën 2,169,795,362 lekë.
- Pasqyra e amortizimit nuk pasqyron amortizimin e aseteve të pasqyruara në llogarinë 212.
- Gjendja e llogarisë 486 në fund të çdo periudhe nuk rakordohet me llogaritë analitike.
- TVSH për projektet me financim të huaj është evidentuar në total dhe jo sipas projekteve dhe nuk pasqyron vlerën e investuar për çdo projekt në pasqyrat financiare të çdo viti kalendarik, por ato mbahen në llogari sintetike.
- Problematika lidhur me PBA si:
 - Kërkesat buxhetore dhe pasqyrat bashkëlidhur gjatë fazës teknike të PBA 2021-2023 për disa programe buxhetore të Aparatit si dhe për fazën e II teknike të PBA 2022-2024 (për 12 programe) nuk janë përcjellë zyrtarisht tek NZ.
 - Ka raste kur nuk janë nënshkruar formularët nga ana e NA, mungon relacioni shpjegues dhe nuk është respektuar afati i dërgimit të kërkesave buxhetore të fazës teknike të PBA-së 2021-2023 dhe 2022-2024.
- Për shpenzimet kapitale me financim të huaj planifikimi për rimbursimin e TVSH-së nuk është detajuar në relacionet e PBA se për cilat projekte do të kryhet rimbursimi.
- Për 4 programe buxhetore të Aparatit, planifikimi për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj nuk tregon lidhjet midis burimeve publike, produkteve dhe rezultateve të arritura, me misionin e programeve buxhetore të MFE.

- Për pagesat e rimbursimit të TVSH dhe kuotën e bashkëfinancimit të projekteve me financim të huaj ku MFE është përfituese, nuk ka funksionuar plotësisht bashkëpunimi me drejtorinë në rolin e njëjësive zbatuese të projekteve.
- Si rezultat i mos rakordimit të gjendjes fizike më atë kontabël kemi mosevidentim real të llogarive inventariale dhe për pasojë pasqyrat financiare në fund të çdo viti kalendarik nuk paraqesin gjendjen faktike të aktiveve të institucionit.
- Referuar regjistrin analitik të magazinës së MFE rezultojnë gjendje produkte dhe pajisje të blera nga financimet e projekteve të huaja për të cilat nuk asnjë informacion mbi statusin dhe destinacionin përfundimtar të tyre pas përfundimit të projekteve.
- Nuk është rakorduar me Drejtorinë e Fondit Kombëtar kthimi i fondeve në buxhetin e MFE ku në fund të vitit 2021 janë kthyer në buxhetin e MFE 248,563,363.51 lekë nga menaxhimi indirekt i projekteve IPA.
- Mangësi në kuadër të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si: mosrespektim i afatit për dërgimin e Regjistrin të Riskut tek NZ, nuk është ngritur komisioni i inventarizimit të aktiveve, ka raste që përbërja e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore nuk është bazuar në metodologjinë e sigurimit të drejtpërdrejtë të përgjegjshmërisë institucionale.

5. Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Arsimit Profesional

Në këtë Raport Auditimi nga DA është dhënë konkluzioni i përgjithshëm *“Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Arsimit Profesional nuk ka një sistem të monitorimit të ngritur me rregulla të shkruara/miratuara e të bazuara në një raportim periodik vjetor të dokumentuar për ecurinë e veprimtarisë së saj vjetore”* dhe janë evidentuar problematikat kryesore:

- Mosndjekje e treguesve të performancës së sigurimeve shoqërore dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor dhe afat mesëm të sigurimeve shoqërore.
- Vonesa të pa justifikuar në kthimin e përgjigjeve të kërkesave ankesave/problematikave/ shkresave të ndryshme, të ardhura nga palët e treta.
- Ka përfunduar mandati 3 vjeçar i Këshilli Kombëtar i Punës.
- Për periudhën objekt auditimi ka patur gjithsej 34 raste të miratimit në heshtje të kërkesave për licensim, për shkak të vonesave të procedimit të dokumentacionit nga institucionet përgjegjëse (MFE, QKB, AKPA).
- Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë raportuar çdo tre muaj pranë MFE për fondet buxhetore të shpenzuara dhe numrin e nxënësve të arsimit profesional që trajtohen më kuota ushqimore në konvikte dhe bursa.
- Në progres raportin e SKPA-së nuk ka informacion financiar për burimet e shpenzuara për secilin objekt/indikator përkatës, sipas planifikimit në strategji (kosto indikative dhe burimi i mbulimit).
- Në zbatim të nenit 35, të ligjit nr. 15/16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH” ka rezultuar se nuk janë miratuar të gjitha aktet nënligjore dhe nuk është respektuar afati 9 muaj brenda të cilit duhej të dilnin aktet.
- Nuk ka urdhër për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Licencë e Certifikatë, në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi. Kjo detyrë kryhet nga Sektori i Arsimit Profesional.
- Vende vakante për periudhën e audituar.
- Mangësi të theksuara në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit: mungesë e përcaktimit të metodologjive për proceset e punës së drejtorisë, mungesë e rregulloreve, mungesë e hartimit dhe dokumentimit të planeve vjetore, mangësi e përcaktimit të rregullave për hartimin e planeve vjetore, mospërfshirje e disa prej proceseve të punës në manualin që administron drejtoria, mungesë e gjurmës së auditimit, mungesë e hartimit të një raport/analizë për veprimtarinë vjetore, etj.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, subjekti nuk ka paraqitur observacione.

2.G.2. Mbi vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Për auditimin e kësaj çështje të programit të auditimit është shqyrtuar dokumentacioni i mëposhtëm:

- Urdhri nr. 89, datë 13.06.2018 i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”;
- Rregullore e Brendshme e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratuar me Urdhrin nr. 52, datë 10.03.2021 të Ministrit të MFE;
- Dokumentacion mbi politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Dokumentacion mbi monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Pyetësorët e vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- Deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Regjistri i Riskut;
- Raporti vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm
- Urdhrat e caktimit të Nëpunësit Autorizues (NA) e Nëpunësit Zbatues (NZ);
- Shkresat mbi ndarjen dhe delegimin e kompetencave;
- Urdhri i krijimit të GMS.

Nga auditimi i komponentëve të sistemit të MFK ka rezultuar:

1. Mjedisi i Kontrollit

Në kapitullin “Mjedisi i Kontrollit” të Manualit të MFK citohet se *“Titullari i çdo njësie publike duhet të ngrëjë një strukturë organizative që të bëjë të mundur arritjen e objektivave dhe të jetë në pajtim me funksionet e ngarkuara sipas kuadrit ligjor. Struktura organizative është korniza me anë të cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësisë. Struktura duhet të jetë në harmoni me përmasat dhe me natyrën specifike të njësisë dhe misionin e saj, duhet të vlerësohet kohë pas kohe dhe të modifikohet në rast se gjykohet e nevojshme”*. Sa i përket strukturës organizative të njësisë, për vitin 2022 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka të miratuar strukturën organizative përmes Urdhrit nr. 89, datë 13.06.2018 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”. Sipas kësaj strukture, administrata e ministrisë kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm, si nëpunësi më i lartë civil dhe ka në përbërje 8 Drejtori të Përgjithshme dhe struktura të tjera, që nuk janë organizuar si pjesë e drejtorive të përgjithshme, ku në total ka në përbërje 334 punonjës.

Manuali i MFK në Kapitullin “Mjedisi i Kontrollit” citon se *“Struktura e njësisë duhet të përfshijë rregulla të qarta që përcaktojnë ndarjen e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisë, duke përfshirë rregullat për delegimin e tyre ...”* dhe *“Struktura e njësisë duhet të reflektohet në një dokument (akt administrativ) të shkruar, ose rregullore të brendshme që u vihet në dispozicion të gjithë punonjësve ...”*. Sa i përket rregullores së brendshme të institucionit konstatohet se kjo e fundit është miratuar me Urdhrin nr. 52, datë 10.03.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë si Titullar i Institucionit, ku në të janë përcaktuar statusi, misioni, funksionet, detyrat, përgjegjësitë për drejtoritë dhe sektorët e MFE. Për më tepër, pjesë e rregullores së brendshme është dhe Kodi Etik, i specifikuar në Kreun III, neni 28 “Etika për stafin” e Rregullores së Brendshme të MFE. Megjithatë, Manuali i MFK në shembullin e

rregullore së brendshme citon se *“Nëse gjykohet e nevojshme, sidomos për njësi të përmasave të mëdha, për rregullat e etikës duhet të ketë një rregullore të veçantë”*.

Në strukturën e MFE përgjatë vitit 2022 evidentohet punonjës me kontratë të përkohëshme, të cilët janë punësuar me VKM nr. 35, datë 19.01.2022 *“Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohëshme, për vitin 2022, në njësitë e qeverisjes qendrore”*, i ndryshuar. Në fund të vitit 2022, në MFE rezultojnë 51 vende vakante në strukturën organizative.

Marrëdhëniet e punëdhënësit me punëmarrësin, janë referuar Ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, VKM nr. 35, datë 19.01.2022 *“Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohëshme, për vitin 2022, në njësitë e qeverisjes qendrore”*, i ndryshuar. si dhe dispozita të tjera ligjore si Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, etj.

Politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore i referohen Ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe procedurat e emërimeve/largimeve kryhen nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike referuar Ligjit të mësipërm. Për më tepër, Rregullorja e Brendshme e sipërcituar ka të pasqyruar rregullat e funksionimit të brendshëm në aspekte të strukturës, të drejtave dhe përgjegjësisë, marrëdhëniet mes strukturave, shkeljet, disiplinën, etj.

Sa i përket përkrahjeve të punës rezulton se janë miratuar dhe firmosur përkrahjet e punës për nëpunësin civil në MFE. Dosjet e personelit janë të pajisura me fletën e inventarit dhe fletën prezantuese referuar VKM nr. 833, datë 28.10.2020 *“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*. Gjithashtu, janë kryer vlerësimet për vitin 2022 për punonjësit, referuar Lidhjes 2 të Vendimit nr. 252, datë 30.3.2016 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*.

Profesionalizmi është një karakteristikë e punonjësit që nënkupton se ai ka aftësinë, dijen dhe zotësinë e duhur për të kryer detyrat që i ngarkohen. Sa mirë duhet të kryhen këto detyra është përgjithësisht një vendim i titullarit, i cili duhet të vendosë mbështetur në objektivat e njësisë si dhe në strategjitë e politikave që ai ka përcaktuar për përmbushjen e këtyre objektivave. Në kuadër të ruajtjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të profesionalizmit rezulton të jenë kryer trajnime nga ASPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike) përgjatë vitit 2022.

Gjatë vitit 2022, detyrën e Nëpunësit Zbatues (NZ) e ka kryer znj. R.N dhe znj. A.V, ndërsa detyrën e Nëpunësit Autorizues (NA) e ka kryer A.Gj. Lidhur me delegimin e kompetencave të NA dhe NZ, ata kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, siç kërkohet në nenin 15 *“Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”*, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar, si dhe në Manualin për MFK. Në bazë të pikës nr. 1, neni 10, i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, NA është edhe koordinator i riskut.

2. Menaxhimi i riskut

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar, neni 21 *“Menaxhimi i Riskut”*, pika 2, citon se *“...Titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të risku. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit”*.

Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, *“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”* të Ministrisë së Financave, pika 3.2.1 citon se *“Titullari i njësisë publike është përgjegjës për përcaktimin*

e objektivave dhe strategjisë. Kjo përfshin: Menaxhimin efektiv të riskut” dhe pika 3.2.2 citon se “Nëpunësi autorizues/koordinatori i riskut ka përgjegjësi për: Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të MR, përcaktimin e nivelit të oreksit të riskut; Vlerësimin e sistemit të MR ...”. Në kundërshtim të bazës ligjore të sipërcituar, MFE nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut. Për më tepër konstatohet se nuk janë kryer takime me stafin menaxherial për çështje të menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme në menaxhimin e riskut.

Për vitin 2022, rezulton të jenë identifikuar vetëm disa risqe lidhur me korrupsionin, referuar Planit të Veprimit 2020-2023 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, ku Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka ngritur Grupin e Punës, nëpërmjet Urdhrit nr. 138, datë 26.07.2021 “Për hartimin e Planit të Integritetit 2020-2023 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”, me qëllim realizimin e objektivit “A9-Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë”, sipas Rekomandimit të dhënë nga GRECO (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit) në Raportin e Vlerësimit për Shqipërinë. Përmes Urdhrit nr. 40, datë 09.02.2022 të Ministrit të MFE është miratuar Plani i Integritetit të Institucionit, një instrument me karakter parandalues në luftën kundër korrupsionit. Plani i Integritetit u hartua gjatë katërmujorit të dytë të vitit 2021 dhe i sjell efektet e tij për vitet 2022-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Misioni i hartimit të këtij akti është përfshirja e analizës sistematike të riskut (në çështje të korrupsionit), sipas fushës së përgjegjësive të institucionit, si dhe formulimi i masave të përshtatshme për përmirësimin e performancës së nëpunësve të ministrisë, llogaridhënies dhe transparencës së institucionit. Në seksionin 2.2 të Planit të Integritetit janë përcaktuar risqet e lidhura me korrupsionin për Drejtorinë e MFE. Gjithashtu në Plan janë identifikuar disa risqe, të cilat mund të çenojnë integritetin e punonjësve të MFE lidhur me rastet e konfliktit të interesit, rastet e shkeljes së rregullave të brendshme të Kodit të Etikës dhe rastet e shkeljes së normave të transparencës, informimit dhe konsultimit publik. Për vitin 2022, Plani i Integritetit ka të parashikuar për zbatim 27 masa për të cilat janë planifikuar kryerja e 27 aktiviteteve, sipas fushave të veprimtarisë së MFE. Nga monitorimi sipas MFE rezulton se përgjatë vitit 2022, në totalin prej 27 masash, janë zbatuar 21 masa, 5 prej tyre kanë mbetur në proces dhe 1 masë nuk është realizuar.

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MFE: deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të MFE, pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK, referuar nenit 18 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Regjistri i Riskut për vitin 2022 i cili përmbledh regjistrat e risqeve dhe planet e veprimit së të gjithë strukturave të MFE, rezulton të mos ketë reflektuar ndryshime në risqe për këtë vit. Në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 11 “Përgjegjësia menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2, citon se “Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë dhe i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për identifikimin dhe krijimin e regjistrat të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”.

3. Aktivitetet e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, titullarët e njësisë duhet të marrin parasysh përfitimin që pritet prej tyre, si dhe kostot për futjen dhe zbatimin e tyre.

Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen.

Nga auditimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, për vitin 2022 rezulton që MFE nuk ka takime të dokumentuara për veprimtarinë e GMS, i cili duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit, referuar përcaktimeve të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 27 “Takimet periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë publike”, pika 1 si dhe Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” të MF, paragrafi 2.2.4 “Roli i GMS në sistemin e MFK”, pika 3, e cila citon “GMS duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit. Vendimet duhet të jenë objektive dhe të merren si grup... Vendimet e GMS duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.” Për më tepër, GMS referuar Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” të MF, paragrafi 3.2.5 “Grupi i Menaxhimit Strategjik” ku citohet se “GMS është përgjegjës të sigurojë se regjistri i riskut për programe/objektiva specifik rishikohet jo më pak se dy herë në vit”, ka për detyrë rishikimin jo më pak se dy herë në vit të regjistrimit të riskut.

Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive dhe shkeljeve si dhe moszbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që e shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjës të zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, procesi, apo aktiviteti. Për të garantuar kryerjen e kontroleve efektive, si dhe për të ruajtur ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/transaksioni, përgjegjësitë duhet të ndahen në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin (marrjen e vendimit), zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin. Sa më sipër, konstatohet se sistemi i nënshkrimit është përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të MFE të miratuar me Urdhrin nr. 52, datë 10.03.2021 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë. Praktika hartohet nga specialisti përkatës, pranohet nga përgjegjësi i sektorit, konfirmohet nga drejtori i Drejtorisë si dhe paraqitet tek NA dhe Titullari i Institucionit (Ministri) për miratim, referuar hierarkisë përkatëse.

Sistemi me dy firma (me të paktën dy firma) është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, përfshirë edhe shitjen e pronës, urdhër-shërbimet, dhe kryerja e pagesës, (urdhërpagesa, etj) autorizohen pas hedhjes së firmës nga:

- NZ ose nëpunësi i deleguar përgjegjës për rregjistrimet në kontabilitet;
- Titullari i njësisë/NA, apo një nëpunës tjetër i deleguar, përgjegjës për kryerjen e shpenzimeve dhe mbledhjen e të ardhurave.

Rezulton se kryerja e pagesave është autorizuar pas firmosjes dhe dakordësisë së Nëpunësit Zbatues dhe Nëpunësit Autorizues.

Sa i përket procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike. Dokumentimi përfshin hartimin e provave të shkruara për vendimet e marra, ngjarjet e ndodhura, veprimet dhe transaksionet e kryera, etj. Dokumentimi duhet të jetë i plotë, i saktë dhe në kohën e duhur. Procedurat e dokumentimit përfshijnë procedurat që lidhen me qarkullimin e dokumentacionit, të cilat përmbajnë urdhrin për qarkullimin dhe përdorimin e dokumenteve të prodhuara dhe të marra. Procedurat e dokumentimit duhet të mundësojnë ndjekjen e çdo dokumenti, veprimi, apo procesi në njësi ku të tregohet saktësisht se kush ka kryer çfarë, kur dhe ku, qëllimin dhe llojin e aktit/dokumentit që është lëshuar me këtë rast. Titullari duhet gjithashtu të garantojë se të dhënat nga dokumente, apo burime të ndryshme krahasohen për t'u siguruar për përputhshmërinë e tyre. Konstatohet se në Rregulloren e Brendshme të MFE janë të përcaktuara rregulla që lidhen me procedurat për dokumentimin,

arkivimin dhe ruajtjen e informacionit në zbatim të kërkesave të parashikuara në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”. Gjithashtu, nga MFE përgjithësisht janë hartuar manuale të proceseve të punës me përshkrim të proceseve, procedurave, detyrave, personave të ngarkuar për kryerjen e detyrave, strukturat përgjegjëse, delegimin e detyrave, etj.

Nga auditimi konstatohet se nuk është miratuar Gjurma e Auditimit si dokument i unifikuar për të gjitha proceset e institucionit, edhe pse pikat nr. 1, 2 dhe 3 të nenit 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, përcaktojnë se “1. Ministri i Financave është përgjegjës për miratimin e gjurmëve standarde të auditimit, që lidhen me procedurat e unifikuara për të gjitha njësitë publike. 2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”.

Për më tepër, dokumentacioni i dorëzuar pranë grupit të auditimit ka paraqitur parregullsi të cilat konsistojnë në: dosje me mangësi dokumentacioni justifikues, databaza me mangësi informacioni, të dhëna të cilat kanë mangësi në rakordime si dhe dokumentacioni i cili paraqet mungesë të gjurmës audituese. Nga grupi i auditimit konstatohet se nga ana e MFE nuk është ruajtur gjurma audituese, duke e bërë të vështirë gjurmimin e qarkullimit të informacionit dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion (sidomos databazat) nuk ofron informacion për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t’i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Sa i përket aktiveve të MFE, referuar Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve të njësive të sektorit publik”, paragrafi 26 ku citohet se “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”, rezulton se MFE ka hartuar një regjistër kontabël të aktiveve. Për më tepër, referuar Kreut IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, paragrafi 74 i po këtij Udhëzimi, citohet se “Çdo njësi ekonomike duhet të kontrollojë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të elementeve dhe dokumentacionit mbështetës” dhe paragrafi 81 i cili citon se “Inventarizimi kryhet nga një komision i posaçëm që krijohet me urdhër të titullarit të njësisë publike ose nëpunësit autorizues të çdo niveli të njësisë publike. Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga nëpunësi zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë”. Referuar kësaj çështje, konstatohet se për vitin 2022, Titullari i MFE nuk ka urdhëruar krijimin e komisionit për inventarizimin e aseteve të MFE.

4. Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t’i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre.

Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të të detyrave të ngarkuara. Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi

të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës. Në kryerjen e monitorimit, titullari i njësisë, NA dhe menaxherët e tjerë, duhet t'i kushtojnë vëmendje gjendjes së MFK-së dhe objektivave të arritura. Procedurat e vendosura për monitorim duhet të jenë në përputhje me kulturën dhe rregullat e brendshme të njësisë, si dhe të garantojnë përshtatshmërinë me rregullat. Sistemi i MFK-së kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Në Rregulloren e Brendshme të MFE është përcaktuar linja e informimit dhe raportimit e cila konsiston si në vijim: Titullari i MFE informohet nga drejtorët e përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive, mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve, evidencave të ndryshme dhe raporteve periodike. Nga ana e NZ realizohet informimi me anë të stacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, si dhe me anë të raporteve të monitorimit çdo 3-muaj.

Komunikimi i brendshëm në institucion kryhet me shkrim dhe email, ndërsa jashtë institucionit komunikohet në formë shkresore zyrtare. Megjithatë, nga auditimi i çështjeve të ndryshme për vitin 2022 në MFE rezulton se janë evidentuar raste në të cilat komunikimi me palë të treta (kryesisht institucione) ka paraqitur vonesa. Konstatohet se menaxherët e informacionit në MFE zotërojnë informacion, por jo të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit duke qenë se zbatimi i ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është respektuar nga të gjitha drejtoritë.

Sa i takon publikimit të raporteve të ndryshme dhe informacionit të nevojshëm për publikun apo palët e treta, konstatohet se në faqen zyrtare të MFE rezultojnë të publikuara raportet periodike të monitorimit buxhetor të MFE. Megjithatë, lidhur me raportime të tjera, konstatohet se në faqen zyrtare MFE nuk janë përditësuar raportimet e viteve të fundit dhe as të vitit 2022.

Lidhur me monitorimin e sistemit, sipas Rregullores së Brendshme të MFE janë përcaktuar ndarja e detyrave mes hallkave duke specifikuar përgjegjësitë e drejtuesve për mbikëqyrjen e strukturave që mbulojnë. Nivelet më të ulta drejtuese sipas strukturës organizative të MFE raportojnë tek niveli më i lartë. Përgjithësisht monitorimi i sistemit kryhet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Titulli i Gjetjes	Problematika të evidentuara në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
Situata	<p>Nga auditimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se përgjatë vitit 2023 ka patur mangësi dhe problematika.</p> <ul style="list-style-type: none"> - MFE nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, në kundërshtim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” të Ministrisë së Financave, pika 3.2.1 Për më tepër, konstatohet se nuk janë kryer takime me stafin menaxherial për çështje të menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme në menaxhimin e riskut. - Regjistri i Riskut për vitin 2022 i cili përmbledh regjistrat e risqeve dhe planet e veprimit së të gjithë strukturave të MFE, rezulton të mos ketë reflektuar ndryshime në risqe për këtë vit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 11 “Përgjegjësia menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2.

	<p>- Për vitin 2022 rezulton që MFE nuk ka takime të dokumentuara për veprimtarinë e GMS, i cili duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit, referuar përcaktimeve të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, neni 27 “Takimet periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë publike”, pika 1 si dhe Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 të MF, paragrafi 2.2.4 “Roli i GMS në sistemin e MFK”, pika 3. Për më tepër, GMS referuar po këtij Udhëzimi, paragrafi 3.2.5 “Grupi i Menaxhimit Strategjik”, ka për detyrë rishikimin jo më pak se dy herë në vit të regjistrit të riskut.</p> <p>- Nga auditimi konstatohet se nuk është miratuar Gjurma e Auditimit si dokument i unifikuar për të gjitha proceset e institucionit, edhe pse pikat nr. 1, 2 dhe 3 të nenit 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, përcaktojnë se Titullari i MFE duhet të miratojë gjurmën standarde të auditimit, ndërsa <i>Titullarët e njësisë publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi. Për më tepër, dokumentacioni i dorëzuar pranë grupit të auditimit ka paraqitur parregullsi të cilat konsistojnë në: dosje me mangësi dokumentacioni justifikues, databaza me mangësi informacioni, të dhëna të cilat kanë mangësi në rakordime si dhe dokumentacioni i cili paraqet mungesë të gjurmës audituese. Nga grupi i auditimit konstatohet se nga ana e MFE nuk është ruajtur gjurma audituese, duke e bërë të vështirë gjurmimin e qarkullimit të informacionit dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion (sidomos databazat) nuk ofron informacion për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t’i verifikuar këto transaksione dhe operacione.</i></p> <p>- Për vitin 2022, Titullari i MFE nuk ka urdhëruar krijimin e komisionit për inventarizimin e asetëve të MFE në kundërshtim me përcaktimet e Kreut IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, paragrafi 81 i Udhëzimit nr. 16/2016.</p> <p>- Sa i takon publikimit të raporteve të ndryshme dhe informacionit të nevojshëm për publikun apo palët e treta, konstatohet se në faqen zyrtare të MFE nuk janë përditësuar raportimet e viteve të fundit dhe as të vitit 2022.</p>
Kriteri	<p>- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 11 “Përgjegjësia menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2;</p> <p>- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 27, pika 1;</p> <p>- Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” të MF, paragrafi 2.2.4, pika 3 dhe paragrafi 3.2.5;</p> <p>- Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” të Ministrisë të Financave, pika 3.2.1 dhe pika 3.2.2.</p>
Ndikimi	<p>Problematika në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke ndikuar potencialisht në efektivitetin dhe dobinë institucionale.</p>
Shkaku	<p>Mangësi në zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” të Ministrisë të Financave.</p>

Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe strukturat përgjegjëse në këtë Ministri, të marrin masa për përmbushjen e mangësive të evidentuara si dhe për implementimin e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, subjekti nuk ka paraqitur observacione.

2.G.3 Mbi bonot e privatizimit.

Një problematikë e evidente për administrimin e pronës mbetet edhe bilanci i bonove të privatizimit, të shpërndara qytetarëve shqiptarë sipas kontributeve në ekonomi, që do të përdoren në privatizimin e pronës shtetërore.

Titulli i Gjetjes	Problematika në bilancin e bonove të privatizimit, të shpërndara qytetarëve shqiptarë sipas kontributeve në ekonomi
Situata:	<p>Një problematikë e evidente për administrimin e pronës mbetet edhe bilanci i bonove të privatizimit, të shpërndara qytetarëve shqiptarë sipas kontributeve në ekonomi, që do të përdoren në privatizimin e pronës shtetërore.</p> <p>Sipas të dhënave zyrtare të Bankës së Shqipërisë rezultojnë se, gjithsej janë printuar bono privatizimi me vlerë nominale 83,302,500,000 lekë, prej të cilave, vlera prej 72,723,410,000 lekë i është shpërndarë Bankës T. dhe vlera 10,579,090,000 lekë është gjendje e pashpërndarë në Bankën e Shqipërisë në formën e arkës stok. Referuar relacionit nr. 1623, datë 12.04.2022 “Mbi përfundimin procesit të inventarizimit të vlerave monetare dhe aktiveve materiale të arkës stok në Departamentin e Emisionit, në Bankën e Shqipërisë”, konstatohet se, gjendja fizike e bonove të privatizimit në vlerën 10,579,090,000 lekë është konfirmuar edhe nga inventarizimi i kryer për arkën stok.</p> <p>Aktualisht nuk kemi një gjendje se sa janë përdorur për blerjen e pronave, sa janë në qarkullim të lirë (ka të dhëna për gjendjen e pa shpërndarë në Bankën e Shqipërisë dhe ato të asgjësuar prej saj) edhe pse afati i përdorimit të tyre është shtyrë vit pas viti.</p> <p>Gjithashtu, konstatohet se ndaj Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë janë kërkuar ekzekutimet e dy vendimeve gjyqësore: Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 24 (çështja 70/73 e Regjistrimit Themeltar), datë 05.02.2015, kthimin e bonove të privatizimit në shumën 22,153,320 lekë dhe për kthimin e shumës 5,505,000 lekë, për të cilat nga MFE nuk është ndërmarrë asnjë veprim, kjo mbështetur dhe në ligjin nr. 7918, datë 13.04.1995 “Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit” dhe Dekretit nr. 1049, datë 27.03.1995 “Për disa plotësime në Dekretin nr. 1030, datë 23.02.1995” nuk ka parashikuar modalitete për kthimin e shumës në bono privatizimi apo të kundravleftës në lekë, në rastet kur nuk realizohet shitja e pronës, kjo edhe për faktin se bonot e privatizimit arkëtohen në bankat e nivelit të dytë dhe më pas dorëzohen në BSH për asgjësim.</p>
Kriteri:	<p>- Ligji nr. 7918, datë 13.04.1995 “Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi) dhe Dekretit nr. 1049, datë 27.03.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit”, i ndryshuar;</p> <p>- VKM nr. 283, datë 30.04.1996 “Për dorëzimin dhe asgjësimin nga Banka e Shqipërisë të bonove të privatizimit mbas përdorimit”.</p>
Efekti:	Risk i lartë në rifutjen në qarkullim të bonove të privatizimit.
Shkaku:	Mungesë koordinimi midis MFE, si porositi dhe administruesi i bonove të

	privatizimit me Bankën e Shqipërisë dhe Bankave të Nivelit të Dytë të cilët arkëtojnë bono privatizimi.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrë masa për evidentimin e gjendjes reale të bonove të privatizimit, të përdorur dhe në qarkullim, me qëllim shmangien e risqeve që karakterizojnë këtë proces, duke rishikuar të gjithë bazën ligjore përkatëse.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET E AUDITIMIT

Për përmirësimin e situatës rekomandojmë marrjen e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit dhe pritje përcjellje rezultuan mangësitë:

a) Nga institucioni për akomodimin e punonjësve, rezervimi në hotele kryhet nëpërmjet agjencive turistike, ku në të gjitha rastet, faturat e paraqitura nga këto agjenci, rezultojnë me data më të vonshme se data e fundit e qëndrimit në hotel. Në këto fatura nuk identifikohet emri i hotelit në të cilën kanë qëndruan punonjësit, si dhe numri i yjeve të hotelit, veprime të cilat bien ndesh me përcaktimet e pikës nr. 9 dhe lidhjes nr. 1 të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Gjithashtu, rezulton se punonjësit, pavarësisht nga pozicioni i punës/kategorisë, janë akomoduar në të njëjtin hotel, si Ministri dhe zv. Ministri, Drejtori i Përgjithshëm dhe Përgjegjësi i Sektorit etj., jo në përputhje me përcaktimet e pikës nr. 9 dhe lidhjes nr. 1 të VKM nr. 870, datë 14.12.2011, e cila i kategorizon sipas pozicionit të punës.

b) Nga auditimi për kryerjen e shpenzimeve për pritjet dhe përcjelljet dhe trajtimin financiar të delegacioneve të huaja, institucioni i referohet përcaktimeve të VKM-së nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje përcjellje që u bëhet delegacioneve të huaja”, ndryshuar me VKM nr. 258, datë 03.06.1998. Ky vendim, nisur nga periudha e hershme e miratimit dhe ndryshimeve të tij mbi 10 vjeçare, periudhë e cila është shoqëruar me ndryshime të mjedisit ekonomik e financiar, si dhe indeksimit të inflacionit, e ka humbur koherencën për zbatimin e tij. Gjithashtu, dhe vendimet për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit, përfshirë dhe udhëzimet përkatëse kanë shfaqur mangësi të vazhdueshme në zbatim, në cënim të performancës së nëpunësve publik, nisur edhe nga auditimet që ka kryer KLSH në këtë periudhë 10 vjeçare, ku janë ndeshur fenomene në këto fusha, me efekte negative në buxhetin e shtetit, të trajtuara në Raportet e përvitshme të Zbatimit të Buxhetit të Shtetit, Raportet e Performancës së KLSH-së dhe pasqyruar në buletinet statistikore ndër vite.

Në këtë kuadër, VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje përcjellje që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar, VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen për shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, paraqesin nevojën e rishikimit të tyre me qëllim sjelljen në koherencë, indeksimin e tyre me inflacionin ndër vite, harmonizimin me dispozitat dhe praktikatat më të mira, për të garantuar përputhshmërinë me zhvillimet ekonomike e financiare dhe përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.4, faqe 280-291 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për rishikimin e VKM nr. 258, datë 03.06.1998, i ndryshuar, për shpenzimet për pritje përcjellje që u bëhet delegacioneve të huaja, si dhe të VKM nr. 997, datë 10.12.2010, i ndryshuar dhe VKM nr. 870, datë 14.12.2011, lidhur me trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit, me qëllim harmonizimin me dispozitat dhe praktikat më të mira, për të garantuar përputhshmërinë me zhvillimet ekonomike e financiare dhe përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: a. Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, rezultojnë se Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) me shkresën nr. 6262/55, datë 25.04.2023, ka paraqitur planin e masave, jashtë afatit 20 ditë, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”. Ndërsa me shkresën nr. 6262/56, datë 09.05.2023, ka dërguar informacion mbi zbatimin e rekomandimeve, jashtë afatit 6 mujor, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 30 pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

Rezultojnë se KLSH me shkresën nr. 364/18, datë 30.09.2022 ka lënë gjithsej 45 rekomandime: 38 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 36 masa organizative, nga të cilat 2 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht, 5 masa organizative rezultojnë në proces zbatimi dhe 29 masa organizative rezultojnë të pazbatuara; 5 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat janë pranuar, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 3 masa nuk janë zbatuar; 1 masë administrative e cila është pranuar, por rezultojnë të pazbatuara; 1 masë disiplinore lënë në kompetencë të titullarit, e cila është pranuar, por rezultojnë të pazbatuara.

b. Nga auditimi i ushtruar në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e rekomandimeve, konstatohet se MFE nuk ka dërguar planin e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe informacionin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Rezultojnë se nga KLSH me shkresën nr. 363/11, datë 30.09.2022 janë lënë gjithsej 32 rekomandime: 30 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 30 masa organizative, 4 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht, 1 masë organizative rezultojnë të zbatuar pjesërisht dhe 25 masa organizative rezultojnë të pazbatuara; 2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, të cilat nuk janë zbatuar.

c. Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Publik për zbatimin e rekomandimeve, konstatohet se MFE me shkresën nr. 169/13, datë 29.09.2022 ka hartuar planin e masave, brenda afatit kohor. Ndërsa me shkresën nr. 169/14, datë 06.03.2023, ka dërguar raportimin në lidhje me ecurinë e rekomandimeve, brenda afatit 6 mujor. Rezultojnë se nga KLSH me shkresën nr. 19/9, datë 09.09.2022, janë lënë 20 rekomandime të llojit masa organizative, nga të cilat janë pranuar 19 masa organizative, nga të cilat 13 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht, 2 masa rezultojnë në proces zbatimi dhe 5 masa rezultojnë të pazbatuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A, faqe 18-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nëpunësi i Parë Autorizues të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme, si dhe **rikërkojmë** zbatimin e rekomandimeve që janë të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe

përshpejtimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe forcimin e disiplinës buxhetore dhe fiskale.

Brenda datës 31.12.2023

2. Gjetje nga auditimi: Janë konstatuar vonesa në hartimin e dokumenteve të Programit Buxhetor nga institucionet buxhetore. Konkretisht, kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike është miratuar me VKM nr. 15, datë 20.01.2021, në tejkallim të afatit të përcaktuar në nenin 22 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Po kështu, udhëzimi për përgatitjen e PBA është miratuar në tejkallim të afatit të përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në tejkallim të afatit të përcaktuar në pikën 3.1.8 të Udhëzimit nr. 7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”.

-Hartimi i politikave fiskale të vitit 2022 dhe miratimi i tyre është bërë në datën 25 nëntor 2021 së bashku me projektbuxhetin e vitit 2022, në kundërshtim me *pikën 3, neni 4/1 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar.*

- Për planifikimin e të ardhurave dhe ndryshimet gjatë vitit, mungon evidenca mbi analizat e plota të realizuara nga MFE, megjithëse nga MFE pretendohet se programimi i të ardhurave për vitin pasardhës bëhet bazuar në metodologjitë standarde bashkëkohore që bazohet në treguesit kryesorë makroekonomikë që projekton Departamenti i Makroekonomisë dhe Banka e Shqipërisë, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 33-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Analizave dhe Programimit Buxhetor në bashkëpunim me Institucionet Buxhetore të marrin masa për respektimin e afateve të përcaktuara në mënyrë që procesi i përgatitjes së PBA-së të rezultojë koherent dhe efektiv.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, MFE me shkresën nr. 15943, datë 21.09.2021 “*Mbi rishikimin e prioriteteve buxhetore për periudhën 2022-2024 përputhje me Programin e Qeverisë 2021-2025*”, ka njoftuar institucionet për rishikimin e prioriteteve buxhetore. Në kuadër të kësaj shkrese kanë dërguar kërkesa të rishikuara Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, institucione të varësisë së MFE, si AIDA, DPPPP dhe DPD. Ndryshimi i prioriteteve buxhetore pas përfundimit të fazës së dytë të PBA-së nuk gjen mbështetje ligjore dhe është në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 7, datë 13.01.2021 “Për miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal”, i cili nuk ka rishikim të mëvonshëm.

Nga auditimi mbi kryerjen e analizave të PBA 2022-2024 dhe dhënien e rekomandimeve, për njësitë e qeverisjes së përgjithshme u konstatua se referuar analizës dhe komenteve të bëra nga MFE për fazën e parë dhe të dytë të PBA 2022-2024 kanë rezultuar mangësi që përfshijnë:

a) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka paraqitur kërkesa buxhetore shtesë në tejkallim edhe të vetë planifikimit të fazës së parë. Gjithashtu kërkesat buxhetore të fazës së dytë rezultojnë në tejkallim të tavanit të miratuar me VKM nr. 440, datë 22.07.2021, si dhe nuk ka prioritarizuar këto kërkesa nga ajo më e domosdoshme dhe më emergjente. Për programet “Mbështetje për Energjinë” dhe “Menaxhimi i mbetjeve urbane” kërkesat buxhetore në fazën strategjike janë dorëzuar në tejkallim të afatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, si dhe afatit të vendosur në kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike.

Me shkresën nr. 6894/1 prot., datë 01.10.2021, MIE ka dërguar në MFE jashtë afatit kërkesat buxhetore për fazën teknike, pas rishikimit të prioriteteve buxhetore për programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, referuar dhe shkresës së rishikimit të prioriteteve.

b) Për fazën e parë të PBA-së 2022-2024 MFE ka paraqitur kërkesa buxhetore në tejkalim të tavanit të miratuar me VKM nr. 119, datë 03.03.2021, problematikë e cila nuk është reflektuar në analizën e kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjithashtu, evidentohen programe për të cilat kërkesat buxhetore janë dërguar jashtë afatit të përcaktuar në udhëzimin nr. 8, datë 26.02.2021.

Për fazën e parë të PBA, MFE ka paraqitur kërkesa buxhetore në tejkalim të tavanit të miratuar me VKM nr. 119, datë 03.03.2021, ndërsa për programet 01120, 01130, 04130 nuk është dorëzuar dokumentacion shoqërues që përfshin formatin nr.3 për politikën e reja, pasqyrat shtesë si dhe relacionin shpjegues sipas rastit, sipas udhëzimit plotësues nr. 19, datë 09.07.2021.

c) Nga auditimi konstatohet se në kërkesat buxhetore të paraqitura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në fazën e parë evidentohet se për disa programe, projektet e planifikuara nuk janë të lidhura me qëllimin e politikës.

Nga auditimi evidentohen mospërputhje ndërmjet kërkesave shtesë të disa programeve të MFE dhe MIE, sipas relacioneve të dokumentuara dhe të vëna në dispozicion në format fizik, me të dhënat sipas Aneksit 4 “Kërkesat shtesë 2022-2024”, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të MFE. Mungon një evidencë e dokumentuar mbi analizën e kërkesave buxhetore shtesë bërë nga strukturat përkatëse të MFE dhe listimin e tyre sipas prioriteteve më emergjente dhe rekomandimet e përcjella prej tyre në strukturën përkatëse në Kryeministri për koordinimin e strategjive, si dhe korrespondenca me këtë strukturë

Nga analizat e MFE rezulton se për disa programe ka ndryshim të theksuar të kostos për njësi gjatë viteve, mungon sasia e produktit; fragmentim të theksuar të produkteve të investimeve, si dhe nuk janë plotësuar vlerat e kostos së plotë të projektit.

Kërkesat nga institucionet nuk janë të mirë argumentuara, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktet konkrete të projekteve dhe programeve, mungon një analizë e detajuar prioritarizimi, duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara.

Konstatohet se, për 29 projekte ka diferenca të fondeve të parashikuara nga PBA 2021-2023 në PBA 2022-2024, që tregojnë për një parashikim të dobët, duke zbehur vlerën e parashikimeve afatmesme për shpenzimet e buxhetit të shtetit, me qëllim ruajtjen e taveve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja, ndërsa për 16 raste, projektet e investimit miratohen fillimisht në PBA 2021-2023 si projekte të reja me vlerë të ulët, duke ruajtur tavanet e miratuara dhe më pas rriten në PBA 2022-2024 me vlera të konsiderueshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 33-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masat e nevojshme që analizat e të gjitha institucioneve për hartimin e kërkesave buxhetore të kryhen në afat, të lidhen me objektivat dhe qëllimet e politikave të programeve si dhe prioritet të pasqyrohen në kohë, me dokumentet përkatëse sipas fazave që ka parashikuar legjislacioni për planifikimin e buxhetit si dhe të krahasojë kërkesat buxhetore në vitin aktual edhe me kërkesat buxhetore të PBA-ve të viteve të kaluara duke rakorduar ecurinë e investimeve kapitale.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan diferenca në të dhënat e raportuara në treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar sipas Tabelës nr. 4 të Ligjit të Buxhetit me të dhënat e planit fillestar të vitit 2022 të sistemit SIFQ, konkretisht në zërat e shpenzimeve dhe deficitit. Raportet e ndërtuara dhe ofruara nga SIFQ për qëllime të planifikimit buxhetor nuk

përdoren nga DPB si një mënyrë për të kontrolluar saktësinë e detajimit të buxhetit fillestar dhe më pas atij operativ.

Konstatohet se propozimet e bëra dhe miratimet e ndryshimit të ligjit të buxhetit vjetor me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 dhe Aktin Normativ nr. 19, datë 29.12.2022 janë në tejkallim të afatit të rishpërndarjeve buxhetore, data 15 nëntor, përcaktuar në nenin 48 “Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore”. Nga auditimi i dokumentacionit shoqëruar të këtyre akteve normative konstatohet se mungon një analizë e detajuar për ndryshimet mes zërave të shpenzimeve buxhetore, korrente e kapitale, me synimin e optimizimit të realizimit të tyre për pjesën e mbetur të vitit 2022, pasi relacionet përmbajnë vetëm një përmbledhje të destinacionit të fondeve.

Pas aktit të fundit normativ nr. 19, datë 29.12.2022 janë bërë reflektime/ndryshime në zërat e shpenzimeve korrente në tabelën 4 shoqëruese të tij, duke pasqyruar një kolonë të emërtuar “Plani me ndryshime 2022 (shpërndarje rezervash)”. Nga analiza konstatohet se ndryshimet e vlerave rrjedhin prej faktorëve të mëposhtëm:

-Efekti i VKM-ve për përdorimin e Fondit Rezervë përgjatë vitit, të cilat nuk pasqyrohen në aktet e fundit të përditësuara ligjore për buxhetin e vitit, në total rreth 20 miliard lekë.

-Efekti i shkurtimeve dhe rritjes së fondeve në zëra të tjerë ku përmendim, uljen e fondeve të shpenzimeve të personelit me 1,062 milion lekë, 1,080 milion lekë ulje të fondeve për politika të reja pagash, 600 milion lekë për shpenzimet e interesit të borxhit të huaj, 6,800 milion lekë për politika të reja pensionesh dhe bonusin e pensionistëve, 1,800 milion lekë për shpenzime për kompensim pronarësh.

Këto ulje i kanë dhënë efektet në rritjen e kufirit të shpenzimeve në plan përtej atyre të pasqyruara në tabelën shoqëruese të aktit normativ nr. 19, datë 29.12.2022, kryesisht në 6,509 milion lekë në shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 11,946 në shpenzime për fonde speciale (sigurime shoqërore), 2,059 milion lekë për ndihmën ekonomike dhe 900 milion lekë për bonusin e lindjeve. Nga auditimi konstatohet se ulja e shpenzimeve të ndryshme nga Fondi Rezervë dhe ai i Kontigjencës nuk ndjek parimet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe shumat e shpërndara sipas tabelë nr 4 të Aktit normativ nr. 19, datë 29.12.2022, i cili, megjithëse në tejkallim të afateve për kryerjen e rishpërndarjeve të buxhetit dhe vetëm 2 ditë nga e drejta për të kryer shpenzimeve me mbylljen e vitit buxhetor është objekt i ndryshimeve të brendshme nga Ministria e Financave. Një veprim i tillë i MFE, para së gjithash është ndryshim i planit të shpenzimeve buxhetore pas miratimit të buxhetit të rishikuar në kuvend, dhe në të njëjtën kohë e bën komplekse shqyrtimin dhe analizën e ecurisë së treguesve, duke e shndërruar atë në një veprim për të rregulluar përqindjet e realizimit të disa prej treguesve të shpenzimeve. Kjo, pasi gjatë auditimit është konstatuar rritje e kufirit të shpenzimeve si pasojë e këtyre ndryshimeve edhe të zërave që normalisht duhet të kishin kaluar nëpërmjet procedurës së shqyrtimit parlamentar për marrjen e konfirmimit për rritje, si bonusi i lindjes rritur me 900 milion lekë, kjo pasi ndryshimet buxhetore duhet të ndjekin të njëjtën procedurë, procedura normale për miratimin e buxhetit ose votohet me procedurë të përshpejtuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.2, faqe 49-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për pasqyrimin e saktë të tabelës 4 shoqëruese të ligjit të buxhetit vjetor në sistemin informatik financiar të qeverisë, me qëllim eliminimin e diferencave ligj-sistem. Titullari i institucionit dhe nëpunësi i parë autorizues të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë e veprimeve të kryera pas aktit normativ nr. 19 datë 29.12.2022 si dhe të evidentojnë efektet në treguesit fiskal.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 është parashikuar rritja e të ardhurave jotatimore në masën 2 miliardë lekë në zërin “Kthim kapitali nga AIC”, si dhe 2 miliardë lekë për Korporatën Shqiptare të Investimeve (AIC), në formën e transfertës kapitale për mbështetjen e projekteve të zhvillimit, për të cilat nuk ka kërkesë nga institucioni përfitues. Me shkresën nr. 22351/129 prot., datë 30.12.2022 është përcjellë zbatimi i Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022, ku aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i është çelur kodi i produktit 21AA201 “Transferta kapitale për AIC”, në vlerën 2,120 milion lekë. Referuar sa më sipër, për AIC efekti neto i veprimeve të autorizuara me këtë akt normativ është 0 (zero) lekë lëvrim fondesh. Pavarësisht efektit neto 0, nga ana e MFE-së është zbatuar vetëm efekti i daljes së mjeteve monetare, me pakësim fondesh për buxhetin e shtetit, pa marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e të njëjtës shumë të specifikuar si kthim kapitali 2 miliardë lekë, pasi nga verifikimi në SIFQ kjo vlerë nuk është arkëtuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.2, faqe 49-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit dhe Nëpunësi i Parë Autorizues të marrin masa për nxjerrjen e përgjegjësiave për zbatimin e njëanshëm të aktit normativ dhe arkëtimin e shumës së specifikuar prej 2 miliardë lekë, duke njoftuar Kontrollin e Lartë të Shtetit për këtë çështje.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Statusi financiar i njësive të vetëqeverisjes vendore llogaritet sipas neneve 55, 56, 57, 58, 59 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si përqindjen e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve, mbi shpenzimet vjetore të miratuara.

Në raportin e hartuar nga Drejtoria e Financave Vendore për statusin e vështirësive financiare, për vitin 2022, 49 bashki janë klasifikuar pa probleme financiare, 8 bashki janë klasifikuar me probleme financiare dhe 4 bashki janë klasifikuar në vështirësi financiare. Konstatohet se, 56 bashki ose 92% e tyre, kanë realizuar buxhetin e miratuar në masën 33%-90% dhe vetëm 5 bashki ose 8% e tyre, kanë realizuar buxhetin e miratuar në masën mbi 90% të shpenzimeve të miratuara. Nëse, statusi i njësive të vetëqeverisjes vendore do të llogaritej mbi shpenzimet e realizuara, 45 bashki do të klasifikoheshin pa probleme financiare, 9 bashki do të klasifikoheshin me probleme financiare dhe 7 bashki do të klasifikoheshin në vështirësi financiare. Bashkitë Përmet, Belsh, Selenicë dhe Rrogozhinë nga statusi pa probleme financiare do të klasifikoheshin me probleme financiare, ndërsa bashkitë Libohovë, Delvinë dhe Peqin, të klasifikuar me probleme financiare do të klasifikoheshin në vështirësi financiare. Në lidhje me gjendjen financiare të qarqeve, 9 qarqe janë klasifikuar pa probleme financiare, qarku i Gjirokastrës është klasifikuar me probleme financiare dhe 2 qarqe (Durrës dhe Berat) janë klasifikuar në vështirësi financiare. Nëse, statusi i qarqeve do të llogaritej mbi shpenzimet e realizuara, 9 qarqe do të klasifikoheshin pa probleme financiare, qarku i Gjirokastrës do të klasifikohet me probleme financiare, qarku i Durrësit do të klasifikohet në vështirësi financiare dhe qarku i Beratit do të klasifikohet në vështirësi serioze financiare.

Rezulton se të gjitha njësitet e vetëqeverisjes vendore të cilat janë klasifikuar me probleme financiare kanë trashëguar të ardhura të pa përdorura në vitin buxhetor pasardhës. Në qoftë se këto njësi do të përdornin një pjesë të ardhurave që trashëgohen për shlyerjen e detyrimeve, stoku i detyrimeve të prapambetura do të ulej dhe gjendja financiare do përmirësohej.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.3, faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë si institucioni i cili ka propozuar ndryshime në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në lidhje me vlerësimin e gjendjes financiare të njësive të qeverisjes vendore mbi shpenzimet e realizuara, si dhe përdorimin e një pjesë të të ardhurave që trashëgohen në vitin pasardhës buxhetor për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, të insistojë për miratimin sa më të shpejtë të këtyre

ndryshimeve, me qëllim që në vitin 2023, të paraqitet një situatë sa më reale e statusit financiar të njësisve.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, MFE për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, ka nxjerrë udhëzimin plotësues nr. 1, datë 10.01.2022, ku përcaktimet e pikës 95 cënojnë autonominë e njësisve të vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet vendosjes së limitit mbi çeljen dhe përdorimin e transfertës së përgjithshme dhe sektoriale, duke e ndarë në katër 3 mujorë: në tremujorin e parë 30%, në tremujorin e dytë 25%, të tretin 23% dhe të katërtin 22%), në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 67/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën B.3, faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financave Vendore të marrë masa e nevojshme, për iniciimin e rishikimit të udhëzimit plotësues për zbatimin e buxhetit në lidhje me limitet e vendosura mbi çeljen dhe përdorimin e transfertës së pakushtëzuar, me qëllim garantimin e autonomisë të njësisve të vetëqeverisjes vendore në përdorimin e të ardhurave nga transfertat e buxhetit të shtetit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022, 8 nga 11 ministri, rezultojnë me diferenca midis të dhënave të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisjes (SIFQ) dhe të dhënave të paraqitura në raportet e monitorimit. Konstatohet se 4 ministri kanë dërguar raportin e monitorimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë jashtë afatit kohor, ndërsa 3 ministri nuk kanë publikuar raportin e monitorimit në faqet zyrtare të internetit. Nga auditimi konstatohet se, në raportet e monitorimit mungon analiza dhe vlerësimi i performancës për zbatimin e buxhetit bazuar në rishpërndarjet e tij, me qëllim evidentimin e impaktit të mundshëm në performancën e objektivave lidhur me to, në kundërshtim me pikën 4.2 të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore” dhe pikën 75 të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Nga auditimi është konstatuar mungesë monitorimi të zbatimit të buxhetit nga MFE për ministrinë e linjës, pasi nuk evidentohet dhe merren masa për përdorimin e shpenzimeve në përputhje me qëllimin e programeve buxhetore për të cilën janë miratuar, konkretisht:

- Programi 04220 “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit”, programi 04250 “Zhvillimi Rural” në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, programi 04520 “Transporti Rrugor” në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, programi 04760 “Zhvillimi i Turizmit” në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, etj, ku janë përdorur fondet për pagesën e shpenzimeve të kryera për karburant, vaj, pjesë këmbimi, goma, bateri, siguracion automjeti, elektricitet, materiale pastrimi, kancelari, shpenzime gjyqësore, shërbim korrier, shpenzime për aktivitete sociale të personelit, shpenzime të kryera për detyrime të prapambetura për ekspert të kontraktuar në çështje gjyqësore jashtë vendit; shpenzime për transportin e mjeteve të rënda dhe pompave, pagesa për ekzekutime të vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqe 71-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të marrë masa për monitorimin e zbatimit të buxhetit sipas produkteve përkatëse në Ministrinë e Linjës në lidhje me zbatimin e objektivave, si dhe të përdor rishpërndarjet si tregues në vlerësimin e performancës.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022, nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj është konstatuar se, 8 projekte investimi, me kredi, në vlerën 1,953,180 mijë lekë dhe 18

projekte investimi me grant, në vlerën 247,278 mijë lekë janë realizuar pa pasur plan buxhetor të miratuar me ligjin e buxhetit, akte normative apo rishikime buxhetore. Ndërsa 8 projekte investimi me financim të huaja në formën e kredisë, në vlerën 985,615 mijë lekë dhe 45 projekte investimi me financim të huaj në formën e grantit, në vlerën 519,754 mijë lekë janë realizuar në tejkalim të planit të buxhetit të miratuar. Realizimi i projekteve të investimeve me financim të huaj pa plan apo në tejkalim të planit buxhetor të miratuar është në kundërshtim me pikën 29 të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”.

Konstatohet se, 95 projekte investimesh me financim të huaj në vlerën totale 3,272,501 mijë lekë, referuar përshkrimit të projektit janë keq klasifikuar kryesisht në llogarinë 231 “Investime për rritjen e aktiveve afatgjata materiale”, duke qenë për nga natyra shpenzimeve operative, aktive afatgjata jo materiale si dhe transfertat ndaj të tretëve. Gjithashtu, nga auditimi, janë konstatuar 29 projekte investimi me financim të huaj, në vlerën totale 120,568 mijë lekë, disbursimet e të cilëve janë regjistruar në vlerë negative, nga të cilat 28 projekte në vlerë 117,197 mijë lekë i përkasin investimeve të huaja në formë granti, ndërsa 1 projekt në vlerën 3,371 mijë lekë i përket investimit të huaj në formë kredie.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqe 71-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për fuqizimin e kontrollit të brendshëm në drejtim të raportimit të saktë dhe të plotë të investimeve publike me financim të huaj, nëpërmjet përfshirjes së tyre në ciklin e menaxhimit të shpenzimeve buxhetore për t’u siguruar për përputhshmërinë me planet vjetore dhe tavanet përkatës buxhetore.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Fondi i rindërtimit me ligjin fillestar të buxhetit është planifikuar në shumën 20,000 milion lekë, ndërsa me Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022, ky fond është planifikuar në shumën 32,400 milion lekë, duke u rritur për vlerën 12,400 milion lekë. Sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi, rezulton se fondi i rindërtimit është realizuar në shumën 28,874 milion lekë, nga të cilat, shpenzimet për qeverisjen qendrore janë realizuar në shumën 7,969 milion lekë për shpenzime kapitale, ndërsa shpenzimet e qeverisjes vendore janë realizuar në shumën 20,905 milion lekë.

Referuar VKM-vë të dala për rindërtimin, gjatë periudhës 2020-2022 janë miratuar rreth 119,833 milion lekë projekte rindërtimi për qeverisjen qendrore dhe vendore, nga të cilat financimi me VKM për vitin 2020 ka qenë rreth 25,795 milion lekë, për vitin 2021 rreth 28,770 milion lekë dhe për vitin 2022 rreth 22,027 milion lekë, ndërsa realizimi për vitin 2020 ka qenë rreth 16,702 milion lekë, për vitin 2021 rreth 29,521 milion lekë dhe për vitin 2022 rreth 28,874 milion lekë. Bazuar në të dhënat e mësipërme, në qoftë se vlera totale e kostos së projekteve nuk ndryshon me VKM gjatë periudhave në vijim, me qëllim përfundimin e procesit të rindërtimit, financimi i pritshëm për periudhat e ardhshme (viti 2023 e në vijim) është rreth 44,736 milion lekë. Konstatohet se, në ligjin nr. 85/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, fondet për rindërtimin janë planifikuar në shumën 5,000 milion lekë, ndërsa në tabelën 4 “Treguesit Fiskal të konsoliduar”, bashkëlidhur po këtij ligji, vlera e planifikuar për fondin e rindërtimit për vitet 2024 dhe 2025 është 0 lekë. Rezulton se, kosto totale e projekteve nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së planifikuar me ligjin e buxhetit për fondet e rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani vijon të paraqitet në shumën 0 lekë për vitet 2024 dhe 2025. Në lidhje me shpenzimet e strehimit për familjet, shtëpitë e të cilave janë dëmtuar nga tërmeti rezulton se në fillim të vitit për produktin me kod 91010AE “Subvencionim i qirasë për familjet e prekura”, janë çelur fonde në vlerën 1,000 milion lekë. Më pas, me Aktin Normativ nr. 12, datë 29.07.2022, këtij produkti i janë shtuar fonde në vlerën 1,698.06 milion lekë, duke e çuar në total vlerën e

planifikuar për këtë produkt 2,698.06 milion lekë. Sipas bazës së të dhënave, rezulton se gjatë vitit 2022, janë subvencionuar 2,208 milion lekë nga fondet e buxhetit të shtetit, pra shpenzimet e kryera për subvencionet e qirave kanë luhatje të konsiderueshme në vlera sipas muajve, ku në muajin Dhjetor janë kryer 335.1 milion lekë subvencione, në muajin Korrik janë kryer 29.2 milion lekë subvencione, ndërsa në muajin Janar, vetëm 2 bashki kanë kryer pagesa për subvencionime, bashkia Tiranë dhe bashkia Kurbin. Në krahasim me vitin 2021, shpenzimet për subvencionimin e qirave janë ulur për vlerën 776 milion lekë, megjithatë, për shkak të ecurisë së ngadaltë në zbatimin e punimeve dhe tejkalimit të afatit të përmbylljes së procesit të rindërtimit, kostot totale të rindërtimit rëndohen edhe më tepër nga pagesat për subvencionimin e qirave të familjeve banesat e të cilëve i kanë në proces rikonstruksioni.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqe 71-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për reflektimin në vitet pasardhëse buxhetore në tabelën nr. 4 shoqëruese e ligjit vjetor të buxhetit, të efekteve të krijuara nga shpërndarja e fondeve të rindërtimit me VKM dhe në komponentët e treguesve fiskal, me qëllim programimin brenda limiteve buxhetore të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit, shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe financimin në kohën e duhur për të ulur kostot e pagesave për zërin shpenzime qiraje.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2022, në 18 prej VKM-ve të dala për përdorimin e fondit të rindërtimit, në lidhje me financimin e projekteve të investimit është përcaktuar si burimi financimi, edhe ngurtësimi i fondeve nga projekte të tjera të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, ku shprehimisht citohet se: “Efekti financiar të përballohet nga hapësirat e siguruara pas ngurtësimit të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe i transferohet bashkisë... në formën e transfertës së pakushtëzuar”. Në VKM nuk përcaktohet se cilat janë projektet me ecuri të ngadaltë që do t’u ngurtësohen fondet, si dhe vlera e ngurtësimit për çdo projekt. Për vitin 2022, shumica e ngurtësuar për projektet me ecuri të ngadaltë dhe përdorim si burimi financimi për projektet e tjera është 2,763 milion lekë. Përdorimi i ngurtësimit të fondeve, si formë financimi për projektet e investimit nuk është e mbështetur në bazë ligjore, pasi në ligjin organik të buxhetit dhe ligjin e buxhetit të vitit nuk parashikohet ngurtësimi, si mënyrë për alokimin e fondeve ndërmjet projekteve të investimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqe 71-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa në të ardhmen për shmangien e praktikës së ngurtësimit të fondeve, si një mënyrë financimi për projektet e reja të rindërtimit dhe ato në proces, e cila nuk ka bazë ligjore që të shërbejë si burim financimi.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi investimet kapitale me financim të brendshëm të realizuara nga të ardhurat dytësore, për vitin 2022 të regjistruara në SIFQ, konstatohet se janë realizuar investime kapitale me financim të brendshëm në vlerën për 1,352 milion lekë. Këto investime nuk kanë plan buxheti të miratuar, ndërkohë që në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar janë raportuar të realizuara ndaj planit të buxhetit. Nga auditimi mbi investimet kapitale me financim të brendshëm të realizuara me burim financimi të ardhurat e arsimit të lartë konstatohet se janë kontabilizuar në llogarinë 231 “Investime Kapitale Të Trupëzuara” 14 projekte investimi me vlerë 180,661 mijë lekë me përshkrimin “Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve” në disa njësi shpenzuese të ndryshme. Për këto investime është përdorur i njëjti kod projekti investimi për disa institucione të arsimit të lartë, duke mos identifikuar specifikisht investimet e kryera në nivel produkti investimi me impakt në cilësinë e informacionit të raportuar dhe vështirësi në ndjekjen e ecurisë së tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqe 71-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të reflektohet në treguesit fiskalë të konsoliduar, sipas tabelës 4 të ligjit të buxhetit të vitit, plani buxhetor për të gjitha investimet kapitale të brendshme me burim financimi të ardhurat e veta sikurse parashikohen për investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë. Në të njëjtën kohë, të detajohen në nivel analitik investimet e realizuara nga të ardhurat e veta të arsimit të lartë dhe të shmanget çelja e projekteve të investimit në një kod të përgjithshëm ndërkohë që projektet zbatohen nga njësi shpenzuese të ndryshme.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi detajimin e fondeve për investimeve publike me financim të brendshëm të miratuara me ligjin nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, konstatohet se janë detajuar në institucione të ndryshme 6 Projekte Investimi me përshkrimin “Fond i ngrirë”, me vlerë fillestare 4,325 mijë lekë, në 12 programe të ndryshme buxhetore. Institucionet më përfaqësuese ku janë detajuar këto fonde përgjatë vitit përfshijnë: *Aparatin e Ministrisë së Infrastrukturës si dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar*. Detajimi i fondeve të ngrira për investime kapitale është në kundërshtim me përcaktimet e bëra për përkufizimin e projektit të investimit publik, pika 49, neni 1 i Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kërkesat e udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022”, pika 25, ku janë të parashikuara kriteret dhe përparësitë në financimin e projekteve dhe nuk parashikohet çelja e fondeve të ngrira për investimet kapitale të miratuara. Rezervimi i fondeve të këtyre investimeve sipas këtij detajimit fillestar nuk krijon mundësinë e zhvillimit të procedurave për prokurimin përgjatë vitit apo kryerjen e pagesave në rast të detyrimeve të mbartura dhe në vijim kryhen rishpërndarje ndërmjet projekteve për çdo njësi shpenzuese.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqe 71-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të shmanget praktika e detajimit fillestar të fondeve të investimeve në projekte me përshkrim “Fond i ngrirë” dhe të alokohen fondet e investimit në projekte specifike për të krijuar mundësinë e përdorimit të fondeve buxhetore të miratuara.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin, realizimin dhe raportimin e investimeve kapitale me financim të brendshëm konstatohet se:

- Raportohet si investim, projekti me kod M062991 i Autoritetit Rrugor Shqiptar me përshkrim “Vendime gjyqësore në proces” me vlerë për 180,000 mijë lekë. Për planifikimin dhe realizimin e këtyre shpenzimeve duhet të ishin përdorur llogaritë e shpenzimeve operative. Nga auditimi konstatohet se, vlera për 32,085 mijë lekë, përfaqëson detyrime të prapambetura të periudhave të mëparshme duke filluar nga viti 2016.

- Në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në programin buxhetor 6210 “Programe zhvillimi” raportohet si investim i realizuar kosto lokale e menaxhimit të projekteve të investimit në shumën 883,196 mijë lekë, me kod projekti M56032 “Projekti i rrugëve dytësore dhe lokale”, ndërkohë që këto fonde përdoren në llogari bankare të nivelit të dytë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për aktivitetin e shpenzimeve korrente të institucionit.

- Në programin 4250 “Zhvillimi rural” në AZHBR konstatohet se janë raportuar investime kapitale me kod projekt 18AL301 “Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 1” në shumën 591,615 mijë lekë, kapitulli 3 “kosto lokale”. Këto pagesa kryhen në kuadër të bashkëfinancimit të fondeve të BE për mbështetjen e fermerëve/agroturizimit në kryerjen e investimeve nga ana e investitorëve. Pjesa e buxhetit të shtetit në kuadër të bashkëfinancimit

është në masën 25%, ndërkohë që konstatohet se për nga natyra, nuk kemi të bëjmë me investim kapital, por me grant të dhënë të tretëve. Në këtë mënyrë, treguesit e investimeve publike janë të mbivlerësuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqe 71-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së diskutimit të kërkesave buxhetore dhe në vijim të detajimit të fondeve sipas kërkesave të institucioneve buxhetore të zhvillohet një analizë mbi natyrën ekonomike të fondeve të kërkuara me qëllim klasifikimin dhe raportimin e drejtë të shpenzimeve sipas natyrës dhe destinacionit për rastet e mësipërme dhe të tjera.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me kontratat e nënshkruara për investimet përgjatë vitit 2022, sipas modulit të kontratave në SIFQ konstatohet se janë nënshkruar 1,319 kontrata pas datës 15 Tetor për investimet publike, në kundërshtim me nenin 51, pika “g” të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe pikën 1 dhe 2 të VKM-së nr. 807 datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore publike”.

Nga këto rezultojnë se 688 kontrata janë nënshkruar nga institucionet e qeverisjes qendrore, me vlerë të kontraktuar për vitin 2022 prej 7,997,295 mijë lekë dhe vlerë totale të kontraktuar gjithsej 27,986,570 mijë lekë dhe 631 nga institucionet e vetëqeverisjes vendore, me vlerë të kontraktuar për vitin 2022 prej 2,048,472 mijë lekë dhe vlerë totale të kontraktuar gjithsej 6,481,841 mijë lekë. Lidhja e kontratave pas kësaj datë krijon kushtet për lindjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë për përdorim pa efikasitet të fondeve buxhetore në nivelin e 20% të kostos së projektit në vitin e parë të zbatimit të tij, pasi koha e mbetur për përdorimin e këtij fondi deri në fund të vitit buxhetor është shumë e shkurtër.

Nga auditimi mbi investimet e raportuara gjatë vitit 2022, konstatohet se 85 institucione të qeverisjes qendrore kanë paguar detyrime të prapambetura në verën 6,169,244 mijë lekë të cilat përfaqësojnë rreth 6.8% të investimeve kapitale me financim të brendshëm të realizuara, në kundërshtim me pikën a, të nenit 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, duke mbivlerësuar investimet e raportuara faturat e të cilave konstatohet se datojnë që prej vitit 2014.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqe 71-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të ndërmerren inspektime financiare dhe masa administrative në lidhje me detyrimet e prapambetura, për rastet e thyerjes së disiplinës buxhetore sipas përgjegjësiwe përkatëse të funksionarëve publik të ngarkuar dhe autorizuar për kryerjen e shpenzimeve publike.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se nga FSHZH, në 17 raste për 9 projekte investimi në vlerën 398,792 mijë lekë, është bërë parapagim i kontratave. Fondi Shqiptar i Zhvillimit me shkresën nr. 1402/4 prot., datë 14.11.2022, i ka dërguar MFE-së kërkesë për miratimin e dhënies së pagesës paraprake në kontratat e mësipërme të zbatimit të punimeve. Ministri i Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 20993/1 prot., datë 23.11.2022 ka miratuar dhënien e fondeve në formën e paradhënies duke përdorur si referencë ligjore pikën 160 dhe 161 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. Nga auditimi konstatohet se kontratat e mësipërme nuk rezultojnë të jenë të një rëndësie të veçantë. Për sa më sipër parapagimi i kontratave është në kundërshtim me pikën 160, 161 të Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar dhe nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqe 71-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për nxjerrjen e përgjegjësi dhe parandalimin e kryerjes së parapagimeve për kontrata investimi, pasi ndikojnë në shqyrtimin dhe analizën e vëllimit të investimeve të realizuara në vitin përkatës fiskal.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i investimeve me financim të brendshëm u konstatua se për 67 projekte në vazhdim nga vitet e mëparshme, fondet nuk janë çelur në fillim të vitit, por janë çelur kryesisht gjatë muajit Mars dhe Korrik, në kundërshtim me pikën 63 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Gjithashtu, nga auditimi i investimeve kapitale me financim të brendshëm janë evidentuar problematika në drejtim të detajimit të investimeve pa kaluar ciklin e menaxhimit të investimeve publike, marrjes së angazhimeve nëpërmjet kontraktimit të fondeve publike të pa miratuara në momentin e nënshkrimit të kontratave nga nëpunësit autorizues, detajimit të fondeve të investimeve vetëm për 20% të vlerës dhe pa pasur fonde të miratuara për periudhën e mbetur sipas vlerës dhe kohëzgjatjes totale të projektit, etj, konkretisht:

- **Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për programin buxhetor 04520 “Transport rrugor”** janë audituar 14 projekte investimi, ku është konstatuar se: 3 projekte nuk kanë qenë pjesë e PBA-së; 11 projekte nuk kanë qenë pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet; 6 kontrata janë regjistruar jashtë afatit kohor; për 9 projekte kontratat e lidhura janë 6,153,761 mijë lekë më shumë se vlera e tyre e planifikuar në PBA; për 4 projekte shumëvjeçare rezulton se alokimi prej 20% i fondeve është bërë për qëllim të lidhjes së kontratës duke qenë se pak ditë më vonë këtyre projekteve u janë hequr fonde; për 7 projekte janë marrë angazhime pa pasur fonde në dispozicion në shumën 2,461,488 mijë lekë.

- **Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për programin buxhetor 06730 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”**, janë audituar 2 projekte investimi, ku është konstatuar se: 1 projekt nuk ka qenë pjesë e PBA-së dhe pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet; për 1 projekt regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit; për 1 projekt është marrë angazhim pa fond buxhetor në vlerën 17,386 mijë lekë; për 1 projekt është paguar me vlerë 102,600 mijë lekë, ose 19.3% e vlerës së kontratës, 16 ditë pas lidhjes së saj.

- **Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** është audituar 1 projekt, ku është konstatuar se: projekti nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet; kontratat e lidhur është 81,430 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti të planifikuar në PBA; regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit; është marrë angazhim pa fonde buxhetore në vlerën 119,048 mijë lekë.

- **Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** është audituar 1 projekt, ku është konstatuar: për 1 kod projekti janë zhvilluar 2 procedura prokurimi; të dy kontratat janë regjistruar jashtë afatit; është marrë angazhim pa fond buxhetor në vlerën 63,320 mijë lekë.

- **Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë** janë audituar 4 projekte, ku është konstatuar se: për 1 projekt vlera e kontratës është 26,530 mijë lekë më shumë se vlera e planifikuar në PBA; për 2 projekte edhe pse kontrata është nënshkruar me afat zbatimi 26 javë fondet janë parashikuara të shtrira për 3 vite buxhetore; për 2 projekte regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit, për 4 projekte janë marrë angazhime pa fonde buxhetore në vlerën 249,496 mijë lekë;

- **Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit** janë audituar 6 projekte ku është konstatuar se: për 6 projekte kontratat janë regjistruar jashtë afatit; për 6 projekte janë marrë angazhime pa fonde buxhetore në vlerën 644,231 mijë lekë.

Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit janë audituar 8 projekte, ku është konstatuar se: për 3 kode projekti janë zhvilluar 7 procedura të ndryshme prokurimi; 8 kontrata janë regjistruar jashtë afatit; për 8 projekte janë marrë angazhime pa fonde buxhetore në vlerën 2,060,892 mijë lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.4, faqe 71-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa me qëllim shmangien e shtyrjes së planit buxhetor përtej periudhës së parashikuar për kohëzgjatjen e kontratave; të merren masa për regjistrimin në kohë të fondeve të obliguara në SIFQ, të shmangët detajimi i projekteve të reja të investimit publik me akte normative gjatë si dhe në përfundim të vitit buxhetor, të cilat nuk krijojnë mundësinë e përdorimit të buxhetit prej 20% të kërkuar në vitin e parë të zbatimit të tij shoqëruar me kryerjen e inspektimeve dhe marrjen e masave administrative përkatëse.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, me ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” është planifikuar vlera 500 milion lekë për projektin për fëmijët dhe rininë me burim Fondin Rezervë, në kundërshtim me nenin 5 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi Fondi Rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit, dhe projekti për fëmijët dhe rininë është plotësisht i parashikueshëm dhe i mundshëm për t’u programuar më parë, duke sjellë për pasojë denatyrin e fondit rezervë në planifikim.

Nga auditimi u konstatua se, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 5, kreu II i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Fondi Rezervë i miratuar me Aktet Normative nr. 12, datë 29.07.2022 dhe nr. 19, datë 29.12.2022 ka tejkalluar kufirin e miratuar, përkatësisht përlllogaritet në 3.065% dhe 3.84% të totalit të shpenzimeve të miratuara.

-Për vitin 2022, Fondi Rezerve të Buxhetit të Shtetit, në 5 raste, në shumën 1,491 milion lekë është përdorur në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit dhe udhëzimin standard për zbatimin e tij, ndërsa në dokumentacionin shoqëruar janë konstatuar mangësi, konkretisht në VKM nr. 287, datë 10.05.2022 " Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për Bashkinë Tiranë, për financimin e projektit "Tirana Youth European Capital 2022", në shumën 700 milion lekë; në VKM nr. 606, datë 28.10.2022 "Për miratimin e Programit Kombëtar të aktiviteteve jashtë orarit mësimor dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit", në shumën 276 milion lekë; në VKM nr. 375, datë 01.06.2022 "Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nga Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit për zbatimin e ligjit nr. 25/2022 " Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve", në shumën 300 milion lekë; në VKM nr. 330, datë 18.05.2022 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për MAS" akorduar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit 160 milionë lekë dhe VKM nr. 833, datë 19.12.2022 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për MAS" akorduar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit 45 milionë lekë.

Referuar objektit të këtyre VKM -ve për përdorimin e Fondit Rezervë, këto fonde duhej të ishin parashikuar e përfshirë me buxhetin e institucioneve dhe nuk justifikojnë përdorimin e Fondit Rezervë, veprime në kundërshtim dhe me UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pikat 89 dhe 90.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.5, faqe 133-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: MFE të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për përdorimin e fondit rezervë për rastet që duhet të përfshihen në ciklin normal të shpenzimeve referuar kriterit të parashikueshmërisë dhe dhënien e mendimit të MFE në kushtet e mungesës së

dokumentacionit shoqërues të projekt akteve. Në të njëjtën kohë, plotësimi i praktikave të përdorimit të fondit rezervë të jetë objekt i verifikueshmërisë së dokumentacionit të plotë për të vlerësuar kriteret e përdorimit dhe arkivimin e tij.

Menjëherë

19. Gjetja nga auditimi Nga auditimi konstatohet se, Fondi i Kontigjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës gjatë vitit 2022 në një rast është përdorur për përballimin e rritjes së pagave në disa institucione qendrore dhe njësi varësie, ku konstatohen mangësi në dokumentacion, përkatësisht për VKM nr. 621, datë 28.09.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 187, datë 8.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar. Argumentet e përdorura për rritjen e elementit të pagës mujore “shtesa e pozicionit” për disa kategori të veçanta në disa institucione janë të diferencuara dhe përjashtuese për strukturat e ngjashme në institucionet e tjera. Pavarësisht se në relacionin për nxjerrjen e këtij vendimi citohet se në themel të çdo përcaktimi të nivelit të pagës dhe elementëve përbërës të saj, qëndron parimi “shpërblim i njëjtë për punë të njëjtë/ngjashme”, mënyra e trajtimit të këtyre strukturave krijon pabarazi në trajtimin e punonjësve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.5, faqe 133-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të marrë masa për rishikimin e pagave dhe elementëve përbërës të saj në respektim të parimit “shpërblim i njëjtë për punë të njëjtë/ngjashme”, pasi mënyra e trajtimit me VKM nr. 621, datë 28.09.2021 krijon pabarazi në trajtimin e punonjësve.

Në vijimësi

20. Gjetja nga auditimi: Sipas raportit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, për vitin 2022 rezultojnë 11 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore me pagesa faktike dhe në tabelën e koncesioneve/PPP me mbështetje buxhetore, raportohen 12 kontrata duke përfshirë kontratën koncesionare/PPP “Ndërtimi dhe Operimi i rrugës Milot-Balldren”, me plan dhe fakt 0 lekë. Plani përfundimtar për këto projekte paraqitet në shumën 12,706,156 mijë lekë, ndërkohë që pagesat rezultojnë në shumën 12,640,991 mijë lekë, me një realizim në masën 99.5%. Shuma totale e pagesave vjetore neto përbën 2.66% të totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2021, prej rreth 475.61 miliardë lekë, duke qenë brenda kufirit të pagesave prej 5% të të ardhurave tatimore faktike.

- Nga auditimi konstatohet se në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2021”, pagesat e realizuara të vitit 2021 rezultojnë në vlerën 11,517,745 mijë lekë ndërkohë që në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, pagesat e vitit 2021 rezultojnë 11,443,679 mijë lekë, pra 74,066 mijë lekë më pak.

- Nga auditimi konstatohet se në 3 projekte koncesionare, janë shlyer detyrime të viteve të mëparshme, konkretisht për: ndërtimin dhe operimin e Rrugës së Arbrit në vlerën 2,940,000 mijë lekë, ndërtimin dhe operimin e Portit të Jahteve Orikum – Dukat në vlerën 150,532 mijë lekë, shërbimin e Skanimit në Dogana në vlerën 231,864 mijë lekë. Realizimi i shërbimit përtej vlerës së buxhetuar ka shkaktuar krijimin e detyrimeve të prapambetura për vitin aktual dhe në të njëjtën kohë mbartjen e tyre në vitin pasardhës.

- Për koncesionin “Shërbimi i Skanimit në Dogana”, pagesat e realizuara në vitin 2022 sipas databazës së pagesave në SIFQ rezultojnë në shumën 1,898,906 mijë lekë, ndërkohë në

raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, rezultojnë 1,925,903 mijë lekë, me një diferencë prej 26,997 mijë lekë.

-Për projektin “Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës”, edhe pse kontrata është nënshkruar në datën 17.10.2018 në shumën 2,364,096 mijë lekë, rezulton se është regjistruar në modulën e kontratave në datën 31.05.2022 në vlerën 197,537 mijë lekë, si një kontratë e copëzuar, jo në vlerën e saj të plotë.

-Pagesat faktike për muajin Dhjetor për kontratat koncesionare rezultojnë rreth 15.94% të totalit të pagesave faktike për vitin 2022, ku vetëm pagesa prej 840 milion lekë për kontratën “Për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit” përbën 80% të totalit të pagesave të realizuara në muajin Dhjetor.

- 6 nga 12 kontrata koncesionare/PPP rezultojnë me rritje pagesash faktike në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021, gjë që përbën një risk fiskal për buxhetin, për më tepër që në mungesë të treguesve të matshëm të performancës së tyre bën të diskutueshme dhe arritjen në kohë të objektivave të tyre me eficiencë, economicitet dhe efektivitet.

Gjithashtu, duke qenë se këto kontrata koncesionare/PPP janë me mbështetje buxhetore dhe koncesionari nuk ka përgjegjësi apo angazhim financiar, këto shpenzime nga ana e buxhetit të shtetit konsiderohen një borxh i fshehur për vitet në vijim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.6, faqe 142-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me autoritetet kontraktuese, të monitorojë detyrimet që lindin nga kontratat koncesionare, veçanërisht kontratat që krijojnë detyrime të prapambetura për t’u mbartur në vitet e ardhshme buxhetore, të cilat përbëjnë një risk fiskal për buxhetin dhe implikojnë borxhin publik për vitet në vijim.

Në vijimësi

21. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për vitin 2023 nuk është publikuar raporti i Performancës së Kontratave të Koncesionit dhe të Partneritetit Publik Privat për vitin 2022, raporti i cili përfshin mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të ecurisë dhe performancës financiare dhe jofinanciare të kontratave të koncesionit/PPP dhe synon të sigurojë që risqet kryesore fiskale nga kontratat e koncesionit/PPP janë identifikuar dhe raportuar në mënyrë sistematike. Mos-publikimi i këtij raporti dhe mungesa e raportimit të tij bashkëlidhur raportit të zbatimit të buxhetit me efekt mungesë transparence nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është në kundërshtim me pikën 7 të nenit 10 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar dhe shkronjën c, të pikës 126.3, të kapitullit IV “Raportimi dhe monitorimi i risqeve fiskale nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësi të tjera të sektorit publik” të udhëzimit plotësues nr. 2 datë 19.01.2023.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.6, faqe 142-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të nxjerr përgjegjësitë e mos-publikimit të raportit të Performancës së Kontratave të Koncesionit dhe të Partneritetit Publik Privat për vitin 2022 dhe mungesës së tij bashkëlidhur raportit “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”.

Drejtoria e Koncesioneve, në funksion të kërkesave të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, transparencës me publikun, përdoruesit e këtij raporti dhe palët e treta të interesuara, të marr masa të menjëhershme për publikimin e tij me qëllim garantimin e identifikimit dhe raportimit të risqeve fiskale.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i monitorimit të stokut të detyrimeve të prapambetura u konstatua se:

- Monitorimi aktual i kryer nga MFE nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 31 dhe 33 të Udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar dhe krijon kushte për mosrespektimin e parimit FIFO në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimin plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, nuk ka kërkuar nga njësitë e qeverisjes qendrore hartimin e një plani për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, me qëllim përfshirjen e tij në propozimet e PBA-së, në kundërshtim me tabelën nr. 5 të kapitullit 6.3 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”. Në këtë drejtim, planifikimi buxhetor për një periudhë afatmesme nuk ka parashikuar të trajtojë me prioritet likuidimin e detyrimeve krahasuar me fondet që do të alokohen për projekte të reja, veprim ky në kundërshtim me nenin 43 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe pikën 63 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Kryerja e rishikimeve përgjatë vitit për alokimin e fondeve të cilat janë përdorur për likuidimin e detyrimeve të kontratave të lidhura në vitet e mëparshme, është një ndër treguesit që gjatë hartimit të projekt buxhetit, nuk janë marrë në konsideratë këto detyrime.

-Nga auditimi janë konstatuar problematika në lidhje me saktësinë e raportimeve si në vijim:

Për ndërmarrjet e sektorit energjetik: procesi i rakordimit të detyrimeve të ndërsjella ndërmjet sektorit publik dhe enteve të tjera publike nuk ka përfunduar ende dhe këto detyrime kanë ardhur duke u rritur. Në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, këto detyrime paraqiten në vlerën 163.11 miliardë lekë ose 18.9 miliardë lekë më tepër krahasuar me vitin 2021. Megjithatë edhe kjo vlerë mbart riskun për të qenë më e lartë për 2 arsye:

1. Detyrimet e ndërmarrjeve UK ndaj OSHEE dhe detyrimet e ML/IB ndaj OSHEE, janë raportuar për periudhën deri më 31.09.2022, në kundërshtim me pikën 143, të kreut 6, të Udhëzimit Plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”.

2. Në vlerën e detyrimeve të ndërsjella ende të pa-rakorduara është marr kufiri minimal i detyrimit. Nëse kjo do të llogaritej me kufirin maksimal tek i cili variojnë detyrimet, detyrimi total i ndërsjellë do të shkonte në vlerën 178.62 miliardë lekë.

Për ndërmarrjet e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve: mungon monitorimi dhe raportimi mbi të dhënat financiare të ndërmarrjeve të këtij sektori. Sipas raportit “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, për periudhën deri në Dhjetor 2022, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) raporton se detyrimet e akumuluarra të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve kundrejt OSHEE rezultojnë të jenë në vlerën 14.01 miliard lekë (pa kamata), ku pjesën më të madhe të detyrimit e zë ndërmarrja e UK SH.A Durrës me 4.93 miliardë lekë detyrime. Kjo e dhënë nuk rakordon me raportimin me tabelën nr. 14 të faqes 50 të këtij raporti, ku detyrimet e ndërmarrjeve UK ndaj OSHEE rezultojnë të raportuara 25.35 miliard.

Po kështu krahasuar me raportimet e vitit 2021 rezulton se referuar raportit të “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2021”, faqe 52 citohet se: *Për periudhën deri në Dhjetor 2021, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) pas rakordimit të të dhënave me OSHEE Group SH.A, raporton se detyrimet e akumuluarra të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të jenë në vlerën 21.9 miliard lekë, ku vetëm ndërmarrja e UK SH.A Durrës ka 6.71 miliardë lekë të këtyre detyrimeve.* Për sa më sipër të dhënat e raportuara për fundin e vitit 2021, nuk rakordojnë me të dhënat e fillimit të vitit 2022 dhe si rrjedhojë as me raportimin e dhjetor 2022.

Për detyrimet e prapambetura të qeverisjes së përgjithshme nga MFE në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022” është

evidentuar se duke qenë se procesi i shlyerjes së detyrimeve nga ana e institucioneve kryhet në respektim të parimit FIFO, rezulton se detyrimet që mbeten për t'u shlyer gjatë vitit 2022 karakterizohen nga një “moshë mesatare” e re e krijimit të tyre, konstatim i cili nuk qëndron duke qenë se nga auditimi janë konstatuar raste të mosrespektimit të parimit FIFO dhe po kështu likuidime të faturave të viteve të kaluara, duke filluar nga viti 2013. Gjithashtu ky konstatim bie në kundërshtim dhe me raportin “Mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2022” në seksionin “Gjetjet kryesore në sistemin e detyrimeve të prapambetura” ku ndër të tjera evidentohet mosrespektim i qasjes FIFO në radhën e shlyerjes së detyrimeve.

Këto situata konstatohen me impakt negativ për krijimin e detyrimeve të prapambetura për shkak të cenimit të kontrolleve për marrjen e masave për reduktimin e këtij stoku. Të gjitha këto problematika ndikojnë në rritjen e detyrimeve të prapambetura dhe si rrjedhojë edhe të risqeve fiskale në të ardhmen.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.6, faqe 142-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të marrin masat për implementimin e kontrolleve të stokut të detyrimeve të prapambetura, duke mundësuar mundësuar gjenerimin dhe publikimin e të dhënave financiare mbi detyrimet e prapambetura sipas kohës së krijimit të tyre, shtesave përgjatë vitit, pagesave dhe gjendjes në fund viti, me qëllim kryerjen e një raportimi sa më të saktë dhe forcimin e monitorimit të risqeve nga njësia përgjegjëse në MFE.

MFE të marr masa për vlerësimin e problematikave të konstatuara nga KLSH me qëllim rritjen e monitorimit të risqeve fiskale.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohen rishikime të shumta të fondeve buxhetore të kryera përgjatë gjithë vitit, me efekt buxhetin e vitit 2022 me 2,956 rishikime të cilat kanë sjellë ndryshime për 25,508 transaksione. Muaji me efekt rishikimesh buxhetore më të mëdha është muaji dhjetor me 6731 raste ose rreth 26.4% të rasteve në total. Numri i rishikimeve buxhetore është i lartë përgjatë gjithë vitit dhe ka filluar që në muajin janar 2022, me detajimin e fondeve buxhetore sapo ka përfunduar procesi i detajimit fillestar buxhetor në nivel njësive ekonomike, nga pothuaj të gjitha njësitë ekonomike. Numri i lartë i rishikimeve është tregues për një planifikim tepër të dobët të shpenzimeve, nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore, mungesës së analizave të mirëfillta para planifikimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, mungesë monitorimi i zbatimit të buxhetit dhe veçanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve me rrjedhojë numrin e lartë të faturave të prapambetura nga viti në vit.

-Nga ana tjetër, nga analiza e bazës së të dhënave të vendosura në dispozicion për rishikimet buxhetore me efekt në vitin buxhetor 2022 konstatohen rishikime të cilat janë kryer në tejkalim të afateve, duke filluar nga data 07.02.2023 deri në datën 13.03.2023, ndërkohë që sipas përcaktimeve në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor e drejta për të kryer pagesa mbi planin e rishikuar zgjat deri në muajin janar pas vitit buxhetor dhe tabela e treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar ka afat publikimi deri në ditën e fundit të muajit shkurt. Këto rishikime janë pjesë të rishikimeve të kryera pas datës 15 nëntor, afati i fundit për kryerjen e rishikimeve buxhetore. Në total, pas datës 15 nëntor 2022, janë kryer 763 rishikime buxhetore, veprim në kundërshtim me nenin 48 “Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, konstatohet regjistrimi i rialokimeve të fondeve buxhetore me data kontabile efektive më të hershme (retrospektive) në 313 raste të regjistrimeve me data efektive (sipas librit të madh) *më të hershme se data e kryerjes së veprimit në SIFQ, në kundërshtim me* udhëzuesin e miratuar me Urdhrin nr. 62, datë 31.08.2010 “Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit”. Ndryshimi i planit të buxhetit për periudha të hershme buxhetore nuk është në përputhje me parashikimet e bëra në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit sipas gjurmëve të miratuara të auditimit duke qenë se ky kriter përcakton kryerjen e ndryshimeve sipas kërkesave të njërive buxhetore për periudha në vijim të kryerjes së ndryshimit dhe jo para saj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 167-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të analizohen shkaqet e kryerjes së veprimeve në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe të nxirren përgjegjësitë për kryerjen e rishikimeve pas mbylljes së vitit buxhetor. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë e saj përgjegjëse, në rolin e ekzekutuesit dhe/apo miratuesit, të analizojë dhe investigojë të gjitha rastet e regjistrimeve me data retrospektive të rishpërndarjeve buxhetore të vitit 2022 me ndikim në saktësinë e raportimeve periodike për të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë përkatëse.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se buxheti i vitit 2022 i miratuar me ligjin nr. 115/2021 të ndryshuar është përdorur për shlyerjen e detyrimeve që i përkasin viteve të mëparshme buxhetore, detyrime të prapambetura për vitet e kaluara, në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, duke sjellë mbivlerësim të treguesve përkatës sipas klasifikimit në llogari ekonomike të publikuar në treguesit e konsoliduar fiskalë në të njëjtën masë për këtë vit. Nga procedurat analitike mbi bazën e të dhënave të pagesave konstatohen gjithsej 9,349 transaksione pagesash në vitin 2022 në shumën totale 16,808.9 milion lekë, të cilat i përkasin faturave me datë të viteve buxhetore të mëparshme. Të detajuara sipas llogarive të investimeve apo shpenzime operative/vendime gjyqësore këto pagesa paraqiten në 7,654 transaksione pagesash në shumën 5,038.3 milion lekë raportuar në grupin e llogarive 602 dhe pjesa tjetër prej 1,695 në shumën 11,770.6 milion lekë në grupin e llogarive të investimeve 230/231. Gjatë detajimit të planit të buxhetit, njësitë e qeverisjes qendrore më parë shpërndajnë fonde për të paguar detyrimet e prapambetura të viteve të kaluara për të gjitha llojet e shpenzimeve. Efekti për vitin buxhetor 2022 për investime konstatohet në 44 projekte investimesh me institucionet më përfaqësuese që përfshijnë MIE, FSHZH, AKSHI, AKUKM, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Tiranë dhe Kamëz. Efekti për vitin buxhetor 2022 për shpenzime operative dhe vendime gjyqësore konstatohet në llogari të ndryshme me institucionet më përfaqësuese AKSHI, QSUT, DPD, MFE si dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vlorë, Kavajë, Tiranë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 167-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave të merren masa për raportimin e efekteve të investimeve/shpenzimeve të cilat nuk i përkasin vitit buxhetor në raportimin e të dhënave të realizimit të buxhetit për vitin 2022 dhe në të njëjtën kohë të shmangët praktika e krijimit dhe shlyerjes së detyrimeve financiare të viteve të kaluara duke shpërndarë vlerën e duhur buxhetore sipas detyrimit financiar të ligjshëm të njërive të qeverisjes së përgjithshme. Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të investigohen pagesat e kryera për detyrime financiare të viteve të kaluara për ligjshmërinë e angazhimeve buxhetore sipas fondeve të miratuara në momentin e ndërmarrjes së këtyre angazhimeve nga nëpunësit autorizues dhe miratimin e dhënë nga strukturat përgjegjëse për planin buxhetor në MFE.

25. Gjetje nga auditimi: Institucionet buxhetore, të cilat operojnë direkt në SIFQ, krijojnë dhe regjistrojnë në sistem çdo urdhër prokurim dhe pasi marrin numrin unik të regjistrimit në SIFQ dhe vulën e Thesarit, procedojnë me dërgimin në Agjencinë e Prokurimit Publik për vazhdimin e procedurës së prokurimit. Në SIFQ gjatë vitit 2022 rezultojnë 642 rekorde unike të dokumentit urdhër-prokurim me vlerë totale 76.19 miliard lekë. Ekzistenca e një numri të vogël të regjistrimit në SIFQ të urdhër-prokurimit rezulton pasi elektronikisht ai është i mundur vetëm për institucionet që kanë akses të plotë në SIFQ, aktualisht vetëm 15 institucione. Institucionet e tjera buxhetore të cilat nuk kanë akses online në sistemin Informatik Financiar të Qeverisë, për ekzekutimin e këtij kontrolli, marrin konfirmimin nga dega e thesarit përkatëse nëpërmjet vulosjes së urdhër prokurimit në rast të vlefshmërisë në sistem të fondeve të cilat synohen të prokurohen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Nga kryqëzimi i të dhënave të bazës së të dhënave të urdhër prokurimeve me të bazën e të dhënave të vendosura në dispozicion për kontratat e regjistruara në SIFQ përgjatë vitit 2022 janë konstatuar parregullsi të cilat janë iniciuar nga institucionet buxhetore dhe janë lejuar të procesohen nga sistemi i thesarit si në vijim:

- Janë konstatuar 102 raste të urdhër prokurimeve të regjistruara në sistem në vitin buxhetor 2022 të cilat lidhen me një kontratë të nënshkruar në vitet e mëparshme buxhetore (2011-2021), pra procedura e prokurimit ka përfunduar para se urdhër-prokurimi të regjistrohet në SIFQ dhe regjistrimi është formal dhe në shkelje të afateve ligjore. Institucionet me problematikat më të mëdha në këtë konstatim përfshijnë MSHMS, AKSHI, ARRSH dhe Bashkia Tiranë.

-Janë konstatuar 52 raste në të cilat urdhër prokurimet rezultojnë të jenë regjistruar 0 deri në 10 ditë diferencë nga data e kontratës, afat ky i pamundur për realizimin e një procedure prokurimi. Konstatohet se radha e regjistrimit në SIFQ është formale dhe pa asnjë vlerë për kontrollin dhe bllokimin e fondeve disponibël përpara fillimit të procedurës së prokurimit. Konstatohet se, dokumenti i urdhër-prokurimit nuk regjistrohet në sistem në shkelje me Udhëzimin nr. 9/1, datë 19.01.2018, pjesa III Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, pika 15.1 “Faza para angazhimit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 167-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të investigohen regjistrimet e konstatuara për urdhër prokurimet e mësipërme për detyrime financiare të viteve të kaluara si dhe ato në diferencë të shkurtër kohore nga data e kontratës për ligjshmërinë e angazhimeve buxhetore sipas fondeve të miratuara në momentin e ndërmarrjes së këtyre angazhimeve nga nëpunësit autorizues.

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohen se në SIFQ rezultojnë gjithsej 20,288 kontrata për periudhën 01.01.2022-31.03.2023 me një vlerë të kontraktuar 177,497 milion lekë, nga të cilat 16,503 kontrata në shumën 146,373 milion lekë të regjistruara për periudhën 01.01.2022-31.12.2022. Për llogari të vitit buxhetor 2022 rezultojnë të jenë lidhur 17,283 kontrata (me datë kontratë 01.01.2022-31.12.2022) me vlerë të kontraktuar 159,283 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se nuk është respektuar afati 3 ditor për regjistrimin e kontratave nga data e nënshkrimit të tyre në 10,602 raste në vlerën 116,288 milion lekë në kundërshtim me pikën 157 të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Njësitë e qeverisjes vendore zënë 27% të totalit të vonesave në regjistrime.

Nga auditimi i databazës së angazhimeve në SIFQ, konstatohet se gjatë vitit 2022 është lejuar regjistrimi i kontratave të “vjetra” të cilat datojnë nga viti 2007 deri 2021. Nga të cilat për periudhën 2007-2020 në vlerën 13.5 miliard lekë dhe për vitin 2021 në 138 raste në shumën

21,314 milion lekë. Në konkluzion ka ende kontrata të lidhura por të paregjistruara në Thesar, në pritje të fondeve buxhetore, me ose pa punime të kryera dhe grupi i auditimit nuk mund të konfirmojë plotësinë e databazës së angazhimeve në SIFQ.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 167-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për investimin e kontratave të viteve të mëparshme buxhetore në lidhje me ligjshmërinë e lidhjes së tyre në momentin e marrjes së angazhimit dhe të merren masa administrative për rastet e konstatuara në shkelje të afatit për regjistrimin e tyre.

Në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua mos regjistrim në SIFQ i planit të pagesave të kontratës e kushtëzuar nga mos detajimi i planit buxhetor për projekte të investimeve sipas parashikimeve të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Analiza është kryer duke përdorur modulën e regjistrimit të investimeve sipas angazhimit të ndërmarrë të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ku janë konstatuar raste të projekteve për të cilat ka angazhim në vitin aktual në vlerë të përcaktuar, angazhim 0 lekë për vitet 1 dhe 2 dhe në vijim angazhim në vitin e tretë dhe të katërt në vlerë. Konstatimi është formuar në bazë të raportit më të fundit për vitin buxhetor, atë të muajit dhjetor të vitit 2022, duke qenë se në këtë periudhë janë konsoliduar edhe të dhënat në lidhje me planin dhe faktin. Ndryshimi i shpeshtë i projekteve të investimit me rialokime apo akte normative si dhe ndërmarrja e angazhimeve në projekte të reja investimesh në kuadër të tavaneve të përcaktuara për programet e shpenzimeve të miratuara, ka sjellë shtyrjen e planit të pagesave si pasojë e planit buxhetor me efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura. Ndër raste të tjera përfaqësuese në fund të vitit buxhetor 2022 paraqiten edhe projekte përmbledhës të cilët e kanë të shtyrë të gjithë shumën e angazhimit të investimit në tejkalim të buxhetit të miratuar tre vjeçar sipas ligjit nr. 115/2021 me rreth 50 miliard lekë. Përgjegjësia e regjistrimit të plan buxhetit sipas PBA është e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, ndërkohë që në Degët e Thesarit ku paraqiten autoritet kontraktuese për regjistrimin e kontratës në SIFQ janë udhëzuar të regjistrojnë në vitin 3 të gjithë shumën e angazhimit në mungesë të fondeve sipas viteve. Nga testimet e këtyre angazhimeve këto raste janë përgjithësisht kontrata apo angazhime të ndërmarra pa fonde buxhetore për gjithë projektin dhe jo thjesht në neglizhencë e Drejtorisë përgjegjëse.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 167-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1 Rekomandimi: Drejtoria e Procesimit të Biznesit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të shikojë mundësinë e implementimit të kontrollove të aplikacionit në SIFQ në mënyrë që sistemi të mos lejojë regjistrim buxheti në vitin 1+1 kur viti 1 është zero dhe të shmanget praktika e shtyrjes së planit buxhetor përtej afatit 3 vjeçar për të cilat bëhet miratimi i fondeve buxhetore.

Në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi janë konstatuar raste në vlerën 3.8 miliard lekë ku vlera e fondeve të detajuara përputhet plotësisht me vlerën e pagesave të kryera. Fondet disponibël të projekteve të investimeve janë buxhetuar vetëm për paguar detyrimet e prapambetura të këtyre projekteve/kontratave, pra detajimi/rishpërndarja buxhetore është ekzaktësisht e barabartë me vlerën e faturës (ve) të prapambetura. Në njësitë e qeverisjes qendrore, efektet e këtyre konstatimeve vlerësohen në shumën 3.64 miliard lekë.

-Nga auditimi janë konstatuar raste në të cilat pagesat nga buxheti i shtetit për shlyerjen e faturave kryhen në të njëjtën ditë ose deri në 10 ditë diferencë nga data e regjistrimit të kontratës (data e krijimit të kontratës) në sistemin informatik financiar të qeverisë. Ky

konstatim përfshin 202 projekte investimesh të procesuara për pagesë në shumën 2,168 milion lekë, që dëshmon formalitetin e regjistrimit të transaksioneve në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe jo duke ndjekur procedurat e parashikuara në udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit si pasojë e anashkalimit të kontrolleve të brendshme.

-Nga auditimi mbi regjistrimin e kontratave dhe kryerjen e urdhër shpenzimeve në sistemin informatik financiar të qeverisë, konstatohen raste në të cilat data e kontratës (data e kontratës fizike) sipas modulit të kontratave është në të njëjtën ditë apo me diferencë deri në 10 ditë nga regjistrimi i urdhër shpenzimit të parë për projektet e investimit të identifikuar me problematika. Këto konstatime përfshijnë gjithsej 63 projekte investimesh në shumën 471 milion lekë, që dëshmon për kryerjen e pagesave drejt përfituesve të fondeve publike në një kohë shumë të shkurtër nga kryerja lidhja e kontratës, afat i pamjaftueshëm për kryerjen e punimeve apo marrjen në dorëzim të tyre. Gjithashtu në disa raste përfaqësuese këto projekte investimesh përfshijnë lëvrimin e fondeve në formën e paradhënies për kryerjen e punimeve, në kundërshtim me parashikimet e bëra në udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit duke parafinancuar investimet publike dhe duke mbivlerësuar treguesit e investimeve publike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 167-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për investimin e rasteve të konstatuara me detajim fondesh për detyrime të periudhave të kaluara dhe të nxirren përgjegjësitë për regjistrimin, miratimin dhe procesimin e transaksioneve për pagesë edhe në rastet e paradhënies.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të transaksioneve të pagesave të procesuara në sistemin SIFQ u konstatuan tejkalime të afateve të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, si nga ana e njësisve shpenzuese ashtu edhe nga degët e thesarit. Në analizën e kryer me qëllim testimin e respektimit të afateve të kryerjes së pagesave janë marrë në shqyrtim vetëm llogaritë e shpenzimeve operative (602) dhe shpenzimeve në proces për rritjen e investimeve (230 dhe 231). Nga auditimi u konstatuan 27,311 fatura në total me vlerë 52,578,940 mijë lekë të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor nga data e furnitorit të përcaktuar në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga këto transaksione të procesuara me vonesë, 4,033 prej tyre i përkasin shpenzimeve për investime me vlerë 34,203,157 mijë lekë, ndërkohë që pjesa tjetër prej 23,279 rastesh i përket shpenzimeve operative me vlerë totale prej 18,375,783.7 mijë lekë.

-Nga auditimi u konstatuan të paktën 20 raste në rreth 2.7 miliard lekë të regjistrimit dhe pagesave pjesore të faturave, të cilat janë më të vogla se sa vlera e detyrimit të lindur sipas faturës së furnitorit, kjo me qëllim përputhjen e fondeve buxhetore disponibël. Me paraqitjen e faturës dhe urdhër-shpenzimit nga njësitë buxhetore, regjistrimi nga degët e thesarit është bërë pjesor duke rezultuar në pagesa pjesore, me vlerë të barabartë me fondet disponibël të detajuara nga buxheti.

-Ekzekutimi i transaksioneve të pagesës, pas regjistrimit në SIFQ, referuar kuadrit ligjor për menaxhimin e shpenzimeve publike, duhet të kryhet brenda 30 ditëve. Nga auditimi konstatohet se në disa raste këto parashikime nuk janë respektuar ku janë konstatuar 9 raste në vlerën 65.4 milion lekë të transaksioneve në të cilat diferenca ndërmjet datës së ekzekutimit në SIFQ me datën e regjistrimit në SIFQ është mbi 30 ditë.

-Nga auditimi konstatohet se pjesa më e madhe e ekzekutimit të shpenzimeve/investimeve përqendrohet në muajin dhjetor në mbyllje të vitit buxhetor. Nga analiza e bazës së të dhënave të pagesës konstatohet se me datë libri të madh në muajin dhjetor 2022 janë procesuar për pagesë edhe fatura të viteve të mëparshme apo të muajve të mëparshëm të vitit

2022. Nga 65.89 miliard lekë fatura të kaluara me datë libri të madh në dhjetor 2022 konstatohen rreth 20.8 miliard lekë të pagesa të faturave që i përkasin muajve janar-nëntor 2022, nga ku konstatohet se ekzekutimi i buxhetit nuk është i njëtrajtshëm përgjatë vitit 2022 duke sjellë problematika si pasojë e planit buxhetor, në planin e arkës për procesimin e tyre.

-Nga auditimi në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e informacionit të raportuar në treguesit fiskalë të konsoliduar për vlerat e raportuara të shpenzimeve operative dhe investimeve u konstatuan nga baza e të dhënave të pagesave deri në 31.03.2023 transaksione me datë fature të vitit 2022 dhe të mëparshëm për të cilat është përdorur buxheti i vitit 2023. Këto transaksione, nuk rezultojnë të jenë paguar në kohë në shumën 8,377 milion lekë, të cilat megjithë efektet e akteve normative dy ditë përpara fundit buxhetor si dhe të drejtës për të kryer shpenzime edhe gjatë muajit janar 2023 për efekt të vitit buxhetor 2022. Të grupuara në investime dhe shpenzime operative klasifikimi paraqitet në shumën 5,677 milion lekë për investime dhe 2,700 milion lekë për shpenzime operative.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 167-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

29.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa administrative për rastet e konstatuara në tejkallim të afateve për procesimin për pagesë si dhe të shmanget praktika e detajimit të copëzuar të fondeve buxhetore përtej detyrimeve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në rastet e vlerësimit të ligjshëm të këtyre detyrimeve pas kryerjes së investigimeve përkatëse.

Në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi krahasimin e datës së ekzekutimit të transaksioneve të pagesave në SIFQ me datën e regjistrimit të urdhër shpenzimit konstatohen raste në të cilat edhe sipas muajve janë ekzekutuar pagesa jo sipas parimit hyrje e parë, dalje e parë në sistem. Nga auditimi u konstatuan ekzekutime të pagesave të faturave të regjistruara në data të mëvonshme, përpara urdhër shpenzimeve të regjistruara në data më të hershme. Ky konstatim rezultoi i përhapur përgjatë gjithë muajve të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2022. Në këtë mënyrë, është konstatuar se pagesat e kryera në 21 data të ndryshme të vitit buxhetor nuk kanë ndjekur në disa raste parimin hyrje e parë dalje e parë (FIFO) sipas përcaktimeve në udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, pika 178, 179 dhe 180 është përcaktuar procedura e procesimit të transaksioneve sipas parimit hyrje e parë dalje e parë për pagesë pas regjistrimit të tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 167-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.1 Rekomandimi: Nga ana e DPTH në vijimësi të merren masa për sigurimin e likuiditetit të mjaftueshëm me qëllim financimin e të gjitha shpenzimeve buxhetore dhe ekzekutimit të tyre në procesimin normal të ciklit të menaxhimit të shpenzimeve buxhetore duke respektuar radhën dhe prioritetet e pagesave buxhetore.

Në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga procedurat audituese ka rezultuar se jo të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme kanë dorëzuar në kohë pasqyrat financiare individuale të tyre me qëllim që të reflektohen në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe në vijim të vijnë procedurat për konfirmimin me degët e thesarit dhe konsolidimin e tyre, duke shkaktuar problematika në drejtim të afateve dhe produktit që rezultojnë nga ky proces, në kundërshtim me nenin 62 *“Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit”* të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*.

Nga auditimi konstatohet se pas dorëzimit të pasqyrave financiare individuale, dorëzimi i pasqyrave financiare të konsoliduara nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk është objekt

shqyrtimi dhe konfirmimi nga strukturat e thesarit për tu siguruar që janë kryer veprimet e eliminimit të transaksioneve të ndërsjellta me njësitë e varësisë dhe për të shmangur efektin e dublimeve në transaksione. Kjo rezulton si pasojë e mungesës së kuadrit rregullator në formën e standardeve të kontabilitetit në sektorin publik të cilat vazhdojnë të mos jenë të miratuara, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 61 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në mungesë të këtyre standardeve, pasqyrat financiare sipas sistemit informatik financiar të qeverisë paraqiten të pakonfirmuara dhe për këtë arsye nuk janë objekt raportimi, publikimi dhe miratimi. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2022, u konstatua se ka diferenca midis pasqyrave fizike, të dorëzuara nga institucionet buxhetore në degët e thesarit dhe pasqyrave financiare të gjeneruara nga (SIFQ), si pasojë e shpenzimeve të konstatuara të muajit dhjetor të vitit, momentit të konstatimit të të ardhurave në krahasim me arkëtimin e tyre, shpenzimet nuk njihen në momentin e ndodhjes së tyre sipas përcaktimit të shpenzimeve dhe për detyrimet e prapambetura përdoret një llogari ekstrakontabile për raportimin e tyre, në grupin e llogarive 486; mungon kuadri konceptual për raportimin financiar sipas përcaktimeve në kuadrin rregullator financiar ndërkombëtar; mungojnë standardet e kontabilitetit për regjistrimin e transaksioneve financiare, nuk kryhet procesi i konsolidimit të pasqyrave në nivel njësie mëmë konsolidues; mungon konsolidimi i pasqyrave financiare të sipërmarrjeve privatë në të cilat shteti ka interesa pjesëmarrje në kapital.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 167-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave të hartohen dhe publikohen standardet kontabël dhe kuadri i nevojshëm rregullator për metodologjinë e procesit të konsolidimit.

Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa administrative për vonesat në dorëzimin e pasqyrave financiare individuale.

Në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2022 është konstatuar përdorimi i instrumenteve të shkëmbimit SWAP si një mjet për menaxhimin e likuiditetit të lirë në monedhën EUR dhe SDR, të cilat paraqiten me tepricë dhe nga konvertimi i tyre fondet e siguruar në monedhë kombëtare janë përdorur për shlyerjen e kërkesave për pagesë në monedhë kombëtare. Nga shqyrtimi i listës së transaksioneve të SWAP, rezulton se përgjatë vitit 2022, është vazhduar në drejtim të përdorimit të instrumenteve SWAP me Bankën e Shqipërisë në monedhat e huaja në të cilat administrohet TSA, përdorimi i konvertimit të njëanshëm si dhe kryerja e një depozitimi për vendosje në depozitë kur ka pasur tepricë të mjeteve monetare. Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2022 ka pasur një konvertim të njëanshëm sipas shkresës nr. 23062 datë 31.12.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë drejtuar Bankës së Shqipërisë. Efektet e konvertimit të njëanshëm janë pasqyruar me datë valutë në vitin 2022, ndërkohë që për pjesën tjetër të vitit 2022 konstatohet se nuk ka pasur asnjë konvertim të njëanshëm por gjatë gjithë kohës janë përdorur instrumentet SWAP për menaxhimin e likuiditetit, me arsyetimin se gjendja e likuiditetit nuk është ende e qartë në fund të vitit 2022, sipas minutave të takimit të Komitetit të Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit. Nga auditimi është konstatuar se gjatë vitit 2022 është kryer edhe një investim në depozitë sipas shkresës nr. 12114 datë 20.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit ku është kërkuar depozitimi i shumës prej 10 miliard lekë për qëllime investimi me datë valute 22.06.2022 dhe datë maturimi 01.07.2022.

Përgjatë vitit 2022, gjendja e likuiditeteve ka rezultuar e lartë ku në total, për pjesën më të madhe të vitit ajo paraqitet ndërmjet intervalit 60 miliard lekë – 100 miliard lekë. Pjesa më e madhe e tepricave është akumuluar përgjatë gjithë vitit në TSA në Euro me një interval të

konvertuar në lekë ndërmjet 40 miliard lekë - 70 miliard lekë. Bazuar në analizën e mësipërme konstatohet se nuk janë administruar siç duhet mjetet monetare duke kryer shumë pak investime të mjeteve monetare në vendosje në depozitë në rastin e tepricave të përkohshme të likuiditetit, sidomos për mjetet monetare në valutën euro. Akumulimi i gjendjes konstatohet se është krijuar nga huamarrjet e mbartura nga viti i kaluar në monedhën Euro si pasojë e Eurobondit të emetuar si dhe nga mbështetjet buxhetore. Mungesa e ndjekjes së duhur e këtyre tepricave jo normale të krijuara gjatë administrimit nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 8 “Menaxhimi i mjeteve monetare të qeverisjes së përgjithshme” të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga auditimi konstatohet se mbajtja e tepricave në valutë përtej nevojave normale të funksionimit të sistemit të pagesave i ka ekspozuar mjetet monetare të qeverisjes së përgjithshme ndaj riskut të kursit të këmbimit. Si pasojë, gjatë vitit janë krijuar humbje nga kursi i këmbimit në rreth 4.6 miliard lekë të cilat janë reflektuar në zërin të tjera, nën financimin e deficitit në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar. Kjo vlerë paraqet pakësim të mjeteve monetare si pasojë e rivlerësimit me kursin e datës së fundit të vitit si dhe efektin e humbjeve nga konvertimi nëpërmjet instrumenteve SWAP. Kryerja e konvertimeve me anë të instrumenteve SWAP përgjatë vitit 2022, për përballimin e nevojave për flukse dalëse në monedhën kombëtare ka rezultuar me humbje të konsiderueshme si pasojë e diferencës ndërmjet kurseve të ditës dhe kurseve të së ardhmes në vlerën 580 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se nuk janë shfrytëzuar mundësitë për kryerjen e konvertimeve të njëanshme të monedhës së huaj në monedhë vendase.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 167-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për investimin e tepricave të mjeteve monetare në depozita me qëllim reduktimin e humbjeve nga procesi i menaxhimit të likuiditetit, si dhe për shtimin e instrumenteve për konvertimin e monedhave edhe me anë të konvertimit të njëanshëm me të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin financiar.

Në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se procesi i konfirmimit të të ardhurave dhe shpenzimeve totale midis MFE dhe BSH zgjat deri në muajin e dytë pasardhës, pasi shkresat e MFE mbërrijnë në BSH disa ditë pas datës së shënuar në shkresë (në disa raste edhe 10-17 ditë), megjithëse nga ana e BSH shkresa konfirmuese është brenda 3 ditëve sipas përcaktimit në marrëveshje. Në kuadër të procesit të konfirmimit sikurse është përcaktuar në marrëveshjen midis palëve, konfirmimi në muajin e dytë pasardhës nuk i shërben objektivit dhe në të njëjtën kohë është jo në përputhje me periodicitetin e parashikuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C.4, faqe 205-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1. Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për hartimin e një udhëzimi në zbatim të Marrëveshjes Kuadër me Bankën e Shqipërisë, ku në mbështetje të periodicitetit mujor të specifikuar, të përcaktohet afati i dërgimit të shkresës nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë drejt Bankës së Shqipërisë për dërgimin e konfirmimeve mujore me qëllim optimizimin e procesit.

Në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Urdhër Shpenzimin nr. 722, datë 03.11.2022, me objekt “Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Shpenzime për likuidim LOA nr. ref AL-B-UBZ”, me urdhërues Reparti Ushtarak 1001 (Ministria e Mbrojtjes), vlera totale prej 1,070,391.00 USD është klasifikuar si “Investim i trupëzuar” në llogarinë ekonomike 231, nënlllogaria 4320, ndërkohë që përbërja e kësaj vlere sipas “Letter of Offer and Acceptance (LOA) AL-B-UBZ”, përfshin edhe elementë të tjerë që nuk

plotësojnë kushtet e klasifikimit si investim: mbështetje logjistike për pajisjet e trajnimit, simulatorët dhe shënjestrat në vlerën 201,914.00 USD; mbështetje teknike për pajisjet e trajnimit, simulatorët dhe shënjestrat në vlerën 183,949.00 USD; shpenzime administrative në vlerën 33,190.00 USD. Këto elementë përbëjnë rreth 39% të vlerës totale. Klasifikimi i këtyre shpenzimeve në totalin e vlerës si Investim i Trupëzuar, rrit shpenzimet e amortizimit në vijimësi, duke amortizuar edhe shpenzimet, pasi baza e amortizueshme rritet në masën e këtyre tri nënzërave prej 419,053.00 USD.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C.4, faqe 205-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

34.1. Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit të marrë masa për verifikimin e klasifikimit të saktë ekonomik në llogaritë kontabël të zërave përbërës të objektit të shpenzimit në Urdhër Shpenzime, ku secili prej zërave të jetë saktësisht i evidentuar në llogarinë ekonomike dhe nënlogarinë përkatëse.

Në vijimësi

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i transfertave në valutë për vitin 2022, grupi i auditimit ka konstatuar se për shkak të përdorimit të llogarisë “Depozitë e Qeverisë në Euro” për 8 transferta në valutën USD (inicuar përmes shkresave të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, MFE drejtuar Departamentit të Operacioneve Monetare, BSH, ku 2 transferta kanë si urdhërues Institutin e Shëndetit Publik dhe 6 të tjera kanë si urdhërues Ministrinë e Mbrojtjes) është shkaktuar shpenzim i panevojshëm në vlerë totale prej 43,275,715.77 lekë (si diferencë e vlerave në urdhër-shpenzime nga konvertimi USD-ALL dhe nga transaksionet e konvertimit EUR-USD-ALL për transfertat). Rezulton se në momentin e kryerjes së transaksioneve, llogaria “Depozitë e Qeverisë në USD” nuk ka pasur gjendje të mjaftueshme, pasi nuk është përfshirë në planifikimin vjetor, edhe pse Ministria e Financave dhe Ekonomisë kryen pagesa vjetore të përvitshme në valutën USD. Për më tepër, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit rezulton të mos ketë kryer një analizë paraprake për përdorimin e valutave të huaja me qëllim përdorimin e mënyrës më të favorshme me më pak kosto si dhe për shmangien e shkaktimit të shpenzimeve të panevojshme. Gjithashtu, në një rast të evidentuar, diferenca mes datës së Urdhër Shpenzimit të Thesarit dhe datës së kryerjes së transaksionit nga Banka e Shqipërisë rezulton në 8 ditë, duke ndikuar dhe kursin me të cilin është kryer transaksioni.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C.4, faqe 205-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

35.1. Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit të marrë masa për (i) përfshirjen e llogarisë “Depozitë e Qeverisë në USD” në planifikimin vjetor dhe (ii) kryerjen e një analize paraprake me qëllim përcaktimin e mënyrës më të favorshme për pagesë, në rastet kur kjo llogari nuk rezulton me gjendje të mjaftueshme për kryerjen e pagesave, me qëllim shmangien e shkaktimit të shpenzimeve të panevojshme nga përdorimi i valutave të huaja.

Menjëherë

36. Gjetje nga auditimi: Me ligjin fillestar të buxhetit fondi për rehabilitimin e të përndjekurve politik është planifikuar në vlerën 1,035,991 mijë lekë, nga të cilat vlera 35,991 mijë lekë për shpenzime administrative.

Me Aktin Normativ nr. 3 datë 12.03.2022 ky fond është ulur në vlerën 1,666 mijë lekë krahasuar me planin fillestar, ndërsa me Aktin Normativ nr. 17 datë 01.12.2022, programimi përfundimtar i këtij fondi është 1,031,325 mijë lekë, duke u ulur në vlerën 4,666 mijë lekë, krahasuar me Ligjin e Buxhetit. Për vitin 2022 fondi i paguar rezulton 996,424 mijë lekë.

- Konstatohet se vlera e detyrimit të njohur nga shteti Shqiptar dhe i papaguar për ish të përndjekurve politik deri në fund të viti 2022 rezulton 29,882,175 mijë lekë. Nëse buxheti

dhe çelja e fondit për ish të përndjekurit do të vazhdojë me këtë ritëm apo të ulet më tej, ky detyrim do të mund të shlyhet mesatarisht pas rreth 30 vitesh.

Përveç këtij fakti, nga auditimi i MFE-së janë konstatuar problematika në lidhje me sistemin elektronik e-dëshmshpërblime të cilat konsistojnë kryesisht në raste dublikimi të listës dhe vlerës së trashëgimtarëve përfitues, pamundësinë e korrigjimit të vlerës financiare kur ndryshon VKM, pamundësisë së pasqyrimin si zbritje në sistemin e-dëshmshpërblimit të vlerave të kthyer nga bankat e nivelit të dytë, vështirësive në ngarkimin e dokumenteve të përfituesve, mungon gjurma e auditimit për kronologjinë e pagesave, pamundësia e gjenerimit të raporteve të konsoliduar etj. Këto problematika dhe nevoja për përmirësimin e sistemit e-dëshmshpërblime janë përcjellë pranë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit me memo-n e datës 30.05.2023, për të cilat deri në mbylljen e fazës së auditimit në terren nuk rezultoi vendimmarrje mbi rishikimin dhe përmirësimin e sistemit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën C.5, faqe 229-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

36.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me qëllim rivendosjen e drejtësisë dhe dinjitetit shoqëror të kategorisë së të përndjekurve politik të kërkojë shtimin e fondeve për dëshmshpërblimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, duke mundësuar shlyerjen e detyrimit të njohur nga shteti Shqiptar.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marr masa për analizimin e problematikave të sistemit E-dëshmshpërblime me qëllim rritjen e sigurisë mbi të dhënat e regjistruara dhe pagesat e kryera për ish të përndjekurit politikë.

Menjëherë

37. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i garancive të huaja jo performuese është konstatuar se në rastet kur huamarrësi nuk ka mundur të bëjë pagesën, në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huasë institucioni huadhënës nuk i ka paraqitur Ministrin të Financave një kërkesë për pagesë, në përmbushje të së drejtës së tij, sipas garancisë shtetërore të huasë, me qëllim që Ministri i Financave, pasi të konfirmoj se kërkesa për pagesë është në përputhje me kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, të autorizojë transfertën e pagesës ose pagesave për institucionin huadhënës brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës”.

Aktualisht konstatohet se procesi konsiston në komunikim paraprak nga MFE me përfituesin e garancisë i cili konfirmon nëse është apo jo në gjendje që të shlyejë këstin e radhës dhe në rast paaftësie nga ana e tij procedohet me pagesën nga Buxheti i Shtetit, veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 42 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 233-256 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

37.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e Autoritetit Publik dhe të Kompetencës nëpërmjet nga strukturat e borxhit, të ndjek të gjitha rrugët ligjore që të merren masa për hartimin dhe implementimin e procedurave të qarta ligjore me qëllim përcaktimin e një procedurë që parashikon monitorimin proaktiv dhe dinamik dhe konfirmimit të gjendjes financiare dhe aftësisë paguese të subjekteve kredimarrëse (përmes aksesit të autorizuar në informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjekteve përfituese të garancisë), përpara realizimit të pagesës në mbështetje të vështirësisë financiare të deklaruar nga subjektet përfituese.

Brenda vitit 2023

38. Gjetje nga auditimi: Nga analizi i Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (2022-2026), rezulton nga ana e MFE-së është përzgjedhur Strategjia S3. Nga MFE është

analizuar se financimi në periudhën e ardhshme duke përzgjedhur dhe aplikuar strategjinë S3 do të ketë rezultate të kënaqshme në drejtim të optimizimit të risqeve të portofolit të borxhit, dhe me një kosto të pranueshme.

Konstatohet se tendenca e borxhit që maturohet brenda 1 viti, për vitin 2022 rezulton të jetë rritur me 1,3% duke kaluar nga 46,6% në vitin 2021 në 47,9% në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një tavan prej 40%.

Koha mesatare në maturim ka ardhur në ulje nga 2,20 vite në 2021 në 2,17 vite në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një kufi minimal 2,5 vite.

Për rrjedhojë tendenca faktike e vitit 2022 nuk ka shkuar në drejtimin e përmirësimit të arritjes së objektivit të strategjisë 2022-2026.

Tendenca e borxhit që rifiksohet brenda 1 viti, për vitin 2022 rezulton të jetë rritur me 1% duke kaluar nga 48% në vitin 2021 në 49% në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një tavan prej 43%.

Gjithashtu konstatohet se edhe koha mesatare në rifiksime ka ardhur në ulje nga 2,19 vite në 2021 në 2,17 vite në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një kufi minimal 2,5 vite.

Për rrjedhojë tendenca faktike e vitit 2022 nuk ka shkuar në drejtimin e përmirësimit të arritjes së objektivit të strategjisë 2022-2026.

(Më hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 233-256 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

38.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa konkrete në përmirësimin e treguesve të riskut të rifinancimit dhe treguesve të riskut të normës së interesit për arritjen e objektivave strategjike të përcaktuara në SAMB 2022 – 2026.

Brenda vitit 2023

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentit të PBA-së së hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për periudhën objekt auditimi, u konstatua se fondet në programet e planifikuara dhe shpenzuara nga aparati i MFE, nuk janë të përfshira në një program të vetëm, por ato janë pjesë e programeve ku përfshihen edhe fondet e njësisve të tjera shpenzuese. Aparati si njësi shpenzuese, nuk ka përgatitur dhe dorëzuar më vete kërkesat për programin buxhetor afatmesëm PBA 2022-2024.

-Nga auditimi konstatohen rishikime të shpeshta të fondeve, situatë që reflekton mangësi në planifikimin efektiv të buxhetit të institucionit, duke u bërë shkak për rishikime të shpeshta të fondeve.

- Nga auditimi u konstatua së në listën e investimeve publike për aparatin e MFE nuk janë përfshirë 5 projekte të cilët janë në vijim nga vitet e mëparshme, si dhe 6 projekte të reja të çelura në fillim të vitit, nuk rezultojnë të përfshira në listën e investimeve publike të miratuara në projekt buxhet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.1, faqe 256-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

39.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Sektori i Buxhetit të marrë masa për hartimin e kërkesave buxhetore për aparatin si njësi shpenzuese më vetë si dhe të marrin masa për hartimin e dokumentit të PBA-së për MFE konform udhëzimeve përkatëse.

-Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të merren masa për planifikim efektiv të fondeve me qëllim shmangien e ndryshimeve/rishikimeve të shpeshta tregues ky negative për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.

Menjëherë

40. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, aparati i MFE, si njësi shpenzuese më vete nuk harton raporte monitorimi për fondet e planifikuara dhe realizuara, pasi kryen pagesa dhe nëpërmjet programeve të tjera, ku përfshihen dhe institucione (të tilla si DPTH,

EKB, SHMP, AIDA, QKB etj), duke mos mundësuar identifikimin e buxhetit që administrohet vetëm nga aparati i MFE. Referuar raportit të monitorimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) evidentohet mospërputhje ndërmjet realizimit të buxhetit sipas të dhënave të pasqyrave financiare/raportit të monitorimit dhe pagesave në SIFQ. Konkretisht, sipas raportit të monitorimit dhe pasqyrave financiare të agjencisë zëri 604 “Transferta korrente të brendshme” për projektet 91007AP dhe 91007AA, parashikuar me VKM nr. 480, datë, 13.07.2022 “Për miratimin e dhënies së granteve për startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve”, për 300,000,000 lekë, është realizuar në shumën 274,543,706 lekë. Ndërsa sipas databazës së pagesave të thesarit, pagesat për këto projekte rezultojnë në shumën 197,939,989 lekë, me një diferencë prej 76,603,717 lekë, mosrakordim i cili nuk është monitoruar nga strukturat përkatëse të MFE.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.1, faqe 256-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

40.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Sektori i Buxhetit të marrë masa për hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit për aparatit si njësi shpenzuese, për produktet e buxhetit të administruara nga ana e saj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit. Për mospërputhjet e evidentuara në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) rekomandohet të ushtrohet një mision auditimi nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë

41. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagave dhe shtesave për natyrë të veçantë pune të punonjësve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u konstatua, se nuk ka pasur një trajtim të barabartë të punonjësve që përfitojnë shtesën mbi pagën mujore për natyrë të veçantë pune, problematikë e trajtuar dhe lënë rekomandim edhe nga auditimet e mëparshme, i cili rezultoi të jetë zbatuar pjesërisht me urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 286, datë 29.12.2022, sipas të cilit nëpunësit civil të Drejtorisë Auditimit Brendshëm dhe Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse kanë përfituar 10,000 lekë në muaj shtesën për natyrë të veçantë pune për periudhën 01.01.2018-01.12.2021.

Pas datës 01.12.2021, në mënyrë të paargumentuar nuk përfshihen në përfitimin e kësaj shtese nëpunësit civil të këtyre strukturave, në kundërshtim me pikën 4/12 të VKM nr. 187, datë 08.03.2017, e ndryshuar “Për miratimin e strukturës së dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve...”, me arsyetimin se këto struktura janë cilësuar njësi teknike të përmbajtjes, referuar legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, në vendim ka disa pozicione në administratën publike, të strukturave horizontale, pjesë e njësive të varësisë së MFE, që përfitojnë shtesë për natyrë të veçantë pune, referuar lidhjeve 6.7 dhe 6.8, duke sjellë pabarazi në trajtimin e punonjësve të strukturave të sipërcituara të Aparatit të MFE

Trajtim i diferencuar i këtyre punonjësve paraqitet edhe pas daljes së VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin strukturës së pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë...”.

Kjo qasje është nxjerrë në fokus edhe nga Gjykata Administrative, konkretisht në Vendimin nr. 1387(80-2023-1420) datë 05.06.2023. ku është vendosur trajtimi i nëpunësit me shtesën e pagës 10,000 lekë nga data 01.12.2021 e në vijimësi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.2, faqe 265-271 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

41.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet strukturave përkatëse në varësi të saj të marrë masa për rregullimin e situatës, duke reflektuar saktë në pagesën e pagës dhe shtesës mbi pagë për natyrë të veçantë pune sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, për një trajtim të barabartë të nëpunësve të strukturave të saj.

Menjëherë

42. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tre procedurave të prokurimit, “Ndërtim i Bazës Prodhuese në Shkollën ”Beqir Çela”, Durrës”, “Rikonstruksion i Shkollës Profesionale

“Herman Gmeiner” dhe “Rikonstrukcion i Shkollës Profesionale “Hoteleri Turizëm”, u konstatuan se në dosjen e procedurës nuk ndodhet në hard copy apo CD projekti dhe preventivi i objekteve me vlerat përkatëse, të cilët kanë shërbyer për hartimin e fondit limit. Konstatohet se, nga Njësia e Prokurimit me procesverbalet përkatëse janë miratuar Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) ku janë përcaktuar dhe kriteret e veçanta për kualifikim, por nuk ka argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur dhe dokumentuar në procesverbal. Nga Njësia e Prokurimit për kriteret e vendosura apo modifikimin e tyre, citohet vetëm baza ligjore: neni 77, i ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

- Në DST e procedurës së prokurimit “Rikonstrukcion i Shkollës Profesionale “Herman Gmeiner”, në “Kriteret e veçanta për kualifikim” në pikën 2.3.7 Njësia e Prokurimit ka vepruar me dy standarde krahasuar me kriteret e vendosura në rikonstrukcionin e shkollës “Hoteleri Turizëm”, veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77 dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, neni 39.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se, në të tre procedurat e prokurimit, nga KVO, pas verifikimeve në SPE janë s’kualifikuar OE kryesisht për mosplotësim të “Kritereve të veçanta për kualifikim” sa i takon stafit, pasi kanë paraqitur punonjës sipas profesioneve, por që nga verifikimi në listëpagesa nuk u korespondojnë kodeve përkatëse. Në të gjitha rastet e deklarimeve të pasakta të OE të konstatuara nga KVO, Autoriteti Kontraktor duhej ti ishte drejtuar APP për veprim të mëtejshëm pasi Operatorët Ekonomikë janë në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, germa (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP)”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.3, faqe 271-280 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

42.1.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

KVO në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s’kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

AK, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjësve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente.

Në vijimësi

43. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 në të ardhurat e Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rezulton se është kontabilizuar edhe llogaria 7780100 “Korrigjime nga vitet e kaluara”, në vlerën totale 84,304,139 lekë, nga të cilat vlera 80,104,138 lekë, referuar ditarëve kontabël dhe librit të madh, i përket kthimit të huasë që MFE i ka dhënë Fondit Kombëtar, në vitet e mëparshme, për IPA 2012, IPA 2013, hua e cila duhet të ishte kthyer brenda vitit kur është bërë disbursimi i shumës. Si rezultat, janë mbivlerësuar të ardhurat e vitit 2022, për vlerën 80,104,138 lekë, pasi transaksioni i arkëtimit nga Fondi Kombëtar është kthim i një shume të dhënë hua që trajtohet si një shlyerje nga debitorët e vitit të kaluar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.4, faqe 280-291 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

43.1. Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues të marrin masa që të gjitha transferimet drejt të tretëve në formën e huadhënies afatshkurtër të kontabilizohen në llogaritë

e debitorëve dhe arkëtimi i tyre të kontabilizohet si shlyerje nga këto debitorë dhe jo si e ardhur e realizuar e vitit ushtrimor.

Në vijimësi

44. Gjetje nga auditimi: Llogaria 203 “Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme”, paraqitet në fund të vitit në vlerën neto 1,196,434 mijë lekë ku përfshihen vlerën e programeve kompjuterike, software dhe licencave. Konstatohet se nuk ka përfunduar procesi i transferimit të aktiveve të teknologjisë së informacionit nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë te Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 2,855,016 mijë lekë e cila përbëhet nga vlera e godinës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe nga vlerat e godinave të ndërtuara apo rikonstruktura të 18 shkollave profesionale në vlerën 2,196,134 mijë lekë. Konstatohet se Ministria e Financës edhe Ekonomisë ka kontabilizuar si asetet e veta, pa pasur kontroll të këtyre aktiveve, vlerën e konstruksioneve dhe rikonstruksioneve, pra investimeve që janë kryera në shkollat profesionale, për të cila çdo vit llogaritet edhe vlerat e amortizimit. Gjithashtu rezulton se në pasqyrat financiare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pasqyrohet vetëm vlera e investimeve të kryera nga kjo Ministri dhe jo vlera e plotë e aktiveve të shkollave profesionale.

Nga auditimi rezulton se llogaritë e investimeve me burim financime të huaja janë të nënvlerësuara, pasi nuk raportohen projektet me financim të huaj të zbatuara nga CFCU dhe Fondi Kombëtar. Në rastin e krijimit të aseteve nëpërmjet projekteve me financim të huaj, në pasqyrat financiare paraqitet vlera e TVSH së investimit të kryer dhe jo kosto e plotë e asetit. Gjatë vitit 2022, shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara dhe trupëzuara me burim financimi të huaj, rezultojnë në shumën 355,657,877 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.4, faqe 280-291 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

44.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë hapat e nevojshëm ligjor për transferimin e të gjithë aseteve dhe investimet e kryera gjatë viteve për shkollat e arsimit profesional te njësitë shpenzuese përkatëse, me qëllimin kontabilizimin dhe njohjen e aktiveve të njësitë të cilat kanë kontroll mbi to.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për përfundimin e procesit të kalimit të aktiveve të sistemeve të informacionit nga MFE tek AKSHI, si dhe të përcaktojnë përgjegjësitë për vonesat e shkaktuara në zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me këtë çështje. Në pasqyrat financiare të MFE-së të pasqyrohet vlera e plotë e të gjitha investimeve të kryera me burim financimi të huaj (grant apo kredi) me qëllim paraqitjen e vlerës së drejtë dhe të plotë të investimeve të kryera gjatë vitit.

Në vijimësi

45. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka kryer procesin e inventarizimit, në kundërshtim me kreun IV, pika 74 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, si dhe pikën 30, të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Gjithashtu nga auditimi rezulton se grupi i komisionit të vlerësimit të aktiveve, i ngritur me Urdhrin nr. 67, datë 12.04.2021 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të aktiveve të MFE-së, të identifikuar për nxjerrje nga përdorimi, nga komisionet e inventarizimit të vitit 2017 dhe 2019 dhe nga Komisionet e Degëve të Thesarit në Rrethe, për vitin 2021”, i ndryshuar, ka hartuar relacionin mbi vlerësimin e aktiveve, i cili nuk ka datë. Në relacion nuk llogaritet për asnjë aktiv efekti ekonomik i masave për riaftësimin e tyre, në kundërshtim me pikën

106, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Sipas procesverbalit “Për vlerësimin e aktiveve që janë konstatuar jashtë përdorimit” rezulton se është mbajtur nga komisioni i vlerësimit të aktiveve më datë 26.09.2022, ndërsa protokollimi i këtij procesverbali është bërë me nr. 24191 prot., ndërsa data 30.12.2022, pra 3 muaj më pas. Vlera e aktiveve të verifikuara si jashtë përdorimit nga komisioni i inventarizimit është 156,603 mijë lekë. Ndërsa nga komisioni i vlerësimit të aktiveve janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit 434 aktive në vlerën totale 65,480 mijë lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.4, faqe 280-291 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

45.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve me qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, për të parandaluar shpërdorimin dhe humbjen e tyre. Gjithashtu të merren masa për përsheptimin e procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve dhe asgjësimit të aktiveve sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

46. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, Korporata e Investimeve Shqiptare SH.A, nuk ka dorëzuar në kohë programet e zhvillimit ekonomik të vitit 2022 dhe vitit 2023, si dhe nuk ka paraqitur programin e korrigjuar pas shqyrtimit të tij nga strukturat përgjegjëse, pra për këtë shoqëri nuk ka tregues ekonomikë të miratuar për këto dy vite.

- Nga auditimi konstatohet se SH.A “Korporata e Investimeve Shqiptare” Tiranë, me kapital të regjistruar 100% shtetëror në vlerën 2,178,529,064 lekë, referuar pasqyrave financiare të dorëzuara, për vitin 2021 ka rezultuar me humbje në vlerën 19,465,000 lekë. Për vitin 2022 kjo shoqëri deri në momentin e auditimit nuk ka paraqitur pasqyrat financiare, por konstatohet se është financuar nga buxheti i shtetit për vitet 2021 - 2022, si më poshtë:

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 98, datë 22.12.2022, Aksionari i Vetëm (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 2,000,000,000 lekë, kaluar me Aktin Normativ nr. 34, datë 03.12.2021, duke e çuar kapitalin e kësaj shoqërie në 2,198,000,000 lekë referuar gjendjes në regjistrin tregtar më datë 13.01.2022.

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 95, datë 15.09.2022, Aksionari ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 200,000,000 lekë, kaluar me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022.

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 112, datë 28.12.2022, Aksionari i Vetëm ka vendosur zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 2,000,000,000 lekë, kaluar më Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022,

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 112/1, datë 28.12.2022, Aksionari i Vetëm ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 2,000,000,000 lekë, kaluar më Aktin Normativ nr. 17, datë 01.12.2022,

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 113, datë 28.12.2022, Aksionari i Vetëm ka vendosur shfuqizimin e Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 98, datë 15.09.2022 për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 200,000,000 lekë.

-Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 113/1, datë 28.12.2022, Aksionari i Vetëm ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën 120,000,000 lekë.

Nga auditimi konstatohet se, për të gjithë këtë vendimmarrje të Aksionarit, nuk ka kërkesa dhe shkresa të AIC SH.A, apo vendimmarrje të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, megjithëse në përbërjen e tij një pjesë e madhe e anëtarëve janë përfaqësues të MFE.

Gjithashtu, në këtë datë nga NPA në cilësinë e NA të ministrisë është urdhëruar Drejtoria e Buxhetit dhe Shërbimeve të kalojë fondet e miratuara në llogarinë e kësaj shoqërie, fonde të cilat janë bërë efektive në SIFQ më datë 17.01.2023. Pra në të njëjtën ditë Ortaku i vetëm ka marrë 4 vendime për zmadhim dhe zvogëlim kapitali me efekt neto në rritje kapitali në vlerën 2,120,000,000 lekë, pa ndonjë argument, rezultat apo kërkesë ligjore. Aktualisht kjo shoqëri referuar gjendjes në regjistrin tregtar zotëron një kapital prej 4,318,000,000 lekë, edhe pse paraqitet me humbje dhe për tre vite nuk ka paraqitur e realizuar asnjë projekt.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.5, faqe 291-298 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

46.1. Rekomandimi: Asambleja e Ortakëve, Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike të marrë masa për analizimin e veprimtarisë ekonomike dhe të situatës financiare të AIC SH.A dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mosparaqitjen e programit ekonomik dhe të pasqyrave financiare të vitit 2022 të shoqërisë.

- Asambleja e Ortakëve të marrë masa për kthimin e kapitalit të AIC SH.A në shumën 4 miliard lekë në buxhetin e shtetit, përfituar pa asnjë kërkesë apo argument dhe në mënyrë të pajustificuar me aktivitetin e kësaj shoqërie.

- Ministria e Financave të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për veprimet e kryera për lëvizjen e kapitalit, si dhe të urdhëroje ushtrimin e një misioni auditimi në AIC SH.A mbi aktivitetin e zhvilluar, qëllimet dhe arritjen e objektivave të krijimit të kësaj shoqërie.

Menjëherë

47. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, deri më 31.12.2022 referuar raportimeve të Drejtorisë së Administrimit të Pronës, dividendi i prapambetur i pa likuiduar është në shumën 4,054,214 mijë lekë, i cili i përket shoqërive si më poshtë:

1. Dividendi i palikuiduar prej 8,910 mijë lekë i përket shoqërisë “Q. T. Zh. K.” SHPK Tiranë, e cila me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 29.03.2017, ka kaluar në pronësi të Bashkisë Tiranë. Meqenëse shoqëria ka kaluar me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, detyrimet e prapambetura të palikuiduara ndiqen nga Ortaku i ri, Bashkia Tiranë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 16550/13, datë 23.01.2023, i është drejtuar Bashkisë Tiranë për likuidimin e shumës së dividendit të prapambetur.

2. Dividendi i palikuiduar prej 3,979,239 mijë lekë i përket shoqërive “KESH” SH.A dhe “Albpetrol” SH.A, të cilat me VKM nr. 317, datë 27.04.2016 dhe VKM nr. 848, datë 07.12.2016 kanë kaluar në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për të dy këto shoqëri Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vijimësi gjatë viteve, por dhe me shkresën e fundit nr. 16550/12, datë 23.01.2023, i ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë likuidimin e shumës së dividendit të prapambetur.

4. Dividendi i palikuiduar prej 66,065 mijë lekë i përket bilancit kontabël të vitit 2012 të shoqërisë “H. U. Sh.”. Me ligjin nr. 94/2013 është ratifikuar kontrata për shitjen e 100% të aksioneve të shoqërisë nga MFE tek shoqëria “K. I.” SH.A.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.5, faqe 291-298 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

47.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me ministrinë e linjës të kërkojnë arkëtimin e detyrimeve për dividendin e pa derdhur në shumën 4,054 milion lekë.

Menjëherë

48. Gjetje nga auditimi: Një problematikë evidente për administrimin e pronës mbetet edhe bilanci i bonove të privatizimit, të shpërndara qytetarëve shqiptarë sipas kontributeve në ekonomi, që do të përdreshin në privatizimin e pronës shtetërore.

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës së Shqipërisë rezulton se, gjithsej janë printuar bono privatizimi me vlerë nominale 83,302,500,000 lekë, prej të cilave, vlera prej 72,723,410,000 lekë i është shpërndarë Bankës Tregtare dhe vlera 10,579,090,000 lekë është gjendje e pashpërndarë në Bankën e Shqipërisë në formën e arkës stok. Referuar relacionit nr. 1623, datë 12.04.2022 “Mbi përfundimin procesit të inventarizimit të vlerave monetare dhe aktiveve materiale të arkës stok në Departamentin e Emisionit, në Bankën e Shqipërisë”, konstatohet se, gjendja fizike e bonove të privatizimit në vlerën 10,579,090,000 lekë është konfirmuar edhe nga inventarizimi i kryer për arkën stok.

Aktualisht nuk kemi një gjendje se sa janë përdorur për blerjen e pronave, sa janë në qarkullim të lirë (ka të dhëna për gjendjen e pa shpërndarë në Bankën e Shqipërisë dhe ato të asgjësuar prej saj) edhe pse afati i përdorimit të tyre është shtyrë vit pas viti.

Gjithashtu, konstatohet se ndaj Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë janë kërkuar ekzekutimet e dy vendimeve gjyqësore: Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 24 (çështja 70/73 e Regjistrisë Themeltar), datë 05.02.2015, kthimin e bonove të privatizimit në shumën 22,153,320 lekë dhe për kthimin e shumës 5,505,000 lekë, për të cilat nga MFE nuk është ndërmarrë asnjë veprim, kjo mbështetur dhe në ligjin nr. 7918, datë 13.04.1995 “Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit” dhe Dekretit nr. 1049, datë 27.03.1995 “Për disa plotësime në Dekretin nr. 1030, datë 23.02.1995” nuk ka parashikuar modalitete për kthimin e shumës në bono privatizimi apo të kundravleftës në lekë, në rastet kur nuk realizohet shitja e pronës, kjo edhe për faktin se bonot e privatizimit arkëtohen në bankat e nivelit të dytë dhe më pas dorëzohen në BSH për asgjësim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.5, faqe 291-298 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

48.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrë masa për evidentimin e gjendjes reale të bonove të privatizimit, të përdorur dhe në qarkullim, me qëllim shmangien e risqeve që karakterizojnë këtë proces, duke rishikuar të gjithë bazën ligjore përkatëse.

Menjëherë

49. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka miratuar Planin Vjetor 2022 në tejkallim të afatit të datës 15 Dhjetor të çdo viti, i cili përcaktohet në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, Kapitulli III, pika 3.3 “Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën F.2, faqe 318-338 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

49.1. Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të marrë masa për respektimin e afatit për përgatitjen dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor, ndër të tjera për të mundësuar edhe shmangien e mbivendosjeve të programeve të auditimit me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Në vijimësi

50. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të subjekteve ku Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit ka realizuar vlerësimet e cilësisë për sistemin e kontrollit të brendshëm, konstatohet se përgjithësisht ekziston diferencë kohore mes realizimit të kontrollit dhe hartimit/dërgimit të Raportit Përfundimtar mbi cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke cënuar koherencën e gjetjeve dhe rekomandimeve lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe asistencës teknike në këtë institucion.

(Më hollësisht trajtuar në pikën F.1, faqe 298-318 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

50.1. Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masa për rishikimin e dokumentit të Metodologjisë së Vlerësimit me qëllim përshtatjen dhe përmirësimin e procedurave të vlerësimit, ndër të tjera duke përcaktuar

afate të qarta dhe të arsyeshme të publikimit dhe dërgimit të raportit përfundimtar, me qëllim marrjen e masave në kohë të përshtatshme nga ana e njësive publike për përmirësimin e situatës.

Në vijimësi

51. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se disa prej vlerësimeve të cilësisë të realizuara në 6 mujorin e parë të vitit 2022 nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit kanë analizuar sistemet e MFK për vitin 2021, ndaj paraqitja e tyre duke u bërë pjesë e Raportit Vjetor 2022 të DH/MFKK i cili i dorëzohet NPA, nuk paraqet në mënyrë të drejtë situatën për vitin 2022. Referuar manualit të MFK, Kapitulli II “Rolet dhe Aktorët në Sistemin e MFK-së”, pika 2.2.2 citon objektivat e realizimit të monitorimit/Vlerësimit të cilësisë, ku një ndër objektivat e realizimit të këtij procesi është përgatitja e raportit vjetor për NPA dhe Ministrinë e Financave mbi statusin e përgjithshëm të MFK-së.

(Më hollësisht trajtuar në pikën F.1, faqe 298-318 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

51.1. Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit të marrë masa për përfshirjen në Raportin Vjetor të vlerësimeve/monitorimeve që reflektojnë gjendjen e sistemit për vitin përkatës për të cilën hartohet Raporti Vjetor.

Në vijimësi

52. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, DH/MFKK ka dërguar drejt njësive publike të qeverisjes së përgjithshme pyetësorët e vetëvlerësimit, ku 146 njësi kanë kthyer përgjigje, nga 152 të dërguara, procedurë që duhet të ishte përfunduar deri më datë 28.02.2023, pasi shërbejnë si burim informacioni për përgatitjen e Raportit Vjetor 2022. Disa prej njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk kanë raportuar në mënyrën e duhur, duke pasur mangësi në dokumentacionin e dërguar apo vonesa në depozitimin e informacionit të kërkuar. Nga ana e DH/MFKK janë dërguar shkresa rikujtuese drejt këtyre subjekteve me qëllim dorëzimin e informacionit të kërkuar. Ndërkohë, nga dokumentacioni i dorëzuar, evidentohet se nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues nuk janë marrë masa (sanksione/gjobitje) sa i takon subjekteve që nuk kanë dorëzuar deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, referuar nenit 29, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën F.1, faqe 298-318 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

52.1. Rekomandimi: Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e Nëpunësit të Parë Autorizues, të marrë masa për përmbushjen e detyrimit ligjor mbi vendosjen e sanksioneve të parashikuara në ligj për subjektet të cilat nuk kanë depozituar dokumentacionin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive të tyre.

Në vijimësi

53. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm konstatohet se Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka funksionuar në MFE dhe nuk janë emëruar anëtarët e tij, që pas mbarimit të mandatit të anëtarëve në vitin 2021. Në ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 12 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike”, germa b, si dhe VKM-së nr. 160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike” përcaktohet funksionimi i këtij Komiteti. Komiteti i Auditimit ka si kompetencë shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimeve për ndryshimin e planit vjetor, gjatë vitit; në monitorimin, nëpërmjet raporteve të auditimit të brendshëm të efektivitetit të sistemit

të kontrollit të brendshëm të MFE; monitorimin e performancës së njësisë së auditimit të brendshëm; këshillimin e Titullarit të Institucionit për mjaftueshmërinë në numër, të burimeve të njësisë së auditimit të brendshëm për realizimin e planit të auditimit; analizimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit të brendshëm, me qëllim informimin për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në MFE; njësitet e varësisë së MFE, në të cilën mbulon veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën G.1, faqe 338-350 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

53.1. Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për emërimin e anëtarëve të Komitetit të Auditit të Brendshëm, me qëllim funksionimin dhe kryerjen e kompetencave të tij.

Menjëherë

54. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se MFE nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, në kundërshtim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” të Ministrit të Financave, pika 3.2.1. Për më tepër, konstatohet se nuk janë kryer takime me stafin menaxherial për çështje të menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme në menaxhimin e riskut.

Regjistri i Riskut për vitin 2022 i cili përmbledh regjistrat e risqeve dhe planet e veprimit së të gjithë strukturave të MFE, rezulton të mos ketë reflektuar ndryshime në risqe për këtë vit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 11 “Përgjegjësia menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2. Për vitin 2022 rezulton që MFE nuk ka takime të dokumentuara për veprimtarinë e GMS, i cili duhet të mblihdet të paktën 4 herë në vit, referuar përcaktimeve të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, neni 27 “Takimet periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë publike”, pika 1 si dhe Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 të MF, paragrafi 2.2.4 “Roli i GMS në sistemin e MFK”, pika 3. Për më tepër, GMS referuar po këtij Udhëzimi, paragrafi 3.2.5 “Grupi i Menaxhimit Strategjik”, ka për detyrë rishikimin jo më pak se dy herë në vit të regjistratit të riskut.

Nga auditimi konstatohet se nuk është miratuar Gjurma e Auditimit si dokument i unifikuar për të gjitha proceset e institucionit, edhe pse pikat nr. 1, 2 dhe 3 të nenit 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, përcaktojnë se Titullari i MFE duhet të miratojë gjurmën standarde të auditimit, ndërsa Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësive dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi. Për më tepër, dokumentacioni i dorëzuar pranë grupit të auditimit ka paraqitur parregullsi të cilat konsistojnë në: dosje me mangësi dokumentacioni justifikues, databaza me mangësi informacioni, të dhëna të cilat kanë mangësi në rakordime si dhe dokumentacioni i cili paraqet mungesë të gjurmës audituese. Nga grupi i auditimit konstatohet se nga ana e MFE nuk është ruajtur gjurma audituese, duke e bërë të vështirë gjurmimin e qarkullimit të informacionit dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion (sidomos databazat) nuk ofron informacion për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Për vitin 2022, Titullari i MFE nuk ka urdhëruar krijimin e komisionit për inventarizimin e asetëve të MFE në kundërshtim me përcaktimet e Kreut IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, paragrafi 81 i Udhëzimit nr. 16/2016.

Sa i takon publikimit të raporteve të ndryshme dhe informacionit të nevojshëm për publikun apo palët e treta, konstatohet se në faqen zyrtare të MFE nuk janë përditësuar raportimet e viteve të fundit dhe as të vitit 2022.

(Më hollësisht trajtuar në pikën G.2, faqe 350-357 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

54.1. Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe strukturat përgjegjëse në këtë Ministri, të marrin masa për përmbushjen e mangësive të evidentuara si dhe për implementimin e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në vijimësi

55. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, referuar raportit të MFE për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, evidentohet se stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e qeverisjes qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore në datën 31.12.2022 është në shumën 12,753,240 mijë lekë, ose 581,703 mijë lekë më pak se një vit më parë.

Nga auditimi konstatohet se 4 Ministri, përkatësisht: *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë*, përbëjnë rreth 91% të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura të njësitë të qeverisjes qendrore. Kategoritë që zënë peshën kryesore janë investimet me 35.5% dhe vendimet gjyqësore me 47.9%, të cilat në krahasim me vitin e mëparshëm janë rritur me 37.4%. Në lidhje me institucionet e vetëqeverisjes vendore konstatohet se 13 bashki përbëjnë rreth 73% të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura. Kategoritë që zënë peshën kryesore janë vendimet gjyqësore me 44% dhe detyrimet e tjera me 28%, të cilat janë dyfishuar në krahasim me vitin e mëparshëm. Institucionet me shtesën më të lartë të detyrimeve për vitin 2022, sipas testeve të kryera nga KLSH, janë: Bashkia Tiranë me një shtesë detyrimi për vitin 2022 në vlerën 6,060,246 mijë lekë, ARRSH me një shtesë prej 5,996,708 mijë lekë, AKSHI me një shtesë prej 1,037,723 mijë lekë etj. Nga testimet e KLSH-së në lidhje me detyrimet e prapambetura për vitin 2022, konstatohet se ky raportim rezulton jo i plotë dhe i saktë pasi konstatohet se: 502 Institucione nga 1031, rezultojnë me diferenca në raportim, konkretisht: 104 institucione kanë raportuar pagesa më të mëdha sesa pagesat faktike; 110 institucione kanë raportuar pagesa më të vogla sesa pagesat faktike; 251 institucione nuk rezultojnë në databazën e raporteve për detyrime të prapambetura për vitin 2022, ndërkohë që nga Thesari për këto institucione/njësi rezultojnë pagesa; 37 institucione rezultojnë në databazën e raporteve për detyrime të prapambetura për vitin 2022, ndërkohë që nga Thesari për këto institucione/njësi nuk rezultojnë pagesa. Si rrjedhojë, pagesat për faturat dhe detyrime të tjera rezultojnë 9,828,089 mijë lekë më shumë se pagesat e raportuara, vlerë e cila nënkupton fatura të prapambetura të padeklaruara më parë nëpërmjet skemës së parashikuar në Udhëzimin nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, procedurë që do të rriste balancën e vitit 2022, me rreth 9.8 miliard lekë. Nisur nga problematikat e konstatuara, rezulton se procesi i raportimit të detyrimeve të prapambetura nuk ka pasur monitorim të plotë dhe mosekzekutimi në kohë i detyrimeve të prapambetura paraqet një risk të shtuar për të ardhmen, duke qenë se krijon kushte potenciale për pretendime mbi interesa dhe penalitete mbi vonesën në ekzekutim, sipas të drejtave dhe detyrimeve të palëve, të përcaktuara në kontratë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.6, faqe 142-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

55.1.Rekomandimi: MFE të parashikojë procedura shtesë kontrolli për të monitoruar raportimin aktual të detyrimeve të prapambetura, me qëllim shmangien e diferencave midis vlerës së raportuar të detyrimeve me vlerën e detyrimit të njohur në pasqyrat financiare si dhe diferencat midis detyrimit të njohur në pasqyrat financiare dhe detyrimit real të prapambetur, kryesisht fokusuar në detyrimet e prapambetura të investimeve dhe vendimeve gjyqësore si zërat me risk më të lartë.

-NPA dhe strukturat përgjegjëse pranë MFE të marrin masat për kryerjen e sondazheve periodike tek ministritë e linjës duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi, nëse ekzistojnë detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme, që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra përtej fondeve në dispozicion.

Në vijimësi

56. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultojnë se detyrimet faktike dhe kontigjente për vendimet e GJEDNJ paraqiten në vlerën gjithsej 21,717,665 milion Euro, për 7 vendime. Konstatohet se 3 vendime, konkretisht: *D. kundër Shqipërisë, R. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, Sh. kundër Shqipërisë* që i përkasin viteve 2015, 2016 dhe 2018, rezultojnë ende të palikuiduara, në kundërshtim me nenin 19/4 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

Rezultojnë se MFE për çështjen “*Sh. kundër Shqipërisë*” me shkresën nr. 2554/1 prot., citon se detyrimi nuk mund të përballohet nga buxheti i shtetit dhe sugjeron pagesë me këste, duke mbajtur një qëndrim bllokues. Ndërsa për çështjen “*R. dhe të tjerë kundër Shqipërisë*” MFE nuk ka kaluar fonde në një llogari të ngurtësuar, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 19/5 të Ligjit nr. 10, datë 13.11.2008 “Për avokaturën e shtetit”, i ndryshuar.

Sipas llogaritjeve të bëra nga KLSH, deri më datë 31.12.2022, kamatëvonesat që rëndojnë buxhetit të shtetit për mosekzekutimin e 3 vendimeve të GJEDNJ-së rezultojnë në vlerën 2,840,740 Euro.

-Nga auditimi mbi Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit rezultojnë se në raportin “*Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022*” vlera totale e kostove të vendimeve të arbitrazhit të paguara nga buxheti i shtetit raportohet në shumë 940.25 milion lekë. Ndërkohë nga mbledhja e pagesave analitike të raportuara po në këtë raport rezultojnë se kjo vlerë është 1,004 milionë lekë, duke reflektuar mospërputhje raportimesh brenda këtij raporti.

Gjithashtu konstatohet se vlera e raportuar e kostove të arbitrazhit të paguara nga aparati i MFE në raportin e mësipërm është rreth 193 milion lekë. Ndërsa sipas të dhënave të sistemit ORACLE këto pagesa rezultojnë në vlerën 291 milion lekë, ose 98 milion lekë më tepër.

Detyrimet e GJEDNJ-së dhe Arbitrazhit, si dhe mosekzekutimi i tyre në kohë, paraqesin një risk fiskal, jo vetëm për treguesit buxhetor të institucioneve përgjegjëse por edhe në nivel makroekonomik për financat publike, pasi pavarësisht se këto detyrime nuk llogariten dhe nuk regjistrohen në treguesit e borxhit publik, e implikojnë dhe e nënvlerësojnë këtë të fundit, pasi janë detyrime që do të shlyhen në të ardhmen.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.6, faqe 142-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

56.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për:

-Analizimin e të gjitha vendimeve të formës së prerë në pritje për ekzekutim dhe nxjerrjen e përgjegjësiave për strukturat përkatëse që me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë shkaktuar rritjen e penaliteteve dhe risqeve fiskale.

-Ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së brenda afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore me qëllim uljen e riskut të akumulimit të kamatëvonesave si dhe minimizimin e kostove si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimit gjyqësor.

Në vijimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: KLSH ka konstatuar krijim të detyrimeve të reja në shumën 3,404 milionë lekë të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë përgjatë vitit 2022, si pasojë e mosshlyerjes së detyrimeve përkatëse. Nga auditimi në lidhje me marrëveshjet e nënhuasë konstatohet se stoku i kredive në lidhje me këtë komponent të borxhit shtetëror është përkeqësuar përgjatë vitit 2022. Sektorët me përkeqësim të situatës financiare paraqiten sektori i energjetikës kryesisht me nënhuatë e KESH, OSHEE dhe OST me rreth 1,650 milion lekë të rritjes totale të detyrimeve nga 3,404 milion lekë në total, pushteti vendor me rreth 1,128 milion lekë, sektori i ujësjellësve me rreth 608 milion lekë, Institucionet e Mikrokredisë me nënhuatë të U. i K. K. me 17 milion lekë, dhe ARMO me 0.62 milion lekë. Në nenin 30 “Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror, mbi të cilat zbatohen kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është përcaktuar që “...është përgjegjësi ligjore e huamarrësve, të cilët kanë marrë fonde, sipas paragrafit të parë të këtij neni, që ti kthejnë fondet e marra hua në përputhje me marrëveshjet e nënhuave dhe të paraqesin raporte për gjendjen e huasë dhe përdorimin e saj, sipas kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Financave”.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e nenit, duke paraqitur një situatë ku detyrimet ndaj shtetit si pasojë e mos pagesave janë rritur me 3,404 milion lekë, me një trend rritës nga viti në vit. Krahasuar nga stoku i detyrimeve të vitit 2018 në vlerën 21,279 milion lekë në fund të vitit 2022 stoku i detyrimeve paraqitet në vlerën 45,009 milion lekë ose me një rritje totale për periudhën 5 vjeçare (2018-2022) në masën 112%.

(Më hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 233-256 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa të menjëhershme për rikuperimin e të drejtave për të arkëtuar nëpërmjet ushtrimit të instrumenteve ligjore që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuasë dhe përcaktimeve të ligjit për institucionet e caktuara për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive.

Brenda vitit 2023

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është në shumën 19,654 milion lekë nga 17,414 milion lekë në vitin 2021, me një rritje vjetore prej 2,239 milion lekë. Garancitë shtetërore përgjatë vitit 2022 paraqesin një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre dhe situatës së rënduar financiare të cilën kalon kryesisht sektori energjetik. Detyrimet si pasojë e pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022 janë akumuluar në masën më të madhe nga kompanitë private me kapital shtetëror përfituese në sektorin energjetik në shumën 1,941 milion lekë. Gjatë vitit 2022 konstatohet se Buxheti i Shtetit ka kryer pagesa si pasojë e paaftësisë paguese edhe të Radio Televizionit Shqiptar, duke rritur stokun e detyrimeve me 255 milion lekë. Gjithashtu edhe në sektorin e ujësjellësve për projektet në Ujësjellës Kanalizime Tirana situata paraqitet problematike duke vendosur Buxhetin e Shtetit në risk për kryerjen e pagesave që kanë dështuar të kryhen nga ky përfitues i garancisë dhe rritjen e detyrimeve në shumën 27 milion lekë. Në nenin 43 “Kthimi i garancisë shtetërore të huasë” të Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është përcaktuar që “Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, në masën e çdo pagese të bërë në kuadër të garancisë së dhënë. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë Ministrin të Financave së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ai i ka në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit. Huamarrësi, në zbatim të këtij ligji dhe të marrëveshjes së mirëkuptimit, është i detyruar t’i kthejë Ministrisë së Financave shumën që kjo e fundit i ka

paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përftuar nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të”.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për aq kohë sa stoku i detyrimeve jo vetëm që nuk është ulur përgjatë vitit 2022, por është rritur me 2,239 milion lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën D, faqe 233-256 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ushtrojë të gjitha mjetet ligjore për arkëtimin e të drejtave për pagesa të kryera për garancitë e arkëtuara dhe në të njëjtën kohë të ushtrojë kontroll mbi planet ekonomike dhe financiare për shlyerjen e këtyre shumave.

Brenda vitit 2023

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitit 2022 në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë kryer likuidime për Vendime Gjyqësore të formës së prerë për ish-punonjës të larguar nga puna për shkaqe të pa përligjura përpara vitit 2022, për 5 punonjës, gjithsej në vlerën 13,568,651 lekë (*paga në shumën 5,901,429 dhe sigurime shoqërore në shumën 7,667,222 lekë*), duke shkaktuar efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit, për të cilët nuk janë analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë nga titullari, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 60.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.2, faqe 265-271 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Nëpunësi Autorizues të marrë masa të menjëhershme për analizimin e të gjitha vendimeve gjyqësore dhe të nxjerrë përgjegjësitë ligjore e administrative ndaj personave shkaktar të krijimit të efektit financiar negativ në buxhetin e shtetit për largime të padrejta nga puna në zbatim të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit është konstatuar kryerja e rikonstruksionit dhe shpenzimeve nga buxheti i shtetit për një objekt që nuk është në pronësi të shtetit, si dhe skualifikim i operatorit ekonomik me ofertë ekonomike më të leverdishme, duke i shkaktuar përdorim të buxhetit pa efektivitet gjithsej në shumën 34,446 mijë lekë konkretisht:

-Nga auditimi i procedurës së prokurimi me objekt: Rikonstruksion i Shkollës Profesionale “Herman Gmainer”, konstatohet se ky objekt është në pronësi të Shoqatës “SOS FSHATRAT E FËMIJËVE NË SHQIPËRI”, ndërsa shkolla e zhvillon aktivitetin e saj në bazë të kontratës së huapërdorjes nr. 4175, datë 31.07.2014. Nga MFE është parashikuar rikonstruksioni i kësaj shkolle si rezultat i dëmtimeve nga tërmeti i vitit 2019, (referuar procesverbaleve të Institutit të Ndërtimit - nuk ka një vendim përfundimtar, por vetëm akt konstatime) dhe me qëllim përmirësimin e kushteve, bazuar dhe në kontratën e huapërdorjes. Referuar neneve përkatëse të kontratës, nga huapërdoruesi do të kryhen vetëm shpenzimet e mirëmbajtjes dhe jo të rikonstruksionit, duke rënduar buxhetin e shtetit në shumën 31,960,919.3 lekë, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 2, pika b), dh), neni 4, pika 37, si dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 9.

-Nga auditimi i procedurës së prokurimi me objekt: Rikonstruksion i Shkollës Profesionale “Hoteleri Turizëm”, konstatohet se Operatori Ekonomik “I.” SHPK është s’kualifikuar nga

KVO, pasi ka depozituar “Deklaratën në formë Autorizimi” nga prodhuesi e cila është specifikuar vetëm për një Autoritet Kontraktor, të ndryshëm nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Gjatë vlerësimit, KVO-ja, pavarësisht këtij fakti, përpara se të kryente s’kualifikimin e OE “I.” SHPK, në interes të AK mund të konsideronte aplikimin e nenit 53, pika 4, në përputhje me frymën dhe qëllimin e LPP, pra të devijimeve të vogla dhe që nuk ndryshojnë në thelb ofertën, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit duke siguruar mirëpërdorimin e fondeve publike, referuar dhe nenit 2 të ligjit nr. 162/2020 prot., “Për prokurimin publik”.

Nga s’kualifikimi i OE Operatori Ekonomik “I.” SHPK me ofertë ekonomike 29,794,365 lekë, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një efekt negativ në vlerën 2,485,182 lekë pa TVSH (32,279,547 – 29,794,365), si diferenca midis ofertave të OE i shpallur fitues BOE “A. C.” & “6 P.” dhe të OE “I.” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E.3, faqe 271-280 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Titullari i MFE të marrë në analizë inicimin e rikonstruksionit të shkollës “Herman Gmainer” dhe të nxjerrë përgjegjësitë për përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit për një subjekt privat, në shumën 31,960,919 lekë.

KVO në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave ,përpara së të kryejë një s’kualifikimin e OE, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

KLSH i rekomandon Nëpunësit të Parë Autorizues të analizojë rast pas rasti gjetjet e pasqyruara hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe marrjen e masave administrative ndaj Nëpunësve Autorizues dhe Zbatues të institucioneve të evidentuara me problematika, në përputhje me kërkesat e nenit 51 “*Menaxhimi i Angazhimeve*” dhe nenit 71 “*Kundërvajtjet administrative*” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

E. MASA DISIPLINORE

E.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 24.11.2014 “Për organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa “b”, “c” dhe “ç” nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandohet Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nisja e procedurave për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

a) “Largim nga shërbimi civil” neni 57, pika 2 dhe neni 58 germa (ç) e ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar:

1. Për znj. M. DH., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit:

- Për problematikën në drejtim të mos respektimit të disiplinës fiskale, konstatuar kjo në të gjitha fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit të buxhetit, në kundërshtim me kërkesat e LOB-it, që konsistojnë në: rialokime për projektet e investimeve me financim të brendshëm pa respektuar radhën prioritare në buxhetim, keqklasifikimin e investimeve, krijimin e kushteve për marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore, problematika në lidhje me procesin

e detajimit të fondeve për rindërtimin, detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA, shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve me detyrime të prapambetura, mungesën e monitorimit të stokut të detyrimeve të prapambetura, pasi nuk raportohet në vlerën e saktë dhe mbetet jashtë treguesve të konsoliduar fiskalë, gjenerimi i penaliteteve nga mos ekzekutimi në kohë i vendimeve të GJEDNJ; për përdorimin e fondit rezervë për rastet që duhet të përfshihen në ciklin normal të shpenzimeve referuar kriterit të parashikueshmërisë dhe dhënien e mendimit të MFE në kushtet e mungesës së dokumentacionit shoqërues të projekt akteve, duke ekspozuar cënueshmërinë e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave; rishikimeve buxhetore përtej afateve të përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi dhe pas periudhave kur është mbyllur raportimi i treguesve fiskalë faktikë.

b) “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”: neni 57, pika 3, germa “a” dhe neni 58, germa “c” e ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar:

1. Për znj. Xh. A., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit e Monitorimit të Buxhetit;
2. Për z. G. O., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Analizave dhe Programimit Buxhetor;
3. Për znj. V. Ç., me detyrë Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor;
4. Për znj. Sh. H., me detyrë Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Zbatimit dhe Monitorimit të Buxhetit.

Për problematikat në drejtim të mos respektimit të disiplinës fiskale, konstatuar kjo në të gjitha fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit të buxhetit, në kundërshtim me kërkesat e LOB-it, që konsistojnë në: rialokime për projektet e investimeve me financim të brendshëm pa respektuar radhën prioritare në buxhetim, keqklasifikimin e investimeve, për krijimin e kushteve për marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore, problematika në lidhje me procesin e detajimit të fondeve për rindërtimin, detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA, shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve me detyrime të prapambetura, mungesën e monitorimit të stokut të detyrimeve të prapambetura, pasi nuk raportohet në vlerën e saktë dhe mbetet jashtë treguesve të konsoliduar fiskalë, gjenerimi i penaliteteve nga mos ekzekutimi në kohë i vendimeve të GJEDNJ; për përdorimin e fondit rezervë për rastet që duhet të përfshihen në ciklin normal të shpenzimeve referuar kriterit të parashikueshmërisë dhe dhënien e mendimit të MFE në kushtet e mungesës së dokumentacionit shoqërues të projekt akteve, duke ekspozuar cënueshmërinë e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave; rishikimeve buxhetore përtej afateve të përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi dhe pas periudhave kur është mbyllur raportimi i treguesve fiskalë faktikë.

c) “Vërejtje”: neni 57, pika 3, germa “a” dhe neni 58, germa “a” e ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar :

1. Për z. E. T., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Menaxhimit të Investimeve;
2. Për z. E. Sh., me detyrë Përgjegjës të Sektorit të Vlerësimit të Projekteve:

Për problematikat në drejtim të mos respektimit të kërkesave të LOB-it, që konsistojnë në: rialokime për projektet e investimeve me financim të brendshëm pa respektuar radhën prioritare në buxhetim, keqklasifikimin e investimeve, krijimin e kushteve për marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore, problematika në lidhje me procesin e detajimit të fondeve për rindërtimin, detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA, shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve me detyrime të prapambetura.

3. Për znj. M. P., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit:

Për problematikat e konstatuara në kuadër të procesit të konfirmimit për llogarinë e qeverisë, specifikisht në mosrespektimin e periodicitetit të konfirmimeve të përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër mes Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave; si dhe në shkaktimin e shpenzimit i panevojshëm në vlerë totale prej 43,275,715.77 lekë gjatë përdorimit të valutës EUR për transaksione në valutën USD, ku për më tepër llogaria “Depozitë e Qeverisë në USD” nuk ka pasur gjendje të mjaftueshme, pasi nuk është përfshirë në planifikimin vjetor, edhe pse Ministria e Financave dhe Ekonomia kryen pagesa vjetore të përvitshme në valutën USD.

4. Për znj. K. H., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj;

5. Për znj. B. J., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Strategjise dhe Monitorimit te Borxhit:

Për mangësitë e evidentuara në shmangien e kamatëvonesave apo penalteteve në rast vonese të pagesës, mungesën e marrjes së masave për mos respektimin e marrëveshjeve të nënhuasë të lidhura ndërmjet shtetit dhe nënhuamarrësit, performanca e dobët e nënhuamarrësve e evidentuar kryesisht në sektorin energjetik, pushtetin vendor dhe ujësjellës, performancën e dobët të subjekteve përfituesve të garancisë si pasojë e paaftësisë paguese dhe mungesën e marrjes së masave të mjaftueshme për realizimin e të drejtave që rrjedhin nga transferimi i të drejtës për të arkëtuar të dorëzanësit, referuar ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 30, neni 42, neni 43.

E.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi këta ish-punonjës aktualisht nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte përkatësisht

1. z. A. GJ., me detyrë ish Sekretar i Përgjithshëm/Nëpunës i Parë Autorizues, do ti rekomandohej masa **“Largim nga shërbimi civil”**;

2. znj. A. B., me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, do ti rekomandohej masa **“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”**.

F. TË TJERA

Për punonjësit e tjerë të cilësuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandojmë masa disiplinore pasi shkeljet e konstatuara pavarësisht se ekzistojnë, në gjykimin e grupit të auditimit nuk janë materiale dhe nuk justifikojnë dhënien e një mase disiplinore.

V. ANEKSE

Tabela: Ndryshimet midis ligjit të buxhetit dhe SIFQ

në milion lekë

Emërtimi	Tabela sipas Ligjit	Tabela Plani fillestar në SIFQ	Diferenca Ligj-Sifq
1. TOTALI I TË ARDHURAVE	536,810.90	536,810.90	-
1.1. Të ardhura nga ndihmat	13,993.90	13,993.90	-
1.2. Të ardhura tatimore	500,167.00	500,167.00	-
1. Nga Tatimet dhe Doganat	360,535.00	360,535.00	-
a. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	166,061.00	166,061.00	-
b. Tatimi mbi Fitimin	35,586.00	35,586.00	-
c. Akcizat	56,478.00	56,478.00	-
d. Tatimi mbi të Ardhurat Personale	45,161.00	45,161.00	-
e. Taksa Nacionale dhe të tjera	49,741.00	49,741.00	-
f. Taksa Doganore	7,508.00	7,508.00	-
2. Të ardhura nga pushteti vendor	27,632.00	27,632.00	-
a. Takse mbi pasurinë	6,187.00	6,187.00	-
b. Tatim i thjeshtuar mbi biznesin	-	-	-
c. Taksa Lokale	21,445.00	21,445.00	-
3. Fonde Speciale	112,000.00	112,000.00	-
a. Të ardh Buxh. Pavarur – ISSH	96,015.00	96,015.00	-
b. Të ardh Buxh. Pavarur – ISKSH	14,985.00	14,985.00	-
c. Të ardhura nga kompensimi i pronarëve	1,000.00	1,000.00	-
1.3. Të ardhura Jotatimore	22,650.00	22,650.00	-
1. Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	1,000.00	1,000.00	-
2. Të ardhura nga Inst.Buxhetore	12,300.00	10,063.55	2,236.45
3. Të ardhura nga Dividenti	300.00	676.55	(376.55)
4. Tarifat e Shërbimeve	3,400.00	5,181.53	(1,781.53)
5. Të ardhura të tjera	5,650.00	5,728.37	(78.37)
2. TOTALI I SHPENZIMEVE	637,693.91	696,808.52	(59,114.61)
2.1. Shpenzime Korrente	507,348.91	561,567.82	(54,218.91)
1. Personeli	91,590.00	94,287.23	(2,697.23)
a. Paga	75,630.00	75,631.39	(1.39)
b. Kontributi për Sigurime Shoqërore	12,460.00	12,455.83	4.17
c. Fondi i rritjes së pagave	300.00	6,200.00	(5,900.00)
d. Politika të reja pagash	2,400.00	-	2,400.00
e. Paga Arsimit Lartë të ardhurat e	800.00	-	800.00
2. Interesat	50,756.91	45,956.00	4,800.91
a. Të Brendshme	27,363.48	27,363.00	0.48
b. Të Huaja	18,593.44	18,593.00	0.44
c. Kontingjencë për risqet e borxhit	4,800.00	-	4,800.00
3 Shpenzime Operative	63,241.00	111,265.55	(48,024.55)
4 Subvencionet	1,550.00	1,550.00	-
5. Shpenzimet per fonde speciale	212,271.00	208,771.00	3,500.00
a. Sigurime Shoqërore	148,865.00	148,865.00	-
a-1. Politika të reja pensionesh	2,570.00	2,570.00	-
Bonusi i Pensionistëve	3,500.00	-	3,500.00
b. Sigurime Shëndetësore	52,836.00	52,836.00	-
c. Fondi i kompensimit të pronarëve	4,500.00	4,500.00	-
6. Shpenzime për Buxhetin Vendor	60,290.00	72,088.05	(11,798.05)
7. Shpenzime të tjera sociale	27,650.00	27,650.00	-
a. Pagesa e Papunësisë	900.00	900.00	-
b. Ndihma ekonomike	23,550.00	25,750.00	(2,200.00)
c. Komp. për ish të përndjekurit politikë	1,000.00	1,000.00	-
d. Bonusi i lindjeve	2,200.00	-	2,200.00
8. Transferime Kapitale	-	1,177.50	(1,177.50)
2.2. Fondi Rezerve	2,900.00	7,700.00	(4,800.00)
2.3. Shpenzime Kapitale	119,445.00	97,267.50	22,177.50
1. Financimi i Brendshëm	62,765.50	62,765.50	-
2. Financimi Huaj	34,502.00	34,502.00	-
2.4 Huadhënie KESH	8,000.00	9,095.70	(1,095.70)
2.5 Fondi i Shpronësimeve	-	-	-
2.6 Fondi i Rindërtimit	20,000.00	20,000.00	-
4. DEFICITI	(100,883.01)	(159,997.62)	59,114.61
4.1. Financimi Deficitit	100,883.01	159,997.62	(59,114.61)
Brendshëm	100,251.19	227,182.92	(126,931.73)

1. Të ardhura nga privatizimi	-	-	-
2. Huamarrje e brendshme	50,000.00	(100,417.74)	150,417.74
a. Huamarrje e brendshme (Nacionale)		(100,251.00)	100,251.00
b. Huamarrje e brendshme (E marre-V)		(166.74)	166.74
3. Të tjera	50,251.19	327,600.65	(277,349.46)
a. Dep. e Qeverisë në Bank. e Shqip		-	-
4. Ripagesat (Vendore)		-	-
1 Huaj	631.82	(67,185.30)	67,817.12
1. Hua afatgjate (e marre)	25,752	(25,752.00)	51,504.00
2. Ripagesat	-42,529	(41,433.30)	(1,095.70)
3. Mbështetje buxhetore	17,408.82	-	17,408.82

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela: Plani i buxhetit me AN 19 e atij operativ dhe mbartja e tij në SIFQ në milion lekë

Nr.	E M Ë R T I M I	Plani vjetor AN 19 29.12.2022	Plani operativ	Plani në SIFQ	Diferenca Plan operativ -AN
	TOTALI I TË ARDHURAVE	583,315	583,315	536,811	-
I.	Të ardhura nga ndihmat	11,994	11,994	13,994	-
II.	Të ardhura tatimore	546,671	546,671	500,167	-
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	398,000	398,000	360,535	-
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	193,000	193,000	166,061	-
2	Tatimi mbi Fitimin	46,000	46,000	35,586	-
3	Akcizat	55,000	55,000	56,478	-
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	47,000	47,000	45,161	-
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	48,500	48,500	49,741	-
6	Taksa Doganore	8,500	8,500	7,508	-
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	27,632	27,632	27,632	-
1	Taksë mbi Pasturinë	6,187	6,187	6,187	-
2	Biznesi i vogël	0	0	0	-
3	Taksa Lokale	21,445	21,445	21,445	-
II.3	Të ardh nga fondet speciale	121,039	121,039	112,000	-
1	Sigurimi Shoqëror	104,009	104,009	96,015	-
2	Sigurimi Shëndetësor	16,030	16,030	14,985	-
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	1,000	1,000	1,000	-
III.	Të ardhura Jotatimore	24,650	24,650	22,650	-
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	1,000	1,000	1,000	-
2	Të ardhura nga Inst. Buxhetore	12,300	10,064	10,064	-
3	Dividenti	300	2,677	677	2,377
4	Tarifat e shërbimeve	3,400	5,182	5,182	1,782
5	Të tjera	5,650	5,728	5,728	78
6	Kthim kapitali nga AIC	2,000	0	0	-2,000
	TOTALI I SHPENZIMEVE	667,178	694,047	696,809	26,869
I.	Shpenzime Korrente	498,291	553,623	561,568	55,332
1	Personeli	86,684	84,817	94,287	-1,867
	Paga	72,568	72,752	75,631	184
	Kontributi për Sigurime Shoqërore	11,817	11,873	12,456	56
	Fondi i vecantë i pagave	300	0	0	-300
	Politika të reja pagash	1,200	192	6,200	-1,008
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	800	0	0	-800
2	Interesat	44,680	39,879	45,956	-4,801
	Të Brendshme	24,243	24,243	27,363	-
	Të Huaja	15,636	15,636	18,593	-
	Kontigjencë për risqet e borxhit	4,800	0	0	-4,800
3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	66,556	118,681	111,266	52,125
4	Subveconet	1,605	1,655	1,550	50
5	Shpenzime për fonde speciale	209,771	212,678	208,771	2,907
	Sigurime Shoqërore	148,135	158,887	148,865	10,752
	Politika të reja pensionesh	3,300	0	2,570	-3,300
	Bonusi i pensionistëve	3,500	0	0	-3,500
	Sigurime Shëndetësore	52,836	51,791	52,836	-1,045
	Shpenzim për kompensim pronarësh	2,000	2,000	4,500	-
6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	61,460	65,408	72,088	3,948
7	Shpenzime të tjera sociale	27,535	30,506	27,650	2,971
	Pagesa e Papunësisë	735	746	900	11
	Ndihma Ekonomike	23,600	28,760	25,750	5,160
	Kompensim për ish-të përndjekurit politikë	1,000	1,000	1,000	-
	Bonusi i lindjeve	2,200	0	0	-2,200
II	Transferime kapitale		23,385	1,178	23,385
III	Fondi Rezervë, Kontigjenca	20,840	5,008	7,700	-15,832
	Fondi Rezervë i buxhetit	10,620	5,008	7,700	-5,612
	<i>nga i cili: Mbështetje financiare e menjëhershme për përballimin e inflacionit të luftës</i>	7,800	0	0	-7,800
	Kontigjenca për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës	10,220	0	0	-10,220
IV	Shpenzime Kapitale	120,047	91,935	117,268	-28,112
	Financimi I Brendshëm	64,565	69,804	62,766	5,239
	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	1,000			-1,000
	Financimi Huaj	22,082	22,082	34,502	-
	Fondi i rindërtimit	32,400	50	20,000	-32,350
V	Fondi i shpronësimeve	0	11,000	0	-11,000
VI	Të tjera	28,000	9,096	9,096	-18,904
	Hua e dhënë për energjinë	8,000	9,096	9,096	1,096
	Mbështetje buxhetore për sektorin energjitik	20,000	0	0	-20,000
	DEFICITI	-83,863	-110,732	-159,998	-26,869
	FINANCIMI DEFICITIT	83,863	110,732	159,998	26,869
	Brendshëm	90,089	177,917	227,183	87,828
1	Të ardhura nga privatizimi	0	0	0	-
2	Huamarrje e brendshme	33,000	-100,414	-100,418	-133,414
3	Të tjera	57,088	278,331	327,601	221,243
	I Huaj	-6,225	-67,185	-67,185	-60,960
1	Hua afatgjatë(e marrë)	13,829	-25,752	-25,752	-11,923
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës	0	0	0	-
3	Ripagesat	-39,042	-41,433	-41,433	-2,391
4	Mbështetje buxhetore	18,987	0	0	-18,987

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela. Miratimi i buxhetit sipas fazave në institucionet me variancë më të lartë në mijë lekë

Nr	Institucionet	PBA (1)	P/Buxhet (2)	Buxhet (3)	(2)-(1)	(3)-(2)	(3)-(1)
1	Kuvendi	1,110,566	1,083,566	1,431,566	(27,000)	348,000	321,000
2	Kryeministria	622,000	428,000	428,000	(194,000)	-	(194,000)
3	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	10,772,064	12,736,369	12,736,369	1,964,305	-	1,964,305
4	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	38,524,176	47,448,725	47,471,725	8,924,549	23,000	8,947,549
5	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	68,228,484	65,273,059	65,473,059	(2,955,425)	200,000	(2,755,425)
6	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	45,224,917	45,658,347	45,458,347	433,430	(200,000)	233,430
7	Ministria e Kulturës	2,246,760	4,112,260	4,312,260	1,865,500	200,000	2,065,500
8	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	69,971,738	77,075,882	77,075,882	7,104,144	-	7,104,144
9	Ministria e Drejtësisë	11,584,832	11,778,132	11,280,132	193,300	(498,000)	(304,700)
10	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	2,897,747	3,142,143	3,120,143	244,396	(22,000)	222,396
11	Ministria e Brendshme	21,628,268	21,191,400	21,191,400	(436,868)	-	(436,868)
12	Ministria e Mbrojtjes	31,606,605	32,632,805	32,632,805	1,026,200	-	1,026,200
13	Këshilli I Lartë Gjyqësor	3,567,808	3,629,808	3,759,808	62,000	130,000	192,000
14	Partitë Politike	156,208	156,208	356,208	-	200,000	200,000
15	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	496,800	1,008,800	1,038,800	512,000	30,000	542,000
16	Instituti i Statistikës	798,000	1,968,400	1,968,400	1,170,400	-	1,170,400
17	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	10,740,000	18,351,924	18,351,924	7,611,924	-	7,611,924
18	Institucionet e sistemit të drejtësisë	623,656	687,656	782,656	64,000	95,000	159,000
19	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	142,940	185,940	274,940	43,000	89,000	132,000
20	Institucione të tjera Qeveritare	6,061,357	8,750,927	8,980,927	2,689,570	230,000	2,919,570
Totali		327,004,925	357,300,350	358,125,350	30,295,425	825,000	31,120,425
Totali me të gjithë institucionet		337,085,167	367,955,002	368,499,502	30,869,835	544,500	31,414,335

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela: Statusi i vështirësisë financiare për qarqet, 2022

lekë

Statusi i Vështirësisë	Nr. i qarqeve	Qarku	Detyrime të prapambetura	% e detyrimeve ndaj totali të shpenzimeve të planifikuara, 2022
Pa probleme financiare	9	Dibër	0	
		Elbasan	0	
		Fier	0	
		Kukës	0	
		Tiranë	0	
		Lezhë	0	
		Shkodër	0	
		Korçë	280,040	0.16%
		Vlorë	1,274,000	1%
Me probleme financiare	1	Gjirokastrë	10,370,648	15.88%
Në vështirësi financiare	2	Durrës	51,499,860	31.86%
		Berat	39,614,901	53.53%

Burimi: Raporti "Mbi statusin e vështirësisë financiare të njëjste të vetëqeverisjes vendore, 2022"

Tabela: Statusi financiar i bashkive sipas shpenzimeve të miratuara dhe të realizuara

lekë

Bashkia	Dety e prap	Plani	% e detyrimeve /planin	Statusi i llogaritur me shpenz e miratuara	Shpenzimet e realizuara	% e detyrimeve/sh penz e realizuara	Statusi i llogaritur me shpenz e realizuara
Këlcyrë	-	151,500,000	-	Pa probleme financiare	130,716,986	-	Pa probleme financiare
Patos	-	751,494,421	-	Pa probleme financiare	441,439,501	-	Pa probleme financiare
Korçë	291,438	2,130,905,912	0.01	Pa probleme financiare	1,629,277,749	0.02	Pa probleme financiare
Shkodër	571,032	2,810,752,290	0.02	Pa probleme financiare	1,865,758,144	0.03	Pa probleme financiare
Kolonjë	303,130	352,117,301	0.09	Pa probleme financiare	328,836,718	0.09	Pa probleme financiare
Vau-Dejë	3,342,860	1,241,049,178	0.27	Pa probleme financiare	411,344,934	0.81	Pa probleme financiare
Prrerjas	1,582,615	502,690,368	0.31	Pa probleme financiare	380,357,493	0.42	Pa probleme financiare
Pustec	720,898	116,230,000	0.62	Pa probleme financiare	86,475,384	0.83	Pa probleme financiare
Sarandë	7,764,072	1,085,690,574	0.72	Pa probleme financiare	719,083,054	1.08	Pa probleme financiare
Gjirokastrë	9,179,908	977,733,694	0.94	Pa probleme financiare	699,785,507	1.31	Pa probleme financiare
Bulqizë	7,738,273	644,707,902	1.20	Pa probleme financiare	519,494,588	1.49	Pa probleme financiare
Maliq	10,618,288	868,608,568	1.22	Pa probleme financiare	666,226,766	1.59	Pa probleme financiare
Mallakastër	10,419,769	845,606,832	1.23	Pa probleme financiare	534,091,195	1.95	Pa probleme financiare
Librazhd	9,977,393	752,989,451	1.33	Pa probleme financiare	527,691,086	1.89	Pa probleme financiare
Mirditë	7,849,021	508,732,542	1.54	Pa probleme financiare	445,709,543	1.76	Pa probleme financiare
Elbasan	49,208,673	3,024,677,342	1.63	Pa probleme financiare	2,064,998,439	2.38	Pa probleme financiare
Fushë-Arrëz	4,808,461	272,187,000	1.77	Pa probleme financiare	192,912,485	2.49	Pa probleme financiare
Himarë	26,556,327	1,341,496,271	1.98	Pa probleme financiare	540,678,356	4.91	Pa probleme financiare
Gramsh	12,643,649	589,386,592	2.15	Pa probleme financiare	463,872,831	2.73	Pa probleme financiare
Dropull	8,960,119	391,496,677	2.29	Pa probleme financiare	263,501,632	3.40	Pa probleme financiare
Krujë	28,507,972	1,218,958,885	2.34	Pa probleme financiare	787,887,817	3.62	Pa probleme financiare
Has	8,807,830	368,572,952	2.39	Pa probleme financiare	290,231,340	3.03	Pa probleme financiare
Durrës	110,492,192	4,618,140,259	2.39	Pa probleme financiare	3,271,807,992	3.38	Pa probleme financiare
Lushnjë	35,818,782	1,390,831,158	2.58	Pa probleme financiare	1,080,035,536	3.32	Pa probleme financiare
Berat	36,018,325	1,384,108,658	2.60	Pa probleme financiare	1,039,637,470	3.46	Pa probleme financiare
Mat	20,475,921	603,519,893	3.39	Pa probleme financiare	550,731,809	3.72	Pa probleme financiare
Vlorë	113,512,308	2,858,088,000	3.97	Pa probleme financiare	1,889,063,531	6.01	Pa probleme financiare
Tiranë	1,179,669,927	29,318,684,558	4.02	Pa probleme financiare	17,651,174,230	6.68	Pa probleme financiare
Skrapar	15,551,728	379,035,925	4.10	Pa probleme financiare	332,673,500	4.67	Pa probleme financiare
Memaliaj	13,410,265	278,403,936	4.82	Pa probleme financiare	223,583,604	6.00	Pa probleme financiare
Fier	113,721,317	2,341,558,727	4.86	Pa probleme financiare	1,759,969,145	6.46	Pa probleme financiare
Shijak	33,198,431	649,077,811	5.11	Pa probleme financiare	470,626,550	7.05	Pa probleme financiare
Divjakë	37,638,005	664,706,051	5.66	Pa probleme financiare	500,386,588	7.52	Pa probleme financiare
Konispol	14,252,000	242,458,305	5.88	Pa probleme financiare	202,969,159	7.02	Pa probleme financiare
Lezhë	94,958,093	1,557,662,725	6.10	Pa probleme financiare	1,155,832,883	8.22	Pa probleme financiare
Kuçovë	38,555,367	625,284,651	6.17	Pa probleme financiare	503,537,693	7.66	Pa probleme financiare

Klos	23,869,856	385,470,051	6.19	Pa probleme financiare	269,639,329	8.85	Pa probleme financiare
Kukës	83,793,293	1,016,153,561	8.25	Pa probleme financiare	949,039,751	8.83	Pa probleme financiare
Kamëz	210,762,579	2,490,533,468	8.46	Pa probleme financiare	1,995,522,645	10.56	Pa probleme financiare
Roskovec	65,119,199	734,958,112	8.86	Pa probleme financiare	505,598,038	12.88	Pa probleme financiare
Malësi e Madhe	69,003,926	759,269,467	9.09	Pa probleme financiare	640,687,979	10.77	Pa probleme financiare
Tepelenë	26,173,384	276,031,644	9.48	Pa probleme financiare	253,150,963	10.34	Pa probleme financiare
Kurbin	65,771,656	675,822,362	9.73	Pa probleme financiare	494,450,202	13.30	Pa probleme financiare
Përmet	45,482,112	464,735,705	9.79	Pa probleme financiare	289,809,952	15.69	Me probleme financiare
Finiq	34,738,089	337,451,299	10.29	Pa probleme financiare	332,101,666	10.46	Pa probleme financiare
Pukë	38,492,096	345,612,924	11.14	Pa probleme financiare	267,517,740	14.39	Pa probleme financiare
Belsh	45,187,376	377,900,699	11.96	Pa probleme financiare	301,239,822	15.00	Me probleme financiare
Selenicë	61,752,350	456,354,843	13.53	Pa probleme financiare	364,845,453	16.93	Me probleme financiare
Rrogozhinë	77,899,480	558,318,748	13.95	Pa probleme financiare	409,300,975	19.03	Me probleme financiare
Poliçan	40,578,821	269,185,456	15.07	Me probleme financiare	236,125,242	17.19	Me probleme financiare
Dibër	168,885,134	1,045,793,546	16.15	Me probleme financiare	922,757,680	18.30	Me probleme financiare
Tropojë	71,000,782	429,383,478	16.54	Me probleme financiare	386,098,448	18.39	Me probleme financiare
Pogradec	278,398,150	1,499,017,581	18.57	Me probleme financiare	1,164,082,072	23.92	Me probleme financiare
Devoll	115,580,200	619,654,946	18.65	Me probleme financiare	517,590,500	22.33	Me probleme financiare
Libohovë	28,894,056	144,388,691	20.01	Me probleme financiare	96,651,378	29.90	Në vështirësi financiare
Delvinë	49,021,631	215,686,478	22.73	Me probleme financiare	168,809,549	29.04	Në vështirësi financiare
Peqin	103,377,558	431,502,886	23.96	Me probleme financiare	313,731,304	32.95	Në vështirësi financiare
Dimal	146,824,791	548,191,175	26.78	Në vështirësi financiare	475,077,777	30.91	Në vështirësi financiare
Cërrik	157,793,548	494,128,955	31.93	Në vështirësi financiare	408,995,052	38.58	Në vështirësi financiare
Vorë	412,867,557	1,058,070,798	39.02	Në vështirësi financiare	601,185,567	68.68	Në vështirësi financiare
Kavajë	837,517,800	1,287,025,490	65.07	Në vështirësi financiare	1,114,401,379	75.15	Në vështirësi financiare

Burimi: Të dhënat e MFE, punuar nga grupi i auditimit.

Tabela: Statusi financiar i qarqeve sipas shpenzimeve të miratuara dhe të realizuara *lekë*

Qarku	Detyrime	Shpenzime të miratuara	% shpenz të miratuara/Dety	Statusi mbi shpenzimet e miratuara	Shpenzime të realizuara	% shpenz të realizuara/Dety	Statusi mbi shpenzimet e realizuara
Dibër	-	69,986,351	-	Pa probleme financiare	36,924,353	-	Pa probleme financiare
Elbasan	-	97,933,251	-	Pa probleme financiare	61,235,695	-	Pa probleme financiare
Fier	-	59,120,082	-	Pa probleme financiare	24,848,719	-	Pa probleme financiare
Kukës	-	53,768,236	-	Pa probleme financiare	50,048,108	-	Pa probleme financiare
Lezhë	-	51,010,109	-	Pa probleme financiare	42,538,715	-	Pa probleme financiare
Shkodër	-	124,204,620	-	Pa probleme financiare	40,346,457	-	Pa probleme financiare
Tiranë	-	113,004,620	-	Pa probleme financiare	80,377,102	-	Pa probleme financiare
Korçë	280,040	170,514,328	0.16	Pa probleme financiare	64,454,302	0.43	Pa probleme financiare
Vlorë	1,274,000	127,450,319	1.00	Pa probleme financiare	29,080,665	4.38	Pa probleme financiare
Gjirokastrë	10,370,648	65,306,240	15.88	Me probleme financiare	47,906,257	21.65	Me probleme financiare
Durrës	51,499,860	161,649,573	31.86	Në vështirësi financiare	83,055,879	62.01	Në vështirësi financiare
Berat	39,614,901	74,008,843	53.53	Në vështirësi financiare	34,332,047	115.39	Në vështirësi serioze financiare

Burimi: Të dhënat e MFE, punuar nga grupi i auditimit.

Tabela: Projekte investimesh të huaj me grant, të realizuara në tejkallim të planit buxhetor *Në lekë*

Min	Programi	Kodi	Përshkrimi i projektit	Plan	Fakt	Diferenca
05	04220	18AJ307	Mbështetje për zhvillimin strukturor të sigurisë ushqimore	66,695,000	80,503,330	(13,808,330)
05	04250	18AL303	Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 3 (7)	1,651,000,000	1,739,104,990	(88,104,990)
05	04250	18CF201	GIZ Mbështetje për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Zonave Rurale në Shqipëri - SDRA (GRAND)	560,829,500	586,462,190	(25,632,690)
06	04320	19AC202	Bashkëpunimi Greqi Shqipëri për ndërtesat me konsum zero, (Greece collaborates With Albania for nZEBs)	9,890,000	10,676,350	(786,350)
11	09450	18BD826	TECOMP	2,806,000	3,730,050	(924,050)
11	09450	18BD827	QUADIC	1,478,722	1,588,240	(109,518)
11	09450	18BD827	QUADIC	697,596	1,361,570	(663,974)
11	09450	18BD829	Accelerating Eastern Balkans University Modernization by Incorporating Virtual Technologies (VTECH@WBUN)	1,220,000	7,728,498	(6,508,498)
11	09450	18BD866	Universiteti i Tiranës, projekti "BLUEWBC"	4,473,120	5,783,930	(1,310,810)
11	09450	18BD867	Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Tiranë: Projekti "SMART TOUR"	100,000	1,724,130	(1,624,130)
11	09450	20AB104	Projekti TTO4FOOD "Economic enhancement of knowledge in the food sector strengthening the technological transfer offices in Albanian universities"	1,855,620	6,112,350	(4,256,730)
06	06370	19AA802	Planifikimi sektorit të ujit për negocia me BE	59,168,247	68,300,985	(9,132,738)
11	09450	20AB106	Universiteti "F. S. Noli", Korçë DualAFS "Dual Curricula Study and Practice in Agriculture and Food Safety"	2,000,000	3,599,360	(1,599,360)
11	09450	20AB111	REACH Improving Research Capacities of Albanian Higher Education Institutions in Conservator and Restoration of Cultural Heritage MAS	500,000	1,743,860	(1,243,860)
11	09450	GM11051	ERASMUS+CBHE UBT	10,137,846	18,932,280	(8,794,434)
11	09770	18CA730	Projekti DRIVE	3,133,625	3,268,290	(134,665)
11	09770	18CA732	Projekt BKSTONE	2,217,375	2,752,690	(535,315)
11	09770	18CD239	Projekti "GEOBIZ"	1,611,600	1,730,250	(118,650)
11	09770	20AB210	Projekti DigiCare4You "Një zgjidhje inovative ndërsektoriale që përfshin mjete DIGItal, fuqizimin e familjeve dhe integrimin e shërbimeve CARE në komunitet dhe parandalimin dhe menaxhimin e diabetit të tipit 2 të hipertensionit.	3,500,000	5,127,040	(1,627,040)
13	07330	GM13009	Fuqizimi i përgjigjes kombëtare ndaj HIV/AIDS (Global Fund)	75,000,000	115,147,035	(40,147,035)
16	03140	18AU106	Asistencë nga Bashkimi Europian për zbatimin e ligjit në Shqipëri - EU4 LEA"	35,000,000	50,585,860	(15,585,860)
50	01320	GM50002	Projekti i Regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë e banesave	92,650,000	92,942,789	(292,789)
06	04320	19AC203	Projektet Games Targe TBLEU DEAL SME.EC dhe Re-Source	1,900,000	27,101,350	(25,201,350)
11	09770	18BD831	Algal Forest Restoration in the Mediterranean Sea	1,000,000	2,509,940	(1,509,940)
11	09770	18CA727	Capacity building for Blue Growth and curriculum development of marine fishery in Albania-ALMARS	860,000	1,555,250	(695,250)
11	09770	18CA727	Capacity building for Blue Growth and curriculum development of marine fishery in Albania-ALMARS	500,000	889,190	(389,190)
11	09770	18CA732	Projekt BKSTONE	2,500,000	2,765,775	(265,775)
06	06220	GM06117	Manaxhimi i mbetjeve të ngurta Vlorë	425,000,000	460,602,385	(35,602,385)
11	09770	18CF918	Universiteti i Tiranës Projekti "SEAVIEWS(ADRION)"	5,000,000	6,028,810	(1,028,810)
11	09770	20AB207	Projekti "STAND UT" në Universitetin e Tiranës	580,477	3,578,220	(2,997,743)
56	06210	18BO601	IPA ADRION + CROSS BORDER + INTERREG MED-IPA AZHR	16,467,009	76,549,640	(60,082,631)
11	09770	18BE002	Reforming Doctoral Studies in Montenegro & Albania "Good practice Parading (MARDS)	1,323,000	1,567,830	(244,830)
11	09770	18CF908	Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës, Bashkë-prodhimi i njohurive dhe hulumtimeve që kanë impakt (U.SIA)	8,180,120	10,236,680	(2,056,560)
16	01160	18CK501	Projekti "Disaster do not know borders" i implementuar nga Prefektura qarkut Shkodër	5,000,000	6,096,450	(1,096,450)
16	01160	20AF201	Projekti "SMARTIMONY"- Prefektura e qarkut Gjirokastrë	1,465,000	2,551,130	(2,086,130)
11	09770	28CF913	Universiteti Politeknik i Tiranës, Projekt CRISIS	959,339	3,039,070	(1,079,731)
13	07330	GM13020	Programi i reformimit të OSUT Faza II	6,000,000	6,803,200	(803,200)
11	09770	18CF921	Universiteti "I.Qemali", Vlorë Transnational Parks and Gardens Resources in Adriatic and Ionian Tourist Marketplace, "TANGRAM"	3,575,920	5,710,630	(2,134,710)
16	03140	18AT501	Blerje pajisje për strukturat e policisë dhe asistencë teknike	10,000,000	35,912,680	(25,912,680)

11	09770	20AB203	Universiteti "L. Qemali", Vlorë, Projekti "Sustainable development of Blue economies through higher Education and innovation in Western Balkan Countries, BLUEWBC"	8,303,950	9,543,915	(1,239,965)
11	09770	18CJ928	Universiteti "L. Qemali", Vlorë Economic enhancement of knowledge in the food sector strengthening the technological transfer offices in albanian universities- TFO4FOOD	4,364,525	5,705,160	(1,340,635)
16	03140	18AU103	Mbështetje e BE për menaxhimin efektiv të kufijve të gjelbër, kufijtë blu në Shqipëri - EU4 SAFE ALB	461,880,000	560,000,000	(98,120,000)
16	03140	GM16044	Programi Policimit në Komunitet faza e dytë (qeveria suedeze)	58,000,000	68,420,370	(10,420,370)
56	06210	GM94013	Programi i zhvillimit rajonal për Shqipërinë	150,000,000	171,373,995	(21,373,995)
87	01150	18BS402	ARSINOE "Rezistenca ndaj klimës - Rajonet përmes zgjidhjeve sistematike dhe inovatore" (Horizon 2020)	3,000,000	4,129,984	(1,129,984)
TOTALI				3,761,823,591	4,281,557,721	(519,754,130)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela: Projekti investimi të planifikuara pas vitit 2024 për programin 04520

Mijë lekë

Prog	Emërtimi i Projektit	Viti përfundimi	Vlera Totale e projektit	Financimi deri në 31.12.2020	Buxheti 2021 - PLAN	Parashikimi për v.2022 MFE	Parashikimi për v.2023	Parashikimi për v.2024	Për tu paguar pas vitit 2024
04520	KARDHIQ - DELVINE	2024	14,243,630	6,456,912	1,760,047	452,500	1,233,769	1,231,000	3,109,402
04520	UNAZA E RE E TIRANES	2024	35,609,907	7,864,874	5,817,591	1,746,011	3,030,000	2,970,000	14,181,431
04520	KORÇE - ERSEKE	2024	5,702,415	606,828	128,000	611,000	240,000	350,000	3,766,587
04520	Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3	2024	2,271,085	170,022	420,001	73,500	500,000	200,000	907,562
04520	Ndërtim rruga mbikalimi Teg dhe rrugët lidhëse të tji	2024	1,683,183	-	110,000	35,000	200,000	300,000	1,038,183
04520	Përfundimi i punimeve në segmentet rrugore ura e Kranesë Qafë Botë, Ura e Kranesë ...	2024	1,700,000	-	340,000	30,000	85,000	250,000	995,000
04520	SIGURI RRUGORE	2024	1,446,990	65,997	251,924	170,000	160,000	160,000	599,069
04520	FOND EMERGENCE	2024	230,774	41,038	159,736	10,000	10,000	10,000	34,567
			62,887,984	15,205,671	8,987,299	3,128,011	5,458,769	5,471,000	24,631,801

Tabela: Projekti investimi të planifikuara pas vitit 2024 për programin 06370

Mijë lekë

Prog	Emërtimi i Projektit	Viti përf	Vlera Totale e projektit	Financimi deri në 31.12.2020	Buxheti 2021 - PLAN	Parashikimi për v.2022 MFE	Parashikimi për v.2023	Parashikimi për v.2024	Për tu paguar pas vitit 2024
06370	Furnizimi me ujë nga burimi i Grames per utesjellesin e Peshkopise	2024	737,095	226,000	25,000	85,000	85,000	208,155	107,940
06370	"Rikonstrukon magjistrali kryesor dhe rrjetit të brëndshëm të utesjellesit qytetit Patos Loti II	2024	720,475	4,095	10,000	51,624	223,912	150,000	280,844
06370	Ndërtim utesjellesi per furnizim me ujë i qytetit Burrel te fshatrave te njesis administrative Derjan dhe Rukaj -Loti I	2024	669,056	134,725	10,000	50,000	100,000	50,000	324,331
06370	Ndërtim utesjellesi i qytetit Ersekë dhe të fshatrave, Faza e II-të nga Burimet e Kozilit	2024	497,280	99,600	15,000	20,000	30,000	150,000	182,680
06370	Utesjellesi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha I, Otlak dhe Orizaj, Bashkia Berat	2024	446,743	-	169,349	44,674	44,674	50,000	138,046
06370	Ndërtimi i utesjellesit për fshatrat Lumas, Pëllumbas, Bardhaj, Sheqez, Vodës, Kreckez dhe Koritez, Njësia Administrative Lumas dhe ndërtimi i pjesës së utesjellesit në fshatin Tapi, Njësia Administrative Perondi, Bashkia Kuçovë	2024	431,599	-	86,320	43,160	43,160	50,000	208,959
06370	Furnizimi me ujë i fshatrave Vertop, Bregas, Fushe Peshtan dhe Vodicë, bashkia Polican	2024	840,000	-	168,000	20,000	20,000	50,000	582,000
06370	Ndërtimi rrjeti furnizimit dhe rrjeti shpërndarës utesjellesi Lagja Almet dhe ndërtimi i rrjetit të KUZ lagja e Vjeter qytetit Bulqize, bashkia Bulqize	2024	389,327	-	77,865	38,933	38,933	50,000	183,596
06370	Ndërtimi i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza I+ Faza II) ,Bashkia Mat	2024	1,245,155	-	309,031	100,000	100,000	100,000	636,124
06370	Ndërtim utesjellesi për furnizim me ujë të qytetit Burrel dhe të fshatrave të Njesis Administrative Derjan dhe Rukaj -Loti II	2024	343,091	-	67,640	20,000	20,000	50,000	185,451
06370	Rikonstrukione në rrjetit ekzistues të qytetit Durrës, zona 14 ,Bashkia Durrës	2024	240,000	-	48,000	20,000	20,000	50,000	102,000
06370	Rikonstrukione në rrjetit ekzistues të qytetit të Durrësit zona 10 & 13/1, bashkia Durrës	2024	479,955	-	95,991	20,000	20,000	50,000	293,964
06370	Ndërtimi i KUZ, Shënavlash	2024	437,398	-	127,480	20,000	20,000	50,000	219,919
06370	Rikonstrukon i tubacionit së dE, mit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V= 2000 m3 Shijak, rrjet shpërndarës të fshatrave Maminas-Karec-Bilalas-Karpen Bodinak, Loti i	2024	250,000	-	50,000	20,000	20,000	50,000	110,000
06370	Makineri Pajisje per UK Elbasan	2024	180,000	-	36,000	18,000	18,000	50,000	58,000
06370	Rikonstrukon i linjës nga STP Gajde ne STP Toshkëz	2024	189,199	-	37,840	18,920	18,920	50,000	63,519
06370	Ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivice & Rexhinë, ndërtimi i utesjellesit Peshtan- Mezhgorane bashkia Tepelenë	2024	235,000	-	47,000	20,000	20,000	50,000	98,000
06370	Ndërtimi e utesjellesit rajonal për fshatrat Vasiar, Iliras, Qesarat, Anë Vjose, Toç, Lulëzim, Zhulaj Krahas dhe qyteti Memaliaj	2024	487,380	-	97,476	20,000	20,000	50,000	299,904
06370	Rrjeti shpërndarës të furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës, Bashkia Kolonjë	2024	390,876	-	78,175	39,088	39,088	50,000	184,526
06370	Ndërtimi i rrjetit të utesjellesit në fshatrat e thellë të Kolonjës (Taç Qendër, Taç Poshtë, Kabash, Kodras, Gjonec, Prodan, Shelegur, Vreppë, Radanj, Radat, Kolani, Priftas, Barmash, Mesarë, Spanjollas, Blush dhe Boshanjë	2024	250,000	-	50,000	25,000	25,000	50,000	100,000
06370	Furnizimi me ujë për Bashkinë Pustec	2024	540,996	-	108,199	20,000	20,000	50,000	342,797
06370	Ndërtim i utesjellesit rajonal Cerrave & Dardhas-Burimet e Gurrasit	2024	930,867	-	186,173	20,000	20,000	50,000	654,694
06370	Përfundimi i gjithë rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të ndotura ne Njesine administrative Pogradeec dhe Njesine administrative Buçimas, Bashkia Pogradeec	2024	943,765	-	188,753	20,000	20,000	50,000	665,012
06370	Utesjellesi i Mokrës Faza e II-të	2024	266,367	-	53,273	26,637	26,637	50,000	109,820
06370	Furnizimi me ujë per zonat bregdetare te njesis administrative Shenkoll, Bashkia Lezhe	2024	791,892	-	158,378	20,000	20,000	50,000	543,514
06370	Ndërtimi i Utesjellesit Muriqan, Bashkia Shkodër, (bashkë financim)	2024	62,855	-	7,940	10,983	32,949	7,013	3,970
06370	Pajisje për Impiantin e ujërave të zeza Kavajë dhe Utesjellesi i fshatit Luz, lidhjet +matësat familjare, Bashkia Kavajë	2024	175,034	-	35,007	17,503	17,503	50,000	55,021
06370	Furnizimi me zonat bregdetare, Plazhi i Gjeneralit - Bardhor - Karpen - Synej Bashkia Kavajë-Varinati I, LOTI I	2024	200,000	-	65,000	25,000	25,000	50,000	35,000
06370	Rikonstrukon i magjistratit kryesor dhe rrjetit të utesjellesit te fshatrave Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okstun dhe Mushnik të njesis administrative Lekaj, Bashkia Rrogozhinë	2024	299,449	-	99,890	29,945	29,945	50,000	89,670
06370	Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të bashkisë divjake dhe njesis administrative Rremas Loti I-njesis administrative Rremas	2024	497,644	-	98,896	25,000	25,000	50,000	298,749
06370	Ndërtimi i rrjetit të Utesjellesit në Zonën Fushë Kamëz, Bashkia Kamëz	2024	314,518	-	62,904	31,452	31,452	50,000	138,711
06370	Ndërtimi i rrjetit KUZ dhe furnizimi me ujë i zonës Valiasi i Ri, Bashkia Kamëz	2024	760,731	-	152,146	42,643	50,000	50,000	465,941
06370	Ndërtim linje e re në tubacionin d=700mm te Bovillës së vjetër, L=6.0 km (Zëvendësimi i tubacionit ekzistues-hekuri nga liqeni i Zallherit deri te Kafja e Rremës)	2024	746,637	-	149,327	20,000	20,000	50,000	507,310
06370	Shtesa e Impiantit të përpunimit të ujit të pijshëm, Boville 1800l/s faza e II me 1200 l/s	2024	1,015,634	-	50,000	20,000	20,000	50,000	875,634
06370	Ndërtim tubacion transmetimi Basen presioni -Tunel-Partitar-Depo Dnias , Sh.a. Utesjelles Kanalizime Tiranë	2024	947,122	-	269,424	20,000	20,000	40,000	597,698

06370	Rikonstruksion i ujesjellesit ne 15 fshatrat e njesisë Administrative Novosele	2024	880,716	-	176,143	20,000	20,000	48,104	616,469
06370	Përmirësim të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrikë e Çimentos-Partizani-Karabash,dhe rindërtimi i ujesjellesit me babcice të vogël ,njesia administrative Qendër Vlorë	2024	248,725	-	49,745	20,000	20,000	40,000	118,980
06370	Përmirësim të sistemit me ujë me të Sh.A UK Vlore, Zevëndësimi i Tubit DN 400 prej Çeliku nga Gjergj Arianiti tek Rotondo e Aviacionit me gjatësi L=2050 ml & Rikonstruksioni i KUB në rrugën Transballkanike	2024	284,488	-	-	10,000	10,000	40,000	224,488
06370	Ndërtim KUZ ,rrjeti terciar (Lidhjet familjare) për UK Vlorë	2024	329,735	-	65,947	20,000	20,000	40,000	183,788
06370	Ndërtim i tubacionit me gjatësi 14 km nga Ura e Orikumit deri në hyrje të tunelit	2024	92,904	-	-	10,000	10,000	10,000	62,904
06370	Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujesjellesit të Dervicjan, Sofratik dhe Terihat,Bashkia Dropull	2024	144,344	-	48,869	14,434	14,434	52,220	14,386
06370	Rikonstruksioni i rrjeteve të brendshme të ujesjellesit të fshatrave Zervat, Vanistër,Haskov,Dhujan,Gorocë,Frashtan, Luga dhe Graphs,Bashkia Dropull	2024	252,321	-	50,464	20,000	20,000	50,000	111,857
06370	Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistuese të ujesjellesit Krongj-Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion, Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Çlirim,Bashkia Finiq	2024	301,087	-	110,217	30,109	30,109	50,000	80,652
06370	Ndërtim ujesjellesi Rajonal nga burimet e Leshnicës, Bashkia Finiq	2024	472,336	-	94,467	47,234	47,234	40,000	243,402
06370	Ujesjellesi i fshatit Gjegjan,Bashkia Puke	2024	174,390	-	34,878	17,439	17,439	40,000	64,634
06370	Furnizimi me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe lugu i Dardhës, Faza e II (Loti Përfundimtar)	2024	386,746	-	77,349	25,000	25,000	40,000	219,397
06370	"Rikonstruksione ne rrjetin ekzistues te qytetit te Durresit" zona 13/2 dhe ndertimi i depos 2/2	2024	450,000	-	90,000	4,000	5,000	40,000	311,000
06370	Permirësimi i furnizimit me ujë të njesisë Administrative Strum(Rikonstruksion i ujesjellesit të fshatit Sukë 1 ,Sukë 2, Strum dhe Velmish 2)	2024	224,623	-	44,925	3,000	5,000	40,000	131,699
06370	Rikonstruksion i ujesjellesit Gose,Bashkia Rrogzohime	2024	193,493	-	68,699	3,000	5,000	40,000	76,794
06370	Ndërtimi linje transmetimit rrjeti jashtem ujesjellesi Rajonal (Nga Burimi i Pocemiti)	2024	575,791	-	115,158	4,500	5,500	50,000	400,633
06370	Tubacioni i dërgimit nga stacioni Virovë-Depo 2500 m3, rrjeti shperndares i furnizimit me ujë të lagjes 18 Nentori (Unaza e Lushnjë -Autostradë), rrjeti shperndarës i furnizimit me ujë të lagjes Karbunarë	2024	302,928	-	60,586	4,600	4,600	50,000	183,142
06370	Implantimi i trajtimit dhe sistemi i kanalizimit te ujerave te perdorura ne zonen e Lundres, Tirane	2024	369,063	-	61,511	4,000	4,000	50,000	249,553
06370	Ndërtim ujesjellesesh per njesine administrative Ballaban,Suke dhe Dishnice Loti I (Nj.A Ballaban & Suke)	2024	300,000	-	60,000	4,000	4,000	50,000	182,000
06370	Ndërtimi i ujesjellesit Vranisht	2024	197,355	-	39,471	10,000	10,000	50,000	87,884
06370	Ujesjellesi i zones Barnush, Hore- Vranisht	2024	42,278	-	8,456	4,000	4,000	25,822	-
06370	SUPERVIZIONI PUNIMESH	2024	527,165	79,257	76,642	68,796	103,555	72,559	128,967
			24,703,629	543,677	4,625,003	1,387,674	1,690,043	3,023,873	13,435,970

Tabela: Projekte në vazhdim nga vitet e mëparshme nuk janë çelur fonde në fillim të vitit

Emërtimi Institucionit	Programi	Kodi i projektit	Emërtimi i projektit
Bashkia Lezhe (2020)	06370	18BQ369	Ndërtimi i Ujesjellesit ne fshatrat Pllane, Zejmen,Markatomaj,Spiten,Tresh,Ne njesine administrative Shengjin,Bashkia Lezhe
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Durres (0707)	06370	18BQ397	Supervizion punimesh per objektin:Sistemi i furnizimit me ujë te zones turistike Hamallaj , faza e II , Njesia administrative Sukth,Bashkia Durres
Bashkia Selence (3737)	06370	18BQ467	Rikonstruksion i rrjetit shperndares Selenicë Kote dhe Armen.Bashkia Selence
Bashkia Tirana (3535)	09120	18BC893	PPP Kontrata koncesionit Bashkia e Tiranës nr.9513, date 17310.2018 Përmirësimi i infrastruktures arsimore, projektim,ndertim, mobilim, mirembajtje, mbuqyrje, dhe kolaudim i 5 objekteve arsimore ne Zonen Tirana I
Aparati i Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise (3535)	06220	M064079	Implantimi i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	04520	18BS614	Emergjence Rreshqitja e Borshit
Bashkia Kukës (1818)	06370	19AG803	Optimizimi i Furnizimit me ujë të qytetit Kukës, Bashkia Kukës
Bashkia Finiq (3704)	06370	19AG721	Ndërtim ujesjellesi Rajonal nga burimet e Leshnicës, Bashkia Finiq
Sh.A Ujesjelles Kanalizime Konispol (3731)	06370	19AG705	Blerje pompash në stacionin e Mursisë Sh.A., Ujesjelles Konispol
Bashkia Lezhe (2020)	06370	19AG305	Ndërtimi i Ujesjellesit ne fshatrat Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh ne njesine administrative Shengjin,Bashkia Lezhe- Loti i II
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Sarande (3731)	06370	19AE403	Ndërtim i KUZ ne bllokun mbi rrugen 5,Lagjia Nr.3,Sarande
Bashkia Sarande (3731)	06370	19AE315	Furnizimi me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe lugu i Dardhës, Faza e II- (Loti Përfundimtar)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Sarande (3731)	06370	19AE313	Ndërtim i sistemit të KUZ, rrjet sekondar dhe terciar, Ksamil, Sh.A., Ujesjelles kanalizime Sarandë
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Kurbin (2019)	06370	18CF903	Ndërtim i rrjetit te jashtem dhe te brendshem te qytetit Lac,faza II
Bashkia Shijak (0707)	06370	18BR105	Rikonstruksion i tubacionit te dE., dn DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V=2000 m3 Shijak, rrjet shperndarës të fshatrave Maminas-Karec-Bilalas-Karpen Bodinak,Loti I
Bashkia Mat (0625)	06370	18BQ645	Ndërtim i rrjetit te kuz Blloku Drita nr. 1 dhe Drita Nr. 2 dhe lagjia e re, qytet Burrel
Bashkia Dibrë (0606)	06370	18BQ387	Ndërtimi i linjës se furnizimit me ujë te pjeshem Gurra e Eperme -Luzni-Peshkopi
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Durres (0707)	06370	18BQ477	Rikonstruksione te rrjetit ekzistues të qytetit Durres, zona 14 ,Bashkia Durres
Bashkia Bulqizë (0603)	06370	18BQ473	Rikonstruksion total i rrjetit të furnizimit me ujë të qytetit Bulqizë dhe rrjeti shperndarës i qytetit te ri Bulqizë
Bashkia Kolonjë (1514)	06370	18BQ469	Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut
Bashkia Krujë (0716)	06370	18BQ459	Rehabilitimi i puseve ekzistuese dhe ndertimi i ri i linjës se transmetimit dhe shperndarjes se ujesjellesit Fushë-Krujë
Bashkia Kavaja (3513)	06370	18BQ457	Rikonstruksion i rrjetit shperndares per furnizimin me ujë ne qytetin Kavaje dhe ndertimi i depo uji te re ,Faza e II
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Durres (0707)	06370	18BQ396	Sistemi i furnizimit me ujë te zones turistike Hamallaj, faza e II,Sukth
Bashkia Shijak (0707)	06370	18BQ390	Ndërtim i rrjetit të ujesjellesit për qytetin e Shijakut
Bashkia Mirditë (2026)	06730	18BQ385	Ndërtim i ujesjellesit për qytetin Rubik
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Durres (0707)	06370	18BQ479	Rikonstruksione te rrjetit ekzistues të qytetit të Durresit zona 10 & 13/1, bashkia Durres
Bashkia Pogradec (1529)	06370	18BQ519	Përfundimi i gjithë rrjetit të Kanalizimeve te Ujerave te Njesine administrative Pogradec dhe Njesine administrative Buçimas,Bashkia Pogradec
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	04520	18BS717	Ndërtim rruga Kardihiq - Delvinë Loti 8 (Sinjalistike dhe Siguri rruqore nga Loti I deri ne Lotin 6), shtese punimesh
Bashkia Prensja (0821)	06370	18CF501	Rrjeti shperndarës i ujesjellesit Prensja
Bashkia Fier (0909)	06370	18BR304	Ndërtim i Sistemit te trajtimit dhe largimit te ujrave te perdorura te spitalit memorial Fier
Bashkia Pogradec (1529)	06370	18BQ647	Mbulimi me rrjet Kanalizimi per fshatin e Gurrasit dhe zona e Drlonit,Pogradec
Bashkia Rogozhine (3513)	06370	18BQ620	Rikonstruksion i magjistralt kryesor dhe rrjetit te brendshem te ujesjellesit ne Bashkine Rrogzohime Loti III
Bashkia Vlorë (3737)	06370	18BQ616	Ujesjellesi -Zona e ujit te fohte dhe lungomares Rrapi Uji i Fiohte - Shkolla e Marines
Bashkia Krujë (0716)	06370	18BQ614	Shimi i sasish së furnizimit me ujë të qytetit të Krujës
Bashkia Finiq (3704)	06370	19AG719	Rikonstruksion dhe zgjerim i linjës ekzistuese të ujesjellesit Krongj-Finiq, linja të reja të jashtme të fshatrave Vrion, Karahaxh, Çlirim, Bregas si dhe linja e brendshme e fshatit Clirim, Bashkia Finiq
Bashkia Tepelene (1134)	06370	19AG503	Rikonstruksioni i rrjetit te jashtem dhe te brendshem te ujesjellesit ne fshatrat Sinaj,Dhemban dhe Prigonat, Bashkia Tepelene
Bashkia Kamez (3535)	06370	19AF818	Ndërtimi i rrjetit KUZ,dhe furnizimi me ujë i zonës Valiasi i Ri, Bashkia Kamez
Bashkia Kamez (3535)	06370	19AF816	Ndërtimi i rrjetit të Ujesjellesit në Zonën Fushë Kamez, Bashkia Kamez
Bashkia Cerrik (0808)	06370	19AF801	Ndërtim ujesjellesi per fshatrat Linas, Kamunah,Mollas dhe Desar,Njesis Administrative Mollas,Bashkia Cerrik
Bashkia Belsh (0808)	06370	18CG001	Linja kryesore per furnizimin me ujë dhe rrjeti shperndarës i ujesjellesit per qytetin e Belshit, Faza II
Bashkia Kurbin (2019)	06370	18CF901	Ndërtimi i rrjetit te jashtem dhe te brendshem te qytetit Lac, Faza I
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Elbasan Qytet (Elber) (0808)	06370	18BQ475	Rikonstruksion i ujesjellesit:Rruga Kongresi i Permetit,(NSHU),J.Dyli,Hashire, Elbasan;Linja kryesore STP -Byshek -depo Mlize, Shushice; Linja kryesore stp Buqes- depo Mjakes
Bashkia Skrapar (0232)	06370	18BQ461	Rehabilitimi i ujesjellesit te qytetit te Corovodes dhe fshatrave Çerenisht dhe Sharove
Bashkia Patos (0909)	06370	18BQ445	Rikonstruksion magjistralt kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujesjellesit qytetit Patos Loti 1"
Bashkia Libohovë (1111)	06370	18BQ455	Rikonstruksion i rrjetit të ujesjellesit të qytetit të Libohovës
Bashkia Rogozhine (3513)	06370	20AD801	Rikonstruksion i Ujesjellesit Gose, bashkia Rrogzohime
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Durres (0707)	06370	20AD701	Rikonstruksion ne rrjetin ekzistues te qytetit te Durresit, zona 13/2 dhe ndertimi i depos 2/2
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Durres (0707)	06370	19AG903	Ndërtimi i KUZ Shënvalash
Bashkia Rogozhine (3513)	06370	19AG604	Rikonstruksion i magjistralt kryesor dhe rrjetit të ujesjellesit te fshatrave Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshun dhe Mushnik të njesisë administrative Lekaj, Bashkia Rogozhine
Bashkia Kuçovë (0217)	06370	19AG405	Ndërtimi i ujesjellesi për fshatrat Lumas, Pëllumbas, Bardhaj, Sheqez, Vodës, Krekez dhe Kortez, Njesis Administrative Lumas dhe ndërtimi i pjeshëm i ujesjellesit, Njad Perondi
Bashkia Peqin (0827)	06370	19AF809	Rikonstruksion sektori i depove Peqin

Bashkia Peqin (0827)	06370	19AF807	Ndërtim rrjeti i Ujësjellësit të fshatit Bicaç dhe Caushaj
Bashkia Peqin (0827)	06370	19AF803	Ndërtim ujesjellesi per fshatrat Gjocaj,Celihakaj dhe Hashmataj,Bashkia Peqin
Bashkia Mat (0625)	06370	19AF218	Ndërtim ujesjellesi për furnizimin me ujë të qytetit Burrel dhe të fshatrave të Njësisë Administrative Derjan dhe Rukaj- Loti II
Bashkia Mat (0625)	06370	19AF216	Ndërtimi i rrjetit shpërndarës të qytetit të Burrelit (Faza I+ Faza II), Bashkia Mat
Bashkia Bulqizë (0603)	06370	19AF212	Ndërtimi i rrjetit të furnizimit dhe rrjetit shpërndarës të ujesjellesit, Lagja Allmet dhe ndërtimi i rrjetit të KUZ lagja e Vjeter e qytetit Bulqizë, bashkia Bulqizë
Bashkia Bulqizë (0603)	06370	19AF210	Rikonstruksion total i rrjetit të furnizimit me ujë të qytetit Bulqizë, dhe rrjeti shpërndarës i qytetit të ri Bulqizë- Faza II
Bashkia Dibër (0606)	06370	19AF208	Furnizimi me ujë nga burimi i Gramës për ujesjellësin e Peshkopisë- Faza II
Bashkia Mat (0625)	06370	19AF206	Ndërtim ujesjellesi per furnizimin me uje te qytetit Burrel te fshatrave te njesise administrative Derjan dhe Rukaj -Loti I
Bashkia Bulqizë (0603)	06370	19AF203	Ndërtim rrjeti shpërndarës i fshatrave Gjorice si dhe ndërtim depo Uji-faza e II
Bashkia Dibër (0606)	06370	19AF201	Furnizimi me ujë nga burimi i Gramës për ujesjellësin e Peshkopisë
Bashkia Vlorë (3737)	06370	19AE305	Ndërtimi i ujesjellesi ne rruget transhalkanike Vlore,Bashkia Vlore
Bashkia Fier (0909)	06370	19AE001	Ujesjellesi ne DMA 6 dhe ujesjellesi i zones Afrimi i Ri-shkolla Bujqesore.Fier
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Durres (0707)	06730	18CG106	Projekti per vendosje matesash ne pallatet me kallome te brendshme, Loti II,Qytet Durres
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Vlore (3737)	06370	18BQ527	Ndërtim KUZ ,rrjeti tercial (Lidhjet familjare) për UK Vlorë
Bashkia Rogozhinë (3513)	06370	18BQ525	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, Lagja e re Gocë, bashkia Rogozhinë
Bashkia Peqin (0827)	06730	18BQ523	Ndërtim i kanalizimeve të ujërave të zeza të zeza të qytetit Peqin

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela: Programet buxhetore më të prekura me akte normative

		Financim i Brendshëm	AN 3 date 12.03.2022	AN 12 date 29.07.2022	AN 17 date 01.12.2022	AN 19 date 29.12.2022
6	Ministria e Infrastruktura dhe Energjise (total programe)	25,374,314	24,142,314	23,742,314	31,886,239	31,886,239
04520	Transporti rrugor	16,171,887	15,571,887	15,571,887	20,571,887	20,571,887
06370	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	7,118,185	6,486,185	6,486,185	8,486,185	8,486,185
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	1,067,042	1,067,042	667,042	562,042	562,042
04320	Mbeshetjet per Energjine	200,000	200,000	200,000	1,502,000	1,502,000
04430	Mbeshetjet per Burimet Natyrore	91,000	91,000	91,000	138,000	138,000
10	Ministria e Financave dhe Ekonomise (total programe)	2,145,329	1,945,329	3,691,329	4,047,329	4,039,683
01130	Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme	400,000	400,000	2,070,000	2,480,000	2,480,000
01140	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	342,640	342,640	445,640	571,640	571,640
01150	Menaxhimi i te Ardhurave Doganore	153,220	153,220	126,220	70,220	52,574
09240	Arsimi i Mesem (profesional)	423,469	280,669	280,669	200,669	280,669
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	3,931,000	3,326,000	3,326,000	2,625,500	2,242,315
09120	Arsimi Baze (perفشire parashkollorin)	1,208,000	1,108,000	1,108,000	970,000	770,000
09230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	1,112,000	1,012,000	1,012,000	1,002,000	892,000
09450	Arsimi Universitar	1,006,000	606,000	606,000	236,000	188,500
12	Ministria e Kultures	2,262,500	2,062,500	2,069,500	1,438,500	1,438,500
08230	Arti dhe Kultura	2,242,500	2,042,500	2,042,500	1,420,500	1,420,500
13	Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	1,342,944	1,342,944	1,026,944	1,012,444	1,012,444
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	147,052	147,052	70,912	70,912	70,912
07330	Sherbimet e Kujdesit Dytesor	1,195,212	1,195,212	930,712	921,212	921,212
17	Ministria e Mbrojtjes	8,339,500	7,304,500	6,504,500	6,299,500	6,034,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	320,000	220,000	160,000	36,500	11,353
09430	Arsimi Ushtarak	500,000	390,000	390,000	68,000	66,800
02150	Mbeshetja e Luftimit	1,113,000	1,113,000	913,000	556,000	475,500
10910	Emergjencat Civile	2,070,000	779,000	879,000	788,500	696,256
50	Instituti Statistikes	300,000	300,000	67,000	14,500	14,500
01320	Veprimtaria Statistikore	300,000	300,000	67,000	14,500	14,500
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	10,500,000	9,000,000	9,500,000	9,565,100	9,565,100
06220	Infrastruktura Vendore dhe Rajonale	3,500,000	2,800,000	2,800,000	3,058,300	3,058,300
04230	Programi "100 Fshatrat"	500,000	400,000	400,000	100,000	100,000
87	Institucione te tjera Qeveritare	2,221,629	2,221,629	2,630,129	2,652,629	2,704,629
01140	e-Qeverisja	1,881,376	1,881,376	2,322,376	2,510,376	2,562,376
TOTALI		62,765,500	57,593,500	58,538,800	65,196,245	64,565,245

a) **Projekte pa plan fillestar ose me plan të vogël fillestar dhe realizim të lartë.**

Marrë në shqyrtim projektet ku plani fillestar – fakt kanë një diferencë mbi (-100,000 mijë lekë)

Mijë lekë

Kodi	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	Fakti	Dif buxhet fillestar-fakti
22AC801		8,000,000,000	8,000,000,000	(8,000,000)
22AC802		8,000,000,000	8,000,000,000	(8,000,000)
19AD201	-	7,742,682,771	7,132,460,417	(7,132,460)
22AC001		1,340,026,888	1,289,285,222	(1,289,285)
M170424	2,329,928,000	3,077,016,773	3,345,624,499	(1,015,696)
22AA201		950,000,000	950,000,000	(950,000)
18BS550	93,000,000	714,057,049	714,057,049	(621,057)
22AD001		500,000,000	499,999,339	(499,999)
M064179	65,000,000	593,639,447	526,051,770	(461,052)
18BS552	576,000,000	1,036,848,960	1,036,848,960	(460,849)
M120694		461,400,000	451,559,305	(451,559)
18BS543	260,000,000	656,419,468	656,419,468	(396,419)
22AA202	-	510,000,000	394,710,251	(394,710)
M064079		376,400,000	376,385,112	(376,385)
22AA101	-	350,026,531	350,000,000	(350,000)
18BS616		256,561,120	256,561,120	(256,561)
19AF901		252,479,750	252,479,750	(252,479)
19AF201		240,000,000	240,000,000	(240,000)
M064192	75,000,000	356,864,523	296,864,523	(221,864)
18BQ519		220,000,000	220,000,000	(220,000)
22AA501	-	200,000,000	200,000,000	(200,000)
18BC893		197,537,194	197,537,194	(197,537)
M064194	60,000,000	254,417,057	254,417,057	(194,417)
18BS712	70,000,000	263,999,232	263,999,232	(193,999)
18BS540	120,000,000	438,516,000	291,381,084	(171,381)
18BS713	46,000,000	215,596,230	215,596,230	(169,596)
M064191	35,000,000	258,020,109	203,965,000	(168,965)
19AG805		166,000,000	166,000,000	(166,000)
19AF818		160,000,000	160,000,000	(160,000)
19AF216		274,478,251	137,158,042	(137,158)
18BS547	93,000,000	303,902,968	229,680,105	(136,680)
19AF206		200,000,000	100,000,000	(100,000)
22AB701	-	155,000,000	98,178,873	(98,179)
M062991	20,000,000	180,000,000	74,040,726	(54,040)
M062993	136,000,000	417,514,470	176,455,103	(40,455)
18BS612	93,000,000	381,712,380	129,084,120	(36,084)

b) **Projekte me plan fillestar të lartë dhe realizim të ulët ose pa realizim.**

Marrë në shqyrtim projektet ku plani fillestar – fakt kanë një diferencë mbi 100,000 mijë lekë.

Mijë lekë

Kodi	Buxheti Fillestar	Buxheti Përfundimtar	Fakti	Dif buxhet fillestar-fakti
18BQ607	4,306,523,821		1	-
M060625	3,543,460,536		70,474	-

M560009	2,888,056,853	1	-	2,888,057
M170203	580,440,000	35,581,000	-	544,859
M170327	420,000,000	17,030	-	419,983
M500002	282,750,000	2,100,000	-	280,650
18BC501	265,188,877	188,877	-	265,000
18AY909	581,572,000	342,306,479	165,375,108	239,266
18BP035	245,000,000	37,124,167	-	207,876
18AZ901	791,059,000	587,719,566	241,045,372	203,339
18AZ106	220,000,000	20,000,000	-	200,000
21AA202	400,000,000	200,000,000	-	200,000
21AC101	1,200,000,000	1,000,000,000	989,102,500	200,000
18BN234	386,245,087	189,742,859	189,742,859	196,502
18BN117	396,248,908	200,755,942	200,000,000	195,493
18BC708	168,000,000	5,976,036	-	162,024
M870013	117,000,000	366,536	-	116,633
M100397	130,000,000	24,877,719	24,877,719	105,122
18BP014	234,484,587	134,948,437	122,128,735	99,536
18BN226	113,927,800	15,000,000	-	98,928
18BN137	259,611,482	162,424,791	159,218,601	97,187
18BA213	312,000,000	224,699,000	224,698,533	87,301
18CD701	85,000,000	500,000	-	84,500
19AA301	100,000,000	20,262,000	-	79,738
18BS551	400,000,000	324,322,094	324,322,094	75,678
18BN132	122,831,268	47,996,634	17,996,634	74,835
18BP004	111,892,756	45,080,840	38,194,231	66,812
M112625	200,000,000	137,309,861	-	62,690
18AZ312	95,000,000	36,789,409	24,479,759	58,210
18BP016	69,817,510	19,746,349	19,746,349	50,071
M160911	58,135,000	9,165,000	4,352,040	48,970
M630008	60,000,000	12,000,000	-	48,000
18AR906	122,231,000	78,150,000	74,423,040	44,081
M870290	52,000,000	8,258,581	2,397,034	43,741
18CC804	77,000,000	33,380,120	11,509,518	43,620
18AZ405	70,000,000	28,000,000	-	42,000
20AD410	70,000,000	30,000,000	-	40,000
18BN118	202,242,002	163,182,972	163,182,972	39,059
M170237	70,905,000	34,905,000	14,864,390	36,000
18BB076	94,106,000	59,405,263	59,405,263	34,701
20AC102	75,000,000	42,110,000	42,101,968	32,890
18AT902	76,878,000	44,278,000	-	32,600
18BP029	84,904,549	54,700,726	49,896,670	30,204
18BN138	88,000,000	58,000,000	22,611,583	30,000
18BP025	142,059,180	112,059,180	112,059,180	30,000
18CI201	186,000,000	156,000,000	79,464,589	30,000
M112684	39,782,944	9,782,944	-	30,000
18BE611	48,500,000	21,000,000	8,355,360	27,500
18AJ309	29,366,000	2,744,000	1,080,000	26,622
18BN233	247,121,552	220,592,426	189,621,178	26,529
18BP022	124,021,251	97,971,865	97,971,865	26,049
18AT818	39,036,000	13,237,075	12,573,957	25,799
18BS613	55,000,000	29,291,000	24,541,000	25,709
18AY636	45,000,000	20,503,076	-	24,497
21AC301	31,000,000	7,000,000	2,499,552	24,000
M064243	58,000,000	34,017,000	34,016,987	23,983
18AZ025	65,000,000	41,231,880	-	23,768
20AD413	120,000,000	96,232,000	-	23,768
18AE714	30,000,000	6,622,395	-	23,377
18AY635	50,987,000	28,697,156	-	22,289
18BN228	90,000,000	69,000,000	38,889,058	21,000
18AK343	47,352,000	27,352,000	27,351,992	20,000
18BN133	66,500,243	46,500,243	28,032,219	20,000
18AY637	35,000,000	15,404,190	9,000,456	19,595
18BH604	16,800,000	200,000	-	16,600
18AA509	46,385,000	30,000,000	17,224,650	16,385
M020002	28,273,000	12,462,045	8,164,396	15,811
M064072	27,240,000	11,564,000	9,564,000	15,676
18AV003	19,000,000	4,000,000	3,942,744	15,000
18BN129	82,257,310	67,257,310	65,479,023	15,000
M062778	100,000,000	85,165,014	85,165,014	14,835
18AA410	30,000,000	15,242,400	-	14,758
18BN134	184,619,250	170,766,663	170,766,663	13,852
M870099	15,000,000	1,335,416	1,335,336	13,664
18AY503	100,000,000	87,200,000	-	12,800
21AC401	39,200,000	26,444,840	14,744,120	12,755
M064080	34,339,300	21,766,300	16,591,121	12,573
18AZ813	200,000,000	187,629,058	187,629,007	12,371
18BP006	25,569,570	13,713,708	13,713,708	11,856
M051202	65,649,600	54,012,000	47,935,017	11,638
20AC101	5,500,000,000	5,488,419,230	5,488,419,229	11,581
18AK340	20,000,000	8,468,416	8,466,373	11,531
18BP013	31,651,304	20,200,000	19,884,506	11,451
18BT006	12,149,000	700,000	-	11,449
M063842	38,822,000	27,878,500	27,878,160	10,943
18CI403	15,000,000	4,192,276	3,916,240	10,808
18AK338	20,000,000	9,200,000	-	10,800
18BH603	10,800,000	147,555	-	10,652
18AI901	15,000,000	4,500,000	4,456,618	10,500
18BN120	11,985,394	1,647,014	1,331,908	10,338
18AJ810	30,000,000	20,000,000	20,000,000	10,000
M010020	13,000,000	3,000,000	-	10,000
M063141	20,000,000	10,000,000	-	10,000

Tabela: Pagesat e realizuar sipas sistemit e-Dëshmëpërblime të ndara sipas kategorive dhe kësteve/Kategoria Parësore

Kësti	Shuma	Nr. Përfutuesish
Kësti 1	453,503.26	2
Kësti 2	226,250	1
Kësti 3	1,211,494.02	8
Kësti 4	1,797,630.96	5
Kësti 5	2,174,399.36	6
Kësti 6	1,007,734.21	6
Kësti 7	1,340,491.26	14
Kësti 8	5,383,198.93	23
Kësti 9	-	-
Kësti 10	989,519.27	1
Kësti 11	1,986,692.77	2
Kësti 12	932,277.42	1
Kësti 13	1,892,455.53	2

Kësti 14	984,469.19	1
Kësti 15	-	-
Kësti 16	-	-
Kësti 17	961,584.05	1
Kësti 18	961,584.05	1
Kësti 19	961,584.05	1
Totali	23,264,868.33	75

Tabela: Pagesat e realizuar sipas sistemit e-Dëshmëpërblime të ndara sipas kategorive dhe kësteve/Kategoria Jo Parësore

Kësti	Shuma	Nr. Përfutuesish
Kësti 1	25,932,386.24	320
Kësti 2	40,000,013.69	609
Kësti 3	611,601,025.30	6320
Kësti 4	296,985,851.44	1441
Totali	974,519,276.67	8690

Tabela: Pagesat e realizuar për vitin 2022 sipas sistemit e-Dëshmëpërblime të ndara sipas VKM-ve

Nr.	VKM	Datë	Nr. Përfutuesish parësor	Pagesa kategoria parësor	Nr. Përfutuesish jo parësor	Pagesa kategoria jo parësor	Total pagesa
1	1699	29.12.2008	5	4,357,841.44	514	107,536,879.63	111,894,721.07
2	707	23.06.2009	4	729,022.25	392	66,978,034.90	67,707,057.15
3	784	01.07.2009	32	6,373,304.31	419	65,314,275.48	71,687,579.79
4	1147	25.11.2009	-	-	142	22,714,798.17	22,714,798.17
5	1231	11.12.2009	-	-	100	13,286,403.46	13,286,403.46
6	1259	23.12.2009	2	1,979,038.54	94	16,068,198.35	18,047,236.89
7	268	21.04.2010	-	-	186	25,483,255.45	25,483,255.45
8	382	19.05.2010	-	-	186	23,350,234.83	23,350,234.83
9	714	25.08.2010	2	852,534.01	311	31,029,695.50	31,882,229.51
10	382	19.10.2010	1	454,030.88	-	-	454,030.88
11	1069	29.10.2010	-	-	296	23,995,155.02	23,995,155.02
12	1015	10.12.2010	-	-	194	19,888,860.93	19,888,860.93
13	61	26.01.2011	-	-	250	20,313,160.24	20,313,160.24
14	99	09.02.2011	2	546,551.36	220	16,262,573.90	16,809,125.26
15	135	23.02.2011	-	-	272	22,075,095.38	22,075,095.38
16	196	09.03.2011	1	154,875	263	23,777,336.40	23,932,211.40
17	230	23.03.2011	1	301,250	216	17,375,312.02	17,676,562.02
18	297	14.04.2011	-	-	334	33,522,297.13	33,522,297.13
19	363	04.05.2011	2	165,333.66	201	21,149,455.29	21,314,788.95
20	390	25.05.2011	-	-	103	9,903,362.69	9,903,362.69
21	457	22.06.2011	1	190,268	62	4,777,744.56	4,968,012.56
22	691	12.10.2011	-	-	179	14,305,969.94	14,305,969.94
23	186	03.06.2012	1	226,750	357	28,927,591.83	29,154,341.83
24	497	01.08.2012	-	-	773	69,897,003.69	69,897,003.69
25	509	13.06.2013	-	-	1980	212,091,483.32	212,091,483.32
26	502	10.06.2015	-	-	641	63,548,025.28	63,548,025.28
27	688	22.11.2017	3	1,507,935.50	4	815,500.01	2,323,435.51
28	256	09.05.2018	11	2,783,880	1	132,373.25	2,916,253.25
29	297	19.05.2021	7	2,642,253.25	-	-	2,642,253.25
29 Total			75	23,264,868.33	8690	974,519,276.67	997,784,944.85

Tabela: Detyrimet e prapambetura të njëjste të vetëqeverisjes vendore

Milionë lekë

Detyrimeve	Stoku i	Vend Gjyq	Shtërbime	Mirëmb	Inves	Rimb TVSH	Mallra	Të tjera	Sig. Shoq	Sig. Shënd	Ardh. Pers	Të Tjera	Total
Bashkia Tiranë	44.9	25.2	0.3	223.4	-	66.6	800.4	8.8	0.0	5.4	4.5	1,179.7	
Bashkia Kavajë	45.6	189.3	-	83.2	-	1.7	517.7	-	-	-	-	837.5	
Bashkia Vorë	6.0	-	81.9	325.0	-	-	-	-	-	-	-	412.9	
Bashkia Pogradec	56.9	87.4	1.8	65.4	-	11.9	32.6	18.4	2.6	0.6	0.7	278.4	
Bashkia Kamëz	-	88.4	-	122.3	-	-	-	-	-	-	-	210.8	
Bashkia Dibër	31.3	10.5	0.1	100.2	-	18.1	-	1.8	0.3	6.7	0.0	168.9	
Bashkia Cërrik	-	1.6	0.4	152.4	-	3.4	-	-	-	-	-	157.8	
Bashkia Dimal	9.1	6.0	9.7	90.8	-	31.3	-	-	-	-	-	146.8	
Bashkia Devoll	-	6.7	-	105.4	-	3.0	0.5	-	-	-	-	115.6	
Bashkia Fier	-	3.3	0.2	110.2	-	-	-	-	-	-	-	113.7	
Bashkia Vlorë	-	7.6	-	66.2	-	2.2	37.5	-	-	-	-	113.5	
Bashkia Durrës	73.5	0.1	-	36.9	-	(0.0)	-	-	-	-	-	110.5	
Bashkia Peqin	19.3	33.9	0.1	14.4	0.8	4.6	30.3	-	-	-	-	103.4	
Bashkia Lezhë	-	33.3	0.0	50.6	-	11.0	-	-	-	-	-	95.0	
Bashkia Kukës	4.4	8.5	6.4	31.7	-	15.4	1.7	8.9	0.6	6.2	-	83.8	
Bashkia Rrogozhinë	-	0.5	-	77.4	-	-	-	-	-	-	-	77.9	
Bashkia Tropojë	3.8	1.2	2.2	63.9	-	-	-	-	-	-	-	71.0	
Malësi e Madhe	-	-	-	69.0	-	-	-	-	-	-	-	69.0	
Bashkia Kurbini	1.9	2.1	-	61.5	-	-	0.3	-	-	-	-	65.8	
Bashkia Roskovec	-	1.1	-	56.5	-	7.5	-	-	-	-	-	65.1	
Bashkia Selenicë	7.8	7.1	-	28.9	-	11.9	5.6	0.3	-	-	0.1	61.8	
Qarku Durrës	51.0	-	-	-	-	-	0.5	-	-	-	-	51.5	
Bashkia Elbasan	10.8	-	-	32.0	-	6.4	-	-	-	-	-	49.2	
Bashkia Delvinë	1.2	3.3	-	43.0	-	-	1.5	-	-	-	-	49.0	
Bashkia Përmet	22.4	2.3	-	20.7	-	-	-	-	-	-	-	45.5	
Bashkia Belsh	-	-	-	45.2	-	-	-	-	-	-	-	45.2	
Bashkia Poliçan	7.1	1.4	-	21.8	-	-	10.3	-	-	-	-	40.6	
Qarku Berat	39.0	0.1	-	0.6	-	-	-	-	-	-	-	39.6	
Bashkia Kuçovë	-	0.6	-	37.6	-	0.3	-	-	-	-	-	38.6	
Bashkia Pukë	25.8	5.7	-	7.0	-	-	-	-	-	-	-	38.5	
Bashkia Divjakë	3.8	3.1	-	26.5	-	4.3	-	-	-	-	-	37.6	
Bashkia Berat	0.6	0.1	-	32.4	-	1.0	2.0	-	-	-	-	36.0	
Bashkia Lushnjë	-	7.0	8.2	13.4	-	7.1	0.1	-	-	-	-	35.8	
Bashkia Finiq	0.1	2.6	-	15.5	-	0.2	16.3	-	-	-	-	34.7	
Bashkia Shijak	4.8	0.5	-	27.9	-	-	-	-	-	-	-	33.2	
Bashkia Libohovë	14.6	0.1	0.4	2.7	-	-	11.2	-	-	-	-	28.9	
Bashkia Krutjë	4.2	1.4	0.0	8.9	-	-	0.7	12.1	-	0.9	0.3	28.5	
Bashkia Himarë	-	-	0.7	19.9	-	-	5.9	-	-	-	-	26.6	
Bashkia Tepelenë	0.1	4.8	1.0	5.0	-	8.4	6.8	-	-	-	-	26.2	
Bashkia Klos	-	-	-	23.9	-	-	-	-	-	-	-	23.9	

Bashkia Mat	1.9	13.5	-	3.9	-	1.1	-	-	-	-	-	-	20.5
Bashkia Skrapar	3.9	0.4	4.5	1.3	-	1.5	4.0	-	-	-	-	-	15.6
Bashkia Konispol	-	6.0	0.2	1.6	-	2.4	3.7	0.2	-	-	-	0.1	14.3
Bashkia Memaliaj	0.2	8.9	0.2	1.1	-	1.7	1.5	-	-	-	-	-	13.4
Bashkia Gramsh	4.0	1.8	-	5.1	-	1.8	-	-	-	-	-	-	12.6
Bashkia Maliq	-	-	-	10.2	-	0.4	-	-	-	-	-	-	10.6
Bashkia Mallakastër	0.9	0.2	0.6	4.0	-	-	4.7	-	-	-	-	-	10.4
Qarku Gjirokastrë	8.8	-	-	-	-	0.4	1.3	-	-	-	-	-	10.4
Bashkia Librazhd	0.3	0.8	-	8.9	-	-	-	-	-	-	-	-	10.0
Bashkia Gjirokastrë	1.0	-	-	8.2	-	-	-	-	-	-	-	-	9.2
Bashkia Dropull	-	-	-	-	-	-	9.0	-	-	-	-	-	9.0
Bashkia Has	0.4	0.4	-	7.5	-	0.5	-	-	-	-	-	-	8.8
Bashkia Mirditë	-	5.6	0.0	0.1	-	2.1	0.0	-	-	-	-	-	7.8
Bashkia Sarandë	2.0	5.7	-	-	-	0.0	-	-	-	-	-	-	7.8
Bashkia Bulqizë	0.2	-	0.5	7.1	-	-	-	-	-	-	-	-	7.7
Bashkia Fushë-Arrëz	4.8	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	4.8
Bashkia Vau-Dejë	3.3	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3.3
Bashkia Përrenjas	-	1.6	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1.6
Qarku Vlorë	-	1.3	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1.3
Bashkia Pustec	-	0.7	-	0.0	-	-	-	-	-	-	-	-	0.7
Bashkia Shkodër	-	0.3	-	-	-	-	-	0.0	-	-	-	0.2	0.6
Bashkia Kolonjë	0.1	-	0.1	-	-	0.0	-	-	-	-	-	-	0.3
Bashkia Korçë	-	0.0	-	-	-	0.3	-	-	-	-	-	-	0.3
Qarku Korçë	-	-	-	-	-	0.2	0.1	-	-	-	-	-	0.3
TOTAL	521.8	594.0	119.7	2,378.1	0.8	228.9	1,505.9	50.5	3.4	19.9	6.0	5,428.9	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tabela: Detyrimet e prapambetura të njëjstëve të qeverisjes së përgjithshme qendrore

Milionë lekë

Stoku i Detyrimeve	Vend Gjyq	Shërbime	Mirëmb	Inves	Rimb TVSH	Mallra	Të tjera	Sig. Shoq	Sig. Shënd	Ardh. Pers	Të tjera	Total
MIE	1,777.7	1.0	-	2,125.5	51.2	-	-	-	-	-	-	3,955.4
MB	707.6	2.3	-	114.9	-	-	4.3	3.4	0.0	0.9	-	833.5
MM	57.4	5.4	0.1	7.6	-	-	531.0	151.4	18.9	41.6	-	813.5
MFE	521.2	0.1	-	41.2	-	0.1	-	-	-	-	-	562.6
MSHMC	108.2	10.7	13.0	12.6	0.2	52.1	37.3	0.0	-	0.0	0.1	234.4
Inst tjera Qev.	1.2	-	105.7	0.2	-	-	0.3	-	-	-	-	107.4
MK	49.2	0.3	-	13.0	1.1	-	19.2	-	-	-	-	82.8
Prok. e Përgj	12.8	19.3	-	4.2	-	-	43.7	-	-	-	-	80.0
FSHZH	-	-	-	31.5	-	-	-	-	-	-	-	31.5
MASR	6.8	-	-	22.8	-	0.1	-	-	-	-	-	29.7
MTM	-	-	-	20.6	-	-	-	-	-	-	-	20.6
MD	-	0.0	-	9.9	-	-	6.2	-	-	-	-	16.1
MBZHR	-	0.6	-	1.0	-	-	-	-	-	-	-	1.5
KLJG	0.7	-	-	-	-	-	0.0	-	-	-	-	0.7
Presidencia	-	0.1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.1
TOTAL	3,242.8	39.7	118.8	2,405	52.6	52.3	642.1	154.8	19	42.5	0.1	6,769.7

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tabela: 30 njësitë me stokun më të lartë të detyrimeve të prapambetura për vitin 2022

Institucioni	Kodi	Stoku 2021	% ndaj totalit	Stoku 2022	% ndaj totalit	ndryshimi 2022-2021
Aparati i Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji	1006001	1,305,132,866	10%	1,452,869,567	11%	147,736,701
Bashkia Tirana (3535)	2101001	489,428,684	4%	1,125,474,706	9%	636,046,022
Bashkia Kavaja (3513)	2118001	820,048,291	6%	837,517,800	7%	17,469,509
INUK (3535)	1016130	565,872,667	4%	686,573,265	5%	120,700,598
Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (3535)	1017142	864,260,553	6%	529,268,791	4%	(334,991,762)
Aparati Drejt.Përgj.Tatimeve (3535)	1010039	950,864,111	7%	433,700,664	3%	(517,163,447)
Bashkia Vore (3535)	2165001	515,591,777	4%	412,867,557	3%	(102,724,220)
Bashkia Dibër (0606)	2106001	282,143,863	2%	406,748,007	3%	124,604,144
Bashkia Pogradec (1529)	2136001	316,431,205	2%	347,178,628	3%	30,747,423
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	1006054	133,711,658	1%	335,297,976	3%	201,586,318
Bashkia Belsh (0808)	2152001	242,615,538	2%	328,522,554	3%	85,907,016
Bashkia Malësi e Madhe (3323)	2130001	322,781,244	2%	282,324,249	2%	(40,456,995)
Bashkia Dimal (0202)	2167001	133,509,042	1%	266,150,796	2%	132,641,754
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Tirane (3535)	2101152	277,851,164	2%	250,490,911	2%	(27,360,253)
Reparati Ushtrarak Nr.4300 Tirane (3535)	1017051	208,773,315	2%	216,088,874	2%	7,315,559
Bashkia Kamez (3535)	2166001	261,171,535	2%	210,762,579	2%	(50,408,956)
Drejtoria e Përgjithshme e Ujesjelles Kana	1006047	494,647,742	4%	207,275,188	2%	(287,372,554)
Bashkia Berat (0202)	2102001	157,160,681	1%	206,843,030	2%	49,682,349
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Kruje (0716)	2123002	204,207,895	2%	204,207,895	2%	-
Bashkia Dropull (1111)	2452001	2,998,286	0%	189,151,168	1%	186,152,882
Bashkia Kucove (0217)	2124001	122,386,434	1%	177,549,057	1%	55,162,623
Bashkia Cerrik (0808)	2110001	181,333,663	1%	157,793,548	1%	(23,540,115)
Bashkia Pustec (1515)	2499001	1,178,459	0%	146,741,618	1%	145,563,159
Bashkia Patos (0909)	2112001	-	0%	125,388,731	1%	125,388,731
Qendra spitalore universitare "Nene Tereza	1013049	124,166,367	1%	124,166,367	1%	-
Bashkia Devoll (1505)	2105001	51,630,393	0%	115,580,200	1%	63,949,807
Departamenti per Krimin e Organizuar dhe K	1016128	-	0%	114,531,216	1%	114,531,216
Bashkia Durres (0707)	2107001	280,950,592	2%	110,374,392	1%	(170,576,200)
Bashkia Fier (0909)	2111001	175,133,473	1%	109,453,287	1%	(65,680,186)
Bashkia Vlore (3737)	2146001	115,078,465	1%	108,413,908	1%	(6,664,557)
Top 30		9,601,059,963	72%	10,219,306,529	80%	618,246,566
<i>Institucione të tjera</i>		<i>3,748,975,037</i>	<i>28%</i>	<i>2,532,653,216</i>	<i>20%</i>	<i>(20,171,311.04)</i>
Totali i detyrimeve		13,350,035,000	100%	12,751,959,745	100%	598,075,255

Tabela: Institucionet që sipas raportit rezultojnë me pagesa të raportuara më të mëdha se pagesat e testuara nga SIFQ

Institucioni	Kodi	Pakesime sipas raportit	Pagesat sipas testimeve SIFQ	Diferenca
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	1006054	5,795,121,801	4,262,918,132	1,532,203,669
Bashkia Tirana (3535)	2101001	5,424,199,528	4,475,818,639	948,380,889
Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (353)	1017142	412,428,305	793,479	411,634,826
Aparati Drejt.Përgj.Tatimeve (3535)	1010039	762,688,952	387,382,942	375,306,010
Aparati Drejt.Përgj.Doganave (3535)	1010077	466,873,977	228,280,599	238,593,378

Bashkia Kolonjë (1514)	2120001	445,001,797	367,541,195	77,460,602
Bashkia Kurbin (2019)	2126001	204,919,390	136,940,091	67,979,299
Administrata Kopshte Çerdhe (3535)	2101054	48,919,233	296,066	48,623,167
Bashkia Dibër (0606)	2106001	260,312,929	211,794,572	48,518,357
INUK (3535)	1016130	45,544,357	126,383	45,417,974
Bashkia Kukës (1818)	2125001	130,684,906	85,899,680	44,785,226
Bashkia Belsh (0808)	2152001	191,933,601	156,933,859	34,999,742
Bashkia Durres (0707)	2107001	578,978,104	544,643,677	34,334,427
Bashkia Kucove (0217)	2124001	254,741,043	221,440,613	33,300,430
Bashkia Pogradec (1529)	2136001	380,486,204	348,095,347	32,390,857
Bashkia Fier (0909)	2111001	220,657,704	193,874,114	26,783,590
Bashkia Elbasan (0808)	2109001	160,197,329	136,805,111	23,392,218
Spitali Kukës (1818)	1013020	27,439,850	7,655,428	19,784,422
Nd-ja Komunale Banesa (1529)	2136005	47,545,717	29,181,398	18,364,319
Bashkia Tepelene (1134)	2142001	43,238,140	25,367,923	17,870,217
Spitali Diber (0606)	1013015	74,821,680	57,551,924	17,269,756
Bashkia Mat (0625)	2132001	368,929,302	351,888,749	17,040,553
Bashkia Delvine (3704)	2104001	41,165,790	24,753,085	16,412,705
Bashkia Selenice (3737)	2159001	72,864,436	57,934,191	14,930,245
Spitali Gjirokaster (1111)	1013018	19,044,559	4,961,871	14,082,688
Bashkia Maliq (1515)	2168001	193,413,810	179,353,599	14,060,211
Bashkia Peqin (0827)	2134001	76,746,450	63,513,025	13,233,425
Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Konispol (3731)	2156002	18,111,215	4,937,565	13,173,650
Sh.A. Ujësjetllës-Kanalizime Durres (0707)	2107018	288,887,352	276,618,190	12,269,162
Bashkia Gjirokaster (1111)	2115001	39,554,580	28,646,577	10,908,002
Bashkia Himare (3737)	2160001	75,665,137	64,894,928	10,770,209
Bashkia Dimal (0202)	2167001	222,020,180	212,436,263	9,583,917
Bashkia Korçe (1515)	2122001	35,606,639	26,857,451	8,749,188
Bashkia Konispol (3731)	2156001	84,801,788	76,722,665	8,079,123
Bashkia Memaliaj (1134)	2143001	16,053,446	9,208,888	6,844,558
Qarku Gjirokaster (1111)	2011001	7,787,358	963,000	6,824,358
Bashkia Patos (0909)	2112001	122,298,084	116,256,883	6,041,201
Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Dibë	1013004	5,832,684	48,521	5,784,163
Klubi Sportiv Tirana (3535)	2101017	5,682,500	289,525	5,392,975
Bashkia Skrapar (0232)	2139001	77,827,037	73,566,230	4,260,807
Universiteti "A. Xhuvani", Elbasan (0808)	1011099	4,574,807	338,242	4,236,565
Qendra Ekonomike Arsimit (0217)	2124009	14,999,238	10,784,341	4,214,897
Reparti Special "Renea" Tirane (3535)	1016009	4,537,388	530,991	4,006,397
Bashkia Prenjas (0821)	2153001	59,602,391	56,056,882	3,545,509
Drejtoria Mbeshtetese e Arsimit Bashkia Ko	2122017	38,966,964	35,542,098	3,424,866
Zyra Arsimore Librazhd (0821)	1011101	3,243,035	134,000	3,109,035
Spitali Vlore (3737)	1013024	6,788,870	3,692,559	3,096,311
Drejtoria Arsimore Diber (0606)	1011006	3,078,584	148,153	2,930,431
Cirku Kombetar (3535)	1012092	2,637,885	170	2,637,715
Qarku Berat (0202)	2042001	9,552,141	7,161,567	2,390,574
Bashkia Has (1812)	2117001	13,094,575	10,773,555	2,321,020
Burgu Rrogozhine (3513)	1014002	4,234,525	2,088,471	2,146,054
Ndermarja e Sherbimeve te Mir. Rrugore	2113002	15,890,894	13,980,474	1,910,420
Bashkia Puke (3330)	2137001	38,420,010	36,566,659	1,853,351
Tirana Parking (3535)	2101816	22,299,221	20,492,277	1,806,944
Bashkia Pustec (1515)	2499001	39,352,305	37,602,305	1,750,000
Drejtoria e Sherbimit (1134)	2143002	3,512,865	1,778,352	1,734,513
Nd-ja Komunale Banesa (0217)	2124004	12,345,599	10,786,702	1,558,897
Bashkia Dropull (1111)	2452001	75,824,953	74,490,611	1,334,342
Bashkia Vau Dejës (3333)	2157001	27,235,898	25,971,375	1,264,523
Zyra Arsimore Skrapar (0232)	1011089	1,934,328	708,411	1,225,917
Nd-ja Komunale Banesa (0202)	2102004	24,411,642	23,239,797	1,171,845
Sh.A. Ujësjetllës-Kanalizime Kurbin (2019)	2126007	18,535,211	17,363,503	1,171,708
Zyra Vendore Arsimore - Belsh (0808)	1011253	13,227,363	12,075,759	1,151,604
Instituti i Edukimit te Vendimeve Penale K	1014097	1,398,995	284,851	1,114,144
Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracion	1016104	1,462,761	369,306	1,093,455
Burgu Tepelene (1134)	1014005	2,622,969	1,568,993	1,053,976
Drejtoria Rajonale AKU Diber (0606)	1005120	1,212,555	205,632	1,006,923
Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracioni	1016101	3,723,966	2,717,693	1,006,273
Ndermarja e Pastrim, Gjelbërim dhe Mirëm	2113003	3,603,979	2,683,829	920,150
Administrata Kopshte Çerdhe (0808)	2109008	5,891,284	4,977,022	914,262
Agjensia Shtetërore per Mbrojtjen e te Dre	1013121	891,024	11,000	880,024
Sp. Tepelene (1134)	1013086	1,825,945	949,217	876,728
Sp. Gramsh (0810)	1013069	873,676	182,896	690,780
Instituti i Integritimit te Perdjekurve Pol	1013122	659,103	340	658,763
Sp. Devoll (1505)	1013067	6,351,679	5,701,293	650,386
Ndermarrja Komunale Divjake (0922)	2147003	19,589,068	19,145,642	443,426
Sp. Mat (0625)	1013078	9,271,250	8,828,792	442,458
Reparti i NSH Tirane (3535)	1016012	324,900	71,944	252,956
Q.K.P. Azilkerkuesve Babru (3535)	1016057	300,000	60,000	240,000
Bashkia Devoll (1505)	2105001	129,721,733	129,485,817	235,916
Zyra Arsimore Kolonjë (1514)	1011112	2,067,688	1,854,588	213,100
Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tr	1010283	297,442	101,182	196,260
Qarku Durres (0707)	2047001	18,638,765	18,470,195	168,570
Sp. Mirditë (2026)	1013079	266,690	107,000	159,690
Drejtoria Rajonale AKPA Diber (0606)	1010183	159,117	6,700	152,417
Drejtoria Rajonale e Monumenteve Vlore (37	1012070	3,579,891	3,433,010	146,881
Bashkia Fushe- Arrez (3330)	2155001	5,024,849	4,904,849	120,000
Drejtoria Vendore e Policise Durres (0707)	1016025	3,073,785	2,953,929	119,856
Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujq	1005114	2,416,140	2,296,833	119,307
Drejtoria e SHIK Lezhe (2020)	1018014	1,955,695	1,860,434	95,261
Bashkia Sarandë (3731)	2138001	143,417,948	143,323,566	94,382
Zyra Arsimore Kavajë (3513)	1011130	78,000	1,578	76,422
Drejtoria Rajonale AKPA Kukës (1818)	1010202	172,800	100,840	71,960
Nd-ja Pastrim Gjelbërim (0909)	2111008	25,406,336	25,342,336	64,000
Reparti Ushtrarak Nr.2001 Durres (0707)	1017031	63,000	23,452	39,548
Drejtoria e shendetit publik Kolonjë (1514)	1013031	1,974,217	1,949,217	25,000
Qendra Sociale Balashe Elbasan (0808)	2109017	2,002,983	1,983,283	19,700
Gjykata e rrethit Kukës (1818)	1029025	96,392	80,000	16,392

Bashkia Libohove (1111)	2116001	6,648,758	6,634,747	14,011
Drejtoria e shendetit publik Mat (0625)	1013037	167,851	156,014	11,837
Drejtoria Rajonale Mjedisit Lezhe (2020)	1026073	59,205	50,000	9,205
Nd-ja Mirembajtja Kruga (0808)	2109014	122,615,240	122,608,122	7,118
Biblioteka Durres (0707)	2107021	103,860	100,440	3,420

Tabela: Institucionet që sipas raportit rezultojnë me pagesa të raportuara më të vogla se pagesat e testuara nga SIFQ

Institucioni	Kodi	Pakesime sipas raportit	Pagesat sipas testeve SIFQ	Diferenca
Aparati i Ministrisë së Infrastruktura dhe Ener	1006001	49,013,123	3,447,641,301	(3,398,628,178)
Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informac	1087006	932,033,799	3,344,534,651	(2,412,500,852)
Bashkia Kamez (3535)	2166001	50,408,956	1,128,685,618	(1,078,276,662)
Bashkia Kruje (0716)	2123001	51,524,888	539,962,014	(488,437,126)
Aparati Ministrise se Financave (3535)	1010001	51,020,570	330,668,887	(279,648,317)
Bashkia Vlore (3737)	2146001	73,375,558	317,753,190	(244,377,632)
Bashkia Finiq (3704)	2326001	42,600,396	249,180,446	(206,580,050)
Bashkia Rogozhine (3513)	2119001	15,506,310	175,708,445	(160,202,135)
Bashkia Vore (3535)	2165001	106,300,397	246,071,839	(139,771,442)
Bashkia Lezhe (2020)	2127001	340,591,205	439,233,609	(98,642,404)
Aparati i Ministrise se Turizmit dhe Mjedi	1026001	1,406,020	92,977,734	(91,571,714)
Aparati Ministrise se Bujqesise dhe Zhvill	1005001	25,812,793	116,073,704	(90,260,911)
Bashkia Permet (1128)	2135001	7,414,601	93,925,489	(86,510,888)
Bashkia Kavaja (3513)	2118001	362,052,387	445,326,433	(83,274,046)
Bashkia Shkoder (3333)	2141001	2,805,188	85,739,141	(82,933,953)
Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publi	2101156	15,337,156	72,754,081	(57,416,925)
Ndermarja e punetoreve nr. 2 (3535)	2101155	20,020,286	76,937,471	(56,917,185)
Agjensia e Parqeve dhe Rekreacionit (3535)	2101815	43,916,510	98,370,678	(54,454,168)
Bashkia Mallakastër (0924)	2131001	7,168,379	58,844,832	(51,676,453)
Universiteti Bujqesor (3535)	1011041	1,800,000	47,807,519	(46,007,519)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Tirane (3535)	2101152	30,000,000	75,368,578	(45,368,578)
Bashkia Bulqize (0603)	2103001	376,591	41,934,891	(41,558,300)
Drejtoria e Përgjithshme e Ujesjelles Kana	1006047	485,036,378	525,845,226	(40,808,848)
Sp. Sarande (3731)	1013084	23,370,075	59,855,686	(36,485,611)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Elbasan Qytet	2109015	22,518,118	57,166,982	(34,648,864)
Aparati Ministrise se Shendetesise dhe Mbr	1013001	30,312,605	63,055,516	(32,742,911)
Nd-ja Tregut Lire (3535)	2101049	5,612,675	37,500,042	(31,887,367)
Bashkia Tropojë (1836)	2145001	35,432,338	64,372,960	(28,940,622)
Spitali Shkoder (3333)	1013023	2,229,554	31,072,006	(28,842,452)
Bashkia Gramsh (0810)	2114001	37,796,659	58,538,733	(20,742,074)
Porti Detar Sarande (3731)	1006093	15,985,100	31,970,200	(15,985,100)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Shkoder Qytet	2141032	16,924,356	32,264,926	(15,340,570)
Maternitet Nr.2T. (3535)	1013088	124,560	13,303,698	(13,179,048)
Spitali Lushnje (0922)	1013022	1,603,084	14,094,339	(12,491,255)
Bashkia Cerrik (0808)	2110001	111,445,742	122,499,442	(11,053,700)
Nd-ja Punetore Nr.1 (3535)	2101146	4,738,375	14,007,887	(9,269,512)
Reparti Usharak Nr.1001 Tirane (3535)	1017009	2,516,671	10,799,873	(8,283,202)
Bashkia Klos (0625)	2654001	36,220,100	44,336,760	(8,116,660)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Korce Qytet (1	2122013	423,573	8,150,354	(7,726,781)
Bashkia Polican (0232)	2140001	103,031,763	110,591,604	(7,559,841)
Bashkia Mirditë (2026)	2133001	353,106,135	359,967,714	(6,861,579)
Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave Dur	1006095	83,177,121	89,435,533	(6,258,412)
Bordi i Kullimit Korce (1515)	1005072	15,329,054	21,583,555	(6,254,501)
Bashkia Berat (0202)	2102001	205,744,123	211,574,400	(5,830,277)
Bashkia Malësi e Madhe (3323)	2130001	174,270,429	179,604,595	(5,334,166)
Nd-ja Pastrim Gjelbrimit (1515)	2122006	656,800	5,711,046	(5,054,246)
Drejtoria Rajonale Arsimore, Korçë (1515)	1011259	5,089,238	9,964,676	(4,875,438)
Bordi i Kullimit Durres (0707)	1005068	5,702,193	10,454,170	(4,751,977)
Universiteti Aleksander Moisiu (0707)	1011150	5,619,829	9,212,823	(3,592,994)
Nd-ja Komunale Banesa (3737)	2146017	2,794,274	6,309,517	(3,515,243)
Ndermarja e Pasurive PNdermarja e Pasuri	2129010	124,114,495	127,552,562	(3,438,068)
Zyra Vendore Arsimore, Cërrik (0808)	1011252	1,539,465	4,798,085	(3,258,620)
Bashkia Librazhd (0821)	2128001	15,786,368	18,854,405	(3,068,037)
Drejtoria Ekonomike e Arsimit (3535)	2141010	1,497,600	4,454,160	(2,956,560)
Bashkia Lushnje (0922)	2129001	14,375,342	17,289,725	(2,914,383)
Reparti Usharak Nr.3001 Tirane (3535)	1017037	755,760	3,193,285	(2,437,525)
Kuvendi Popullor (3535)	1002001	10,887,827	13,303,303	(2,415,476)
Universiteti Politeknik (3535)	1011040	264,026	2,361,260	(2,097,234)
Ndermarja Balneare Peshkopi (0606)	2106014	1,806,691	3,818,524	(2,011,833)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Sarande (3731)	2138008	10,859,626	12,837,019	(1,977,393)
Agjensia e Rinise (3535)	2101824	123,000	1,865,890	(1,742,890)
Drejtoria Vendore e Policise Vlore (3737)	1016022	575,410	2,306,843	(1,731,433)
Sp. Laç (2019)	1013075	465,354	2,069,056	(1,603,702)
Bashkia Divjake (0922)	2147001	129,771,192	131,374,142	(1,602,950)
Qendra Ekonomike Arsimi (0202)	2102005	2,656,515	4,167,375	(1,510,860)
Bashkia Shijak (0707)	2108001	159,280,079	160,595,765	(1,315,686)
Dega e Kujdesit Paresor Fier (0909)	1013007	696,350	2,008,888	(1,312,538)
Bashkia Roskovec (0909)	2113001	213,644,907	214,830,270	(1,185,363)
Nd-ja Sherbimeve Komunale (0707)	2107013	7,840,734	9,012,654	(1,171,920)
Universiteti i Tiranës, fakulteti i Shkenc	1011140	2,140,080	3,309,207	(1,169,127)
Sp. Tropoje (1836)	1013087	1,186,299	2,339,178	(1,152,879)
Admin Qendrore e ISHP (3535)	1010227	2,000,000	3,150,508	(1,150,508)
Qendra e Arsimi Lushnje (0922)	2129012	1,858,155	2,994,683	(1,136,528)
Prefektura e qarkut Korce (1515)	1016067	85,955	1,175,723	(1,089,768)
Spitali Lezhe (2020)	1013021	5,003,901	5,949,396	(945,495)
Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore (3737)	1010076	200,000	1,112,000	(912,000)
Agjencia Kombetare per Sigurin dhe Emergj	1006158	60,000	810,777	(750,777)
Qendra Ekonomike Kultures (3737)	2146015	160,624	855,624	(695,000)
Agjensia Kombetare e Turizmit (3535)	1026088	106,042	796,274	(690,232)
Drejtoria e shendetit publik Lac (2019)	1013034	59,375	694,333	(634,958)
Prokuroria e rrethit Vlore (3737)	1028030	96,000	710,200	(614,200)
Teatri (3333)	2141017	588,725	1,126,325	(537,600)
Drejtoria e shendetit publik Mallakaster (1013036	8,190	539,945	(531,755)
Muzeu Historik Kombetar (3535)	1012010	16,728	479,400	(462,672)
Prokuroria e rrethit Lushnje (0922)	1028019	587,000	854,300	(267,300)

Federata Te Tjera (3737)	2146025	563,250	812,806	(249,556)
Ndermarrja Rruga (0707)	2107014	6,595,705	6,770,365	(174,660)
Qendra Kombetare e Emergjences (3535)	1013143	414,877	558,166	(143,289)
Ndermarrja e Parqeve dhe Rekreacionit (152)	2136023	847,880	977,380	(129,500)
Qendra e Grumbullimit Trajtimet Kimikateve	1006159	3,054,548	3,174,605	(120,057)
Qarku Diber (0606)	2046001	102,509	221,509	(119,000)
Sp. Kavaje (3513)	1013071	76,031	194,614	(118,583)
Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Kukë	1013010	1,164,375	1,282,875	(118,500)
Zyra Arsimore Bulgizë (0603)	1011090	122,489	240,161	(117,672)
Drejtoria Vendore e Policise Elbasan (0808)	1016026	5,515,244	5,624,317	(109,073)
Muzeu Kombëtar "Gjethi" (3535)	1012098	379,080	471,356	(92,276)
Sp. Peqin (0827)	1013080	490,000	560,655	(70,655)
Drejtoria Rajonale Mjedisit Fier (0909)	1026069	351,846	416,406	(64,560)
Qend. Zhvillimit Durrës (0707)	1013136	259,990	317,725	(57,735)
Drejtoria Vendore e Policise Diber (0606)	1016024	6,764,278	6,818,491	(54,213)
Prokuroria e rrethit Elbasan (0808)	1028007	13,000	66,000	(53,000)
Teatri "Skampa" (0808)	2109010	355,436	395,436	(40,000)
Komisariati i Policise Tropoje (1836)	1016055	311,430	351,235	(39,805)
Drejtoria e Mbikqyrjes se Sherbimit te Pro	1014100	1,000,000	1,039,080	(39,080)
Reparti Usharak Nr.5570 Vlore (3737)	1017083	45,838	68,757	(22,919)
Dega e Thesarit Durres (0707)	1010007	111,664	133,587	(21,923)
Dega e Kujdesit Paresor Lushnje (0922)	1013012	190,878	207,344	(16,466)
Njësia e Administrimit të Banesave Sociale	2109021	59,600	69,200	(9,600)
Drejtoria Arsimore Gjirokastr (1111)	1011011	221,668	225,808	(4,140)
Nd-ja Komunale Plazh (0707)	2107015	30,312,060	30,312,080	(20)

Tabela: Institucionet që kanë kryer pagesa por s'kanë raportuar

Institucioni	Kodi	Pakesime sipas raportit	Pagesat sipas testimeve SIFQ	Diferenca
Fondi i Zhvillimit Shqiptar (3535)	1056001	-	2,241,022,528	(2,241,022,528)
Qendra spitalore universitare "Nene Tereza	1013049	-	512,252,630	(512,252,630)
Agjencia e Eficences se Energjise (AEE) (3	1006164	-	181,307,694	(181,307,694)
QFM Teknike Tirane (3535)	1016056	-	115,519,855	(115,519,855)
Spitali Universitar i Traumes (3535)	1017138	-	99,563,099	(99,563,099)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Lushnje Qytet	2129008	-	94,050,000	(94,050,000)
Drejtoria e Rajonit Qendror (Tirane) (353	1006079	-	89,700,432	(89,700,432)
Sanatoriumi Tirane (3535)	1013051	-	88,206,615	(88,206,615)
Spitali Korce (1515)	1013019	-	84,251,680	(84,251,680)
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësis	1010179	-	75,873,424	(75,873,424)
Sh. A. Ujesjelles-Kanalizime Kamez (3535)	2166003	-	70,200,000	(70,200,000)
Bashkia Këlcyre (1128)	2154001	-	60,400,272	(60,400,272)
Spitali Universitar i Traumes (Sherbimi Ur	1013104	-	59,929,919	(59,929,919)
Aparati Ministrise se Kultures (3535)	1012001	-	57,284,971	(57,284,971)
Njësia e Manaxhimit te projektit te nderti	1006933	-	45,848,754	(45,848,754)
Spitali Elbasan (0808)	1013016	-	38,086,737	(38,086,737)
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura(3	1026087	-	37,481,052	(37,481,052)
Universiteti i Tiranës (3535)	1011039	-	37,287,653	(37,287,653)
Aparati Ministrise se Puneve te Jashtme (3	1015001	-	37,164,664	(37,164,664)
Aparati Ministrise Mbrojtjes (3535)	1017001	-	36,101,636	(36,101,636)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Peqin (0827)	2134003	-	31,723,888	(31,723,888)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Vlore (3737)	2146029	-	24,000,000	(24,000,000)
Qendra e Formimit Policor Tirane (3535)	1016003	-	18,929,409	(18,929,409)
Qarku Tirane (3535)	2035001	-	18,648,218	(18,648,218)
Aparati i Ministrise se Brendshme (3535)	1016001	-	17,943,259	(17,943,259)
PIU Rehabilitimit te Sistemit Shendetesor	1013902	-	16,942,693	(16,942,693)
Instituti I Sigurise Ushqimore dhe Veterin	1005111	-	16,184,538	(16,184,538)
Ujesjelles Kanalizime Vora -Shoqëri Anonime (3535)	2165003	-	14,740,960	(14,740,960)
Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore (AK	1006162	-	14,726,919	(14,726,919)
Instituti shendetit publik Tirane (3535)	1013048	-	14,148,557	(14,148,557)
Qendra Nderuniversitare e Sherbimeve te Rrjetit Tel	1011160	-	13,636,968	(13,636,968)
Aparati i Keshillit te Ministrave (3535)	1003001	-	11,975,030	(11,975,030)
Ujesjelles Kanalizime Belsh (0808)	2152002	-	11,564,067	(11,564,067)
Drejtoria e Arkivave Shtetit (3535)	1020001	-	10,980,225	(10,980,225)
Fakulteti i Mjekesise (3535)	1011139	-	10,616,824	(10,616,824)
Matemiteti Tirane (3535)	1013050	-	10,529,736	(10,529,736)
Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor Qendro	1013106	-	10,007,492	(10,007,492)
Aparati Ministrise se Drejtësisë (3535)	1014001	-	9,669,315	(9,669,315)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Rrogozhine (35	2119004	-	7,649,669	(7,649,669)
Aparati i Drejtorise se Pergjithshme te po	1016079	-	7,537,308	(7,537,308)
Komiteti i Ndhimes Ligjore (3535)	1014103	-	5,751,500	(5,751,500)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Delvine (3704)	2104004	-	5,222,328	(5,222,328)
Aparati Ministrise Arsimi e Shkences (353	1011001	-	4,876,025	(4,876,025)
Spitali Fier (0909)	1013017	-	4,858,770	(4,858,770)
Reparti Usharak Nr.4401 Tirane (3535)	1017089	-	4,829,387	(4,829,387)
Universiteti "L.Qemali", Vlore (3737)	1011136	-	4,758,123	(4,758,123)
Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbim	1013147	-	4,605,764	(4,605,764)
Qarku Elbasan (0808)	2048001	-	4,466,088	(4,466,088)
Drejtoria e Rajonit Jugor (Gjirokastr) (1	1006067	-	4,305,036	(4,305,036)
Prokuroria e rrethit Tirane (3535)	1028002	-	4,295,800	(4,295,800)
Klinika Stomatologjike Universitare Tirane	1013053	-	4,005,833	(4,005,833)
Teatri Operas dhe Baletit (3535)	1012024	-	3,774,050	(3,774,050)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Selenice (3737)	2159002	-	3,000,000	(3,000,000)
ASHR Tirane (3535)	1013002	-	2,855,968	(2,855,968)
Sp. Pogradec (1529)	1013082	-	2,770,321	(2,770,321)
Qendra Sociale "Strehëza Tirane" (3535)	2101819	-	2,675,341	(2,675,341)
Qendra Kulturore Tirana (3535)	2101151	-	2,538,352	(2,538,352)
Komisariati i Policise Kavaje (3513)	1016038	-	2,529,178	(2,529,178)
Sp. Permet (1128)	1013081	-	2,484,119	(2,484,119)
Qarku Vlore (3737)	2037001	-	2,342,605	(2,342,605)
Agjencia e Mbikqyrjes Policore (AMP) (353	1016110	-	2,284,963	(2,284,963)
Drejtoria e Sherbimeve Qeveritare (3535)	1087002	-	2,281,502	(2,281,502)
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investi	1010276	-	2,082,868	(2,082,868)
Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujq	1005112	-	2,056,728	(2,056,728)
Universitet "E. Çabej", Gjirokastr (1111)	1011108	-	2,009,295	(2,009,295)

Agjensia Kombetare e Bregdetit (3535)	1026090	-	1,985,838	(1,985,838)
Drejtoria Vendore e Policise Tirane (3535)	1016020	-	1,956,364	(1,956,364)
Sp. Berati (0202)	1013064	-	1,952,331	(1,952,331)
Sp. Kucove (0217)	1013074	-	1,709,963	(1,709,963)
Sp. Kruje (0716)	1013073	-	1,690,225	(1,690,225)
IPQP Tirane (3535)	1016005	-	1,648,200	(1,648,200)
Paraburgimi Durres (0707)	1014054	-	1,487,197	(1,487,197)
Agjensia e Industrisë Kreative Tiranë (3535)	2101076	-	1,392,000	(1,392,000)
Agjensia e Mjedisit dhe Pyjeve (3535)	1026060	-	1,313,206	(1,313,206)
Rektorati i Universitetit te Mjekesise Tir	1011199	-	1,301,820	(1,301,820)
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (3535)	1073001	-	1,272,527	(1,272,527)
PPKKO (3535)	1041001	-	1,221,700	(1,221,700)
Galeria Kombetare e arteve (3535)	1012021	-	1,186,712	(1,186,712)
Zyra Arsimore Permet (1128)	1011109	-	1,140,190	(1,140,190)
Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) (3535)	1010278	-	1,136,336	(1,136,336)
Shk. Elektrike. "Gjergj Canco", Tirane (35	1010269	-	1,135,575	(1,135,575)
Arkivi Qendror i Filimit (3535)	1012015	-	1,118,725	(1,118,725)
Shtepia e te Moshuarve Kavaje (3513)	2118010	-	1,104,840	(1,104,840)
Qendra e zhvillimit Tirane (3535)	2101153	-	1,094,536	(1,094,536)
Aparati Keshilli i Larte i Prokurorisë (35	1035001	-	1,082,635	(1,082,635)
Klubi Sportiv Studenti, Tirane (3535)	2101821	-	1,080,906	(1,080,906)
Presidenca (3535)	1001001	-	1,024,730	(1,024,730)
Agjensia Kombëtare e Rinisë (3535)	1087039	-	994,179	(994,179)
Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsi	1011264	-	884,668	(884,668)
Dega e Kujdesit Paresor Elbasan (0808)	1013006	-	867,492	(867,492)
Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane (3535)	1010040	-	863,102	(863,102)
Qendra Komunitare Shkoze (3535)	2101165	-	861,590	(861,590)
Agjensia Telegrafike Shqiptare (3535)	1031001	-	857,493	(857,493)
Qarku Korçe (1515)	2015001	-	847,078	(847,078)
Universiteti Bujqësor - Fakulteti i Mjekesise Veter	1011165	-	765,466	(765,466)
Qendra Kombetare Kulturore e Femijeve (353	1012009	-	757,596	(757,596)
Shërbimi Kombëtar i Urgjencës (3535)	1013119	-	756,420	(756,420)
Shkolla Hoteleri Turizem, Tirane (3535)	1010266	-	704,633	(704,633)
Qendra Komunitare "Gonxhe Bojaxhi" (3535)	2101818	-	689,334	(689,334)
PIU Global Fund (3535)	1013903	-	662,832	(662,832)
Qendra e Botimeve për Diasporën Tiranë (3535)	1011275	-	661,510	(661,510)
Unversitet "L.Gurakuqi", Shkoder (3333)	1011129	-	610,000	(610,000)
Nd-ja Pastrim Gjelbrimit (1128)	2135002	-	609,000	(609,000)
Spitali Distrofik (3535)	1013054	-	592,122	(592,122)
Reparti Usharak Nr.6010 Tirane (3535)	1017079	-	582,400	(582,400)
Laboratori i barnave (3535)	1013056	-	558,485	(558,485)
Qendra e Studimeve Albanologjike Tirane (3	1011153	-	518,390	(518,390)
Drejtoria e Antiterrorit (3535)	1016129	-	512,868	(512,868)
Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	1087014	-	512,079	(512,079)
Qendra e Ofritit te Sherbimeve Publike te	1087017	-	509,681	(509,681)
Agjensia Shtetërore për Shpronësim (3535)	1006187	-	484,134	(484,134)
Drejtoria Rajonale Formimit Profesional Pu	1010217	-	462,707	(462,707)
Aparati Qendror INSTAT (3535)	1050001	-	451,955	(451,955)
Qendra e Restaurimit dhe Realizimit te Vep	2101823	-	450,139	(450,139)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Bulqize (0603)	2103007	-	400,000	(400,000)
Drejtoria e shendetit publik Peqin (0827)	1013039	-	386,506	(386,506)
Komisioneri per Mbiqyrtjen e Sherbimit Ci	1067001	-	378,240	(378,240)
Agjensia për Mediat dhe Informim (3535)	1087040	-	377,773	(377,773)
Instituti i Konfucit në Universitetin e Tiranës (3535)	1011234	-	365,165	(365,165)
Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor (3535)	1014106	-	361,437	(361,437)
Qendra Kombetare e Librit dhe Leximit(3535)	1012100	-	361,305	(361,305)
Administrata Qendrore SHSSH (3535)	1013141	-	342,250	(342,250)
Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DP	1010279	-	315,612	(315,612)
Inspektoriati Qendror (3535)	1087011	-	313,046	(313,046)
Qendra Sociale Multidisiplinare (3535)	2101163	-	296,187	(296,187)
Agjensia e Administrimit të Tregjeve (3535)	2101817	-	272,950	(272,950)
Paraburgimi Berat (0202)	1014051	-	271,984	(271,984)
Muzeu Vendor "Shtepia Studio Kadare" (3535)	2101822	-	244,810	(244,810)
Aparati i Akademise (3535)	1022001	-	244,234	(244,234)
Drejtoria e shendetit publik Kavaje (3513)	1013030	-	241,792	(241,792)
Departamenti i Administrates Publike (3535)	1087015	-	237,600	(237,600)
Gjykata e rrethit Permet (1128)	1029032	-	237,320	(237,320)
Komiteti i Minoriteteve (3535)	1087005	-	232,530	(232,530)
Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (D	1010282	-	231,967	(231,967)
Prefektura e qarkut Vlore (3737)	1016074	-	228,600	(228,600)
Departamenti i Kufirit dhe Migracionit (35	1016099	-	197,304	(197,304)
Burgu Vaqarr Tirane (3535)	1014012	-	193,834	(193,834)
Agjensia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndet	1013155	-	185,009	(185,009)
Agjensia e Menaxhimit të Qendrave për Hapj	1087019	-	183,000	(183,000)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Kelcyre (1128)	2154002	-	182,967	(182,967)
Shtëp.Moshuarve Tiranë (3535)	1013138	-	181,792	(181,792)
Agjensia per Mbeshtetjen e Veteqeverisjes	1016131	-	181,648	(181,648)
Qendra Rinore TEN (3535)	2101830	-	181,056	(181,056)
Qendra e Trajnimit te Administrates Tatimore dhe Dog	1010140	-	180,979	(180,979)
Sherbimi mjeko ligjor (3535)	1014044	-	169,064	(169,064)
Kontrolli i Larte i Shtetit (3535)	1024001	-	166,187	(166,187)
Agjensia e Mbrojtjes se Konsumatorit (3535)	2101161	-	160,659	(160,659)
Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane Vipat (1010041	-	154,055	(154,055)
Drejtoria e shendetit publik Skrapar (0232	1013044	-	153,600	(153,600)
Drejtoria Arsimore qytetit Tirane (3535)	1011035	-	153,575	(153,575)
Paraburgimi Vlore (3737)	1014057	-	150,210	(150,210)
Drejtoria e shendetit publik Delvine (3704	1013026	-	150,002	(150,002)
Uzina e Plehrave Azotike (0909)	1006168	-	144,000	(144,000)
Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te	1010097	-	133,053	(133,053)
Qendra Kombetare e Trajimit te Viktimave	1013142	-	132,490	(132,490)
Drejtoria e Perqasjes Juridike Nderkombeta	1016088	-	131,080	(131,080)
Avokati i popullit (3535)	1066001	-	120,799	(120,799)
Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike (3	1011202	-	119,400	(119,400)
Qendra e Zhvillimit Vlore (3737)	2146031	-	119,025	(119,025)

Universiteti i Tiranës, Instituti i Fizikës Bërthamore	1011204	-	118,605	(118,605)
Drejtoria e shendetit publik Has (1812)	1013029	-	113,677	(113,677)
Sp. Bulqize (0603)	1013065	-	111,975	(111,975)
Gjykata e rrethit Tiranë (3535)	1029011	-	107,050	(107,050)
Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi	1091001	-	105,600	(105,600)
Drejtoria Rajonale e Shërbimit Veterinar	1005135	-	100,356	(100,356)
Komisioni i pavarur i Kualifikimit (3535)	1063002	-	99,600	(99,600)
Qendra Ekonomike Kultures (0202)	2102006	-	99,340	(99,340)
Drejtoria Rajonale Tatimore Fier (0909)	1010049	-	99,000	(99,000)
Fakulteti i Mjekesise Dentare (3535)	1011200	-	95,377	(95,377)
Gjykata e rrethit Kruje (0716)	1029024	-	94,300	(94,300)
Shkolla Profesionale Kamez (3535)	1010270	-	91,650	(91,650)
Universiteti i Tiranës, fakulteti i Gjuhev	1011137	-	86,589	(86,589)
Agjencia shtetërore e programimit strategjik	1087041	-	79,860	(79,860)
Sekretariati i nismes per Transparencë ne	1006163	-	76,023	(76,023)
Instituti Studimeve te Transportit Tirane	1006099	-	74,400	(74,400)
Gjykata Administrative e Shkalles se Pare	1029048	-	73,140	(73,140)
Drejtoria Vendore e Policise Fier (0909)	1016027	-	69,954	(69,954)
Autoriteti i konkurrencës (3535)	1077001	-	63,130	(63,130)
Agjensia e Prokurimit Publik (3535)	1087001	-	63,100	(63,100)
Prefektura e qarkut Tirane (3535)	1016072	-	61,941	(61,941)
Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit (3535)	2101831	-	60,000	(60,000)
Drejtoria e shendetit publik Kruje (0716)	1013032	-	59,647	(59,647)
Shkoll. Prof."Pavarsia" Vlore (3737)	1010273	-	59,400	(59,400)
Universiteti i Tiranës, fakulteti i Shkencave Sociale	1011143	-	57,600	(57,600)
Komiteti Shtetëror i Kulteve	1087029	-	56,128	(56,128)
Drejtoria Rajonale Formimit Profesional Pu	1010219	-	51,272	(51,272)
Agjencia Kombetare e Diaspores (3535)	1015003	-	45,000	(45,000)
Drejtoria Rajonale e Trashegimise Kulturore Tirane	1012103	-	43,407	(43,407)
Universiteti i Tiranës, fakulteti i Ekonom	1011142	-	42,000	(42,000)
Inspektoriati i Larte i Kontrollit dhe Dek	1076001	-	41,067	(41,067)
Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve (DP)	1010281	-	40,000	(40,000)
Shtepia e te moshuarve Gjirokaster (1111)	2115019	-	38,247	(38,247)
Mbeshetjet per Shoqerine Civile (3535)	1088001	-	36,824	(36,824)
Agjencia Rajonale e Mjedisit Tirane/Durres/Diber	1026081	-	33,400	(33,400)
Gjykata e rrethit Lac (2019)	1029026	-	32,776	(32,776)
Sherbimi i Kontrollit te Brendshem (3535)	1014098	-	32,150	(32,150)
Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracioni	1016100	-	28,976	(28,976)
Gjykata e rrethit Berat (0202)	1029012	-	27,000	(27,000)
Prokuroria e rrethit Durres (0707)	1028006	-	27,000	(27,000)
Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracioni	1016107	-	26,640	(26,640)
Instituti i Femijeve qe nuk degjojne (3535)	1011052	-	23,938	(23,938)
Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Mallakaster (0924)	2131012	-	22,823	(22,823)
Sherbimi i Avokatures se Shtetit (3535)	1087033	-	20,102	(20,102)
Enti Shtetëror i Farnave dhe fidanave (353)	1005040	-	20,000	(20,000)
Drejtoria Rajonale AKPA Tirane (3535)	1010214	-	19,206	(19,206)
Shkolla e Magjistratures (3535)	1055001	-	19,200	(19,200)
Rep.Ush.Nr.6604, Qendra e Menaxhimit të M	1017131	-	18,600	(18,600)
Garda e Republike Tirane (3535)	1016004	-	18,480	(18,480)
Agjensia e Sherbimeve te Sportit (3535)	1011205	-	18,470	(18,470)
Sp. Delvine (3704)	1013066	-	17,824	(17,824)
Aparati prokurorisë se pergjitheshme (3535)	1028001	-	13,978	(13,978)
Aparati Qendror i SHIKUT (3535)	1018001	-	13,900	(13,900)
Drejtoria e shendetit publik Bulqize (0603)	1013025	-	12,649	(12,649)
Agjens. Komb. Arsim. Prof. Kualifikim (3535)	1010240	-	11,873	(11,873)
Gjykata Administrative e Shkalles se Pare	1029045	-	11,000	(11,000)
Zyra Vendore Arsimore, Selenicë (3737)	1011267	-	10,476	(10,476)
Muzeu Kombetar i Artit Mesjetar Korce (151)	1012018	-	10,000	(10,000)
Universiteti Bujqesor - Fakulteti i Ekonomise dhe Agr	1011161	-	9,950	(9,950)
Muzeu Kombetar i Fotografise Marubi (3333)	1012097	-	9,948	(9,948)
Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile	1017139	-	9,116	(9,116)
Q.SH.A.M.T. Tirane (3535)	1016007	-	8,341	(8,341)
Kolegji i Posacem i Apelimit (3535)	1063003	-	7,500	(7,500)
Drejtoria e Pergjithshme e Permbarimit (35)	1014047	-	6,373	(6,373)
Drejtoria Rajonale Formimit Profesional Pu	1010218	-	4,516	(4,516)
Agjencia e Falimentit (3535)	1014102	-	4,420	(4,420)
Shtëp. Fëm. Shkoll. Tiranë (3535)	1013135	-	4,319	(4,319)
Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor Rajona	1013107	-	3,094	(3,094)
Gjykata e rrethit Kavaje (3513)	1029021	-	3,000	(3,000)
Drejtoria Vendore e Policise Berat (0202)	1016023	-	2,550	(2,550)
Burgu Kruje (0716)	1014004	-	2,530	(2,530)
Shk. Pr "Ali Myftiu" Elbasan (0808)	1010246	-	2,508	(2,508)
Dogana Elbasan (0808)	1010088	-	2,500	(2,500)
Prokuroria e rrethit Permet (1128)	1028022	-	2,470	(2,470)
Sp. Skrapar (0232)	1013085	-	2,392	(2,392)
Dega e Instat rrethi Durres (0707)	1050008	-	2,112	(2,112)
Gjykata e rrethit Korce (1515)	1029023	-	2,100	(2,100)
Gjykata Administrative e Shkalles se Pare	1029044	-	2,000	(2,000)
Drejtoria Vendore e Policise Lezhe (2020)	1016031	-	1,975	(1,975)
Spitali i burgut Tirane (3535)	1014013	-	1,860	(1,860)
Burgu 302 Tirane (3535)	1014010	-	1,200	(1,200)
Agjencia Rajonale e Bregdetit Vlorë (3737)	1026093	-	1,165	(1,165)
Agjencia e Auditimit të Programeve të Asis	1087026	-	1,145	(1,145)
Agjencia Kombetare e Kerkimit Shkencor dhe	1011237	-	1,145	(1,145)
Sherbimi Gjeologjik Shqiptar (3535)	1006156	-	820	(820)
Dega e Instat rrethi Shkoder (3333)	1050034	-	760	(760)
Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhun	1016136	-	480	(480)
Universiteti Bujqesor - Fakulteti i Shkencave Pjore	1011164	-	480	(480)
Drejtoria Rajonale AKPA Berat (0202)	1010180	-	340	(340)
Kultura & Sporti (Sht.Pushimit Dr.) (0707)	1016086	-	180	(180)
Agjencia Kombetare e Energjive Berthamore	1006155	-	140	(140)
Shtepia e Foshnjes Vlore (3737)	2146030	-	80	(80)

Tabela: Institucionet që sipas raportit rezultojnë me pagesa por sipas SIFQ nuk kanë kryer pagesa

Institucioni	Kodi	Pakesime sipas raportit	Pagesat sipas testimeve SIFQ	Diferenca
Agjencia Kombetare e provimeve te vleresim	1011055	34,758,038	-	34,758,038
Agjencia per Zhvillimin Bujqesor dhe Rural	1005117	13,535,623	-	13,535,623
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Mat (0625)	2132006	4,747,359	-	4,747,359
Drejtoria Vendore e Policise Gjrokaster	1016028	4,594,505	-	4,594,505
Shk Profesion. "Hamdi Bushati" Shkoder (33	1010264	2,063,205	-	2,063,205
Zyra Arsimore Kamez (3535)	1011159	2,009,967	-	2,009,967
Repartit Ushtarak Nr.5001 Tirane (3535)	1017081	1,860,940	-	1,860,940
Agjencia e Zhvillimit te Territorit	1087028	1,835,000	-	1,835,000
Qendra Ekonomike Kultures (1514)	2120004	1,000,000	-	1,000,000
Zyra Arsimore Mirdite (2026)	1011123	977,290	-	977,290
Shkolla "Beqir Çela" Durres (0707)	1010244	917,868	-	917,868
Shkolla "Nazmi Rushiti" Diber (0606)	1010243	904,559	-	904,559
Shk Pr "Enver Qiraxhi" Pogradec (1519)	1010258	845,449	-	845,449
Drejtoria Arsimore Elbasan (0808)	1011008	795,883	-	795,883
Shk. Profesion. Mekanike Lushnje (0922)	1010251	627,392	-	627,392
Drejtoria Rajonale AKU Kukes (1818)	1005126	559,226	-	559,226
Shk Prof. "Arben Broci" Shkoder (3333)	1010262	478,520	-	478,520
Bashkia-Seksioni Ekonomik (3731)	2138007	477,600	-	477,600
Shk Prof. pjore "Kol Margjini" Shkoder (3	1010263	424,597	-	424,597
Drejtoria Arsimore Fier (0909)	1011009	275,870	-	275,870
Shk Pr. "Ndre Mjeda" Shkoder (3333)	1010265	164,774	-	164,774
Agjencia e Kontrollit Shteteror te Ekspert	1017126	143,727	-	143,727
Shk. Prof."Fan Noli" Korçe (1515)	1010253	55,091	-	55,091
Drejtoria e shendetit publik Gramsh (0810)	1013028	50,253	-	50,253
Zyra Arsimore Mat (0625)	1011092	44,141	-	44,141
Dogana Rinas (3535)	1010079	39,186	-	39,186
Drejtoria Rajonale Tatimore Durres (0707)	1010047	21,923	-	21,923
Drejtoria e shendetit publik Tropoje (1836	1013047	11,524	-	11,524
Prefektura e qarkut Kukes (1818)	1016068	10,003	-	10,003
Zyra Punesimit Shkoder (3333)	1010208	9,900	-	9,900
Dogana Kukes (1818)	1010093	9,623	-	9,623
Shkolla Profes "Hafzi Nela" Kukes (1818)	1010259	8,817	-	8,817
Burgu Burrel (0625)	1014006	5,000	-	5,000
Nd-ja Komunale Banesa (0625)	2132005	5,000	-	5,000
Zyra Vendore Arsimore, Klos (0625)	1011249	5,000	-	5,000
Galeria e Artit Tirana (3535)	2101829	1,800	-	1,800
Prokuroria e rrethit Lac (2019)	1028016	39	-	39

Tabela: Institucionet me shtesën më të lartë të detyrimeve

Institucioni	Kodi	Shtesa e logaritit nga KLSH
Bashkia Tirana (3535)	2101001	6,060,245,550
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	1006054	5,996,708,119
Agjencia Kombëtare e Shoqerise se Informac	1087006	1,037,722,851
Bashkia Kolonjë (1514)	2120001	440,023,473
Bashkia Pogradec (1529)	2136001	411,233,627
Bashkia Durres (0707)	2107001	408,401,904
Bashkia Dibër (0606)	2106001	384,917,073
Bashkia Kavaja (3513)	2118001	379,521,896
Bashkia Mat (0625)	2132001	368,899,704
Bashkia Mirditë (2026)	2133001	360,275,538
Bashkia Dimal (0202)	2167001	354,661,934
Bashkia Kucove (0217)	2124001	309,903,666
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Durres (0707)	2107018	288,887,352
Bashkia Belsh (0808)	2152001	277,840,617
Bashkia Dropull (1111)	2452001	261,977,835
Bashkia Berat (0202)	2102001	255,426,472
Bashkia Kurbin (2019)	2126001	250,833,042
Bashkia Patos (0909)	2112001	247,686,815
Aparati Drejt.Pergj.Tatimeve (3535)	1010039	245,525,505
Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kana	1006047	197,663,824
Aparati i Ministrise se Infrastruktures dh	1006001	196,749,824
Bashkia Devoll (1505)	2105001	193,671,540
Bashkia Shijak (0707)	2108001	185,364,298
Bashkia Pustec (1515)	2499001	184,915,464
INUK (3535)	1016130	166,244,955
Bashkia Lezhe (2020)	2127001	156,794,426
Bashkia Fier (0909)	2111001	154,977,518
Bashkia Malësi e Madhe (3323)	2130001	133,813,434
Bashkia Elbasan (0808)	2109001	125,089,850
Bashkia Sarandë (3731)	2138001	120,780,479
Bashkia Peqin (0827)	2134001	116,265,329
Departamenti per Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin	1016128	114,531,216
Bashkia Kukes (1818)	2125001	106,433,289
Bashkia Roskovec (0909)	2113001	100,961,191

Tabela: Institucionet me pakësimet më të larta të detyrimeve

Institucioni	Kodi	Pakësimet sipas raportit per 2022	Pagesat testime KLSH nga SIFQ	Diferenca
Bashkia Tirana (3535)	2101001	5,424,199,528	4,475,818,639	948,380,889
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	1006054	5,795,121,801	4,262,918,132	1,532,203,669
Aparati i Ministrise se Infrastruktures dhe Energjitikes	1006001	49,013,123	3,447,641,301	(3,398,628,178)
Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit	1087006	932,033,799	3,344,534,651	(2,412,500,852)
Fondi i Zhvillimit Shqiptar (3535)	1056001	-	2,241,022,528	(2,241,022,528)
Bashkia Kamez (3535)	2166001	50,408,956	1,128,685,618	(1,078,276,662)
Bashkia Durres (0707)	2107001	578,978,104	544,643,677	34,334,427
Bashkia Kruje (0716)	2123001	51,524,888	539,962,014	(488,437,126)
Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kana	1006047	485,036,378	525,845,226	(40,808,848)
Qendra spitalore universitare "Nene Tereza	1013049	-	512,252,630	(512,252,630)
Bashkia Kavaja (3513)	2118001	362,052,387	445,326,433	(83,274,046)
Bashkia Lezhe (2020)	2127001	340,591,205	439,233,609	(98,642,404)
Aparati Drejt.Pergj.Tatimeve (3535)	1010039	762,688,952	387,382,942	375,306,010

Bashkia Kolonjë (1514)	2120001	445,001,797	367,541,195	77,460,602
Bashkia Mirditë (2026)	2133001	353,106,135	359,967,714	(6,861,579)
Bashkia Mat (0625)	2132001	368,929,302	351,888,749	17,040,553
Bashkia Pogradec (1529)	2136001	380,486,204	348,095,347	32,390,857
Aparati Ministrise se Financave (3535)	1010001	51,020,570	330,668,887	(279,648,317)
Bashkia Vlore (3737)	2146001	73,375,558	317,753,190	(244,377,632)
Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Durres (0707)	2107018	288,887,352	276,618,190	12,269,162
Bashkia Finiq (3704)	2326001	42,600,396	249,180,446	(206,580,050)
Bashkia Vore (3535)	2165001	106,300,397	246,071,839	(139,771,442)
Aparati Drejt.Pergj.Doganave (3535)	1010077	466,873,977	228,280,599	238,593,378
Bashkia Kucove (0217)	2124001	254,741,043	221,440,613	33,300,430
Bashkia Roskovec (0909)	2113001	213,644,907	214,830,270	(1,185,363)
Bashkia Dimal (0202)	2167001	222,020,180	212,436,263	9,583,917
Bashkia Dibër (0606)	2106001	260,312,929	211,794,572	48,518,357
Bashkia Berat (0202)	2102001	205,744,123	211,574,400	(5,830,277)
Bashkia Fier (0909)	2111001	220,657,704	193,874,114	26,783,590
Agjencia e Eficences se Energjise (AEE) (3)	1006164	-	181,307,694	(181,307,694)
Bashkia Malësi e Madhe (3323)	2130001	174,270,429	179,604,595	(5,334,166)
Bashkia Maliq (1515)	2168001	193,413,810	179,353,599	14,060,211
Bashkia Rogozhine (3513)	2119001	15,506,310	175,708,445	(160,202,135)
Bashkia Shijak (0707)	2108001	159,280,079	160,595,765	(1,315,686)
Bashkia Belsh (0808)	2152001	191,933,601	156,933,859	34,999,742
Bashkia Sarande (3731)	2138001	143,417,948	143,323,566	94,382
Bashkia Kurbin (2019)	2126001	204,919,390	136,940,091	67,979,299
Bashkia Elbasan (0808)	2109001	160,197,329	136,805,111	23,392,218
Bashkia Divjake (0922)	2147001	129,771,192	131,374,142	(1,602,950)
Bashkia Devoll (1505)	2105001	129,721,733	129,485,817	235,916
Ndermarrja e Pasturive PNdermarrja e Pasuri	2129010	124,114,495	127,552,562	(3,438,068)
Nd-ja Mirembajtja Rruge (0808)	2109014	122,615,240	122,608,122	7,118
Bashkia Cerrik (0808)	2110001	111,445,742	122,499,442	(11,053,700)
Bashkia Patos (0909)	2112001	122,298,084	116,256,883	6,041,201
Aparati Ministrise se Bujqesise dhe Zhvill	1005001	25,812,793	116,073,704	(90,260,911)
QFM Teknike Tirane (3535)	1016056	-	115,519,855	(115,519,855)
Bashkia Polican (0232)	2140001	103,031,763	110,591,604	(7,559,841)

Tabela: Interesi i paguar për vonesë në ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së Në lekë

Nr.	Vendimi GJEDNJ	Vlera në Euro	Vlera në lekë	Interes	Totali i paguar lekë	Burim Financimi	USH	Data
1	X... dhe të tjerë kundër RSH-VKM	22,500	2,605,500	41,115	2,646,615	FR 2022	1417- 1420,1477	30.12.2022
2	S.... kundër RSH-VKM	17,500	2,063,250	249,286	2,312,536	FR 2022	1475	26.01.2023
3	F.Z. kundër RSH-VKM	15,000	1,777,500	21,208	1,798,708	FR 2022	779	20.07.2022
4	B. kundër RSH-VKM	13,500	1,603,800	7,909	1,611,709	FR 2022	1110	20.10.2022
5	P. kundër RSH	13,450	1,585,755	222,679	1,808,434	FR 2022	1485	26.01.2023
6	B. kundër RSH-VKM	10,700	1,313,960	37,790	1,351,750	FR 2022	121	28.02.2022
7	L....kundër RSH-VKM	10,500	1,269,450	7,912	1,277,362	FR 2022	698	16.06.2022
8	D. M.. kundër RSH	5,000	622,000		622,000	MFE	68	03.02.2022
9	A. K. kundër RSH	5,000	613,500		613,500	MFE	663	16.06.2022
10	S. kundër RSH	5,000	600,000		600,000	MFE	912	26.08.2022
11	L. kundër RSH	3,850	464,695	745	465,440	MFE	1458	30.12.2022
12	K. kundër RSH	3,500	429,450	803	430,253	MFE	664	16.06.2022
13	M. kundër RSH	2,750	341,000		341,000	MFE	397	15.04.2022
14	R. P. kundër RSH	2,500	299,750		299,750	MFE	896	24.08.2022
15	P. B. kundër RSH	2,400	294,480		294,480	MFE	542	24.05.2022
16	P. P. kundër RSH	2,350	288,345		288,345	MFE	543	26.05.2022
17	M. N.. kundër RSH	2,300	286,580		286,580	MFE	38	21.01.2022
18	E. Z.kundër RSH	2,300	286,580	6,900	293,480	MFE	39	21.01.2022
19	H. kundër RSH	2,050	246,000		246,000	MFE	1200	07.11.2022
20	Ë.B. kundër RSH	1,200	143,880		143,880	MFE	895	24.08.2022
Total		143,350	17,135,475	596,347	17,731,822			

Tabela: Pagesat për kostot paraprake, shërbimet juridike dhe kostot e tjera ligjore në sistemin ORACLE

Nr	Përshkrimi i vendimit (Nr. i çështjes/Data/ Emërtimi)	Ofruesi i shërbimit (studio ligjore)	Pagesat	Nr. Ush.	Data e pagesës	Vlera lekë
1	Pagesë për shërbimet e ekspertëve të C. G. për përfaqësim dhe mbrojtje në Gjykatat e Anglisë dhe Uellsit për vendimin e arbitrazhit ICSID No. ARB/15/28 dt 24.04.2019	C. S. P. A. L.	50,000 £	120	23.02.22	7,325,000
2	Shpenzime procedurale gjyqësore për rishikimin e vendimit të arbitrazhit ICSID Case No. ARB/15/28	I.C. f.S.I.	10,000 \$	427	20.04.22	1,123,000
3	Tarifë e studios ligjore C... D...L....., për përfaqësim dhe mbrojtje të inter. të Shqipërisë në kundërshtim të vendimit të arbitrazhit dt.24.04.19 "Sekues.e llog. të Albcontrol sh.a. në Mbretërinë e Belgjikës"	C.D. S..	26,895 €	516	19.05.22	3,267,743
4	Pagesë e avokatit për kundërshtimin e njohjes dhe ekzekutimin e vendim arbitrazh dt. 24.04.2019 në Itali	S. L. C.	60,000 €	517	19.05.22	7,290,000
5	Pagesë e avokatit për kundërshtimin e njohjes dhe ekzekutimin e vendim arbitrazh dt. 24.04.2019 në Itali	S. L. C.	30,000 €	615	07.06.22	3,639,000
6	Pagesë e shpenzimeve paraprake gjyqësore për çështjen e arbitrazhit SCC Case No.V2021/155: IVICOM H..... kundër Shqipërisë.	A.I. O. S.	272,550 €	821	03.08.22	32,160,900
7	Shpenzime për likuidimin e studios ligjore N.D. B./S... për kundërshtimin e ekzekut. Vendimit të arbitrazhit ICSID Case No. ARB/15/28	N.D. B.	128,000 €	903	26.08.22	15,104,000
8	Shpenzime për likuidimin e studios ligjore O. S. L.për shërbimin e konsulencës sipas kontr. dt.15.06.2022.	O. S. L.	150,000 €	952	13.09.22	17,820,000
9	Shpenzime për likuidimin e studios ligjore O.S L për shërb. e përfaqës. dhe mbrojtje sipas kontr. dt.22.07.2022.	O. S. L.	150,000 €	975	16.09.22	17,685,000
10	Shpenzime për likuidimin e ekspertit "C.&G.." për rishikimin e vendimit të arbitrazhit dt.22.04.2019 ref ICSID Case No.ARB/15/28.	C.&G	250,000 €	976	16.09.22	33,625,000
11	Pagesë për kundërshtimin e procedurës për ekzekutim vendimi Arbitrazh. çështja ICSID Case no:ARB 15/28 (kësti II)	O. S. L.	10,000 \$	984	21.09.22	13,500,000
12	Kosto administrative për fazën fillestare për rishikimin e vendimit të arbitrazhit ICSID Case No. ARB/15/28 (200.000\$)	I. B.F.R.D.	200,000 \$	1,235	15.11.22	22,780,000
13	Shpenzime për likuidimin e ekspertit "C.&G.", rishikimin e vendimit të arbitrazhit dt.22.04.2019 ref ICSID Case No.ARB/15/28. Kësti i dytë	C.&G.	250,000 €	1,337	15.12.22	33,675,000
14	Shpenzime për likuidimin e studios ligjore O. S. L. për shërbimin e konsulencës sipas kontratës dt.15.06.2022	O.S.L.	150,000 €	1,413	17.01.23	17,640,000

15	Shpenzime per likuidimin e studios ligjore O.S.L për shërbimin e konsulencës sipas kontr dt.15.06.2022	O. S. L.	200,000 €	1,414	17.01.23	23,140,000
16	Shpenzime për likuidimin e studios ligjore N. D...B.../S....për kundërshtimin e ekzekut. Vendimit të arbitrazhit ICSID Case No. ARB/15/28	N. D.B./S.	150,000 €	1,415	17.01.23	17,640,000
17	Shpenzime per likuidimin e studios ligjore C. C.në kuadër të shërbimit të përfaqësimit dhe mbrojtjes në zbatim të kontratës së shërbimit datë 10.06.2022, për çështjen e arbitrazhit SCC Case no. V2021/155	C. C. P. M.	200,000 €	1,416	17.01.23	23,520,000
18	Diferencë nga kursi i këmbimit (shpenzime per likuidimin e studios ligjore O... S.... L....për shërb e përfaqës dhe mbrojtjes sipas kontr dt.22.07.2022	O. S. L.		1,476		380,000
Total						291,314,642

Tabela: Rishikime pas datës 15 Nëntor

ID rishikimi	ID rishikimi	ID rishikimi	ID rishikimi	ID rishikimi	ID rishikimi	ID rishikimi	ID rishikimi	ID rishikimi	ID rishikimi	ID rishikimi	ID rishikimi	ID rishikimi	ID rishikimi
6723400	6724403	6725403	6727406	6729408	6730416	6731411	6732416	6734410	6745466	6747463	6748450	6753433	
6723401	6724404	6725404	6727407	6729409	6730417	6731412	6732417	6734412	6745467	6747464	6748451	6753434	
6723402	6724405	6725405	6727408	6729410	6730418	6731413	6732418	6734413	6745468	6747465	6748452	6753435	
6723403	6724406	6725406	6727409	6729411	6730419	6731414	6732419	6734414	6745469	6747466	6748453	6753436	
6723404	6724407	6725407	6727410	6730400	6730420	6731415	6732420	6734415	6745470	6747467	6748455	6753437	
6723405	6724408	6725408	6728400	6730402	6730422	6731416	6733401	6734416	6746432	6747468	6748456	6754435	
6723406	6724409	6725409	6728401	6730403	6730423	6732400	6733402	6734417	6746433	6747469	6748458	6754436	
6723407	6724410	6725410	6728402	6730404	6730424	6732401	6733403	6735400	6746434	6747470	6748459	6754437	
6723408	6724411	6725411	6728403	6730405	6731400	6732402	6733404	6735401	6746435	6747471	6748460	6755433	
6723409	6724414	6726400	6728404	6730406	6731401	6732403	6734400	6735402	6746436	6747472	6748461	6755437	
6723410	6724415	6726402	6728405	6730407	6731402	6732406	6734401	6735403	6746437	6747473	6748462	6756432	
6723412	6724416	6726403	6728406	6730408	6731403	6732407	6734402	6735404	6746438	6747474	6748463	6756436	
6723413	6724417	6726404	6728407	6730409	6731404	6732408	6734403	6735405	6746439	6747475	6748465	6757438	
6723414	6724418	6727400	6729400	6730410	6731405	6732409	6734404	6735406	6746440	6747476	6748466	6757439	
6723415	6724419	6727401	6729401	6730411	6731406	6732410	6734405	6735408	6746442	6747477	6748468	6758432	
6723416	6724420	6727402	6729402	6730412	6731407	6732412	6734406	6735409	6746443	6747478	6748469	6758438	
6724400	6725400	6727403	6729403	6730413	6731408	6732413	6734407	6735411	6746444	6747479	6748470	6759433	
6724401	6725401	6727404	6729406	6730414	6731409	6732414	6734408	6735412	6746445	6747480	6748471	6759434	
6724402	6725402	6727405	6729407	6730415	6731410	6732415	6734409	6735413	6746446	6747481	6748472	6760433	
6735414	6737418	6738437	6738478	6738520	6739407	6740411	6741439	6743432	6746447	6747482	6748473	6761434	
6735415	6737419	6738438	6738479	6738521	6739408	6740412	6741440	6743433	6746448	6747483	6748474	6762432	
6735416	6737420	6738439	6738480	6738522	6739409	6740413	6741441	6743434	6746449	6747484	6748475	6762433	
6735417	6738400	6738440	6738481	6738523	6739410	6741400	6741442	6743435	6746450	6747485	6748476	6762434	
6735418	6738401	6738441	6738482	6738524	6739411	6741401	6741443	6743436	6746451	6747486	6748478	6762435	
6735419	6738402	6738442	6738483	6738525	6739415	6741402	6741444	6743437	6746452	6747487	6748479	6763434	
6735420	6738403	6738443	6738484	6738526	6739416	6741403	6741445	6744432	6746453	6747488	6748480	6763435	
6735421	6738404	6738444	6738485	6738527	6739417	6741404	6741446	6744433	6746454	6747489	6748481	6771432	
6736400	6738405	6738445	6738486	6738528	6739418	6741405	6741447	6744434	6746455	6747490	6749432	6774442	
6736401	6738406	6738446	6738487	6738529	6739419	6741407	6741448	6744435	6746456	6747491	6749435	6775439	
6736402	6738407	6738447	6738488	6738530	6739420	6741408	6741449	6744436	6746457	6747492	6749436	6780437	
6736403	6738408	6738448	6738489	6738531	6739421	6741409	6742432	6744437	6746459	6747493	6749438	6782434	
6736404	6738409	6738449	6738490	6738532	6739422	6741410	6742434	6745432	6746461	6747494	6749439	6782435	
6736405	6738410	6738450	6738491	6738533	6739423	6741411	6742435	6745433	6746462	6747495	6749440	6782436	
6736406	6738411	6738451	6738492	6738534	6739424	6741412	6742436	6745434	6746463	6747496	6749441	6782437	
6736407	6738412	6738452	6738493	6738535	6739425	6741413	6742437	6745435	6746464	6747497	6749443	6784432	
6736408	6738413	6738453	6738494	6738536	6739426	6741414	6742438	6745436	6746465	6747498	6749444	6785432	
6736409	6738414	6738454	6738495	6738538	6739427	6741415	6742439	6745437	6746466	6747499	6749445	6788445	
6736410	6738415	6738455	6738496	6738539	6739428	6741416	6742440	6745438	6746467	6747500	6749446	6793442	
6736411	6738416	6738456	6738497	6738540	6739429	6741417	6742441	6745439	6746468	6747501	6749447	6797437	
6736412	6738417	6738457	6738498	6738541	6739430	6741418	6742442	6745440	6746469	6747502	6749448	6745465	
6736413	6738418	6738458	6738500	6738542	6739431	6741419	6742443	6745441	6746470	6747503	6749455	6747462	
6736414	6738419	6738459	6738501	6738543	6739432	6741420	6742444	6745442	6746471	6747504	6749456	6748449	
6736415	6738420	6738460	6738502	6738544	6739433	6741421	6742445	6745443	6746472	6747505	6749457	6752436	
6737400	6738421	6738461	6738503	6738545	6739434	6741422	6742446	6745444	6746473	6747506	6750432		
6737401	6738422	6738462	6738504	6738546	6739435	6741423	6742447	6745445	6746474	6747507	6750433		
6737402	6738423	6738463	6738505	6738547	6739436	6741424	6742448	6745446	6746475	6747508	6750434		
6737403	6738424	6738464	6738506	6738548	6739437	6741425	6742449	6745447	6746476	6747509	6750435		
6737404	6738425	6738465	6738507	6738549	6739438	6741426	6742450	6745448	6746477	6747510	6750436		
6737405	6738426	6738466	6738508	6738550	6739439	6741427	6742451	6745449	6746478	6747511	6750437		
6737406	6738427	6738467	6738509	6738551	6740400	6741428	6742452	6745451	6746479	6747512	6750438		
6737407	6738428	6738468	6738510	6738552	6740401	6741429	6742453	6745452	6746480	6747513	6750439		
6737408	6738429	6738469	6738511	6738553	6740402	6741430	6742454	6745453	6746481	6747514	6750440		
6737409	6738430	6738470	6738512	6738554	6740403	6741431	6742455	6745454	6746482	6747515	6750441		
6737410	6738431	6738471	6738513	6738555	6740404	6741432	6742456	6745455	6746483	6747516	6750442		
6737411	6738432	6738472	6738514	6738556	6740405	6741433	6742457	6745456	6746484	6747517	6750443		
6737412	6738433	6738473	6738515	6738557	6740406	6741434	6742458	6745457	6746485	6747518	6750444		
6737413	6738434	6738474	6738516	6738558	6740407	6741435	6742459	6745458	6746486	6747519	6750445		
6737414	6738435	6738475	6738517	6738559	6740408	6741436	6742460	6745459	6746487	6747520	6750446		
6737415	6738436	6738476	6738518	6738560	6740409	6741437	6742461	6745460	6746488	6747521	6750447		
6737416	6738437	6738477	6738519	6738561	6740410	6741438	6742462	6745461	6746489	6747522	6750448		

Burimi: Të dhënat nga MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Tabela: Investime paguar deri në 10 ditë nga kontrata

Kodi projektit	Data e urdher shpenzimit	Shuma	data e krijimit	diferenca kontrate urdher shpenzim
22AA201	2022-09-26	205.039.426	2022-09-23	-3
1011995	2022-12-23	110.207.871	2022-12-27	4
20AD413	2022-12-30	95.943.904	2022-12-28	-2
1012370	2022-08-26	90.000.000	2022-08-26	0
1012369	2022-08-26	87.305.749	2022-08-26	0
18BN014	2022-12-21	80.000.000	2022-12-28	7
18BP019	2022-12-13	76.614.840	2022-12-17	4
22AC001	2022-09-28	68.029.859	2022-09-28	0
M062778	2022-07-07	63.238.121	2022-07-07	0
22AB901	2022-12-15	57.277.000	2022-12-19	4
22AA001	2022-12-02	55.022.536	2022-12-05	3
22AD001	2022-11-17	53.055.295	2022-11-17	0
18BS712	2022-04-08	50.000.400	2022-03-31	-8
22AA801	2022-12-02	44.659.871	2022-12-05	3

22AC101	2022-12-02	38.848.859	2022-12-05	3
1011991	2022-03-24	38.200.472	2022-03-18	-6
20AD408	2022-06-16	34.795.545	2022-06-06	-10
18AZ505	2022-12-30	28.440.000	2022-12-29	-1
22AA501	2022-10-14	27.493.990	2022-10-17	3
20AD407	2022-06-16	25.233.894	2022-06-06	-10
18BN138	2022-12-12	22.611.583	2022-12-13	1
1660888	2022-10-24	22.355.765	2022-10-25	1
1360419	2022-06-29	20.812.991	2022-06-22	-7
22AA203	2022-10-13	20.215.688	2022-10-14	1
18AY405	2022-10-06	20.010.000	2022-10-06	0
18BA217	2022-11-18	19.888.706	2022-11-15	-3
18BN005	2022-12-14	19.000.000	2022-12-14	0
18CF501	2022-07-26	19.000.000	2022-07-21	-5
18BP016	2022-11-21	18.759.032	2022-11-22	1
18BC899	2022-12-30	18.282.097	2022-12-20	-10
18BC895	2022-12-29	17.600.318	2022-12-28	-1
1030148	2022-12-23	15.600.751	2022-12-19	-4
1360412	2022-10-17	14.640.000	2022-10-14	-3
3260105	2022-11-09	14.600.550	2022-11-11	2
M064184	2022-04-11	13.448.581	2022-04-11	0
1661036	2022-08-03	12.873.600	2022-08-08	5
1600188	2022-05-19	12.507.598	2022-05-19	0
1380201	2022-12-19	12.347.112	2022-12-21	2
22AB801	2022-06-09	11.870.188	2022-06-09	0
18BD917	2022-03-25	11.640.000	2022-03-25	0
18BP004	2022-05-12	11.625.448	2022-05-13	1
20AB607	2022-03-24	11.131.848	2022-03-18	-6
1160090	2022-12-27	11.028.000	2022-12-23	-4
22AD701	2022-12-20	10.852.687	2022-12-23	3
18BS717	2022-09-08	10.450.000	2022-09-06	-2
1140210	2022-02-23	10.402.500	2022-02-21	-2
1012371	2022-08-16	10.172.767	2022-08-15	-1
19AF823	2022-08-10	10.000.000	2022-08-02	-8
1430140	2022-12-02	9.839.000	2022-12-02	0
1410503	2022-02-08	9.760.899	2022-02-07	-1
18AZ313	2022-12-22	9.572.880	2022-12-20	-2
M870323	2022-09-01	9.240.720	2022-08-25	-7
1230838	2022-05-20	9.024.000	2022-05-11	-9
M240002	2022-11-04	8.580.000	2022-10-27	-8
1410740	2022-02-21	8.067.377	2022-02-11	-10
1661038	2022-08-29	7.920.000	2022-08-26	-3
1071418	2022-08-26	7.668.000	2022-08-26	0
1450193	2022-04-28	7.632.000	2022-04-28	0
1012006	2022-06-24	7.052.327	2022-06-21	-3
19AF829	2022-10-07	6.991.247	2022-10-03	-4
18CK801	2022-03-10	6.956.400	2022-03-01	-9
1450187	2022-08-12	6.493.552	2022-08-12	0
20AB705	2022-09-27	6.027.155	2022-09-22	-5
19AC409	2022-12-23	5.982.000	2022-12-28	5
19AC411	2022-12-23	5.982.000	2022-12-28	5
1520182	2022-12-16	5.963.980	2022-12-13	-3
22AC301	2022-10-27	5.749.702	2022-10-24	-3
1120133	2022-09-13	5.496.000	2022-09-06	-7
1560072	2022-07-06	5.478.840	2022-07-05	-1
1410846	2022-02-11	5.357.051	2022-02-09	-2
1100143	2022-04-13	5.285.476	2022-04-08	-5
1050038	2022-11-09	5.208.000	2022-11-01	-8
1680281	2022-05-05	5.069.611	2022-05-11	6
1071443	2022-08-24	4.813.440	2022-08-18	-6
1180067	2022-03-16	4.788.000	2022-03-16	0
4990098	2022-09-14	4.434.600	2022-09-08	-6
18BP014	2022-03-17	4.407.764	2022-03-18	1
1100224	2022-02-21	4.388.090	2022-02-18	-3
1100226	2022-06-09	4.357.476	2022-06-08	-1
1060276	2022-11-15	4.332.000	2022-11-16	1
1420120	2022-07-27	4.252.500	2022-07-26	-1
1130365	2022-11-18	4.134.575	2022-11-18	0
1460192	2022-12-05	3.825.200	2022-12-06	1
1370352	2022-12-30	3.800.000	2022-12-21	-9
M170490	2022-12-21	3.768.120	2022-12-12	-9
1520047	2022-12-29	3.762.193	2022-12-29	0
1410713	2022-02-21	3.741.799	2022-02-11	-10
4990099	2022-12-06	3.739.200	2022-12-02	-4
1130188	2022-02-17	3.707.912	2022-02-17	0
19AD202	2022-10-13	3.703.493	2022-10-14	1
18BB154	2022-11-02	3.525.833	2022-11-03	1
1100241	2022-03-17	3.489.210	2022-03-15	-2
18AX503	2022-06-14	3.403.020	2022-06-09	-5
1012270	2022-12-27	3.356.400	2022-12-19	-8
1150205	2022-12-29	3.354.600	2022-12-27	-2
1410004	2022-02-09	3.269.520	2022-02-07	-2
18BP018	2022-07-18	3.216.567	2022-07-19	1
22AA202	2022-10-13	3.210.000	2022-10-14	1
1180229	2022-06-23	3.154.920	2022-06-23	0
18AG003	2022-07-08	3.108.000	2022-06-30	-8
1460226	2022-11-15	3.052.920	2022-11-17	2
1410753	2022-02-09	2.956.121	2022-02-07	-2
1410754	2022-02-09	2.956.121	2022-02-07	-2
1410755	2022-02-09	2.956.121	2022-02-07	-2
1410773	2022-02-09	2.956.121	2022-02-07	-2
1410774	2022-02-09	2.956.121	2022-02-07	-2
1410832	2022-02-09	2.956.121	2022-02-07	-2
1410833	2022-02-09	2.956.121	2022-02-07	-2

1410839	2022-02-09	2,956.121	2022-02-07	-2
1410841	2022-02-09	2,956.121	2022-02-07	-2
1450200	2022-11-09	2,850.000	2022-11-09	0
3260107	2022-12-13	2,774.100	2022-12-19	6
1410855	2022-02-09	2,768.433	2022-02-07	-2
1090604	2022-12-19	2,664.000	2022-12-19	0
0470029	2022-02-17	2,621.021	2022-02-14	-3
1030149	2022-12-19	2,593.200	2022-12-14	-5
1460193	2022-11-10	2,581.607	2022-11-16	6
1150179	2022-10-24	2,520.000	2022-10-18	-6
18BA612	2022-12-28	2,491.042	2022-12-20	-8
18AK351	2022-10-25	2,490.000	2022-10-21	-4
M063124	2022-12-28	2,428.109	2022-12-27	-1
4520133	2022-05-18	2,400.000	2022-05-12	-6
1650163	2022-08-29	2,378.735	2022-08-29	0
1560074	2022-12-27	2,375.000	2022-12-29	2
1200132	2022-08-02	2,344.440	2022-07-28	-5
1460223	2022-09-23	2,154.600	2022-09-26	3
1430141	2022-12-02	2,122.540	2022-12-02	0
1130288	2022-02-21	2,071.745	2022-02-21	0
1200169	2022-12-21	2,032.162	2022-12-13	-8
1410724	2022-02-15	2,013.307	2022-02-07	-8
1130255	2022-02-21	2,000.000	2022-02-21	0
1190069	2022-04-27	2,000.000	2022-04-21	-6
1400092	2022-06-10	2,000.000	2022-06-10	0
1071441	2022-07-15	1,973.868	2022-07-15	0
1330066	2022-06-08	1,938.072	2022-06-01	-7
1090689	2022-12-21	1,919.590	2022-12-14	-7
1430138	2022-12-22	1,861.194	2022-12-21	-1
18BC409	2022-12-12	1,852.889	2022-12-05	-7
1071445	2022-12-23	1,830.930	2022-12-15	-8
1140249	2022-12-15	1,800.000	2022-12-06	-9
1060049	2022-03-11	1,771.279	2022-03-11	0
18BN135	2022-03-17	1,755.000	2022-03-18	1
18CI408	2022-12-29	1,633.800	2022-12-28	-1
1450198	2022-08-12	1,565.000	2022-08-12	0
18AZ817	2022-11-16	1,378.080	2022-11-21	5
1012057	2022-04-12	1,374.000	2022-04-12	0
1130292	2022-11-17	1,368.903	2022-11-18	1
M260404	2022-05-24	1,317.750	2022-05-24	0
18AD801	2022-04-21	1,239.936	2022-04-21	0
1200162	2022-05-11	1,200.000	2022-05-05	-6
1012254	2022-12-19	1,175.880	2022-12-23	4
1520183	2022-10-06	1,150.200	2022-09-30	-6
18AT905	2022-06-14	1,139.330	2022-06-08	-6
1430139	2022-11-16	1,069.215	2022-11-17	1
M870009	2022-12-29	1,066.666	2022-12-29	0
18AT826	2022-12-29	1,000.000	2022-12-29	0
18BQ648	2022-06-27	976.274	2022-06-28	1
1250123	2022-12-28	948.000	2022-12-23	-5
1010950	2022-04-01	912.000	2022-03-31	-1
1100126	2022-10-19	894.000	2022-10-18	-1
20AA104	2022-12-29	878.200	2022-12-22	-7
M500011	2022-07-12	742.256	2022-07-13	1
1410658	2022-02-21	660.938	2022-02-11	-10
19AA001	2022-05-19	650.000	2022-05-18	-1
18AE106	2022-12-29	646.800	2022-12-21	-8
1012204	2022-04-12	597.960	2022-04-13	1
21AC401	2022-03-25	587.520	2022-03-18	-7
0470032	2022-08-10	571.200	2022-08-04	-6
20AB612	2022-10-25	555.600	2022-10-20	-5
1100133	2022-10-17	500.000	2022-10-14	-3
91105AA	2022-02-24	500.000	2022-03-04	8
4520142	2022-11-24	480.000	2022-11-24	0
1670006	2022-04-04	450.300	2022-04-01	-3
1570775	2022-10-06	410.000	2022-09-28	-8
18BQ395	2022-08-10	400.000	2022-08-02	-8
18BQ464	2022-07-26	350.000	2022-07-26	0
1180230	2022-08-26	327.400	2022-08-29	3
1470101	2022-12-30	300.000	2022-12-30	0
1071442	2022-08-17	296.577	2022-08-12	-5
1590163	2022-09-30	261.431	2022-09-29	-1
19AE322	2022-12-12	250.216	2022-12-13	1
M100424	2022-12-29	248.040	2022-12-21	-8
1240152	2022-08-30	204.866	2022-08-30	0
19AF824	2022-12-30	200.000	2022-12-29	-1
19AF826	2022-08-10	200.000	2022-08-02	-8
19AF830	2022-10-12	189.782	2022-10-03	-9
1011608	2022-11-15	178.631	2022-11-11	-4
M180120	2022-01-17	137.580	2022-01-25	8
1140214	2022-05-18	136.317	2022-05-12	-6
19AH805	2022-02-22	120.000	2022-02-21	-1
A000002	2022-05-20	116.400	2022-05-13	-7
M050694	2022-06-06	114.000	2022-06-15	9
1140251	2022-05-18	113.598	2022-05-12	-6
A000003	2022-03-10	104.126	2022-03-04	-6
18CG004	2022-08-02	100.000	2022-08-01	-1
19AE320	2022-07-06	100.000	2022-07-07	1
18BQ526	2022-08-09	76.659	2022-08-05	-4
M100013	2022-06-10	74.400	2022-06-13	3
19AH806	2022-01-21	65.000	2022-01-21	0
19AG724	2022-07-26	50.000	2022-07-27	1
1280423	2022-12-29	39.600	2022-12-29	0
1280407	2022-12-16	7.051	2022-12-15	-1

Burimi: Të dhënat nga MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Tabela: Diferenca Urdhër Shpenzim me datën e kontratës në SIFQ

KODI_PROJEKTIIT	DATA_URDHER_SHPENZIMIT	Sum of SHUMA	data e kontrates	diferenca kontrate-shpenzim
0470029	2022-02-17	2.621.021	2022-02-09	-8
0470032	2022-08-10	571.200	2022-08-04	-6
1011982	2022-03-07	66.125.616	2022-02-25	-10
1012411	2022-12-30	13.296.000	2022-12-27	-3
1012425	2022-12-30	2.397.000	2022-12-20	-10
1020186	2022-06-22	20.690	2022-06-30	8
1030148	2022-12-23	15.600.751	2022-12-15	-8
1030149	2022-12-19	2.593.200	2022-12-12	-7
1120133	2022-09-13	5.496.000	2022-09-06	-7
1130188	2022-02-17	3.707.912	2022-02-17	0
1130255	2022-02-21	2.000.000	2022-02-21	0
1130288	2022-02-21	2.071.745	2022-02-21	0
1130292	2022-11-17	1.368.903	2022-11-18	1
1130365	2022-11-18	4.134.575	2022-11-18	0
1150179	2022-10-24	2.520.000	2022-10-17	-7
1150205	2022-12-29	3.354.600	2022-12-27	-2
1200132	2022-08-02	2.344.440	2022-07-27	-6
1200162	2022-05-11	1.200.000	2022-05-05	-6
1200169	2022-12-21	2.032.162	2022-12-13	-8
1230838	2022-05-20	9.024.000	2022-05-10	-10
1330066	2022-06-08	1.938.072	2022-05-30	-9
1470101	2022-12-30	300.000	2022-12-28	-2
1570775	2022-10-06	410.000	2022-09-28	-8
1600188	2022-05-19	12.507.598	2022-05-10	-9
1680281	2022-05-05	5.069.611	2022-05-06	1
18AD801	2022-04-21	1.239.936	2022-04-15	-6
18AG003	2022-07-08	3.108.000	2022-06-29	-9
18AK351	2022-10-25	2.490.000	2022-10-19	-6
18AK601	2022-08-15	4.077.960	2022-08-22	7
18AO601	2022-06-24	347.400	2022-07-04	10
18AP102	2022-12-19	264.661	2022-12-12	-7
18AT905	2022-06-14	1.139.330	2022-06-06	-8
18AX503	2022-06-14	3.403.020	2022-06-06	-8
18AY405	2022-10-06	20.010.000	2022-10-04	-2
18AZ313	2022-12-22	9.572.880	2022-12-20	-2
18AZ505	2022-12-30	28.440.000	2022-12-29	-1
18BB058	2022-07-13	2.000.000	2022-07-22	9
18BC409	2022-12-12	1.852.889	2022-12-05	-7
18BN014	2022-12-21	80.000.000	2022-12-15	-6
18BN133	2022-03-17	6.495.561	2022-03-10	-7
18CF501	2022-07-26	19.000.000	2022-07-20	-6
18CI408	2022-12-29	1.633.800	2022-12-28	-1
19AA001	2022-05-19	650.000	2022-05-16	-3
19AC409	2022-12-23	5.982.000	2022-12-28	5
19AC411	2022-12-23	5.982.000	2022-12-28	5
19AH805	2022-02-22	120.000	2022-02-21	-1
19AH806	2022-01-21	65.000	2022-01-21	0
20AA104	2022-12-29	878.200	2022-12-20	-9
20AB612	2022-10-25	555.600	2022-10-19	-6
20AD424	2022-12-30	23.726.916	2022-12-29	-1
21AC401	2022-03-25	587.520	2022-03-18	-7
22AB701	2022-11-03	1.148.023	2022-11-08	5
22AB901	2022-12-15	57.277.000	2022-12-13	-2
4520133	2022-05-18	2.400.000	2022-05-09	-9
4990098	2022-09-14	4.434.600	2022-09-08	-6
4990099	2022-12-06	3.739.200	2022-11-30	-6
91105AA	2022-02-24	500.000	2022-02-24	0
G042001	2022-12-29	658.480	2022-12-31	2
M050694	2022-06-06	114.000	2022-06-13	7
M064184	2022-04-11	13.448.581	2022-04-01	-10
M100013	2022-06-10	74.400	2022-06-03	-7
M180120	2022-01-17	137.580	2022-01-24	7
M870009	2022-12-29	1.066.666	2022-12-28	-1

Burimi: Të dhënat nga MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Tabela: Diferenca mes urdhër-shpenzimit dhe datës së kontratës

KODI_PROJEKTIIT	DATA_URDHER_SHPENZIMIT	Sum of SHUMA	data e kontrates	diferenca kontrate-shpenzim
18BN014	2022-12-21	80.000.000	2022-12-15	-6
1011982	2022-03-07	66.125.616	2022-02-25	-10
22AB901	2022-12-15	57.277.000	2022-12-13	-2
18AZ505	2022-12-30	28.440.000	2022-12-29	-1
20AD424	2022-12-30	23.726.916	2022-12-29	-1
18AY405	2022-10-06	20.010.000	2022-10-04	-2
18CF501	2022-07-26	19.000.000	2022-07-20	-6
1030148	2022-12-23	15.600.751	2022-12-15	-8
M064184	2022-04-11	13.448.581	2022-04-01	-10
1012411	2022-12-30	13.296.000	2022-12-27	-3
1600188	2022-05-19	12.507.598	2022-05-10	-9
18AZ313	2022-12-22	9.572.880	2022-12-20	-2
1230838	2022-05-20	9.024.000	2022-05-10	-10
18BN133	2022-03-17	6.495.561	2022-03-10	-7
19AC409	2022-12-23	5.982.000	2022-12-28	5
19AC411	2022-12-23	5.982.000	2022-12-28	5
1120133	2022-09-13	5.496.000	2022-09-06	-7
1680281	2022-05-05	5.069.611	2022-05-06	1
4990098	2022-09-14	4.434.600	2022-09-08	-6
1130365	2022-11-18	4.134.575	2022-11-18	0

18AK601	2022-08-15	4.077.960	2022-08-22	7
4990099	2022-12-06	3.739.200	2022-11-30	-6
1130188	2022-02-17	3.707.912	2022-02-17	0
18AX503	2022-06-14	3.403.020	2022-06-06	-8
1150205	2022-12-29	3.354.600	2022-12-27	-2
18AG003	2022-07-08	3.108.000	2022-06-29	-9
0470029	2022-02-17	2.621.021	2022-02-09	-8
1030149	2022-12-19	2.593.200	2022-12-12	-7
1150179	2022-10-24	2.520.000	2022-10-17	-7
18AK351	2022-10-25	2.490.000	2022-10-19	-6
4520133	2022-05-18	2.400.000	2022-05-09	-9
1012425	2022-12-30	2.397.000	2022-12-20	-10
1200132	2022-08-02	2.344.440	2022-07-27	-6
1130288	2022-02-21	2.071.745	2022-02-21	0
1200169	2022-12-21	2.032.162	2022-12-13	-8
1130255	2022-02-21	2.000.000	2022-02-21	0
18BB058	2022-07-13	2.000.000	2022-07-22	9
1330066	2022-06-08	1.938.072	2022-05-30	-9
18BC409	2022-12-12	1.852.889	2022-12-05	-7
18C1408	2022-12-29	1.633.800	2022-12-28	-1
1130292	2022-11-17	1.368.903	2022-11-18	1
18AD801	2022-04-21	1.239.936	2022-04-15	-6
1200162	2022-05-11	1.200.000	2022-05-05	-6
22AB701	2022-11-03	1.148.023	2022-11-08	5
18AT905	2022-06-14	1.139.330	2022-06-06	-8
M870009	2022-12-29	1.066.666	2022-12-28	-1
20AA104	2022-12-29	878.200	2022-12-20	-9
G042001	2022-12-29	658.480	2022-12-31	2
19AA001	2022-05-19	650.000	2022-05-16	-3
21AC401	2022-03-25	587.520	2022-03-18	-7
0470032	2022-08-10	571.200	2022-08-04	-6
20AB612	2022-10-25	555.600	2022-10-19	-6
91105AA	2022-02-24	500.000	2022-02-24	0
1570775	2022-10-06	410.000	2022-09-28	-8
18AO601	2022-06-24	347.400	2022-07-04	10
1470101	2022-12-30	300.000	2022-12-28	-2
18AP102	2022-12-19	264.661	2022-12-12	-7
M180120	2022-01-17	137.580	2022-01-24	7
19AH805	2022-02-22	120.000	2022-02-21	-1
M050694	2022-06-06	114.000	2022-06-13	7
M100013	2022-06-10	74.400	2022-06-03	-7
19AH806	2022-01-21	65.000	2022-01-21	0
1020186	2022-06-22	20.690	2022-06-30	8

Burimi: Të dhënat nga MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Tabela: Rishikime

ID rishikimi	Date krijimi	Shuma e rishikimit
6771432	7.02.2023	2.190.004
6774442	10.02.2023	375.511.463
6775439	13.02.2023	410.602
6780437	20.02.2023	7.000.000
6782434	22.02.2023	2.000.000
6782435	22.02.2023	12.220.000
6782436	22.02.2023	14.662
6782437	22.02.2023	725.338
6784432	24.02.2023	725.338
6785432	24.02.2023	12.220.000
6788445	28.02.2023	8.697.372
6793442	7.03.2023	129.200
6797437	13.03.2023	129.200

Burimi: Të dhënat nga MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Tabela: Kontratat e analizuara në total

Row Labels	Investime 230-231	Operative 602	Operative 603	Operative 604	Operative 606	Totali
Agjensia Grafike Shqiptare	1,000,000	2,718,995	-	-	-	3,718,995
Akademia e Shkencave	7,879,800	10,454,760	-	-	-	18,334,560
Autoriteti per te Drejtesise e Informimit	1,798,800	2,160,000	-	-	-	3,958,800
Avokati i Popullit	-	1,465,200	-	-	-	1,465,200
Drejtoria e Arkivit te Shtetit	59,971,182	41,883,079	-	-	-	101,854,261
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	15,494,161,087	-	-	-	-	15,494,161,087
Gjykata Kushtetuese	28,143,720	6,228,511	-	-	-	34,372,231
Inspektorati i Larte i Kontrollit dhe Deklarimit te Pasurive	22,742,400	5,032,538	-	-	-	27,774,938
Institucione te tjera Qeveritare	3,504,083,469	4,352,708,006	-	-	-	7,856,791,475
Instituti i Studimeve te Krimeve te Komunitetit	-	2,333,288	-	-	-	2,333,288
Instituti Statistikes	2,058,658	11,363,549	-	-	-	13,422,207
Keshilli i Larte Gjyqesor	447,723,017	340,291,666	-	-	-	788,014,683
Keshilli i Larte i Prokurorisë	7,834,600	7,921,790	-	-	-	15,756,390
Komisineri per Mbrojten e te Dhenave Personale	6,501,042	3,867,983	-	-	-	10,369,025
Komisineri per Mbrojten nga Diskriminimi	2,436,000	4,554,804	-	-	-	6,990,804
Komisioni i Prokurimit Publik	21,000,000	63,000	-	-	-	21,063,000
Komisioni i Sherbimit Civil	-	1,369,482	-	-	-	1,369,482
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	34,836,982	86,320,674	-	-	-	121,157,656
Kontrolli Larte i Shtetit	10,883,310	23,835,565	-	-	-	34,718,875
Kryeministria	-	16,655,419	-	-	-	16,655,419
Kuvendi	167,894,615	83,369,660	-	-	-	251,264,275
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise	4,379,346,818	1,066,516,300	-	-	5,309,363	5,451,172,481
Ministria e Brendshme	1,405,931,409	3,774,003,463	-	-	-	5,179,934,872
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	1,624,765,323	528,326,664	-	-	-	2,153,091,987
Ministria e Drejtesise	465,199,132	988,538,893	-	-	-	1,453,738,025
Ministria e Financave dhe Ekonomise	1,490,288,473	877,106,862	398,200	-	-	2,367,793,535
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	34,098,399,030	10,596,284,054	-	-	-	44,694,683,084
Ministria e Kultures	3,856,548,298	120,967,938	-	-	-	3,977,516,236
Ministria e Mbrojtes	10,363,091,425	2,129,071,085	-	208,068,304	-	12,700,230,814
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtes Sociale	1,086,958,132	9,501,626,896	-	-	10,915,034	10,599,500,062
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	256,153,763	178,880,544	-	-	-	435,034,307
Ministria per Evropën dhe Punët e Jashtme	-	123,277,600	-	-	-	123,277,600
Presidenca	-	2,726,400	-	-	-	2,726,400
Prokuroria e Pergjithshme	102,536,603	207,271,932	-	-	-	309,808,534
Sherbimi Informativ Kombtar	38,856,227	41,824,407	-	-	-	80,680,634
Shkolla e Magjistratures	5,675,040	753,960	-	-	-	6,429,000
Struktura e Posaqme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar	19,350,360	134,119,896	-	-	-	153,470,256
Njësitet e vetqeverisjes vendore	32,465,065,640	10,345,873,203	10,000,000	1,380,521,065	475,149,382	44,676,609,290
Veprimtaria e Mbiqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtesisë	77,457,461	13,944,168	-	-	-	91,401,629
Grand Total	111,556,571,815	45,635,712,233	10,398,200	1,588,589,369	491,373,779	159,282,645,396

Burimi: Të dhënat nga MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Tabela: Rakordimi i të ardhurave të raportuara nga bankat e nivelit të dytë 01.01-28.02.2022

Në lekë

Banka	Periudha 1 Janar - 28 Shkurt 2022			Diferenca
	Shkresa nr. 4688 Prot., datë 10.03.2022		Shkresa nr. 1128/1 Prot., datë 11.03.2022	
	MFE	Të ardhurat	BSH	
Banka K.	15,938,887,905.80	15,938,887,905.80	15,938,887,905.80	-
Banka R.	18,437,325,132.22	18,437,325,132.22	18,437,325,132.22	-
Banka I.	8,792,053,750.34	8,792,053,750.34	8,792,053,750.34	-
Banka P.	3,067,309,413.14	3,067,309,413.14	3,067,309,413.14	-
Banka A.	2,885,278,170.26	2,885,278,170.26	2,885,278,170.26	-
Banka T.	4,428,096,987.55	4,428,096,987.55	4,428,096,987.55	-
Banka B.	386,091,623.80	386,091,623.80	386,091,623.80	-
Banka A.	1,653,537,349.41	1,653,537,349.41	1,653,537,349.41	-
Banka C.	15,619,572,107.87	15,619,572,107.87	15,619,572,107.87	-
O. Bank	5,966,872,814.88	5,966,872,814.88	5,967,022,814.88	-150,000.00
Banka U.	2,600,170,267.33	2,600,170,267.33	2,600,170,267.33	-
Banka P.	1,005,891,825.80	1,005,891,825.80	1,005,891,825.80	-
TOTALI	80,781,087,348.40	80,781,087,348.40	80,781,237,348.40	-150,000.00

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Tabela: Përmbledhje e të ardhurave dhe shpenzimeve totale sipas MFE dhe BSH, 2022

Në mijë lekë

Periudha	MFE		DOM		Diferenca	
	Të ardhura totale	Shpenzime totale	Të ardhura totale	Shpenzime totale	Të ardhura totale	Shpenzime totale
01.01-31.01.2022	41,847,061.93	32,156,810.76	41,847,062.32	32,156,811.80	-	-
01.01-28.02.2022	80,175,224.41	53,270,173.40	80,175,224.08	53,272,373.35	-	-2,199.95
01.01-31.03.2022	126,163,146.55	81,280,935.02	126,163,147.43	81,283,135.92	-	-2,200.90
01.01-30.04.2022	173,605,185.04	112,178,400.37	173,605,185.56	112,180,600.03	-	-2,199.66
01.01-31.05.2022	217,705,436.85	143,100,887.77	217,705,437.91	143,103,087.06	-	-2,199.29
01.01-30.06.2022	262,497,927.90	178,472,123.54	262,497,928.83	178,474,323.28	-	-2,199.74
01.01-31.07.2022	308,382,533.81	209,372,949.50	308,382,534.76	209,375,149.35	-	-2,199.85
01.01-31.08.2022	356,831,895.80	245,580,551.33	356,831,896.42	245,582,751.19	-	-2,199.86
01.01-30.09.2022	403,593,978.51	275,930,403.77	403,593,979.93	275,932,603.16	-	-2,199.39
01.01-31.10.2022	447,780,399.66	312,432,550.77	447,780,400.27	312,434,750.90	-	-2,200.13
01.01-30.11.2022	488,932,101.20	340,778,791.90	488,932,101.93	340,780,992.00	-	-2,200.10
01.01-31.12.2022	537,981,152.84	414,988,602.57	537,981,153.33	414,990,802.20	-	-2,199.63

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Tabela: Paraqitja e gjendjes në fund të muajit për llogarinë “Depozitë Qeverie” në valutë për vitin 2022 nga MFE dhe BSH

Periudha	DSKPF në BSH				DPHF në MFE			
	Llogaria kryesore e qeverisë				Llogaria kryesore e qeverisë			
	ALL	EUR	USD	SDR	ALL	EUR	USD	SDR
31.01.2022	20,179,083,786.62	532,370,196.80	1,445,616.17	33,560,522.12	20,179,083,786.62	532,370,196.80	1,445,616.17	33,560,522.12
28.02.2022	17,914,705,003.87	523,130,599.72	66,288.45	16,085,588.12	17,914,705,000.87	523,130,599.72	66,288.45	16,085,588.12
31.03.2022	18,104,957,337.56	549,582,998.55	66,288.45	46,085,588.12	18,104,957,337.56	549,582,998.55	66,288.45	46,085,588.12

30.04.2022	19,390,190,829.09	438,341,799.94	3,067,064.26	44,123,088.12	19,390,190,829.09	438,341,799.94	3,067,064.26	44,123,088.12
31.05.2022	22,148,776,488.90	420,756,608.74	5,074,583.10	37,785,779.12	22,148,776,488.90	420,756,608.74	5,074,583.10	37,785,779.12
30.06.2022	10,370,040,361.94	470,382,353.99	3,301,516.57	35,823,279.12	10,370,040,361.94	470,382,353.99	3,301,516.57	35,823,279.12
31.07.2022	20,127,899,128.11	452,732,115.34	316,816.87	5,823,279.12	20,127,899,128.11	452,732,115.34	316,816.87	35,823,279.12
31.08.2022	23,815,396,077.33	397,050,399.23	1,323,336.87	17,974,868.12	23,815,396,077.33	397,050,399.23	1,323,336.87	17,974,868.12
30.09.2022	31,169,988,659.58	433,557,491.17	676,439.57	17,974,868.12	31,169,988,659.58	433,557,491.17	676,439.57	17,974,868.12
31.10.2022	27,013,561,048.33	397,580,586.60	769,083.04	16,012,368.12	27,013,561,048.33	397,580,586.60	769,083.04	16,012,368.12
30.11.2022	30,647,079,608.57	401,100,680.01	3,019,133.29	8,668,606.12	30,647,079,608.57	401,100,680.01	3,019,133.29	8,668,606.12
31.12.2022	16,456,827,100.04	277,015,124.47	2,034,121.22	6,706,106.12	16,456,827,100.04	277,015,124.47	2,034,121.22	6,706,106.12

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Tabela: Gjendja dhe lëvizjet e llogarisë “Depozitë Qeverie” në lekë dhe valutë, 2022

Në ALL				
Muaji	Gjendja në fillim	Të dala	Të hyra	Gjendja në fund
Janar	6,952,653,701.50	56,191,894,054.68	69,418,324,139.80	20,179,083,786.62
Shkurt	20,179,083,786.62	58,769,321,161.85	56,504,942,379.10	17,914,705,003.87
Mars	17,914,705,003.87	55,657,601,766.05	55,847,854,099.74	18,104,957,337.56
Prill	18,104,957,337.56	53,694,073,877.89	54,979,307,369.42	19,390,190,829.09
Maj	19,390,190,829.09	50,258,555,389.88	53,017,141,049.69	22,148,776,488.90
Qershor	22,148,776,488.90	64,910,122,934.16	53,131,386,807.20	10,370,040,361.94
Korrik	10,370,040,361.94	59,102,213,800.12	68,860,072,566.29	20,127,899,128.11
Gusht	20,127,899,128.11	59,551,493,459.95	63,238,990,409.17	23,815,396,077.33
Shtator	23,815,396,077.33	54,123,320,436.83	61,477,913,019.08	31,169,988,659.58
Tetor	31,169,988,659.58	56,399,907,123.96	52,243,479,512.71	27,013,561,048.33
Nëntor	27,013,561,048.33	51,361,273,539.50	54,994,792,099.74	30,647,079,608.57
Dhjetor	30,647,079,608.57	103,563,729,190.41	89,373,476,681.88	16,456,827,100.04
Në EUR				
Muaji	Gjendja në fillim	Të dala	Të hyra	Gjendja në fund
Janar	652,211,794.85	120,782,982.40	941,384.35	532,370,196.80
Shkurt	532,370,196.80	10,957,224.73	1,717,627.65	523,130,599.72
Mars	523,130,599.72	76,222,691.47	102,675,090.30	549,582,998.55
Prill	549,582,998.55	181,800,153.10	70,558,954.49	438,341,799.94
Maj	438,341,799.94	19,688,190.42	2,102,999.22	420,756,608.74
Qershor	420,756,608.74	50,197,263.42	99,823,008.67	470,382,353.99
Korrik	470,382,353.99	19,924,638.24	2,274,399.59	452,732,115.34
Gusht	452,732,115.34	83,154,883.43	27,473,167.32	397,050,399.23
Shtator	397,050,399.23	37,164,259.18	73,671,351.12	433,557,491.17
Tetor	433,557,491.17	53,589,456.16	17,612,551.59	397,580,586.60
Nëntor	397,580,586.60	48,846,412.41	52,366,505.82	401,100,680.01
Dhjetor	401,100,680.01	267,563,237.59	143,477,682.05	277,015,124.47
Në USD				
Muaji	Gjendja në fillim	Të dala	Të hyra	Gjendja në fund
Janar	214,579.79	172,373.62	1,403,410.00	1,445,616.17
Shkurt	1,445,616.17	2,452,265.22	1,072,937.50	66,288.45
Mars	66,288.45	-	-	66,288.45
Prill	66,288.45	-	3,000,775.81	3,067,064.26
Maj	3,067,064.26	1,142,384.76	3,149,903.60	5,074,583.10
Qershor	5,074,583.10	2,522,406.73	749,340.20	3,301,516.57
Korrik	3,301,516.57	2,984,700.45	0.75	316,816.87
Gusht	316,816.87	-	1,006,520.00	1,323,336.87
Shtator	1,323,336.87	2,115,373.19	1,468,475.89	676,439.57
Tetor	676,439.57	760,538.15	853,181.62	769,083.04
Nëntor	769,083.04	1,410,453.14	3,660,503.39	3,019,133.29
Dhjetor	3,019,133.29	32,260,231.64	31,275,219.57	2,034,121.22
Në SDR				
Muaji	Gjendja në fillim	Të dala	Të hyra	Gjendja në fund
Janar	33,560,522.12	-	-	33,560,522.12
Shkurt	33,560,522.12	17,474,934.00	-	16,085,588.12
Mars	16,085,588.12	-	30,000,000.00	46,085,588.12
Prill	46,085,588.12	1,962,500.00	-	44,123,088.12
Maj	44,123,088.12	6,337,309.00	-	37,785,779.12
Qershor	37,785,779.12	1,962,500.00	-	35,823,279.12
Korrik	35,823,279.12	-	-	35,823,279.12
Gusht	35,823,279.12	17,848,411.00	-	17,974,868.12
Shtator	17,974,868.12	-	-	17,974,868.12
Tetor	17,974,868.12	1,962,500.00	-	16,012,368.12
Nëntor	16,012,368.12	7,343,762.00	-	8,668,606.12
Dhjetor	8,668,606.12	1,962,500.00	-	6,706,106.12

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE.

Tabela: Zërat e të ardhurave, shpenzimeve dhe gjendjes së llogarisë “Depozitë e Qeverisë” Në mijë lekë

A+B	TË ARDHURAT, HYRJET E DEPOZITËS	Gjendja sipas MFE	Gjendja sipas BSH	Diferenca MFE - BSH
A (I+II+III)	TOTALI TË ARDHURAVE	122,370,671.58	536,459,776.46	-414,089,104.87
I	Të ardhura nga taksat	122,992,550.27	485,325,049.30	-362,332,499.03
1	Nga Tatimet	-	241,431,518.22	-241,431,518.22
2	Nga Doganat	-	243,893,531.09	-243,893,531.09
II	Të ardhura jo tatimore	-621,878.69	51,134,727.15	-51,756,605.84
1	Të ardhura jo tatimore sipas raportit të bankave	-	51,068,745.56	-51,068,745.56
2	Fitimi i derdhur nga Banka e Shqipërisë	-	-	-
3	Kontribute vullnetare	-	-	-
4	Dividendi nga ndërmarrjet e përbashkëta	-	-	-
5	Të ardhura nga koncesionet	8,194.12	-	8,194.12
6	Të ardhura nga shitja e licen. telekomunikacionit	-	-	-
7	Të ardhura nga AAPSK	-	-	-
8	Të ardhura nga sekuestrimi Prokuroria e Përgjithshme	-	-	-
9	Të ardhura të tjera	100,227.23	65,981.59	34,245.64
10	Transferuar në mjete në ruajtje për shpronësimet	-750,000.00	-	-750,000.00
11	Fitim - humbje rezultuar nga derdhja në Depozitat e Qeverisë - të fondeve të projekteve dhe Kthimi i fondeve të llog projektit Shtator 2022	64.82	-	64.82
12	E hyrë e pa përcaktuar, Disbusim Projekt me Financim (derdhje e përkohshme)	188,511.01	-	-

13	E dalë e pa përcaktuar, Disbursim Projekt me Financim (derdhje e përkohshme)	-168,875.88	-	-
III	Grant	-	-	-
B (I+II+III)	FINANCIMI, INVESTIMI, TRANSFERTA	139,972,045.73	95,478,875.36	44,493,170.37
I	Financimi i në total	49,231,224.90	7,927,179.83	41,304,045.07
1	Financimi i brendshëm	26,308,279.25	26,303,299.80	-
1.1	Nëpërmjet bonove të thesarit	32,357,937.34	32,357,937.34	-
1.2	Nëpërmjet Obligacioneve	-6,049,658.09	-6,054,637.53	4,979.45
2	Nënuaja	3,837,253.30	713,161.58	3,124,091.71
2.1	Principali	2,606,630.68	-	2,606,630.68
2.2	Interesa	1,230,622.62	-	1,230,622.62
3	Financimi i jashtëm	19,016,696.74	-19,098,809.64	38,115,506.38
3.1	Mbështetje buxhetore për Kontratën e Reformës Sektoriale BE për Përfshirjen Sociale	767,454.61	-	767,454.61
3.2	Mbështetje buxhetore Asistencë Sociale - kredi	905,045.00	-	905,045.00
3.3	Mbështetje Buxhetore Kredia EBRD	7,313,100.00	-	7,313,100.00
3.4	Mbështetje Buxhetore Kredia AFD	8,898,750.00	-	8,898,750.00
3.5	Mbështetje buxhetore për Kontratën e Reformës Sektoriale BE për Mirëqeverisjen	1,132,347.13	-	1,132,347.13
4	Projekte me thesar të plotë	59,467.53	-	59,467.53
5	Total interesa Depozita	9,528.08	-	9,528.08
6	Interesa të depozitës më afat	2,490.41	9,528.08	-7,037.67
7	Interesa nga depozita Garanci	7,037.67	-	7,037.67
II	Depozitë & Kredi	-500,000.00	-5,283,129.29	4,783,129.29
1	Depozitë për garanci	-500,000.00	-500,000.00	-
1.1	Maturim Depozitë	-	-10,500,000.00	10,500,000.00
1.2	Interesa depozite me afat	-	10,000,000.00	-10,000,000.00
2	Kredi	-	-4,783,129.29	4,783,129.29
III	Transferta e të ndryshme (1+2+3)	91,240,820.83	92,834,824.82	-1,594,003.98
1	Gjendja e mbartur nga viti 2021	91,240,820.83	91,240,820.83	-
2	Diferenca cash e accrual	-	1,559,045.56	-1,559,045.56
3	Transferta nga llogari të veçanta	-	34,958.43	-34,958.43
C (I+II+III)	SHPENZIMET, DALJE TË DEPOZITËS	208,472,518.82	578,068,453.32	-369,595,934.50
I	Shpenzime të Përgjithshme	118,364,176.28	534,104,978.54	-415,740,802.26
1	Shpenzime sipas bankave të nivelit të dytë	-	414,990,802.26	-414,990,802.26
2	Transferta për ISSH-në	100,877,173.00	100,877,173.00	-
3	Transferta për FSDKSH-në	15,630,000.00	15,630,000.00	-
4	Transferta për llogaritë e tjera speciale	1,857,003.28	2,607,003.28	-750,000.00
4.1	Transferta për kompensimin e pronave	1,857,003.28	-	1,857,003.28
4.2	Transfertë kapitale për Shpronësimet	-	-	-
II	Shpenzime për borxhin e brendshëm	24,193,044.17	24,188,064.72	4,979.45
1	Shpen. interesat e Bonove të Thesarit	-	3,566,256.63	-3,566,256.63
2	Shpenzime për interesat e Obligacioneve	-	20,621,808.09	-20,621,808.09
III	Shpenzime për borxhin e jashtëm	53,799,418.42	15,683,912.04	38,115,506.38
1	Interesa të borxhit të jashtëm	38,385,744.51	15,683,912.04	22,701,832.47
2	Principali i borxhit të jashtëm	14,751,435.35	-	14,751,435.35
3	Komisioni i borxhit të jashtëm	662,238.56	-	662,238.56
IV	Shpenzime Kapitale	5,752,695.03	5,752,695.03	-
1	Gabime, kthime nga bankat e nivelit të dytë	-1,661,197.01	-1,661,197.01	-
2	Transferim i shumës së kthyer nga Konvert. projekti Aech Societe General	-	-	-
3	Pagesë Ministria e Bujqësisë fondet IBRD	-	-	-
4	Pagesë komision Ministria e Bujqësisë fondet IBRD	-	-	-
5	Pagesë Ministria e Energjitikës në Euro	-	-	-
6	Transfertë për ISHP	1,836,333.39	-	1,836,333.39
7	Pagesë Ministria e Mbrojtjes në USD Nëntor 2022	3,262,979.37	-	3,262,979.37
8	Transferta Ministria e Arsimit	315,368.19	-	315,368.19
9	Pagesë Ministria e Mbrojtjes e Turizmit dhe Mjedisit	178,000.00	-	178,000.00
10	Komisioni i Transfertës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit	2.49	-	2.49
11	Huadhënie e KESH-it	7,907,221.00	-	7,907,221.00
12	Transfertë për Ukrainën (ndihmë) MEPJ	116,760.00	-	116,760.00
13	Komisioni i transfertës për Ukrainën (ndihmë) MEPJ	5.73	-	5.73
14	Transfertë për Fondin Kombëtar nga MEPJ	115,417.39	-	115,417.39
15	Pagesa interesi garancia sovra	2,199.70	-	2,199.70
16	Diferenca datë pagese datë regjistrimi në sistem pagesë e MEPJ Dhjetor	-456.16	-	-456.16
17	Diferenca kursi i këmbimit konvertim EUR USD transfertë Ministria e Mbrojtjes	40,292.92	-	-
18	Diferenca kursi i këmbimit konvertim SDR USD transfertë ISHP Shkurt	2,952.94	-	-
D	GJENDJA E LLOGARISË MË 31.12.2022	53,870,198.49	53,870,198.49	-
I	Gjendja në Lekë	16,456,827.10	16,456,827.10	-
II	Gjendja në valutë e konvertuar në lekë	37,413,371.39	37,413,371.39	-
1	Gjendja në Euro (EUR) 32,704,134.31	31,643,437.67	36,261,260.50	-4,617,822.84
	Interesa Spot Forward (për EUR)	580,074.17	-	-
	Fitim/humbje Konvertim projekti në EUR	3,545.49	-	-
	Fitim/humbje rezultuar nga derdhja në Depozitat e Qeverisë - të fondeve të projekteve dhe kthimi i fondeve të llog projektit	-50.40	-	-
	Fitim/humbje kthim shume derdhur nga BSH në një llogari tjetër projekti gabim	-30.85	-	-
	Diferenca kursi i këmbimit Blerje valute (konvertim nga ALL në EUR)/shitje valute (konvertim nga EUR në ALL)	66,000.00	-	-
	Rivlerësim i EUR Dhjetor 2022	3,968,284.43	-	-
2	Gjendja në dollarë amerikan (USD) 688,986.23	217,752.68	215,820.51	1,932.17
	Interesa Spot Forward (për USD)	-	-	-
	Fitim/humbje Konvertim projekti në USD	-2,295.55	-	-
	Diferenca kursi i datë pagese datë regjistrimi në sistem pagese në USD e datës 16.12.2022	53.59	-	-
	Rivlerësim i USD Dhjetor 2022	309.79	-	-
3	Gjendja në SDR 19,812,271.55	955,418.94	936,290.38	19,128.56
	Interesa Spot Forward (për SDR)	14,793.50	-	-
	Rivlerësim i SDR Dhjetor 2022	-33,922.06	-	-

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Tabela e konceptuar nga grupi i auditimit.

Tabela: Të dhëna mbi Urdhër-Shpenzimet për transfertat në valutë nga llogaria “Depozitë e Qeverisë”

Urdhër-Shpenzim									
Nr.	Datë	Kod Programi	Llog. Ek.	Nën Llogaria	Kod Projekti	Shuma (lekë)	Urdhërues	Përfitues	Objekti i Shpenzimit
81	02.03.2022	4760	231	0500	18BE902	178,000,000.00	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	EBRD Albania	Mbështetje financiare Projektit BERZH, viti 2022
105	13.04.2022	7450	605	1099	91305AH	198,072,200.33	Instituti i Shëndetit Publik	Banka e Shqipërisë	Transfertë për vaksinë Anti Covid 19
116	19.04.2022	7450	605	1099	91305AH	386,770,555.85	Instituti i Shëndetit Publik	Banka e Shqipërisë	Transfertë për vaksinë Anti Covid 19
23	08.02.2022	7450	605	1099	91305AI	114,117,632.50	Instituti i Shëndetit Publik	Banka e Shqipërisë	Transfertë për vaksinë gripi
151	12.05.2022	7450	605	1099	91305AA	131,809,602.50	Instituti i Shëndetit Publik	Banka e Shqipërisë	Transfertë për vaksinë kalendari
45	03.08.2022	01120	605	1099	91502AE	116,760,000.00	Përfaqësitë Diplomatike	State Treasury Service of Ukraine	Ndihmë për Qeverinë e Ukrainës
450	14.09.2022	09770	605	9100	91106AE	49,589,000.00	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	European Commission	Pagesë kuote vjetore 2021-2022 "Horizon Europa"
		09770	605	9100	91106AE	265,779,192.72	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	European Commission	Pagesë kuote vjetore 2021-2022 "Horizon Europa"
317	15.09.2022	7450	605	1099	91305AA	127,722,771.76	Instituti i Shëndetit Publik	Banka e Shqipërisë	Transfertë për vaksinë kalendari
391	31.10.2022	7450	605	1099	91305AH	877,840,626.58	Instituti i Shëndetit Publik	Banka e Shqipërisë	Transfertë për vaksinë Anti Covid 19
722	03.11.2022	02120	231	4320	M170424	129,388,864.08	Repartit Ushtarak nr. 1001	D..... United States of America	Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/shpenzime për likuidim LOA nr. Ref. AL-B-UBZ
796	12.12.2022	02120	231	4320	M170424	197,028,000.00	Repartit Ushtarak nr. 1001	D.... United States of America	Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/blerje e sistemeve të mortajave të çmontuara
934	12.12.2022	02150	602	1005	91703AA	834,085,200.00	Repartit Ushtarak nr. 4001	D..... United States of America	Pajisje, materiale dhe shërbime ushtarake
812	14.12.2022	02120	231	4320	M170424	646,080,000.00	Repartit Ushtarak nr. 1001	D..... United States of America	Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Blerje automjeti taktik të lehtë të përbanskët
		02120	231	4320	M170424	323,040,000.00	Repartit Ushtarak nr. 1001	D..... United States of America	Armatim i lehtë municion dhe makineri pajisje/Blerje pajisje të komunikimit taktik SOLTG
425	14.12.2022	02120	6025	5200	91702AE	144,254,804.16	Forca Ajrore (Rp. 3001)	L.... M... G...L.....	Materiale për mirëmbajtjen e objekteve specifike (Radar)
1049	27.12.2022	01110	231	0500	GM15008	115,417,394.16	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	EU Funds for IPA 2014 Programme/EUR	Transferim fondi në llogarinë bankare të Fondit Kombëtar pranë Bankës së Shqipërisë
470	22.12.2022	02120	231	4280	21AC101	989,102,500.00	Forca Ajrore (Rp. 3001)	Repartit Ushtarak nr. 3001 (Baykar Makina San. VE TIC.A.S)	Shpenzime për rritjen e AAM – Sistem dhe pajisje të teknologjisë dhe informacioni e komunikimit

Burimi: Të dhënat nga Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit, MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Tabela: Gjendja e llogarive speciale në EUR në 30.12.2022

Emërtimi i llogarisë	Monedha	Gjendja në 30.12.2022
Key People BP	EUR	156,936.70
Uji I pastër në Gjakovë dhe Kukës	EUR	0.05
Erasmus+ CBHE - AUT UBT	EUR	41,856.00
Ndihmë KFW zhvillimi i infrastrukturës	EUR	523.87
REACH-UART	EUR	268,088.60
TANGRAM	EUR	24,766.96
Projekti Kredi Mbështetja Zhvillim Biznesi Privat	EUR	4,036,171.10
Lidhja hekurudhore Durrës Prishtinë	EUR	979,900.00
Green Waters Adventure	EUR	12,868.26
VALEU X UK	EUR	26,565.00
Qev Greke / Projekt Infrastruktura Shqipëria e Jugut	EUR	71,894.36
FIRE PREP	EUR	20.00
Dual AFS Q.T.T.B Korçë	EUR	5,285.70
DIGI-ACBD	EUR	20,996.70
Active Tropoja Youth	EUR	38,770.56
Grant Komisioni Europian "Kurrikulat e Shkencës së Sportit në RSH"	EUR	0.01
Programi i Zhvillimit të Mjedisit	EUR	294,023.96
Projekti DILMA	EUR	0.30
PEEA	EUR	20,996.70
First STEP	EUR	34,837.20
i-THEA	EUR	4,978.58
Projekti i rrugëve dytësore dhe vendore - CEB	EUR	29.10
SMARTIMONY	EUR	6,582.56
New Opportunities in Kukës - NOK	EUR	108.24
Asistencë Teknike për zbatimin e programit Shqipëri-Mal I Zi 2008	EUR	44,218.97
ALPASEU	EUR	20,996.70
Asistencë Teknike për zbatimin e programit Shqipëri-Maqedoni 08	EUR	221.70
Natural and Cultural Network for the Prom. And Integr. Of Trans. Res.	EUR	1,482.71
ADRIFORT	EUR	26,841.76
ADRIACOLD	EUR	20,996.70
Adriatic Governance Operational Plan	EUR	625.46
Awareness of Illicit Financial Floës	EUR	24,496.70
Spredy Projekti i Përbashkët për vler. Mjedis. Me qev. Dinamike	EUR	15,034.92
TRANSPEARLYWARNING	EUR	25,813.17
A. Live art channel	EUR	21,415.16
Planifikimi i sektorit të ujit për negociatat me BE	EUR	369,587.48
EMOUNDERGROUNDS	EUR	612.60
Learn to Be Resilient - L2BR	EUR	17,296.50
Join EU SEE	EUR	1,038.00
Integ TeknoDijitMetodMësimdhënie	EUR	5,600.00
Future Medicine Spitali Obstetrik Gjinekologjik Koço Glozheni	EUR	58,138.12
Promot. Connect. Internet Broadband in Accursed Mount. Bord. Area	EUR	56.46
Fire Prep MTM	EUR	18,224.96
ProSEED	EUR	150,000.00
Europe Adriatic Sea Way (EA-SEAWAY)	EUR	8,149.23
MARED Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi	EUR	0.40
Skemat e Praktikës për punësimin e të rinjve në Shqipëri	EUR	1,326.41
Projekt-H2020-VISSEM	EUR	3,794.25
EPALE National Support Service	EUR	159,276.33
Mbështetje për Pagesën e Detyrimeve Offestimeve për MIE	EUR	12,437.57
Erasmus+ Library Network Support Service	EUR	10,748.38
Blue NET	EUR	3,656.39
Interreg Med "Compose"	EUR	10,191.85
Erasmus+ Gradua	EUR	23,183.81
Nat. Coord. For the Imp. Of the European Agend. For Adult Learn	EUR	26,508.32
AGROLABS	EUR	83,919.03
Zbatimi I Projektit PANORAMED 2017-2022	EUR	2,901.60
HELIX UD	EUR	20,913.39
Zbatimi I Projektit EUSAIR Facility Point 2017-2023	EUR	12,949.00
DIMTV	EUR	12,052.61
Less Waste 2	EUR	33,579.13
Complete UBT	EUR	10,010.09
INNOTOURCLUST	EUR	1,981.24
EnerNetMob	EUR	31,777.85
For Work - Fostering Opportunities for Refugee Workers	EUR	12,230.65
NETMETERING	EUR	79.61
BAS	EUR	64,204.45
BLU LAND AKZM	EUR	1,498.09
EXPLORAL BP	EUR	8,238.50
AIRTHINGS	EUR	92,223.14
Inter-Connect	EUR	15,005.82
SAGOV	EUR	4,589.33
3CASME	EUR	74,996.74
OLIVE CULTURE BB	EUR	2,448.23
BalkanROAD UBT	EUR	29,431.56
CIRCLE	EUR	6,407.47
EUSAIR 4 YOUTH BD	EUR	20,341.83
ADRINET UBT	EUR	50,640.53
BALKANET UBT	EUR	49,352.70
Bridging Tourism in Lezha and Gjakova	EUR	198,306.70
TOURNEE - Bashkia Fier	EUR	209,528.43
MONET MX	EUR	83,340.11
Resilienza marginale - il modello della circola economy	EUR	28,850.00
Preserving Cultural Landscape of Albania and Montenegro KQSH	EUR	0.10
NETMETERING B PUSTEC	EUR	66.74
NEST	EUR	63,616.42
LED B KORÇË	EUR	18,751.20
PHAREM KQVlorë	EUR	0.30
LED MIE	EUR	6,691.32
Sustainable University UV	EUR	28,865.90
INNOXENIA	EUR	4,300.13

3 WATCH OUT KQLezhë	EUR	1,436.32
WELCOME MTM	EUR	32,957.33
EFFECTS	EUR	22,642.55
3D IMP ACT IMK	EUR	31,175.24
HAMLET MK	EUR	188,280.98
Social Service Services in Mallakastra	EUR	91,442.10
3C4SME QKB	EUR	30,797.39
OPEN TOURISM BF	EUR	240.34
Promotion of Alternative Tourism ECO-ROUTES	EUR	249,810.70
POLYPHONIA	EUR	10,934.40
AKM-LASPEH	EUR	17.52
Il modello della circular economy-BV	EUR	58,960.00
POLYPHONIA B DROPULL	EUR	6,490.50
POLYPHONIA MK	EUR	5,839.13
ERASMUS+HarISA UBT	EUR	8,277.00
Monuments in Nature: A Creative Co-Existence Mo.Na	EUR	48,816.54
ISACC	EUR	19,534.61
TO BE READY - ALB	EUR	3,137.08
Food4Health	EUR	5,001.74
HERMES UPT	EUR	0.70
DUE MARI/358	EUR	36.04
SCOPE	EUR	7,685.79
ALTTOUR 5041899	EUR	10,670.90
TARGET	EUR	0.34
VjoSusDev	EUR	109,554.40
CROSS WATER	EUR	9,462.13
AuthentiKK BK	EUR	0.01
EUROPE FOR CITIZEN	EUR	21,404.00
G.A.M.E.S	EUR	0.96
Total		9,386,868.20

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Për sa më lart paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit